
# KRISTO FLOQI

Doktor i Drejtsisë, ish-kryetar i gjyqeve civile
e penale, prokuror i gjyqit t'Apelit, avokat etj.




# AUTOBIOGRAFIA IME

**Përgatiti për botim: Henrik Kaçulini**

# KRISTO FLOQI

Doktor i Drejtsisë, ish-kryetar i gjyqeve civile
e penale, prokuror i gjyqit t'Apelit, avokat etj.



# AUTOBIOGRAFIA IME

---

**Përgatiti për botim: Henrik Kaçulini**

*Përgatiti për botim:*

**HENRIK KAÇULINI**

© Ky libër është për pëdorim familjar.
Ndalohet ribotimi pa lejen e trashëgimtarëve
të Kristo Floqit.
Çdo libër duhet të ketë firmën origjinale
të Diana Kaçulinit (Floqi).

*Nr. 1*




*Foto e vitit 1917 në Shkodër.*
*Kristo Floqi, gruaja e tij Urania dhe djali i tyre William-Pirro, pagzuar në kishën mormone në Salt-Lake City (USA)*



*Kristo Floqi, foto e vitit 1936*
*Kristo Floqi, i pari djathtas, në shtëpinë*
*e Thanas Floqit në Elbasan, 1936.*



*Foto e Kristo Floqit, që ndodhet mbi varrin e tij.*



Emërim


Kristo Floqi.

Ministori i Drejtësisë u deklaron, që me vendim të 25 prill 1913 u emëruate Kryetar i Gjykatës, civile dhe së denimeve e këmbimeve Vlonese, dhe u fton, të nisni detyren nga dita e pasë 28 Prill 1913 dhe të punoni me të Drejtë pas ligjeve që ka prania shtetit shqipetar.

Vlonë 28 Prill 1913

Ministori Drejtësis

*Dekret i emërimit të Kristo Floqit si Kryetar Gjykate në Vlonë. AQSH. F.429.D.1.*



Nous Guillaume,

Prince d'Albanie

avons accordé à K r i s t o F l o q i , à Tirana, le 19 août 1921

l a c l a s s e d e c o m m a n d e u r

d e l' O r d r e d e l' A i g l e - N o i r

et lui donnons comme certificat de cette décoration cette lettre de créance munie de Notre signature personnelle et du sceau Princier.

Achenseehof, le 19 août 1921.

Wilhelm

*Dekret i dekorimit të Kristo Floqit nga Princi Wied.*

# Përmbledhje e biografisë së Kristo Floqit

Lindi më 24/5 Nëndor 1872 në lagjen “Mantho” të qytetit të Korçës.

Më 1899 fiton titullin “Doktor i Drejtësis” në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Athinës.

Më 1900 shkon në Stamboll për të perfeksionuar gjuhën juridike turke, që i duhej për profesionin e tij të avokatit. Aty viziton idhullin e tij Naim Frashërin, pak ditë përpara se të vdiste, gjithashtu takon edhe Sami Frashërin. Për këto takime arrestohet e burgoset për 19 ditë.

Më 1905 martohet me Uranija Poçi, motrën e Marigo Posio (Themeliu), “Nënën e Flamurit Kombëtar Shqiptar”.

Më 1911 ai caktohet nga shoqëria “Besa-Besën”drejtor i gazetës “Dielli” në Boston (USA). Ai organizon 326 konferenca në kolonitë shqiptare, duke u bërë Ciceroni shqiptar në Amerikë për formimin e Federatës Pan Shqiptare ku ai ishte inisiatori i themelimit të saj, në bashkëpunim me F. Konitzën dhe F. Nolin (Noli ka meritën që propozoi për Federatën emrin “Vatra” e që u miratua). Në shumë nga kto konferenca ai shoqërohej nga prifti patriot At Naum Cërri.


Më 1912 themelon në New-York gazetën “Zëri i Popullit”.

Më 1921 ftohet nga princ Wiedi në rezidencën e tij në Achen të Austris, ku, në gjuhën shqipe e dialektin shkodran e informon se po pregatit një forcë gjermane për vendosjen e rregullit në Shqipëri dhe marrjen e Fronit Mbretnor duke i propozuar postin e Ministrit të Pallatit, që pranohet nga K. Floqi. Wiedi i jep dekoratën e komandarit të Shkabës së zezë.

Më 1926 Mbreti i Italisë Viktor Emmanueli III e dekoron K. Floqin si Commendator me medaljen e “Koronës së Italisë”.

Më 1936 emërohet antar i Këshillit të Shtetit dhe mbas 1939 ai ishte Kryetar i tij, detyrë që e mbajti deri më 1943.

Në fund të vitit 1944 sekuestrohet nga Brigadat e Kuqe (ndoshta më 29 Nëndor në darkë) dhe mbahet në birucë (nuk dihet se ku) deri në fund të vitit 1950.



# Autobiografía ime.

I. Jam lindur në Korçë, në lagjen "Manthos", me 24/5 Nëntor 1872. Im atë Vasili, i biri i Kristos, ose Ristos Flogit kish lindur në fshatin historik "Flog", 3 orë larg Korçës nga lindje-perëndimi. Mëma ime Angeliku, ose Ngjeka, lindur në Korçë, ish e bij'e Spiro Kitkos, nga familja e dëgjuar e Kitkollinjve, dhe e bij'e Lenkës Çuçetkut.

Gjeneallogjia ime prindore, nga sa mbarj mënt prej plegve dhe më fort prej gjyshes s'ime, mëmës së babajt t'em dhe prej babajt t'em ka qënë kështu: Katragjyshi, ose prijsi i familjes s'onë quhej Thoma, ose Tôma. Ish një burrë shkurtalaq, topolak, kuqerëm, me pulpë-trashë dhe mustaqe-verdhë. Ishte trim, si m'a kanë rrëfyer, me gjithë kuptimin e fjalës. Për mjeshtëri kish dyfekgillëkun, ose kondakgllëkun, si e quhanin atë zanat atëhere. Ish nisharxhi i rallë dhe dallonte midis shokëve të tij për kitë virtute, pranë daj dhe ri shpejt në sy të Reverisë turke dhe u mor si dyfekgi me trogë çaushi në dëpon e armëve e të lëndës luftuese në qytetin e Manastirit (Bitolia). Për ca tro-

# AUTOBIOGRAFIA IME

## I.

Jam lindur në Korçë, në lagjen "Mantho”më 24/5 Nëndor 1872. Im atë, Vasili, i biri i Kristos ose Hristos Floqit kish lindur në fshatin historik “Floq” 3 orë lark Korçës nga lindje-perëndimi. Mëma ime Angelika, ose Ngjelika, lindur në Korçë, ish bij’ e Spiro Mitkos, nga familja e dëgjuar e Mitkollinjëve, dhe bij’e Lenkës Çuçukut.

Gjeneallogjia ime prindërore, nga sa mbaj mënt prej pleqëve dhe më fort prej gjyses s’ime, mëmës së babait t’em dhe prej babait t’em ka qenë kështu: Katragjyshi ose prijsi i familjes s’onë quhej Thoma ose Toma. Ish një burrë shkurtalaq, topolak, kuqërem, pulpë trashë dhe mustaqe-verdhë. Ishte trim, si ma kanë rrëfyer, me gjithë kuptimin e fjalës. Për mjeshtëri kish dyfekçillëkun, ose kondakçillëkun, si e quhanin atë zanat atëhere. Ish nishanxhi i rallë dhe dallonte midis shokëve të tij për këtë virtutë, prandaj dhe ra shpejt në sy të Qeverisë turke dhe u muar si dyfekçi me rrogë çaushi në depon e armëve e të lëndës luftnore në qytetin e Manastirit (Bitolia). Përveç rrogës së çaushit merrte edhe bakshishe mjaft prej oficerëve turq të cilëve iu sillej mirë e i shoqëronte shumë herë në gjah, se ish per njiment gjujtar me fe. Sa herë ndodhej në paganjanë e tyre vriste pa masë lepura, dhelpra, zarkadhe, kaperolle, mace t’egra, derra t’egër etj. etj. Oficerët turq, tuke e përkëdhelur e thërrisnin Tomë, ose Tomço dhe më vonë prej këtij gjithë rodi jonë u quajt “Tomço” ose “Tomçollë” ose “Tomçollarë”, sikur se është sot me këtë llagap quhen gjithë far’ e fisi jonë. Edhe shtëpia e jonë kështu quhej e titullohej, gjer sa im atë, për një arsye që do tregonj më poshtë, u qojt me mbiemrin “Floqi”, të cilin siellim edhe sot unë, im vëlla Thanas Floqi si dhe fëmijët t’onë.

Raca jonë ka origjinën e saj pikërisht prej Vithkuqit, katunt 4 orë lark Korçës nga jug-perëndimi, i cili katunt tjetër herë në vlugun e tij ka qenë një koxha qytet me 50. 000 e ca frymë, por u prish e u shemp prej kryengritjeve e invazioneve bashibozuke turko-tartare gjer sa s’mbeti sish përveç se disa gërmadha e shembëlltyra dhe sot figurojnë tre lagje, “Grekasi”, “Dukasi” edhe “Saraqi”. Stërgjyshi jem Toma ose Tomçoja ish prej lagjes të Saraqit.

Nuk di më gjatë për këtë kryeprindin t’onë, po di këtë vetëm se ky la tre djelm, Dhamin, Naqin dhe Tasin. Për Dhamin tregojnë se e punoj disa kohë mjeshtrin e t’et tuke qënë bashkë me këtë në Monastir, por më vonë ky u kthye në Vithkuq e u muar më fort me bujqësi dhe me bagëtitë e gjënë e gjall’ të tija, sa, si më tregonte ime gjyshe, e ëm e babajt, harrin të ketë 5 stane të mbëdhenj dhe 20 e ca qëna stani dhe u bë mjaft i begatshëm.

Si u çkatërrua e u prish krejt Vithkuqi shumë familje shkuan e u installuan në Monastir, në Megarovë e gjetkë si dhe në Ohri që aso kohe ishte Vilajet më vehte. Disa Vithkuqarë të tjerë u shpërngulë në Rumani e në Austri dhe disa në Bukovinë e në Besarabi.

Djali tjetër i Tomços, mbassi qëndroj në Monastir atje lindi disa fëmijë e vdiq. Kur isha Prokuror në Korçë më 1914 takoj të njoh një zonjushë mësuese nga Monastiri që sillte mbiemrin “Tomço” të greqizuar në mbiemrin “Thomaidhou”. Pyeta mirë origjinën e saj dhe duallm kushërinj të larkmë prej një fisi. Ajo ishte një nga stërmbesat, ose të paslindurve, që zbrisnin nga Naqi i Tomços. Dhe sot shumë kushrinj t’onë rrojnë në qarkun e Monastirit dhe në Kosovë me këtë mbiembrin, që derivojnë gjithë prej katragjyshit tonë Tomços.

Dhami dhe Tasi, përveç Naqit, mbetnë në Vithkuq megjithë që e hupnë gati gjithë pasuninë e tyre, por mbas disa vjetësh u hodhë në katundin e ri “Floq” që ish aso kohe në formim e sipër, si ish edhe Korça, e cila numuronte disa kasolle bujqsh e mjeshtrash kthisevet.

Katundi “Floq” gjindet nga an’ e djathtë e malit të Qarit, kur vijmë nga Kolonja në Korçë, dhe storaset[1] pothua në rëzën e Qarit mbi një pëqi tërmali[2] të bukur e pitoresk. Sot ka një pamje romantike amfitheatri dhe mund të thom se është nga më të bukrit e më të pasurit katunde të qarkut të Korçës. Këtu zunë vënt Dhami e Tasi e fëmij’ e tyre.

Shtëpia e këtyre dy vëllezërve në Floq nuk vonoj të marrë titullin e aristokracisë, si me thënë, të Floqit, dhe njihej si “oxhaku më i vjetër e më fisnik i Floqit”[3]. Këtu hynin e delnin e hanin e pinin njerës e njerës gjithfarë klasit, të krishterë, myslimanë e të huaj. Priteshin e përcilleshin me shtektinë më fisnike që munt të bëhej. Shtëpia rinte me dyert hapur dit’e natë si me qenë monastir, ose teqe. Myslimanë e të krishterë jetonin kaqe bukur e armonisht me shoqi-shoqin sa kujtonje se aty kish ngrehur çerdhen Lumëria vetë.

Ime gjyshe, që ish një nga më të mirat antika që arriva, e cila rrojti edhe një jetë kathusaljane se ish 92 vjeç kur m’i tregonte këto, me mëndjen në vënt, me synë të kjartë, si kandili në mes të natës, dhe me një memorie për ta patur lakmi, më molloiste se kaqe zengjinë u bënë të dy këta vëllezër në Floq – po ishin edhe zembërbardhë e të dashur – sa mbassi nuk ish e mundur ta binin posht në xhaden’ e fushës gjith’ atë alamet qumësht që mblidhej prej staneve të tyre në fshat që ish destinuar për myshterinjt e bashdarët e tjerë të huaj për të bërë djathë e bulmeto të tjera sa Dhami ose Xhakodhamua si e quanin, si i pari ose plaku i familjes kishte goditur qyngje që prej Floqit dhe gjer në funt të fshatit ku gjindej një prrua i vogël, e ku kishin ksollet e tyre e kishin kondisur blerësit. Dhe kështu qumështi, në vënt të mbartej, derdhej si rëke nëpër qyngjet artificial gjer sa përmblidhej në një depo, ose sterne të madhe të gurtë ku ju dorëzohej myshterinjve. Vëndi i këtyre qyngjeve shihet edhe sot në Floq dhe diku, diku tfaqet edhe nga ndo një copë qeramidhe qyngji që të munt të dëshmojë fjalët e mija.

Familjet e këtyre dy vëllezërve u shtuan mjaft, dhe sa do që me burra e gra e fëmijë arrinin numurin rrumullak të 30 shpirtve jetonin kurdoherë bashkë e të pandarë, një jeta abramike , jetë patriarchale ku sundonte pas zakonit prehistorik një vetëm pater familiae, Xhako Dhami, ky ish plak, baba, gjysh, protektor, gjysëm Perëndi për atë familje shumë-mirëse dhe vetëm kur mungonte ky e zëvëndësonte i vëllaj Xhako Tassi, i cili, në presencë të Xhako Dhamit ishte një shtetas i bindur i familjes dhe po kishte një votë të vetëm, sikurse të tjerët djelm e nipa në moshë përveç gravet e çupave të cilat zakonisht nuk kishin as vafe as zë akoma përpara Xhakodhamit përposë plakës së Xhakodhamit dhe nuses së Xhakotassit të cilat në hierarhinë shtëpijake zinin vëndin e Dhamit e të Tasit sa për urdhërat që jepnin e rregullave që mbanin përpara nuseve të djemve e të vajzave të pamartuara.

Xhako Dhami kishte katër djelm e dy goca dhe Xhako-Tasja 3 djelm e 4 çupa. Të gjithë djelmt’ e këtyre, si më tregonte ime gjyshe, u martuan dhe bënë se cili nga një karvan fëmijë gjer sa më një kohë numri i përgjithshëm arrin te 70.

Një prej djemve të Xhako Dhamit ishte dhe i qojturi Thoma, i cili u martua në katundin Lubonjë dhe pati dy djelm dhe 2 a 3 çupa. Prej djemt i pari quhej Stylian ose Styllo, dhe i dyti Naum. Thomaj i Xhako Dhamit ish tepër shakaxhi, po edhe trim. Ish edhe vjershëtar, si thonë e këngëtar i prapë. Vjershonte me një lehtësi të madhe dhe vjersha të bukura e këngë e bejte (satyra) të çuditshme të cilat përveç që kishin një shpirt poetik të thellë, një lyrismë të jashtzakonshme, po kishin një domethënie e kuptim të mjaftë prandaj çquhej në zë jo vetëm midis Floqarëve, po edhe në shumë katunde të tjera të rëzave të maleve e fushës së Korçës, edhe në Kolonjë akoma e në Opar, ku Tomçua kishte mjaft të njohur. Përveç këtyre Thoma ose Tomçoja loste edhe valle gjithfarësh e kërcente shumë bukur, sa të gjithë e kishin zili; po ishte edhe shume zembër-bardhë, mirëbërës dhe mëshirmath për të vobektët, kaqë sa filloj dal nga dalë të shpëndajë andej këtej edhe pasuninë e t’et si një tjetër Shën-Francesco i Azizit.

[1] storaset = ndodhet, është vendosur (shpjegimi i këtij termi është bërë nga Henrik Kaçulini që më pas do shenohet vetëm me germat H. K.)

[2] Tërmal = anë mali (shpjegimi i këtij termi është bërë nga Kristo. Floqi, që më pas do shenohet vetëm K. F.)

[3] Ky është shpjegimi i ndryshimit të mbiemrit nga “Tomço” në “Floqi” (H. K.)

Kur e vuri re i ati Xhakodhami se po ja shpërndante pronësinë me të djatht' e me të mëngjër pa një mëshirë, e thiri një ditë përpara tij dhe i bëri vërejtje të hidhura e e qortoi mjaft dhe e shtërngoi të largohet nga Floqi e të marrë kurbetin, që të mos e kish havale, si kundër thoshte, e të mos t'a nxirrte shpejt-shpejt me "opinga të kuqe"d. m. th. myftys.

Tomçoja, i pikëlluar tepër prej qortimeve që i bëri i ati qau si një çilimi dhe pa ç'pa u largua në Janinë, tuke lënë në fshat gruan e fëmijën e tija në kujdesjen e t'et, i cili aqe kokëfortë ish, sa nuk zbriti as t'a përcjellë të birin gjer në bisht të fshatit. Këto m'i tregonte një nga një i ndyeri im atë, sikur se i kishte dëgjuar prej pleqvet.

Tomçoja zuri një dyqan të vogël në lagjen "Kalluçezme" në Janinë, dhe filloj të punoj zanatin stërgjyshor, kondakçillëkun. Ndreqte atje kobure e dyfegje me çargje e armë të tjera, derthte pallaska të argjëndta dhe harbirra dhe me pak fjalë shkonte mirë.

Shakatë, vallet e vjershat e tij nuk i la as në Janinë, me gjithë vrerin e pikëllimin e zembrës që ndjente nga përbuzja që i bëri i jati. Po këto shaka e këngët e valet nuk mënuan të venë edhe në vesh të satrapit të math t'athershëm të Janinës, Ali pashajt Tepelenës. Një ditë Ali pasha dërgoj e e thirri në ishullin e Janinës ku kish pallatin e tij dhe si e pa e foli me të u çudit me shtatin e tij të bukur e i pëlqeu shumë muhabeti i ëmbël i Tomços e sjelljet e humorizmi i tij. Prandaj edhe Ali Pasha e këshilloj të lerë punën e të vijë pranë tij gjë që e pranoi menjëherë Tomçoja dhe shiti ose shpërndau andej-këtej pasuni, vegla etj. që kish, bëri një palë fustanella, ante të arta dhe tirqe etj. dhe ju paraqit një ditë satrapit ose Vezirit, siç i thoshin, të Janinës, i lar e i nderuar, i hollë e i gjatë e i hiejëshëm e mustaqe-verdhë si ish. Pashaj i Janinës e priti mirë dhe s'e ndante nga tryeza. Kur e pa se ishte edhe trim i fali edhe armë të bukura e një jatagan me myll[1] të argjendtë.

Në pallat u njoh edhe me djelmt e Ali Pashës, Muhtarin e Velinë, me trimin e pandarë të Vezirit Tahir Agën dhe me disa kapitanë Grekë, që mbante me vehte Ali pasha me të cilët ndodhej në një miqësi të ngushtë.

Më tregonte im' atë, që, kur vuri ndërmënt Ali Pasha të bënte një Shqipëri të madhe dhe një Greqi nga ana tjetër për t'i bërë ballë Perandorisë së madhe Ottomane, dhe mbassi ra d'akord edhe me pashanë e Beratit Omer Vrijonin, Tomçua ishte ajy besniku i Ali pashës që u dërgua për këtë qëllim në Shkodër, te Veziri Shkodran Kara-Mahmud Pasha. Qy qëllim i naltë, sa do që kish lidhje edhe me kryengritjen e Grekëve më 1821 s'dihet sepse dha falimenton sa për anën e Shqiptarëve.

Në pallat të Ali pashës Tomçoja kaloj një jetë të gjattë e të lumur. Veziri i Janinës, tue i çmuar burrninë e karakterin e naltë, nuk e përdori kurrë për qëllime satanike, sikurse përdori Thanas Vajën, atë gjakpirësin e fëlliqur, xhelatin Jusuf Arapin dhe katilin e keq Tahir agën. Përkundrazi ne Tomçua ushqente ndjenjat më të mira, e kishte shumë kujdes dhe e donte mjaft. Shume herë i vinte dhe këndonin bashkë me një tjetër këngëtar e vjershëtar Korçar, me Muçon e famshëm. Kur piqeshin këta bejtexhinj si i quante Ali Pasha, të dy, gëzimi dhe dëfrimi i Vezirit arrinin kulmin. Po midis Muços e Tomços ishte një ndryshim i math karakteresh, sepse Muçua ishte edhe ashik mbas qira-Vasiliqisë, që kish të dashur Aliu, dhe ky ishte shkak që e burgosi Muçon Ali pasha e dha urdhër ta vrasin, por e shpëtoi i bir' i Vezirit, Veliu, kurse Tomçoja ishte karakter i naltë e fisnik e kurrë nuk i dha shkak Pashajt që ta marrë me sy të keq.

Dikur Napoleon Bonaparti i kërkoj Ali Pashës një nga më besnikët e më të hijëshme nga shteti prej Shqipëtarëve të tij që ta kishte me vehte për kujtim të dashurisë e miqësisë që kishte me Pashajn e Janinës. Tepelenliu, sado që i vinte keq t'a ndante nga gjiri që aq shumë e desh, po mbassi s'kish më të mirë e më të hijëshmë burrë se Tomçon (ish ahere Tomçua 28 vjetsh) u shtërngua e ia dërgoi Tomçon Bonapartit, i cili u çudit kur e pa dhe i bëri përshtypje bukuria e tij burrnore. Si u stërvit mjaft në Paris dhe msoj edhe frëngjishten, u njojt me shumë

[1] myll = kllef shpate (H. K.)

xhenerallë e oficerë të famshëm të ushtërisë me nam Napoleontine, si kur se Davustin, Myrat, Bernadotin, etj, etj. dhe mori pjesë në disa luftra të mbëdha si në atë të Austerlitzit e gjetkë. Babaj më tregonte, se, si dëftënte gjyshi i tij Styllua, i ishin gjetur disa shkresa përsipër kur vdiq, të cilat dëshmonin mbi këto ndodhina që po bënj fjalë. Tomçua vdiq në Korfus, që aso kohë e sundonte Napoleoni.

Napoleon i kish dhënë edhe nishanin e "Legjionit të Nderit"(Legion D'honeur) dhe e kish dërguar në Korfus me disa oficerë të tjerë frengje. Atje Tomçoja njohti edhe Marko Boçarin, Foto Xhovallën, e disa Sulote e palikarë të tjerë. Kam dëgjuar se Buonaparti i kishte falur një pelë të bukur nga të tijat, sepse Tomçua ish edhe hippës i mirë.

Më kot plaku, i ati, i penduar tani, e kërkoj djalin e tij të kthehet në Floq. Tomçua nuk u bind kurrsesi, sa edhe kur vdiq Xhako Dhami në një moshë 90 vjeçare as ahere s'u kthye Tomçua dhe kështu Xhako Dhami ka vdekur tepër i pikëlluar!

U zgjata pak mbi historin' e këtij fatosi, të Tomços, se me të vërtetë, si më tregonte im' atë dhe disa pleq të motshëm të tjerë Floqarë, Tomçua ka qenë ajo më e mira e më e çkëlqyera gjymtyrë e trungut të familjes s'onë.

Të bijt e Tomços Styllua e Naumi u bënë shumë të mbarë e të prokapsur. Mbassi vdiqnë pleqtë Xhako Dhami e Tasja këta e muar përsipër shtëpinë dhe më fort Styllua, si më i math, ky ishte plaku i shtëpisë. Kushërijt e tij muar kurbetin pothuaj që të gjithë.

Që të dy këta, si Styllua, si Naumi u martuan sa ishte gjallë akoma Xhakodhami. Nuk zgjatem për djelmt e tjerë të Xhakodhamit si dhe për XhakoTasjen e djelmt' e tij se as që mbaj ment mirë, as që u interesova shumë të pyes pleqtë, babanë e gjyshen time.

Styliani apo Styllua u martua në Leshnjë dhe Naumi në Bellovodë. Prej këtyre Styllua lindi 4 djelm Kriston ose Riston (i cili ishte im gjysh, i ati i tim eti), Filipin, Harrin e Markon edhe dy çupa Linën dhe Annën dhe Naumi lindi dhe ajy tre djelm e dy çupa Janaqin ose Naqin, Tasen dhe Ndrion dhe çupat Ristën dhe Nonkën.

Im gjysh Ristua, i cili u martua me t'ime gjyshe Kostandinon prej fisit të Didakëve në Korçë lindi dy djem Jakovin ose Kovin dhe babanë tem Vasilin, edhe tri çupa, Ngjelon e cila u martua në Bulgarec, Ndrinon e cila u martua në Vithkuq dhe Zoitsën e cila u martua në Dardhë.

Si vdiq Styllua dhe pas tij Naumi, im gjysh Ristua ishte kryetari i gjithasaj familje që përbëhej prej 44 e sa shpirtsh. Prej djelmve të Naumit, Naqi, të cilin e arriva gjallë edhe unë e e njoha në një pleqëri të thellë 74 e sa vjetsh, s'ish i zoti për shtëpi, prandaj, si kryetar njihte familja e jonë Riston, i cili sado i ri, po ishte më i zgjuari edhe më i zoti nga të gjithë.

Naqi la 4 djelm, Mihalin, Kosmanë, Thimin dhe Viskën dhe dy çupa Tasja dhe Ndriua, që vdiqnë të rinj, i pari la dy djelm e një çupë dhe Ndriua la dy djelm Kotin, Gurrin dhe një çupë, Majën.

Prej vëllezërve të t'im gjyshi Filipi la dy djelm Spiron e Nisin dhe një çupë Margën. Harri la një djalë Pandon dhe një çupë Linën dhe Markua la një djalë Thiminë dhe dy çupa Evgjeninë edhe Cilen

Sado që Styllua e Naumi ishin të pasur prapë se prapë e dijnin edhe zejen katragjyshore kondakçillëkun dhe në këtë zanat i kishin stërvitur edhe fëmijën e tyre edhe më fort Riston t'em gjysh dhe Ndrion dhe Tasen. Vegla e orendi gjithfarësh kondakçillëku gjindeshin kurdoherë në një dhomë të veçantë të shtëpisë së tyre. Ky zanat ishte adoptuar si "zeje familjare" e trashëguar bres pas brezi. Këtë zanat ja msoj më vonë edhe gjyshi im të bijve të tij Kovit dhe t'im eti Vasilit sidhe Harri birit të tij Pandos ashtu edhe Markua, përveç Filipi, i cili njërit djalë Spiros ja msoi zanatin, po djali tjetër Nisi ose Nisi i Vitos (nga embri i t'ëmës) si i theshin, u bë tregëtar. Ky zanat ekziston edhe sot në shumë kushërinj t'onë që derivojnë prej trungut të "Tomços" përveç në familjen t'onë dhe atë të Nisit Tomços, të cilit dy djelmtë Angjelin e Thomaj , u bënë dy nga më të mirët e më të zotët tregëtarë të Korçës.

Si u vra Ali Pasha në Janinë dhe si mori funt kryengritja Greke kundra Turqisë me fitimin e Grekëve dhe u njoht për të parën herë "Mbretëria Hellenike", nënë mprojtjen e të tri fuqive protektore Anglisë, Francës edhe Russisë disa urdi turke, tuke u kthyer të shkatërruara prej luftës Greko-turke u vrulë si grigjë të egra në Toskëri e prishnë shumë fshatra e grabitnë e doqnë shumë shtëpija. Midis atyre nuk shpëtoi dhe fshati jonë Floqi. Bashibozukët mbasi plaçkitnë ç'muntnë më në funt doqnë edhe shtëpinë t'onë që ishte në krye të fshatit! Kjo katastrofë i kushtoi shumë gjyshëve t'onë, të cilët u shpërngulë me gjithsej në Korçë. Këjo i shtërngoi pleqtë të lenë familjet në Korçë e të marrin të gjithë kurbetin. Kështu Ristua, im gjysh, Filipi dhe Harri lanë vëllanë e tyre të vogël Markon me familjen shumëmisëse[1] dhe ata vetë shkuan në Greqi e zunë vënt në qytetin e Vonitzës ngrehur mbi bregun e djathtë të gjirit Ambraqik.

Në Vonicë zunë një copë dyqan e filluan që të tre vëllezërit zanatin shpëtimtar të pleqve, kondakçillëkun. Si shkoj ca kohë dhe puna po vinte mbarë im gjyshi le të dy të tjerët në Vonicë dhe hap një dyqan tjetër në Ajo-Mavrë, ose Levkadhën e sotme. Si më thesh i ndyeri im atë, im gjysh kurdoherë e përsëritte një fjalë të urtë që kishte trashëguar nga i ati Styllua, ahere kur ajy e mësonte në Floq veçanërisht zanatin, ndonse ishin mjaft të pasur e s'kishin asnjë nevojë me pasuninë e madhe që kishin. Kjo fjal' e urtë, kjo gnomike ishte kështu: "Mso zanat, pa në daç lëre, kur të gjen urria zëre", fjalë këto mjaft të holla e filosofike që im gjysh s'i harronte kurrë. Edhe kish të drejtë, se kur ju shkrepi poter' e madhe do kishin humbur krejt sikur të mos dijinin edhe zanatin! Këtë e provuan fare mirë kur vanë në Vonitsë. Këto fjalë s'i harronte as i gjori im' atë edhe gjithnjë m'i përsëritte ndonse unë isha i vogël ahere e s'merrja vesh rëndësinë e fjalëvet. Po e pashë edhe vetë me sy tim atë se edhe ajy u bë një tregëtar i mirë qeresteje e qymyri me kaqe sharra e mushka, po ardhi dita që me një katastrofë që e gjet i humbi të gjitha edhe zuri prapë zanatin e parë, të cilin filloj të ma msonjë dhe mua tuke më këshilluar me proverbin e sipërmë.

Mjerisht im gjysh u sëmur keq në Levkadhë pas ca kohësh dhe mbassi lëngoj mjaft, mbaroj më në funt lark shtëpisë dhe fëmijës së tij. Ime gjyshe mbeti me një herë e shkretë me pesë fëmijë , prej të cilëve, Kovi dhe im' atë Vasili ishin më të vegjlit, i pari 16 vjetsh e im' atë vetëm 12 vjetsh.

Si vdiq im gjysh, vëllezërit e tjerë Filipi, Harri e Markua u ndanë me një herë si kush më vehte dhe të ngratën t'ime gjyshe e lanë të mjerë veçan në mëshirën e Perëndisë me një karvan fëqmijë! Më këputte shpirtin e gjora plakë kur m'i radhitte një nga një mjerimet që i ngjanë nga vdekja e papritur e t'im gjyshi. Të kunetërt e të kunatat nuk e shihnin me sy, përveç së motrës t'im gjyshi, Linës, e cila ish martuar në Vithkuq me Ndrio Turtullin ; veç ajo e shëkonte dhe dikur edhe e motra tjetër e t'im gjyshi Anneja që ish martuar me Thanas Babën , ose Stratin në Voskopojë. Të kqijat që hoq ime gjyshe , pa një plank, pa një shtrofkë, pa një mshtetje s'kanë të rëfyer.

Në mes të kësaj agonije, djali i saj më i math Kovi, që ish ahere 17 vjetsh dhe punonte me rrogë te i ungji Markua për një bukë gojet nuk duroj t'a shohë shtëpinë e tij në atë gjëndje aq të mnerishme. Niset me një herë e vjen në Levkadhë gjen disa hallate të t'et e filloj me një herë nga puna . Në pak vjet mundi ajy vetë të martonjë dy nga motrat e tij Ndinon dhe Zoicën e të shpëtonjë shtëpinë e nderin e familjes. Mori më vonë edhe t'em atë në Levkadhë edhe kështu një jetë e re e e lumur filloj edhe një herë për familjen t'onë. Nuk vonoj të blerë edhe një shtëpi në Korçë, ku mblodhi t'ëmën, ku u martua dhe ku priti pas ca kohë edhe motrën e tij të martuar Ndinon, e cila shumë shpejt mbet e ve në Vithkuq e u kthye në shtëpi t'onë. Në atë shtëpi jam lindur edhe unë e vëllezërit e mij

Po kjo lumëri që kish aguar për shtëpinë t'onë nuk ish e thënë të duronte shumë kohë. Im ungj Kovi kur kthehej një herë prej të shtunave nga Korça për në Lefkadhë, udhës , midis

[1] mis = anëtar, pra shumëmisëse d. m. th. me shumë antarë (H. K.)

Kolonjës e Leskovikut, e zuri një dimbër i math e gjer sa harrin ne Lefkadhë mer një të ftohtë të mirë, e cila iu çfaq si pneumonia që nuk vonoj të marrë formën e tuberkulozit. Lëngoj i shkreti 6 muaj dhe më në funt dha shpirt në krahërorin e t'im eti në një moshë vlugare[1] 26 vjetsh tuke i lënë t'im eti amanet shtëpinë dhe nderin e familjes!

E mjera ime gjyshe , kur dëgjoj mëndatën e zezë gati mënt luajti mentsh! Nga që s'duronte një nate piu edhe helmin, po e shpëtuan të bijat. Kaqe e pikëlloj ky djalë sa e qau e e vajtoj akoma edhe gjer sa vdiq, murga[2]! Në zin' e poteren e madhe që kishte thiri shpejt t'im atë, i cili për hatër të saj e prishi punën që kish në …jo-Mavrë dhe ardhi pranë s'ëmës në Korçë. Kështu im' atë qëndroj e zuri vënt në Korçë, ku hapi një dyqan të vogël dhe ia filloj zanatit prindor . Ish ahere im atë 23 vjetsh. Ardhja e tij në Korçë e ngushëllojte për të gjorën plakë dhe sa do që ju largua nga shtëpia edhe e shoq' e Kovit se s'kish fëmijë, ime gjyshe rronte vetëm me t'ëm atë e me bijën e saj të kthyer, Ndinon.

Si shkuan ca kohë, gjyshja deshte tani t'a martonte t'im atë. Nuse i vinin mjaft, se edhe punën e kishte të shtruar në Korçë edhe i ri 25 vjetsh ishte. Po ime gjyshe , si tjetër herë Isaaku , deshte për birin e saj të vetëm një nuse fisnike , prej oxhaku, pa le t' ishe edhe "e rënë" si theshnin ahere "nga dynjallëku".

Një nuse e këtillë nuk vonoj të çfaqej. Spiro Mitkua prej familjes historike të Mitkollarëve, familjes më të vjetër e aristokratike të Korçës, kishte 4 djelm, Ligorin, Mihalin, Mitkon edhe Kriston edhe një çupë të vetëm t'ëm ëmë Ngjelinën, ose Vangjelinën. Kjo ishte e destinuar si nuse për t'em atë. Hyn mbleskë tetua ime Ndinua dhe kështu vlohet im' atë me Ngjelinën e Mitkos, edhe martohen më 1869.

Me t'em ëmë, im' atë pati katër djelm, Dhimitrin të parin, i dyti isha unë, i treti Nikollaqi, i katërti Thanasi dhe një çupë Katerina. Prej këtyre Dhimitri rrojti vetëm mot-mot, Nikollaqi 6 muaj, Katerina një javë dhe unë e Thanasi që jemi gjallë edhe sot, qëndruam në jetë. Im vëlla Thanasi gjëndet sot në Elbasan, ku exerson profesionin e avokatit, është martuar atje dhe ka dhe 3 vajza e dy djelm, gjithë të mbarë. Thanasi është më i vogli nga gjithë ne, dhe 12 vjet m'i vogël se mua.

Gjer sa u lint Thanasi, unë quhesha "djalë i vetëm". Mëma ime kish 10-11 vjet që kish pushuar së pjelli dhe as njeri s'munt të mendonte se do lindtte tjetër fëmijë. Po mrekullia u bë dhe kështu një natë dimbri, më 14 Janarit 1884, ditën e shtunë e ora 20 të natës, në mes të një të ftohtë të madhe e një thellimi leu im vëlla Thanasi, i cili mori këtë embër, sepse u lint afër së kremtës së Shënt Thanasit që bie më 18 të Janarit.

Im'atë, si u martua e la zanatin dhe hapi një bakall-hane në tregun e vjetër të Korçës, tuke u bërë shok me një tjetër Korçar, një farë Miti i Cicos, i cili në pak kohë e qiti me këpucë të kuqe t'em atë; ky, kur e pa se në dy vjet e sipër humbi gjithë kapitalin e vet që kish edhe 70 lira turke të prikës që kishte marrë, një natë të bukur u shtërngua të lerë Korçën, dhe t'em ëmë, bashkë me gjyshen t'ime e me teto Ndinën e ju venit prapë limerit[3] të vjetër, Ajo-Mavrës, ku zuri prapë kondakçillëkun. Po me qenë se s'kishte aqë punë atje, shpërngulet e zë vent në qytetin Etoliko, ose Anteliko, që gjindet në Etoli të Greqisë, afër qytetit historik të Mesollongit. Aty hapi një dyqan të mirë dhe në pak kohë zuri një sërë të bukur.

Nëna ime në atë kohë lindi djalin e parë Dhimitrin. Kështu im' atë dërgonte rregullisht të holla e mbante q'andej mirë shtëpin' e tij tuke u dukur mot e për mot në familjen t'onë në Korçë. Kishte në dyqan bashkë me dy shërbëtorë të tjerë dhe të kunatin e tij Mitkon, të vëllan' e 'sim 'ëme, një djalë 17 vjetsh, të cilin e hiqte si besnik dhe e donte shumë.

Po një herë nga të shumat, kur im' atë gjindej në Korçë e vonoj të kthehej në Etoliko, Mitkua, besniku i tij u gënjye pas një çupë Etoliqjotke, dhe pa një pa dy u martua me atë. Dhe

[1] Vluk-gu : lulja e moshës (K. F.)
[2] Murg : i mjerë, i përzishëm (K. F.)
[3] limer = shesh, mriz, lëndinë (H. K.)

me qenë se i duheshin të holla për dasmën e për qefet e tjera Mitkua s'e vrau mëndjen edhe shumë, shiti si mundi tërë sermenë[1] dhe tërë hallatet e t'im eti, i bëri parà dhe mbaroj punën e tija. Kur kthehet im' atë në Etoliko s'gjen dyqan, asgjë! Nuk u dëshpërua i mjeri , as që e qortoi Mitko-Katranin për batërdinë që i bëri, po kthehet në Vrahar (Agrinion), qytet i Trihonisë në Greqi, 8 orë lark Etolikosë, dhe atje me anë të miqve hap një dyqan të ri, ku përmblodhi edhe të dy shërbëtorët që ia kishte zbuar Mitkua.

## II

Kur u linda unë, me qenë se pak kohë më parë kish vdekur im vëlla Dhimitri, shtëpia ndjeu një gëzim të math, po ajo që u gëzua më tepër ishte ime gjyshe. Ditën e Shën-Mitrit kisha të tretat. Pas një jave pagëzohesha në kishën e Mitropolisë. Kumbari jonë, një farë Koti Mihal nga Vithkuqi kur po më mbante në duart dhe ju kërkua embri prej priftit që më pagëzonte Ekonomi Zografit, të vëllajt të Nikolla Zografit, një prifti huqli e inatxhi kumbaroja harroi se kishte pagëzuar vëllanë tim më të madhin me embrin Dhimitri, dhe mbassi unë u linda atë ditë e sipër të Shën-Mitrit, m'a ngjiti me një herë embrin "Dhimitri". Po prifti Ekonomi, zembrak si ishte, zemrohet me një herë dhe ja prêt kumbarës me këto fjalë: "Të plastë koka, të plastë! S'mban ment kur pagzove më të parin e ja vum embrin "Dhimitër". Gjith këtë embër do t'ja vesh fëmijëve? S'paske embër tjetër? Këto tha Ekonomi, po ime gjyshe që u ndoth atje afër kujtoj me një herë t'em gjysh, edhe tuke dashur t'a ngjallë ne mua ia priti me një herë priftit Ekonomi: "jo, uratë, jo ka harruar kumbarja, po verja shentërija jote embrin "Risto". Ashtu, deh tha prifti edhe menjë herë u gjënt me një mëndje edhe kumbari e kështu më mbet embri Risto që më vonë u bë Kristaq, që më tutje, për të mos u dukur si embër greku, vetë e ktheva kur isha në Amerikë, tuke e zëvëndësuar me embrin "Kristo".

Një episode ngjau atë ditë. Midis kalamajve që u ndodhë kur pagëzohesha, ishte dhe një farë Lipi, Lipi, një djalë 15 vjetsh pak si i lënë e hallakatur. Ky vrapoj më parë nga të gjithë djelmt' e tjerë për të thënë në shtëpin t'onë myzhdenë[2] e embrit t'em. Kish fukaraj mbathur një palë këpucë të reja vidhella edhe që të mos bënte me baltë në odën e shtruar, ku ishte lehonë im' ëmë, i zbathi këpucët e i la në divanon t'onë e hyri brenda tuke iu adresuar grave që ishin brenda me këto fjalë që i përsëriti shumë herë, se nuk e kuptonin: "Gëzuashi e për shumë motni gëzuar embrin Kristo". Gratë i dhanë embëlsira petulla edhe një grosh për mushdenë. Por kur dolli jashtë këpucët e reja kishin bërë krahë e kishin fluturuar! Një tjetër Lipi, po Lipi i Bizdunit, ky ia kishte vjedhur e kishte ikur. Kërkuan andej, kërkuan këndej s'i gjetën deri sa i dhanë një palë pandofle Lipit të parë, i cili, tuke qarë e vajtuar këpucët e reja që i këmbeu me një grosh që mori për myzhde, shkoj në shtëpi të vet.

Kështu ime gjyshe ishte shumë e enthusiasur me mua se i vinte si kur i ngjalla të shoqin e i solla lumërin' e shtëpisë. Prandaj më deshte fort dhe s'më dahej as qimen. Se, të thom të drejtën, ajo po thuaj se më riti edhe më von, ajo m'a kish gajlenë e shkollës e msimeve me gjithë që s'dinte gramë dhe ajo më merrte gjithnjë nga shkolla e s'më linte të më rinin[3] shokët. Me mua i shkonte gjithë hallet e saj, harronte gjithë mjerimet që kishte vuajtur dhe ngushëllohej kur më shëkonte për humbjen e djalit saj Kovit, që i kish këputur krahët e s'e harronte kurrë e më theshte se i ngjas shumë atij gjëmë-madhit.

Si u bëra nj'a 4 vjetsh ime gjyshe, e cila s'më ndante nga gjiri as natën, as ditën , më shpuri për të parën herë në shkollën e kalamajve dhe më dorzoj te msuesja, dhaskalica Amalia, një zojushe 20 vjetshare nga Selaniku. Kjo zojushe kish një sympathi të madhe tek

[1] sermaj = pasuri, kapital (H. K.)
[2] müjde =mrekulli (perkthyer nga turqishtja me google H. K.)
[3] rrihnin (H. K.)

mua e më deshtë shumë si ajo, si e ëm' e saj, se për çudi edhe atyre ju ngjisja si një të vllan' e tyre që ju kishte vdekur i ri. Kështu, qiria Amalia, filloj të më dojë kaqe shumë sa, pastaj, më mbanin edhe për drekë dhe nga ndo një herë më mbanin edhe natën e flinja me një krevat me qiria Amalian.

Po këjo që më mbanin edhe natën e flinja nuk i pëlqente s'ime gjyshe e cilla e sillte shume rëndë mosqënien t'ime pranë saj, se ishte msuar me mua e më desh pranë në robat kur flinte se ndryshe prishej dynjaja. Po, edhe mua s'më vinte mirë që më mbanin edhe natën dhaskalicat, se isha mësuar që më rëfente pralla ime gjyshe natë për natë e më vinte në gjumë me gjithë që im ëmë insistonte të rinja atje te zonja Amalia që të msohesha tarbijet e t'i lija rehat, mbassi s'linja dy gurrë bashkë kur isha në shtëpi, si një djal' i vetëm e i përgëledhur.

Shumë herë ime gjyshe, nga s'i ndaheshe shpirti nga mua rinte edhe ajo për darkë ne qiria Amalia, dhe si zuri miqsi dhe me t'ëmën e saj plakën, ahere rinim gjer më 10 të natës, tuke punuar bashkë e tuke biseduar e tuke më parë ime gjyshe e tuke u gëzuar gjer sa kalonte ora dhe shtërngohej nga turpi të kthehej në shtëpi me fenerkën në dorë. Ahere një sqenë mjaft ngashërore e tragjike merte pjesë midis asaj e meje. Ajo që të më thotë "u gëdhifshi shëndosh" më merrte në krahët, më puthte me shtërngonte dhe lotët i vijnin rëke nga sytë goja s'i fliste e këmbët s'i bënin të shkonte. Po edhe mua më vinte keq dhe s'e lëshonja nga duart, sa shumë herë emosionoheshim e milloviteshim edhe qira Amalia me t'ëmën e më linin e shkonja me t'ime gjyshe. Oh, ahere, ahere gëzimi i saj nuk përshkruhej dot; syt' i ndritnin fytyra i shkëlqente, i nënëqeshte buza e s'dinte si t'i kënaqte dhaskalicat që i bënin gjith' atë të mirë, që i jepnin djalën e dashur t'a merte në shtëpi!

Oh, sa e mira ka qenë gjyshja ime! S'hante kurrë pa mua, më ruante çdo gjë që i binte në dorë, më kish kujdes si të dy sytë dhe pak si kur t'i thesha s'munt futeshe në dhe e gjallë. S'duronte gjë për mua. Pak të më shante, të më mallkonte im'ëmë ajo do bënte kijametin e math. S'e deshte jetën për para meje. Po edhe unë e desha fort e e adhuronja. E kisha baba, mëmë, vëlla, motër, shok, mik, protektor. S'besonj të më ketë dashur në botë njeri sa atë me aq sinqeritet, me aq therori.

Motin tjetër shkoj qira Amalia. Unë e kam qarë me lott, si kur më iku nëna ime, si kur m'u çkëput zembra. Ahere ime gjyshe më çoj ne trashëgimtarja e saj, qira Kleoniqi, edhe me qenë se ajo u martua me një msues, Z. Tabakidhi ime gjyshe më dërgoj te dhaskalica tjetër, qiria Irini dhe m'andej te qiria Andhromaki. Kështu shkova 2 vjet plot në shkollën e kalamajve me dhaskalica, gjer sa u kthye im' atë nga kurbeti.

Unë isha ahere 5-6 vjetsh, po s'dija as Abecenë, se as që ma vinte veshin njeri, me gjithë që im'ëmë ishte e msuar. Im atë, kur më pa që isha një dru i pagdhëndur, që për dy vjet me radhë s'kisha msuar gjë, desh të më vinte në shkollën popullore me nxënësit e tjerë, ku, pa fjalë do mernja edukatën e parë e do msonja të shkruanja e të këndonja.

Po, në ato dit që po pregatitej im' atë të më dërgonte në shkollë më ngjau një taksirat. Hethe të forta e të paprera filluan të më zënë , siklet të math kisha dhe dal-nga-dalë nuk bënja dot as ujët. Më ekzaminojnë e më gjejnë që kisha gurë në fuskën. Si shkuan ca ditë dhe situate ime po keqsohej më tepër, u shtërnguam' atë e mori dy xheranj (chirurgë) të më bëjnë operacjon.

Chirurgët e çuditshëm, ishin dy njerz praktikë fshatarë që të dy e veshur me floketa e me bruca të bardha. Ah, i mbanj mënt si kur se i shoh sot ata dy xhelatë të pa shpirt! Vijnë në shtëpi t'onë , bëjnë një konsulltë në mes tyre, tuke asistuar edhe im'atë, e vendosin të më çajnë (të më bëjnë operasjon) dhe i kërkojnë edhe s'im ëme me shkrim konsentimentin e saj, që si do të ngjasë puna për mua mos më kërkonte prej tyre. Im' atë e nënshkroj. E shkreta ime 'ëmë, pa ç'pa e nënshkrojti shkresën edh' ajo.

Po në qoftë se prindët të dy vendosnë të më bëhej operasjoni, nuk vendoste plaka ime gjyshe. Ajo kur e dëgjoj u hoth përpjetë. Qysh? Do t'i thernin djalin e vetëm kështu pa një pa dy ata dy kasapë që po lanin duart ahere e po përvishnin llërët e nxirnin e pregatitnin brisqet

(se brisqe berberësh kish ahere) e mashkat e cimbidhet e hallatet e tjera për t'i therur djalin? Qysh? Qysh? Është e mundur kjo? Mezi e bintnë plakën e gjorë se kisha nevojë që të shpëtonja me gjithë që ajo i gjetë të tepërta këto, mbassi ca paraklise[1] te prifti sa të taksura në kishë vaj e llambadha, dhe ca duvarra që i bënte veçanërisht Zotit, mjafton të ma hiqnin të ligën e të m'a shduknin gurrin që kisha.

Më në funt të dy kombajanitët bizara çveshin flokët e bardha, venë hallatet përpara, të cilat po i shihja me syt' e mija e dridhesha si purteka hapin disa shtullunga pambuku e pregatiten për operasionin, pa ethere, pa hlloroformë, pa gjë dhe në vënt që të më flinin, ose te me anesthezonin ndryshe, ata, pa një pa dy më lidhën këmbë e duar, pas një astagaçit ë math dhe nga njëra anë im' atë më mbante kokën e duart nga tjetra, xhaxhaj im Ligori më mbante këmbët , e kështu fillojnë operasionin.

Cfilit' e dhëmburit e mija kalojnë ç'do përshkrim. Të dy xhelatët më okupojnë dhe njëri më hap një goxha plagë pa pikën e mëshirës, tjetri mizorisht e çnjerëzisht ngul mashkën brënda në varrën e hapur e, si pa gjë të keq, kërkonte gurrin, të cilin, desh Zoti e gjeti më në funt dhe e nxorri jashtë. Ishte një alamet gurri sa një kokërr arrë, plot me gjëmba rrotull. Kështu ma qepnë plagën e shpëtova. Gjith' operasioni s'mbajti më shumë se 10 minuta, po të keqen që hoqa, agoninë e sikletin do t'ja rrëfej varrit.

Si u shërova mir e bukur, im' atë desh të më vendosë më parë në shkollë, pastaj të nisej për në kurbet, ku kish punën. Kështu pra, një ditë më merr për dore e më çon në shkollën popullore greke të Korçës.

Ish ahere viti 1877, ku elementi i krishterë ndodhej në një vrejtje strikte nga ana e authoriteteve lokale nga trazimet që po ngjisnin në "Rumeli e Bullgari", ku Turqit vrisnin me qindra ditën. Disa kryengritje të vogla shkrepnin andej këtej edhe komitaxhinj bullgarë e maqedhonas shëtitnin posht' e përpjetë në Maqedhoni, si edhe Grekët në Epir e në Thesali për të kndjellur popullin në këmbë kontra tyranisë turke.

Sa do që far' e fisi jonë s'deshin ta lijshin t'em atë të shkonte në Greqi, ku kishte punë, ajy s'dëgjonte asish prallash po një ditë shkoj me mua të më vendosë në shkollë.

Asokohet ishte drejtor i shkollës një farë Tabakidhis prej Bujackoje dhe msuesit e tjerë ishin Kristaq Themeliu nga Dardha për klasën e IV, Antonaq Piperi me dollamë të gjata çifuti prej Bllaçi për klasën III, Dhaskal Petrua, ose Pepja i tmeruari, prej Kosove të Përmetit për klasën e II dhe Dhaskal Miçe Kostandini prej Korçe për klasën e parë. Me qenë se asokohet ajy kalamaq që dinte të numuronte pa një gabim deri në 200, mua, kur më provuan, me qenë se mund të numuronj pa pikën e gabimit deri në 450, më regjistruan me një herë në klasën e II pa s'kish gjë që nuk dinja as Abecenë as sa bëjnë 5+5. Kështu takova e u vendosa në klasin e Dhaskal Pepes, i cili rron akoma në Berat.

Po bënj një përshkrim të vogël të këtij msuesi mizor e prototyp, prej të cilit kam ngrënë kaqe shumë dru deri sa ta kem për tërë jetën. Edhe sot e kam kokëm me xhunga nga të përpjekurat që s'kish dit të mos më mbërthente kokën pas pinakajet (tabellës së zezë), që përdoret për hesape etj. në shkollat.

Dhaskal Pepa ish një burrë shkurtalaq nja 40-42 vjetsh, verdhanik, turi-mvrejtur, i çalë nga njëra këmbë, i egër, i pashpirttë, gjakpirës. Djelmt e shkollës ishin për atë lodrat e ditës. Purteka e stepinj me duzina ishin në dispozicjonin e tij; litarë e tërkuza që përdortë për fallaguja (një soj shkencë mes shekullore e gjakpirëse që përdortë për të lidhur këmbë e kokë bashkë të kalamajve) Kjo ish për Dhaskal Pepen si buka me kripën. S'bëntë dot një ditë pa ato, kaqe ishte amator i mizorive ç'njerzore. Kurrë s'qeshte; kurrë ndo një herë s'fliste si njeri, i egër, i prapë, nopran, vramus ishte mnera e fëmijëve. Prandaj me të drejt edh' ata të ngratët e quanin "Pepja i tmeruar"! Jo një her' e dy ktheheshin djelmthit në shtëpit' e veta me kokrat e çara; jo një her' e dy i bënte kalamajt që çfaqnin gjak nga hundët e nga goja së

[1] paraklit ose paraklet = engjëll ngushellues (H. K.)

rahuri; kushedi sa herë kish mvarur djelm me krye tatpjetë dhe i mbante si pula të therura nga një anë e përpjetë në atë pozitë agonije dhe me të rahura e me hidhka vitheve dhe me tym prej glasa-pulash që diqnin mbi qeramidhe nën hundët e kalamajt të njohmë, të dënuar! Edhe me gjith' ato asnjë kujdestar shkolle, ose efor si i thoshin, as një dhimogjeront, ose ndonjë prej parësisë korçare s'u ndoth ta marrë për veshi këtë farë bishe e t'i japë një shkelm të mirë! Kjo shqerbë[1], ky katil figuronte pa pikën e turpit a të frikës, mjerisht, si një nga më të mirët pedagogë të asaj kohe sepse ish i vetëmi pas opinionit të Korçës dhaskal, që mund të bënte terbijet fëmijën! Ky ishte mentaliteti i asaj kohe!

S'kish ditë të mos më ngrinte të bënja hesape në pinakâ[2] megjith që s'dinja as t'i shkruaja mirë numrat gjer më 10. Më vinte edh' ajy për sipër. "Sa bëjnë 5 herë nga 5?" – "15 Dhaskale"!. . . Të krismën koka ime pas pendakaje! – "Folë sa bëjnë 5 herë 5" – "10 Dhaskale"! Një shkelmë vitheve e gjindesha i rëzuar përdhe ku prisnja edhe 2-3 shkelme të tjera ku të muntte! Ngrihesha prap duke qarë. "Fol, harbut, maskara, hajvan, gomar… sa bëjnë 5 herë 5" – "S'e di dhaskale". S'e di?. . . S'e di?. . . Ejani ju të tjerët këtu…Mblidheshin një karvan djelm, që e dinin sa bënin 5 herë nga 5. Pra, kush do që e zgjidhte këtë problem e detyronte dhaskal Pepja të më pështynte në surat! Ky ishte sistemi pedagogjik i njeriut që dinte të bënte terbijet çilimijtë!

Janë të panumurta mjerimet e mija të atij viti të zi 1877. Kur mbaroj moti, me gjithë që nga provimet që dhashë mora një zero me bisht dhe me lëvdima e apllaudime mbeta prap në klasin e II, por sidomos e ndjenja veten të lumur, se shpëtova nga mundimet e mizoritë të autodafesë të dhaskal Pepes.

Dhaskal Pepja, për çudi rron edhe sot, si thashë, gjindet në Berat dhe është i verbër. Do të jetë 92-93 vjetsh[3]. Më takoj të jem në Berat para 2 vjetsh dhe e pashë. Rasti ardhë kështu: Një ditë, tek po bisedonja me ca miq në kafenenë qentrale në pjacën e Beratit, më afrohet një burrë me gjyzlyke e më jep të njohur. Më thotë se më njeh, se më ka parë në Korçë, më thotë që është prej Kosove të Përmetit e më lutet t'i gjenj një punë në financë, mbassi isha edhe unë deputet. I thashë, si të vete në Tiranë pa shohim. Po duke fjaluar, e pyes a në rron ndonjë prej familjes së Dhaskal Pepes nga Kosova, se për dhaskal Pepen isha më se i sigurtë se ishte kalbur në dhé prej vjetësh. Më përgjigjet se ajy vetë është i biri i dhaskal Pepes! U çudita fort dhe e pyeta përsëri kur ka vdekur dhaskal Pepja, që aq fort më ka rahur e më ka copëtuar. Më thotë "Rron dhaskal Pepja!" Qysh the , qysh the?. . . Rron? – Rron, thotë tuke qeshur, mbretëron dhe e ke këtu. Këtu në Berat? – Këtu, këtu dhe po të duash urdhro t'a shohësh, më thotë. – Tani dua ta shoh, i thom, po të jetë e mundur. – Urdhëro, më thotë e nisemi me një herë e vemë ne dhaskal Pepja.

Kur e stërdita[4], u çudita mjaft. Nuk e besonja dot se ishte ajy vetë vërtetë dhaskal Pepja. Afrohem e i zë dorën. Kujtonj atë ças të gjitha sa vojta prej tij. Këtë radhë m'u duk një plak i butë, i urtë po si dele, simblë, fytyr qeshur e i mirë. Dhe e shëkonja që në funt e në krye, sikur do vërenja në fytyrën e tij gjithë historinë t'ime mizore të vitit të mallkuar 1877. – Je vërtetë zotrote, i thom, dhaskal Pepja? – Po biri jem, m'a prêt. – Ajy që ke qenë në Korçë, në klasën e II të Fillores me 1878? – Si urdhëron, më thotë…A më njeh mua? A më sjell ndërmënt? Jo – thotë . Jam një prej nxënësve të tu të atij viti, të atij klasi. Jam Kristaq Floqi. – S'të njoh – më thotë prapë s, më bije ndërmënt. Ahere do t'ju kujtonj më mirë atë kohën e cfilive i tregonj disa të ngjara, disa episode, disa rahje nga më të këqijat, gjersa ja solla ndërmënt. Ahere më mbajti ment, më njohu, po dyshonte nga fytyra ime, se shëkonte pak edhe i dukesha tepër i ri.

[1] Shqerbe = egërsinë, bishë (K. F.)

[2] pinaka = tavolinë (përkthyer me google nga greqishtja, por në këtë rast, mendoj se asht "tabela e zezë" H. K.)

[3] Nga llogaritë e moshës së këtij mësuesi rezulton se Kristo Floqi e ka shkruar këtë pjesë rreth vitit 1927 kur ishte 55 vjeç (H. K.)

[4] Stërdit = has, takonj, gjenj përpara (K. F.)

– More bir më thotë , po ti më dukesh tepër i ri. Që të kesh qenë nga nxënësit e mij lipse sot të jesh 55-60 vjetsh. Nxënësit e mij janë pleq, më thotë. Ké të drejtë, i thom edhe unë që po të flas këtu e po më sheh i kam kaluar të 54-at edhe shto edhe këtë që kam qenë më i vogli i nxënësve të tu. E mbassi i tregova shumë hollësi të tjera, u bind më së funti që isha nxënësi i tij e më rroku për qafe e më shtërngoi e më puthi në ballë e në faqe disa herë, tuke qarë. – A e mban mend i thom, sa herë më ke rahur e më ke përpjekur për pendokije? Mban ment sa herë më ke dërmuar kokën, sa edhe sot më njihet? A mban mënt sa herë më ke expozuar të më pështyjnë shokët e mij, e që më ke lidhur në fallaga e më ke vënë pendokanë në kokë e më ke tharë duart me fshikulla thane e hithka, e më ke varur kokë-tatpjetë e më ke mbajtë pa bukë? – Po , bir, po përgjigjet i penduar dhaskal Pepja, po ç'do që bënja ahere e bënja për terbijetin t'uaj. – I bukur terbijet, i thom të lumtë zotrisë sate dhe atyre shtazave, atyre gomarëve efore, dhimogjerondë e dhespotlerë që të bënin sehir e s'të jepnin me kohe pashaportën. Ato ishin barbarizma, i thom, ishin mysteret, shkëndijat e Autodafesë të Spanjës që sot po t'i bënje do mbaronje në burg si një kriminel. Me gjithë ato, i thom, po t'a fal fajin e pandjerë e po t'a puth atë dorë që më ka lënë sakat, vetëm e vetëm se të respektonj sot që jé plak. Qau kur i flisnja këto fjalë dhe më kërkoi disa herë ndjesë. E pyeta në do gjë prej meje. Më tha t'i vë djalin në punë e t'i nxirrnja 4. 000 e sa franga që kish për të marrë nga Financa, të cilat pa ardhur mirë në Tiranë, ja mbarova, tue e emëruar të birin Kristaqin llogaritar të parë në Drejtorinë e Financës të Beratit edhe tyke i dhënë të hollat e prapambetura me anë të Prefektit të Beratit, z. Rexhep Jollës.

U zgjata mjaft për mbi dhaskal Pepen po desha të përfytyronja një typ barbari i cili nën maskën qesharake të edukimit të fëmijëve, figuronte si msues në atë kohë dhe orgjiaste[1] dhe vandalizonte në kuris të kalamajve të ngratë, të cilët i transformonte në shtrembanikë, në sakatë, në nevrasthenikë dhe në gjysmë-të marrë, dhe këto nën elenkun e mitropolitëve bukuroshe e andartë, e të dhimogjerondëve e eforëve gomerë!

Vitin tjetër (1879) isha prap në klasin e II. Dhaskal Pepes, pas disa ankimesh të disa prindërve i kishin dhënë pashaportën. Shpëtuam nga xhelati i keq.

Shpëtuam vërtet nga gjakpirësi i Kosovës së Përmetit, po ramë në duart e një tyrani tjetër, të dhaskalit Kosturlli Dhiamandopullit të njoftur me parangomin "Dhaskal mustaqe-rabecka". E kishte peshqesh këtë nofkë prej Korçarëve, se me të vërtetë i kishte mustaqet si bisht miu ose bisht rabecke (trumcaku).

Kur më çonte, ndjesë pastë, babaj motin e dytë në shkollë ditën që u prezantova te mustaqe-rabecka, tyke qenë aty im' atë dhe dy dajinjt' e mij Ligor Mitkua e Spiroja i Vitos, një tërmet i fortë n'a drodhi të gjithëve. Disa bango fëmijësh e tryeza u rëzuan njëra mbi tjetrën. Shumë djelm u plagosnë së përplasuri mbi njëri tjetrin, mbi bangot shkollore, ose pas murit. Në atë koh' e sipër tjetër trondotje m'e fortë se e para çau më disa vënte e shkatëroj muret. Një epistat, ose kujdestar shkolle, një farë Kostandin burrë me satar me fustanell e flokartë ndodhej në partismentin[2] e sipërm të shkollës. Me të plasur tavani hapet një vër e madhe në mes të davanit dhe rëzohet që andej Kostandini e bie mbi t'im atë e dajinjt' e mij po për fat asnjeri s'pësoj gjë me rëndësi.

Kur duallm jashtë shkollës pamë se s'kishte mbetur oxhak më këmbë! Shumë shtëpi kishin plasur, ose ishin shembur edhe më shumë se 10 shpirt kishin gjetur vdekjen, të shtypur prej gurëvet, ose qeramidhevet.

Tërmeti mbajti më shumë se dy javë dhe gjithë Korçarët familjarisht lanë shtëpit' e flinin jashtë në për arat e livadhet. Shumë dëme të mbëdha solli ajy tërmet, i cili mbahet ment edhe sot në Korçë si një humnerë e madhe e stinës.

Po, s'ishte mjaft ky tërmet i math, që rafshoj për toke aqe shtëpi e që vrau e damtoj kaqe njerës, po edhe një tjetër gazep i math i shkrepi Korçës. I ra zjarri në çarshi dhe e përvëloj e e

[1] orgjiaste = masakronte (H. K.)

[2] partisment = ndarje, kat shtëpie (perkthyer nga frengjishtje me google H. K.)

shkrumbosi krejt! Prej kësaj potere mijra Korçarë prej pasanikësh që ishin u gjetnë me një herë të varfër. Shumë të tjerë u prishnë mëntsh, ose katandisnë të lypin. Shumë muar Misir e Vllahinë edhe të pakët ishin ata që qëndruan më këmbë në Korçë.

Zjari iu vu çarshisë në Korçë me urdhërin e dorë trathtarit Mustafa Pashë Vlorës, babaj i bejlerëve, Neshat Pashës, Ferid Pashës, tjetër herë Vezir i Turqisë, Namik e Syreja bej Vlorës[1]. Mustafa Pasha ishte aso kohe Kajmekami i Korçës. Këtë ngjarje e la të pavdekur një kushëriri i parë i gjyshit nga im' më, shkrimtari Efthimi Mitkua, i cili e trajtoj këngën e e notoj në Beni-Suef të Misirit, kështu :

"Korçë, moj e zeza Korçë, ç' është ky gazep mbi ty,
"Një poter' e zez' e madhe, po si kur[2] na ré më sŷ.
"Të dërmoj tërmet' i shkreti, të rëzoj s'të la shtëpi,
"Me lott qajnë varfëria, me lott e me logori!
"S'të qe mjaft edhe tërmeti, të ra zjari në çarshi,
"Një zjar fort i math, i shkreti, të dogji, të bëri hi!
"Ky Mustafa Pashë Vlora të dogji, të përvëloj,
"Atij më ju thaftë dora që të la e nuk të shoj.

Dhe më poshtë, tuke ngushëlluar Korçën i thotë:

"Mos kij keq, e mjera Korçë, i ke djemtë kurbetllì,
"I ke djemtë kurbetllije, në Misir e në Vllahi,
"Ata për ty po fitojnë, të të lajnë me flori,
"Ata ty do t' të ndërtojnë si s'e ka ndër ment njeri!"

Atë mot, në të cilin krisi edhe lufta Ruso-turke unë vazhdonja klasën e II të fillores me mësues Mustaqe-rabeckën. Sa do që mbeta prap në atë klasë, prap isha fare dru. S'dinja, përveç Abecenë edhe pak syllavisma[3]. Im' atë vetë ish ajy që kish durimin e më shtroj në këndim e mora pak fuqi përpara.

Po edhe Mustaqe-rabecka ishte nje edicjon i dytë i dhaskal Pepës. Edhe ky filloj të më rinte si shtazë, ose si kërp, edhe për iç mos gjë. Më mbante me një këmbë ngritur 1 ose 2 orë; më vinte një koxha pendoka në kokë, sa një ditë më zuri gjumi e më ra nga koka e theu sobën, u thye edhe vetë. Merret vesh që kjo m'u çpërblye me një dru të paqmë të dytë edhe me një të blerë nga qesja. Më futte në bodrum, ku më përpara kisha frikë, po pastaj u msova dhe merrnja edhe nga një gjumë të mirë në mes të plerave, sa mezi më zgjonin.

Një ditë më kish zënë aq rëndë gjumi sa më thrrisnin me zë e nuk dëgjonja. U trëmp ahere Mustaqe-rabecka dhe me frikë në zembër zbriti në bodrum bashkë me epistottin Petro Dajlanin me një kandil në dorë e po më kërkonin gjer sa më gjetnë. Po ky ka qenë shkak që pushoj druri qysh ahere, megjith që edhe një shkak tjetër më praktik invencjon ky i s'ime gjyshe, e zbuti dhaskal Mustaqe-rabeckën e më sillej mirë. Ky e hante fort lakrorin me harmé dhe byrekun me presh, po edhe pastërmanë e llukanikët i lakmonte mjaft. Prandaj ime gjyshe, "me që s'ia dilte ditëshkurtit Mustaqerabeckës ndryshe"filloj t'i zerë gojën, mbassi mallkimet që i jepte për ditë e pa që nuk zinin ndo një vënt. Kështu plak' e gjorë i dërgonte me mua Mustaqe-rabeckës kur byrekun, kur lakrorin, kur pastërmanë e kur llukanikun.

Mustaqe-rabecka m'u vu mjaft m'andej dhe zura çeç mësonja. Po me qenë se u mbyllë shkollat prej shkakut të trazimeve politike e të frikës së madhe, u shtërngova te ri disa ditë në shtëpi! Po aty gjetne belanë prej meje gjithë shtëpia se s'i linja rehat. S'kishte ditë të mos ankohej mëhalla kundra meje. Dajot e mij, me gjithse s'interesoheshin shumë për mua, se s'kisha edhe babanë aty, por nga ndo një herë kur më thrisnin në gosti e sillesha aq mirë, çuditeshin edhe ata pse kisha kaq nam të keq në mëhallën t'ime e në shkollë, kur unë isha i urtë si një engjell"!

[1] Nga ky përshkrim rezulton se Mustafa Pashë Vlora ka qenë kushëri i "patriotit" Ismail Qemali (H. K.)
[2] kur = gur (H. K.). Në origjinal është shkruar "kur"
[3] syllavisma = drejtshkrim (perkthyer me google nga greqishtja H. K.)

Më në funt edh' ajo ime gjyshe që më desh aq fort gjeti belanë nga mua edhe desh një or' e më parë të më siguronte në shkollë. Të kisha t'em atë afër ndofta do mos strapacoresha[1] aqe, po kur xhaxhajt' e mij nga im' më nuk m'a vinin veshin, as më shëkonin kurrë në shkollë dhe gratë që kisha në shtëpi s'm'a mbanin dot frenë, si munt të bëhesha i mirë?

Shumë herë i ankohej im' më të vllajt Grigorit për mua që më rahin në shkollë ajy i përgjigjej: "Mirë ja bëjnë" i thosh se nuk msoj gjë në shkollë, ajy i përgjigjej: "po hiqeni ahere nga shkolla e vëreni gjëkundi çirak", i thosh shpesh se më rahin shokët, i përgjigjej se "kur s'është i zoti s'e bëkërkan copë? Atë kokë ka atë feste të verë"! Aqe u interersuan xhaxhallarët e mij për mua sa kurr' ndo një herë s'muar mundimin të vinin të më shihnin në shkollë, ose të paktën të pyesnin për mua. Ndenja 2 javë i sëmurë prej dhaskal Pepes dhe njeri s'u ankua për mua. Vetëm ime gjyshe ishte ajo që bënte poteren me dhaskenjt sa herë që më rihnin, ose më shqepnin së rahuri. Po sa para bënte? Kush ia vinte veshin një plake? Kush e përfilltte. Të shumën, të shumën munt të talleshin me atë dhe as gjë tjetër. Është e ditur se sikur të më kish evlat[2] xhaxha Ligori , ose cili do xhaxha tjetër do tundeshin pak; të paktën do ankoheshin në Mitropoli si bënë më vonë për fëmijën e tyre, po unë isha pa njeri, kush do përkujdesej për mua? Nga kush do merrnja edukatë? S'kisha njeri! Zura ruga të këqija, me shokë të këqinj. Luftonim me gurrë me djelmt myslimanë, si kur se turq e kaurë me një fanatismë fort të ashpër edhe s'ndodhej as Polici, as Gjendarmëri për ne, as edhe ndonjë burrë me mënt të na hiqte veshin e të na shmangte q'andej, për kundrazi burra, gra, delnin nga lumi i Korçës e na bënin sehir si luftonim e çanim krerët me shoqi-shoqin e prisnin me agoni, kur do mbarohej lufta dhe cila anë do të fitonte edhe shpesh herë vinin edhe me bast!

Sepsé kthehesha në shtëpi shumë herë me kokën e çarë e me ndo një xhungë të madhe në ballë, ose me ndo një plagë tjetër në trup, të shkaktuar nga gurrët e luftës, kush prej dajllarëve të mij përkujdesëj të më hiqte vërejtjen, të ankohej ku duhej, të merrte masa për mua etj. etj. Kush? Askushi. Prandaj pasi e panë edhe gratë, ime gjyshe, im' ëmë dhe teto Ndinua që nuk shtrohesha edhe se dita ditën po përparonte e keqja e po vinja në një katastrofë të sigurtë, dërguan shpejt e thirë t'im atë të më mbledhë e të më përmbledhë.

Im' atë i gjori pa ç'pa e la punën në duart e huaja e vrapoj në Korçë për djalin e vetëm. Kur erdhi e pa edhe ajy mirë se sa ish i gënjyer, tuke pritur përkujdesje e edukim nga xhaxhallarët e mij. Dhe me që shkollat ishin mbyllur ahere u mendua të më dorëzonjë në shkollën private të Dhaskal Kapanit.

Dhaskal Kapani ose dhaskali i Galave (nuk pyeta ndo një herë se pse i patnë mbetur këto dy nofka dhaskalit të gjorë) dhaskal Kapani, po thom, ishte nga Opari. Embri i tij i vërtetë ishte "Thanas Armodhiu". Ky kishte një farë shkolle, thuaj fillore, thuaj pregatitore, po si do që të jetë, ishte shkollë private me një frymë shkollë platonike, sepse msimet jepeshin prej tij, ose në shtëpi të tij, ose në bahçen e tij, ose në odën e gjumit të tij, ose edhe jashte qytetit, si p. sh në kodrinën e Sh. 'Thanasit të Korçës, që ish edhe afër shtëpisë së tij, si nën hijen e "lisit të Stamos"m'at'anë Sh'Thanasit, te "Çeshma e Shetros" ose te "Mburimi i Çetanit" .

Shkolla e tij kishte herë 3, herë 4, herë 5 dhe herë më tepër klasë. Klasat ishin gjithë më një dhomë, të gjitha dhe rotull msuesit e drejtorit të shkollës Dhaskal Kapanit, i cili, tuke zënë mesin e sallës së msimeve, përbënte qëndrën, ose strumbullarin si me thënë të msimeve dhe kshtu ish i detyruar të vërtitej herë nga e djathta, herë nga e mëngjra, herë nga veriu dhe herë nga jugu, si e donte puna, sipas rendit të klasës.

Mua më mori me sy të mirë Dhaskal Kapani e më reshtoj në klasën e II. Ishim aty nj'a 35-40 shpirt nxënës, të gjithë grumbulluar, si thash asfyktisht më një odë dhe mosha e fëmijëve fillonte që më 4 vjetsh e mbaronte me 22, d. m. th. ata të moshës 20-22 vjetsh ishin në klasin më të epërt të shkollës Kapànase dhe ky ish rendi të shumën i V, ose të shumën, të shumën i VI i fillores!

[1] strapacohesha = të trajtohesha keq (nga italishtja H. K.)
[2] evlat = fëmijë, bir, djalë (H. K.)

Në këtë shkollë s'rinja edhe liksht, po e keqja ishte që s'linja rehat të tjerët të këndonin edhe të gjithë qaheshin mbi mua. E keqja më e madhe ishte se s'linja bango pa e gdhëndur me thikë ose pa lënë nga një nishan të embër mbiembrit t'em, ose tjetër shenjë si kokën e mustaqet e gjata të dhaskal Kapanit, fytyrën e kujdestarit, një plak i mirë që më desh e e desha shumë, fytyrën e ndonjë shoku që e kisha inat e s'e duronja dot etj. Po kish edhe një më të madhe e akoma të keqe dhaskal Kapani që ia shkaktonja unë dhe kish të drejtë të ankohej e të më qortonte për ditë. Kish një kopsht të bukur plot pemë qershi, kajsi, fiq, dardha etj. që s'linja kokër më këmbë me nja dy tre shokë të tjerë. Pra, s'munt të më duronte më shumë i shkreti dhaskal Kapani, e kështu një të bukur pasdrekeje më dorzoj këpucët dhe passaportën e më detyroj që të mos merrnja më mundimin të kthehesha prap se nuk do më pranonte, si kur edhe i jati t'i ngjallesh prej varrit! Im'atë s'ish ahere në Korçë që të më sillte prap në rrugë, por për fat u hapnë për nja dy muaj shkollat publike dhe rashë prap në duart e Mustaqe-rabeckës, i cili më priti më mirë se cilin do nxënës, po edhe ime gjyshe lakrorët e byrekët e pastërmatë e llokanikët s'ia shkrepte fare. Kështu munda të kalonj në klasën e III, ku prap patmë Mustaqe-rabeckën për msues.

Po motin tjetër, që vazhdonja në klasën e III ime gjyshe e harroj krejt Mustaqe-rabecken. Shumë rrallë ia njomte gurmazin. Prandaj filloj prap avazi i parë me mua, domethënë u vu në veprim druri dhe fallagaja, me gjithë që përparonja pak në msimet, e s'isha fare dru. Por shkaku i rifillimit të drurit e të fallagasë ishte më fort një ndollinë tjetër, që po e tregonj.

Dhaskal Mustaqe-rabecka ishte i vluar në Kostur dhe atë kohë e kishte sjellë të vluarën e tij në Korçë që të martohet. Unë pata dëgjuar se e vluara e tij ish një zeshkane mjaft e shëmtuar me ca dhëmbë të dala jashtë si shusta me një hundë të shtypur e lijosur etj. dhe një dit po ja kallxonja shokëve të klasit gjithë virtutet e nuses së re. Nuk di kush prej syresh ja shtiri në vesh dhaskal Mustaqe-rabeckës dhe ky pa një pa dy më ze, më lith, më shtrin poshtë në dysheme dhe fillon të më rahë me një fshikull të fortë pa mëshirë! Më kot protestonj, më kot thres, më kot shonj. Ajy kur më rinte më përsëritte her pas here fjalët: na edhe një herë, majmun që të msosh si shahet nusja e tjetrit. Prej atij druri mbeta një javë i sëmurë në shtrat dhe s'ju rëfeva në shtëpi se e psova prej të pashpirtit Mustaqerabeckës.

Tani të kish pak njerzì, pak edukatë ky njeri, ose kjo shtazë me fytyrë njeriu nuk do sillej kështu përpara një kalamani, sa t 'a shqepë së rahuri e t'a mbante një javë sëmurë nga plagët. Munt të më merte mënjanë e të më hiqte vërejtje, ose veshin, pa u expozuar në syt' e nxënësve tjerë e pa më sjellë në atë ditë. Po ku e gjeti edukatën harbuti? Gjithnjë më sillej me të keq, gjithnjë më çfrynte, më shtynte, më dërmonj. Një ditë i dërguam një tjetër byrek, që ta mernim me të mirë, po s'na e pranoj.

Megjith' atë ka ardhur dita që edhe këtij barbari, sikur se edhe dhaskal Pepes, ja çpërbleva drut' e barbarizmat me të mirë, edhe ja se si: Më 1904, kur isha avokat në Korçë, vinë në zyrë dy kosturlinj e më lutem të vi pak gjer në burg për një tjetër kosturli, se do më emëronte avokat. Vajta. Kur ç'të shoh? Dhaskal Mustaqe-rebeckën! E njoha, me gjithë që kishin kaluar plot 25 vjetë; po ajy s'më njohu aspak. Si ja mora përsipër punën, si e përkraha para gjyqit e si e lirova nga burgu ardhi në zyrë me nja 3-4 të tjerë prej Kosturi, ku bashkë me këta u ndoth edhe e shoqja, zonja Kaliopi, për të cilën hëngra aqë dru të pamëshirtë. Mbassi m'u fal nderit ajy edh' e shoqja më në funt nxjerr disa lira turke të më paguanjë. Më vuri përpara 5 lira e më pyeti në janë mjaft. Un' e pashë në sy dhe s'fola gjë. Më ardhë ndër mënt gjith' ato gjëra që hoqa nga ajy vandal. Desha t'a vë përpara e t'a bëj rezil, po prap u mbajta. Ajy kujtoj se s'isha i kënaqur dhe nxori dhe 3 napolona të tjerë, a lira s'mbaj mënt, e m'i vu përpara. Ahere e pashë në sy me inat e i thashë: "meri të hollat prapë, s'kam nevojë. Të kam patur msues dhe nxënësi s'duhet të paguhet kurrë nga msuesi. Duhet të të isha mirnjohës, zotni, si nxënës, por mjerisht nuk më bën zembra të të jem se nuk je sjellë mirë me mua"! Dhe fillova t'ia rendit një nga një të gjitha. Mustaqe-rabecka si më solli ndër mënt mirë zuri të më kërkonjë pardon për gjërra që kaluan etj. etj. dhe m'u lut t'i marr të hollat, se ishte i kënaqur

fort se e shpëtova, edhe me që s'desha t'i pranonja, e shoqja e tij më vuri me përdhuni në xhepa m'u lut t'i mbaj, se ndryshe ju mbetej hatri. I mbajta më së fundi. Më thirë edhe për drekë e vajta. Më vizitoj disa herë në shtëpi t'eme me gjithë të shoqen si dhe unë ju a ktheva. M'u lutnë t'i harroja ato të parat. Ju thashë se dua t'i harroj, po s'harrohen dot. Qysh ahere s'e kam parë as Mustaqerabecken, as Mustaqerabeckinën.

Vinjë prap në historinë time. Megjithë që s'vinja edhe aqe mirë munda ta kalonj klasën e III e u hodhë në të IV. Këtu takova në një msues shumë të matur e fisnik, i cili kurrë s'ngriti dorë mbi mua, as që më shau. Ky ishte dhaskal Andrea nga Bugakoja. Më mori me një sy të mirë. Më këshillonte e më sillej butë. Po edhe unë, për çudi, ndërova menjë herë karakter. Zura këndonja dhe vinja rregullisht në shkollë. Brënda dy muaj isha nga të parët e klasit, prandaj edhe dhaskal Andrea më tregonte si shëmbëllin e shokëve. Këtu fillova të flas edhe greqisht, se më parë s'flisja as dy fjalë.

Po kjo jetë e bukur për mua nuk vazhdoj shumë kohë. Im'atë mbassi e prishi punën në Vrahor, zbriti në Karvasara (Qervan serai sot Amfilohia). Aty hapi një dyqan të ri, bleu edhe një shtëpi në mes të pazarit me dy dyqane përposh, që njërin e përdorte për vehte.

Si u sheshua mirë në Karvasara, ju mbush mëndja t'na marrë atje t'em ëmë dhe mua, që t'na kish pranë. Kështu lamë në shtëpi t'onë në Korçë gjyshen e dashur dhe motrën e t'im eti teto – Ndinon dhe u nisëm për në Karvasara nga ana e Janinës e Nartës. Na shoqëroj gjer në Karvasara daj Ligori.

Me një mallëngjim të patreguar mezi u ndava nga dhaskal Andrea, të cilit me të vërtetë i vinte keq, se ju nda një nga nxënësit më të mirë. Më përqafoi i ngrati dhe mbushi sytë me lott. Më përcolli vetë gjer te Kolla e Hirit jashtë Korçës e më daroviti 5 grosh. Ja një njeri shpirt – mirë e bujar. Si munt ta haronj njerin' e naltë? Pse të mos ishin si ky edhe dhaskal Pepja e Mustaqe-rabecka? Ç'i shtërngonte të mos më silleshin mirë e të më ndreqnin gabimet, si fëmijë që isha? Po në besoftë njeriu në atavizmën kam frikë se ata të dy vandal prototypë kush e di ç'raçë ulkonje, ose kulçedre do kishin!

Ishte muaji i Nëntorit kur u nismë nga Korça për në Karvasarë të Greqisë, qyteth me 3000 frymë në funt të gjirit Ambraqik, ngrehur në mënyrë amfitheatrike në pëqintë të e dy maleve "Petalla" dhe "Argos stufillohikon", me një pamje pitoreske e me një det të kulluar e fosforat, me banja extra, po mjerisht pa ujë të mirë dhe me pak mallarie.

Do mos e harroj kurrë atë udhëtim që bëmë me kuaj qiraxhinjsh. Ishte e para herë që delnja nga Korça e udhëtonja. Ishte moti 1880. Një kohë e bukur, jo aq e ftohtë. N' Ersekë na kanë pritur shumë mirë disa miq të t'im eti. Kur vamë në Leskoviq do ish ora një e natës alla-turka. Ishte ramazan dhe qyteti tregonte një pamje shumë të bukur me dritat nëpër shtëpitë e kandilat e xhamive. Leskoviku ahere ishte në zenithin e tij, ish në vlugun[1] e lumërisë, kur se sot gjith' ato ndërtesa, gjith' ato bukuri i kanë zëvëndësuar gërmadhat e shëmtyrat, gjurmat e invazorëve vandal të Greqisë. Sa fatbardhë ish ahere qyteti e sa i mjerë është sot!

Kemi shkuar një natë të mirë në Leskovik, në një dhomë të mirë të një hani, ku ballas naltrohej një minaré e kandëshme dhe kronj dy derdheshim me ujë të kolluar si loti përpara dritares s'onë. Ishim mjaft udhëtarë dhe hëngrëm darkën të gjithë tok më një dhomë të gjërë me këng' e me muhabete.

Të nesërmet që me natë nisemi nga Leskoviku dhe zbresim nga urat e Pogonit. Oh, sa bukur! Nga njëra anë dukej panorama romantike e Leskovikut, majë malit dhe me malin tjetër gjigant të Melesinit, ku tjetër herë Zylyftar Poda me një grusht trima luftoj kundra ordhive të egra të Kara-Mahmud Pashës[2]. Nga ana tjetër urat e gurta me lumin e rëmbyer të Vijosës dhe me kodrat e grykat e kandëshme!

Në të ngrysur i afrohemi hanit të Kalibaqit, afër lumit Kallamajt. Hani duket së largmi sikur e ka mbuluar me miell, prej pullazeve me plloça, që janë të bardha si mermeri. Ka edhe

[1] Vluk-gu = lulja e moshës (K. F.)

[2] Këtë luftë Kristo Floqi e ka pasqyruar në dramën e shkruar prej tij "Fe e Kombësi"botuar në Sofje më 1914

disa mburime të kulluara nag an' e djathtë. Sado që mungonin dritrat, po prap nja dy kandila e një pishtar i math shërbenin mjaft mirë për shtektarët. Hanxhiu i Kalibaqit atë natë s'kish darkë për ne, po mbassi ishim mjaft udhëtarë, blemë një dash të vogël e thermë e e coptuam dhe burra e gra u përveshnë të bënte kush supën, kush kukurecin, kush ta kripë qëngjin e t'a shkonjë në hell e kush të mbledhë dru e të bënjë zjarin. Vonuam të hamë, por kur hëngrëm, hëngrëm kaqe mirë e me aqe oreks sa s'rëfehet. Kishim edhe nj'a dy ploska me verë të mirë nga Leskoviku që na knaqnë edhe më tepër.

Nga Kalibaqi çohemi herët e ja mbajmë për në Janinë. Kur muarm Lykostomin e duallm në fushën e Janinës, mbanj ment jam enthusiazmuar tepër prej një kënete të gjërrë se kujtonja se ajo do ishte liqeni i Janinës, por mbassi përparuam edhe ndo një orë ahere pamë gjolin e vërtetë të Janinës, një pasqyrë të kalltërtë e të qetë që shtrihej me aqe madhështi përpara syvet t'onë me qytetin e Janinës, si një nuse e turpshme që ishte zhytur të lahej në atë liqen që flinte aq i qetë.

Janinën e dinja si një qytet të vogël, por kur hymë brënda më bëri një përshtypje shumë të thellë për ndërtesat e popullsin' e math që kish. Ndejm dy ditt në Janinë dhe shetitmë edhe mbi liqenin deri në mburimin përtej që quhet Trambatovan. Kur ktheheshim natën nuk munt të përshkruanj dot atë panoramë të bukur, atë natë aqe të shkëlqyer e magjike me hyjet si xhixhillonja të ndritshme e me Kashtën e Kumtrit si mjergull mbi qiellin e kjartë, që pasqyroheshin me aqe hije e ende mbi liqenin e qetë dhe përkarshi qytetin e Janinës zërtellente e shkreptinte në dritra dhe më fort me kandilet e panumurta të minareve të lartra, mbassi ish dhe Ramazan.

Shkuam dhe nga Janina shumë herët dhe me të mugtit ishim te bishti i urës së Nartës. Narta ose Arta nuk kish një javë që i ish dorëzuar Greqisë, simbas traktatit të Berlinit. Nja kallaballëk i math ushtarësh grekë dhe efronësh shihej përtej bregut tjetër. Aty fjetmë atë natë në njëanë të zgjebosur e të ftohtë, sa mezi u gdhimë se n'a korrte edhe era e fortë e lumit Arahthos të Nartës.

Kishim lajmëruar babanë t'im, i cili kish ardhur e po na priste në Nartë. Kur mori vesh se kishim arrirë në bishtin e urrës dolli e na priti nga ana tjetër e lumit. Na mori në Nartë, n'a shëtiti në të katër anët e na kënaqi sa mundi. Pashë atje njerës të tjerë me një liri të plottë, gjithë të mveshur mirë, vallja e kënga gjëmonte nga të katër anët dhe një gëzim e lumtëri shihej gjithkah. Populli i Artës i libruar prej robërisë së vështirë turke festonte tani lirimin e tij. Sa gjë e madhe kjo liria e popullit! Ka si bëhet dhuratë më e mirë për njerinë në këtë botë?

Ditën e nesërme u nismë që të katër me babanë, mëmën time e xhaxha Ligorin për në Karvasara. Hipmë më një karrocë e po drejtoheshim në skelën e Menidhit, tri orë lark Nartës dhe s'andejmi do lundronim me anije për ne Karvasara.

S'kisha hipur tjetër herë në karrocë dhe më vinte çudi si ecte ashtu me rotat tuke qenë ne ndenjur brënda ndenjur mbi fronet edhe gjith' e pyesja t'im atë për çuditë që paska Greqia dhe që ajy mezi më pa e që më deshte aqe fort, nuk rëndoheshe aspak, po gjithë më përgjigjeshe e më shpjegonte mrekullitë.

Kur shkonim afër një kafehane të vogël nj'a dy orë lark Artës, babaj desh të na gostitë. E thiri kafexhinë e e porositë të na bjerrë llokume. Për pak na solli një kuti plot me llokume të Syrës, të mira fort. Si muarm nga një llokume e më pëlqyen, e si pashë që babaj po fjalosej me xhaxha Ligorin dhe kafexhiu nuk e kishte mëndjen ne llokumet fillova t'i qëronj një e nga një dhe hëngra nja 4-5 menjëherë dhe po i jepja edhe s'ime 'ëme. Kur mbaruan së foluri babaj me xhaxhanë dhe karocjeri filloi të ngasë kuajt, im' atë e qëndron që të paguaj kafexhinë. Po vuri re që ishte mbaruar pothuaj një radhë e llokumeve në kuti. I thotë kafexhiut të numërojë sa llokume hëngri ky djali – për mua – Gjer më katër llokume e pashë që hëngri, tha kafexhiu, s'pamë tutje ç'bëri , Perëndia e shpirti i tij e di. Ç' bëre kështu, më thotë xhaxhaj? Ti na turpërove këtu. Kujtove se na i nxori tërë llokumet që t'i hamë ne? – Po ahere pse s'na i dha

me numur i thom, secilit nga një. Qeshi im' atë. Lëre, lëre i tha xha Ligorit se e ka herën e parë pa kur të vemë në Karvasara e prêt edhé këtë zakon bashkët me të tjerat.

Kur po flitshin këto fjalë ja ku u çfaq përtej edhe deti i Ambraqisë ose gjiri Ambraqik. Shumë u çudita kur pashë det për të parën herë në jetën t'ime. E pyes t'em atë ç'është ajy lumë aq i math si stihì[1]. Është deti, më thotë, atje po vemë tani. – Po ajo gjë e zezë që duket sikur ec në det? – Është një barkë, thotë, që e ngasin dy veta me rema. – Po ato vela që zbardhin mbi atë direkë të gjatë? – Janë kaiket me vela e me alburet e tyre, ma prêt, që lundrojnë mbi det. – Hipim në njerës në ato? Pa fjalë, më thotë im'atë. Në një prej atyre do të hipim edhe ne.

Kishim marrë tatëpjetën për në skelën e Menishit. Edhe pak edhe soseshim në mal. Si duallm jashtë e u drekuam mirë, hipmë në një pasare (lundrë me një velë të madhe) dhe mbassi e kishim nga prapa maestralin[2], hapim pluhurën e nisemi me dy naftë[3] prej të cilëve njëri ishte kapiteni i pasares.

Filloj të na tundë deti dhe u tremp mjaft im 'më edhe pas asaj edhe unë, po tuke ecur n'a u mësua syri edhe pas 4-5 orë lundrimi u duk andej thellë edhe Karvasaraja me shtëpit' e saj të goditura në mënyrë amfitheatrike andej e këtej pëqijve të maleve "Argos Amfilohikon" dhe "Petallajt".

Edhe pak e ulte velën pasara jonë, tuke u afruar në limerin e Karvasarasë. Duallm jasht dhe në vënt të heqim në shtëpint'onë, na mori mysafirë një zojushe Marigo Vaso nga Labova, direktoreshë e shkollës femnore të Karvasarasë, e cila kishte edhe t'ëmën aty dhe e njihnim dhe na njihte që në Korçë akoma, ku motin e kaluar kishte pasë qenë drejtoresh' e shkollës dhe mbassi ra një zjarr i math e doqi krejt shkollën femnore të Korçës dhe ju doqnë dhe kësaj të ngratës gjitha robat e pasunia e tundshme që kishte me vehte si dhe gjithë vëthet, byzylykët e xhevahiret e tjera edhe mezi që shpëtoi vehten, e ishte kthyer prapë në Greqi, ku ish edhe më parë. Ishte një zojushë shumë fisnike ndo 24-25 vjetsh si ajo, si e ëma , një plakë shkurtalaqe shum' e mirë e e sjellë. Këto na muar mysafirë atë dit që shkelmë në Karvasarâ e na mbajtnë dy ditt e dy nett.

Përshtypja e parë ishte ambjenti i ri grek që po shëkonim, si unë si im' më dhe që të dy ndjenim një siklet e vështirësi për gjuhën greqishte që nuk e dinim. Pa sikur të ish edhe ajo greqishtja që kishim nxënë ne nëpër shkollat, bereqatversum, po këtë greqishten e Karvasarasë as e kuptonim fare.

Një tjetër siklet ishte për mua shokët e parë të Korçës që nuk i kisha këtu. Kujtonja jetën e Korçës dhe më dukeshe më e mira megjithë pocaqitë e cfilitë që kisha hequr. Kujtonja lodrat me plloça, me ashkie, me turra, me perustithi, etj. etj. e më vinte kijameti. Ata kishin qenë lumëri për mua. Më vinin ndër ment luftat që bënim nga lumi nga korçarët djelm të muhamedanëve, ku "kolli i lumit" i përbërë prej 300 e ca shpirtsh dhe i ndarë në tri rema ose bylyqe, si i quanim ne, kishte tre kapetanë ose kollozë[4], një nga të cilët isha edhe unë dhe ndofta më kuximtari nga të tjerët, me gjithë plagët që njëra mbi tjetrën kisha marrë në luftat e ndryshme e s'vija mënt. Kujtonja kur një ditë unë me 80 veta theva armikun prej 200 e sa shpirtsh dhe i ndoqmë gjer nga shtëpit' e tyre, trimëri kjo që bëri një përshtypje të madhe midis shokëve, ku për shpërblim komandanti jynë i përgjithëshëm Camit Llogori më emroj zyrtarisht nënëkomandantin e ushtrisë s'onë. Më binin ndër mënt kur delnim për zoq e hipnim si macet mbi plepat e gjattë të Korçës e s'linim fole më këmbë, ose kur dilnim për këpudhra e ligavecë (kërmilla), kur delnim për trajçe, aguliçe e trentelin me shokët etj. etj. e më vinte plasja! Kujtonja akoma edhe një pësim të tmershëm një psova një ditë kur, me gjithë që isha komandant, rashë rop në duart të armiqve e mora aqe plagë sa ment i pagova me jetën t'ime,

[1] stihi = (gr.) hije, llamje, kulçedër (K. F.)
[2] maestral = erë e ftohtë që fryn nga veri-perëndimi (H. K.)
[3] naft = marinar (nga greqishtja H. K.)
[4] Kollas (koll-agasi) = kapitan ushtrije (K. F.).

edhe që, kur u ktheva i gjallë në shtëpi nuk dinin ç'plagë të më lithnin më parë, edhe sa do që më ngjetheshin mishrat kur i kujtonja, prap më vinte keq që s'isha në Korçë të luftonja edhe një herë pa le të përmbysej bota. Ç'do me thënë sepse mora aqe plagë atë ditë e më kalpnë së rahuri me shkopinj me shkelmë e me këpucë suratit, hundëve, nofullave, barkut, kurizit etj. etj.? Burrat i heqin të gjitha, lufta i ka ato. Po aman të isha edhe një herë pa tashti do luftonja edhe më mirë. Këto mendonja dhe ja thesha edhe s'em ëme e s'gjeja dot ngushëllim, prandaj isha i penduar që ardha në Greqi dhe disa herë ju qava babajt pse na solli në Karvasara, ku s'ka as lumë, as fiçorë[1], as lufta me turqit, as plepa me folera, as këpudhra, asgjë. Po im'atë çkulej së qeshuri me mua e më ngushëllonte me detin me karavet skunat etj. etj.

Një ditë i plasi shpirti e më tha: S'ke pushuar akoma me këtë avazin e Mukës? Nuk mer vesh se për këto të solla këtu që të eqç dorë nga çapkënllëqet se s'janë gjëra të mira e të bëhesh njeri? Më solli pastaj ndër ment shumë episodhe të tjera që unë i kisha haruar, si për sh. Më kish marë një ditë në katundin Dardhë të Korçës e si me shkak se do pinja ujë në isvor, u derdha për fole zoqsh e humba rrugnë e më gjetnë pas 5 orësh; si një herë tjetër kishim vajtur bashkë në Drenovë dhe u ngjitmë në majë të malit të Drenovës, ditën e Panairit të Shën-Kostandinit, ku im' atë i armatosur me pisqolla, pallaska e fishekë e dyfek me krahë më hiqte për dore kur zbrisnim tatëpjetën e tmershme të malit që s'kish as udhë mushke ahere , e unë pa marrë parasysh rrezikun losnja, tuke u hedhur me një këmbë sa mënt e rëzova edhe t'em atë edhe vehten në greminë, etj. etj. dhe ahere mblodha mëndjen e s'fola më.

Dy ditë mbassi u installuam në shtëpinë t'onë në Karvasara, im' atë më çoi në shkollën popullore në klasën e IV. Po unë s'e dinja greqishten ta flas e këtu e gjeta pisk. Ahere e pashë vehten të izolluar; e pashë se isha i huaj. Me gjithë që më pranuan në klasin e IV, po tuke qenë se im' atë kish një mik Karvasarjot, një farë Pavlo Ekonomi, të cilin e kish edhe kumbarë dhe ish ky msues në klasin e parë të Shollarqisë (shkruar edhe greqisht H. K.) klasë që korespondonte në të 5 klasë të Fillores, ky i thotë një ditë tim' eti që të më dorëzonte tek ajy e të më mbante sa të mësonja gjuhën pastaj të më vinte në klasin e V e kështu fitonja edhe gjuhën edhe një mot. Këtë e pranoj me një herë babaj dhe kështu brënda në dy muaj zura të mernja vesh mirë greqisht dhe u regjistrova në klasin e V, ku me 4-5 muaj e sipër i arriva shokët dhe kur kemi dhënë provime midis 37 vetave që ishim dolla i treti nxënës. U bëra me të vërtetë një nxënës i mirë, sa më s'linja librat prej dore.

Zura mjaft ca shokë të mirë atje, djelm prej shtëpijave të mira, që ndryshonin si nata me ditën me ata çapkënët e birbot e Korçës. Njëri prej shokëve të mij ishte edhe i biri i konsullit të Turqisë në Karvasara që quhej Janko Janidhi, prej Janine. Shkonim mjaft mirë me shokët, gjer sa një aksident i papritur, që mënt më kushtoi jetën, na trondit gjithë qetësinë.

Ishte viti 1881. Një ditë para Shën-Mitrit, d. m. thënë më 24/5 Tetorit, ditën e Martë (thonë se e Marta ka një sahat të keq) unë posa ardha nga shkolla më drekë herë dhe plasa çantën t'ime me gjithë librat e shkollës si mbas zakonit, dolla të los me shokët afër detit, në një shesh përpara Konsullatës Turke, ku e kish shtëpinë miku im Jankua dhe ku losnim nga hera. Im' ëmë po tiganiste, mbaj mënt, ca qofte e i mora një prej tigani, a ja rëmbeva, thuaj, edhe theva tatëpjetë, tuke më porositur ajo e varfra të mos vonohem se dreka ishte gati dhe tryezën po e shtronin shërbëtorët.

Unë shkova shpejt, se po më prisnin shokët dhe kështu u bashkuam dhe luajtmë disa minuta. Ata më cazë u shpërndanë e iknë e më lanë, po unë, i cili e vura merak t'a shkonja njërin prej shokëve t'onë, që na kalonte të gjithëve kur hidhej më trish, mbeta prapa e po ushtëronja këmbët e lagët, tuke u hedhur, si e si të kalonja masën që kish arrirë në kërcim shoku im.

Po pa u menduar se kisha detin afër, që ishte gati dy bojë njeriu thellë, unë po kërcinja më trish nga an' e detit. Mbassi kërceva disa herë dhe gjithë po përparonja, një herë nga të

[1] fiçor = gur i vogël zalli, i lëmuar e i rrumbullakët, por është edhe lojë ku në një rreth vihet një gur që gjuhet me gurë të tjerë (H. K.)

shumat, që vura edhe gjithë fuqinë, u hodha kaqe shumë, sa s'u mbajta dot në hapin e tretë e rrëshqeva e rashë brënda në det tuke u rrukullisur me disa gurrë të tjerë të buzës së malit! Not nuku dinja dhe as që më pa njeri, se ishte koha e drekës.

Do përpiqem të tregonj caktimisht atë ngjarje tragjike e të paharruar dhe agoninë që ndjen një i mbytur. Si rashë në det me gjithë robat e dimbrit, si kundrë isha, në fillim zura e po përpiqesha me duar e me këmbë që të shpëtonja, po kot. Si e pashë se mënt pëlcisja nga firoma se mbylluri gojën, u shtërngova të hap edhe gojën, po ahere u gjënda në një situatë shumë më të keqe e në të vështirë se të parën. Uji më hynte nga goja e nga hunda bashkë, stomaku po më ngarkohej me ujë sa më në funt s'kisha ku ta vinja. Hundët, sytë, veshët mënt më pëlcisnin, shpëtim nuk shëkonja gjëkundi! Nga të përpjekurit e të munduarit e pamasë u lodha; më kap një agoni shpirti, një asfyksi, që as dinja ku jam e si të bënj, m'u terë sytë, m'u turbullua mëndja; më hipi një frikë e madhe e vdekjes; e pashë që s'kam shpëtim, edhe për pak po mbaronja. Shkuan më se 5 minuta me këtë poterë e sipër, njeri s'më kish marrë vesh; të qanja, s'qanja dot, lottët më kishin shteruar, njeri s'po dukej të hidhej dot me not të më shpëtonte; hall i math! Nuk mbaj mënt pastaj ç'më ngjau. Një gjë vetëm mbaj mënt, si nëpër ëndër, që mbassi u lodha tepër, më zu një farë gjumi, tamam si një njeri që i vjen gjumë e fillon të dremitë po që e ka edhe mëndjen. Edhe unë e kisha mëndjen akoma. Mbaj mënt se shëkonja ëndra, sikur hidhesha më trish, sikur vajta në shtëpi dhe u shtrova në sofër dhe sikur më qortonte im' më pse u vonova e unë sikur i rëfenja hallin që rashë në det, po shpëtova etj. etj. Mbaj mënt akoma sikur kujtonja Korçën, lodrat, shokët dhe më fort t'ime gjyshe të dashur që do mos e shihja më kurrë. Më së fundi kujtova edhe t'im atë që sa do që më shante për këtë gabim që bëra e sa do helmohej, etj gjer sa humba edhe mëndjen e s'ëndrroja më asgjë, as që mbaj mënt më tutje. Një gjumë i ëmbël më kishte përfshirë, kaq i ëmbël sa s'më vinte mirë të më zgjonin. Ishte gjumi i vdekjes! Po njeriu kur i ka ditët e gjata shpëtokërka si kur edhe të vejë në buzë të varrit.

Një prej shërbëtorëve t'onë, i dërguar nga mëma imë të më kërkonjë kishte ardhur për fatin t'im në sheshin e tragjedisë, cak para disa minutave që do jepnja shpirtin. Ky i shkreti më pa kur mundohesha në det dhe më njohu nga robat dhe mbassi s'dinte vetë not ia kërcet të qarit dhe tuke bërtitur e tuke i rënë kokës del në rrugë dhe lajmëron ngjarjen e keqe duke kërkuar shpejt ndihmë.

Disa djelm opingaxhinj që po hanin drekë aso kohe, lanë bukën të shkretët dhe me një herë u ndodhë në vënt të ngjarjes. Pa humbur kohë hidhen nja 3-4 ashtu si ishin dhe me një herë më zunë e më nxuar jashtë! Unë ahere isha krejt i humbur. As mbaj mënt si më nxuar. A s'kuptova gjë fare. Ata si më nxuar e më ngritnë me kokë tatpjetë edhe si e panë se isha fryrë si kaceke i nxirë në fytyrë e më fort në buzët që i kisha pleh të zeza, e kuptuan se isha mbytur dhe më shtrinë në tokë.

Në atë koh' e sipër brodhë atje një kallaballëk i math, midis të cilëve ish dhe im' atë. Kur më ngritnë edhe një herë ndër duar dhe e panë që mvara kokën, të gjithë u siguruan se kisha vdekur dhe filluan t'a ngushëllojnë tim' atë, tuke i thënë: "kryet shëndoshë"! I varfri im' atë kur më pa në atë hall, mbërtheu duart e shtrëngoj zembrën për gjëmën që e gjeti dhe dy lott të hidhura i rëshqanë ngaj sytë.

Të dy shërbëtorët që kishim Josifi e Filipi kur panë t'ëm atë që po e ngushëllonin burra e gra, u derdhë shpejt të lajmërojnë të mjerën nënën t'ime, nusen – se ashtu i thesha s'im' ëme që në vogli – po, për fat u gjënt xhaxha Ligori në dyqan e s'i la të ngjiten lart në dhomë t'i rëfenin.

Më anën tjetër ime ëmë, qyqarja që s'dinte gjë nga këto po çuditeshe pse u vonova kaqe fort, që s'e kisha bërë tjetër herë e po hante llërët se iku edhe im' atë e xhaxha Ligori e

yzmeqarët e s'kish njeri në dyqan, po edhe sofra mbet shtruar dhe qoftet e shkreta e xhervishi[1] u ftohnë krejt.

Mua më muar në duart ashtu si isha, dhe që të mos më çonin me një herë në shtëpi se kush e di ç'munt të bënte e zeza im' ë në dëshpërim e sipër, më shpunë në Konsullatën e Turqisë në shtëpinë e Konsullit Theofrasto Joanidhit, babës të mikut t'em Jankos. Atje më çveshnë më lanë më lidhë buzën, më ndezë një llambadhe mbi krye, më shtrinë të vdekur të mes të sallës dhe filluan provizorisht të më qajnë dal-nga-dalë, sipas zakonit të grave, pa më prurë në shtëpinë time.

Le të mendohet gjith' cili tani në mos isha i vdekur unë ashtu si i vdekur isha! Le të mendonjë pozitën e të mjerit baba, që po rinte me duart kryq, i brengosur e i fikur me buzën në vrer nga dëshpërimi i math e pa pikën e shpresës për birin e vetëm që e humbi ashtu pa pandehur kot! Le të mendojë nënën t'ime kërcurën, që s'dinte gjë edhe që s'mund të delte as nga shtëpia të merte vesh ç'bëhej, se s'kish me kë të lintë shtëpin' e dyqanin! Po drama mjerisht, a tragjedia po çvidhohej pak hapa m'at'anë shtëpisë së Konsullit Janiot që ishte vis-à-vis[2] me ballkonin e shtëpisë s'onë e që vetëm rruga i ndante.

Nuk shkoj shumë dhe nëna ime e dëshpëruar del në ballkon e thrët me zë herë mua e herë t'ëm ' atë. E mjera imë 'ë! Se qysh bëri, se kush shkoj atje dhe e lajmëron se djali i saj u mbyt e po e kanë në shtëpi të Konsullit! Ahere, oh, ahere s'rëfehet dot gjëndja e agonia e asaj së mjere grua, që humbi më një herë djalin e saj të vetëm në vënt të huaj pa far' e fisin pranë. Lëshohet e ngrata me leshrat e çthuruara dhe s'arrin të vijë te shkalla e konsullatës tuke thirur "bir, o bir Kristaq, o djali im, bir e zeza unë" i ra të fiktët e u përplas aty ku e muar dhe e shtinë brënda më një dhomë tjetër!

Në atë koh' e sipër, mbassi ardhë shumë njerës e po hynin brënda dhe dhoma , ose salla ku isha shtrirë u mbush plot me njerës, burra e gra që po thuaj se qanin të gjithë se më kishin njohur e ju vinte keq, dikush tha se duhet thirur një heqim t'a shohë një herë të mbyturin dhe të vërtetonjë vdekjen e tij, pastaj të lajmërohet edhe Bashkia.

Mjek aso kohe në Karvasara më i mirë e më i provuar ishte Dr. Elia Karajani, një plak serioz nja 70 vjetësh, që e kish shkuar jetën e tij më fort në për spitalet e Parisit. Atë thirë për të examinuar mua. Ish për fat edhe miku i t'im ati.

Posa erdhi Dr. Karajani i shmangej andej këndej grave edhe m'u afrua porositi shpejt të shuajn llambadhën, të hapin të gjitha penxheret e të mos bëjnë zë fare. Dërgoj thiri edhe një farmacist me të shpejtë i cili ardhi sa kaqe, tuke sjellë disa vegla, disa barna nje pendë pate të gjattë dhe një shiringë. Më shtrin, më çvesh më fërkon fort dhe më në funt më bën një inxheksjon. Sa do që njeri s'kuptoj gjë, doktori sheh në sy t'em atë e i bën me shenjë të ketë shpresë. Me një herë im' atë, Konsulli i Turqisë Theofrasti dhe disa të tjerë u avitnë pranë meje. Dr. Karajani më bën një tjetër inzheksion dhe o mrekulli!. . . Unë lojta pak krahun e djathtë. Ahere të gjithë e kuptuan se po rronja akoma. Në atë kohë kish ardhur edhe im 'më brënda ku isha unë dhe zu t'ia kërcasë vajit, po me një herë u dëgjua zëri i ashpër i doktorit "…. . "(shkruar greqisht H. K.)! "Plasja, ose bretku", domethënë e kështu e bëjnë t'ëm ë më nj'anë, tuke e siguruar se jam gjall.

Doktori mbassi më fërkon mirë tëmthat, ballin, xverkun, shpinën, më leu me një mejlem, më vuri ethera në hundët dhe me një herë hapa pak sytë, po prap humba në gjumë. Im' atë i shkreti po më shihte më një angushti zembre dhe me gjithë që e pa se s'kisha vdekur, prapë nuk desh t'i zinte pesë ringjalljes s'ime gjer sa të më shihte në këmbë. Prandaj akoma s'i kishte ikur frika.

Dr. Karajani më ngriti me një herë në bythë dhe tuke më mbajtur farmacisti ndihmës, im'atë dhe dikush tjetër më futi gjith' atë pendë pate në gurmas, të lyer me një farë ilaçit dhe me një herë fillova të vjell ujë deti, që isha ngosur së piri. Ahere më mbajnë barkun e më ulin

[1] çervish = qull që bëhet me miell të skuqur, me lëng mishi e me hudhra (H. K.)

[2] vis-à-vis = ballë për ballë (përkthyer nga frëngjshtja me google H. K.)

kryet e kam qitur kaqe okë ujë! Më së fundi hapa sytë e po shëkonja rotull, tuke u çuditur edhe vetë si u ndodha atje dhe aspak s'më binde ndër ment se disa minuta më parë isha i mbytur e i vdekur!

Si më mbajtnë pak e u siguruan se shpëtova, më muarn me kujdes e më suall në shtëpi t'tonë, e cila, si edhe dyqani përposh gjer ahere kishin mbetur vetëm dhe as që ishte vjedhur një sent. Kështu më ujdisin në krevat dhe sipas porosisë së Dr. Karajanit më zgjonin ç'do orë nga gjumi që me jepnin nga një lugë lëngu prej barit dhe nga një farë pluhuri sipas ricetës së mjekut.

S'rëfehet me ngjyra gëzimi i math i prindërve të mij kur më panë edhe një herë në jetë. Iu vinte si kur u rilinda prapë. Si u bëra fare mirë, pas 3 dittsh, im' atë dha një gosti të madhe, ku thiri shumë miq edhe më fort shpëtimtarët e mij, të cilët veçanërisht i daroviti mirë. S'mbet njeri pa ardhur e pa na uruar. Ngjarja ime, një ngjarje e jashtzakonëshme tundi gjithë Karvasaranë dhe, si ish i mirnjohtur im' atë nuk prani një javë shtëpia e jonë së prituri vizitorë, për të cilët, si më theshnin greqisht unë isha një Shënt-Llazar i dytë. Atë ditë e festonim dhe e festojmë edhe sot për ç'do mot se përveç që koincidon me datlindjen time, por është edhe dita e shpëtimit t'em. Me këtë munda të fitonj një idhe ç'do me thënë vdekje që munt ta them sheshazi, mbassi me të vërtetë vdiqa e u ngjalla si për çudi, se "***vdekja qënka një farë gjumi, ku s'jam i sigurt në shkon apo jo shpirti në atë botën tjetër, që askushi s'e njeh, e në vete në qiejt, në parajsë apo në sketerë, për më tepër jam i bindur se me vdekjen mbaron edhe existence e njeriut si me trup ashtu edhe me shpirt e se përtej vdekjes të gjitha të tjerat që thohen, ose suppozohen janë dokra***. Përveç në mos vdiqa tamam ahere mbasse ndryshon puna.

Po të heqim më nj' anë këtë ngjarje të hidhur, nga të tjerat shkova shumë mirë. U bëra me të vërtetë një djalë i bindur, i urtë, i dashur dhe punëtor. Në shtëpi s'ndjehesha aspak , po edhe në shkollë isha shëmblla e urtësisë e i shokëve.

Nga muaji i Korrikut të atij viti merrnja certifikatën që kalonja në klasën e VI (ose të II-të) të Shollarhios me gradën $9^{12/40}$ dhe me që s'na riheshe në Karvasara, as mua, as s'ime 'ëme – e cila, që ditën që na ngjau e keqja ime s'desh të shëkonte det me sy – u nismë nga Gushti prej Karvasaraje për në Korçë ku n' a shoqëroi edhe im' atë.

## III

U nismë me një kohë shumë të bukur prej Karvasaraje dhe me qenë se aso kohet kishte ndo një muaj që kish filluar shoqërija navigator "Helleniqi Atmoploea" të dërgonte për javë vapor në limerin e Karvasarasë, ne u nismë me vaporin "Hydhra" dhe duallm pas 3 orë në Sallaharë.

Ishte e para herë që lundronja me vapor. Nuk munt të imazhinonja se ajo anije e madhe që lëviste me avull në det do mund të kishte edhe odë edhe krevate e sallone e tryeza e pasqyra të gjatta etj. etj. Prandaj shumë u habita edhe më fort kur e pashë se zu të ecë aq shpejt pa vela, veç se me fuqinë e avullit.

Me babanë shkuam shumë mirë rrugës. Kishim edhe një shakaxhi të math si bashkudhtar një farë Jani Qiritsi samarxhi nga Goshtivishti-Perasi i Kolonjës. Vinte edhe ky në Kolonjë bashkë me ne tuke u kthyer nga kurbeti. E njihnim që në Karvasara, ku punonte samarxhillëkun. Kaqe shakaxhi ishte ky plakosh, sa munt të të bënte edhe të qanje së qeshuri, edhe të mos e shpinte kurrë buzën në gas, gjë që të bënte të qeshnjë edhe më tepër.

Me këtë farë shakaxhiu, që s'pushonte kurrë nuk muarm vesh si u degdismë gjer në Janinë. Një bashkudhëtar kaqe qeshi dikur, sa ment u rëzua nga kali. Një hartofor ose

tahydhrom[1], si e quanim ahere, një farë Numi i Velos, që s'i qeshte kurrë buza, e bëri Jani samaraj të qeshte kaqe fort, sa ju këput oçkuri i potureve. Të gjithë u çkulmë së qeshuri atëhere. Në Kolonjë e në Leskovik e thirnin enkas bejlerët e asaj kohe që t'i bënte të qeshin. S'kish dasmë, s'kish gosti që të mos thirej mysafir Jani Qiritsi. Nga ndo një herë e thrisnin, ose vinte edhe në rast të ndo një vdekje. Tregonte për sh. vetë Jani se kur vdiq një farë Nasuf bej nga Starja, në mes të helmit të zisë, burra e gra kanë qeshur kaqe shumë, sa harruan se kishin të vdekurin përpara! I tillë shakaxhi ishte Jani Samaraj nga Goshtivishti. Prandaj ishte lumëri për ne që e kishim pas atë njeri.

Mbas dy ditsh rrugë arrijmë në Janinën plakë. Hoqmë te i qojturi "hani i Kacimbros", se ahere s'kish hotel në Janinë. Po një mik i babajt, çifut e tregtar në Janinë që e kish klient t'em atë, njeri pasanik që quhej Megjir Jakov, posa që mori vesh se im' atë ardhi familisht në Janinë dërgoj në han vëllain e tij Josanë bashkë me një ortakun e tij Samuel e na muar që të tre në shtëpi të tyre ku na pritnë shumë mirë dhe na rekomandoj me të shoqen e tij Rakellën e me një çupë te vetëm 18 vjetshare Sarinën. Si hëngrëm edhe drekën edhe darkën atje, që të na dëfrente më mirë z. Megjir na mori në një barkë të madhe në liqen të Janinës, në të cilën u futmë Megjiri, i vllaj i tij Josaj, e bija Sarina dhe ortaku Samueli si dhe ne të tre im' atë, im' më dhe unë.

Si shetitmë ndo një orë, Megjiri i thotë së bijës të na këndonjë një herë. Ajo bënte shumë naze e s'deshte. Iu lut ortaku i Megjirit Samueli, prapë s'ish e mundur të këndonte. Më së fundi i thotë Megjiri të vllajt ta bëjë të këndonjë. Josaj ishte një djalë 23 vjetsh, shumë i hijeshëm, si ndo një nuse. Ky ish edhe i vluari i mbesës së tij Sarinës, e cila e dashuronte fort. Kur i tha, pra, Josaj të marrë një këngë, ajo unji sytë e qeshi dhe që të mos përshpjegohej tha: Do të këndonj për hatër të miqve, të qir Vasilit (t'im 'eti) edhe të zonjës (s'im'ëje). Edhe ja filloj me një herë edhe Pale këngës. Këndoj aqe bukur e me një zë melankolik, sa na habiti të gjithëve. Kaqe ëmbël e me aq një madhështi që këndonte. I 'ati u ngrit, e puthi në ballë. Im 'atë e daroviti një flori Austrijet 3 napolonash, më fort si darovë dasmet se ato ditt do martohej me Josanë. Im 'ëmë nga ana tjetër i dha një karficë të florinjtë. Sarinës dhe të tjerëvet çifutë ju bë shumë qefi prandaj Sarina n'a këndoj kush mban mënt sa këngë të tjera të kandshme dhe Megjiri me të vllezërit e me disa çifutë të tjerë na përcuall të nesërmet me kuaj një orë jashtë Janinës. Atë natë mbi liqenin e Janinës e me ato këngë nuk do të harronj kurrë. Natë me të vërtetë poetike, magjike.

Me qenë se në Greqi kisha kënduar vjershën e bukur të qira-Frosinit, të dashurës të Muhtar Pashës, që ishte i biri i Ali Pashë Tepelenës, dhe të cilën e desh fort vetë vjehri Ali Pasha, dhe mbassi ajo s'desh t'i binte në dorë e mbyti tinazi në atë gjol një natë bashkë me 17 gra të tjera, atë natë pra e solla ndër mënt qira Frosinin, dhe pyesja Josanë se më ç'vënt është mbytur këjo qira Frosini prej Ali Pashës. Edhe ajy bashkë me Sarinën më tregonin një vënt aty afër nisisë[2] së Janinës, ku kish Pallatin Aliu. Vjershëtari Grek i Lefkadhës Aristotelis Vallaorits (thohet se origjina e tij ishte nga Voskopoja, si dhe vetë e tregon në "Memories" e tij), ky vjershëtar, po thom, me kaqe aftësi e hollësi dramatike e përshkruan këtë histori, sapo t'a këndonjë me vërejtje njeriu do kuptonjë se me të vërtetë është në atë vënt edhe se përpara tij çvillohet gjithë ajo dramë.

Si u ndamë nga miqtë çifutë vazhduam rugën e gjattës, tuke hequr për në hanin "Negradhes" ku do të flinim atë natë. Filluan prapë shakatë e Janit Samarajt. Sesi na u ndoth kali i tij qor nga syr' i mëngjër dhe bëntë ç'bënte pengoheshe nga ajo anë, sa mënt na e rëzoi Janin kaqe herë. Të gjithë qeshnin sa herë i pengoheshe kali Janit. Jani, tuke parë këtë hallin e kalit e thiri të zotin, qiraxhinë, që së largu – o Demir, o Demir. – Lepe – gjegjet Demiri - . Ore, pafsh Pejgamerët e pilafet e hyrijet hajde këtu pak. – Ç' urdhëron qir Jani? – Ja e bëj

[1] dromos = rruga (nga greqishtja, kështu që termat hartofor dhe tahydhrom duhet të përkthehen "udhrrëfyes", por për këtë nuk jam i sigurt H. K.)

[2] nisi = ishull, ujdhesë (H. K.)

këtë kalë të mos qorolliset[1] se do më mbinjë gjëkundi si ndo një presh, ja se po qitja edhe syrin tjetër të shpëtojm' një herë e mirë. – Qeshi Demiri dhe ne bashkë. – Ore, usta Jani, po ç't'i bënj un' i mjeri, kur ja ka dhënë zoti këtë hall? – Ahere Jani nxjerr një shami të kuqe nga sillahja[2] e sbret poshtë e ze t'i lidhë sytë kalit. Ç' bën ashtu maestro Jani, i thotë Demiri? – Lëmsh të bëhesh ti bashkë me qorin kalin t'ënd. Mbassi ti s'do t'a nxjerrësh sŷnë, unë do t'ia lith që të dyja, që kur të bjerrë të dijë si të bjerrë, or buf i kënetës! Ja t'ia qit, ja t'm'i qitë…Mos qesh pastaj me Janin.

Këto edhe shumë të tjera na bënte Jani Qiritsi që na u bë çështja e ditës. N'a bëri një shaka tjetër kur shkonim vahun e Vijosës, sa mënt na u mbyt një prej udhëtarëve. Se ishim nj'a 15 shpirt gjithësej. Si e pa se një prej udhëtarëve ishte shum' i shkurtër edhe pak leshko nga mendja, para se të shkonim Vijosën, me qenë se ajy udhëtari po i tregonte si iu marrë menttë një ditë kur shkonte një lumë, Jani Qiritsi e këshilloj se duhet që të lidhë sytë që të mos shohë. Ashtu bëri edhe ajy fukaraja. Jani ja lidhi mirë sytë e e hipi në kalë dhe ia lidhi kalin pas samarit të tij. Po këtu i lojti një dhelpëri të ngratit. Si i lidhi sytë , e hipi mbi kalin e tij qor, dhe vetë hipi kalin dori të udhëtarit shkurtabiq. Si zunë të kalojnë vahun, kali qor i shkurtabiqit, si pas zakonit që kish n'a pengohet. Shkurtabiqi mbassi nuk shëkonte e humbi terezin i ziu dhe ra në lumë edhe për fill mënt na u mbyt, se i shkau këmba përtej vahut. U ndodhë dy prej qiraxhinjve afër e mezi e tërhoqnë e e shpëtuan. Ne u këputmë së qeshuri. Por shakaja më e madhe ishte kur para se t'i zgjidhë sytë shkurtabiqit, Jani hidhet në lumë, mer kalin qor të tij, lë kalin e shkurtabiqit dhe hidhet më këtë anë.

Kishim ardhur në fshatin Ostenica, ku n' a zuri nata në një fushore gjelbërore. Qiraxhinjë thanë të flemë atje atë natë dhe të nesërmet te ngriheshim herët që të arrinim Kolonjën. Fshati Ostenica ishte ndonjë orë lark. Han aty s'kishte. Do të flinim jashtë në luadhet. Kështu edhe bëmë, çkarkuam kuajt shtruam disa velenxe e mutafë[3] kuajsh e ramë të flemë, mbassi hëngrëm bukë pa perënduar Dielli.

Mëma imë shumë herë shihte ca ëndra të çuditshme. Disa herë kishte një telepathi që tregonte ca gjëra, të cilat më vonë delnin të vërteta dhe çudia ishte këjo që, takonte ngjarja e tyre bash në atë kohë që e parashikonte im' ëmë. Do të tregonj këtu një shëmbëll të vogël për të vërtetuar këtë telepathinë e nënës simë.

Kishim një unq të math, xhaxhako Dinçe-Pramatarin, që ish i shoqi së motrës t'im gjyshi Annes. Ky një dit na vdiq. Mbassi e mbuluam e vinim me t'em ëm për natë që e ngushëllonim teto Annën edhe flinim atje. Një natë im 'ëm pa një ëndër të çuditshme dhe e tregonte të nesërmet përpara teto Annës, të bijave të saj edhe dhëndrit të saj Taçe Dhespotopullit. Sikurse po lante në çeshmë të Kyroakos, n'mëhallen t'onë sa shamiçka dhe sikur kaloj aty njatë xhako-Dinçja bashkë me një burrë të gjatë e të hollë, të zheshkë e të lijosur me xibuna e me kallca shajaku dhe me një takije[4] të lyrosur në kokë. Si kur e përshëndoshi t'ëmë dhe si kur i tha: A e sheh këtë njeri, moj bijë? – Po xhaxha - E kam mik dhe është nga Porodina. Më ka dhënë hua 3 shinikë[5] urof[6] për farë vjet. Unë simvjet ja ikonomisa dhe ja kam përposhë në qilarin t'onë, në hambarin e vogël po harrova t'i thom s'at'ëme (do me thënë të shoqes) e cila s'e di e do mos ja japë pa fjalë. Po ti, moj bijë vëre re mirë këtë aganë (dhe ja tregoj me gisht) edhe thuaji s'at' ëme t'ja japë se më ka bërë të mirë agaj. Dëgjove? – Po xhaxha. Eh, lamtumirë bijë. Edhe hiku Dinçja me gjith' aganë.

---

[1] qorrollisem = 1. -pengohem diku dhe rrëzohem ngaqë nuk e shoh mirë rrugën, 2. - Eci në rrugë zë gabuar nga padija apo nga mungesa e përvojës, veproj verbërisht. Rrënja e fjalës është "QORR" (H. K.)

[2] silah = brez i gjerë lëkure, shpesh i zbukuruar me qendisje të arta (H. K.)

[3] mutaf = mbulesë zakonisht prej leshit të dhisë që hidhet sipër vitheve të kalit (H. K.)

[4] takije = lloj ksule me majë të ngushtë prej pëlhure të bardhë dyfishe, të rrahur me tegel që e mbajnë fshatarët e Myzeqesë (H. K.)

[5] shinik = enë druri e rrumbullakët, që shërben si masë drithi(nxen nga 25 deri 110 okë H. K.)

[6] urov = bimë barishtore që përdoret si ushqim për kafshët (H. K.)

Këtë ëndër e tregonj fjalë pas fjale, si e kishte përsëritur shumë herë im' më. Por kur ja tha teto Annës ajo u hoth përpjetë. U kutra, burri im të ketë hua gjësendi e të mos ma rëfenjë mua? S'është e mundur. Protestonte teto Anneja. Mirpo, pa mbaruar fjalën im' ë trokëlliti dera e sokakut. Shkon yzmeqarja e e hap e hyn një burr' i gjatë brënda në hajat. Pyet shërbëtoren ku është qir Dinçja (se s'e dinte se vdiq) edhe mbassi shërbëtorja i tha se vdiq afendikoj Dinçja, njeriu i huaj zu e po thoshte: "oh, jazëk, oh jazëk, oh, i mjeri si s'e pashë edhe një herëetj. etj. ", thosh.

Gratë po dëgjonin që lart. Im' ë shtie sytë nga penxheretë e e sheh njerin' e huaj tamam atë që kish parë atë natë ëndër, që ia kishte rëfyer xha-Dinçja. Mveshur e mbathur ashtu si e kish parë e e kish treguar. Iu thotë grave të tjera: Ja ky është ajy që pashë në ëndër bashkë me xhaxhanë. Hidhet i dhëndri i Dinçes Taçja e e pyet në e njihte të ndyerin Dinçe. Si s'e njihja, thotë i huaji, e kisha shumë mik e ardha t'a shoh, po ajy paska vdekur, Jazëk, jazëk! Dhe po ngushëllonte Annën e çupat e saja, të cilat s'e njihnin, se s'e kishin parë ndo një herë. Mbassi piu një kafe e pyet prapë Taçja pse ka ardhur Agaj e s'desh të rëfente se i vinte turp, mbassi ngjau edhe vdekja, po Taçja insistonte. Ahere Agaj i huaj çel gojën e thotë, se vitin e shkuar i pat hojtur 3 shinikë urof për farë e i kishte thënë para dy javësh i ndyeri Diçja që të vinjë në shtëpi e t'i marrë se ja ka vënë më' njanë në hambarin e vogël. Këto fjalë bënë aqe një përshtypje të madhe sa gratë u panë sy ndër sy njëra me tjetrën e nuk e shpjegonin dot këtë mrekulli.

Mirpo teto Anneja protestonte që s' ka gjë në hambar dhe agaj zu të ikte. Po Taçja zbriti shpejt në qilar, pa në hambarin e vogël dhe për çudi gjeti të tre shinikët me urof që i ndyeri Dinçe i kishte lënë atje për aganë.

Të këtilla ëndra shihte nga ndo një herë herë im' ëmë. Pra, atë natë që fjetmë në livadhet e Ostenicës, aty si nga gjumi i parë, im 'më, e cila më kish marrë në mest mua si edhe im' atë sheh në ëndër sikur dy veta të panjohur po na afroheshin të na plaçkitnin. Zgjohet tuke u trëmbur, edhe me të vërtetë 10-12 çape përtej prej nesh zgjateshin dy hije, dy sillueta të zeza, të frikshme. Im' ë e zgjon shpejt babanë. Babaj le t'a themi këtu ishte shumë trim e kuximtar. Sikur se ishte një levent nga shtati, këngëtar e vallëtar nga të rallët ishte edhe trim edhe nishanxhi i prapë. Kudo ecte i armatosur se ishin edhe kohët anormale e i kishin ngjarë shumë aksidente në jetën e tij. Zgjohet, pra, im 'atë shtije sytë dhe i sheh ato të dy hijet. Hej!. . . Hej përgjigjen të dy hijet. Ç' jini ju? – Njerës të mirë, përgjigjen hijet. Kur jeni të mirë pse vijni natën dhe nga dalë si kusarë? Dhe më një herë kap shashepon (chassepôt) e tij të mbushur që e kishte pranë e ngrihet më këmbë. Poshtë armët ju thot' im' atë. – S'kemi armë, zotni, po rini rehat se s'ju trazon njeri, thon' ata e zenë ta largohen me vrap. Im' atë ju bie pas më t'erët. Dëgjohen ca zëra përtenj në disa dushnja[1]. Duket se janë edhe të tjerë njerës e po llafosen. Çështja u muar vesh prej gjithë karvanit t'onë, ku ishim 12 burra, 1 grua, e dy fëmijë, unë dhe djali i Jani Qiritsit. Të gjithë të tjerët ngrinë në lëkurat e tyre. Jani Qiritsi i la shakatë e s'dinte ku të futesh. Vetëm im' atë dhe një prej qiraxhinjëve qëndruan burra.

Iu thot' im' atë të gjithëve mos tunden po të qëndrojnë në vëndet e tyre. Im' atë mer qiraxhinë trim, të cilit i jep pushkën dhe fyshekët e Jani Qiritsit, që i mbante vetëm për kapadaillëk dhe nisen që të dy përpara. Më kot im' më desh ta ndalonte, e unë, si çilimi po qanja se na ikte babaj. Ajy s' dëgjonte prej atyre.

Po pa bërë 100-150 çapë krisi një pushkë nga ana tjetër edhe pas asaj një tjetër. Ne ngrimë të gjithë. Ora ishte një pas mesit të natës. Im' atë me Seferin (qiraxhinë) zunë me një herë vënt, por nuku shtinin. Pas cazë edhe dy pushkë të tjera ranë, po prapë im' atë nuk shtiri, as qiraxhiu. Si shkoi ndo një orë kështu në një pushim të thellë filloj nga pak të zbardhëllonjë dita sa mezi njiheshe njeriu. Ahere çquan im'atë se ata ishin 6 hajdutë, se zunë e po ngriheshin nga pritat e tyre. Dy prej sish, si u siguruan se s'ka ndo një frikë u nisnë të

[1] Dushnjë = shelgjishte të ulta, ferrishte (K. F.)

plaçkitnin karvanin t'onë, mbassi dy prej qiraxhinjëve po pregatitnin kuajt që të niseshin të gjithë.

Kur i sheh im' atë se po i vërsuleshin karvanit ata të dy të armatosur kusarë, ju bërtet ashpër të largohen. Po ahere një pushkë i përgjigjet t'im eti nga an' e të katër kusarëve të tjerë që kishin zënë vënt. Im' atë s'ja vonoj ahere e fishëlloj shashepoja e tija breshâne e plagos në gishtat njërin prej atyre të katërvet, të cilët kur panë gjak kështu pa pritur, u tërbuan dhe zunë po shtihen rëndom mbi t'im atë. Në atë ças një prej atyre kusarëve që ishin më këmbë e po afroheshin të na plaçkitnin i bërtet t'im eti: " Ri urtë, bre kaur i derit, se do t'ju therim njerëzinë që keni këtu. Edhe filloj të shtjerë mbi ne. Po pa shënuar mirë, bam një pushkë tjetër edhe bie i vrarë mbi dhe! E kishte shënuar im' atë tamam nga tëmthi i djathtë. Tjetri kusar, shoku i tij iku shpejt tuke u ulur e diku duke u hequr barkazi.

S'rëfehet ajo që ngjau ahere. Lufta filloj e ashpër, po im' atë shtije shumë rallë me gjithë qiraxhinë trim, që të kursejnë fyshekët se s'kishin shumë. Ne u larguam tuke lënë ç'kishim dhe u futmë afër një prrojë të vogël. Zembrat n'a dridheshin të gjithëve. Lufta po vazhdonte. Në koh' e sipër i thret kapetani tim' eti të bëhen teslim[1], ndryshe do t'i bijen karvanit, edhe me qenë se im' atë kish zënë vënt të mira e s'përgjigjej ata shtijen dhe vrasin një kalë t'onin. Për fat ishte kali qor i Jani Qiritsit!

Tmer e llahtar n'a kapi të gjithëve se po na shkonin mbi krye disa plumba. Për fatin t'onë të mirë del një paganja me armë nga fshati i Ostenicës se kishin dëgjuar pushkët dhe po na afrohet. Një prej karvanit t'onë nga Leskoviku ju del përpara e i lajmëron se ata andej janë hajdutë që na ranë në qafë. Dikush prej paganjasë shtije mbi hajdutët se i kishte përposh dhe plagosi rëndë vetë atë kapetanin. Kusarët kur panë se po bijen midis dy zjareve lanë menjë herë pritat e tyre dhe lëshohen tatpjetë një lumi të vogël. Paganjaja ju bie pas e po zbras disa dyfegje mbi ta gjer sa ata u futnë në një pyll e s'u duknë më!

Kur pushoi lufta na u afruan Ostenicjotët, si edhe im' atë me qiraxhinë trim u bashkuan tok dhe po ngushëllonin shoqi-shoqin për të keqen që na gjeti e që shpëtuan faqebardhë.

Si mbaroj tevaturi[2] dhe qiraxhinjtë zunë të ngarkojnë kuajt, shohim që kali qor i plagosur rëndë s'kish shpresë të kthehesh në jetë. Seferi i varfër, - se i atij ish kali – e pa e i ardhi keq shumë. Po qir Jani Qirici s'e linte me gjithë hallin e tij, po i thesh "pse më le pa kalë", ose "mirë të thashë unë t'ja qitnje edhe syrin tjetër; tani të ardhi keq për syrin, qaje tani kalin", etj. Po Seferi ia prêt: s'ka gjë se më shkoj kali e u bë kurban, po ja, edhe ti, qir Jani, mos kij keq se më krahë do të shpie në Kolonjë, pas na turpërove sot, jazëk që je Kolonjar! Edhe Usta Jani i gjegjet: Pse mos të thuash Sefer agë se ardhë më more armët pa lejen t'ime e shkon të luftosh me qir Vasilin (t'ëm atë). - Po pse s'ardhe të m'i marësh atje ku kisha zënë vënt. Pse?. . . Nuk e mer vesh i thotë Jani? Pse…s'ma mbante!. . . U këputmë së qeshuri të gjithë me qyfyret e Janit.

Më pakëzë dhe niseshim të gjithë dhe Jani Qirici më këmbë. Kalit që i qitmë samarin e të tjerat e e lamë të ngratin se po iqte shpirt. Ostenicjotët na përcuall gjer sa zumë xhadenë, tuke u drejtuar në Leskovik.

Nuk do t'a harroj kurrë atë sqenë të tmershme, që na panë sytë atë ditë! Të gjithë e lëvduan babanë për trimërinë që rëfeu se ndryshe do na çvishnin krejt ata kusarë, të cilët për atë qëllim ardhë me kallaus. Po mbi këto s'duhet harruar edhe ëndra e telepathia e t'im ëme.

Si vamë në Leskovik e hëgrëm drekën, u drejtuam në Kolonjë dhe pa perënduar dielli ishim në Ersekë.

Atë natë n'a u nda qir Jani Qirici se shkoj në Goshtivisht. Na la shurdhër nga shakatë. S'kishim mbetur përveç se ne me t'em atë e t'em ëmë, dy dardharë dhe qiraxhinjtë. Të nesërmet, pik' e mëngjezit na zuri mbi kullën e Qarit. Me një herë zbardhi së largu si një nuse e bukur Korça e jonë. Im 'ë dhe unë qanim nga gëzimi dhe s'na duroheshe dot gjer sa të

[1]teslim = dorëzanës (H. K.)

[2] tevatur = zhurmë që bëhet për një njeri apo çështje (H. K.)

sosemi. Si zbritmë në fushën e bukur të Korçës, pas 3 orë ishim në Drenicë, ku kishin dalë shumë prej gjinisë s'onë, burra më fort e çiliminj e po na prisnin se ishin lajmëruar më parë. U poqmë atje e u përqafuam njëri me tjetrin e kështu pas gjysmë ore hynim në Korçën e dëshëruar. Afër shtëpisë na del ime gjyshe e gjora me teto Ndinon e gra e teto e kushërira të tjera e na zbresin prej kuajve e qanin me lott e më s'ngopeshim dot nga malli që mezi na panë edhe një herë.

Kështu arthmë edhe një herë në patridhën[1] e shejtë që kaqe kohë e kishim dëshëruar dhe u sheshtuam. Im' atë ndenj në Korçë edhe dy muaj akoma dhe mbassi më vendosi mua në shkollë e vuri zahiren e shtëpisë që duhej për motin, na la ne në Korçë dhe vetë u nis për Greqi.

Përpara se të niset më shpuri në shkollë, tuke qenë bashkë me xhaxha Ligorin. Më paraqitnë përpara direktorit të shkollës së naltë z. Harallamb Karmicit. Shkoll' e naltë përbëhej prej klasave të shkollës hellenike (shkruar edhe greqisht H. K.) dhe prej një klasit, klasit të parë gjymnasial, pas systemit shkollor të vjetër.

Z. Karmici, si më pa e më examinoj pak, si pa dëshminë t'ime që kisha mbaruar në Karvasara klasin e parë hellenik dhe nga ana tjetër që dinja edhe greqishten mirë, tha se munt të më venë në klasin e VII ose të III hellenike, në vënt që të më vinte në të II hellenike. Po babaj bashkë me xhaxhanë insistuan që t'i shkoj klasat me radhë edhe kështu hyra në klasin e VI ose të II hellenik. Isha ahere 10 vjetsh.

Kur vajta në shkollë gjeta shumë shokë prej atyre që më kishin kaluar kur mbeta dy vjet në klasin e II popullores, po gjeta edhe disa grezdenë[2] shoq, burra pothuajse nga 16-20 vjet secili, që unë isha më i vogli nga të gjithë. Në këtë klas isha me të vërtet më i miri, a më mirë me thënë, i pari i shokëve. Kisha ahere si msues Sotir Nasen, Nikoll Pigadhanë, Anastas Anastasiadhin, ose Bixhon edhe Petro Harisin. Isha shumë m'i zoti nga gjithë shokët në msime.

Këtë vit një tjetër aksident më ngjau, që më la edhe sot me mëane apo sakat. Kishim brënda në avullin' e shkollës gjithfarësh orendi gjymnastike të ngulura në dhé si p. sh. monozygat, dhizygat, krikot, anavathrën që hipnje me të duart ose me nganjë dorë e me tjetrën e zbrinje, 20 e ca doreza druri etj. etj.

Unë, si i lehtë që isha msova shpejt gjymnastikë, aqe shpejt aqe mirë sa ju tërhiqnja vërejtjen gjithë shokëve sa edhe msuesit.

Një ditë, tuke qenë një kallaballëk i math, nxënës, mjeshtrash edhe sehirxhinjsh të tjerë e ku po ushtroheshin disa djelm, profesori i gjymnastikës më thret mua me embër e më urdhëronj të bënj rolet më të zorshim në gjymnastikë. Edhe unë u çvesha dhe fillova si mbas urdhnit. Në fillim shkova shumë mirë, por kur hipa disa herë e zbrita në anavathrë ose klimaxin (shkallën) disa herë, profesori më urdhëron të ngjitem dymezaj e të zbres dymezaj, do me thënë tuke lënë tuke lënë njërën shkallë e tuke hipur mbi të 3-ën, të 5-ën të 7 e gjith ashtu, ashtu edhe të zbrisja me të duart bashkë. Unë, me gjithë që isha i lodhur s'i kundërshtova profesorit, po u çlodha pak e fillova prapë.

Po ç'ngjau ahere? Kur hipa, hipa mirë gjer në krye, por kur zura të zbres me të parën që u lëshova prej të 20-it dru të shkallës në të 18 kërcet njëri prej drurëve që ishin nga 3 pogjt dhiametri thyhet e unë si s'u mbajta dot me një dorë, humbas equilibrin edhe rëzohem prej një naltësije 10 metrash me gjithë fuqinë hundëzoj për dhé, ku vëndi ishte kalldrëm me gurrë! Kuptohet se sa rashë m'u pre fryma edhe e humba mëndjen. Me një herë më laknë, më fërkuan por s'vinja ndër mënt. Më shpunë në një farmaci në Pazar për ndihmat e para, ku mezi më ngjallë, më lidhnë plagët e më shpunë me tesqerë në shtëpi! Nuk mund të rëfej dhëmbjet e mbëdha që hoqa, se kisha çarë më disa vise kokën, kisha disa plagë në fytyrë, kisha thyer krahun e djathtë e më fort kisha thyer hundën! Ah, hundën që edhe sot mbeta

[1] patrida = atdheu (përkthyer me google nga greqishtja (H. K.)
[2] grezhë = qime të forta që u dalin burrave në mjekërr (H. K.)

sakat se s'muntnë të m'a sjellin dot në vënt heqimët, sado që u munduan. Edhe sot, përveç që m'u thyer kërcka e hundës e më mbet hunda e shtrembër po m'u zu edhe ana ose vrima e djathtë e hundës, e sot nuhat vetëm nga njëra anë! Kështu lëngova një muaj plot në shtrat gjer sa u shërova.

Më në funt ardhi edhe provimet. Me gjithë që kisha munguar një muaj e ca nga shkolla, kur dhashë provime dolla prapë i pari. Kështu kalova në klasin e VII, ose në të tretën hellenike, ku isha prapë i pari mbi të gjithë. Ky mot 1884 ishte një mot lumnije për mua se më 14 të Janarit të këtij viti, si thashë edhe tjetër herë, m'u lint një vëlla, vëllaj im Thanas Floqi, që sot është avokat në Elbasan.

Im' ëmë, e cila kish 11-12 vjet që kishte pushuar së pjelli, këtë radhë, për çudi, mbet me barë që të sillte në botë një djalë si ëngjëll, t'em vëlla Thanasin, të cilit u vumë këtë ember, se e solli, si deshin të theshin, Zoti Shën-Thanas.

Kur u lint im vëlla, kishim në shtëpi mysafirë një kushërirën time nga Dardha, të bijën e Zoitsës, së motrës tim 'eti, Efvgjeninë e Anagnost Ramanit. Sado që binte dëborë në orën 10 të natës alla-franga, ne me Efgjeninë u mveshmë dhe duallm në mes të dborëspër të dhënë myzhdenë dhe gjer në mëngjes vamë në te gjith far' e fisin tonë e mbluathmë mjaft bakshishe. Ime kushërirë Efgjenia ish nja 16 vjetsh ahere edhe unë nja 12.

Pas ca muajsh martoheshe Efgjenia, ose Nija, në Dardhë dhe u nismë edhe për dasmë. Ishe ahere edhe im 'atë. Vamë një karvan veta gra e burra. Udhës, në vëndin që quhet "Skerkë", na dalin disa hajdutë. Im 'atë posa i pa me dylbi që për së largu e kuptoj punën se s'ishte mirë dhe desh që të na kthente të gjithëve. Po mjerisht kishin rënë të gjithë në pusi e nuk ish e mundur të shmangeshim. Siç u muar vesh, ata kusarë ishte çeta e famëshme e Abidin Shagut, një kapitani të dëgjuar, që ishte tmeri jo vetëm i Sanxhakut, por edhe e gjithë vilajetit të Monastirit. Ishin ata 8 shpirt.

Im 'atë, si e pa që ramë në pusi, pa n'a thënë gjë ne u tërhoqme një herë dhe zuri vënt vetë prapa një shkëmbi. Hajdutët nuk e vunë re, po si bërtitnë gratë (ishim 5 gra unë dhe nipi i një tim 'eti, Kristo Koleci nga Vithkuqi, një djalë 22 vjetsh, që dukej si një luan dhe lëvdohej për trimëri, po s'bënte asnjë ovull[1]), pra si bërtitnë gratë: "O Vasil ku je", tuke i thirur tim 'eti që s'po e shihnin, hajdutët veshgëlluan andej këtej edhe e dalluan pak t' ëm atë prej një gune që kish të murme e të dhirtë. I thret kapiteni t'im eti "të lidhet" do me thënë të japë armët, po im' atë as që u përgjiq as u tunt nga vëndi. Karvani me gratë e me Kristo Kolecin në ballë si dhe unë që më kish përpara Kristo Koleci mbet e më s'bënte udhë. Im 'atë bërtet një herë "shkoni përpara karvanin", po me azallah se kuxonte të shkonte njeri. Ahere i thret edhe një herë kapiteni tim' eti "ore do të bëhesh teslim, apo të bëjmë copë? Si e ke hallë?" Edhe me që s'ju përgjegjeshe im 'atë, kapiteni dërgon dy veta që të më marin skllaf mua. Këtë e dëgjoj im' atë dhe iu trëmp zembra se mos pësonja gjë unë. Me një herë duall dy veta nga prita e na u derdhë neve. Do ishin nja 22 çape larg prej atyre, kurse im' atë ish 400-500 çape lark mbi një gurishte "Skërkës" së keqe. Im 'atë si e sheh që u lëshuan ata të dy të më mernin skllaf mua, s'ja u hasmëris po bam njërit dhe e shtrin mbë dhe, sa të zërë të ikë tjetri, të krismet dhe atij dhe e rëzoj edhe atë për dhé! U ndez dyfeku ahere, ne se si bëmë edhe ja u ngamë me vrap kuajve dhe shpëtuam, me gjithë që na shtinë disa plumba që prapa e plagosnë në krahët vetëm një dardharkë dhe Kristo Kolecit i muar festen plumbat. Dëgjojmë një 'ohhhu!" Ishte vrarë edhe një tjetër, mbetnë 5 me një. Lufta po vazhdonte. Bëjnë një yrysh hajdutët mbi tëm' atë, po plagosen dy prej tyre, prej të cilëve njëri rëndë. Mbenë 3 me 1. Disa dardharë po vinin që poshtë dhe qëndruan e bënin sehir luftën. Me azallah se kuxonin të shtinin me gjithë që kish dy veta prej syresh pushka shishanera.

Kapiteni si e pa se ju vranë 3 e ju plagosnë dy, më s'hodhi më, po largohet shpejt me të 5, prej të cilëve njëri i kishte mbetur rrugëve. Karvani kishte shpëtuar e kishte dalë afër Shën

[1] ovull = Monedha më e vogël turke, që ishte prej bakri dhe vlente një parà (H. K.)

Thanasit të Dardhës. Im ‘atë ndënji edhe ndo një gjysmë ore atje dhe pastaj, tuke u drojtur kurdoherë levendin[1] që kish zënë dhe tuke bredhur piqet me dardharët e tjerë më poshtë e zbresin të gjithë në Boboshticë. Shkuan me të shpejt në Korçë dhe lajmëruan Qeverinë, e cila nisi 20 shpirt me të shpejt me një yzbash në krye, me të cilët u nis edhe im’ atë. Kur vanë në vënt, gjetnë të tre të vrarët dhe ju muar kokrat e i shpunë në Korçë. Tjetrin, të vrarin s’e gjetnë. Pas dy javë çeta e Abidin Shagut u përpoq me një koshare tjetër nga Nikolica ku u vranë të gjith’ hajdutët.

Im ‘atë bëri si bëri vajti në Dardhë dhe u ndoth edhe në dasmë të së mbesës, Nijes. Si ndenjmë ca dit në Dardhë u kthyem prapë në Korçë me suvarinj[2]. Kur ardhmë në Korçë n’ardhë vetë mytesarifi i Korçës në shtëpi dhe falenderoj t’ëm atë për të mirën që i bëri shtetit dhe veçanërisht Vilajetit të Monastirit, i tha se do shkruante në Babi Ali që t’i jepnin një shpërblim të math për këtë bamirësi, si dhe një nishan nga Sulltani. Po e vërteta është që im’atë s’pa asnjë fletë preshi nga Qeveria, ose nga Sulltani. Të ishte gjetkë sa do çmoheshe një trim i këtillë, që s’e kishte shoqin!

Kjo ngjarje bëri një bujë të madhe në gjithë Vilajetin, që edhe sot shumë njerës e mbajnë mënt në Korçë këtë dhe e tregojnë. Nga gjithë soji i jonë im’ atë ishte korona e tyre, ajy që nderonte te gjithë sojin. Shumë pleq në Floq mollojisnin se Vasili (im’atë) i ngjiste stërgjyshit të tij Tomços, që bëri aqe mrekulli pranë Ali Pashajt e pranë Napoleonit të math. Po edhe im gjyshi Risto Styllua Tomçua, nuk binte poshtë. Harrova të përmënt që edhe ajy mori pjesë në luftën e Krimesë më 1854 me anën e frëngjëve, ku fitoj edhe ky dekoracjonin “Legion d’honoeur”. Edhe im ‘atë, i cili më 1885 mori pjesë me disa kryengritës kundra Turqisë kur krisi lufta në Thesali e mori nga mbreti Georgji I i Greqisë kryqin e Taksiarhëvet (shkruar ndër kllapa greqisht H. K.), të cilin e kisha parë edhe unë e e mbaj mënt mirë po s’di se kush grabiti nga shtëpia.

Tuke i dhënë funt kësaj historisë së hajdutëve s’harronj të shtonj edhe këtë, se kushërir i jem Kristo Koleci, të cilin e la im ’ë me gratë kur na duall kusarët, ky farë daiu me gjithë që kish një goxha shashepo të shkurtër përsipër dhe fyshekë plot as kuxoj të qitë një pushkë kur pa t’im atë në rezik! Im’atë i foli rëndë kur e pa në Dardhë, po ajy e lau vehten, tuke thënë se ishte i shtërnguar të rinte me gratë, se ku munt t’i linte, sikur se po t’ na kish gjetur gjë ne do n’a mpronte kapadaiu Kristo Koleci! Im’atë qysh atë ditë as i foli më me gojë Kolecit, as e afroj në shtëpi t’onë. E quante me ironi “Miu me mustaqe”.

Këto ngjisnin në muajin e Majit. Nga Korriku i atij viti dhashë provimet e u hodha me gradën më të naltë në klasin e I gjymnasial, që korespondon sot me klasin e IV gjymnasial. Veçanërisht mora edhe një peshqesh këtu nga Dhespoti i Korçës Filotheu me që dolla më i miri i shokëve.

Në atë mot (Vjesht’ e parë 1885) kur bënja klasin e I gjymnasial krisi edhe lufta e Turqisë me Greqinë. Im’atë me disa kapetanë të tjerë, më fort dardharë ishin në marrëveshje me kryeministrin e ahershëm të Greqisë Theodhor Delijanin, që në qoftë se liroheshin vëndet t’ona dhe më fort Epiri me një pjesën e Maqedhonisë gjer në liqenin e Ohrisë, të jepej një autonomi e plotë të asaj zone. Me gjithë që Qeveria Greke ja u refuzoj në krye këtë proponim, po tuke pasur provën e traktatit të Berlinit më 1879 që s’mundi të zaptojë Epirin gjer ne lumi i Kallamajt, ku e ka edhe sot kufirin për shkak se kundërshtuan Shqiptarët me armë në dorë e s’e lanë të kapërxenje Prevezën, prandaj ju a pranoj Shqiptarëve propozimin me disa kondita, që atyre viseve do t’u jepej një autonomi e gjërë nën mbretin e Greqisë, të cilin Shqiptarët e pranuan dhe muar pjesë në luftë, ku im’atë e me Jovan Themelinë nga Dardha ishin prijsit kryesorë. Po lufta e vitit 1885 dështoj pa nisur mirë dhe Greqia e pësoj dhe andartët[3] shqiptarë

[1] levend = Shtathedhur, i shkathët e i zhdërvjellt, i fuqishëm e trim (H. K.)
[2] suvari = kalorës përkthyer me google nga turqishtja (H. K.)
[3] andart = komit (H. K.)

fituan që hupnë mjaft të holla si dhe punën e tyre dhe s'ktheheshin dot më në Shqipëri se ishin të përshkruar (proscrits[1]). Prandaj edhe s'ardhi më im'atë në Shqipëri.

Atë vit unë vajta mirë në shkollë edhé u çvidhova mjaft. Pata fat se i vllaj më i vogli i sim'ëje, xhaxha Kristua një djalë 26-27 vjetsh i mirë e i sjellë dhe mjaft i qytetëruar, si frangoraft që ishte njihej me shumë njerës me të cilët më bënte të njohur edhe mua dhe zura të zhvillohem mirë.

Ahere kishte nisur edhe propaganda shqipe në Korçë.

Në Stamboll ishte formuar një shoqëri shqiptarësh e cila filloj të nxjerë edhe një gazetë shqiptare me embrin "Drita" të cilën e drejtonte Petro Poga. Këto të pakët shqiptarë me gjithë që ishin nënë vërejtjen e Turqisë po sidomos punonin. Shtytjen më të madhe morale e jepnin te dy patriotët e paharuar Naimi dhe Sami bé Frashëri, i pari si nëpunës në Ministri të Arsimit dhe i dyti si nga më të mbëdhenjtë shkrimtarë të Turqisë. Nga ana tjetër në Rumani dhe më fort në Bukuresht, nënë kryesinë e të paharuarit Nikoll Naços shqiptarët po punonin e po shtypnin disa libra shqip.

Më përpara Efthimi Mitkua kishte botuar "Mbletën Shqiptare" me shkronja greqishte. Më vonë Naum Veqilharxhi nga Vithkuqi nxori një gramatikën e tij dhe ca gërma sui generis, prototype krejt. Më pas shoqëria e Stambollit pranoj alfabetin llatin me disa ndryshime, me të cilat edhe shqiptarët e Bukureshtit shtypnë librat e para shqipe.

Me gjithë që vinja në shkollën greke, por me që im unq Kristo Mitkua çquhej si një nga të pakët shqipëtarë që kish ahere Korça (se si shqipëtarë hiqeshin, ose ishin ahere vetëm 3-4 vetë, Orhan beu i Çerçiz beut, Jovani i Cico Kosturit, Thimiu i Mihal Markos dhe pastaj im unq Kristua i Mitkos, prandaj desh të më inspironte edhe mua ndjenjat shqiptare.

Shqiptarët quheshin ahere prej filogrekëve propagandiste allvanitas, masonë, të mallkuar, por jo kurrë shqiptarë. Po edhe unë, me gjithë që dëgjonja mallkime dhespotësh dhe nëma të tjera burrash e grashë, më pëlqeu idhea shqiptare dhe nuk vonova të bëhem një neofyt i idhesë kombëtare, që u nis me shokë, po më vonë bëri mrekullira.

Xhaxha Kristua ish i pari që më msonj të këndonja shqip, me gjithë që kisha 3 vjet që i dinja karakteret llatine , tuke msuar frëngjishten e llatinishten.

Naim beu në atë kohë kishte shtypur greqisht në Bukuresht librin e parë e të pavdekur të tij "Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve" (shkruar edhe greqisht H. K.) që më vonë unë e përktheva shqip prapë në vjersha me atë titull. Kjo vjershë ishte shkëndia e parë që ndezi flagën e pashojtur të patriotizmit. Dijet se Naim beu e dinte mirë greqishten se kish mbaruar gjymnazin e Janinës. Kjo vjershë ishte një kryevepër që tërhoqi vërejtjen e Sulltanit dhe e gjithë dipllomacisë.

Këtë vjershë që posa e këndova më pëlqeu kaqe fort sa e mësova mëgojë. Më ndezi kaqe shumë ndjenjën kombëtare, sa munt të thom se qysh ahere s'pushova të jem një shqipëtar i flaktë. Nga ana tjetër, mbassi xhaxha Kristua më njohu me të ndyerin Orhan beun, ajy më dha disa vjersha esopike dhe lyrike të Naim beut, si dhe një vjershë të veçantë "O vëllezër Shqipëtar, gëzohi që arth kjo ditë", etj. shtypur me një letër të veçantë që ishte ndarë më të katër anët ku kish shqipëtar nacionalist dhe kishte entuthiasur masën e re si dhe burra e pleq. Këtë vjershë e kisha mësuar krejt më gojë, prandaj më një dasmë bejlerësh që u bë në Korçë, Orhan beu më kish marë mysafir bashkë me xhaxhanë t'em Kriston dhe atje, për të parën herë, para një grumbulli të math dasmorësh ligjërova atë vjershë me një afshë zembre e me gjeste te nxehta. Enthusiasmi ishte aqe i math sa s'pushonin së trokituri duart, disa edhe qanin nga gëzimi. Ky ligjërim më njohti me gjith' ato zotërinj, që s'mbet njeri pa më thirur në në gosti për të dëgjuar prapë këtë vjershë, si dhe shumë vjersha të tjera të bukra të Naim beut që kisha msuar më gojë.

[1] proscrit = i jashtligjshëm (përkthyer nga frengjishtja me google H. K.)

Me anë të vjershës (titulli greqisht H. K.) "Dëshira e vërtetë" bëra më vonë më të madhen propagandë ne Grekomanët që ndodheshin në Karvasara, në Nartë, në Vrahon, në Mesollonjë, në Patrë dhe në Athinë.

Kur dhashë provime në klasin e I gjymnasial ishte korriku i vitit 1886. Tre veta prej shokëve unë, Ligori i Llaskos dhe Kristaq Papakostandini duallm të parët. Prandaj edhe Dhespoti i Korçës me Dhimogjerandët e Eforët e shkollave deshnin t'na dërgonin ne Munchen të Gjermanisë që të mbaronim gjymnasin pastaj edhe Universitetin me bursë të një bamirësi Maqedhonas që s'ja mbaj ment embrin.

Shtëpia me gjithë që s'deshin të më largonin, po si u bintnë nga ungjrit e mij që kjo ishte fati e e mira ime e lanë për të marrë edhe pëlqimin e tim' eti, dhe kështu i shkruan në Karvasara.

Mjerisht aso kohe i kish ngjarë një rrezik tim' eti. Mbassi humbi gjith' ato pare për një ideal atdhetarije në luftën greko-turke dhe për një kohë të gjatë mungonte nga Karvasaraja, në mosqënien e tij e sipër, dhe tuke qenë se babaj merreshe më tepër aso kohe me tregtin' e qerestesë e të thëngjillit, një prej njersve të tij, Kristo Koleci, gjith' ajy bukurosh, për të cilin fola më sipër, tuke treguar trimërin' e tij në pusinë e Skërkës së Dardhës, që im' atë e quajti "mi me mustaqe" për paburrninë e tij dhe s'desh t'a shihte me sy, Ky Kristo Koleci, po thom, njeri i dobët dhe i çoroditur, me qenë se kish mbetur zevëndës i tim' eti në dyqan ahere, gjen kohën, ngarkon një trehandir[1] me qymyrin t'onë, ikën me gjith' qymyrin e e shet në Pire, mer të hollat e kërcet në Rumani dhe s'u duk më se pas 3-4 vjetsh vdiq atje. Dëmi që na bëri ky i poshtër i kalonte të 10. 000 dhrahmitë, shumë kolosale për atë kohë.

Shëmbëllën bukuroshe të këtij e ndoqi edhe një tjetër nëpunësi jonë Grigor Papadhopulli, prej Dardhe, të cilin e kishim kandarxhi mbi qymyrin. Edhe ky ngarkon një goletë[2] tjetër dhe duke u shoqëruar me kapitanin e anijes shkojnë për në Vollo, ku do ta shitnin qymyrin. Po mëkati nuk bekohet, thotë një proverb. Tek shkonin në detin e hapur të Egjeut, jashtë hundës "Kavo D'oro" ose (shkruar greqisht) hasin në një fortunë të madhe ku mbytet karavi[3] me gjithë qymyrin dhe equipazhin bashkë , u mbyt kështu dhe G. Papadhopulli. Kështu shpërblehet pabesia! Pra, tjetër një katastrofë e dytë, këjo që gjet të gjorin t'im atë që kjo ish tepër e rëndë për atë se dami kalonte të 12. 000 dhrahmitë, veç paravet të thata që i kishte vjedhur t'im eti kur iku ajy dorëthati i poshtri njeri Papadhopulli, i cili n'a shkretoi shtëpinë se me këtë kusari të dytë shtëpija e jonë mbet e mjerë dhe lumëria e jonë u kthye në vobeksi!

Kur kthehet im 'atë dhe i mer vesh këto i ardhë plasje, po s'kishte ç'bënte. Me qenë se kishte borxhe shumë nëpër sharxhinj e qymyrxhinjtë, u shtërngua të vërë në hypothekë dy dyqanë + dy shtëpit' e vjetra që kishim në tregun e Karvasarasë e kështu i pagoj ato. Mjerisht nga taksiratet e poterat që i ngjan më vonë t'im eti, s'mundi të lanjë atë hypothekë e kështu shtëpit' e dyqanet n'a u shitnë në ankand.

Si kur të mos ishin mjaft gjithë këto që i ngjanë të mjerit t'im eti, po një betejë tjetër i vjen mbi krye e cila e varfëroj edh' atë edhe ne se ahere mbeti mish në meshë si thotë fjala.

Me qenë se në dy sharra të vogla që i mbetnë, edhe në nj'a dy tre konakë thëngjilli vinin shpesh kusarët e maleve e besdisnin sharrxhinjtë dhe këta u lodhë së paguari haraçe se ju dhanë mjaft franga, fyshekë, guna, ushqim etj. një natë ngjau një gjë e keqe dhe e tmeruar në një prej konaqeve t'ona. Kishin shkuar dy hajdutë me bujtë në atë konak që ish afër një fshati Varetdhës. Njëri prej të dy kusarëve ishte edhe i dëgjuari kapitan Thimjua, që dridhej prej atij gjithë Valltua e Keromeri. Atë natë ju kishin kërkuar pare shumë qymyrxhinjve t'onë dhe këta si e panë hallë u zotuan se do t'ja binin të nesërmen. Po me që hajdutët nguteshin shumë u

[1] një lloj barke (H. K.)
[2] një lloj barke me vela (H. K.)
[3] karav = lloj barke (H. K.)

shtërnguan të dërgojnë dy djelm të konakut me bileta të t'im ati ku kërkonin shpejt 2. 000 dhrahmi, se ndryshe ishim në rrezik.

Në konak kishin mbetur dy sharrxhinj dardharë, një i qojtur Çome dhe një Sotir. Hajdutët hëngren e pinë atje dhe si kish zjar shumë e bënte ngrohtë mjaft ranë të flenë. Të dy qymyrxhinjtë Çomja e Sotiri mbassi i vunë në gjumë hajdutët dolën pak të shohin kaminet. Po aty se si dreqin marrin që të dy një vendim të dëshpëruar e satanik, t'ju presin krerët në gjumë që të dy hajdutëve dhe të shpëtonin një her' e mirë nga ata! Pa, e bëjnë me besa-besën që të dy, rëmbejnë latoshkat e tyre, i mprehin mirë e bukur, hyjnë në konak edhe me vrap Çomja qëllon kapitan Thimjon edhe vrink një herë me latoshkën e mprehtë e ja hodhë kokën atje tej si një kokëlakre! Tjetri, Sotiri, që duhej edhe ajy të spastronte tjetrin bash në atë ças e sipër, u trëmp fukaraj e zu po dridhej. I mbet sopata në dorë. Kur kthen kokën Çomo-fucaraj e e sheh Sotirin që po ri si dru me latoshkën në dorë i bërtet një herë me inat: "bjeri shpejt, bre më t'u thaftë ajo dorë". Po hajduti tjetër nga zhurma e fjalëve zgjohet dhe zë të ngrihet, po ahere edhe Çomja u hasmëris, po me një latoshkën e tij ia heq kokës dhe ja ndan më dysh, pa i dhënë kohë të kapet nga armik. Kështu mbaroj ajo natë tragjike.

Çomja ju mer krerët që të dyve, prish konakun që atë natë dhe ikin bashkë me Sotirin e vijnë e ia rëfejnë t'im eti në Karvasara. Babajt s'i ardhi mirë po ç'të bënte, po edhe atyre të shkretëve ju kishte plasur shpirti e kishin të drejtë që u shtynë gjer atje prej dëshpërimi.

Të nesërme Çomja i dorëzon krerët në Qeveri dhe pas dy muaj merte 20. 000 dhrahmi prej Qeverisë Greke se koka e njërit prej hajdutëve, e kapitan Thimjos ishte proklamuar për 20. 000 dhrahmi. Kështu ajy i mori parat' e shkoj në shtëpi të tij në Dardhë po taksirati gjeti sharrxhinjtë e tjerë që shokët e hajdutëve vranë një natë dy djelm sharrxhinjsh, për të marrë gjakun, prishnë sharra e kamine, ju vunë zjarrë gjithë konaqeve e kështu si sharrxhinjt' e qymyrxhinjt' e mjerë si edhe im'atë u batardisnë krejt!

Po e keqja s'qëndroj gjer këtu. Meqenë se fisi i kapetan Thimjos që u vra akuzuan tërthorazi edhe t'im atë, qinse me inisiativën e tij u vra kap. Thimjua prej qymyrxhinjve e e trëmpnin se do të mernin gjakun nga im' atë. Im' atë jo se i numuronte ato po nga që ju vunë disa miq të pajtohen dhe mbi atë e sipër e lutnë të pagëzonjë dhe djalin e njërit të hajdutëve të mbetur, që ish kushëriri i kap. Thimios, edhe im' atë e pagëzoj për shumë arsyna, se kish vënë konakë të rinj qynyrxhinjsh e dëshirontë që të mos i bezdiste ky hajduti dhe shokët e tij, prandaj dikush e kallzoj te Qeverija se gjoja im'atë ishte jataku i atyre hajdutëve. Kështu një ditë e marrin t'im atë në gjyq dhe e burgosnë 6 muaj, dhe si dolli i pafajshëm, e lëshuan, por kur u kthye prapë në Karvasara gjet të katër muret e dyqanit dhe dy çirakë që i kishin mbetur besnikë një Kiço nga Paramythjoja dhe një Spiro nga Kamenica. Të tjerët dy nëpunës, që njëri ishte dhëndri ynë, shitnë ç'muntnë e shkuan në Rumani.

Në atë kohë unë pregatitesha të shkonja në Monako (Munchen) të Gjermanisë bashkë me të dy shokët e mij të tjerë me bursën që përmënda dhe ishin tuke pritur edhe pëlqimin et'im eti dita-ditën, pa ditur ç'ngjiste atje, se im'atë kurrë s'më shkrojti se ndodhej në burg për të mos n'a trëmbur.

Kur marrin një letër nga babaj e na tregon një nga një ç'i ngjanë ne ahere e muarm vesht. Në atë letër që i adresonte xhaxha Ligorit, im' atë i thoshte se është nevoja të më dërgonin mua në Karvasara, se s'ka njeri të besuar dhe se do më mbante ca kohë me vehte pastaj prapë do më dërgonte të vazhdonja gjymnazin në Mesollonjë.

Im' ë kur dëgjoj, gati mënt lojti mëndsh. Nuk desh as të më linte të shkonja se isha edhe i vogël për atë punë fëmijë 13 vjetsh. Po mbassi e pa se insistonte im'atë në dy letrat e tija të tjera, pa ç'pa me nisi për Greqi me të vëllan' e saj xhaxha Kristo Mitkon.

Më 5 të Tetorit 1886 jemi nisur me t'ëm unq nga Korça, tuke marrë me vehte edhe t'ëm kushëri Sotir Romanin nga Dardha, të cilin gjith 'ashtu i ati i tij Anagnost Romani që kish motren e t'im eti e kish hequr nga shkolla e e deshte pranë tij në Mesollonjë (shkruar edhe greqisht H. K.) ta stërvitte në punë.

Udhëtuam mirë gjer në Janinë. Xhaxha Kristua si njeri i gjesdisur që kish parë gjith' Evropën me sy e Misirin, na mori atë natë në një theatro. Ish e para herë që shihnja theatro me sy dhe më bëri shumë përshtypje. Shkuam të nesërmet nga Janina dhe pas dy ditësh isha në Karvasara. Ish e dyta herë këjo që vinja në Greqi.

Im' atë më shtërngoj fort në krahërorët e tij kur më pa dhe tepër u ngushëllua me mua. Pas dy ditësh xhaxha Kristua u nis me t'em kushëri Sotiraqin për në Mesollonjë dhe q'andej shkoj në Selenik bleu kazmirë për në dyqanë të tij dhe u kthye në Korçë.

Në Karvasara babaj n'a priti në shtëpin e re afër detit që s'e kish mbaruar akoma. Kish blerë edhe një vënt të mjaftë rotull si dhe një copë vënd tjetër anës detit, ku kish një barakë të vogël që e përdornim si kafene. Këto i kish blerë im' atë 2 vjet më parë dhe s'i kisha parë akoma.

Pashë një copë dyqan bakallëk që kish, po që s'kish as 500 dhrahmi mall brenda, se ja kishin çveshur bukuroshët yzmeqarë që i shitnë edhe qymyrin. Gjysmën e dyqanit tjetër e kish transformuar im'atë në kondakçihane dhe punonte edhe zanatin stërgjyshor. Me një herë më vanë sytë në hallatet dhe dyfegjet e koburet e vjetra që ishin mvarur andej këndej edhe e pyeta naivisht që "pse e punon edhe zanatin që e kish lënë prej kaqe vjetsh". Po im'atë nënqeshi me një nënqeshje të hidhur e më tha: "S'e mbant mendt, djali im, kur të thesha tjetër herë që "mso zana n'daç lëre, kur të vjen urrija zëre". Po, i thom, më bije ndërmënt. E pra, biri im, më thotë babaj, ja ku erdhi sëra ta zë prapë zanatin e babës, pa dhëntë Zoti e mos paç nevojë kurrë.

Si? Zanat do më msohsh mua, nuk do më vesh në shkollë?

Mjaft msove, o biri im, ma prêt im'atë. Tani duhet t'i ndihmosh babajt

edhe shtëpisë e syt' i kishte gati në lott.

Po, jam i zoti për punë kaqe i vogël?

Je, edhe fort, mor bir, për mua je burrë. Cili ajy baba, që do të heqë

djalin nga shkolla? Po tani që na plakosi e keqja nga të katër anët, un' e preva shpresën se munt të kem fuqi të dajandis[1] gjer në funt sa të mbarosh ti gjymnazin. Prandaj të solla këtu edhe duhet t'a shtrosh mëndjen për dyqan, mjaft ke msuar, makar të dinja edhe unë sa ty. Zoti ju martë hakun, pason i shkreti im'atë, atyre katilëve të dy që më shitnë gjithë mallin e më lanë në rrugën e madhe mua edhe fëmijën t'ime. E gjetçin nga Perëndia që të dy.

Këto më thosh edhe pa dashur i vurkoseshin sytë me lott.

Unë e pashë se rashë keq e m'u prish gjaku. Nuk kujtonja kurrë se do më hiqnin aqe tëvogël nga shkolla, ku vinja shumë mirë dhe kisha aqe dëshirë për gramë[2] e msime. Po e pashë që s'bënja dot ndryshe. S'munt t'i binja murrit me kokë! Ishte vullneti i babajt ky, të cilin unë e adhuronja si Perëndi të dytë. Qava pak nga dëshprimi, unja kryet dhe ju shtrova fatit. M'u pre një her' e mirë shpresa për në shkollë!

Im'atë kur më pa aqe të dëshpëruar zu të më ngushëllonte pak, tuke thënë që të mos e humbas krejt shpresën, se do Zoti e n'a vinte puna mbarrë edhe ahere ma jepte fjalën se do vazhdonja prapë msimet që i lashë për gjysmë.

Të nesërmen, posa zbardhi dita im' atë më lidhi një podhjao[3] të bardhë përpara, dhe tuke thënë "e mbajç me shëndet e Zoti na nxjerrtë faqe bardhë" më mer tuke nënëqeshur e më sjell përpara bankos së dyqanit ku ishin disa shishe me pije e disa gota verret e rakijet e më thotë se, kjo shishe ka rhum, kjo mastikë, këjo uzo, kjo mendë, kjo konjak, kjo denturë, këjo qyrasë e ku ta di unë. Më thotë akoma, tuke më treguar disa varele[4] të vogla me kanule m'at'anë bankos të pijevet, se kjo varelë ka verë të zezë, ajo të kuqe, ajo të bardhë, më rëfen si të shesh pije me gota e si të shesh me okë, më tregoj me radhë çmimet e secilit çeshit[5] të dyqanit, mori

[1] dajandis = duroj, qendroj, i bëj ballë (H. K.)
[2] gramë = shkrim e këndim, shkollë (H. K.)
[3] pódia = përparse (përkthyer nga greqishtja me google H. K.)
[4] varelë = fuçi e madhe prej druri, që shërben për të mbajtur vaj, bulmet, turshi etj. (H. K.)
[5] çeshit = lloj malli që shitet, asortiment (H. K.)

fsheshën e fshiu vetë dyqanin që të më msonte si fshiheshe dyqani, lau gotat e bankon që të msohem t'i lanj unë tjetër herë dhe me pak fjalë më stërviti në mjeshtrin' e re të bakallit.

Tani mund të imazhinojë njeriu gjëndjen e një fëmije që s'ka zënë fsheshë me dorë, që s'di si lahet një gotë e që s'njeh tjetër veç librave dhe le të më thotë se ç'bela më ardhi mbi krye kështu pa pandehur! Zura ahere edhe unë e po mallkonja ata arrankatët që na prishnë, ata sharxhinjtë që na fiknë me vrasjen e atyre dy hajdutëve dhe n'a shiti shtëpit' e dyqanet etj. etj. Po ç'u bë u bë. Unë duhej të katehisesha në zanatin e ri që më paraqitej, pa ditur akoma se po më rruheshe edhe një zanat tjetër kryesor, zanati i katragjyshëve, kondakçillëku, të cilin me do e mos desh të m'a msonte im'atë dhe për të cilin ndjenja aqe siklet, sa as për 20 vjet s'më mbushej mëndja t'a msonja. Tani, To be, or not To be? si thotë Shakespeari në Hamlet-in e tij, të jem apo të mos jem. T'i shtrohem zanatit të ri apo jo? (vjen një fjali greqisht H. K.) theshin grekët e vjetër, do me thënë "nevojës i shtrohen edhe Perënditë". Kështu ju binda vullnetit të t'im 'eti dhe fillova nga puna. Qysh atë dit i linja të gjitha ëndrat e mija më nj'anë, prej nxënësit bëhesha kërçmar e kondakçi! Pikë!!

Atë natë mezi më zuri gjumi nga halli që më ra mbi krye. Gjer ahere isha msuar të bije të fle që më ora 9 të natës e të ngrihem më 7 mëngjes domethënë 9-10 orë duhet të flinja rregullisht, po qysh atë ditë që zura zanatin e ri ndryshoj edhe program. Duhet të flinim më 10 të natës e të ngriheshim në mëngjes më 5!

Posa vajti 5 ora në mëngjes, çohet me një herë im'atë, dhe tuke më kënduar, po më zgjon edhe mua. Unë protestonja se është shpejt akoma, po im'atë që, si më thosh, "s'dinte pëth e ç'pëth" nuk e mori parasysh proteston t'ime, po me të qeshura e me ca këngë të vogla e më të lëmuara ballit e faqeve më ngriti, më vuri të lahem me ujë të ftohtë kurdoherë dhe më thotë t'i bënj kafenë se edhsh prej duarve të djalit. Ia bëra me një qind belarka, mbassi s'kisha bërë kurrë kafe në jetën t'ime. Si piu kafenë, po jo edhe unë, se si më thosh më nxiheshin dhëmbët po të pinja e zbresim ahere përposh në dyqan. Me një herë më thotë të ndez zjarin, tuke fryrë kaminin se do fillonte të punonte. Do me thënë zanatin e jevgëve. Bëra si më tha dhe zjari u ndez. Zë tani të më msonjë si bëhen burgjitë e si digjet hekuri. Baba, i thom unë, po këtë punë s'ë bënj dot unë. Do t'a bësh, thotë, edhe fort. S'ka gjë që s'e bën njeriu, veç po të mos dojë. Tembeli thotë që s'e bënj dot, jo punëtori, po marsh, mos hump kohën se koha është flori, bërtet e brihet im'atë. Kërcen prifti nga belaja, theshin pleqtë, pra edhe unë zura e diqnja hekurin e fillova të bënja burma.

Afrohet të zbardhëllonjë. Tashti duam një kaçamak, thot' im' atë. – Ç'do me thënë kaçamak? – Mërmëligje. - tamam, kam ngrënë mëngjes baba. – Ke ngrënë, bir, po duhet të dish edhe si bëhet. – Po s'e bënj dot. – Do t'a bësh. –Do ta bënj edhe këtë? – Do e mos – Pse mos e bëjnë çirakët? – Ata dijnë ta bëjnë shumë mirë, po duhet të msosh edhe ti, më thotë, si bëhet kaçamaku, mos prit më të tjerët. Shërbëtorët po na rijnin rotull e çkuleshin së qeshuri.

Desha s'desha bëra edhe kaçamakun si më msonte im'atë. Si hëngrem mëngjes. Marsh tani, më thotë prapë, hidhu andej nga bangua e pijeve, laj atë dhe gotat e fshij dyqanin.

Do e mos u konformova vullnetit të tim' eti. Shërbëtorët më shihnin e qeshnin. Dëshpërimi im po shtohej për minuta, po ç'munt të bënja ndryshë? Im'atë në punë ishte shumë sever; punën e deshte punë.

Kur mendova se u dënova të punonj kështu për jetë më vinte të çjerrja leveret e të bërtitnja me sa zë kisha. Shumë herë më vinte të mos punonja; desha të mernja syt e këmbët e të shpëtonja nga ajo zgjedhë, po kur shëkonja t'ëm 'atë aqe të sëkëlldisur, edhe kur më thoshtë që duhet t'i jap ndihmë për rrojtjen e nderin e shtëpisë s'onë, i gëlltitnja të gjitha dhe i shtroheshe prapë detyrës.

M'u desht një kohë mjaft e gjattë gjersa u msova. Im 'atë kur e pa që e shtrova mëndjen u gëzua tepër edhe një ditë më ka marrë për qafe e më tha: Tani besova që më do dhe do bëhesh për shtëpi!

Një ngushëllim të veçantë ndjenja në këndimin e shkrimeve shqipe dhe më fort në vjershat e Naim beut, të botuara në periodhikat "Drita" e "Dituritë". Veçanërisht vjershën e pavdekur lyrike "Bagëtia e Bujqësia", "Lulet e Verës" "Historinë ose Epopenë e Skënderbeut" edhe "Dëshirën e vërtetë të Shqipëtarëve" greqisht s'i linja prej dore sa herë që gjenja kohë.

Takoj që kish ardhur atë kohë nga Shibin-el-Komi i Misirit një kushëri i tim' eti, Gaqi Nastradini, i cili kur më dëgjoj që i thashë disa vjersha, shqiptar edhe ajy i flaktë, u çudit dhe më sympathizoj shumë. Kur u kthye prapë në Chibin-el-kom ja tregon këto Spiro Dines, një shqiptari nacionalist nga më shovenët[1], i cili me një herë më shkruan letër s'andejmi dhe më kërkon disa vjersha të reja shqip të mijat që kisha trajtuar. Si ja dërgova dhe u kënaq shumë filloj një korespondë e rregullt me atë dhe më dërgon nga Chibini nga 3, 4, 5 kopje të ç'do libri të ri shqip që kishin dalë ose delnin aso kohet si dhe fletorët shqip që dukeshin në dritë herë pas heret dhe më inkurajonte shumë në nacionalizmën. Ajy më rekomandoj te Efthimi Mitkua në Bonisuef, te Jani Vretua në Bukuresht dhe te Naim e Sami be Frashëri në Stamboll, me të cilët fillova një korespondencë të zjartë, me gjithë që përveç Vretos dhe Mitkos Naimi e Samiu më shkruanin shumë rallë dhe letrat m'i dërgonin me miq kurdoherë , jo me postë.

Të gjithë këta apostujt'e parë e idhesë kombëtare më inkurajonin me fjalët e shpresat më të zjarta, më futnin thell' e më thellë afshën e patriotizmit dhe më inspironin në vepra për kombin. Spiro Dinja i kish dërguar Naim beut kopjet e 34 e sa vjershave të mija, të cilat sado që ishin vjersha çilimiu, më fort satyrike, marrë nga të Aesopit ose të Lafontain-it, disa edhe origjinale, po Naim beut i kishin bërë mjaft përshtypje. Në një letër që më dërgonte mbaj mënt, jo vetëm që m'i pëlqente vjershat, ishin s'ishin të mirë, po edhe më enthusiaste fort tuke më thënë se do bëhem një vjershëtor i mirë, se do t'i sjell Atdheut dobi të mbëdha, se do bëhem i shënuar në Shqipëri etj. etj.

Po Naim beu s'e dinte se isha 14 vjetsh ahere. Këtë e mori vesh kur i dërgonj Spiro Dinja fotografinë t'ime. Ahere ishte ç'ishte me Naim bejnë. I ndjeri ndjente një gëzim të math se ju shtua edhe një shkrimtar Shqipërisë edhe me gjithë që isha i vogël më titullonte në letrat e tij si: "bashkëpuntor i tij i vyer", si "atdhetarin e kombit të palodhur" etj. etj. Në një letër tjetër më titullonte "Lafontaini im i vogël". Këto letra si dhe shumë të tjera të Eftim Mitkos, Jani Vretos, Sami beut e tjerëve, i rrojta si kujtim për shumë vjet. Po s'di as unë se qysh humbnë kur më vonë vajta në Athinë si student për disa vjet si do trëgonj më poshtë.

Disa prej atyre vjershave i botoj Spiro Dinja në librin e math të tij "Valët e detit" me nënëshkrimin "K. F. " d. m. th. Kr. Floqin shumë të tjera u botuan në copa fletë në Bukuresht që shpërndaheshin posht' e lart nëpër Shqiptarët nacionalistë, po më të shumtat mbetnë në zyrën e Spiro Dines si dorëshkrime të pabotuara.

I enthusiasur prej këtyre parabredhësve e njerësve të paharuar të kombit t'onë, fillova të katehis piksëpari shokët që gjindeshin në Karvasarâ edhe më fort djelmt' e yzmeqarët e sharxhinjve që na sillnin me mushka qymyrin ose qerestenë. Kaqe bukur i msonja shqip e i stërvitnja dhe kaqe mirë i enthusiasnja sa u ndezë edhe ata si mua e zume e po përhapnim ndjenjat kombëtare ku mundnin e si mundnin. Të voglit mos i hyftë mikrobi i patriotizmit, pa si t'i hynjë s'ka se si e shëron. Ashtu edh' ata, djelm të kulluar, vllastarë[2] të pastër e të shëndoshë të Atdheut u bë po thua secili edhe nga një apostull më vehte.

Babanë t'em e kisha kurdisur mirë në idhenë kombëtare e m'i pëlqente shumë e m'i aprovonte tepër demarshet e mija. Veç dy gjëra kish im 'atë e m'i rekomandonte për dit:" Ruaju se këto të lënë pa punë" dhe e dyta "Hap syt' e kij mëndjen se mos të të marrë vesh qeveria greke e të prish punë". Po qeveria greke flinte ahere. Autoritetet e Karvasarasë aq shum' e çanin kokën sa nuk kishin haber nga lëvizjet shqiptare, as që dijnin se shkruhej shqipja edhe ca më fort se shkruhej me karaktere llatinë, por edhe vet' ata nuk e dijnin këto

[1] shoven = nacionalist i thekur (H. K.)

[2] vllastar = degë e njomë, e gjatë, e hollë dhe e drejtë, filiz, lastar, (H. K.)

karaktere se aso kohe autoritetet ishin funksionarë analfabetë më të shumit. Prandaj s'kishim edhe aqe frikë, se ne n'a numuronin për "omogjenas helleni" se kishim nje fe me ata, kurse "Arvanitë" ishin "Turkarvanitët" domethënë muhamedanët shqiptarë dhe kjo ish një pikë kryesore ky binin me kandare jashtë Grekët dhe Politika e tyre.

Dal nga dalë në Karvasarâ bëra edhe një shkollë të natës, ku msonja gratis, 5-6, shumë herë edhe gjer më 10 djelm. Nga posta greke mernja lirisht librat që më dërgonin prej Misirit, Stambollit e Rumanisë si edhe korespondencën, edhe tani zura ta mar vesh mirë se pengimi që m'u bë prej tim' eti që të mos vazhdonja më në shkollë u bë më fort për të mirën teme edhe atë të kombit. Për të mirën t'eme se hyra në korespondencë me njerzit më të çquar të Kombit e më patriotët, dhe stërvitesha jo si djalë por si burrë e si shok e bashkëpuntor i tyre e këndonja me zell kaqe libra e sende të tjera që çvillohesha gjigangisht dita-ditën shumë më tepër se në shkollën skollastike me msues të kufizuar nga mëndja që s'kishin haber nga jeta sociale; Për të mirën e Kombit se i shtohej një ndihmë e madhe, një krah i fortë dhe një tribun më tepër për çvillimin e letrësisë e kullturës nacionale.

Biblioteka Shqiptare që kisha në Karvasarâ ishte një nga më të pasurat bibliotheka për një shqiptar të asaj kohe. Kishte ç'do libër e ç'do gazetë shqiptare që kishin parë dritën gjer ahere, që mjerisht disa prej atyre librave e broshurave nuk ekzistojnë as pak. Kisha shumë më tepër libra shqipe se sa romane e libra të tjerë greqisht e në gjuhë të tjera.

Paralelisht këndonja edhe greqishten. Librat e shkollave që kisha shkuar s'i linja prej dore, gazeta, romane greqisht etj. etj. i këndonja natën më shumë, se s'më linte im' atë ditën. Me këtë bashkë msonja edhe diplografî[1] për tefterët tregtarë me gjithë që s'kishim ne aqe daravera tregtare sa të mbanin teftera diplografike, por ky ka qenë shkaku që msova edhe bukurshkrim të mirë, se shkrimet e mija të mëparshmet ngjisnin si një farë krabash[2] ose si të ckërfitura pulash.

Me këto bashkë kisha edhe një zell të math për gjuhën frëngjishte. Më ranë në duart një methodhë "Ollendorff dhe një Eau de Paris" librë me dialloge që mënt i hanja me dhëmbë së kënduari. S' linja prej dore kurrë. Kështu kisha nxënë mjaft frëngjishten. Takoj edhe një frënk i cili ndejti dy vjet në Karvasarâ si sekretar i Konsullatës Turke me të cilin shetinja nga hera dhe ndodheshim bashkë 3-4 orë ditën e kshtu e msova me fé frëngjishten. E flisnja mirë e pa gabim. Vazhdova kështu gjer sa u bëra 17 vjetsh djalë, edhe me të vërtetë ju duka shumë i dobishëm tim'eti, se i mbanja hesapet, i drejtonja tregtinë e qerestesë e qymyrit, ndodhesha në ngarkimet e qymyrit e qerestesë, në inspektimet e tyre nga an' e autoriteteve, dinja fort mirë ç 'do formalitet, mbanja korespondencën etj. etj. që e kisha çlodhur shumë tëm' atë. Edhe ajy ishte mjaft i kënaqur nga mua e më kish dhënë liri të plottë. Sillesha mirë, po veç që vinja shum' i turpshëm dhe kisha frikë të përzjehesha me njerës të ditur se mos gabonj në fjalimet e pastaj do talleshin me mua. S'di pse më kishte hipur kaqe frikë.

Do tregonj një sent karakteristik që më ngjau kur isha 15 vjetsh, që, më gjithë që kisha kënduar e dinja shumë gjërra bënja nga ndo një herë ca gafa trashanike që më prisnin gjithë kurajon e s'kuxonja të paraqitesha përpara njerësve, ca gafa që s'i ngrihnin as qerret e Bashkisë.

Vajta një dit në Mesollonjë ku më kish ftuar im'unq Anagnost Rumani, ku do piqesha me t'ëm kushëri Sotirin, të birin e Anagnostit. Me gjithë që Sotiraqi ishte një mot më i vogël nga mua dhe e kish nxjer' i ati nga shkolla që kur ish në të V klasë Popullore, ahere kur u nxora edhe unë, Sotiraqi kishte liri shumë nga i ati dhe çdo budallì që thoshte, ç'do kërcu që këputte ja prisnin me gëzim e ja aplaudisonin (duartrokisnin H. K.). Për kundrazi unë s'flisja shumë po dëgjonja dhe çuditesha me atë dhe sa do që i matnja fjalët që flisja s'ishte e mundur të shpëtonja nga gabimet e të mos hapnja gojën pa bërë edhe nga një gafë! Prandaj në

[1] diplografi = shkrim i dyfishtë, pra kur shkruhej gabim një germë, fjalë apo fjali – shkruhej prap se ahere nuk kishte kompjuter (marr nga fjalori italisht-italisht H. K.)

[2] krrabë = një farë druri në formën e germes Y ku lidhen dy llastiqe për të gjuajtur me gurë (H. K.)

Mesollonjë një tok shqiptarë më kishin karakterizuar si “put” se s’flisja, disa të tjerë më quanin për “teveqel” kur flisja.

Një dit shkonim me Sotiraqin ne rrugë, në pazar të Mesollonjës e më pijeshe ujë. Futem në një ëmbëltore dhe në vënt t’i kërkoj lirisht një gotë ujë, i fola ëmbëltarit me shumë të drojtur e me frikë: Oré ti, a kini ujë këtu? – Por se m’a prêt me të qeshur, ëmbëltori, për të pirë apo për të larë duart? Edhe me që unë ju përgjigja “për të pirë” ajy si më pa ashtu të turpshëm, më thotë: Sa para ujë do? – Pse, i thom, me para shitet uji këtu në Mesollonjë? Me para, thotë, me para, këtu çdo gjë shitet me para edhe qeshte.

Sotiraqi, si e pa që u vonova në ëmbëltore, hyri brënda. Ata posa e panë Sotiraqin, të cilin e njihnin, i thanë ç’e ke këtë, për mua. Kushëri ta parë, iu thotë Sotiraqi. Të përgëzojmë fort i tha ëmbëltari sepse ke një buf të mirë, t’ju rronjë! Mjaft ishte kjo për mua. M’u duk sikur më ra tavani kokës, po e gëlltita e s’fola gjë, as që piva ujë, po ika.

Një ditë tjetër u ndodhë ca zotërinj të tjerë në zyrën e t’im ungjit, Anagnostit. Unë iu nxora kafetë dhe shqava e i derdha kafetë, tuke spërkatur dy prej syresh ne pantallonat! T’i lemë të sharrat me të cilat më lanë e më shplanë funt e krejt, po më bënë edhe budallë me patent! Shumë episode të tilla më ngjanë që edhe unë çuditesha si i bënja, kurse në dituri, në shkrim e në shumë virtute të tjera e kalonja t’em kushëri, Sotiraqin me kandarë.

Ky tutkunllëk që më kish plakosur vazhdoj për disa kohë akoma në Karvasarâ, kur u ktheva. Në dyqan kishim marrë midis yzmeqarëvet edhe një djalë nga Karvasaraja që ish nja dy vjet më i math se mua e quhej Harallamb Morajiti që sot është Dr. Theollogjie dhe professor e drejtor i Gjymnazit në Nartë të Greqisë. Ka edhe ky një histori të çuditshime për të cilën do bënj fjalë më tutje se meriton të shkruhet në histori që si prej një shërbëtori u bë professor!

Harallambi ishte një shërbëtor jo dhe aqe i zgjuar, po djal’ i mirë e i ndershim. I pëlqenin vetëm shumë arrat edhe më fort kur haheshin me fiq të Kallamatës bashkë, prej të cilëve kishim shumë vargje në dyqan. Sa herë hynte, sa herë delte nga bezaktaja, ku ndodheshin arat e fiqt, do t’ju bënte nga një vizitë. Po kjo katandisi për Harallambin një zakon, edhe zakoni, siç dihet, është një natyrë e dytë. Prandaj babaj mezi ia preu këtë zakon.

Kur vinin myshterinj ndaj nate dhe rijshin jashtë dyqanit afër tryezave që kishim të shtruara, Harallambi kishte marrë përsipër t’i servirte, dhe i servirte mirë me ca shokë, me ca fjalë që kënaqeshin myshteria. Një natë e kishte dërguar në Pazar të psonisë dhe takuan të kthehen nga shetitja tuke qeshur disa gra e çupa, gjithsej nja 8 gra të aristokracisë së Karvasarasë, si e shoq’ e komandantit të regjimentit, e shoq’ e një deputeti, e shoq’ e një doktori e vajzat e tyre. Im ‘atë më dërgon jashtë t’i pyes ç’urdhërojnë, se po trokisnin mbi bangon. Unë kisha turp e s’desha të dal, po im a’të më çfryri një herë, edhe me të drejtë, se desh të ma priste atë ves të keq. Pashë ç’pashë dolla edhe zura t’i pyes, por më dridhej buza dhe më humpte fjala në gojë nga turpi. Ato zonja kur panë se s’dinja as t’i pyesja u këputnë së qeshuri dhe filluan të talleshin me mua si njëra tjetra. Unë mezi munda të marr vesh se ç’urdhronin, po nga nxitimi e nga të dredhurit as unë s’mbaja mënt se ç’u qita për të pirë. Ato kur panë se s’ju kisha nxjerrë ç’deshnin po tjetër për tjetër, zunë prapë të qeshin aqe fort sa kndjellën shumë njerës që shkonin rrugës, të cilët mbanin këmbët të shihnin ç’bëhej atje, ç’ngjiste. Njëra prej tyre i thotë tim’eti: Qir Vasili, djali yt është ky? – Si urdhëron, zonjë, ja prêt im’atë. Shumë të zgjuar e ke, i thotë me një ironi. Të rruat sa malet i thotë tjetra. Kujt i ngjet ia prêt një tjetër? Mos i ngjet s’ëmës? Im’ate s’dinte ç’ t’ju theshte. Unë që i dëgjonja të gjitha këto komplimenta mbi kurrizin tem, mbeta si kastravec! Pa, s’ishin mjaft këto, po kur po i servirnja për së dyti i shkela një zonje këmbën pa dashur dhe u hoth përpjetë, tuke sharë “qor, i verbër kaqe nuk sheh ku shkel?” Sa të ruhem nga njëri taksirat i dal përpara një zonjushe, dhe pa kuptuar se kisha njeri prapa e shtynj pa dashur dhe rëzohet për dhe me gjithë karekllën që rinte! Oh, medet, i varfri unë! Kur u ngrit e ëma kulçedra e desh të m’a mvishte kokës me ombrellën e saj, vaj halli ku të futem!

T’ im eti i erdhi kijamet, po ç’të bëntë i varfri? Zhurmën që bënë atë ças ato ulkonja s’di si t’a rëfej. U bëra koqe-mol. S’dinja si do mos edhe t’ju kërkonja pardon. Kaqe s’më jepeshe. Mezi e solli kokën Harallambi. Posa e panë ato gra histerike ju neveritnë të gjitha, tuke ju ankuar kundra meje dhe tuke lëvduar Harallambin që ësht’ i zoti, që s’ka shok etj. etj. S’lanë gjë pa thënë për mua. I theshnin t’im ‘eti të më dërgonjë prapë në Shqipëri, se s’jam unë për atë punë. E porositnin edhe Harallambin të mos e lerë edhe një here ate shtazë, për mua, atë hajvan, atë budallë të servirë myshterinj. Më në funt e këputnë qafën. As që paguan. Unë i durova të gjitha. T’im ‘eti i vinte plasja!

Kështu vazhdova gjer në moshën 16 vjetshe. Ish e thënë të kalonte edhe kjo. Im ‘atë më hiqte vërejtjen gjithnjë, por edhe un’ i ngrati se mos e desha? Qënka një sëmundje edhe kjo për kalamajtë. Herë rëfejnë një zgjuatsi, herë një budalli, herë të enthusiasin dhe herë të dëshpërojnë krejt. Unë s’kisha po këtë ves të keq, kisha edhe disa të tjera të kategorisë së dytë, për sh. po të më dërgonin më ndo një vënt munt të vonohesha edhe 2 orë, me gjithë që atë porosi mund t’a mbaronja në 10 minuta. Nuk lahesha kurrë me sapun, nuk llustronja kurrë këpucët as kur vinja në kishë, pshtynja 100 herë në sahat, krunja hundën e mbyllnja sytë 10 herë në minut, ecja si i çapluar, trazonja ç’gjeja përpara, thyeja ç’muntnja se më binin nga dora. Me gjith’ ate flisja frengjishten pun’ e madhe sa më mernin edhe për dragoman[1]. Shkruaja vjersha të bukura greqisht, që shumë herë botoheshin në të përkohshmet, mbanja mjaft mirë acompagniamente me qitharë dhe këndonja bukur. Losnja disa valle e bënja edhe disa shaka të tjera, me gjithë që këto nuk krahasoheshin kurrë, as pajtoheshin me veset e këqija që kisha.

Më 1888 im’ atë, mbassi s’mundte dot të vejë në Shqipëri vendosi të sjellë në Karvasarâ gjithë familjen t’onë. Prandaj dërgoj harxhet e rugës dhe porositi xhaxha Ligorin t’i bjerrë në Karvasarâ. Këjo edhe u bë, po bashkë me familjen t’onë u nisnë e ardhë në Karvasarâ edh im’ emtë Zojica e motra e t’im ‘eti me time kushërirë Efgjeninë, e cila kish mbetur e veh dhe ishte kthyer te e ëma. Këto të dy drejtoheshin te i shoqi i Zoicës, Anagnost Rumani.

Kur ardhi Ligori në Nartë me gjith’ atë karvan njerësh e i telegrafoj t’im ‘eti, u nis ky dhe vajti në Nartë, i mori e i solli në Karvasarâ në dy karoca. Shtëpinë në Korçë e dhamë me qira.

Për mua ardhja e familjes tonë në Karvasarâ ishte një ngushëllim i math. S’rëfehet gëzimi kur u pamë me njëri jatrin dhe më fort e ime gjyshe për mua dhe i jemi për t’im vëlla të vogël Thanasin që ish ahere nj’a 5 vjetsh topolak e i kuq si molla. U mblothmë një kallaballëk i math në shtëpi t’onë, që mbassi ardhi dhe im kushëri Sotiraqi me gjithë një dajon e tij Kristo Glioxheni nga Mesollonja edhe t’im unq Mitkon nga Antelikoja, u bëmë bashkë me çirakët gjithsej 15 shpirt, që deshnim nga një furrë bukë vetëm në ditë. Po dobarem shkuam mirë nja dy javë me muhabete, pralla, këngë e shakâ.

Qysh se ardhë gratë shpëtova nga darka e dreka që gatuanja më të shumtat herë unë, si dhe nga të larat e pjatave dhe të tenxherevet, se babajt i pëlqente që edhe ato t’i bënja unë.

Një eveniment që më stërditi motin tjetër, kur isha 17 vjetsh mjaftoj të më ndronjë me një herë veset e këqija të gjitha që kisha dhe të më transformonjë në një njeri tjetër krejt të ndryshëm nga ajy i pari i moshës 13 gjer 17 vjetshave. Tani kisha rënë ne ustaj, i cili më ndreqi e më njerzoj.

[1] dragoman = përkthyes (H. K.)

# V.

Në Karvasarâ si komandant i Gjindarmërisë e së bashkut si inspektor i pyjeve të N. Prefekturës së Valltos isht më 1889 një kapiten i Gjindarmërisë, ndjesë pastë Pano Manolidhi prej Karbeneshit të Akarnanisë. Këtë njeri, këtë bamirësin tem nuk do t'a haronj kurrë!

Ky si zuri vent në Karvasara, ardhi në dyqanin t'onë një dit dhe e thiri t'em atë të jepte llogari të qymyrit e të qerestesë që kishim, si edhe të kamineve e sharrave që kishim. Si ndjenj në tavolinën t'eme dhe folë mjaft me t'em atë, shtyri sytë e pa tefterat t'ona, të cilat i tërhoqnë me një herë vërejtjen dhe i pëlqeu tepër shkrimi e rregulli. Sheh pastaj disa vjersha origjinale greke, disa libra frëngjishte e disa romane etj. etj. edhe pyet t'im atë kush i shkruan këto kaqe bukur dhe kush i këndon gjith' ato libra. I'm bir, i thot' im'atë. – Yt bir? Po a ësht' i math shumë i thotë përsëri? Ndo nja 16 vjetësh, ja prêt im'atë. – Si the, i thotë, 16 vjetsh e shkruan kaqe bukur e këndon gjith' këto libra që janë për njerës më të mbëdhenj se moshën e tij? A munt ta shoh, thotë, këtë djalë? – Si të urdhëroni, i përgjigjet im 'atë edhe vjen e më pëzan në apothekën që kishim në funt të avullisë s'onë ku unë po peshonja qymyrin që po ngarkonim për një trehandir nga Kullurot Sallamina e Greqisë. Unë isha bërë si i bukuri shejtan, i zi që në kokë e gjer në thembrat e këmbëve e s'njihesha cili isha. Desha të lahesha po s'më jepte kohë im 'atë se kapitani nguteshe të shkonte. Edhe unë u paraqita i zi si arapi, nj'ashtu si isha, tuke i kërkuar ndjesë.

Kur më pa qeshi pak, po unë iu afrova, si më tha, dhe e përshëndosha me kokë, mbassi s'kisha si e zinja për dore. Ti mor çun, i shkruan gjith' këto më tha? – Si urdhëron, zoti kapitan. – Po qënke i zoti të këndosh frëngjisht Lafontainin, Lamartinin, Molierin, La Brujerin, Cornelin, Racinën, Voltairin e Viktor Hugonë, që po shoh përpara këtu? – Si urdhëron, z. kapitan. Edhe i mer vesh? – Fare mirë – Dhe qëndron akoma këtu djali im në mes të këtij pluhuri të qymyrit dhe në këtë copë pijetore këtu? Ç' të bënj, z. kapitan, i thom, këtu më urdhëron babaj të ri. – Gjer në cilën klas ke vajtur, mor bir. – Mbarova klasin e parë gjymnasial, zoti kapitan. – Klasin e parë gjymnasial, edhe munt t'i marësh vesh këta shkrimtarë frëngj? –Munt t'i mar vesh, z. kapitan, se i kam kënduar nga nj'a dy tri herë. Bravo, thotë z. Manolidhi. Edhe kthehet i thotë t'im 'eti: Nuk është mëkat që e ke skllavosur këtu këtë djalë? – Ç' të bënjë, z. kapitan? i gjegjet im 'atë. Nevoj' e madhe në bëri t'a zvjerdh djalin nga shkolla që të vogël. – Sa vjet po e mban këtu? – Bëhen nj'a 5 vjet, i thot' im 'atë, ajy gjithë kohën e shkon me librat. – Çudi si s'i ka lënë msimet, po përparon akoma! – Atë po t'a lësh, thot' im'atë, ajy gjithë kohën e shkon me librat. – Ca më mirë i thotë Manolidhi, nuk gëzohesh? – Të gëzohem? Po ahere ç'të bënj un' i vetëm? thot' im 'atë. Ke të drejtë , i thotë kapitani, por ky djalë s'është për këtu. Natur' e tij s'është për këtë punë. A ma jep mua ca kohë ta kem me vehte se shkruaka shumë bukur? Kjo ish një problemë shumë e rëndë që i vuri përpara tim'eti kapitani. T'i theshte t'a jap? Do prishte gjithë punën e tij. T'i theshte jo? Kish frikë se e hidhëronte kapitanin inspektor e i prishej qefi, pastaj munt t'a merte edhe ajy me sy të keq e munt t'i prishte punë me gjith që ish njeri noble. Hall njëra, belâ tjetra. Si të bënjë? Im'atë i ngrati ra në një mendim të math, se nuk e priste këtë proponim nga z. inspektor i pyjeve. – E po mendohesh? i thotë kapitani tuke qeshur. Mendohesh se kush munt ta zëvëndojë t'ët bir në detyrën e tija? – Si urdhëron, ia prêt im'atë. –Ja ku ke kaqe yzmeqarë, mundohu edhe ca vetë, lëre zanatin e kondakçillëkut, që si më duket mua, humbet kohë e s'bën gjë, edhe kështu mbarohet çështja. Kush e di. Munt të bëhet më mirë kështu për t'ët bir, por edhe për shtëpinë t'uaj. Nga ana tjetër unë do t'i jap nga xhepi im nj'a 50 dhrahmi në muaj, që aso kohe bënin 2 e1/2 napolona e ishin të pakta.

Im'atë kur dëgjoj se do t'i jepte edhe 50 dhrahmi në muaj për mua, edhe tuke kujtuar se do të ketë një mik të mirë e protektor , u bint dhe i thotë, mere, z. kapitan, të qoftë. Kapitani e falendëroj shumë dhe nxori i dha me një herë 100 dhrahmi nga xhepi dhe kthehet e më thotë

mua: Mvishu, djali im dhe eja që tani me mua. Si të thonë? – Kristaq, i përgjigjem. Qofsh shëndosh, më thotë edhe u bëfsh i mirë. Do të të kem si djalë.

Unë i dëgjonja me kujdes e me gëzim gjithë këto fjalë. Me dukej si kur ky ish një shpëtimtar për mua, një Salvator, një ëngjëll, një Mesiah. T'im 'eti e pashë që i ardhi shumë keq, se po më shëkonte i pikëllyer në sytë. I dukej sikur më shiti dikujt. Gratë kur e dëgjuan u vranë së qari, si kur iu ika nga duart si kur vdiqa. Im'ëmë e dëshpëruar i thotë kapitanit po bukë nuk do hajë këtu në shtëpi? – Si të doni , zonjë, ia prêt me një noblesë të hollë Manolidhi, po e mira do ishte të hante me mua se unë do t'a kem si djalë. Kur që ta doni ja u dërgonj. Po dua t'ju bënj një të mirë, se është gjynah të humbasë kështu ky djalë qymyrxhi e bakall. Dua të shpërblenj edhe me një të mirë që më kanë bërë tjetër herë, se edhe unë kështu kam qënë si djali juaj kur më nxuar në dritë e më bënë njeri. Unë kam shpresë shumë te djali juaj, zonjë, se e shoh karakterin e tij nga shkrimi i tij dhe ia njoh zellin për dituri prej librave që shoh që ka kënduar. Ju, duhet të më luti t'jua mar, jo t'ju lutem. Këto i theshte s'im 'ëme edhe qeshte z. Manolidhi dhe qëndroj e n'a tregoj me pak fjalë historin' e tij.

Z. Pano Manolidhi ishte djali i një druvari prej një fshati të Karpenishtit të Eurytanisë në Greqi. U lint tepër fukara, djal' i vetëm me 3 motra, ky ishte m'i vogli. I ati e dërgonte me dy hajvanë ngarkuar me dru që i shiste për dita në Karpenish. Një dit e njohu një zotni i mirë, që ish edhe deputet i Karpenishit. E sympathizoj se e pa të zgjuar dhe ja lypi t'et. I ati, haj nga interesi, se do zinte mik një deputet, haj nga frika, ia dha djalin. Panua ish ahere 12 vjetsh dhe s'dinte as abecenë. Deputeti e kish si shërbëtor, po e hiqte edhe si djalë se s'kish fëmijë. I mori msues në shtëpi dhe pas 5 vjetsh msimi e pregatitje, Panon e dërgoj në gjymnazin e Llamisë (Zeitun në Greqi). Më 4 vjet Panua mbaroi gjymnazin dhe kur ish 21 vjet hynte në universitetin e Athinës në Fakultetin e Drejtësisë. Pas 4 vjetsh dolli doktor në drejtësi dhe me që i ati adoptues, ishte i pasur e s'kishte nevojë të bënte avukatllëk e stërviti në politikën. Panos, me që i pëlqente kariera e gjindarmërisë, posa mbaroj universitetin dha provim dhe u bë officer i gjendarmërisë (shkruar greqisht H. K.) dhe mbassi dolli dy herë deputet edhe një herë dhimark (Kryetar Bashkie) në vëndin e vet, më së fundi vazhdoj në karierën e gjendarmërisë dhe sot ishte (greqisht H. K.) d. m. th. kapiten i gjindarmërisë. I ati adoptues, deputeti e martoj me të bijën e një gjenerali nga Thesalia, zonjë bujare e të mentshme, që quhej Ariadhni që pata fatin t'a njoh edhe unë, se e kish me vehte z. Manolidhi me dy djelm të vegjël , një Aleko e një Leonidhë. Ishte zengjin si ajy si e shoqja dhe kishin zënë me qira një nga më të mirat shtëpi të Karvasarasë. Kish një koxha bibliothekë të pasuruar me shumë libra të vlefshime, një zyrë extra, një pastri e rregull shëmbëllor. E shoqja, zonja Ariadhni, ish edh' ajo e msuar mirë dhe shum' e sjellë. Dinte frengjishten extra, si franceze se kishte qenë disa vjet në Paris me t'atin e saj.

Unë si u lava e u mvesha mir' e bukur me ato roba që kisha, roba drili se s'kisha zënë të mbanj akoma roba kazmiri për ekonomi, ju paraqita zotit Manolidhi. Ajy kur shtiri sytë e më pa, bravo, më tha, qënke koxha djalë, bravo. Po nuk paske roba kazmiri? – Jo – S'mbajtke as gravatë? – As pak, s'di as si lidhet, i thom. Me sheh këpucët. Po këpucët, thotë, s'i paske të llustrosura? Si kështu? Qënke fare llosho, djali jem. Kthehet e i thotë tim'eti: Do t'i bënj një palë roba të mira, këmishë, këpucë, gravata, kapella, se kështu s'munt të hynjë në zyrën t'ime. Do t'ja zë në rogë. Bëni si të doni, i thot' im'atë, djali është i juaji tani. Zotit Malonidhi iu bë qefi shumë me këto fjalë dhe ju premtua t'im eti se do m'i bënte ajy vetë nga qesja e tija. Kaqe fisnik ishte i shkreti!

Më mori pas në mes të pikëllimit të math të tim'eti e të qarave e lotëve të mallëngjyera të gravet. Më sjell në shtëpi, më rekomandon me fjalët më të bukura e enthusiastike ne bujarja e shoqja dhe më vë të shkruaj do shkresa zyrtare për në Ministri të Financave. Kur pa shkrimin t'im, kur pa kaligrafinë si ajy, si e shoqja që më vëzhgëllonin tuke më ndenjur për sipër, u habitnë që të dy. U enthusiasnë shumë. Si njëri, si tjetri e quanin vehten të lumur për thesarin që gjetnë, se z. Manolidhi nuk shkruante dot, ose shkruante shumë keq. E shoqja ish

ajo që i shkruante shkresat më serioze zyrtare edhe i mbante edhe korespondencën. Tani i çlodha unë, si njërin, si tjetrin prandaj gëzimi shkëlqente në fytyrat e tyre të sinqerta. Të lumtë ata që më gjetnë! I lumi unë që rashë në duart e tyre!

Me të shpejt zoti Manolidhi më porositi një palë roba cheviot të mavija t'errta extra. Këmishë, kapella etj. m'i bleu të gjitha. Kur më vonë të ndrohesha, zonja Ariadhi me fali dy gravata të bukura dhe më lidhi njërën për qafe, tuke më msuar si t'a lidh. Vura kapellën e re, këpucët e ra, shaminë e mëndafshtë në xhepin e mëngjër të sipërm të setrës (sakaqit) dhe t'u bëra një birko djalë, për t'u rëmbyer. Ja kështu të dua deh! Më tha z. Manolidhi. Shumë i hijeshëm u bëre më tha zonja Ariadhni. Kam frikë mos të rëmbenjë ndo një çupë. Dhe qeshnin si ajy, si ajo. Oh, ata njerës të lumur! Mbas dite (ishte dita që u mvesha robat e reja) shkova në shtëpi dhe kur më panë babaj dhe gratë u çuditnë e qanin me lott dhe më shterngonin fort, tuke më puthur.

Unë si e pashë vehten gentleman në pasqyrë, e mora pak për sipër e zura të mbahem serioz. Me qenë se hanja bukë bashkë me ata njerës të mirë, më bënin gjithënjë vërejtje duke m'i prerë të gjitha veset e këqija që kisha përsipër. Dal nga dalë më sympathizuan kaqe fort, sa më shëkonin si fëmijën e tyre. Edhe unë u bëra si i shtëpisë. I nderonja shumë. Ju sillesha tepër mirë e nuk përtonja për ç'do gjë që më theshin. Z. Manolidhin e shpëtova nga gjitha shkresat e korespondencat e tjera. Ishin kaqe të kënaqur prej meje sa më s'bëhet. Delnim edhe me shetitë bashkë. Më rekomandonin kudo dhe kështu u njoha me gjithë familjet e nëpunsave të Karvasarasë, ku n'a thrisnin shumë herë për çaj e për muhabet. Me kohë u bëra njeri i societesë që s'më linin prej goje të gjithë.

Z. Manolidhi u ndoth përmua një babë i dytë, një kryeprofesor, një pedagog, një shpëtimtar dhe udhëheqësi i së mbarës s'ime. Më inspironte gjithnjë për vepra të mira. Më jepte të këndonja librat më të mira e më të dobishme. Aty kam kënduar gjithë veprat e shkëlqyera të Darwinit, të Miltonit, gjithë tragjeditë e Shakespearit, Hegel, Byhner, Goethe, Shiller, Ipse, Tolstoj, gjithë veprat e Hugojt, te Rousseau-it, të Bossuetit, Fenelonit, Montesquie, Chateaubrandt, Alfred de Musset, filosofit' e Schopenhaureit, të Spenserit, të Spinosës, të Lambrosos, Jule Vern, Anatole Franz dhe shum' e shumë shkrimtarë Francezë, Gjermanë, Englezë, Italianë, Russë etj. etj. Aty këndova më të bukrat romane të Dumajt, e birit Duma, Checoft, Dostojefski, Turganieff etj. etj. Mjaft literaturë klasike greke e llatinë të përkthyera në gjuhën greke modern, ose në frëngjishten, sikurse Ovidius, Oratius, Virgilius, Salustius, Tacitus, Julius Caesar, gjithashtu veprat filosofike të Platonit, Aristotelit, Senekës, etj. oratorit' e Dhemostenit e të Ciceronit, Aeschylit (Eskilit H. K.) Isokratit, Lysias, Lykurgut, etj. etj. tragjedit e Aeschylit, Sofokliut e Eurypidit, disa diksionerë historikë, enciklopedikë, gjeografikë etj. etj. shkurt bibliotheka e paçmueshme dhe zyra e këtij burri të rallë ishin një thesar për mua, një shkoll' e artë, një universitet praktik i dijenive të ndryshme, që për shumë vjet do mos i kisha parë e nxënë. Isha fatlumur.

Dy vjet ndenja me këtë zotni të fishim e atë zonjë të begatë e më vleftnë sa për 10 vjet msim. Kisha me të vërtetë fat që u poqa me ata dhe do t'i mbanj ment sa të rronj ato dy vjet, se u stërvita aqe shumë sa u dallova mbi të gjithë shokët, të cilët nuk ishin djelm bakajsh ose reshperash[1], po gjithë student, djelm aristokracije, djelm deputetësh etj. Këso doret, midis të cilëve munt të them se isha më i miri si në msimet e ndryshme engjyklopedhike, si në shoqëri, si në presentime gjithfarësh, në bisedime, në konferenca etj. etj.

Nga ana tjetër kish edhe im'atë e shtëpia ime hair prej mejet, se përveç që puna e tij shkonte sigur e mirë, po unë hanja atje te kapitani gjithnjë, mernja 100 dhrahmi në muaj, prej të cilavet gjysmat ja jepnja tim'eti dhe kisha edhe të tjera peshqeshe e dhurata prej syresh si prej z. kapitan, si prej zonjës së tij.

[1] reshper = tregtar i madh, i pasur (H. K.)

Im'atë më shihte dhe gëzohej që u bëra një djalosh si duhet, shok më të mirët dhe e nderonja atë edhe familjen t'onë. Z. Manolidhi më merte shumë herë kur inspektonte pyjet, ku e shoqëronja kaluar mbi një kalë dori të mirë dhe shetitmë bashkë gjithë pyjet e N. Prefekturës së Valltos dhe mallet e pyjet virgjinesha të Prefekturës së Artës.

Isha aqe i shtëpisë sa zonja Ariadhni shumë herë më merte e e shoqëronja në shetitjet e më ndo një vënt ku donte të udhëtonte. Më deshnin si djemt e tyre. Pak ti sëmuresha bëheshin të paqetë e thrisnin me një herë mjekun e tyre. Im'ëmë, teto Ndinua dhe babaj vinin na vizitonin nga hera, megjithë që unë ndodhesha gati gjithmonë në Karvasarâ dhe vizitonja shtëpinë t'ime.

Mjerisht kjo lumëni s'mbajti për mua më shumë se dy vjet! Ndjesë pastë Pano Manolidhi vinte shpesh herë për gja, ku e shoqëronja edhe unë. Një dit ishim për rosa të egra dhe ish një e ftoht' e madhe. Ajy kish qef të futej vetë zbadhur në kënetën e të merte rosat e vrara, ose të plagosura, me gjithë që kishim dy mjaft të aftë langore. Ka hyrë, pra, të mbledhë nj'a dy rosa, dhe si dolli ndejti një copë herë i eksposuar n'atë të ftohtë ku mori një plevit të fortë dhe pas një lëngimi prej 40 e ca ditsh vdiq në duart e të shoqes edhe të mjekvet, tuke na mallënjyer aqe fort, në një moshë 44 vjetshe!

E mjera e shoqja mbet e vehë me të dy kalamajt ' e saja. S' gjente dot ngushëllim e ngrata. Mua s'më lëshonte prej duarsh që ju ndodha të ndyerit në momentet e fundit edhe ngushëllohej mjaft me mua e s'e linja të sëkëlldisej. Po pas 3 ditsh të vdekjes të shoqit ardhi një i vllaj i saj avokat nga Tërhallia dhe e mori me gjithë fëmijë, mbassi shitnë gjith' ato mobile të çmueshme që kishin në shtëpi të tyre, veç librave, të cilat i muarn me vehte. I mbajta një fjalë fort të mallnjyeshme funerale.

Kështu mbaroj jetën bamirësi jem i paharruar, Pano Manolidhi. Kurrë nuk do t'ja harroj mirësit' e tija.

Si mbeta i lirë u ktheva prapë te im'atë, ku s'më bënte zembra të merrem edhe një herë me qymyr e me qereste. Kisha marë tjetër sërë tani. Isha i pangushëlluar për humbjen e atij farë burri dhe s'e harronja dot.

Kur ishte gjall Manolidhi takoj që vdiq një deputet i Karvasarasë Thanas Iskua. Me qenë se ky ishte kolonel komandanti i Etapës se Karvasarasë ngarkoj kapitan Manolidhin t'i japë të vdekurit përshëndetjet e fundit nga an' e oficerëve të garnizonit. Manolidhi u pregatit në dy dit e sipër, po u sëmur me një herë dhe me qenë se desh të më stërvitnjë mua në oratori funerale, i dërgoj fjalë komandantit se s'munt të vinjë në varrim të kolonelit se ish i sëmurë, por iu lut t'a zëvëndësonjë sekretari i tij Kristo Floqi, i cili, i thoshte, ka mjaft kurajo për të mbajtur një fjalë të tillë. Si ardhi pëlqimi nga komandanti, më thrët mua z. Manolidhi e më ngarkon të flas në vënt të tij e më dha dhe fjalën e tij të pregatitur e më porositi, që në është e mundur t'a msonja mëgojë[1] e ta ligjëronja përpara popullit. Unë e këndova nja 5 herë dhe po thuaj e msova për jashtë se më ndihmonte shumë edhe memoari që kisha. Si mbaroj salikimi dhe përpara se t'a varrojnë të vdekurin mbajta fjalën e porositur.

Ishte një kallaballëk gati dy mijë shpirtsh dhe me qenë se ishin për jashtë sons la belle etoile që thonë francezët isha i shtërnguar të thrisnja shumë sa të munt të dëgjonin të gjithë. Mbajta frymën, shtërngova zembrën dhe fillova. Isha i ushtëruar kaqe mirë në gjestet oratorike dhe në mënyrën e fjalimit sa ju bëra më të madhen përshtypje të gjithëvet. Shtova shumë periodhe të tjera të mijat në rjedhjen e fjalimit, sa munda tragjike, tuke përshkruar veprat e të vdekurit, gjë që i dha një shkëlqim të math oraisonit funebrë. Ajo fjalë më shtoj shumë në aktivin t'em. I ndyeri Manolidhi u kënaq për së teprit dhe kur më panë më puthnë në ballë edhe ajy edhe e shoqja. Fjala që mbajta u botua në shumë gazeta.

Qysh ahere mora embrin e oratorit, kështu që pas disa kohësh vdiq një tjetër i shënuar politikan i Valltos prapë unë u ngarkova t'i mbanj fjalën e fundit. Gjithashtu kur e suall të

[1] mëgojë = përmendsh, palexuar tekstin (H. K.)

vdekur e të ballsamosur në Vonicë general Dhimitraq Grivën, ardhi një komisjon studentësh e më mori në Karvasarâ me vaporin e Qeverisë e vajta në Vonicë e i mbajta fjalën e fundit midis një popullsije 5. 000 e ca shpirtsh burrash e grash, që ju bëri një ndërshtypje të thellë.

Fjalë të tilla funerale kisha mbajtur shumë, po edhe disa të tjera fjalë panegjyrike[1] më ra rasti të flas në Karvasarâ, në Artë edhe në Mesollonjë. Në një përshpirtje të lord Byronit, që u mbajt në mauselumin e tij në kopshtin e bukur të Mesollonjës "Heroon" ku ngrihet madhështore e e bardhë prej mermeri statua e poetit engles, filogrek, po edhe filo shqiptar që vdiq në Mesollonjë në kohën e çlirimit të Grekëve prej zgjedhës turke, unë i angazhuar prej shoqërisë të djelmënisë Mesollogjite, mbajta një fjalë gati gjysmë ore prej tribunës së ngrehur nga Bashkia e Mesollonjës mbassi folë më parë dy oratorë të tjerë, njëri në emër të qeverisë dhe njëri në emër të Bashkisë për popullin mirënjohës të Mesollonjës. Po edhe konferenca kisha mbajtur disa dhe shpeshherë kisha marrë edhe pjesë në çfaqime theatrale, tuke exekutuar nga sqena rolet më të zorshme të disa dramave.

Prej të ndyerit Manolidhi kisha vënë baza mjaft të forta diturije dhe sjelljesh shoqënore. Në kohën e fundit para se të ndahet prej nesh bamirësi i paharuar më kish stërvitur në disa këndime juridike dhe me fort në historinë e principet e drejtësisë, në procedurën civile, në kodin penal e proc. penale dhe në filozofin' e engjyklopedhinë e drejtësisë. Gjenja shumë shije e ënde në këndimin e atyre librave, të cilat m'i rekomandonte vetë Manolidhi dhe më stërvitte t'i këndonj pa mos përtuar të më japë ç'do shpjegim si jurist konsult që ishte. Më thosh i mjeri mso edhe prej këtyre, se nuk do pendohesh. Edhe me të vërtetë kjo më dolli për të mirë muven!

Si ndjenja pothuaj ndo një muaj pa punë në dyqanin t'onë, ku, si thashë s'më bënte zembra të kthehesha prapë në zanatet e vjetra, zura e po mërzitesha, zura të hâ të azërta[2] dhe s'mejtonja djersën e t'im'eti e interesin e shtëpisë. Pas ca kohësh e hodha krejt jashtë dhe s'mblidhesha dot në shtëpi. Desha roba, këmishë, gravata e këpucë të modhës, të cilat ish shtërnguar t'i paguaj im'atë, se i vinte turp nga bota. Shokët nga ana tjetër s'më linin rehat me qitharat e mandolinat me kandallat e me shetitjet në për det. Sa shpejt mer tatpjetën i riu e sa s'e kupton rezikun! Për çudi im'atë s'më hoqi kurrë vërejtjen, po gëlltitte për së tepri. Gratë s'e kuptonin rrokullimin në të cilin po rëzohesha dita-ditën. Zura të pi cigare, që gjer ahere s'kisha vënë në gojë . Fillova të los me lettra, të los si maniak bilardhon, të pi pa masë uzo e mastikë e të mar edhe rugë të tjera më të këqija. Edhe isha në moshën më lulëzore, isha 18 me 19 vjetsh!

Një ditë kemi glendosur me shokët tërë natën e tërë ditën që pasoj edhe natën tjetër do m. th. 36 orë glent! Një natë tjetër jemi nisur tuke kënduar me disa shokë me një karro dhe jemi gdhirë në Vrahor. Kemi marë q'andej edhe nj'a 6-7 shokë të tjerë dhe kemi vatur në Mesolonjë. Kemi marë edhe nj'a 3-4 të tjerë s'andejmi e kemi shkuar në Patrë gjithë tuke kënduar e tuke bërë një mijë gjëra të papëlqyera. Kemi ndenjur në Patrë nj'a 4 orë dhe jemi nisur të gjithë siç ishim me vapor e kemi shkuar në Kefaloni, në Argostol, s'andej ne i jemi drejtuar Levkadhës, tuke mbledhur të tjerë shokë të marë nga do që shkonim gjer sa u kthyem prap në Karvasarâ. Ishim shumuar gjer atje në numurin 35! Edhe glendi gjithë zinxhir shkonte; smbanj mënt të jemi ç'lodhur gjë kundi, s'mbaj mënd në ka fjetur njeri prej nesh në gjithë këtë distancë! A ka si përshkruhet me ngjyra të tjera këjo marrija jonë?

Një natë tjetër kemi qënë nj'a 12 shokë në një barkë me një velë. Kishim vënë me refene[3] e kishim pregatitur një tavë (bostan-tavasi), disa kukurecë e meze të tjera dhe vezë e raki boll. Dikush kishte marë fizarmonikën, dikush qitharën, dikush mandolinën e dikush flauton. Si hëngrëm e pimë e ja shtruam koncertos, pak përpara mesit të natës me të kthyerit të

[1] panegjirik = fjalim i mbajtur në publik për të naltësuar meritat e një personazhi, të një qyteti apo populli (H. K.)

[2] të hazërta = të gatshme, qyl (H. K.)

[3] refene = gosti me të ngrëna e me të pira që bëjnë disa veta, duke paguar seicili pjesën e vet (H. K.)

lundrës kur po bënte vollta[1], timonieri, njeri i pa-zoti s'e ktheu mirë lundrën edhe vela si ish e hapur u kthye me një herë dhe rëndësia e saj e ktheu lundrën përmbys. Për një hejrësh të gjithë u gjëndmë në det! Velenxa, tava, gota, thika, pirunj, lugë e të tjera ç'kishim shkuan në funt të detit. Dhe ishim në mes të detit, kush e di sa bojë thellë. Instrumentat t'ona, përveç flautos s'ime që vajti e gjeti fundin, lundronin për mbi det. Lumërisht të gjithë dinim më not dhe filluam të notojmë sado që ishim të mveshur dhe s'dukej njëri me tjetrin. Me gjith'atë shakatë nuk pushonin. Kënga po vazhdonte munt të thom akoma me gjithë poteren që na gjeti. U ndoth atje një më i marri nga ne, prej shokëve, i cili insistonte të loste në det akoma fisarmonikën, tuke pasuar këngën atje ku e lamë! Kjo marri nuk e vë vulën ç'do marrije tjetër? Mezi më në funt e kthyem barkën nga e mbara dhe u futmë të gjithë brenda. Nuk u sëkëlldismë aspak me ç'na ngjau. As u ankuam pse ishim bërë qull e do plevitoseshim, as n'a ardhi keq pse shkuan gjith'ato velenxe e sende të tjera që kishim marrë prej shtëpijave. Njerës të çuditshëm.

Si e pamë që po mërdhinim si në mes të dimbrit vendosmë të kthehemi. Ahere një prej nesh që ishte afër timonit vuri re se një litar lidhur prej lundre po hiqte diçka në det. Litari ishte mbërthyer afër timonit. Me një herë bërtet: Dhiane Do me thënë "sihariq". – Ç' ësht' i themi? – Na paska shpëtuar galloni me verën thotë!. . . Ne harruam që kishim lidhur afër timonit një shishe me verë triokatare. Oh, sa u gëzuam ahere. E marrim atë shishe dhe e ngrehim në gojë secili me radhë gjer sa e pimë të tërë. Te e mbramja u shpërndamë.

Ky aksident u komendua të nesërmet gjithfarësh. E vërteta ish që kishim lënë një përshtypje të keqe në popull, sa të nesërmet disa miq më hoqnë vërejtjen. Një mik i babajt, i ndyeri Petro Vitua nga Labova kaqe më qortoj për marrëzitë e rrugën e keqe që kisha marrë, e munt të mernja në qafë vehten edhe shtëpinë kështu, sa më vuri në një mendim të thellë. Më solli ndër mënt ç'djalë isha kur ronte Manolidhi dhe ç' çapkën u bëra sot! Po, ç'të bënj, zoti Petro, i thom. – Të kthehesh ne yt' atë e t'i përvishesh punës; s'është ndonjë turp. Turp është të vazhdosh në këtë rrugë. – Po, si të bënj? – Ashtu si të thashë. Në mos të pëlqen munt të hapësh ndo një copë zyrë e të bësh lutje e shkresa të tjera. Do të nxjerrç si do kudo një rrogë. Po të duash prapë munt të vesh në zyrën e një mikut t'em, avokatit praktik, në zyrën e Jan Kallapazarit.

Jan Kallapazari ishte një avokat praktik (greqisht H. K.) në një moshë 60 vjetshare. Kish 35 vjet që bënte avokatllëk në Karvasara ku ishin edhe 2 avokatë të tjerë pa diplomë dhe të gjithë fitonin mirë. Unë e njihnja atë zotëri dhe s'më kish vajtur kurrë ndër mënt t'i bënja një proponim të tillë.

Me një herë e mblodha mëndjen dhe i thashë zotit Vitos që i falem nderit fort, po s'di në më pranon për sekretar, se ajy kish një sekretar tjetër, që unë e kisha shok të cilin e paguante 80 dhrahmi në muaj dhe e kishte prej 3 vjetsh në shërbimin e tij. Petro Vitua më thotë që më rekomandon vetë ne ajy dhe po të dëshëronja mund të shkonim që tani te ajy. Ju fala nderit edhe një herë dhe u nismë që të dy ne avokati Jan Kallopazari.

Avokati na priti mirë dhe më mbajti në zyrë të më provonjë. Kur më pa bukurshkrimin dhe shpejtësinë në shkrim e inteligjencën që kisha edhe më fort kur pa se isha i stërvitur në ligjet edhe kuptonja mirë, ju bë qefi mjaft dhe më tha se s'e pandehte të isha kaqe i zoti. Kështu u shtrova atje për gëzimin e math t'emin edhe të t'im 'eti dhe mbassi mbeti shumë i kënaqur prej mejet muajin e parë më pagoj për rrogë 100 dhrahmi, të cilat, që atë ças, shkova e ja dhashë t'im 'eti, i cili më përqafoj dhe qau nga gëzimi.

Si ndjenja 4-5 muaj ëdhe u stërvita mirë nëpër gjykatoret, ku e shoqëronja nga herë z. Kallopazaro dhe si e pa se munt të delnja edhe vetë përpara gjyqit e të mbronja davara, më ngarkoj një dit me nj'a 5-6 padina të lehta, ku bëra përshtypje të mirë midis kolegëve tjerë e miqve të cilët më përgëzuan që të gjithë. Qysh atë dit isha avokat.

[1]vollta = veprim i anijes kur rrotullohet për t' u parkuar në port (H. K.)

Në ca davara të tjera që mora për sipër më vonë, munt të them se triumfova. Z. Kallopazaro dalë nga dalë zu më jeptë përsipër sa davara që merte, se vetë si plak zuri të rëndeshe. Kështu më 8 muaj e sipër e zëvëndësova z. Kallopazaro edhe fitimet i ndanim për gjysmë. Më vinin në pjesën t'ime që prej 200 gjer më 300 dhrahmi në muaj, shumë kollosale për atë kohë, se 300 dhrahmi merrte një prokuror i shkallës së I e 350 kryetari i gjyqit filluer. Tri qind dhrahmi s'i fitonte as 'im 'atë nga gjithë tregëtitë që bënte.

Kështu për pak kohë u dallova si një avokat i mirë e i zoti e s'kisha mbushur akoma të 20 vjetët. Kënaqesha shumë kur dëgjonja një që më titullonin si "z. avokat " si brënda dhe jashtë gjykatores dhe mbahesha mjaft serioz, i pastër e krenar.

Të hollat ia dorzonja të gjitha babajt dhe mernja uratat e tij me thasë. Harxhonja vetë më pak se gjysmat, po mbahesha mire dhe më deshnin gjithë miqt' nëpunësit civilë e ushtarakë të qytetit.

Kështu filloj prapë të nënqeshë lumëria dhe isha edhe një herë gëzimi e shpresa e shtëpisë.

Pas një moti e gjysmë n'a la shëndet një natë Jan Kallopazari prej pike se ishte kardhijak (sëmurë nga zemra H. K.) edhe kështu zyrën e tij e trashëgova unë. Sekretarin e tij, të cilin si e thashë e kisha edhe shok e mbajta prapë sekretar e ja shtova rrogën mora edhe një ndihmës tjetër me 50 dhrahmi në muaj, se kishim shumë punë dhe me gjith' ato me mbeteshin 400-500 dhrahmi në muaj.

Gëzimi i babajt e i gjithë shtëpisë arrin në kulmin e tij. Gravet ju a bënja vetë robat e gjithë mveshjen tjetër si dhe vllajt t'im Thanasit, i cili ahere mbaronte klasin e III të helenikos (klasin e 7 popullor) dhe kalonte në Gjymnazin. Edhe me qenë se duhej ta dërgonin në Mesollonjë, se s'kish gjymnaz në Karvasara e mora përsipër t'a mbanj me shpenzimet e mija, që babajt iu bë shumë qefi.

Po ardhë trashëgimtarët e Kallopazarit dhe më kërkonin t'iu dorëzonj, librat e veglat e tjera të zyrës së tij. Mezi e godita punën edhe me ta tuke iu dhënë 1. 000 dhrahmi për të gjitha, e tuke ju marrë quitancën. Kësisoj u bëra i zoti i zyrës e i një kapitali. Se që t'i blinja të reja gjith' ato libra, ato bibliotheka ato frona e ato tryeza desha të paktën 3. 000 dhrahmi.

Këtu do të largohem pak nga thema, tuke bërë disa fjalë për mbi t'em vlla Thanasin, edukatën e të cilit m'a kishte besuar mua im' atë.

Djali u rit ne një disciplinë të fortë, se s'i ndahesha unë këmba këmbës. Sa ish i vogël s'e linja kurrë të përzjehej me shokë të këqinj, e shëkonja 2-3 herë në javë në shkollë, i bënja msime veçanërisht, i rinja përsipër dhe i shkonja mbrapa gjurmëve të tija, tue survejue mbi sjelljet e disciplinën e tija. Msuesit e tij, të cilët i kisha shokë e miq, i vijeshin gjithashtu, prandaj im' vëlla ishte kurdoherë më i miri, i pari i gjithë shokëve të tij, shembull bindësije, e shembull nxënësi.

Mbassi e kishim shtëpinë afër detit, kisha frikë se mos pësonte gjë, si më ngjau edhe mua tjetër herë, prandaj u shtërngova një verë t'a msonj më not, se vetë kisha msuar kaqe mirë që kur isha 15 vjet djalë, sa dallonja nga më të mirit notarë të Karvasarasë. Thanasi, pra, nxuri më not që kur ishte 10 vjetsh.

Ngutësija imë që e msova më not shpejt ishte edhe kjo.

Një dit djali vinte nga shkolla në shtëpi. Fati i tij takoj të isha prapa tij, tuke ecur prej një largësije 200-250 metrash. Me qenë se e kishim shtëpinë lark qytetit, qysh atje ku mbaronte qyteti e gjer në shtëpin t'onë ishte një largësi 500 metrash, që vetëm ruga publike rëzë malit bashkonte shtëpinë t'onë me qytetin tjetër. Rruga ish afër detit, ose përbënte bregun e detit dhe ish bërë me gurë, e nalt nj'a 8 metro që nga deti. Im vlla tek shkonte fare afër rugës, se qysh bëri dhe u gremis s'andejmi e ra poshtë në det, tuke bërditur. Njeri tjetër s'u ndoth atje përveç meje që më shpuri fati i tij. Ngutem shpejt t'a arrinj, po mjerisht s'kisha nga të lëshohem se ishte mur vëndi, si një thikë. Djali po mbyteshe në ujë, po e shihja me syt' e mija; vendi ish i thellë nj a dy bojë njeriu. Koha s'pranonte vonesë. Ahere në dëshpërim e

sipër u hodha që atje lart me sa fuqi kisha rash' në det nj'a dy metra lark të mbyturit dhe menjëherë e përfshinj, tuke u drojtur se mos më mbërthente me duar, e siç ishim mveshur që të dy (ishte muaji i Marsit) munt të krydhesim nënë ujë e të mbyteshim që të dy. Tani mir' e kapa po s'kisha nga t'a nxjer se isha gjith anës së murit të naltë, pa shkallë, pa gjë. Kafeneja e vogël jona mbi malin e ulët ishte nja 100 hapa lark nga vëndt i mbytjes. Këjo më vinte në një dyshim se do mos e shpëtonja dot me gjithë që e arriva të gjallë. Një e drithme ma depërtoj trupin më mori frika. E deshnja kaqe shumë sa edhe jetën e therorizonja për atë. Desh Zoti e po shkonin disa njerës mbi rrugën dhe na panë që po luftonim me vdekjen. Im vlla mbaheshe mbi supin t'em të mëngjër, tuke më patur hedhur dorën e tij të djathtë mbi zverkun t'em. Unë i shtërnguar të notonj vetëm me dorën e djathtë e me të dy këmbët isha e detyruar të dajandis me gjithë atë rëndësi të madhe që kisha te t'im vëllaj edhe të robave t'ona që ishin fuskosur me ujë.

S'kisha notuar as dhjetë hapa dhe ndjenja vehten të lodhur. Por ata që n'a shihnin përsiprë më bërtitnin të afrohesha afër murit të detit ku mund të mbështetesha dhe të qëndronja ashtu gjer sa të sillnin ndo një litar, të lithnja t'em vëlla që poshtë e ta ngjisnin ata lart, e unë të pasonja notin tuke dalë te moli i kafenesë s'onë. Kishin dhënë haber në dyqanin t'onë dhe muarn litar. Kishin dalë të llahtarisura e me gjysmë shpirti edhe gratë të gjitha të shtëpisë e po shëkonin me agoni dramën që po ngjistë përposh në det.

Lumërisht kur po afrohesha afër murit, pa pandehur shkela në tokë, ku do ish nj'a një metro e gjysëm thellë. Më panë që shkela. Kishim shpëtuar! Ahere një djalosh nj'a 17 vjetsh mvaret nga muri e hidhet në det pranë meje, e kështu, në vënd ta lithnim me litar për sqetullash u lëshuam prapë më not që të dy me t'em vëlla, ku ajy djaloshi tjetër notonte anës nevet, gjer sa arrimë molin t'onë. Me litarin kishin frikë t'a lithnim se mos këputej e binim prapë. Kështu atë dit i kam shpëtuar jetën t'im vëllaj i cili kishte thyer një dhëmp kur po rëzohej dhe kish kafshuar edhe gjuhën.

Atë verë që e msonja not t'ëm vëlla, mbassi ja hoqa frikën e e mirnja me vehte në një largësi 50-100 metrash mbi det i lithnja kurdo herë një papir rogozi nga mezi që t'a mbante për sipër uji. Kështu im vëlla luante duar e këmbë e notonte përbri mejet. Po një dit, si ishte kalbur spangua që lidheshe papyri, u këput me një herë dhe po kur e shoh që andej im vëlla edhe humbi equilibrin! Medet! Edhe ishim mbi një thellësi nja 10 metrash e më tepër. I'm vëlla zu të bënjë si munt të bënjë një i mbytur po e kallmova (qetësova H. K.) me një herë, kështu që ky po mbahej lavër[1] pas supeve të mija, gjer sa munda e i lidha papirin tuke notuar.

Me këtë rast do të tregonj edhe disa episodhe që më ngjanë në atë detin historik të Karvasarasë.

Mua s' më ishte mjaft që u mbyta një herë, kur isha 9-10 vjetsh si e tregova tjetër herë, po takoj dikur ahere kur msonja më not e delnja jashtë detit tuke u mbajtur prej një tërkuze të gjattë, takoj, po thom një dit të këputet tërkuza e të ndihem i izolluar me gjithë tërkuzë në një thellësi3-4 metrash ku do mbytesha sigurisht po të mos ishte ndodhur një tabakçi, Kosta Dhosi, i cili më pa që për së largu ku po argaste[2] një lëkurë buzë detit dhe u sul shpejt e më arrin të gjallë e më shpëtoj, me gjithë që luftova mjaft me detin edhe thëthiva disa litra ujë.

Kur më nxori në skaj të molit ju fala nderit shumë, po Kostë Dhosi, më tha s'ka gjë, lava huan, se edhe mua kështu më shpëtuan një herë nga deti. Pra, m'a paç borç edhe ti, më tha, tuke qeshur.

Shkuan qysh ahere 5-6 vjet. Kostë Dhosi kishte një djalë të vetëm 7-8 vjetsh, një djal' i prapë, një lanet, që s'linte dy gurë bashkë. Një mbrëmja djali po loste afër detit, tuke hedhur gurë nga an' e detit. Ishte ora një e natës dhe s'kishte hënë fare. Një bracerë ndodhej aty afër molit ngarkuar me qeresté[3], edhe unë isha në molin t'onë ndenjur mbi një karekllë e po

[1]lavër = keq, shumë keq ("E bëri lavër diçka" = "e prishi diçka, e përmbysi dhe e bëri rrëmujë" H. K.)

[2]argas = regj (regj lëkurën H. K.)

[3] qeresté = lëndë druri e prerë, si trarë, drrasa etj. që përdoren në ndërtim (H. K.)

mernja erën e fullimit ose e majistratit të natës. Ishte Korrik. Dëgjoja nga anija që po e qortonin djalin të shkonte në shtëpi se ishte von e e prêt e ëma, po djali as tundej nga vëndi, po gjithë loste tuke hedhur gurë. Pastaj s'u dëgjua gjë. Unë kujtova se djali do të ketë shkuar në shtëpi edhe si ndenja nj'a dy minuta u ngrita të vete në shtëpi. Se si më tha Zoti a dreqi të shkoj nga vëndi nga ku ishte tuke hedhur gurë djali i vogël. S'pashë njeri. Po tek po shihja rëzën e detit m'u duk sikur një gjë po lëviste brënda në ujë, nja 3-4 hapa lark detit. Thashë mos ish ndo një breshkë deti, ndo një delfin, ndo një sent tjetër, po kurrë s'më vinte ndër mënt të ishte njeri atje brenda. Për një herësh më arth ndër mënt djali i vogël që po loste atje e që s'e pashë të shkonjë. Bëhem merak dhe i afrohem më afër detit, ku veshgëlleva ca si duar njeriu, me ndihmën e dritës fosforate të detit, që po silleshin andej këtej, tuke u përpjekur me një farë dëshpërimi! Më ra ndër ment me një herë që do të ishte djali i Kostë Dhosit që po mbyteshe. S'kishte as gjysëm njeriu. Një qetësi e thellë. Me një herë xhvesh sakaqin e pantallonat, i lë buzë detit dhe hidhem në det e e kap më një herë kalamanin prej flokësh. Për dy minuta e kisha nxjerë jashtë. Bërtita pastaj dhe duall nj'a dy naftë prej bracerës e ardhë jashtë, i nxuarëm robat, e ngritmë koktatpjetë, volli sa ujë kish pirë dhe kështu e shpëtuam e ja çuam t'et Kostë Dhosit, i cili kishte orë që po e kërkonte në pazar djalin e s'e gjente. Kështu erdhi sëra që edhe unë ja shpërbleva K. Dhosit!

Një dit tjetër, me 22 të Janarit 1892, tek po loste në një mol afër zyrës s'ime e bija e komandantit të piaza-forme të Karvasarasë z. Athanas Kokotaqit e motra e z. Jan Kokotaqit që ndodhet sot këtu në Tiranë në Legacjonin e Greqisë si charge d'affaires i Rep. Greke, një vajzë e vogël 13 vjetshe shkon edhe u gjent në det. Shoqet e saj filluan të qajnë e të bërtasin me zë të naltë tuke kërkuar ndihmë që ta shpëtonin. U mblodhë disa veta aty në vënt, por ose nga e ftoht' e madhe që bëndej ose nga që s'dijnin not, ose që s'deshin të rrezikonin jetën e tyre, nuk kuxonin ndo një prej syresh të hidheshin në det e t'a shpëtonin. Unë dëgjova klithmat e paprera të gocavet, se po isha tuke shkrojtur edhe kur pashë se ishin mbledhur një grumbull i math e nuk guxonte njeri ta shpëtonte të ngratën vajzë, hoqa me një herë pallton e trashë prej trupit dhe u hodha në det, tuke notuar, se ish larguar nj'a 10-12 metra prej bregut. Pikësëpari i kapa një fustanin e saj që ish i foskosur e po plekste[1] si një fener Venetikas i kuq mbi ujë. Posa që e tërhoqa dhe i ngrita kokën përpjetë, ajo e dëshpëruar hap sytë dhe më një herë më përfshin me të duart në qafë. Edhe ishte mjaft e fortë. Një luftë ahere fillon ndërmjet nevet të dy; ajo kërkonte të shpëtonte e po më fundoste mua, tuke më rënë përsipër me sa fuqi kishte; unë po mundohesha të çqitesha nga ajo të shpëtonja më parë vehten që po e shihnja në rrezik pa pandehur, pastaj të mendohesha të shpëtonja edhe atë. Ajo mundohej unë mundohesha, herë fundosnim të dy her' ajo vetëm, herë unë, dhe me gjithë që i thrisnja të lijëshe në dispozicjonin t'em e të mos më shtërngonte se do mbyteshim që të dy ajo ca më tepër më shtërngonte e dëshpëruar. Kjo luftë vazhdoj 2-3 minuta që më dëshpëroj krejt. E keqja ishte që s'ndodhej as një burrë të munt të hidheshe të më ndihmonte, se si domos kur janë dy veta me një ndryshon puna. Përkundrazi ata njerës pa shpirt, ata rezila po qeshnin tuke parë dy njerës që po mundoheshen të shpëtojnë jetën e tyre, dhe po luftojnë vdekjen me dëshpërim.

Në një dëshpërim e sipër ja shtërngova tepër njërën dorë çupës sa i dhëmbi dhe më lëshoj; me të shpejtë ahere e shtynj dhe ngreh kryet jashtë detit të mar firomë, se ment pëllcisnja prej asfyxije dhe tuke e hequr me tjetrën dorë munda e arriva një shkëmp afër molit, ku u unjtnë dy vetë e ju dorëzova vajzën!

Kështu e shpëtuam atë vajzë që mënt më mbyti edhe mua. Si e dërgova në shtëpi të saj kthehem në shtëpi të ndrohem, po pas dy orësh vijnë në shtëpi t'onë zonja dhe zoti major Kokotaqi të më falenderojnë se ju shpëtova çupën. Zonja Kokotaqi më dha në një zarf të mbyllur 2 banknota nga 500 franga njëra, tuke më thënë që "pak janë, po m'i jep si një regallo

[1] pleksur = që është lidhur me diçka tjetër sa nuk zgjidhet dot (H. K.)

se i shpëtova çupën". Unë ja ktheva më një herë, pse nuk e bëra këtë për të holla, kurse rrezikova edhe jetën time, po e bëra për njerzi. Po zoti Kokotaqi m'i jep prapë dhe insiston që t'i mar se prisha robat, sahatin e sende të tjera që m'u ndodhë përsipër kur u hodha në det, por as këtij s'ja pranova. Ahere e shoqja, tuke nënëqeshur, i thotë s'im 'ëme , se mbasi e shpëtova Lilikën (Julnë)[1] kishin qef të ma jepnin grua. Babaj im ahere mer fjalën e i thotë zonjës Kokotaqi "falemi nderit, moj zonja ime, po edhe djali im s'i ka mbushur të 20 –tat dhe goca e juaj është e vogël akoma. Si ndejnë ndo një orë me ne u ngritnë shkuan, duke na falenderuar së teprit, dhe tuke na ftuar të nesërmet mbrëma në gosti, ku s'munguam të vemi të gjithë, sepse dha një gosti tepër të madhe z. Kokotaqi për shpëtimin e çupës. Të 1000 dhrahmitë prapë se prapë ja dhanë s'im 'ëje, e cila natyrisht i mbajti.

Lilika e vogël qysh ahere, sa herë kalonte nga zyra ime do vinte të më puthte në dorë e të më falenderonte. Më quante gjithnjë "……. "(shkruar greqisht H. K.) d. m. thënë shpëtimtarin e jetës së saj.

Edhe një tjetër:

Po në atë kohë pothuaj, po një vjet më vonë, një mik prej Karvasaraje, professor Dhimitri Bitta, ishte martuar në Athinë para disa muajsh e kishte sjellë të shoqen në shtëpi të tij për të veruar në Karvasarâ e për të bërë banja. Bitta kishte t'ëmën dhe 3 motra në moshën e martesës .

Një dit n'a vjen e shoq' e tij z. Sevasti, një nuse 22-23 vjetsh bashkë me të tri kunatat e saj dhe dy të kushërirat e prof. Bittës, në banja t'ona që kishim afër kafenesë. Unë me disa miq kishim bërë banja më përpara në banjërat t'ona të burrave dhe po mvisheshim dal nga dalë. Dëgjojmë më një herë klithma e të bërtitura grash nga banjërat e grave, po s'merrnim vesh ç'kanë se ishin shumë gra e çupa që po laheshin. Shtiem sytë nga të plasurat e banjëravet edhe shohim kujdestarin e banjove një djalë të qojtur Kosta Çikujas, që u hoth me një herë në det e që po drejtoheshe tuke notuar nga banjërat e grave. Kur shohim me tutje një gjë si të mavi, si të bardhë në për shkumbët e ujit dhe Kostë Çikujanë që po vërsulej në atë vënt. Me një herë kuptuan se dikush po mbyteshe. Po ç'të ish i mbyturi grua apo burrë? S'e merrnim dot vesh, se ishte më shumë se 100 çape përtej banjove t'ona. Shëkojmë K. Çikujanë që arrin në vënt dhe po mundohej të shpëtonte të mbyturën, po në vënt t'a shpëtonte po rezikonte edhe ajy vehten e tij, se i mbyturi e kishte përfshirë prej supevet. Pa shkuar dy minuta një tjetër levent hidhet në det e po drejtohet me pashe të gjatta e të shpejta notuese në vëndin e dramës. Ishte i vëllaj i Kostës, më i vogli, Vasili, i cili që e shëkonte në rrezik të vëllanë dhe u derth ta shpëtonte. Gratë po thrisnin, po lebetitnin, po çirreshin, po vajtonin.

Gurgule e madhe. Ç'ngjiste aty?

Zonja Sevasti Bitta nga Athina dinte pak not dhe shumë herë delte nga banja dhe shkonte tuke notuar një largësi deti të vogël dhe pastaj kthehesheshe prapë. Këtë e përsërittë shumë herë. Atë ditë për fat të keq ishte larguar në det më tepër nga masa; kur zu të kthehej e pa se ishte shumë lark nga banjot e ju trëmp syri. Me një herë e humbi toruan humbi equilibrin e zu po mbyteshe me të vërtetë. Kostë Çikujaj i shkreti që ish një djalë 20 vjetsh, u hoth në det që ta shpëtonte, po zonja Sevasti e përfshin me një herë nga supet dhe po mbyteshin që të dy. I vëllaj Vasili kur e pa Kostën në rrezik u derthmë fort për të vëllanë, se sa për zonjën Sevasti. Këtë e muarm vesh unë dhe një shoku im kur u afruam në vënt (se pse u hodhmë edhe ne bashkë me një shok, Vasil Papakriston, kur pamë që po mbyteshin që të tre).

Si u afruam në vënt të ngjarjes edhe unë edhe Papakristua, ajy zhytet me një herë dhe ja shpërthen duart zonjës Bitta prej supeve të Kostës, tuke shpëtuar në këtë mënyrë Kosta Çikujanë, që pa fjalë do ishte mbytur, prandaj ja detyronte jetën Vasil Papakristos, e jo të vëllajt të tij Vasil Çikujajt, i cili në ment arriu në vënt, po s'kishte kuximin as njërin, as tjetrin të shpëtonte.

[1] Embri i vajzës (K. F.)

Si dolli në livelin e detit Kostë Çikujaj tuke sharrë e tuke mallkuar zonjën Sevasti, shkuan bashkë me të vëllanë e n'a lanë nevej. Vasil Çikujaji thesh të vëllajt: Për një dosë vajte të humbaç të ritë tënd. Eja të ikim. Lëre ta hanë peshqit. Atë kokë pat. Dhe iknë.

Vasil Papakritua një notës i aftë më thotë mua t'a zë Sevastinë për këmbësh e t'a heq nga ana ime. Sa kaqe bëra si më porositi Vasil Papakristua. Ajy ahere e zuri për leshrash dhe kështu ja qitmë kokën jashtë që të merte erë piksëpari. Pastaj tuke e kthyer nga kurrizi zonjën, ajy ecte përpara me flokët e saj të gjatta ndër duar dhe unë tuke e shtyrë nga këmbët, kështu që s'munt të përfshinte ajo as njërin as tjetrin, me gjithë që ishte gjysm' e mbytur gjer ahere dhe s'kish fuqi as të lëviste dorën. Kështu me një lehtësi të madhe e shpumë në banjot e grave tuke kujtuar se e suallën të mbytur nga shenjat që po shihnin mbi atë.

Oh, s'rëfehet ajy çasht kur ja u dorëzuam të kunatave nusen, Ja u ngjitmë lart në banjërat me gjithë që ato të shkretat gjysmë të veshura tuke qenë se na u lutnë të qëndrojmë pak t'ju ndihmojmë se mos e binin nër vehte nusen e mbytur, për të cilën unë me shokun ishim të dëshpëruar se do munt të ngjallej edhe një herë.

Në atë koh' e sipër ja mbrini edhe shoq' i saj prof. Bitta me një doktor pas dhe hynë në banjo ku ishim ne dhe mbassi e fërkoj doktori nusen dëndur më në funt ajo hapi sytë dhe ardhi ndër mënt.

Një episodhë e tillë prapë, po pa rëndësi e pasoja më takoj një dit tjetër. Një mullxhi po vinte me një gomar të ngarkuar me mjell , që e kish blojtur në katunt ku kish mullirin e tij e ja sillte të bluar dikujt zotnije në Karvasara. Ish e djelë. Unë kisha dalë me shëtitë dhe po ecnja udhës vetëm. Mullixhiu fukaraj le gomarin e ngarkuar të vazhdonjë rrugën dhe vetë zbret të lanjë pak sytë në një farë mburimi gjysmë t' ëmbël, gjysmë të kripur që ish aty poshtë ndanë detit. Gomari qetë dal nga dalë edhe mullixhiu zbret shpejt afër detit që të lahet në mburim e të arrijë prapë gomarin e ngarkuar.

Unë po ecnja anës rrugës zallit e po e vëzhgonja mullisin ku lahej. Dukej se s'mbahej mirë mbi gurin që po qëndronte dhe me një herë ra më krahëza në det dhe përveç që ish i mveshur rëndë po kish edhe një koxha gunë të dhirtë përsipër dhe ra me gjithë gunë brënda. Brodha me një herë poshtë dhe arriva e i kapa gunën e e tërhoqa jashtë, po më mbet guna në dorë, kurse mullixhiu i shkretë mbet prapë në det. Po tani? Thashë të hidhem brenda me gjithë që ishte e djelë atë ditë, por isha mveshur me robat e mira; megjithatë e shinja që ish larguar akoma shumë nga stereja dhe kështu shtrihem pak barkazi mbi gurin nga kish rënë mullixhiu, zgjata sa munda bastunin dhe munda t'a zë nga e çepkësë (e mëngës së gjattë). Kështu e tërhoqa të zinë dhe i dhashë dorën e dolli jashtë. Nuk e lashë të rinjë më tepër se dy minuta brenda në ujë.

I mjeri mullixhi ishte me gjysmë shpirti kur e hoqa jashtë, i kish ikur gjaku, , se e pa vdekjen me sy, po ishte fati i tij që u ndodha unë atje pranë. Më shëkonte si i habitur dhe në vënt të më thoshte gjë tjetër, kujtoj menjëherë gomarin e tij të ngarkuar. Gomari, afendiko, më thotë, gomarin t'em, a mos ma pe gjëkundi? Askor fatkeq, i thom nuk thua që shpëtove. Po kërkon edhe gomarin. – Ç' të bënj afendiko, thotë, pa gomarin? Pa atë më mirë të mos jem. E kam shok, vëlla, mik. – S'je i kënaqur që shpëtove? i thom. – Për atë falemi nderit Zotit. - Po mua, i thom, që të shpëtova, nuk më ke borç gjë? – Tani kur të vemë në pazar thotë mullixhiu, të qeras një uzo! Theshte edhe dridheshe nga e ftohta se ishte Prill akoma. Qesha me zembër me naivitetin e mullixhiut katundar dhe u ktheva nga shëtitja, tuke e shoqëruar deri afër qytetit. Udhës gjetmë edhe gomarin e ngarkuar, i cili s'e kish prishur aspak havan' e tija.

Tuke shkuar bashkë me të shpëtuarin t'em, më thotë: Nga të kemi ty, afendiko? Karvasarjot jam, i thashë. Je i martuar apo jo? Jo. Tamam kam një mbesë në fshatin t'em, Sardhinina, dhe bën tamam për zotrin t'ënde. Ka prikë? Ja pres. – Ne marim prikë thotë, në katund, nuk japim. Është turp për një burrë të marë prikë nga gruaja!. . . Mullixhiu katundar m'u duk se kish të drejtë.

Kështu ardhmë gjer në dyqanin t'onë. Atje i thom mullixhiut: E po tani s'më gostit një uzo që të shpëtova? Katundari dinak, si u krojt pak. M'a fal, thotë, afendiko, të qeras tjetër herë se kam frikë mos më ikinj gomari!. . . Ky katundar më la një ndërshtypje që s'do ta harronj. As e qojti për punë të madhe shpëtimin e tij. As më tha një "faleminderit" por edhe jo të më qeraste edhe ahere i ardhi keq për një pendare! Kur ja tregoja këtë episodë një mikut t'em, më tha me fjalë të thata: Të isha si ty do t'a linja të mbytej. Ajy ishte një kafshë me fytyrë njeriu. T'i shpëtosh jetën një herë e mos të të qerasë as një uzo!

Pasonj prapë mbi historin' e vëllajt t'im Thanasaqit.

Si mbaroj të tre klaset e hellenikosë (e 7-$^{ta}$ popullore) e mora një dit dhe vamë në Mesollonjë. Djali kishte gradën më të madhe të kalimit tij në gjymnas. Po nuk di se qysh bënë ata msues skollastikë edhe në provimet që dha e lanë prapë në klasin që qe, përse? Për 1/48 të numurit, që përmetonte hyrjen e tij në gjymnas! O skollastikume! Kjo i kushtoj shumë vëllajt t'em se s'kish mbetur kurrë dy vjet më një klas. Ishte shum m'i fort e më i aftë në msimet se mua. Ishte më i miri i shokëve dhe shemblla e gjithë shkollës. Nuk e deshte vehten. Deshte të vriteshe se sa të ktheheshe në Karvasara. Po me qenë se ishte shumë i bindur tek meje, posa i çfrytta një herë u ul dhe e mora me vehte dhe u kthyem prapë në Karvasara.

Kur ka vajtur motin tjetër në Mesollonjë e hyri në Gjymnas u bë me të vërtet i pari i shokëve dhe profesorët, gjith'ata profesorë që e kishin lënë në klasin e parë, kaqe fort e deshin, sa s'e linin nga goja. Nxënës tuke qenë botoj edhe një libër të bukur "idhetë e nxënësit", libër që ju bëri përshtypje të madhe gjithë profesorëve të tij, të cilët u ngutnë t'a shtypë edhe i dhanë edhe "premium". Zuri një shumë mjaft të madhe të hollash, ndonse ishte djal' 12 vjetsh!

## VI

Isha 20 vjet kur i dolla punës zot. Pa kuptuar mirë edhe si me shaka kisha hyrë në një karierë të mirë. Isha një avokat i vogël vetëm me një praktikë dy vjetshare.

Nuk shkoj shumë kohë dhe mora një embër të mirë. Gjith' ajo klientella e të ndjerit Kallopazaro brodhi ne mua dhe ndofta më e madhe. Kudo kisha nder, kudo isha i mir pritur. Gjithë shtëpitë më të mira ishin të çelura për mua, gjithë nëpunësit civilë e ushtrijakë ishin miqt e mij. Xhirua e zyrës arrinte gjer më 600 dhrahmi në muaj, neto shpenzimeve, një gjë kjo e çuditshme për një avokat praktik krahine.

Nuk shkoj shum' dhe ma ndyen nevojën edhe politikanët e vëndit. Me që ishte im' atë nënështetas grek, isha naturalizuar edhe unë para se të vinj në moshën legale të shërbimit ushtrijak. Prandaj kisha të drejtë të të exersonja profesionin e avokatit, tuke paguar edhe taksë patente.

Me qenë se im 'atë ishte me partin 'e Trikupit do e mos isha edhe unë anëtar i asaj partije dhe kështu ishim me komën e deputetit Kosta Stratos, që ishte trikupist. Stratua ish deputet i Valltos. Unë pra u njojta si përfaqësuesi i partisë trikupiste në Karvasara. Ahere arriva kulmin e forcetës politike për atë vënd.

Për një çashtje politike u dërgova në Athinë te kryeministri i Greqisë Harila Trikupi. Ishte e para herë që shihnja Athinën. Më bëri një përshtypje të madhe se s'kisha parë qytet më të math e më të bukur. Trikupi më priti shumë mirë, më presentovi edhe me të motrën e tij, Sofien, grua politikane edhe këjo, që vetë ja drejtonte partinë e Trikupit dhe kishte mbetur pa martuar vetëm e vetëm për hatrin e vëllajt të saj. Ish shum' e zgjuar e e mençime.

Si mbarova punë dhe misjonin që më kishin vënë për barrë populli i Karvasarasë, u ktheva në shtëpin t'eme.

Në Athinë s'pata kohë të njihesha edhe me persona të tjera politikë se ndenja vetëm një javë. Kur i lashë shëndet Trikupit, më porositi t'i shkruanj lirisht, si kurse babajt t'em, për

ç’do çështje politike, e më premtoj se , si të mbushnja moshën e 25 vjetve, pa tjetër do të zgjidhesha një nga deputetët e Valltos nënë mprojtjen e tij. Pata disa raste e i shkrova për disa sende Trikupit, i cili kurrë s’u rënt, sado që ish njeri tepër serioz.

Dal nga dalë u bëra një person i dukur dhe i duhur dhe një krah’ i fortë i politikës së vëndit, mbassi isha edhe avokat. Ardhi koha që gjithë nëpunësit e Karvasarasë gjenin një mshtetje te mua dhe shumë herë edhe m’a kishin frikën. E vërteta ishte që u solla mirë me cilindo , veç se më nj’a dy raste për dy nëpunës, një drejtorin e financës dhe një drejtorin e policisë së qytetit që më urgusnë shumë me sjelljet e tyre, vetëm këta i largova s’andejmi, njërin tuke pushuar nga puna, tjetrin tuke e transferuar në Cirigo ose”…. ” (shkruar greqisht H. K.), insullën e Greqisë, për kapriço. Tjetër gjë jo.

Në këtë kohë ngjau për mua një e keqe, që për shumë kohë s’e harronja dhe s’gjenja as të paktin ngushëllim. Humba të shtrenjtën t’ime të shumëdashurën e të respektuarshmen gjyshen t’ime. Vdekja e saj ish natural, se rrojti 92 vjet!

Ajo e mjera, qysh se ardhi në Karvasara më 1886 nuk ngjinjeshe nga gazi që u bashkua edhe një herë me mua e që më deshtë përmbi ç’do gjë tjetër që kishte dashur në të gjithë jetën e saj.

Me qenë se në dyqanin t’onë kishim gjithfarë pijesh se si një dit e gostita një uzo të Nartës dhe i pëlqeu fort. Pa kur i dhashë një tjetër soj uzo, uzo të Kallamatës, ahere ishte ç’ishte; i shijoj tepër, sa me të drojtur kërkoj edhe një tjetër e i dhashë dhe mbet shumë e kënaqur. Po s’bëra mirë se e msova liksht. Le ku dreqin e kish gjetur një pagur të kallajtë e m’a jepte për dit e ja mbushnja me atë uzo dhe mernja urimet me të dy duart. Dikur ja mbushnja edhe dy herë ditën.

Po ahere na gjeti një sent tjetër, na deheshe. Edhe kur deheshe do zinte të qante fshehtazi, cilin, djalin e saj Kovin që s’i delte nga mëndja kurrë, gjer sa e muar vesh im ‘ë që pijeshe e ja fshihnin pagurin fukarasë.

Un’ i bleva tjetër pagur dhe prapë ja mbushnja, po e këshillonja të pijë me kujdes. Ajo e ruante pagurin si të dy sytë se mos ja merrnin prapë gratë si të parin.

I’me gjyshe ish shumë punëtore dhe i çkujdiste gratë e tjera nga gatimi i gjellëve e shumë gjërra të tjera shtëpijake, po që kur zu pijeshe dhe i binin shumë sende dhe më shumë pjata e kupa nga duart e i thynte, qysh ahere gratë s’e linin për asgjë. Gatuanin vetë.

Një dit, pra nga të shumat u sëmur, dhe dita ditën po bëheshe më keq. U kuptua se iu mshtuall më në funt lëmshi dhe do të bënte detyrën e saj si gjithë bota.

Kur e pamë shumë keq gratë thirë priftin t’a kungonjë e t’i këndonjë edhe “Tetravangjellonë”, të katër ungjillët do me thënë, që plakat e grat’ e Korçës, pa ditur mirë domethënien e fjalës, i quajnë “Kryet e Petrovangjelit”.

Po jeta ësht’ e ëmbël, e shkreta dhe s’ime gjyshe s’i pëlqente të vdiste. Kur zuri prifti të mërmëriste mbi krye të saj, ajo s’e duronte dot. Më bën me shenjë që të ulem, se diç’ka do më thotë. Ulem afër dhe më thotë nga dalë “thuaj këtij ditshkurtri të pushonjë se s’e duronj dot”. Im’ emtë Ndinua afrohet e i thotë se “ishte gjynah të flasë kështu për priftin”. Po ajo e mjera prapë më thotë se “prifti i dukej si lugat e s’e sheh dot, po aman ta paguaja e …. t’a thyente qafën shpejt, t’a linte sidomos të vdiste rehat”. Dhe kish, më duket, të drejtë. Edhe unë i fola me marifet priftit të hiqet se po e paguanj, mbassi plaka s’duronte dot. Kështu u hoq prifti dhe u qetsua gjyshja ime.

Me gjithë që po i linte shendet kësaj jete nuk e harronte dot uzon e ngordhur të Kallamatës. Aman, bir, më thotë me gjysmë goje, m’a jep një herë atë pagurin, se plasa, m’u tha fyti. Me të shpejtë ia dhashë fshehura mos shëkonin gratë, se s’e linin të pinte, dhe e mori e mjera me një etje të madhe e s’e lëshonte nga goja. Piu sa mundi. Edhe bëri mirë, sepse qysh atë ças ju pre fjala, i hipi hethe e fortë dhe agoni’ e saj s’mbajti as 1 orë. Kështu mbaroj e paharuara gjyshe në krahërorët e mij, tuke më shtirë syrin e saj drejt mbi mua, si kur do më

linte shëndet për gjithënjë e do më kënaqte për dëshirën e saj të fundit që e përmbusha, pagurin me uzon!

S'munt t'a tregonj hidhërimin që ndjeva për humbjen e kësaj kreature kaqe të dashur e të adhuruar për mua! Ajo ishte për mua mëma e parë, dashuria ime, përgjërata ime. Për shumë kohë s'ngushëlleheshe dot. Dita-ditën vinja i hithnja lule mbi varrin e saj dhe ja përlakuja me lottë. Zoti ja ndjeftë shpirtin e qetë!

Vazhdonja mirë e fitimisht në profesjonint'em praktik dhe kisha një dëshirë të paprerë për të kënduar libra juridikë, me gjithë që shumë prej tyre s'më hynin mirë në trutë se s'i kuptonja. Me gjith'ate mjaft një figurë të mirë bënja midis të paditshmëve tjerë avokatë të Karvasarasë dhe nxura një praktikë dhe experiencë për çudi, sa shumë herë më kërkonin mendimin edhe disa gjyqtarë të cektë, që na dërgonin atje ose edhe nëpunës të tjerë të administratës lokale. Sidomos procedurën civile e penale dhe kodin penal i dinja gati mëgojë si dhe ligjet administrative.

Me profesjonin t'em bashkë nuk kisha hequr kurrë dorë prej këndimeve në gjuhën shqipe dhe prej korespondencës së dëndur që mbanja me shum' akoma shqiptarë të tjerë.

Mbi këtë s'pushonja edhe së mbajturi fjalë panygjerike, funerale, konferenca, etj. sa herë që më jepeshe rasti, ose që shtërngohesha nga miqtë e shokët e mij. Shkruanja edhe në për gazetat shpesh herë artikuj dhe në dy gazeta të Athinës "…. " edhe "…. " (shkruar greqisht H. K.) isha korespondent i rregullshëm.

Po ish thënë të mos qëndronja  në këtë jetë të këndëshme për shumë kohë, me gjithë që shkonja mirë e fitonja mjaft sa mund të lanj gjithë borxhet që kish andej këtij im 'atë, të mbanja mirë shtëpinë, dhe akoma të mbanja si student me të hollat e mija dhe vëllanë tim në Mesollonjë. Vetëm një borç nja 10. 000 dhrahmi kishim akoma. Një eveniment i papandehur më turbulloj mëndjen dhe më prishi tërë atë qetësi, e cila tronditi edhe gjithë qetësinë e shtëpisë.

Kisha një mik prej Vrahorit, me të cilin ngjisnim edhe shumë në fytyrë, sikur ishim binjakë, inxhinjer i Prefekturës, i cili kish ardhur si inspektor në Karvasara për pak dit. Quheshe Gjorgji Dhimitropudhos. Shumë janë episodet që më ngjanë në Vrahor nga an' e s'ëmës e të së motrës të këtij miku, si dhe shumë miq e kumbarë të tij që më muar për atë. E ëma, e motra m'u hodhë për qafe e më puthnin si Gjorgon e tyre, një dit që m' shpuri për vizitë në shtëpin e Dhimitropudhit një miku im Jovan Llaci nga Dardha, me gjithë që po më shihnin për herën e parë. Po këto s'kemi kohë t'i radhitim këtu.

Ky miku im, pra, Dhimitropulli kur ardhi në Karvasara hoqi drejt në shtëpin t'ime dhe ne e pritmë mirë. Nëpunësit të gjithë të Karvasarasë pa përjashtim ardhë e e vizituan në shtëpi për "të mirë se ardhtë".

Unë që isha tuke pritur gjith' ato nëpunës si miq, në fjalimet e sipër me Dhimitropullin që bënin ata, disa më lëvdonin shumë për mirsjelljen t'ime faqe atyre dhe mshtetjen që gjenin tek meje si përfaqësuësin e partisë qeveritare të Nënëprefekturës së Valltos etj. etj. Të tjerë prapë më mburnin për profesjonin t'em të ri, për mbarëvajtjen t'ime, për pozitën e mirë e të sigurt që kisha krijuar, si dhe veçanërisht më komplimentonin me ngjyra të gjalla për konferencat e për fjalët panegjyrike e funebre që mbanja më ç'do rast.

Miku im Dhimitropullos i dëgjonte këto të gjitha me vërejtje dhe naturisht gëzoheshe për mua se më deshte sinqerisht. Po atje ku ja aprovonte të gjitha lavdrimet e çfaqura për mua vizitorëve, i shpëtoj një frazë, e cila më ndezi që atë çast një flagë të madhe në shpirt, një flagë që s'u shua më. Më zgjoj merakun t'em, më zgjoj ndjenjat e mija të kohës të studimeve, të cilat kishin tani 8 plot vjete që po flinin.

Inxhineri Dhimitropulli, ndofta pa dashur të më bënjë ndonjë të keqe, por vetëm se i vinte keq për mua dëshëronte të më shëkonte ndryshe e jo si isha, ja u pritë lavdëruesvet të mij me këto fjalë: Miku im z. Floqi me të vërtetë është një djalë prej të rrallëve dhe një karakter i xhevahirtë, e është i paisur me shumë virtuta, po mjerisht (dhe këtë fjalë "mjerisht"

e tonizoj me një aksent dëshprimi, që e vura rë fort mirë), mjerisht, tha, i mungonte vetëm një gjë. I mungon një dëshmi gjymnasiale, që të mos them që i mungon edhe një dipllomë universiteti që të jetë tamam si e lyp sot puna". Edhe më vjen shumë keq, tha, që s'e ka.

Këto tha miku inxhiner. Dëgjonjësit e tjerë u panë sy ndër sy me shoqi-shoqin, po s'folë gjë. Mua ato fjalë më pikëlluan në zemër. U ngurosa, s'dinja ç'të thesha. Po e gëlltita e s'fola gjë. Mirë po qysh atë dit unë s'isha më i qetë. Natë për natë s'më zinte gjumi ose më delte gjumi dhe s'kisha derman. Hyra në një mejtim të math.

Këjo ishte shkëndi e parë që bëri reaksjon të fortë në shpirtin e në mëndjen t'ime. Po s'ishte vetëm këjo. M'a përsëritnë këtë fjalë, ose vërejtje edhe disa persona të tjerë. Akoma. M'a përsëriti me një mënyrë serioze edhe ajy miku i shtëpisë s'onë Petro Vitua nga Labova, për të cilin bëra fjalë tjetër herë, kur më hoqi vërejtjen për rrugën e keqe që kisha zënë edhe që më rekomandoj ne i ndyeri avokat Jan Kallopazari. I a thotë t'im 'eti: "Është gjynah Kristaqi të mos ketë mbaruar as gjymnasin sidomos, pas kaqe dijenive dhe vitutave që ka. Do t'a kishim edhe ne Shqiptarët si një brilland. Do ta shihnim një dit deputet dhe do ta kishim një kollonë të fortë". Këto i këndonte disa herë t'im 'eti, me gjithë që ajy s'ja priste mirë këto fjalë, se s'i vinte mirë e s'kishte as një interes në qoftë se munt të mernja një çertifikatë që mbarova një gjymnas.

Si kur s'ishin mjaft të gjitha këto. Një tjetër mik, ose dy miq të tjerë, i pari Dhimosten Karajanopulli, student i mjekësisë dhe i dyti Aristotelis Lytras, student i drejtësisë në universitetin e Athinës, shoq të ngushtë me mua, se qysh po bisedonim një dit mbi tragjeditë klasike të Aeschylit, Sofokliut e Europidit dhe mbi domethënjen e naltësinë e disa prej këtyreve dhe mbassi iu kundrështova në disa pika dhe kuvendi mori një ngjyrë t' ashpërtë, jo ne i dijme po ti s'i di, jo i kemi studjuar më mirë, e ti s'i ke parë, as t'i kanë shpjeguar kurrë, po vetëm se i ke dëgjuar e shkon pas berihaj't[1], etj. etj. deri sa u zembëruan dhe m'a thanë sheshazi se unë s'jam shoku i tyre, se s'munt të barabitem me ata që kanë mbaruar gjymnazit e sot po mbarojnë gati edhe universitetin, edhe se duhet të ha shumë kulaçe që t'i arrinj ata etj. etj. Ndonse unë tragjenianët Grekë i kisha studijuar më mirë se ata me kohë.

Këto ishin plumba për mua ishin plagë të pashëruara. Ahere zura kujtonja ç'kisha humbur; ahere zura mallkonja fatin që s'më la të mbaronja msimet si i kisha nisur me gjith që unë isha shumë më i mbaruar se ata dy injorantë të fandaksur edhe me gjithë që mbi themat që bisedonim i kisha studijuar tjetër herë e i kisha honepsur[2] mirë dhe kisha të drejtë në pikpamjen që mbronja, se ashtu ish si pretendonja unë. Po mua më gënjente mëndja se po të kisha mbaruar gjymnazin, ahere munt të kisha të drejtë të bisedonj me ata, për ndryshe jo. Një idhe edhe këjo.

Plaga ime, derti, sapo vinin malcoheshin[3]. Më dukeshe se s'isha gjë. Si kur s'dinja gjë prej gjëje, si kur të gjithë talleshin me mua. Një siklet, një hall që s'dinja si të ngushëllohesha.

Babaj kishte kohë që më vinte re që s'para hanja bukë, që s'isha i qetë, që gjithë dilnja jashtë në shëtitje të gjata edhe që punën zura të mos e shoh si më përpara.

Atij i shkoj tjetër mendim, se mos kush e di kisha hedhur dashuri gjëkundi dhe kisha turp t'ja thom. Po s'më binte në sy, as ju çfaqeshe gravet.

Po ardhi një tjetër ndollinë që ju vuri kapak të gjithave dhe këjo e shpejtoj punën, ose ndërimin e situatës s'ime që do ta tregonj më poshtë.

Afrohej dita e 15 Marsit të vitit 1894, dita e shënuar nacjonale e indipendencës së Greqisë. Atë dit në ç'do qytet të math e të vogël duhej zakonisht, si edhe sot, të mbahej fjala panegjyrike e ditës prej një oratori. Këtë fjalë mot e për mot e mbante vetëm një njeri në Karvasara Dr. Gjorgji Stajkua, mjek mjaft i dijshëm Karvasarjot. Atë vit dr. Stajko, me qenë se ish i dëshpëruar se nuk e nxuar dhimarks (Kryetar Bashkije) Karvasarjotët nuk desh të

[1] beriha = thirrje, kushtrim, britmë pë alarm (H. K.)
[2] honeps = tret, bluaj, pranoj (H. K.)
[3] malcoj = pezmatoj, mahis, keqësoj (H. K.)

mbante as panegjyrikun. Ahere 3 dit më parë Bashkia më ngarkon mua të flas ditën e shënuar të indipendencës greke.

Me gjithë që s' kisha edhe shumë oreks, po i shtërnguar nga shumë miq e nëpunës dhe më fort nga populli e pranova propozimin. Ditën e caktuar, kur m'u dha shenja dhe mbassi mbaroj Tedeumi[1], hipa në tribunë dhe fola gati 1 orë. Nga dëshpërimi që kisha për hallin t'em më fort, fola me kaqe pasjon, tuke lavdëruar më fort burrat shqiptarë që ishin A-ja dhe Z-ta i atij revolucjoni të math si Miauli Londua, Kundurjoti, Milisi, Buduri, Kryeziu, Boçarenjtë, Xhavelenjtë, Bukuvallajt etj. etj. sa fjala ime i ndezi an' e kant edhe kur do zbrisnja nga tribuna nuk më lanë të shkelnë tokë, po më pritnë në duart!

Ahere, mbassi s'mbet njeri pa më dhënë dorën e pa më përgëzuar, një tok miq më suall edhe gjer në shtëpi, ku ndejtim ndo një orë duke komenduar fjalën t'ime e cila me të vërtetë i kishte çuditur. Ishte shumë më e lartër nga ato fjalët e Stajkos.

Tjetrën dit kisha shkuar në gjykatore për disa gjyqe. Gjyqtari sapo më sheh më jep dorën e më përhiron nxehtësisht, por kur mbaronte fjalën, më goditi edhe ky më keq se inxhineri Dhimitropulli: "Jazëk mor Floqi, më thotë, të mos ishe një Doktor i Drejtësisë, mbassi ke nxënë kaqe gjërra dhe ke këtë eloquence: "Jazëk jazëk pa një dipllomë universiteti sot njeriu s'munt të zerë vendin e meritueshmë në qarkun shoqnor! Megjithë që më të mirin vënt në qarkun shoqnor të intelektualëve të Karvasarasë e kisha sigurisht kaparuar unë prej shumë kohësh. Po, eja, u dashka edhe një dipllomë! Kështu e lypka shoqërija intelektuale.

Sa ishim të gënjyer, po edhe unë sa isha i marrë që nuk e peshonja çështjen në pikëpamjen e vërtetë të saj dhe nuk e shihnja mirë nga prisma e pagabuarshme.

Pra, mbassi u dashka një Dipllomë Universiteti, mbassi e lypka societeja, unë lipset t'a fitonja edhe këtë, ndryshe isha i mangët; isha i çalët. Po si bëhet halli? Si përfitohet një Dipllomë Universiteti kaqe lehtë? Që të përfitosh njëDipllomë të këtillë duhet të kesh marrë pikësëpari një dipllomë gjymnazi. Si munt të kisha shpresë unë për një dipllomë gjymnazi kur kisha bërë vetëm klasin e I e më mongonin 3 klase akoma? Këjo më dëshpëronte krejt se më dukëshe gjë e pamundur. Si të bënj? Si t'a marr një dipllomë?

Një mik i sinqertë që kisha, drejtori i shkollës hellenike të Karvasarasë, më pa një dit shumë melankolik e më tha: "Kristaq, s'të shoh mirë, pse s'më thua ç'ke? . Unë të hap zembrën nga hera, ti pse s'më tregon dhëmbkën tënde? Folë, shpjegohu mikut.

Ahere për të parën herë i shpjegohem këtij, cila është ajo që më ka futur kaqe në merak e melankoli. Si do bënja për një "…. " (shkruar greqisht H. K.), një çertifikatë gjymnazi si munt të merret e me ç'mënyrë, mbassi unë vetëm klasin e parë kisha mbaruar.

Miku im si u mendua pak më thotë "dy rrugë janë, ose do fillosh nga klasi II i gjymnazit gjer sa t'a mbarosh me pallë, ja se të marrësh, ose të blesh një çertifikatë të tillë prej gjymnasiorhëve të vjetër e të pushuar, si për sh. prej Papallukajt në Patrë, prej Papazhurit në Mesollonjë ose prej Gallanit në Athinë" më tregoj d. m. th. disa embra që munt të më prokuronin me një mijë a dy mijë dhrahmi një çertifikatë të tillë fallco , si kanë marrë edhe shumë të tjerë. Më rëfen edhe mënyrën si t'a mar e më dha edhe ca informata të tjera, që të mos kuptohem aspak.

Këto kshilla të mikut t'em më ardhë për hesap. Mënyra e dytë e marrjes së çertifikatës më pëlqeu më tepër dhe e preferova. Një mijë a dy a më tepër dhrahmi munt t'i jepnja pa ndo një shtërngim. Qysh atë ças e kisha vendosur, po për të mos u marrë vesh gjurmët dhe për të mos rënë njeri në dyshim e gjeta të arsyeshme të vete në Athinë ku kisha mjaft të njohur e miq, që munt të më ndihmonin.

Babajt ose shtëpis s'ime s'i tregova gjë. Vura për shkak një ndollinë që as e kuptoj njeri se ishte një pretext. Shkaku ishte ky. Xhaxhaj im, i shkreti Kristo Mitko prej të cilit mbanja mënt disa të mira ishte çikur prej tuberkulozi dhe ky për pak kohë i ishte transformuar në

[1] Te Deum = "O Zot, ne po të lavdërojmë". Është një hymn kristian që këndohet në celebrimet e falenderimit (H. K.)

tuberkul. (tuberkuoz H. K.) galopante, dhe tek po vinte nga Selaniku në Pire vdiq prej një aimoptysije[1] brenda në vaporin rus "Nahimoff" dhe u varros në Pire. Ç' kish ç'nuku kish ishin depozituar te një gjyqtar paqtues i Piresë. Për t'i marrë këto, unë mora disa çertifikata dhe një prokurë prej trashëgimtarëve të Kr. Mitkos dhe një natë të bukur mar nj'a 3. 000 dhrahmi me vehte dhe ia përmbush për në Athinë, pa i lënë njeriut shëndet, përveç shtëpisë s'ime.

Ishte Tetori i vitit 1894. Pasi arriva në Athinë u poqa me mikun t'em Spiro Kondin nga Dardha, që është professor sot në Korçë. Me atë njiheshim mirë, e kisha edhe krushk. Ajy atë mot mbaronte Universitetin, degën e filosofisë. Me pak fjalë i shpjegonj sekretisht qëllimin. Në krye më tha: "si kuxove e more një vendim të tillë, që nesër pasnesër po të meret vesh munt të pëlcasin nj'a 5 vjet në burg". Po si e pa se insistonja ahere më tha që ç'ka " bëhet". E mori përsipër. Ajy ishte i vjetër në Athinë e dinte shumë dyer t'atilla mysterioze.

Natë për natë vinim me Spiron në Opera ku pashë operat më të bukurat frëngjisht, se kish ardhur një kompani e famëshme franceze në Athinë, dhe, si e dinja mirë frëngjishten, gjenja një ngushëllim të math në representacjonet.

Zyrën t'ime në Karvasara ia kisha lënë një tjetër avokati t'a kqyrte. Njeri s'dinte pse vajta në Athinë përveç mikut drejtorit të skolarhias në Karvasara i cili e mbajti gjer në funt sekret.

Mbas dy javësh z. Konda më jepte në dorë çertifikatën fallco që dëshëronja, të nënëshkruar prej nj'a 3-4 profesorave dhe me vulën e një prej gjymnazeve të Athinës me një datë 4-5 vjet më të parëshme. Kjo mesele, ky fallcifikim më kushtoj vetëm 800 dhrahmi.

Atë natë që m'a dha z. Konda isha gjithë gëzim. I bëra një darkë extra. Vamë jasht' Athinës me karocë dhe harxhuam edhe disa para të tjera për qefe. po të nesërmen se si më hyri një dyshim. Mir' e mora, po si do t'a përdornja? Mbassi një dit do të paraqitnja në Universitet a nuk rrezikonja një rrezik të math, po t'a kuptonin? Pastaj, si kur të më merrnin në gjyq, si kur të më burgosnin e të bjerrnja pozitën t'ime, nderin t'em dhe nderin e shtëpisë, si do ish për mua? Ahere si njeri i ndershëm duhet të preferonja të vrisnja vehten. Me këtë hap a nuk e mernja më qafë vehten dhe gjith' ata që prisnin nga mua? Nuk do shuhej e çnderohej shtëpija j'onë? Ç' fitim do kisha?

Këto mejtime luftonin njëri-tjetrin në shpirtin tim edhe ment prishesha mentsh. Gjith' atë natë jam gshirë më këmbë. Te e mbramja mora një vendim definitive. Të hiqna dorë prej një trillimi këso doret që munt të na shtinte në rrezik të gjithëve. Me një kurajo u ngrita me një herë, e çora atë të mallkuar çertifikatë, që më dukeshe se më haptë varrin e e shihnja përpara meje e e hodha në stufë të dhomës s'ime të hotelit "Danemark" ku banonja dhe kështu hoqa një ankth të math prej trupit t'em që më shtypte krahnorët. M'u duk sikur shpëtova!

Të nesërmen vjen Konda të më marrë nga hoteli të shetisnim si nga hera. I kallxonj luftën e gjith' asaj nate dhe djegjen e çertifikatës, u gëzua edhe ajy se s'ishte edhe për atë mirë dhe më përgëzoj. Ahere me vinin ndër mënt shumë gjërra edhe më fort kjo problemë: Po ata maskarenj profesorë që ma dhanë atë çertifikatë kaqe të çoroditur e të poshtër qënkan, sa shitkan vehten, nderin e namuzin e tyre për 200 dhrahmi për shoq, pa pikën e turpit, pa pikën e frikës që një dit munt të delte mashtrimi në shesht edhe të mernin vehten e shtëpit' e tyre më qafë? Mjerë arsimi publik, mjer' edukata e fëmijëve dhe dinjiteti i një Shteti që prêt nga njers si këta! Mua s'më kish ardhur aspak keq se prisha gjith' ato para. Më mirë që m'u bë një msim.

Tani lëri ato, më thotë Konda, ç'u bë u bë, po ti ç'do bësh tani? Bëra një gabim, i them, po shkoj e vajti këjo, tani s'më mbetet tjetër përveç se të shkonj në vezët[2] t'ime të parat në Karvasara. Shumë mire do bësh, më thotë Konda. Unë s'mar vesh, thotë, si të hipi kështu kjo

[1] hemoptisia = nxjerrje gjaku gjatë kollitjes si në T. B. C. , cancer të mushkrive etj (H. K.)

[2] vezë = qelizë seksuale femrore. Në këtë rast ka kuptimin "origjin" (H. K.)

megallomani, kur se ke një birko sëre në Karvasara edhe nxjer e fiton aqe tëholla sa ne të tjerët as ëndër do t'i shohim një dit.

Kish të drejtë Konda, se ajy si professor do mundohej shumë vjete sa të arrinte të merrte një rrogë 200 dhrahmi në muaj e unë pa dipllomë, pa mundime, pa shpenzime kollosale kisha krijuar një pozitë aqe të mirë e të lakmushme që zinja 400 e 500 e dikur edhe 600 dhrahmi në muaj.

U bë, ç'u bë, i thom prape unë nesër po nisem për në Karvasara. Tamam, thotë, tani e gjete mirë. Ahere le te glendisim sot edhe nesër, më thotë dhe kështu nesër mbrëma të përcjell në stasjon e shkon në të mirën tënde.

Po kanë thënë të motshmit "se nuk shpëtoka njeriu nga e thëna". Ç' na ngjet atë dit? U poqa në kafene me një mik Karvasarjot, Theofrast Papakostandin i cili ish student i theollogisë e sot është arhipeshkv i Artës. Ishim vërsnikë dhe miq të dashur që vogëlije me atë. Ajy kish familjen e tij në Karvasara edhe me që i thashë se po shkonja atë natë për në Karvasarë, m'u lut të më japë një kapellë për të motrën e tij të fejuar, Uraninë, e cila do martohej ato ditt me një avokat në Mesollonjë e ky desh t'i bënte një dhuratë së motrës. I thashë se e mar me gjithë qef dhe të ma bjerë në hotel "Danemark" Nr. 44.

Kështu Theofrasti pas pak kishte prurë e lënë në odën t'ime kapellën bashkë me një letër. Unë u pregatita të ikinj, ju lashë shëndet disa miqve dhe atë natë ora 20 do të shkonja në udhën e hekurt Athinë-Patrë, që kështu në pikë të mëngjesit të isha në Patrë që të arrinja vaporin për në Kalydhonë të Mesollonës.

Për fat na zë një shi kur hipa mbi omnibusin, ama ç'farë shi. Ishin hapur kataraktet e qiellit dhe derdheshin mbi ne, që u bëmë qull si minj me roba, me plaçka. Mbi këtë, na rëzohet mb' udhë një prej 4 nga kuajve të omnibusit që n'a hasemorisë[1] gjysmë ore gjer sa muarm një kalë tjetër, po kur arimë në stasjon, s'patmë kohë as bileta të nxjerim, se treni kishte ikur n'ato minuta e sipër! Kështu mbetmë të gjitha pasaxherët, tuke mallkuar motin e keq dhe kalin që n'a u rëzua e s'arrimë trenin.

Kthehem prapë në hotel "Danemark" gjithë në atë odë që kisha fjetur. Atë natë më zë një e dredhur, një hethe që mos e pyet. Mezi u gdhiva. Kisha marrë një të ftohur të mirë dhe nuk munt të nisesha dot. Kështu desha s'desha ndenja edhe 10 dit të tjera i sëmurë në Athinë, pa ditur njeri se jam atje dhe tuke vënë në një merak shtëpinë t'ime, e cila ish lajmëruar se po kthehesha.

Im 'atë po telegrafonte shpesh në Athinë e në Mesollonjë e s'po merte vesh ku jam. Theofrast Papakostandini kishte marrë letër që as kapellë s'muar, asgjë, as që Floqi (unë) s'u duk në Karvasara. Ahere ngrihet e vjen Theofrasti në hotelin t'em e mer vesh se jam aty akoma i sëmurë dhe hyn e më sheh. Më pyet e i thom ç' kisha pësuar.

Si ndejmë ndonjë orë tuke biseduar, edhé unë isha pak më mirë më pyet prapë, psé kisha ardhur në Athinë e ndejta aqe ditt. Ahere, tuke qeshur, i kallzova gjithë çështjen. U çudit. Po si kuxove kështu, thotë, ti jé njeri me ment. Një i mënçur s'bën kurrë kësij përçapjesh të rrezikshëme. Më shtyri namustra e madhe, i thom, se e qojta vehten të përbuzur, mbassi jam një njeri pa shkollë e mbassi u folë kaqe gjërra për mua. – Ti, harron më thotë, se jé më i miri e më i zoti nga ata që t'a flasin prapa e që të lëvdohen? Ndofta i thom, po kjo mungesë m'u bë një sëmundje, një lëngatë, prandaj mora sŷt' e këmbët e ardha këtu, po tani jam penduar, i thom, edhé këto ditt po nisem për në Karvasarâ. Dhe ju luta mos i thotë kujt.

Si mendohet pak Theofrasti më thotë prapë : Po, psé s' ma thé mua një qëllim të tillë që kishe ndërment? Psé, i thom, di ti ndo një ilaç tjetër? – A ké me të vërtetë qellim t' a mbarosh gjymnasin, më thotë? Si, s' kam, i thom, fjal' i thon' asaj? Po e shoh se nuk është e mundur. Psé, s'është e mundur, më thotë, gjer në cilën klas ké vajtur të gjymnazit?

[1] charamizo = humbas (perkthyer nga greqishtja megoogle H. K.)

Unë, kur më thesh Theofrasti këto fjalë, po e shihnja në sŷ dhe po kuptonja se diç' ka kishte ndër ment që po më fliste në atë mënyrë. Ahere i fsheva apostafat të vërtetën. I thom se kisha mbaruar klasin e II të gjymnazit, ndonse unë kisha mbaruar vetëm të parin. Ashtu, thotë? Po, i përgjigjem. Ahere shton e më thotë se nuk jam edhe shumë lark për të mbaruar gjymnazin e ëndëruar. Si, i thom? Seriozisht po flet? – Po, po, thotë seriozisht edhé fort. Vetëm këtë më thuaj, thotë, a jé disposé të rijsh një mot këtu në Athinë? – Si u mendova pak : rri, i thom edhé më tepër. Fort mirë thotë. Unë po shkonj edhé mbas dite po vinj prapë këtu, të flasim edhé një herë mbi këtë çështje. Psé, i thom, nuk flasim tani? Tani s' kam gjë në dorë, thotë, po do shkonj të pyes më parë, pastaj vinj e të them. Edhé iku me ngutësì Theofrasti. Unë po vrisnja mendjen e po mendohesha të gjenj mysterin që si munt të zgjidhej këjo çështje kaqe e zorshime për mua.

Theofrasti u duk prapë në odën time pas ditet. Vjen e më thotë se u fjalos me një mikun e tij Vasil Vullgarin drejtorin e një Lycesë private që përmbante dhe gjymnas komplet. I kishte kallxuar gjith' historinë t'ime edhe dëshirën e madhe që kisha për me nxënë. I kishte thënë se kam mbaruar klasin e II të gjymnazit të Korçës etj. etj. Ahere kishin mbetur dakord që unë mundet të pranohesha drejt për drejt në klasin e IV e të fundit gjymniazial, po me kushtin që do paguanja nj'a 500 dhrahmi disa profesorëve, të cilët do të më jepnin një dëshmi se pata mbaruar privatisht klasin e III, di unë se kur, klasin e III gjymnazial edhe kështu hynja lirisht në klasin e IV. Si më tha këto edhe shumë të tjera miku Theofrast më pyet në pranoj apo jo, se ishte gati të më presentonte te z. Vullgarës.

U mendova andej, u mendova këtej, vrava pak mëndjen, peshova gjëndjen e punën t'ime, moshën, sërën etj. dhe mbas pak minutash kthehem e i thon Theofrastit se "e pranova". Ahere sa do që s'isha dhe aqe mirë nga shëndeti, u ngrita, u rrojta, u lava, u mvesha mirë dhe për gjysmë ore ishim që të dy përpara lycearhit z. Vullgaris.

Z. Vullgaris ishte një plak 65 vjetsh, i gjatë me një mjekër të gjatë shumë e të zbardhur, një njeri venerable e savant[1]. Na priti mirë edhe me pyetjet që më bëri e me përgjigjet që i dhashë më sympathyzoj me një herë. Dhe sa do që i ardhi keq se më pa të math (isha ahere 21-22 vjetsh), po tuke parë zellin extraordinary që kisha për msim, më pranoj.

Ahere qita e i dhashë të 500 frangat e dëftesave që do më jepnin profesorët e atij Lyceut që kalova qinse privatisht të III klas të gjymnazit, si dhe 100 dhrahmi të drejta regjistrimi në klasin e IV.

Kur më kërkoj dëftesën e klasit të II, i thashë që s'e kam me vehte. Më thotë se është nevoja ta paraqit, se pa atë janë kot të gjitha.

Kur më tha kështu, më arth si kur më ra tavani mbi kokë. Si munt ta paraqitnja dëftesën kur ajo ishte e klasit I. Si munt t'a gënjeja? Po t'ia paraqitnja atë a nuk do më nxirte jashtë si një gënjeshtar dhe do mos më pranonte në shkollë? Po mikut Theofrast si do t'i delnja më sy kur t'a turpëronja përpara Z. Vullgaris?

Medet! Po tani? . . . Mbajtja gjakftohtëtësi me pahir, me gjithë që zembra më rihte shpejt e shpejt. Kthehem e i them z. Vullgarit: Çertifikatën s'e kam këtu z. Vullgari. Ahere si u nise pa çertifikatë më thotë. S'e pandenja se do vinja në Lyce, i thom, se si kur sa ua shpjegoj z. edhe zoti Thefrast. Po munt të shkruanj në Karvasara të ma dërgojnë. – Nuk ke kohë, më thotë, se pas 5 ditsh inspektohen regjistrat e shkollës e në qofsh i regjistruar humbet motin e tërë.... Regjistrat ose matrikullën e shkollës së Vullgarit do ta inspektonte një nga inspektorët e Arësimit. –Ahere, i thom , z. Vullgarit, do vete unë t'a mar. – Për 4 ditt a munt të vesh e të vish? Besonj, i thom, do të përpiqem. Veç më regjistroni që sot.

Kështu, me premtimin që do t'a paraqitnja në 4 ditt e sipër çertifikatën e klasit II gjymnazial, u regjistrova, pagova të hollat dhe mbassi e falenderojmë nxehtësisht edhe unë edhe Theofrasti zotin Vullgaris shkuam.

[1] venerable e savant = i nderuar e i mësuar, i ditur (përkthyer nga frengjishtja me google H. K.)

Si u ndava me Theofrastin dhe vajta prapë në hotelin t'em zura përsëri të mendohem. Po tani ç'farë çertifikatë të klasit II t'ju paraqit kur s'kam? Edhe në e paraqitsha, edhe në e justifikofsha e në më pranojshin a isha i sigurt se do t'i arrinja shokët e mij pas 8 vjetsh që i kisha lënë msimet? Si do më futeshin në tru gjith' ato gjeometri, algjebra, trigonometri, etj.? Omeri, Dhimosteni, Platoni etj. Si do munt të ndiqnja msime në latinishten, në Virgjilin, Oratin, Ovidin, Salustin, Ciceronin etj. etj. Po syntaks , po fyzikë, po chimi që s'isha gjë kundi? Në klasin e IV në provimet zyrtare përpara profesorëve të Shtetit do të pyeteshim në të gjitha msimet e gjymnazit të të katër klasave. Unë, si do të përgjigjesha? . . . Ah, ah, s'më harohet ajo dit' e ajo natë që u nisa për në Karvasara gjer sa u gdhiva në Patrë. Tërë natën e lume pa pikën e gjumit, me cigaren në gojë, me mejtime njërin pas tjetrin e me agoni!

Po zarin e kisha hedhur, prapë s'kthehesha dot; as që munt të kthehesha, se pastaj ku vinte turpi? Këtu ja se bëra një gafë, rëfeva një budallë të kllasit të parë, ja se tregova një trimëri të pashëmbëlltë.

Të humbnja edhe 600 dhrahmitë, që bënin ahere 30 napolona, ashtu si humba 800 dhrahmitë të diplomës falco si dhe gjithë kusurin, që mbeta vetëm me harxhet e udhës gjer më Karvasara? Për këtë më vinte shumë keq. Të vinja të shtrohesha prapë në zyrën time, e cila munt të ish edhe më preferablë e e logjikshme? Më vinte turp se po thuajse u muar vesh pse vajta në Athinë. Duhet t'a ndanja njërën dysh. Preferova shkollën pa le të përmbysej bota e lé të dalë një.

I lashë shëndet Theofrastit, i cili më përcolli gjer në stasjon e nisem nga mez' i natës, një dit të Premte, dita e nesërme që folmë me z. Vullgarin. Të Hënë duhej të isha prapë në Athinë, se të hënë mbas dite mbyllej inspektimi[1]

Ardha në Patrë të Shtunë në mëngjes. Ishte 28 i Tetorit. Një herë, një furtunë që ruajna zot. Duhej t'i hipnja vaporit për në Klodidhë në Mesollonjë. Një orë lundrimi ishte, po lundrim kanali, lundrim i keq. Asnjë pasaxher s'kuxonte të vinte në vapor. Po unë duhej të shkonja, si kur kijameti të bëhej. Për një orë nuk bëhej kijameti, nuk do bëhej prishja e dynjasë. Pastaj po të mos kalohej dot, nuk mund të nisej as vapori. Po kapiteni po fishkëllente.

Ahere prej gjithë pasaxherëve vetëm një oficer i ri grek edhe unë u futmë në barkë për në vapor. Të tregonj tani ç'psuam gjer sa ja mbrrijmë vaporit? Një Perëndi e di edhe ne që pamë vdekjen me sy me atë oficerin. Kur sapo dolli nga kanali vapori e pamë me një herë rrezikun përpara. Vapori u ngrit si ariu me të dy këmbët edhe kur u përplas i pamë hundën që hyri gati e tëra në det, si një patë kur lahet! Me fjalë të tjera prisnim që nga minuta në minutë të fundoste vapori. E pamë se u trëmp edhe kapitani. Kisha parë shumë furtuna e tallaze, po jo si atë. Është tmer t'a tregonjë njeriu ashtu si na e pa syri.

Pas 2 orësh mezi ju afruam skelës dhe një mijë taksirate të tjera që psuam gjer sa n'a shkeli këmba dhe i hipa trenit dhe s'u ndala aspak në Mesollonjë. Harinj në Vrahor, ha darkë dhe nisem për Karvasarâ ku arriva më 2 orë të gdhihet me kushtin që në mëngjes do të vinte prapë të më mertë karoca se do nisesha për në Athinë.

Im'atë, im 'më, tejzja kur më panë u çuditnë po edhe u gëzuan. Me të shpejtë i tregonj qëllimin tim'eti i cili po e dëgjon për të parën herë dhe po habitet. Si të paska rënë kjo mëndje, më thotë, tani në pleqëri? Tani prapë gramë? Nuk n'a le rehat, në daç Perëndinë, që n'a prishe mëndjen me vonesën tënde? I thom një e një bëjnë dy ja se do mbaronj gjymnazin e do shkoj në Universitet ja se ndryshe s'e dua vehten! Këjo u vendos, i thom, s'kthehem prapa.

Im 'atë u mek! U nguros! Si të bënj? Unë desha të holla tani se m'u sosnë, ajy s'kish sa desha unë. Po edhe puna s'i vinte dhe aqe mirë. Me të shpejtë gjej sekretarin t'em që ish edhe ajy gjysmë avokati. I mar nja 600 dhrahmi që kishte, i dorëzova zyrën me konditë që do më dërgonte të paktën 100 dhrahmi për ç'do muaj. Po mobillat, librat, etj. që kisha në zyrë

[1] Në Karvasarâ më fort vinja për të ikonomisur të holla të tjera e jo për çertifikatën e klasit II, se si thashë, çertifikata ime është e klasit I. (K. F.)

mbeteshin të mijat. I mora edhe babajt nja 300 dhrahmi që kish. Mora hua nga një mik të tjera 200 dhrahmi, hëngrëm atë mëngjes bukë tok dhe pas dy orë u nisa prej Karvasaraja. Arrinj në Vrahon 5 minuta para se të nisej treni arrinj në skelën Kalydhôn të Mesollonjës, i hipinj vaporit dhe dolla në Patër. Pas 20 minuta u nisa për në Athinë ku arriva të Shtunë në mes të natës. Ç'bën vullneti!

Të Hënë në mëngjes do t'i paraqitesha zotit Vullgaris. Po para se t'i paraqitem i heth një herë një sy çertifikatës të klasit I gjymnazial që kisha marrë me vehte. Udhës kisha bërë mendimin t'a falcifikonja, do me thënë gjermën A! Gjymnasion si ishte e shkrojtur në dëftesë do t'a bënja B! Gjymnasion. Shifrën 13 të moshës që sillte dëshmija do t'a bënja 15. Këjo e dyta bëheshe me lehtësi. Mëkot ishte ; Faj i math ishte falcifikimi që dënohej 5-10 vjet po të kuptoheshe. Të gjitha këto i dinja fort bukur, po i kisha marrë parasysh. Po edhe rrezikun, edhe atë e kisha marrë parasysh. Ndryshe s'kisha si hynja në klasin e IV (që sot është klasi III lyceal). Po fundi i fundit kush do t'a merte vesh? Kush munt të mbante mënt pas 8 vjet se nga cili klas kisha dalë. Ishte kaqe e domosdoshme, por vetëm ajo do më shpëtonte.

Në këtë moment kritik, në këtë angushti e acarim që ndodhesha atë çash duhet të kisha edhe kurajo të mjaftë. Kurajua ime arrin gjer atje sa, për ç'do eventualitet, s'përtova të vete të blé një revolver të vogël, të ri, system "Gallani" dhe 6 fyshekë. Edhe një klluf. E mbusha revolverin dhe e mvara nga prapa mbi supin. Ja se në rast rreziku do t'a trëmpja z. Vullgaris, ja se do vrisja vehten! E kisha vendosur. Vetëm kështu mbulohej gënjeshtra dhe s'turpëronja mikun tim naif Theofrastin.

Para se të vete te z. Vullgaris shkoj nga Universiteti e hasem me Theofrastin. I ngrati mik u gëzua kur më pa dhe më kërkoj të shëkonjë çertifikatën time. Me një herë u mbajta. Pse t'ja rëfenj? S'ishte çudi ta merrte vesh falcifikimin se myreqepi[1] ishte i freskët akoma. S'kisha gjysmë ore që kisha falcifikuar germën B! edhe shifrën 15. Më mirë të mos ja rëfej. Edhe s'ja rëfeva. Po i thashë se bëmë telegraf të na dërgojnë nga Korça se e kisha haruar atje. Ajy e besoj dhe s'foli gjë.

Pas gjysmë ore isha para z. Vullgari. Ajy kujtoj se s'kisha shkuar akoma; po kur i thashë që vajta në Karvasarâ e ardha në krye s'më zuri besë. Pastaj si e mbesoj më kërkoj dëshminë. Po atë ças se ç'më mbajti të mos ia rëfenj me një herë me gjithë që e kisha në xhep. I thashë pra edhe këtij si kur se Theofrastit. Z. Vullgaris u zembrua po më në funt e binda që për dy tri javë do t'ja paraqitnja pa tjetër.

Si të bënte tani Vullgaris? të më jepte të 600 dhrahmitë prapë e të mos pranonte? S'e bënte dot se më kishte regjistruar edhe inspektori s'kishte 10 minuta që e kish inspektuar regjistrin (matrikulin) dhe kish firmosur nënë të nga ana tjetër s'i vinte mirë të më kthente edhe të 600 dhrahmitë që i kisha dhënë të cilat i përfitonj të gjitha ajy se profesorët që nënëshkruan dëftesat ishin profesorët e Lyceut, rrogtarët e tij.

Pa ç'u pa u duk se e besoj. Më jep listën e librave që do të blinja dhe më thotë që pas dreke të gjëndem në klasin t'em me shokët e tjerë.

## VII

Me gëzim të math shkova e bleva librat e pagova afër 200 dhrahmi, se mora edhe libra të klasave II e të III.

S'rëfehet gëzimi jem kur ja prisnja fletët të gjitha librave e kur shihnja përmbajtjen e tyre. Hynja në të thellat. Më dukej si kur shihnja ëndër, po më dukej edhe si kur losnja një rol komik, i cili s'dinja se si do t'a kish fundin. Unë prej një bakalli ose prej "djalë dyqani" si më quante ime gjyshe, tani po bëhesha prapë nxënës. A do kisha atë fatbardhësi, që të shinja me

[1] myreqep = bojë shkrimi (H. K.)

sy dhe të mernja një çertfiikatë gjymnaziale? A do shkelnja ndo një herë pragun e Universitetit? Universitet? Ëndër homerike, Utopi! "Chateaux en Espagna" që thonë francezët.

Pas dreke, atë ditën e Hënë e historike për mua, ditë e cila më transformonte nga jeta reshpere në jetën intelektuale, atë ditë, po thom, mbas dreke z. Vullgaris më paraqit e më rekomandon së parit te drejtori i Gjymnazit privat (gjymnasiarhin), Gjalfinopullos dhe me profesorët e tjerë prof. Gallanin të llatinishes, Thividhopullon të historisë, Kakurjotin të matematikës e Kosmografisë e gjeografisë fyzike, Zymbrakakis të fyzikës e chimisë, Panopullon të frëngjishtes, Zission të poezisë e tragjedisë, Rungas të letraturës dhe epigramatikës[1]. Që andej më sjell në klasin e IV.

Kur hyra brenda dhe pashë atje 50 e ca veta nxënës që prej 16 vjetsh deri 22 e 23 mbeta si trangull! Më ardhi mjaft turp se, burrë tani unë me mustaqe po sheshehesha edhe një herë mbi fronat skollastike të shkollës! Po u ngushëllova pak kur shtira sytë e pashë disa shokë të tjerë nga bangat e fundit që i kishin edhe ata buzët të stolisura me nga një tufë mustaqe gjithfarë rangut e ngjyre.

Eja, Floqi, eja, po nagas z. Vullgari, zëre vëndin e mos kij turp. Ke shokë si veten, po mos u tremp, s'je vetëm, reshtohu, zëre vëndin t'ënd. Edhe më rëfen një vënt atje në cept, të cilin vajta e e zura, duke sallutuar më parë shokët, të cilët që atë çast zunë e po më shëkonin me ironi e me nënëqeshje. Unë e kisha bërë zembrën gur. Vendosa t'i duronj të gjitha.

Vjen profesori i frëngjishtes atë çash. Shokët kishin përpara "Meropin" e Voltair-it si msim, të cilën "Meropi" unë e dinja mjaft bukur qysh se isha sekretar te Manolidhi i ndyeri. U ngushëllova mjaft. Më vinte t'i thesha profesorit që edhe un' e dinja dhe të më ngrihte t'ja thosha shumë më mirë nga shokët.

Si mbaroj ajy msim delnim të gjithë përjashta se ish koh' e intervalit. Ju afrova profesorit të frëngjishtes dhe e sallutonj frëngjisht dhe me një herë fillon një bisedim frëngjisht midis nesh. Profesori u habit kur e pa që e dinja frëngjishten me fe dhe e flisnja me aksent e pronunciation purement français. Më pyeti gjër' e gjatt e i tregova studimet mbi frengjishten dhe u kënaq kaqe shumë sa e bëri fjalë edhe ne kolegët e e tij të tjerë. Më porositi që të Mërkurën e arthme do më ngrihtë në msim, t'ja thesha atë që n'a caktoj për msim. E pranova me gëzim dhe u pregatita.

Kur ardhi të Mërkurën piksëpari më ngreh mua. Kur fillova të analyzonj pjesën e dramës që kishim dhe kur filloj konferenca të zvillohej frëngjisht midis profesorit e meje, shokët mbetnë me gojë hapur! Profesori më rekomandoj ne shokët për model e shëmbëll për ata.

Si msim vazhdues pasonte historia. Kishin historin' e Greqisë së re dhe më fort të kryengritjes të vitit 1821 që unë e dinja përjashta me gjith' hollësitë, mbassi edhe kaqe konferenca e diskure dhe panygjerike kisha mbajtur për mbi atë. E pashë fort në sy profesorin si kur se t'i thesha "ngrehmë edhe mua". Profesori e kuptoj e më thotë të ngrihem t'a thom me gjithë që as e kisha zënë me dorë msimin e asaj dite e të asaj pjese.

Kur u ngrita e fillova, e kur kujtova një herë sikur se isha mbi tribunën e kopshtit të herove në Mesollonjë edhe përpara statujës së mermertë të Lord Byronit e kur më hipën një enthusiazmë, u ndeza i tëri e po e tregonja historinë me hollësinë që as libri s'i përmëntte e me gjeste retorike, aqe sa profesori e la msimin, kryqëzoj duart dhe po dëgjonte, dhe tuke parë që po kënaqeshin të gjithë e po më dëgjonin me vërejtje e zgjata me shumë se 3/4 të orës.

Kur mbarova profesori më shtërngoj dorën dhe më thot' se është e para herë që po shoh një nxënës gjymnazi që t'a dinjë aqe mirë dhe aqe hollë historinë greke. Po unë e kisha përtrypur e honepsur aqe mirë atë histori.

[1] epigramatika = përshkrim i shkurtë poetik lavderues, kryesisht për shërbimin funeral, p. sh. shkrime në pllakën e varrit (që quhet epitaf ose epigramë), por edhe për shërbime të tjera (H. K.)

Tjetër triumf ky për mua. Shokët zunë e po më kqyrnin me një admirasjon dhe çuditeshin si e kisha msuar aqe mirë edhe e shpjegonja si një orator nga tribuna. Po njeri nuk dinte historin' time dhe aventurën që kisha hequr.

Atë dit e shkova plot enthusiazmë. Pashë se në dy nga objektet e msimeve t'ona isha i fortë. Po të nesërmen që në mëngjes n'a vjen profesori i mathematikës, një njeri i vramur, nopran e serioz. Kishim algjebrë që un' e dëgjonja për të parën herë. Ngreh disa shokë me radhë. Unë e shoh e s'kuptoj kurrgjë! E humbas si Xhaferi simitet! Turbullohem, dëshpërohem e fillon mellankonija.

Mbas dreke vjen ajy i llatinishtes. Kishim Aeneadën e Virgjilit. Kuptonj se po msohet llatinishtja, po s'mar vesh gjë. "Terra incognita" për mua. Gjith' atë orë kishim edhe të Oratius Flaccus një satyrë. Edhe këtu më mban erë barut; s'lagem aspak. Si do bënj? A do munt t'i afrohem makar atij më të humburit nga shokët t'anë? Dilemë!

Vjen profesori i letraturës. Kishim "Theogonia"[1] e Hesiodhit dhe "Gorgjian" e Platonit. Sa doqë s'i mernja vesh mirë, se s'i shpjegonja dot fjalët, po e pashë se m'i merte syri nuk trëmbesha. Ashtu edhe për tragjedit' e Sofokliut e të Europidit, sa do që i dinja nga këndimet e parafraseve, prapë nuk u dëshpërova kur i dëgjonja në gjuhën klasike hellenike. Gjithashtu Omerin, Pindharin, etj. etj. të cilat fillova t'i studjonj vetë me ndihmën e diksionerit omerik, e me shumë durim, sa brenda dy muaj këndonja e shpjegonja Omer e Pindhar me një shpejtësi e lehtësi të zellshme.

Dal nga dalë u stërvita mirë në fyzikën, dhe në gjeografinë fyzike e kosmografinë. Të vetmet msime që më bënin përshtypje e më dukeshin si male ishte mathematika nga njera anë me algjebrën, gjeometrin' e madhe e trigonometrin' dhe llatinishtja nga tjetra anë me Virgjilin, Oratin, Ovidhin e Salustin me gramatikën e syntaksin e zorshëm e enigmatik të saj.

Hirë ju paça disa shokëve të mij.

Kisha një shok, Jankon, të birin e konsullit të Turqisë në Karvasarâ, në shtëpi të të cilit më shpunë kur u mbyta, kur isha i vogël, si e tregova në krye. Ky ish student i Drejtësisë dhe i fortë ne mathematikë. Më vinte për natë në shtëpi e më bënte nga dy orë ditën msim, herë algjebrë herë gjeometri dhe më futi mirë në nojmë[2] edhe mbassi edhe unë këndonja qënçe me gjithë fuqinë, në 3 muaj e sipër zura t'ju afrohem shokëve. Vura themele të mira dhe përparonja me hapa të mbëdha.

N'a mbetej llatinishtja. Tjetër një mik nga Eurytanija e Greqisë, student i Medicinës, Jani Mitali, zu më bënte paralelisht Virgjil e Orat e syntaksë latine. Brenda në dy muaj i arriva shokët. Kështu që, kur ardhë Krishtlindjet dhe na lanë 12 ditt të lirë nga shkaku i kremteve unë gjeta kohën të studjonj me një manì të pashoqtë dhe më 8 Janar të vitit 1895 isha në pozitë të ngrihesha e të recitonja msimet tamam si kur se shokët e tjerë.

Po kisha gjetur belanë nga shokët se s'më lini rehat me gjithë hallet që kisha.

Mbassi i rrojta mustaqet e dukesha fare djalë filloj të më duket hunda në tërë madhësinë, trashësinë, gjatësinë e gjërësinë e saj, dhe kjo u tërhiqte të gjithëvet vërejtjen, atyre të mallkuarve arrakatë, shokëve. E zun' e talleshin me mua me gjithë që ishim miq e më respektonin. Floqi, jotja është gjith' ajo hundë që mban? Nuk të sjell rëndësi? – Floqi, pse e solle gjithë hundën këtu? Nuk linje edhe ca okë në Karvasara? – Floqi, sa kut pluhurë do në javë për të fshirë gjith' atë hundë? – Edhe dikush më i zgjuar: Floqi a munt të nxjerrë nga një vagon vërrat e hundës t'ënde? Ose : Floqi, a e ke peshuar ndo një herë hundën sa kandarë të peshon? Një tjetër prapë: Të lutem z. Floqi, kur të pjellë hunda do të më ruash ndonjë klysh të vogël (?) . Një tjetër, do ish nj'a 17 vjetsh, një mistrek më nxehu shumë. E hiqte vehten shumë të zgjuar dhe e shëkonin në sy të gjithë. Më thotë një dit: Kur kthen, zotrote, nga ndo një qoshe rruge, fillon të shihet përpara hija e hundës sate dal nga dal fillon të dalë hunda, që kuptohet se po vjen Floqi, bën ballë e duket! Shakaja e tij kish një frymë zgjuajtësije edhe e

[1] theogonia = lindja, krijimi i perëndive (H. K.)

[2] nojmë = shenjë që i bëjmë dikujt me sŷ, me kokë a me dorë për t'i dhënë të kuptojë diçka (H. K.)

dëgjonja deri diku tuke nënëqeshur, po kur filloj të bëhet arrogant, tuke i këshilluar ca kalamaj të hapnin rrugë se mos ju nxirte një sy hund' e Floqit, ahere më s'u mbajta. E pashë se e teprovi dhe i afrohem me një herë e i jap një shputë aqe të fortë suratit, sa i lëshuan sytë shkëndija! M'u lëshuan të gjithë shokët e tij, të klasit të III e filluan të lozin grushte me mua. Më shtërnguan të rah kështu nj'a 3-4 prej syresh gjer sa ardhi e shoq' e drejtorit z. Vullgaris, dhe në vënt të më delte zot mua m'u vërsul e më lau me epithetat më të dobta e më të fëlliqura që munt të dalin nga gardhi i dhëmbëve të një gruaje të ritur keq! Më kot mbrohesha. Më kot justifikonja veten. Ajo m'u derth si një tigër e keqe. Lumërisht që arriu edhe i shoqi, i cili me gjakftohësi pyeti e mori vesh që kisha të drejtë dhe më mproj nga thonjt' e asaj kulçedre, që e respektonja vetëm se ish e shoq' e drejtorit. Më vonë e mora vesh se ajo bistrë e kishte nip djalin që raha të parën herë, i cili na ishte çuni i një koloneli.

Po kjo ngjarje shkaktoj një zhurmë të madhe dhe u komendua liksht prej prindërve të djemve të rahur, të cilët kanë bërë huxhum të nesërmen në shkollë dhe dikush pretendoj të më përjashtojnë edhe nga shkolla se qënkam një katundar, një anagog[1], një barbar. Po kjo poterë mbajti vetëm ndo një orë, dhe sa do që kujtova se do më kushtonte shtrenjtë, pata këtë fitim , që, qysh ahere më s'u dëgjua të bëhet fjalë për hundën t'ime.

Po mbi këto s'më linte të qetë edhe z. Vullgaris. Bënte ç'bënte, më pyeste në më ka ardhur çertifikata e klasit që po prisnim prej kaqe kohe. Unë e mbanja me fjalë me sot me nesër më shumë se 3 muaj.

Një dit i thashë si me shaka: Është kaqe nevoja z. drejtor të insistoni për atë çertifikatë? S'më zini besë se e kam mbaruar klasin e II? Munt të ketë edhe humbur, ahere si lipset të bënj? Po z. Vullgaris, njeri nevrik, s'i priste mirë këto fjalë. Nga ndo një herë zgurdullohej kaqe shumë sa më merte frika. E pashë që nuk shkonin tek ajy të këtilla profka. I thesha se shkrova e prapë shkrova të m'a dërgojnë edhe gjithë e gënjeja. Ajy s'e harronte kurrë.

Një dit më shtërngoj për së teprit. Më friksoj se po të mos ja paraqitnja brenda 10 ditve do më përjashtonte nga shkolla. E pashë që nuk shkonte puna më gjatë edhe vendosa t'ja rëfenj. Revolverin e mar në xhepin e djathtë të setrës dhe një dit i vete në mëngjes në zyrën e tij të veçantë. Zembra më rihte fort. Djersë të ftohta më përshkonin trupin. Z. Drejtor, çertifikata më ardhi dje me postë, i thom. – Të ardhi? Ku e ke thotë nxire shpejt e m'a jep. E nxora brenda në një zarf të hapur e ja dhashë. E mori, e pa, e examinoj; unë e shinja në sy; ja qepa syrin mbi sytë e tij dhe zembra me rihte si kur do më çkëputej. E vuri në një bezaktan e tij, nënë bangon (tavolinën) që shkruante e më tha: "shko tani në klasin t'ënd". Salutova e ika. Nuk e examinoj mirë.

Gjithë ditën atje e kisha mëndjen ne çertifikatën. Shpirti s'më qetësohej kurrë. Dy nett me radhë shëkonja ëndra sikur më zinin , sikur më sillnin para gjyqit, sikur më dënonin.

Pas 5 ditt më thret me kujdestarin e shkollës prapë në zyrën e tij drejtori. Mua më lojti zembra nga vëndi. Hipa shpejt në odën t'ime se isha intern[2] në Lycenë, hapa një xhekmexhi[3] të vogël, mora revolverin dhe e shtira në xhep. Ngjitem në zyrën e drejtorit, trokëllas dhe hynj brenda.

Ishte vetëm. Më priti me inat shumë; ishte tepër i egërsuar. Posa më pa më adressohet me zembrim: Ke mbaruar vërtet klasin e II, apo erdhe të n'a hedhësh pluhur syve? më thotë. – Pse, z. drejtor? Përgjigjem gati si i trëmbur. S'e pashë mirë, thotë, çertifikatën t'ënde dhe e shohë që është e falcifikuar. Falcifikuar? i thom. Ç' thoni ashtu z. drejtor , ësht' e mundur? – Pse s'është? më thotë. S'është çudi ta kesh falcifikuar vetë. – Unë? zoti na rrujt! i thom. Rëfe të drejtën, më thotë, ndryshe të nxora që tani nga shkolla. Aman, z. drejtor, mos flisni ashtu për mua, s'di gjë, ju betohem. – Ahere rëfe, më thotë, kush e ka falcifikuar. Këtu shifet se ka qenë A! dhe me maryfet është bërë A-ja B. Edhe m'a rëfen në dritë, ku këndoheshe gërma

[1] anagog = njeri mbi arsyen, i pa-arsyeshëm (H. K.)
[2] intern = konvikt (H. K.)
[3] çekmeçi = sirtar (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

edhe A edhe B, gjë që s'më kishte ra ndër mënt ta parashëkonja më parë. E shoh tani që ardhi momenti i keq i katastrofës s'ime. Drejtori insistonte; munt të më nxirte krejt nga shkolla, munt edhe nga inati të më bënte qepazë e të më hiqte në gjyq. Kush më shpëtonte? Si munt të shpëtonja? Ahere e mblodha mëndjen. Sŷri zû më egërsohej, zembra ment më çkatërohej se rahuni. S'dinja si të bënj. S'isha i zoti i vetes s'ime. Duhej të merja një vendim. U mata një herë të përdor revolverin e t'a tremp drejtorin, po prapë u mbajta. I thashë me një zë fermë e të theksuar: Z. drejtor, mos ma bëni këtë të keqe mua, se është mëkat të jem munduar kaqe kohë këtu, të kem prishur kaqe të holla dhe të kem humbur pozitën që krijova në Karvasarë me kaqe mundime. Në dor' e kini të mos më bëni të keqe; të mos më shtyni në dëshpërim! – Si the, si the? më thotë, të të shtynj në dëshpërim? Pse ke frikë kur e quan veten të larë? Qielli i kjartë s'ka frikë nga rrufeja! Po duket se do jesh fajtor, thotë. – Fajtor unë? Kurrë. – Po ahere kush e ka falcifikuar? – S'besonj të jetë e falcifikuar, i thom. E kam mbaruar klasin e II. Kaq më thotë, mos e shty më tutje se do të të zë në presht, që s'e ke kaluar! Folë të drejtën. – E drejta kjo është, i thom, këjo që ju thashë. – E mora vesh, thotë. Je një falcifikatar. Edhe egërsohet me një herë. Mer librat shpejt e plaçkat, edhe nesër mos të të shoh këtu. Je i çregjistruar qysh sot. del jashtë!. . . Rrufe të më kish rënë nuk do më vriste kaqe sa ato fjalët e ashpra të drejtorit! M'u turbullua mëndja, s'isha më i zoti i vetes s'ime. Drejtori më sheh se po qëndronja si dru dhe ashprohet më tepër. Me heth në surat çertifikatën edhe ngrihet më këmbë e më rëfen derën. Shko shpejt, thotë, tani, tani, marsh prej këtej. Ahere s'u mbajta dot. M'u prish gjaku, kur e pashë se më përdori aqe liksht. Nxjer me një erë revolverin edhe në dëshpërim e sipër ja mbanj përpara krahrorit. Drejtori kur e pa revolverin drejtuar mbi atë, kaqe u tremp sa u zbe si dylli! Mos fol as gjysëm fjale, i thom, se të kam në dorë. Po hape gojën je i vrarë edhe ti edhe unë. Merri fjalët prapë shpejt! Z. Vullgaris, i trempur për vdekje u ul kaqe fort sa s'dinte ç'të më theshte. – Pardon , biri im, pardon, thotë, më ndje, m'a fal, jam një plak, jam nevrik, mos më mer më qafë fëmijën t'ime! Më ndje për sa të fola! Do mos bëni më fjalë, i thom, për çertifikatën t'ime? – Jo, kurrë, kurrë, të siguronj. – Për fjalën e nderit? – Për fjalën e nderit. Do mos rëfeni gjëkundi ç'ngjau tani në mes t'onë? – Jo, kurrë, të betohem! – As xonjës t'uaj e fëmijëvet? – As atyre. – Për fjalë të nderit? – Të betohem. Ahere ju lutem, mbassi e shoh mbi tavolinën regjistrin e shkollës do shënoni se e paraqita dëftesën e klasit II dhe se u gjet në rregull. Mirë fort, e shkruanj, thotë, dhe ulet e mer dëftesën që m'a kish hedhur q' parë. Më ndjeni, i thom që ju solla në këtë pozitë. Ke frikë, thotë, prej meje se nuk ta mbaronj dëshirën? Jo, i them, po experienca e pakët që kam si një avokat praktik dhe kjo ngjarja e sotme më vunë shumë ment; m'u bënë një msim i mirë. Ç' ka, thotë, si të duash, mbaje në daç çertifikatën që të mos kesh dyshim se mos e paraqit kundra teje. Po në regjistrat si do themi kur s'gjindet dëftesa? – S'ka kush t'ju kërkonjë fjalë për atë, në dor' e kini. Fund'i fundit do themi se ju ka humbur. – Qeshi pak. A, katerzar, më thotë, s'të dinja kaqe të zotin. – Unë s'i përgjigjem aspak, po kurdoherë revolverin në dorë dhe të drejtuar mbi drejtorin. – Si thoni, z. drejtor, e merni përsipër edhe këtë? – E mar, thotë. Dorën!. . . Më jep dorën e djathtë dhe unë të mëngjërën. Jam shqiptar, thom, si je edhe zotrote (se ishte nipi i Dhimitri Vullgaris, kryeministrit tjetër herë të Greqisë), shqiptar nga Hydhra. Prandaj më dhé besën dhe duhet ta mbash, si shqiptari!

Ajy për të parën herë po dëgjon se jam Shqiptar dhe u habit. I donte shumë shqiptarët dhe i pëlqente të flasë shqip, ose arbërisht, siç thoshte. – Si, ma pret, vërtet shqiptar je ti? Vërtet shqiptar je ti? Vërtet. Ahere ma kthen barbarçe shqip dhe i përgjigjem, mbassi e dinja mirë atë idiomë se isha msuar me kapetanët Kranidhjotë, Kullurjotë, Specjotë dhe Hydhjotë që ngarkonin qymyr nga apothekat t'ona. . . Menjëherë ndryshoj puna. Vëre në xhep revolverin, me thotë, se s'i mbet më lezeti. – Po fjalët, i thom? – Zumë besë, thotë, do akoma apo s'je shqiptar? – Shqiptar! – Ja besa – ja – besa, më thotë dhe më zë prapë dorën. – Besa-besën, i thom, edhe unë dhe e ul revolverin e e vë në xhep. Ulu poshtë, thotë e ri. Ungjem mbi një kolltuk. Qënke zëmbrak, thotë. Nevoja, thom, e dëshpërimi më shtërnguan. – S'më ka

ngjarë kurrë këjo, thotë. Edhe unë për të parën po sillem kaqe barbarisht, po ja pres, përpara një bamirësi, edhe unjem e i puth dorën. Të ndjej, thotë, Floqi im, po tjetër herë hap sytë se je i ri dhe këto s'janë gjëra të mira, as që të rekomandojnë për kalorësi. – E di, thom, edhe pendohem. Mjaft, thotë, le t'i lemë këto fjalë. Ti do vazhdosh msimet, mbassi disa profesorë janë të kënaqur prej teje. Unë do përpiqem të marrësh dipllomë gjymnazi. Do vish për herë e të më shëkosh dhe do të jesh si njeri i shtëpisë, mbassi qënke shqiptar.

Këto fjalë aqe më kënaqnë, e s'kisha ku t'a vinja zotin drejtor. Më hyri në zembër, më theku. U ngashërova kaqe shumë sa i kërkova pardon disa herë. Ju lutem të mos marrë vesh njeri ç'ngjau, se më vinte turp. Më qetsoj. Më tha se do hanim bashk' atë ditt familjarisht; e falenderova tepër për nderin e math që më bënte. Troket zilen dhe vjen shërbëtori, të cilin e porosit t'i thotë zonjës Vullgaris se e kemi për drekë z. Floqi. M'u bë qefi fort, për një mënt. Pse, i thom, z. drejtor? Dua të të marr në tryezën familjare, si një shqiptar, se do gëzohet shumë edhe zonja ime që është arbneshë prej Porozit. Arbneshë edhe zonja Vullgaris? Po, thotë, Arbneshë dhe me ndjenja arbnore!

Oh, sa i lumur që isha edhe pa pandehur! Isha midis Shqiptarëvet edhe s'e dinja kaqe muaj. Gëzimi im s'tregohej.

Pas një ore shkonim bashkë me z. Vullgaris në odën e veçantë të hamjes (sale à manger), përpara një tryeze të shtruar bukur e të stolisur me lule. Vjen zonja Vullgaris, e cila gjer ahere më kish marrë me gazep, se i kisha rahur të nipin dhe më rekomandon përpara saj si Shqiptar z. Vullgaris. Ajo u gëzua mjaft, si e vura re. Më foli shqip dhe e pashë se kisha përpara një heroinë, një kapitaneshë, një Bubulinë të dytë.

U shtruamë në sofrë e hëngrëm mirë. U interesuan shumë për historinë t'ime, të cilën ja u tregova sido kudo e ju bëri shumë përshtypje një jetë e tillë e çuditshime.

Qysh atë dit ndryshoj krejt programi. Livolveri i shejtë më mbaroj punë, po më hapi dhe një lumëri tjetër se u bëra dal nga dalë shtëpijak te z. Vullgaris dhe do shkonja mirë, si kur se shkova.

Tuke kaluar koha panë se dinja edhe valle mirë, edhe këndonja mirë edhe losnja disa instrumenta dhe më fort flauton, e cila ju pëlqente tepër gjer në pasjon. Këto kanë qenë shkake që s'më ndanin prej shtëpije, dhe e shihja se ishim të lumtur si ata, si unë.

Më mernin, po thuaj, kudo që vinin. U njoha me shumë shtëpi të mira me shumë zotërinj dhe deputetë të Athinës me shume zonja e zojusha të aristokracisë

Athinjote. Me vallet, shakat' e lodrat e këngët me flautin e qitharën që losnja shkonja aqe mirë sa s'rëfehet. Po edhe këndonja aqe shumë e vinja aqe mirë në msimet sa hesap s'bëheshe. Me një fjalë isha vërtetë i lumur e do mos e harroj kurrë atë kohë të artë. Zonja e zoti Vullgari më kishin si djalë. S' ngjijeshin dot me mua. Shih se ç'bën alltipatllarja nga ndo një herë!

Pas pak kohe ja mbrinte muaji i Frorit. Duhet të jepnim provime me shkrim. Dhamë. Ardha nga të parët nga shokët e tjerë. Kur panë profesorët versjonet e mija me aqe shpjegime, hollësi e art shkruar u çuditnë. Më thirë përpara tyre. Më thanë se unë nuk ngjas si shokët e tjerë se kam shkruar ndollina e sende me aqe bukuri e naltësi, sa duket se kam kënduar e parë shumë gjërra. Shkrimi jem, lektura, mendimet, idheali ju dukeshin gjëra extra ordinare. Ju kishin bërë përshtypje të thellë e më përgëzuan të gjithë. Edhe unë përvujtësisht ju fala nderit të gjithëvet.

Kështu kaloj ajy mot i bekuar ku shkova një jetë që rallë munt të shkonjë një student tjetër. E njohura ime me aqe persona të naltë e në zë, prej të cilëve goditi një të jetë edhe gjymnasiarhi Manxhakos, drejtori i gjymnazit publik shtetnor "Varvaqion" ku dhashë provimet, rekomandimi nga an' e Vullgarit ku ishte nevoja si dhe rasti që dhashë nj'a dy konferenca ne sallën e syllogut "Parnassos" më ndihmuan shumë.

Më së fundi ardhi edhe koha e provimeve. Me gjithë që kisha kënduar mirë e kisha gjith' ato rekomandime, prapë më trembeshe syri.

Midis shokëve kisha edhe një djalë të zgjuar aristokrat, po krejt analfabet, vërsnikun tim nga Pirea. Ky quheshe Vangjel Ekonomon. Më ishte vardisur shumë se s'përtonja t'a msonja, me gjithë që kishte ndenjur 7 vjet në gjymnas. S'më ndahej këmba këmbës. Edhe kur na lanë dy javë të lirë, që të pregatiteshim për provime, ajy qëndroj në odën t'ime. Ishte i pasur i ati fabrikant me 20 e sa shtëpia e dyqane, dhe ky Vangjeli, prishte pa masë të holla. Me gjithë që m'u ngarkua barrë e rëndë po s'kursehesha t'i msonja ato që dinja dhe shumë e qërtonja kur s'ja nxinte truri.

Një ditë Vangjeli desh të presë një palë roba të reja. M'u lut t'a shoqëronj gjer ne terëziu[1] i shtëpisë mbretnore të Greqisë. Vamë bashkë dhe zgjodhi një stofë princore, prej atyre stofave të ralla inglize që bënin roba mbreti dhe princat e tjerë. I thotë terëziut Feretopullit të më marë edhe mua masë. Ç' flet, i them. Unë s'ja kam kohën sot të bënj roba. – Meri masë, i thotë terëziut, se robat i paguanj unë. E shoh se Vangjeli desh të më darovitte një palë roba për msimet që i bënja dhe kjo më ardhi për hesap. Qëndrova e më mori masë. Për 5 ditt u mveshmë që të dy me robat e reja. Roba extra bleu (të maktja) që s'kisha mbajtur tjetër herë. Vangjeli s'mjaftoj gjer këtu, po më mori me radhë edhe kusurin e kombinaisonit, kapellë, këmishë, gravatë, këpucë, gante[2] etj. etj. edhe të gjitha peshqesh. Më kurseu nga nj'a 800 franga.

Vinë edhe provimet më në funt. Na caktojnë ditën e n'a thresin të paraqitemi. Filluan provimet dhe mbajtnë plot një javë. dalin përfundimet edhe prej 57 nxënësve që ishim në klasin t'onë kaluan 18! Unë kisha ardhur i gjashti i graduar. Njëzet e dy mbetnë për t'u provuar edhe një herë nga Vjeshta dhe kusuri mbet prap n'atë klasë.

Ja edhe dita e lume shkrepi për mua! Mbas një jave mernja dipllomën që mbarova gjymnazin me gradën "mirë" (katus) dhe kalonja në Universitet.

Atë natë që vura dipllomën në xhep, qava nga gëzimi. Më duket si kur shëkonja ëndër. Një qint herë në sahat e shihnja dhe e palosnja prapë. Që atë dit i telegrafisa t'im eti sihariqin e dëshëruar: Mora çeretifikatën (shkruar edhe greqisht H. K.) gjymnaziale. Tri dhet' e sa telegrafe mora nga im'atë dhe miqt' e tjerë të Karvasarasë.

Kur pas një jave kthehesha në Karvasarâ u prita me gëzime e brohori të mbëdha. Shumë edhe s'e besonin gjer mos e panë me sŷ dipllomën t'ime. Të gjithë çuditeshin. Po ç'farë s'bën vullneti i njeriut? Im'atë, im' ë, teto Ndinua, im vëlla derdhnin çurkë lott gëzimi.

Nuk do të harronj kurrë edhe dashurinë që më rëfyen zonja e zoti Vullgaris, të cilët u gëzuan shumë kur mora dipllomën dhe më mbajtën edhe dy dit në shtëpi të tyre mysafir. Gjithashtu një javë më mbajti mysafir në Piré edhe Vangjel Ekonomi, i cili më rekomandoj me t'atin, t' ëmën, të vëllezërit e të motrat. U njojtmë edhe me shumë shtëpi të mira në Piré edhe natë për natë vinim në Opera familisht, ku kishin llozhin e tyre. Kaqe familjar u bëra në shtëpi të Ekonomit, me që edhe Vangjeli mundi e kaloj gjymnazin (më fort me njojtje e me të holla shumë) sa deshin të më bëjnë edhe dhëndër, tuke më mblesëruar një të motrën e Vangjelit Molle Marikën.

Si ardha në Karvasarâ e shtrova mëndjen. Iu përvesha me gjithë qef prapë zyrës së dashur avokatore. Tani e shihnja vehten ndryshe. Ajy mot që ndenja në Athinë më vjejti sa të thuash. Sekretari që kisha e që e kisha lënë në zyrën t'ime kur ika u duk mjaft i ndershëm. Më dorzoj bibliothekat, librat etj. etj. edhe unë e mbajta ortak e i jepnja një të tretën e fitimeve.

## VIII

[1] terzi = rrobaqepës (përkthyer mga turqishtja me google H. K.)
[2] guante = doreza (H. K.)

Nga Shtatori i vitit 1895 vajta prapë në Athinë. U shkrova në Universitet në Fakultetin e Drejtësisë. Tash pra isha student i drejtësisë. Shtypa edhe kart vizitat e para në këtë titull. Shkova e vizitova gjithë miqtë e vjetër, më së parit zonjën e zotin Vullgaris, të cilëvet ju solla edhe disa peshqeshe. Njenja kështu nj'a dy muaj në Athinë, bleva librat e nevojshme juridike e u ktheva prapë në Karvasarâ ku ju përvesha zyrës.

Me gjithë që s'ishte ajo pun' e parë që kisha lënë kur vajta në gjymnazin, po prapë mirë vinja. Më mbeteshin 200-300 dhrahmi në muaj. Edhe im'atë sido kudo mirë e kishte punën dhe shkonim shumë mirë dhe të lumur.

Motin e II të studimit në Universitet vajta prapë në Athinë, ndenja dy javë vetëm, bleva edhe disa libra juridike dhe prapë u ktheva në Karvasarâ e exersonja profesjonin.

Simestrat e dyta të Frorit i pagonja tuke ju dërguar miqvet rekomande librezën t'ime të Universitetit si dhe të hollat, të cilët paguanin për mua taksin simestral, më regjistronin në Universitet e më kthenin librin prapë.

Motin e III vajta në Athinë e ndenja 6 muaj, tuke lënë prapë ortakun t'im në zyrë. Përveç të hollave që kisha marrë me vete, më dërgonte im' atë edhe nga 75 dhrahmi në muaj dhe shkruanja edhe gjithfarë artikujsh në disa gazeta t' Athinës, prej të cilave fitonja 80-100 dhrahmi në muaj. Merresha më fort me artikuj, ose kritika theatrale, të cilat i përpillonja me një specialitet të posaçëm dhe i pëlqente publiku.

Motin e I të Universitetit kisha njohur artistin e math tragjik Mounet Souly. Këtë mot, motin e III njoha mirë edhe aktoreshën e famshme frenceze Sarah Bernard, si edhe Veronin. Më vonë kam nohur edhe aktricen tjetër që çuditi botën, franceze prapë, Eleonora Duse[1], e cila më kishte sympathizuar shumë. S'kishte natë të mos vinja në theatro, ku kisha fronin t'im të veçantë të fletararit[2] pa të holla. S'lashë Opera e Operettë pa parë e pa e studjuar mirë. Isha amator i fortë i muzikës hynore të Beethovenit, ta Wagnerit, të Moxartit, Schubertit, Medelsonit etj. etj si dhe të Saint-Saënsit, Bleriôt, Bizet, Gounoud, Halevy, Amboise Thomas etj. etj. ashtu edhe të Listit, të Chopinit, të Mayerbeerit etj. Sa për muzikën italjane më pëlqente më fort muzika e Rossinit, sepse ajo e Verdit, e Donizettit, e Bellinit, e Puccinit e e Leoncavallos e e Mascagnit më dukeshin si të përtrypura e vullgare. Admironja Parsifalin, Tanhauzerin, Lohengrin dhe Tristanin e Wagnerit dhe Fideglon e gjith symphonitë qiellore të Beethovenit. Rossinit i pëlqenja Guglielmo Tellon, Barbiere di Siviglia, La Gazza Ladra, dhe Semiramis dhe nga Verdi vetëm Fallstaffin, Rigoletton, dhe Aidën.

Ngordhnja në koncertet e symfonit' e festivalet. Vdisja për muzikë dhe më fort sympathizonja violinë, violincellon, flauton dhe oboën. Shumë familje aristokratike në Athinë e në Piré më thrisnin vetëm e vetëm që t'ju tregonja mirë hypothesin e një drame ose operette dhe t'i frymëzonja në mysteret e muzikës. Çudia ishte kjo që s'kam ditur nota muzikale aspak, po veshi më ndihmonte kaqe shumë, nga që i kisha dëgjuar kush e di sa her' sa s'më shkonte asnjë notë. Ndjeja edhe më të voglën parafoni[3], ose falco muzikale, sado vegël-shumëse të ish banda ose orqestra.

Nuk dua të përshkruanj këtu jetën e studentit që shkonja në Athinë, njohtjet me profesorët e Universitetit e me qindra studentë shokë, se do të zgjatesha shumë, por të gjitha këto i përmbleth në këtë shkurtim që kam shkuar shumë mirë si tuke vajtur rregullisht në Universitet dhe në Frondistirjot (shkruar edhe greqisht H. K.), shkollën e natës praktike jurisprudence, si dhe tuke nxënë e tuke vizituar po thuajse për dit Bibliothekën nacjonale të Greqisë "Valaneion" , ku studjonja gjith farë dijenije e shqence, gjë që më vlefti shumë në jetën praktike. Përgjithërisht jeta ishte e qetë e pa episodhe dhe me gjithë shoqt' e miqtë shkonim në një armoni të madhe.

[1] sipas Wikipedia kjo artiste la lindur në Vigevano (Itali H. K.)

[2] flat = apartament (nga anglishtja). Fletararit ndoshta ka kuptimin e llozhës në teatro (H. K.)

[3] parafoni = papastërti akustike (H. K.)

Me të afruar të Pashkëve të atij viti një sent n'a turbulloj atë jetë të lumur e të qetë. Lufta Greko- Turke që ngjau më 1897. Qeverija e Dilijanit, mbassi u dekllarua lufta dhe kryexheneralli i Turqisë Etëhem Pashaj hyri në Thesali, u shtërngua të mbledhë sa klasa të ndundtte ushtarësh për në luftë. Un' ahere isha 23 vjetsh. Po me qenë se isha naturalizuar si nënështetas grek, u thira në shërbimin rezervë. Po tuke qenë se s'kisha shërbyer tjetër herë edhe s'kisha haber prej exercizevet ushtrijake, dhe mbassi isha i degës së drejtësisë, pikësëparit u mora si nënoficer kapter i Gjendarmërisë dhe që atë javë më mveshnë aspirant e më dorëzuan në ballin e luftës të Nartës nënë xhenerall Manon, komandantin e përgjithëshëm të Ballit të II ushtrijak i cili sundonte 8 regjimenta. Unë isha në regjimentin e 6-të.

Prej shkresave që shkëmbenin me komandën e Divizjonit nga an' e baonit t'onë, (do me thënë prej bukurshkrimit) u pëlqeva si sekretar i Divizjonit dhe me 2 javë e sipër isha sekretar i veçantë i xhenerallit Manos, i cili më sillej si baba se ishte shumë gentil, shumë zembër – mirë, po edhe serioz e strikt në detyrë.

Kur krisi lufta një të Djelë mbas dreke - dhe ishte atë ditë dita e Luleve, një javë përpara Pashkëvet, gjylja e parë na erdhi nga trinçetë turke, nga vëndi "imaret" m'at' anë lumit të "Arahthos" të Nartës. Pashë se ushtrija greke këtej u enthusias dhe ja filloj këngës luftarake, kurse të tjerë shanin me frazet më të ndyra Turqit barbarë që ja okuponin Epirin e tyre dhe të tjerë trëmpnin se do t'i çqyhenin si tigra e si pantherë ato bisha për m'at'an' të lumit që quheshin Turq.

Gjylet po n'a i dërgonin turqit njërën pas tjetre gjer sa pas gjysmë ore zunë të përgjigjen dhe artileritë greke.

Kjo luftë filloj si me shaka dhe me qenë se asnjë gjyle gjer m' atë ças s'kish bërë ndo një dëm, n'a dukej sikur s'paske lodër e sehir më të mirë. Po me një herë na vjen një sharpnel dhe plagosen dy ushtarë aty 500 çape lark nesh. Unë isha bashkë me xhenerall Manon e me nj'a 10 oficerë të mbëdhenj e të vegjël të Etat-majeurit dhe shikonin luftën me dylbi ushtrijake.

Pas 2 orë lufte u ngrys. Ahere lufta u egërsua. Turqit, nj'a 3 bataljone fanterije kishin ardhur në buzë të lumit m'at'anë, ku i pritnë së këtejmi dy bataljone efzonesh dhe një grigjë (bylyk[1]) gjendarmësh mori pjesë edhe një kompani artilerije fushore. Plumbat vinin si breshri andej e këtej, topat t'ona e shtuan zjarrin, e trifishuan. Sharpnelet s'andejmi n'a vinin njëra pas tjetre, si edhe gjyle të kalibrit të math.

Dikur pëlcet një gjyle mbi një barakë afër nesh, ku ishin stalet e kuajve; bije brenda dhe plagoset një kalë. Ahere trëmben të gjithë kuajt dhe tërbohen, si mbas huqit që kanë kuajt shpesherë. Në tërbim e sipër dhe mbassi më të shumit ishin lidhur pas tagjisorevet (vëndet që hanin tagjinë) harbohen dhe marin nëpër këmbë tagjisore, kadhrone, drasa, direkë dhe më në funt xvarisin gjithë barakën. Zhurmat e tyre dhe hingëllimat e dëshpëruara të kuajve, që u coptuan njëri me tjetrin nga gozhdat, nga drasat e tabanit nga disa hekura të tjera edhe nga të kafshuarit njëri jatrin prej agonije, të gjitha këto shkaktuan një panik kaqe të math në rangjet ushtarijake t'onat sa shumë ushtarë e oficerë zunë të prapseshin nga frika. Një gurgule e një anarshi filloj me një herë dhe mezi pas gjysmë ore mundi të restabilohet rregulli.

Ata të zinj kuaj, më të shumët u vranë, u shtypnë ose u dërmuan. Disa mbetnë sakatë dhe u përjashtuan nga shërbimi dhe 3-4 vetëm qëndruan në gjëndje të shëndoshë.

Në atë kohë ishin vrarë prej nesh nj'a 11 ushtarë dhe plagosur nj'a 60 shpirt, disa shumë rëndë.

Një gjë me rëndësi ngjau të nesërmen ditën e Hënë.

Një kalorì turke, një kompani 200 e sa kalorësh, tentuan të bëjnë asalto[2] nga ura e Nartës. Isha mbi bregoren e Nartës të qojtur "Amyotikos straton". Një oficer i shtabit t'onë sheh lëvizjet e Turqve dhe me një herë i jepet urdhëri komandantit të grupit t'artilerisë së rëndë që kishte installuar topat e mbëdha maje bregut, 200 metra lark nesh.

[1] bylyk = njësi ushtarake në Perandosinë Osmane që përbëhej nga 100-250 ushtarë me pagesë (H. K.)
[2] asalto = sulm (H. K.)

Komandanti Gulimes pregatitet dhe si e la kalorinë turke të hipin urën ju a dha me batare të dëndur me topat.

S'kisha imazhinuar asnjë herë manovrë ushtrijake si atë. Buçiste hapsira nga kërcëllimi i tmershëm i atyre topave, tundej dheu që të dukej sikur do shkatërohej. Na u thyen disa xhama e korniza fotografirash etj. etj. Sytë t'ona me anë të turbive ishin sjellë me kureshtim mbi urën e Nartës të vjetër 3-3. 500 metra lark nesh. Pamë ahere një sqenë të tmershme që s'më del kurrë nga mëndja. Disa prej gjyleve qëlluan ushtrinë kalorëse turke tek po kalonte me galop mbi urë. Ahere, oh ahere! Si t'a përshkruajë penda atë tromarë[1], gjith' atë llahtarë që na panë sytë? Ishte një tmerr i math kur rëzoheshin kuaj e njerës bashkë prej asaj ure të qemertë aqe të lartë brenda në lumë. S'ka të treguar potera e bërtitjet e atyre të shkretëve sufarinj[2] që po vriteshin aqe mizorisht prej gjyleve të rënda greke! U zbrazë më shumë se 200 topa të vogla e të mbëdha mbi ata; u çart ura në disa pjesë; me një herë lumi u skuq, u bë gjak; kush e di se sa u vranë të tjerë nga plumbat e infanterisë greke që qëllonin nga buz' e lumit edhe sa e sa të tjerë u vranë a u shtypnë në ritiratën e asaj kavalerije! Ajo ishte një marrëzi që ju kushtoj defaitin[3] ushtrisë turke. Pas një or' e gjysmë lufte prani beteja nga të dyja anët. Po nga an' e Prevezës vazhdonte akoma lufta. Të nesërmet për çudi nuk shihej njeri m'at'anë; asnjë feste turke, asgjëkundi. Dërguan një patrujë gjurmuese dhe pas 2 orë kthеheshe këtej, tuke dhënë sigurime se m'at an' s'kishte njeri. Kështu si u sigurua xheneralli ynë jep urdhër edhe marshojnë 2 regjimente mbi Filipiadhën e Llurosin. Shkova edhe unë tuke shoqëruar dy oficerë të Shtabit Madhor, dhe mbasdite zumë vënt në Filipiadhë.

Vëndasit e Filipiadhës, të enthusiasur se u libruan nga zgjedha turke filluan t'ju bijnë këmbanavet. Një prift plak gati u prish mëntsh nga gëzimi; ment tërbohej. Një shoku im i shkruante një mikut të tij në Athinë, tuke filluar : "Filipias Heleniqi", Filipiadha greke. I thom tuke qeshur : "mos u ngut akoma, se s'dihet fundi". Qysh, thotë, akoma s'beson ti se Pashkët e Mbëdha do t'i kremtojmë në Janinë? E pashë një herë në sy edhe s'i fola gjë, se munt të ngatërroheshe kuvendi dhe kush e di si n'a delte pastaj. Ndejmë ndo një javë në Filipiadhë, kurse një regjiment nënë Kumunduron eci përpara. Tjetrën dit kishte zaptuar Anogjin dhe të 5 puset.

Turqit ishin larguar nga malet e Bizhunit dhe nga Kumçadhesi. Kumundurua si i zaptoj ata vënde përhapi ushtrinë nga bigllat e të 5 puseve. Por një natë ushtarët Labër të ordusë[4] XI që ishin m'at'anë ç'bëjnë? Bëjnë një lodrë nga ato më dinaket e më strategjiket që vetëm ata e kanë në thua. Që t'i gënjejnë Grekët e t'i venë në gjumë e që të mundin t'a zaptojnë kodrën strategjike të Anogjit, kodrën 203 si e quanin, morën disa këmborë dhenjsh dhe duke ecur si bagëtia me duar e me këmbë, e tuke blegëritur si berra, ngjiteshin dal-ngadalë kodrën. Ishte natë e terët. Santinellat[5] greke kujtonin se po ngjitej një kope dhensh dhe s'e vunë re djallëzinë që po lozesh në kurrizin e tyre. Ushtarët Labër me dyfegjet ndër duar ndo nj'a 5-600 shpirt kështu tuke ngjitur pllajën u afruan gjer 100 çape lark çadërave greke, ku ushtarët grekë flinin gjumin e parë. Ahere Labrit tuke pasur disa kapitana nga Borshi e nga Progonati çohen përpjetë dhe ja u japin me rebesh. Grekët sa të ngrihen nga gjumi u gjetnë me një herë të qarkuar dhe s'patnë as kohë të rëmbejnë pushkët. Labrit ahere i grinë herë me pushkat e tyre mauzere e herë me bajonetat. Për mbi 700 ranë të vrarë e të plagosur atë natë. Disa të tjerë kanë dashur të hidhen prej mureve të një mulliri me erë të shembur dhe u dërmuan, u bënë copë. Më shumë se 400 vetë u zunë robër. U vranë edhe mjaft oficerë dhe ushtria greke filloj të kthehet pa rregull.

[1] tromar ose tromaksem = trembem, tmerrohem (H. K.)
[2] süvari = kalorës (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)
[3] défaits = disfatë, i mundur (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)
[4] ordu = ushtria (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[5] sentinella = roje (Italisht H. K.)

Pas 10 orë rrugë të zorshme arrinë në bregun Kumxhallës ku u stalluan. Nga mezi i natës çohen prapë e fillojnë të marrin rrugën e hanit vjetër të Karvasarasë me qëllim që të bashkoheshin me bataljonet 5, 6 edhe 8 të Regjimentit të II e kështu të ktheheshin bashkërisht në Nartë. Për fat stërditin dy barinj që po vinin nga poshtë tuke ecur rrugën e ngushtë të Kumxhadheses

Grekërit shëkonin dritra përhapur nëpër fushën dhe kujtonin se aty do të jishin bataljonet në fjalë. Po kur pyesin barinjtë dhe ata ju thanë se ata dritra janë në çadëret e Turqve që kishin ardhur që nga ana e Meçovës, ushtrija greke e humbi pusullën dhe shpejt jepet urdhër të kthehen prapë nga ardhë, se për fill do binin robër ne Turqit pa dashur! Kaqe bukur i dinte Stabi Madhor Grek atyo vënde që i rivendikonte.

E marrim vesh edhe ne në Filipiadhë edhe kthehemi prapë në Nartë, tue ju a lënë prapë Turqve vëndet që ju kishim zaptuar para një javet.

Nga an' e Thessalisë Etëhem Pasha kishte zaptuar gati gjithë Thesalinë dhe po zbriste në Lame.

Ahere mblidhet shpejt Parlamenti, rëzon Qeverin' e Delijanit dhe vjen Rali si kryeministër, i cili ju ra ndër këmbë Fuqive të Mbëdha që të shpëtonin Greqinë.

Kështu u deklarua armëpushimi dhe lufta pushoj. Ahere kemi pasur një rast të bukur të kalojmë një jetë ta paharuar me shokët e tjerë oficerë.

Oficerët t'anë haruan maskarallëkun që pësuan, që u bënë qesharakë në sytë e Europës, dhe sikur s'ishin ata që 2 dit përpara se të deklarohej armëpushimi u trempnë nga një lëvizje turqsh afër katundit Strivina dhe të panikosur iknin si ljepurit, tuke flakur armë e shpata e mantora e kapella e ç'kishin edhe tuke marrë frymën në Menith 3 orë lark Nartës në bregun e gjirit Ambraqik, me një herë u krekuan dhe gjëmoj kënga e glendi an' e kant rangjeve.

Pas ca ditsh n'a thirë në gosti oficerët turq m'at'an' urës së Nartës. U nismë dhe vamë nj'a 20 oficerë prej nesh. Oficerët turq na pritnë shumë mirë. Po ata oficerë s'ishin turq, ishin Shqiptarë, disa nga fshatrat e Korçës, disa nga kazaja e Beratit dhe e Vlorës dhe disa nga Gjirokastra. Të gjithë shqiptarë. Po edhe ne në ushtri kishim shumë shqiptar' prej fshatrave të Athinës e të Korinthit, që flasin të gjithë shqip.

Disa prej oficerëve të Turqisë ishin mjaft fisnikë e të qytetëruar, gjithë farë sojesh armë. Na kishin shtruar tryezat bukur dhe n'a kishin edhe dy deshinj të pjekur etj. etj.

Sado që flismin greqisht me oficerët e Turqisë, por ata në mes të tyre flisnin kurdoherë gjuhën e tyre, shqip. Unë kur dëgjova dialektin toskë aqe të kjartë prej atyre edhe më fort idiomën e veçantë Korçare u enthusiasa fort; zembre ment më fluturonte. Ahere kujtoja fatkeqësinë e kombit t'onë që nga padijenija e fanatisma arrin gjer atje sa të na përdorin njëri e tjetri; Turku e Greku, Shqiptarë ne të luftojmë shoqi shoqin, i vëllai të vëllanë, të thyejmë krerët, të vdesim, të shuhemi për hesap të tjetrit, të një të huaji! Oh! Sa turp, sa turp! Ah, fetë, këto fet' e mallkuara ç'farë dëm na bënë! N'a përçanë, na larguan nga shoqi shoqin edhe sot luftojmë vëllaj vëllanë për të huajt, turp!

Këto mendonja dhe s'm'u durua. U afrova pranë ca oficerëve që m'u duk se do ishin nga qarku i Korçës dhe ju fola shqip, Korçarçe. Ata me një herë hidhen përpjetë nga gëzimi. Më shohin sy ndër sy dhe çuditen si një oficer me uniformë e stemë greke po ju flet shqip, edhe shqip Korçarçe thjesht.

Me një herë dhamë duart shoqi-shoqit, ata sidomos m'u hodhë edhe për qafe njëri pas tjetrit më shtërngonin dhe më dukeshe akoma se edhe sikur qanin. Të mjerët! Ata të tre që ju dhashë të njohur ishin njëri prej Zëmblakut të Korçës, tjetër prej Babanit të Devollit edhe i treti.... . . nga Floqi im! Kur ju tregova se edhe unë jam nga Korça i akcilit edhe se gjysh shtërgjyshrit e mij si dhe babaj ishim nga Floqi se edhe vetë kisha mbiemrin Floqi, ata kaqe janë habitur sa m'u hodhë rishtas për qafe. Oficeri nga Floqi që quhej Myslim dhe ishte Bolbais (kall-agasi) do me thënë kapiten i klasit I, më thotë se është i biri i një farë Shaqirit, që kishte qenë shok me babanë t'em edhe vinin për gjah nga hera, bile edhe ky Myslimi e

njihte mirë t'em atë dhe shtëpija e jona dhe e tyrja në Floq ishin afër e afër. Kështu shtruam një bashkëfjalim të këndëshëm me ata sa s'nginjeshim dot. Më rekomanduan po thuaj se me të gjithë të tjerët oficerë dhe shkuam shumë mirë gjithë ditën.

Si arthmë në pozitat t'ona, pas 3 dit i thirmë edhe ne edhe ardhë, po mjerisht të tjera fytyra e jo ata që na thirë, me gjithë që edhe prej këtyre që thirmë ishin disa shqiptarë.

Pas një muaji mbaroj krejt lufta dhe u deklarua paqja. Ne u kthyem si kush në shtëpi të vet, kështu që edhe unë u ktheva në Karvasarâ dhe fillova punën si më parë.

Viti tjetër ishte viti i katërtë. Duhesh do e mos të vinja në Athinë e të qëndronja gjithë motin në Universitet tuke vazhduar msimet e tuke u pregatitur të jap provime Doktorsisë. Kështu ardhi Tetori e u nisa për në Athinë.

Këtë mot që duheshe do e mos të isha në Athinë, puna e t'im 'eti ishte pakësuar mjaft nga shkaku i luftës, po edhe zyra ime nuk ecte si më parë. Si vajta në Athinë shoku im që mbante zyrën në Karvasara e la për gjithënjë zyrën se shkoj në Rumani ku u martua e e muar dhëndër brenda, se i vjehri i tij Kacan nga Janina kishte një çupë të fillme. Kështu zyra ime në Karvasarâ u mbyll dhe mbassi im'atë s'gjeti ndo një avokat tjetër t'a installonte në atë zyrë ose s'deshin të vinin askushi, u shpërndanë edhe klientët e mij.

Këjo ishte një poter' e madhe për mua dhe një mjerim për gjithë shtëpinë. Im'atë ishte shtërnguar tani të më mbante edhe mua edhe t'ëm vëlla në gjymnazin e Mesollonjës, pastaj edhe shtëpinë. Çështja ishte delikate. Pozita e jonë ishte tepër kritike. Si të bënim? Të mbetesha unë në Karvasarâ? Po unë kisha tani motin e fundit dhe lipsej t'a mbaronja e të mblidhnja mëndjen. Të nxirrnim nga gjymnazi t'im vëlla? Edhe kjo ishte mëkat, pastaj sa para bënte kjo e dyta. Po pse ta bënim?

Im'atë më thotë të qëndronj atë mot në Karvasara, pa vinja motin tjetër. Po edhe kjo ishte gjë e keqe për mua se isha i pregatitur mirë. Un' e mblodha mëndjen dhe ika me vetëm 600 dhrahmi përsipër. I thashë t'im 'eti që për 3 muaj s'desha të më dërgojë gjë.

Vete në Athinë dhe le shokun në zyrë, i cili, si thashë, mbas dy muajsh, m'a mbylli zyrën. Unë kur e msova këtë më ra pika, po ç'të bënja? Të kthehesha hall, të rinja në Athinë hall! U mendova andej u mendova këtej dhe s'dinja si të bënj, ku të gjenj të holla që të mbahem. Duhet t'i bënja derman vetes këtë radhë pa tjetër. E mbaj ment, kam hequr shumë siklet atë mot.

Nga janari m'u sosnë edhe të hollat. Në gazetat s'gjenja dot punë si tjetër herë, se ishin ngjallur shumë të tjerë si mua të cilët punonin për bukë ngoje. Si të bëj? kujt t'i kërkoj? I shkruanja e prapë i shkruaja babajt të gjorë dhe ajy i mjeri kishte s'kishte hua merte e më dërgonte, po më vinte keq edhe për atë, më këputej shpirti se ishte 60 e sa vjetsh tani e priste nga mua. Posi t'ja bëjmë se kështu më ra halli?

Po, kur thonë, në një dëshpërim e sipër, atje ku koklavitet puna, që vetëm shpata e Aleksandrit të math munt t'a zgjidhë, vjen, si thotë edhe tragjediani Grek Sofokles-i, Perëndija nga machina (Deus ex machina). Do të tregonj, pra, një ndollinë të bukur, e cila, pa pandehur më nxori në selamet.

Në shtëpi që rinja në motin e IV, banonim në rrugën "Lykavite" Nr. 40 bashkë me një mikun t'em z. Perikli Simetta nga Lefkadha, i cili atë mot mbaronte edhe ajy fakultetin e Mjeksisë. Ishte një djalë xhevahir prej oxhaku, vërsniku jem dhe shkonim mirë.

E zonj' e shtëpisë që rinim ishte një grindaveckë, që mos e pyet hallin. Ziheshe me robat e saj kur s'kish të ziheshe me njeri tjetër. Nga ana tjetër gjithë në atë shtëpi banonte edhe një tjetër shoku im Styljano Thanua, qe edhe ky student i drejtësisë po pregatitej për provime si mua. Ky ish i martuar dhe rinte më dy oda të tjera n' avllinë t'onë bashkë me të shoqen, një gocë nevrasthenike, hysterike dhe ç'të duash tjetër. Kishte edhe t'ëmën, një tjetër typ noprani, një sharrëse, një magjistare, me një fjalë një shtrigane.

S'kish dit të mos ziheshe me të dyja këto e zonj' e shtëpisë, herë për këmishët kur i lanin, ose kur i ndenin për të tharë, herë për plerat dhe ku mbanj ment se ç'farë. Në kafgan'[1] e tyre përzjeheshe shumë herë edhe dhëndri i shtriganes Styljanoja Stelua dikur edhe kunati i tij një serxhent kavalerije[2] kur takonte atje, e ahere kafyaja merte formë të përgjithëshme, gjer sa përzjeheshin edhe i shoqi dhe të tri çupat e së zonjës shtëpisë edhe më në funt edhe ne të dy me Periklinë, shokun t'em dhe disa gra të tjera nga mëhalla edhe furxhiu që e kishim për bri.

Kishim gjetur për njëment belanë nga këto gala të urgjisura që s'na lini rehat në hallin t'onë. S'kishte dit të mos ziheshin. Një dit u kërleshnë në mes të tyre, u rrahnë, u shqepnë, dhe më së fundi e vjehr' e Stylos të rëmben një garbe[3] me lule e t'ja thyen në kokë të zonjës së shtëpisë, e cila ra për dhe e zalisur! Këto edhe shumë të tjera ngjisnin në atë shtëpi ku banonim edhe ne.

Një dit u mendova: A nuk bënj një komedi në bazë të këtyre ngjarjeve? Themë më të bukur s' mundnja të gjenja.

Ja fillova dhe brenda një javet e kisha mbaruar. E kisha përshkruar me sa hollësi munda karakterin e gruas nervoze, e gruas nevrasthenike, e gruas hysterike. Kisha kurdisur mirë hypothezën; s'kisha nevoja të shtonja gjë, se ishin mjaft ato që kisha parë. I kisha ndarë rolet mirë dhe kisha futur edhe veten t'ime brenda bashkë me shokun Periklinë. Komedinë e kisha titulluar "Vjehra", se rolin principal e loste këtu e vjehra e Stelos, pastaj vinte e shoq' e Stelos, e zonj' e shtëpis e kështu me radhë.

Një dit ku po e kisha në dorë e e ndreqnja dorëshkrimin më viziton një mik, student edh' ajy i Drejtësisë nga Mesollonja. Unë zura t'a fsheh mos t'a shihte, se veç shokut Perikliut s'e kishte parë njeri tjetër. Ky miku Mesollongjit, kur më pa që e mshihnja dorëshkrimin, zu të ma rëmbente e m'u lut tepër t'ja jap t'a shëkonjë! Ç't'a shohsh, i thom, s'është gjë, një komedi është origjinale; kam dashur të zbavit veten prej këtij sikletit që kemi. Komedi origjinale? më thotë, po ahere aman m'a jep t'a shoh, s'është punë të mos jet' e mirë se ti ke mjaft një hymorizmë për sipër dhe di ç'do kesh bërë.

Ja dhashë dhe filloj t'a studjojë. I dhe më tha ta shtyp se do të fitonj. Ishte me 3 akte. Lermë, në daç zotin, i thom, ne s'kemi bukë të hamë këtu, ti kërkon të të shtypnin edhe libra? Ahere, më thotë, m'a le mua për sipër të fjalosem me ndo një shtëpi botonjëse se mos e sheshim gjëkundi? Eshtë e mundur, i thom? Pse jo, thotë, kjo më duket mua një komedi e mirë. Se mos ato që shohim nga sqenat janë më të mira. Ahere mere, i thom. Edhe ja dhashë në besë me kushtin që të mos i thotë njeriut se e kisha trajtuar unë mbassi nuk figuronte as mbi sipërfaqen embri i auktorit.

Miku jem vjen prapë tek meje. Më thotë se libri u pëlqye prej shtëpisë botonjëse "Fexi" edhe gjer sa munt t'shishnim titullin dhe të drejtën që t'a botonte.

U mendova ca minuta dhe s'dinja për sa t'i thesha. T'i kërkojmë, thotë ndo një mijë dhrahmi? M'u duk si një shumë e exazheruar këjo. I thom: S'të duken shumë kaqe pare? Mbesonj do t'na i japin, më thotë. Ahere bëj si të duash, i përgjigjem. Miku im shkoj prapë dhe ditën tjetër vjen shumë i gëzuar. E kishte shitur për 1. 500 dhrahmi dhe ardhi të më thotë të shkonj shpejt e të firmonj kontratën me blerësin.

M'u duk si kur u linda. Nuk e besonja akoma, po miku im Leonidha Kostaqi, se ashtu quhej, ishte njeri serioz e s'munt të talleshe me mua. Me gjith' atë e pyeta disa herë akoma dhe si u sigurova që ishte e vërtetë, u ngrita e shkuam bashkë në zyrën e drejtorit të shtëpisë tregtare botonjëse, i cili na bëri shumë komplimenta, nënëshkruam bashkë me atë kontratën përkatëse dhe më numuroj të hollat 1. 500 dhrahmi. Si ndejmë ndo nj'a 10 minuta akoma, e salutuam z. Fexi dhe dualla jashtë. Oh sa s'refehet gëzimi im i asaj dite.

[1] kavga = grindje (përkthyer me google nga greqishtja (H. K.)
[2] serxhent kavalerie = rreshter kalorësie (H. K.)
[3] garbe = qyp a poçe me grykë të thyer që përdoret pë mbjellë lule etj. (H. K.)

Leonidha, kur po shkonim rrugës, më thotë, si me shaka: Mua s'do më falësh gjë për komisionar? I them, ke të drejtë mer ç'të duash. Edhe i zgjata dorën me disa qindsha Dhrahmish që nxora nga xhepi im. Ajy qeshi dhe nuk desh t'i pranonte. Po unë, ahere i sillem e i thom, se e udhës është që mbassi mori më shumë se 1000 dhrahmi që i caktova si çmimin e librit, tepricën 500 dhrahmi duhej të paktën ta ndanim në mes. Leonidha mbassi prapë s'deshi do e mos i mora prap të hollat. Po pas 3 ditësh bëra edhe unë si bëri për mua Vangjel Ekonomi i Piresë tjetër herë, do me thënë i bëra një palë roba që kushtuan 220 dhrahmi dhe mbet shumë i kënaqur i miri Leonidha.

Kështu pra u zgjidh kjo problem' e rëndë ekonomike për mua që më shpëtonj nga shumë halle se lava borxhet që kisha, bleva libra e sende tjera që më duheshin dhe prapë më tepruan 400 dhrahmi, që munt të shkonja rehat me ato nj'a dy muaj. Kam uruar të vjehrën e Stelos e të shoqen e tij e të zonjën e shtëpisë, se të mos ishin ato hysterike unë do mos bënja kurrë atë komedi, e cila ka edhe konsenda që do t'i tregonj më poshtë. Përveç këtyre kisha shpëtuar edhe nga halli i math i krizës për mua.

Ca miq që muar vesh më vonë se ja kisha shitur Fexit aqe lirë atë libër prej 80 faqesh, më qortuan. Të isha mbajtur akoma do kisha marrë edhe 4000 dhrahmi të tjera.

Po kjo komedi ka edhe passime, ka një episod mjaft për të qeshur.

Kishte shkuar ndo një muaj qysh ahere, kur një natë më fton miku Stelua t'i shoqeronja në theatro "Neapolis", ku do jepej për të parën herë një komedi e re prej grupit theatral me famë "Pantopullos". Unë konsentova[1] t'i shoqëronj, mbassi vinin familjarisht dhe kështu u pregatita dhe ora më 8 mbrëmanet shkuam në theatro Stelua me të shoqen, e vjehra shtrigonja edhe unë. Stelua pagoj biletat edhe zumë 4 vënde të mira në parterin. Komedia sillte po atë embër që sillte edhe komedia ime; por mbassi s'na dhanë ndo një program nuk dinim sa rolle janë, si dhe rollin e gjithsecilit.

Kur filloj akti i parë, në krye më dukej sikur s'ishte vepra ime, por dal nga dalë zu po zhvillohej mirë akti dhe ahere vëreja fjalët që flisnin auktorët e që çkëmbenin, se ishin gjith'ato fjalë që kisha përdorur unë. E pashë pra që ishte komedia ime, po s'fola gjë, se 4 prej rolistët e komedisë, do me thënë Steljon, të shoqen e të vjehrën edhe veten time i kisha aty pranë edhe zoti n'a ruajtë sikur të mertë vesh e vjehr' e Stelos se ishte vet' ajo protagoniste në atë komedi! Vaj halli ç'munt të bëhej . Ishte gati t'a vinte me gjithë theatrinë e me gjithë popullin që kish ardhur të shijojë komedinë. Sa për mua? Unë do kisha rënë i vdekur që me bataren e parë të fjalëve saj të jashtarregullshme, me të cilat do më qëllonte. Po akti ecte bukur; rolistët losnin me nam rolet e veta, populli mbante hijet e veta me dorë së qeshuri se sado i thatë të jeta objekti i veprës kur rolistët e lozin me tërë mjeshtrin' e artit munt të thuash se është një kryevepër. Unë, them të drejtën, kurrë s'munt t'a recitonja tekstin në atë mënyrë që e exekutonte grupi i Pantopulit, burra e gra, me gjithë që isha vetë auktori i veprës.

Stelua me gruan e të vjehrën po e verejnin me një vemendje të aftë e kujdesore komedinë. Dikur kthehet e më thot' e shoq' e Stelos: z. Floqi s'të duket sikur je në avullinë t'onë edhe sheh një prej atyre sqenave të përditshme që ngjasin midis nesh? Unë u theka në zembër e kafshova buzën. Po, i them, po zonja Marigo, ashtu më duket edhe mua, edhe po shterngonja dhëmbët se mos qesh.

Kur mbaroj akti i parë kaqe mbeti i kënaqur populli, sa duartrokiti me sa fuqi kish dhe i thiri disa herë amatorët mbi sqenë që t'i aplaudisonjë[2]. Një grumbull po kërkonte të çfaqet në sqenë auktori i komedisë, dhe mbassi auktori nuk po shihej gjëkundi, populli po insistonte duke kërkuar auktorin, gjer sa dolli në sqenë impresari i theatros e i deklaroj popullit se auktori i asaj komedie s'dihet akoma se kush është, edhe kështu heshti populli.

Kur fillon akti i dytë shohim ca sqena fort skandalloze, shumë më skandalloze se sa i kisha përshkruar unë vetë, si auktor. Si e pashë se do t'a kuptonin më së fundi edhe në fort e

[1] konsentova = dhashë pëlqimin (H. K.)
[2] aplaudisonjë = duartrokasin (H. K.)

shoqja dhe e vjehra e Stelos shtrigona Dermanina (se ashtu e thojshin) , u ngrita me maryfet e u largova tuke gjetur nje pretekst se do piqesha me ca shokë e tuke ju kërkuar ndjesë. Kështu u shmanga dhe vajta të rri nga fundi i parferit. Por tuke kaluar më panë nj'a dy djaj shokë, të cilët e dinin se e kisha përpiluar unë atë komedi. Më bëjnë me shenjë dhe afrohem e ri pranë tyre se kishte edhe vënt. Ahere më thanë këta që do t'a tregojshin se kush ishte auktori, po mbassi s'më shihnin gjëkundi atje nuk e bënë fjalë. Iu thom bëtë mirë se këtu brenda gjinden edhe disa prej protagonistëve të vërtetë të komedisë e do n'a ngjiste ndo një aksident se Dermanina nuk ngrihte asij hollësirash.

Po një prej shokëve insistonte se është mëkat të bjerrë këtë okazjon, mbassi do merret vesh më në funt edhe pse të mos përfitonja të delnja në sqenë, ku munt të mernja edhe ndo një shpërblim, ose bravurë tjetër. Unë prapë i qetsonja se s'është nevoja. Po kur mbaroj edhe akti i dytë që Stelua e kompania bella e muar vesh se ishte gjith' ajo komedi që e kishin lojtur ata edhe më fort kur e panë se edhe rolistja që represantonte Dermaninën ja ngjeshi me garben me lule kokës asaj protagonist tjetër që përfaqësonte të zonjën e shtëpisë s'onë, ahere edhe un' e pashë hollë edhe preferova më mirë të mos jem atje se sa të çfaqem dhe mbi sqenë. Po kush i mbante ato të mallkuar, që u ngrit njëri e i tha impresarit se "auktori gjindet aty në theatro" . Vjen ahere impresari vetë e më lutet fort të shkonj me atë në sqenë. Unë s'desha për të madhe punë të çfaqesha, por mbassi u përhap çështja dhe e muar vesh gjith' ata që kishim afër, m'u vardisnë burra e gra që të dal me doemos. Impresari më thotë se , me qenë se komedia u pa se ka sukses të math do t'i bënja nder të math edhe vetes s'ime edhe atij edhe grupit të rolistëve. Ahere pashë ç'pashë u ngrita edhe qëndrova me theatrinët brenda në pallkosqenik gjer sa afroj akti III.

Kur do tërhiqej perdhja, ose para se të ngrihej, del impresari en grande tenue[1] dhe i thotë popullit: "Zonja zotrinj të ndershëm, lumërisht auktorin e komedisë që kërkonit e kemi këtu, në dëshironi munt t'ju a paraqit". Brohori të mbëdha gjëmuan an' e kant të theatros dhe zërra e duartrokitje mbushnë hapësirën. "Të dalë shpejt auktori", "Jashtë auktori", "Auktori shpejt" etj. etj.

Impresari më bëri me shenjë të afrohem në mes të sqenës përpara suflerit, edhe me që zura po vërtitesha e s'dinja si të bënja, impresari vjen më mer për dore dhe vijmë që të dy në mes të sqenës përpara rideausë[2] të unjur. "Zoti Kristo Floqi" thotë impresari dhe i përulet popullit.

S'munt të rëfenj dot se ç'u bë atë ças. Trokasin aqe shumë duart e bërtasin aqe fort sa të shurdhojnë "Bravo, bravo..... ,.... (shkruar greqisht H. K.), rroft auktori" edhe disa të tjerë që më njihnin më thërisnin me embër, pa marrë vesht unë se cilët ishin ata. Si u përula pak zakonisht u tërhoqa bashkë me impresarin, pa mundur të hap as gojën, me gjithë që tjetër herë kisha folur përpara populli dy-tre fijsh më tepër se ajy që ish në theatro, ku munt të ish më tepër se 500 shpirt. Brohorit' e tyre dëgjoheshin edhe si u futmë në parasqenat (coulisses).

Impresari më dorzoj me një zarf 500 dhrahmi. Ishte një llokume kjo për mua që s'kishte më e ëmbël. Mbarova me ato kush e di sa punë.

Akti III u lojt edhe më mirë. Ajy i vuri vulën gjithë komedisë. Kryetari i rolistëve Pantopullos, komiku që s'e kaloj as një artist tjetër gjer më sot në Greqi, i cili loste në atë komedi rolin e një furxhiu kopuk që kishim në mëhallë e që përzjeheshe në kafganë e atyre dosave, Pantopuli, po thom, bëri njerëzine e u fiknë gazit. Mbanin hijet me dorë, qanin! Ësht' e ditur se shtonte edhe shumë fjalë e fraze të tija ndërkohë. Gjithashtu të gjithë lojtnë shumë mirë rolet e tyre.

Kështu shkoj ajo natë. Po kur vajta në shtëpi u nguta të hyj shpejt në dhomën t' ime që të mos vinte të më gjente e vjehr' e Stelios me të shoqen. Hyra brenda, ula perdhet edhe shova

[1] en grande tenue = me veshje të plotë, ndoshta kuptimi eshte "me gaz", e " me hare" (H. K.)

[2] rideaus = perde (perkthyer nga frengjishtja me google H. K.)

dritën. U çvesha shpejt dhe rashë se bashkëndenjësi im Perikliu kishte shkuar në Lefkadhë ato dit dhe isha vetëm në shtëpi.

Kur mendonja Dermaninën ( të vjehrën e Stelios) më zinin hethet. Si do t'i dilnja përpara? Kush e di sa do ishte fyer. Po e shoqja e Stelios, Marigoja? Medet tjetër kulçedër kjo. Ku do futesha! po, sikur të ishte zembruar edhe Stelua? Po ahere? Gjithë këto po më shtypnin si cfialt njëra pas tjetrës. Nuk shkuan edhe disa minuta që kur rashë në robat, kur dëgjova këmbë që po ngjiteshin në taracën time se kisha një taracë të vogël përpara portës. I ndjeva që u arritnë. Kuptova që do të ishin që të tre Stelua, Marigoja, Dermanina. Folë diç'ka ndërmjet tyre. Unë koqe-mel[1] brenda nënë robat e shtratit. Stelua thotë se do mos kisha ardhur akoma në shtëpi, e shoqja theshte që as që do vinjë Floqi sonte, kush e di se ku ja kanë shtruar me miqtë, mbas atij gëzimi që mori në theatro. Vetëm ajo shtriga Dermanina insistonte se duhet të isha brenda në odë dhe s'ndaheshe. Trokiti nj'a 2 herë. Unë iç. Prapë troket. Unë po duronj. Pres të më stolisnjë me gjësendi të shame të trasha prej atyre që s'i ngrehin as qerret e Bashkisë, po as këjo. Prapë dëgjoj Stelion që po bisedonin me të shoqen: More si u bë, sa të bukur e kishte kurdisur djalli? Floqi të mos bëjë komedi të bukur? theshte Marigoja. More s'e kam këtu, ja priste Dermanina, po kur të mos ja çkulnja mustaqet fije-fije! I tillë, i atillë më një plakë kërkon të tallet? Unë po dëgjonja që brenda edhe po mendohesha ç'më priste të nersërmet. Eja të shkojmë, i thosh e bija. S'ikij që këtej, ja priste e ëma. S'los që këtu gjer sa të vinjë maskaraj! Edhe s'loste për një ment Dermanina.

Shkoj gjysmë ore që s'dëgjohej gjë. Kujtova se po e kish thyer qafën edhe Dermanina. Po që të jem më i sigurt u afrova nga dalë dhe tërhoqa pak perdhen e penxheres, po kur e pashë magjistaren që po rinte si ndo një hije aty pranë cepit e mora vesht se ajo desh të marrë shpërblim, që s'po më ndaheshe.

E lash' atje gjer sa e preu të ftohtit se ish edhe muaji i Janarit e bënte shumë të ftohtë.

Të nesërmet zgjohem herët dhe ikinj nga shtëpia pa larë sytë akoma. Kështu s'më kuptoj njeri. Kur ardhi nata prapë ardha nga mez' i natës kur flinte Dermanina. Kjo gjë vazhdoj nj'a 4-5 ditt e nett, gjer sa një herë më gjojti e më zuri. Unë thashë se kush e di ç'do më bënte. Po desh Dialli dhe ishte zbutur mjaft se ja kishte mbushur mëndjen Stelua se .... . . vetëm njerëzit e mbëdhenj përmenden nëpër theatrot. Edhe mbassi Dermanina ishte një shtrigane e dëgjuar që s'e kish shoqen, ndofta gjeti ngushëllim ne fjalët e Steljos. Prandaj kur më pa u kufizua vetëm në fjalët e buta për atë: "maskara", "palo njeri" etj. etj. e kështu mbassi kish një garbe tjetër me lule të m'a thyente kryet, më mori brenda në odë të saj edhe më gostiti edhe një kafe. Kështu mori funt kjo komedi e dytë, pasojë e komedisë së parë.

Me gjithë që kujtonja se do mos kisha nevojë për shumë kohë për të holla se kisha mjaft, nuk di edhe unë se si ardhi puna kështu që nga fundi i Frorit, në kohën e Karnivaleve të mbetemi pa të holla edhe unë edhe shoku im Perikliu. Bëra ca roba më tepër, bleva edhe disa libra më shumë, i lidha me ar të gjitha librat shqenzore bëra edhe disa honordallekë të tjera edhe ngela kështu si peshku pa ujë. Po edhe Perikliu pësoj gjithë atë sëmundje që pësova dhe unë.

I kisha shkruar t'im 'eti të më dërgonte urgjent ndo nj'a 100 dhrahmi; po edhe Perikliu gjithashtu i kish dërguar t'et. Im 'atë më kish dërguar 75dhrahmi me një tregtar nga Karvasaraja, po ajy torullaku kishte humbur letrën që i kishte dhënë im'atë për mua e kështu nuk dinte adresën t'ime të vinte të m'i jepte. Nga ana tjetër edhe Perikliu po priste dita-ditën para nga i ati dhe gjer ditën e djelë të fundit të Karnivaleve s'kishte marrë gjë.

U gdhi edhe e Djela e Karnivaleve. U zgjuam në mëngjes, u lamë dhe vamë të pimë nga një qumësht si mbas zakonit, por se as njëri as tjetri s'kishim fen' e metelikut për sipër. Ishte e para herë që edhe unë edhe ajy mbetmë pa të holla. Kur vamë në qumështoren "Penteli" për fat të keq e gjetmë mbyllur. Duruam gjer më drekë. Cigare s'kishim; duruam edhe pa cigare.

[1] koqe-mel = i bërë grusht, i mbledhur skrupull (H. K.)

Ardhi dreka. Shkojmë te restauranti jynë që hanim bukë te Barbantoni që munt të hanim edhe veresije. Mjerisht edhe ajy mbyllur. Vërtitemi andej këtej mos gjejmë njeri, t'i marin ndo një pare. Mezi gjetmë një kunduraxhi, miku i Perikliut, e n'a dha 5 dhrahmi hua. I ndamë bashkë me Periklinë. Mua më ra ndër mënt Vangjel Ekonomi në Pire, që kisha kohë t'a shoh e më kish zënë malli shumë. E lashë Perikliun të vrasë veten me të 2 e 1/2 dhrahmitë edhe vetë u nisa e vajta në Pire, se isha merak të pyes për shëndetin e tij si ishte, me gjithë që ajy duhet të ishte mirë. Arrita në Pire, vete në shtëpi të tij dhe i gjenj më drek' e sipër. O, urdhro, urdhro, Z. Floqi, si u kapnë këto udhë, si na harove kaqe, thotë plaku Ekonomi dhe gjithë redhi. U përshëndoshmë e ndenja, ose më mirë të thom u shtrova se më ishte terur syri, që e kisha të pamsuar nga agjërimi. Ardha, ju thom, të shkonj Karnivalet me ju, mbassi jam lark shtëpisë s'ime. T'ju thesha se kisha më tepër nevojë të shoh sofrën e tyre se sa ata vetë? S'ishte nevoja, e dinja unë vetëm. – Të lumtë këmba, thotë plaku, se ardhe pak vonë. A po ke ngrënë? më thotë. Do e mos duhet të kisha ngrënë se ishte ora 3 po thuaj mes dite. T'ju thesha që kam ngrënë? Do ishte një marzi që s'do më falej kurrë. Miku dy shkopinj nuk ha, ju thom, po dy herë bukë edhe munt të hajë. Do me thënë se kisha ngrënë një herë dhe tashti munt të haja për hatër të tyre!

Ahere shpejt zonja Ekonomi porosit një brizollë dhe një omeletë për mua. Hëngra e piva mirë dhe posa që u ngrys u nisa prapë për në Athinë të shoh ç'bëhet Perikliu i gjori, që e lashë pa bukë, me gjithë që s'deshin të më linin të shkonja zonja Ekonomi. Edhe do kisha bërë mirë të rinja se sa pësova gjith' ato që do tregonj tani më poshtë.

Vinj në Athinë ku mezi e gjenj Periklinë më 6 të natës (ora 18 do me thënë). Ment i zgurdulloheshin sytë nga urija fukarajt; s'ishte msuar të agjëronte. Hë, more, si shkove, më thotë. Birinxhi, i thom. A hëngre, a hëngre? Atë të pyes, pa lëri të tjerat. – Brixolla deri, i thom, e omelette e verë moskato. – Si lum ti, më thotë. Po ti mos derzi? Si më sheh më shkruaj, thotë, të këput shpirtin. Në mos hëngërsha edhe sonte nesër më pregatit një fjalë të mirë funerale. Aman, bre, kaqe u trëmbe. Dynjaja mban trimërat e ti s'duroke dot një dit? – Një dit e durova, thotë, po a durohet edhe nata? Pastaj nesër eshtë prapë e Hëna e madhe që dua s'dua prapë do agjëroj. Pse, i thom. Se do jenë prapë të mbyllura gjithë dyqanet, thotë, s'e kupton? Ah, bre, Perikleto, t'a dinja se s'kishe ngrënë do të të sillnja edhe ty të paktën një brizollë, si atë që hëngra unë! Perikliu i shkretë përpoq buzët dhe i lëpiu nj'a dy herë, pastaj psherëtiti! Po lë brizollën, më thotë, po s'më sillnje sidomos pak bukë , sa të më zinjë me shpirt? Po le ajo që shkoj, më thotë po si t'ia bëjmë hallit sonte! Gjej ndo një myrafet.

U mendova pak. A di ç'bëjmë, i thom? Kam një kushëririn' e t'im 'eti që është kondakshi i ushtrisë dhe i martuar këtu me fëmijë afër tempullit të Thesseusit. Vemë, sikur t'i urojmë, thom, sonte edhe shtrohemi. Vemë, thotë. Edhe një e ja përmbushmë më këmbë për ne xhaxha Kostandini si i thesha unë. Do ishte ndo një gjysmë ore lark nga shtëpia e jonë.

Kur vamë e gjejmë derën mbyllur. Trokasin andej këtej, trokasim disa dyer të tjera gjer sa dalin disa burra e na thanë se z. Kostanti ka 2 dit që shkuan ne e vjehra në Argos në gosti për Karnivalet. Sikur të na kish qëlluar njeri me kobure nuk do na vinte aqe keq, sa kur muarm vesh këtë lajm kaqe të hidhur për ne! – Po tani ç'të bëjmë Perikleto? A vem thotë më një vënt tjetër se kam edhe unë një kumbar këtu e munt t'i kalisemi[1]? – Po vemi, i thom. Vemi edhe fort. A është shumë lark? Ç'pyet në është lark, thotë, këmbët s'i kemi? – I kemi. Ahere avanti.

Nisemi për në Patisjat e jashtme dhe bëmë pothuaj se një orë gjer sa vamë ne shtëpia në fjalë. Troket si i xhindosur Perikliu. Mezi del një plakë. Këtu është kumbarë Gjorgua? – Jo mor bir, i përgjigjet plaka që ish e ëma e Gjorgos. Ka vajtur të glendisë[2] me shokët, që, as unë s'e di se ku, thotë! Medet! Tjetër bombë këjo. Ne, Perikli ku vemi tani? Ku të duash, thotë,

[1] kalisem = i bie më qafë dikujt, i qendroj në zverk, i ngec në shpinë (H. K.)

[2] glendis (γλέντια) = festoj, bëj festë (përkthyer nga greqishtja me google H. K.)

vemi në daç të vdesim. Kurajo, bre teknefes[1], i përgjigjem, u trëmbe me kaqe? Ah, thotë, por edhe unë sikur të kisha në bark një brizollë si atë tënden, nuk do ankohesha kështu! Edhe filluam të kthehemi më këmbë. Perikli, bre! Lepe. Po si kështu prapë më këmbë do kthehemi? Ne mezi arthmë këtu. A i hipim tranvayt? ke para, më thotë. Kam 50 centim. Po ty s'të sosin as për vete. Kish ahere një dhrahmi bileta gjer në sheshin "Omonia". Na dy dhrahmi, thotë, që na dha ajy kundraxhiu sot dhe paguaj tramin. Kështu kemi secili nga 50 centim. Hipmë në tram dhe nxjer i jap një cigare se kisha një kuti të tërë se kisha haruar t'i jap të ngratit. Bre, e gjeç nga Perëndia, thotë, paske cigare e s'po më jep? M'u hoth për qafe e më puthi. Ti më shpëtove, thotë, më ngushëllove fort me këto cigare. Rrrofsh, bravo edhe prapë më zinte për qafe.

Shkurt, arthmë prapë në shtëpi e po mendoheshim si të bëjmë? Për fat të keq s'ishte as e zonj' e shtëpisë, as Stelua me gratë. Njeri s'kish në shtëpi. Të gjithë ishin mbledhur me miqt' e fisin e tyre për Karnivalet.

Befas Perikliut i vjen një mendim, sikurse një frymë e shenteruar. U hoth për një herë përpjetë. A e di ç'do bëjmë, thotë? Do bëjmë një gjë që t'a mbajmë mënt për gjithë jetën. Do marim, pason Perikliu, ti flauton dhe unë qitharën. Do dalim jashtë e do lozim ç'turlish copra prej atyre që dijmë; do bëhemi trubadûrë[2] dhe do gledisim si kavalierë. A të pëlqen? U bëftë si thua, i thom. Amin!

Marim secili instrumentin e vet dhe bëjmë disa exercise dhe që andej zbresim poshtë e marrin për së gjati rrugën e "Solonit". Në funt të rrugës ku piqet me rrugën e "Praksitelit", në ballë shohim një shtëpi tripatesh që llamiste në dritra. Dëgjoheshin piano, mandolinata, këngra. Njerëzia bënin aheng të math në të gjitha apartamentet. Posa u afruam më thotë Perikliu që duhet të qëndrojmë. Qëndruam. Tani kij mëndjen, i thom, mos bëjmë ndo një gabim në të lojtur nga shkaku që bënde shumë ftohtë e mua më dridheshin buzët e Perikliut gishtrat.

I jap me një herë "la"-në Perikliut dhe ajy e kurdis pak qitharën. Kishte qitharën t'ime, një qitharë shumë të bukur si edhe unë një flauto si bemol prej ebenasit. I thom se do marim një marsh të Granadierëve. Filluam. Flautoja dëgjohej extra, se ish edhe koha e kjartë dhe ftohtë. Perikliu më akompanjarte tepër bukur.

Pa mbaruar mirë akoma u mblothnë rotull nesh një grumbull njerëzish, të cilët qëndruan disa hapa lark nesh edhe po dëgjonin atë melodhi aqe të bukur. Vjen edhe patrulla, një oficer me 5-6 ushtarë. Edhe ky n'a afrohet fare afër e po n'a dëgjojnë të gjithë. Grumbulli po shumohet sa po vjen. Sa vijnë atje nuk ikin më. Kur mbaruam n'a brohoritnë me duartrokitje dhe n'a u afruan të n'a përgëzojnë. Disa thrisnin: Da capo, da capo! E përsëritmë edhe një herë për hatër të tyre kaqe ëmbël e kaqe mirë sa populli s'dinte të n'a kënaqte. Ndofta u mblodhë aty mbi 200 shpirt në 10 minuta e sipër dhe as një s'lëviste prej vëndit.

Nga duartrokitjet e shuma ndyen edhe ata që glendiseshin në atë shtëpin' e madhe aristokratike që ish si një pallat. Me një herë shohim kokra e kokra plot burrash, grash e më fort zonjushash. Ne ahere me Perikleton marim "solon e Cavalleria Rusticana" të Mascagnit. Unë atë e losnja pikë, po edhe Perikliu s'binte poshtë. Qetësi e madhe. Populli po pret. Ahere fillonj unë me flauton në një ton andantissimo "o Lola bianca come camicia" etj. dhe Perikliu akompanjon ëmbël fort. Kur e mbaruam u tunt vëndi. Duartrokitje dhe "bravo, bravissimo" dëgjoheshin edhe poshtë edhe lart nga të tri apartimentet "Da capo, da capo, bis, biiiiissss" po bërtasin nga të katër anët. Kthehet nga dalë më thotë Perikliu: "Ore, si e kanë hallin këta, nuk do n'a thresin lart gjer më . . . (nuk lexohet H. K.). Më shoj urija. Duro, i them, se do n'a thresin, po eja të marim edhe një copë tjetër. Populli po pret. Tani po losim serenatën e Faustit "vous qui faites l'endormie"! Oh, sa bukur që vajti, extra, extra. Enthusiasmi i popullit arrin në kulmin. Prapë duartrokitje , e brohori të pa reshtura. Tani do ishin andej e këtej më shumë

[1] teknefes = njeri që ka vështirsi kronike të frymëmarrjes, e sidomos frymënxjerrjes (H. K.)

[2] trubadur = këngtar(H. K.)

se 500 shpirt. Edhe një i them Perikliut dhe basta! Muarm serenatën e Schubertit. Edhe kjo shkoj bukur fort. Mbas kësaj muarm "Eri tu che machiavi quest'anima, la delizia del' anima mia etc. të "Ballo in maschera" të Verdit. Këjo ju vuri kapak të gjithave. Posa mbaruam, Perikliu, i dëshpëruar kërkon të shkojmë. Po kur dëgjohet një zë burri nga patoma[1] e sipërme. "Urdhëroni lart, zotërinj, po të doni, urdhëroni. Jini të mirëpritur e n'a bëni një nder të math". E dëgjon, i thom Perikliut. Hej, shyqyr o Zot! thotë i urëti Perikliu. Hidhem unë e i përgjigjem: "Falemi nderit fort, zotni, se është kot t'ju deranxhojmë. Ne jemi dy studentë që n'a pëlqen të glendisim në këtë mënyrë". Mir po ata insistonin: "urdhëroni, urdhëroni, kemi kënaqësi të madhe". Shkojmë, thotë Perikliu e mos e zgjat shumë me filozofit' e tua të pagdhëndura. Dëgjohen zëra grash: "Urdhëroni, zotërinj studentë, urdhëroni për hatrin t'onë". A! ja u pret agjërim-madhi Perikliu, në është për hatrin t'uaj ne e respektojmë pikërisht. Po ju lutemi nga të hyjmë? Këtej, këtej është antreja[2], na përgjigjen dhe po n'a tregojnë antrenë. Edhe ne salutojmë atë mizëri populli në rrugë e hyjmë.

Kur u futmë në një koridor të gjatë qëndrojmë pak dhe ja marrim një duetto të Normës "Eh, perche perche mira Norma" të Bellinit. Kaqe bukur jehonte këjo an' e kant mureve sa duall plot njerës me llampa në dorë dhe po n'a ftojnë të hyjmë brenda. Ne kaqe e kishim humbur sa u futmë në patomën e dytë. Po kur ja mbrrijnë një karvan zojusha si burbuqet e Majit nga patoma e tretë dhe po brihen[3] me këta të patomës së dytë, se ato na thirë e jo këta. Ahere ne shkuam mbas atyre zojushave dhe disa zotrinj e zonja prej patomës së dytë n'a ranë pas. Ngjitemi në patomën e III ku na pritnë si ujin e ftohtë. I zoti i shtëpisë, një milionar, Z. Vathis n'a del përpara e n'a mer brenda. I japim kart-vizitat t'ona dhe hipën mbi një karekllë e n'a rekomandon ne të gjithë me këto fjalë: "Zonja, zojusha, zotrinj ju u rekomandoj z. z. Floqi dhe Simetën të parin student i drejtësisë, të dytin të Medicinës". Dhe pastaj kthehet nga nevej të dy dhe n'a thotë: "Zotërnij, ju rekomendonj gjithë këto zonja e zojushe e gjithë djemt' e pleqtë që shihni këtu brenda; jemi të gjithë tanët. Një buçimë duartrokitjesh përcolli fjalët e fundit të z. Vathis.

Ishin 3 salonë me radhë njëri pas tjetrin të hapur që të komunikonin të ftuarit. Luks an' e mbanë. Një pianoforte e bukur në fundin e një saloni. Burra e gra do ishin përmbi 100. Tri a katër tryeza gjendeshin shtruar akoma. Kishin ngrënë bukë, por se kish akoma copra buke të prera andej e këtej mbi tavolinat, si edhe 'arra e bajame të qëruara, kadaife, bakllavara dhe biskota nëpër pjatat e piatancat dhe plot shishe verë të bardhë, të kuqe dhe recinato[4].

Ne pik së pari n'a bënë vent në tryezën e parë ku ndejmë afër e afër me Periklinë. Unë zura një muhabet, po Perikliu merreshe me tjatër punë. Qinse kur kish ngrënë, po hante për fruta disa portokaj, të cilat i përcillte me thela të mbëdha, herë kadaife e herë bakllavaje, të cilat prapë i përcillte me gota me verë herë të kuqe herë recinato. Unë po e vinja re, ajy po shëkonte punën. Dalngadalë zura të ha edhe unë tuke llafosur, po dikur mernja edhe copa buke me sardhela, dhe për mbi ato biskota, edhe dank[5] verës. Ata si ishin të ngopur s'na vinin dhe aqe ré né. Perikliu s'e ngrinte aspak kokën. Edhé ishim me palltotë akoma, të cilat nuk i kishim edhé qitur. Më thotë një zotni, nxirni pallton të rijni rehat. E nxora. I thanë edhe Perikliut t'a nxjerë një mushama të lehtë që kish përsipër. Me azallah, se e nxirte mushamanë Perikliu. Insistojnë nj'a dy që ta nxjerë, po Perikliu ia pret si me shaka: "Aman, m'a falni se kam robat e dyta veshur e s'dua të bënj figurë të keqe përpara zonjave e zojushave". Ata qeshnë pak dhe e lanë të qetë Periklinë, i cili prapë iu qep shërbimit që filloj në krye, të

[1] patomë = dysheme (H. K.)

[2] entrée (antree) = hyrj' e shtëpisë (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

[3] brihen = zihen, grinden (H. K.)

[4] verë retsinato = verë tavoline prodhim grek që staxhonohet në buta ku shtohet rezina. Është një nga pijet alkoolike greke më populloret dhe me traditën më të lashtë (H. K.)

[5] dang = fjalë tingull-imituese (H. K.)

ngjishet, do m. thënë së ngrëni edhe për drekën që s'hëngri edhe për darkën. Po edhe unë s'rashë poshtë; hëngra e piva mjaft.

Ngrihen disa zojusha e na u lutnë të exekutojmë ndo një copë me flauton e qitharën. Morëm ahere disa copë prej "Traviatës", prej "Pagliacci", prej "Faustit", "Barbiere di Seviglia" etj. etj. Pastaj disa valse të bukura, disa barcarolla etj. etj. N'a u lutnë edhe të këndojmë. Perikliu ishte një tenor i mirë edhe unë një mezzo-soprano. N'a ardhi edhe një zojushe soprano extra dhe një djalë tjetër basso i rendit të parë. Kënduam së bashku "Quarteton e Rigolettos". U kënaqnë tepër. Më cazë filloj edhe vallja. Muarn pjesë nj'a 30 palë kavalierë edhe dama. E ngritnë edhe Periklinë të kërcenjë. Por, Perikliu s'e nxirte për të madhe punë mushamanë. Më në funt e lanë të kërcenjë me gjithë mushamanë. Unë s'lojta nga vëndi. Dy zonja zunë vënt në pianoforten dhe formonin muzikën bashkë me një zotni tjetër që loste bukur viollinë.

Kur po kërcente Perikliu, O Hy, O Perëndi! Pashë për çudi që nga xhepi i mushamasë, i kërcyen disa bajame e arra të qëruara e ranë në dysheme! Mua më ra tavani përsipër! Bre, i paudhi, thom me vete paska vjedhur arra e bajame të qëruara. I bënj me shenjë të ketë mëndjen, ajy as që më vinte ré. Dikur afroheshe nga mua edhe e hiqnja me maryfet prej pëqirit të mushamasë që ta sjell në rregull; Perikliu as m'a vinte veshin, edhe arat e bajamet prapë po delnin nga xhepi i mushamasë si kur i shtynte njeri.

Desh zoti e mbaroj pjes' e parë e asaj pollke, e cila për pak, ment na turproj! Si ndenji pranë meje ky i paudhi i thashë nga dalë: Bre, maskara, a e di se do n'a bësh rezil këtu brenda? – Ç'farë thotë? Arra, bre, të qëruara e bajame po të bijen nga xhepi, si e ke hallin? S'ke pak turp Oh, edhe ti, më thotë, edhe këtu s'më lë rehat? Bukë a dolli nga xhepi? më thotë. Pse, ke mvedhur edhe bukë? i thom. Ahere qënke për të lidhur. Lithmë, thotë, bëmë ç'të duash, po këtu mos m'a prish yryshin.

Mbassi kërcyen nj'a dy "mazurka" pas-de-quatre e një valle tjetër që i theshin "zing" edhe më në funt "quadrilles", pushoj orqestra dhe u afruan përsëri tryezat. Ahere u shtruam prapë né me Periklinë. Na suall mollë, dardha e disa kuti me sardhele. Filluam të hamë molle e dardha bashkë edhe të pimë verë. U hapnë edhe disa kuti me sardhele. Po një kuti me sardhele që ishte përpara nesh fluturoj, me gjithë që disa veta e pamë që n'a e servirë aty përpara. Një zotni i thotë servitores të na sjellë edhe ne sardhele. Ju solla, përgjigjet servitorja. – Jo, s'na solle. – Ja u solla e di mirë. Ke gabim, nuk ke sjellë gjë, po ashtu të duket. Dhanë muar me fjalë gjer sa u bint servitorja se nuk kishte sjellë. Vajti e na solli një kuti tjetër dhe e hapmë e muarn meze secili.

Mbassi ndejmë ndo një orë akoma, dhe e pamë që vajti 3 pas mezit të natës, u ngrita unë dhe pas meje Perikliu, i përshëndoshmë një nga një të gjithë e duallm jashtë. Ata na përcuall gati gjer ne porta.

Si duallm jashtë vamë prapë në atë qoshen historike ku filluam më parë dhe muarm edhe një pjesë tjetër të bukur me instrumentat t'ona dhe u larguam në mest të duartrokitjeve, tepër të kënaqur, si unë si Perikliu.

S'ishim larguar shumë çape dhe kur e shoh Periklinë që u afrua afër një fanari (reverbere) e po shëkonte pantalonën e djathtë. Ç' ke , i them që pashëkohesh ashtu? Lëre e mos e pyet, thotë. Qënkam kallaisur krejt. Jam bërë helaq. Ç' pate, i thom? Ç' është? Ç' të jetë, më përgjigjet, është derdhur tërë vaji i sardheleve në xhep e më lërosi gjithë pantalonën!

Betohem se s'kam qeshur aqe fort në jetën t'ime sa atë here! I paudhi, i patënzoni, si thonë gegët t'onë, kishte vjedhur një koxha kuti me sardhele nga tryeza e asaj shtëpije, cok atë kuti sardhele që u bë aqe fjalë në atë shtëpi, që e shkreta servitore e z. Vathit insistonte se e dinte fare mirë që e kish prurë në tavolinë dhe të cilën, myster, se si mundi e e sufrosi Perikletua, pa e marrë vesht njeri! Duket se ajo kishte zënë t'a hapë kutinë, e kishte hapur pak, sepse ky dreq i mallkuar Perikliu e kishte rëmbyer me gjithë çilës! Vaji, pra, i sardheleve i

kishte kulluar në xhep edhe vetëm kur u ngritmë të shkonim, ose kur muarm rrugën e kuptoj Perikliu.

Nuk mbanja dot të qeshurat, me gjithë që ajy i panafakti s'qeshte aspak. Vemi të hamë? më thotë. Akoma të hamë , bre, tartakut[1]? i thom. S'të ka rënë në bark gjith' ajo që hëngre? More, lëri fjalët, më thotë e hajde të hamë! Ti gjithë do të fillosofisësh, tuhaf! Po s'të durohet gjer sa të vemi në shtëpi? Ç'ka, thotë hajde vemi në shtëpi. Vazhduam rrugën gjer sa vamë në shtëpi.

Si ndezmë llambën, ç'të shoh? Perikliu zu e po çkarkoheshe. Nxjer gjysëm oke a më tepër arra e bajame të qëruara nga mushamaja, 5-6 copra bukë, dy mollë, nja 4 dardha, biskota, nxjer kutinë me sardhele më në funt dhe një shishe verë të vulosur ndo një litër, po thua! Ahere kuptova pse nuk e nxirte mushamanë, kur i luteshin, ahere kuptova pse i kërcenin nga xhepi arrat e bajamet kur loste etj. etj.

Më në funt e bëra të qeshë edhe Periklinë. Ajy kish ngrënë aqe shumë atë natë sa më s'bëhej! Edhe s'ishte mjaft që hëngri po kishte marë zairé edhé për të nesërmen, që ishte e Hëna e madhe!! A munt të harohet kjo histori, kjo ndollinë kaqe e lezeçime?

Pa fjalë, lipset t'a kem përsëritur këtë histori qint herë, në për shoqëritë, në për gostitë, në për dasmat, në suaretë e ku di unë. S'ka mbetur njeri pa qeshur e ndofta edhe pa derdhur lott me mënyrën që e kam rëfyer. Historija e kutisë me sardhele ka mbetur e paharuar! Kësij mrekullinash bën nga ndo një herë urija. Po si kur të mos kishim edhe instrumentat nuk besonj t'a nxirnim mb'anë gjithë këtë lodër që lojtmë me Periklinë. Kështu kaluan edhe Karnivalet e atij viti të paharuar.

Si hyri Marsi i lashë gjithë shakatë më nj'anë. U mbyllme brenda si unë, si Perikliu edhe u shtruam të këndojmë për provime doktorale. Këndonim nga 10 orë e më tepër ditën. Shumë herë haronim të zbathnim këpucët natën, shumë herë haronim të shuanim edhe llambën. Një herë kemi dalë jashtë të dy, tuke lënë llambën ndezur edhe arthmë e e shuam në drekë! Një herë tjetër na gënjeu Hënëza dhe kujtuam se u gdhi e u mveshmë e duallmë jashtë në rrugë, po bota flinte ndofta gjumin e dytë. Ishte saati 3 pas mezit natës. Të tilla episodhe s'kanë të rëfyer.

Tani mendohesha për provimet. Nuk kisha kohë as komedi të bënja të reja për diçka të përfitonja, as në gazetat të shkruanja, as kurrgjë. Duhet të prishnja vetëm nga t'im atë, i cili kishte zënë pak një sërë të vogël edhé mbi gjithë hallet filloj të më dërgonjë nga 70-75 dhrahmi në muaj që s'më sosnin as për bukë. Prapë zura të çqetësohem.

Me qenë se Perikliut i dërgonte i ati 200 dhrahmi në muaj, ky i shkreti ishte aqe zembër mirë sa m'i jepte mua të gjitha paret posa që i vinin edhe më theshte "bëji si të duash arrin këto me 275 të shkojmë të dy mirë e pa siklet".

Ahere, me që ishin edhe 6 studentë miq të ngushtë me njëri-jatrin, unë i binda që të gjithë që të bënim një maryfet që të munt të hamë edhe mirë edhe lirë. Kështu përfunduam një dit që të më japin mua secili anticipato[2] gjysmat e atyre që harxhojnë në për restaurantet për të ngrënë dhe unë zotohesha që t'ju jepnja drekën e darkën alla pension sa të ngjinjeshin e të mbeteshin të kënaqur.

Mora pra, prej se cilit nga ata të 4 nga 100 dhrahmi përpara dhe 200 vumë ne me Periklinë, gjithsej 600 dhrahmi. I mar unë këto edhe vete merem vesh me një farë Nikoli Qefalonit, të cilin e njihja mirë dhe me të cilin kisha fjalosur shumë herë një gjë të këtillë. Ajy ish tjetër herë gjelltar me nam në Odessë të Rusisë, po tani ishte si i allakatur e kish një dyqan afër shtëpisë s'onë me 2 bute vere edhe një bango me gota e me shishe pijesh, ishte tavernar dhe s'bënte punë.

[1] tartakut = njeri i ulët, i keq, djall, dreq, por edhe të dridhura nga të ftohtit (H. K.)
[2] anticipato = paradhënie (H. K.)

E ujdisa me ‘të t’i bënja fugaron e gjellëve, t’i blinja tenxhere, kacarodha[1] etj. si dhe ajy të blinte mishin dhe gjalpën e zarzavatet edhe kështu të na gatuante gjellë atje për ne të 6 me perunat t’ona, lugët, thikët pjatat e peshqirët dhe t’i paguanin një fitim 10%, dhe ajy e pranoj.

Shpejt vrapuam të dy me atë dhe brenda 2 orëve me një usta kishim kurdisur kuzinën provizore; shkuam e blejmë një tryezë për 10 veta, 2 tenxhere allumini etj. etj. , si edhe mish, zarzavate, gjalpë etj. Të gjitha këto kushtuan 280 dhrahmi. Tani kisha edhe kusurin në xhep. Simfonia ime me Nikolinë ishte të mbante 10% nga fitimet ajy tuke më dhënë hesap mua, porse nuk do futte njeri tjetër të hante me ne. Nikolini i pranonte të gjitha e ish i lumur.

Një dit, pra u poqmë të gjithë në shtëpi t’onë dhe plot më 12 mbas ditës vamë ne Barbanikoliu, ku gjetmë një trapezë të shtruar bukur, me 6 pjata e takëme të tjera, e pastër, me lule etj. që kurrë s’munt të ish restauranti ku hanim bukë. U shtruam e të kemi ngrënë me aqe oreks, sa s’rëfehet edhe gjellra extra dhe kushtonte vetëm 30 lepta[2] pjata, kur se restaurant kushtonte 70 edhe 80 e jo si atë gjellë edhe aqe shumë. U knaqmë fort. Dal nga dalë u bëmë 22 studentë që hanin atje, po kurdo herë Nikolini më njihte mua dhe pa lejen t’ime s’futte njeri.

Në 3 muaj e sipër Barbanikolin u gjënt me një kapital 1. 000 dhrahmish dhe ishte tepër i enthusiasur e mirënjohtës para përmeje, tek i cili haja sa të desha me një skonto 10%, që më vinte vetëm 1 dhrahmi ditën, dreka e darka, dhe qumështin në mëngjes gratis. Kjo më shpëtoj nga një problemë shumë të madhe. Po edhe Nikoli u sigurua mirë nga kjo ndollinë se kur takova prapë me atë më 1914 në Athinë, ajy kishte një grand hotel e restaurant e shtëpi të tijnë e të holla e pasuri tjetër që s’i kisha patur ëndër më.

Gjer këtu e prumë mirë punën. Po tani ishim në muajin e Majit 1899 edhe unë do jepnja provime më 2 Qershor ditën e Mërkurë që më kishte caktuar dekani i Fakultetit t’onë. Më duheshin të paktën 1. 000 dhrahmi e unë s’kisha as 100. Si të bënja? Isha në hall të math. Nga im’atë e kisha prerë uzdajën[3] se s’ish e mundur të më ndihmonte gjë, se nuk kishte. Halli im, sikleti, skotura ishin të shumë mbëdha.

Nga do gjenja të holla? Po vrisnja mëndjen, po mendohesha e më s’gjenja asnjë solucjon, as një çare!

Një dit, tek po kërkonja në kafe “Paris” një mik, se si më vanë sytë mbi një fytyrë të njohtur. Unë po e shëkonja me vërejtje, po edhe ajy po më shëkonte. Më në funt u afruam dhe dhamë dorën shoqi-shoqit. I thom, diku të kam parë, por s’e sjell ndër ment. Edhe unë, thot’ ajy. Mos je nga Karvasaraja? Si urdhëron, i thom unë, e zotrote? Unë jam Athinjot, thotë. O, gëzohem tepër. Po ku jemi parë bashkë? Më duket se në Karvasarâ, thotë . Do jenë 7-8 vjet, kur isha atje reshter i artilerisë, kam ardhur në dyqanin t’uaj e kam njohur edhe ju edhe babanë t’uaj. Po embrin, i thom, si e keni? Quhem Mantho Gavallâs, më thotë. Qofsh shëndosh.

Në këto fjalë më fton të më qeraste edhe u ulmë në një tavolinë. Tuke folur më thotë se bën varele e enë të tjera druri në fabrikën e madhe “Zannos et Roche” të konjakëve dhe pijeve. Më tha që po të dua munt të vemë në fabrikë t’a shohim. Vemë, i thashë, mbassi isha tepër i sëkëlldisur atë dit. U ngritmë, i hipmë tramvajit e shkuam në vëndin “Mylli Athinon” ku ishte fabrika, jashtë Athinës. Atje më rekomandoj me disa zyrtarë të fabrikës edhe pamë fabrikën.

Vura re stiva plot me dhoga për bute, varele e fuçija gjithfarësh, që unë i njihnja mirëfillit nga ç ‘dru janë, a në janë të mira, ç’masë duhet të kenë, përse e si hyjnë në punë etj. etj. se isha marrë vjete me ato pranë t’im ‘eti. I adresonj gjithfarë pyetje njërit prej atyre zyrtarëve, i cili ishte edhe specialist i fabrikës për atë lloj lënde. E pashë se i kishin blerë shumë shtrenjt se sa nga Karvasaraja ku munt t’i merrnin, ku edhe plaçkë shumë më të mirë e

[1] casseruola = lloj tenxhereje (H. K.)
[2] leftà (ΛΕΦΤΑ) = të holla, parà (H. K.)
[3] uzdaj = shpresë (H. K.)

shumë më të lirë e munt të blinin. Nga ana tjetër kishim edhe ne dy konakë, nj'a 8 mushkash, që na sillnin qereste shtëpish edhe dhoga dhe do kishim një sasi nj'a 5. 000 copësh, që im'atë do të ishte kontent për ato sikur t'i shishte avrom[1] nga 0, 7 lepta copën, të dorëzuara në Karvasarâ, kurse fabrika "Zannos et Roche" i blinte 1, 0 e 1, 10-1, 20 copën në Volo e njeti[2] dhe plaçkë më të keqe, se mjerisht ne në Karvasarâ s'kishim të njojtur me fabrika të mbëdha që konsumonin sasija kolosale. Im'atë kishte akoma në apothekë prej vjetësh një sasi dhogash skarta 7-8. 000 mijësh, të cilat shumë herë ju ish lutur disave Qefalonitëve e Lefkodhitëve t'ja shiste qesim për 1. 000 dhrahmi, si në vënt të druve zjarit, e s'kish qenë e mundur. Me këtë bashkë ishin edhe 3-4 tregëtarë të tjerë në Karvasarâ që munt të kishin përmbi 60. 000 copë dhoga të pashitura.

Me një herë më ra një mendim i bukur; A do mos ish e mundur të bënim edhe ne ndo një allish-verish me këtë fabrikë?

Kthehem i thom specialistit që këtë tregëti e bën edhe im'atë dhe kemi plaçkë shumë më të mirë e më të shëndoshë se këtë edhe me 10 centim më pak copën etj. etj. profka.

Specialisti i fabrikës më dëgjoj me vërejtje e më thotë se do flasë me drejtorin e përgj. Z. Jean Roche, frënk i naturalizuar grek e i martuar në Athinë.

Mbas 2 orë u ndava nga Mantho Gavallaj e ardha në shtëpi. Manthos i kisha dhënë adresën t'ime. Kur pas dy ditsh vjen e më gjen në shtëpi t'ime e më thotë se është dërguar nga drejtori i fabrikës, i cili po më priste në zyrën e tij në rrugën "Eôllou", të flisnim për mbi dhogat.

U mvesha sport, si i dalë nga sënduqi, për t'i bërë impresjonin më të mirë dhe një e dy pas 20 minutash u gjetmë përpara z. Roche, një burrë aristokrat, serioz e i mendshëm. Më priti shumë mirë dhe u ula atje pranë tij dhe filluam bisedimin.

Ajy u kënaq shumë me hollësitë që i dhashë mbi kubizmin e cilësinë e dhogave dhe më fort u kënaq se bisedimi u bë në gjuhën frëngjishte, se atij, si frënk, i pëlqente të fliste frëngjisht. Më thotë a munt t'i pregatiti im'atë një sasi 300. 000 dhogash. Unë u stapita[3], se e pashë se ajy kujtoj se kush e di sa tregëtarë të mbëdhenj ishim. I përgjigjem se aqe një sasi tash për tash s'munt të mblidhej, po deri më 50-60. 000 copë doraj-dorën. Çka, më thotë, 50-60. 000 tani, pa shofim më tutje. Sa për fiatin e bëmë 1 dhrahmi copën, dhoga 7 x 8. Këto prisnin një shumë 60. 000 dhrahmish. Më thotë si do jet' e mundur të bëjmë kontraton dhe a kam të drejtë unë, ose a kam ndo një prokurë të nënëshkruanj për t'im 'atë? I them "po" mbasi firma e jonë ishte "Vasil Floqi e bir". Fort mirë, thotë po mundet brenda 2 muaj të na dorëzohen? Edhe më parë në daçi , i thom se e dinja që do gjenj një sasi të kaqtë në Karvasarâ. Sidomos shpresonja në përqindjen që do t'ju mernja tregtarëve tjerë dhogash në Karvasarâ si edhe në dhogat t'ona e në ato skartat që kishim ne, që do t'i goditnja nëpër mes dhogave të mira, si dhoga të mira. Do kisha edhe vetë një fitim.

Zoti Roche thiri telefonisht notarin e tij, i cili ardhi aty në zyrë të Roche-it e komponoj kontratën relative. Në trajtim e sipër të kontratës më thotë z. Roche, si e kemi zakonin kur lidhim kësij kontratosh, sa marrim përpara. Ja preva shkurt: "gjysmat". Bon, thotë z. Roche edhe posa nënëshkrova kontraton më numuron 30. 000 dhrahmi. Mora një kopje kontrate dhe i lashë shëndet z. Roche e më s'pashë si ika nga zyra e tij. Mora një karocë e vajta në shtëpi e u mbylla ne odën t'ime. I nxora të hollat, i numurova, prap' i numurova edhe një her' i numurova dhe po çuditesha si arth ky fat kështu pa pandehur! Nga ndo një herë fërkonja sytë si kur se isha në ëndër; çuditesha si m'i besoj gjith' ato pare z. Roche pa njohur mirë. Po tani?

Zura të mendohem se mos binja jashtë e turpërohesha. U mata disa herë t'i telegrafoj t'im 'eti për sasin' e dhogave që munt të mblidheshin, po e dinja se do mos më merte vesh

[1] avrom = besoj se do të thotë "qesim", por këtë fjalë nuk e gjeta në fjalor (H. K.)

[2] ngjeti = gjetkë, gjetiu, në tjetër vënt (K. F.)

[3] stapita = shtangem (me origjin nga fjala "Stap – shkop, dru"H. K.)

mirë, pastaj munt t'a ngrinin hundën përpjetë tregëtarët e tjerë, tuke dëgjuar se kërkoheshin dhogat e tyre. Ahere u mendova se më mirë do ishte të nisesha vetë. Ashtu edhe bëra.

Atë natë i lë shëndenë Perikliut t'em dhe pa i thënë gjë e mora gjer në stasjon dhe u nisa për Karvasarâ ku me shpejtsi arrita të nesërmen me dy orë natë. Im'atë u habit kur më pa. U trëmp. Si këjo e ardhur, më thotë? Mbeta pa pare, i thom, e u nisa. Po plaçkat? Vijnë me vapor se s'i mernja të gjitha pas. Po provimet? Ç'provime, i thom. Me ç'parà. Ata duan 1. 600 franga, ku t'i gjenja? – Po ahere? Mbeta i thom për në Nëntor pa ka Perëndia. Uli kokën im'atë e s'foli gjë. Neise thotë, mirë bëra që ardhe se të t'a kisha merakun. Si u shtruam të gjithë e më pregatiti im 'ë të ha, se ata kishin ngrënë. Si pimë nga nj'a dy gota me t'em atë i thom. Nuk më thua, nuk do t'i sheshim ato dhogat ndo një herë? Kush i mer? thotë. Ju kanë vënë këmbën e i kërkojnë 0, 5 centim copën kurse nevej na kushtojnë 2, 15. Sa copë ke, i thom. Ç' pyet thotë kur s'i blen njeri? Kam nja 6. 500 – 6. 800 copë. Sjellin akoma sharxhinjtë? Sjellin 50-60 copë ditën, po tani do t'i prishim konakët e jam në hall të math, se duan paratë sharxhinjtë. Ju ke borç shumë? – Afro 1. 400 dhrahmi. Po si do bësh ahere? Do mbyll sŷt e do t' i shesh sa, sa. Gjer sa munt të jesh kontent[1] t'i japësh? – Po të më japën 60 centim copën i jap që sot, edhe 55 akoma, thotë, po veç të gjenj. Qesha pak. Me 60 centim t'a kam gjetur një myshteri, i thom. Hajr ollâ[2]! thotë im' atë i gjori. Folë mirë, vërtet a po qesh? Vërtet, vërtet. Dhe qita nga xhepi 2 mijëshe dhrahmi pa i parë të tjerat im' atë. Zëre dorë, i thom, se do të të jap kaparin dhe paratë i shtërngonja me dorën tjetër. Zumë dorë. Im'atë po çuditeshe ç'ishim këto fjalë. Ahere qita e i thom: na 2. 000 dhrahmi kapar e t'i kam blerë të 6. 800 a sa dhoga të kesh edhe kur të vinjë tregtari të jep kusurin e i dorëzon dhogat, po konakun edhe sharrat që ké mos i prish.

Im 'atë m'u hoth për qafe e më puthi fort në ballë. Im' ë e teto Ndinua gjithashtu. Ishin fort të gëzuar. Ahere kthehem e i them prapë babajt po ato dhogat skarta, i thom. Ja, thotë, kemi filluar t'i djegim në zjarr në vënt të druve, mbassi nuk shiten. Kini djegur shumë, i them. Këto dit kemi filluar të djegim, më përgjigjet babaj. Sa ke, i thom? Nja 7-8. 000 copë; as unë s'e di sa janë. Për sa deshe t'i shishnje? – Ato? Ja, sot të më japin 500 dhrahmi, falur i qofshin atij që t'i marrë. Edh' ato t'i blé un' i thom, po jo 500 dhrahmi. – Po sa 400, 300? Jo, jo. Po t'i ble 1. 000 dhrahmi, siç do t'i shishnje më parë i thom edhe mbaji për atë tregëtarin. A të dha kapar edhe për këto? më thotë. Nxjer edhe një mijëshe tjetër: na, i thom po t'i paguanj që tani.... . Oh, kur m'u hoth edhe një herë në qafet, i mjeri, e po i mbusheshin sytë lot nga gëzimi! i qënke shpëtimtari im, më thotë, ti paske ardhur me duart plot, të keqen babaj, ehu, ehu se ç'u bë ahere!

Me një herë i bërtet yzmeqarit t'onë që flinte poshtë në dyqan: Ngrehu, Aristidhi se ardhi afendikoj i vogël. U ngreh Aristidhi e ardhi lart e më përshëndoshi. Bjerna i thotë im'atë prej asaj vere 3 vjetshe të bardhë që kemi në raftin e sipërme, prapa shisheve me konjak të gostitim Kristaqin.

Aristidhi, gjysmë i fjetur akoma, sa e ngritmë nga gjumi, zbret përposh e na sjell dy shishe verë të vjetër. Hapim një shishe dhe n'a mbush im'atë katër gota veret. Tetua ime Ndriua, siç ish enthusiasur tepër: mirë së ardhë, të keqen më thotë, paç këmbën e mbarë me dipllomën shpejt. Një edhe e zbars gotën gjer më funt. Im' ë më uroj edh' ajo, por se zu ta pijë nga dalë. Kur e vë në buzë, kthehet e na thotë : more, më duket se na ka dhënë konjak Aristidhi. Jo, i thotë im'atë, ké gabim; nga që është vera shum' e vjetër, duket si konjak. E shijonj unë, konjak! Konjak, i thom t'im 'eti. E sheh edh' ajo, tamam konjak. Thret Aristidhin, sheh edh' ajy vërtet konjak. Aristidhi paske gabuar fukaraj se ishte në gjumë. Ahere n'a shkoj mendja ne teto Ndinua. Bre! Fukaraja. Po tani?

[1] contento = i kënaqur (nga italishtja H. K.)

[2] hajr ollâ = puna u krye, na qoftë pë hajr (H. K.)

Nuk shkoj 5 minuta, Ndinua u bë më qef; shtoj fjalët, zu n'a këndonte, u ngrit të n'a kërxenja valle, ju muar menttë, ra, i vjen me të vjellë. Vaj halli tani . Ngrihet shpejt im'atë e shtërngon e vjell dhe kështu shpëtoj tetua e ngratë, por se ra fjet e n'a la rehat gjithë natën.

Prapë pasuam muhabetin. I thom t'im 'eti: sa dhoga munt të kenë ata tregëtarët e tjerë Kostë Kerja, Miti Jovani dhe Kostë Themeli? – Pse, më thotë. – Po them kot. Munt të kenë nj'a 40. 000 që të tre, më thotë. Mund ti kaparosim i thom edh'ato që nesër? - Pse jo, thotë. A ke kapar edhe për ato? Do kem, i thom. Babaj u hoth përpjetë! Po ti paske ardhur tamam, më thotë. Ti na shpëtove të gjithëve. Si sa munt t'ja marim atyre? –Po thuaj kaqe, më thotë. Me 60-65 lepta copën munt t'ja u blemë. Pa shëko, i them t'im 'eti. Ata duhet të të japin një komisjon ty, që ju bën këtë të mirë. Ja u marrim, thotë. Ahere 5% është mirë? i thom. – Bukur fort, ma pret im'atë. Në qoftë i thom se i katafer[1] me 55 leptà copën, 5 centim fitoji prapë ti. Jo, jo, thotë, po si unë edh' ata. Veç se të 5% do t'i falin ty. Jemi d'akord. Jemi, i thom.

Të nesërmen im'atë u poq me ata dhe kish mbyllur pazarllëk me të tre tregëtarët për 40. 000 copë X 6 centim copën. Vijnë që të tre në shtëpi t'onë bashkë me t'ëm atë dhe s'e besonin në krye . Pastaj si e panë se puna ishte serioze e ata kishin nevojë të madhe për të holla, shkrova me një herë të tre kontratot shkurt që secili ma shiti mua pjesën e tij dhogash 6 centim copa, që muar kapar 12. 000 dhrahmi dhe që brenda një muaji do më dorëzonin në shkelë të Karvasarasë mallin.

Nxora e ju dhashë edhe këtyre 12. 000 dhrahmi tuke ju mbajtur 600 dhrahmi për komisjon të cilat ja u ndava s'im 'ëje dhe teto Ndinos nga 300 dhrahmi për shoq, të mvishen e të bëjnë ç'të duan. Mora urimet e dynjasë nga ato të gjorat gra, që i gëzova aqe fort.

Si mbaroj këjo punë, i thom t'im'eti, që edhe dhogat skarto do t'i shishte për të mira, se do vinte një njeri i njojtur, Manthua, me të cilin kisha folur unë, se do t'a ndreqte punën, kështu që edhe dhogat skarta u zunë në hesap si kurse dhogat e sagllamta sepse ato që pashë unë në fabrikën e Zannos, s'ishin më të mira se dhogat skarto t'onat.

Kisha tani edhe 15. 000 dhrahmi akoma për ca më sipër. I thom t'im 'eti s'i duheshin akoma për të installuar edhe nj'a 4-5 konake sharxhinjsh. Pa dalë, më thotë im'atë, se ti më duket se je i ngarkuar me dhrahmi me barrë. A ke të më ndihmosh gjë? më thotë. Sa do, i thom. Ke nj'a 2. 000 të arrijnë . Më arrijnë. Mirë fort t'i dërgonj nga Athina. Pse, më thotë, a do vesh prapë në Athinë? Ti the se do rish gjer në Nëntor. Ashtu të thashë, i thom, po do vete. A! tani e mora vesh, më përgjigjet im'atë, ti e paske siguruar dipllomën, bravo. Aferim. Qënke i zoti!

Ahere i kallxova gjithë punën me Zanno-Roche, veçse i mfsheva çmimin e vërtetë të dhugave, si edhe i thashë se mora vetëm 20. 000 franga. Prandaj nxora e i dhashë edhe 3. 000 dhrahmi të tjera për të vënë një sërë të mirë e i thashë se më mbetn' akoma 2. 000 dhrahmi, të cilat i dua për dipllomën. Mbaji, tha, hallall të qofshin. Po të duash të jap edhe të tjera. Jo, i them, se më mjaftojnë, po edhe këto që mbajta do të t'i shpërblenj kur të vijmë të ngarkojmë dhugat. S'i thashë gjë tjetër. Mbetmë d'akord, mora kontratot me vehte dhe gjith'atë dit u nisa për në Athinë. S'ndenja as një ditë të tërë në Karvasarâ.

Si vajta në Athinë i vura shpejt në Bankë 11. 000 dhrahmi dhe kusurin e mbajta në xhep t'em. Asnjeri s'mori vesh pse vajta e ardha kaqe shpejt në Karvasarâ. S'i thashë as Perikliut.

Satisfaksjoni që ndjenja për atë të mirë që i bëra t'im 'eti dhe shtëpisë, s'kishte kufi për mua. . Gjithashtu gëzimi që ndjenja se do munt të jap provime shpejt dhe do ktheheshim në Karvasarâ i paisur me robat e gjithë garniturat e tualetës, s'kish të rëfyer.

Perikliu çuditeshe nga i gjeja paratë se kisha filluar të bënj pak havardallëk. Po kurrë s'mori vesh gjë për mua.

[1] katafer = menaxhoj, administroj (përkthyer me google nga greqishtja (H. K.)

Porosita shpejt dy palë roba, extra, gravata, kapella etj. Një dit i vajta prapë z. Roche me robat e reja e tjetër kapellë e këpucë. E pashë që i bëra përshtypje. Tjetrën të Djelë i vajta me një palë roba gri inglize. Më vinte re hollë. Më në funt s'e mbajti dot: Zoti Floqi, më thotë dukesh shumë chik. Bravo mbahesh shumë distingue, më pëlqejnë "le jeunes gens[1]" kur mvishen mirë, më thotë. Më mbajti ndo një orë tuke fjalosur. Më presentoj edhe te i kunati dhe ortaku i tij z. Zannos. Pas ca ditsh më thirë edhe për drekë e u njojta edhe me familjet e tyre djelmt' e gocat e tyre, njerës shumë të mirë. Dal nga dalë u bëra si i shtëpisë, sa kur dhashë provim e mora dipllomën ndjenja një javë mysafir në shtëpi të Roche-s. E shoq' e tij dhe të dy të bijat, një Ginette edhe një Josephine kaqe më sympathizuan, sa s'bënin një ditë pa mua. Venim natë për natë në Opera. Më gjenin perfectione nga të gjitha. Këndonim në piano bashkë. Solla atje edhe flauton e qitharën e shkonim me fe. Z. Roche nga ana tjetër më gjente gentlemann, më jepte aqe liri sa disa herë i shoqëronja unë vetëm në opera (Theatre royal) zonjën Roche dhe çupat e saj. Kur kam ikur nga Athina më kanë dhënë kaqe peshqeshe. Kaqe kohë mbajtmë korespondencë frëngjisht. Zonja Roche (Cecil Roche) me titullonte "Cher freu" zojushat "Tres amable Mr. Flochi".

Edhe pak fjalë mbi provimet.

Javën e provimeve nuk shkela te zoti Roche. Kisha kërkuar "exeuses" tuke kallxuar çështjen e provimeve.

Gjith'atë javë kam kënduar nat' e dit pa massë. Isha i pregatitur si jo më mirë. Do të jepnim provime bashkë me një tjetër camerade z. Stefano Stafyllos. Edhe ajy ishte mirë i pregatitur.

Ditën e caktuar për provime, 2 Qershor e Mërkurë vjen që më 7 në mëngjes të më marë Stafyllaj nga shtëpia. Me gjithë që isha i pregatitur mirë më ardhi sikur më thrisnin të vete në guillotinë, kaqe që mora një frikë.

Shoku im Stafyllaj më thotë të shetitim pak nga lulishtja mbretnore gjer sa të vinte ora 9 e provimeve. Vamë e ndejmë aty më një bango. Më thotë shoku: A bëjmë një provë të vogël si kur se jemi në provimet? Si të duash, i thom. Edhe filloj ajy të më pyesë. Unë s'i përgjigjesha mirë ose i përgjigjesha shumë keq. Ç'pate, më thotë? Ti s'ditke gjë! Kështu do paraqitesh në provimet? Më mirë mos del fare, më thotë.

Më kapi një siklet, një turbullim që mos e pyet. Unë të kisha kënduar aqe mirë e tani të mos dinja gjë? Si u mentova pak, i thom edhe unë shokut. A qëndron të të pyes edhe unë? Pyet sa të duash, thotë, jam gati.

Fillonj e e pyes ca gjëra të holla, më përgjigjej tjetër për tjetër. Jahu, i thom a i ke mentt në vënt? Zë pastaj e e pyes të lehtat, më në funt edhe definicjone. Edhe ato s'i theshte mirë. S'paske gjë në torbë as ti, i thom. Kështu do t'ju dalësh profesorëve? Të jesh i sigurtë se e meritokërke zeron edhe do të ta japin me shumë duartrokitje! Nuk vete të mbytesh? i thom.

Ajy ngriu në lëkurën e tij, po unë mora kurajo kur e pashë ashtu. Eja i thom në sallën e provimeve. Me azallah se dëgjonte. Hajde, mor teveqel, i thom, ashtu të duket po s'është gjë. Mezi që e hiqnja xvarrë gjer sa arthmë në Universitet.

Shokët t'onë, përmbi 200 vetë ishin grumbulluar atje e po n'a prisnin. N'a qortuan kur n'a panë, se u vonuam. I them unë më të mirët nga shokët, z. Leonidha Kostaqit, që s'kish 2 javë që kish dhënë provime e kish triumfuar: Leonidha, kam frikë se kështu e kështu n'a ngjau me Stafyllonë. Ajo s'është gjë thotë po ulu zëre vëndin shpejt se do vijnë profesorët e bën përshtypje të keqe.

Unë akoma s'po ulesha në fronin t'em, as shoku tjetër Stafyllaj; kishim frikë. M'atë ças vjen profesori i të drejtës Internacjonale z. Streit, më i riu nga gjithë profesorët, të cilin e kisha edhe mik të veçantë. Kur më pa: O! i dashur Floqi, ti sot këtu? Bravo. Ulu të fillojmë. Ulem nga dalë në vesh e i thom: Zoti profesor më ka hyrë një si frikë sot edhe s'm'a mban të

[1] le jeunes gens = të rinjtë (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

qëndronj në provimet. Bah, thotë. S'ke turp? Ti je nga më të mirët studentë këtu brenda e ke frikë? Pa ri, pa ri, leri ato m'nj'anë, unë s'i dëgjonj.

Nga turpi ndenja. Z Streit që të më inkurajojnjë më thotë t'i tregonj ç'farë themë që më pëlqen, ose që e di. Edhe me që unë ja jepja atij atë të drejtë si profesor, ahere fillon e më pyet thema të lehta, ku i përgjigjesha shpejt edhe mirë. Pastaj më të rënda, e më të rënda, tuke mbetur tepër i kënaqur nga përgjigjet që i jepnja. E sheh, më thotë se s'janë gjë provimet? Ja se ku të jap gradën më të madhe "4". A je i kënaqur tani? A të dolli frika? Falemi nderit fort, i thom, dhe më shtërngoj dorën tuke më uruar të dal faqe bardhë.

Gradat e Universitetit ishin kështu :4 = s'ka më mirë (shkruar greqisht por pëkthyer nga vetë autori H. K.); 3 = shumë mirë (shkruar greqisht por pëkthyer nga vetë autori H. K.); 2 mirë (shkruar greqisht por pëkthyer nga vetë autori H. K.); 1 = mesatar dhe pastaj vinte zerua 0.

Profesori i dytë që më pyeti ishte z. Kazagi, profesor i Filozofisë së Drejtësisë dhe i Ekonomisë Politike. Ky u enthusias aqe shumë nga përgjigjet mbi të dy lëndat, sa me kënaqësi të plottë më vuri përpara biletën me gradën 4 tuke më shtërnguar dorën e tuke më thënë se : "mjerisht s'ka gradë më të naltë se këtë për me ju dhënë zotris s'uaj, që e meritoni".

Këto fjalë më inkurajuan kaqe shumë, sa e mora për sipër. Mjerisht shoku im s' përgjigjeshe edhe aqe mirë. Mori nga një "2" nga të dy profesorët. Shumë herë çështjet që nuk i zgjidhte dot ajy, isha i shtërnguar t'i zgjidhnja unë.

Vjen profesori i tretë i së të Drejtës Administrative a. Angjelopullos. Ky ish njeri tepër serioz dhe shumë ja kishin frikën studentët, se s'e kish për gjë zeron. Më pyet mua mbi Gjykatoret Administrative, mbi Këshillin e Shtetit edhe mbi komunat. Kaqe mirë dhe sipas qefit të tij analyzonja sa edhe vetë ajy çuditej. Shkaku se në jetën t'ime praktike këto çështje i dinja si ujin e kripën. Pra, edhe nga ky mora gradën "4".

I katërti ardhi profesori i të Drejtës Romane, z. Polygjenis. Këtë po, e kisha shumë të njohtur, e kisha parë edhe në disa shtëpi aristokratike të Athinës, si dhe në shtëpi të Ekonomit në Pire, po me këto bashkë ju përgjigja mirë edhe në pyetjet që më bëri. Më dha edhe ky "4".

Vjen pastaj profesori i se Drejtës Eklesiastike, ose Kanonike, - Eftaksias. Ky ish një gentlemann dhe s'më mundoj shumë. Me gjithë që po thuaj se s'i thashë gjë, se më të shumtat i thosh ajy vetë, për çudi më dha edhe ky "4", që s'e meritonja as "një" për me folë të drejtën.

Vjen tani profesori i Procedurës Civile, plaku babaxhan Psaras e më pyet disa gjërra të forta mbi Procedurën Civile, në të cilën isha aqe i fortë, sa munt të matesha me gjithë studentët e Fakultetit t'onë. Ky më njihte mjaft mirë dhe e shëkonja për herë e më deshte. Mora edhe prej këtij "4".

Kisha marrë gjer tëni 6 katrëshë dhe isha kaq' i sigurtë se do mernja gradën më të naltë të doktoratit, sa si kur e kisha lidhur në shami. Në enthusiasm' e sipër s'më dukeshin gjë profesorët e tjerë. E kisha marrë shumë për sipër, kurse përkundrazi, shoku im Stefan Stafyllaj kishte shumë rënë jashtë dhe m'a pëshpëriti nj'a dy herë me nga dalë se do tërhiqej në të dy materjet e dyta nga frika se mos e rejetonin[1].

Mbi këtë enthusiasmë e sipër ia mbrrin profesori më i egër e më i ashpër nga gjithë profesorët e tjerë të Fakultetit t'onë. Ky ish Alqiviadhi Krassaj, që dridheshin nga ajy e kishin marë lahtarën gjithë studentët e Drejtësisë. Ishte njeri i çuditshim, njeri bizar që s'kënaqeshe kurrë, që vinte re edhe alën e zembrohej për as gjë. Njeri që kur të jepte zeron e kish për shaka të vogël. S'desh t'ja dinte as nga rekomandimet as nga gjë tjetër. Tamam po shihte ndo një biletë ose ravasaq rekomandues për ndo një student, ahere e merte djalli. S'e kish për gjë se t'a çnderonte të varfrin student përpara publikut, që s'di, që s'ësht' i zoti, që shkon i lutet njërit e tjetrit, atyre që kanë fuqi, sepse nuk ka besim në kapacitetin e tij etj. etj. S'kishte mik

[1] rejetoj = refuzoj, kthej mbrapsht, mbetem në klasë (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

njeri, as që munt t'i afroheshe e t'a zinje mik. Të ç'nderonte në mes të rrugës pa një pa dy. I këtillë ishte Krassaj!

Vjen pra gjakpirësi – se ashtu e quanin gjithë studentët – e pa n'a salutuar, pa n'a parë as në sytë, e qëndron përpara meje. Më sheh me sŷzet e tij vramûse me një inat, gjë që më kalli hethet me një herë. Më pyet nga jam, më kërkon gjithë dëftesat e profesorëve për të gjitha rendet e Universitetit. Më në funt më kërkon fotografinë bashkë me libretin e hyrjes në Universitet, si edhe numurin e regjistrimit. Pastaj qëndron. Më pyet shkurt një sent që s'munt të mos e dinja: "Shkaqet që thritet një njeri në trashëgim si trashëgimtar". Këjo s'kish ndo një filosofi. Gjë e lehtë ishte. Edhe unë ju përgjigja me një herë: Zotni profesor, shkaqet e trashëgimit që më pyesni janë dy "Ligja dhe Vullneti". M'a pret me një herë "jo". – Si jo? Këta janë shkaqet kryesore, "Ligja pastaj edhe vullneti". Jo, jo thotë! Deh, hall, deh, po kjo? Ishte e mundur të mos dinja një gjë elementare kaqe të lehtë? Prapë fillonj: Zoti profesor, më duket edhe insistonj edhe një herë se motivet janë këto që ju thashë, 1- Ligja simbas urdhërave përkatëse të trashëgimisë, 2 – vullneti i testatarit simbas novellës 118 të Justinianit. Jo, jo, jooooo! Më thotë prapë. Ato t'i thoni gjetkë, zotërinj e jo këtu në Universitet. Unë Krassaj ju pyes: Në qoftë se s'e dijni, thoni që s'e dijni, s'është turp. – Zoti profesor! S'ka, s'dëgjonj tjetër. E dini apo s'e dini? Thom: Zoti profesor, ju lutem, kam kënduar e studijuar aqe shumë sa s'më permetohet[1] të mos di një element trashëgimi kaqe të lehtë si këjy. Kam studijuar Kaliganë, Paparigopullon, Winscheïd, Dernburg, Wangerow etj. Me të parët s'kam punë, thotë, të tjerët Gjermanë janë profesorët e mij, s'ju jap të drejtë t'i zini në gojë se s'i kuptoni! Të gjithë i paski studijuar, thotë, përveç Krassajt. Ju pyes për të fundit herë ç'thotë Krassaj në librin e tij "E drejta trashëgimore"? – Zoti profesor, nuk ësht' e mundur të më pyesni një themë tjetër ku të doni? – Po ajy egërsohet fort edhe m'a pret me një herë : Mjaft! Nuk do t'a bjerr kohën me ju. Tjetri; edhe kthehet nga shoku im Stafyllaj, i cili i ngrirë nga frika, s'dinte se ç'theshte.

Aty ishin edhe 5 profesorë të tjerë, të cilët çuditeshin pse s'u kënaq me mua profesor Krassaj, me gjithë që, pas mëndjes së tyre isha përgjigjur mirë. Edhe shiheshin sy ndër sy. Midis tyre profesori babaxhan Psaraj më pa një herë në sy edhe tundi kokën, tuke shtënë buzën në gas, edhe zu të ngrihet të shkonjë. Un' ahere nuk bjerr rastin po me një herë i afrohem Psarajt e i thom: aman zoti profesor, folë nj'a dy fjalë për mua profesor Krassjt se më mori më qafë! Djali im, më thotë i shkreti Psaraj, akoma s'e njeh ti Alqiviadhin sa kokëshkëmp është? Të lutem profesor, thuaji dy fjalë, pastaj shko. Edhe Psaraj, për hatrin t'im kthehet e diç'ka i thotë në vesh Krassajt edhe ky tundi kokën. Kështu iku Psaraj, duke më parë me një bisht syri, e cila më dha mjaft kurajo në mes të atij dëshpërimi.

Krassaj si e pyeti shokun t'em, e si e fëlliqi funt e krejt se s'i tha gjë, i vuri një koxha zero përpara edhe u kthye prapë nga mua me një nënqeshje ironike. Zotni, më thotë, me qenë se u ankove te kolegu im z. Psaras, unë po të jap "Jus eligenti" të drejtën do me th. të zgjethsh cilën themë të duash e të të pyes mbi atë. – i përgjigjem: Zoti profesor "Jus eligenti" që më propozoni me rëzon shumë, se jam një student nga më të mirët të Universitetit në Fakultetin t'onë. Ju lutem më adresoni ç'faro do që të doni. Ahere, më thotë, nëm definicjonin e "Hereditatis petitio" (padisë trashëgimore), por hapni sytë mirë se e dua nj'ashtu si e kam përshkruar vetë në "Të drejtën trashëgimtare" timen. E dua të vernikosur, asnjë "edhe" të shtoni asnjë "virgull[2]" të hiqni. Ja recitova si jo më bukur. U kënaq. Kush është paditsi? Edhe këtë përgjigje ja dhashë mirë. – I padituni? Edhe këtë ja thashë bukuri! Po tue ja shpjeguar me hollësi, u kap me fjalën "pretendues". Ja shpjegonj. Jo, më thotë. Medet! Ja thom ndryshe. A! Tamam, tani e thatë mirë, thotë mjafton! – Të lutem, z. profesor urdhroni më pyesni më poshtë. – Mjafton, mjafton. Prej thojit, thotë, e njoha luanin edhe qesh sarkastikisht. Nxjerr syzet edhe shkruan në një copë karton numurin 1! Të mjafton? thotë. – Z. profesor, nuk u

[1] permetohet = lejohet (H. K.)
[2] virgull = presje (H. K.)

kënaqtë prej meje? Ahere na, thotë, edhe shton edhe1/2 fragmenti = 1 1/2! Ç' të thesha mbeta! Fillon të ngrihet po edhe mua s'më durohet. Mar pak frymë e tuke u ngritur edhe unë më këmbë i thom: Z. profesor, mbassi s'e dinja pyetjen t'uaj të parën, që "Ligja dhe Vullneti" janë shkaqet e thritjes në trashëgimi, a ju ësht' e mundur të më thoni mendimin t'uaj? Edhe ajy me kapellën në dorë më thotë këto që ta dëgjojnë edhe të tjerët nj'a 500 e ca studentë që nodheshin atje e popull burrash e grash si dhe familjet miq të z. z. Vullgaris, Zannos, Roche, Levidhis, Ralis, Vulpiotis, etj. njerës të shënuar të aristokracisë Athinjotë që kishin ardhur atje të më dëgjonin. Flet Krassaj: "Mso zotni, kandidat doktor i Drejtësisë, se shkaqet që thritet dikush në trashëgimi nuk janë si kishnit nderin më përpara të më theshnit "Ligja dhe Vullneti" (shkruar edhe greqisht H. K.), po "Vullneti dhe Ligja", po.... .... . "Vullneti dhe Ligja" (shkruar edhe greqisht H. K.).

Një brohori, një disaprovim, një këmbëtrokitje buçiti an'e mbanë nga studentët dëgjues, që u trondit gjithë salla! Disa manijakë, që s'e duronin dot atë xhelat, ja filluan vërshëllimit si të marrë; zhurma më s'gjente funt; burra, gra po flisnin, po bisedonin, po briheshin! Kassaj zembërohet fort, zgurdullohet, sbehet, mahnitet! Si pushoj zhurma kthehet me një ceremoni ngaj popullit dhe më fort nga studentët dhe ju thotë: Zotërinj, ju njoh të gjithëve që jeni studentë të kësaj dege dhe më ndjeni t'ju them se u nguttë shumë, se jeni djelm akoma!.... Gërrrr dërrrr këmbëtrokitje, vërshëllime, disaprovime e presin fjalën e fundit të Krassajt. Krassaj ahere fillon i egërsuar: Zotërinj, në qoftë se fola liksht, ahere qeshni mirë, po në qoftë se fola mirë, pse qeshni? Dëgjoni pra dhe merreni vesh diferencën e këtyre fjalëvet: Thashë "vullneti" më parë, pastaj edhe "Ligja", sepse pa vullnet s'ka testament dhe ligja i vjen ndihmës vullnetit të testatorit, edhe kjo ka rëndësi të madhe në pikpamjen juridike, për atë që i thotë vetes jurist, i cili duhet t'i verë re fjalët kur i flet. Këto thotë e del nga dera tjetër, pa kthyer kokën nga populli, i cili prapë kishte filluar të fishkëllejë e të kërcasë këmbët |

Që këtej munt të merret vesh ç'farë xhenabét[1], ç'farë tersené ishte Krassaj!S'mori mundimin as të më thotë "cili është shkaku më i parë" e kështu munt t'i thesha se është "vullneti", por m'a mori pa një, pa dy për gabim e për fill do më vinte një zero!

S'ka dyshim se të gjithëve ju ardhi keq për mua dhe me inat e disaprovonin Krassanë e vështirë që u suall aqe qenisht tek meje, pale për të shkretin Stafylla që e mori më qafë, i cili i jati ment qante. Dy herë u mat të tërhiqeshe po s'e lashë unë me shokët e tjerë. Kështu ndenji prapë.

Posa mbaroj kjo fusari filloj profesor Theofanopullos të më pyesë mbi të drejtën landore e obligatore. Mjerisht edhe ky ishte në orë të keqe; i kishin hipur xhindet. Më pyet një themë, ja thom , s'kënaqet. Më pyet një tjetër, i përgjigjem, as ajo s'e kënaqi. Po halli? Më pyet për të katërtën herë me inat: Edhe këtë thotë, edhe mjaftojmë. Ja shpjegonj. Nuk më thua zotni, thotë, se s'ditke kurrgjë? – Unë? i thom, kini gabim, zoti profesor, kam kënduar aqe shumë sa s'bëhet. – E shoh, e shoh, thotë s'është nevoja të ma thuash. Dhe mbassi pyeti edhe Stafyllanë, n'a ve edhe ky nga nja "1" e shkon me rëmbim.

Sjellja e këtij shtrigani më solli në një dyshim. E shoh që të dy këta maskarenj më rëzuan shumw. Durova të pyetem edhe nga të tjerët dhe ishin akoma 4 profesorë gjer sa të mbaronim. Ora ishte 12 e mesditës dhe provimet po vazhdonin. Vapa shtërngoj fort; disa profesorë ankoheshin se shkoj koha e drekës, po fajin e pati Krassaj e jo né.

Fillon e më pyet prof. i së drejtës penale Kostiu. Në krye vinim mirë me këtë, pastaj zu më ngatrronte. Si s'e kënaqja mirë zû të më mundonte më tepër. U turbullova, s'dinja ç'i thesha, fund i fundit u çudita kur më dha një "2". Bereqet versen!

Më pyet m'andej profesori i të drejtës komerciale Dhamaskinos. Edhe ky gati sa s'më vuri zero. E kisha humbur si Xhaferi simitet. S'e kisha mëndjen. Gjith'ajo anthusiazmë më dolli e thartë. Mezi më dha edhe ky një dyshkë. Shoku im nga ana tjetër merte njëshka. Si e pa

[1] çenabet = jo i pastër, i ndytë, i fëlliqur (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

kështu, mori raqet e shkoj tuke deklaruar se po tërhiqet për me dhënë provime pas 6 muajsh. E kish të drejtë me ligje të tërhiqej në të dy materjet e mbrame.

Tani na ardhi plaku sympathik Stefan Streit, i ati i George Streitit. Ky do më pyeste mbi "Të drejtën konstitucjonale". Fillova e po përgjigjesha mjaft mirë; zura të përkuranjohem dal nga dalë, sa vajti ora 2 e 1/2 ; ju përgjigja fort bukur. Më vë një "3"atje ku kujtonja se do mernja "4" edhe nga ky.

Si mbaruam me këta dhe populli po thuaj se u shpërnda, përveç nj'a 15-20 miq të mij dhe ora po vinte tri e më s'kish të dukesh profesori i fundit N. Dhimaras, dërgoj dekani i Fakultetit e e thirë nga shtëpia. Kur ardhi ju tha se s'muntte, edhe makar të mos e kishte sjellë kokën se e solli. Vjen i xhindosur përpara meje se i prisha qetësinë dhe fillon të më pyes me egërsi. Më preu gjakun. Ju luta së parit të më pyeste nga dalë, se s'e mernja vesh ç'desh të thotë. Ajy egërsohet edhe më tepër. Zë më pyet gjërra që as i kisha parë, as i kisha dëgjuar, disa hollësi historike mbi "Lex Aquilia", mbi "Lex Duodecim Tabullarum", mbi "Senatus Consulta" e mbi "Libribens e Emanei paccio", etj. etj. Sa do që çeç përtypesha, ajy s'pranonte asgjë. Më pyet hollësi mbi historinë romane, mbi introductiones, mbi Novelae, Pantectae, etj. etj. dhe si e pa që e humba ngrihet të shkonjë me inat. Zoti profesor, i thom, nuk do më vini ndo një gradë? – Gradë? Do edhe gradë? Kur dashke gradë, thotë, ahere urdhëro. Shënon në një nga biletat kartoni që kishte përpara një koxha "zero" dhe ikën pa thënë gjë!

E pashë se më fiku, më theku, më shduku, qerataj. Po tani? Kthehem i dëshpëruar nga shokët! Ca më theshin s'ka gjë do marrësh të paktën një gradë lycencie endoit (shkruar edhe greqisht H. K.), ca më trempnin se do më refuzonin krejt! Isha në një siklet të math, se përveç turpit, do prisnja edhe 6 muaj akoma që të munt të jepnja provime. Shokët po më ngushëllonin. Më jepte shpresë vetëm ajo që mora 6 katëra dhe 1 trizë dhe kujtonja se s'ish e mundur të rejetohesha. Ç'farë do gradë të mernja e pranonja.

Pas 1/2 ore delnin përfundimet. Në hajatin e math afër dhomës që çkëmbeheshin bisedimet për gradimet t'ona mund të ishin për mbi 1. 000 shpirt, se atë dit në sallat e ndryshme kishin dhënë 12 veta provime, prej të cilëvet 2 ishin tërhequr. Njëri prej tyre ishte dhe Stafyllaj.

Nuk munt ta përshkruanj dot agoninë e asaj gjysëm ore. M'u duk si kur ish një shekull! Zembre po më rihte fort; djersë më përshkonin trupin; më dukej se kisha hethe; s'isha ndër vete!

Më së fundi hapet dera e sallës. Del një sekretar i Universitetit bashkë me një ftuës të shkollës s'onë. Sytë t'ona vërviten tek ata të kurreshtuara fort; s'dëgjohej zë, as kollej njeri, as tundej nga vëndi. Të gjithë mbanim frymën. Sekretari ka buletinin e rezultateve në dorë. Fillon. Ajy i dikton nga dale ftuësit dhe ftuësi thret me zë të naltë. Si numuroj të dy të tërhequrit Stafyllanë me Megaklinë pason: Radho Kanaqis. . . lycencie! (shkruar edhe greqisht H. K. d. m. th. jo "doktor" po gradën më të vogël) Nr. 4 Koronaios.... prapë lycencie Nr. 5 Passaris . I rejektuar (shkruar greqisht H. K.) Medet! Psherëtiva një herë!. . . Mikelopulos. . . i rejektuar. . . Po, po, po! Tash po vinte radha ime. Nr. 6 Nikolakopulos. . . i rejektuar. . . Aman bre!! Po halli? .... . Zorbas .... lycencie.... Mora frymë. Nr. 7 Floqis.... O Hŷ e Savaoth[1], zembre po më ikën krejt. Sa arrinj të mendohem, dëgjonj me një herë ".... . . " (shkruar greqisht H. K.) ( "Doktor i Drejtësisë"). Bravooooo! Bërtitnë miqt' e mij edhe më rëmbyen për një herjash ndër duart e tyre e s'pashë si dolla jashtë.

Nuk di ç'u bë me të tjerët, po më ardhi shumë keq për ata që u rejetuan. Ajo ditë paske qenë një ditë e keqe, po lavdi Zotit që shpëtova faqe bardhë.

[1] Sabaoth = në Testamentin e Vjetër shprehje që e celebron Perëndinë si kapiten të ushtrive të Israelit, më pas hyri në liturgjinë katolike në kuptimin e kapitenit të ushtrive qiellore, kurse sot Perëndia e Universit por jo emri i Perëndisë se Perëndia nuk mund të ketë emër tjetër (H. K.)

Atë ças ç'ndjeva dhe aqe gëzim me gjithë që ishte çashti më i lumtur i jetës s'ime, se isha i turbulluar, por se s'më lijnin edhe shokët, të cilët ndjenin një gëzim shumë të math për mua.

Më tepër se 50 telegrame ju dërguan t'im 'eti nga shokët e mij e deputetët e Karvasarasë. Zoti Roche më thirë të nesërmen më gosti ku kish ftuar edhe disa persona për nderin t'em. Gjithashtu më thiri për darkë edhe deputeti i Mesollonjës e Ministri i P. Jashtme të Greqisë z. Leon Deligjorgji, si edhe Komandanti i përgjithëshëm i Gjindarmërisë Greke generall Andre Stratua, që ish prej Karvasaraje dhe hynja e delnja si i shtëpisë në familjen e tij, mbassi ishim edhe shokë me të birin e tij Niko Straton, që duke qenë ministër bashkë me Gunarin, Theotaqin, Balltaxhinë, etj. u dyfeqosnë[1] për tradhëti të naltë në Athinë, ndonse ishin të pafajshëm, por se ishin Royalistë e jo Venizelistë.

Unë akoma s'e kisha lajmëruar t'ëm 'atë që u gradova Doktor i Drejtësisë. Me gjith'atë mora 30 e sa telegrame urimi nga shtëpija e shumë miq të tjerë.

Dy a tre ditt kështu shkuan gjithë me ahenge e shetitjë posht' e lart me 5-6 karoca e me piknike ne disa fshatra të Athinës, si në Amarus, Qifisja, Galaci, Hallandhri, Qesarjani e gjetkë.

Tash pra u realizua edhe ëndra ime! "Mieux vaut tard que jamais" thotë francesi, më mirë von se kurrë. Pra edhe unë u vonova, e kisha prerë krejt shpresën se do shihnja Universitetin e do delnja q'andej me diplomë po te e mbramja e fitova.... (ndoshta frontin H. K.) Ç' bën vullneti, ç'bën! Tani s'munt të më qortonte njeri dhe jo vetëm të më qortonte, po edhe s'munt të mos çuditeshe me këtë ndryshimin e fatit t'em.

Për fat, midis miqve të mij që glendismë ato dit ishin edhe dy miq të tjerë, njëri prej Karvasaraje, student i Medicinës dhe tjetri prej Arte student i Drejtësisë, z. z. Dhemosthenis Karajanopullos edhe Aristotelis Lytras, tamam ata të dy zotërinj, që si kam treguar tjetër herë në rrjedhën e kësaj historije, që s'më bënin kabull, të më kishin në redhin e tyre se ata ishin studentë Universiteti edhe unë një copë bakall! Tani shih si e solli Dialli, unë të mbaronj Universitetin e të dal Doctuer en Droit dhe ata të jenë akoma studentë, të qëndrojnë plot 7 vjet në Athinë e të mos mundin të japin provime! S'është çudi këjo? Lytra kish dhënë provime dhe ish rëzuar. Dhe pa ju thënë unë gjë, atje ku ishim mbledhur tok, bash atë ditë që dhashë provime, më s'ju durua Aristotel Lytras dhe tha : Një ditë jemi sjellë shumë liksht përpara z. Floqi, kur ky ishte bakall në Karvasarâ dhe ju lëvduam se s'kish të drejtë ajy të ishte në shoqëri t'onë, se ne me Karajanopullin ishim studentë. Pa shihni një herë se si e pruri fati, z. Floqi të prokllamohet sot "Doktor i Drejtësisë" dhe ne me Dhimosthenin të jemi akoma studentë! Na zuri gjynahu! Tani lipset z. Floqi të mos n'a pranojë ne në shoqëri. Unë s'ju përgjigja gjë, por ndërhynë shokët e tjerë e i ngushëlluan.

Si ndenja një javë në Athinë, dhashë edhe maturën, një libërth prej 120 faqesh mbi të drejtën ndërkombtare. U aprovua libri im dhe më thirë përpara syllogut[2] të profesorëve ku ish edhe Dekani i përgjithëshëm, ose Prytanis i Universitetit dhe trashëgimtari i fronit mbretnor të Greqisë princ Konstandini me të shoqen, princesën Sofia dhe princit e tjerë Nikollën e Andrenë. Si dhashë benë zyrtarisht më përgëzuan me radhë gjithë profesorët e mij, si dhe princesa Sofia e princit e tjerë më dhanë dorën. Prytanis ose Kryepari i Universitetit mbajti një fjalë të shkurtër. Pastaj u ngrit edhe Dekani (shkruar Greqisht H. K.) profesor Krassaj i cili bëri fjalë mbi shqencën hynore të drejtësisë e mbi barrën e rëndë të një juristi, ose juriskonsulti përpara shqencës e shoqnisë njerzore. M'andej mbaroj, tuke më zgjatur dorën, tuke më përhiruar edhe një herë e tuke me quajtur "camarade" (Shkruar edhe greqisht H. K.).

Si mora dhiplomën ndenja akoma në Athinë edhe dy javë. Midis miqve kisha edhe dy të tillë që njëri ish student në Fakultetin t'onë, Jan Triljas nga Athina dhe tjetri Efthim Xhimikali, prej Vrahorit, që sot është generall në Greqi, i pari ishte pagëzuar prej

[1] dyfeqosnjë = pushkatuan (H. K.)

[2] syllog = mbledhje (përkthyer me google nga greqishtja H. K.)

mbretëreshës Ollga të Greqisë sepse i ati ishte Champelan në pallat dhe i dyti Thimio Xhimikali ishin shokë në shkollën ushtrijake me princin Andrea të Greqisë.

Kësi soj m'u dha rast të vete disa herë në pallatin mbretnor dhe në Tatoë me Jan Triljen, i cili ishte shumë mik me princ Nikollën, se losnin që të dy qitharë të mirë. Me këta u shoqërova disa herë dhe unë me anë të instrumentave. Me Thimio Xhimikalin që isha që në vogli mik, vajta veçanërisht disa herë në pallat. Ajy më kish rekomanduar te princ Andrea dhe te princ Gjorgji. Njëherë u ndothmë edhe në vallen mbretnore. Vetëm princ Konstandini ishte i egër e s'munt t'i afroheshe dot. Të tjerët ishin shumë të begendisur e të buta.

Kështu ato 15 ditë që ndjenja në Athinë s'lashë vënt e mik pa parë. Vamë edhe në pallat të Tatojit (shkruar edhe greqisht H. K.) me Triljan ku ndenjëm një natë në shoqri me princit Gjorgjin e Nikollën.

Mbas 15 ditëve nisesha për në Karvasarâ, po thash t'ju bënj edhe një vizitë te shtëpia e Ekonomit, që e hiqja si shtëpinë t'ime. I lashë plaçka në dyqan të babajt të Vangjelit, Kostandin Ekonomit dhe vetë vajta në shtëpi të tij në Freatidhën e Piresë. Po atje zonja Ekonomi dhe djelmt' e vajzat e saj më mbajtnë me do e mos në shtëpi. Kështu pa pandehur kam ndenjur plot një javë edhe në Pire ku kemi shkuar extra.

Nisem nga an'e Patrës e dal në Mesollonjë. Atje përveç që kisha motrën e babajt Zoitsën, që ish installuar që kur ish gjall i shoqi, si dhe kushërinjt e mij Efgjeninë dhe Sotiraqin, po kisha edhe një stan miq e avokatë të cilët më kanë mbajtur dy dit dhe shumë më kënaqnë tuke më çfaqur përgëzimet më të sinqerta. Ah, sa miq zë njeriu n' atë moshë të ëmbël dhe si i duken të gjitha shesh e lule! Ah, jeta e studentit, vlugu i moshës së trëntafiltë.

Më në funt ja pashë sytë edhe Karvasarasë. Më pritnë me shumë të madhe enthusiasmë. Jashtë qytetit munt të ishin për mbi 100 shpirt miq e Shqiptarë të tjerë. Kur vajta në shtëpi im'atë, im' e më, teto Ndinua, im vëlla qanin nga gëzimi. Oh, sa ishim të lumtur ato ditt! Ju kisha sjellë edhe peshqeshe mjaft. Vetë kisha 6 palë roba chic, 5 palë këpucë gjithfarësh, 3-4 kapella, dhe një bylyk kollare e gravata e shami të mëndafshta e gante. Më kishin mbetur edhe akoma 5. 000 e ca dhrahmi që i mbanja për sipër e që s'i dinte as njeri.

Esht' e tepër të shtonj këtu se një javë po thua, s'pushoj shtëpija e j'onë nga të hyrat e të dalat e vizitorëve, nga miqtë, fshatarët që na vizitonin nga fshatrat edhe më fort nga kumbarët e ndrikullat që vinin n'a uronin edhe n'a sillnin edhe peshqeshe. Mezi pas një jave mblothmë mëndjen.

## IX

Pas dy javësh që ardha nga Athina, hapa një zyrë tjetër në piacën e Karvasarasë, e pasurova me libra juridikë të lidhura me ar e mobilla të tjera. Mjerisht në Karvasarâ ishin bërë gjer ahere 7 avokatë, prej 3-ve që lashë unë, dhe kishin një konkurencë aqe të madhe me shoqi-shoqin, sa nuk nxirnin as nga 150 dhrahmi për shoqnë në muaj. Disa s'nxirnin as 100! Unë, që tjetër kisha fituar edhe 600 dhrahmi në muaj, tani s'nxirja as 80! Mezi që e arrinja qindin.

Këjo ish një problemë e madhe për mua, i cili tani kisha edhe dhiplomë. Ato që nxirnja s'më sosnin as për vete dhe hanja në shtëpi në kurriz të t'im 'eti, i cili fitonte 300-400 dhrahmi në muaj se kish vënë një sërë të mirë prej të hollave që i dhashë për dhogat e mira e skarta që i bleva për hesap të Zanno-Roche-s. Me gjith' ato i jepnja edhe unë nga 80 a 100 dhrahmi në muaj, qinse më tepëronin nga fitimet mujore, po e drejta ishte që aqe të holla unë s'nxirnja gjithsej në muaj, po e bënja që të mos i vinte rëndë t'im 'eti, e bënja edhe nga turpi që më vinte që s'kisha punë si duhej.

Në atë kohë ardhi edhe Mantho Gavallaj nga Athina e ngarkoj të 50. 000 dhogat e kaparuara për fabrikën Zannos-Roche, prej të cilavet mbassi unë qërova hesapin për 60 leptë copën e dhogës në vënt të 1 dhrahmisë që i kish blerë prej meje fabrika, për posë një fitimi të

math që i teproj t'im 'eti, po veçanërisht më mbetnë mua 18. 000 dhrahmi dhe nj'a 3. 000 kisha të tjera që bëheshin 21. 000 dhrahmi. Këto s'i dinte njeri.

Po brenda më 6muaj të tjera që isha në Karvasarâ nuk di se si më shkuan 4. 000 dhrahmi prej këtyre. Kisha ndarë edhe disa hua andej këtej, prej të cilave s'mblodha gjë; shkuan të gjitha.

Si e pashë që s'kisha punë në Karvasarâ, shkova prapë në Athinë dhe me miq u emërova kryesekretar i tribunalit të Mesollonjës. Aty mernja 200 dhrahmi në muaj, po prishnja për të rrojtur mirë, si edhe me shokët e mij për mbi 400 edhe dikur edhe 500 dhrahmi në muaj, një shumë kolosale këjo për një njeri dhe sidomos për atë kohë.

Dhashë dorëheqjen dhe qëndrova avokat, tuke u bërë shok me një avokat tjetër Mesollongjit Panon Stajkon. Që andej pas ca kohë vete në Patër në zyrën e ish Kryeministrit të Greqisë Dhimitri Gunarit, për praktikë më të gjërrë në Appelin e Patrës, se Gunaris ishte ahere korona e avokatëve grekë.

Kështu prisha mjaft të holla gjer sa u ktheva prapë në limerin e parë të Karvasarasë. Në këtë udhëtim më ngjau edhe një episod.

Kur u nismë nga Patra për në Zaqintho udhës, nga mesi i natës trakarim me një karaf italjan që vinte i ngarkuar nga Malta. Gabimi ardhi nga gabimi i kapitanit i karavit, një italjan sarahosh që atë natë ish i dehur sknipë dhe s'e drejtoj timonin mirë, kështu që vapori që ishim ne "Epiros" i ra e bëri copë edhe fundosi në det dhe u mbyt. Naftët dhe kapitani me të shoqen gjithsej 10 shpirt shpëtuan mrekullisht, se kapitani t'onë urdhroj me një herë dhe lëshuan barkat dhe shpëtuan.

Çudi e madhe ka qenë me të shoqen e kapitanit të karavit. Ajo kur po mbytej karavi arriu e u zu pas ankorës së vaporit t'onë edhe nga fustëni i s'ëmës mvarej i biri i saj 8 vjetsh, i cili ishte për gjysmë në ujë. Për 5 minuta të mos i kishim arrirë do të ishin mbytur që të dy!

Si mbaroj kjo poterë e filluam të pasojmë rrugën, dikush prej pasaxherëve të vaporit pa një trup, si trup njeriu mbi det që po luftonte me valët. bërtet dhe qëndron vapori prapë. Lëshojmë dy barka me 4 naftë, të cilët u afruan pranë të mbyturit, edhe një prej naftëvet e kapi. Kur oh!.... thiri një herë se i mbyturi e kafshoj në dorë. Ishte qeni, një alamet qen rojtar i karavit që u mbyt.

Si ardha në Karvasarâ e ndenja ca dit, e si e pashë që s'më bënte zembra për punë, nga ana tjetër kisha edhe ca mijë dhrahmi akoma përsipër, që më rëndonin xhepin. Ç' të bënja tani? Më ra ndër mend sikur të bënja një udhëtim gjer në Korçë, mbassi kisha 14 vjet t'a shoh edhe kaqe tepër më kishte marrë malli.

Im 'atë s'deshte të më linte, po mbassi e pa vullnetin t'em, i cili tani isha burrë 27 vjetsh, më la, me premtimin se s'do vonoja më tepër se një muaj e do kthehesha.

Ishtë viti 1900, nga muaji i Marsit. Nisemi me kartoforin dorëhar Kristo Gjymin dhe shkuam nga an' e Nartës tuke u drejtuar në Janinë.

Në Janinë ramë në një hotel të vogël. Posa lamë plaçkat në një odë , unë dolla jashtë ku u poqa me disa miq. Një prej tyre më thotë të bëjmë një shëtitje mbi liqenin e bukur të Janinës e të mernim karavidhe të pjekura nga nisija e Ali Pashës e të vinim të hanim në mburimin me nam "Trabatova" me atë ujin aqe të ftohtë dhe kështu më bindi e u nismë.

Ishte një zembër-herë[1] e këndshme, ndonse ishte ftohtë. Vamë mirë gjer më Trabatova dhe hëngrëm karavidhe të pjekura dhe ndejmë sa u tëher. I thom mikut, munt të shkojmë, mbassi edhe lundra e vogël po n'a priste. Por ajy m'a pret se do ishte mirë të bënim një shëtitje të vogël nga ana e tokës, tuke shkuar nga vëndi "Perama" se do kënaqeshim shumë me vëndet e bukura që do shihnim rrotull liqenit. I thom, mos është lark? Jo, thotë, 20 minuta dhe s'andejmi në Janinë të tjera 10 minuta. Po do kënaqesh më thotë. Pa ndezur akoma dritrat do jemi në Janinë. Dhe i jep urdhër lundrarit të ikë.

[1] herë = erë (H. K.)

U nismë nga Trabatova tuke fjaluar. Po ajy teveqel s'e dinte rrugën se nuk kish shkuar as një herë s'andejmi. Nuk dinte as sa lark mbahej vëndi Perama i cili ishte 1 1/2orë lark nga Trabatova edhe q'andej në Janinë tjetër një orë që bëheshin 2 1/2orë, që miku im m'a tregoj vetëm për 1/2ore.

Dal nga dalë u ngrys dhe udha s'dukeshe aspak. Tuke kaluar hasim një kope dhënsh, nga e djathta e jonë, po nga ana e pllajasë (kodrinës), aty na lëshohen dy qena të mbëdhenj stani dhe s'kishim me vete as armë as bastun, as unë as ajy, po s'gjenim as gurrë rotull të mbroheshim nga qenat. Nga të mbroheshim? Me se t'i ndiqnim qentë? Ku të iknim? Miku thret me dëshprim çobanët e kopesë, të cilët as që dukeshin gjëkundi. Unë bënj të ikinj nga an' e mëngjër se më dukej se do gjenja gurrë të mbrohesha, dhe bije mbi një llom, më një kënetë të thellë gati gjer mbi gju! Mbeta atje se sa më tutje shkonja më thellë futesha. Këtej s'guxonja të dilnja se kisha qenat që po lejshin dhe kur e pashë se s'vinin dot gjer ne mua se mbyteshin në llom, e pashë se qenat ishin të mençur se e njihnin vëndin, po edhe unë kisha shpëtuar nga dhëmbët e tyre.

Mikun Spiro – se Spiro i theshin atij bufi se ishte dhe profesor në gjymnazin e Janinës – s'e shinja gjëkundi afër, po as që dukej. Nuk shkoj një minut qysh se rashë në llom, po kur dëgjoj një zë, si të ngjirur, si të çjerrë, një zë dëshprimi të një njeriu që e mundonin, ose e thernin. Të shkretin profesor, një prej atyre qenve e kish vënë poshtë dhe ment e çqyente! Për fat të ti u lëshuan dy çobenë të vegjël dhe mezi i kndjellë afër tyre të dy qenët dhe i mbajti lidhur, kurse tjetri ju afrua profesorit dhe i dha dorën, pastaj tuke dëgjuar edhe bërtitjet e mija vijnë që të dy atje ku isha unë dhe bariu i vogël më tregon vëndin nga të dal e kështu mezi dolla prej atij taksirati! I thom profesorit të kthehemi se do mos vemë dot në Janinë edhe unë të nesërmet do shkonja herët me karvanin e qiraxhinjve për në Korçë, po ajy skollastiku insistonte të shkonim nga vëndi "Perama" se ishim më afër.

Këtë dyshim n'a e ngriti bariu i vogël i cili n'a thotë se te "Parama" ishte një orë e gjysëm lark që andej dhe deshim edhe një orë që andej të vinim në Janinë. Kështu mezi u bint ajo kokë xhorrë të ktheheshim prapë në Trabatova.

Me shumë vështira u ktheym. Mirë u kthyem, po tani me se do vinim në Janinë? As lundrë as lundrar gjëkundi. Kemi ndenjur atje gjer më orën 3 të natës tuke thirur lundrarët nga nisia e afërt e Ali Pashës e tuke pritur. Dha Zoti e u dëgjua një zë përtej që i përgjigjeshe zërit të profesorit. Po që të vinte atje e të na merte e të n'a çonte në Janinë me lundrë deshte një mexhitkë të bardhë, që profesorit që ish tepër çingun[1], i dridheshe dora se ishte msuar me groshaqe të vinte në Trabatova. Po lundrari kish të drejtë se ky ish një shërbim nate i jashtëzakonshëm dhe simbas rregullit të varkarëve duhet të paguhej një çikë më shtrenjtë.

Ahere i bërtas unë lundrarit të vinjë shpejt se po e paguajm sa deshte. Kështu u nqas lundra dhe hymë që të dy brenda, tuke qenë që të dy në ditën e hallit, unë i mbytur në baltë dhe ajy i kafshuar nga të katër anët prej balikut gjaksuer të kopesë.

S'është nevoja të thom se tuke ardhur udhës s'i lashë gjë pa i thënë atij mikut budalla që mënt n'a mori më qafë. Ajy, tepër i penduar, më kërkonte ndjesë sa herë që e shanja.

Arthmë në Janinë dhe shkova në hotel në odën t'ime, u ndrova shpejt, hëngra darkë me ç'gjeta edhe të nesërmet me një orë të gdhihet iknim nga Janina që të munt të arrijnim Leskovikun.

Mbas shume mundimeve e pocaqive që hoqmë udhës 13 orë plot mbi kalë qiraxhinjsh ju afruam dritrave të Leskovikut, të cilat sa do që n'a dukeshin shumë afër na u pa sikur bëmë një javë udhë gjer sa i arrijmë dhe u futmë në hanin e njohur të qiraxhinjve. Ishim 8 udhtarë dhe 2 qiraxhinjtë të një beu. Atë natë që ramë në Leskovik u thira për darkë në një shtëpi që kish martuar ato ditt të birin e tij. Si ndejmë gjer nga mezi i natës shkova pastaj në han dhe të nesërmen u nismë për në Ersekë. Tuke kaluar nga katundi Shalës n'a zë një dborë, një tufan,

[1] cingun = koprac, dorshtërnguar (H. K.)

një kijamet. Dbora binte me copra, rruga dal nga dalë po mbulohej me dborë e kuajt nuk shihnin ku të shkelnin.

Sado që lamë monopatin e duallm në rrugën e madhe prapë se prapë nuk udhëtoheshe. Mezi që arrimë në Barmash dhe u futmë me njerës me kuaj në një kishë të vjetër të shembur afër rrugës, e cila, lavdi zotit, kish një copë çati e kështu qëndruam pak të marrim frymë.

Si ndejmë nj'a dy orë prani pak dbora po gjer ahere kish rënë më tepër se dy pëllëmbë dborë. Malet, fushat, rruga publike, pyjet ishin zbardhur krejt. Ngarkojmë kualt e pasojmë rrugën me anën e xhadesë. Po nuk shkoj gjysmë ore e t'ja thuri një tjetër dborë e keqe me tufane, që ruajna o Zot! Kuajt të lodhur nuk deshin të avancojnë; dbora, era n'a përcëllojnë sytë, po thuaj se n'a verbojnë. Ç' kemi hequr gjer sa u sosmë në katundin Borovë të Kolonjës, nuk rëfehen dot. ndejmë në Borovë në shtëpi të një miku gjer sa u ngrys. Po mbassi nuk kishim vënt për kuajt dhe s'munt t'i bëheshim havale mikut t'onë, i cili u suall aqe fisnik ndër ne, edhe me qenë se Erseka s'ishte edhe shumë lark, u nismë prapë në mes të asaj dbore e motit të keq e me një mijë aventura e mjerime mezi sosmë në Ersekë.

Hanxhiu, në han të të cilit ramë, z. Prodani, posa n'a pa që ishim qull dhe mezi mbaheshim më këmbë, dhe me qenë se ishte miku i vjetër i t'im 'eti, n'a pregatit me të shpejtë 2 mangaj të mbëdhenj me qymyr trazmë dhe për dy orë mezi u thamë. Në atë koh' e sipër na serviri 3-4 lakra arme turshi extra me vaj, limua e piper të kuq Bukove, e n'a dha edhe nga një gotë të madhe lënk armoje, një farë nektarit për të mos harruar kurrë. Unë kisha 14 vjet t'i ngjeronja[1] ato gjëra, prandaj edhe s'nginjesha së ngrëni e së piri. Për mbi ato më qiti edhe një shishe raki manash të Boboshticës, që kështu kombinacjoni u plotësua mirëfillit.

Si hëngrëm mirë me ca fasule extra Kolonje, kërmidha të tiganisura dhe tarama (havjar) me kulaçe të ngrohtë të çerepit, ose carranit si i thonë gegët t'onë, edhe si pimë një verë të vjetër të Negoshtit, i haruam të gjitha vuajtjet e asaj dite dhe ja shtruam me pralla dhe muhabete gjer nga mezi i natës. Unë ndjenja aqe një enthusiasmë të madhe atë natë që ju afruash Korçës sa s'më merte as gjumi.

Mezi që fjeta nj'a 3-4 orë. Posa u zgjova, qëndrova pranë mangallit që kish akoma zjar dhe si nuk më flihej e më dukej nata shumë e gjatë sqova nga gjumi qiraxhinjtë, tuke ju dhënë nj'a dy mexhite turke e kështu ngarkuam me një orë të gdhihet dhe e lamë Kolonjën, me gjithë që protestonin shokët e tjerë.

Do t'a mollojis[2] sa të rronj atë të ftohtë të keqe e të tmershme që kemi hequr gjer sa duallm në Kullën e Qarit. Përveç rrugës që ish mbuluar me dborë dhe vënde vënde përdornin qiraxhinjtë edhe lopatat që qëronin dborën se mos gremiseshim në ndo një hendek a gropë; po nuk duroheshe edhe ajo e ftohtë aqe e madhe që të priste por si brisku. Na u thanë duart edhe më fort këmbët. Shumë herë zbrisnim nga kuajt e barisnim mbi dborën, që ishte ngrirë e bërë gallgan, si e si të ngroheshim nga pak se n'a krojti prej zembre cingërimi i sabahut. Thamë se po mbetmë atje!

Mbi Kullën e Qarit shkrepi edhe reza e Diellit. Me gjithë që ishin ngrirë për palcë prapë ato reze Dielli n'a ngushëllonin mjaft. Drita zbarthte e shkëlqyer e e kandëshme dhe Qielli shkëlqente si një pasqyrë kristali e llagartë.

Tani po shëkonim së largu edhe Korçën e bukur, Korçën plakë e historike, për të cilën aqe e madhe nostalgji më kishte përfshirë shpirtin e mëndjen.

Lumërisht dbora shtrihej gjer në rëzën e Qarit. Fusha e Korçës s'e kishte shijuar akoma mezen e Gorenit[3]. Në disa vënde gjelbëronte nga pak bima dhe diku andej e këndej katundeve të Korçës të asaj ane dallonte nga ndo një dru thane me burbuqe të endura. Kaqe u mallënjeva atë ditë sa më shkonin lottët sysh padashur.

[1] ngjeroj = provoj a shijoj diçka, (H. K.)
[2] mollojis = mbaj mend (H. K.)
[3] goren = erë e veriut, dëborë e madhe me erë të fortë (H. K.)

Kur u afruam afër Floqit t'onë zbrita nga kali e putha tokën, atë tokë aqe të bekuar, tokën jetike të katragjyshëve të mij, dhe me një herë më shkuan nga mëndja si një fillmë qinematografi gjithë peripetit' e jeta e stërgjyshëve, si i tregova në vijim të kësaj historije.

Muarm prapë fushën dhe ora më 10 para dreke arthmë në Korçë. Bashkëudhëtarët e mij shkuan me qiraxhinjtë nga ana e çarshisë dhe unë, hipur mbi dorinë t'em hoqa drejt për drejt në shtëpi të xhaxha Ligor Mitkos.

Zbrita nga kali përpara portës, portës së vjetër të Mitkollarëve, e cila numëronte një zeman[1] afro dyqint vjetsh. Hyra brenda bashkë me kalin e ngarkuar, dhe mbassi s'gjeta njeri përpara, as jashtë as brenda, e hoqa kalin në një ahur të vjetër të shtëpisë, çkarkova dy valixa që e kisha ngarkuar dhe i solla brenda në sobë[2].

Shoh andej këndej s'ka njeri. Xhaxha Ligori ishte në çarshi se ish ditë pazari, e shoqja e tij, tezja Viktorja kishte shkuar në furrë me një drrasë me çyrekë, ime gjyshe, e ëm' e s'im 'ëje esh edhe ajo në çezmën e Haxhimborjes aty afër me disa plaçka të vogla për të larë, fëmij' e xhaxhait më të mbëdhenj Theodhora ose Dhorka edhe Vangjeli ishin në shkollë edhe vetëm çupa më e vogël, ime kushërirë Ollga ishte lidhur në djep e po flinte, si një fosnjë 8 muajshe që ishte.

Unë hyra brenda në sobë, nxora festen, çantën, pagurin, me rhum dhe dylbinë që kisha përsipër, ndeza një cigare e u afrova pranë zjarit. mbylla edhe derën e sobës që e kishin lënë hapur dhe shëkonja andej këndej shtëpin' e t'em 'ëje dhe m'u mallnjye zembra pas kaqe vjetsh pa e parë, pse, po thuaj isha ritur edhe unë në atë odë dimbri antike.

Nuk njihnja asnjë prej kushërinjve e kushërirave, se s'kishin lindur kur ika unë. Këto e shumë të tjera mendonja dhe po trazonja zjarin me mashë.

Nuk shkuan 5 minuta dhe u duk tezja Viktoria me një mësallë e një qilimkë nër duar që kishte mbuluar çyrekët kur i çoj në furrë. Po sa hyri brenda në hajat, dhe me qenë se doriu im kur hymë brenda ju kish mbjellë gjatazi disa pokllone të ngrohta, nga ato që lenë kuajt ku mundin kur i shtërngon nevoja – edhe kjo qënka shenjë auguri , si e shpjegojnë plakat prosopmbëdha e bedenegjërra të Korçës - , tezja Vike bërditi një herë sa mundi : kush n'a ka hyrë, kutra, kështu me gjithë kalë? Pastaj hyn brenda e më sheh mua pranë zjarit, i cili posa kisha vënë prapë festen mbi kokë, edhe me qenë se s'më njifte personalisht se s'më kishte parë kurrë (se xhaxha Ligori e kish grua të dytë këtë prej 8 vjetsh martuar), ajo më pandehu si për ndonjë aga, ose efendi. Mirë se ardhe, t'u ngjatë jeta, më thotë. Mirë se të gjeta – nuse i thom. Më ndje cila je zotrote. jam e shoqja e Ligor Mitkos, më thotë, po zotrote? Unë, tani, si e pashë se nuk dyshoj pse një i huaj hyri me kaqe familjari në shtëpi të saj dhe nuk i shkonj ndër mend se isha njeri i brendëshëm, i thom se kam ardhur nga Greqia, i porositur nga zonja e z. Vasil Floqi e i biri i tyre Kristaqi t'ju thom të fala shumë, e më kanë dhënë edhe ca peshqeshe për ju.

Asaj t'i vejë mëndja që unë vetë isha Kristaqi? Aspak. Të më shëmbëllente e të kujtoheshe? As atë s'e bëri, po mjaftoj vetëm të gëzohej shumë e të më uronjë të më lumshin këmbët që ardha e që ju solla lajmin e mirë e peshqeshet.

Ngrihet më qit një gliko dhe një raki rushi dhe pas atyre një kafe e po më pyeste për njërin e për tjetrin prej nesh pa e gjyrmuar më tutje, dhe unë po i përgjigjesha.

Në atë kohë u zgjua çupa lureckë Ollga dhe e ëma e çliroj nga djepi dhe i ndroj pak robkat. Unë e mora në duart dhe më ranë nj'a dy lott pa dashur. Nxora e i dhashë një mexhitkë edhe një lodër të vogël për fëmijë që kisha blerë për 'të në Janinë. Tezja Vikë, si e kanë zakon gratë, m'u fal nderit dhe më qortoj pse të harxhohem kaqe fort. Cak edhe në atë kohë vinin edhe fëmija nga shkolla, Dhorka që ish ahere 6 vjetsh dhe Vangjeli 4 vjetsh. E pyeta Tejzen edhe për këta. Më thotë se janë fëmijët e saj, i mora i shtërngova në krahëror, i putha që të dy e i dorovita secilin prapë me një mexhite të bardhë.

[1] zemin = terren (pëkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[2] soba = dhomë (H. K.)

Tejze Vika, sa do që më qortoj e më hoqi vërejtjen disa herë që pse harxhohem kaqe shumë, prapë se prapë çuditej nga ana tjetër që ç'është gjithë kjo gallantomi që po tregonja në atë shtëpi një njeri i huaj, dhe më fort kur hapa njërën prej valizave dhe ju dhashë peshqeshet që ju kisha sjellë të tre fëmijëve, qinse nga im 'ëm dhurata.

Pyes ku është i shoqi e e vjehra, imë gjyshe nga im 'ë, e më thotë se, Ligori vjen pak vonë, por dadua, ime gjyshe kudo që ishte do vinte se po lante ca plaçka të fëmijëve.

Unë, si më rroj për bukë, kthehem e i thom me një si kur se me drojtje, me gjithë që një i huaj, një shtektar s'munt të flasë në atë mënyrë: Zonjë, më ka porositur jot kunatë zonja Ngjelkë (im 'ëmë d. m. th.) që të na bëni një byrek me presh, se i bëni shumë të mirë. Ajo më pa një herë në sy edhe u skuq në fytyrë. Si kuxon ky njeri i huaj të ketë aqe kurajo në shtëpin' e huaj? U përtyp pak, edhe nga turpi më fort, e pranoj propozimin t'em. Pse jo? më thotë. Edhe u ngrit me një herë e s'dinte si të silleshe. Sidomos s'kish as të shoqin aty të këshilloheshe.

Dolli jashtë dhe unë mbeta me kalamajtë njërin andej, tjetrën këtej dhe Ollgën e vogël në pëqi e po fjalonja me ata.

Mbas pak ardhi edhe ime gjyshe Dadua, e cila duhet të më njihte se s'kishte 8 vjet që më kish parë kur ardhi me xhaxha Kriston e me të shoqen e tij në Karvasarâ. Hyri brenda tuke sharë e mallkuar se mezi gjeti radhë të lanjë e u vonua. Më tjetrën anë zu e qortonte edhe e reja pse u vonua, se ka ardhur edhe një mysafir nga Ngjelka e bija, i cili po n'a kërkon edhe byrek e kishte rënë në pikën e hallit! Edhe mbi këto kish haruar, si theshte, të më pyesë ç'isha, turk apo kaur.

Mbi këto hyn edhe ime gjyshe brenda dhe më zë për dore tuke thënë mirë se ardhe, e si i kemi ata njerës andej etj. etj. Mua s'm'u durua atë ças por iu hodha me një herë për qafe e shtërngova fort e e putha. Ajo, si plakë që ish s'i vuri re ato, sa edhe s'më njohu me të parën. Po si e pa që e shtërngova e e putha më vuri re mirë në sy e më njohu. Kristaqi! Bërtet me një herë. Oh, kurban, ti je, moj të marsha të keqen? Edhe filloj të qanjë me ngashërim se kujtoj atë ças murga plakë djalin e saj Kriston që i vdiq 32 vjetsh, si thashë në vaporin rus, tuke ardhur nga Selaniku në Pire, e që i kish shkurtuar krahët!

Ahere m'u hoth për qafe edhe teto-Vika e fëmija e qanin e qanin të gjithë që s'pushonin dot. Fëmija, Dhorka e Vangjeli deshnin të jepnin myzhdene që ardha unë, po unë s'i lashë se do na plakoste kallaballëk e do n'a linte pa bukë. E kujtonj shpejt teto-Vikën t'i përvishet byrekut, Dadua vajti të nxjerrë preshtë nga bahçja që e kishin mbuluar nga të ftohtët e dimbrit dhe me qenë se atë ças ardhi edhe qiraxhiu Nuçi Llogori të merte kalin e tij, ja dorzova, e pagova, e përcolla, i shtira llozin derës sokakut tej për tej që të mos vinte njeri edhe kështu hyra brenda e ndeza një cigare, tuke folur me të vegjlit.

Byreku me presh ishte pjekur pothuaj dhe në ato këmb' e sipër ardhi edhe xhaxha-Ligori e kështu u shtruam e hëngrëm të gjithë, përveç gjyshes, e cila, si plakë, mbante kreshmë.

Të nesërmen n'a plakosnë si mizëria gjithë far' e fisi jonë edhe miqtë që të më thonin "mirë s 'ardha". Shtëpia s'pushoj 3 ditt me radhë e nga miqt që vinin të më përshëndoshnin.

Pastaj kanë filluar gostitë. S'mbanj ment në sa gosti, e dreka e darka u thira, - një muaj me radhë.

Kisha vendosur të rinja ndo një muaj e të kthehesha prapë, sipas fjalës që i kisha dhënë t'im 'eti. Mir po soji jynë edhe miqt' e mij s'deshin të më lejonin të iknja nga Korça. Deshnin të më mbushnin mëndjen se Korça kish nevojë shumë për një avokat të mirë dhe duhet të qëndronja atje, se do fitonja më mirë se në Greqi.

Po unë s'dinja as turqisht as ligjet turke. Ju vinja këto përpara e ju thesha se s'ësht' e mundur të ri, me gjithë që më pëlqente jeta e Korçës. Mir po ata insistonin se insistonin të qëndronja dhe më këshillonin të fillonja nga gjykatorja e Mitropolisë, ku vepronin ligji roman dhe procedura civile e Patrikanës, e cila ishte marrë prej proc. civile greke.

Tuke vajtur shumë herë në Mitropoli, asistova disa herë në gjyqet dhe pash' atje që disa të vetë thënë avokatë, që bënin avukatllëk në Mitropoli, ishin fare kërpaçë, drurë të pagdhëndur, analfabetë. Pashë si i shpjegonin ligjet dhe Armenopullon, që un' i dinja përjashta ato e munt t'ju jepnja sa msime të deshnin.

U ndoth një dava me rëndësi një pretendim trashëgimi prej 1. 700 lira turke, i bazuar mbi një testament, që do gjykohej në Mitropoli. Pretenduesi, i cili s'kish shpresë t'a fitonte davanë ardhi në shtëpi t'ime dhe m'a ngarkoj davanë përsipër. Kaqe ishte i dëshpëruar sa më falte gjysmat e atyre që do fitonte. Të bënte hesap njeriu që munt të merte nga kjo dava 850 lira turke me një herë nuk ishte gjë e vogël. Po unë që s'e dinja akoma ambjentin e dredharakëve të Korçës, s'bëra fjalë për pazarllëk. E mora davanë përsipër dhe tuke përfituar nga padijenija e trashë e të dy avokatëve të anës tjetër e fitova davanë dhe ana tjetër u shtërngua të ndreqen me të mëkamsuemin t'em, i cili ishte kontent të merte edhe 800 lira e tuke vënë këmbën unë e tuke u trëmbur nga ana tjetër u udisnë gjer në 1. 500 lira turke, të cilat klienti im i mori pas 5 ditësh të gjitha.

Kujtova tani unë se fjala ishte fjalë dhe se mernja gjysmat. Por isha i gënjyer. Mbassi prita dy javë dhe as që dukesh gjëkundi klienti im u shtërngova t'i vete në shtëpi të tij dhe me një noblesë delikate t'i kërkonj të hollat. Por kur më thotë sa për qint duhet të më paguanj. Ç'thua, i thom, s'kemi për qinda këtu, ti më ke falur gjysmat. – Gjysmat? – Unë? Jo, kurrë! – Po ahere gënjej unë? Jo, as ti, as unë, po s'di si e ke marrë vesh zotrote. Mor zotni, s'm'a the një herë, i thom, po ma përsërite kush e di sa herë, se ti s'kishe shpresë t'a fitonje këtë dava. E pe, i thom, që ana tjetër kishte emëruar dy avokatë. – E ke gabim, thotë, s'të kam thënë ashtu. Po si më ke thënë ahere? – S'të kam thënë gjë. Po, s'bëmë pazarllëk, i thom? Jo, thotë, ma le në erzin t'em. Ashtu? i them, ç'ka. Fajin e kam unë që s'të mora dorën po mënt për tjetër herë. Ahere, pa të shohim sa t'a mban erzi , i them, të më japësh! Ja, thotë, sa herë që dolle në gjyq të të jap nga një lirë turke. Do me thënë kisha dalë 5 herë në gjyq e duhesh të më jepte 5 lira turke! Kur më tha këto fjalë më erth t' rëmbenj për gryke, po s'fola gjë. E gëlltita. I thom ben një be që s'më ke falur gjysmat? Jo një, thotë, po një qint. – Qënka i poshtër, u mendova me veten t'eme. – Për krye të fëmijëve , i thom. Mos i paça, thotë. Ahere më hipi gjaku në kokë edhe sado që isha në shtëpi të tij, i thom: S'pandeha se do ishe kaqe i dobët! Merre fjalën prapë , thotë, s'e bënj kabull. Duhet t'a bësh, i thom, se qënke i atillë. Tani të njoha mirë, i thom, po s'ka gjë. U ngrita e shkova, pa i thënë gjë e pa i marrë gjë.

Të nesërmet e padita në gjyq të shkallës së parë. Ajy s'pati turp të verë një avokat dhe t'i paguanj 10 lira. Ç'farë shtaza mban ky dheu ndo një herë! të më kish folur si njeri mund të bënja ç'do therori, po të betohet kështu paturpësisht mbi kryet e fëmijëve për ca pare, tuke ditur bukur mirë pazarllëkun që kishim? Më vinte çudi! Shihnja për të parën herë një poshtërsi të atillë karakteri që as ajy më neqezi[1] katundar s'm'a bëri në Karvasarâ.

Po çështja mori mejdanin dhe veç meje të gjithë e dijnin se ç'karakter i fëlliqur ishte ajy njeri. Më së fundi ndërhynë disa miq dhe e goditnë të më jepte 30 lira turke, të cilat u shtërngova t'i pranoj, mbassi ajy ishte gati të bënte benë dhe t'i hante.

Prej kësaj davaje mora një embër të mirë në Korçë që jam një avokat i aftë dhe zunë të vinë disa punë të tjera të kompetencës së Mitropolisë, nga të cilat fitova nj'a 30 lira të tjera, dhe tani po e shoh se do ish mirë të vendosesha në Korçë, ku edhe avokatë s'kish si lipsej edhe puna paguhej mirë.

Po e keqja që s'dinja turqishten, të munt të bëjna avokatllëk edhe në gjykatat e tjera ordinare, civile e penale. Ahere pa dyshim do fitonja më mirë.

Mbassi m'u vardisnë kaqe shumë miqtë e far' e fisi vendosa të msonj pik së pari turqishten. Mora si msues profesorin e Idadijes në Korçë, z. Hafis Ali Korçën, i cili sot është anëtar i Këshillës së Naltë të Sherijatit Tiranë.

[1]neqez = koprac, dorshtërnguar (H. K.)

Më dy muaj e sipër kisha msuar sa të munt të shkruanja arzualle të lehta turqishte. Po ishte nevoja t'a dinja gjuhën mirë që të mund të studijoja ligjet turke.

Miqtë më këshilluan të shkonj në Stamboll, ose në Prusë ku munt t'a msonja gjuhën, t'a flas e t'a shkruanj mirë dhe munt të kisha gjithë lehtësit' e tjera, tuke dëgjuar edhe profesorët e fakultetit juridik të Stambollit.

E mendova dhe ja mbusha edhe t'im 'eti mëndjen se do vinja në Stamboll për këtë qëllim tuke ndenjur jo më shumë se 6 muaj dhe tuke i premtuar thesaret e Krissos[1].

U nisa pra, prej Korçe për në Stamboll. Por mbassi im a'të më kish telegrafuar në Korçë që të shkonja nga Karvasaraja kur të nisesha dhe telegramin e mora në Selanik se s'më arriu në Korçë, u shtërngova të lë shoqërinë tjetër të shkonjë për në Stamboll dhe vetë mora vaporin e dolla në Vollo dhe q'andej me tjetër vapor ardha në Pirée. Si ndenja një dit në Athinë, u nisa për në Karvasarâ nga an' e detit, ku pas dy ditsh arriva dhe u poqa me të mijtë, tuke ndenjur një javë.

Të holla kisha nj'a 80 lira përsipër dhe s'ishte nevoja t'i kërkonja t'im 'eti, i cili tani duhet t'i dërgonte t'im vëllaj që në atë vit duhet të mbaronte gjymnazin e Mesollonjës.

Si u muarm vesh mirë me t'ëm 'atë, me gjithë që s'ishte i mëndjes të largohesha aqe lark, po e pa se më ishte mbushur mendja, u pregatita dhe shkova nga an' e Mesollonjës, ku pashë edhe t'em vëlla. Që andej në Patrë, në Pirée prapë.

Më 8 të tetorit 1900 nisesha direkt për Stamboll. Hipa në vaporin e math "Orénoque" të shoq. "Messageries Maritimes" të Francës dhe u drejtuam për në Izmir.

Në vapor para se të embarkohemi, me qenë se edhe një shoku im do shkonte në Stamboll, m'u lut e më bindi të nxjerim biletë për klasin e III, se edhe ikonomi bënim edhe nuk do hiqnim keq se diferenca ishte 3'Lira turke për biletën gjer në Stamboll. Pastaj më vinte keq edhe mua t'a linja vetëm se e kisha shok të mirë, dhe ishte edhe mjaft shakaxhi.

Po kur hipmë në vapor, ca farë shtratesh hekuri të klasit III, të vetëthëna shtrate ishin të gjitha të okupuara prej një shunmice pelegrinësh hoxhallarë e ulemanj, arabë etj. etj. që do shkonin në Izmir e s'andejmi në Jafë tuke u drejtuar në Kudus i Sherif, në Mekë për haxhillëk. Munt të ishin nj'a 600 shpirt. Kështu nuk gjenim vënt ku të shtrirnim këmbët. U vërtitmë andej, u vërtitmë këtej, mezi gjetmë një copë vënt afër oxhakut të vaporit, ku do shtriheshim unë nga njera anë dhe shoku im nga tjetra anë, kështu që vetëm thembra e këmbëve munt të na bashkoheshin kur do flinim, se s'kish tjetër vent as për të shtrirë duart, pse vëndin tjetër e kishin zënë haxhillarët, që kishin shtruar nga të katër anët jorganet e sixhadet e tyre. Ne me shokun kishim se cili nga një velenxë të vogël që e kishim shtrirë më dyzaj për të fjetur. Për jorgan, ose mbulesë tjetër s'kishim nevojë se dy pëllëmbë lart suratit kishim për së gjati një mur të hekurt, 5 pëllëmbë të gjërë sa na mbulonte për së gjëri edhe 4 metra të gjattë, sa na nxinte edhe së gjati. Mos harrojmë se ajo ishte shtrati i furrës ku njerëzit e vaporit piqnin çyrekë për veten e tyre e për pasaxherët.

Zura të ankohesha te miku për sikletin ku më futi kot dhe e shihnja se nuk do shkonim mirë jo vetëm se do flinim sous la belle etoile, që thotë frëngu, po edhe se do mërziteshim gjithë natën me ata të palarë, me ata qelbanikë haxhillarë që do na nxirnin veshët se gërgërituri gjithë natën ose së kënduari amanera e duvarra gjithë natën e lume.

Po miku bashkështektar, shakaxhi i prapë e djalli vetë aqe më bindi me shakat' e tij sa u shtrova në jatakun e pregatitur e s'u ankova më. Më vinte pak si turp se s'e kisha sërën të shtrihesha bashkë me ata derra, po ç'u bë u bë.

Vapori sallpari[2] nga limani i Piresë e dolli në detin Sarronikos, tuke marrë rrugën për në nisin' e Chios (Sakëzit). Ndo nj'a dy orë shkuan mirë, po m'andej vapori, sado i math që ishte, zuri të lozë valle, ashtu si e inspironin valët. Kënga e amanetë e haxhillarëve u kthyen

[1] Crixo ose Crisso = udhëheqës i kryengritjes së skllevërve në vitin 72 para Krishtit bashkë me Spartakun etj. (marrë nga Wikipedia H. K.)

[2] salpare = me lundrue (përkthyer nga italishtja me google H. K.)

në ankime e në blegërime dhe pa shkuar shumë filluan të vjellin me radhë! Unë këtë s'e kisha bërë hesap . S'e kisha shkuar në listë!

Kthehem i thom shokut: E gjeç nga qeramidhet, ç'na bëre! Më paç më qafë. Ajy i paudhi çkulej së qeshuri me hallin t'em. Po katarrat e mija e zunë gjer më në funt. Filloj të vjellë edhe ajy e u prenë me një herë lodrat e shakatë që bënte. Vetëm unë po qëndronja!

Haxhillarët e ulemajt' e tjerë zun' e bënin duva tuke vjellë dhe thrisnin ndihmës Allahun e Pejgamberët e tjerë t'i shpëtonin, se kishin frikë mos mbyteshin. Vala e shkretë shtërngoj dhe zu po na spërkatte edhe ne. Stojan, maskara, rezil, i dobët, po i bërtisnja shokut, shihe në ç'dit na solle që të sjellçin, jarebi, në të katër drurët në nosillat. Po ku Stojani! Ajy kish zënë hallin e tij e s'ish ndër ment.

Desha të dal pak të vete atje ku vete, si thonë, mbreti më këmbë. Pa ngritur mirë më zu dhe mua taksirati i haxhillarëve. Tuke dashur të kalonj për ne vëndi i destinuar isha i shtërnguar të shkel shumë herë mbi trupat e krerët ose kurrizet e haxhilerëve. Tuke shkelur e tuke bërtitur ata, se kisha edhe këpucët me thumba, më ardhi për një hejrësh e vjella e s'e mbajta dot. Volla ku munda e me gjithë fuqinë që më shtërngoj. Mos e pyet se ç'u bë atje dhe sa surata e gjokse u spërkatnë e u bënë helaq. Prapë volla, edhe një herë, edhe prapë gjer sa m'u ngatërruan edhe këmbët e u përplasa mbi ata sa i gjati isha. Medet ç'më gjeti! Mallkime, katarra, të sharra po më sulmonin e po më lanin e më shpërlanin nga gjithë anët. Po isha i lumur se më shanin arabisht e s'i mernja vesh.

Mezi vajta ku kisha punë e u ktheva gjithë po me ato mënyra si ta parat gjer sa zura jatakun t'em.

Ishte 2 ora pas mezit të natës. Deti u egërsua tepër. Deshim edhe 2 orë të arrijmë në Chios. Me një herë ndjej një si të nxehtë në fytyrë; dal nga dalë po më ngroheshin edhe krahët. Silla po shtohej më tepër gjer sa po më përvëlonte suratin. S'mernja vesh ç'ngjiste! Po kur e pashë që mënt përvëlohesha, u ngrita me një herë, tuke zgjuar edhe shokun t'em, i cili po flinte i këputur nga të vjellët. Stojan! Lepe ..... Po digjemi!.... Folë mirë!.... Më duket se duan të na përvëlojnë sonte, s'jemi mirë! Hap sytë Stojani dhe vë pëllëmbën për provë mbi mbulesën e hekurtë që n'a shërbente për kuvertë. Po, pa vënë mirë dorën e shmangi me njëherë, se u përvëlua. More, mirë thua, më thotë.... Po, po....!Ç'është bre? I paskan vënë zjarr furrit, thotë, të pjekin bukën edhe ne po rrijmë këtu! Ikë, të ikim shpejt. – Ku të vemi? – Ku të mundim. Po a s'e sheh dallgën që ment harbohet? i thom. Është rrezik të afrohemi nga parmakët e vaporit. Unë preferoj më mirë të digjem këtu, i thom, se sa të më përfshinjë vala e të më mbytë.

Edhe si kur s'na ishin mjaft gjith' ato të këqija, vjen një valë me rëmbim e na lau të gjithëve. S'mbet ahere pa u lagur, njerës, kuverta, jorganë, plaçka e ç'kishte përsipër kuverta!

Një behrihaj, një kijamet që Allahu na shpëtoftë! Haxhilerët, hoxhallarët, shejlerët po bërtisnin si kurse i therte njeri! Francezët senegalezë që ishin naftët e vaporit po i shanin me ç'turlish epitheta cochons, sacre nom de Dieu, etj. etj. S'merte vesh qeni të zotin! Mbi ato tjetër dallgë më e madhe n'a lëshohet prapë që u qullmë si minjtë kur i mbytin në kurthë! Orë agonije që s'më harrohen kurrë! Kapitani jep urdhër me njëherë të na shtijen të gjithë në hambaret e vaporit. Ahere ishte ç'ishte. Naftët e egërsuar zunë n'a urdhronin të zbrisnim poshtë nga shkallët e hekurta të hambareve, që me azallah se kuturiste njeri të lëshohej prej një naltësije 10 metërsh për të zënë funt përposh! Edhe me që s'dëgjonte njeri të zbriste, naftët zunë e i rëmbenin me përdhuni e po i lëshonin kalaviç poshtë, tuke i sjellë mbi kurrizet e tyre. Shumë të tjerë, i lidhë si dengat e i lëshuan me anë të vinçit poshtë. Disa u shduknë, tuke u fshehur ku muntnin që të shpëtonin prej atij rreziku!

Dy naftë ardhë edhe mbi ne e n'a urdhërojnë të shkojmë në hambar. Stojani më thotë hajde të bëjmë qef atje poshtë, se ata do jenë bërë si sardhele për sallamuk. I marrë, i thom, a e ke mëndjen? Unë të vete atje? Tani që n'a u lirua vëndi nga ata munt të shkojmë më mirë aty ku ishim. Pastaj duhet edhe të thahemi, i thom, pranë furrit, se jemi bërë qull.

Stojani ndofta munt të bindeshe të mos zbriste në hambar, po si e muar me përdhuni ata dy senegalezët, as e pashë se më iku që përpara. Shkoj edhe ajy në hambar me të tjerët.

Si mbeta vetëm dhe po prisnja të më gjente edhe mua e keqja që gjeti haxhilerët e Stojanin t'em, ju adresova lostromit[1], tuke i folur frëngjisht e tuke ju lutur të më paraqitte në office, ku desha të mar biletë të klasit II.

Ajy me njëherë u duk gentil përpara meje dhe më thotë t'i vete pas. Por atje ku shkonim bashkë nga një koridor ajy më thotë : s'do të ishte mirë të vinje në kabinën t'eme, në daç edhe gjer në Stamboll dhe nem ç'të duash mua se sa të paguash një diferencë 3 napolonash?

Të them të drejtën më ardhi për hesap ky propozim dhe aqe më tepër se m'a tha me një noblesë lostromi edhe e pranova. kështu hoqa në odën e lostromit, një odë mjaft e mirë dhe u ndrova me njëherë e u shtriva i qetë, tuke mallkuar Stojanin që më shkaktoj gjith' ato potera!

Lumërisht kishim hyrë në limanin e Chios, me gjithë që deshnim një orë të afronim në liman.

Kështu arthmë në Chio ku ndejmë gjer sa u gdhi dhe që andej u nismë për në Ismir, ku arrimë pas 3-4 orë.

Dolla në Izmir vetë se Stojani s'munte e kishin zënë hethet. E këputnë qafën edhe gjith'ata haxhilerë e mbetmë vetëm. Shetitmë në Izmir nja 4-5 orë e më pëlqeu fort.

Nisemi q'andej për në Mitylinë, qytetin historik të vjershëtores Safo, qytet piktoresk, dhe nisia fort e kandëshme.

Mbas 2 orë hoqmë drejt për në Stamboll. Po aty kur u afruam të hynim në Dhardhanelet, kisha dalë jashtë në kuvertë e bënja sehir të ngushtat e Dhardhaneleve. Frynte një er' e keqe dhe ca isha i ftohur prej të lagurit nga valët e natës kaluar, që vuajtim aqe shumë, ca prapë u ftova dhe nga era e marrë, pra më zenë një palë hethe atë natë që më tundnë tepelekun e kokës.

U shtriva në kabinën e lostromit i sëmurë dhe veç ahere u ngrita kur më thanë se u afruam në Stamboll. Me hethe në gojë dolla jashtë e pashë atë panoramën e bukur të Byzantit të vjetër, kryeqytetin e Kostandinit të Math, të Justinianit e të aqe imperatorëve të tjerë Byzantinë e sillnja ndër mënt të rënit e Stambollit në dorën e Sulltan Mehmetit të II. S'nginjesha dot së pari atë pamje majestike, që s'e ka kujtonj as Napoli, as Lisbona, as Windsori i Kanadasë, qytete që i kam parë e kanë të ngjarë me natyrën dhe ajrin e Stambollit.

Nje tjetër bukuri i jepnin minaret' e nalta që s'kishin të numuruar, si edhe quartieri i lartër "Bey agllu", kisha e Shën Sofisë, Dollma Bakçeja, bugaret e gjirit Qeratios dhe e Bosforit, lagjet e bukura të "Bujuk Daresë", Therapeia e Bojaxhiqaj, si dhe ana tjetër aziatike e Kadiqajit e e sqydarit.

Posa hodhi hekurin vapori në limanin e Gallatës unë u shtriva prapë në kabinë e m'a dhanë edhe një herë hethet, më të rënda se të parat, sa humba fare e s'dinja se ku isha dhe as mora vesh si më nxuar e si më kishën prurë në patomën e tretë të një hoteli që quhej "Monastero".

Në atë hotel ndenja dy dit e dy net pa njeri, pa doktor, pa kurrgjë. As i zoti i hotelit s'ardhi të më shëkoj, as një garçon s'dërgoj. Kisha humbur edhe Stojanin dhe as që mora vesh ku vajti dhe qysh ahere s'e pashë më.

Si ardha ndër ment thira drejtorin e hotelit, ju ankova për këtë çnjerëzim që rëfyen para meje, një të huaji, e i tregova adresën e një mikut t'em Gorçi Skalit, student farmacije prej Korçe, i cili ish në Stamboll edhe e dinte se do vinja, porse unë vonova tuke u kthyer, si thashë edhe më parë në Karvasarâ. – Thira Gorçin të vijë të më shohë.

Atë dit mbremanet ardhi Gorçi e më gjet të sëmurë në hotel. Si i tregova gjithë odhyssenë që vuajta udhës, ju luta të më gjenjë një odë të mobilluar të shtrihem rehat. Më thotë Gorçi se ka folur me mikun tjetër t'onin Petraq Kondin, edhe atë prej Korçe që kish

[1] lostrom = lundrues (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

motin e fundit ahere si student i Drejtësisë, e se Petraqi po më priste në shtëpi të tij në Jedik Pashë, m' at anë Bajazit Jollit.

Sado që isha i sëmurë u ngrita me të pahir, pagova hotelin dhe u nismë me Gorçin e arthmë në odën e Petraqit, i cili më priti vëllazërisht dhe atje u çlodha.

# X

Filloj një jet' e re këtu me Petraq Kondin. Shtëpinë e kishim shumë të mirë me një pamje romantike që s'bëhej më e bukur. Ishim në patin e III sipër dhe shëkonim që andej gjithë Stambollin, gjithë limanin dhe Bosforin akoma.

E zonj' e shtëpisë, një greke Stambolli shum' e sjellë më ujdisi një krevat extra dhe kishim shërbim e pastrim mjaft. Petraqi më bënte turqisht kur kishte kohë edhe flisnim gjithë turqisht me Petraqin, me zonjën Helena dhe çupat e saja Dhespina e Romylia, që të stërvitesha.

Petraqit i ra puna pas ca ditsh në Korçë dhe në odë mbeta vetëm unë. Një natë kur po studijonja dëgjoj ca topa edhe pas atyre ca zërra bekçish[1] gjithfarësh toni prej do diezis deri në si bemol "Jangën var, Gallatadâ Peerçembé Pazarënda, Ali-Hajdar xhatesi gjermi pësh numurosënde, jangën vaaaarrrr!! Edhe pas këtyre një vajtim qenash të mjerushme që të depërtonte zembrën!

Në krye s'e mora vesh. Më vajti mëndja ne Ermenët e shkretë që 2 vjet më parë me mijra kishin rënë nënë thikë të halldupëve xhelatë të Stambollit e thashë se mos ngjiste edhe tani ndo një gjë e tillë. Prandaj me vrap shkova i trokita madames te dera : ç'është kështu, Madame? ç' janë këto gjërra, mos ngjet gjë? – Jo, zoti Kristaq, ma pret, s'është gjë, zjar ka rënë gjëkundi e po lajmërojnë bekçinjtë. – Po qentë ç'kanë që haullinë në këtë ditë? Ju mbajnë zërin ma pret me një sarkazmë zojusha Romylia. U çudita.

I kurreshtuar t'a njihja Stambollin mirë po thuaj se s'lashë vënt pa e parë. Tuke ditur historinë byzantine kush e di sa herë vizitova pallatet e vjetra e të çuditshme të imperatorëve Byzantos si dhe të famshmen Agjia-Sofia, këtë tempull majestik e të çutishmë në botë etj. etj. vise të shënuara historike, me gjithë që s'na linte edhe koha me shirrat e më fort me baltrat dhe çfarë baltra – baltrat e Stambollit që janë të dëgjuara në botë.

Vjershëtori satyrik Grek Georges Sures kur kish ardhur tjetër herë në Stamboll ishte çuditur me baltrat e Stambollit me qentë e me hamajt e saj, të cilët i la të pavdekur me këto strofa :(shkruar greqisht H. K.) domethënë : Qëna, hamenj, balt' edhe shi dhe gjëra kësi dore.

I ka Stambolli për stoli, brillante për kurorë! Sa për baltën e jashtazakonshme G. Suris tregonte këtë alusjon të bukur.

"Shkonja një ditë, thotë, nga rruga Sulltan-Bajazit në Stamboll, seç desha të blinja dhe hodha dorën në jelek e nxora ca të holla, po për fat të keq më ra një mexhite në baltë. E kërkova andej këtej më s'e gjenja dot. Zura pastaj po i binja baltës me bastun, se mos fundi i bastunit takonte atë mexhiten e humbur, kur, o Perëndi! .... Dëgjonj një zë që vinte nga balta : Nga dale , jahu, atë bastun se na theve kokën! I çuditur tepër, thotë, tërheq e shtynj andej këtej baltën, po kur shoh atje thellë një kafkallë njeriu!.... Bre, bre, bre!!!.... Njeri qënke ti këtu futur në baltë? – Po nuk më sheh , pra që jam njeri? .... çudi, çudi! Po habitem, po mahnitem!. . . Jahu, i thom, po si të nxuri balta gjithë ty kështu , koxha njeri? – Po njeriu i baltës m'u përgjigje me një të qeshur Sardhonike[2], ha, ha, ha! Si? më thotë, çuditesh për këtë? – Po është për të mos çuditur? – Ke qenë herë tjetër në Stamboll? – Jo. Ahere ke të drejtë, thotë baltani. Ti s'ditke se rrojnë edhe njerës brenda në baltë. – Brenda në baltë njerës? – Po, po,

[1] bekçi = rojtar (pëkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[2] qeshje sardonike = qeshje tallëse (H. K.)

thotë. Edhe në daç të marrësh vesh mirë sa baltë ka këtu ku jam unë mso se unë këtu gjëndem akoma.... hipur mbi kalë!!!.... Pra, le të bëhet hesap tani balt' e Stambollit.

Në ato ditt' e para që ardha në Stamboll e mbasi u shërova prej hethesh shkova një dit' e vizitova të pavdekurin vjershëtor të Shqipërisë Naim be Frashërin. E gjeta shumë të sëmurë. Lëngonte i mjeri në shtrat nga një lëngatë që s'kishte sherim. Ajy s'më njihte personalisht veç se nga letrat e u gëzua shumë kur më pa. Më pyeti shumë gjërra; më mbajti për mbi dy orë pranë. Ishte shumë i zbejtur në fytyrë e i dobësuar fort. Më ardhi shumë keq për të mjerin burrë edhe m'u qa kur më tha vetë se s'kishte shpëtim. Mendova sa keq e sa mjerim do të ishte vdekja e tij për Shqipërinë!

Ditën tjetër shkova vizitova të vëllanë Sami Be Frashërin, në zyrën e tij të pasuruar me lloj lloj librash. Ndonse 6-7 vjet më i vogël se Naim beu m'u duk se po ish 15 vjet akoma më i madh; kaqe ishte zbardhur e ishte krusur nga shpina e qafa. Sa sympathik ishte Naim beu, aqe i vrejtur e stoik m'u duk Sami beu.

Më priti edhe ky shumë mirë. Ndenja ndo një gjysmë ore se e pashë që ishte okupuar tepër me punë e zhytur në studime, prandaj i mora lejen dhe ika e e lashë Po prapë e vizitova edhe nj'a dy herë, si edhe Naim bejnë.

Një dit pa pritur n'a lajmërojnë vdekjen e tij, e cila më pikëlloj aqe fort sa e qava si një baba. Vdiq i mjeri në një moshë 57 vjetsh! Qoft' i pa vdekur kujtimi i tij për veprat e vjershat e bukura lyrike që i fali Shqipërisë.

Nj'a dy muaj shkova mirë në Stamboll dhe përparonja mjaft në gjuhën turqishte, tuke pasur edhe një profesor turk si msues. Po mjerisht një taksirat i papritur më ra si rrufe në kokë e më prishi tërë sërën e mirë që kisha zënë, gjithë shpresat e dëshirat e mija, që gati mënt më kushtoi jetën. Për këtë do bënj fjalë gjat' e gjërë më poshtë se është faqja më e zezë e më e tmershime e jetës s'ime.

Ishte një dit' e Enjte, dita e 7 Shën Endreut-1900. Ora 3 mbas dite. E zonja e shtëpisë më kish dërguar një çaj të mirë dhe po e pinja nga dalë tuke u marrë me këndimin e disa gazetave turke, me të cilat edhe studijonja mbi turqishten. jashtë binte dborë, një koh' e keqe, një tufan. Bënte shumë ftohtë.

Isha kaqe i krydhur në këndimin e fletorëve dhe në të numuruarit e fletëve të diksionarit turqisht-frëngjisht.

Atë ças troket dera. Urdhro, thom greqisht, por se prapë trokitnë. "Entrez" thom ahere edhe dera çilet dhe shoh të hynë brenda një kryekomisar i policisë me 3 hyje me dy policë të tjerë e me muhtarin e lagjes s'onë, dhe më salutuan.

Unë kujtova se mos bënë gabim dhe prisnja të më thoshin "pardon", por kur me njëherë më thotë kryekomisari : Zotrija juaj jini z. Kristo Floqi, avokat nga Korça? Si urdhëron, i përgjigjem turqisht. Ahere më kërkoj passaportën e ja dhashë. Pse keni ardhur këtu? thotë. Për të msuar turqishten mirë, i thom, mbassi do qëndronj në Korçë të bënj avokatllëk. Njihni njeri këtu? – Si urdhëron, dhe i numurova disa tregëtarë korçarë, studentë e njerës të tjerë që njihnja në Stamboll. – E tjetër – thotë. Njoh edhe Naim be e Sami be Frashërin, i thom. - Si i paskë njohur këta? – Tani s'di ç't'i përgjigjem, se e pashë që ardhë për qëllim politik dhe kisha frikë mos binja brenda. I thom , pra, se Naimin dhe Saminë i njoha për të parën herë këtu në Stamboll. – Dini, thotë, se ka një klub Shqiptarësh këtu? – Po, i thom, e di. E kini vizituar ndo një herë? – Një herë vetëm. –Jini antar i shoqërisë? – Jo. Kini armë me vete? – Armë? Unë armë? Zoti komisar mos më merni për ndonjë reaksionar? Ju siguronj se jam një nga më të bindur nënështetas të M. T. padishahut t'onë. – S'ka dyshim – thotë, po unë ju pyes e ju lutem m'u përgjigjni: Jo, i thom, s'kam gjë veç një thikë të vogël për të prerë fletët e zarfet e letrave. Mundim të bëjmë një anketë, thotë, tuke parë. – Pse jo, i thom, po do mundohi kot e më vjen keq për ju.

Komisari nënqeshi dhe urdhëroj të dy policët të shohin andej këtej si dhe valizat e mija, po s'gjetnë gjë, veç korespondencën që kisha, që s'kishte kurrgjë, letra miqsh, shënime e jo gjë tjetër.

Muhtari i lagjes, një këpucëgrisur i krishterë, më këshillonte t'i tregonja komisarit ç'do gjë që kisha se z. kryekomisar ishte njeri alixhenab , njeri i mëshirës dhe do m'a falte ç'do gabim. Këto fjalë m'i tha greqisht, po edhe unë ju përgjigja të shohë punën. Mbassi s'gjetnë gjë kryekomisari kthehet me një farë fisnikërije e më lutet t'i shoqëronj gjer në qëndrën e policisë në Kum-Kapu. E pashë se s'bënja ndryshe edhe shkova me ata bashkë gjer në zyrën e tij në Kum-Kapu, ku më shtroj në një hetim të imtë më tepër se dy orë, jo pse ika prej Greqije, jo me ç'qëllim ardha në Stamboll, jo pse dua të qëndronj në Korçë etj. etj.

Nga sa më pyeste kuptova se isha i akuzuar si revolucionar dhe se puna ime, pozita ime ishte shum' e kritikstime. Si më pyeti mirë mirë më dërgonj me një polic e me dy gjendarmë gjer në Policin' e Qëndrës në Gallatë. Atje tjetër hetim. Një trup hetues, ose gjykues prej 3 vetave civilë zunë e po më pyesnin dendur edhe kaqe me hollësi, sa u çudita si i dijnin, po thua, gjithë biografinë t'ime ata njerës!

Si më mbajtnë nj'a 3 orë më dërgojnë s'andejmi në një tjetër zyrë policore në Babi-Zaptije, afër Agja-Sofisë. Ishte ora 9 e natës d. m. th. ora 21. Paraqitem përpara një burri të gjatë me një mjekërr, të paktën gjysmë kuti të gjattë. Ky, si më pyeti nj'a 10 minuta dhe përsëriti disa herë fjalët "zavalli çoxhuk", më tha a në pranonj të më dërgojnë kajmekam (Nënëprefekt) në Melenik, e mbassi i thashë "unë s'kam nevojë të shkonj atje, se kam ardhur për të msuar turqishten", ajy s'kundërshtoj veçse thiri një policë tjetër të cilit s'mora vesh ç'i tha dhe më përcolli me policin, tuke më thënë "gjit efëndëm, gjit, bukadar qafidër" shko, zotni, shko, mjafton me kaqe. Ora ishte 22 d. m. th. 10 i natës.

Më mer ky polici e shkojmë nga një rrugë të gjattë e pas disa minutash futemi të dy në një portë të madhe të hekurtë, që andej ecim akoma gjersa arthmë përpara një ode të unjtër. Aty qëndruam. Një plakosh nj'a 65 vjetsh, krejt myjap[1], më mori embrin, më regjistroj në një tefter që kish aty përpara, i dha një copë pusull të shkruar policit që më solli dhe e përcolli jashtë e ajy n'a salutoj e iku. Pastaj plakoshi kthehet nga mua, thret dy ushtarë nobetçnij[2] dhe shkojmë të gjithë tok prapa asaj dhome, çili një derë me parmakë t'hekurta e më thotë: urdhro, hyr brenda. Ku jemi këtu? i thom. Në burgun, thotë. Në burgun? – Si urdhëron, në burgun. – Po cili je zotrote? Unë gardjan i burgut, më përgjigjet. – Po, pse, për ç'punë më burgosni? – Haj, haj, thotë hyrë brenda e mos folë shumë. – Po ç'bërë, ç'bëra? pa më thuaj. Po gardjani i burgut në vënt të më përgjigjet më pa një herë me inat dhe ahere e muar fjalën gjendarët, dy qyrda[3] të këqinj, që prisnin te dera e burgut. "Gjit içerije, qopagllu, qipek" hyrë brenda qen bir qeni, më thotë njëri prej tyre edhe më shtyri një herë e u gjeta brenda edhe porta e hekurt u mbyll me kërcëllim pas mejet!

Qëndrova një minut tuke u mentuar. Ku jam kështu? ç'të keqe kam bërë? Pse më plasnë në burg pa faj? Ku të vete tani? Cili do jetë fati im? Sillem pak tuke shetitur në atë farë ahuri të terët, ku vetëm një kandil i vogël dukej atje përtej mvarur mbi murin e zi e të muhliasur të atij burgu historik. Ndeza një cigare dhe po shetitnja tuke menduar. Ora ish 11 gati mezi i natës.

Afrohem përtej nga fundi i ahurit dhe shoh nj'a 4 kaushë, dy andej, dy andej. Një shkallë e vjetër mezi që dukej nga an' e mbrapshtë e njërit prej kausheve. Duket që edhe lart kishte oda të tjera. Nga e rëmakta[4] e burgut ishin 3-4 dyer me radhë; ishin nevojtoret. Më tutje një copë krua me një qyngj hekuri po rrijithte ujë; ishte kroni që laheshin, ose mernin abdast të burgosurit. Për së gjati tokë e kalldrëme.

---

[1] müyap = memec (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[2] nöbetçi = roje (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)
[3] qyrd = qytetar nga Qyrdistani (K. F.)
[4] nga e rëmakta = nga e majta (H. K.)

Një gardjan nobetçi, a shërbëtor, më afrohet: Hemsheri[1] me thotë, pse s'vete të flesh? Është jasek të rish jashtë këtë orë? Nuku shëkon kolegët e tu që janë gjithë brenda? Kolegët e mij! Po, po ku katandisa, po mendohem! Kolegët e mij të cilët duhet të ishin gjësendi katila, gjakpirës, hajdutë, njerës të dënuar nga societeja. – Po ku të vete? i thom. Eja me mua thotë, edhe më mer e më çon në një prej atyre kausheve. Hyrë, thotë, e zerë vent.

Perëndi, O Zot! ç' të shoh atje brenda! Një tym i gjallë cigaresh, një er' e keqe që s'e duronja dot, një vrimë, një qelbësirë që Zoti na ruat! Ishin më shumë së 30 shpirt në atë odë, që do ish nj'a 6 metra e gjattë e nja 4 e gjërrë. Disa flinin e gërgëritnin keqas, disa llafoseshin e pinin cigare, dikush ndroheshe, ose qëronte morrat e ku di unë!

Bujurim, arkadash[2], bujursunllar! .... më thresin me një gojë edhe më hapin pak vent. Desha s'desha qita pallton t'ime dhe u sheshova këmbë kryqas. Më pyesin nga jam, kush jam etj. etj. po unë druhesha t'ju rëfenja të drejtën. Më pyesin prapë pse më suall atje, ç'bëra, mos jam i dënuar etj. etj. Ju përgjigjesha se edhe vetë s'dinja gjë, po më prunë kot. Më dhanë cigare, deshin të më gostitnin kafe po unë s'ja u pranova se s'kisha ngrënë as bukë që më drekë. I pyeta edhe unë me sërën t'ime e mora vesh se ata ishin të dënuar me nga 5 vjet e përpjetë për faje të rënda. Pyes në ka ndo një shqiptar, s'kish; ndo një Grek, as Grek, të gjithë ishin Turq, Kurdë, Girqezë e nj'a dy Ermenë. U shtërngova, pra të flas turqisht edh' ajo ishte një shkollë e dytë për mua.

Pas një ore shtriheshin të flenë edhe ata që s'kishin fjetur e që vegonin akoma. Unë mbeta vetëm. Ku të shtrihem? Si do munt të fle? Si do gdhihem? Po ç'munt të bënja? U shtriva. Takova në një qoshe, vënt që m'a dhanë mbas disa lutjesh që ju bëra posesorëve të atij këndi me gjithë që ajy që do kisha pranë meje u ndoth të jetë një arap i shëmtuar sa edhe i mërzitur fort.

Si më zuri gjumi, shoh një ëndërr të keqe sikur me zinin e më hiqnin xvarrë, më mbytnin. Ngrihem i tromaksur edhe shoh që kurrizi i arapit më kishte plakosur kaqe fort sa mënt më ziheshe fryma. Edhe s'muntnja as t'a losnja nga vëndi se ishte një vigan i madh si Goliadhi.

E zgjonj pak, tuke ju lutur të bëhet më tutje. Po arapi i keq çohet i tromaksur e më ndrit sytë e dhëmbët sa më zuri tartakuti, pa më shau edhe me një dialekt që s'e mora vesh dot. Edhe s'lojti prej vëndi. Unë, tuke qëndruar gjysmë i ngritur ndeza prapë një cigare me gjithëqë ishte "jasak[3]" të tymosurit duhan pas mezit natës, dhe po mendohesha.

M'u duk ahere sikur çeç më hëngri në kurris. Me një herë u kujtova se do kem kulisur mora. Po kur sa kaqe? Fillova të kruhem; tuke u kruajtur m'u ndes trupi; ngrihem, s'qëndronj dot, s'di ku të futem. Dal jashtë, drita e kandilit që po kleitte u shua. Ishte një terësi[4] e madhe. Vajta gjer ne kroni; piva një herë ujë; më vinte sikur të çvishesha e të vinja kurrisin nënë ujin të freskohesha se plasa, m'u ndes trupi. Dëshpërim i math!

Ndeza një tjetër cigare. Dreqi t'a sjellë, një gardjan më sheh dhe më sulet tuke më sharë e tuke më shtyrë të shkonj brenda se është jasak atë orë të isha jashtë. Brax, jahu, allah ashkëna, i thom, lermë ashtu daç Perëndinë, se u prisha mentsh brenda, s'munt të qëndronj. Ajy po më shtyn akoma barbarisht si një egërsirë. Mos shty, i thom, se e di rrugën vetë, sillu njeri, posa të mbaronj cigaren vete brenda. Gardjani i egër zembrohet e m'a mvesh me një shkelmë këllqeve, tuke sharrë. S'di si më ardhi atë minutë e s'e mbajta dot veten; kthehem e t'i heq një shukretë suratit atij dojuzi sa i lëshuan sytë shkëndija! Ahere m'u hoth përsipër tuke bërtitur, po s'ishte më i fortë se mua e s'më rihte dot; unë e solla një herë rotull, e përplasa përdhe dhe ika e lashë; u futa në kaush e zura vëndin e parë. Po kur hyra më panë disa hapsanë që hyra i ngutshëm.

---

[1] hemsheri = bashkqytetar (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[2] arkadash = shoku (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[3] yasak = e ndaluar (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)
[4] terësi = errësirë (H. K.)

Ajy gardjani shkon edhe mer edhe një gardjan tjetër e n'a hynë që të dy na kaush tuke kërkuar kuximtarin që rahu gardjanin. Unë s' pëzanja aspak, as tundesha. . U zgjuan gati të gjithë kolegët e mij dhe s'dinin ç'kish ngjarë, se as më njihte gardjani i rahur e as e njihnja.

Disa prej nesh u ngritnë më këmbë e si muar vesht ç'kishte ngjarë, mezi i bintnë gardjanët të largoheshin, pa ç'kishin për të bërë munt t'a bënin të nesërmen, ditën. Kështu e këputnë qafën që të dy ata shtrembanikë.

Të nesërmet urdhër nga drejtori i burgut të mbyllet në dollap ajy edepsiz, ajy sojsiz që kuxoj, efëndëm, të rajë një koxha-gardjan të Dovletit, një kastravec! Edhe me qenë se faji më ra mua, se më diktuan disa maskarenj prej kolegëve të ndershëm, më marin âron, âron gati sikur më hiqnin xvarë e mundohen të më lidhin e të më futin më një bodrum që edhe unë nuk di sa dru do të hanja.

Unë si pashë pisk, vendosa më mirë të vdes tuke luftuar me ata, se sa të më lithnin këmb' e kokë bashkë e të më kalpnin në dru, që munt të linja edhe lëkurën në atë bodrum! Ata mundohu të më futin brenda, unë kundrështohu; një poterë, një gurgule e madhe; gjithë arkadashët fisnikë po n'a bëjnë sehir e po qeshin. Ajy gardjani që e kisha rahur më fut një grusht kurrizit; unë kthehem me njëherë e i fut një grusht turinjve me gjithë fuqinë, sa zuri kryet me të dy duart, kur se ajy tjetri më heth duart të më mbytë! U sulë ahere nj'a dy kolegë e mezi n'a ndanë. Gardjani i rahur për së dyti po bërtiste "vur gjaure" bini kaurit!

Në atë koh' e sipër vjen plaku drejtor i burgut, ajy që kish dhënë dekretin, jo të më rahin, po vetëm të më mbyllin në dollap më këmbë si gjobë që piva cigare jashtë kaushit pas mezit të natës. Gardjani i rahur s'i kish rëfyer njeriut se ç'pësoj atë natë. Po në proteston e dytë që ngriti gardjani dy herë rahur, se i përshesha hundët, më mbajtnë krahun të gjithë kolegët e ja hodhë fajin atij. Unë prapë kundraprotestova se deshin të më mbyllnin në bodrum e të më kalpnin në dru që të dy ata njerzit e Dovletit; tuke frikësuar se këta do t'ja bënj të njohura nazir beut (ndërmentonja ministrin e Policisë) e se jam njeri i njohur etj. etj. avokat e ku di unë se ç'thashë. Drejtori i burgut të cilit duket i bënë përshtypje ato fjalë, i largoj me njëherë ata dy firauna, m'a fali gjobën, e kështu u futa brenda në kaush, tuke pritur përgëzimet e nxehta nga gjithë kolegët, të cilët më lëvdonin si trim.

Po në shpëtova atë herë nuk shpëtova ditën tjetër. Vjen një urdhër që unë jam zënë për çështje politike edhe që duhet të veçohem krejt nga shokët e tjerë! Ahere vjen vetë drejtori të exekutonjë urdhrin superior, e megjithë që i vinte keq si më tha, ishte shtërnguar t'a bënte.

E ndoqa pas dhe më dredhon nga një anë tjetër ku më mbyll në një odë të terët e pa dritë dhe më le!

Zot, ç'ishte ajo poterë me mua? S'munt t'a përshkruanj sikletin që aqe mbyllur atje brenda 3 ditt e 3 net vetëm me gjysmë çyreku që më jepnin ditën e me një lug ujë që më linin për të pirë! E keqja më e madhe ishte që s'afroheshe as njeri atje, që të shkëmbenja dy fjalë me një njeri!

Në atë agoni të tmeruar që isha, pa zjar, pa cigare, pa një ngushëllim, pa një karekllë ose fron ku të ri pak edhe më fort në kthizën e dimbrit, m'u terr syri, m'u turbullua gjaku, më shkonte mëndja më një mijë të këqija dhe e kërkonja vdekjen si ngushëllim! Mendonja të shkuarat, mendonja vëndin që lashë në Greqi, mendonja prindët e mjerë që i mora më qafë e më vinte të vrisnja vehten! Nga hidhnimi; nga zjari që ndjenja shpërtheva në sharje e në të nëmura. Mallkonja orën që u nisa për në Stamboll ; mallkonja gjithë far' e fisin e miqtë që u bënë shkak e ardha në Stamboll ; mallkonja gjuhën çagote turke, Turqit barbarë, Sulltanin , dreqin, të birin e thristnja të më dëgjonin të gjithë, pa le të përmbyseshe dynjaja; s'kish ku të vinte më keq!

Si durova 3 ditt e 3 nett në atë agoni e si s'plasa, një perëndi e di! Ato mjerime do t'ja rëfenj varrit!

Fati im të më kërkonjë një dit në shtëpi miku im Gorçi Skali, farmacisti dhe mbassi e zonja e shtëpisë i kish rëfyer taksiratin t'em, që as ajo s'dinte ku më shpunë, ngrihet e vete në

Fanar ku i kallzon Dhespotit të Korçës Gjervazit zhdukjen t'ime. Gjervazi ahere ishte synodhik në Patrikanë edhe mbassi u interesua për mua, me gjithë që s'më njihte personalisht, msoj se gjindem në burg të Babi-Zaptijesë për çështje politike. Dërgon shpejt një njeri të msonjë e ta informonjë për mua. Kthehet ajy e i thotë që s'më pa dot se jam i izolluar. Ahere Gjervazi përpiqet me anë të Patrikut, Konstandinit të V edhe po kur shoh, për çudi, ditën e katërtë të mjerimit t'em vjen me një noblesë një gardjan – jo ata të parët – dhe më nxjer nga ajy qimetër i keq. Mezi pashë dritën e Zotit me sy! U bashkova prapë me shokët e parë, të cilëvet ju kish ardhur keq e më gostitnë me kafe e më fort me cigare që mënt pëlcisnja sa t'ja ndjenja vetëm erën. Ata më thanë se si kish dërguar Patriku e pyeste për mua etj. etj. e më nderonin mjaft, po edhe unë u ngushëllova tepër se e pashë se dikush po u interesoka edhe për mua.

Shkuan dy dit të tjera e më s'vinte njeri të më shëkonte. Prapë më hipi një dëshpërim që ment humbisnja mëndjen. Si do bëhej ky halli im, pse nuk më pyesin?

Ditën tjetër nga mëngjesi shkova në nevojtoren për nevojë. Nevojtorja ish e ndarë më trish dhe e pambuluar nga përsipër, përveç se kish dy, tre kadhrona që shtriheshin të mbërthyera sipër dhe për së gjati nevojtores.

Unë mbanja një bres të kuq Manastiri të gjatë dy pashësh që ngjishnja mezin. Këtë zakon m'a msuan në Korçë. Si mbarova punë e zura të ngjishesha, më hipën prapë me një herë dëshpërimi, po këtë radhë kaqe fort, sa vendosa t'i jap funt jetës s'ime. Vendosa të mvarrem! Unë që s'desha as të dëgjonj për mvarje, se një herë kisha parë një efgjit të mvarur edhe s'më zinte gjumi për kaqe net! Tani e kisha vendosur për veten time!

Tuke parë brezin e gjatë e tuke menduar se ky munt të më shërbente për qëllimin t'em të vendosur sa kaqe e vura në vepërim dhe më dukeshe si kur do çkarkohesha nga një barrë e rëndë, nga jeta ime do me thënë mizore.

Me njëherë e hodha brezin për mbi një prej kadhronave dhe po mundohesha të godit shklekun për t'a hedhur në qafë. Për fatin e mirë t'emin, një hoxhë, hoxha i burgut posa kishte mbaruar edhe ajy punë e po laheshe me një ibrik në nevojtoren tjetër për bri mejet. Ajy i shkreti sheh një bres të kuq që po tundet andej këtej e s'po mer vesh gjë. Sheh në për të ndarat e drasave një njeri që po mundohe të hipë nga an' e pervazeve gjer sa të mundë t'a hedhë atë shklek në qafë. Kupton me një herë se këtu po bëhet një vetëvrasje edhe i trëmbur mjaft del jashte e vjen nga dera ime e po gërcet me batare: "Aç ogllum, aç, rixha iderëm açën, japma bajle" Hape, djali im hape, më thotë, të lutem fort mos bëj ashtu.

Ja hapa hoxhës dhe hyn shpejt brenda. Me një herë rëmben brezin e e heth jashtë. ç' bën kështu, thotë, mos je i marrë? S'e di se kjo është mëkat i math përpara Zotit?

Unë unja kokën e s'fola. Hoxha i mirë më mer për krahu e më shpie në odën e tij, ku ishin edhe dy pleq të tjerë. Më mban atje e më ka kujdes e më ruan të mos dal jashtë vetëm.

U sheshova pranë hoxhës e hanja e pinja mirë pranë atij. Edhe me qenë se ishte Ramazan i ndihmonja sa muntnja në duvatë dhe sa herë vinte të faleshe në një sallë të madhe, ku grumbulloheshin edhe shumë hapsorë të tjerë, unë i vinja pas edhe falesha tani sikurse faleshin edhe ata.

Një dit më pyet ç'jam turk apo ermen? Orthodoks, i thom. – Po si falesh kështu si ne? – Pse është – i thom – gjynah? Jo, thotë, se Zoti pranon ç'do falje. Tamam, i thom, prandaj edhe unë falem simbas fesë t'uaj. A ke qef, thotë, të bëhesh musliman? – Tjetër gjë, i thom. Mua më vjen rëndë akoma se jam edhe orthodhoks! Qysh? Po ahere ç'kërkon të jesh? thotë hoxha naif. Pagan, i thom, kurrgjë! S'dua të jem asgjë! Dua të dal vetëm nga burgu. – Falju Zotit, thotë, të të nxjerë, Zoti është i math. E di, e di thom, po s'e shoh të bënj ndo një mrekulli për mua. Pak mrekulli është thotë këjo që më dërgoj Allahu ne ty e të shpëtova nga vdekja? – Pse Allahu, i thom, të dërgoj? Allahu, thotë, po kush tjetër? Ahere i falemi nderit Allahut, thom, edhe zotrisë s'ate.

Pas dy ditsh më thrasin te dera e burgut. Vete. Kur ç'të shoh? Gorçi Skali kishte ardhur të më shohë. Posa më pa ja krisi të qarit dhe zu të më rrokte për qafe. Nga dale i thom, Gorçi vëlla, se mos të të ngjit ndo një tabor me mora, siç je kështu i larë. Ajy po qan prapë. Jahu, i thom, sa të qanj unë qan ti? – Si je bërë kështu? – Si je bërë kështu? thotë. Si të bëhem, ja, ka më mirë se kështu, me mjekër, me thonj të gjatta, me mora me zgjyrë, me gurmaz' e tharë , a ka si të bëhet më mirë? A më ke sjellë gjë, thom, pa leri ato. Po, thot' i ngrati të kam sjellë ca qofte dhe një franxollë, po s'm'i lanë t'i sjell brenda. Ahere, ku i ke, i thom se m'u bë syri pishë për një çikë mish! Ja dhashë drejtorit të burgut, thotë.

Shkuam bashkë ne drejtori dhe më thotë se është jasak të futin gjellë brenda. Po të duash haji këtu, thotë. U çtrova dhe hëngra 10 qofte në 5 minuta. Bukën e mora në xhep. Me se hani, thotë Gorçi. Ne, i thom, mos e pyetë, herë bukë me ullinj e herë ullinj me bukë dhe nga ndo një herë vetëm bukë. Do para? më thotë. Ç't'i bënj? Mer dy lira t'i kesh se mos të të lipsen. I mora. Pas kësaj ju luta të më dërgonjë një dyshek e një levenxë e jastëk. Të nesërmet m'i dërgoj i varfri.

Kaluan kështu nj'a 4 dit akoma. Njeri s'u duk më të më shohë. Prapë zura të dëshpërohesha, po hoxha fukaraj s'më ndaheshe as qimen. Por ku i thashë një dit se jam avokat, ahere më desh ç'më desh hoxha, sepse kishte kush e di sa meselera gjyqi të mvarura, për të cilat i jepnja opinionet e duhura.

E msova turçen aqe bukur në burk sa s'kishte nevojë të mernja profesorë të tjerë. Dal nga dalë zura po msohesha. Ç'është ky njeriu i shkretë!

Një dit tek po shetisnim në divan me hoxhën t'im (se hoxha banonte në dhomën e sipërme të patomës së dytë), n'a afrohet një djal' i gjatë, moshtari im, i hollë e i hijeshëm, i cili më kërkon cigaren t'ime të ndezë të tijnë. Ja dhashë e nderoi e më thotë "merci". Ja kthenj unë prapë frëngjisht "pas de quoi". Ahere ajy njeri sympathik pason: Ah, vous parlez français? Oui, Monsiuer. Vous etes des condannes? Pas encore. –Pourez-vous venir avec moi pour causer ensemble? Avec beaucoup de plaisir, mon ami. I kërkonj pardon hoxhës t'im. Ç'është thotë hoxha? S'ka gjë ja pret ajy zotnia i panjohtur do vemë pak gjer në odën t'ime me këtë zotni. Hoxha s'kundërshtoj.

Kur vemë në odën e këtij, ky djal' i ri, që do ish 27-28 vjetsh më jep një cigare të mirë, një çaj edhe më të mirë dhe qëndrojmë të dy pranë porrit ndezur, që kisha 10 dit të shoh zjar me sy.

Ky zotni ishte i veshur mirë, i biri i një pashajt, bërë syrgjyn nga Sulltani. Ishte nga oxhakët më të mbëdhenj të Shishllisë në Stamboll. Kishte qenë toger i kavalerisë turke dalë prej shkollës ushtarake të Bruxelles-it (Belgique) dhe ndodhej aty si i pandehur për një artikull që kish shkruar në një gazetë frënge kundra ushtrisë ottomane.

Si zumë muhabet mirë e u njohum i rëfeva edhe unë me pak fjalë historinë t'ime dhe filloj një miqësi e sinqertë ndërmjet nesh. Ajy kish kënduar shumë gjërra edhe unë i tregonja gjith'ashtu shumë sende e kështu edh' ajy ish i lumur se më takoj atje edhe unë pse shpëtova nga pisllëket, se te e mbramja këtu kisha një shoqëri të mirë edhe disa libra që munt të këndonja, veç asaj diku i sillnin atij dhe nga pak ver' e raki, që kështu e pinim bashkë. Quhej Lutfi bey, i biri i një generalli Shukri Pashës, pikrisht nga Amassia, po shpërngulur në Stamboll dhe ky Shukri pasha ishte një prej shokëve e bashkëpuntorëve të të famshmit Sherif Pashës që botonte revistën revolucjonare "Meskoudiet" në Paris, që i kundërshtonte Sulltan Hamitit dhe politikës së tij.

Atë dit Lutfi beu më mbajti për drekë me gjithë protestimet e hoxhës t'em Naerullah efendiut, i cili s'më ndante nga sofra dhe ardhi dy herë të më kërkonjë.

Kur është njeriu në një moshë t'atillë vërsnike si ishim ne me atë liberal djalë, nuk vonuan të zerë një miqësi të ngushtë, të bëhet vëlla me atë e t'i zbrazë barkun. Ashtu n'a ngjau edhe ne me Lutfi benë. Më dy or' e sipër ja dinja gjithë historin' e tij dhe ajy t'imen dhe

n'a vinte sinqerisht keq njërit për tjetrin, dhe s'druheshim as ajy, as unë të tregonim ç'do të fshehtë të zembrës.

Në bashkëfjalimet e sipër që kishim më thotë një dit se ajy ka një të kushëririn të parë që është kryesekretar i Ministrisë së Policisë. Un' i thashë ahere dhe u çudita pse, kur ka miq kaqe të fortë është akoma në burg. Kishte 8 muaj në burg. Ajy më përgjigjet se pun' e tij s'është si puna ime se ajy ishte burgosur drejt për drejt prej Sadri-a-ramit Teufik Pashës dhe kishte qint për 100 shpresa se do delte, prandaj ishte i vetëmi midis të burgosurve, që kish të gjithë lehtësirat e duhura brenda në burg.

Po çështja ime si të duket? i thom. – S'duket të ketë rëndësi, më thotë se shpirti yt s'di gjë. Ti mos u mërzit që vonojnë pak hetimet, ja ku jemi bashkë. Mirë, mor vëlla, i thom, por unë kam shtëpi përsipër, kam ardhur për punë këtu, është gjynah të ri këtu. Ti, po të duash, i thom, më rekomandon te yt kushëri, kur paska një pozitë të lartë, si thua. Ajy mundet të më shpëtonjë. Do përpiqem, më thë, Parole d'honneur "Parole d'honneur".

Natën tjetër gardjani që i shërbente Lutfi beut ishte ndruar. Në vënt të tij ardhi kush? Ajy shkurtabiqi që rraha dy herë. Qyhej Daut aga prej Kaiserrijë. Në krye më shihte me inat, po s'kuxonte të fliste gjë, se kish frikë nga Lutfi beu.

Një dit, tuke qeshur i kallxoja Lutfi beut episodhet me Dautanë dhe u çkul së qeshuri. Dhe zu po e gërgiste Dautanë që e rahu një gjahur[1], që s'ishte i zoti, që e ha bukën haram etj. etj. gjërra që e thartuan shumë Dautanë, me gjithqë un' i lutesha Lutfiut të mos i binte më qafë.

Shkova mirë nj'a 5 ditt me Lutfi benë. Po një natë, natën e pestë vjen një polic me ngutësi e më mer nga burgu. Më lith duart me hallka, si kur isha ndo një kriminel e më sjell përpara një kryekomisari në Ministrin' e Policisë. Atje më pyesin hollë si dhe nga e njoha Lutfi benë e pse jam me atë, ç'kemi folur, ç'më ka thënë etj. etj. Ju përgjigja të drejtën si u njohëm dhe si s'dinja gjë tjetër. Më sjellin prapë lidhur në burg e më vendosin në një kaush prej atyre të katërve, ku ishin gjithë katilët e kriminelët më të mbëdhenj dhe ku ruheshin më një severitet tepër strikte.

Aty rashë shumë keq; s'kisha ku të shtrinj këmbët. S'më lanë të mar nga oda e Lutfi beut as jatakun, as jorganin e jastëkun, agjë. U mbusha prapë me mora edhe mora me bisht. Qelbësira, pisllëku e ndyrësia e këtij kaushi kalonin ç'do përshkrim. Këtu vojta të zit' e ullirit.

E mora vesh se gjithë ky gazep më shkrepi nga gardjani i keq Dautaj, i cili vinte e më mbureshe në kaush që ajy ma bëri këtë edhe që s'më ndahej gjer sa të më shihte në litar.

Durova nj'a dy dit në këtë mjerim të math dhe bëra si bëra i shkrova në një copë letër me molyvë[2] Lutfi beut, ku i tregonja ç'më bëri Dautaja e i lutesha të bënte ç'të muntte për mua e ja dërgova letrën me një gardjan tjetër.

Ditën tjetër më vjen që me natë Dautaj i mallkuar e më thotë pa një pa dy se i kish thënë drejtori i burgut qinse kish marrë vesht se unë isha i dënuar për vdekje prej Këshillës gjyqsore të Policisë dhe se dënimi i jem do të exekutohej shpejt!

Munt të imazhinonjë tani kushdo pozitën t'ime të mjerueshme, pikëllimin e math e të patreguar që ndjeva atë ças! Agoninë t'ime m'a shtonin hapsorët e tjerë të atij kaushi që e dëgjuan të gjitha Dautanë që të theshte seriozisht këto lajme. Ata më ngushëllonin tuke më zënë për dore e tuke më dhënë gajret! S'dinja ç'të thesha, s'dinja ç'të mendonja, m'u pre buka, m'u pre fjala, të gjitha! Qysh atë ore gjer sa u ngrys kisha pirë dy paqeta cigare! Ora më 10 të natës, mezi më mori pak gjumi, e ç'farë gjumë, gjumi i andrallës, i agonisë, gjumi, si e mendonja, i fundit!

Ditën e parë, midis kolegëve tjerë, kisha njohur në kaushin që hyra natën e parë dy Ermenë hapsorë një farmacist të gjatë e të fortë nga trupi si Goliath që quhej Mihran dhe e

[1] gjahur = kaur (H. K.)

[2] molyvë (молив) = laps (përkthyer nga bullgarishtja me google H. K.)

kish farmacinë në Jedukule dhe një teneqexhi që quhej Tonos, të vetëmit njerës me të cilët shkëmbeva dy fjalë e që u njohtim.

Atë natë të tmershme e të paharuar, që po kujtonja se ishte nata e fundit e jetës s'ime, e që po i linja shëndet kësaj bote, tuke mos ditur me ç'farë dënimi do më vrisnin, më kish hyrë një frikë e madhe, edhe më tepër se, një natë më parë kishin marrë në mes të natës dy nga kaushi t'onë, gjoja sikur t'i pyesnin dhe të nesërmet ishin gdhirë të mvarur brenda në avullinë e burgut t'onë! Këtë e muarm vesh të gjithë, pra, kur n'a lajmoj edhe Dautaj në atë mënyrë, e besova vërtet se edhe mua fati i atyre të dy të zinjve do më gjente!

Një vetëm më ngushëllonte pak, se s'kisha shkuar në gjyq që të dënohesha më parë pastaj të exekutohesha. Po edhe ky ngushëllim, mjerisht m'u shduk, kur pyeta nj'a dy prej atyre katilave të kaushit e më thanë se edhe ata të dy ashtu i muar pa një, pa dy, edhe pa i gjykuar aspak! Kisha humbur ç'do shpresë. Këto mendime të këqia më vranë fare, më fiknë! U mshteta në një qoshe i tralisur edhe s'mora vesh si më kish zënë gjumi.

Nga mezi i natës ndjenj një shkelmë të fortë vitheve. Zgjohem i tromaksur. Shoh Dautanë përpara! Medet , ardhi fundi i dramës! Ah, Dautaj, Dautaj, ajy njeri odioz[1] e ogursëz për mua! Më vinte sikur shihnja xhelatin t'em! Kalk be, jezit, kalk çabuxhak! Ngrehu, bre jezit, çohu shpejt! – Hajr oller? i thom. – Seni bekliorllar, Ty po të presin, më thotë. – Aman, ç'është i thom, mos do më mvarin? – Bilmem, thotë, nuk di!

Zembra më iku, s'më bënin duart as këpucët të mbathnja, të cilat as që i mbatha dot, po i mora në duart se s'më linte Dautaj. U zgjuan nj'a 3-4 kolegë prej kaushit dhe po më mbanin me gajret "mos u tremp, më thonë, kjo dynja është jallane, je i lumur se shkon sheit (dëshmor) pranë Allahut" – Haj ogurllarolla, ja priste tjetri; Allaha ismarlladëk, të rekomandojmë ne Perëndia shpirtin etj. etj. Bre, bre, mejtohem, si më përcjellin këta njerës në atë dynja tjetër!.... Aman, Zot si s'u prisha mentsh!

Mora këpucët në dorë e pallton tuke lënë festen e disa gjërra të tjera që kisha në jatakun t'em dhe hoqa përpara duke patur Dautanë prapa, edhe midis ngushëllimeve të kolegëve, dhe isha kaqe i pikëlluar; sa i pikëlluar munt të imagjinohet të jetë një i dënuar për vdekje që ecën mbi Golgothanë në karmanjollëk.

Kur afronim te porta e hekurt e burgut kthehem prapë e i them Dautajt : Daut aga më ndje për ç'të kam bërë. Na edhe një mexhite ta pish për shpirtin tim. Po , aman më thuaj, a kanë ngrehur jashtë në avulli ndo një trikëmbëshe për mvarje, sikur se mvarë ata të dy pardje? Dautaj mori mexhiten e e vuri në xhep, një herë, pastaj nënëqeshi pak dhe më dha një cigare dhe ajy mori shkas se munt të pinte natën, se kish ngrënë iftarin, e më thotë: Afedersenez, bej efendi, më ndje zotni, korkma[2], mos u trempni kaqe fort se s'ka gjë jashtë në avulli. –Vërtet, vërtet? Ju hotha për qafe Dautajt e e bëra me një herë vëlla. – Aman, mos më gënje, i thom. Vallahi, Bilahi, Tallahi, thotë, s'të gënjej. Po ahere pse më trëmbe sot aqe fort , ç'të bëra . Desha të çfryj inatin, thotë, po tani e shoh që gabova e të mora më qafë, m'a fal, m'a fal. – Eh, apo ka gjë? folë të drejtën , për imamin që ke, i thom. Prapë përsëriti benë që s'di gjë, veç se i kish dhënë urdhër drejtori i burgut të më marrë shpejt se po më kërkonte vetë ministri (nazër efendi hazretleri) i Policisë. Mos kij frikë, thotë. Më ardhi pak shpirti, me gjithëqë s'i zinja besë Dautajt, se mendoja se mos desh të më mbante me ngushëllim se mori mexhiten. Po prapë zura t'a mbesonja se munt të ishte ashtu.

Në këto fjalë arrimë ne dera e hekurt e burgut. Dautaj bërtiti një herë dhe ardhi e n'a e hapi një gardjan tjetër. Duallm jashtë dhe kur po shoh nja 10-12 të tjerë hapsanikë grumbulluar afër derës së zyrës drejtorit të burgut.

Brenda ish drejtori, 3 policë edhe një civil tjetër, veshur elegant e me syze, një djalosh nj'a 23-24 vjetsh. I pashë e më ardhi pak zembra. Të mvarren gjithë këta? Mendohesha. Jo, s'ësht' e mundur. Po ahere ku i çojnë?

[1] odioz = i urrejtur (H. K.)

[2] korkma = mos kij frikë (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

Afrohem e pyes një e më thotë se munt të na qitnin në gjyqin e posaçëm të Policisë qëndrore. Një tjetër më informon se po n'a transferojnë në burgun e Gallata-Serajit dhe dikush tjetër, se na bëjnë syrgjyn në Halep. A s'po n'a mvarrin, thom. Si të bëhet le të bëhet, ne u msuam nga aventurat! Po, tuke u menduar kështu më venë sytë në një njeri të njohur që dallonte prej të tjerëve, se ish edhe më i gjatë edhe më i trashë. Ishte gjiganti Mihran, farmacisti Ermen i kaushit të parë. Mihran efendi! i thom.... . Kthehet e më sheh; Monsieur Floki. . . Par l'amour de Dieu qu'est ce qui nous deviendrons maintenement? – Je crois que nous allons nous juger. – Vraiment? – Pent-etre. Va-til qualque danger? – N'en croyez pas. Kështu u morëm vesh frëngjisht dhe kuptova se do n'a gjykonin.

Ajy djaloshi elegant me sŷze që përmënda, m'u duk si një sekretar i veçantë i Ministrit. Pas 2 minutash si vajta, filloj të n'a thresë një nga një dhe të n'a regjistronjë në një copë letrë. Kur ardhi sëra ime thret : "Gjeuritxheli dava veqili Hiristo Floqi efendi.... . Edhe unë dolla përpara : Mevxhud, efendëm. Ja ku jam, i thom. Djaloshi me sŷze më pa një herë me vërejtje, pastaj më pyet prapë : Siz mësën, efendëm? Ju jini, zotni? – Si urdhëron, i thom avokat Kristo Floqi. "Gjel shuradan, më thotë, eja këtej" edhe më veçoj nga shokët. – Unë ngriva prapë! Medet, psé më veçoj? Po ajy si i thiri të gjithë ja u dorëzoj policjotëve që ishin atje, e mbassi shkuan të gjithë më thotë t'i vete pas. E dëgjova edhe duallm nga oda e drejtorit të burgut, tuke e salutuar e tuke marrë një direksion nga e mëngjëra e avullisë. Aty hymë më një derë që vetë ajy djaloshi e çili me çelsin që kish në xhep. Pastaj hymë brenda. Pashë një koridor të gjatë me disa dritra. Djaloshi e mbyll derën që përbrenda dhe mer çelsin në xhep. Nxjer pastaj një shami të bardhë prej xhepi dhe më thotë se do më lidhë sytë. – Pse? i thom . Ashtu kam urdhër, thotë po mos u tremp se do të të heq për dore, s'duhet të dish, thotë se nga të shkonj. – Po pse këjo? – Mos u tremp s'është gjë, thotë. Ç' do bënja? Ndenja e më lidhi sytë dhe po heq pasdore. Shkojmë gjatë, kthejmë nga an' e djathtë, ecim mjaft hyjmë me një si ahur ku ndjenja se shkel mbi një plehë kuajsh a ku di unë, pastaj dalim prapë e shkelim në tokë, ecim akoma e më thotë "hipni" ose "ngjituni"; ngjitemi disa shkallë, ecim pak mbi dysheme, ku do ish ndo një sallë, këthejmë nga e rëmakta dhe posa u ngjitmë në një shkallë tjetër, më qëndron e më zgjith sytë.

Një sallon i math lluks më del përpara syve e ment më qoronin dritrat e shumta. Djaloshi më saluton, tuke kërkuar ndjesë me një fisnikëri të veçantë. Ku jemi? i thom. Jini në sallonin e Ministrisë së Policisë, më thotë. Qëndroni këtu pak sa të lajmëronj superiorin t'em e po vinj t'ju mar. Më lë aty vetëm, me gjithëqë ish një kallaballëk njerëzish që hynin e delnin e hipnin e zbrisnin shkallët e megjithë që ishte ora një pas mezit të natës. Pas 2 minutash kthehet prapë djaloshi e më drejton në një derë tjetër, ku mënjan një perdhe të trashë të gjelbër e të terët e më bën me shenjë të hynj brenda, ajy del për jashta dhe më s'e pashë më.

Hyj në një sallon të shtruar bukur me haljâ ose sixhadi persane, mobila extra, dritë elektrik, një .... . (nuk lexohet H. K.) europjan, ngrohtë, lluks. M'u duk sikur hyra në Parajsë. U ngroha me njëherë se isha tharë së ftohti. I harova të gjitha, frikën e mvarjes etj. etj. Shoh atje tej një desk[1] të bukur dhe një zotni tepër elegant 30-35 vjetsh me sŷza edhe ky, po shkruante. Bëra disa hapa e i vajta përpara. Ajy i okupuar tepër po shkruante e s'më vinte ré. U shtërngova të benj sikur kollem e kështu shtiri syt' e më pa : Cili je ti? më thotë. Avokat Kristo Floqi, i thom. Me diplomë avokat? Si urdhëron. Ku ke mbaruar shkollë? – Në Athinë. Nga Korça je? Si urdhëron. – Sa ditt ke në burg? Bëhen 19 ditt Shkëlqesi, i thom. – Urdhëro ri më thotë e më tregon një kolltuk me lëkurë lluks.

Shkëlqesi i thom , a munt të ri kështu si jam, t'ju ngjit mora?

Otûr, otûr, efendëm[2], më thotë, zazur jok[3].... dhe tuke më parë në sy:

[1] desk = tavolinë (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

[2] Otûr, otûr, efendëm = uluni, uluni, zotni (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

[3] şaşur jok = shaka tronditëse (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

Pse je kaqe i zbetë? thotë. – Nga sëkëlldia, i thom, pastaj kam qenë edhe i sëmurë. – I sëmurë? E s'të ka parë ndo një heqim? – Aspak, i thom. I gërcet ziles e vjen një polic. Shko shpejt, i thotë e më dërgo këtu bash-komiserin. Shkon polici dhe për 5 minuta hyn një njeri i gjatë me një mjekër si të Tollstoit dhe saluton atë zotni 3 herë gjer më dhe. Ishte kryekomiseri i Ministris Policisë. Mora vesh se efendiu me gjyzylyket që e thiri do ish njeri i math, që e salutoj aqe fort.

Hasan bey, i thotë me inat Kryekomisarit, kështu t'i kemi besuar këta jabanxhinj (dhe me tunt mua për jake) t'i lesh të vdesin në burg pa ju dërguar heqim kur s'mundish. "Efendëm , af edersener, zatialileri, ja pret Komiserbashi S'di pse s'ka shkuar doktori ta shohë; Un' i kam dhënë urdhër. – Shko shpejt, i thotë e më dërgo këtu Doktor Tahir benë të burgjevet. Shpejt, tani. Hasan beu saluton gjer më dhe edhe ikën tuke ecur prapazi për nder gjer dolli.

Si mbetmë vetëm e u sheshova në kolltuk, më thotë me një fisnikëri, se do më dërgonjë në spitale, po tash të shkonjë prapë në burg, mbassi të më shohë heqimi.

Aman, i thom, zotni, shkëlqesi, kushdo që jeni, më mirë më vrisni se sa të më dërgoni edhe një herë në burg. Plasa, s'duronj dot, do vdes atje brenda; lutfen merhamzten[1] bëni embër të dal nga burgu.

Ajy s'më foli po porositi një kafe, pastaj tuke kujtuar edhe mua i tha policit të bjerrë dy kafe. Dhe filloj të shkruaj pa më dhënë përgjigje. Ardhë kafetë. Mua më shkoj ndër mënt, se mos ajo ishte kafeja që ju jepte Sulltani të sëmurve për vdekje. Prapë zu po më rihte zembra. Që të jem jashtë rrezikut dhe tuke përfituar nga okupimi i këtij zotnije që ish unjur e po shkruante, i ktheva me maryfet filxhanin t'em atij dhe të tijnë e solla nga ana ime. Zura të pi por gjithënjë frika s'më delte. Ajy e mori, e piu me njëherë të tijnë, unë po e shihnja në sŷ se si do bënte, e pashë se ajy s'mendoheshe si mua e kështu u shërova edhe nga ky dyshim. Më në funt e piva edhe unë t'imen.

Më atë kohë erdhi edhe komisar-bashi, i cili e lajmoj zotninë se doktori i burgjeve kishte qenë në Makriqoj e do vinte të nesërmet. Ahere ajy zotnija i naltë, që unë kujtonja se ishte vetë ministri i Policisë më thotë me një bujari delikate, urdhroni shkoni edhe sonte në burg dhe nesër do të vini që me natë në spitale; e i jep urdhër dhe kryekomisarit të më marë.

Kallk[2]! më thotë ajy vigan i keq me inat. Un' u ngrita. Në atë dëshpërim që më kapi prapë i flas atij zotnije frëngjisht. Excellence, ne me laissez aux mains sauvages de cet homme; je suis tres malheureux; si je vais un fois encore en prison assurement je sui perdu. Sauvez-moi. [3]

Zotnija që më kuptoj mirë nënëqeshi. U suall pak, u mendua nj'a dy minuta, pastaj kthehet i thotë Hassan beut. Lëre, lëre (për mua); ikë tani, i thotë pa në paça nevojë të thres. Komisarbashi iku e më la. Tani m'u duk sikur shpëtova.

Zotnija i mirë më thotë në një frëngjishte gati parisiane : Nuk më thua, pse s'pranove të vesh nënëprefekt në Melenik kur t'a propozuan? E pashë që e dinte mirë punën t'ime. I thom: Shkelqësi, unë kam ardhur këtu për turqishten i thom, pse të pranonj nëpunësira kur kam karierën t'ime? Më pyeti pastaj cilët njoh në Stamboll, pse vinja shpesh herë në Sirqexhi ku mblidheshin gjithfarë njerëzish të dyshimtë për qeverinë etj. etj. E mbassi u përgjigja dhe sigurova mirë që s'kam asnjë qëllim politik, po vetëm turqishtja më solli atje, ahere ngrihet nga vendi i tij, më thotë t'i vete pas, del në divan e shkon për së gjati ku hyn në sallonin e math të gjyqit policor. Hyra dhe unë dhe pashë një tribunal chic, llampste nga dritrat. Dukej se bisedonin. Ishin nj'a 9-10 shpirt, midis të cilëve shkëlqente një mjekër e bardhë si dbora, si

[1] lutfen merhamzten = lutem, kij mëshirë (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

[2] kalkmak = çohu (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

[3] përkthimi me google i kësaj fjalie nga frengjishtja: "Shkëlqesi, mos më lër në duart e egra të këtij njeriu; Unë jam shumë i pakënaqur; nëse shkoj edhe një herë në burg, jam i sigurt se jam i humbur. Më shpëto" (H. K.).


mjekra e profetit Avraham. Pa fjalë ky do ishte kryetari i gjyqit dhe të tjerët anëtarë. Ajy efendiu që më solli atje brenda më porositi të qëndronj jashtë parmakëve të sallës së bisedimeve dhe vetë vajti nga ana e djathtë dhe çeç i foli në vesh për mua kryetarit, i cili shtyri sŷtë e më pa, e pastaj ju foli edhe diçka azallarëve të tjerë prapë për mua si kuptova, dhe më bëri shenjë me dorë (kryetari) të dal jashtë. Ahere ajy zotnija jem e salutoj me një nënqeshje si kur se u kënaq për mua, ose sikur ju fal nderit dhe zbret s'andejmi e dalim që të tre sipas urdhërit të atij zotnije. Atje përpara derës shoh gjith'ata njerës që pashë edhe përpara derës drejtorit të burgut. U gëzova kur pashë Mihran, spicerin. Mihran efendi yat-il quelque chose? i thom. – Enfin nous sommes delivres, më thotë dha Zoti thotë e jemi të lirë tani. – Të lirë? Të lirë? Vërtet Monsieur Mihran? Vërtet? – Po, po, më thotë e më dha një cigare. Ndejmë aty tuke fjaluar nj'a 10 minuta. Po ç'bëjnë tani, i thom, do n'a mbajnë akoma këtu? Presim të lirohet komisari, thotë e të n'a dorzonjë se cilin në shtëpi të tij. Mora frymën.

Për pak del një njeri. Ishte komiseri për të cilin kisha edhe unë shkresën që mbanja në dorë. Ja dhashë, e hapi, s'foli gjë. Hyn brenda e zgjon një polic shkurtalaq, një perzhûnt, një biçimsëz e i thotë të n'a marrë ne të tre, mua, Mihran efendinë dhe Ermenin tjetër teneqexhi Tonosin, e të n'a çonjë nëpër karakollet e shtëpijave t'ona se ishim më afër se hapsorët e tjerë të liruar.

Ky polic i poshtër, ky gjakpirës i keq n'a mer të treve e n'a heq gjer më një avulli të vogël ku hap një copë qymes pulash sa nxinte 4-5 veta me një dritare të vogël, n'a fut brenda e n'a mbyll. Deshte i poshtri të flinte nja 3-4 orë se i prishmë gjumin pastaj të na dorëzonte nëpër shtëpitë gjithsecilin. Po Mihrani u zembrua fort e zu bërtiste e shante. Ajy polici u kthye dhe e shau rëndë. Un' e pashë se kush e di sa do n'a mbante atje dhe qit i jap një mexhite nga penxherka. Polici e mori hapi derën e më thret vetëm mua të dal jashtë. Ahere dhe Mihrani më dha 2 çerekë dhe Tonozi një tjetër e ja dhashë policit dhe kështu n'a nxori që të tre jashtë. Me një mëjri xharra e britmë të n'a shpjerë nëpër shtëpitë tuke i thënë se do t'i jepnin edhe të tjerë bakshishe.

Na mori, n'à nxori jashtë Ministrisë së Policisë. Hej, shyqyr o Zot mezi shkela një herë në rrugën e lirë! Dalim në rrugën e gjërrë të Sulltan Bajazit. Dbora po binte copra copra. Kur shkonim rrug's më thotë polici të vetë t'i ble një paqetë cigare. Shkova i mora një paqetë 50 parallëke duhan. Posa ja dhashë e flakëriu atje tej në baltë. Dua cigare, më thotë, 3 ½ grosh paqetën që ishin më të mirat. Shkova ja mora të poshtrit. E mori kutinë e s'foli gjë. Tuke shkuar shoh që afrohemi afër shtëpisë sime. I lutem të më dorëzonjë mua më parë se isha afër. Ajy liron teneqexhi Tonozin, pa dorëzani e mbetëm vetëm ne të dy me Mihranin. Tonozi na zu për dore ne, i bëri një temena policit rezil dhe ja mbajti drejt për në shtëpin' e tij.

**FUND I VOLUMIT TË PARË**




*Vazhdon nga vol 1*

Duke shkuar kështu të tri, polici, Mihrani dhe unë futemi në lagjen Vllanga që i ka rrugët shumë të ngushta e suspekte[1]. S'mora vesh se si u nis një shamatë midis policit e Mihranit, se kisha mbetur pak prapa, po vetëm pashë se po shaheshin me shoqi shoqin dhe n'atë kohë Polici i hiqte një shukretë faqeve Mihranit. Mihrani ju derth t'a përfshijë për gryke atë xhenabet, por ajy nxori bajonetën dhe gati ment e vrau Mihranin, po hyra unë në mes, tuke ju lutur policit të mos sillet i egër, por se polici i dobët ahere heq dorë nga Mihrani kur i fala unë një saat të florinjtë (pa kapakun e sipërm), të cilin im 'ëm më kish dorovitur dikur.

Si pushoj kafgaja nisemi drejt e drejtohemi në lagjen "Psamathia" ku e kish shtëpin' e dyqanin Mihrani dhe ku do t'a dorëzonte polici.

Mbas gjysëm ore udhëtimi apostolik harrijmë në "Psamathia"dhe dorëzojmë Mihranin në karakollin[2] e asaj lagje .

Kur e pashë që mbeta vetëm me policin i thashë frëngjisht Mihranit të merrnin një karrocë dhe të vimin në Jatim Pashë ku banonja unë, e para se ishte shumë lark e s'vijnim dot më këmbë, e dyta se më më mori frika nga ajy katil Polici. Mihrani e pranoj me njëherë propozimin që i bëra dhe shkoj e gjeti një karrocë e hymë brenda të dy tuke lënë jashtë policin me karocjerin.

Për pak harrimë në Jedik Pashë përpara shtëpisë si'ime. Kish akoma 2-3 orë të gdhihej dhe këmbanat e kishave po tingëllonin gëzimisht. Ahere më ra ndërmënd se ajo dit ishte dita e Krishtlindjes dhe këmbanat po ftonin besnikët në kishë.

Shtije sytë përpjetë dhe dallonj plot dritta. Thres që përposh të zonjën e shtëpisë Elenën, e cila atë kohë po pregatitej bashkë me çupat e saj Dhespinën dhe Romelynë të shkonin në kishë.

Ato të ngrata posa dëgjuan zërin t'em u coptuan gjer sa zbritnë përposh e n'a hapnë derën. Hymë brenda e n'a pritnë me një gzim të patreguar.

Mirpo Polici maskara s'deshtë më dorëzonte mua se s'gjenja ndo një garant si gjeti Mihrani.

Mihrani ju lut policit të më erë e të vinte të nesërmet t'i jepnja edhe garantin, ose edhe vetë ajy ofrohej si garant, në qoftë se e pranonte. Por se polici nuk dëgjonte dhe më zë për krahu e më heq të dalim të më çonte prapë në burg.

Tani kjo punë munt të ujdisej me ndo një bakshish tjetër, po Ermeni Mihran nuk më linte t'i jepnja gjë. Polici e mori vesh dhe kafgaja filloj prapë. Fjala-fjalën u zunë që të dy dhe polici s' mënoj, po ja mveshi një pëllëmbë suratit Mihranit. Ahere Mihranit s'ju durua. Më ta rëmbeu policin për xverku dhe, si vigan që ish, e përplasi sa mundi në plloçat e hajatit, sa thamë se mos i plasi koka. E vuri poshtë dhe ja filloj me grushte suratit e ku muntte.

Ndërkohë kthehet e më thotë mua : "merri-a shpejt sahatin e florinjtë që i fale për mua këtij pezevengu" . Edhe unë, menjëherë ja gjeta në xhep të jelekut policit dhe ja mora.

Tue qenë se gratë e shtëpis s'ime u frikësuan tepër kur panë këtë sqenë dhe zun' e thrisnin, po ana tjetër thriste edhe polici që po rihej, dëgjojmë gërcitje në portën e sokakut me një furi, me batare. Ishin rojtarët e rrugëve që deshin të futshin brenda.

Ahere Mihrani e lëshon policin, i cili çohet me njëherë dhe çvesh kasaturën[3] e fillon t'i bjerë Mihranit. Unë ja përfshiva dorën e po ja mbanja, kurse njera prej gocave shkoj e hapi derën dhe 3-4 bakçinj u futnë me yrysh brenda.

Nedër bu, nedër bu[4]? Ç' është këjo thanë dhe futen në mes të Mihranit e të policit. Mihrani ju thotë se ky polici kërkon të n'a vrasë brenda në shtëpi t'onë, tuke treguar edhe kasaturën të cilën polici e kish akoma në dorë dhe unë nga ana tjetër i shtërngonja krahun dhe e ndalonja.

---

[1] suspekte = të dyshimta (H. K.)
[2] karakoll = postë policije (H. K.)
[3] kasatura = bajonetë (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[4] Neder bu, neder bu = Çfarë është kjo, çfarë është kjo (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

Bekçinjtë s'pritnë më të marrnin të tjera shpjegime dhe tuke kujtuar se polici do të ishte i dehur e rëmbejnë tuke shtyr' e tuke rahur e e qitin jashtë, kështu që shpëtuam edhe ne prej atij firauni të keq. Mbyllmë derën e hypmë lart të gjithë dhe gratë nuk shkuan të varfrat në kishë po ndejnë aty me ne e s'na lanë vetëm.

N'a bënë një tenxhere çaj, më dhanë biskota, etj. Të cilat i gollofitmë si të paparë si unë si Mihrani. N'a dhanë pastaj edhe nga një çorbë…(nuk lexohet por mund të jetë "simite"H. K.) të mira, që kishin pregatitur për mëngjezin e Krishtlindjes si dhe nga nj'a dy gota verë për shoq edhe pastaj kafe 3-4 herë me radhë mbassi kishim kaqe dit që ishim dëshëruar.

Mihrani sapo zû të zbardhëllehet më la shëndet e iku, tuke m'u lutur të vinja t'a shihnja nga ndo një herë, mbassi u njohëm në kondita të këtilla. Unë u çvesha, u ndrova dhe mbassi dyshegu dhe jorgani im mbetnë në burg më dha e zonj' e shtëpisë takëme të saja, më goditnë shtratin e rashë të flë i lodhur e i raskapitur në gradën e fundit.

Zura të fërkonj sytë. Më dukej ëndërr që e shihnja vehten të lirë. Nuk e besonja. Mora një frikë aqe të madhe, sa për kush e di sa kohë mezi që e shtrova mëndjen. U betova të mos rinja më në atë qytet të mallkuar të Stambollit ku mënt lashë eshtrat e mija.

Rashë në gjumë e u zgjova të nesërmet më të ngrysur do. m. th. kisha fjetur gjithë ditën.

Mbassi kaluan nj'a dy ditt e e pashë se s'pat pasime ajo dramë e asaj nate me Policin, dhe mbassi s'u thirmë as prej policije as prej karakollit të lagjes, një ditë u lava e u vesha en grande uniforme (me redinkotën që ish e modhës) dhe shkova në Ministri të Policisë për me ju falë nderit atij burrit fisnik që ndërmjetsoj atë natë në gjyqin e Policisë e më shpëtoj, sepse kisha marrë vesh se ajy ish kryesekretari i Ministrisë Policisë dhe kushëriri i Lutfi beut, mikut t'em në burg që i ishi lutur për shpëtimin t'em. Pyeta edhe si e quhanin në embër e mora vesh se quhej Gani bey i bir' i një generali, nga Stambolli.

Pra, atë ditë ngjitëm në Pallatin e Min. Policisë dhe kërkonj audience prej Gani beut. Ky me një herë urdhroj të hynj brenda dhe kur më pa ashtu të veshur elegant më priti mirë, po nuk më njohu në fytyrë, se këtë radhë isha pa mjekër dhe veshur si gentleman.

Si më njohu, qeshi pak dhe më thotë pse jam munduar gjer atje. I përgjigjem së bënj një detyrë faqe një mirëbërësi t'em, të cilit vinj të çfaq falenderimet e mija të nxehta dhe mirënjohjen e thellë për mundimin që mori të më shpëtonjë prej atij burgu të tmerrshëm. Ajy s'foli gjë, po pas një pushimi të vogël m'u lut të mos ja zë embrin në gojë, se munt t'a kompromentonj si atë, si mikun t'em Lutfi bejnë. Fort bukur i thashë e i kërkova ndjesë. Me gjith' atë më porositi t'a shoh më të rallë, po jo në zyrë. Kështu më tregoj shtëpin' e tij në Bujuk dere, ku i vajta nj'a dy herë e e njoha për së afërmi si njeri fort të mira e sociablë, djalë serioz e mjaft i dijshëm.

Një dit tjetër vete në burg të shoh mikun Lutfi bejnë, mora edhe disa peshqeshe hajesh t'i shpie me gjithë që kur e kujtonja atë burg më çpifeshin hethet.

Hyra në odën e vogël të drejtorit të burgut e i thashë përse kam ardhur. Ajy plakoshi i keq , posa dëgjoj që kërkonja Lutfi benë, pa një pa dy më mer e më mbyll në një odë tjetër afër tij e më thotë se do të jem nënë vërejtje gjer sa të vijë urdhëri prej Nazër effendi hazretlerisë (Min. së Policisë) e ahere do më lëshonte. Më kot mundohem t'a bint se isha një herë në atë qen burg e mezi shpëtova, po më kot, plakoshi gërmuq s' bindej me asnjë mënyrë. Medet ç'më gjet! E kërkova si breshka gozhdën! Ç'më duhej mua? Mirë të më bëhej.

Po tani si do vejë halli as unë s'e di.

Ndejta nj'a dy orë në atë agoni. Për fatin t'em pashë prej penxheresë një fytyrë të njohur që po vinte te drejtori i burgut, s'di se për ç'farë çështje. Ishte një bej Stambolli të cilin e kisha njohur në Universitet të Stambollit, miku i Petraq Kondilit, student edhe ky i drejtësisë. E thira shpejt e i tregova hallin dhe ky e një herë i thot' atij shtriganit drejtor të burgut e m'a hap e dal jashtë tue u pjekë me mikun bej.

Plakoshi maskara s'dinte si të justifikohej përpara mikut t'em. Me gjith'ato prapë s'më la të shoh Lutfi benë po edhe poklonet që kisha harxhuar 2 mexhita, m'i mbajti i poshtëri e s'më la as t'i mar me vehte. Kësij hajdutësh memur kish Sulltan Hamiti asokohet.

Kisha vendosur të mos ri më në atë namkeq Stamboll, se më zijnin edhe hethet e kisha fituar nje reumatismë të fortë ne bodrumet e atij burgu dhe dita-ditën po mendohesha kur do shkoj. Desha të kthehem prapë në Karvasarâ, që të mos vete prapë në Korçë, ku far' e fisi me të luturat e tyre që të rinja atje më kishin marrë më qafë.

Sikurse kam përmëndue edhe tjetër erë në këtë histori, në Karvasarâ kisha njohur një zonjushe Marigo Vasso nga Labova, e cila na kish pritur atje kur për të parën herë vamë me tem' ëmë në Karvasarâ.

Këjo zojushe qysh atë mot ish martuar me një zotni prej Kalipolit të Thrakës që quhej Janaqi Ekonomidhi, doktor i marinës luftarake të Turqisë.

Unë, i vogël ahere, ju pata vënë kurorë në Prevezë dhe kështu isha kumbari i tyre. Janaqin e mbanja ment mirë, po Marigonë e sillnja ndër ment ndose kisha 18 vjet t'a shoh. Ajo më kish dashur shumë e gjora.

Prej Stambollit i kisha shkrojtur nj'a dy herë ditët e para që ardha, por me që rashë në burg, s'muar vesh se ç'u bëra më tutje. Marigoja me të shoqin ndodheshin në Kios (Ghemlek), një qytet i bukur në funt të gjirit të Mudanjasë në pellgun e Propondidhës. Atje edhe banojshin rregullisht tuke patur shtëpin' e tyre e mylqe[1] të tjerë dhe Janaqi ishte major mjek i marinës Ottomane që qëndronte nër ato ujna.

Një dit kur po rinja në odën t'ime në Jedik Pashë më presentohet një djal' i ri, i holl' e i gjatë nj'a 25-26 vjetsh me emër Aleksandër Buda, me origjinë nga Elbasani, po prej kohësh mbetur në Ghemlek ku ishte msues. Ky zotni më vjen me një letër nga ndrikulla Marigo e cila kish marrë vesht burgosjen t'ime e lirimin e më kërkonte patjetër të vete në Gjemlek të më shohë se e kishte marrë malli prej kaqe kohësh vjetësh.

Zoti Budda më tha se ësht' autorizuar prej Janaq efendiut të më marrë nga Stambolli të paktën për një muaj si mysafir dhe s'duhej t'ja prishnja qefin.

Ky mik më ardhi si një engjëll prej qielli, një fort i math ngushëllim për mua. E prita me gëzim të math, tuke pranuar pikë për pikë propozimin që më bëri.

Mbas dy orësh, mbassi e mbajta edhe për drekë e hëngërm u nismë për në Ghemlek me vaporin "Hamidije". Z. Buda kish telegrafisur se po vijmë.

Mbas një udhëtimi tepër të bukur 9 orësh kemi vajtur natën në Gjemlek, një qytet amfitheatrik fort i këndëshmë në funt të gjirit të Mudanjasë.

Posa hodhi hekurin vapori shoh një barkë të stolisur me flamurin e Turqisë dhe me 8 remtarë që po i afroheshin vaporit. Me një herë një burrë me gjyzlyke ndo nj'a 40 vjetsh bashkë me një oficer turk të marinës hipin në vapor. Z. Buda më thotë me një herë se ajy burri me sŷze ishte i shoqi i Marigosë, Janaqi, tepër i gëzuar që më pa, më rekomandoj oficerin mik e kështu zbritmë në barkë e duallm në skelë ku më priste Marigoja e gjorë me gjithë djalin e vetëm të tyre Jorgaqin nj'a 12 vjetsh djalë si dhe me të mbesën e Janaqit, zonjushën Aglaïa Ekonomidhi.

S'rëfehen të qarat e mallëngjimet e Marigosë. Më priti si kur se munt të priste e ëma të birin e saj, të largura prej shumë vjetsh. Vamë në shtëpi të tyre, një shtëpi të re e fort të bukur, ku më kishin pregatitur shumë mirë edhe odën t'ime të veçantë.

Ndejta mysafir plot një muaj te Marigoja. Përveç që më rekomandoj ne gjithë miqt e miqeshat e saja, por më shetiti edhe në shumë vënde e qytete të tjerë, si në Brussë, në Mudanjâ, Sigjì, Trilia, Srmutli, Ismit, Pandorma etj. etj.

Unë prej nature isha shumë shakaxhi kur më hipte ora. Me të vërtetë shakat' e satyrizmat e mija vjershat e çashta hymoristike dhe llagapet që ju vinja njërit e tjetrit për tallje, ose shaka,

[1] mylk = pronë e madhe e palujtshme e trashëgueshme dhe e tjetërsueshme (H. K.)

s'kishin sosje. Këto i kisha shtuar tuke dëgjuar e u përzjerë me shumë qarqe shakaxhinjsh në Greqi e më fort në Athinë, në Pire e në Mesollonjë.

Mbasi kaluam nj'a 3-4 ditt mirë e si ju tregova kush e di sa shaka e qyfyre Janaqit e Marigosë dhe më fort të burgut, prej të cilave shaka fikeshin së qeshuri si ata, si dhe të tjerë mysafirë që ndodheshin në tryezë kur hanin ose kur bisedonin, u rekomandova nga të katër anët si shakaxhi dhe bejtexhi satyrik dhe mbi të gjitha Marigoja më kishte kaqe fort rekomanduar ne disa miqeshat të sajat gra e zojusha që s'kisha njohur sa një dit pas dreke ngrihen e n'a vijna nj'a 10 gra e zojushe prej shtëpijave më të mira prej Gjemlekut, greke të gjitha, që të më dëgjonin shakatë.

Takoj një dit e Djelë mbas dreke që më gjetnë ku flinja se kishim ngrënë bukë vonë e kishim pirë mjaft e si ishte ftoht' akoma më kish zënë mjaft rëndë gjumi.

Vjen Marigoja e gjora dy tri herë të më zgjonjë, po meazallah se tundesha ; më kish plakosur një gjumë që ler e mos e nga. Nuk çohesha nga tembellëku.

Si e pashë që insistonte Marigoja ahere u ngrita, u lava dhe ju dolla përpara zonjave dhe zojushave tuke u rekomanduar nga Marigoja. Disa prej atyre ishin kaqe të bukura, një racë e thjeshtë georgjiane që nuk shihen kollaj në botë. Omollogoj[1] se gjer ahere s'kisha parë as në Greqi as në Stamboll. Bukuri e symetri trupi extraordinare.

Djalli t'a sjellë të mos kem aspak qef atë ditë, jo shaka të tregonj, po as goja të më hapeshe.

Më afrohet disa herë fukaraja Marigoja e më shtyn e më lutet të hap gojën e diç të flas. Meazallah! S'më delte fjala nga goja. Mbeta si pût!

Të shkretat ato pritnë, pritnë me shumë se dy orë, po bosh, s'kisha as më të paktin oreks të flas. Edhe shakatë dashkan orën e tyre të volitishme, ndryshe s'kanë asnjë shije, asnjë lezet.

Të dëshpëruara ngrihen e hikin një nga një pa dëgjuar as gjysmë shakaje dhe nj'a dy prej atyre e muar më nj'anë Marigonë e ja thanë ashtu sheshazi se guak më i mirë se këtë djalë (mua) s'munt të bëhej e ju falë nderit që muar zahmetin kot e ardhë enkas për një buf si mua .

Marigoja, tepër e hidhëruar, m'u qa shumë e më hoqi verejtjen pse u solla ashtu pse nuk shkëmbeva asnjë muhabet. Po si të bëja kur s'më delte fjala nga goja? Mezi e rehatova Marigonë se një ditë tjetër do sillem më mirë, tuke vënë në vënt atë të metë.

Pas nj'a dy dit delnim me shetitë me një barkë familisht. S'kishim asnjë të huaj tjetër përveç një zojushe prej atyre që ardhë atë ditë të Marigoja për mua e s'u kënaqnë. Unë kisha edhe një qitharë në dorë e tyre marrë disa këngë satyrike të bukura që u entuziasnë e u fiknë gazit sa u ndodhë aty brenda u enthusiasa edhe vetë ca nga ca e m'u zgjith gjuha për shaka të ndryshme, që zura e serënditnja njërën pas tjetre. Ahere thotë Marigoja : Ah, ku ti kishim ato zonja të asaj dite të dëgjonin.

Zojusha e huaj, që ish në barkë n'a kërkon lejen të dalë pak në mol dhe e nxjerim gjer atje. Ajo ec me vrap e lajmon disa zonja e zonjusha dhe pas gjysmë ore shohim dy barka të tjera që po na afrohen plot me gra e vajza, ku pashë se ishin midis tyre disa nga ata që kishin ardhur atë ditë si dhe të tjera akoma.

Kuptohet se dëgjonin edh' ato ç'flisnin e ç'këndonim dhe për hatër të tyre e të Marigosë u shtërngova t'i repetoj[2] kush e di sa herë si këngët, si shakatë, po më fort shakatë. Kaqe shumë u kënaqn' ato sa n'a u lutnë të jem ashtu si ishim në shtëpin' e zonjës Evanthia Kangjellari, një zonjë e martuar me një Dr. G. Kangjellaris, milioner, po edhe zonja Evanthi ishte gjith'ashtu milionare, bij' e vetëm e një farë Liakaqis që kish fituar milionra në Persi.

Vamë në shtëpi të saj ku u mbothmë një numur aproksimatif 30 shpirt, prej të cilëve 2/3 ishin gra e zojusha. U shtruam. Mua më hapet një oreks hymoristik me një sukses nga më të rallët që paçë gjer ahere. Nuk di ç'farë e sa shaka tregova ; kaloj mezi i natës dhe akoma po rëfenja ; kujt i hahej bukë? Shakatë ishin kaqe të shumta e të goditura sa burra e gra

[1] omologare = miratoj, deklaroj etj. (përkthyer nga italishtja H. K.)

[2] repetoj = përsëris (H. K.)

betoheshin se s'kishin dëgjuar shaka më të bukura e më të shishme. Me të vërtetë atë natën Marigonë e nxora faqe bardhë edhe kush e di sa herë u ngrit e më përfshinte për qafe e më puthte e gjora.

Po ajo natë pat një pasojë tjetër gati të rezikshme. Një zonjë prej atyrë, zonja Katina Kuzuni, zonjë shumë e bukur, hyll po thuaj, 4-5 vjetsh martuar, ajo 25 vjetsh, i shoqi 56-58 vjetsh, mjaft i mplakur po zengjin shumë, mbassi fjaloj kush e di sa herë me mua, i hyra ne mes të zembrës qysh atë natë me maryfet më çfaqte ndjenja sympathije e më vonë dashurije, sa më shëkonte gjithë në sy.

Si u ndamë e shkuam nëpër shtëpitë secili midis falenderimeve të mbëdha e kujtimeve të paharuara, të nesërmet më vjen zonja Katina në shtëpi e si muntmë e u gjetme vetëm në sallën e pritjeve, më hapi zembrën e më thotë se ndjen një dashuri kaqe të madhe për mua sa është gati të më vinjë pas kudo që të vete, tuke lënë burrin e saj e shtëpinë.

Sado që u përpoqa t'a qetsonj se kjo ishte një punë e çmëndur dhe një gjë katastrofale për nderin e saj e të shtëpisë, s'ish e mundur t'a bintnja. Ajo e kish vendosur të më vinte pas, dhe si të ndahej nga burri të martoheshim bashkë, e më premtonte se kish një pasuni gati 5000 lirash, veç robave e xhevahireve të saja e veç ç'munt të trashëgonte nga një xhaxhaj i saj që e hiqte si bijën e vet e trashëgimtare.

E pashë që m'u vardis fort. Mori edhe fotografin t'ime që ja kisha dërguar më parë Marigosë nga Stambolli. Kaqe më ra në qafë sa për pak mënt i dhashë fjalën. Po e pashë se konsekuencat munt të ishin shumë të këqija për një grua të martuar, por edhe për mua akoma. Si të bënja as unë s'dinja. Më futi në një mendim të math dhe i kërkova një afat 24 orësh që të mendohem.

Po mbi këtë një tjetër taksirat po më ngjiste brenda në shtëpi të Marigosë. E mbesa e Janaqit Agllaja një çupë 20-22 vjetsh, esmere dhe jo shumë e bukur – kurse Katina ishte një hyll – Agllaija, po thom, kish nj'a dy dit ahere që po më tregonte shenja dashurije, të cilat s'gjenin asnjë vënt pranë meje se s'ndjenja as më të paktën sympathi për atë se s'më pëlqente. Kjo gocë kaqe m'u afrua sa që një nate kishte kuximin e më ardhi vetëm fillja me robën e natës në odën që flinja! U çudita fort për këtë paturpësi dhe formova idhenë që këtë maryfet munt t'ja kish bërë edhe tjetër kujt e më dha një përshtypje të keqe.

Si e pashë se insistente t'a mernja në robat u egërsova mjaft dhe më fort kur një çupë virgjineshë kuxonte në atë mënyrë edhe në një shtëpi ku unë isha mysafir dhe ku sillnja respektin më të madh që munt të bëhej sepse Marigonë e respektonja si nënë.

U shtërngova t'a bint se nuk bën mirë dhe, se si çupë që është duhet të jetë shum' e mbajtur në cirkonstanca të këtilla, gjer sa më së fundi hiku tuke qarë.

Po këjo s'qëndroj gjer këtu. Vuri shërbëtoren e Marigosë një gocë pikë 18 vjetshe që quhej Smarô, e cila pa një pa dy më lutet t'a mar grua Agllainë. Qesha mjaft me naivitetin e këtyre çupave dhe i thashë që do mendohem si të vete në Karvasarâ.

Po zojusha Agllai s'kish derman. I çfaqet më së fundi Marigosë edhe ajo m'a tha mua. I përgjigjem Marigosë se s'është e mundur se martesën s'e kisha shkuar ndër mënt akoma, se po të desha isha martuar në Piré me Marikën e mikut Ekonomi të motrën e mikut t'em Vangjel Ekonomi, të cilën m'a propozuan kaqe herë e me prikë të madhe, po s'e mora, se mendimi im ish që të mernja grua shqiptare e jo të huaj.

Marigoja, kur dëgjoj këto fjalë e mblodhi mëndjen e ja tha të gjitha Agllaisë, po kjo e çmëndur mori një koxha dozë sublimé[1] atë ditë e u helmua dhe me një mijë belarla mezi e shpëtuam.

M'u mbush mëndja të hiqinj e të largohem nga këto sirena se mos e psonja si i ndyeri Odhyseusi kur u poq me Kalypsonë e me Kirqin.

Vijmë prapë te Katina.

[1] sublimé = helm me bazë zhive (klorur merkuri H. K.)

Këjo s'më ndaheshe për të madhe punë. Sado që desha të rinja pranë Marigosë se jetë më e mirë s'kish se si bëhej, por këto evenimenta më shtërngonin të largohesha sa më parë.

Katina, si e mori vesh se po pregatitesha të shkonja, më thret një ditë në shtëpi e më thotë se është gati së gjithash të niset me mua. Aman, i thom, se s'e bënj dot këtë, s'është e mundur. Unë s'kam ardhur për kësi gjërash dhe s'munt të bëhem shkak mjerimi i një shtëpije të nderishme! Po Katina s'dëgjon nga këto. Më së fundi zë më shan se s'qënkam burrë, se s'paskam zembër, ajo një grua e martuar edhe po kuturisej edhe unë një djal' i pamartuar të jem kaqe i pakuxuarshim, turp! Ndofta ishte turp, po unë mendonja të fundit. Ishte gjë që s'bëheshe.

Funt i fundit ardhi dita që do të shkonja. Katina më lajmëroj që atë natë tinazi se do niseshe me mua. Sado që desha t'a ndalonj, s'ishte e mundur. Ajo me pretextin se do vinte në Stamboll të shihte një të emtën e saj, niset të nesërmet me mua, pa ditur gjë as burri i saj as njeri. Me vehte kish marrë gjith ç'kish xhevahire, të holla, aksione etj. Të mjerët burra me kësij grash, të mjerat shtëpi si batërdisen!

I shkreti i shoqi me do far' e fis tjetër e përcuall gjer në vapor gruan e pabesë. Asnjeri veç ne të dy e dinte mysterin. Mua më vinte sikur kisha një bela të madhe mbi kokë.

Mbassi u përqafuam me Marigo, Janaq , Jorgaq Agllaia etj. Dhe si ju lamë shëndet gjith'atyre miqve e miqeshave, me të cilët shkuam aqe mirë, u nismë nga limani i Ghemlekut për në Stamboll, midis brohorive e të përshëndetjeve me tundjet e shamive në erë.

Katina s'derdhi as një lot që u nda nga i shoqi! Ajo ish tepër e gëzuar se u bashkua me mua. Zumë një kabinë që të dy në vapor si me qenë burr' e grua. S'desh të dalë jashtë në kuvertë ; desh te rinte gjithë një mbi gjunjët e mija. Si të bënja? Më shkonin ç'turlish mendime. Nga do një herë thesha t'a mar, se ku munt të gjenja një grua si atë, që posa hipi në vapor edhe ashtu si ishte veshur për të rëmbyer kokën tërhoq gjithë syt' kapitaneve e pasaxhereve të vaporit. Shkreptinte bukuria e saj. Shumë herë prapë mendohesha se ajo ish grua e martuar me burrin gjall, si munt t'a bënja unë këtë "vraje Zot" për atë familje? Edhe në gjë tjetër. Përveç se mernja kështu një belâ kokës, po ku munt ta shpinja? Ç'do theshin bota për mua që u solla kaqe çnderisht dhe si do çkatërohesha me burrin e saj pa episodi të rezikshme dhe ekspozimeve që do më rëzonin ç'do nder? Po si kur të m'a bënte edhe mua më von atë që i bëri burrit saj?

Këto e shumë të tjera më shkonin ndër ment dhe s'kuxonja në krye t'i përgjigjem Katinës në gjestet e saja dashurore, po si pashë pastaj se do katandiste fare monoton ajy taksirat e se do ish një budalli e pashoqtë një sjellje aqe tartufe sa e tregova gjer ahere, e hodha jashta dhe ku të dalë le të dalë, faji s'ishte i imi, boll e defendova e i mbrova nderin. Volenti non fit injuria theshin Latinët d. m. th. se kur don vet' e zonja ç'faj ka tjetri?

Tani munt të mendonjë njeriu si shkuam me Katinën, e cila kujtonte se ishte në paradhis!

Në Stamboll e shpura në shtëpinë ku banonja. E hoqa si për kushërirë të parë dhe ashtu ja u rekomandova zonjës shtëpisë dhe çupave të cilat zunë një miqësi tepër të ngushtë me Katinën, e cila i shkonte në bukuri të gjitha.

Shkuam kështu një javë të tërë dhe njeri s'e dinte folenë t'onë; ishim aqe fort të lumur.

Po një ditë Katina se si bëri dhe ju çfaq çupës më të madhe të zonjës shtëpisë që quhej Dhespina e i thotë se mua më ka burrë e më ka marrë me dashuri, tuke i ikur të shoqt!.... Pas dy ditsh më merte më nj'anë e zonj' e shtëpisë edhe seriozisht më thosh këto fjalë : Zoti Floqi e dijni fort mirë sa ju kemi dashur edhe unë edhe çupat e mia. Zonja Katina s'qënka kushërira po gruaja juaj, dhe sidomos grua e martuar që iku e lâ burrin. Tani imazhinoni, z. juaj si munt të vejë kjo punë për mua që po ju mbanj në shtëpi dhe ç'daravere munt të kem një ditë me policinë, ose me Prokurorinë, në qoftë se vjen këtu burri i saj t'a kërkonjë. Prandaj ju lutem, me hidhërim të math, ja se t'a përcillni këtë zonjë, ja se të gjeni që të dy një vent tjetër.

Ja thashë Katinës këto, po ajo as u sëkëlldis fare! Menjë herë vuri kapellën dhe më mori edhe mua dhe mbassi e njihte Stambollin mirë, më çoj në lagjen "Tatavlla" banuar prej greksh të krishterë dhe atjé gjetmë një shtëpi me dy oda e ja shtruam paq.

Të lemë këtu vehten t'onë. I shoq i Katinës i shkreti se e pa se shkuan dy javë e s'po dinte ç'ju bë gruaja ngrihet e vjen vetë në Stamboll e po e kërkon nga të katër anët e ngreh më këmbë gjithë stacjonet policore të Stambollit.

Fati im, një ditë, në një kafene të vogël në "Tatavlla" ku kisha zakon të mernja nga ndo një kafe, dëgjoj par hazard[1], si thotë frëngu se paskan rëmbyer një zonjë nga Ghemleku që quhet Katina dhe burri ka ardhur në Stamboll e po e kërkon kudo dhe gjithë policët janë në këmbë e s'dijnë se ku.

Me të shpejt shkonj në shtëpi e ja kallxoj këto me ngutsi Katinës, e cila prapë s'u sëkëlldis. Po kur i thashë se rreziku m' i math është për mua, edhe se po të më zenë do vete të paktën 2 vjet në burg e shkatrohet krejt mendimi e qëllimi që kemi për një bashkim të përjetëshëm e se do ish më mirë që të mos ngjiste një skandall i këtillë, i cili do n'a expozonte keq që të dy e s'kishim një farë fitimi, ahere u bint, po si munt të ndahej nga mua tani, që s'i ndahej dot shpirti? Preferoj të vriste vehten, po edhe për këtë s'e lashë. Funt i fundit i dhashë fjalën se do t'a mar, mjafton të gjente një shkak divorci e të shkurorëzohej nga i shoqi e të ishte e lirë.

Kështu me një mijë të qara e me aqe më shumë të përqafuara me Katinën u ndamë më së fundi dhe ajo ja mbajti per ne tezja e saj. Unë nga tjetër pregatit shpejt plaçkat edhe pas 3 orësh u nisa me tren për Selenik tuke i dhënë munxët[2] e mallkime Stambollit të qelbur ku vojta aqe fort! Kështu shpëtova nga një rrezik i math që po më priste, se e dinja mirë se Katina nuk do tregonte kurrë se mbetmë bashkë ato dy javë, as që do merte vesh njeri.

Si vajta në Korçë, pas dy javësh mernja një letër nga Marigoja, ku midis të tjerave më thosh edhe aventurën e Katinës me të shoqin tuke mos ditur as ajo se cili e rëmbeu Katinën, ose cilin rëmbeu Katina.

I shkreti burri i saj nuk di si bëri e si u suall me të shoqen edhe më ja ndjeu apo jo fajin lavarashes së urgjisur[3]. Po duket se ja ndjeu se pas nj'a 8 muajsh më lajmonte një mrekulli Marigoja, se qysh, të shoqit të Katinës i fali Zoti një djalë si pullump, pas kaqe vjetsh martese dhe si i ishte gëzuar tepër plaku, i shoqi, që u bë me trashëgimtar. Merret vesh pra, se nuk e kisha lënë plakun, të shoqin, të pangushëlluar. Prej asaj aventure të paharuar pat sido kudo një fitim. Fitoj një koxha djalë që s'e mendonte kurrë.

Unë i urova që të dy si të shoqin, si Katinën për djalin që ja fali Zoti. M'u përgjegjnë që të dy. Veçanërisht Katina më dërgoj edhe fotografin' e bebes me këto epigrame : "Shëkoje kujt i ngjet. Është djali i jonë. Sa her' e shoh të kujtonj ty. Do Zoti e n'a bashkon një ditë".

"Katina"

V. O. Katina më daroviti 50 lira kur u ndamë, nga të cilat 40 ja dërgova me çek babait (Shënim i K. F.).

Edhe me të vërtetë, Katina e gjorë kish të drejtë. Djali ish i yni.

Të këtilla aventura më ngjanë shpesherë në jetën t'ime, në Athinë e Mesollonjë edhe një brenda në vapor.

Sa do që janë mjaft romantike t'i tregonjë njeriu që të gjitha në mënyrë konfesimi[4] sikurse të çkarkohet prej do fajeve, të cilat me të drejtë s'munt t'ja ngarkonj pasivës s'ime se s'ja pata ndonjë faj zojushesTheodhora Dhimitriu, e cila më ndoq gjer në Karvasarâ e q' andej në Athinë dhe më së fundi lindi edhe një çupë. "Lilikën" të cilën desh të ma ngarkonte mua ,

[1] par hazard = rastësisht (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

[2] munxë = shenjë që bëhet me pëllëmbë të hapur të dorës drejtuar dikujt për të a përçmuar (H. K.)

[3] lavarashe = njeri që të fut ndër kllapa, të vë litarin në fyt. Orgji = festë që bëhej në Greqinë e lashtë për nder të Dionisit, perëndisë së rrushit dhe të dëfrimit (H. K.)

[4] konfesim = rrëfim (H. K.)

si të vehës zonja Amalia Selivou në Mesollonjë e cila m'u vardis fort gjer sa i fala një djalë që natën e dorëzuan në Strehën Vorfnore me embrim Aleksandër, i cili më vonë u bë i bir' i deputetit Patrës Rufo-Kanakarit etj. etj. , sado, po them, që me këto munt të bëhet një romancë idyliake mjaft zbavitëse, do kufizohesha të tregonj ç'më ngjau brenda në vapor me një kontesë Ruse, e cila kish ndarë të shoqin e kish marrë për burrë një professor Arqeollogjije frënk, një plakosh 60 e ca vjetsh, kur ajo s'ishte as 35, e megjith'ato konservonte akoma bukurinë slave të veriut, e njohmë si një trëndafil, blonde e sy kalltërt, e gjattë e mjaft e dijshime.

Aso kohe kisha vitin e III si student Drejtësije. Kur po vinja në Athinë, brenda në vapor na ardhë prej Patre një çift pasaxherësh të huaj, veshur me roba udhëtimi, me petka turisti. Dukeshin se ishin arqeollogë, si burri, si gruaja. U njohmë në vapor e më fort kur u shtruam në tryezë të hamë darkën. E me qenë se në vapor s'dinte njeri tjetër frënçe, përveç mejet, unë fjalonja më ato të dy edhe ndër kohë po bënja edhe dragomanllëk[1] për ç'do nevojë.

Mora vesh se ishin arqeollogjë, se burri ish Frënk professor i Universitetit në Lyon e e shoqja ish ruse prej Petersburgut, kontesë etc. e martuar me atë professor e se po shetisnin Greqië për me pa antikat e saj në Athinë e njeti e se këtë radhë drejtoheshin në Korinthë e s'andejmi në Dhefos ku ish orakli i Apollonit.

Si u njohëm mirë e folmë pothuaj se gjer pas mezit të natës, e mbassi panë tek meje një njeri që munt t'ju ndihmonte në informatat e hollsinat që kërkonin (se edhe unë merresha mjaft me arqeollogji asokohet) m'u lut kontesa (embrin e kish Ollga Vladhimiroff) që në qoft' e mundur t'i shoqëroj gjer në tempullin e Apollonit në Dhelfos me harxhet e tyre, në mos më shkaktohej dëm në punët e mija.

Unë si e pashë që më lutesh aqe ëmbël ajo zonjë aq' e këndshme e fluturake dhe mbassi m'u vu për së teprit, u binda t'i shoqëronj gjer në Dhelfos e Termopyllë, ku kish luftuar Leonidha i famshëm me të 300 spartiatët e tij kundra Persëve edhe që andej do ktheheshim në Marathonë, në Platorias e në Athinë. M'u falë nderit fort dhe kështu nga mëngjezi harrimë në skelën Ifea, ku duallm, lamë bagazhet, mormë kuaj dhe u drejtuam në Dhelfos.

Të nesërmen shkuem për në Beoti e që andej vijmë në Marathonë dhe në Athinë, ku ramë në hotelin e math e splendit të Athinës "Hotel de la Grande Bretagne" ku muarmë 3 oda në dispozicjonin t'onë, njërën prej të cilave m'a dhanë mua.

Në gjithë këtë udhëtim u njojtmë mjaft mirë me kontesën Ollga. Kontesa më dashuroj aqe fort sa gati mënt më expozonte edhe në sy të të shoqt, i cili si një tjetër suaxagora nuk filozofonte gjer atje sa të vërente sjellje kompromëtante të së shoqes. Ajy ish njeri i butë dhe tepër stoik, kaqe sa shumë herë e shihte të shoqen që bënte me mua ca gjeste të dyshimta dhe s'i bënin as më të voglën përshtypje.

Unë si pash' ashtu e mendova se s'duhej t'a zgjatnja më tepër dhe kështu i përgjigjesdha kontesës ruse në ç'do sentiment të saj e dëshirë.

Si arthmë në Athinë dashuri e saj u shtua edhe më tepër, munt të them se mori një formë tragjike. Kontesa derthtë lotë dashurije për mua dhe dëshëronte mos i largohesha as një minutë. Harrim gjer atje, sa natën e vinte burrin e saj në gjumë e gati gdhihej me mua bashkë. Me mua shetitte kudo, un' e çonja në theatrot, në koncertat edhe i shoqi sa t'i hiqte ndo një vërejtje, përkundrazi kënaqej më tepër edhe disa herë m'u fal edhe nderin se shpëtonte nga një belâ të madhe që ta shëtitte andej këndej të shoqen, mbassi ish edhe plak e i pëlqente të rinte brenda të studionte si filozof që ish. Të lumit ato burra që merren me filozofi!

Ësht' e tepërt të themi se me kontesën rronim si burr' e grua pa të na bëhet havalé njeri dhe ësht' e tepërt të përmendim që sa isha me ata jo vetëm s'harxhova asnjë metelik prej xhepi, po akoma më jepte të holla pa masë Ollga për të prishur, pa i kërkuar vetë, dhe gjithë

[1] dragoman = përkthyes (H. K.)

më pyeste në kam nevojë për pare e më mbushte xhepin me dhrahmi: A munt të bëheshe jetë m'e mirë se këtë?

Si ndejmë kështu më shumë se një muaj, një ditë më thotë kontesa se dëshiron shumë të më marrë me vehte, të harxhojë për studimet e mija në Universitet të Lyonit, të më mbajë me të ngrën' e me të pir' e ç'do herë tjetër pranë saj edhe më së fundi të më ketë edhe amant (të dashur) në syt' e të shoqt, mbassi ajy, si e kuptova më vonë i kishte dhënë liri të plottë së shoqes të bënte si të deshtë. Me fjalë të tjera profesori s'ishte vetëm një stoik, po edhe një kozmopolit.

Unë, sado që më vinin për hesap ato fjalët e kontesës se s'kish më mirë për mua edhè aji ishte zengjine po mendonja pleqtë ku do t'i linja. Mendonja t'em atë që u therorizua për mua dhe më vinte shumë keq e kështu i thashë Ollgës se një gjë e tillë ish e pamundur për mua dhe i tregova dhe arsyet.

S'munt të tregonj dot momentet tragjike kur u ndamë me atë në vapour se i përcolla gjer në Pirè. Në sŷt e të shoqt m'u hoth kush e di sa herë për qafe e më puthte sa më vinte edhè turp prej të mjerit të shoqt , po ç'të bënja. Gruaja qënka stihì, qënka lubì, qënka monstruoze nga ndonjë herë! Turpin e hëngërka me bukë përpara dëshirës e zjarit që ndjen! Sa gjërra mson njeriu në këtë jetë!

S'ndaheshe dot nga mua. Shume herë më kthente nga rruga, nga të zbriturit në shkallë të vaporit, me gjithë që i linim shëndet njëri-jatrit, aqe sa ju tërhoqi verejtjen gjithë atyre që kishim rotull, të cilët kujtonin se mos më kish ndo një vëllà të dashur, se vetëm një vëlla munt të puthet në atë mënyrë, me gjithë që edhè dashuri vllaznore e kaloj ç'do masë. Të shoqt i justifikohej për këtë paturpësi në këtë mënyrë "Je sens pour cet enfant un amour plus que fraternel[1]" (?) edhe ajy fukaraj e besonte.

Në së fundi para se të ndahemi për gjithnjë, kthehet e i thotë të shoqt: "duhet t'ja shpagush maitre Floqit gjithë këto mundime e hasomeri që bëri për ne". Edhe ajy njeriu stoik, m'a pret : Ç' është zahmeti juaj, z. Flokis? – S'është fjalë ajo, i thom, z. Profesor. Po ajo shejtanja kontesa s'e le t'a zgjatë fjalën, po i kreu portofolin prej xhepit dhe qit e më jep dy banknota nga 1. 000 baras 2000 dhrahmi. S'desha t'ja pranoj, po Ollga m'i vuri në xhep me përdhuni dhe për mbi këtë nxori prej gravatës së saj një spillë të florinjtë me një brillant të bukur e m'a mbërtheu në kravatën t'ime për kujtim.

Kështu u ndame me kontesën Ollga, e cila për kush e di për sa kohë vazhdoj korespondencën me mua. E mbyll gjer këtu këtë kaptinë e cila duhej të mbaronte me një idyl mbassi filloj me një tragjedi, pjesa më e tmerishme e jetës s'ime që s'munt t'a haronj për sa të jem gjallë. Të 2000 dhrahmitë ja dërgova babajt në Karvasarâ.

## XI

Përpara se të ikinj nga Stambolli u mendova disa ditt se ku duhet të vete të zë shtek.

Shumë herë thashë të shkonj në Karvasarâ pranë shtëpisë s'ime, po prapë s'e gjenja të arsyeshme se prokopin' e Greqisë e pashë në motin e fundit, ku nuk munt të fitonja më shumë se 200 dhrahmi (7 napolona të sottmë) me gjithë diplomën që kisha, se avokatët ishin shtuar shumë ahere dhe nga ana tjetër punët ishin paksuar. Prandaj, mbassi këtë radhë e kisha msuar mjaft mirë turqishten, të cilën e shkruanja dhe e këndonja e e flisnja mirë, vendosa të kthehem prapë në Korçë. Kështu edhe bëra.

Kur ardha në Korçë më pritnë shumë mirë dhe disa miq e tregëtarë m'u premtuan se se do më përkrahin, mjafton të të hap një atjé një zyrë.

[1] ndjej për këtë fëmijë një dashuri më shumë se sa vëllazërore (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

Për ç'do eventualitet u shoqërova me një avokat diplome nga Stambolli, me z. Maliq Babani me të cilin fitimet i ndanim në mes. Ajy merte gjyqe përpara gjyqeve civile e administratore turke edhe unë përpara gjyqit fetar e mikst të Metropolisë Korçës dhe veçanërisht e ndihmonja shokun t'em në gjyqet turke si dhe në shkrimet.

Kështu vazhduam mot mot dhe fitimet ishin midis 10-12 lirave turke në muaj për secilin prej nesh.

Por unë, në këtë koh' e sipër vrejtja se pjesën më të madhe te fitimeve ja sillnja unë zyrës. Me një far' hesapi unë sillnja 15-20 lira turke në muaj e Maliq beu 7-10 lira në muaj, kështu që në funt të vitit u ndava nga ajy e hapa një zyrë më vehte. Mora për sekretar një farë Nexhipi, që e dinte turqishten mirë dhe kështu fillova të punonj, ku zura të fitonj 15-20 lira në muaj, një shumë mjaft e mirë për atë kohë.

Zura një shtëpi më vehte dhe e mobillova mirë dhe kisha qëllim t'i sjell edhe prindrit në Korçë, se do shkonin një jetë të mirë.

Në atë vit, që ishte viti 1902, mbassi panë Korçarët që zura një sërë të mirë, filluan të më vijnë mblesëri për dit. S'dua të përmënt këtu hollësina mbi këtë pikë, veç se mjaftohem të thom se prej 200 deri në 500 lira prikë mblesëritë ishin të mjafta, po nuk vendosnja gjer sa të vinja një sërë të mirë e gjer sa t'i sillnja prindët në Korçë.

Po xhaxhaj im Ligor Mitkua, tuke u marrë vesh me familjen e një farë Theodhori Kristodhulo prej Bukureshtit, më proponoj një çupën e tij Efrosinën për grua. Unë pa e njohur personalisht gocën, po vetëm tuke u bindur në rekomandimet e xhaxha Ligorit, të tetos s'ime së shoqes së Ligorit e të disa farefisit tjetër t'onit, se është një vajz' e mirë e msuar, e bukur e e pasur edhe në fotografin' e saj, e cila e tregonte si një virgjineshë elegante e të qytetëruar, i dhashë fjalën xhaxha Ligorit, po me konditë që të vinjë në Korçë çupë dhe në qoftë se s'më pëlqen ahere munt të isha i lirë t'a zgjithnja fejesën.

Kështu mbetmë d'akord dhe u fejova me Efrosinën dhe e ëma e saj më premtoj një prikë prej 500 lira turke, përveç roba të tjera etc. Që do kishte nusja dhe pjesës së saj prej trashëgimit pas vdekjes s'ëmës.

Sado që u deklarua zyrtarisht fejesa jonë, unë s'mora asnjë metelik nga prika për ç'do eventualitet, tuke e lënë t'a rregullojmë mbassi të vinjë nusja prej Bukureshtit, ku banonte me t' ëmën e të motrat.

Me gjithë që kontratën e fejesës kishim fjalën se dasma do bëheshe në Korçë dhe pas 2 muaj qysh se u bë akti i fejesës ime vjehrë, tuke lojtur prej fjale filloj më përpara të më lutet, pastaj edhe të më shtërngonjë të vete në Bukuresht të martohemi, ku do hynja edhe dhëndër brenda, se këjo ishte çupa më e vogël e saj, kurse çupat e tjera i kishte të martuara dhe kjo rinte vetëm me Efrosinën.

Ky propozim jashtë konditave që kishin paktuar, naturisht më zembroj dhe kështu u shtërngova t'i shkruanj s'ime vjehre se në qoftë se s'vinte me të bijën në Korçë brenda një muaji kisha me zgjidhë fejesën nga ana ime e me ju kthye nishanin.

Kështu më përgjigjen se po vijnë brenda një muaji dhe unë lajmova prindët në Karvasarâ, të cilët nisen e vijnë në Korçë, im 'atë, im 'më, teto Ndinua dhe im vëlla Thanasi e i prita mirë në shtëpinë që kisha zënë me qira, e cila kish 7 oda të mira, veç kuzinës si dhe kopsht të bukur e të math dhe ish mobilluar edhe mirë, se çashtja e dasmës më bëri të harxhonj gati gjithë ekonomitë që kisha në të holla, kisha marrë edhe hua.

Babaj posa ardhi, pa ditur mirë ç'kish ngjarë e me ç'kondita isha fejuar më kërkonj t'i kallxonj kur i kam 500 lirat e prikës, e kur i thashë se u fejova e si s'mora asgjë, i arth shumë keq. E keqja më e madhe ishte se edh' ajy kishte ardhur gati pa të holla dhe puna në Karvasarâ nuk i vinte mirë. Nga ana tjetër unë kisha vënë edhe ndo 100 lira borç andej këtej e duheshin paguar. E pash' edhe vetë se bëra një gabim të math, po ç'u bë u bë, fundi për hair! Po im' atë kishtë shumë durim dhe i jepte kurajo vehtes si dhe mua: E pa se u ngutmë, se duhet të kishim marrë në dorë gjysmën e prikës pa të niseshim për mobile shtëpijet e për

peshqeshe e dasmë. – Po ç'munt të bënim?  Durim. S'munt edhe t'i qanim hallin njeriut: Me azallah, dhe ruajna zot po të hapnim edhe gojën, do bëheshim krejt qepaze se diç'ka n'a dinin dhe do turpëroheshim. I vura gurin zembrës, edhe unë edhe im'atë e s'folmë gjë. S'ju treguam as gravet. Fajin e kishte xhaxha Ligori, i cili, zoti e ndjeftë, për 20-30 lira që mori rushfet nga ime vjehrë s'më kallxonj të vërtetën që të dijnim si të silleshim, se ashtu as do t'isha fejuar, as harxhe të mbëdha e peshqeshe do kisha bërë, as në borxhe nuk do t' isha mbytur, as t'ëm atë nuk e sillnja në Korçë

Far' e fisi e miqtë s'dijnin gjë. Ata hynin e delnin në shtëpi t'onë me dit e me natë dhe s'kish natë të mos kishim mysafirë e harxhe sa të thuesh.

Gratë, im' ë e teto Ndinua ishin gjithë gëzim, se po prisnin dasmën t'ime dhe shumë herë i mbanin me të pahirë për drekë e për darkë sojin t'onë, se ky ishte gëzimi i parë, si thojshin, i shtëpisë s'onë. Vetëm ne të dy me t'ëm atë vrisnim mëndjen e po mendoheshim si do n'a vejë filli.

Un' e ngushëllonja t'em 'atë se ato dit do vinte vjehra me nusen nga Rumania dhe do mernim të 500 lirat e prikës e kështu dal nga dalë do t'i vinim në vënt të gjitha e do mos n'a merte dot vesh njeri.

Dy javë më von marim telegraf nga ime vjehrë se u nisnë prej Bukureshtit dhe pas 3 ditsh muarm edhe tjetër telegraf nga Manastiri që u nisnë për Korçë.

S'di sepse nuk ndjeva as një gëzim as kur u nisnë nga Bukureshti, as kur iknë nga Manastiri. Thesha ahere se ndofta nga hidhërimet që ndjenim me babanë për borxhet që kishim vënë edhe për sërën që i prisha t'im 'eti që e solla familisht ne Korçë, ndofta nga këto s'ndjenja një farë gëzimi se po më vinte nusja. Po duket se telepathia ime shihte për së largu dhe jehimi i saj tingëllonte në shpirtin t'im

Më së fundi, ditën e caktuar që do të vijnin në Korçë, im' atë me gratë t'ona e t'em vëlla, xhaxha Ligori me fëmijën e tij edhe disa të tjerë prej fisit t'onë ju duall përpara me nj'a 5-6 karoca.

Disa herë më thanë gratë që duhet të dal edhe unë përpara nuses, po im 'atë, mbassi e dinte shkakun më mirë, ju tha grave se s'bën të dalë edhe dhëndri përpara e kështu unë mbeta në shtëpi, porse në atë kohë që kujtonja se munt të hynin në Korçë dolla me disa miq në kafenenë e Plakocit jashtë Korçe që t'i munt t'i shoh kur do vinin dhe të mar impresjonin e parë për atë që do t'a kisha shok të jetës.

Kur po vinin karocat unë me miqt' e mij po rijnim afër një trapeze dhe sado që karocat ecnin revan, im 'atë më pa për së largu dhe më thiri të afrohem në rugë: U afrova. Në karocën që ish im' atë ishte edhe vjehra ime dhe Ligori me të shoqen. Në karocën e dytë ishte im 'ë, Ndinua, im vëlla dhe nusja Efrosina. Im' atë në thotë në nj'anë se duhet të salutonj nusen, mbassi munt t'i mbetet hatri se kisha qen' aty e s'i fola: Edhe unë afrohem në karocën e nuses e e përshëndosh që "mirë se ardhi". Ajo s'më njohu me të parën, po kur i tha teto Ndinua që pa shëko nuse se ç'burrë të japim ahere Efrosina shtiri syt' e më vërejti mirë e nënëqeshi, dhe desh të më rokte për qafe po i ardhi turp prej kallaballëkut të math që ishte rrotull. Un' i lashë e shkuan dhe mbassi përshëndosha për së dyti vjehrën, e cila, si e pashë, ish tepër e enthusiasur me mua u ktheva prapë ku isha e ndenja me shokët.

Tani po përshkruanj pak nusen. Prej fytyre m'u pa se ishte mjaft çehre'vrarë, mjaft e zbetë dhe aspak e bukur. Një surat vogël me një hundë si qiqër, trupin e duart tepër delikate dhe as një tjetër shije nuk i pashë përsipër. Mbi ato vura re se duhet t'ishte nj'a 27-28 vjet, do me thënë më e madhe se mua, ndonse m'a kishin rekomanduar për 18-19 vjetsh! Kështu e pson ajy që ble "derë në thes".

Që atë ças m'u pre fjala e muhabeti dhe sado që i gostita 2-3 herë shokët e mij atje, vetë s'vura gjë në gojë. Ju kërkova ndjesë miqve dhe vajta në shtëpi, ku atëhere kthehesin në shtëpi edhe prindërit e mij .

Me një herë më pyetnë gratë si m'u pa nusja. Iu thom e "mirkë", po juve si ju pa? Hidhet teto Ndinua e më thotë : E kemi nusen si një hanko, si kadanë, veç të n'a rroni e të na trashëgohi që të dy**.**

Im' atë s'foli gjë, po nga syt' e s'im'ëje pashë se disa lott po i derdheshin faqeve. E pyeta menjë herë ç'ka, se ato lott s'më dukeshin lotte gëzimi. Ajo e shkreta m'u hoth për qafe e po më shtërngonte e qante! E kuptova menjë herë zembrën e e madre dolorosës! E mar më nj'anë e i kërkoj shpjegime. Ardhi me ne edhe im' atë. Ahere hap gojën e gjora im' ë e më pyet edhe një herë në më pëlqeu nusja. I thashë : A do të drejtën? Mua s'më pëlqeu aspak, dhe jo vetëm s'më pëlqeu, po m'u pa edhe si e sëmurë. Ahere u panë sy ndër sy im 'ë me t'em atë. Si, nga e njohe? më thotë babaj. Po, po e njoha, thom se duhet të jet' e sëmurë, po tani do t'a marim vesh. Po si do të jetë mua s'më pëlqeu, ju thom prindërve, edhe nbassi jam fejuar me kusht që po të më pëlqenjë t'a marr, prandaj unë po ju thom se nuk më pëlqeu aspak dhe gjejeni ju tashti mënyrën si lipset t'a prishim vlimin.

Ndërkohë ardhi edhe teto Ndinua në odën ku bisedonim ne edhe kur mori vesh se ç'theshnim, n'a u turr me një herë se këto janë turpe, janë maskarallëke, do bëhemi qepaze në gjithë Korçën" etj. etj. dhe përfundoj se duhet t'a mar se .... . atë kësmet pata!

T'a vuri përpara im'atë dhe gati ment e shau të motrën. Si, i thotë, djalit s'i pëlqen e ti kërkon t'ja japësh me pahir? Ajy e mer për vehte, pra, kur s'e do i zoti ti ç'ke? Këto i foli teto Ndinos im'atë edhe ajo më s'insistoj më po zun'e qanin si ajo si im'ë.

Si shkoj ndo një orë n'a vjen xhaxha Ligori me të shoqen plot gëzim e n'a thotë të pregatitemi se pas dreke do vinin të dy ata të n'a merrnin e të shkonim te nusja t'ju theshim "mirë se arthtë".

Im'atë s'foli gjë, po as Ligori s'kuptoj gjë se ç'ngjiste midis nesh, me gjithë që n'a gjetnë në ato fjalë e sipër. Kështu shkoj Ligori me të shoqen dhe ne u shtruam të hanim bukë, sado që as një prej nesh s'vuri as një kafshatë në gojë. Ajo natë ish natë zije për ne e jo gëzimi!

Ora më 9 alla franga të natës, n'a vjen xhaxha Ligori me të shoqen dhe n'a thonë të shkojmë tok te vjehra. T'im 'eti s'i bënin aspak këmbët. Mua ca më tepër, dhe që të mos n'a marrë vesh njeri shtërnguam zembrat se cili prej nesh edhe shkuam ashtu të shtatë tok si ishim bashkë më vëllanë t'em Thanasin, që ish ahere 17 vjetsh.

Te vjehra ishin grumbulluar një kallaballëk i math krushqish që po n'a prisnin. Kur vamë duall të gjithë te dera e avullisë e n'a pritnë e u futëm brenda e ndejmë të gjithë me radhë.

Im'atë zuri muhabet me t'ime vjehrë dhe gratë me krushkat e tjera. Mua më thanë se jam i lirë të shkonj në bashtë ku ishte nusja Efrosina me t'em vëlla dhe disa çupa të tjera, të kushërijvet të saj. Më parë kishte ardhur Efrosina e n'a tha "mirë s' arthtë" dhe ndejti ndo një gjysmë ore afër mejet, por as unë që i hapa fjalë, as ajo që munt të më thoshtë gjë, veç se me vëzhgellonte mirë që në majë të kokës e gjer në këmbët, si dhe unë e verejta mjaft mirë dhe me ndihmën e dritrave e njoha bukur se sbetësija e saj s'ishte prej lodhjes nga rruga, po nga ndonjë sëmundje sekrete që do kish, prej së cilës dukej se vuante. Mbi ato dallova edhe më mirë moshën e tiparet e saja si edhe shëmtin' e saj më gjithë që ishte veshur si një kokotë.

Sado që të gjithë m'a dhanë lejen të shkojmë në bahçe e të flasim lirisht me të fejumen t'eme, unë prapë se prapë ndenja në dhomën ku ishim gjithë bashkë. Nuk di pse s'ndjenja as më të voglin gëzim e s'më bënte zembra të shkonja.

Te e mbramja ardhi im vëlla me nj'a dy çupa të tjera e më muar me zor në bahçe. Zura vënt pranë Efrosinës. Mjerisht unë që isha aqe hymorist, aqe shakaxhi, s'muntnja atë natë as të hap gojën.

Pushimin e preu më në funt vetë e vlumja. Më pyet për disa gjërra për në Korçë, për mbi theatrot etj, etj. Ku i përgjigjesha me fjalë të thata e e pashë se s'i bëra përshtypje të mirë. Më heq më nj'anë e më pyet shkakun pse ri ashtu edhe si ishim vetëm më përqafoj e më shtërngoj

në krahrat e saj, ndonse unë ndenja prapë i ftohtë. U justifikova se kjo vinte mbasse prej një gëzimi të tepërt që ndjenja ditën e parë që u poqa me atë edhe ndofta dita më ditën si të njiheshim edhe më mirë do zhvillohej edhe dashuria jonë më mirë. Edhe e besoj edhe jo, prandaj mjaftoj në nënëqeshje.

Nga mez' i natës shkuam në shtëpi edhe s'kemi fjetur gjithë natën, po jemi gdhirë së biseduari. Më së fundi përfunduam t'a prishim atë fejesë dhe t'u kthejmë nishanin. Këtë e mbajtmë nj'a dy ditt sekrete në mes t'onë, po ditën e tretë ja çfaqmë edhe daj'Ligorit.

Ligori kur e dëgjoj këtë u hoth përpjetë dhe zu t'i hiqte verejtjen t'im eti se këto janë turpe e s'n'a sjellin asnjë nder. Po ahere e vura unë përpara dhe e qojta fajtor se më futi verbërisht në këtë valle e i thashë se edhe unë bëra faj të math që rashë brenda me këmb' e me duar, po ç'u bë u bë, ajo s'më pëlqen, i thashë dhe nuk e mar, prandaj ajy që mori inisjativën e kësaj punë, ajy duhet t'i japë funt tani.

Më kot u grì me mua Ligori, më kot shkëmbyen disa fjalë të hidhura me t'em atë edhe më kot thiri edhe gratë t'ju blerë mëndjen. Ne të gjithë insistonim në thezën t'onë. Gjëmonin muret nga bërtitjet e të thirurat e Ligorit, i cili kish të drejtë fukaraj se kish marë 20 lira turke kapar që më shiti kësodoret, ndonse më kish nip, edhe i cili po të bëhej dasma do merte edhe kusurin 30 lira akoma, prandaj ajy me të drejtë çireshe aqe fort, se humbiste gjithë ato të holla¸pa s'kish gjë se më bënte mua të mjerë.

Po Ligori s'e merte përsipër këtë. Bëni, n'a tha, si të doni dhe iku e n'a la! Edhe ne s'folmë gjë, po Ligori tuke ja tregue njerit e tjetrit, çështja mori dhenë. Ditën tjetër e dinte gjithë Korça.

Vjehra m'at'anë e dëgjoj fort bukur po s'deshte t'a besonte. Prandaj dërgoj disa herë e thiri t'ëm atë, po ajy, që të mos ndodhej në Korçë shkoj në Dardhë, qinse kishte punë. Më thiri edhe mua, as unë s'i vajta. Kërkoj shpjegime dhe unë i dërgova fjalë qinse babaj ishte zembruar për punën e prikës, sepse natën që ardhë, vjehra i kish thënë babajt që prikën, 500 lira do të na jepnin pas dasme, një herë tjetër se do t'a vinin në Bankë mbi embrin e së bijës e ku di unë se ç'farë akoma. Këtë i vura s'ime vjehrë për shkak edhe e justifikova mirë që mos t'ju mbetej asnjë dyshim se nuk e desha Efrosinën.

Ime vjehrë si e pa ashtu kujtoj se mos ishte ashtu puna si pretendonja unë, prandaj vuri 2-3 herë t'vluemen t'ime të më shkruanjë se të 500 lirat i ka vetë ajo dhe të shkonj në shtëpi të tyre të m'i numurojnë dhe munt t'i bënja ç'të desha.

Tani e pashë se më zunë ngushta dhe duhej t' ndanja njërën dysh. Pra më shtërngonin t'ju çfaqnja të drejtën e kështu një her' e mirë të çkëputeshim.

Për fat t'im, edhe si ardhi edhe im'atë nga Dardha, n'a vjen një dit në shtëpi një kushëriri im Dr. Bilbili, i cili njihte mirë të fejuemen t'ime që në Bukuresht. Ajy ardhi postafat atë ditë të më çfaqë një sent tepër urgjent e të nevojshëime. Më mori pra, më nj'anë e më flet me një mënyrë serioze, a e di unë se ç'mar për grua, apo jo? – Pse, i thom. - Si t'emin, thotë, që të kam, duhet të të çfaq një të drejtë për të mirën t'ënde, por ti në daç më dëgjo, në daç jo. Fol' i thom, dhe kurreshtimi po smadhohej sa po zgjatej fjala. – Dëgjo, kushëri, më thotë! Unë të dua të mirën. Ajo që do març ti për grua është e sëmurë, është, ç'të të thom, tuberkulloze! Tuberkulloze? i thom, more folë mirë, doktor! – Atë që të thom unë thotë. Jam thirur dy herë në Bukuresht prej saj, si mjek i shtëpisë që kam qenë dhe të dy herët e gjeta që kishte bërë aimoptysi!.... Prandaj, pasoj Dr. Bilbili, ajo që s'bën për ty dhe çuditem si e marton ajo teveqelja e ëm' e saj, po më tepër çuditem me ty, më thotë, si e vendose këtë punë kështu pa e parë vetë me sy? – Pyeta i thom, sa munda po njeri s'ma kallxoj të vërtetën: Ja ku të thom, thotë doktori, të gjith' e dijnë këtë veç juve dhe në qoftë se e mer, ahere në mos vdektë në kuror' e sipër prej qirinjve e prej asfyksije, pa fjalë pas një muaj a dy si të martohi do të vdesë! Pra mendohu tani.

Ahere hapa gojën e ja sërëndita të gjitha kushëririt t'im mjek, i cili më shtërngoj dorën e më tha që është gati vetë të lajmojë t'ime vjehrë se për këtë shkak s'munt t'a mar të bijën. Ja

dhashë lejen me pash doktorit e shkoj e ja tha s'ime vjehre të gjitha, tuke i kthyer edhe nishanin.

Ahere, oh ahere, poter' e madhe u bë në shtëpin të s'ime vjehrë. Efrosinës i ra të fikët nga sikleti dhe bëri një aimoptysi[1] të madhe sa mënt vdiq. Për të mos u expozuar më tepër, ime vjehrë me Efrosinën shkojnë në katundin Boboshticë të Korçës, tuke përhapur fjalën qinse ato e çartnë fejesën se gjoja.... . unë qënkam martuar në Athinë edhe paskam edhe grua, e cila po vinte në Korçë.

Sado që ne vetë ja kthyem nishanin edhe këtë e mori vesh gjithë Korça, edhe sado që s'kish më të madhe gënjeshtër se këtë që përhapi ime vjehrë me krushkat e tjera mbi kurrizin t'em, prapë se prapë një fjal' e këtillë n'a jepte dorë nevej edhe tani isha i bindur se këjo fejesë u prish dhe unë u çkarkova nga një bela.

Të dëgjuar këtë lajm, të prishjes d. m. th. të fejesës e të të kthyerit të nishanit, plakosnë gjithë far'e fisi jonë e n'a u mbush shtëpia me njerës, të cilët ahere po n'a çfaqeshin se e dijnin se e fejuara ime ishte e sëmurë dhe çuditeshin si do t'a mernja. Edhe me gjith' atë s'u ndoth një sidomos të më tregonte të drejtën! Kësij soji të kesh pastaj të thuash që kam far'e fis e gjak.

Me të vërtetë atë natë ja kemi shtruar me t'em atë me një gëzim të math sikur diç fituam. Më vinte edhe mua edhe atij se u çkarkuam nga një bar' e rëndë e e paduruarshme.

Nuk shkuan 5 ditt dhe ime vjehr u kthye në Korçë bashkë me të bijën. Efrosina si dëgjova, ish mjaft e sëmurë edhe mezi e suall.

Të nesërmen dy maskarenj prej atyre krushqëve që s'lanë gjë pa thënë kundra meje, më vijnin nga ana e Efrosinës tuke më lutur të vinja shpejt te Efrosina se ishte në orë të vdekjes dhe dëshëronte di ç'ka të më theshte veçanërisht.

Unë s'ju zura besë atyre arakatëve dhe ju fola mjaft rëndë për ç'kishin folur për mua. Po ata më luteshin se është nevoja të vete shpejt t'a harrinja me shpirt.

Nuk i besova aspak, se s'kujtonja se ish e sëmurë Efrosina gjer në gradën e fundit. Mendonja se, pas këtyre qepazellëkeve që u bënë, mos më punonin ndo një pabesi, për të cilën munt të pendohesha për gjithë jetën. E kështu as që u tunda nga vëndi edhe krushqëve rezile ju thashë se s'vinj e i përcolla.

Nuk shkuan dy orë e më vjen në zyrë një dhëndri i jonë, i cili më thotë se Efrosina vdiq!

Me të vërtetë si njeri më ardhi keq, po nga ana tjetër e pashë që ndërmjetsoj Perëndia e machinës (Deus ex machina) dhe kështu mori funt ajo tragjedi, që e shkaktoj për ca të holla vet'ajy ungji im Ligor Mitkua.

Të nesërmen u bë edhe varrimi i saj solemn, në të cilën, ndonse u thirmë nuk vamë**.**

Si mori funt kjo tragjedi mluathmë mëndjen. Im'atë desh të shkonte në Karvasarâ po mjerisht s'kish të holla. Bëra një hesap dhe pashë se kisha andej këtej 180 lira turke borç. U mendova të shesh mobilet e të shkonim gjithë në Karvasarâ, po e pashë se s'ish e mundur, se as që i paguanja dot borxhet me shitjen e mobilave. Rashë në një hall të math. Më vinte të vras vehten. Si i bëheshe këtij halli? Far'e fisi vijnin e shkonin dhe harxhe kishim shumë dhe njeri s'na qante hallin.

U mendova andej, u mendova këtej. Më në fund shkova e u hojta 30 lira turke e ja dhashë t'im ati e u nis vetë për Karvasarâ. Unë mbajta gratë në Korçë dhe t'em vëlla dhe që të mos e kisha bela e mbassi kishte mbaruar gjymnazin e emnova msues në Dardhë me 20 lira turke në mot. Vetë ju shtrova punës dhe fillova të bënj ekonomi të madhe që të munt të delnja mb'anë. Po halli i borxheve si bëhej? Këjo më prishtë mentsh.

E përcolla t'em atë në Karvasarâ me një mallnjim të math e i kërkova ndjesë se faji ish i imi që i solla në Korçë e e harxhova kaqe fort edhe tani u bëmë dy shtëpi e harxhet n'a hipnë mjaft. Po babaj jo vetëm s'desh të më lëndonjë zembrën, po përkundrazi më dha një kurajo të

[1] hemoptizi = eliminim gjaku të pastër me kollë në sëmundjen e tuberkulozit, kancerit të mushkërive etj (H. K.)

madhe e më tha që të shtërngonj zembrën e të kem mëndjen për shtëpinë, për të cilën edh' ajy do më ndihmonte që andej. Edhe kur i dorëzova të 30 lirat ajy s'desh t'i marrë, po vetëm mbajti 5 lira, por se unë, tuke ditur hallet që kisha i dhashë 20 lira edhe vetë mbajta 10. Kisha tani borç afro 220 lira turke.

Shumë u sëkëlldisa atë dit që përcolla t'em atë, se e kisha një ngushëllim të math. Po ishte nevoja të shkonte im' atë, i cili diç'ka do më ndihmonte. Kështu i vura krahët shtëpisë dhe ju përvesha punës me gjithë vullnetin e mundur. Edhe që të jem edhe më i lirë në punën t'ime u ndava edhe nga shoku që kisha edhe hapa një zyrë të veçantë në mes të tregut Korçës, ku mora për sekretar një djalë, një farë Thrasyvullo Naçi, i cili shkruante turqishten shumë mirë me gjithë që edhe vetë e shkruanja e e flisnja mirë.

Desh Zoti të mos turpërohem. Pas 2 ditsh, si iku im'atë, më vjen një dava e mirë për një divorcë të një vakëflliu, Gjini Stratobërdha, i cili kish ardhur nergut prej Amerike që të ndanjë gruan e tija, dhe si duket kishte dollarë me bisht.

I ndyeri Spiro Kosturi m'a pruri në zyrë dhe sa do që si shpërblim ose rogë avukatije munt t'i kërkonja gjer në 20 të shumën lira turke, prej të cilave 10 në dorë edhe 10 kur të merte funt gjyqi, i ndyeri Spiro Kosturi, tuke i pasur në dorë 2. 000 e ca lira inglize që i kish lënë si depozito Gjini në duart e tija, para se të hap gojën për pagesë, mori fjalën vetë e i tha Gjinit që duhet të më paguaj 100 lira inglize, edhe Gjini e pranoj. Do me thënë Spiro Kosturi në këtë rast më shpëtoj. Ndjesë pastë i mjeri atje ku ka rënë!.... Spirua më nj'a' i mori fjalën Gjinit, më tjetrën anë pas një ore më sillte në zyrë 100 plot lira inglize, që as ëndër s'i kisha parë, as i kisha marrë ndo një herë si avokat. Ishin këto 125 napolona! Ju fala tepër nderit Spiros dhe që atë ças shkova e lava 100 lira borxhe, ku ish nevoja m'e madhe, që edhe kreditorët e mij u çuditnë ku i gjeta. Kështu u çlirova mjaft e mora frymë.

Për këtë gjyq shkova në Mitropoli të Kosturit 4-5 herë me shpenzimet e Gjinit dhe te e mbramja ja fitova davanë dhe e ndau të shoqen. Prandaj Gjini u kënaq tepër e nxori e më dha edhe 10 lira turke akoma, që, kënaqsi më e madhe s'ka si bëhet. Më lau kaqe halle.!

Për fat prapë të mirë, pa mbushur muaji qysh se shkoj im'atë, përveç 110 lirave të Gjinit mora edhe 4 dava të tjera të reja, dy në gjyqin civil, një në gjyqin penal edhe një për divorcë në Mitropoli, prej të cilave mora një kapar prej 60 e ca lirave. Kështu me të shpejtë e mora vehten edhe gjith' ajy hidhërim n'a u kthye në gëzim! I harrova të gjitha hallet dhe i shkruanja me shum' enthusiasmë t'im'ati, prej të cilit s'desha të dërgonte as gjë në shtëpi.

Atë mot që kujtonja se do ish më i hidhuri nga gjithë motet që kalova në jetën t'ime, e shkuam përkundrazi me lumëri e në enthusiasmë. Puna më vinte mirë, brenda 5 muajve i lava gjith'ato borxhe që kisha dhe e shtrova mëndjen. Më vonë filluan prapë mblesëritë, po si e psova një herë s'desha as të dëgjonja gjë për fejesë edhe në shtëpi ju kisha thënë të mos pranojnë as një mbleskë.

Pas një mot-moti, me qenë se babaj i gjori filloj të mplaket dhe kish nevojë për njeri, nikoqiren e shtëpisë, më shkroj t'i dërgoj një prej grave në Karvasarâ, t'em 'ë, ose Ndinon. Naturisht vendosmë t'i dërgoj t'em 'ë dhe kështu një dit e mora t'em 'ë dhe u nismë nga an' e Manastirit, të Selanikut e të Athinës dhe ja dorëzova në Karvasarâ. Këtë e bëra më fort që të haptë sytë edhe ime 'ë e të shëkonte disa qytete të bukura e më fort Athinën, ku e mbajta kaqe dit e e shetita mirë, tuke i rëfyer gjërat më të çuditshime që ka ajy qytet.

Si ndejmë bashkë me prindët ndo një javë në Karvasarâ, unë vetë u ktheva në Korçë, e mbassi dërgova dhe t'ëm vëlla në Universitet në Athinë, ne me teto Ndinon zumë një shtëpi më të vogël dhe mbetmë të dy.

Më 1904 Qeveria turke më proponoj kryesin' e gjyqit penal të Dibrës së madhe. Sado që roga ishte 16 lira turke edhe unë si avokat në Korçë nxirnja më tepër se aqe, tuke qenë se m'u vu shumë konsulli i ahershëm i Austro-hungarisë në Manastr August Krali, të cilin e kisha shumë mik, edhe mbassi ishte edhe për shkak kombësije, se shqiptarët nacionalistë me ndihmën e Austriakëve mbaronin shumë punë e i shërbenin mjaft Atdheut, u shtërngova e

shkova në Manastir edhe e pranova atë vent, tuke shkuar në Dibrë, ku nuk ndenja as dy muaj, se valiu i Manastirit me hafijet e tij më survejonte mbi vepërimet e mshehta e marëveshjet që kishim me disa kapo të Dibrës e të Kossovës, dhe nuk vonoj të më transferonjë ne Serfixhe! Po unë u ktheva prapë në Manastir e i thashë konsullit t' Austrisë Kralit se në Serfixhe s'mundesha të shkonja e kështu dhashë dorëheqjen, e cila në krye s'm'u pranua. Valiu i Manastirit, shum' i zembruar më thiri përpara tij e më kërkoj shpjegime pse s'dua të vete në Serfixhe. I thashë se shkaku është vetëm ekonomik, se si avokat në Korçë zinja 20-25 lira në muaj e isha në vent t'im e tani Dovleti më jep vetëm 16 lira në muaj, prej të cilave s'më tepron gjë të dërgonj në shtëpi. Valiu ahere më tha të shkonj në Serfixhe me 20 lira në muaj, d. m. th. me 4 lira shtesë, mbassi jam një nga më të mirët nëpunës të Adilijas.

Kështu, të mos i prishnja qefin Valiut, me të cilin duhej t'a kisha mirë shkova në Serfixhe. Po atje u sëmura rëndë e u shtërngova të kthehem në Korçë, tuke dhënë dorëheqjen, e cila m'u pranua.

Ardha në Korçë dhe e rihapa zyrën avokatore dhe zura të vinja mirë. Shkonim një jetë të qetë e të lumur si në shtëpi si me shokë e me miq.

Sado që kisha vendosur të mos martohem, nuk di se si një dit, kur shkonja me disa shokë nga shtëpia e Kostë Poçkës, afër Mitropolisë, pashë te dera e tij 2-3 çupa, të cilat, simbas zakonit Shqiptar të asaj kohe, posa n'a panë ne burat, u futnë brenda. Mua prej të trijave më tërhoqi vërejtjen njëra, e cila m'u pa tepër e bukur e e hijëshme, e bardh'e e kuqe si një trëndafil. S'e kisha parë ndo një herë në Korçë me gjithë që kaqe vjet isha atje!

E kuptova se do ish nga të bijat e Kostë Poçkës, që të bir' e tij Dhimitri Poçin dikur e pata msues në gjymnas të Korçës. Un' e dinja se Kostë Poçka kish vetëm një çupë të martuar në Vlorë, po jo se kish edhe çupa të tjera. Prandaj nuk përtova të pyes shokët që shetitnim bashkë, cilat ishin ato tri çupa që n'a panë e u fshehnë prapa derës së Kostë Poçkës. Më thotë njëri prej atyre, Jani Dardha, se njera prej atyre, ajo me faqet e kuqe ishte e bija e Kostë Poçkës e dy të tjerat ishin dy kushërirat e saj.

Atë natë s'folmë tjetër gjë me shokët mbi atë gocë. Po mua më mbet merak dhe desha t'a shëkonja prapë, se më kish hyrë në sy, më kish pëlqyer, që s'dinja se munt t'a shihnja, dhe sa do që punë pa punë shkova shumë herë nga shtëpi' e saj s'e pashë dot as një herë.

Një dit ishte dita e Shën-Anastasit. Tuke shkuar për të uruar takonj me ish profesorin t'em Petro Harisin, i cili më thotë të vemë të urojmë më ca Tasër që kishin embrin atë dit. S'ja prisha qefin e e lashë të më shpinte ku të desh ajy. Kështu vemë edhe në shtëpi të Tasit Ilos për të uruar Tashkon e Ilos. Futemi brenda dhe o! mrekulli n'a presin dy çupa, njëra e bij' e Pandeli Zografit Antigoni dhe tjetra ishte çupa faqe-kuqe e Kosatë Poçkos, ajo që kërkonja në Qielli kaqe kohë e e gjeta pa pandehur në shtëpi të Tasit Ilos, dhe e cila quhej Uranija.

Zonjusha Antigoni n'a priti mirë e n'a dha dorën të dyve me Petron, po zojusha tjetër Uranija u turpërua tepër dhe n'a shqau prej duarsh e iku. Un' e pyeta Antigonin, cila ish ajo zojushe që s'na bëri kabull e u suall aqe e egër ndaj nevej, e më thotë se ësht' e bij' e Kostë Poçkës dhe quhet Urania, por se shkoj është shum' e turpshime.

Ndejmë më shumë se një or' atje se ishte edhe koh' e drekës e s'vinte ndo një vizitor tjetër, e kështu u kënaqmë me muhabetin e Antigonit e të s'ëmës Tashkos, Alexandrës, po mjerisht, sa do që ju lutmë zonjës Sandës Ilos të thriste edhe zonjushen Urani të n'a shoqëronte në muhabet, edhe sa do që ajo e ngrata e ftoj kaqe herë, zojusha Urani s'n'a begenisi. Kështu shkuam me z. Harisi, po unë tuke pasur për bri shtëpin' e një tezes s'ime, Ciles së Nisit Tomços, prej çatmave të së cilës dukej mirë obori i shtëpisë së Tasit Ilos e kështu kisha një shpresë së munt t'a shëkonja zojushen Urani s'andejmi, u ndava prej z. Harisi dhe hyra ne tetua ime. Asaj i kallxova veçanërisht qëllimin t'em dhe tinazi shkova nga bajlladit' e vjetra të

shtëpis së saj, ku munt t'a shoh e t'a vëzhgonj mirë zojushen Urani, edhe t'a dëgjonj akoma të këndonja ca këngë të reja të bukura greke, nga të cilat shumë u enthusiasa

Qysh atë dit vendosa t'a kërkonj për grua atë zojushe të kandëshme, të cilën e gjenja të mbaruar në ç'do pikpamje edhe tam ashtu si e ëndëronja unë. Zonjusha Urani s'kish mbaruar akoma të 20 pranverat nga mosha.

Mendohesha cilin, ose cilën të vë mbles, ose mbleskë pa u expozuar, që të mos kujtonin se e kërkova vetë, po që m'u lutnë nga ana e nuses.

Në këto mendime e sipër dhe atje ku po veshgëllonja cilin, ose cilën munt të dërgonja si mbles, takoj të martohet kushëriri im Sotir Zografi, ku naturisht u thira për dasmë, po ku ishte ftuar edhe zojusha Urania, që ish kushërir' e tij e parë.

Atje m'u dha rasti t'a shoh edhe më mirë, po vura re se të gjitha çupat losnin valle e vetëm këjo nuk loste. Pyeta shkakun e më thanë se që kur ju ka vdekur i vëllaj i saj Dhimitri, ish profesori im, i cili i kishte shkretuar fort, ajo s'ka lojtur kurrë valle. Përveç asaj po e verenja se rinte tepër serioze e jo si shoqet e tjera dhe këjo më bëri përshtypjen më të madhe e më hyri më tepër në zemër.

Si mbaroj dasm' e Sotiraqit, një dit më vjen ky në zyrë dhe fillon të më fjalosë për Uraninë. Un' e kuptova me një herë po s'desha të çfaqesha edhe më vinte edhe mirë se filloj nga an' e tyre, pa ju propozuar gjë unë.

Sotiraqi, si më pa në dasmë se po e shihnja më tepër Uraninë me një verejtje të madhe, i kishte thënë s'ëmës së çupës Lenkës Poçit se kish gjetur një vent fort të mirë për Uraninë. Lenka i kishte thënë se s'ka më bukur edhe se më njohin mirë po s'kuxojnë të hapin gojën se mos ju kërkonja prikë shumë e s'kishin. Prandaj Sotir Zografi ardhi të më blerë mendjen më parë pastaj të hynte si mbles.

Unë u mbajta mirë përpara Sotiraqit pa i dhënë të kuptonjë se unë isha më i pari që e dëshironja një gjë të tillë. Mjaftova t'i thom që, tuke çmuar familjen fisnike të Poçkallarëve, pranoj një propozim të këtillë, por se lipset më parë të merrem vesh edhe me prindët, mbassi duhet t'i respektonja dhe ata. Këjo mjaftoj për Sotiraqin, sa të vejë e t'i ngrehë mendjen zonjës Lenkë Poçit, e cila u gëzua tepër kur pa se çështja munt të merte funt e kështu filluan të më vihen me mish e me shpirt për këtë mblesëri, të cilët, ku t'a dinin ata se un' e kisha pranuar pa asnjë konditë dhe se pak akoma po të ishin vonuar do t'ja kisha propozuar vetë.

Sipas fjalës që i dhashë Sotiraqit u mora vesh edhe me prindrit në Karvasarâ, të cilët u gëzuan pa masë e më ngutnin ata më tepër t'a mbaronja.

Takoj asokohet që ndodhej në Korçë dhe e motra e Uranisë Marigoja, e cila ish e martuar, si thashë, në Vlorë, dhe e cila nuk deshi të ikte nga Korça pa i dhënë funt kësaj punë. Mbanj ment mirë, se nër ato ditë takoj një ditë feste zyrtare turke, një dit donanmage ku, tuke qenë gjithë dyqanet hapur e të ndritsuar me drita, fenere etj. Sikur se ish edhe zyra ime avokatore, gjithë Korça gra e burra ishin në këmbë gjithë natën tuke shetitur e tuke dëgjuar muzikat e këngët gazmore. Midis kallaballëkut të math që po shkonte, shkoj edhe zonja Lenkë me të bijat e saja Marigonë, Uraninë, Angjeliqinë, me Sotiraq Zografin e me disa mbesra e nipër të tjerë, e mbassi ishte në bisedim e sipër mblesëria imë në zojushën Urani, ata kaluan kush e di sa herë nga zyra ime tuke më parë me verejtje të madhe, kur për të parën herë më pa e motra e Uranisë Marigoja, e cila më sympathizoj kaqe shumë sa kërkonte me ç'do farë therorije t'a mbaronte këtë punë. Është e ditur se edhe unë po i shihnja e po verrenja gjithë manevrat e tyre, tuke ndjerë një të math gëzim.

Po Sotiraqi i Zografit, si mbles që kish hyrë nuk priste sa të merrnja edhe konsentimentin[1] e prindërve e t'a mbaronim këtë punë. U ngut tepër, sepse një dit, ku kisha edhe shumë punë e andralla, më vjen bashkë me nji tjetër kushëririn e tij, dentist Kristaq Zografin e më urgusin kaqe shumë që ja ta mar Uraninë për grua, ja s'ka dhe më folë me një gjuhë tepër brutale, sa, pa dashur, më shtërnguan t'ju thom se "s'e mar" e kështu iknë që të dy të zembruar dhe një punë që kish gati 2 muaj që po vazhdonte rregullisht e mirë ata e

[1] konsentimentin = pëlqimin (H. K.)

shkelmuan në gjysmë ore e sipër, e shkuan e i thanë s'ëmës çupës se "kot po mundohen, se unë tallem me ato e s'kam njet të bënj gjë, etj. etj. Sa e dëshpëruan krejt të mjerën grua si dhe të shoqin Papakostën dhe gjithë familjen.

Unë, si u shkarkova nga gjith' ato punët që paçë ardhë në shtëpi e i kallxoj teto Ndinos se ç'ngjau me ata mblesës të jashtazakonshëm dhe ç'përgjigje ju dhashë. Teto Ndinos së ngratë i ardhi shumë keq kur dëgjoj e zu po qante, se kujtoj se u prish krejt puna, e po më lutej e gjora me gjith fuqin' e saj t'a mbaronj se është gjynah për atë farë çupe që s'kish shoqe, e më mori kush e di sa herë për qafe dhe më siguronte se edhe prindët do mos kundërshtonin, po përkundrazi do gëzoheshin, mbassi edhe im'ë e njihte nusen që do mernja.

E sigurova se unë do t'a mar vetë me të vërtet, edhe se, sado që më kanë folur një prikë vetëm prej 200 lirash turke, prapë e kisha pranuar, mbassi na qëndronte të gjithëve karari, edhe mbassi as një çupë tjetër në Korçë më kish hyrë aqe fort në sy e më kish pëlqyer sa Urania. Më dha uratat e shkreta e më shtërngoj t'a mbaronj që atë natë, mbassi gdhihej edhe dit'e Dielë.

Për fatë atë natë mora edhe nje telegraf nga prindët ku e aprovonin këtë martesë edhe n'a dërgonin bekimet e tyre edhe mua edhe nuses. Kështu, pra, puna ardhi tel më tel edhe s'mungonte përveç se konsentimenti i jem.

Tuke qenë se as një prej gjinisë s'onë s'dinte gjë mbi këtë çështje, as asnjë njeriut s'i kisha treguar, edhe për të ardhur puna me lezet ndonse s'ish nevoja të pyesnja gjithë botën, se mjaftonte që kisha pyetur veten t'ime më parë, thira një këshillë familjare atë natë prej 10-12 burrash, dajo e kushërinj dhëndurë dhe 7-8 tetosh e kushërirash, si dhe gjyshen, mëmën e s'im ëje.

Si u mblothmë në shtëpi t'ime e i vura përpara të gjithë ju tregova shkurtazi qëllimin që i thira dhe ata të gjith' e aprovuan e u gëzuan shumë që i nderova në atë mënyrë, përveç Ligorit dhe s'ime gjyshe. Ata u hodhë përpjetë kur e dëgjuan dhe sidomos xhaxha Ligori kundrështoj rreptësisht të mos bënj një gjë të këtillë se do bëhem pishman. Pse? i thom. Se sa e di unë, thotë, s'e di ti. Do të zerë gjynahu i kaqe çupave ma të mira që të kanë ardhur e i ke shkelmuar. Mos e bëj, thotë, se un' e di pa të thom.

E shtërngova të më thotë psenë, po ajy më vinte përpara ca gjëra abstrakte si e si të më justifikohej, sende që s'hynin aspak në torbë. E mora vesh se këtë e bënte xhaxha Ligori se nuk e pyeta atë para se t'a vendosnja një gjë të këtillë, e bënte pse ja prisha nj'a 2-3 herë kur më propozoj disa mblesëri të tjera, nga të cilat munt të kishte do lira të verdha, si kur se m'a punoj më parë me mblesërinë me Efrosinën e Thodhoriut ku përveç që i mori s'ime vjehre së pari 20 lira, po edhe si u prish puna e fejesës nga ana e jonë s'pati turp (Perëndia e ndjeftë) t'i kërkonjë të 30 lirat e tjera që ajo i kishte premtuar për atë mblesëri, edhe akoma më keq - tri herë Përëndia e ndjeftë atje ku ka rënë – të dojë të më emërojë mua avokat për t'i kërkuar kusurin e 30 lirave s'ime vjehre me anë të gjyqit! Munt të bënjë hesap njeriu se ku harrinte babzia, ku harrinte lakmia e këtij njeriu për pare, i cili pa një pa dy më shiti mua për ca të holla, tuke më dhënë për grua një nuse të sëmurë, një nuse tuberkulloze, një më të madhe se mua, një të shëmtuar! Lakmija e këtij xhaxhajit t'em ishte shprovuar edhe tjetër herë, ku na shiti të vetmen shtëpi që kishim në Korçë, ku isha lindur edhe vetë edhe të vetmen vreshtë që kishim, veç për kapriçjot e tija. Kështu më s'e sgjata më fjalën me xhaxha Ligorin po u mjaftova t'i thom "mirë, mirë" gjer sa i përcolla të gjithë e mbetmë vetëm me teto Ndinon.

Si ikn' ato ja shtruam mirë, hëngrëm e pimë e trokitmë disa herë gotat për shëndet të dhëndrit e të nuses gjer sa kaloj edhe mezi i natës.

Të nesërmen, mbas vendimit që kisha bërë vetë për gjithë natën, si u lava mir' e u vesha dhe pa dal' akoma Kisha, se ish e Dielë, ja mbajta pe ne tetua ime Cilja e Tomços, e cila e dinte çështjen që natën e parë se u ndoth në shtëpi t'onë, e si piva një kafe i thom të më thresë shpejt fqinjën e saj zonjën Alexandrë Tasi Ilo, e motr' e s'ëmës Uranisë, se e desha për një

punë me ngutësi. Teto Cilia s'priti t'i thom dy herë, po një, edhe shkon e m'a thret Alexandrën, ose Sandrën, si e quanin, e cila edhe ardhi e ndenj para mejet.

Si u përshëndoshmë, i kërkova ndjesë pse e tundova n'atë mënyrë dhe mbassi u sheshuam e s'kishim njeri pranë, i flas këto fjalë. Zonja Sandrë, ti e di fort mirë se po mblesërohem me zojushën Urani t'ët mbesë. Mjerisht mblesët që më kishit dërguar dhe të cilit i ishin përveshur kësaj pune, po të thom se s'e paskan në thua këtë mjeshtëri. Sado që puna shkonte në rregull edhe ishte më të sosur e sipër, s'di se ç'ju hipi kështu për një herësh e vijnë dje në zyrën t'ime e më shtërngojnë në një mënyrë brutale që ja se të këmbeheshe dje nishanin e të bënim vlesën, ja se dy të mira s'bëhen. Unë u çudita fort me atë sjelljen jo fisnike të tyren, edhe tuke pasur edhe shumë punë e andralla u zembrova fort e ju thashë se s'bëhet. Ata ahere iknë të hidhëruar edhe kush e di sa e kanë mbushur me fjalë t'ëtë motrë.

Në këto më përgjigjet teto Sandra, se ishte dje atje te e motra Lenka ku ardhë ata të dy mblesës bizarë e më tregoj një nga një ç'ju thanë, ku dëgjova se paskeshin shtuar edhe gjërra që s'u folë në zyrën t'ime atë ditë.

Si e pashë ata ishin dëshpëruar krejt e mezi ishin gdhirë atë natë së qari, se nuk e pandehnin të prishej kaqe shpejt një pun' e këtillë që u fillua e vazhdonte kaqe mirë.

Ahere mar fjalën prapë e i thom : Unë u pendova më njëherë që i dbova që të dy mblesët me atë mënyrë, po fajin e kishin vetë. Un' e vonova çështjen sepse prisnja edhe nja telegraf nga prindët që t'a aprovonin atë fejesë. Lumërisht edhe ky telegraf më ardhi dje mbrëmë. Po edhe si do që të ishte puna unë Uraninë do t'a mernja se më kishte hyrë në zembër. Prandaj të thira ty sot këtu e të lutem të shkosh që tani te jot motër e t'ju japësh lajmin gëzuar që puna ësht' e mbaruar edhe sot pres në shtëpi përfaqësuesit e nuses të bëjmë priko-synfonitë e të këmbejma nishanin. Për këtë gjë po lajmëroj tashi Mitropolinë të n'a dërgonjë sekretarin e saj në shtëpi t'ime.

S'priti t'i thom më tepër teto Sandra, po m'u hoth për qafe me sytë plot me lotte e më puthi disa herë, tuke më uruar trashëgim e jetë të mirë. Këto tha edhe shkoj shpejt te e motra, edhe unë, si i tregova teto Ciles çështjen e më zu edhe ajo për qafe e më uroj, shkova në Mitropoli e lajmova sekretarin të vinjë në shtëpi t'eme.

Tani se ç'u bë në shtëpi të s'ime vjehre kur ja dha sihariqin teto Sanda, ato s'rëfehen dot. Pas dreke ime vjehrë Lenka më dërgoj dy njerës serioz në shtëpi, t'ungjin e saj Nikoll Zografin, plak 75 vjetsh edhe të vëllanë Kostaq Ballaurin, të cilët ardhë të marrin vesh prej meje, a në ishin të sigurta lajmet që ju dha teto Sandra, edhe si ja u konfesova edhe vetë me gojë, më uruan që të dy e më thanë se, prikë çupa nuk ka më tepër se 200 lira turke edhe se atë natë do më jepnin vetëm 50 lira dhe pas 3 muajsh që do bëhej dasma, një javë ose 2 më parë se dasmën do më jepnin edhe kusurin. Këto kondita i pranova të gjitha dhe ju thashë se po i prisnja atë natë të urdhëronin.

Atë natë thira edhe disa prej sojit t'onë burra e gra, si edhe ndo një dyzinë kushërira të vogla. Ora më 8 alla franga të natës ardhi sekretari i Mitropolisë Nisi Themeli edhe pas gjysmë ore arrijnë edhe përfaqësuesit e nuses nj'a 3-4 burra, të cilët ishin plaku Nikoll Zografi, i vëllaj i vjehrës Kostaq Ballauri, dhe dy niprit e s'ime vjehre Llazaraq e Stavraq Ballauri.

Prikosymfonitë u bënë e u nënëshkruan dhe nishani u shkëmbye. Far' e fisi jem dëshironte të vinim atë natë të shëkonim nusen e t'a darovitnim se cili me nga një peshqesh. Po unë, mbassi nuk desha të vinte xhaxha-Ligori, i cili nuk e aprovoj atë fejesë dhe i cili e kundërshtoj reptësisht e nuk dëshironte të vlohesha me Uraninë, si iknë përfaqësuesit e nuses të gjithë, përveç se unë me teto Ndinon. Far' e fisi nuk m'u zembrua për këtë gjë, se i ardhi edhe pak për hesap, se shpëtoj disa lira e florinj e peshqeshe që do darovitte nusen, po sa për xhaxha-Ligorin me të shoqen, ata u zembruan aqe shumë sa ndezë fenerkat e shkuan me fëmijën e tyre e t'ime gjyshe, pa n'a thënë as natën e mirë. Edhe s'mjaftuan me kaqe, po bënë

më shumë se 9 muaj të shkelin në shtëpi t'onë edhe vetëm më ardhë për dasmë. Po edhe mua s'm'u prish shumë punë se mbeta rehat nga ata.

Ora më 10 të natës alla franga, simbas fjalës që kishim bërë, ardhi në shtëpi t'onë një i kushëriri i nuses dhe u nismë që të tre bashkë me teto Ndinon e vamë në shtëpi të nuses.

S'munt t'a përshkruanj dot atë ças kur vanë e kur ju trokitmë në derë, që të n'a e hapnin. Gjith'ajo dëshirë e ajy gëzim që po ndjenja prej aqe muajsh do realizohej atë natë. Atë natë do shëkonja për të parën herë të vluarën t'ime, atë që ëndrova e e dëshërova atë që do bënja shokun e jetës s'ime. Zembra më rihte kaqe dort si kur do më shkëputej.

Për pak minuta ishim përpara derës të së dashurës s'ime, dhe kushëriri i saj Kristaq Zografi mblesi punëprishës tjetër herë si e tregova, trokiti me fuqi tri herë në portën e tyre. Me një herë një karvan çupa, kushërirat e së vlumes s'ime vijnë e n'a hapin derën e hyjmë brenda. Shtëpia llampste nga të katër anët dhe një kallaballëk i math ishte grumbulluar atje e po n'a prisnin padurim.

Pikë së pari dolli vjehra ime me gjithë të motrat e saj e n'a zunë për qafe, tuke n'a uruar, pastaj gjith'ashtu nj'a 15 gra e çupa. U futmë brenda në odën e mirë, ku të tjera të papritura si pas zakonit të Korçës.

Nusja vonoj të n'a dalë dhe mezi që n'a dolli pas një orë e ca si vamë edhe me shumë naze e nafaize, si e kishin zakon çupat e Korçës asokohe që s'delnin jashtë po gjithë fshiheshin prapa dyerve.

Nuk e di si m'u duk Urania atë ças. As e kisha ëndërruar kurrë ashtu. E mveshur bukur me një toaletë bojë trëndafili, e bardh' e e kuqe si trëndafili që ish edhe e gjatë si biskonjë me leshrat lëshuar që i kalonin mezin, m'u pa si një hyll, si një ëngjëll! Kur ardhi t'a qerasë teta Ndinon, tuke mbajtur dhiskun me ëmbëlsinat e konjakun e kur i shihnja shtatin e tiparet që për së afërmi, më dukej e më vinte të çohesha e t'a përfshinja ashtu si ishte pa le të thyheshin gotat e dhiskut e makar le të bëheshin copë, po u mbajta! Ishte kaq' e bukur Urania sa s'kishte përshkrim. S'kish çupë më të bukur se ajo po edh'ato që kisha pasur të dashura tjetër herë si në Mesollonjë, Athinë, Ghemlek, Stamboll e gjetkë nuk ja kalonin bukurinë Uranisë. Aqe e bukur m'u pa atë natë!

Mendonja të fejumen e parë Efrosinën, mendonja edhe Uraninë, e para e madhe nga mosha (28 vjetsh), e that' e mpitë e zheshk' e shemtuar edhe mbi të gjitha e sëmurë, fumasioze. Këjo çupë 20 pranverash, e gjat' e trupderdhur, e kuqe e e bardhë si trëndafili dhe e shëndoshë si malësore. Ndryshimi si nata me ditën. Në të parën jo vetëm s'ndjeva as një të paktën gëzim në zembër, po përkundrazi nuk e shihnja dot qysh natën e parë. Po sa për Uraninë jo vetëm që më fluturonte zembra që po sa e pashë, po edhe dita-ditën më shtohej dashuria dhe s'prisnja ditën të martohesha me atë e të bashkohesha.

Një gjë vetëm s'e kuptonja dot, as që munt ta merrnja vesh që Urania a ndjente edh' ajo një dashuri për mua aqe të fortë, sa unë për atë, apo vetëm sa bëheshe gruaja ime, dhe i vinte kapak çupërisë së saj si gjithë çupat e tjera? Si çupë Korçe që s'kishte parë, si thonë, dynja me sy, a munt të kishte ndjenja ashtu si dëshëronja unë, a munt të ishte me fjalë të tjera për shoqëri, e dejtë grua për një profesionist me një shkollë të naltë si mua? Sepse e keqja në Korçë ishte këjo që, çupat korçare si të padala e të mbyllura, naturisht s'munt të dijnin kësij gjërrash, dhe si të paedukuara si duhet e me një jetë aqe monotone si atë të Korçës, mbasse do më dëshpëronte një dit, kur t'a njihja së afërmi dhe ahere përveç bukurisë, nuk do t'i gjenja tjetër gjë përsipër, një sent këjo që do më dëshpëronte kryekëput. Pastaj e keqja më e madhe ishte, se një njeri që s'e ka njohur mirë që më parë, si munt t'a marrësh për grua e t'a bësh shokun e jetës, kur ajo s'është në pozitë të të kuptonjë mirë?

Këto po mendohesha e e shihnja pa reshtur drejt për drejt në sy, e më s'ja hiqnja sytë ahere kur ajo qeraste Ndinon. Ndinua nga ana tjetër, mbassi ish e para herë që po e shihte, e mbassi e pëlqeu tepër fort, ja kish mbërthyer sytë, mbi ato dhe s'ngjinjeshe së pari, aqe sa s'i dilte fjala nga goja dhe gati si krejt e shashtisur po e mbante nusen më këmbë, edhe vetëm kur

i thanë krushkat “urdhro krushka Ndino, shëkoje një herë glikonë e nuses si të duket” vetëm ahere ardhi ndër ment edhe mori liko e ngriti gotën t’a uronjë nusen

Si e uroj sa mundi, si edhe t’ime vjehrë e gjithë krushkat e tjera, nxori e e daroviti nusen simbas zakonit e me gjithë që kishte dhiskun në dorë dhe po dridheshe, si e pashë, teto Ndinua e rroki një herë mirë për qafe e t’a puthi së parit ajo në ballë e në të dyja faqet, tuke i dhënë të gjitha uratat e Abrahamit, Isakut e Jakobit.

Kur u tërhoq nga nusja sytë i kullonin lott edhe sa herë e shihte Uraninë në sy qante e fshinte lottët me shami. E pashë edhe unë dhe tuke kujtuar prindët e vëllanë që s’u ndodhë aty në atë gëzim të parë, pa dashur më ardhë edhe mua lottët e po qanja si fëmijë, aqe sa njëri prej krushqve m’a pret : mos qaj dhëndër, mos qaj, pa në të zu malli që tani për nusen mundeni t’a merni që sonte, jini të lirë, ca më mirë për ne, se shpëtojmë. E filluan të qeshin të gjithë. Jo more krushk, i thom, jo, s’qanj për atë, se mua më pëlqen të shtyhet fehimi[1] për nj’a dy vjet, në qoft’ e mundur, që të vinjë këtu ne vjehra ë t’a shëkonj nusen, se ajo është jeta më e mirë për mua, po derth lott vetëm se u mallnjeva nga tetua ime që po qan, edhe kujtonj këtë ças prindët e vëllanë që s’i kam këtu të gëzohen.

Si e qerasi Ndinon Urania kthehet edhe nga mua. Pres të më hedhë sytë e të më shohë të paktën një herë, as pak. Dhiskun e kam përpara, po ajo sytë s’i ngreh përpjetë. Fillon të flas ca shakara që ta bënj të qeshë, ajo aspak nuk cënohet prej atyre shakave, me gjithë që u çkulë së qeshuri të gjithë, edhe sikush atje tha se “e paskemi dhëndrin edhe shakaxhi”. Nusja po vrejtet më tepër, më tepër po bëhet tramuse. Më vinte sikur më thosh me ment’ e saj “pa mer glikonë e më ler të shkonj se më këputtë së mbajturi më këmbë, pa s’të lipsen ato. Kemi kohë kur t’i flasim bashkë”.

Kështu bëra edhe unë, mora glikonë, piva konjakun, tuke uruar edhe e lashë të gostitë edhe tjerët që ishin rotull. E darovita 1 pesë lira turke.

Teto Ndinua tani n’a kërkonte nusen pranë që ta shëkonte edhe më mirë e të çmalleshe me të. Edhe ime vjehrë s’ja prishi qefin, ja pruri pranë. E zuri prapë për dore teto Ndinua e e shtërngonte e e puthte e më s’e lëshonte dhe gjithë qante. I vinte si kur t’a merte e të ikte me ‘të e t’a sillte në shtëpi, kaqe e simpathisi e s’i ndaheshe.

Më së fundi në mes të enthisiasmit të math e të kënaqësisë u ngritmë e ju lamë shëndet edhe shkuam të dy me Ndinon, kur veçanërisht m’u derdhë të gjitha kushërirat e tjera të Uranisë e më uruan dhe motr’ e saj e vogël Angjeliqia, çupë 16 vjetshe m’u hoth për qafe e s’më ndaheshe, po edhe mua më ardhi shumë keq e shumë u mallënjeva. Ajo e shkreta derthë lotte çurk, se kujtonte të vëllan’ e saj Dhimitrin, ish profesorin t’em, që kish vdekur aqe i ri në Vlorë e ju kish këputur krahët, e që s’u ndoth gjall edh’ ajy t’a ndjente gjith’atë gëzim të asaj nate. Se vërtet kishin martuar të motrën e tyre më parë, Marigonë me Jovan Themeliu në Vlorë, po gëzim si këtë ishte e para herë që po shihte shtëpia‘ e tyre kaqe fort e përvëluar!

Si arthmë në shtëpi e pyeta teto Ndinon si ju duk nusja. Ajo m’u hoth përqafe e më uroj sa mundi e më tha që nuse më të mbaruar s’kish si bëhej edhe më lëvdoj mjaft si e ku e paskam gjetur kaqe të mirë, se i kishte pëlqyer pa masë.

Nuk rëfehet enthusiasmi i Ndinos atë natë, i vinte si kur zuri Perëndinë për mjekre, në qoftë se Perëndia s’e rruan ndo një herë mjekrën. Nuk flinte dot nga gëzimi; s’la njeri për pa ja lëvduar nusen e djalit dhe i vinte si kur t’a kish në shtëpi e t’a shtërngonte.

Kur qënka fat të bashkohet njeriu me shokun e tij të jetës dhe kur i qetsohet shpirti se më së fundi e gjeti atë që kërkonte sa e ndjen vehten e tij të lumtur! Mua më vinte sikur t’a shkonja atje gjithë kohën t’ime. Gati e braktisa zyrën. S’e kisha mëndjen në punë. Shumë herë vinja edhe von në gjykatoret, kështu që kolegët avokatë kishin të drejtë të më rëzonin davat’ e mija, mbassi s’ndodhesha në orët e caktuara, po s’e bënin këtë prej respektit që ushqenin ndaj mejet edhe pse, si i vluar që isha kësij fajesh duhet të më faleshin.

[1]fehimi = fejesa d. m. th. të qëndrojmë të fejuar (H. K.)

Mbassi u vluam, unë zura e vinja për dit ne e vluara ime dhe qëndronja atje shumë, sa edhe harrohesha dhe jo një her' e dy i linja pa punë t'ime vjehrë e çupat, se duhet të më mbanin shoqëri, se naturisht edhe simbas zakoneve severe[1] të asaj kohe (1904) s'munt të më lijnin vetëm me Uraninë, e cila prapë kish aqe turp, sa edhe posa shëkonte që e lijnin vetëm me mua, çoheshe edhe ajo e më linte vetëm mua.

Për kush e di sa kohë s'ja kisha dëgjuar zërin, as muhabetin. Ju ankohesha disa herë te vjehra pse kaqe hypokrisi nga an' e nuses, porse ato më justifikoheshin jo kështu, jo ashtu, jo ësht' e urtë nusja, e jo s'duhet të flasë para burrit etj. etj. gjer sa u ndoth edhe një plakë nga soji im e më tha ca fjalë filosofike : "Mor bir, mos u ngut t'ja hapësh gojën s'atë shoqe, se sa ta hapë një herë e të flasë pastaj s'e mban dot. Marifeti është si t'ja mbyllç gojën e të mos flasë e jo të të mbetet hatri pse s'hap gojën. Ditët e mira paskëtaj i kini e do t'a dëgjosh nusen të flasë sa të lodhesh edhe ti së degjuari. Lëre pra kështu memeckë, se këtë kohë s'e gjen". Këto më tha ajo tetua plakë dhe fjalët e saj më bënë një përshtypje të thellë.

Me qenë se zun' e më vini re mëhalla kur hynja e kur delnja ne nusja dhe komentonin gjithsecili pas mëndjes së vet, u shtërngova të mos vete ditën po më mirë natën dhe kështu, mbassi po thuaj gjithë Korça që prej orës 8 ose 9 alla franga të natës dorëzoheshin disciplinisht në krahrorët e perëndisë së gjumit Morfeut e s'bëheshin të gjallë gjer në pikën e mëngjezit, unë kështu gjenja kohën edhe sa do që ishin nett dimbri (Fror 1905) unë i mshtillnja rotull t'ime vjehrë, të motrën e saj teto Santën që e deshim të gjithë si edhe të gjitha kunatat e mija me gjithë të vluarën t'eme e ja shtronim muhabetit gjer një orë të gdhihej e kështu vinja i kënaqur në shtëpi dhe flinja deri në drekë. Kështu s' kuptohesha aspak në shkonja te nusja, apo jo, se veç shtëpisë s'ime vjehre as kush tjetër, as prej fisit tyre, as prej t'onit s'dijnin gjë.

Nër ato kohë n'a jepej rasti që delnim edhe me shetit shumë herë edhe s'lijnim sokak të Korçës pa e gjesdisur, si edhe gjithë çarshinë. Shkuam me fjalë të tjera një jetë aqe të ëmbël e aqe të lumur ato nj'a 9-10 muaj, sa ishim të vluar me Uraninë sa s'do t'a harrojmë kurrë as ajo, as unë.

Te e mbremja ardhi edhe koh' e martesës s'onë. U martuam më 12/25 Nëntorit 1905. Sa do që ju luta shpesh herë t'im 'eti që të ndodhej në dasmë, në këtë gëzim të parë që shihte nga djal'i tij, ajy s'pat kohë, po më dërgoj vetëm t'em 'ë, të cilën e shoqëroj im vëlla gjer në Korçë.

Kështu u bë dasma zyrtarisht edhe Urania ime hyri nuse në shtëpinë t'onë.

Nuk do zgjatem më tepër mbi martesën t'onë veç se do kallxonj një episodë që ngjau të Djelën mbrëma, natën d. m. th. që vumë kurorë edhe mbassi shtruam të hanim darkën.

Naturisht unë duhet të thrisnja më të afërmit t'em, të cilët u ndodhë shumica shqiptarë, por edhe disa të tjerë grekomanë. Si hëngërm mir' e bukur e kur ja shtruan këngës piksë pari një miku im edhe patriot Llazo Progri ja nisi këngës shqip. Po këjo s'ju ardhë mirë miqve të tjerë grekomanë, të cilët merren vesh me shoqi-shoqin dhe një prej atyre, farmacisti Dhori Lehova ja filloj një kënge greqisht, ku e shoqëruan edhe grekomanët e tjerë për t'ju prishur këngën shqiptarëve që filluan më parë. Këjo s'ishte një gjë e pëlqyer e sidomos në një dasmë, ku lipsej të nderohej hospitaliteti e njerzia që ju tregoj edhe me të cilat i nderoj vet' i zoti i shtëpisë, unë.

Ahere im kushëri Thoma Turtulli që u ndoth përpara Dhorit Lehovës u zembrua fort edhe i sillet Dhorit e i thotë të mos ju prishë këngën shqipe Shqiptarëve miq. Po tuke qenë se Dhori Lehova me shokët nuk i dhanë rëndësi fjalëve të Thoma Turtullit, Thomaj zembrohet për këtë përbuzje dhe s'ja vonon Dhorit po t'i heq një pëllëmbë kaqe të fortë sa i lëshuan sytë shkëndia.

[1] severe = të ashpra (H. K.)

Dasmorët ngrihen më këmbë dhe ndahen në dy arte, në atë të Shqiptarëve ku ishin Thoma Turtulli, Idhomene Kosturi, Llazo Progri, etj, etj. Dhe në atë të grekomanëve ku ishin Dhori Lehova, Gorçi Skali, të bijt' e Loni Bimblit etj. etj.

Fillojnë grekomanët të msyjnë Thoma Turtullin, po me një herë Idhom. Kosturi, Ll. Progri etj, rëmbejnë karekllat e ja sjellin atyre, disa të tjerë prej artës shqiptarëve rëmbejnë të tjerë grekomanë prej gryke e për xverku e i hedhin jashtë, ose i rëzojnë nga shkallët e përposh. Një betejë, një luftë, një gurgule që s'njeh i pari të dytin. Thyhen pjata, thyhen shishe, gota etj. etj. e gati ment thyhen edhe pasqyrat e mira të kristallta që kisha n' atë odë. Gratë nga ana tjetër derdhen këtej e kërkojnë burrat ose vëllezrit, a djelmt' e tyre. Disave po ju bije alivan; disa po zbehen e marrin fytyrën e vdekjes; fëmija, çilimijtë, djelm, çupa thresin e bërtasin që mos e pyet hallin! Nuk mundet as kush të sjellë në vënt qetësinë. Disa duan të nxjerin edhe revolveret e tyre po u ndaluan nga disa të tjerë të urtë. Më së fundi harrin edhe devrija (patrolla) prej 7-8 vetash, të kryesuar prej një komiseri të Policisë të cilët trokasin në derë e ja hapmë e hynë brenda. Po mbassi komiseri u ndodht miku jem, i tregova çështjen si ngjau dhe ky hyri në mes e i qetsoj.

Të gjithë grekomanët, të cilët ishin gjith'ata që u ranë prej tarafit të nacionalistëve shkuan të zembruar, kur se bashkë me komiserin e Policisë, Beqir Progrin, nacionalistët edhe ky, ja shtruam e bëmë një qef ta jashtazakonshmë gjer sa u gdhi. Kështu mori funt edhe martesa jonë!

## XII

Dy javët e Hënës së mjaltës, javët d. m. th. të para shkuan mirë. Po n'a takoj një çështje që m'u desh me shkue gjer në Karvasarâ dhe m'andej gjer në Patrë. Ishte një pun' e veçantë e t'im 'eti për të cilën ish nevoja të ndodhesha edhe unë në Karvasarâ mbassi ishte urgjent e s'priste vonim. Këjo takoj në ditët e para të Dhetorit 1905.

U shtërnguash të nisem nga Korça me një të ftohtë të madhe, në një cingërim, që do ish të paktën 4 nënë 0.

U nisa me qiraxhinë Nasi Llogorin dhe ndodhën dhe të tjerë bashkudhëtarë, të cilit vijnin gjer në Janinë.

Kur ikmë nga Korça thamë se n'a u zu fryma. Dy tri herë mendova të kthehem prapë, po me qenë se gratë e konsiderojnë këtë si prapësi, thashë le të dalë ku të dalë edhe hoqa përpara.

Me një mijë bela mezi arthmë në Kolonjë. S'andejmi u nismë me 2 orë ditë edhe me gjysmë shpirti mezi zumë Leskovikun. Ditën e tretë duhet të ishim në Janinë, sepse brenda 4 ditve duhet me do e mos të isha në Karvasarâ se ashtu ishte puna. Pra me qenë se symfonia ishte që atë dit, d. m. thënë ditën e tretë të ishim në Janinë, në mos do humbiste 6 mexhite një bas, qiraxhinjtë, ose më mirë të them, qiraxhiobashi Nuçi Llagori për të mos humbur basin ç'bën? Na heq atë natë (natën e tretë) në hanin "Negradhes" 4 orë lark Janinës dhe nuk n'a la të flemë as 3 orë po n'a ngreh me to e mos tamam në mes të natës edhe në mes të asaj së ftohte e n'a shtërngon të nisemi për Janinë ku do të arrijnim 3 orë para se të gdhihet, kështu që të kisha ditën e katërt të nisesha me karocë e të arrinj Prevezën ku më të ngrysur arrinte edhe vapori që niseshe për në Karvasarâ dhe me këtë mënyrë do gjëndesha në Karvasarâ po natën e katërt, simbas fjalës e bazit.

Më kot dua e mundohem t'a bint të mos nisemi në mes të natës, se kjo do ishte një marrëzi e pashoqtë; më kot i thashë se heq dorë nga bazi në favor të tij, po bosh-bosh. Unë, thotë, qiraxhi bashi do nisem, se kam edhe punët e mija në Janinë dhe është nevoja të ndodhem atje pa gdhirë, ju po të doni nisuni, po të doni rijni.

Pamë ç'pamë ahere u nismë. Ishte ora një pas mezit të natës dhe tuke u gdhirë sh. Spiridhoni (12 Dhetor) në piskun e dimbrit, d. m. thënë, një e ftohtë, një thëllim që mos e

pyet. Vetëm një gjë n'a ngushëllonte se koha isht e kjartë si kristali dhe Hëna e plottë e shndritëse, si edhe qielli plot me hyje.

Para se të nisem mbusha një pagur me rum inglizi të fortë, mora edhe 100 drehem stafidhe të thata, të cilat vijshin mirë me rumin. Piva një herë hesëll dhe ja hipa kalit t'em. Ashtu edhe shokët e tjerë. Po kalin më të mirë, një gjok, e kisha unë. Ajy ishte edhe kali i karvanit. Më përpara ishte kalë oficeri të kavalerisë dhe më vonë kal karoce gjer sa u bë kalë qeraxhiu, po si do kudo aftësin' e revanit s'e kishte humbur akoma.

Si u larguam ndo një gjysmë ore nga hani dhe si e pashë se u thava së ftohti përmbi kalë me gjithë që isha i mveshur mirë dhe kisha dhe një brucë të shëndoshë përsipër, prapë s'e duronja dot të ftohtit, që më kishte depërtuar palcën. Prandaj i zbrita kalit dhe zura të rendinj më këmbë tuke e hequr kalin pas kapistallit, gjer sa ndjeva një të ngrohtë. Po kisha edhe 3 orë udhë akoma, si do bënja, më dukej se do mos vinja i gjallë në Janinë.

Për të shkurtuar rrugën ja hipa prapë kalit dhe i rashë një herë me thembrat e këmbëve për të nxituar. Kali ahere mer yrysh edhe ja mbush përpara me një shpejtësi 20 kilometrash në orë, gjë që më pëlqeu tepër, se për një orë do futesha brenda në Janinë.

Kështu u largova mjaft nga karvani tjetër e qiraxhijtë, të cilët kujtonin se po më kishin pak hapa përpara. Ësht' e tepër të bënj fjalë për të ftohtën e tmerëshme që e duronja mbi kalin, që po shtohej edhe më tepër sa kalonte mez'i natës edhe sa gjëndesha i hipur. Edhe rumi sa do që s'e linja as një minutë pagurin prej goje, prapë s'i bënte ballë asaj së ftohte të paduruar. E ftohta kaloj kulmin kur u futa nga Lykostomi në fushën e Janinës. Thashë se m'u zu fryma, thashë se mbeta.

Më së fundi dha Zoti e dallova liqenin romandik të Janinës. Ahere mora një kurajo edhe për gjysmë ore hynja në Janinë, e cila flinte e zhytur në gjumë. E mbajta kalin përpara karakollit për të dhënë e vizuar passaportën, po s'dukej as njeri. Dhe një gjendarm që qëndronte si sentinellë[1] në ruajtoren edh'ajy flinte i ngrati i turullosur në manton' e tija e më ardhë keq t'a zgjonja. Kështu u sosa përpara derës së madhe të hanit të Kacimbros, ku kondisnin qiraxhinjtë.

Para se të hynj në han më përsëlloj hundët një e kandshme për mua erë , erë paçesh që goditeshin me udhër e me uthull. S'më durohej dot. Shpejt hynj në han dhe sa do që kish edhe dy orë të gdhihej, ju dorëzova kalin nj'a dy shërbetorëve të hanit dhe unë kthehem e shoh paçet me fé të Janinës, që i kisha aty përpara e porosit një pjatë të madhe me një samune bukë të ngrohtë Janine e shkonj lart e mbyllem më një odë ku zjari ishte trazmë, shtrohem e ha me qef edhe një pjatë tjetër edhe një tjetër, po edhe ndonjë okë verë edh'ashtu si isha u shtriva e më mori një gjumë aqe i ëmbël sa s'ka.

Qiraxhinjtë që kisha lënë prapa s'lanë vënt pa kërkuar edhe shumë ishin trembur, që s'më gjenin, po më në funt arthnë e më gjetnë në han. U zgjova nga mëngjezi e shkova shpejt me karocë për në Prevezë, ku harriva 5 minuta para se të niset vapori për Karvasarâ e kështu prej Janine në Karvasarâ që janë 16 orë i mora për një dit. Po edhe ato paçe që hëngra në Janinë me aqe qef e me aqe oreks do mos i harronj sa të rronj.

Në Karvasarâ ndenja me t'ëm 'atë disa ditt dhe tuke qenë se nër ato ditt kishim edhe Krishtlindjen për hatër të babajt ndenja e bëmë Krishtlindjen bashkë. Më 30 të Dhetorit u gjenda prapë në Korçë.

Kishim filluar të shkonim një jetë të mirë, por se t'em vëllajt që kisha me vehte, s'di se si i ngritnë mëndjen të shkonjë në Amerikë. U mundova sa munda t'a ndalonj, se s'kish mbaruar akoma Universitetin (fakultetin e Drejtësisë), po s'ish e mundur. Me shumë hidhërim, pra u shtërngova e i dhashë navllonin[2] e e përcolla për në Amerikë, ku shkoj e zuri vënt në qytetin Jamestown N. Y.

[1] sentinel = roje (nga italishtja H. K.)

[2] navllo = shuma e të hollave që jepet për të udhëtuar me anije (H. K.)

Shkuam shumë mirë nj'a dy vjet kështu të martuar në Korçë. Në këto dy vjet e sipër vetëm dy episode karakteristike më ngjanë, përveç një episodit tjetër të math, të cilin do t'a tregonj më gjatë, mbassi ka karakter nacionalizmi.

Episodet që po përment ishin këto :

Një farë Seid, ose Seida prej Panariti, një zengjin i math e me shumë influencë, po edhe i trashë e harbut, prej të cilit dridhej Korça edhe i cili shumë herë më vinte në zyrë e më mbante kot pa punë, tuke më ngrënë orë të mjafta të vlerta edhe tuke qelepirosur kafe pa masë, një ditë vjen e më ankohet që pse kam marrë një dava civile kundra dy nipërve të tij. Ju përgjigja se unë jam avokat edhe në këtë mënyrë munt të marr edhe shumë davara të tjera e këtu s'ka sepse t'i mbetet hatri askujt, masi tjetri më paguan. Seitaj mbassi më çfaqi kaqe herë idhërimin e tij, më së fundi pat paturpësinë të më thotë të heq dorë nga ajy gjyq se ndryshe s'jam miku i tij. Unë në krye s'ju dhashë aqe rëndësi fjalëve të tija, po kur e pashë se insistonte tepër edhe më në funt zuri të më frikësojë, ja preva një her' e mirë, tuke thënë se ajo s'është e mundur të heq dorë, se kisha marrë edhe 25 lira përpara nga kundrështarët e nipërve të tij grabitës e hajdutë edhe se frikësimet e tija nuk i mar si fjalë të rënda, as që jam prej atyre që trëmben. Ahere Seidaj ngrihet më këmbë edhe me një mënyrë barbare çthur gardhin e dhëmbëve edhe zë të më shanjë. I them të mbanjë gojën, se është njeri i matur etj. etj. , por ajy më keq po harboheshe. Më së fundi ngreh edhe bastunin e më godit në supin e mëngjër. Ahere m'u nxheh edhe mua gjaku, m'u tëher sŷri edhe s'ja hasmërisa po i futa një grusht turinjve sa e përplasa për dhe e ju dërmuan kockat. Ngrihet ashtu si ishte edhe nxjer revolverin, po pa e nxjerë mirë nga kullufi ja rëmbeva prej dore e ja dhashë shërbëtorit t'em që ish aty pranë. Matet të më godiste edhe një herë, po s'harrin dot se e përfshiva prej xhybesë, ose binishit me gëzof që kish veshur edhe me dy shkelmë që i futa vitheve e nxora jashtë zyrës e ra përmbys në sokak.

Bërtet ahere burracaku i keq e mblidhet një koxha kallaballëk përpara zyrës s'ime, se Seidaj çoj dynjanë në këmbë "ku jini, or turq, se n'a vranë kaurët".

Kishte një karvas me vehte, një kapadaji mustaqezi, që t'a shihnje nga të pamët thua se ishte ndonjë fatos prej atyre që s'kanë shok, fatos legjendar, me pisqollën të argjëntë në bres, ose në silahe e me pallaskat e argjënta, me fustanellë shumë klindash, etj. etj. po e vërteta ish se ky farë burrit s'vlente asnjë ovull[1], se kur i bërtiti Seidaj "bjeri kaurit" ajy nxori koburen vërtet, po s'ishte i zoti t'a zbrazë, se kur m'u afrua mua, mjaftoj shërbëtori im, një djalë 18 vjetsh t'ja rokë krahun e t'i marrë pisqollën, ti cilat, si revolver' e agajt si pisqollë e gogolit tjetër i dërgova në Polici me shërbëtorin t'em tue u mbajt për këtë edhe një proçes verbal.

Seidaj i rahur e i turpëruar mënt pëlciste nga marazi. E pa se u turpërua mjaft edhe këjo u komendua tepër në pazarin e Korçës, se e njihnin mirë Seidâ Panaritin edhe mbassi më paditi në gjykatore edhe në vënt që të dënohem unë u dënua ajy me një javë burg e me 10 lira gjobë, kërkonte më ç'do mënyrë të më vriste. Këto i dëgjonja edhe unë prej miqve, të cilët më porosisnin të ruhesha, po si shkoj pak kohë e u ftoh puna jo vetëm s'më vrau Seidaj, po përkundrazi me anë të të famshmit Alo-bej Dishnicës, u miqsua me mua e më sillej si njeri e si mik, më nderonte mjaft e më sillte edhe myshterinj! Ky është karakteri i dobët e i qelbët i disa gogozhelave që janë msuar të trembin botën e qetë dhe vetëm kur u bije lëkura edhe çfaqet gomari, ahere ju vijnë mente.

Episodi tjetër ka qenë me Kadin' e Korçës, që s'më bije ndërment embri, por se ish edhe ky naturisht prej Gjinokastre prej familjes Kumbaro.

Një dit bënte ftoht shumë dhe zyrat kishin ndezur sobat. Në dhomën e audiencës së gjyqit të Korçës stufa bënte tym, edhe me qenë se s'ish asnjëri prej sherbëtorëve të hiqte huret që bënin tym e të vinte disa të tjera, Kadiu shtije sytë këtej nga ishin tre avokatë e po rijnim

[1] ovull = monedhë me vlerën më të vogël të sistemit monetar turk të asaj kohe (H. K.)

edhe mbassi unë isha më i vogli nga mosha kthehet e më thotë të hujem e të nxjer hurët që tymosnin e të heth dru të tjera, tuke hapur edhe penxheret.

Mua më ardhi çudi si pat paturpsinë të m'a thotë atë fjalë Kadi efendiu, që vetëm një shërbëtori munt t'ja theshte! Po Kadiu, si e pa se unë s'lojta nga vëndi, m'a përsëriti edhe një herë edhe në një mënyrë sikur se isha i detyruar t'a bënj atë punë. Ahere ja kthenj me një herë, tuke i thënë se ajo s'është puna e ime dhe duhet vetëm yzmeqarët të urdhërojë në atë mënyrë. Po Kadiu u zembrua mjaft dhe urdhëron një tjetër avokat, Vasil Orolloganë, i cili me një herë u konformua me urdhrat e Kadiut e i nxori hurët që tymosnin, tuke hedhur dru të tjerë në stufë.

Kadiu u zembrua fort me mua, po nuk e çfaqi zembrimin, e mbajti në zembër, dhe qysh atë dit zu më shikonte me inat, zu më sillej i ashpër, s'më bënte asnjë lehtësi, më sillte sa ndalime muntte dhe jo nje her' a dy më rëzonte pa ndonjë shkak ligjor edhe davatë që kisha.

Un' e durova mjaft herë, po si më plasi edhe mua shpirti, një dit më s'ja mbajta. Për arsye se më rëzoj një dava kot së kot me gjithë që të drejtën e kisha të plottë, ju ankova para gjyqit që vendimi ish i padrejtë, shumë i padrejtë edhe do t'a apellonj, tuke shtuar se e shoh fort mirë që gjyqi ngutet të japë vendim pa i peshuar mirë të gjitha arsyet ligjore që paraqiten. Vërtet i fola pak ashpër e jashtë rregullit, po më mbyti e drejta që kisha. Ahere Kadiu zembrohet tepër e më bërtet të dal jashtë. Unë qëndrova në vënt. I përgjigjem se s'e ka atë të drejtë Kadiu, përveç se sa i imponon Proç. Civile. Ajy insiston të dal jashtë, po unë s'tundem. I urdhron mubashirit të më nxjerrë ajy jashtë, po edhe mubashirit ju akrova fort kur u afrua dhe isha gati t'a pres turinjve po të vinte dorë përsipër. Ahere i xhindosur ngrihet Kadiu vetë të më nxjerrë jashtë. E prita edh' atë me një gjakftohtësi, po ndërhynë gjyqtarë e avokatë bashkë e s'e lanë Kadinë të më afrohet. Kështu Kadiu u shtërngua të shkonjë e të tërhiqet në odën e bisedimeve të veçantë tuke na lënë ne në sallën që ishim.

Kadiu bëri një ankim të math të Prefekti i Korçës kundra meje. Prefekti më thiri e më pyeti, po kur i tregova çështjen si ngjau u këput së qeshuri. Edhe për të qeshur më tepër e thiri Kadinë përpara meje, tuke qenë edhe disa antarë të Këshillës Administrative të Prefekturës e më jep fjalën mua t'a shpjegonj mirë punën si rodhi. Kur zura e tregonja çështjen me një mënyre hymoristike gjithë sa ishin u fiknë gazit veçanërisht prefekti, i cili ironisht e pyeste nga ndonjë herë Kadinë se "a i vë avokatët të ndezin edhe zjarrë", "a ja cakton secilit ditën", "a i urdhron edhe për tjetër gjë avokatët", etj. etj. , si e si të jepte shkak Kadi efendiu për të qeshur edhe më tepër mexhelisi[1], gjer sa Prefekti mori një pozë serioze e i foli mjaft ashpër Kadiut, tuke i hequr vërejtjen për të tilla sjellje kundrejt avokatëve, të cilëve ajy i pari duhet t'i respektonjë.

Kadiu iku i turpëruar që andej edhe unë tepër i kënaqur. Çështja u komentua shumë keq mbi kurrizin e Kadiut¸i cili sikur copë të më bënte nuk do ngjinjeshe kurrë me mua. I vinte mjaft turp se e mori vesh edhe e gjithë Korça. Po kush i kish faj? Kush i tha t'i ankohet Prefektit?

Po këjo nuk mjaftoj gjer këtu.

Me qenë se qysh ahere më rëzoj kot nj'a dy dava ky Kadiu, herën e dytë unë s'durova dot. Tuke u marrë vesht edhe me klientin t'em e padita Kadinë (ishtiqah-an-huqam) për dhel[2], i cili e shtyri që të më rëzojë padinë dhe këtë dava e fitova dhe

Kadiut i kushtoj shumë shtrenjtë. Nga ana tjetër me qenë se u ankova te inspektori i Drejtësisë Kirkor efendiu në Manastir si dhe bashkë me mua edhe një koleg tjetër, shkaktuan që të vinjë inspektori (adilije-myfetishi) në Korçë dhe prej inspektimit që bëri i duall shumë të palara në shesh Kadiut, kështu që pas raportit që dha inspektori, u pushua nga puna e u muar edhe ne gjyq. Si mori funt pastaj pun' e tij nuk e di se në atë koh' e sipër më ngjau një tjetër

[1] meçlis = këshill (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)
[2] Dhel = djallëzì, mejtim i keq (K. F.)

taksirat që prisha gjithë atë sërë të mirë që kisha vënë qysh prej aqe vjetsh në Korçë, si kurse do ta tregonj tani.

Moti 1906 ishte një mot mjerimi për mua një mot katastrofal për familjen t'onë.

Ndjenjat t'ona atdhetare s'na lijnin kurrë të qetë, prandaj bashkë me profesjonin që kisha nuk e lashë pas doret edhe çështjen kombëtare. Zyra ime ishte qëndra e nacjonalistëve Shqiptarë ku këmbeheshin gjithë farë mendimesh dhe ku mbaheshin aqe e aqe fjalime. Propaganda e jonë po përhapej mjaft dhe dita-ditën shtohej e përhapej idheja kombëtare, e cila po zhvillohej me të vërtetë me një droje e frikë të madhe, po edhe me hapa gjigandike e jo vetëm në Korçë brenda por edhe në qarket e saj, në katundet Dishnicë, Zemblak, Pojan, në Progër, Bihlisht e gjithë Devollin, akoma edhe gjer në Kolonjë e Leskovik dhe gjer në Berat, Vlor' e Gjinokastër edhe më fort gjente truall idealismi në elementin muhamedan.

Po sa do që kishim marrë ç'do masë preventive edhe sado që kishim edhe vegla zyrtare që n'a ruanin e n'a ndihmonin, si p. sh. Nafus-memurin, të ndyerin Orhan be të Çerçiz beut, Tahrirat-qati Emin efendinë, drejtorin e Policisë Beqir Progrin etj. etj. prapë se prapë spiunët e fëlliqur turkomanë e grekomanën s'na lijnin rehat.

Kryekomisari i Policisë Beqiri, që ishte shoku ynë e bashkëpuntor, vjen një dit në zyrë e më thotë se të nesërmen do vinte me urdhër të Prefektit të bënte anketë në shtëpi t'ime e në zyrë si dhe në disa të tjera shtëpi atdhetarësh e kështu më lajmoj të djek ose të fsheh ç'do libër, shkresë, letër ose dokument tjetër që muntt të më kompromentonte përpara Qeverisë. Është lumëri këjo kur paralajmërohet njeriu.

Me të vërtetë të nesërmet vinte Beqiri me dy policë e me muhtarin e lagjes s'onë e më bënë anketë si në shtëpi, si në zyrë¸ku s'më gjeti gjësendi, ësht' e ditur, se ç'do gjë që kisha i çova te një tetua ime e motr' e babajt në Katovarosh.

Pas pesë ditsh internonin në Diaribeqir në Anadollit Oran bejnë, Hafiz Alinë, Emin efendinë dhe nj'a dy të tjerë. Unë për fat të mirë shpëtova.

Nga ana tjetër Metropoliti i Korçës Foti, një propagandist i keq i idhesë greke nuk rinte i qetë. Bënte propagandë çiltazi për Greqinë, n'a mallkonte ç'do të Djelë në kishë ne massonet (!) Shqiptare dhe s'linte gurë e baltë pa përdorur kundra nesh.

Nuk shkoj shumë kohë edhe më thiri zyrtarisht Prefekti i Korçës, i cili më tha se ka urdhër të më internojë në Konjë tëAnadollit, po mbassi e kisha mik e s'më desh të keqen, më porositi të përpiqem të suspendohet urdhri i cili vinte nga Valiu i Manastirit. Ahere me të shpejtë shkova në Manastir edhe me anë të miqve dhe më fort të konsullit Austriak në Manastir u suspendua urdhri i Valiut.

Ardha në Korçë, po e pashë se s'munt të qëndronja dot. Despoti shkroj për mua edhe në Patrikape dhe, si kisha marrë vesh, po më tirej një rrezik i math mbi kokë

edhe dita-ditën po keqsohej puna. Një taksirat tjetër arrin e më bën të shpejtonj ikjen t'ime nga Korça edhe këjo ishte vrasja në pritë e Metropolitit në fjalë Fotit.

Despoti Foti, i cili s'la spiunllëk pa përdorur kundra nevej nacjonalistëve, e më fort nacjonalistëve të krishterë ishte harbuar tepër, aqe shumë sa qertoj e shau zyrtarisht edhe brenda në Kishë , një dit të Djelë , edhe atë Prefektin e Korçës, mikun e Shqiptarëve Fejzi bej Alizotin nga Gjinokastra, si propagandist e jatakun e Shqiptarëve nacjonalistë edhe si nëpunës kundrështar të interesave të Dovletit.

Fejzi beu kur e dëgjoj i ardhi shumë liksht edhe unë që u ndodha atë dit në kishë i tregova se i dëgjova edhe me veshët e mija gjithë ç'tha dhespoti.

Prefekti i dëgjoj këto e s'foli gjë. Po pas dy-tre javësh kur Mitropolit Foti shkonte për në Bradëvicë, mb' udhë nga i quajturi Guri i Cjapit i kishin bërë pritë Çerçiz Topulli me shokë , që jishin ahere andartët[1] e anëtarët e komitetit të Shqiptarëve , i cili më vonë mori embrin

[1]andart = komit (H. K.)

“Komiteti i Shpëtimit të Atdheut” e kështu tuke kaluar që andej Despoti e pritnë me një batare pushkësh prej të cilave plumbave ra Dhespoti i vrarë!

Kështu i shpagoj një her’ e mirë ajy firaun Dhespot gjithë të zezat që kish vepëruar kundër nesh, që kaqe herë na vuri në rrezik.

Po sa do që unë s’isha në atë kompllot zura e po dëgjonja ankime nga shumë grekomanë qinse thonë edhe për mua e Spiro Kosturin se ishim brenda në kompllotin e asaj vrasje. Një komisjon i veçantë ngrihet e shkon te Valiu i Manastirit e ankohet kundra nesh . Na thirë disa herë në Polici e n’a pyetnë. Situata ime po keqsohej dita-ditën. Nga nëra në druhesha se mos n’a dërgonin lidhur në Manastir. Nga ana tjetër ruhesha edhe nga grekomanët e Korçës se mos çfrynin kundra nesh , tuke i marrë gjakun Dhespotit Foti. Takoj rreziku i math që vajti edhe Spiro Kosturi për punë tregëtije në Selanik e u vra i ngrati prej dorës trathtare të Grekëve po për këtë shkak edhe dita më drekë në mes të Selanikut . Ahere, pra, ç’lipset të bënja unë?

Pash’ andej, pashë këtej, u mendova e prapë u mendova dhe e gjeta të arsyeshme të largohem nga Korça , se mos n’a gjente ndo një e keqe. Për këtë qëllim shkova u këshillova me Perfektin mik, i cili më tha se duhet me doemos të çkëputem krejt nga Korça , e mbassi i thashë se a munt të jem i qetë në Vlorë , dhe Prefekti më siguroj se atje do isha shumë mirë, tuke më dhënë fjalën se për ç’do eventualitet do më lajmëronte systhematikisht me telegraf që të hidhesha përtej në Itali , vendosa më në funt të ikinj me gjithë familjen nga Korça , tuke prishur zyrën e tuke ja mbajtur për në Vlorë.

Në atë javë e sipër shkatrova zyrën avokatore që me aqe mundime e sakrificje e kisha ngrehur. Shita ç’ munda , si edhe mobiljet e shtëpisë , lashë nëpër të afërmit e mij të m’i ruajn ç’kisha velenxe, dyshegje , jorgane etj. etj. edhe me qenë se ndodhej aso kohe në Korçë edhe ime kunatë Marigo Pozio , e cila do nisej për në Vlorë, zume 3 karroca të mira e u nismë të gjithë tok për në Janinë e s’andejmë arthmë në Prevezë. T’em ‘ë dhe Ndinon i futa në vapor dhe shkuan për në Karvasarâ edhe unë me t’ime shoqe e me Marigonë u nismë për në Korfuz edhe s’andejmi me vapor’ e Llojdit vamë në Vlorë.

Në Vlorë, si mbas qellimit që vendosa, dëshironja të çelnja një zyrë avokatore. Po si e pashë që edhe atjé s’ isha në siguri, m’ u mbush mendja të shkonj prapë në Karvasarâ e të mblidhemi gjithë tok si ishim edhé më parë me një ndryshim që këtë radhë n’ a shtohej një njeri tjetër, ime shoqe, e cila për të parën herë vinte në Greqi.

Ish e ditur se sërën që vura në Korçë nuk do t’a kisha kurrë në Greqi, ku mot e për mot kamini i nxehtë i Universitetit flakëronte me qindra avokatësh , të cilët shpërndaheshin nëpër qytetet si karkalecët në për arat. Prandaj kur ardha këtë radhë në Karvasarâ , gjeta 8 avokatë me dipllomë vetëm me një gjykatore paqi që kish Karvasaraja , kur se tjetër herë , 6 vjet më parë kur bënja avokatllëk atje , vetëm unë isha avokat i dipllomuar dhe 3-4 të tjerë ishin vetëm dhikollovë, ose prokuratorë në gjyq¸ose përfaqësuesa në gjyq, si e quan ligja e re e avokatëve në vepërim në Mbretërinë Shqiptare. Punë s’kishte. Prandaj më ishte thyer krejt zelli i profesjonit dhe që ditën e parë që shkela në Karvasarâ u dëshpërova tepër e s’më bënte zembra të nisesha nga puna.

Prindët na pritnë mirë në Karvasarâ dhe shumë njerës , miq e tjerë kishin dalë në mol të kurreshtuar të shëkonin edhe gruan t’ime, edhe mbassi shumë goca karvasarjote ishin të zembruar se s’pranova për grua asnjë prej atyre që n’a u paraqitnë, dëshironin të kisha marrë ndonjë grua të shëmtuar që të kishin ç’të flisnin kundra meje e të më theshin se më zuri gjynahu i atyre po kur panë Uraninë t’ime si një mollë të kuqe, si një trëndafil, kurse ato ishin gjithë çehre vrarë e si të htiqasura qëndruan ahere e u qetësuan edhe e pohuan edhe ato që si Urania s’kish as një grua as një çupë në Karvasarâ. Edhe s’mbet një prej atyre që të mos t’a zinte miqeshë Uraninë.

Desha të hap një zyrë po s’gjenja vent. Dyqanet ishin të okupuar. Ahere mbassi isha tepër i njohtur me atë popull në gji të të cilit jetova 16 vjet e përpjetë, disa miq që dëshironin të bënja avukatllëk dhe që u gëzuan që ardha prapë në Karvasarâ, më rekomanduan me një

avokat tjetër në Karvasarâ një farë Simo Zafiropullos prej Mesollonje, i cili kishte zyrën e vet në pjacën e qytetit dhe i cili edhe vetë dëshironte të bëheshim ortakë, mbassi kish dëgjuar shumë gjërra për mua edhe për punën e pozitën që pata tjetër herë në Kaevasara, e mbassi ajy vetë s'kishte aspak punë.

Kështu ajy më propozoi dhe unë e pranova ortakinë dhe u bëmë ortakë nënë firmën "KR. FLOQI e SIMO ZEFIROPULLI, avokatë".

Ajy ortaku im kishte 3 vjet që exersonte avokatinë në Karvasarâ dhe nuk nxirte as 80 dhrahmi në muaj. Po qysh ditën e parë që shkela këmbën unë atje plakosnë me një herë myshteria aqe sa muajin e parë zumë 600 e sa dhrahmi , të cilat i ndamë në mes dhe Simua mbet tepër i kënaqur e i enthusiasur.

Do ta lë pak këtë pikë që të përshkruanj shkurt gjëndjen e pozitën e t'im eti në të cilën e gjeta kur ardha në Karvasara.

Babaj si u nda prej nesh e mbet vetëm në Karvasarâ, përveç që në shtëpi s'më dërgoj asnjë metelik qysh se e përcolla ahere për në Karvasarâ por kishte rënë edhe krejt jashtë nga puna sepse dy herë që bëri ortakëri me disa njerës, edhe ortakët e tij që të dy herët e kishin nxjerrë edhe borç edhe që të mos turpërohet u shtërngova e i dërgova që të 200 lirat që mora prikë pa e ditur këtë njeri, as gruaja ime ,po mjerisht edhe këto 200 lira s'i kishin mbaruar punë, pse i kish harxhuar që të gjitha edhe e keqja më e madhe ishte futur edhe borç, gjer në qafë, edhe më e madhja nga gjitha të këqijat e tjera kishte shitur edhe shtëpinë që rinim , dyqan' e tij, kafenenë që kishim afër detit , dy apotheka dhe një copë truall tjetër.

Këto nuk m'i kallxoj im'atë kur posa vajta, po i mora vesh më vonë sepse nuk shkuan dy muaj qysh se hapa zyrën kur mora një letër prej blerësit të mylqeve t'ona prej Volosit që quhej Papajanidhi , i cili drejt për drejt më shkruante t'i dërgonja qirat' e dyqanit , shtëpisë, kafenesë e apothekave për një mot-mot të kaluar, se mjaft, thosh, , e priti t'em atë e s'ja dërgoj!

Zot, o Perëndi! Rrufeja të më kishte rënë nuk do më pikëllonte aqe fort se ajo letër! Gjith' ajo pasuni e palujshme që me aqe mundime e sakrificje e krijoi im' atë sot s'ishte e jona, ishte e huaj edhe ne , brenda në mallin t'onë rijnim me qira , si qiradhënës ordinarë! Në qoftë se s'lojta mentsh atë dit, nuk jam për t'u çmëndur kurrë! Edhe gjith' ajo pasuri gjtih' ato prona ishin shitur për 20. 000 dhrahmi, edhe të gjithë këto të holla si dhe të 200 lirat e prikës së gruas ishin bërë rush e kumbulla! Medet, medet ç'na kishte gjetur e s'e dinja!! Si t'ja them grave? Si t'ja kallxonj gruas s'ime së ngratë që e paskesha marrë më qafë?

Po kur vjen katastrofa hapi derën thonë. Bëra durim të math e shtërngova zembrën. Përpara një çkatërrimi të këtillë ç'munt të bënja?

E mora më nj'anë t'em atë e i tregova letrën e Papajanidhit, po atje ku prisnja se do qante me lott për atë që kishte vepëruar e do pendohej tepër , për kundrazi e pashë tepër stoik , tepër apathik, si kur të mos i kish ngjarë gjë! Në vënt të më thotë tjetër gjë, më mban ajy me kurjo e më thotë se , shëndet të kemi se ato prapë t'onat janë , se i shiti me të drejtë t'i blerë prapë brenda 10 vjetëve me atë çmim etj. etj. gjepura, për të cilat më ardhi të pëlcas. Si e bëri këtë gabim im' atë? Si u gënjye kaqe fort? Si s'më pyeti e si më privoj edhe nga shpresa e fundit e 200 lirave të prikës që e dinja se do t'ja gjenj, këto të gjitha më turbulluan e m'a prishnë krejt gjakun! Si të punonja tani? Ç'farë shprese tjetër më mbetej dhe si do bënim më tutje me aqe familje, që edhe Urania ishte me të pjellë e sipër? Në raste të këtilla , në një dëshpërim këso doret njeriu a nuk vret vehten?

Po ç'u bë u bë. Ishte nga më të mbëdhenjtë shuplakë që na jepte fati mbi krye! Durim, pra! Heshta e s'i thashë asgjë kurrkujt.

Si kur të mos më ishin mjaft gjithë këto , na edhe një tjetër që gati më tërboj fare.

Shoku im i poshtri, si e pa se vijnim shumë mirë me punën që kishim edhe i lakmuar tepër, i pabesë e i pashpirt si ishte u mendua se do ishte mirë sikur t 'a mbante ajy zyrën e unë

të heqnja dorë , mbassi zyrën e kish zënë ajy me qira. E tuke qenë se unë s'ja pranova këtë se s'gjenja edhe zyrë tjetër, ajy s'la dinakëri pa përdorur si e e si të më nxirte jashtë.

Më së fundi, si e pa se s'delnja nga zyra , u mendua të më punonjë një pabesi , një tradhëti të pashoqtë. Dhe tuke qenë se kishte dëgjuar se unë isha një propagandist i idhesë Shqiptare edhe një nga shtytësit moralë të vrasjes së Dhespotit të Korçës Fotit, redakton një akuzë të gjattë kundra mejet , ku më pikturoj me mënyrat më të zeza dhe ja dërgoj Prokurorit të Mesollonjës .

Naturisht sa i ra në dorë Prokurorit një akuzë e këtillë kundra një avokati , ajy me një herë më thëret telegrafisht në Mesollonjë ku më ardhi pas edhe ime shoqe, e cila u tremp se mos pësonja gjë.

Në Mesollonjë kisha shumë miq , si dhe deputetë e politikanë të tjerë. Ata kur dëgjuan u habitnë, sepse sapo ju paraqita Prokurorit , ajy jo vetëm që më priti e m'u suall brutalisht si kur të kish përpara një rrugaç e jo një avokat, kolegun e tij , po nuk m'a vonoj edhe kategorinë të cilën m'a hodhi në surat, edhe ç'farë kategori , për tradhti të naltë kundra Atdheut (kujt Atdhe Greqisë, sikur unë të isha grek! Mos më keq o Zot). Do me th. me fjalë të tjera unë akuzohesha , pa asnjë dëshmi , ose argument : a) se tradhtonja interesat greke tuke shkaktuar kryengritje e ndjekje kundra omogjenëve grekë (?) në Shqipëri , b) se meresha vesh me komitetet kryengritës shqiptarë për të çdukur të krishterët grekë (?!) të Korçës të cilët kundrështonin propagandën shqiptare , c) se unë isha njëri prej vepruesve moralë ta vrasjes së dëshmorit kombëtar grek , Dhespotit Fotios etj. etj.

Kuptohet se kësaj kategorije të pathemeltë iu kundërshtova rrebtësisht edhe kërkova prova prej Prokurorit, i cili as ajy s'dinte ku t'a bazonte kategorinë. I dhashë të kuptonjë se këto janë çpifje të poshtra të ndonjë intigranti tuke kujtuar dhe bukuroshin, shokun t'em avokat Simon , pa e ditur se vet ajy e kish përpilluar gjith' atë punë të poshtër dhe i kujtova Prokurorit nenin e posaçëm të Statutit grek që liria personale ësht' e padhunëshme dhe s'ka të drejtë të më burgosi edhe se nuk bëri mirë të më ndalonjë nga puna për të cilën gjë sillte responsabilitet të plottë.

Po Prokurori s'dëgjonte nga këto e më dërgoj te Gjyqtari hetues , ku filloj hetimi që të nesërmet . Sa do që s'kisha frikë se mos pësonja gjë sepse nuk kishte dokumenta as një, prapë se prapë kisha dyshim se mos më këputnin ndo një letër-rreshtimi[1] edhe pastaj vaj halli me mua , isha për të mbytur, se kush e di se kur munt të bëhej gjyqi e kështu isha i batërdisur! Prandaj s'lashë mjete pa vënë në veprim gjer sa mora në dorë letër-lirimin e ju ktheva Prokurorit tuke kërkuar ndjekjen e tij penale që më ngjizi një punë të pa qenë për inate personale, sepse ishte miku i maskarajt ortakut t'em Simos.

Ta lemë këtë pikë këtu , mbassi shpëtova faqe-bardhë dhe nuk u solla më shumë se 10 dit në Mesollonjë e të shohim se ç'ngjiste në Karvasarâ në kohën e absencës s'ime e deri sa u ktheva.

Simua kishte përhapur lajmin se unë u burgosa në Mesollonjë dhe se e kam punën liksht. T'im eti s'i kishin thënë gjë miqtë se mos e hidhronin. Simua tuke justifikuar mungesën t'ime për kundra meje kish hapur fjalë se zyrën ja lashë atij dhe kishte hequr tabellën , tuke e vënë në një cep të zyrës dhe kish zaptuar gjithë librat e mija e dokumentat e tjera , tuke e bërë kështu zot dyqani.

Kur ktheheshim me t'ime shoqe në Karvasarâ takuam jashtë qytetit disa miq, të cilët më lajmëruan hyneret[2] e Simos , tuke më përgëzuar që shpëtova faqe bardhë . Këto fjalë i dëgjova me gjakftohtësi edhe posa që harrimë në shtëpi t'onë, lë gruan time atje edhe vetë lëshohem shpejt nga dyqani të cilin e gjeta mbyllur se ishte ora 9 e natës. Ahere nuk përtova të ble një luqeto[3] (katinë) si atë që kishte zyra , mora edhe një ustâ edhe me pretekstin që

[1] rreshtimi = arresti (H. K.)

[2] hyner = fjalë që nuk e gjeta në fjalor por kuptohet si "mbrapshti" , "punë e keqe"(H. K.)

[3] lucchetto = drz (nga italishtja H. K.)

desha të marr një dokument e s'e gjenja Simon t'i mar çilsin , vura ustanë dhe e çkallmoj bravën e kështu hapa zyrën , hyra brenda, vura tabellën mbi zyrë , siç ishte më parë dhe shkova në shtëpi i qetë mbassi e mbylla zyrën.

Të nesërmen në mëngjes kur vjen Simua të hapë zyrën mua më gjen brenda e i ardhë të pëlcasë nga marasi . Në vënt që të hyjë brenda – se po të hynte brenda e të bëhej sikur s'dinte gjë , ndofta do mos kish ngjarë gjësendi – në vënt të hynte brenda, po thom, ajy ngreh isnafet më këmbë e bërtet se kanë hyrë kusarë në dyqan të tij , se e kanë grabitur etj. etj. sa u mblodhë me qindra njerës përpara dyqanit t'onë.

Më së fundi pruri atje edhe gjykatsin paqtues, drejtorin e Policisë edhe nj'a dy policë e një reshter të Gjindarmërisë. Gjithë bota me gojë hapur shëkonin të kurreshtuar se ç'do të bëhej tani.

Unë, me gjak të ftohtë ju them autoriteteve ose funksionarëve , që pa të drejtë muar mundimin gjer aty¸se fort fort munt të vinte një a dy policë të shihte një flagrant delikt e të raportonin, po jo edhe të mblidheshin për hatër të Simos gjithë autoritetet e vëndit. Pastaj ju tregoj kjartazi si kemi qenë ortakë , gjë që e vërtetonte edhe vetë gjyqtari pajtues, ju tregova librat e dokumentat e mija dhe më në funt tabellën e përbashkët. Të gjitha këto justifikonin hyrjen t'me në zyrën t'onë në kohën e natës, pra unë isha në rregull.

Ahere hyn në mes komandanti i Gjindarmërisë që arriu në atë koh' e sipër si dhe funksionarët e tjerë, që të na pajtojnë, mbassi jemi avokatë. Ju them se ortak me një njeri të keq e të mbrapshtë si ky unë s'munt të bëhem edhe se që atë dit do bënja demarshat e duhura ligjore kundra Simos për çpifjet që më bëri përpara Prokurorit, për difamacjon.

U fut ahere në mes Simua të thotë se këto janë gënjeshtra , janë gjërra fantastike etj. etj. po u ndoth edhe dikush e ja tha në fytyrë që vërtet ajy m'a kish kurdisur atë kategori , që ajy lëvdohej posht' e lart se më vuri haps në prangat etj. e se janë edhe shumë të tjerë si ajy që e dëshmojnë këtë.

Për të mos malcuar puna u ngritnë e iknë s'andejmi gati të gjithë si dhe Simua , përveç disa miqve të mij që ndejnë bashkë me mua.

Të gjithë më dhanë dorën për ç'i punova Simos , i cili sa do që më vuri 4-5 rixhaxhinj që t'a pranoj në zyrë¸unë përkundrazi protestova me anë të Noterisë se po e çart shoqërinë dhe e provokonja të marrë librat e tij që kish në zyrë, tuke më dhënë hesap më përpara. Në atë koh' e sipër kisha trajtuar edhe kontrato me të zotin e dyqanit mbi embër t'im, mbassi ja shtova pak qiranë.

Kështu që ajy faqeziu Simo desh s'desh u shtërngua të më kthejë 278 dhrahmi që më takonin në pjesën t'ime, mori librat e iku. S'i dhashë as dorën kur shkoj.

Të nesërmen i këputa një ankim për difamacjon me prova të plotta. Po, kur thonë, ajy që i bën varrin tjetrit bije vetë brenda. Simua ishte edhe epileptik edhe një dit, tek po shkonte anës detit e atakon epilepsia, rëzohet e çan kryet liksht dhe tuke u përpjekur u gjent në det e u mbyt! Kështu dikur e mer hakun edhe Zoti vetë!

Zyrën vërtet e mbajta vetë e puna vinte mirë e mbanja edhe shtëpinë mirë, mbassi pun' e tim eti ishte gati në çkatërrim e sipër. Po ato gabime që kish bërë babaj s'më delnin nga ment kurrë!

Me të zotin e mylqeve t'ona Papajanidhin, me të vërtet kisha gjetur belanë. S'më linte aspak të qetë. Duhet me doemos t'i paguaja 150 dhrahmi në muaj për qira, përndryshe më menasonte se do n'a nxirte jashtë. Ajy ishte turpi më i math që munt të n'a gjentte. Prandaj u shtëngova t'a mar me të mirë, gjer sa te gjenj kohën të mendohem si lipset të bënj, se jeta për mua katandisi një problemë!

Që t'i tërheq sympathinë e tuke ditur se kishte shumë para për të mbledhur nga shumë korçllinj në Karvasarâ, ju ofrova se…. për hatër të tij, mernja përsipër gratis ç'do dava e marrëdhënie që kish në Karvasarâ dhe munt të më dispozonte si djalën e tij. Kjo e theku në zembër atë gjakpirës dhe e bëri akoma të duket edhe galantom përpara meje. Më shkrojti një

letër ku më lëvdonte shumë për karakter, kalorësi e ku di unë e më dërgoj disa senote e hypotheka t'ju jap funt e të mbleth të hollat. Më dërgoj edhe prokurën përkatëse. Mbi këto bashkë nuk e bënte kabull ky fajdexhi i keq t'i shërbenja gratis, prandaj më shkruante që duhet të mbaja hesap për shpenzimet që do bënja e për të drejtat e mija avokatore, të cilat do zbriteshin nga qiratë.

Kështu e zbuta Papajanidhin e më la të qetë shumë kohë dhe ishte i kënaqur prej mejet.

Në atë koh'e sipër Zoti më fali një djalë. Merret vesh sa gëzim ishte ky për ne në mes të atij hidhërimi. E pagëzoj vetë im'atë e e qojti Jorgaq. Po mjerisht nuk rrojti shumë se një javë, se u lint fort I pakët e I dobët nga trupi.

Mjerisht, qysh ditën që Simua më kategorisi për çështjen e vrasjes së Fotit e propagandat e tjera antihelenike, Qeveria greke më kish kurdoherë nënë vërejtje dhe hafijet s'më ndaheshin.

Unë aso kohe shkruanja edhe artikuj në disa gazeta, nga të cilat paguhesha mirë e kështu i nxirnja 500-600 dhrahmi në muaj, që gjysmat e këtyre më tepronin.

Midis artikujve që kisha shkruar qertonja ashpër një herë edhe Prokurorin e Artës, i cili kishte bërë një skandall të math në atë qytet. Skandalli ishte ky që, një natë i kishte shkuar në shtëpi një gruaje të veh, të bukur, që kish edhe dy çupa të bukura në moshën e martesës dhe mbassi s'ja hapnë derën kishte hyrë me përdhuni nga avllia e i ishte hedhur së vehsë, të cilën kish dashur t'a marrë grua. Ajo edhe çupat e saj çuan më këmbë mëhallën dhe z. Prokuror më s'pa si iku që andej, por se na i mbetnë brenda kapella, bastuni edhe të dy kollaret e duarve, të cilat të nesërmen i paraqiti e vehja në Polici edhe si dëshmi sa duall gjithë mëhalla. E themi, tra parenthesi, se ky bukuroshi Prokurori z. Panteli Psomaqis, Mesollongjit, kishte bërë edhe tjetër herë hynere të këtilla.

Naturisht kjo u bë një skandall i math edhe me gjithë që e mbuloj Prokurori me miq e me të holla, gojët e popullit s'gjenin pushim. Prandaj edhe unë, si korespondent i dy gazetave më të mbëdha të Athinës, ja raportova këto drejtorive relative me gjithë hollësinat.

Mos harrojmë se ky Prokuror ishte edhe mik edhe kushëri me të ndyerin avokat Simo edhe sa herë më shihte në Artë kurrë s'më salutonte po për ato shkaqe të Simos.

Kur pa ky se e exposova keqas e i shkaktova të thritet në Min. Drejtësisë për shpjegime e u bë çështje edhe në Parlamentin grek, lisaksi nga marazi dhe tuke marrë për shkak s'di se ku e gërmoj këtë , se unë kisha nxjerë disa arka me armë e fyshekë për komitat shqiptarë, Çerçis Topullin, Demo Eminin, etj. etj. më kurdis një kategori aqe të madhe, sa edhe unë u habita kur m'u komunikua. Edhe këtë e ndau në dy pjesë I. në difamacjonin që i bëra, e cila do gjykohej në gjykatoren penale të Artës, ku kish juridiksjonin e tij ky bukurosh Prokuror, II. në tradhtin' e naltë që, si nështetas unë grek, i atribuonja shtetit helenik, tue tradhtue interesat e tij për jashta dhe tue prokurue armë e fyshekë propagandistëve andartë Shqiptarë kundra elementit grek (!) Të Epirit e të Maqedhonisë. Këjo e dyta u caktua të gjykohej në Argostol të Qefalinisë, mbassi gjyqi i Kasacjonit të Greqisë e kish caktuar si një gjykatore imparciale. Edhe këjo e dyta ishte mjaft e rëndë po të shprovoheshe, se më dërgonte drejt për drejt në guilotinë.

Akuza e parë mori funt shpejt në Artë me vendimin që dha gjyqtari hetues i atjeshmë që s'ka shkak për akuzën. E dyta kish serënditur akuzuesi Prokuror nj'a 15 a 16 dëshmues, të cilët as që më njihnin mua, kjo u bë në Argostolin e Qefallonisë, ku u shtëngova të vete edhe unë.

Disa kolegë atje, që njiheshim që në Athinë si bashkëstudentë, si Andre Kavalieratis, Anton Momferatos, Spiro Theofilatis e Gjerasimo Pretenderis, posa e muar vesh ardhe në hotel e më panë e u ofruan gratis të më defendojnë përpara gjyqit, ku ardhi e u paraqit edhe vetë akuzuesi jem Prokurori i Artës, dhe ku mori pjesë Prokurori i Gjyqit Apelit të Korfuzit Kost. Kypraios.

Për fat qysh në fillim të kategorisë Prokurori akuzues Psomaqis ne rymë të fjalës u rëmbye shumë kundra meje e zû të më akuzonte ndyrësisht, gjë që tërhoqi vërejtjen e gjyqtarëve, gjersa kryetari i gjyqit i mori fjalën disa herë e e qortoj rëndë. Po këjo ishte në favorin t'em se me një herë u muar vesh që ajy desh të çfrynte kundra meje për inatet që kish e jo se interesohej edhe aqe fort për interesat e Shtetit. Kështu që gjithë sympathit' e gjyqtarëve dhe të të 12 jurive që do më gjykonin u kthyen në anën t'ime, po edhe gjithë dëgjuesit e tjerë dukeshin që e disaprovonin akuzuesin.

Kur më ardhi siraja të flas si i akuzuar e kam mbajtur 4 orë plot gjyqin, ku çvillova çështje me shumë rëndësi dhe përhirova shtetin grek që ka kësij Prokurora bukurosha që shkojnë natën e trokasin dyert e huaja e viollojnë grat' e vehja dhe hodha poshtë ç'do kategori kundra mejet, të cilat nuk bazoheshin në argumenta, pa fshehur edhe se jam Shqiptar prej race, po i cili kurrë s'kam punuar kundra interesave greke, mbassi edhe vetë isha një shtetas grek.

Fjala ime e pashë që i theksoj shumë e ju bëri të madhe përshtypje. Veçanërisht edhe të katër avokatët miq e mbrojtës folnë dy dit me radhë tuke e poshtëruar e tuke e groposur Prokurorin faqe-zi.

Gjyqi mbajti plot 7 dit dhe për ç'do herë grumbullohej aqe kallaballëk i math burrash e grash sa ndërhynte disa herë edhe Policia për të restabilizuar urdhrin.

Më së fundi, brenda një solemniteti tepër serioz, ku ishin ngritur që të gjithë më këmbë, këndohet edhe etymigoria[1], ose përfundimi i enoskëve (jurive), të cilët më nxirnin krejt të pafajshëm.

Një gurgule ahere, një kijamet u bë në sallën e madhe e të bukur e të ndritshme me ilektrika të gjyqit. Shumë zërra u dëgjuan të thonë "poshtë faqezinjtë", "poshtë çpifësit", etj. etj.

Si mbaroj ajo poterë, e si u dha edhe vendimi i gjyqit të synedhëve në favorin t'em, kthehet ahere nga mua kryetari i gjyqit e më thotë në kam të shtonj gjë mbassi do t'a mbyllte seancën se po afrohej edhe mezi i natës.

Ahere mora fjalën edhe simbas nenit 89 të Proc. Penale greke, mbassi dolla i pafajshëm kërkonja prej akuzuesit 2. 000 dhrahmi për hasomerit e mija e shpenzimet e udhëtimit edhe 5. 000 të tjera për ristorasje[2] nderi të fyem.

Sado që akuzuesi kundrështoj sa mundi pretendimete mija. Me gjith'atë gjyqi dënoj të më paguaj vetëm 1. 500 dhrahmi, tuke përjashtuar çështjen e nderit, të cilën s'e pranoj. Kështu kemi ndenjur edhe 3 ditt të tjera në Argostol gjer sa i ardhë paratë Prokurorit e m'u dorëzuan mua. Kështu e pësoj Prokurori Pandeli Psomaqi! Po s'i ishte mjaft edhe këjo, pas 10 ditt që ahere u dekretua edhe pushimi i tij nga puna. Kush e bën e gjen!

Të hollat që mora shkova t'ju a jap avokatëve miq që më duall mprojtës, por asnjë prej syresh nuk deshi të paguhet, mbassi isha koleg i tyre. Kështu dhashë një darkë të mirë, ku thira gjith' avokatët e Qefallonisë, e cila në darkë më kushtoj nj'a 350 dhrahmi, të tjerat para më mbetnë e u nisa me ato në Karvasarâ.

Ndofta do shkonim edhe mirë mbas këtyre evenimenteve, por mjerisht propaganda e mbjellë kundër meje si patriot Shqiptar kish marrë udhë edhe dita – ditën po humbisnja sympathitë e fituara prej aqe kohësh. Autoritetet e vëndit më vëzhgëllonin ç'do hap letrat më censuroheshin në postë edhe shumë herë më mbaheshin atje, gjithashtu librat që më vijnin prej Misirit, Rumanisë dhe Stambollit zunë e po m'i konfiskonin gjer sa më ardhë edhe në zyrë e më bënë anqetë. Do me thënë shpëtova nga anqetat e Turqisë që të bija në duart e Greqisë.

Përpara se të merte funt këjo komiko-tragjedi që kish filluar me këto mënyra, përpara se të mernin funt problema e ndjekjes nga an' e autoriteteve greke për propagandën shqiptare, si

[1] etymigoria = aktgjykim (përkthyer nga greqishtja me google (H. K.)

[2] ristoras = rivendos, vë në vëndin e vet (H. K.)

edhe çështja e Papajanidhit që do merte në dorëzim gjithë pronat t'ona të blera që ja kishte shitur im'atë, një tjetër taksirat i math vjen e më trondit nga themelet, sa ment më lojti menda. Këjo ishte vdekja e papritur e babajt që n'a shkrepi befas!

Tuke qenë mirë edhe në një kohë që unë gjindesha për një davâ në Mesollonjë, një qen sharxhiu, që ishte në mandhrën t'onë na e kafshoj në këmbë. Qeni s'ishte i tërbuar, po duket se e kish dhëmbin e pëgërë. Gjer sa të kthehem në Karvasarâ plaga i kish majisur fort.

Kur ardha e gjeta rënë në shtrat nuk kujtova se një plagë e atillë munt t'i shkaktonte vdekjen. I mora 3-4 doktorë me radhë, doktorë druxhinj, që kish të drejtë Molieri që ju lojti fenë, të cilët në vënt që ta shëronin e bënë më keq, gjer sa më në funt më thonë se tani s'kanë ç'bëjnë, pse filloj plaga të bëhet kangrenë dhe duhet shpejt t'i pritet këmba dhe është nevojë t'a shpije në spitale në Patrë.

Kur ja thom këto t'im eti ajy s'e pranoj aspak. Më mirë më thotë nënë dhé se sa me një këmbë përmbi dhé. S'i të jetë thënë, thotë!

U mundova t'i mbush mëndjen, u mundova t'a shpëtonja edhe un' edhe gratë, s'ish e mundur. Edhe s'ish edhe ndo një gjë e madhe se në 10 orë e sipër do t'a çonja në Patër, ku me një herë do t'i bëhesh operacjoni e do shpëtonte, po s'desh, s'desh. Ishte çudi ky insistiti i tij, të preferonjë të vdesë, se sa të presë këmbën!

Thira telegrafish një specialist chirurg nga Patra, po ajy posa ardhi e e pa tundi kokën e kthehet nga mua e me shenja më jep të kuptonj se s'ka shpëtim. Më mer edhe veçanërisht më nj'anë e më thotë që mos mundohem më t'i mar as doktor, as gjë, po as për operacjon s'është, më thotë sepse gjaku kishte filluar t'i qelbëzonjë dhe, pas mendimit të tij brenda 24 orëve mbaronte jet' e tij.

Këto fjalë më depërtuan eshtrat. Një djersë e ftohtë më përshkoj gjitha trupin. Me një herë më hyri një frik' e madhe në zembër. M'u her mendja. Më vinte sikur po prishej dynjaja! Të humbisnja edhe babanë mbi gjith' ato taksirate që ishte akoma i ri, që e desha aqe fort e që e kisha një ngushëllim! Po nga fati nuk shpëtokërka njeriu!

Doktori chirurg po thua se më caktoj edhe orën se kur munt të vdiste e më porositi me gjakftohtësi t'ja pregatitnja që tani të gjitha të vdekjes, që të mos më vijnin përnjëherësh mbi krye, d. m. th. roba, të ndruara etj. etj.

I mar më nj'anë gratë e jua thom, tuke i mbajtur me gairet. Im 'ë ngriu e zeza se s'e pandehu të ndahej në atë mënyrë prej një burri, me të cilin rrojti plot 37 vjet! Ndinos, s'ime shoqe ju hipi një frikë e madhe e po dridheshin.

Pas një ore si iku doktori I Patrës, edhe sa do që ne e mbanim me kurajo se nuk ka gjë, se do shërohet etj. etj. ajy i mjeri, tuke kuptuar fundin e tij n'a mblodhi të gjithëve me radhë, n'a zuri për qafe e n'a puthi, n'a dha uratat e bekimet çurk dhe qysh atë orë ju mbyll goja dhe filloj agonia e vdekjes, po mëndjen e kishte akoma. Mua më kishte porositur të rëfeheshe burrë dhe të kisha kujdes shtëpinë të mos turpërohet e të dërgonja të mernja edhe t'em vëlla nga Amerika.

Si ju mbyll goja dhe filloj agonia, gratë si pas zakoni dërgojnë e thresin priftin t'a kungonjë. Unë që të mos ju prishnja qefin dërgova e thira. Po kur e pa babaj i mjerë me një herë lojti prej vëndi dhe për çudi i ardhi pak goja, më bën me shenjë të unjem e më thotë me fjalë të mbytura që mezi i kuptonja ç'm'a suallt këtë lugat! Ky do m'i ndjenjë fajet mua? Paguaje dhe rëfeji udhën. Dhe unë me marifet e përcolla priftin që të mos i jepnja të kuptonte se babaj ishte atheist, jo athejist me kuptimin e fjalës, por se s'jepte rëndësi edhe në orën e fundit në të tilla byzantinisma, që ju kish shkuar lezeti!

Ardhi nata. Disa miq u lajmëruan e ardhë në shtëpi që të mos gjëndeshim vetëm. Gratë qanin ca andej, ca këtej. Dërgova shpejt edhe thira edhe të motrën e babajt Zoitsën, që ishte në Mesollonjë, e cila ardhi me një herë. Të gjitha ishin gati dhe po e prisnim me minutën të mbaronte.

Une, si isha i lodhur e pa gjumë u mshteta pak të fle tuke lënë të tjerët t'a ruaja. Ah, kishte ardhur ora e fundit fatale. Rreziku n'a kërcënonte derën. Vdekja kish kondisur në shtëpi t'onë!

Më kishte zënë gjumi mirë, po kur nga mezi i natës vjen e më zgjon ime shoqe. Ç'ësh' i thom, edhe çohem me një herë i andrallosur. Ajo në vënt të më përgjigjet, nxjer shamin' e bardhë e mbush sytë me lott e qan. Hë, i thom, mbaroj? Folë. Ajo më zë me dorën e saj të dredhur e mezi mundi të më thotë "vetë shëndosh".

Oh, s'refehet ajy ças, s'rëfehen ato minuta. Humba baban' e dashur që aqe e adhuronja! Humba kollonën e shtëpisë, atë njeri aqe të mirë e zembërbardhë që i kish shokët e rallë, atë trim e njeri gjakftohtë që s'ju tremp syri kurrë, atë trim me fletë që me aqe nder e respekt e mbanin në për gojë gjithë bota, ata që e njohnë! Unë humbisnja një shok, një ngushëllimtar, një këngëtar, një valletor, një hymorist një njeri të societesë, që s'të linte të sëkëlldisesh kurrë.

Ngrihem e vinj në odën tjetër. Posa kish dhënë shpirt. Im 'ë kur më pa i arth keq për mua edhe zu të më jepte kurajo, ndonse vet' ajo e ndjente ç'do me thënë ndarje prej një shoku, me të cilin rrojti aqe mirë një jetë të tërë.

Nuk rëfehet e keqja e asaj nate!Si u gdhimë një Perëndi e di. Kujtonja gjithë jetën e tij të kaluar, aktivitetin e tij, trimërinë etj. etj. Dhe shëkonja se sa e kottë është kjo botë.

Të nesërmen n'a u mbush shtëpia me njerës që s'kishim ku t'i vemë. U shtërnguam t'i vemë jashtë në obor më të shumit. S'mbet njeri pa i ardhur keq për t'em atë, i cili kishte rojtur 40 e ca vjet në atë vent. Pale kur e muar vesh katundarët kumbarët t'onë e të njohurit e tjerë. Plakosnë me qindra dhe u bë një kallaballëk i math. U mbyllnë gjithë dyqanet e qytetit për shenjë zije, si dhe varrimi i tij u bë shumë solemn, tuke marrë pjesë edhe gjithë autoritetet civile e ushtarake.

Kur u kthyem e kur s'e shihnja në shtëpi isha i pangushëlluar. Më vinte si kur diku do t'a shihnja, diku do t'i dënjonja zërin e tij të ëmbël e të kjartë. Ah sa i mjerë ësht' ajy që ndahet nga një i afërm që e do me gjithë fuqin' e shpirtit! M'u duk si kur u prish bota.

Babaj i gjorë vdiq në muajin e Prillit (26 prill) të vitit 1907 në moshëm e 64 vjetve. Zoti e pastë në gji të tij dhe mir trimiro pastë shpuz' e koskave tija. (nuk e kuptoj domethënien e fjalisë së fundit H. K.)

Dy muaj më von vajta vetë në Athinë e i bleva gjithë rrasat etj. të varrit të tij prej më të bukurit e më të bardhit mermer të botës, prej mermerit të malit "Penteli" që është afër Athinës, i cili mermer kushton mjaft. Kështu i ngreha një mausole në vartoren e Karvasarasë, afër kishës së Sh. Kostandinit, që kushtoj një shumë kolosale, por se varr-mausole si atë s'kishte parë akoma Karvasaraja. Për mbi rasën e gjatë e mbuluese të mermertë gjindet e shkrojtur këjo epigramë

"Vasil Kristo Floqit
lindur në Floq më 1843
vdekur e varrosur më 1907
Të bijt' e tij si shenjë respekti të thellë,
dashurije e mirënjohtje ja kushtojnë"

U varros afër varreve të së mjerës gjyshe, mëmës së tij dhe të djalit t'em Jorgaqit.

Si mblothmë mëndjen e mbetmë vetëm të ndarë nga kryeja e shtëpisë, të cilin as sot që kaluan 22 vjet qysh ahere s'mundem t'a harronj, ju shtrova prapë punës, se tani gjithë barrën e shtëpisë e kisha unë përsipër.

Po nuk shkuan shumë ditt e zunë e po më paraqiteshin disa borxhë të vogla të ndyerit baba, me senate, ose letra të nënëshkruara prej dorës së tij. Këto lipset t'i paguanja, se edhe vet' i ndyeri në ato ditt e fundit më kish përmëndur se ka disa borxhe të vogla e m'u lut të mos ja lë më qafë. Prandaj edhe unë dal nga dalë lava 1. 600 e ca dhrahmi borxhet e tija, megjithë që mundnja edhe të mos i njihnja, mbassi nga babaj nuk trashëgova gjë, përveç se

plaçkave të shtëpisë që edh' ato bashkë i kishim blerë, kurse asnjë pronë, as një pëllëmbë toke nuk trashëgova prej tij. .

Po mirë këtyre borxheve ju gjëndeshe halli dhe i paguanja ca e nga ca tuke bërë ikonomira të mbëdha në shtëpi, po hallit të persekutimit nga an' e Qeverisë, si propagandist Shqiptar, kësaj si t'ja bënja, që dita me ditën po zgjeroheshe e po ma vinte jetën në një pozitë problematike.

Çështja harriu gjer atje sa kur kam shkuar nga muaji i shtatorit të atij viti të paguanj taksin vjetor të exersimit të profesjonit t'em për motin 1907-1908, funksionari kompetent që jepte lejet nuk desh të më njohë për avokat. Në krye s'më çfaqeshe kjartazi, po mbassi shkova 2-3 herë dhe më në funt insistova se s'ësht' e drejtë të më mbanjë ashtu me fjalë pa më kallzuar të vërtetën, funksionari ahere, një njeri mesatar nj'a 50 vjetsh, hithrohet fort e më thotë "s'munt të japin ne njerës propagandistë leje avokatije. Ju turbulloni qetsin' e vendit, tradhtoni interesat e Shtetit dhe çuditemi si ju durojnë akoma e ju mbajnë këtu, kur se jeni parasitë të rrezikshëm"!

Këto fjalë, që m'u hodh' ashtu në fytyrë pa pandehur, më pikëlluan në zemër. E pashë që s'munt të rronja dot në atë vent të urgjër e midis atyre njerësve që jo vetëm haruan që kisha një jetë të tërë atje, po edhe s'më honepsin dot e më urrejnin fort.

I them nëpunësit: More zot, këto fjalë i thua tuke u bazuar në prova, apo nga koka jote, se në qoftë se i çpif do t'i drejtohem Prokurorit dhe do shohç pastaj edhe zotrote si përbuzet aqe lehtë një avokat. Të lutem fjalët q'i the merri prapë.

Në vënt të përgjigjes ngrihet me inat e më rëfen derën: Jashtë që këtej, thotë, jashtë tradhëtor i kombit, nga zyra ime! Edhe mbassi po qëndronja akoma më afrohet të më shtynjë. Të lutem, i thom, mos u sill kaq' i egër se je një funksionar dhe unë si njeriu i ligjeve, dua të t'a respektonj vëndin. Po ajy s'pret. Fillon të më shanjë alla greku, fillon të më shtynjë, gjer sa duallm që të dy jashtë derës afër shkallës. Ja ndalonj duart, po ajy egërsohet më tepër edhe mbassi ment më shtyri të bëhesha copë, s'durova edhe unë ahere, më prishet gjaku e t'a rëmbenj pas xhaqete e si e solla një herë rrotull e përplasa për dhé e i futa nj'a dy shkelmë! U mblodhë të gjithë nëpunësit e asaj zyre, po nuk vuri njeri dorë mbi mua se isha gati të nxjer edhe revolverin e t'i qëllonj. Ata e ngritnë më këmbë Eforin Ekonomik i cili prapë m'u vërsul e më prêt me një grusht në kokë, kështu që i kthehem e i jap nj'a 3-4 pëllëmbë të forta suratit tij, sa i lëshuan sytë shkëndia. Mezi që na kanë ndarë dhe unë zbrita nga shkallët e ika tepër i vrerosur që ardha gjer në atë gradë.

Funksionari i Qeverisë më heq një kategori të fortë përpra gjyqtarit paqtues të Karvasarasë që e shava e e rava mbi detyrat e sipër të tija, po edhe unë dhashë një tjetër kategori kundra atij për sa më punoj dhe si ajy, si unë bazoheshim po në ata dëshmues, që ishin sekretarët e shërbëtorët e zyrës.

Për fat të mirë ndërhynë ca miq si nga an' e tij, si nga ana ime dhe kështu u mbyll këjo punë e s'pësuam gjë as ajy, as unë.

Po ajo ngjarje tingëlloj lark. E mori vesh Mesollonja e mori vesh Qeveria e Athinës. Klubi i avokatëve të Mesollonjës ku isha regjistruar si misavokat më çregjistroj e më lajmëroj për këtë edhe Qeveria porositte autoritetet përkatëse në Karvasarâ të më kenë nënë vërejtje strikte. Opinioni i popullit u egërsua shumë qysh atë dit dhe me hidhërim shëkonja një ftohtësi të madhe nga an' e shumë miqve e të njohurve.

Një dit, tek po pinja një kafe në kafehanen centrale të qytetit u kapmë me fjalë me disa nëpunës zyrtarë e studenta që u ndodhë atje, prapë mbi çështjen e propagandës dhe fjala-fjalës arthmë edhe në duar, se më shanë. Unë rëmbenj një stekë bilardoje e e qëllonj njërin prej atyre, po s'e zura dot se më mbajtnë dorën. Me një herë 2-3 kareklla u çuan përpjetë e m'u trajtuan përsipër dhe pa fjalë që do më kishin goditur keq, po arriu e ndërhyri policia e n'a ndanë, se gati isha të mbronja vehten me armë.

Nuk shkuan shumë ditt, kur se një natë, tek po vinja në shtëpi tuke u kthyer nga pazari, ora 8-9 të natës e mbassi shtëpin' e kishim jashtë qytetit e duhet të ecnja nj'a 3-400 metra nga udha që s'kish as një shtëpi përveç malin nga e djathta dhe detin nga e mëngjra, me një herë tre të panjohur më dalin përpara në mes të terit të natës e të asaj shkretije dhe më qëllojnë me gurrë të mbëdhenj, të cilët për fat të mirë s'më zun' as një se ranë në det. Sa të mar vesh ku jam e sa munt të ishin ata që më kishin zënë në pritë, të tjerë gurrë po më vijnë përsipër dhe s'kisha nga të ruhesha. Dy prej atyre zenë të më afrohen edhe njeri ngreh bastunin të më goditi. Me të shpejtë ahere nxjer revolen t'ime dhe e zbras mbi njërin prej atyre, të cilin më duket se e plagosa diku, po s'u muar vesh se kush ishte ajy, si dhe ata të tjerët, të cilët me të dëgjuar krismën e armës muar të gjithë të përpjetën e më lanë të qetë gjer sa tuke u drojtur arriva në shtëpi dhe as që rëfeva se ç'pësova! Për çudi nuk u ndoth njeri atje pranë dhe as që mundnja të kthehesha prapë në pazar e të lajmëronja Policinë. Ç'ishin ata s'munda t'a mar vesh, po e mora me ment se do ishin prej atyre që u zumë atë dit në kafehanën centrale. Megjith' ate e gëlltita e s'bëra as një vepërim që mos e ntrashnja punën e e koklavitnja më shumë sa ishte.

Po mjerimet e mija nuk pushonin.

Një natë tjetër dy veta të tjerë më vijnë nga pas posa që lashë pazarin e drejtohesha për në shtëpi. Ishte me të ndezur dritrat. Si e pashë që po m'u qepnë nga prapa kthehem e ju them një herë që ç'duan prej mejet, po ata më thonë të shoh punën se s'kishin gjë me mua. Porse, po sa arthmë në atë vent të rrugës që s'kish shtëpi, gati po thua në atë vent ku m'u bë dhe atentati i mëparshëm, me një herë ata të dy bëjnë një yrysh mbi mua e më përfshihnë që së prapi. Vërtitem ahere me sa shpejtësi që munda edhe e përfshiva njërin për xverku gati sa s'e mbyta. Tjetri zu të më goditte me grushta, po si ishte kthyer me kurrizin nga an' e detit, lëshonj këtë të parin e i jap një të shtyrë atij tjetrit sa me një herë e flakëriva e ra në det, dhe si kur të mos dinte not pa fjalë do të ish mbytur. I kthehem pastaj këtij tjetrit e u kapmë fyta fytas gjer sa e rroka për mezit me sa fuqi që kisha e e plasa për dhé. Edhe unë s'di se sa dru hëngri ajy prej meje deri sa kaluan andej disa njerës të tjerë e u shtërngova e lashë e shkova në shtëpi.

Prapë ky jezit pas 3-4 ditsh më gjen në mes të pazarit, më prêt udhën e mbassi më shan e e shanj nxjer revolverin të më bjerë. Po sa pa nxjerë edhe mirë, ja përfshiva me dorën e djathtë, ja përdrodha një herë dorën e ja mora koburen dhe as unë s'mora vesh si e kisha vënë poshtë e i kisha hipur përsipër, tuke i vënë gjurin mbi gjoksin e tij. Lumërisht u mbloth një kallaballëk i math dhe arrinë nj'a dy policë, të cilëvet ju dorëzova revolverin e e muar atë qafir e e çuan në burg. Pas një muaji u bë gjyqi dhe u dënua me 3 muaj burg. Qysh ahere kisha mbetur rehat dhe s'para delnja jashtë, veç se kur vinja në gjykatëra, mbassi edhe zyrën e kisha transferuar në shtëpi. Kisha marrë edhe lejen për me exekutue profesjonin t'em.

Si kaluan disa muaj që mbeta rehat, një natë tek po vinja në shtëpi, pesë-gjashtë hapa para se të afrohem te dera e sokakut, në mes të terësisë dallonj një gjë si hije. Qëndronj në vënt dhe nxjer revolverin e po pres. Me dukej se më kishin zënë pusinë për vrasje përpara derës s'ime. Dëgjonja këmbë; më vinte si kur po fjalosnin me nga dalë. S'humbas kurajon po afrohem gjer sa ardha fare pranë. Ç'të shoh? Një i shkretë gomar, të cilit i kishin lidhur të dy këmbët e përparshime po zariste dal nga dal nga bregu që të delte në rrugë! S'i e pashë se s'është tjetër gjë, afrohem e trokas ne dera dhe dalin gratë me llamba e e shohin gomarin e shkretë që n'a trembi aqe fort. Pas kaqe atentateve duhet edhe të qeshnim pak.

Mbi gjithë hallet diku n'a jepej rasti të bënim edhe nga një mirasi si njerës.

Një dit Janari (1908) tek po shkruanja në zyrë, dëgjonj një behriaj[1] të math dhe dal jashtë. Ç'të shoh? Një gocë e vogël nj'a 10 vjetsh kishte shkarë në det në një thellësi një bojë njeriu. Rotull ishin vetëm disa shoqet e saj të tjera edhe nj'a dy njerës që s'dijnin not. Ishte

[1] Behriâj : kushtrim, allarmë (K. F.)

edhe mjaft ftohtë. U afrova e e pashë se po mbyteshe e shkreta. U mundova t'a arringa me bastunin e t'a tërhiqnja së këtejmi, po ishte mjaft lark e s'e roknja dot. Ahere pashë ç'pashë u hodha në det ashtu siç isha me gjithë roba dhe në dy tri minuta e nxora jashtë të gjallë.

Sado që ndenja rehat nj'a 3-4 muaj prapë filluan ndjekjet, të cilat sa po vijnin po shtoheshin. Nuk di se nga ishin informuar se unë nxirrnja prapë armë jashtë gjë që s'ish e vërtetë dhe se propagandën po e vazhdonja. Kishin marrë vesh, me gjithë që edhe këto ishin gënjeshtra, qinse unë shtynja disa komitete Shqiptare të vrisnin omogjenët të krishterë, ata d. m. th. që ndalonin përhapjen e gjuhës shqipe e të idhesë nazionale Shqiptare etj. etj. gjepura.

Më thiri nj'a dy herë Nënëprefekti i Valltos dhe i thashë mjaft shpjegime, tuke i thënë se këto janë gjithë çpifje të fabrikuara prej armiqve të mij dhe s'kanë as një themel, si kur edhe ç'do çpifje e bigoni[1] që më kishin skarosur gjer ahere, po me gjithë këto e vura re se Nënëprefekti nuk bindeshe. Kështu m'u ngrit krejt rehati sa m'u mërzit edhe puna edhe jeta e s'dinja si të bënja.

Mbi ato e sipër e për të përballuar shpenzimet e rënda familiare që kisha, pata bërë një ortaki thëngjilli me një tregtar Janiniot, që quhej Jorgji Makris e kishim blerë një pyll, tuke vënë nj'a 15-16 mushka me 4-5 konakë. Z. Makris kishte depozituar në shoqëri kapitalin prej dhrahmish 20. 000 dhe unë mundimin si i specializuar që isha prej vjetësh në çështjen e qymyrit.

Kishim 3 muaj që po vazhdonim dhe hë për hë s'kishim gjë të marrim fitime mbassi ishin në harxhe e sipër, po kuptohet se pas 2-3 muajve të tjera do ballansonim harxhet e do zijnim të ndanim fitimet. Qymyri po e shtijenim në apothiqet t'ona, prej të cilave mernja një qira nga shoqëria prej 80 dhrahmish, që gjysmat e këtyre më mbeteshin mua fitim.

Po kur nuk ec fati mundohu sa të duash: Mynefikët e armiqt' e tjerë deshin si e si të më çpornin qafet e t'ju mbetej atyre puna e gjithë ç'kisha të mijat. U mundova ta ndaloj çkatrimin që po më pregatitej po s'ishte e mundur. Ardhi dita që zunë e më shihnin të gjithë me sy të keq. Disa miq më këshillonin të iknja sa më shpejt që të shpëtonja nga ndo një rrezik më i math, po edhe unë s'dinja se ku lipset të shkonja. E kisha humour krejt si Xhaferi simitet.

Në atë dëshpërim e sipër dërgova të thres t'em vëlla Thanasin nga Amerika, i cili kish tani 3 vjet që s'bënte asnjë pun' atje dhe s'kish edhe mallin që të ktheheshe e po më shkruante edhe vetë që t'a tërheq një or' e më parë se do mbeteshe keq rrugëve.

Kisha s'kisha i dërgova edhe t'im vëllaj navlonin nj'a 500 dhrahmi dhe u nis e ardhi gjer në Pire ku i sosnë të hollat e mori edhe 100 dhrahmi më tepër nga një miku im në Pire, të cilat do e mos duhet t'i paguanja unë, si kundrë që i pagova. Njeri s'mendonte se ç'vuanja. S'isha as për në qiell, as për në dhe ashtu si ardhë punët. Po kujt t'ja rëfenja hallin? Ku të përpiqnja kokën? Kisha hall të math. Po mbi ato desha të ndodhej im vëlla në Karvasarâ për ç'do eventualitet, jo se do më mbante shtëpinë, po se do t'a linja me gratë gjer sa të zinja ndo një shtek tjetër e të fillonja ndo një punë.

Më së fundi ardhi edhe im vëlla e e katehisova[2] për të gjithë sa më ngjanë e po më ngjisnin edhe e msova si të sillet në qoftë se mua më gjente ndo një e keqe, ose iknja prej Karvasaraje natën, mbassi ashtu dukej puna.

Jemi në muajin e shtatorit 1908.

Një dit shoh prej penxheres së shtëpisë se po vijnin nga neve, komandanti i gjindarmërisë, drejtori i policisë, një nëpunës tjetër i Bashkisë dhe disa gjindarmë e policë. Pa më lajmëruar njeri e kuptova se ata pa fjalë vijnin për mua. Me vrap dal nga dera tjetër e shtëpisë dhe vete te konsulli i Turqisë në Karvasarâ Agoγ Similian efendiu, se konsullata e Turqisë ishte 10-15 hapa lark shtëpisë s'onë. U futa atje me të shpejtë e ju luta konsullit të më dalë zot në qoftë se më kërkojnë autoritetet lokale dhe unë s'dua kurrsesi t'ju dorëzohem. Ajy e dinte se jam edhe shtetas ottoman e më siguroj se nuk do pësonj gjë, si do që të jetë puna.

[1] bigoni = çpifje (H. K.)

[2] katehisoj = fjalë që nuk e gjeta në fjalor, por duhet të jetë "i tregova, dhe u bë pjesë" (H. K.)

Me të vërtet gjith' ajo kustodhi vinte në shtëpi t'ime për mua edhe si s'më gjeti e mori vesh që jam në konsullatë, komandanti vetë dërgoj një gjindarm në konsullatë e më kërkonte të paraqitesha për disa pyetje. S'ka fjalë që un' e kuptova gjithë punën e i thashë gjindarmit se jam nështetas ottoman, prandaj s'munt t'ju dorëzohem grekëve. Konsulli gjithashtu më përkrahu dhe kështu ata funksionarë u shtërnguan të kthehen nga ardhë pa bërë gjë, veç se më muar disa libra shqipe e letra të tjera që gjetnë në zyrën t'ime.

Qysh atë dit vendosa të ikinj, po s'kisha dhe të holla përveç se 700 dhrami para të thata. Thira në Konsullatë mikun ortak Jorgji Makrinë dhe i dhashë shkresë që heq dorë nga shoqëria që kishim me kushtin që do më jepte 3. 000 dhrahmi dhe ja falnja të gjitha fitimet e tjera. Atij i dha dorë këjo dhe nxori e më dha 3. 000 dhrashmitë. Nxora edhe passaportën për në Vlorë që të shkonja me gjithë gruan t'ime dhe isha gati, veç se prisnja rastin si të iknja e mos mersha vesh.

Në hikjen t'ime prej Karvasaraje më ndihmoji shumë dhe Gjyqtari pajtues i qytetit dhe shkaku ishte se desh të më shpërblenjë një të mirë që i kisha bërë një muaj më përpara, dhe istoria ishte këjo:

Ditën e 15 Gushtit 1908 bënte një vap' e madhe edhe siç ish edhe dita e Shën-Marisë isha veshë me një palë roba të reja dhe kisha dalë natën afër bryllit central të molit të Karvasarasë, tuke zënë vënt pranë një bankoje në buzë të detit. Ishte ora 8 a 9 e natës. Një anije e madhe ishte lidhur pas një hekuri të molit dhe komunikonte equipazhi i saj me tokën me anë të një drase, që shërbente si urë midis anijes (karavit) dhe molit. Disa kalamaj po losnin tuke u hedhur mbi atë drasën, ndonse ish frikë se mos shkiste drasa edhe gjëndeshin të gjithë në det.

Midis kalamajve ishte edhe i biri i Gjyqtarit pajtues të Karvasarasë, një djalë 8-9 vjetsh që quhej Jorgo dhe ish i vetëm djalë i tij. Dhe sa do që ju bërtita disa herë kalamajve që të mos lozin në atë mënyrë se do bijnin të gjithë në det, ata përkundrazi vazhdonin në lodrën e tyre. Ishin nj'a 5 a 6 kalamaj. Hipnin në drasë e kërcenin përpjetë edhe herë hidheshin brenda në anijen, herë kapërxenin nga an' e tokës, gjer sa një herë anohet drasa edhe njëri prej atyre kalamajve që u ndoth në mes të pondit "bëlldum" ra në det! Ajy për fat të keq ishte djali i vetëm i Gjyqtarit pajtues.

Unë, si thashë, kisha veshur një palë roba të reja atë ditë edhe s'para më bënte zembra të hidhesha në det. Po mbassi pashë që u mblothnë 20 e ca shpirt dhe asnjë s'mori mundimin të hidhej në det të shpëtonte atë djalë të mjerë, çohem ashtu si isha e u hodha me gjithë robat e mira në det dhe e nxora djalin. E shpëtova.

Si ja dorëzova disa njerësve dhe mbassi më vinte turp të shkonja në mes të pazarit i lagur ashtu si isha, sa mezi që ecnja, preferova të hidhem prapë në det e të dal më një mol privat, ku që atje ja mbajti fill e në shtëpi, mbassi s'kish njeri rrugës. Kisha humbur kapellën, bastunin edhe sahatin t'em n'ujë.

Të nesërmen Gjyqtari pajtues Z. Çoni, bashkë me të shoqen e tij e djalin që ju shpëtova ardhë në shtëpi e ju ishin falur nderit grave që kisha, se unë isha në Konsullatën e Turqisë. I kishin thënë s'ime shoqeje se nuk shpërbleheshin kurrë për këtë të mirë që ju bëra dhe ju luteshin që t'ju caktonja me shkresë sa gjërra humba në det për këtë rënje që të m'i paguanin, si edhe robat e reja që m'u prishnë nga deti. Ime 'ë e ime shoqe nuk pranuan gjë nga këto. Të nesërmen ardhi vetë gjyqtari në zyrën t'ime e m'u fal nderit veçanërisht për atë të mirë, tuke më thënë se djali i tij është djali im tani, se unë isha babaj i tij spiritual.

Tani pra, pas 40 dittsh po thua, vinte koha që të ma shpërblente edh' ajy të mirën. Pra, dy dit më von mbassi ngjau episodi i Konsullatës së Turqisë, si e tregova më sipër, z. Gjyqtar pajtues ardhi një natë në shtëpi t'ime e fshehtazi hyri në odën t'ime e më thotë konfidentisht se të nesërmet do më zijnin pa fjalë policia, ose Gjindarmeria dhe do më dërgonin lidhur në Mesollonjë në burg edhe se sido që të bënja, sido që të ruhesha ata prapë do m'a gjenin volinë e do më mernin pa tjetër edhe më këshilloj se duhet të ikinj shpejt se po të jem gati mundet

me rrezikun e tij të më sjellë një barkë afër molit të shtëpisë s'onë dhe gjysmë ore para mezit natës kur të mos dëgjohet zë njeriu duhet të gjëndesha në vaporin e Janullatos "Pyllaron" i cili nisej në mes të natës për në Prevezë. Më pyeti pastaj në kam nevojë për të holla e i thashë se kam, po me gjith'ato nxori e më dha 500 dhrahmi që kish përsipër, të cilat sado që s'desha, m'u lut t'i mar si një dhuratë.

Si mbetmë d'akord, ajy më uroj udhën e mbarë dhe unë nga ana tjetër pregatita shpejt valixat dhe në orën 11 isha gati. Ardhi barka tinazi në molin e kafehanës s'onë dhe tuke u përcjellë prej s'im 'ëje, teto Ndinos e t'im vëllaj shkuam me t'ime shoqe në vapor e hipmë sipër pa u marrë vesh prej as njeriut. E pagova mire barkën dhe u larguan edhe lundrarët dhe pas një çerek ore nisë edhe vapori dhe kështu ikmë nga Karvasaraj e urgjisur, ku ment lashë lëkurën në burg, se e dinja se ç'më priste nga Grekët edhe ku s'shkela më qysh ahere!

M'u duk sikur u librova. Sikur vesha një këmishë të larë. I harova të gjitha të këqijat, veç se më vinte keq për ata që lashë prapa, por se e kisha porositur t'em vëlla që me rastin e parë të shishte ç'kishin e ç'nuk kishin atje e të merte gratë e të vinte edhe ajy në Vlorë, ku po vinim edhe ne! Me gjith'ato ju lashë edhe mjaft të holla të kenë.

Të nesërmen në pikë të mëngjesit duallmë në Prevezë. Atje na u poqnë shumë miq dhe ndejmë gjer në drekë. Po autoritetet e Karvasarasë, kur muar vesh të nesërmen si ju ika nga duart, kishin telegrafisur te Konsulli grek i Prevezës se mos më shtinin me marifet në dorë.

Ç'na ngjau pra, në Prevezë? Një kavas[1] i Konsullatës, djalë prej Karvasaraje që më njihte mirë, mveshur teptil me roba civile, më kërkon andej këtej e më gjen futur në një farmaci, ku bisedonja me disa miq Shqiptarë muhamedanë. Ajy hyn brenda e më përshëndosh, si edhe unë atë e më propozon të më gostitë një bakllava jashtë. Unë tuke e patur të njohur, pa ditur se është jasakçi i Konsullatës e padyshuar gjë prej atij, gati isha të mernja leje nga miqtë e të vijnim ku desh ajy. Po miku im patriot, ndjesë pastë Sheh Sabriu që u ndoth atje me ne, u ngrit me një herë më këmbë e i thotë se më kanë ata mysafir e nuk më lenë të vete me tjetër kent. Po kavasi grek po insistente të më marrë më parë miqësisht e me të butë, pastaj edhe me të egër e me istek[2]. Këjo më vuri në dyshim, të cilin dyshim prapë m'a skjaroj Sheh Sabriu. Ajy më flet mos gënjehem të dal me të se do më zerë e do më dorëzonjë në Konsullatë, ku q'andej do më dërgonin lidhur në Karvasarâ. M'i tha këto me një mënyrë që s'e kuptoj karvasi grek. Dhe si s'desha të vinja me atë, ajy më heq ahere me pahir që të më nxjerë jashtë, kështu që ja mora vesh gjithë qëllimin e tij. Ahere ajy tuke u largur bëri budallinë të më trembë se nuk kisha për t'i shpëtuar nga duart unë traditori, un' i tillë e i atillë, dhe e këputi qafën.

Si hëngrëm drekë u nismë për në vapor "Galatea" të Llojdit, i cili qëndronte lark limanit të Prevezës dhe i cili do shkonte pas një oret.

Në barkën ku hymë unë dhe ime shoqe na ardhë prapë përsipër ajy kavasi bashkë me dy grekë të tjerë e n'a u afruan kur po hynim në barkë. Po bashkë me pasaxherët e tjerë u ndoth në barkë edhe një kolonel turk, Hassan bej Çapari nga Margliçi i Çamërisë, deputet i Turqisë po Shqiptar i flaktë, të cilit posa që ju çfaqa pse kanë ardhur ata tre grekë atje, del nga barka e ju sillet atyre tuke i sharrë qënçe e tuke i sikterdisur gjer sa u largua lundra nga limani i Prevezës e na çoj në vapor.

Si kur s'më ishte mjaft këjo, kur arrijmë në Korfus lë t'ime shoqe në vapor e dal në Korfus të ble njërën e tjetrën e të thyenj edhe dhrahmitë t'i bënj napolona e mexhite turke. Kurrë s'më shkoj ndër ment që edhe atje do isha i tradhtuar.

Posa shkela jashtë edhe shkova pranë një sarafi të shkëmbenja të hollat, një polic më afrohet dhe po më vëzhgëllon mirë. Ky polic, si kur të më kapte që atë ças më delte zahmeti. Po ajy më la e theva mirë e bukur të hollat pastaj zë të më afrohet. Mua më ngriu gjaku. E pashë se rashë si capi ne kasapi, po ç'të bënja. Polici budallaj më pyet nga jam, e unë i thashë

[1] kavas = roje, ose punonjës (H. K.)

[2] istek = kërkesë, d. m. th. që është i kërkuar (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

se jam Lefkadhit. Nuk më ndaloj po më la të shkonj. Si e pashë që po më vinte nga dalë pas nuk u nguta gjer sa ardhë afër molit ku ishin barkat. Si hipa shpejt në të parën barkë që gjeta, ze më pyet prapë si m'a thonë embrin. I them një embër tjetër edhe prapë s'i tërhoqa vërejtjen. Po mbassi u larguam ndo 100 hapa nga skela ahere vërenj se edhe dy policë të tjerë ardhë në mol e u bashkuan me të parin dhe po i thresin barkaxhiut t'em të kthehet prapë. Barkaxhiu, një hor-hori s'merte vesh pse e thrisnin së jashtmi. Kujtoj se mos ishin gjësendi pasaxherë, po unë e binda të më çojë mua më parë në vapor.

Si hipa në vapor e mora vesh nga disa pasaxherë të tjerë që i kishin ndaluar në Korfus e mezi i lanë të ikin se mua me të vërtet më kërkonte policia e Korfuzit e cila ish lajmëruar gjithashtu prej Karvasaraje për çështjen t'ime. Kështu për fill do t'ju kisha rënë prapë në dorë grekëve, po më shpëtoj fati.

Të nesërmet që me natë ishim në Vlorë, ku n'a pritnë mirë baxhanaku im Jovan Posio dhe e motr' e gruas t'ime, e shoq' e tij Marigoja. Kisha shpëtuar nga taksiratet si do kudo edhe kisha këtu një shpresë se do bënja pak punë se dinja edhe turqishten e me këtë bashkë ishte proklamuar hyrijeti (liria turke) me anë të çpalljes së konstitucjonit ottoman.

Pas 3 ditsh si vamë në Vlorë fillova nga puna dhe sidomos kisha shpresë se do vinja mirë, tuke qenë i sigurt se nuk do më bëheshe ndonjë ndjekje nga an' e autoriteteve lokale, mbassi ato të parat ishin falur dhe gjithë sa Shqiptarë ishin burgosur për faje politike në burgjet e ndryshme të Shqipërisë ishin lëshuar.

Po nga ana tjetër kisha merak edhe të grave e të t'em vëllaj që i lashë në Karvasarâ dhe duhej të përkujdesesha edhe për ata.

Im vëlla nuk mbushi as javën si ika unë me Uraninë, si e pa si i ranë më qafë shumë grekët për shkakun t'em e si ishte edhe vetë nacjonalist, pat shumë frikë. Prandaj filloj e shiti plaçkat e mobilet e shtëpisë si mundi e sa mundi dhe tuke ditur se as shtëpia që rijnim, as dyqani e pronat e tjera s'ishin t'onat, një dit të bukur më ngrihet s'andejmi me gjithë gratë e më ardhi në Vlorë, ku u shtërngova të zë një shtëpi të mirë dhe u sheshtuam të gjithë.

Po edhe në Vlorë s'ishte kësmet të qëndronim. Duket se kështu ish i shkruar fati jonë të mos zemë vent gjëkundi më keq se ciganët nomadhë!

## XIII

Konstitucjoni I famshëm i Turqisë, që e provokoj e e realizoj komiteti "Stihad ve Terekin (bashkim e përparim) nuk mbajti shumë kohë.

Gjith' ajo vëllazëri e përzembërt, ato të shtërnguara e të puthura me njëri-tjetrin si priftërit me hoxhët dhe sunijtë e bektashinjtë me gjithë popullin tjetër eterogjen n'a duall krimçka. Xhon Turqit nuk n'a shihnin me sy të mirë ne Shqiptarëve, prandaj posa që filloj prapë çështja jonë dhe vepërimi i lirë i gjuhës shqipe e i shkollave ata me një herë u çfaqnë kundrështarë dhe pastaj armiq.

Xhon Turqit po n'a këshillonin ta shkruajm gjuhën t'onë me shkronja arabike dhe n'a dërguan një farë Arif Hiqmeti nga Dibra, Shqiptar ky propagandist i Xhon-Turqëve që të na bindë. Po Shqiptarët i vunë drunë kudo që shkeli dhe ju deklaruan Xhon –Turqve me anë të klubit të Selanikut se ata s'heqin dorë nga ideali i tyre.

Lufta ahere u hap sheshazi. Xhon-Turqit n'a kundrështonin kjartazi në ç'do vepërimin t'onë dhe si panë një rezistencë nga ana e jonë edhe si kishin edhe fuqinë në dorë zunë e po i burgosnin Shqiptarët e po i mundonin me ç'do farë mënyre.

Atë kohë n'a ardhi në Vlorë Dervish Hima prej Ohrije, patriot nacjonalist i njojtur dhe mbassi e muarm në klubin t'onë politik, ku unë isha anëtar, u këshillova me atë si lipset të sillemi. Ajy n'a tha se duhet të qëndrojmë si burrat dhe të pregatitemi për një kryengritje të afërme e të përgjithëshme.

Ne në Vlorë ishim organizuar mjaft mirë. Kishim edhe disa oficerë e nëpunës civilë të Qeverisë Ottomane, të cilët, si Shqiptarë, ishin me ne dhe n'a ndihmonin tërthorazi sa mundnin.

Me qenë se në Parlamentin Ottoman në Stamboll dy deputetë Shqiptarë Ismail Qemali i Vlorës dhe Mufit bé Libohova i Gjinokastrës, përkrahnë çështjen shqiptare në Parlament, njëri tuke u rahur prej një deputeti turk brenda në Parlament edhe tjetri Mufidi, tuke kundrështuar me fjalët e paharruara "var, efendëm, var" = ka, zotni, ka në përgjigjen e fjalëve "s'ka shqipëtarë" që një tjetër deputet adresoj në atë Parlament, për këto ngjarje faza shqiptare mori një karakter të rezikshëm për Perandorinë Ottomane dhe Xhon-Turqit s'lijnin rast pa përdorur kundra nevej, si e si të n'a shduknin krejt idhealin t'onë edhe në më keq se Tiranët e parë të Turqisë.

Unë, si përzjehesha energjikisht në klubin t'onë e me marëveshjet me klubet e tjera të Shqipërisë kudo që ishin edhe më von me konferencat që mbanja e me fjalimet e tjera, ju hyra ale në sy Xhon-Turqve, të cilët kërkonin të gjenin rast të më burgosnin e të më çonin në burgjet e ritta të Janinës.

Me qenë se Ismail Qemali u nda nga partia e Xhon-Turqve dhe vendosi të bashkëpunonjë me ne atdhetarët nacjonalistë, ardhi në Vlorë, ku e pritmë me një enthusiasmë të madhe aqe sa edhe araban' e tij që në skelë e gjer në shtëpi në Vlorë ja hoqnë njerës vlonjakë në vënt të kuajve.

Pra, me Ismail Qemalin ishim marrë vesh mirë si lipset të punonim edhe kështu organizuam një komitet në Vlorë, i cili u përhap në gjithë Shqipërinë dhe disa çeta shqiptarësh me Çerçis Topullin, Themistokli Gërmenjin, Mihal Gramenon, Namik Delvinën, Demo Eminin etj. etj. filluan të përhapen ndër malet e Shqipërisë, të cilët ishin tmeri i Xhon-Turqve.

Në Korçë, kryetari i Xhonërve kapitan Rexhep Palla zu po i mundonte shumë nacjonalistët Shqiptarë, tuke ju mbyllur shkollat, tuke sikvestruar gazetat shqip që delnin aso-kohe në Korçë dhe tuke burgosur mjaft macionalistë. Po një dit ramazani e gjeti edhe ky atë që kërkonte.

Një nacjonalist shqiptar Vasil Tromara nga Dardha bashkë me një shok tjetër e me përkrahjen e Themistokli Gërmenjit, që fshehtazi dhe natën kishte hyrë me çetën e tij në Korçë, ky Vasil Tromara, po thom, i vajti përpara në një kafene ku po loste me disa oficerë të tjerë dhe e qëllon 2-3 herë me revolverin e tij e e le në vent të vdekur, tuke shkuar lirisht në mes të atij kallaballëku e tuke u bashkue me çetën tjetër të Themistokliut pa psuar gjë.

Vrasja e Rexhep Pallës bëri një përshtypje të fortë edhe Xhon-Turqit u trempnë mjaft se e panë se Shqiptarët s'kishin vdekur akoma.

Zunë, pra, e na mernin me të mirë, po prapë intrigat nuk i lijnin. Gjithnjë mundoheshin të n'a shduknin.

Valiu i Manastirit bëri kijametin e math për Rexhep Pallën, po ja mbushi mëndjen një prej inisjatorëve të revolucjonit Xhon-turk, Shqiptari Njazi bej Struga, që s'duhet të n'a bjerë më qafë nevej Shqiptarëve e kështu çburgosi shumë nacjonalistë e la të lirë të tjerët.

Të lemë Korçën. Këtej në Vlorë ne, mbassi përcuallm Ismail Qemalin, i cili shkoj në Selanik të vinte në një marveshje me Xhon-Turqit që kishin qëndrën e tyre në Selanik e të n'a lijnin të qetë, filluan të zhvillojmë një aktivitet të jashtazakonshme, dhe për disa muaj n'a lanë rehat.

Po një dit marim një telegraf shifrë në klub prej Ismail Qemalit, i cili e shihte vehten në rrezik atje dhe mendonte të delte jashtë Turqisë për me punue më mirë me Shqiptarët e tjerë jashtë Shqipërisë.

Xhon-Turqit e Vlorës, posa që e muar vesh këtë zunë e n'a i mbanin telegrafet që n'a vijnin prej Ismail Qemalit, gjë që n'a vuri në dyshim të math. Kërkuam shpjegime nga zyra post telegrafie, po edh'ata, sado Shqiptarë, kishin frikë të çfaqeshin zyrtarisht me anën t'onë.

Ahere mblidhemi në klubin t'onë, bisedojmë e vendosim t'a okupojmë ne zyrën telegrafie të Vlorës që të merreshim vesh mirë me Ismail Qemalin. Këtë edhe bëmë!

Çohemi en grup 50 e ca shpirt, marrim edhe disa të armatosur e vemë në telegraphonë, të cilën e okupojmë edhe nëpunësit e saj i vëmë nënë dispozicjonin t'onë, kështu që kishim korespondencë të lirë me Ismail benë, pa marrë vesh Selaniku se zyra telegrafie e Vlorës ishte në dispozicjonin t'onë. Nga ana tjetër lajmuam edhe qarqet e Vlorës, edhe të nesërmen më shumë se 500 shpirt burra të armatosur kishin ardhur në Vlorë.

Xhon-Turqit kur i panë këto u ngurosnë. Ju hyri frik'e madhe. N'a dërgojnë nj'a dy oficerë në telegraphane, ku isha edhe vetë një person aktif e kërkonin të hiqnin nja 5-6 telegrafe shifra për klubin e Selanikut, për Stamboll e për Janinë. Ne s'ja u pranuam pa na i deshifruar. Fjala fjalën u zumë. Njëri prej atyre oficerëve i futi një pëllëmbë një telegrafisti shqiptar që s'desh t'i pranonte telegrafet pa lejen t'onë. Ahere, oh, ahere t'a kemi zënë atë oficerin për këmb' e për koke e t'a kemi flakur jashtë që nga ballkoni e u gjent në rrugë, i dërmuar e i coptuar. Tjetri oficer, me që kuxoj e çveshi pallën të n'a qëllonte, i jemi hedhur të gjithë përsipër e ka ngrënë kaqe grushte kurrizit sa s'munt t'i hante në gjithë jetën e tija. Më së fundi e hothmë edhe nga shkallët e përposh.

Këto kur u dëgjuan jashtë egërsuan shumë oficerët turq të Stapës së Vlorës. Tré oficerë, një bimbash dhe dy kapitenë sulen në depon' e armëve e të municjoneve për të marrë armë e për të armatosur gjith' oficerët që të na bijnin nevej. Po në depo ishte rojtar një farë Nexhipi, ushtar prej Borshit, nacjonalist edhe ky, i cili ju kundrështoj këtyre e s'i la të hapnin magazinën e deposë. Njëri prej kapitenëve nxjerr revolverin t'a friksonjë rojtarin nacjonalist, po edhe ky s'ja vonoj, i kthen martinën e t'a pret në ballë, tuke i derdhur trutë e tuke e shtrirë te vdekur. Oficeri tjetër, i cili e qëlloj n'atë ças Nexhipin me revolver 2 herë po nuk e zuri, pret një tjetër plumb nga Nexhipi trim dhe u plagos rëndë. Një tjetër plump i dytë i thyen krahun e djathtë. Majori që mbet ja u dha këmbëve sa mundi, tuke hipur mbi një avulli të shtëpisë Hasan Sharrës e ashtu mezi shpëtoj. Oficeri i plagosur vdiq të nesërmen.

Kështu vajti filli i asaj ditte. Gjithë oficerët turq u ndrynë në kazermën e s'kuxonin të delnin jashtë. Vlora ishte në duart t'ona

Po nuk shkoj një javë e n'a msynë nga an' e Beratit dy bataljonë. Lumënisht komandanti i këtyre u ndoth Shqiptar prej Çamërije dhe jo vetëm s'n'a ra më qafë, po edhé n'a dha kohë me marifet të largoheshim nga Vlora, para se të ngrihej atje gjyqi ushtarijak, i cili do n'a shkonte në litar të gjithëve.

Unë si e pashë se edhe në Vlorë ra erë barut e nuk munt të qëndronja më, vendosmë familisht të largohemi jashtë Shqipërisë. Po ku të vemi tani i dbuar si nga Turqia, si nga Greqia? Vendosmë pra familisht që të shkonj për në Amerikë, ku (në Shtetet e Bashkuara) kisha edhe dy kunetët e mij, të vëllezërit e gruas, Kristo dhe Niko Poçin, të cilët prej vjetësh ishin atje!

Ime kunatë Marigoja kish dashur prej kohësh të dërgonte djalin e saj të vetëm Vason të studijonte jashtë Shqipërisë. Djali ish ahere 10 vjetsh. Edhe me qenë se e gjetmë më mirë t'a dërgonin në Amerikë ne t'ungjit e tij, më angazhuan t'a shpije unë, edhe kështu u nisa bashkë me atë. Me gjithë që më vinte zjar se do largohesha prej Shqipërisë aqe lark, tuke lënë gjithë të dashurit e mij në Vlorë, po mbassi u pa edhe pun' e Vlorës, si ajo e Karvasarasë që s'kishte prokopi, me do e mos duhej t'i bënja derman kokës.

Kështu u nismë një të Dielë mbrëma me "Galipolin" e Puglias dhe të nesërmet në mengjes ishim në Brindisi të Italisë me gjithë Vason e Marigosë, dhe pas dreke shkuam për në Napoli ku arrimë më 8 të natës. Nxuarmë atje edhe biletat e risemi me vaporin suratlantik të shoqërisë inglese "White Star Line", që quhej "Canopic".

Të nesërmet mbas dite ishim në Palermo, edhe pas 5 orësh niseshim direkt për në Spanjë. Pas një lundrimi të bukur tre dittsh e netsh u duknë malet e nalta e të thata të Spanjës, kur se

nga ana tjetër e Mediterranesë lulëzonte e bleronte Marokua e Afrikës me zallet e tij të kandëshme e gjelbërorë, një ndryshim midis Spanjës e Marokut si nata me ditën.

Qyteti i parë që takuam piksëpari në Spanjë ishte "Almeria", një qytet i vogël e jo aqe i hijeshim. Pas disa orësh arrimë qytetin Malaga, qyteti si do kudo i mirë, ku ndejmë nj'a 3-4 orë. S'anejmi prapë vijmë në ngushticën e Gibilteres (Xhebel-ul-Tarik) dhe pas 3 orësh lijnim Spanjën tuke shkuar të ngushtat e Gibilteres që bashkojnë Mediteranenë me Oqeanin Atllantik.

Shkuam një udhëtim shumë të bukur e të lezetshim, kishim një shoqëri mjaft të mirë dhe deti, Oqeanin e kishim shumë të qetë.

Pas 4 dittsh si ikmë nga Spanja arrimë në ishulliat midisatllantikë që quhen "Azores" e që janë vëndi integral i Rep. Portugalisë. Aty mbassi do rijnim 5-6 orë duallm të gjithë pasaxherët jashtë në qytetin San Miguello si edhe në qytetin tjetër Ponta nel Gada.

Nuk munt t'a rëfenj dot bukurinë e këtyre isullavet, që për çudi gjinden midis Oqeanit Atllantik. M'u duknë si një parajsë e dytë. Një bukurim nature extraordinare, një blerim gjithkunt, kopshte të pa sosura e parqe, gjelbërim kudo, shtëpi pastaj e ndërtesa e katedrale të bukura dhe njerës të butë e të qetë. Kaqe përshtypje të bukur më kanë lënë ato ishulla sa kurrë s'më hiqen nga mendja.

Si i lamë Azoret atë natë pësova një taksirat që edhe sot kur e kujtonj më ngjethen mishrat.

Ishte ora 8 a 9 e natës, një natë e terët po e qetë. Mbassi hëngrëm darkë mora Vason e vogël dhe ndejmë aty në buzë të vaporit të math transatllantik, dhe bisedonim bashkë tuke marrë herën e detit. Si ndejmë ashtu ndonjë orë edhe tuke parë se s'kam cigare i thashë Vasos të qëndronjë pak atje ku ishte gjer sa të zbrisnja poshtë në kabinën t'onë e të mernja një paqetë. E lashë Vason atje dhe shkova në kabinë, ku s'u vonova as 5 minuta. Vason e kisha mshtjellë me pallton t'ime të natës që të mos ngrinte dhe e kisha porositur të mos lozë nga vëndi.

Si mora cigaret u ngjita prapë sipër, po kur vajta në vënt Vasua s'ish atje edhe palltoja ime gjindeshe po në vënt e rëzuar për dhé. Munt të imazhinojë njeriu për një ças pozitën t'ime, në të cilën u ndodha posa që s'e pashë djalin! Një mijë të këqia më shkuan në për mentje më lojti zembra nga vëndi, m'u pre fjala, s'dinja se ku isha. Zoti na rujtë! A mos kishte shkarë e rënë në Oqean? Medet! Po ahere si i bëhej hallit? Ku do shkonja unë pa atë? Si do t'i shkruanja s'ëmës ç'ngjau, që ajo e kishte bir të vetëm, dritën e syrit? Hall i math! Një mijë djaj, një mijë rruferra! Hidhërimi im kalonte ç'do masë; më vinte sikur t'a kërkonja vërë më vërë; më vinte nga ndo një herë të hidhesha edhe vetë në det, kaqe që s'e durona të keqen. Më vijnin dallgë-dallgë dhe djers' e ftohtë me depërtonte trupin. Medet ç'pësova!.... .

Në këtë tmer e sipër, në këtë agoni vrulem një herë t'a shoh më të katër anët të vaporit e të pyes që nga kapitani e gjer te detari i fundit. S'lashë vënt pa parë. S'lashë kabinë pa trokitur e pa pyetur; lajmërova edhe kapitanin më të parë të vaporit i cili dha urdhër e u alarmua gjithë equipazhi i vaporit gjer ne më i mbrami pasaxher. Të gjithë më këmbë e po kërkonin Vason, gjer sa thotë kapitani se, në një nevojë munt të kthehemi prapë nga vija që po lundronim që ja t'a harrinim djalin të gjallë, ja se të vdekur!

S'lamë vënt pa kërkuar, aty edhe ne mashinat përposh të vaporit. Vasua s'gjëndej gjëkundi. Më kapi ahere një trishtim i math, një melangoli që s'kam si t'a rëfenj. S'dinja ç'të bënj, s'dinja ku të vete. Edhe kur kujtonja se si do vinja në Amerikë pa atë dhe si do t'a lajmëronja të mjerën nënën e tij, më vinte të vras vehten!

Kapiteni thotë se munt të kthemi edhe prapë e munt t'a kërkojmë e t'a gjejmë me projektile, po do rijmë gjithë natën për këtë punë, edhe s'ësht' as arësye, thosh kapiteni të kthehemi e të humbasim kaqe kohë, ndonse është fjala për njeri, të cilin vetëm të mbytur munt t'a gjejmë. Kësij aksidente n'a kanë ngjarë shumë herë, thosh kapiteni, po unë kujtonj se nuk do ketë rënë në oqean, se s'e mer as hesapi. Diku do jetë futur gjëkundi, si i vogël e

mikroskopik që është, e do t'a ketë zënë gjumi, kështu që ajy fle fle gjumin e ëmbël të miturisë e ne po vritemi së kërkuari. Shpresonj se nesër do vinjë vetë të të gjenjë me thotë, po flij rehat se kaloj mezi i natës.

Këto fjalë ngushëllimtare të kapitenit s'munt të më qetësonin aspak, se s'lamë vent pa kërkuar. Pastaj palltoja ime, me të cilën e kisha mshtjellë djalin dhe e cila u gjent atje më futte në dyshim të math.

I dëshpëruar sa s'bëhet, s'më bënte zembra as të vete të fle. Po sillesha posht' e lart në kuvertën e vaporit, tuke pirë cigare e tuke u menduar.

Atjé ku po mendohesha kështu e ment më fluturonte mendja nga sikleti, shoh në një sallotino të vogël nj'a 7-8 italjanë që po losnin poker. Kot hyra edhe unë brenda e po zbavitesha tuke i pare kur losnin, se si t'a haronja pak sikletin. Ulem e rri aty pranë në kanape.

Tek po rinja ashtu e po shihnja lojtarët, ndjenj se dikush më ra me një si këpucë vitheve. Shtije syt' andej, këtej se mos ka njeri prapa, nuk shoh gjë. Po prapë edhe një herë ndjenj një këmbë që së prapi që po më binte vitheve hope-hope. Ngrihem me një herë dhe shoh një majë këpuce të vogël dhe e mora vesh se ajo majë këpuce më godiste. Ahere unjem e zë me dorë këpucën, kur shoh një çilimi që po flinte. Prapë s'më ra ndër ment kush munt të ish ajy çilimiu. Një Italian, që quhej Giacomo, dhe që e njohnja kaqe dit në vapour, me që i ranë dy letra lodret poshtë u ngrit që t'i marrë e u unj, kur ……O Zot i math, o mrekulli, shoh suratkën e vogël të Vasos të më çfaqet përpara! Më lojti zembra me një herë. Fërkonja sytë se mos isha në ëndër. Ish e vërtetë me gjith'ato. Ishte Vasua i tëri që po flinte rehat, si kur se më tha edhe plaku kapiten. U unja, e përfshiva një herë në krahror e shtërngova e e putha sa munda dhe e rëmbeva në krahët e e solla në kabinën t'onë. Ajy s'ishte squar akoma. E zgjova dhe me lottë në sy po e pyesnja pse m'a shkaktoj gjith' atë të keqe. Ajy si i mitur po qeshte e po më zinte për qafe. Kaqe u gzova e u qetsova sa s'bëhet. S'më merte gjumi nga gëzimi. M'u duk si kur kisha fituar dynjanë. Shaka do ishte t'a humbisnja?

Të nesërmen s'lashë njeri pa lajmuar se e gjeta djalin edhe më fort kapitenin e math, i cili e qërtoj shumë Vason anglisht e i tha të mos vejë gjëkundi pa lejen e babajt, se kujtonte se unë isha i ati i Vasos.

Pas 3 ditsh qysh atë natë nga mëngjezi, edhe pa sbardhëllyer akoma dallonim për së largu farin (fenerin) me projektorët e forta të Bostonit. Kishim ardhur në Botën e re, në Amerikën e Kolombit.

Më vinte si kur isha në ëndër. Tjetër orizont i bukur shtriheshe përpara meje, tjetër dynja, tjetër erë. Për pak çfaqet i gjatë e madhështor qyteti historik i Bostonit, kthizës, çerdhes, djepit të lirisë Amerikane. Gjithë pasaxherët duall në kuvertën e vaporit dhe kqyrnin me kurreshtim të math gjith' atë madhështi e bukuri t'atij qyteti.

Për dy orë ishim brenda në liman, ku me qindra vaporë të mbëdhenj e të vegjël silleshin posht' e përpjetë tuke lundruar, ca tuke hyrë, ca tuke dalë nga limani dhe të tjerë të pa numur tuke patur zënë vënt në për pearet, ose limeret e veçanta artificiale detare. Një mijë kujtime më vijnin atë ças. Mendonja se jam larguar nga të mijtë, nga Shqipëria. Më vinte se do mos kthehesha kurrë andej, më dukej si kur u shita, si kur mbeta këtej. Ishin 14 ditt udhë këto, s'ishte një lodër.

Sado që ishim në klas të II dhe munt të delnim lirisht në Amerikë, për fatin t'onë ato ditt kish dalë urdher që të gjithë imigrantët, ç'do klasi duhej të shkonin nga Censura e imigracjonit, që në New York këjo quhej Castel Gard.

Prej vaporit duallmnë një sallon të math më shumë se 800 shpirt gjithfarë kombesh. Dhe filluan të n'a examinojnë me radhë një komisjon i posaçëm, ku ishin edhe disa doktora.

Kur më panë mua më gjetnë të shëndoshë e më dhanë lejen të dal jashtë në Boston, por se Vason e vogël me qenë se unë isha i ungj' i tij dhe ishte nevojë të tregonja një njeri të njohur në Boston, një garant të mirë. Edhe unë tregova si të këtillë kunatin t'em Niko Poçin, që po n'a priste në Boston, por se nuk e pranuan se s'kish një pasuni të palujtshme në

Amerikë, ose një tregti të madhe, ose të paktën 5. 000 dollarë një kapital. Prandaj, mbassi s'ish e mundur të paraqitnja as një prej këtyreve, komisjoni vendosi të kthenjë Vason prapë nga ka ardhur!

Tjetër siklet ky për mua. U mundova sa munda, fola edhe disa fjalë anglisht që dinja me disa prej syresh, po s'ish e mundur t'i bindnja. Ordre is ordre! Një të drejtë veç rekurimit[1] kisha përpara komisjonit më të naltë të imigracjonit, i cili mblidhej 2 herë në javë.

Shkuan 3-4 ditt kështu që po n'a mbanin në Policin' e imigrandëve dhe s'dukej njeri të n'a kërkonte, as im kunat Niko Poçi, i cili ishte lajmëruar se po vijmë. Unë isha i lirë të shkonja vetë, po s'ish e mundur të linja një çilimi 10 vjetsh në duart e huaja, që edhe munt t'a kthenin në Itali edhe s'kish edhe të holla me vehte jo vetëm ajy, po as unë, i cili kisha mbetur vetëm me 12 dollarë, se bënim hesapin gjer në Boston të n'a arrijnë vetëm.

Po nga ana tjetër Niko Poçi kishte pyetur vetëm në Agjencinë e "White Star Linee" dhe gabimisht në vent të embrit t'em me Vason i kishin tregue embra te tjera të ndryshme, kështu që ajy e kish fjetur mëndjen se ne s'ishim në atë vapor.

Si e pashë se më s'dukej njeri dhe frika ishte se do t'a kthenin Vason, ahere i shkrova shpejt një letër Niko Poçit me adresën që më kish dërguar, i cili posa mori letrën t'ime vrapoj e ardhi në Imigration Office, ku gjeti regjistruar embrat t'ona. Atje u përpoq me sa miq kish dhe mezi pas dy ditsh n'a libroj nga ajy siklet dhe duallm që të tre në Boston. Unë për të parën herë po shihnja t'em kunat më të voglin, Nikon, i cili kish 15 vjet që ndodhej në Amerikë. Nikua n'a priti shumë mirë. N'a hoqi në një furnisht-room (odë të mobilluar) të mirë dhe hëngrëm një drekë fort të mirë, që n'a gatoj e zonja e shtëpisë një franceze prej Parisit.

Të madhe përshtypje më bëri qyteti i Bostonit. Tjetër system qyteti, të tjerë njerës. Sa ndryshim kanë këta qytetet e Amerikës me ata të Evropës!

Mbassi u hasmë me shumë Shqiptarë atje, më shumë se 300 shpirt edhe më fort në hotel-restaurantet shqiptare "Hylli i Shqipërisë" dhe "Skënderbeu", e mbassi ndenjmë nj'a 3-4 ditt në Boston, ku im kunat Nikua s'na la Muse, Bibliotekë e theatra pa shetitur, më në funt vamë në katundin Natick, Mass, një orë e gjysmë lark me tramway nga Bostoni.

Kur thua katunt në Amerikë, duhet të supozosh se lipset të ketë të paktën 10. 000 banorë. Naticku kish më shumë se 15. 000 banorë, fshat tepër pitoreske e romantik, në mes të mollëve, të kopshteve dhe të ujrave. Plot fabrika, industri të madhe. Liqeni i saj që ndodhet nga verilindja e qytetit, është kaqe i bukur e majestik e kaq i kulluar, sa ja shkon shumë gjolit t'onë të Ohrisë. Uji ishte kaqe i ëmbël e i shishmë sa s'bëhej. Prej atij uji tash pinte ujë Naticku. Arrin vetëm të them se, sado që munt të kish një thellësi prej 5-8 metrash, ishte shtruar përposh me çemento, i pastër, i filtruar dhe ish ndaluar të peshkonte njeriu atje, ose të lundronte me barka. Munt të theshe së ishte një sternë e jo një liqen.

Kaqe më pëlqeu Naticku sa s'kam si e përshkruanj. Me rrugët e bukura e të shtruara me asfallt, me dyqanet e mbëdha e të kristallta, me banorët e butë, me kopshtet me nam e me lëndinat që gjelbëronin dimbër-verë dhe më fort me qetësinë e tij shembullore. Aty do zijnim vent bashkë me Nikon t'em kunat.

Nikua kish aty një restaurant në qendrën e qytetit me një kafene brenda e bilardo, ku, veç Shqiptarëve punëtorë s'kishim ndonjë myshteri tjetër të huaj.

Ç'munt të bënja tani unë që erdha në Amerikë? Avokatllëk? Jo. Ndo një tregëti tjetër? As atë. Pa fjalë do zgjidhnja një prej zanateve që kishim, ose punonin Shqipot e mjerë, si p. sh. në fabrika gjith llojesh si punëtor, hamall do me thënë, , nëpër minijerat, qe punë e rëndë e më e rrezikshime s'munt të bëhej, ose të shumën po të kisha kapital munt të hapnja një drogueri, një farë farmacije që munt të shishnje edhe fshesha, ose një grossery, d. m. thënë bakallëk ose një Candy story ëmbëltore, një restaurant, ose një hotel edhe fund i fundit munt të bëhesha edhe weter garçon, d. m. thënë, po edhe këtu lipseshe zotsi jo e vogël. Sa para

[1] rekurim = rekurs (H. K.)

bënte dhiploma universitare këtu, kurse shihnje pashallarë e aqe më tepër kontë e princër Russë që lanin pjatat e kazanet në për restorantet e mbëdhenj! Kështu si ardhi puna do t'i duronim të gjitha. Këtu n'a solli nacjonalisma, e cila munt të n'a linte edhe rrugëve, edhe pa bukë!

Nikua më tha se po më mer ortak në atë restaurant (Restaurant "Korça") ku do mbanja hesapet, korespondencat e tefteret e dyqanit edhe nga no një herë munt të ndihmonja si servitor, ose gjellbërësit, tuke i grirë qepë, ose tuke i bërë ndo një shërbim tjetër, veç të larit të pjatave e tenxhereve e spastrimit, për të cilat ishin ngarkuar dy djelm të tjerë. Bereqetversen edhe me kaqe. Fshinja faqen për dhen, veç paraja të delte. Dhe kështu ju përvesha me zell punës. Vason e vumë në shkollë.

Shkuam shumë bukur nj'a 3-4 muaj, brenda të cilëvet munda të dërgonj në shtëpi 30 napolona, po edhe vetë u mvesha mirë, si edhe për Vason harxhonim bashkarisht unë dhe Nikua.

Ishim mjaft të kënaqur me këtë jetë të re punitori. Hanim e pinim mirë e vijnim dhe nga një her'a dy në javë nëpër theatrot.

Mbanj ment se bëri edhe shumë nxehtë atë muaj në Natick, muaji i Korrikut 1909, dhe më fort ditën dhe natën e së 4 Korrikut (Foor July), që është edhe dita e madhërueshme e nacionale e indipendencës Amerikane.

Kaqe një të nxehtë, një vapë të tmeruar s'kisha parë në gjithë jetën t'ime. Atë natë, sa do që u çveshmë lakuriq me penxhere e dyer hapur thamë se plasmë. Dhjetë a më tepër herë u mshtuallm me çarçafë të lagur për freskim, por se pa u mshtjellë mirë avullonin çarçafët nga e nxeht' e madhe! Tjetër t'a rëfenjë njeriu e tjetër t'a provonjë. Po kjo e nxehtë s'mbajti më shumë se 3 ditt, se për ndryshe ishim të fikur!

Në 3-4 muaj që ndenja në Natick kisha kohën të shetinja disa qytete të tjerë të Shtetit Massachussett, sikurse Worcester, S. Framingham, Marlborooh, Hatson, Clinton, Lynn, Soothbridge etj. etj. shumë pitoreske, tepër manjifike.

Nuk di pse, me gjith'atë daravér që kishim, ramë jashtë, po unë këtë faj ja ve, ndjesë pastë kunatit t'im Nikos, që s'e shihte punën mirë, tuke shetitur posht' e lart e tuke mos u mbledhur pothua aspak në dyqan, dhe kështu, pa e kuptuar, ramë jashtë, dhe me gjithë që e shitme restaurantin, ramë fare jashtë sa, shuma e shitjes mezi arrin të lahen borxhet dhe të n'a mbeten vetëm 98 dollarë, të cilat edh' ato i mori im kunat Nikua, se i duheshin e iku e n'a la të dy me Vason vetëm me 12 dollarët e mija që m'i ktheu, mbassi i kisha vënë që në fillim si kapital nga ana ime.

E pashë se mbetmë tani të dy me Vason në Natick, pa punë, pa gjë prej gjëje, dhe e keqja ish se s'mbanja dot as vehten t'ime, jo edhe një njeri të dytë, se Vasua do bënte mirë të vinte me Nikon, që e kish edhe të vëllan' e s'ëmës, por kur s'deshte ç't'i bënja unë? Ajy preferoj të rijë me mua, se e shihte se e desha si një djalë e e kisha kujdes shumë, kurse ungji tjetër Nikua, i silleshe mjaft i ftohtë.

Duhet tani t'i bënja hall vehtes. Ku të përpiqnja kokën? Ç'ishin për ne 12 dollarë që kisha unë? Po për fat të mirë u ndodhë disa kushërinj të mij në Marlborooh, ku vajta i vizitova e më huan nj'a 50 ollarë, se aqe ju kërkova, me gjithë që munt të më jepnin edhe më tepër. Kisha dobarem një ngushëllim edhe nga miqtë.

Atje ku po mendohesha ç'rrugë duhet të mar, më vjen një letër nga im kunat tjetër Kristo Poçi prej qytetit Salt-Lake City të Shtetit Utah, që është afër Kalifornisë dhe 6 ditt e nett lark Bostonit! Ky më thotë se do ishte mirë të vinja atje me atë se sa të rinja me Nikon, të vëllanë, ishte problem a do bënja një punë të saktë apo, si që u pa me të vërtetë që brenda më 3 muaj ramë jashtë me një koxha restaurant që kishim!

Mua kjo letrë e t'im kunati më të math më ardhi fare për hesap dhe më ngushulloj mjaft. Me një herë i telegrafonj se munt të vijmë bashkë me Vason, por n'a mungonte navloni gjer atje, i cili ishte një shumë mjaft e madhe për ne 120 dollarë, se do kalonim një largësi prej 3.

000 e sa kilometrash. Ahere im kunat Kristua më dërgon vetëm 50 dollarë e jo tjetër gjë. Ç' të bënja tani me këto, të huhesha edhe të tjera e të nisesha me gjithë Vason, apo t'ja kthenja prapë ato që më dërgoj? Hall ajo , hall këjo. Preferova të parën e mbassi me anë të një miku pagova për Vason vetëm ½ navloni, kërkova e mora hua dhe 50 dollarë të tjerë dhe pagova 90 dollarë vetëm për biletat dhe u nisa me djalin për në Salt-Lake City.

Për më lirë preferuam të shkojmë nga ana e Kanadasë, Montreal, Quebek, Toronto. Ikmë nga Bostoni tuke kaluar nga shtetet New Hamshear, Vermont, etj gjithë Canadanë dhe prej qyteteve Sarnia, Huron, arthmë prapë në Shtetet e Bashkuara, në qytetin Detroit, Michigan, q'andej hymë në shtetin Illinois në qytetin e paanët Chicago, m'andej në qytetin Omaha të Nebraskës, tuke kaluar më të madhin lumë të botës Mississipin, s'andejmi arthmë në qytetin Chayeme Woawoming gjer sa qëndruam në qytetin e bukur të Collorados, Denver.

Aty do rijnim 5-6 orë. Kishim bërë gjer atë dit 4 ditt e katër nett udhëtim dhe duhej të çlodheshim.

Unë kisha nj'a 6 dollarë përsipër, që më kishin mbetur e s'e çanja kryet me që po i afroheshin Salt-Lake City, ku përveç t'im kunati Kristos do gjenim edhe t'ime vjehrë Lenkën dhe t'ime kunatë të vogël Angjeliqinë, si edhe të motrën më të vogël të Vasos, Fereniqin, të cilën e kish bërë si çupë të vehtën ime vjehrë dhe ajo e ritte. Vjehra, kunata dhe mbesa Fereniqi, 8 vjetsh ahere, kishin mot-mot që kishin ikur nga Shqipëria dhe i kisha përcjellë edhe unë bashkë me gruan t'ime në Patrë, ku shkuan me vaporin "Marta Washington".

Tuke qenë pra, se po afrohesha ne njerëzit e mij, e pashë me arsye se duhet të rruhesha e të qethesha, si edhe Vasua, prandaj hymë në një berberane luks që ishte ngjit me stacjonin e chemin-de ferit.

Si u qethmë e u rujtmë mirë e mirë e mbassi në ç'do propozim që më bënte berberi që "a do të të bëjmë edhe masazhe", "a do të të ujdisim mustaqet", "a do të të lajmë kokën me Chamboo", etj. etj. unë i përgjigjesha gjithë po, po, më në funt kur kam dashur të paguanj, më paraqisin listën e më thonë të paguanj, sa? . . . Dollarë 4, 75!!! Aman kur e pashë billën të ngarkuar me aqe para për një të rojtur e dy të qethura, d. m. thënë 1 lirë inglize më ardhi kijamet, e më fort se mbetesha pa të holla. Protestova mjaft, po Amerikani s'dëgjon protestime. U ankova të policemanni, po edh' ajy më detyroj të paguaj. Pashë ç'pashë dhashë 5 dollarë e më kthyen 25 cens, domethënë tani kisha përsipër vetëm 1, 25 dollarë.

Mbas të pyeturave që bënja, e mbas orarit feroviar që kisha në dorë, duhej edhe për 11 orë të arrijnim në Salt-Lake City, e kështu për një natë s'ishte kijameti, më arrijnin ato pare. Po mjerisht si u nismë, treni kaloj nga disa vise të tjera që nuk duhej të kalonte, po nuk e mora vesh edhe pse kaloj nga qytetet Pueblo etj. kështu që në vënt të bënim 11 orë bëmë 32!

Të hollat që kishim përsipërn'a u mbaruan brenda 12 orëve. Të nesërmen isha pa metelik. S'paska më keq se të mbetesh në midis të rrugës pa metalik!

Tani duhet të agjëronim, donim, s'donim. Po mirë unë munt të rinja edhe dy ditt pa bukë, po Vasua i vogël, që ishte msuar të hante 4-5 herë ditën, ky si do bënte tani? Deh, more hall, deh! S'n'a mbaroheshin këto të shkreta taksirate.

Rashë në një mejtim të thellë, që s'dinja si të bënja. Nuk shkoj një orë dhe Vasos i hahej bukë. Më kërkoj para të blerë një lakrorkë me mollë (cakes). Ku të gjenja t'i jepnja? Ajy fukara s'dinte se ç'më gjet. Më ardhi keq e u ngrita e zura po shetisnja nëpër vagonat se mos gjenja myshteri të shishnja një sahat që kisha, maker për 2 dollarë, ndonse vetë e kisha blerë në Vlorë për 1/2lire turke. Po mjerisht, as për një dollar nuk m'a mernin e po talleshin me mua, me mjerimin që n'a gjet. Hej dynjah, ku i ngopuri nuk e kujtoka kurrë të urëtin!

Më vinte t'i hidhesha dikujt për gryke e të bënja ndonjë krim. Syri m'u her nga urija. Mendonja Vason. Si të bënja të lypnja tani?

Po u ndoth në mes të tyre edhe një njeri i mirë, shpirt math, zembër mirë edhe jo ndonjë prej atyre pasaxherëve të pashpirtë, që disa munt të ishin edhe miliarderë, edhe me gjithë që ja u thashë anglisht kjartas se mbetmë pa bukë edhe unë edhe djali prandaj po e shishnja sahatin,

jo ndo një prej atyre, po thom, po një djalosh ndo njëzet vjetsh, që shishte banana e ëmbëlsira në për pasaxherët e trenit, ky i shkreti kur më pa me sahatin në dorë që mundohesha t'a shesh e s'ma blinte njeri, e si dëgjoj që mbetmë pa bukë me gjithë djalin, më afrohet e më mer më nj'anë e më pyet nga jemi e ku vemi. I tregova tërë historinë e hallin që n'a zuri. Ahere njeriu i mire vë dorën në taskën e menshintë që kish përpara, mbush dorën me të holla amerikane nga një kore, dhjeta e pese sencash e m'i shtije në dorë t'ime pa shumë ceremonira. U çudita fort me zembrën bujare të atij djali!Na, më thotë, meri, se un' e di ç'do me thënë uri fukarallëk. Dikur jam ndodhur edhe unë kështu si ty, thotë djali i mirë, e dikush u ndoth e më dha e s'më la të vdes. Prandaj edhe unë po lanj borxhin. Falem nderit tepër i them, po unë dua të t'i kthenj prapë këto posa të harrinj në Salt-Lake City, se atje do kem para. Ahere si të duash më thotë, po edhe sikur të mos m'i kthesh s'prish gjë, jepja edhe ti ndonjë tjetër të mjeri, po t' a shohç; kështu është kjo botë, thotë. Po mbassi insistonja të më japë adresën, edhe ajy m'a dha, tuke thënë se në këtë adresë munt t'i linja ato të holla te kapo stacjoni i kompanisë feroviare "Oregon Short Lines".

Si u ndamë me atë bujar djalë, i cili edhe nga fytyra tregonte njeri fisnik, i numurova ato para e ishin 8 dollarë e 25 cens. M'u ngroh zembra. Me një herë i bleva Vasos ç'deshte për të ngrënë, hëngra edhe vetë se kishim ajy 5 orë pa ngrënë e unë 12.

Desh Zoti e arthmë në qytetin Ogden, një orë lark ". E bëmë 6 ditt e 7 nett gjer atje, tuke u nisë prej Bostonit.

Ishte pik' e mëngjezit posa vamë. Po zbardhëllente një ditë fort e bukur, fort e këndëshme. Msuar prej qiellit të vrërët e bojë-plumbit të Bostonit e Natickut, këtu po shihnja një qiell të kalltërtë e të kjartë e po gëzohesha se do qëndronim e do rronim në atë vent aqe të bukur.

Dalim nga treni e marrim një automobil dhe drejtohemi për në Canyon Road Nr. 261, ku banonte ime vjehrë me gjithë të tjerët, të cilët n'a kishin dalë përpara dy-tri herë, po nuk u poqmë nga shkaku i vonimit të trenit.

Ç'të shoh tuke ecur? Një qytet extraordinar, një pastri shembullore; gjërrësi e madhe;rrugët nga 30 metra të gjërra edhe gjithë me bulevarde e me çezma andej e këtej qosheve të rrugëve. Për të parën herë shihnja një qytet aqe të bukur e aqe shik në jetën t'ime.

Pas pak minutash arthmë në shtëpi, ku po n'a prisnin. Hyjmë brenda e u pamë me shoqi-shoqin dhe shumë u gëzuan kur n'a panë.

Im kunat Kristua flinte. Si u zgjua ardhi në salon e n'a poq. Po e shihnja e po e njihnja për të parën herë. Njeri flegmatik e shum' i ftohtë, se kish më shumë se 20 vjet që ndodhej në Amerikë dhe ish amerikanizuar krejt. Ajy sikur më kish parë prej vjetësh dukej. S'i bëri asgjë përshtypje, as për të motrën më pyeti, për gruan t'ime, d. m. thënë as për gjë. Kur shtiri syt' e pa Vason aqe vockalak, nuk e mbajti dot kureshtimin. S'e la as t'a zerë për qafe xhaxhanë si miturì që ishte. Kthehet e më thotë:ç'ma solle këtë majmum këtu? Nuk ja dërgonje më mirë s'ëmës .

Djali i vogël kur e dëgjoj xhaxhanë ashtu mbet e zu të qante. Po e ngushëlloj ime vjehrë Lenka dhe ime kunatë Angjeliqia, se xhaxhaj ashtu flet nga hera po me zembër e do.

Kristua s'priti as të çlodhemi pak po me një herë më thotë të ngrihemi e të vemë të hapim dyqanet. Ç'dyqane? i thom. Dyqanet t'ona, më thotë. Njërin e kemi këtu afër dhe tjetrin ndo nj'a 10 minuta lark me tramvai. Po ç'farë soj dyqanesh? - i thom. Tani do t'i shohç thotë edhe gjyko.

Nisemi nga shtëpia. Po para se të nisemi, Kristua hyn në kuzinën, a kantinën që kishin, ku mer një karoce të vogël dore dhe fillonj t'a shtynjë vetë. Ç' bën kështu? i thom. Ja nuk sheh? thotë, e shtynj karocën të vemë në fabrikën e akullit të marrim nj'a 3-4 kallëpe akulli për ice-creamet (xhelatot ose dondurmatë që shqip i quajm akullore).

Akoma s'po kuptonj se pse na duheshin akullat. Kristua gjithë po shtyn karocinën. Fabrika ishte mjaft lark. Më në funt u loth e qëndroj. Nuk e shtyn edhe pak ti? më thotë, a po ke diplomë Universiteti e ke frikë mos të bjerë nderi?

Amerika s'di, as njeh prej këtyre, më thotë. Këtu punojnë njerëzia me duar e me këmbë, me kok' e me tru e me ç'të mundin.

Këto fjalë më bënë të madhe përshtypje, po s'fola gjë. Ke të drejtë, i thom, duhet të punojmë, prandaj arthmë këtu në Amerikë. Edhe rëmbeva karocën t'a shtynj, po e pashë se ish mjaft e rëndë e më këputte krahët. Nuk mundem, i thom, t'a shtynj. S'e kam bërë edhe ndo një herë tjetër këtë mjeshtëri. Po ahere ç'më erdhe këtu? më thotë im kunat. Ti më thire i thom, ku dinja unë se do vinja këtu të bëhesha hamall?

Kristua u zembrua po s'foli. Unë s'dinja si të flisnja me atë, se shëkonja një karakter bizar, që s'e kisha stërditur në jetën t'ime, pra s'dinja edhe si lipsej të sillesha! Nga ana tjetër më pikonte buza vrer, se tani e pashë se po fillonte një histori e re për mua, histori hallesh e mjerimesh.

Vamë në fabrikën e akullit dhe muarm dy kallëpe të mbëdhenj akull e ja ngarkuam karocinës. Kristua zu t'a shtynjë prapë karocinën me gjith akullat, që unë s'e shtynja dot pa akulla.

Më së fundi arrimë në dyqanin e parë, që ishte kundrejt një shkolle popullore. Ky dyqan s'ishte tjetër gjë, përveç se një copë barake prej drasash të lyera me bojë dhe s'kishte përve1 se 2 metra gjërësi dhe 3 metra gjatësi. Medet! Ky ishte dyqani Nr. 1 i Krostos, bezesteni, bonmache-ja a si t'a quanim.

Hap derëne hymë brenda. Ç'kish atje? Dy, tre rafe me ca kuti çokollatash etj. dhe nja bango të gjatë me 4-5 kuti të mbëdha 5-6 killosh me 4-5 lloje dondurmash. Nga an' e mëngjër një copë stufë me gazolinë, ose petrolinë për të pjekur qofte të gjërra, si betulla, të përzjera edhe me qepë të grira e me piper të zi.

Ky ishte gjitha dyqani, gjithë puna e Kristos.

Tani po e kqyrnja andej e këtej, posht' e përpjetë dyqanin dhe nuk dinja se ç'të mendonja më parë.

Ç'e shikon, më thotë Kristua. Ja këtu do të rish të punosh. Unë do ri në dyqanin tjetër që do t'a rëfenj tani:

Edhe u ngritmë e shkuam për ne dyqani tjetër, tuke lënë njërin kallëp akulli aty e tuke marrë kallëpin tjetër me karocën e vogël për dyqanin Nr. II.

Ishte mjaft lark dyqani, ose dyqanka tjetër. Edhe duheshe të vijnim më këmbë, që mbante 35-40 minuta. Kristua mbyll dyqanin Nr. 1 dhe mer karocinën me akullin që t'a çonjë te dyqani Nr. II.

Këtej udha vinte gjith' e tatëpjetë. Kristua më thotë: E tani nuk do t'a ngaç edhe ti pak karocinën se un' u lodha? E shëkon se është e tatëpjetë edhe nuk e besonja të bësh naze prapë.

Edhe unë për të mos i prishur qefin e rëmbeva karocën e zura po e shtynja. Ahere më ardhë ndër ment diploma e Universitetit, pozita e naltë e avokatit si në Greqi, si në Korçë, jeta gjallnore e iluzioniste që kisha kaluar tjetër herë dhe mikrobi i patriotizmit që më solli në atë derexhe, që prej professionisti, d. m. th. të hamalli! Po ç'do bënja? Do të duronja. Ç'n'a gjet, n'a gjet!

Kështu pas gjysmë ore të shtyrit të karocës me krahë, arthmë në dyqanin tjetër Nr. II. Qëndro, më thotë Kristua. Jemi përpara dyqanit tjetër.

Hajde, hajde dyqan Nr. II, ky ishte ç'ishte. Ky s'ish dyqan, as ish një barakë, ishte një copë nofull drasash në krye të një qoshe ku përpiqeshin tri rrugë dhe faqe një gjymnazit, ku studjonin djelm e çupa bashkë mas systemit amerikan të Jeffersonit, kryetarit tjetër herë të Republikës Federate të Shteteve Bashkuara.

Si hapmë derë e hyjmë brenda ajo që më bëri përshtypjen më të parë ishte ngushtësia e dyqanit. Vetëm dy veta nxinte brenda, i treti s'kish nga të vërtitet. Gjithë dyqani ish një metër e gjysmë me një metro e gjysmë gjatësi e gjërësi bashkë. Ish dyqan vetëm sa munt të punonin dy njerës brenda. Penxhere s'kish. Një port e madhe e drastë, një metro e gjërrë e dy metra e naltë, ajo ish dera, ajo ish penxheret. Një bango e vogël me 3 teneqe dondurmash, tre llojit edhe një stuf' e vogël për qofte, dy tigane, 2-3 perune, dy thika të gjatta e një teneqe, si depot gasoline ky ishte tërë malli i atij dyqani.

S'ta mbush mëndjen as këjo? më thotë Kristua. Tani do shohç sa para munt të zërë ky dyqan. Edhe me një herë u përvesh e zu pregatitte qofte të gjërra me një shpejtësi të jashtazakonëshme, e më thotë të vërenja mirë zanatin që t'a msonj.

Kërcen prifti nga belaja tani. Po të duash mos e mso edhe këtë zanat. Nga ky prisnja të ushqehesha e të ushqenja dhe fëmijën. Zoti na rujtë për më keq.

Zura , pra, dhe unë të gatuanj qofte, si ato që bënte Kristua, po s'më hapeshin dot. Ky as priste dy fjalë, po me një herë ze më bërtet që s'dinja as qofte të bënja etj. etj. Unë po gëlltitjnja ç'do bërtitje, se e pashë se kisha të bënja me një njeri nervos, një exantrik. Sido kudo fillova t'i bënja më mirë qoftet. Po duheshin edhe qepë. Qepëëëë!Bërtet Kristua. S'kemi qepë, shko shpejt të n'a blesh qepë. Nga dale, mor jahû, i thom, mos bërtit kështu. Ku të vete për qepë? Ku shiten? Shko, thotë, gjej ku të muntsh, s'kam gaile për atë. Po ahere kush ka gaile? I thom. Ti, thotë, ti puna jote është këjo, shko të gjesh qepë. Po nuk shkon më mirë ti, i thom, e unë të ri të bënj qofte këtu, gjer sa t'a msonj këtë zanat kaq të bukur, se më pëlqeka shumë?

Kristua si e pa që unë s'tundesha nga vendi, u ngrit e shkoj vetë e solli qepë. Tani griji, më thotë. Ze unë t'i grij si kurse gratë e Korçës. Jo ashtu, jo thotë, ja si grihen qepët. Dhe filloj t'i grijë shpejt e shpejt, sa as shëkonja thikën se si shkonte. Kështu t'i grish, thotë. Atë s'e bëkam dot, i thom. Pse? Se ashtu pres gjishtërinjtë 10 herë në minutë. Të msohesh, thotë. Tani të msohem? Tani, po kur? A ke ndo një zanat tjetër, i thom, më të lehtë se këtë? Më të lehtë se këtë? Po ky është më i lehti nga gjithë zanatet e tjerë. E shoh, thotë, që s'qënke për punë ti, po qëndro dobarem këtu të mbledhësh paratë nga djelmt e çupat që do vijnë tani të blenë qofte.

Ishte ora 12 pa ca. Për pak minuta u dëgjua topi i mesditës. Me një herë buçet një zile e madhe e shkollës dhe gjithë djelmt' e gocat dalin jashtë edhe n'a grumbullohen ne dyqani, tuke kërkuar qofte e akullore me të hollat në dorë. Kristua çvilloj një shpejtësi aqe të madhe në të ndarit e qofteve, sa më abiti. Unë s'kisha tjetër punë, veç se të mblithnja të hollat e të jepnja kusure. Po edhe këjo donte një shpejtësi që unë s'e kisha. Më 20 minuta e sipër sa mbajti intervali i shkollës kishin ardhur për mbi 200 shpirt djelm e goca prej 13 gjer 20 vjetsh. Në atë koh' e sipër kishim zënë 27, 50 dollarë! Prej këtyre sermeja s'ishte më shumë se 6-7 dollarë, që d. m. thënë 20 e ca dollarë (5 napolona e ca) kishim fitim brenda 20 minutave.

Dyqani hapej vetëm dy herë ditën, një herë në mëngjes më 8-9, ku ziheshin 7-8 dollarë dhe më drekë vetëm 20 minuta, ku ziheshin 20 gjer 30 po edhe 40 dollarë! Ahere ja kuptova vleftën dyqankës vogël dhe konstatova se s'qënke liksht të bënjë njeriu qofte në Amerikë në dyqanka t'atilla, të cilat e kalonin tregëtinë me kapitale më të mira. Edhe këjo pa shumë mundime edhe vetëm me 1 ose 1 e 1/2ore punë, kur se orët e tjera munt të bënja dhe tjetër punë.

Si hynë djelmt' e vajzat në shkollë mbyllmë edhe ne dyqankën, muarrm prapë karocinën e shkuam, ose u ngritmë më mirë në shtëpi, se këtej ish shumë ulët.

Kur ngjiteshim Kristua m'u pa tjetër njeri, se zu të më fliste me të mirë e të më inkurajonte. U kthehemi edhe nga një lunç-room e hëngrëm nga një stekë (brizollë) e pimë edhe nga një birrë të mirë. Ashtu po.

Arthmë në shtëpi. Atje n'a pret një tjetër lajm gazmor. Ime shoqe në Vlorë kishte lindur një gocë, si një hyll e ja kishin vënë embrin Teftë. Gratë më pritnë me gëzim të math e me petulla. Këjo ish mjaft një ngushëllim për mua midis atyre halleve.

Pas darke shkuam ne dyqani Nr. I. Aty më msoj si të godit akulloret, si t'ju shtije kripë anëve që të forcoheshin akullat etj. Më tregoj çeshitat që kish dyqani një nga një, embrat e çmimet e më la aty.

Ç' kam pësuar prej atyre djaj kalamajve në orën 3-3 e 1/2që u hap shkolla popullore e do hynin brenda s'munt ta rëfenj dot. Iu bëri përshtypje të madhe hunda ime që e kisha si një çomage, veçanërisht mustaqet e mija të gjata, kurse Amerika s'mban mustaqe, gjithashtu sjelljet e mija të pavolitshme (gauchy) mbassi s'isha i stërvitur në asij punësh. Me gjith'atë zura nja 7-8 dollarë, ishin fitim. Kështu vajta nj'a dy javë sa u msova pastaj e rregullova mirë punën, u njoha me të gjith'ata e zun' e më deshin shumë. Me ato më fort se sa me tjetër kënt msova gjuhën anglishte.

Atë natë më mer më nj'anë Kristua e me thotë cilin dyqan preferonj më mirë e i thashë se më duket m'i lehtë dyqanka Nr. 1, ku ishte edhe ime kunatë Angjeliqia, e cila e dinte gjuhën shumë bukur, e cila ish tashi 7 muaj në atë dyqan, e mbassi vajta unë, ndenj edhe nj'a 2-3 javë me mua sa u msova unë e pastaj u çkëput e rinte në shtëpi me fëmijën tjetër.

Unë brenda 2 muajve munda të lanj borxhet që kisha marë nga Naticku e Marlborouch për shpenximet e udhëtimit dhe të dërgonj në shtëpi 50 dollarë, ndonse edh'atje kishin harxhe shumë, si u lint dhe çupa ime. Po edhe im vëlla ishte pa punë.

Në atë kohë, domethënë nga Dhetori 1909, im vëlla u emnua Drejtor i shkollës shqipe në Korçë me rrogë 50 lirash në mot dhe shkoj për në Korçë, tuke lënë vetëm gjithë gratë, d. m. th. mëmën t'ime. Teto-Ndinon, t'ime shoqe dhe çupën t'ime Teftën. Im vëlla desh t'i grinte gratë të gjitha t'i çonte në Korçë, me gjithë që në Vlorë kishin koxha një shtëpi me qira për një vit. Nuk di im'ë me teto Ndinon si u gënjyhen e iknë në Korçë, pa më pyetur, pa u marrë vesh me mua dhe si do rronin atje vetëm me 50 lira turke në mot me qira shtëpije e me kaqe të hyra e të dala që kishim në Korçë nga far'e fisi. Ishte një gabim i math ajy që bënë, po edhe gabim i t'im vëllaj që i mori me vehte, si kur se u duk më von. Se ajy ishte shkaku që u shkatërua shtëpija jonë e u shpërndamë me njëri-jatrin si zoqt' e korbit.

Ime shoqe nuk dëgjoj t'ju vejë pas, se s'kish edhe lejen t'ime. Ajo pra qëndroj në Vlorë bashkë me të motrën e saj Marigonë, tuke dhënë shtëpinë që kishim me qira tjetër kujt.

Kjo marri që bënë gratë, kjo punë e pamenttë që vepëruan s'më pëlqeu aspak. Jo vetëm s'më pëlqeu po edhe më dëshpëroj mjaft, se unë për atë familje mora sytë e këmbët e vajta gjer në Amerikë, si e si mos turpëroheshim, edhe brenda 7 muajve ju kisha dërguar 100 lira inglizi, kur se im vëlla do t'i mbante vetëm me 50 lira turke në mot! Po kur bëhen punët të rëmbyera pret prokopi pastaj? Tani kishim 2 n'a u bënë 3 shtëpi, një në Vlorë, një në Amerikë edhe një në Korçë.

Dobarem mbet ime shoqe në Vlorë, se sikur të kish ikur edh'ajo me ato, ashtu pa më pyetur edhe unë s'di a do t'i shihnim më sytë njëri-tjetrit. Do mos vinja më në Shqipëri. S'ishte gjë e vogël kjo që më punuan! Qysh ahere unë nuk shkrova më në Korçë, me gjithë që im vëlla më justifikohej se deshin edhe vetë gratë të vijnin në Korçë që të jemi afër far' e fisit etj. etj. e me gjithë që më inkurajonte se me këtë shkak do përblidheshin gjithë në Korçë për gjithmonë.

Këtij zembrimit t'em të arsyeshëm i dha funt një ndollinë e keqe që n'a ngjau pas dy muaj qysh se im'ë edhe teto Ndinua vanë në Korçë.

Një dit po losnim me t'im kunat Kriston, ajy violi, unë fllauto. Mbassi lojtmë më tepër se një orë, Kristua më thotë të pushojmë pak e më jep nj'a 5-6 letra të mijat të ardhura nga Shqipëria, njëra prej të cilave kish zarf të zi për shenjë zije dhe dukej që më dërgohej prej s'ime shoqeje.

M’u droth e më iku zembra me një herë e u zbeha në fytyrë se s’dinja se ç’më ngjau. Po Kristua njeri i ftohtë e stoik m’a pret me një herë: ore më duket si kur të paska vdekur jot ‘ëmë …. .

Im’ë? Folë mirë, i thom, nga e di ti këtë? Më shkruan jot shoqe, më thotë, po miqtë shëndoshë.

Nuk di si më ardhi atë ças. U bëra si i marrë, dhe e humba fare! Lotët po më vijnin çurknga sytë dhe zembra m’u pikëllua fort. Ishte thënë t’a pi edhe këtë kupë hidhërimi lark e në vënt të huaj e të mos i ndodhem sidomos pranë së mjerës s’im ‘ëje në orën e fundit!

Dëgjojnë mandatën edhe ime vjehrë e ime kunatë e ardhë këtej ku ishim ne e zunë të më ngushëllojnë e të qajnë edh’ ato për mëmën t’ime.

M’u pre fjala, m’u pre oreksi, buza më pikonte vrer. E mjera im’ë ishte e re, s’ishte aqe e shkuar, s’kish mbushur akoma 54 vjet kur vdiq. Ishte asthmatike prej kohësh e kardhiake dhe shumë ja kisha frikën. Po nga ajo që u rojtmë nuk shpëtuam.

Gjith’atë dit u mbylla në odë e e qanja t’ëm ‘ë si një fëmijë. S’gjenja ngushëllim as prej njeriut! Më dukeshe sikur s’ish e vërtetë, si kur do t’a shihnja prapë, si kur do t’i dëgjonja zërin e saj të ëmbël, këngët e saj të bukura, fjalët e saj ngushëllore!

Një javë të tërë s’më largohej zjari i hidhërimit. S’desha as të ha, as të pi. Më vinte si kur vet’ e mora më qafë që s’i shkrova kaqe kohë në Korçë. Më vinte sikur t’a gjenja gjëkundi e t’i kërkonja ndjesë, po shkoj, shkoj. Fluturoj edhe ajo e mjerë!

Qysh ahere s’më rihej në Amerikë. Po ku do t’a gjenja edhe më mirë? Vërtet këtu punonim punra hamalli, gjërra për të qeshur, po dobarem nxirnim diç’ka e n’a tepëronte, po në Korçë, ose në Vlorë ç’do bënja që ndodheshim kurdoherë mbi një vullkan? Atje do rrezikonim edhe jetën, këtu dobarem kishim liri të plottë. Sikur ishim ne të parët e të fundit që punonim në atë mënyrë? Ehu, sa e sa shihnin më të mirë se ne!

Përpara se të mbyll këtë kapitull do bënj pak fjalë mbi qytetin e bukur të Salt-Lake-ut.

Ky qytet, i cili quhet edhe Jordhan City d. m. th. qyteti i Jordanit (i lumit të Jordhanit) është qyteti pikërisht i Mormonëve, një fe e re që do ketë më shumë se 80 vjet që është çpikur prej një farë Joseph Smithit, piksëparit në Shtetin Vermount të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky Josef Smithi ishte njeri me dituri, mystikopath e alucionist, po edhe hypokrit. Tuke qenë se ish një familje e madhe e e dëgjuar dhe desh të imponohej mbi gjith fshatrat ku kish çfligjet e tija e të përfitonte nga padijeni e tyre, një dit u bë si kur pa Përendinë vetë në një pyll, si tjetër herë Moseu pa Perëndinë t’i çfaqet me anë të një ferre që digjej, dhe si kur i tha (Josef Smithit) të vejë afër një mali e të rëmojë, ku do gjejë dy rasa të florinjta, si kur i gjeti edhe Mosiu (Moissiu) të 10 porosit’ e njohura të Zotit tjetër herë. Kështu Josef Smithi gjet porosit’ e reja të Zotit për popullin e tij, të cilin e quante Mormon, do me thënë popullin besnik e të dashur të tij. Këto porosi ja u tregoj solenisht fshatarëve Josef Smithi, edhe ata si injorantë që ishin e besuan, dhe tuke patur ky Josef Smithi (ky Nasr-udin i dytë) një tjetër Gjor-gënjeshtër për shok Bingham Jungun, një apostull të doktrinës së tij të nxehtë, mundi e bëri propagandë të madhe në fen’e re. Mormonisma kufizohet në këtë doktrinë:

Të besojnë Perëndinë, engjëjt dhe gjithë profetët

Të rrojnë të lirë dhe të martohen me sa gra të duan

Po të shkojnë mirë për një kohë të gjattë munt të martohen edhe një herë, po me gratë që kanë për n’atë botën tjetër.

Të japë ç’do mormon 1/10 e gjithë pasurisë tij për arkën e përgjithshme të Mormonisë, si dhe nga 1/10e fitimeve neto të përvitshme, edh’ato për Arkën e Mormonismë.

E kanë edhe sot ata një profet, që e njoha edhe unë, që quhet edhe ajy Josef Smith, shtërnipi i profetit më të parë, një plakosh i gjatë, nj’a 70 vjetsh, që kishte 28 gra dhe 112 fëmijë, djelm e çupa!Mormonët kanë edhe sot 12 apostuj, disa prej të cilëve i njoha edhe unë per sonalisht në Salt-Lake City.

Mormonisma, si thashë më sipërt filloj nga Shteti Vermont, po mbassi Qeveria Amerikane i ra prapa kësaj çarllatanismës së re, mormonët iknë q'andej e zenë vent në Shtetin e mall Illinois, që ka kryeqytet Cicagon.

Po atje tjetër luftë i priste. Populli u ngrit më këmbë dhe ka zënë një dit disa apostuj mormonë e ka dashur t'i djegë si eretikë, dhe në mos i dogji të paktën i vrau që të gjith'ata apostuj. Lufta u çpall sheshazi kontra kësaj fesë së re dhe mormonët pas kaqje humbje e vrasje që patnë ardhë në Shtetin Nebraska, po edh' atje gjith' ajo i gjet, aqe sa një dit tek predikonte vetë profeti Josef Smith (i pari), populli i egërsuar u ngjit nga penxheret, e rëmben profetin me këmb' e me duar e t'a flakëron përtej në rrugë prej 3 katesh lartë si, ky profeti i shkretë gjet vdekjen më të tmershme, e jo vetëm ajy, po edhe shumë mormonë të tjerë.

Fund'i fundit ardhë në viset e gjera të Shteteve Idaho e Utah, vende të paexploatura ku zunë vent e qëndruan. Kur ardhë në Salt. Lake City, që ata e quajtën Jordan-City dhe lumin që shkon afër qytetit, Jordan River (lumi Jordan, ku u pagëzua Krishti), ata gjetnë përveç se 10-12 kësolla. Brenda 30 vjetëve ndërtuan një koxha qytet dhe fort të bukur e moderne prej 90. 000 banorësh, prej të cilëve 4/5 janë mormonë. Sot, pas 20 vjet që ahere ky qytet ka 300. 000 ndenjës. Gjithë bankat jo vetëm të Shtetit Utah, po edhe të Idahos dhe po thuaj gjithë qytetet, katundet, fermat, minierat e tjera të këtyre shteteve janë në dorë të tyre.

Janë aqe fanatikë pas fesë, sa asnjë fetar tjetër. Prishin para e shuma kolosale që të prosilitizojnë të tjerë në fen' e tyre. Do të tregonj këtu një episodë mjaft karakteristike e për të vene re, që të kuptohet se deri ku arrin fanatisma e tyre.

Motin e dytë që vajta për së dytit në Amerikë e në Salt-Lake City, kishim me t'em kunat Kriston një furrë, ku na shërbente një italjan si furxhi edhe nj'a dy sherbëtorë Shqiptarë. Merrnim mjell rregullisht ne një fabrikant të math e milioner që quhej Mr. Vogler, i cili ishte një nga kapot e mormonëve, ish edhe predikues në Tabernacle temple, Kishën centrale të mormonëve në Salt-Lake City e cila nxen 14. 000 shpirt, e cila kushton qindra mijë dollarësh, se është gati gjithë ar, edhe e cila, për çudi është ndërtuar pa një gozhdë, sepse gozhdën e kanë zët mormonët, pse me ato Çifutët, ose Romanët ushtarë të Pilatos, për hesap të çifutëve mbërthyen Zotin Krisht.

Sado që i paguanim me rregull këstet e borxhit t'onë për mjellin që mernim, një dit myshteria më e madhe që kishim puntoret e udhëve elektrike grekë, bullgarë e Syrianë bënë grevë e iknë natën dhe ne n'a mbetnë pa paguar gati 1. 000 dollarë, gjithë fitimin që prisnim se do merrnim, me fjalë të tjera n'a fiknë.

Nga ky shkak s'munt të paguanim edhe një borç prej 827 dollarësh, mbanj ment, që i kishim z. Vogler prej mjellnave. Sado që e gënjyem disa herë edhe unë edhe Kristua, po më së fundi ky s'duroj dhe një dit e lajmoj Kriston se, ja të hollat, ja se do n'a mbyllte dyqanin me gjithë furrën.

Kristua si e dëgjoj më s'u afrua më në furrë. Unë, tuke mos ditur gjë, atë dit kishim pjekur një tavë të mirë me mish dashi e mbasi e bëmë me oris i hothmë edhe kos sipër e u bë një Elbasan tavasi extra. Ishim shtruar të hamë, unë me sherbëtorët e mij, tuke marrë edhe një kovë 6 kilosh me birë.

Me një herë një automobil n'a qëndron te dera. Një djalosh bashkë me 3 policemannë zbresin e hyjnë brenda. Pyesin ku është z. Kristo Poçi e ju thashë se ka dalë. Ahere më thotë ajy djaloshi që ish nj'a 25 vjetsh, se kishin ardhur me mbyllë furrën e me sikvestrue ç'kish brenda për borxhin që i kishim z. Voglerit.

Unë u preva me një herë, kafshorja më mbet në fyt dhe qëndrova i ngurosur. Më kot lutjet e mija që të n'a presin edhe ca kohë, më kot justifikimet për grevën që bënë e topin n'a hodhë punëtorët. Ata s'dëgjonin kësij prallash. Ju jep urdhër policjotëve dhe fillojnë e bëjnë inventarin e mallit që kishim brenda me gjithë që, përveç 7-8 thasëve mjell, dy furrë bukëve e veglave të tjera që kishim s'gjetnë gjë tjetër. Po thuajse kishin mbaruar inventarin e teshave të

furrës. Unë po mendohesha dhe në fort turpin që do n'a gjente, pa le që do mbeteshim edhe pa punë.

Atje ku po vrisnja mendjen, më venë sytë ne xhepin e palltos të atij djaloshi, i cili quhej Harry Vogler, e ish nipi i Voglerit të math, kreditorit t'onë. Shoh atje një libër, që kishte dalë nj'a dy gisht jashtë palltos të Harry Vogler, aqe sa dukeshe titulli i tij me shkronja të mbëdha greqisht. Titulli i librit ishte kyç (shkruar në greqisht) "Dritë prej së brendshmit". Me një herë një gjë, si një frym' e shentëruar më ardhi mdër ment. Kthehem e i thom me një gjentilecë: zotni i ndershëm, a më permetoni t'a shoh pak këtë libër të bukur që kini në xhep e që është shkruar greqisht? Pse, më thotë, di z. jote greqisht? Si jo, mor zotni, i thom, po unë në këtë gjuhë kam bërë studimet e mija gjer sa mora dipllomën prej Universitetit të Athinës si doktor i Drejtësisë! Ç'thua, më thotë, ç'thua? Ditke zotrote greqisht? Qënke edhe avokat? O, o gëzohem tepër se edhe unë e di greqishten, edhe unë jam avokat.

Oh, ahere s'tregohet dot ajy moment. Filluam një herë piksëpari të flasim greqisht me z. H. Vogler, i cili më thotë se ka qenë tre vjet në Athinë si apostull i Mormonismës, i fesë më të mirë e më të qytetëruar të botës etj. etj. prej të cilave kuptova se kisha përpara një shoven të math mormon. Këtu tash u frymëzova me disa mendime të tjera.

I kërkova librin e m'a dha. I shtira një sy e po e këndonja dhe i thashë se më pëlqen fort dhe dua të katehisem edhe unë në këtë fe kaqe të mirë, mbassi kam kaqe kohë që po jeton në këtë kthizën e Mormonismës.

Kaqe mjaftoj sa t'a enthusias z. Harry gjer në Perëndi. Ahere më hidhet për qafe e më puth, tepër i gëzuar se do shtohesha me një njeri plus Mormonisma. I qeshnin edhe syt' edhe këmbët akoma. Menjë herë kthehet e ju thotë policjotëve të shkojnë, se s'ka nevojë prej syresh. Unë e ngroha edhe një herë tavën e ju luta Harryt të hanim një bukë bashkë si kur se t'ishim në Athinë dhe ajy e pranoj e u shtrua me ne e u kënaq tepër. Gjith'ajy hidhërim u transformua në gëzim.

Si hëngrëm e pimë mirë, më thotë: më jep lejen të të rekomandonj ne xhaxhaj im z. Vogler, i cili do gëzohet tepër nga një ndollinë e këtillë. I thashë, të lutem, jo një herë po dy herë, në daç, rekomandomë, kënaqem fort. Harry ahere merr telefonin e më rekomandon të Vogleri plak, i cili u enthusias tepër e ju lut Harryt të më marrë edhe mua e të vemë të presantohemi te ajy, në officin e tija.

Me një herë i hipmë automobilit dhe vamë e më paraqiti përpara xhaxhajt të tij me një rekomandim të zjartë. Z. Voger, plak nj'a 60-65 vjetsh tepër serioz e venerable, u kënaq shumë që më njovi, ndenja pranë tij , më dha një puro Havane[1] e ja shtruam një muhabeti fort të mirë. I tregova me pak fjalë gjithë historinë t'ime dhe më sympathizoj mjaft. I tregova se kemi edhe familje në atë qytet prej 7 shpirt e kush e di…. Do Zoti e bëhemi të gjithë…. Mormonë.

Mr. Vogleri s'kishte ku të më vinte. Kaqe u gëzua sa s'tregohet. Pastaj kur ardhi çështja e borxhit e i tregova si na ngjau me punëtorët që bënë strike (grevë), ajy më tha se s'ka gjë, aqe shum' e vogël sa ësht' ajo munt ta paguanim kur të kishim dhe mbi ato më pyeti në kam shpresë se munt të vejë puna mirë, e kur i thashë se po, por na mungon kapitali dhe të holla s'kemi që t'a blemë, ahere më thotë se po n'a jep veresije sa thasë mjell tjetër të duam. Ahere mora yrysh e më dërgoj në apothekë bashkë me Harryn e të kam marrë 80 thasë mjell gjithfarësh, veç semigdhalit etj. që bënin një shumë 2. 000 e sa dollarësh me kushtin që t'ja paguanim pas 3 muaj, e mbassi ju luta unë më tha ç'ka, munt t'i paguanim edhe për 5 muaj, dhe ç'tjetër të kemi nevojë munt t'i thoshim lirisht. Më tha se do vinte të n'a vizitonte en famille të Dielën e arthme, e m'u lut të vijnim në tempullin atë të Dielë etj. etj.

Kuptohet se sa u anthusiasa prej këtyre fjalëve, se me pak fjalë shpëtonim nga një problem të math, që mëndja po n'a vinte rrotull. Pa ardhur në furrën t'onë kishin ardhur thasët

[1]puro Havane = duhan kubanez special (H. K.)

me mjell më parë e po shkarkoheshin për çudi e habitje të shërbëtorëve të mij, të cilët s'munt t'a shpjegonin ate mrekulli!

Atë natë vajta me një barrë qef në shtëpi e ju kallzova grave sa që më ngjanë me Voglerët. Kristua s'ishte atje, se kish dëgjuar se n'a u mbyll furra dhe s'desh të vinte atë natë në shtëpi, se mos i ankohesha unë. Prandaj ajy shkoj të nesërmet afër furrës që t'a shohë si ishte e vulosur, etj. Po kur e pa furrën hapur e hyri brenda e kur shtiri syt' e pa gjith'atë stivë mjellrash u habit. Priti gjer sa ardha unë dhe për të parën herë ajy njeri aqe i ftohtë e flegmatik hapi gojën e më përhiroj nga zembra e më tha: Kjo punë kaq'e madhe e e mrekullueshme që bëra këtë radhë, që kaq bukur ju hodha hi syvet Amerikanëve të zgjuar e shpëtuam nga rreziku, kalon ç'do masë, ju vë kapak gjithë të tjerave e më tregon një njeri të math e me kapacitet të jashtazakonshëm. Kurrë s'kishte folur ashtu Kristua.

Ësht' e tepër tani të thom, si vamë në tempullin e mormonëve me burra e gra, si u njohëm me Mr. Voglerin e familjen e tyre e me shumë familje të tjera aristokrate mormone, edhe si ardhë edhe ata e n'a vizituan, si sympathizuan mbi ne e si n'a sillnin mjaft peshqeshe e na thrisnin në gostira, si dhe kur vdiq atje çupa ime Tefta, u mbulua me salltanet të math mormonisht nga an' e tyre, si u lint djali im Pirrua atje e ç'bënë e ç'harxhuan ata për Pirron gjer sa e pagëzuan mormonisht, si edhe si u martua Kostaq Kotta, sot kryeministër, prapë mormonisht me kunatën t'ime Angjeliqinë etj. etj. Do të tregonj më tutje kur t'a sjellë rasti disa gjërra akoma për mormonët.

Si vazhduam nj'a 7 muaj më Kriston, ajy në dyqan të vogël Nr. II e unë në dyqanin Nr. I, me ca të holla që n'a tepruan hapmë edhe një kafene në Greek town, në lagjen e Grekëve – se në Salt-Lake City ishin më shumë se 5. 000 grekë – dhe për disa kohë vinim mirë. Po si njerës që s'ishin msuar me mjeshtrin' e kafexhillëkut ramë jashtë e humbmë nj'a 400 dollarë. Këjo më shtërngoj që të hiqem një herë e të shkonj ne gruaja e çupa ime në Shqipëri, pa të dalë ku të dalë.

Bëmë hesap me Kriston edhe sa do që në hisen t'ime bënte të mernja edhe 600 dollarë akoma, ajy më qiti ca hesape të tjera kështu, që mbassi lava gjithë borxhet më dha edhe 250 dollarë, me të cilat u nisa. Në stacjon disa Shqiptarë të njohur më bënë havale të mar pas një djalë nj'a 20-22 vjetsh që quhej Shaqir nga katundi Goskovë i Korçës që t'a çonj gjer në Vlorë, tuke qenë se s'bënte ndonjë punë në Amerikë, me gjithë që kish mot-mot atje. Edhe unë e mora, por ajy s'dinte as një fjalë anglisht e me këtë bashkë ish edhe teknefes djalë.

U nismë nga Salt-Lake, tuke marrë vijën për Chayemme-Chicago-St. Joe. Misuro. Shaqiri kish mjaft të holla me vehte si dhe biletën gjer në New York , ku drejtohesha edhe unë. Ishte muaji i Qershorit 1910.

Gjer në qytetin Chayenne-Wawoming shkuam mirë. Po pak më parë afër një stacjoni, kur n'a u kërkuan biletat, unë për fat të keq s'e gjenja dot t'imen. Mjerisht bashkë me biletën kisha humbur edhe passaportën e disa shkresa e letra të tjera. Myster puna e tyre! S'munt t'i gjenja dot sa do që u mundova. Ahere konduktori më thotë të zbres në Chayenne dhe në u gjenttë bileta në tren, prapë ata do telefononin në stacjon të Chayennit të më jepnin biletë tjetër gjer në New York. Kur mora valixat e dolla jashtë Shaqiri ment u prish mentsh. Zu e po qante që i bëri gjith'ata që ishin rotull që të çkulen së qeshuri, se qante si ndo një foshnjë. I thashë të zbresë e të rijë me mua, po edh' ajo s'i pëlqente, se për atë ishte gjynah i math e prapësi të kthehej nga rruga. Më në funt i thashë një "udhë e mbarë" e e lashë.

Ndenja 3 ditt në Chayenne dhe mezi të tretën ditë ardhë telegraf se u gjent bileta ime në tren brenda dhe kështu m'u dha biletë e re gjer në New York pa pagim. Ardha në New York, qytet gati më i madhi i Botës së re, qytet ku i humbet njeriut mendja nga ndërtesat që fillojnë prej 10 patesh e arrijnë në patin 64, ku sheh aqe ta math kallaballëk sa s'sheh gjëkundi dhe aqe drita të dëndura, aqe vaporë, aqe limanë, aqe sende të çuditshime, aqe mrekulli.

Ndenja një javë në New York e pashë ndërtesat, theatrot, musetë, kopshtet publikë e sendet më të çuditshmime që ka ky qytet. Pashë dhe mora pjesë në lodrat më të çuditshime e

të rrezikshme në Ford George e në Luna Park. Shetita kush e di sa herë urën e famshme e të çuditshme të Brooklinit, që është një nga të shtata mrekullit' e botës, që ka 3 palë të ecura njërën mbi tjetrën ku shkojnë tramwaje, automobile e kamione, e njerës e gjithë farësh, këtë urë që ësht' e mvarur në erë e mban gjith'ato miliunë okë rëndësira e që është aqe e lartë, sa edhe albura e vaporëve transatlantike duhet disa metra akoma që të munt t'a arrijnë e kështu kalojnë lirisht nënë urë. Këtë urë e shetita edhe sipër edhe që përposh në det.

U nisa nga New Yorku me vaporin e Cunard Line-st "Carpathia" me një kohë shumë të bukur. Po mbassi kaluan 3 ditt rugë hymë në një mjegull të dendur që s'ma kish zënë syri tjetër herë e dendur sa nuk shihte as vapori rugën, po edhe ne pasaxherët nuk dallonim dot njëri jatrin në kuvertë, përveç se për së afërmi.

Vapori u shtërngua të verë në vepërim sirenat (bilbilat fishkëllonjës) e tij, të cilat s'pushuan së vërshëllyeri gjer sa duallm prapë në dritë. Dy dit e një natë rrugë mbajti kjo mjergulla që natën e parë edhe për pak ment u përpoqmë me një vapor tjetër transatlantik që vijte nga Europa, me gjithë projektorët që drejtonin herë pas heret si njëri vapor si tjetri.

Shkuam shumë bukur në vapor me shoqëri, me muzikë, me theatra, me gjithëfarësh syiresh.

Pas 8 dittsh udhëtimi u duknë mallet e Portogalisë dhe pas 5 orësh hynim në qytetin e bukur të Lisbonës, kryeqytetit të Portogalisë, qyteti aqe romantik e pitoresk. Duallm e shetitmë nj'a tri orë brenda e pamë monumentat e kathedrale, parqet e kopshtet etj. të këtij qyteti.

Prej Lisbonit u nismë natën me një Hënë të plottë e të kjartë e me Oqeanin vaj, si pasqyrë. Të nesërmet në mëngjes ishim në Spanjë dhe qëndruam në Gjibraltar. Shkelmë edhe një herë në Europë, që më vinte se do mos e shihnja kurrë edhe me gjithë që isha aqe ditt lark Shqipërisë me dukej sikur isha në shtëpi t'ime.

Pas 3 dittsh udhëtimi arthmë në Marseilles (Marsilia) të Francës. Duallm edh'atje e shetitmë nj'a dy orë mjaft mirë. Edhe ky qytet n'a pëlqeu, po siç kishim përshtypjen e New Yorkut, këto qytete si Lisboni, si Marsilia n'a dukeshin si me shtëpi të unjta, si pa njerës e si të qelbura.

Lamë edhe Marsilien e ju drejtuam Genovës të Italisë, qytetit panoramik e amfitheatrik me ato bregore aqe të këndëshme, të mbushura plot me shtëpi. Arrijmë edhe ne Genova e duallm edh' atje jashtë më shumë se një orë, ku pamë mjaft gjërra të çuditshime.

Kur shkuam nga Genova pamë së largu ishullën historike "Elba" ku u internua si rob për të parën herë Napoleoni i math Buonaparti.

Lundruam gjatasi zallit mediteran të Italisë, tuke parë qytetet historike t'Italisë si Livornon, Pisën etj. etj. gjer sa arthmë në Napolin aqe të bukur e romantik që bukuri' e saj naturale si edh' ajo e Stambollit dhe pak a shumë ajo e Lisbonës nuk gjindet në botë. Napoletani thotë për Napolin e tij " Vedi Napoli e muore", "Shih Napolin pastaj vdis"!

Kur hyra në Napoli, në atë Napoli që më bëri aqe përshtypje të parën herë kur e pashë këtë radhë s'm'u pa gjë. M'u duk shumë i qelbur edhe ndërtesat tepër të ulta. Kisha akoma përshtypjen e kolosalitetit e të pastrisë të New Yorkut e Romës.

Kur do nisesha prej Napolit, në vent të mar rugën Napoli-Foggia-Bari, preferiva rugën Napoli-Salerno. Taranto-Bari, Brindisi, mbassi s'e kisha kaluar tjetër herë.

Kur shkova nga Napoli, në stacjon u poqa me një Shqiptar nga Progonati, i cili vinte edh' ajy nga Amerika, po me një dorë, se dorën e djathtë ja kish prerë fabrika në Amerikë. Muarm së bashku klas të II dhe u nismë, tuke bërë muhabet.

Kur arrimë në Metaponte, konduktori bërtiti nj'a dy herë që duhet të ndrojmë tren, po ne me shokun e dëgjuam si në për ëndër se flinim ahere edhe nuk u tuntmë nga vëndi. Treni mori prapë rrugën e tij. Nga mëngjezi u sqova dhe po pinja një cigare. Më vinte çudi si s'kemi arrirë akoma në Taranto, ndonse që kur u nismë nga Napoli e gjer ahere kishin kaluar më shumë se 12 orë, kur se prej Napolit në Brindisi s'ishte më tepër se 10 e1/2-11 orë.

Më në funt humba durimin e kur kaloj andej konduktori e pyes: nuk do t'arrijmë ndo një herë në Taranto? Ç'ka dreqin është kjo që kemi 12 e sa orë e s'kemi sosur akoma në Taranto? Kur dëgjoj kështu konduktori u mahnit dhe zu po shante Napolitançe. Pastaj kthehet e më thotë: Ç'Taranto e gorica-fica po më psall? Ne këtu jemi në Calabria dhe tash po i afrohemi qytetit Regio! Regio? Folë mir' i thom. Se e dinja gjeografisht se qyteti Regio (shkruar edhe greqisht H. K.) ishte në funt të Italisë dhe kundrejt qytetit Messina të Siçiljes. Si, në Regio jemi? po i thom. Po, po, thotë, hane ku e kemi lënë Taranton. Kjo është vija e Calabrisë. Aman bre, i thom, po tani? Tani, thotë konduktori duhet të kthehi prapë gjer në Metaponte me trenin që vjen pas një ore e shkon për atje, edhe s'andejmi do merni tjetër tren të shkoni për në Taranto.

T'a marrë djalli ç'pësuam! Kur udhëton me njeri të shenuar si unë me doracin Kristo nga Progonati, ç'të mirë do preç? Ca avaze të këtilla do të të gjejnë. Për mbi atë kisha frikë se nuk arrinim edhe vaporin për në Vlorë e ahere duhet të prisnim një javë tjetër.

Konduktori n'a urdhroj të dalim jashtë posa që mbrimë në stacjonin më të afërm, që ishte stacjoni historik i Sibarit (shkruar edhe greqisht H. K.). Dal me një herë jashtë tuke nxjerrë edhe valixat e mija. Zqonj pastaj edhe doracin bashkudhëtar. Ç'është thotë, qir Hristaqi? Ngreu i thom se arthmë në Brindisi. Shyqyr o Zot, thotë, n'a u sosnë taksiratet! I mora edhe valixat e tija e i qita jashtë, se ajy s'ish i zoti t'i qitte jashtë vetëm me dorën e mëngjër.

Del jashtë me sytë gjysmë të mbyllur prej gjumi dhe si shkoj treni më thotë: ku e ke Brindisin, qir Hristaqi? – Ja, i thom, përpara e ke, nuk e sheh? Qe edhe së pari po n'a prêt! – Ku, xhanëm, ku i ke këto që po thua? më thotë. Ahere ja krisa gazit. Ajy e kuptoj me një herë se kishim lajthitur rrugën e fillonj të qanjë. Ç'ke, more derë-zi, i thom? Çuditem, thotë si të qeshet. Po ç'munt të bënj, i thom? Nuk sheh se gabuam të ndrojmë tren në Metaponte e arthmë këtu në Kallabri? Muarmë dal nga dalë, ose më mirë të thom, mora vetë valixat dal-nga dalë e i solla në stacjon. Sibari katundi ishte pak lark, kur se aty s'ish tjetër përveç se stacjoni e deti.

Posa kish zbardhëllyer. Shoh atjé tej një çesmë që po rrjedhte një ujë i kulluar. Nuk vemë, i thom, atje ne kroni të lajmë pak sytë të na hapen më mirë? U nis me mua e vamë ne kroni e lamë sytë. Unë, mbassi piva një tjetër cigare, e si e pashë që jemi në një vetëmi të qetë, nxora një ocarinë të vogël që kisha në xhep e fillova të mar disa avaze italike. Kristo doraci po çuditeshe ku e gjenja gjith' atë oreks. Ti qofsh, më thotë, si të bëhet e po i bija bilbilkës. S'ka gjë, i thom, s'ka gjë. Mbasse n'a del për hair.

Më cazë shëkojmë nj'a 3-4 goca që po vijnin me shtëmbat mbi krye për të marrë ujë. Na salutuan italisht dhe zunë të mbushin ujë. Kur ç'të dëgjonj? Ato po flisnin shqip me njëra-jatrën; na qënkeshin Shqiptarka prej Kallabrije. Unë mora kurajo e ju flas shqip këtyre gocave, të cilat po çuditeshin si ditkan shqip. Jam arbëresh, zojusha, i thom si edhe ju.

Ato u kënaqnë edhe me qenë se i pyeta ku e kanë katundin, m'a treguan me gisht e më thanë se është lark. Ahere, si ju tregova edhe hallin që n'a gjet, ato të mira vajza, n'a proponuan që po të dëshironim munt të shkonim me ato gjer në katunt, të njihnim edhe babën e njërës prej syresh, i cili ish i vjehri i kapostacjonit të Sibarit.

Kështu shkuam me ato më këmbë gjer në katunt e n'a rekomanduan me prindët e tyre, njerës shumë të butë e më fort plaku, i cili u kënaq se qënkemi Arbëreshë.

Si ndejmë nj'a dy orë n'a gostitnë me kafe me qumështi etj. u ngritmë të ikim, po ku na linte plaku? N'a mbajti për drekë e n'a theri një gjel, e vezë të frigueme.

Si hëngërm e pimë mirë edhe si n'a këndoj plaku edhe disa këngë shqipe, u ngritmë që të tre me plakun e arthmë në stacjon, ku n'a rekomandoj të dhëndrin , që ish kryetar i stacjonit e kështu ajy n'a futi në klas të I në tren që ikte mbas dite për në Brindisi, pa paguar gjë. Kështu falenderuam Kapostacjonin dhe plakun e mirë, e muarm rrugën për Taranto. .

A e pe tani, i thom Kristo Doracit se n'a dolli për mirë ajy ndalim? Prandaj, edhe një herë tjetër s'lipsesh të dëshpërohesh. Kështu vamë në Taranto dhe q'andej në Brindisi. Vapori për fatin tonë nisej të nesërmet mbrëma për në Vlorë.

Si arthmë në Brindisi, ditën e nesërme në kafen' e madhe "Cafe internazionale" hasëm me cilin? me konsullin tjetër herë të Turqisë në Karvasarâ, atë që më kishte shpëtuar tjetër prej thonjve të Grekëve. Ajy u çudit kur më pa, se më dinte të vrarë prej Grekëve. Prandaj atë dit më mori për drekë në shtëpi të tij, mbassi njihesha fare mirë edhe me zonjën e me djalin e tij.

Kur po hanim bukë n'a vjen një agent i kompanisë "White Star Line" i Napolit, i cili i lutet Konsullit në qoft' e mundur t'a dorëzonjë gjer në Korçë një pasaxher Shqiptar që është kthyer prej Zyrës së imigrandëve t'Amerikës, të cilin ishte e detyruar ajo Shoqëri, mbas ligjeve amerikane t'a dorëzonte në vent, mbassi s'ishte pranuar në Amerikë. E me qenë se ky agenti s'kishte qenë kurrë në Shqipëri e kujtonte se mos është ndo një farë zullullandi ku munt të hahen edhe njerës, ju lut Konsullit t'i japë sa shpenzime të dojë mjafton t'a marrë përsipër ta degdisë gjer në Korçë me një dëftesë të Policisë Korçës që u dorëzua.

Konsulli Ermen ahere, mbassi unë kisha vizuar passaportën t'ime për në Shqipëri, m'u lut në ish e mundur t'a mernja përsipër këtë Shqiptar t'a dorëzonja në Korçë e t'i dërgonja një dëftesë nga Policia e Korçës që e muar në dorëzim.

Kur më thanë se ajy Shqiptar i kthyer ishte nga Korça, mentova që mundet edhe t'a njoh, prandaj kërkova më parë t'a shoh. Pra, në kërkimin t'em hidhet agenti italjan e thotë se ajy Shqiptari është përposh në shkallë, se e kish sjellë gjer atje agenti. I thom ahere axhentit, me lejen e Konsullit të n'a e ngjitë lart Shqiptarin.

Agjenti zbriti poshtë edhe e mori Shqiptarin e n'a e solli brenda në odë, ku hanim bukë. Kur ç'të shoh? Ajy Shqiptar i shkretë posa më pa m'u derth e më përfshin për gjunjësh e zu qante si fëmijë! Më kishte njohur, po unë s'e kisha shembëllyer mirë kush ishte, se ish i parojtur, i palare, i reckosur, i qelbur, i ligur.

E ngreh përpjetë, kur, o djajt e Ferrit!.... Ishte ajy Shaqiri që u nda nga mua në Chayenne Wayoming ahere kur unë humba biletën në tren e më shtërnguan të dal në Chayenne. I thom, ti Shaqir je? Unë thotë.

Konsulli dhe agenti italjan u çuditnë kur panë që më njihte dhe e njihja. Ju tregova ahere historinë, e cila i çuditi mjaft. Fundi, unë e mora përsipër Shaqirin me shpenzimet e agjensisë dhe e dorëzova në Korçë, tuke i kthyer Konsullit dëftesën përkatëse të Policisë së Korçës.

Shaqiri kishte hequr të zit' e ullirit që kur u nda nga mua në Chayenne. Po ajo i dolli për mirë, se mbassi dolli në New York e s'dinte gjuhën e as kuptonte se nga do shkonte, e kish marrë Policia ja kish dorëzuar imigration offisit, dhe ajy shoqërisë White-Star-Line, me të cilën shoqëri kish ardhur në Amerikë dhe e detyroj t'a dorëzojë pa të holla gjer në Korçë. Kështu nga kjo shoqëri hëngri e piu badjhava e ardhi badjhava gjer në shtëpi të tij! Ja, këtij i thonë kësmet!

Atë natë u nismë nga Brindisi dhe të nesërmen në pikë të sabahut po hynim në liman të Vlorës e kështu pashë edhe një herë Shqipërin' e dashur e të dëshëruar!

Në vapor duall e më pritnë ime shoqe me t'ime bijë Teftën, një hyll me të vërtet bukurije, si dhe baxhanaku im Jovani me të shoqen e tij Marigonë.

Arthmë në shtëpi ku n'a plakosnë miqtë nga të katër anët, dhe nuk ngjinjesha dot së pari andej këtej e së fjalosuri me miqtë, e më vinte si kur shihnja ndo një ëndër. Ç' është njeriu? Të vejë në tjetër botë, të largohet aqe shumë edhe prapë të kthehet në të tijtë.

Po çupa ime Tefta s'desh të më afroheshe me gjithë që e mora me të mirë e i dhashë çokollatna. Asaj i gjëmbuan pak mustaqet e mija të ashpërta edhe e mori frika, se e kish lëkurën të butë si katife.

Kështu ardha prapë në Shqipëri me vendim që të mos los më nga vëndi im dhe t'i shtrohem punës sido që të jetë, se kur kujtonja hamallëket e Amerikës më vinte kijamet!

# XIV

Kështu isha kthyer nga një udhëtim aqe i gjatë gjer në funt të Amerikës, ku, për të rotulluar gjithë cirkonferencën e lëmshit të dheut, nuk më mungente veç se 2/5 akoma mbassi të 3/5 i kisha shetitur. Edhe në këtë udhëtim kaqe të largët më pat shtyrë si thashë nevoja e bukës po edhe taksirati i patriotismës.

Në atë Amerikë, vëndin e çudive, si kur se thashë kisha shprovuar gjer tani zanatin e restaurantjerit, zanatin e akulloreshitsit, atë të ëmbëlshitsit, të kafexhiut edhe të sendvitzjerit. Po ku t'a dinja unë i grati se në fat më ruheshin të shprovonja dhe të tjera zeje!

Sido kudo u sheshova e u përmblodha me familjen t'ime edhe sidoqë s'kisha kapital më tepër se 22 napolona, nuk mendonja aspak të shkonja më në Amerikë, ku hoqa aqe e aqe, edhe ku e pashë se duhet të kisha krahë të forta, se ndryshe diploma s'bënte as 5 para.

Gjith' uzdaja ime ishte se do fillonja prapë nga profesjoni jem në Vlorë, mbassi kishte ndryshuar mjaft edhe situata, dhe kishim një farë rehatije nga Xhon-Turqit.

Për pak ditt fillonja prapë profesjonin t'em dhe zura të fitonj nga pak e isha i kënaqur. Po, nuk e di se si një tjetër eveniment do vinte të n'a turbullonte edhe një herë qetsinë e të n'a shpërngulte familisht nga Vlora Shqiptare.

Kur ardha në Vlorë, midis atyre që ardhë në shtëpi e më përshëndoshnë ishte edhe Kostaq Kotta nga Korça. Ky ishte kthyer aso kohet nga Parisi e ndodhej si sekretar në klubin e nacjonalistëve në Vlorë. Unë e njihnja që në Korçë, kur ish akoma student në gjymnas, po Kostaq Kotta ahere kishte vazhduar disa kohë në fakulltetin e Medicinës në Athinë pa e mbaruar e pa marrë diplomë.

Kostaq Kotta më tregoj një miqsi të madhe në Vlorë, ndonse unë në Korçë kurrë ndo një herë as që e kisha salutuar, se e dinja për grekoman të fortë, si kur se grekomanë ishin gjithë familjet që sillnin embrin "Kotta" në Korçë. Sikur se grakomanë ishin edhe i ati e të vëllezërit e këtij si edhe e ëm' e tij kryetare e sillogut të grave grekomane në Korçë. Si tashti, Kostaq Kotta, ritur në mes të grakomanismës, munt të ishte një shqiptar i flaktë, si m'a rekomanduan? këtë s'e besonja dot. Më vinte në dyshim se mos ishte ndo një i dërguar nga shoqëria "Helenismos" i Megali-idhesë greke, për n'a vezhgëllue ne Shqiptarët ç'bënim e si silleshim në Vlorë. Prandaj e pranonja me rezervë.

Po Kostaq Kotta më vinte për dit në shtëpi e më tregonte një patriotismë të madhe, gjë që më kënaqte shumë. Dal nga dalë u bë si i shtëpisë edhe ne e prisnim e e përcillnim me gëzim.

Po kur iknja nga Salt-Lake City, im kunat Kristua më kish porositur të bënja si të bënja t'i gjenja së motrës Angjeliqisë një burrë, mbassi ish ahere 22 vjetsh. Të ishte nga an' e Kristos nuk do të çanja kokën, mbassi m'u suall aqe liksht e mbassi ajy ishte shkaktar që ika nga Amerika, po ishte për Angjeliqinë, kunatën t'ime, që e desha shkuar motre. Prandaj gjithë që e kisha këtë ndër ment.

Mirë po gratë kishin kaqe kohë që më theshin t'a mblesëronja me Kostaq Kottën. Idhea s'ishte e keqe, por se Kostaq Kotta s'kish një punë, s'kishte një zanat. Si t'a mblesëronja me atë? Ajy Universitetin s'e kishte mbaruar, dhiplomë medicine s'kishte, po as i ati s'i dërgonte gjë, si do bënte pra, në qoftë se do martoheshe? Këjo më vinte në një dyshim dhe nuk munt t'a vendosnja.

Nga ana tjetër Kostaq Kotta ish edhe i martuar një herë me kurorë e kish edhe një çupë në Athinë, si do bëheshe? Ju a thashë edhe së motrave, po ato prapë më ngutnin, mbassi gruan e parë me gjithë çupën i kishte lënë prej vjetësh e munt të merte divorcë.

Një ditt e pyeta Kottën tërthorazi ç'qëllon të bënjë paskëtaj në Shqipëri! Në krye e pashë se ish obtimist, po kur i vura përpara vështirësit' e jetës në Shqipëri, e që as si msues s'munt të jetonjë njeriu në Shqipëri, e pashë se u topit fort e e kapi dëshpërimi. Siç kuptova ajy më

vinte rrotull se mos e mernja në Amerikë në një rast që munt të kthehesha prapë atje, pa sa për navllonin munt të ma jepte kur…. ishallah të gjente punë atje.

Po Kristua s'më linte rehat as pak. Më luteshe me ç'do therori t'ja heq prej qafet. Ahere i shkrova edhe unë idhenë t'onë për Kostaq Kottën dhe pas pak mernja një përgjigje t'a mbaronj sa më parë, më dërgoj edhe 300 dollarë e më thesh që merni këto e nisuni për në Amerikë, tuke marre me vehte edhe gruan e çupën t'ime. .

Ahere edhe ne e vendosmë qa t'a bënim dhëndër.

Një dit, pra, siç ishim të dy vetë në një odë të klubit në Vlorë, ja zura fjalën tërthorazi, a dëshëron me të vërtet të vijë në Amerikë e m'u përgjeq se mjaftonte t'a mernja dhe do bënte ç'do therori që të mos ndaheshe nga ne. Gjeta rastin ahere e i thom që mbassi do ishim gjithë tok kush e di se si munt t'a sillte fati e e bënim edhe vëlla me të vërtet. Ajy qeshi ahere, tuke më vënë përpara pengimin që ishte i martuar e i rronte gruaja. Unë i thashë që ajo është një punë që ndreqet, se kush do t'a kërkonte gjer në Amerikë. Kështu që Kostaqi e pranoj të bëheshe vëlla me ne e të mertë për grua Angjeliqinë, të cilën ja propozova.

Vinj e ju thom grave, të cilat u gëzuan fort edhe pas dy orësh e prisnim në shtëpi jo si mik më, po si dhëndër. Kështu i vluam Kostaqin me Angjeliqinë.

Tani unë mendonja t'a dërgonja vetëm Kostaqin te Kristua dhe i shkrova për këtë Kristos, po ajy, i cili kishte aqe tepër frikë se mos ja jepnja të hollat e kërciste nga ndo një anë tjetër, më shkroj urgjent që të nisem me do e mos edhe unë me atë dhe më premtonte se ç'kish e ç'nuk kish do t'i kishim bashkë, do të ishim ortakë etj. etj. po aman t'ja heq qafe të motrën.

Ahere pashë ç'pashë e mbassi edhe s'ime shoqeje i vijeshe n'Amerikë pranë s'ëmës, vëllezërve dhe motrës vendosmë të nisemi së bashku që të katër, do. m. th. ne të tre me gruan e çupën dhe Kostaqi. **Gafë e madhe**!

U nismë me një shi të math prej Vlore, hipmë në Vaporin e Llojdit Austriak "Melpomeni" e shkuam nga ana e Dallmacisë për në Triesht, ku do mernim vaporin e Canard Line, që do nisej ato ditt prej Trieshtit me anë të Napolit, Palermos, Spanjës për New-York.

Pas 3 ditve ishim në Triesht. Të nesërmen do të mernim vaporin "Carpathia" po atë vapor me të cilin kisha ardhur vetë prej Amerike pak muaj më parë.

Fati i keq një natë më parë se të nisemi n'a sëmuret liksht preh hetheve Kostaqi dhe kaq' u zbe e u dobësua sa s'njiheshe në fytyrë.

Kur hipmë në vapor ne të gjithë n'a nxori të shëndoshë doktori i vaporit, po Kostaqin e nxori të sëmurë edhe s'ishte e mundur t'a pranonte në vapor me gjithë lutjet t'ona e të disa njerësvet akoma.

Kështu me hidhërim të math u shtërnguam t'a lemë Kostaqin në Triesht, gjë që na bënte të ktheheshim edhe ne. Po mbassi vapori do vinte edhe në Fiume, ku do rri-

nte 3 ditt, pata shpresë se mos t'a futnin brenda Kostaqin kur të iknin nga Fiumja. Dhe e porositë Kostaqin të gjindet atje të nesërmet nga an' e tokës.

Kur athmë në Fiume i pari që na dolli si fante-bastun në molin ishte Kostaqi. Mbassi u përpoqmë edhe një herë me atë e mar me maryfet e e fut brenda në vapor, po nuk shkuan dy orë edhe kur u bë një kontroll i dytë i pasaxherëve nga an' e mjekëve të vaporit, n'a zenë prapë në presht Kostaqin, n'a marin e n'a qitin jashtë, për helmin e math t'onin që u ndamë prapë. Kështu bashkë me biletën që i kisha dhënë për gjer në Amerikë i dhashë edhe 30 napolona të tjera që të niset e të vinjë nga an' e Francës.

Të lemë tani ndarjen me Kostaqin e hidhërimin e math që kemi ndjerë atë dit e të zemë hallin t'onë.

U nismë nga Fiume e arthmë në Napoli, tuke kaluar nga kanali i Siçiljes midis qyteteve historikë Regio e Messina. Në Napoli ishte një epidemi koleret asokohet dhe bashkë me pasaxherët e tjerë që kishin hyrë brenda në vapor u gjetnë edhe nj'a dy të sëmurë prej kolere. Kur e kuptuan doktorët në vapor me një herë i isolluan këta të dy, të cilët para se të arrimë në Spanjë vdiqnë njëri pas tjetrit e i hodhë në det!

Po sëmundja ishte përhapur midis pasaxherëve të klasit të III dhe brenda 10 ditve që mbajti udhëtimi që prej Spanjës deri në New-York n'a vdiqnë 18 shpirt, të cilët u hodhë në det, simbas zakonit detar, pa shumë komplimenta. Nj'a 5-6 prej këtyre i pashë edhe vetë me syt' e mija e u mallënjeva tepër. Sidomos dy prej atyre sqenave ishin aqe të tmershme e të mëshirshme sa edhe sot i kam ndër ment! Ishte një djal' i shkretë që kish ardhur prej Amerike për me marrë një nënën e vet që kish aty afër Napolit, në "Caserta", për me e çue në Amerikë, ku punonte edhe vetë. Tjetër kent s'kish veç s'ëmës edh' ajo e kish bir të vetëm. Kur pamë n' atë ças të mnershëm që po e lidhnin djalin e ngratë pas një drase me një lëmsh hekuri në krye për t'a hedhur në det, plakën e shkretë që po çirreshe e cfiliteshe e e çonte zërin gjer në kubë të Qiellit e desh të hidheshe edh'ajo me djalin e vetëm t'a përcillte n'atë dynja tjetër, ah, s'n'a u mbajtnë lotët! S'paska gjë m'e tmershime. S'harrohet ajy çash kurrë!

Si e hodhë djalin në det, nuk shkuan dy orë dhe tjetër tragjedi n'a çfaqet përpara. Plaka, e ëm' e djalit që s'duronte dot vetëmin' e saj lark djalit, u hoth edh'ajo në Oqean! Deri sa të lajmohet kapitania, deri sa t'a marri vesh mirë, vapori ishte larguar më se 3 milia dhe kapitanët nuk u sëkëlldisnë edhe shumë për një viktimë të tillë të fatit. E lanë! Di kush tha më një nënëqeshje prej kapitanëve: bëri shumë mirë që i vajti djalit pas, ç'e desh vehten pa djalin?

Episodi tjetër ishte prapë me një italjan, një dhëndër të ri, i cili kish ardhur edh' ajy nga Amerika e ish martuar në Itali e kish marrë një grua katundare italiane e po e çonte në Amerikë. Edhe ky i shkreti nuk shpëtoj. Po klithmat e të bërtiturat e asaj së mjere grua që mbet qyqare në vapor mbassi i flakërinë të shoqin në det, n'a këputnë shpirtin!

Me një mijë halle mezi arrimë në New-York.

Atje tjetër siklet. Nuk n'a lënë të dalim jashtë. Bëmë 5 ditt karantinë. Aty m'u sëmur edhe çupa ime Tefta.

Kur duallm jashtë në Castel Garden dhe si u grumbulluam në salonin e math të emigrandëve filluan të n'a examinojnë me radhë. Tjetër siklet këtu, që për pak mënt

më ndanë nga gruaja e nga çupa e ment më ktheu prapë në Shqipëri, po për fat më shpëtoj gjuha anglishte, të cilën ahere e flisnja mirë.

Nga pocaqit ' e mbëdha që hajmë e nga valët e mbëdha si male të Oqeanit unë isha dobëtuar fort. Kisha mbetur kosk' e lëkurë dhe i zbetë në fytyrë. Pra, kur po shkonim me radhë si dhënjtë tuke u kontrolluar, tre vetë që po qëndronin përpara së dalmes të emigrandëve, kur kaloj gruaja me t'ime bijë bashkë me një zonjë greke e me të birin e saj Nikon, që ishim së bashkut në një kabinë, ata i lanë të lirë dhe kaluan jashtë e munt që atë ças të shkonin ku të donin, kur se mua më shënuan me një tebeshir të gjelbër si të sëmurë dhe më hoqnë në një dhomë tjetër bashkë me ndo 20-22 vetë të tjerë emigrandë gjith ashtu të sëmurë, ku n'a priste një komisjon i posaçëm doktorësh për examinim.

Ime shoqe u tremp fort, kur më pa se u ndava nga ajo dhe kërkon të më vinjë pas bashkë me çupën po s'e lenë. Unë prapë s'dinja si t'a mbanja me gairet.

Posa që u mbyll dera e dhomës së kontrollimit doktorbashi n'a bërtet të gjithëve "xhvishi lakuriq". "Lakuriq"? Medet, thashë me mëndjen t'ime, vaj halli ç'do n'a gjejnë.

Një nga një n'a shtrinë më krahëzaj përmbi disa bango të mermerta. Nga sikleti i math s'dijnim se ç'të bënim. U xhveshmë, u shtrimë dhe n'a hipi një e qeshur e pa-sosur se shihnim shoqi-shoqin me veshje adhamike. Qeshnin edhe doktorët.

Gjysmit po thua prej nesh midis të cilëvet isha edhe vetë u gjetmë të sëmurë e u vendos të n'a kthejnë prapë nga arthmë, të tjerët i liruan.

Deh, o hall, deh tani ishte rreziku më i math, të lë gruan e çupën e të kthehem prapë! Po ato të mjerat ku do vinin pa mua? Të ktheshim mbajse që të tre prapë, po me ç'të holla që s'kishim?

Më hipi një andrallë, një zjarmi në kokë që s'e tregonj dot. Po prapë në atë dëshpërtim nuk e humba pusullën. Afrohem te kryemjeku e i thom në një gjuhë të pastër inglize: zoti

Doktor ç'sëmundje më gjettë që po më ktheni prapë e më ndanë nga gruaja e foshnja e vogël, që mezi i prura gjer këtu? Doktorit piksëparti i tërhoqa vërejtjen që i fola anglisht. Qysh, thotë, e ditke inglishten? Si jo, i thom, kam qenë mot-mot në Amerikë në Shtetin Utah. Ashtu? thotë. Po ahere më mirë për ty, veç se na vjen keq se natura të paska krijuar të çalë, e ne këtu në Amerikë, me kanunin t'onë nuk pranojmë të hynë të çalë e sakatë në Shtetet e Bashkuara.

Ahere më ra ndër ment që disa ditt më parë kisha përdredhur këmbën e djathtë dhe çalonja pak. Pra mar një kurajo me një herë e i jap fuqi vehtes e fillonj të shetit me të dy këmbët 2-3 herë gjatazi salonit. Kqyrni, i thom, zotni, kqyrni si bares më mirë se ju akoma!

Ata ja përmbushnë gazit dhe doktori më përkëdhel nj'a dy herë në shpatullat e më le të lirë, tuke më dhënë edhe laisser-passer-në. Bëj hesap si kur të mos dinja inglishten, do t'a pësonja keq. Do më kthenin nga ruga pa ditur as shkakun.

Kështu dolla q'andej si qeni nga zinxhiri, u derdha me të shpejt në salonin e të liruarvet ku mezi gjeta t'ime shoqe dhe çupën që po vriteshin së qari për mua, si njëra, si tjetra.

Shëkonj ahere valixat dhe vërenj se mungente një çantë, bash ajo çantë që kishim nj'a 150 dollarë e gjithë vëdhët, byzylyqet e xhevahiret e tjera të s'ime shoqeje. Çanten? i thom me një herë, ç'e bëre çantën? Gruaja ime si ishte fort e pikëlluar u turbullua dhe s'dinte se ç'i mungente. Ajo zonja greke me djalin e saj

Nikon një djalë 18 vjetsh kishin ikur bashkë me çantën, pesë minuta më parë. Lë ahere gruan e çupën e derdhem shpejt afër molit nga niseshin vaporet për në destinascjonet e ndryshme. Më ra ndër ment se ajy djal' i asaj gruaje më pat thënë në vapor brenda se do vijnin në Lynn, qytet 2 orë lark Bostonit, ku kisha vajtur edhe unë nj'a 3-4 herë një mot më përpara.

Ahere vrulem shpejt, arrinj vaporin pa shkuar, mar lejen nga nëpunësi kompetent e hynj brenda në vaporin që do nisej atë çash për Lynn, e gjenj Nikon dhe i mar çantën. E hap sa kaqe me çilsin një kisha me vehte e mbassi i gjeta në rregull ç'kisha brenda, i lashë e shkuan.

Vinj prapë e gjenj fëmijën t'ime dhe si e pashë se ishin të lodhur shumë kërkuam leje te rinim nj'a 2-3 ditt në New-York. Po autoritetet e emigracjonit nuk dëgjonin për të madhe punë të n'na lijnin, sepse kishim deklaruar më parë se jemi për në Salt-Lake City.

Si e pamë se s'ishte e mundur u nismë, me gjithë që ishim të vrarë nga udhëtimi e nga sikletet e tjera.

Kur arthmë në Chicago e duallm prej trenit të çlodheshim frynte një er' e marrë sa n'a plevitosi. Kjo erë shkaktoj të më sëmuret çupa e vogël që gjer ahere ishte si një trëndafil. I hipi një hethe me një herë. Kur vamë në Omaha-Nebraska shkuam më një hotel e ndejmë dy ditt, po ime bijë Tefta nuk merte për mbarë. Kur arthmë në Ogden ju mbyllë sytë krejt edhe nxori me një herë fruthin.

Në Salt-Lake City, vërtet na duall e n'a pritnë mirë im kunat Nikua, ime kunatë Angjeliqia dhe Vasua e Fereniqi, fëmij' e s'ime kunatë Marigosë, po taksirati i çupës dhe sëmundja e t'ime shoqe, që ishte edhe me barrë, më prishnë gjithë qefin.

U munduan me doktorë – doktorët kërpaçë të Amerikës – e me ç'muntmë tjetër që t'a shpëtonim atë farë gocë si trëndafil, po s'qe e mundur. Pas një javë n'a fluturoj ky engjëll, që n'a pikëlloj zembrat si mua, si s'ëmës. Fqinja mormonë që kishim rotull, gra e burra n'a bënë një nder të math në varrimin e së ngratës vajzë me kush e di sa aurora e automobilla që e përcuallm gjer në banesën e saj të fundit, tuke mos n'a lënë të harxhojmë as metelikun dhe tue n'a dhënë një koxha darkë, ku u thirë edhe priftët mormonë, të cilët n'a ngushëllonin me lumturit' e Parajsës, me jetën e pasosur e plot pilafe të asaj botës tjetër e me një mijë e sa ngushëllime këso-doret. Atë natë fjala s'më delta nga goja; më vinte plasje për një humbje t'atillë për atë vajzë që e kisha ngushëllim.

Atë natë, afër mezit të natës, ku gjithë gratë e burrat të qederosur ranë të flenë, vetëm unë po vegonja, tuke pirë cigare e tuke shetitur posht' e lart dhomës e tuke u menduar. Kur na, po troket dera. Vete e e hap vetë. O, Perëndi ç'të shoh? Kishte ardhur Kostaq Kotta, i zi

plehë, me një fytyrë efgjiti, plot blozë thëngjilli e tym chemin-de ferri, i kapitur e i hallakatur, sa mezi që e njoha!

E mora brenda, zgjova të shtëpisë e kështu e kaluam gjith'atë natë me muhabet. Të nesërmen i vluam zyrtarisht me Angjeliqinë, tuke trajtuar me anë të Notarisë kontratën e martesës e kështu ditën e trëtë, në mes të një kallaballëku të math edhe me priftë mormonë i martuam. .

Këtë herën e dytë që vajta në Amerikë isha mjaft i dëshpëruar, më tepër se herën e parë! Prisha punën t'ime që të kënaq jo Kriston, nevrasthenikun exentrikun t'em kunat, po më fort vjehrën t'ime, që ishte një grua shentnore e aqe e lartë dhe kunatën t'ime Angjeliqi qe e desha aqe fort. Pra, si e pashë se as Kristua, as Nikua

kishin një punë me terzi, edhe nga ana tjetër si humba edhe ate farë çupe për hatër të tyre, m'u përshti jeta dhe mendohesha të kthehem me gruan t'ime në Shqipëri, ku munt të jetonja rehat edhe më mirë si zot!

Po ahere m'u vunë të gjithë të ri, Kristua edhe Mikua më kërkuan pardon për sjelljet jo të mira kundrejt mejet, i cili edhe sikur të mos isha njeri i shqencës, isha sidomos vëllaj i tyre më i math se duhet të më respektonin e jo të më përdornin si ndo një skllav të tyre, mbassi fati më shtiri në dorë të tyre. **Ata më muar më qafë!**

Kështu, me qenë se kishin marrë që të dy një furrë dhe puna shkonte mirë me myshterinj Italjanë, Shqiptarë, Grekë, Bullgarë e Syrjanë, mbetme d'akord që të mbanja unë me Nikon furrën dhe Kristua të dy dyqanet e tjera, për të cilat bëra fjalë më lart. Sa për Kostaq Kottën, ky, me qenë se s'kish punuar kurrë në jetën e tij, as që i pëlqente puna, ishte edhe dhëndër e lamë rehat dhe kështu e shkonte gjithë kohën me muhabet me gratë, me të ngrën' e me të pirë mbi kurriz të të tjerëve. Ku do gjente më mirë Kostaq Kotta? E pamë edhe ne gabimin që u bë me këtë farë burri që nga të pamët ç'ke me të, mustaqen gjer në vesh, shtat-burna etj. etj. po nga të bëmet një tembel i math, një parasit i keq, një rëndësirë e paduruar! Po fajin s'e kisha unë e kishin gratë Marigoja e Urania që më ngutnë në Vlorë, e pati Kristua që me gjithë që ja kisha përshkruar hollë kush ishtë Kostaq Kotta, ajy me do e mos desh t'i jepte të motrën!

Me furrën shkuam mot-mot mirë, me gjithë që Kristua s'i linte të qarët, me gjithë që vinte e grindeshe për hera e kërkonte të holla, të cilat as unë s'mernja vesh se ku i harxhonte, e më lintte një karvan njerës mbi krye, për të cilët ai pak s'përkujdesej gjer sa shkoj edhe në spital i sëmurë, e mbeta krejt vetëm.

Nga ana tjetër Nikua ja ngriti mëndjen Kostaqit të shkojnë në St. Louis, Mo, se atje paske shumë Shqiptarë e shumë punë, ku Nikua do punonte si magahazin (pa një qëndresë e pa një ekonomi) edhe Kostaqi do bënte heqimllëk (edhe ky pa një diplomë, pa një experiencë etj. etj.)

Në krye i kështillova të mos iknin, po mbassi vunë këmbë, u vendos të niseshin, tuke marrë edhe Angjeliqinë.

Në atë koh' e sipër që ishte muaji i Marsit 1911 edhe kur po pregatiteshin këta që të shkojnë dhe Nikua mori një shumë para prej mejet e m'a shiti pjesën e tij të furrës, mua më ngjau një taksirat.

Tek po ngjitesha i ngarkuar prej furre që të vinja në shtëpi për drekë edhe posa zbrita prej njërit tramway që t'i hipnja tjetrit që vinte gjer në shtëpi, një automobil që po vinte me një shpejtësi të madhe më godit me anën e parafangut të tij e më flakëron pashpirt 5-6 metra lark. E humba mëndjen dhe s'mora vesh si më çuan në një farmaci e më kishin lidhur plagët. Si s'më la në vënt ajy automobil ishte çudi!

Si ardha ndërment mirë më suall në shtëpi dhe rashë si i vdekur në shtrat me dhëmbje të mbëdha. Ky aksident i ndaloj nga rruga Nikon dhe Kostaqin, të cilët u shtërnguan të mbajnë furrën t'ime gjer sa u shëndosha mirë dhe u ngrita nga shtrati.

Po një e keqe s'ardhka edhe pa një të mirë, një gëzim. Atë natë, në mes të dhimbjeve të mbëdha që kisha, n'a qenë dhimbjet edhe t'ime shoqe. Më ra ndërment ahere se këto dhimbje

ishin dhimbje lindjeje. Medet thashë me mëndjen t'ime, tani gjeti edhe këjo të pjellë, s'priti sa të shërohesha?

Zgjonj shpejt nga gjumi t'ime vjehrë dhe Angjeliqinë, dhe ato me një herë zunë të pregatiteshin, zgjuan edhe Vason, të cilin e dërguan shpejt t'i thosh Miss

Haldey, një zonjë milionare mikeshë mormone fanatike që kishim afër, që t'i lutej të n'a rekomandonte një mami për Uraninë. Por se ajo ishte edhe vetë mami, e ngrihet shpejt e mer gjithë instrumentat me eftike e vjen në shtëpi.

Aty në odën që ishte shtrirë Urania isha rënë edhe unë në krevatin tjetër si i plagosur e i dërmuar. Miss Haldey thotë që s'bën të jetë zotnia këtu kur pjell e shoqja. Po i thotë Angjeliqia, janë gjithë odat zënë e s'kemi ku t'a vemë. I përgjigjem unë anglisht nga krevati tjetër: Miss Haldey, të lutem shëko punën e m'a fal, se kështu si kam rënë unë as që munt të tundem, jo edhe të ngrihem të shoh se ç'bëni ju gratë.

Nuk shkoj një ore që kur ardhi Miss Haldey, po kur dëgjova një zë fëmije, një zë foshnje, si të ntrashur. Mbas 3-4 minuta më afrohet ime kunatë Angjeliqia e më jep sihariqin në vesh që Urania lindi djalë. Mos e pyet, pra, gëzimin t'em. I harova të gjitha. Djali u lint mirë dhe pas një javë e pagëzuam ne dhe këtë mormonisht, tuke pasur kumbarë të kushëririn e tij Vason evogël, i cili e qojti Wiliam-Pirro , të cilin m'a fali Zoti mbi gjithë fëmijët e tjerë që humba.

Pirrua im u lint, pra, më 11 Marsit 1911.

Si mbaroj edhe kjo fasarì e si u ngrita më këmbë e si dolli prej spitalit edhe Kristua, i përcuallm për në St. Louis që të tre Nikon, Kostaqin, Angjeliqinë.

Mbeta unë në shtëpi, po thuaj vetëm, se Kristua, për shumë shkaqe, nuk desh t'afroheshe në shtëpi.

Në këtë koh' e sipër gjau edhe episodi gazmor me z. Vogler e te nipin Harry, mormonit fanatikë, të cilin episode e kam treguar gjatt' e gjërë më parë. Gjith'atë borç që i kish Kristua Mr. Voglerit u shtërngova t'a paguanj unë, mbassi n'a kreditoj me 80 e sa thasë mjell z. Vogler.

Kristos i kisha dhënë edhe 740 dollarë të tjerë të paguante disa borxhe grekësh që ja u kish marrë më parë, të cilat mbassi s'ju pagoj, një dit më kanë ardhur në furrë nj'a 8 grekë prej atyre dhe fjala-fjalën një prej tyre Gjiritlli më nxori edhe kamën të më therte po e ndaluan të tjerët. Kishin të drejtë Grekët, se parat' e tyre kërkonin, po kusuret e Kristos i paguanja gjithë unë.

Si do që vinte mirë puna, isha mërzitur fort. Ishim 7 vetë në shtëpi e duhet të punonja vetëm unë që të ushqeheshim. Ç' taksirat kisha unë për fëmijën e Kristos e të Marigosë? Po më vinte keq edhe duronja. Mir po kur vajti thika në koskë dhe e pashë që s'durohej dot Kristua, i cili në or' e sipër ngriti një gotë të m'a sjellë surratit, ahere u pa se s'roheshe dot me atë dhe kështu e vendosa të largohem nga ajy. Po ku të vinja?

Desh Zoti dhe u gjent një zgjidhje, nje "Deus ex machina" si theshin Latinët edhe këjo ardhi në këtë mënyrë:

Shoqëria historike Shqiptare e Bostonit "Besa-besën" që botonte aso kohet fletoren kombtare "Dielli" më parë me direktor Fan S. Nolin e më von nënë drejtimin e Faik Konitsës, mbasi u zu me këta e i përzuni më thiri mua nga Salt-Lake City, tuke më propozuar drejtorin' e "Diellit" me 50 dollarë në muaj dhe 10% shtesë mbi sa do mblidheshin prej gazete.

Rast më i mirë për mua për t'u çkëputur prej Salt-Lakut e më fort prej mizorive të Kristos s'bëhej më.

U mora, pra, vesh me të dy kryetarin e arkëtarin e shoqërisë Kol Rodhe dhe Llambi Çikozin e mbassi më dërguan harxhet e rrugës, i dorëzova furrën Kristos me

veresijet e borxhet që kish furra, por kurdoherë në gjindje të mira dhe me shpresa fitimi të mjafta, edhe këtë jo vetëm pa ndo një interesë, po edhe me damin e math t'emin, i

konsenjova[1] mallin që kish brenda edhe isha gati të lë Salt-Lakun, ku do linja edhe t'ime shoqe dhe djalin t'em gjer sa të shihnja si a munt të qëndronja në Boston e të zinja shtëpi e m'andej t'i sillnja edhe ata ku isha vetë.

Iknja me një të math siklet nga Salt-Laku ku, përveç zanateve të tjera të qymyrxhiut, të gjelltarit, të hotelxhiut, të ëmbëltarit, të garçonit etj. që msova, kisha msuar edhe mjeshtrin' e furxhiut, të kafexhiut e të arabaxhiut, mbassi m'u desht për disa kohë të mbanja bukët ne myshterinjt' e ndryshmë që kisha, të shpërndarë në të katër anët e Salt-Lakut, ku venja i gjenja me psarinë kalin t'em që hiqte arabanë e vogël. Të lumt', or avokat diplomé i Universitetit të Athinës!! Eh, ç'nuk mson i shkreti njeri nga nevoja?

Kështu një dit u nisa nga Salt-Lakku, tuke lënë fëmijën t'ime atje në dorë të Kristos, edhe me qenë se më kishte plasur shpirti të shetitnja vënde e vënde të Shteteve të Bashkuara, mora e çkëmbeva kush e di sa vija hekurore, tuke shkuar kush e di nëpër sa e sa Shtete posht' e përpjetë, linkthi e tërthorazi gjer sa pas 10 ditsh arriva në Boston, ku më pritnin pa durim Shqtptarët, të cilët më pritnë me enthusiasmë të madhe me qindra, grumbulluar në stacjonin të Nordit në Boston, në atë Boston, ku kam jetuar një mot-mot i lumur e i qetë dhe me gjithë dinjitetin e duhur, tuke i shërbyer Atdheut me gjithë fuqin' e shpirtit e tuke përhapur sa ishte e mundur propagandën nacionale nër gjithë kolonitë Shqiptare për një bashkim të plottë, gjë që e nxora në skaj si do t'a tregonj më poshtë.

## XV

Në Boston më bënë një pritje shumë të bukur Shqiptarët. Përmbi 300 shpirt ishin grumbulluar në stacjon e po më prisnin pa durim, edhe mbassi ishin përvëluar e dëshpëruar prej predecesorëve më të parë të mij, Fan Nolit e Faik Konitzes, mua më prisnin si një Messiah të dytë, si një reformator.

Mbassi u përshendoshmë e u njoha me të gjith'ata Shqiptarë, shumicën e të cilëve e njihnja që më parë kur isha në Boston, hoqnë ne restorant "Skënderbeu" ku n'a kishin pregatitur një drekë të mirë e ku gjitha sallat e restaurantit ishin okupuar prej nesh.

Me të vërtet ndjeva një kënaqësi zembre të madhe atë ditë, edhe po filosofisnja ç'është ky njeriu i shkretë, ç'është kjo botë e si hipën e zbret njeriu në për shkallët e fatit! Kujtonja zanatet e ndryshme që u shtërngova të vepronj i shtyrë prej asaj idhesë kombëtare, prej idealismit nacional që po më mundonte kaqe tepër e pastaj krahësoja ato me situatën e sotme, ku e shëkonja se isha thirur më një misjon të naltë përpara Atdheut. Ç' është njeriu, e si harrohen shpejt të shkuarat! Mendonja si në Salt-Lake u hamallova krejt, sa edhe i ngarkuar për dit ngjitesha në shtëpi, për atë familje që Kristua m'a la përsipër e s'përkujdesej, edhe sa ndryshim do kisha tani që do kisha nënë urdhrin t'im kaqe sherbëtorë edhe pozitë të naltë e të dalluarshme.

Si hëngrëm mirë-mirë e si ngritme dolli disa prej syresh për mua dhe unë për ata, për shoqërinë "Besa-besën" e për Atdhenë, shkuam nga hotel restauranti e më përcuall nj'a 10 vetë deri në Warrenton Street, afër zyrave të gazetës "Dielli" ku më kishin kaparuar një odë shumë të mirë e të mobilluar mjaft bukur, me banjë etj. etj.

Si ndejmë no nj'a 10-15 minuta u ngritnë e shkuan të gjithë, përveç një Shqiptari shkurtabiq, i cili u mbërthye në një kolltuk e s'loste nga vëndi.

Unë kisha nevojë të lahesha e të ndrohesha e të flinja pak të çlodhesha, si i lodhur që isha prej udhet.

[1] consegnare = me dorëzue (nga italishtja H. K.)

Naturisht, mbassi ajy mik shkurtalaq nuk e kuptonte këtë nevojë që kisha, u shtërngova t'i sillem pak fisnik e t'i jap një purro, të cilën e pranoj e e ndezi dhe filloj një farë muhabeti ndërmjet nesh.

Po ç'munt t'i thesha tani e të më thoshtë? Fjalët ishin mbaruar dhe duhej t'a kuptonte të ikte e të m'ë linte të qetë se edhe ora ishte 2 mas dite.

Për të shtyrë kohën, pra, filloj ky muhabet:

Unë. Më duket se diku të kam parë, po s'më bije ndër mënt, fytyr' e njohur për e njohur.

- Ajy. Pa më kujto mirë dhe do gjesh cili jam.
- Vallahi se më bije ndër ment. Harronj çpejt
- S'më njeh, or, a?
- Jo, për kokën t'ënde, jo M'a trego embrin
- Unë jam Vani…. .
- Cili Van , jahû? Vanër ka 45 e ca…. edhe gati isha t'i thom "45 Vanër as për një tru këndezi"
- Vani i Katos!....
- Ha!.... Vani i Katos, thé, Vani i Katos? Edhe e zura edhe një herë për dore. Si je mor Vani, si e ke Katon?
- Katua vdiq, më thotë
- Vetë shëndosh ahere, po si je qysh je? etj. etj. Edhe meazellah se e njoha se cili Vani i Katos ish ajy perzhunk, që aqe insistonte t'a njihnja
- Po m'a fal, i thom, se nuk të sjell akoma mirë ndër mënt. Më thuaj, allah ashkénâ, Vani i Katos, i cilës Katoje, a e njoh unë Katon?
- He, ore, Vani i Katos Lenkes, s'më mban ment?
- Uuuuuu!.... Vani i Katos Lenkes, more ç'thua? Ja tani mezi të njoha. Po si jeni, Vani, si shkoni, si i kini nga shtëpia?
- Mirë, mirë thotë (nuk lexohet po duhet të jetë "po ju si jini").
- Shumë bukur, i thom, të fala ké nga të gjithë, fëmia të puthin dorën.
- Ei-vallah, thotë, i paça shëndosh.

Po prapë s'e sillnja ndërment dreqin cili Vani ishte ajy edhe si lipsej t'a mar vesh më mirë. Prandaj kuxova t'a pyes edhe një herë.

- Or, më ndje, se të rashë më qafë. Nuk më thua, as aman, nga ishte Katua, ose Lenkua, cila do prej tyre? Nga ishin aman?
- Ehuhaaaaaaa!.... Po ti s'më njohkërke fare, bré Kristaq!
- Jo s'të njoh si duhet, më vraft mushk' e priftit se në të gënjej, aman m'a kallzo se më lé merak. Cili Van je?
- Eh, or, hé, Vaniii i Katoooos Lenkoooos nga Drenova
- Po ashtu thuaj, or i uruar! Tani të mora vesh e ju hodha për qafe. Edhé.... as pak s' e kisha marrë vesh këtë njeri enigmatik se kush ishte!.... Vani i Katos Lenkos nga Drenova! Ashtu thuaj deh, tanimw bije ndër ment. Mos. . . ké qënë ndo një herë yzmeqar ne xhaxhaj im Kristo Mitkua?
- Yzmeqar, unë? Jo, xhanëm, unë jam nikoqir.
- Nikoqir? Ahere më ndje! Kam gabim.
- Mos ke qenë mullixhi në Mborje?
- Mullixhi? Mullixhi? Ore folë mirë, ti s'më njohkërke fare, duket! Unë jam dhëndri juaj.
- Dhëndri jonë? Ore folë mirë, paskemi edhe ne kësi dhëndurësh? Kjo është një lumëri. Po, si je, more dhëndër i dashur, si të kam?
- Mirë, mirë, plasa gjer sa më njohe! A më njohe tani, pra?
- Tani s'të njoha? Tani aqe të njoha sa s'ka. Tani më vjen ndërment. Po ti, i uruar nuk më theshe që në krye që të kemi dhëndër, po më kallzonje se je Vani i Katos Lenkos etj. etj.

- Do me thënë tani më njohe mirë.
- S'ka dyshim. Po dëgjo, Vani, mbassi të paskemi edhe dhëndër, unë jam i lodhur e do të lahem e do fle. Nuk munt të vish nesër t'a pasojmë këtë bisedim e tani të më lesh vetëm? E më ndje se po t'a thom, se të kemi t'onin. Nuk ësht' ashtu?
- Po, po. Por unë ri këtu e këndonj gazeta gjer sa të lahesh e të flesh.

I paudhi desh të rinte në odën që do flinja e të priste gjer sa të zgjohesha. Dhëndër ky, nuk munt të nxiret jashtë, me gjithë që akoma s'më binte ndër ment nga e kemi dhëndër. Po, Vani i Katos Lenkos, duket se ndroj mendim edhe ngrihet të shkonjë gjer më një vënt, e më thotë se pas nj'a dy orë po kthehet prapë. Dhe si e përcolla gjer ne dera, prapë s'm'u durua t'a pyes edhe një herë, që t'a mar vesh mirë cili është.

- Të lutem, i thom, edhe një fjalë. Nuk më thua çilën ke marrë nga fisi jonë që të kemi dhëndër!

Vani i Katos, ahere, ja krisi të qeshurit. Tani e mora vesh, thotë, se kemi një orë që

po bisedojmë edhe akoma s'më paske marrë vesh cili jam. E, pra, thotë, unë kam marrë kushërirën t'uaj Sijen. E more vesh tani?

- Sijen? Sijen paske marrë e s'më thua? Ç'thua mor Vani, paske marrë Sijen ti?

Haj, medet, haj, po ashtu thuaj të merremi vesh…. Edhe të më mertë djalli se në kisha kuptuar akoma se cila Sije ishte ajo që n'a mori burrë atë farë kastraveci.

- He, më thotë, a t'u mbush koka tani?
- Po, po, i thom, m'u mbush, e mora vesh.

Posa dolli prej meje Vani i Katos Lenkos u has me mikun t'em At-Naum Cërren, i cili e kish të njohur e folnë pak bashkë e u ndanë. At Naumi, vinte ne mua, e si u poqmë e pyeta: aman, cili është ky shkurtabiq që po më thotë se e kemi dhëndër e unë s'e shembëllenj aspak? Nuk e njeh, më thotë At Naumi? Ku ka marrë një kushërirën t'uaj, a ç'e kini, një farë Anastasia (që Vani i Katos Lenkos e quante Sije) që ësht' e bij e Markos Dhimë-Dekos. Hu, hu, hu, bërtita nje herë!.... Tani po, e mora vesh me të vërtet. Ajo Sija, ishte e mbesa e një s'im'emte, e teto Ndinos, d. m. th. e bija e së kunatës saj Markovicës, që ajy ditshkurtri Vani i Katos Lenkos kujtonte se e kisha kushërirë, që unë s'e kisha asgjë!

Këtë meselé të shishme kush e di sa herë e kam rëfyer nër miqt' e shokët e mij, që disa prej syresh kanë qeshur kaqe shumë sa kanë qarë, ose ju është zënë kafshorja në grykë!

U zgjatmë ca me Vanin e Katos Lenkos, po ka qenë një nga të paktat episodi që më ka bërë të shkrihem gazit.

Kështu kaloj ajo ditë. Të nesërmen ju përvesha punës. Po pa filluar mirë ishte nevoja të kryesonj në mbledhjen e madhe Panshqiptare që u mbajt në Boston, ku zhvillova gjat' e gjërrë programin e vepërimit t'onë, e vepërimit d. m. th. të Shoqërisë historike "Besa-besën" i cili program u akceptua me unanimitet e me enthusiasmë.

Në atë rast e sipër mbajta një fjalë edhé mbi kujtimin e dëshmorëve djelmosha të Kombit Kostaq Kosturin, Odhise Kottën, Kristaq Furxhinë etj. gjithsej pesë veta, të cilët pak më parë kishin rënë dëshmorë për idhenë kombëtare prej bajonetave e kondakëve mizorë të Xhon-Turqve në fushën e Korçës, ku shkaktari i kësaj gjakderdhe të shejtë ishte vetë kapiten Rexhep Palla, tirani i math i Korçës dhe ndjekësi i rreptë i nacionalistëve, i cili pak më von u vra në mes të tregut të Korçës prej dorës së patriotit Vasil Tromarës nga Dardha. Këtyre dëshmorëve ju kushtuam edhe një kurorë të bukur e të vlefshime që jau paraqita prej anës së Shoq "Besa-besën". Ajo dit ishte një shkëndi për Shqiptarët e diegur të Shteteve të Bashkuara. Me të vërtet ajo fjala ime e asaj dite i përsëlloj e i ndezi të gjithë sa u ndodhë atje, se ja përshkrova me mënyrat më të zeza vujtjet e nacionalistëve të Shqipërisë prej sjelljeve mizorë e të egërta të Xhon-Turqvë.

Munt të thom se qysh atë ditë një tjetër lëvizje, lëvizje extraordinare u konstatua sidomos ne Shqiptarët e Bostonit, të cilët ishin më shumë se 800 shpirt asokohet. Këta të mërzitur fort

prej sjelljeve të Faik Konitzës e të Fan Nolit, prej të cilëve F. Konitzën pak ditt më parë e kishin dbuar me sharje e me fishkëllime, tuke i hequr prej dore edhe gazetën "Dielli" që Faiku e kishte qojtur "Dielli e Flamuri" dhe e kishte katandisur vetëm me dy faqe, si një copë lëvere prej 30 centimetrash të gjattë dhe 20 centimetra të gjërrë, dhe Fan Nolin tuke e syrgjynosur nga Amerika, i cili kishte shkuar në Rusi e mezi u kthye prapë 3 muaj më von se ardha unë në Boston. Që të dy këta i quanin parasitë, se përveç rrogave që ju jepnin, të cilat s'ju arrinin këtyre lordëve, po ju jepnin edhe para të tjera, ose lypnin a grabitnin nga mundnin, posë borxheve që kishin vënë si njëri, si tjetri që edhe sot s'janë larë nga Shqiptarët.

Numrin e parë të gazetës që nxora e qita në 4 faqe dhe në një formë pak

më të madhe se "Diellin e Flamurin" të Faik Konitzës. Dhjetë numera të tjerë më von i nxora me nga 5 shtylla dhe në formë dublë nga forma e numurit të parë që botoja, dhe gjithashtu gazeta "Dielli" përveç që delte rregullisht, pa u lajthitur asnjëherë, po sa po vinte smadhoheshe gjer sa arrin formën e një gazete për të qënë, rregull të cilin e mbajta gjer ditën që ja lashë prapë Faik Konitzës, si do t'a tregonj më poshtë:

Pika m'ë parë e programit t'em ishte të ndeznja zembrat e Shqiptarëve që të zgjoheshin e të vepëronin patriotikisht, tuke bërë edhe disa sakrificje, që gjer ahere s'kishin bërë gjë. Prandaj për t'i arrirë këtij qëllimi e para fillova të shkruanj ç'do kryeartikull për Turqinë e Xhonturqit, për tiraninë e mizorit' e tjera dhe për një avenir të shkëlqyer për Shqipërinë me një liri e indipendencë të plottë; e dyta organizova një seri konferencash patriotike, tuke ja filluar që të Dielën e parë mbas konferencës së Bostonit dhe prej qytetit të math Worcester, Mass, ku ishte një nga më të mbëdhatë koloni Shqiptare.

Kështu, mbassi krijuam edhe shoqërinë kishëtare "Sh. Gjergji" në Boston dhe rregulluam rrogat e të dy priftëve Shqiptarë që kishim, At Naum Cërres dhe At Dhamjanit, çohem një të Dielë e vete në Worcester bashkë me At-Dhamjanin, ku shqiptarët e atjeshëm të lajmuar për ardhjen t'onë kishin dalë si mizëri në stacjon e po n'a prisnin.

Si mbajti At Dhamjani një meshë në shqip, ardhi sëra të flas unë në kishë. Një inspiratë e aftë më frymëzoj atë ças dhe ju fola përmbi një orë sa munda. Kaqe u mallëngjyen, sa shumë fshinin sŷtë me lottë. Entusiasma e brohorit' e duartrokitjet s'tregohen dot me pendë. Kemi mbledhur një shumë prej 200 e ca dollarë si ndihma, e përveç kësaj, i shtova gazetës "Dielli" 78 abonatë më tepër.

Si n'a gostitnë mirë, mbas dreke n'a përcuall për në So. Framingham, në mes të një shiut me stomma. Në tren, ose prej trenit sa do që i këshillonja gjith'ata Shqiptarë që të ktheheshin se u qullnë prej shiut, ata s'ndaheshin, po kërkonin prapë edhe një fjalë. Ju fola prej trenit nj'a 5 minuta, që të mos i mbanja më tepër, se i pashë se kullonin në ujë, po ata bërtitnin të vazhdonja, tuke hedhur kapellat në erë gjer sa u ndamë. Dit' e paharruar!

Vijmë në So. Framingham. Tjetër pritje këtu, me gjithë që s'ishin më tepër se 80 Shqiptarë. Na hoqnë në një hall (sallë të madhe konferencash) ku ju mbajta një fjalë nj'a gjysmë ore, prej së cilës tepër u enthusiasnë dhe n'a dhanë 80 e ca dollarë ndihma përveç 34 abone për gazetën "Dielli" të reja. Gjith' këto lëvizje e këto të pritura i botonja natyrisht edhe në gazetën "Dielli", gjë, e cila solli një reaksjon të math në gjithë kolonit' e tjera, aqe sa me qindra n'a vijnin në zyrat e "Diellit" ftime[1] nga an' e kolonive e individve të ndryshmë shqiptarë për t'i vizituar edhe ata. Gjith'ashtu s'kish dit që të mos shtoheshin edhe pajtimtarë të rinj për gazetën.

Kur e mora përsipër gazetën gjeta 252 pajtimtarë. Kur hoqa dorë këta kishin arrirë në shumën e rrumbullaktë të 2360 pajtimtarëve.

Prej shoqërisë "Besa-Besën" merrnja një rrogë prej 50 dollarësh në muaj dhe 10% mbi të ardhurat e gazetës, të cilat arrinë gjer më 180 dollarë në muaj, që kështu më zinte muaji 200-230 dollarë, gjë që ju tëhoqi vërejtjen bukuroshëve t'anë Faik Konitzës e Fan Nolit e pas tyre

[1] ftime = ftesa (H. K.)

mikut t'em e t'atyre Kristo Kirkës prej Korçe, të cilët s'lanë gjë pa bërë gjer sa me dinakëri e mjete të çndershme vunë gazetën në dorë. Po për këto do flas më tutje.

Konferenca e tretë u mbajt në Brockton, Mass, në Elliot Street. Këjo ka qenë një nga më të bukurat e më enthusiastike të konferencave. Shqiptarët e Brockton, si një e një, djelmt të flaktë e shkrimtarë më të shumit, si Paskal Aleksi e Vangjo Mileri etj. etj. n'a pritnë aqe bukur, aqe me zembrë sa s'ju çpërblehesha për jetë. Se veç kësaj prapë ata u ndodhë për mua, kur hoqa dorë nga "Dielli" e më ndihmuan me 700 dollarë!

Edhe në Brockton, ashtu si në Worcester, më përcuall të gjithë gjer në stacion, kur nisesha për Boston dhe u shtërngova t'ju mbanj edhe një tjetër fjalë nga treni, gjë që enthusiasi edhe konduktorët e nëpunsit feroviarë sa për hatër t'onë e ritarduan zinxhirin trenor 15 minuta më tepër, të cilat i vunë në vënt, tuke çvilluar një shpejtësi më të madhe.

Një djalë piktor shqiptar më fali aty dy gjallëshkrime të mbëdha e artistike, një të Skënderbeut dhe një të Sami bè Frashërit, që kishin një vleftë mjaft të mirë. Këto në vënt që t'i mbanja vetë ja fala shoqërisë "Besa-Besën".

Konferencën e katërt, që ish një nga më të mbëdhatë konferenca që mbajta, ishte ajo e Sooth-Bridge-Mass-it. S'munt të mos vinja atje kur se edhè delegatë të veçantë kishin dërguar në Boston të n'a marrin.

Aty mora prapë At-Dhamjanin, i cili mbajti meshë në kishën e rè kombëtare e private të shqiptarëve në So. Bridge, për të cilën ata burra kishin harxhuar 5. 000 e sa dollarë që e bënë të re!

Në stacion do ishin për mbi 200 shpirt. N'a pritnë shumë bukur. Djelm të kulluar e hovardanj. Mbi të gjith'ata ishte kryetar i tyre Sotir Gjika nga Shtika e Kolonjës. Ky na mbajti edhe fjalë posa mbritmë në stacion. Të nesërmet në kishë u mbajta unë një konferencë nja orë e gjysmë. Kaqe u enthusiasnë, sa gjëmonte Kisha nga brohorit' e tyre! N'a dhanë 300 dollarë ndihmë për shoqërinë e gazetën dhe gati 100 pajtimtarë të ri u shkruan ne "Dielli". Pritja e So-Bridge-it mbet e paharruar në zembrën t'ime.

Të Dielën e arthme vamë në Manchester N. H. bashkë me patriotin prift At-Naumin. Aty gjetmë disa djelmosha shkrimtarë, ca oratorë të përmendun, që n'a bënë shumë përshtypje.

Atë Naum Cërja, si mbaroj ungjillin, ju mbajti një fjalë më tepër patriotike se sa fetare. Kur mbaroj m'a la radhën mua. Unë kisha dhe një flamur në gji, dhe tuke e sjellë fjalën mbi flamurin e shêjtë, e nxora nga gjiri e ja tregova me madhështi. Oh, s'rëfehet dot ajy ças, ku me sytë plot me lott i ranë në gjunjë flamurit dhe e puthnin me mallnjim. Ajo frenetismë, ajo enthusiasmë s'më del mentsh kurrë. Dy veta hapnë flamurin t'em e të tjerët vijnin duart në xhep e nxirnin dollarët e tyre e mbushnin flamurin! Për mbi 500 dollarë n'a dhanë ata atdhetarë të flaktë.

Deshim të niseshim për Boston, po Shqiptarët e Concord-N. H. që kishin dërguar në Manchester përfaqësonjës, s'na linin të iknim. Duhej me do e mos të shkonim në Concord, kryeqytetin e Shtetit New Hamscheer, ku mbajta konferencën e VI.

Edhe në Concord, ku s'ishin më shumë se 150 Shqiptarë, n'a pritnë shumë bukur e n'a përcuall me enthusiasmë të madhe, tuke n'a dhënë 100 e sa dollarë, 22 pajtime të reja për "Diellin" dhe harxhet e rrugës.

Si arthmë në Boston, kryetari i Shoqatës s'onë m'u lut të shkonj po atë mbrëma në Natick, ku presentohej edhe drama ime "Fè e Kombësi" që e kisha trajtuar në Vlorë, në kohën e tiranisë Xhon-Turke.

Shkova në Natick, Mass, ku isha mjaft i njohur, se dy vjet më parë në atë qytet kisha një restaurant dhe ndejta 3-4 muaj, si e tregova tjetër herë. Shqiptarët edhe këtu n'a pritnë shumë bukur dhe mbassi mbajta një konferencë të gjattë edh'aty, shkuam në një pik-nik të pregatitur afër liqenit fort të bukur e të kulluar të Natickut dhe pas një ore u gjetmë në hall-in e math të Natickut, ku u çfaq drama ime "Fè e Kombësi", prej një grupi amatorësh të ardhur prej

Worcesterit, shumë bukur e me shumë sukses. Kishin ardhur edhe shumë vendas Amerikanë e Amerikane.

Këtë dit kisha dhënë 3 konferenca dhe isha mjaft i lodhur e pregatitesha të shkonja në Boston. Po ku të lenë Shqipot e Natickut 200 e ca vetë! Më mbajtn' atje atë natë dhe të nesërmet në vënt të vinja në Boston, mora udhën e Cochituate-it, tjetër qytet afër Natickut, ku ishin ndo nj'a 100 e më tepër Shqiptarë. Colonia e Cochituate-it kish dërguar tre delegatë që më ftonin të vete atje të mbanj gjitashtu një fjalim.

Shqiptarët e atij qyteti, sa do të pakët, po ishin gjithë Korçarë e Dardharë të njohur, disa prej syresh ishin edhe nxënësit e mij që në Karvasarâ të Greqisë, ku i msonja shqip e i bënja nacionalistë Shqiptarë, e ishin një e një të zgjedhur e të qytetëruar e më pritnë me një enthusiasmë të patreguar. Mbajta edh' atje një fjalim e ja shtruam shqiptarçe afër liqenit t'atij qyteti, ku disa shakaxhinj n'a zbavitnë tepër me shakat' e tyre.

Atë mbas dreke kthehesha në Boston.

Shqiptarët kishin marrë një flagë të pashojtur prej këtyre konferencave, midis të cilave, qëllimi më kryesor ishte "Bashkimi gjithë Shoqërive Shqiptarë" të Shteteve të Bashkuara në një shoqëri të madhe, në një "Federatë Panshqiptarë".

Në Boston gjeta ftime nga më shumë se 12 koloni. Duhet të vinja, pra, e t'i vizitonja të gjitha. Shoqëria "Besa-Besen" nga ana tjetër kish deklaruar se nuk munt të bënte shpenzime udhëtimi për të tilla konferenca veçanërisht për ç'do koloni! Këtë kur e msuan kolonitë që më ftonin n'a dërguan të gjithë telegrafe qëharxhet e udhëtimit janë mbi kurris të tyre. Shoqëria, ose menaxheri i shoqërisë z. Llambi Çikozi s'kish të drejtë të bënte një deklarim të tillë se mjaft dhurata i kishin dhënë shoqërisë me anën t'ime, si dhe pajtime të panumurta për gazetën "Dielli".

Të Djelën tjetër shkova në Marlborouh, Mass, bashkë me At-Naum Cërren. Aty kisha edhe disa kushërinj të mij. N'a pritnë me një miqësi të rallë. Edhe së këtejmi s'ikmë duar-thatë, si me ndihma për shoqërinë "B-B" si me pajtime të rêja për "Diellin"' atë dit mbajta tjetër konferencë në qytetin e këndëshëm Hudson, Mass, ku u pritmë mjaft bukur. Në stacion më priti me një fjalë të mirë e plot patriotismë kryetari i asaj kolonije z. Baze. Edhe Shqiptarët e Hudsonit n'a nderuan shumë, tuke n'a hequr në hotelin më të mirë të qytetit e tuke n'a dhënë një darkë të mirë, ku muarm pjesë 30 e ca shpirt e ku ngritmë disa dollija.

Të nesërmet shkova vetë në Clinton, Mass, ku ishin nj'a 40 Shqiptarë. Më pritnë të gjithë gjer më një enthusiasmë të madhe. Edhe këtu mbajta një fjalë si ato të

tjerat. Vepra karakteristike në Clinton ishte këjo, që, "Dielli" s'kish as një abone këtu, se as një prej Shqiptarëve të atij qyteti s'desh të dëgjonte as për F. Konitzën, as priftin Fan Nolin. Unë munda e bëra aty 27 pajtimtarë të "Diellit".

Kështu me radhë të Dielën tjetër vizitova qytetin Centrall-falls, R. I, qytet pitoresk, ku mora at-Dhamjanin. Priftërit më vinin pas me radhë, kush e kush të më shoqëronjë më parë se edhe mirë shkonin me mua, edhe në për më të mirat hotele flinin dhe nga ndo një herë edhe diçka shkëputnin për vehten e tyre peshqeshe nga Shqiptarët.

Në Central-falls, gjeta edhe shumë të njohur Grekë prej atyre që kisha parë në Greqi. Çuditeshin si më shihnin me Shqiptarët Turq (!), (Turkarvanitas) si n'a quanin ata, kur se mua më konsideronin Grek omogjen. Po si muar vesht propagandën që po përhapnim zunë e po më shihnin me sy të keq. Një shqiptar vjen e më thotë, mbassi kisha mbaruar konferencën, se duhet të iknja shpejt, se Grekët e atyshëm deshin të më vrasin.

Ora më 3 m. d. e lashë Central-fallsin e u drejtuash në qytetin Londale, ku mbajta tjetër konferencë e mbeta atje atë natë. Shqiptarët e atyshëm n'a kënaqnë tepër.

Të nesërme shkonja në qyt. Woonsocket, qytet i gjërrë e i përhapur. Ka qenë dit' e Hënë atë dit, që punonin Shqiptarët e i prita gjer sa duall nga fabrikat. U mshtuall nj'a 60 vetë dhe ju mbajta një konferencë të mirë. Më përcuall me kënaqësi, po jo me hovardallëk të math. Munda të bënj vetëm 12 pajtimtarë të rinj të Diellit.

Po atë ditë pas dreke vizitova qytetin tjetër romantik Pawtucket, ku do ishin nja 30-35 Shqiptarë. Edhe këtu të shkretët mirë më pritnë. Aty bëra vetëm 4 pajtimtarë të rinj të "Diellit".

Nuk u ndala më tepër se dy orë këtu e ja mbusha në qytetin e math e historik të Provedence Conn. Qytet extra, mjaft i bukur e tepër historik. Pas Bostonit është metropol i dytë Providencë për indipendencën Amerikane.

Këtu kishin dalë nj'a 70-80 shpirt që po më pritnin. Kryetari i Shoqërisë (s'ja mbanj ment embrin e Shoqërisë) më priti në embër të shoqërisë e më thuri një dithyramb[1] të tërë. Ju përgjigja edhe unë me sërë.

Kishim bërë një darkë të mirë në restaurantin e math "Novara", ku hëngrëm shumë mirë e mbajtmë shumë dollira. Vamë en grup në kinema e në Variete! Fjeta atë natë në hotelin më të math e aristokratik të Providencit që quhej "Birmingham".

Të nesërmet rodhë edhe nga fshatrat rotull e u bënë nj'a 200 Shqiptarë. U mbajta një konferencë afro 2 orë, në mes të një enthusiasmi të patreguar. Ishte një ditë që do t'a mbanj ment për jetë. Enthusiasmi i atyre njerësve ishte aqe i math sa më shëkonin si një Mesiah, si një apostull, shpëtimtar të Kombit, gati ment më adhuronin.

Më shumë se 300 dollarë më dhanë për shoqërinë "Besa-Besën" dhe për gazetën "Dielli". Me qenë se do nisesha për në qytetin Attleboro, Mass m'u nisnë pas e më shoqëruan gjer atjé 15 veta.

Në stacjonin e math të Providencit n'a ngjau si edhe në Worcester e në Brockton. Të gjithë ardhë atje en grup që më përcuall. Deshin një konferencë tjetër. U shtërngova t'u flas disa fjalë, sa tërhoqmë kurreshtimin e disa qindra pasaxherë që ishin grumbulluar atje, të cilët n'a qarkuan e n'a vërrejnin lëvizjet. Edhe me qenë se konferenca po vazhdonte midis brohorive e duartrokitjeve dhe ligja e vëndit ishte që

të respektohej ç'do orator ç'farë do fjalë që të fliste e kundra kujtdo që të fliste qoftë edhe kundra Presidentit të Shteteve të Bashkuara, trenat qëndruan e më s'ikin, gjer sa u shtërngua një nga drejtorët e stacjonit të më afrohet e të më pyesë me një noblesë a do t'a zgjatnja akoma fjalën se po nguteshin pasaxherët të iknin. Ahere e kuptova edhe unë që e tepërova e tuke i kërkuar ndjesë mbarova fjalën në mes të një apotheosi[2] nga an' e Shqipove zembër-djegur të atij qyteti dhe hipa në tren. Brohoritë e përshëndetjet e tyre vazhdonin akoma gjer sa u zhduk treni. Edhe kjo ditë e paharruar. Në Attleboro mbajta edhe atje një konferencë të gjattë.

Ardha në Boston e u çlodha tërë javën. Atë javë takoj që ardhi edhe ime shoqe me t'em bir Pirron që ish ahere 8-9 muajsh foshnjë. I shoqëronte djali i s'ime kunate Vasua, i cili kësisoj ardhi të rijë me ne, tuke preferuar mua nga dajot e tjerë, të vëllezërit e s'ëmës. Atë të Diellë u nisa për në Valley-Falls, ku mbajta një fjalim të vogël, përpara 20-25 Shqiptarëve. Ika që atje dhe ardha në qytetin e Springfield. Edhe këtu s'ishin përveç se 30-32 shqiptarë. Gjithashtu një konferencë e vogël mjaftoj edhe për ata, sa t'i futim në vathën t'onë si dhe shumë Shqiptarë të tjerë që i kishim futur në atë mënyrë.

Bash n'atë ditë në orën 20 të natës arrinja në qytetin e math të Bedfordtit, ku më prisnin me qindra shqiptarë Kurveleshash, Proganatas, Labër, Çamër, Beratas, Himarjotë etj. etj. Ishin grumbulluar atje për mbi 500 shpirt: Sadik Lekdushi, një patriot i flaktë dhe Ramis Idrizi një çam nga Margëlliçi më pritnë në embër të të gjithëve dhe më adresuan se cili nga një fjalë në embër të të dyjave shoqërive që përfaqësonin. Edhe unë ju përgjigja gjithsecilit më radhë.

[1] ditiramb = Këngë korale e gëzueshme e plot gjallëri, që këndohej në Greqinë e Vjetër për nder të Dionisit, perëndisë së rrushit e të verës; Vjershë lirike madhështore, që lavdëron e himnizon dikë dhe që është e ngjashme me odën dhekuptimi i tretë është : Lëvdatë e tepruar që i bëhet dikujt a diçkaje (H. K.)

[2] apoteozë = Lavdërimi i një njeriu, i një ngjarjeje etj. në mënyrë të ngritur e madhështore (H. K.)

N'a shtruan një darkë të mirë në një prej konakëve të tyre dhe me që ishte ora 2 pas mezit natës më shoqëruan gjer në hotelin e bukur "Splendit" ku fjeta e u çlodha mjaft mirë.

Të nesërmet ju kam mbajtur dy konferenca me radhë, njërën pas tjetret dhe në mes të tyre ju kam recituar disa vjersha të Naim beut, të Vasso Pashës e të de Radës e Skirojt, të cilat i kanë enthusiasur tepër që të gjithë.

U përcolla tepër i kënaqur si nga pritja e fjalimet ashtu dhe nga të hollat e dhuratat që më ngarkuan si për shoqërinë "Besa-Besën" si për "Diellin". Ndihmat e tyre afronin të 400$.

Prej New-Bedfordit hoqa për në qytetin Lowell, Mass. Këtu nuk do mbanja ndo një konferencë se s'ishin më shumë se 15 shqiptarë, edh'ata llustraxhinj e bananeshitës, po për inat të grekëve, që munt t'ishin më shumë se 1. 000, u ndalova dhe atje e i mshtolla në një restaurant të gjattë, ku ju mbajta edh' atyre një fjalë të shkurtër e ju dhashë disa këshilla. Aty u ndodhë edhe ca Grekomanë Shqiptarë, të cilët zunë të fishkëllejnë e të trokasin këmbët. Shqiptarët e mij sa do të zgjebur që ishin si llustro e bananmenë po u çuan me një herë përpjetë e u kapnë fyta-fytas me Grekomanët Shqiptarë, ku muar pjesë edhe disa Grekë; dhe do n'a kish ngjarë ndo një rrezik më imath po të mos kishin arritur aty dy polismanë e t'i kishin shpërndarë. Dy prej syresh, një Grekoman Shqiptar edhe një Grek manjat, që ishin shkaktarët e parë e asaj zënje i muar në burg.

Pasdreket e lè Lowelin dhe i drejtohem qytetit të bukur Bedfort, Me, me të cilin e ndan një lum' i bukur prej qytetit tjetër Sacco, Me, që duket si kur janë një qytet që të dy, mbassi janë afër e afër. Këta dy qytete janë aqe të bukur e pitoreskë sa kalojnë ç'do përshkrim.

Shqiptarët e të dy qyteteve, më të shumtit vakëfllinj prej Luarasi, Trebicke e Stratobërdhe, po edhe shumë Korçarë, Kolonjarë e Përmetas më pritnë shumë bukur. Me qenë se u ndodh aty një kushërira ime, i shoqi i saj nuk më la të shkonj në hotel. Kështu ndenja 3 ditt në Bedfort e Sacco, Me dhe mbajta dy konferenca.

Në konferencën e dytë n'a ngjau një episodi. Një shqiptar Himarjot, Thanas Beni, një djalë shumë trim po Grekoman gjer në palcën e ashtës, i vënë prej Grekëve e Grekomanëve të Saccos që të vinjë të shohë ç'do të flisnim në atë konferencë kundra Grekëve, ardhi e hyri në hall (në sallën e madhe të konferencave) dhe me qenë se Shqiptarët e Saccos e njihnin si për njeri kavgaxhi[1] dhe heqës kobureje, s'deshin t'a linin brenda e mundoheshin t'a nxirnin jashtë. Un' e pashë që së largu këtë fasari e ju thira Shqiptarëve t'a lenë të lirë të hynjë edhe më fort se qënka Shqiptar Himarjot. Kështu e lanë edhe hyri e vjen drejt për drejt në tribunë e më rekomandohet vetë kush është.

Zoti drejtor, më thotë shqip, këta Shqiptarët këtu thonë se (shkruar greqisht H. K.) (Aleksandri i Math d. m. thënë) s'ishte Helinas (grek) po gjoja ishte Shqiptar. Unë këtë s'e besonj, thotë, prandaj të kam rixha zotris s'ate të ma mbushësh mëndjen. Edhe në qoftë kjo e vërtetë do bëhem edhe unë Shqiptar. Ti je Shqiptar, mor djalë, se je nga Himara plakë e trime, i thom, po është nevoja t'i bëhesh krah e ndihmë Atdheut t'ënt, dhe mbassi dashke të marrësh vesh në ishte shqiptar Leka i Math, urdhro ri të dëgjosh se do flas mbi këtë çështje.

Thanas Beni ndejti dhe unë fillova konferencën piksëparit prej Aleksandrit të Math. Si fola mjaft për Maqedhonasit, Thrakasit, Epirotët e Illyrët, si shpjegova origjinën e dinastisë Maqedhonase, si analyzova jetën e Filipëve, pastaj të Alexandrit tw math dhe të trashëgimtarëve të tij, ahere prapë ardha mbi luftat e Filipit kundra Grekëve mbi fjalët Filipike e Olynthyake të oratori math Grek Dhemosthenit[2], dhe nga sa argomenta të gjallë që ju paraqita të shkrimtarëve gjermanë Kurtius, Krumbacher etj. etj. jo vetëm që u bint plotësisht

[1] kavga = grindje (përkthyer nga greqishtja me google H. K.)

[2]Demostheni, oratori i madh i Greqisë së vjetër, ka mbajtur katër fjalime të shkruara kundra Filipit të Maqedonisë (babait të Aleksandrit të Madh) gjatë fushatës së tij për pushtimin e Greqisë, prandaj këto fjalime të shkruara u quajtën "Filipike". Pas pushtimit të qytetit grek të Olintit, Demostheni mbajti tre fjalime të shkruara për dërgimin e ndihmave për atë qytet, për ta zgjuar nga gjumi ku kishte rënë ai qytet. Nga emri i këtij qyteti morën emrin "Oliantike" 3 fjalimet e shkruara të tija (marrë nga Wikipedia H. K.)

Himarjoti Thanas Beni, po edhe zu qante e më së fundi bërtiti sa mundi “Rrofshin Shqiptarët trima”!

Kjo konferencë ju pëlqeu të gjithëve, se ish tepër interessante. Mbajti më shumë se një orë. Thanas Beni tepër i enthusiasur vjen e kërkon të më puthë dorën; unë s’desha t’ja lè, po më së fundi m’a puthi. Nxjerr pastaj një banknotë 50 dollarësh e m’a jep tuke shtuar e tuke u folur Shqiptarëve: Ja ore, kështu duhet të darovitni dhe ju, jo më nxirni nga një e nga dy dollarë e të tjerat i vini në qemeret; Shqiptarët e vërtetë s’duhet të kursehen. Gjer tani kam dhënë për Grekët e për Greqinë, që sot e tutje do jap edhe shpirtin për nënën Shqipëri.

Thanas Beni qysh atë minutë ishte një Shqiptar i flaktë, si e provoj edhe puna më von, se ajy u nda e u bë armik me Grekët e Grekomanët e tjerë. Më vinte nga hera në Boston, si dhe më von në New-York dhe gjith’ i ndihmonte Atdheut me sa muntte. Më në funt kur u deklarua Shqipëria indipendente ka ardhur edhe në Vlorë ku e emrova policë e e kisha gjithë me vehte. Më në funt i shkreti u vra në Vuno të Himarës, atdhen’ e tij të veçantë prej andartëve Grekë, në kohën e Vorioepiriotëve, prap për çështje kombëtare. Grekët plasnë gjer sa e vranë këtë farë trimi.

Ishte kaqe trim Thanas Beni, sa kur e ablokuan 100 e ca andartë Vorioepirotë, ky mbajti 4 orë luftë me ta, dhe mbassi vrau 7 e plagosi nj’a 10 të tjerë, më së fundi që të mos binte në dorë vrau edhe vehten!

Kështu patriotët e Saccos e të Bedfortit tuke marrë shembëll nga Thanas Beni dorovitnë edh’ ata mjaft për shoqërinë “B. Besa” si dhe më shumë se 80 pajtime të reja dhanë për “Diellin”

Ika tepër i kënaqur prej këtyre dy qyteteve, tuke ja përmbajtur për në qytetin Bangor, Me, ku Shqiptarët më prisnin më parë se të vinja në Sacco e në Bedfort.

Shqiptarët e Bangorit më prisnin të gjithë në stacjon pa durim. Kur zbrita nga treni gati nuk shkelnja mbi dhè; po thua se më mbaninnë për duarvet, kaqe e madhe ishte entusiasma e tyre.

Atë dit u mblodhë Shqiptarët e Bangorit e Pennykookut, etj. gati nj’a 100-120 shpirt. Edhe këtu mbajta një konferencë të gjattë dhe ika mjaft i kënaqur. Të nesërmet u ktheva prapë në Boston.

Tani çështja ishte mjaft e arirë për një bashkim të përgjithëshëm, për një Konfederatë të madhe Panshqiptare dhe nuk mungonte veçse inisiativa.

Për posë këtyre qyteteve që përmënda gjer tani, vizitova edhe nj’a 15 të tjerë, tuke mbajtur kudo fjalime. Munt të them pa dyshim që i kisha shtuar Kombit t’onë të paktën nj’a 5. 000 Shqiptarë Nacionalistë. Propaganda bëhej shum’ e madhe e systematike dhe dita ditën po përhapej mbi gjithë pengimet që n’a sillnin patriotët e mbëdhenj Faik Konitza me Fan Nolin, herë njëri, herë tjetri dhe herë të dy bashkë.

Tani n’a kishte mbetur edhe një koloni e madhe Shqiptare, koloni që sado ish prej Shqiptarësh e hiqte vehte për Grek edhe me azallah se kuxonte ndo një propagandist Shqiptar të shkelte aty për ndo një propagandë, ose për të kërkuar ndo një pajtim për gazetën “Dielli”. Kjo Koloni e madhe ishte Lynni (Lynn, Mass), qytet mjaft i bukur afër detit, po edhe afër Bostonit.

Faik Konitsa, Fan Noli, Kristo Kirka që kishin vajtur tjetër herë atje, njëri pas tjetrit për të kërkuar ndihma, kishin hikur si mos më keq, të përzënë a të dbuar, edhe

prej këtyre Fan Nolin e kishin zënë edhe me gurë e e kishin sharrë liksht e më fort si prift. Andaj s’guxonte as një atdhetar të shkelte atje.

Kur hapa gojën e thashë përpara shoqërisë “Besa-Besën” se dua të vizitonj edhe Lynn-in, ata u hodhë përpjetë. Si ësht’ e mundur më thanë, kur në Lynn janë ata më fanatikët Grekomanë, që jo vetëm s’pranojnë konferencë Shqipe, po as të nqasin ne pragu i derës, e sidomos të zenë dhe me gurë. Unë do shkonj ju thashë, pa le të më zenë dhe me gurë, do t’a bënj, ju thashë , si Jan Hussi kur e thirë për apollogji në Romë, e kur miqt’ etij e ndalonin nga

rruga se do t’a gjente më e madhja e keqe. Jan Hussi tha ahere: Sikur edhé gjithë qeramidhet e Romës të më rëzohen përsipër unë do vete. Pra, edhe unë e vendosa të vete në Lynn, sido që të ngjiste.

E vendosmë, tuke caktuar ditën e Dielë që afronte. I thashë edhe At. Naum Cërres, po ajy pat frikë në krye, se mos e zijnin me lemonj të kalbur, pastaj u bint e më tha që ku të pësonj unë lè të pësonjë edhe ajy.

Në Lynn i vetëmi nacionalist që ish që Elia ose Louis Tromara nga Dardha. Këtë e lajmërova me një letër të veçantë se po vinj në Lynn, po edhe ajy m’u përgjigj që, “shëko mirë se mos nisesh se nuk garantohem për ç’të pësoni”

Të Dielën në pikën e mëngjezit u gdhimë në Lynn bashkë me At-Naumin. As n’a mori vesh njeri.

Ardhi ora 9 dhe vamë edhe nè në kishën e Grekëve me At-Naumin, se aty ishin mbledhur të gjithë Grekomanët Shqiptarë. Mbassi meshuan vet’ ata në mes tyre greqisht dhe vet’ u bënë priftë, vetë psalttë, vetë thanë Apostullin, vetë Ungjillin, at-Naumi hodhi një fjalë si me shakà midis tyre që a duan t’ju a thotë një herë

kolonjarçe Ungjillin, po atë Ungjill që ata e kënduan greqisht. Edhe me qenë se at-Naumi ishte shumë shakaxhì, ata ja pritnë prapë me shakà, “thuaje Papanuni, thuaje” me gjithë që shumë protestuan seriozisht dhe s’deshin t’a dëgjonin.

Elia Tromara hidhet e thotë : xhanëm, ç’do n’a gjenjë se t’a dëgjojmë edhe shqip Ungjillin? Thuaje Papanume, thuaje, i thotë: Tjetri prapë thotë: “S’ka gjë sa të tallemi pak me Papanumen. “Talluni, djelmt’ e mij, talluni me mua, ju thotë At-Naumi, edhe unë për të tallur po e them, ju vijni re e dëgjoni fjalët, por sa për gjuhën shqipe, atë ja u hithni patavet”.

Fjalët e fundit të at-Naumit i mbuluan qeshjet e haharismat. Ahere i dhanë të gjithë lejen At-Naumit të thotë ungjillin.

Edhe At-Nauni ja filloj, si tha, kolonjarçe Ungjillit, me një zë të naltë, të kjartë e të mallëngjyeshme, gjer sa mundi e tërhoqi vërejtjen të 150 e ca vetave që u ndodhë atje!

Unë po i vëzhgëllonja mirë, e i pashë se ju pëlqente në atë mënyrë t’a dëgjonin Ungjillin.

Si e mbaronj At-Naumi, u dëgjua një zë që “t’ja u shpjegonte atë Ungjill Papanaumi” se duket se ju pëlqente e deshin akoma t’ë dëgjonin. Dikush m’u afrua mua e më tha : thuajì priftit t’a thotë edhe një herë Ungjillin. Këto fjalë mua më enthusiasmë tepër dhe kthehem i thom At-Naumit që e kisha pranë e i lutem t’a përsëritë edhe një herë Ungjillin, po At-Naumi, kolonjar i xgjuar “ e thom edhe pesë herë, më thotë, po kam frikë se mos n’a ikin e s’i zemë dot pastaj, se mërziten, po tani e ke fjalën zotrote” më thotë. Edhe s’humbet kohë e ju kthehet dëgjonjësve : “Zotërinj, ju thotë, ju kërkoni t’ja u shpjegonj Ungjillin me fjalë të tjera domethënjen e kuptimin që ka Ungjilli i sotmë; po do më ndjeni t’ju thom se më pengojnë dy gjërra, e para se jam plak, e dyta se s’e kam zanat oratorinë e s’munt t’ju lëvdohem për këtë, veç do t’ju lutesha të më jepnit lejen që t’i lutem zotit Kristo Floqit të më çkarkojë nga kjo belà, ajy lè të flasë për mua, në dëshironi.

Ahere zërra shumë buçitnë : Po, po, të flasë z. Floqi…. Floqi, Floqi të flasë, tani duam tani…Urdhro, z. Floqi…. etj. etj.

Prej vendit që isha dhe mjaft i turbulluar, po edhe i enthusiasur prej atyre fjalëve fillova kështu :

Të ndershëm Zotërinj,

“ Ju falenderonj që m’a latë mua këtë barrë, të cilën e pranoj më gëzim, tuke shpëtuar kësisoj mikun t’em At-Naumin, nga një belà e madhe që do t’a gjente, si kur se tha më parë”.

Të dashur Zotërinj,

E shoh nga fytyrat t’uaja se sa me gëzim e dëgjuat Ungjillin e sotmë nga i përnd. At-Naumi. Të jeni të sigurt se gëzimi juaj vjen nga ndjenjat t’uaja që e dëgjuat Ungjillin e shenjtë në gjuhën amtare shqipe, në atë gjuhë me të cilën u linttë, u rrittë, u burrnuat dhe po jetoni, në

atë gjuhë që u lëkunttë në djepin e foshnjërisë, në gjuhën që pittë sisë, që foltë fjalët e para që lojtë me shokët t'uaj, me atë gjuhë që ju sjell nder të math, që dalloni se jeni Shqiptarë, me gjuhën, po thom, që ka folur ajy fatosi i math i Kombit, ajy luan i Shqipërisë që i theu hundët dy Sulltanëve më të mbëdhenj të Turqisë, heroji e shpëtimtari i Evropës Skënderbeuuuuuuu!. . .

Një rebesh i math duartrokitjesh, tingëlloj e i paprerë e një enthusismë e pa treguar priti fjalët e mija të fundit. Vërejta disa që fshinin lotët e tyre me shamia. As zë dëgjohej, as një pëshpëritje; të gjithë më kishin msŷe me shigjetat e tyre të sŷve; të

gjithë po më vëzhgëllonin. Ahere, mbassi edhe vetë u mallënjeva, pasonj me një zë të ngashërueshëm :

Vëllezërit e mij, Shqiptarë të dashur,

"S'është nevoja të m'a thoni, e kuptonj nga fytyrat t'uaja të ëmbla e sympathetike; ato më thonë tani sheshazi, se ata që thanë gjer dje se në Lynn s'ka Shqiptarë, ata që më ndalonin të vinja këtu, se mos pësonja fatin e precedentëve të mij, ata, po thom, ishin të gabuar! Ishin të gabuar! Këtu, o vëllezër, unë nuk shoh vetëm Shqiptarë, po Shqiptarë të flaktë, Shqiptarë të kulluar! Ndjenjat janë ndjenja kurdoherë edhe gjaku ujë s'u bëka! Jini edhe ju Shqiptarë si mua, në rëmbat t'uaja vlon gjith' ajy gjak që vlon edhe në dejt e mij. Munt të mohojë njeriu gjuhën, gjakun, fisin, kombin e tij? . Një njeri i tillë do jet' i poshtër, do jet tradhëtar!

"Tradhëtoooor!.... . buçiti gjithë holli.

Poshtë tradhëtorët…. . ja pret një tjetër.

Rroftë Shqipëria…. jehojnë zërrat….

Po, vëllezër – pasonj – rroftë Shqipëria, ajo

"Shqipëri që n'a jep nderin

"N'a jep embrin Shqipëtar

"Zembrën ajo n'a e gatovi

"Plot me dëshirë e me zjar,

si thotë edhe i pavdekuri vjershëtori ynë Naim Frashëri.

Rroftë, po, Shqipëria, ajo Shqipëri që ka nxjerë gjith' ata fatosa legjendarë qysh prej Lekës e Pirros së math e deri te âta i Kombit Skënderbeu.

Duartrokitjet, brohoritë, enthusiasmi i tyre kalon tani ç'do masë. U mbush salla rëckë e më s'zinte njeri tjetër. Një frenesi një dêje enthusiasmi një kijamet i math, sa

s'më lijnin të vazhdonja fjalën! Si pushuan duartrokitjet e brohorimet pasova konferencën, e cila mbajti një or' e gjysmë e mbaroj me një gazment të pashoqtë.

Kur zbrita nga tribuna, gati ment flytyronja në duart e tyre. S'mbet njeri pa n'a dhënë ndihmë. Gati të gjithë u bënë pajtimtarë të "Diellit", që gjer atë dit s'figuronte asnjë.

N' bënë një drekë shumë të mirë. S'n'a linin të shkonim. N'a ftuan të vemë prapë.

Kur ardha në Boston, u çuditnë të gjithë. T'atillë pritje s'n'a bëri as një prej kolonive!

Koha kishte ardhur për një mbledhje të përgjithëshme e për një bashkim të plottë e të përhershëm.

Mbas marrëveshjeve që kisha bërë, mbetmë d'akord me kolonit' e ndryshme dhe caktuam si ditë mbledhje ditën e 24 Dhetorit 1911.

Sado që Shoq. "Besa-Besën" nuk deshte as me sy t'i shëkonte Faik Konitsën e Fan Nolin, unë tuke i respektuar si patriotë e si intelektualë e si për më të çquarit nga gjithë Shqiptarët e tjerë, i ftova veçanërisht se cilin me nga një imitacjon të posaçmë

Fan Noli ardhë në mbledhje. Po Faik Konitsa, me qenë se s'e duronte dot këtë bashkim edhe më fort nga nakari i math që nuk e bënte vet' ajy, po e bënja unë nuk ardhi në mbledhje, po më dërgoj një letër të veçantë, ku me justifikohej se s'e kishte marrë vesh ditën e caktuar të mbledhjes, dhe se mjerisht atë dit ishte i okupuar të kryesonte komitetin e math (!) të tij, që e kish titulluar vetë "Flamuri i Krues" i cili s'kish as një program, as një qëllim përveç se qëllim çkatërrimin, sikurse kështu kanë qenë gjithmonë qëllimet e këtij patrioti të çuditshëm, që prej

marazit e ambicionit të math që ka pasur s'ka duruar as një patriot tjetër të marrë një flamur në dorë, një nismë patriotike e të udhëhiqte Shqiptarët.

Ky Komitei i famshëm i "Flamurit të Krues" që s'numuronte me shumë se një dyzinë anëtarë me gjithë kryetarin e tyre Faikun, përbëhej prej disa miqsh të tij të veçantë, disa bravo, që shtyeshin më fort nga cmiret e inatet që kishin me shokët e shoq. "Besa-Besën" se sa nga ndjenja patriotike e nga qëllime të tjera atdhetare.

Atë letrën e tij kur ja këndova mbledhjes u zembruan fort dhe u dëgjuan disa disaprovime për hesapin e z. Konitsa.

Ditën e shënuar të 24 Dhetorit u mblodhmë në sallën e madhe e historike "Rathbone hall", ku do ishin më shumë se 600 shpirt.

Përveç Shqiptarëve që muar pjesë si persona të veçantë, pjestuan edhe shoqëritë më të përmendura, "Besa-Besën" e Bostonit, "Dallëndyshja" e New-Yorkut, të cilën e përfaqësonja unë, "Arsimi" i Bostonit, "Shoqëria Kombëtare" e Worcesterit, "Skënderbeu" i Garry, ind. E disa të tjera të rëndësisë së dytë.

Si hapa mbledhjen ftova popullin të zgjedhë një kryetar për mbledhjen dhe si të tillë propozova Fan Nolin, që të mos theshnin se s'i nderonja kundrështarët e mij. Po Shqiptarët e asaj mbledhje u ngritnë me një herë më këmbë e protestuan:"Jo, jo, s'e duam atë, mirë je zotrote, zëre vëndin" Të tjerë bërtisnin: Floqin, Floqin, Floqin duam "jo njeri tjetër, ajy mori inisjativën, atij i përket. " Kështu u shtërngova e hapa mbledhjen në mes të duartrokitjeve të parreshtura, tuke mbajtur një fjalim të gjatë e tuke shpjeguar hollësisht qëllimin easaj mbledhje historike.

Mbassi muar fjalën me radhë disa oratorë më së fundi u bë një program prej z. Marko Adamos, që për formimin e një bashkimi të përgjithëshëm të zgjidhej një trup prej katër vetave nga më të zotët e më intelektualë që kanë kolonitë Shqiptare në Amerikë, dhe si të tillë proponoj: **Kristo Floqin, Faik Konitsën, Fan Nolin, Paskal Alexin.** Paskal Alesi prej Përmetit ish një patriot i zjartë, djalë si lipset, intelektual, shkrimtar, vepërimtar. Ky shkruante nënë pseudonimin"Pushkë" ca artikuj që të përsëllonin nga patriotisma. Veçanërisht ishte një nga miqtë më të fortë të mij, besnik gjer më të dhe kundrështar i Faikut e Fan Nolit.

Këtë proponim mbledhja e pranoj unanimisht edhe më fort se pjestonin aty né të dy më Paskal Aleksin. Kështu mori funt ajo mbledhje dhe né tani të katër, të porositur prej asaj mbledhje duhej të merreshim vesh e të mblidheshim për të formuar shoqërin' e madhe Panshqiptare, ose Federatën Panshqiptare.

Mbassi mbaruan festat e Krishtlindjeve, i ftova zyrtarisht të gjithë delegatët e emëruar. Faik Konitza në krye n'a bëri ca naze, po mbassi e lajmërova që edhè pa qënien e tij né munt të fillonim nga puna, u shtërnguar e ardhi edhè ajy me né.

Unë jy çvillova programin t'em që kjo Shoqëri e madhe e përbashkët do kishte qëllim politik dhe do formoheshin edhè filiale të tjera tuke patur qendrën në qytet të Bostonit. Do formonte një grup konferecjerësh që të shetisnin koloni më koloni në Amerikë dhe propaganda e jonë do përhapeshe edhè brenda në Shqipëri. Do vijnim në marrëveshje me njerëzit më të çquar politikanë e intelektuale të Shqipërisë kudo që ishin brenda e jashtë Shqipërisë dhe do bashkëpunonim. "Dielli" do të ishte organi i asaj shoqërie Panshqiptare, dhe me këtë bashkë do paguanim edhè gazeta të tjera të huaja nga më të përmëndurat të bënin propagandë për idhenë Shqiptare.

Faik Konitza me Fan Nolin ishin të mendimit të bënin një shoqëri po jo me karakter politik, që të mos kishte frymën e një shoqërije revolucionare.

Mbassi këto mendime sidhe të tjera u biseduan, më së fundi, që të mos përçaheshim me Faikun e Fan Nolin, të cilët do e mos kërkonin t'a zgjeronin misjonin t'onë, tuke thirrur nga çdo shoqëri një delegat për të zhvilluar më mirë veprimet e shoqërisë së rè, u shtërnguam edhe ne me Paskal Aleksin të pranojmë propozimin e tyre. Këta më këtë propozim deshin më fort

të fitonin vota që të munt të imponoheshin më mirë më von, mbassi nuk muntnë dot të më veçojnë mua prej mikut e dashamirësit t'em Paskal Aleksit.

Kështu filloj "Dielli" të botonjë në ç'do numur ftimin e gjithë shoqërive, si të atyre që muar pjesë në mbledhjen e përgjithëshme të 24 Dhetorit, si edhè të atyre që s'muarn për të n'a lajmëruar se në ç'mendime gjendeshin sa për formën e Shoqërisë së Bashkimit të përgjithëshëm, që kështu të vinim bazat e Shoqërisë. Kjo vazhdoj gadi 3 muaj, dhe përgjigjet vijnin te segretari që kish zgjedhur komisjoni, i cili ishte At Fan Noli. Rekordi i botuar ishte ky :

**R e k o r d**.

"Né të katër të nënëshkruarit, të zgjedhur si Komisjonin e Bashkimit në meetingun e math që u mbajt në Boston më 24 të Shën-Endreut 1911, për të gjetur udhën e një bashkimi të Shoqërive Shqiptare të Amerikës u mblothmë e përfunduam kështu :

Të pyeten gjithë shoqëritë ekolonitë e mbëdha, ku ka shoqërira, në u pëlqen një bashkim :

Në ç'formë e duan, d. m. thënë federale a qentrale

Me ç'qëllim, d. m. th. politik, edukatoral apo propagand-popullor

Në rast që u pëlqen Bashkimi, të zgjedhin një delegat, i cili do vinjë në Boston ditën që të caktojë Komisjoni, për organizimin e Bashkimit.

Për shkëmbimin e mendimeve për këtë qëllim, Komisjoni zgjodhi si sekretar At-Fan Nolin, me të cilin do merren vesh Shoqëritë ose kolonitë:

Dita e mbledhjes për herën e dytë caktohet dita e 3 Marsit 1912, ku do bisedohen e shqyrtohen përgjigjet e Shoqërive.

Boston 13 Shkurtit 1912
Komisjoni i Bashkimit
Faik Konitza,

Kristo Floqi
At-Fan Noli

Paskal Aleksi

Si thash' edhè më parë, këto ishin të tepërta që po bëheshin, edhè bëheshin vetëm për të zgjatur kohën, ose për të përçarë Komisjonin, se shumë herë kur ju kundrështonja unë, Faiku me Fan Nolin ishin gati të jepnin dorëheqjen, edhè ahere do mos merrte çështja nja përfundim të shpejtë edhè faji do më ngarkoheshe mua më fort, prandaj i durova të gjitha, dhe bashkë me mua duronte dhe Paskal Aleksi.

Përgjigjet më të shumat që vijnin nga jashtë kërkonin që shoqëria e Madhe e Bashkimit të kishte qëllim politik dhe propagand-popullor. Kështu u lajmëruan edhe delegatët e ndryshmë të shoqërohen e të kalonin, të cilët duhet të gjëndeshin në Boston më 17 të Marsit 1912, në sallën e Kishës së Sh. Gjergjit, në Tremont Street.

Më 17 të Marsit ardhë si delegatë z. Kristo Kirka, si përfaqësues i shoqërive "Malli i Mëmëdheut" e "Përlindja" i Jamestownit dhe "Dallëndyshja" e New-Yorkut, z. Llambi Çikozi, si përfaqësues i shoqërisë "Besa-Besën" z. Elia Tromara, si delegat i "Flamurit të Krues" z. Kostaq Kotta, si delegat i shoqërisë "Mirëbërëse" të Syracusës dhe z. Kostika Treska si delegat i "Shoqërisë Kombëtare" i Worcesterit.

Kështu filluan mbledhjet e përbashkëta dhe u vendos që Bashkimi do kish qëllim politik-propagandor.

Mbledhja vazhduese ishte më 31 Marsit, ku n'a u shtua edhe shoqëria "Skënderbeu" e Garryt, Ind. Në këtë mbledhje mbassi u paraqit e u pranua kanunorja e Shoqërisë, u propozua pagëzimi i shoqërisë së madhe. Ahere secili delegat, po thua, propozoj edhè nga një embër për

shoqërinë. Të tilla embra ishin këto: “Bashkimi”, “Skënderbeu”, “Plugu”, “Shkaba”, “Arbënia”, “Hylli i Shqipërisë”, “Kastrioti”, “Shpresa e Kombit”. Këto po diskutoheshin njëra pas tjetre, kur At Fan Noli n’a hodhi në mes embrin “Vatra”. Nuk di si u ndothmë atë ças, porse të gjithë e pritmë këtë embër me gëzim edhe në mes të një apllause e të duartrokitje, Shoqëria e rè Panshqiptare u pagëzua unanimisht me embrin “Vatra”, ose Shoqëria Panshqiptare “Vatra” që më von e titulluam “Federata Panshqiptare “Vatra”.

Në mes të një entusiasmi të math të katër né të komisjonit bashkë me të pesë delegatët e tjerë të Shoqërive nënëshkruam procesverbalin e pagëzimit të Federatës. Pra dita e 31 Marsit 1912 që u formua Federata Panshqiptare “Vatra”, shënoj një periudhë të rè në historinë nacionale.

Më 4 të Prillit 1912 botonja kryeartikullin mbi themelimin e shoqërisë se rè të përbashkëtë dhe ky artikull u botua në gjithë gazetat shqiptare brenda e jashtë Shqipërisë, ku domethënja e fjalës “Vatra” çvillohej në ç’do pikpamje kuptimi.

“Vatra” destinohej më von me kapitalet e saj të mbëdha e me organet e saj të loste një nga më të mbëdhenjtë rolle në rilindjen Shqiptare. Për këto nuk do përment gjë këtu, se kujtonj se s’ka shqiptar të mos njohë “Vatrën” e të mos dijë e të mos çmojë veprat e saj të gjalla.

Faiku e Fan Noli dikur lëvdoheshin se edhe Floqi si kur të mos ishte, prapë një shoqëri si “Vatrën” do bëheshe, si edhè ata kishin ndër ment një gjë të këtillë. Këjo n’a ngjau si veza e Kolombit. Vërtetë të gjith’ata që ishin mbledhur reth Kristofor Kolombit dikur, pretendonin se s’ishte ndonjë çudi e madhe exploacjoni i Amerikës prej Kolombit, mbassi një dit do gjendeshe Amerika po vezën s’u ndoth njeri t’a storaste më këmbë, përveç se Kolombit, i cili, me një të çuknitur pas nga puçka mundi t’a qëndronjë më këmbë! Ashtu n’a ngjau edhe për çështjen e “Vatrës”. Vërtet edhè Faik Konitza me Fan Nolin kishin ndër ment një gjë të këtillë, po ajy që vajti e që u loth, ajy që u ngjir së foluri e së shkruari isha unë. Shqiptarët, pra, lè të gjykojnë kush ish fondatori i “Federatës Panshqiptare Vatra”.

Më 28 të Prillit 1912, që u bë mbledhja e fundit e “Vatrës”, mbledhja d. m. th. që i dha funt formimit të saj, u zgjothmë unë edhè Faik Konitza si organizatorë të degëve të ndryshme, e si konferencierë dhe si pleqësi e shoqërisë z. z. Fan Noli, Kr. Kirka dhe Llambi Çikozi, kurse Paskal Alesi dhe Elia Tromara u emruan si

kontrollorë. Më von u bashkua edhè Fan Noli me né të dy me F. Konitzën e kështu u bëmë 3 organizatorë të degëve që do formonim.

Kur u mblothmë të trè për të ndarë punën, d. m. thënë degët që kishim për të formuar, z. z. Faik Konitza edhè Fan Noli zgjuadhë kolonitë më të sigurta e më popullore, ku s’kishin frikë se mos binin jashtë, sepse, nga 20 anëtarë sa duhej për të formuar një degë, pa fjalë që do t’i gjenin ndër ato koloni, ku nëmuroheshin me qindra anëtarët. Mua përkundrazi më lanë kolonitë më të vogla, më të zorshme në formim edhè më të shumtat. Puna pra u nda në këtë mënyrë :

Fan Noli

Kishte për të formuar këto degë :

Brockton, Mass, 2. Natick, Mass, dhe Cochituate, Mass.

Faik Konitza

Worcester Mass, 2. Lynn, Mass, 3. Manchester N. H. , 4. Central Falls R. I. 5. Southbridge, Mass

III Kristo Floqi

Milford, Mass, 2. So. Framingham, Mass, 3. Marlboro Mass, 4. Hudson, Mass, 5. Tauton Mass, 6. New Bedford, Mass, 7. Bideford, Me, 8. Sacco, Me, 9. Lewiston Me, 10. Sanford Me, 11. Augusta, Me, 12. Concord N. H. 13. Franklin N. H. , 14. Pennycock N. H. dhe Bangor, Me. Përveç degave të tjera që do formoheshin në shtetet e tjera, New-York, Pennsylvannia, Conecticut, Rode Island, Ohio dhe Indiana.

Nuk do zgjatem tuke treguar se si i formova gjithë ato dega e me sa vështirësi, se kjo është një histori e gjatë dhe ajy që ka mbajtur koleksjonin e "Diellit" prej numrave 150 e deri 161 munt të shohë me radhë e hollësisht përpjekjet e konferencat e mija e vuajtjet gjer sa i formova ato degë, kur se kolegët e mij Faik Konitza me Fan Nolin brenda më një muaj muntnë e i formuan degët e tyre. Këtu do kufizohem të tregonj ç'pësova unë se mora dy gjarpinj e desha t'i ngroh në gji, si një patriot i kulluar që isha dhe si m'u shpërblyen të mirat nga Shqiptarët.

Faik Konitza dhe Fan Noli, të cilët s'duronin të më shëkonin në krye të punës e shtynin sa të muntnin ditën e zgjedhjes së pleqësisë "Vatrës", sepse si njëri, si tjetri bënin propagandë të madhe kundra meje nëpër fshatrat nga shetitnin.

Si shkaqe dheli[1] e mashtrimi, këta njerës ambiciozë e zembër-liq vinin përpara Shqiptarëve këto : qinse un' i heq për hunde gjithë kolonitë shqiptare, qinse "Vatrën" e formova vetëm për interesat e mija, edhe se unë, përveç darovave që mernja nga Shqiptarët sa herë mbanja konferenca jashtë, përveç të 50 dollarëve që mernja si rrogë, po mernja edhè 10% të tjera nga të mbledhurat e abone të "Diellit" që më vinin 180-200 doll. në muaj, kurse unë, po të isha patriot, ato 10% duhej t'ja linja shoqërisë. Këto e të tjera gjepura përhapnin nëpër Shqiptarët dhe unë s'kisha marrë vesh gjë.

Edhè që t'i influenconin edhè më tepër, Faiku ju kish thënë që ajy munt t'a merte "Diellin" përsipër vetëm me 30 dollarë në muaj, pa një shtim tjetër, si ai d. m. th. sa të ma hiqte mua prej dore, pastaj e dinte vetë Faiku. Fan Noli më tjetrën anë, ky Nastradini i dytë, sado që Shoqëria paguante për ç'do konferencë që mbanim, i bindi Shqiptarët të më kërkojnë hesap për shpenzimet e konferencave të fundit. Dhe s'lanë intrigë tjetër pa punuar, si e si të më rëzonin mua e t'a mernin ata Federatën e gazetën në dorë!

Kur e panë se formuan parti të shëndoshë kundra meje, ahere provokuan prap'ata të caktohet më 16 Korrik 1912 dita e mbledhjes së pleqësisë, në vent që kjo do ishte zgjedhur sipas programit qysh më datën 4 korrik, që ish dhe data e Indipendencës Amerikane, por se këta të dy armiqt' e mij, me shkak se munt të shtoheshin – sikurse u shtuan – edhè shoqëri të tjera që s'i kishim në numur, e shtynë kohën gjer më 16 korrikut për qëllimet e tyre!

Ditën e caktuar u bë mbledhja e përgjithëshme për parinë. Unë sa do që s'isha informuar për propagandën që bënë ata kundra meje, përveç se fjalë vage[2], nuk kujtonja kurrë se poshtërsia e tyre do t'arrinte gjer atje sa të nxirnin jashtë potencës një bashkëpuntorin e tyre, një reformatorin e asaj situate të këndëshme dhe më fort një patriot, një bamirsin e tyre, që i përmblodha nga arratia, nga shdukja, ku i kishte dënuar opinioni publik.

Kur u hap mbledhja Faik Konitza proponoj që ajy që do delte me vota sekretar (që ishte baras me kryetarin e Federatës) do të ish edhè drejtor i "Djellit" dhe si rogë nuk do kish më shumë se 30 dollarë në muaj, edhè pa shtesën e 10% që merte gjer ahere drejtori i gazetës prej të ardhuravet.

Kjo i arth për hesap mbledhjes edhè ahere mora vesh se punët ishin gatuara. Unë kur e pashë ashtu protestova se kjo s'ish e mundur, se 30 $ në muaj janë një rogë fatkeqe për një drejtor gazete e një kryetar Federate, kur se punëtorët e fabrikave mernin nga 40 e 50 dollarë në muaj. Po ahere një batare zërrash m'u përgjigjnë se duhej bërë ekonomi, ne jemi patriotë!

Kur e pashë ashtu hoqa dorë nga kandidatura e kryesisë dhe me gjith'atë Faiku u zgjoth vetëm me 13 vota më tepër se mua, i cili sa do që s'vura kandidaturën më proponuan miqt e mij, të cilët, kur u zgjoth F. Konitza me 13 vota më tepër bënë poterën e madhe, edhè si kur të mos kisha hyrë vetë në mes t'i kallmonja[3]gjith'ata gjaqe të ndezura për shkakun t'em, munt edhè të kapeshin fyta-fytas me kundrështarët e mij. "Lawrence Hall", ku bëheshin zgjedhjet,

[1]Dhel : djallëzì, mejtim i keq (K. F.)

[2] vago = të papërcaktuara, jo të sakta, nëpër tym (nga italishtja H. K.)

[3] calmare = me qetsue (nga italishtjaH. K.)

buçiste e gjëmonte prej këmbëtrokitjesh të parties s'ime, e cila disaprovonte partin'e Faik Konitzës me gjithë Faikun bashkë!

Kështu për të pushuar ç'do grindje mora fjalën tuke hipur në tribunë, ku i urova sukses F. Konitsës si sekretar i përgj. i Federatës e redakor i "Diellit" tuke çfaqur dëshirën që t'i arrinin të 30 dollarët që do merte në muaj, sa do që mua më paguante Shoqëria gjer në 200 dollarë në muaj.

Pleqësia, pra, e "Vatrës" u zgjoth kështu :

Faik Konitza, sekretar i përgjithëshëm
Kristo Floqi Kontrollor I i "Vatrës"
Paskal Aleksi " II "
Vangjel Gjika " III "
Josif Pani " IV "
Llambi Çikozi Arkëtar i "
Kristo Kirka Menazheri i "Diellit"

Federata "Vatra" filloj nga veprimet vetëm me një kapital $ 928, 58.

Të nesërmen unë i dorëzonja shërbimin Faik Konitsës, i cili sa do që u mbur në krye se e fitoj postin me dinakëritë që lojti, po pastaj si e pa se unë dhashë dorëheqjen nga ofiqi i ri i kontrollorit edhè bashkë me mua dhanë dorëheqjen edhè të trè kontrollorët e tij, gjë që bëri përshtypje të madhe në Federatën, se né ishim nga më

të mirët e më të besueshmit e të dy partive, ahere edhè F. Konitza u pendua për sa vepëroj, se munt të humiste edhè pozitën.

Po mbi këtë e sipër mua më ngjiste edhè një hall tjetër, edhè kjo dorëheqja nga ofiqi më sillte në një rrezik të math, rrezik existence!

Sado që në shtëpi kisha gruan edhe djalin dhe nipin Vason e Marigosë, të cilin e mbanja unë, dhe harxhet t'ona nuk kalonin 40-45 dollarë në muaj, me ardhjen e Kostaq Kottës me gjithë të shoqen Angjeliqinë, harxhet n'a u shtuan shumë; se përveç të ngrënit e harxheve tjera, duheshin edhe harxhe mveshje e mbathje, se më ardhë nga Vlora me robat e trupit e pa një metalik, dhe unë si vëlla i tyre i pranova nga turpi që të mos i linja sokakëve. Mirpo harxhet mujore kalonin të 80 dollarët, dhe mbassi ishin harxhuar shumë nër udhëtimet dhe në takëmet e mobilizimin e shtëpisë si dhe në mobile të tjera, krevate etj, me ardhjen e Kostaqit me Angjeliqinë, kishin ardhur barabar me të hollat dhe dorëheqja ime nga "Vatra" n'a gjet me 1, 65 dollarit! Lumërisht se s'kishim edhè ndonjë borç tjetër!

Sikleti im i asaj nate s'rëfehet. Ime shoqe e ime kunatë ranë në zi e në vaj. Shaka ishte këjo? Se mos kish punë dobarem Kostaq Kotta? Ajy kish 6 plot muaj ahere ne mua edhè pa punë, po se kishte punuar ndo një herë në Amerikë? Gjithë mbi kurrizin t'onë ronte edhè kurrë s'e çante një herë kryet të mendoheshe seriozisht se kishte edhe grua! Si të bënja, pra, ku të vinja, ku të mbytesha? Të punonja në fabrikë unë me gjithë gratë? Ish e pamundur! Të kërkonja hua? Po si do t'i lanja pastaj?

S'kam fjetur tër' atë natë. Po prapë s'i dhashë armët. Njeri s'dinte se në portofol s'kisha më tepër se 1, 65 $. S'kish ku të vinte më keq!

Po paska, thonë Perëndia! Shqiptarët e Brocktonit, ata që më deshin aqe fort dhe më fort Paskal Aleksi, Leoni Qafëzezi dhe Rapi Magjistari, mbassi u ndamë atë natën e fundit të rrezikut t'em e shkuan në Brockton, të nesërmet u kthyen prapë në Boston e më vijnë në shtëpi. "Miku i mirë njihet në të keqen" thotë një fjal' e urtë. Ata miq të mirë më pyesin sinqerisht si vete nga të hollat pik së pari. Ju thashë të drejtën se kisha vetëm 1 dollar e 20 censa. E ju kallzova ç'harxhe kisha e si i kisha prishur sa pare kisha. Ahere nxjerin e më japin me një herë 300 dollarë. S'desha t'i pranonja edhe sytë po më mbusheshin me lott, se kisha dobarem miq!

Ahere ata më propozojnë këtë : Puna mbassi ka nder në Amerikë, qoftë edhè lustraxhihanë, po të desha, ishin gati të më blinin në Brockton një koxha restaurant te

mobilatur e të gatijtë me gjelltar me të gjitha, arrinjtë t'a merrnja përsipër. Për të holla, më thanë, mos kij merak se përgjigjemi né. Në fitofsh n'a i kthe pas 6 muajsh, në bjerç falur të qofshin të gjitha, s'duam gjë!

Ç'do njeri munt të mendonjë sa ngushëllim i math ishte ky për mua edhe si m'u duknë atë ças ata miq aqe bujarë! Me një herë e pranova propozimin e tyre dhe prej të 300 dollarëve ju mbajta vetëm 100. Ata si mbetnë d'akord shkuan në Brockton dhe brenda 2 ditve e blenë restaurantin e bukur në "Eliot Street, 21" e më telegrafuan të nisem. E kishin blerë 700 dollarë për hesap t'em edhè unë s'kisha tjetër veçse të vinja në Restaurant dhe të mernja punën përsipër. Kurrë s'e harronj këtë të mirë që më bënë këta miq se ndryshe edhè unë s'di se si do bëheshe halli im më një karvan njerës që kisha në shtëpi! ……. .

## XVI

Tjetër orizont po shkrepte për mua, orizonti i Natickut, i asaj kohës së parë që shkela për të parën herë në Amerikë dhe hapmë restaurant-kafenen' e Natickut bashkë me t'em kunat Niko Poçin. Prapë restaurantjer! Munt të bënja ndryshe kur kisha edhè fëmijë përsipër? Në këtë shkallë më suall miqt' e dashur Faik Konitza me Fan Nolin, këta dy gjarpërinj që vetë i shpëtova nga mërija e Shqiptarëve, i ngroha në gjirin t'im që të më potisnin farmaq një dit e të më hidhnin në rrugën e madhe pa një mëshirë me gjithë fëmijën t'ime! Kësaj i thonë patriotismë, kësaj i thonë kalorësi!

Po ç'e gjen njerinë e s'e heq? Unë që formova e ristorasa "Federatën Vatra", tuke sakrifikuar veten t'ime mbi altarin e kurbanëve e të dëshmorëve, unë që s'lashë vent pa shetitur e pa mbajtur konferenca të zjarta për atë Atdhe, unë që e bënja natën ditë tuke mos lënë rast pikniku ose feste për me ju folë Shqiptarëvet e me propagandue, unë që arriva e i bashkova të gjithë po thua, unë tani u dënova të mbetem jashtë tempullit edhè të bëhem prapë restaurantier!

I vura gurë zembrës dhe posa u lajmërova prej Brocktonit lashë fëmijën në Boston bashkë me Kostaq Kotën e të shoqen, kunatën t'ime dhe u drejtova në Brockton. Në atë qytet, ku tjetër u apotheosa si konferencjer e apostull i idhesë kombtare, tani do bëhesha servitor e do servirnja ata që tjetër herë më vijnin pas si populli pranë dhe rotull udhëheqësit të tij. Kinematograf kjo botë!

M'a dorëzuan restaurantin, si dhe disa oda për të fjetur me krevate dhe një biliardo të mirë. Më rekomanduan gjelltarin dhe më dhanë një shqiptar tjetër për shërbim.

Gjithë Shqiptarët e Brocktonit për hatër t'em i lanë restaurantet e tjera ku hanin bukë e brodhë të gjithë në restaurantin t'im ; e shëkonja që puna do vinte mirë.

Si ndenja ca dit e e vura punën në vi dhe si zura edhe një shtëpi të mirë e me banjo në vëndin më të mirë të Brocktonit, dërgova e mora fëmijën nga Bostoni dhe tjetrën dit më ardhë bashkë me Kostaqin e Angjeliqinë.

Kostaq Kotta msuar gjithë jetën e tij tembel e të hajë mbi kurris të tjetrit, kur ardhi në Brockton e pa atë restaurant për bukuri, u sheshua dhe i pëlqente të rijë gjithënjë me gjelltarin, ku hante stekat e brizollat e omeletat më të mira pa dashur t'ja dijë se, kur kërkonte ndonjë myshteri ndo një stekë të mirë, nuk gjente se s'i linte Kostaqi!

Një dit më plasi shpirti dhe i hoqa vërejtjen, që tjetër herë s'i kisha folur aqe ashpërsisht. I thashë që duhet të shohim myshteritë më parë, pastaj barkun t'onë, mbassi ka boll gjellë edhè për né. Po Zoti Kostaq n'a u zembrua, edhè si ishte msuar që e mbanim gjithnjë si dhëndër në fron, si kukumblaq, nuk më shkelte në restaurant, po hante bukë – prapë në shtëpi time – edhè me pretendime sa të duash!

Durova ca dit kështu, po prapë s'desha t'a shihnja të ftohtë, sa të n'a mernin vesh edhè të jashtmit. E mora me të mirë edhè këtu bëra një gabim trashanik, një budallì të pashoqtë. Ç'

më duheshe mua t'a mernja Kostaqin në restaurant? Ç' më bënte më parë që të më bënte edhè tani? Akoma s'ja kisha pirë lëngun në Salt-Lake e në Boston?

Si e mora prapë në dyqan, ky prapë zuri avazin e Mukës. Tempeli munt të bëhet punëtor? Kurrë . E mora më nj'anë e i thashë se duhet të punojmë këtu, se kemi grâ e fëmijë, dhe tembellëkun t'a hedhim më nj'anë. U duk sikur u vu në sëndrë, po s'ish gjë. Një dit më thotë : dua të di ç'më kè ortak, apo yzmeqar? I thashë s'të kam as ortak, as ysmeqar, të kam vëlla. Puno, të punojmë, të lajmë 800 e ca dollarë që n'a kushton restauranti dhe ç'të kemi, bashkë do t'i kemi.

Po Kostaqi ishte kurdoherë maskara; kurrë s'kishte punuar, kurrë s'kishte fituar dhe kurrë s'ja dinte kimetin pares. Më thotë t'a ndajmë shërbimin. Fort mirë, e ndamë. Unë do punonja ditën dhe ajy që posa ndizeshin llambat gjer në mesnatë. Kështu filluam. Po Kostaqi s'rinte gjer në mes të natës, po shumë herë gdhiheshe gjer në mëngjes. Kostaqi nuk shëkonte punën, po loste edhe vetë kartrat, tavllin e bilardhon edhè shume herë u humbiste. Kështu që jo vetëm s'e shëkonte punën, po kush muntte hante, kush munttne pinte edhè kush muntte mvithte. Brenda një javet më shkaktoj një dëm prej 120 dollarësh!

Kur e pashë kështu i thashë më mirë të rijë në shtëpi e të mos përzjehet se do më nxirte me këpucë të kuqe në pak kohë. Ajy ahere u zembrua, kishte edhè ndo 100 dollarë në xhep të dyqanit, edhè pa më dhënë as një hesap mer të shoqen e shkon në Boston, ku i futet Faik Konitzës në hundet, i cili e pranoj me një rrogë mujore 30 dollarëshe, tuke e ngarkuar me shërbimin të delte jashtë Bostonit e të mblidhte pajtimet.

Zoti Kostaq Kotta, njeriu im, vëllaj im, pamirënjohës sa s'bëhet, nuk mjaftoj me kaqe po bënte edhe propagandë kundra mejet, qinse unë s'isha aqe i zoti sa Faik Konitza, e që s'kishte tjetër Shqipëria veç Faikut etj. etj. gjërra që m'i shkruaninj nga ndo që shkonte e që fliste Kostaqi! Ka poshtërsi më të madhe, t'a mbash kaqe kohë, t'a ushqesh me gjithë fëmijë, të prishësh kaqe të holla për atë e të hedhë gurin e nëmës? Po dardha e kish bishtin prapa. Se tradhësinë e do gjithkush, po tradhtorin askush!

Faiku s'e mbajti as 3 muaj. Një dit të bukur e flakërin në rrugën e madhe. Kostaqi mbet rehèn[1] në Boston. Ku do vinte tani, ku do përpiqte kokën? E keq' e madhe që ishte edhè me gruan bashkë.

Unë aso kohet, mbassi më 4 muaj e sipër që mbajta restaurantin, hirë pastë Kostaqi, rashë jashtë[2], mezi munda të shesh restorantin, të lanj borxhet edhè të më mbeten 80 dollarë, me të cilat shkova në New-York, mbassi Shqiptarët e atij qyteti, të zembruar tepër me F. Konitzën, i cili i shante pa mëshirë, deshin të krijonin një gazetë tjetër në New-York, që edhè interesat e tyre të mpronin edhe ato të Atdheut se bashkut.

Unë, si zura vent në New-York, dhe si vunë një kapital të mjaftë për gazetën e ré nacionalistët e New-York-ut e të rretheve (Springfield, New-Haven, Bridgport etj.) nxora gazetën e dëshëruar me 6 kollona dhe gati dy herë më të madhe se "Diellin" dhe këtë gazetë e titullova vetë unë "Zëri i Popullit" , për të cilën mora edhè lejen e duhur nga qeverija e Shtetit të New-Yorkut.

Mbassi i kisha gjithë adresat e patriotëve qysh në Boston, që ishin pajtimtarët e "Diellit" ju dërgova numurin e parë të gjithë atyre. Ahere pashë se si u ringjall në zembrat e Shqiptarëve ajo enthusiasm' e vjetër, që, një mot më përpara më tregonin në shetitjen e sipër t'imen e në konferencat patrioke (362 plot konferenca) që ju mbajta kohë pas kohe.

Pas 8-9 ditsh u dëgjua me një herë kondragrushti që hëngri "Dielli" dhe indirekt Faik Konitza nga botimi i kësaj gazetës së ré, që edhe dy fijsh m'e madhe se "Dielli" ishte, edhe me shkronja të reja artistike lynotypi, dhe redaktuar bukur e me plot lajme të reja, mbassi kabllon internacional e kisha afër zyrës s'ime e i mernja qysh atë ças lajmet e përbotëshme me anë filmi kinematografik.

[1] rehen = peng (H. K.)

[2] rashë jashtë = falimentova (H. K.)

Më shumë se 600 pajtimtarë i kthyen gazetën Faikut, tuke shkaktuar kështu një boycotage[1] terrible "Vatrës", që u ndye nga të katër anët. Dal nga dalë edhe brenda më një muaj e sipër "Dielli" humbi më shumë se 1. 000 abone, të cilat m'u shtuan mua.

Nga 20-30 letra më vijnin për dit prej pajtimtarëve të rinj dhe plot me para; disa dërgonin 5 e nga 10 dollarë për pajtim, me gjithë që pajtimi ishte vetëm 2 dollarë në mot edhè me gjithë që ata e kishin parapaguar edhe pajtimin vjetor ne "Dielli".

Enthusiasma e Shqiptarëve të këtij pellgu s'rëfehej kur dolli "Zëri i Popullit". Nuk kisha kohë të shkonja nëpër duart e të këndonja gjith'ato letra, që shumë herë mblidhesin me grumbuj të pakënduar.

Midis atyre ishin disa që më dërgonin artikuj kanstikë[2] kundra Faik Konitzës, Fan Nolit e kompania bellës, dhe të holla plot për këto, po unë për princip nuk i botonja këto se evitonja ç'do polemikë me exentrikun e nevrasthenikun Faik Konitzën, i cili, posa e pa "Zërin e Popullit" filloj me një herë t'a luftonjë si "gazetë tregëtare", si gazetë spekulatore, etj. etj.

Në krye mbajta një atitudë[3] përmbajtëse dhe s'i përgjigjesha Faikut në ataket e ndohtësit' e tij, po si e pashë që kaloj ç'do masë, ahere s'lashë edhè unë gur e baltë pa hedhur kundra një marroci të tërbuar, aqe sa e pushoj polemikën e ndenji urtë!

Unë në një muaj e sipër u gjenda me 800 e ca dollarë prej të mbledhurat e "Zërit Popullit", një fakt ky që më siguronte të paktën 6 muaj mbajtjen e gazetës. Dhe anëtarët gjithë po shtoheshin dita-ditën, se atë që bënja në Boston, fjalimet d. m. th. dhe konferencat, e bënja edhe në New-York në një rayon më të hapur gati gjer në Cicago, Indianapolis, Milwakee, Jamestown, Buffalo, Windsor Canada, Detroit, Toronto-Canada etj. M'u dha rasti të shetit kështu 300 e sa qytete, dhe në vënça në hesap edhè qytetet e tjera të Amerikës Veriore që kisha shetitur, këto kapërcenin numurin e 1. 000 qyteteve e fshatrave, të mbëdhenj e të vegjël, të përmbledhur në 32 Shtete (prej të 48 Shteteve që kanë Shtetet e Bashkuara) që kisha shetitur herë pas heret.

"Zëri i Popullit" shkonte më shumë se "Dielli" për arsye se kishte lëndë më tepër, lajmë më të rà, e jo bajate si te "Dielli", korespondenca nga Shqipëria, si dhe nga kolonit' e ndryshme Shqiptare të Amerikës dhe gjuhë të pastër. Edhè sado që në programin që çpalla në numurin e 1-rë deklaronja se po ndjek gjith' atë program që ndjek edhe "Vatra", të cilës po përpiqesha t'i shtonja anëtarë sa mundnja, Faik Konitzës i dukesh se isha kundra tij edhe se menasonja[4] existencën e Federatës, të cilën e krijuan mundimet e mija e jo ato të Faikut e Fan Nolit.

Këtu në New-York filluam një luftë të rreptë patriotike kundra të dy gazetave të mbëdha e shumëfletëse greke "Shkruar greqisht" (Atlantis) edhè "Shkruar greqisht" (Panelìnios). Drejtorët e tyre, të cilët më njihnin bukur mirë që në Athinë, u përpoqnë sa mundnë të më mernin me vehte, si redaktor i regullt i njërës ose i tjetrës gazetë, e më ofronin qysh me 100 e gjer më 200 dollarë në muaj për 5 vjet një kontratë. Mbassi s'dëgjova kurrsesi të bashkëpunoj me ata, të cilët më hiqnin si omogjen, pse kisha studjuar në shkollat greke, ahere më ofruan nga 50-100 dollarë ne muaj të mos shkruanja kundra atyre, dhe po që që t'ju ndihmonja që qëllimet e tyre politike kundra Turqisë mbi luftën Ballkanike që m'atë koh' e sipër kishte shkrepur ahere më ofronin një shumë prej 5. 000 dollarësh për një herjesh.

Unë në krye, me që luftonja systematikisht tyraninë turke, nuk kisha ndonjë kundrështim të bashkohesha me ata në këtë pikpamje, po tuke u menduar se gjith' ajo

shamatë bëhej për jorgan' e Nastradinit, d. m. th. lufta Ballkanike do ndante më trish Shqipërinë t'onë, e mblodha mëndjen e ju dhashë përgjigje negative.

---

[1] boycotage = bojkot (H. K.)

[2] Immanuel Kant = ka qenë një filozof gjerman, i konsideruar si filozofi më i rëndësishëm i mendimit perëndimor (marrë nga Ëikipedia H. K.).

[3] attitudine = qëndrim (nga italishtja H. K.)

[4] menasoj = intrigoj në dëm të dikujt (nga italishtja H. K.)

Lufta ahere që u përhap midis nesh e Grekëve ishte shum' e ashpër. Grekët n'a konsideronin si tradhtorë dhe n'a kishin gjak në sy. Shumë herë edhè n'a atakuan edhè me duar e me kama gjiritase, po desh Zoti e shkuan në luftë më të shumit e mbetmë rehat.

Faik Konitza vjen në New-York dhe, si tjetër herë Aristidhi Themistokliut, më has e më jep dorën e më thotë : Lè t' lemë më nj' anë armiqësitë përpara Atdheut, i cili ndodhet në rrezik me këtë luftën Ballkanike. Dhe më shpjegoj gjithë mendimin e tij, të cilin, një javë më parë e kisha dëgjuar edhè nga Fan Noli në një pjekje që bëmë në Southbridge, që, d. m. thënë, ne duhet të marrim garanci prej Perandorisë Ottomane për njohjen e një Shqipërije indipendente nënë hijen e Turqisë, si tjetër herë Bullgaria e Rumania dhe kështu në këtë luftë t'ju ndihmonim Turqve kundra aleatëve të bashkuar ballkanas.

E pranova thezën e tyre dhe fillova atë ditë po atè politike me anën e gazetës s'ime.

Nga ana tjetër u muarm vesh edhè me konsullin e përgjithëshëm të Turqisë në New-York, i cili në marëveshje me ambasadorin turk në Washington n'a i pranoj një nga një kërkimet t'ona dhe n'a u falë nderit fort.

Kështu i dhashë fjalën Faik Konitzës, që në meetingun e math Panshqiptar, që do mbaheshe pas ca ditsh në Boston, do pjestonja edhè unë, sikur se më von mora pjesë me gjithë shokët e mij e delegatët e tjerë.

Atë dit që vajtmë në Boston për këtë qëllim, me gjithë që s'desha t'ja shoh sytë Kostaq Kottës për sa më punoj, po tuke ditur se ishte papunë, dhe i lutur nga ime shoqe, të cilën e mora pas edhe e cila desh të vizitonte të motrën, që s'ishin parë që në Boston, shkuam bashkë më gruan t'ime ne Kostaq Kotta, ku gjetmë vetëm t'ime kunatë Angjeliqi. Ajo, sa do që mua s'më tha gjësendi, po së motrës ja hapi zembrën e i tha që ndodhen keq ekonomikisht dhe s'dijnë nga t'ja mbajnë. Ja hithte fajin të shoqit që i ra së mirës me këmbë në Brokton e gjetkë.

Ime shoqe iku q'andej me sŷtë me lott e m'a tregoj hallin e tyre të vajtueshëm, kur iknim prej Bostonit.

Me të vërtet më ardhi keq, po si duhet të bënja? Mua në New-York, pak ditt më parë më ngjiste tjetër gjë. Im kunat Kristua më dërgonte prej Salt-Lakut fëmijën e tij në shtëpi t'ime, d. m. th. t'ëmën (t'ime vjehrë) dhe çupën e Marigosë Fereniqin, që ish ahere 10-12 vjetsh. Kështu në shtëpi t'ime ishin tani 6 shpirt. Pas ca ditt n'ardhë edhè im kunat Nikua, e ishim bërë 7 shpirt. Tani të më shtoeshin edhe Kostaqi me Angjeliqinë, të bëheshin 9 shpirt? Po ç'taksirat kisha un' i ngrati të mbanja kaqe shpirt?

Po ime shoqe s'kish derman për të motrën e saj. Aman që aman t'a marim në New-York. Për dit m'a përsëritte gjer sa i dërgova e i mora edhè zotin Kostaq me Angjeliqinë. Tani munt të bënjë hesap njeriu harxhet e mbëdha që kisha në New-York. Kristua m'u premtua se do më dërgonte të holla për fëmijën e tij, po më kot! Nikua zuri një punë në New-York, po më parë e la se sa e zuri. Kostaqin e dërgova msues në Southbridge për Shqiptarët e atjeshëm, të cilët do të hapnin një shkollë nate e do t'i mësonte shqip Kostaqi. I dhashë edhè nj'a 25 dollarë. Ajy ndenji një javë, edhè si që hëngri e piu e fjeti si kumbarë në miqt' e mij, si edhè të 25 dollarët që i dhashë i gollofiti, edhè m'u kthye prapë si fandi kupa në shtëpi. Shtëpin t'ime po e kishin që e kishin hapur, se mos do t'i zinte ndo një gajle?

Kostaqin e futa në shërbimin e gazetës. Po edh' atë të çalë e bënte edhè gjithë ankohej kundra fatit.

Goditi që e dërgova në Jamestown, Albany, Syracuse e gjetkë të mbledhë pajtime nga Shqiptarët që s'kishin paguar për "Zërin e Popullit". I bir' i botës vajti në Jamestown me shpenzimet e mija, kishte mbledhur ndo 130 dollarë, ndejti te një kushëriri i tij 40 e ca ditt, pa u përkujdesur aspak për të shoqen e tij dhe më së fundi, kur mezi ardhi pas 2-3 telegrameve që i hoqa, prapë më ardhi pa një dyshkë në xhep! I këtillë njeri, i këtillë parasit e misor ishte Kostaq Kotta, ky kryeministri i sotëm i Shqipërisë! Ka si përshkruhet poshtërsi e tij?

Shkoj shumë gjattë ky izijet[1] i math e këto mjerime që po hiqnja në New-York. Më kishte plasur shpirti. S'dinja si të bënja. Më vinte të mernja syt' e këmbët e të iknja! Po ku t'i linja gjith' ata që kisha mbi kurris? Kush do përkujdesej për ata?

Kisha shumë kohë që po rinja melankolik

Në atë kohë më vjen edhè Fan Noli në New-York, i cili i zembruar liksht me Faik Konitzën, po më tregonte një miqësi extraordinare. Faiku e kishte dbuar keqas nga Bostoni e ishin sharë liksht! Ajy Fan Nol që ngorthte për Faik Konitzën e shante tani me epithetat më të ndryshme. Tani e shihnja mirë edukatën e dobët të njërit dhe të tjetrit. Nuk ndryshonin nga dy fëmijë, dy kalamanj ritur keq. Këta ishin ata që më bënin varrin mua! T'a përzinja dhe unë si Faik Konitza? Atë s'e bënja dot, mbassi më ra në besë. I hodha prapa krahëve të gjitha.

Fan Noli shkonte në Londrë të përkrahë çështjen Shqiptare pranë njerësve të mbëdhenj e filoshqiptarë politikanë Englesë. Faik Konitza do shkonte për pak ditt si delegat i "Vatrës" pranë Kongresit të math Panshqiptar të Trieshtit, që do mbaheshe më 1 Mars 1913. Unë me nj'a dy shokë, të zgjedhur nga an' e Shqiptarëve të New-Yorkut e redheve, sidhe nga italo-Shqiptarët e New-Yorkut vijnin në Washington, te Shtëpia e Bardhë për me përshendetë e me urue Presidentin e ri të Shteteve të Bashkuara Woodrow Wilsonin, i cili ato dit ishte zgjedhur President i Shteteve të Bashkuara. Ne ishim unë, professor Orazio Iriani, italo-shqiptar dhe një tjetër shqiptar Çam, Idris Seferi.

Presidenti Wilson n'a priti me gëzim, u interesua për nè si Shqiptarë, edhè n'a dha fjalën qysh ahere se nuk do t'a lerë kurrë Shqipërinë të vuajë. Audienca e jonë mbajti 5 minuta dhe u përcuallm me kënaqësi të madhe.

Harrova të thom se që kur u deklarua Shqipëria indipendente dhe u ngrit pas kaqe shekujsh flamuri i kuq e zi i Skënderbeut në Vlorë prej Ismail Qemalit, kishte filluar një lëvizje extraordinare në qarqet e Shqipëtarëve të Amerikës dhe me gjithë sharjet e thash' e themet me shoqi-shoqin prapë se prapë të dy gazetat Shqiptare të Amerikës "Dielli" dhe "Zëri i Popullit" ishin flamurtarë të lëvizjes kombëtare dhe si njëra, si tjetra ishin apostujt dhe interpretë të ndjenjave patriotike.

Prandaj midis çështjeve tjera ish edhè çështja e një mbreti, ose e një princi për Shqipërinë. Pra edhè kandidatët nuk n'a mungonin. Përveç Princ Gjikës e Aladro Kastriotit, kishim tani edhe princin Urach që n'a rekomandonte Austro-Hungaria, Dukën e Abruzzëve që n'a impononte Italia dhe princ Ahmet Fuatin (sot mbretin e Egjyptës), i cili, si trashëgimtari i të madhit Shqiptar Mehmet Aliut e të Ibrahim

Pashës kishte drejt për drejt pretenza mbi fron' e Shqipërisë. Të gjithë këta kishin edhè agjentët e tyre në Shqipëri, po edhè jashtë Shqipërisë, si dhe në Shtetet e Bashkuara.

Faik Konitza, i cili ndiqte propagandën austrijake ish deklaruar për një princ gjerman si Mbret të Shqipërisë. Ahmet Fuadin, pra, s'e duronte aspak, prandaj bënte një propagandë shumë të rreptë kundra tij, se do n'a sjellte arabë e xharije në Shqipëri, se do n'a vinte me harem e me hadëme, se do n'a bënte turq, etj. etj.

Naturisht edhè unë në "Zërin e Popullit", mbassi s'na mbushej mendja për ndo një princ Shqiptar, do e mos përkrahnja mendimet e F. Konitzës. Ku t'a dinja unë se do vinte dita të piqesha me Ahmet Fuadin në Venetik, dhe atë njeri që aqe fort e kisha sharë pa e njojtur, tani do t'a njihnja që për së afërmi, do të hanja bukë me atë dhe do t'a admironja nga sjelljet e tija fisnike e evropjane, se Ahmet Fuadi, mbreti i sotëm i Misirit, tjetër gjë munt të ish, po kurrë një Turk, si e përshkruante Faiku, dhe si ja mbanja edhè unë zërin, pa ditur njerinë, si tjetër herë Sanxo Panchia të ndryerit Don Chishotit.

Në atë kohë një kongres i math Panshqiptar do të mblidhej në Triesht, me inisiativën e tërthortë të Austro-Hungarisë, e cila i dolli zot Shqipërisë dhe dëshëronte që Shqiptarët të kërkonin sovranin e tyre prej shtëpisë mbretnore të Habsburgëve, ose të paktën ndo një princ

[1] isajet = goditje (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

tjetër gjerman. Për këtë kongres ishim lajmëruar edhè ne, dhe Federata “Vatra” zgjodhi Faik Konitzën si përfaqësonjës, dhe orthodhoksit e kleri orthodhoks Shqiptar zgjodhi Fan Nolin, i cili do vinte më parë në Londrë të fliste me disa politikanë filoshqiptarë inglizë për çështjen t’onë pastaj do vinte të bashkohesh në Triesht me F. Konitzën.

Mua më shkruan nj’a 2-3 shoqëri t’ represantoj po të ish e mundur, në atë kongres. Po mbassi për harxhet e udhëtimit s’jepnin përveç se nga 30 dollarë ç’do shoqëri, gjërra qesharake për një udhëtim kaqe të math e shumë shpenzues, unë u përgjigja që s’mundem t’a pranonj atë përfaqësim, i cili munt të më kushtonte më se 500 dollarë.

Përveç këtyre dhe një çështje tjetër më ndalonte të shkonja nga Amerika dhe kjo ish se, mbas largimit të Faikut e të Fan Nolit s’mbetej tjetër veç meje kush të vazhdonte propagandën e patriotismit për Shqipërin’ e lirë e për zgjedhjen e mbretit të saj. Prandaj edhè u ndala në Amerikë, me gjithë që edhè të tjera shoqëri më von më propozuan t’i përfaqësonj në Triesht.

Pra Fan Noli iku për Londrë dhe Faiku pregatitej të nisej për në Triesht si delegatë.

Në ato dit – ishim në muajin e Frorit 1913 – takoj që ardhi në New-York një miku im, Sotir Gjika, nga Shtika e Kolonjës, i cili nisej nga S. Bridge Mass, të vinte në Shqipëri, prej së cilës ishte largura 20 e sa vjet. Ky në atë koh’ e sipër kishte bërë nj’a 6. 000 dollarë dhe kështu vinte në Shqipëri me qemerin plott.

Më lajmoj me telegraf se po vinte në New-York e më lutej t’i kaparosnja një vent në klasin e II në vaporin 30. 000 tonësh “Gorge Washington” të Shoqërisë “North German Lloyd” që nisej prej New-York ato dit për në Liverpool të Anglisë dhe s’andejmi për në Cherburg të Francës dhe në Bremen të Gjermanisë.

Atë natë që ardhi S. Gjika në New-York më ngjau një rrezik i math. Kisha do paret e mija, 860 dollarë, të mbledhura prej ikonomive të mija dhe i kisha marrë përsipër që t’i vinja në Bankë. Taksirati im që u ndoth Banka mbyllur dhe të hollat më mbetnë në xhep, dhe me gjithë që ime shoqe më tha t’i linja në shtëpi, ishte taksirat t’i mbanja akoma përsipër.

Si ardhi Gjika e e prita, i bëra një darkë të mirë dhe sa do që kishim edhè mysafirë atë natë, ju dërgova fjalë të mos më presin.

Si hëngrëm mirë dhe që t’a kënaq edhè më mirë Gjikën e shpura edhè në theatro, në Metropolitan.

Fati i keq, mbassi e vendosa në hotel dhe po kthehesha në shtëpi (banonja në 39-ën rrugë midis 7-th e 8-th Avenue-së), kur po drejtohesha në shtëpi t’ime, pashë se dritta elektrike për çudi ishin shuar. Kësilloj po shkonja më t’erët, pa pasur as një dyshim. Kujtonja kurrë se do ndodheshin gangsterë në kthizë të New-York-ut?

Tek po shkonja, katër të panjohur më presin rrugën. Dy me revolverë në duar më dalin ballë për ballë e më thresin : “Hands up”! d. m. th. “duart përpjetë” dhe më venë në gjoks grykat e revolverëve.

Ç’ të bënja? I ngrita duart përpjetë. Ahere njëri po m’a mbante në ballë revolverin e tjetri më kërkoj andej këtej, më gjeti portofolin, më mori të gjitha të hollat 800 dollarë, tuke pasur mirësinë të më lerë prej tyre 20 dollarë edhè sahatin e florinjtë!.... .... .... . . .

Si mbeta vetëm zura po fërkonja sytë se mos isha në ëndër, po……. mjerisht ishte e vërtetë!! Ata hajdutë të këqinj më kishin xhveshur, më kishin marrë shpirtin, më kishin lënë fukara, edhè me një karvan njerës pas, se, si thashë, përveç gruas e djalit t’em kisha në shtëpi edhè t’ime vjehrë me t’im kunat Niko Poçin, të dy fëmijën e s’ime kunatë Marigosë, Vason e Fereniqin, po edhè baxhanakun Kostaq Kottën me të shoqen Angjeliqinë, dhe të gjithëve ne n’a mbante gazeta e gjorë “Zëri i Popullit”, se as im kunat Niku s’kishte ndonjë punë, as K. Kotta!

Më kot vajta në Polici! më kot u përpoqa të zbulonj kusarët! Pastaj thonë se s’ka vent më i sigurt e më i organizuar se sa Shtetet e Bashkuara!

Kur u ktheva në shtëpi, gati si i lojtur menç e ja tregova aksidentin vetëm s’ime shoqe, ajo sa t’ja kiste të qarit e të këputte cullufet, si bëjnë të gjitha gratë në raste të tilla të

shembëllta, përkundrazi e priti mandatën me një gjakftohtësi të rallë e më dha një inkurajim jo të vogël. T'u bënë kurban, më tha, të rrosh vetë, prapë i vè në vent! Fjalë burnore që s'i harronj kurrë, që i mbanj ment edhè sot. Edhè ahere njoha edhè më mirë karakterin e lartë e të paçmuar të shokut t'im të jetës. Këjo më ringjalli edhè e harrova të keqen.

Të nesërmen u poqa prapë me Gjikën, të cilit i tregova taksiratin e math që më gjet, tuke shtuar se, po të mos kishim vajtur në theatro ndofta do mos e kisha pësuar atë maskarallëk. Po, Gjika, ndjeje Zot shpirtin e tij, se vdiq i shkreti i mjerë në Bari – Gjika po thom, i cili m'i dëgjoj ato fjalë me vërejtje, mer fjalën e më thotë : "E mar vesh se jam shkaktar që humbe këto të holla, po unë kam përsipër 6. 000 dollarë, beqar jam, s'kam kush të më kërkonjë gjë, prandaj për një mik si ty, që e kam dashur e adhuruar aqe fort, I bënj theror do pare; mos kij merak, se të hollat që të mvodhë t'i jap unë"! Edhè me një herë fjalët që tha i shoqëroj edhè me vepra. Nxori kuletën e më hodhi përpara 8 copë banknote nga 100 dollarë njëra! Do edhè të tjera më tha?

Për Perënditë tërë u çudita me këtë gjenerozitet, me këtë kalorësi të këtij miku! Kurrë nuk do t'a besonja. Bravo! ……. . Kaqe më mallëngjyen fjalët e tija, sa kujtova atë ças se i gjeta paret e mija.

Ja ktheva prapë, tuke e falenderuar fort për këtë bujari, po Sotir Gjika – kokë kolonjari – s'desh t'i merte të hollat. Unë kam, më thotë, edhè 5. 000 dollarë të tjera, 800 më pak, 800 më tepër, s'do me thënë gjë më thotë, theror u bëfshin për një mik. Kush e di si vjen sëra një dit, më thotë. Po me gjith' ato unë s'ja mora, dhe Sotirit të gjorë e pashë se i ngeli hatri.

Tuke folur, i tregova për Kongresin Panshqiptar të Trieshtit, që do bëhej më 1 Marsit. Më tha se kishte qef edhè ajy të ndodhej në Triesht. I thom unë se janë 3 shoqëri, që më janë lutur t'i përfaqësonj atje, po japin vetëm 90 dollarë. Mer, më thotë, Gjika vetëm përfaqësimet e tyre, d. m. th. kredencialet, dhe sa për të holla kemi vetë. I heq unë, thotë, të gjitha harxhet, mjafton të jem pranë jyve; për mua, thotë, këjo do ish një lumëri!

Unë këto fjalë ja thashë s'ime shoqe, e cila, për çudi më tha edh'ajo që do bënja mirë të nisem me Gjikën, që me këtë shkak të harronj edhe taksiratin që më gjet, edhè mbasse hiqnja edhè këmbën xvarë, si themi ne, për në Shqipëri, e kështu i tërhiqnja të gjithë andej. Në këtë mëndje ish edhè Nik Poçi e Kostaq Kotta. More, ju thom, a jini ndërment ju, që po flisni kështu? Po gazetën kush do t'a drejtonjë "Po ju si do bëni pa para një karvan njerës"? Mos n'a qaj hallin, më thanë, se do bëhemi garçona në për hotelet e shtëpinë s'e lemë të vuanj. Fundi i fundit m'u mbush mëndja edhè mua, mbassi dashkan të gjithë. Mbi këtë bëra edhè një hesap. Sido qoftë, s'ime shoqeje do t'i linja harxhet e rrugës, e po t'a shëkonte pisk do ngrihej të vinte bashkë me djalin, në Triesht, ose në Napoli, ku t'i urdhronja vetë.

Ahere piqem prapë me Gjikën, i cili u gëzua fort kur e pa se e vendosa të shkojmë bashkë e më thotë se të gjitha harxhet janë të tijat. Mbi ato kaparosmë shpejt dy bileta të klasit II në vaporin splendid "George Washington" vizuam shpejt pasaportat dhe ishim gati! Nga ana tjetër unë lajmërova shoqëritë të më dërgojnë shpejt brenda 3 ditëve letrë-përfaqësimet përkatëse e kështu brenda 3 ditëve kisha marrë 4 përfaqësime me 120 dollarë.

Sotir Gjika i shkreti nxjer e më jep 300 dollarë për t'i lënë në shtëpi, e sa për të tjerat ishte pun' e tij. Kësisoj i lashë 120 dollarë s'ime shoqe, i dhashë 100 doll. të tjera K. Kottës që të komandonte shtëpinë me ikonomi të madhe për nj'a 2-3 muaj, pa më von kishte Perëndia. Vetë mbajta 80 dollarë me qëllim që, ja se do hynja në Vlorë dhe do t'i sillnja të gjithë, ose vetëm gruan e djalin, ja se do kthehesha prapë në Amerikë, gjë që s'e dëshëronja kurrë, se më ishte mërzitur tepër vendi i Washingtonëve, ku kisha gati katër vjet, pa një farë prokopije!

Kështu, si mora edhe të 120 doll. të tjera nga shoqërit' e përmendura, që s'ja rëfeva njeriut, u nismë më 20 të Frorit (1913) me "G. Washington" prej New-York-ut tuke lënë zembrën e shpirtin në New-York, d. m. th. gruan dhe djalin.

Kishim një lundrim, një udhëtim extra në Oqean, me gjithë që ishim në palcën e dimbrit. Kaq' i paqm e i ri ish vapori, kaqe n'a kishin kujdes brenda, sa në asnjë kompani tjetër transatllantike nuk e kisha parë, ndonse ishte e katërta herë që po e kryqëzonjë Oqeanin e math. Nat-për- natë kishim teatro, si p. sh. të parën natë kishim "Otello", të dytën "Aida", të tretën "Boheme", të katërtën "Cavalleria Rusticana e

Pagliacci" e të pestën "Norma", gjith'ashtu koncerta dy herë ditën, tennis etj. etj. kaqe sa kur arthmë në Liverpool të Anglisë n'a artdhë shumë keq që u mbarua aqe shpejt Oqeani.

Në Liverpool ndejmë nj'a 8 orë. S'andejmi vijmë në Plymooth, ku ndejmë edhè 4 orë të tjera dhe q'andej hoqmë drejt për drejt për në Cherburg të Francës, ku arrimë në orën 20.

Një vaporaq ardhi e n'a mori nga vapori i math e n'a nxori në tokën franceze. Merret vesh me sa hidhërim u ndamë nga bashkëudhëtarët t'onë, me të cilët kishim shkuar aqe mirë në Oqean, si dhe në detin e Manche-it, dhe i fatmironim se do shkonin edhe nj'a 3 net të tjera akoma mirë, gjer sa të vinin në Bremen e në Hamburg.

Si duallm nga dogana pyesim për trenin për Paris, e n'a thanë se s'ka tjetër tren, veç një që shkonte në mes të natës expres për turistët me klasë "unique" e të shtrenta. Ja përkthenj Gjikës shqip, sa që folmë frëngjisht me kapostacjonin frenk dhe Gjika, si hovardar që ishte, ç'ka më thotë, shkojmë me këtë tren, sa të rijmë e të flemë në Cherburg.

Kështu ne mes të natës u nismë nga Cherburgu dhe në pikën e mëngjesit arthmë në Paris. Po në vagon brenda kishim një muhabet të gjatë me dy franceska Pariziane, që po vinin edh' ato në Paris, kështu që gjithë nata shkoj me muhabet, edhe Gjika, nga që s'kuptonte "gra" frëngjisht, ose flinte atë natë, ose merrej me një diksioner të Kristoforidhit, që i pata dhënë që në New-York, tuke përshkruar fjalë shqipe të reja q'andej e tuke i msuar mëgojë[1], dhe si një tjetër filozof Anaximenis, as që shtiri sytë një herë t'i shohë ato franceskat.

Në mëngjes ishim në Paris. Posa duallm në stacjon muarm një karocë dhe hoqmë në "hotel dè Passy" afër Trokaderasë.

Si i lamë valixat në hotel, i thom Gjikës të dalim të shetitim një herë Parisin e dëgjuar e të përbotshëm. Po Sotiri kish qef më mirë të rinte në hotel e të merrej me diksionerin e Kristoforidhit se sa të dilte nëpër qytet. Kur kam parë një New-York theshte, është nevoja tani të shoh Parisin?

Kur e pash' ashtu e lashë Gjikën në hotel e u drejtuash me një herë në Tour Eiffel, mrekullin e çuditshme të kapitalit frances, i cili ishte afër hotelit t'onë, posa që të kalonje lumin e bukur e të kulluar Senën (La Seine).

Afrohem në Tour Eiffel edhe me një herë hyra në portikë dhe tuke paguar 2 fr. Francet, hipa në assensor, i cili ecte shumë nga dalë, gjer sa për 15 minuta isha në majën e Tourit Eiffel. Oh, sa bukuri, një bukuri e patreguar, një sent extraordiner.

Që andej dukej Parisi i paanshëm, si një fushë e gjërrë dinga me shtëpi e ndërtesa të çuditshime, me ato kathedrale të mrekullueshme e ato paysages deliciose. Dikur më dukej se si kur anonte pak maja e mrekullueshme e asaj kulle. Vura re mirë edhè konstatova se trualli i kullës sikur ishte, ose shkiste nënë këmbët e mija. Bëra çudi edhè pyeta me njëherë le guide, udhërëfyesin d. m. thënë : Dit done, qu'est ce qui c'est que sa? Il me semble que ce plancher est en mouvement. M'a pret me një herë guidi : Oui, monsiur, ça c'est vrai, porcequ'il se mouve vraiment, le tour, mais n'ayez pas peur, më thotë. Kështu tundet gjithnjë, më thotë, po mos kini frikë.

Që atje lart shkrova letrën e parë s'ime shoqeje, që arthmë mirë gjer në Paris dhe e impostova po majë kullës. Pas një ore zbrita poshtë, po kurrë s'më delte mentsh ajo përshtypje manjifike që kisha marrë prej tourit nalt.

Si zbrita ja përmbusha në Place de la Concorde, ku të tjera bukurira më prisnin. I fillova pastaj me radhë quartieret e Parisit, pastaj pashë Champs Elysèes, shetitjen më të bukur që ka

[1] mëgojë = përmendsh (H. K.)

në Botë, Mont Martre, Quartier latin, Vandomë, Bastille, Arc de Triomphe, Notre Dame de Paris, ku kujtova Hugonë, Dumasët, Rabelais, Moliere, Voltaire, Corbeille, Racine, Chateaubriand etj. etj. ku solla ndër ment gjithë revolucionet gjaksore francese, guillotinat etj. etj. dhe sa e sa romane frëngje që kisha kënduar. Më së fundi vajta në " Bois de Boulogne", në pyllin, ose parkun më pitoresk e romantik të botës.

Gjith' atë dit më ra ndërment të vete t'i bënj një vizitë princ Aladro Kastriotit, që banonte në rue St. Martin Nr. 9. Këtu më ngjau një episodë.

Posa që shkela kopsën elektrike të portës së sokakut, vjen një djalosh e më çel derën. Hynj brenda midis një kopshti të gjatë dhe posa që afrova në banesën, një njeri venerable më del përpara. Unë që kisha parë fytyrën e Aladros në fotografi e e sillnja gjithënjë ndër ment, posa që e pashë atë fytyrë që ngjiste aqe tepër me princ Aladron, më nje hërë qëndrova, qita kapellën e e salutava gjer më dhè, tuke e emëruar me titullat "naltësi", "naltësia jote" etj. etj. të cilat ajy i priste me një nënëqeshje, gjer sa u futa brenda në salon e u ula mbi një fauteuil[1].

Dikur kthehet e më thotë: më vjen keq zotni, se s'e gjeni princin këtu. Ka dy dit që iku për në …. . di unë se ku…. . Po zotrote, i thom, cili je ahere, mbassi s'qënke princ Aladrua? Jam, thotë, bostanxhiu i tij, edhè zu qeshte, po mos u çuditni, më thotë, në një gjuhë të kjartë parisjane, se shumë veta e kanë pësuar këtë, se me të vërtet i ngjas shumë t'em zot Princit.

Po pse s'ma theshe që në krye, i thom, po më lè e të servira kaqe "naltësira" gjer tani? Apo të vinte mirë, i thom. Natyrisht që kënaqesha, më thotë, e s't'a prisnja hovin, e filloj të qeshë mirë. E pashë se kisha të bënja me një typ parisiani, që ju pëlqen të qeshin gjithë ditën.

Më dolli pastaj edhè një zonjë mesatare, e cila ishte mantenuta e princit, po unë si u përvëlova një herë me kopshtarin, nuk dinja me ç'titull t'a komplimentonja edhè këtë, gjer sa më në funt i thashë : më ndjeni, me ç'farë titull duhet t'ju adresohem, se unë po vinj këtu për të parën herë. M'a prêt : jam zonja …. . s'mbanj ment ç'farë. E kështu zura e po i flisnja me embrin zonjë. Po ajy kopshtari i ngjiste kaqe shum' Aladros sa ishte çudi. Shumë veta ishin gënjyer.

Më së fundi, si ika që andej, më ra ndër ment se në Saint Clouë, në Boulogne-sur-Seine (Roud point) kisha edhè një kushërì, Nikollaq Lakon. Mar tramin e dal në Madeleine e drejtohem në shtëpi të tij, ku, mbassi s'e gjeta, i lashë një kartë-vizitë e kështu Nikollaq Lakua n'a ardhi atë natë në hotel e n'a mori në shtëpi të tij, ku n'a rekomandoj edhè me të shoqen Mrs Margheritën, Parisiane, po e cila e fliste shqipen si të ish një korçare. Kemi shetitur kështu bashkë më shumë vënde të shënuara të Parisit, tuke parë shumë monumenta. Po, mjerisht s'patmë kohë t'a shetisim Parisin si duhej se do niseshim për në Triesht.

Si ndejmë 3-4 ditt në Paris u nismë e vamë në qytetin historik Nancy të Francës, qytet fort i bukur, i ngrehur mbi disa bregje pitoreske. Si ndejmë disa orë aty

vamë në Strasburg të Gjermanisë ahere dhe q'andej në Karlsruhe. Ndejmë edhè këtu një natë. Të nesërmet ndrojmë tren e vemë në Ulm, që andej ne Stutgard, qytet tepër i bukur dhe që nga Stutgard, vamë në Munchen (Monaho).

Aty ndejmë dy ditt e kemi shetitur gjithë atë alamet qyteti, kapitalin e Bavierës, qytet extraordinar historik, klasik. Pamë atje më të shumtat e momumenteve të shënuara, kathedralet e muzet' e bukura, parqet e statuat e çuditshime etj. etj.

Si lamë Monahon arthmë në Augsburg dhe q'andej u futmë në Austri, ku në qytetin Vilah qëndruam nj'a 4-5 orë. Mbas tri orësh udhëtimi ishim në Triesht, ku mora edhè unë pjesë në Kongres, sado që arriva në ditët e fundit.

Si u shpërnda Kongresi, i cili pati një rezultat të mirë për Shqipërinë e lirë, shumë delegatë Shqiptarë, si ata të Rumanisë, të Bullgarisë, etj shkuan nëpër vënde të tyre. Në Triesht mbetëmë gati nj'a 50 delegatë.

Me Faik Konitzën e me Fan Nolin u poqmë në "hotel de la ville" të Trieshtit,

[1] fauteuil = kulltuk (përkthyer nga frengjishtja me google H. K.)

ku Faiku më fort u çudit si u ndodha edhè unë në Triesht, që ajy më dinte në Amerikë. Fan Noli, i cili s'e kishte mirë ahere me Faikun më afrohej më fort mua. E vërteta ishte se nuk kish edhè të holla tamam e kështu hanim më fort bashkë bukë, kurdoherë me ikonomi, ndonse Faiku kish boll dollarë prej "Vatrës" dhe rronte si princ.

Sotir Gjikës n'a i kish hyrë një merak të msonte italisht, se i pëlqente mjaft kjo gjuhë ashtu si e flisnin në Triesht, e mbassi unë e flisnja si do ku do m'u vardis t'i bënja nga dy orë ditën msim. Edhe unë s'ja prisha qefin Sotirit. Kaqe maniak ishte pas italishtes, sa u qep pas hotelit e s'delte fare jashtë.

Po në Triesht gjetmë belanë nga disa Shqiptarë delegatë, të cilët s'di se qysh kishin mbetur pa të holla në Triesht e s'kishin as për të ngrënë.

Një prej atyre, i mirënjohturi nër redhet nazionaliste si "Shaban-beg Goça", i cili s'ish tjetër veç se Leonidha Dhosi, një dreqi vetë, po edhe vagabond internacional, mbassi vuri borxhe më të katër anët e gënjeu edhe Gjikën e gjorë e i mori 300 dollarë, qinse do vinte në Venetik të piqeshe me mbretin aspirant të Shqipërisë, Ahmet Fuadin, për të cilin bëra fjalë edhe tjetër herë.

I shkreti Gjika, njeri naif, njeri që s'e kish njohur akoma karakterin vagabond, kujtoj se ka të bënjë me një njeri të math, i cili s'kishte prishur akoma një çek (?) të math në Bankën e Trieshtit, se u ndoth e Dielë atë ditë, kurse i zoti i hotelit e kish shtërnguar për të hollat e hotelit. Ky, pra, Shaban-beu kish një rendez-vous me Fuadin në Venetik, i cili qinse e kishte thirur nergut atjè këtë njeri të math.

Unë kisha harruar t'i thom Gjikës të ruhet nga ky vagabond i pashoqtë, që kish rijepur botën. Ç'ngjau pra? Shaban beu, i cili më njihte mirë e e njihja më mirë që tjetër herë, tuke qenë se desh të shtinte shuma të mbëdha në dorë nga paralliu Ahmet Fuadi, kish nevojë të ketë pas edhè një Shqiptar tjetër si nacionalist të mirënjohur, e kështu tuke e përdorur këtë si ndërmjetës, ose tuke e shkuar për budallà, të munt t'i rëmbente fashën më të madhe princit (nuk lexohet H. K.), dhe si mjet të këtillë më zgjodhi mua.

Më mer (atë dit që gënjeu Gjikën) e më thotë më nj'anë se ishte nevoja të shkonim në Venetik të piqeshim me Ahmet Fuadin për çështjen e fronit të Shqipërisë,

mbassi ajy ish kandidati më probablë. I thashë se un' e kam kritikuar A. Fuadin me gazetën t'ime e s'munt t'i delnja në sy. S'ka gjë, më thotë, ju bashkonj unë se e njoh

që në Misir, ku kam qenë inxhiner në çifligjet e tija. Mir' i thom po pse nuk shkon vetëm? Është nevoja, thotë, të kem edhe një, ose dy shokë të tjerë, prandaj ti je mjaft. Ç'ka, i thom, po unë s'kam të holla të vinj në Venetik e të kthehem prapë. Kam unë thotë. Ku i gjete, bre? i thom. Ti s'kishe fen' e metalikut gjer dje! Shaban beu, i cili s'dinte se kisha ardhur tok me Gjikën nga Amerika, më tha se ka njohur një kastravec, një teknefes, që ka ardhur tani nga Amerika e ka plot dollarë, e ja hodhë vllakën, thotë, sa të fërkosh sytë. Aman bré, Shaban bè, i thom, cili ësht' ajy, nuk më thua që t'i kërkonj edhe unë? Ti m'a lerë mua t'a mjel, më thotë, mos u përzje!

Po mua s'më duroheshe gjer sa e shtërngova e m'a rëfen, se ajy kastravec, ajy guak që u gënjye prej tij s'ish tjetër veçse i ngrati Sotir Gjika! Ahere s'm'u durua. Me një herë mora tjetër fytyrë. Ajy njeri që e paske gënjyer, i thom, është miku im e kemi ardhur bashkë nga Amerika. Të lutem ktheja shpejt paratë që more e mos u bëj rezil! A i kè mentë? më thotë. Unë mezi ja mora e ti kërkon të vete t'ja jap prapë? Si e pashë që s'kish qëllim të mirë, u nxeha me një herë e i thom : Atë që i bëre Gjikës m'a kè bërë mua. Ç'thua ja jep paratë prapë, apo jo? Ajy qeshte e s'e turbullonte gjakun. Po në mos ja dhënça? thotë. Në mos ja dhënç ahere po shkonj që tani në Polici e po të bënj pesë para, i thom; mos e sill punën gjer atje se do të të kushtonjë keq këjo që bëre!

Dha, mori, të më bintte, s'ish e mundur. Filloj pastaj të më marë me të mirë, po unë s'dëgjonja aspak. Ngrihem me një herë e lëshohem të vete në Polici. Ajy më ra pas, e kur e pa se vërtet po drejtohesha në Polizei e kuptoj se s'bënja shaka më hoqi në një kafene e nxjer më

jep 100 dollarë. Të gjitha, i thom, të gjitha, ndryshe s'të ndahem. Më jep ahere edhè 100 dollarë të tjerë;Akoma i thom. Si, akoma, po s'kam të tjera. S'është e mundur, i thom, nxiri të gjitha. Ahere pa ç'pa më nxori edhè 72 dollarë të tjera. Kusurin e kishte prishur. S'i lashë gjë!

Ahere me lott ndër sy më thotë: po kështu do më lësh të vdes për bukë? I tillë që jè, i thom, rraj edhè vehten po të duash! Po si e pashë se u zbè në fytyrë e ment ikte nga mentë, i lashë edhè dy dollarë e i mora të tjerat e ika, pa dëgjuar as një lutje tjetër.

Vinj e gjenj Gjikën që po këndonte italisht, si pa gjë të keq. Ajy s'më pa që po zjenja nga inati. E sjell fjalën të më tregonjë për Shaban benë ku edhe si e njohu e e pashë se më fliste për atë me një enthusiasmë të madhe, si kur kishte njohur personin më eminent të Shqipërisë. I thom, këta persona janë aventurierë të klasit parë që ti s'ke haber fare, mor ditshkurtër! Mos të gënjeu edhè me ndonjë parë? Po, thotë, i dhashë 300 dollarë. Treqint dollarë? E s'të ardhi keq aspak? Po pse s'më pyete mua? E bëra këtë faj, thotë, po tani ç'bëhet? S'më vjen aqe keq për paret, sa që më gënjeu!

Ahere i tregova ç'ngjau e qitta e i dhashë të 270 dollarët që i mora Shaban beut, aqe sa u habit e mbet me gojën hapur Gjika. Tani, i thom, hapi sytë se mos të të gënjenjë tjetër kush. Edhè që të mos kish pare për sipër e detyrova t'i verë në Bankë të gjitha të hollat që kish për sipër, sepse edhè herë tjetër, kur ishim në Paris, i humbi një kulet' e veçantë me 2. 500 dollarë e për fat ja gjeta unë dhe ja dhashë, prandaj Gjika pat hair e jo dam prej meje që arthmë tok nga Amerika.

I kisha thënë Gjikës se Shaban beu desh të vinte me ato të holla në Venetik që të piqeshe me Ahmet Fuadin, të cilit do t'i shkëputte ndonjë fashë të mirë, se ish i zoti. Ahere m'a pret Gjika që s'do ishte keq të vinim edhè ne në Venetik, që të shëkonim edhè çudirat e atij qyteti të çuditshëm që ishte ngrehur për mbi ujët. Si të duash, i thom, në mos të dhembin paret. Po né harxhojmë që harxhojmë thotë, si këtu, si atje e mbassi s'po hapet blokua për të vajtur në Shqipëri, në daç, më thotë, munt të rijmë edhè në Venedik.

Kështu u nismë atë natë të dy me Gjikën dhe të nesërmen ishim në Venetikun e bukur, tuke qëndruar në hotelin "Rialto" ku pas dy ditt n'a ardhë edhe Shaban beu, i cili i lypi ndjesë Gjikës për ç'ka i punoj. Po mua s'më honepste dot.

Pas dy dittsh kemi pasur pjekje me princ Ahmet Fuatin njeri shumë gentil e fisnik, typ Europjani. N'a mbajti për drekë, vetëm mua. Folmë më shumë se dy orë bashkë, po s'më tregoj as një zembrim, as pakënaqësi për sa kisha shkruar kundra tij ne "Zëri i Popullit". E pashë se dëshëronte shumë të hipte në fronin e Shqipërisë, se kam edhe unë, më tha, gjak e zembër Shqiptari, si stërnipi i të madhit Muhamed Ali. Unë ja përcillnja sa mundja ëmbël dëshirat e tij të respektuara. Më pyeti në kam nevojë për gjësendi e i thashë "falemi nderit, jo, s'kam ndo një nevojë".

Shaban beu më gjet veçanërisht e m'u lut fort mos i thesha gjë Princit për atë. Bëj si të duash i thom, unë s'ngatërohem, veç se kur më përzihesh me miqtë e mij. Prandaj Shaban beu bëri si bëri i çkëputi nj' a 2. 000 lireta italjane princit.

I ndejmë disa ditt në Venetik e s'lamë vente monument pa parë u kthyem prapë në Triesht, në jetën e parë, se në Venetik mërzitet njeriu pa automobile, pa tramvaje e karoce e pa kallaballëk, kur se në Triesh i kishim të gjitha.

Na u bënë plot një muaj në Triesht e s'kishim asnjë shpresë se mos thyheshe blokua e Vlorës prej Grekëve. Unë tuke mos dashur t'i bije më qafë Gjikës, kisha prishur gati gjithë paratë që kisha për sipër e më dukej se mbeta rehen në Trieshtë, se s'isha as për në Shqipëri, as për Amerikë.

Nga ana tjetër kishim gjetur belanë edhè prej Shqiptarëve te mbetur në Triesht, të cilët gjithënjë n'a ngarkoheshin nevoj, se s'kishin bukë të hanin. Unë ju kisha ndihmuar nj'a 40 dollarë dhe Gjika më tepër se 100 dollarë, po ku arrijshin dot gjith'ata?

Tani unë kisha gjithsej 10 dollarë. Ky ish gjithë kapitali im. Gjika më jepte sa t'i kërkonj, po s'mundnja, se për udhëtimin për mua, si edhè për harxhe të tjera kish prishur për mbi 600 dollarë. Pra duhej t'i gjenja derman vehtes.

Po vrisnja mendje disa nett me radhë e s'e gjenja dot. Një dit më mer Fan Noli në kafe "Exelsior" e si më gostiti një melange, më pyeti a kam pare t' huanj ndo 100 dollarë. I thom se kapitali im përbehët vetëm prej 10 dollarësh; po të duash të jap gjysmat. Po të jetë për 5 dollarë, thotë Fan Noli, të jap unë 10, se kam akoma nj'a 20 dollarë, po unë dua 100. Pse, i thom. Se…. . edhe fillon të më rëfenjë një të tërë.

E njeh në thotë dukun Monpensier? – Po e dëgjonj për të parën herë, i thom. Ky është famus parelli më thotë Fan Noli, edhè një nga kandidatët e fronit të Kastriotëve. Tani gjëndet në Napoli dhe matet të vejë në Vlorë. Po të kisha, thotë, 100 doll. Do vinja atje do t'a shtynja të çante blokon me yahtin e tij, do t'i mernja të holla për ju (me fjalën "ju" Fan Noli kish parasysh mua, Hil Mosin, Hamdi Ohrin, Filip Krajën, Goxhamanin edhè Sotir Gjikën, të cilët ishim një taraf kompakt) dhe do t'ju sjell të gjithëve në Vlorë. Po si t'ja bënja që s'kisha? Po më një herë u kujtova. Aqe para n'a huante Gjika. Ja kërkova e m'i dha me një herë. Po në vënt të shkonte Fan Noli, u nis Hil Mosi me Hamdi Ohrin.

Këta vanë në Napoli, u poqnë me Monpensienë, po nuk di pse s'e bindën të venë bashkë në Vlorë. As Hil Mosi, as Hamdi Ohri, s'deshin të n'a rëfenin ç'pësuan, por se dukeshin si njëri, si tjetri tepër të mërzitur e ju vinte plasje se prishnë ca të holla pa bërë gjë!

Mirë po sa vanë e ardhë këta, këtej ngjisnin të tjera havaze. Italjanët ishin të zembruar që pse s'e bëmë Kongresin në Itali, po në Austri, mbassi Italia kaqe fort n'a përkrahu në çështjen e independencës s'onë. Për këtë shkak ishin dërguar disa agjenta, të cilët filluan të merren vesh me mua e me Fan Nolin, që ishim nga kryetarët e Shqiptarëve të jashtëm.

Ne si e pamë se Italia ishte dispose të prishte disa qindra mijësh lireta për të fituar pondin e saj për kundra Austrisë dhe nga ana tjetër mbassi n'a bëheshe edhe nè mirë të kishim një qendër të dytë, ku me shtyp e me mjete të tjera munt t'i sillnim dobi çështjes s'onë edhè më fort të tre qyteteve të mbëdhenj të Shqipërisë, Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës, të cilat ishin në rrezik të math të merreshin prej Serbisë e Greqisë, arthmë në marrëveshje me agjentët italjanë.

Austriakëve ju râ në erë për një herjesh dhe filluan të n'a marin me të mirë, që të qëndrojmë në Triesht, ku na jepnin gjithë lehtësinat, të holla dhe një shtypshkronjë e zyrë në dispozicjon t'onë, etj. etj. Mua më thiri drejtori i Sigurimit publik të Trieshtit Dr. Von Metkovich e u mundua të më bindë të qëndronj me shokët, tuke më ofruar edhe 10. 000 korona (500 e ca napolona ahere) që të mbanjmë ato shokët e gazetën vetëm për 3 muaj. Po unë s'ja pranova, jo për tjetër, po se ju ishim lutur më parë të n'a lehtësonin të nxirnim një gazetë shqip e ata s'n'a qasnë as në pragun e derës e tash si dëgjuan italjanët u zgjuan.

Ju thashë shokëve e më thanë se s'bëra mirë, po më në fund e muar vesh se kisha të drejtë. Vërtet dhì të zgjebura ishim, po kokën e kishim përpjetë. Nuk është marifeti, ju thashë, të marim ca para, po është marifeti të bëjmë edhè punë. Italjanët i bëjmë si të duam, po Austriakët kurrë; këta janë lanetë, ju thom, s'i gënjejmë dot. Po më mirë t'a hedhim synë nga Italia

Në Milano ahere ndodhej Prenk Bibë Doda, princi i Mirditës, i cili, me pretekst që do t'ju jepte italjanëve gjithë pyjet e Mirditës për exploatim, ju kish marrë italjanëve me anë të një ndërmjetësi të Qeverisë Giaccomo Bismara më tepër se 500. 000 lireta, me të cilat hante e pinte e bënte qef në Milano, edhè italjanët prisnin të stabilizohej qetësija në Shqipëri e të vinin të mbaronin punë me Bibë Dodën!

Ne tuke ditur këtë prej Shkodranëve që kishim në Triesht ju thamë agjentave se nuk munt me as një mënyrë të pranonim të holla nga Italia, se s'ishim aventurierë, po si patriotë që ishim deshim vetëm të na siguronte gazetën Qeveria Italjane; të n'a jepte në dispozicjon me shpenzimet e saj Agjensinë "Stefani" të lajmeve telegramoradiografike dhe të n'a mbanin 5-6

shpirt me ushqim për një kohë 6 mujore me kushtin se këto të holla do t'i paguante një dit Qeveria Shqiptare. Dhe mbassi këto i pranuan pa një pa dy italjanët dërguam në Milano Hil Mosin, i cili si u muar vesh me Bibë Dodën me Vismarën, me Dr. Paolo Mashin e me Profesorin Italo-Shqiptar Giuseppe Schirò, më dërgoj mua 150 korona (8 napol. të sotme) për

të gjithë shokët që po linja amanet në Triesht.

Në stacjon më pritnë në Milano Prof. Schiroj e Hil Mosi e hoqmë në hotel "Roma", hotel luks. Si hëngrem bukë, shkuam të tre tok në Galerì të qytetit dhe atje filluam të bisedojmë gjërr' e gjatë për çështjen që ardha. Hil Mosi, si anëtari i shoqërisë s'onë, m'a la radhën mua të flas.

Prof. Schiroj, mbassi i pranoj të gjitha konditat e mija, si përfaqësonjës i Vismarës, i Italisë d. m. thënë, më pyeti a munt të mblidhemi më tepër se 6 në Milano për të formuar komitetin t'onë. I thashë, mjafton të paguani me konditat që ju propozova e ju sjell 16 po të doni. Sa më shumë më mirë më thotë Schiroj, i cili me këtë bashkë, më proponoj t'ju japin edhè një farë rroget se cilit nacionalist mbassi munt të kenë edhè nevoja vehtijake. I thashë, kur doni të ndihmoni fakir fukarenjtë aherë Zoti ju shtoftë bereqetet, po t'a dijni se unë s'lè as një prej shokëve të lëshojnë dëftesa se muar pare nga Italia, se ju thashë se duam të punojmë si patriotë e jo si propagandistë e mercenarë, atë duhet t'a dijni.

Prof. Schiroj, kur mori vesh se ç'qëllim kishim, më thotë se Italinë s'e gjen gjë të japë ca të holla, e t'ju lerë të lirë të punoni si patriotë, përkundrazi është nder' i saj që djelmt e Shqipërisë të punojnë për Shqipërin' e lirë në tokën italiane dhe është gati të bëjnë edhè ç'do sakrificje tjetër, mjafton që solli një contra-coup[1] kundra antagonistes mike (Austro-hungarisë)

Edhè Schiroj m'u lut t'i paraqitnja budxhetin e harxheve t'ona, të cilin edhe ja paraqita me gjithë detajet. Pas këtij do paguhej prej Qev. Italiane dhoma e bisedimeve t'ona, shtypshkronja dhe redaktimi i gazetës, të gjitha shpenzimet e tjera telegrafo-radiotelefonike, do n'a installohej telefon në zyrë dhe gjithë orendit e nevojshme, plus do paguheshim nga 400 lireta në muaj ç'do anëtar, si ata edhè unë etj. etj. , sado anëtarë që të sillnja në komitet.

Z. Vismara i kish pranuar të gjitha ato dhe më dorzoj me anë të Dr. Paolo Maschit lireta 20. 000, për të cilat do mbanja hesap unë. 22 lireta bënin një napolon. Mua veçanërisht më paguanin edhè hotelin, si kryetar që isha e më jepnin nga 1. 000 lireta në muaj, pa ju dhënë asnjë dëftesë për këto, përveç se mbanim ato hesape për shtypshkronjë e harxhet e tjera të "Stefanit".

Të nesërmet thira telegrafisht nga Trieshti Fan Nolin, Hamdi Ohrin, Filip Krajën, Ndrek Kiçin, Sotir Gjikën e Zef Kurtin. Më von dërgova e mora dhe Dhimitër Beratin, Spiridhon Ilon dhe Mihal Gramenon dhe tuke u shtuar në shoqërinë t'onë dhe italoshqiptarët Prof. Orazio Iriani, prof. Giuseppe ose Zef Schirò dhe avokat Kosmo Serebe, si dhe inxhineri shqiptar Sabatini, dhe ne të dy me Hil Mosin e më von edhè Luigji Kodheli prej Shkodret u bëmë gjithsej 16 shpirt dhe kështu formuam komitetin t'onë "Shqipërì e rè" dhe filluam të punojmë.

Prej shokëve n'a iku Fan Noli, i cili do vinte në Rumani e Russi për çështjet e tija dhe më von Hil Mosi dhe Dhimitri Berati. Ne që mbetmë pasuam veprën e nisur me një nxehtësi të madhe e me përfundime të mira.

Munt të thom se 100% telegrafet t'ona e meetingjet dhe apelet e tjera mbi Sir Edward Grey dhe politikanët e tjerë të Francës, të Gjermanisë e të Shteteve të Bashkuara shpëtuan më parë Shkodrën nga thonjt' e Malazeziasve, pastaj edhe Korçën e më së fundi Gjirokastrën nga thonjt' e Grekëve, në një kohë që Vorioepiriotët deklaronin se s'delnin të gjallë nga ata vende dhe Kral Nikolla i Montenegros insistonte "Scutari o morte", "Shkodrën o vdekjen"!

[1] contra-coup = kundragoditje (përkthyer nga frengjishtja me google H. K.)

Në ato kohë i famshmi duku Monpensier kishte thyer ablokon e Vlorës me yahtin e tij, kishte hyrë në Vlorë e kishte marrë e sjellë në Napoli Ismail Qemalin me dy djelmt' e tij Etehemin e Qazimin si dhe Gurakuqin Aloisin.

Ismail Qemali posa ja mbrini në Napoli dhe tuke ditur nga Monpenè-ja se jemi disa Shqiptarë në Milano sidhe adresën t'onë, më thiri mua në telefon e vajta e u fjalosmë. I thashë gjëndjen t'onë e vepërimet, i dhashë haberet e mija për Shkodrën e Korçën, që ata andej s'dijnin gjë dhe më në funt i shpjegova gjithë programin e vepërimeve t'ona. U gëzua fort. Më lajmoj se po shkonte në Vienë më anë të Venetikut. Ju luta ahere që, mbassi po vinte në Venetik, munt të drejtoheshe që nga Bolognia në Milano që të shihte e t'a shihnin dhe s'andejmi munt të shkonte për në Vien. Harova të përment se kishte pas edhè të famshmin luanin e Kosovës Isa Boletinin.

Ismail Qemali e pranoj propozimin t'im edhè në të nesërmen me një ceremoni të jashtëzakonshme e pritmë në hotelin "Cavour".

Si ardhi Ismail Qemali e poqmë edhè me Prenk Bibë Dodën dhe kështu që të dy, njëri si kryetar i Toskërisë e tjetri si kryetar i Gegërisë nënëshkruan një protokoll ku në emër të Qeverisë Shqiptare më autorizonin mua me shokët e mij të punonim jashtë Shqipërisë për integritetin e plottë të saj. Kështu ishim edhè një herë akoma brenda rregullit sepse veprat t'ona ishin vepra gjysmë-zyrtare të bëra drejt për drejt me autorizimin e Qeverisë vetë.

Ismail Qemali si ndenji 3-4 dit në Milano u nis për në Wien, tuke n'a lënë nevoj të bir' e tij Etehemin e Dhimitër Beratin. Po midis të tjerave më tregoj se Vlora e rethinat po vdesin për bukë nga shkaku i blokimit nga an' e flotës Greke, edhè se është nevojë të përpiqemi t'i gjejmë ndo një çarè kësaj krize.

Si iku Ismail Qemali un' e vura shpejt në vepërim këtë, edhè pas një marrëveshje me Qeverinë Italiane, ministri i ahershëm i P. Jashtme Marqezi z. San Giuliano dha urdhër që të ngarkohet një vapor i tërë me mjellra, orize, patate, galeta, kuti qumështi të sterilizuar e sende të tjera ushqimi për popullin e Vlorës dhe një njeri të shkojë apostafat në Vlorë t'i shpërndanjë.

Z. Vismara m'a komunikoj këtë shpejt e më tha se duhet të nisem vetë të shkonj në Vlorë për t'i shpërndarë në popull. Më dha si harxhe vajta e ardhje 2. 000 lireta, dhe me këtë bashkë ishte paguar edhe ferovia alle-retour, si edhè në vaporin "Adriatico" që ish i ngarkuar me këto ushqime, më ish rezervuar kabinë e posaçme në Klas të I.

Nisem, pra, nga Milanua me një enthusiasmë të madhe, e kur arrinj në Foggia hasem edhè me sekretarin e parë të Min. P. Jashtme avv. Spartacus Canarsa, i cili do asistonte në Vlorë me mua në distribucjonin e ushqimit.

Në Brindisi më priste vapori dhe kur hyra brenda kapitani i I më bëri shumë komplimenta. Në Vlorë prapë dolla në Skelë me barkën e kapitanit e u prita prej Vlonjakëve me një enthisiasmë të patreguar, si një shpëtimtar, se në Vlorë ahere s'kish as mjell, as gjë!

Të nesërmet, mbassi u çkarkua gjithë malli në skelë, në bazë të listave që n'a paraqiti Bashkia u bë edhè ndarja më 3 ditt e sipër dhe mbetnë shumë të kënaqur se mbajta paanësi e një painteresim shëmbëllor.

Si mbarova misjonin, pregatitesha qe të nisem prapë në Milano. Po Qeveria Shqiptare s' më linte të shkonja. Ministri i Drejtësisë Petro Poga më dha me

një herë dekretin me të cilin më emëronte Kryetarin e gjyqit shk. I të Vlorës me rrogë 16 lira turke, me misjon që të organizonja dhe gjyqet e tjerë Shqiptarë që ishin në formim e sipër, tuke adaptuar zyrtarisht gjuhën shqipe. Për këtë shërbimin e dytë do paguhesha akoma nga një lirë turke ditën më tepër, veç rrogës dhe shpenzimeve e udhëtimit përsa të vazhdonte organizimi.

Unë u ndodha në një pozitë delikate, se, si patriot s'munt të refyzonja një shërbim zyrtar, me të cilin më ngarkoj e para Qeveri Shqiptare, sa do e vogël qoftë roga. Po ana ana tjetër, si i ngarkuar më një misjon nga ana e Qeverisë Italiane me një qëllim mirëbërës për Shqiptarët e

Vlorës, s'munt edhè të mos kthehesha në Milano, ku kisha edhe detyrat e komitetit t'onë përsipër.

Kështu i dhashën fjalën Qeverisë s'onë se, posa të vinja në Milano, do sheshtonja punët e komitetit, do t'ja ngarkonja barrën t'ime tjetër kujt dhe do kthehesha në krye të detyrës që në ngarkoj Qeveria. Dhe ashtu bëra.

Po u duk se nuk do kthehesha më në Amerikë dhe ishte nevoja të sillnja fëmijën t'ime në Vlorë. Të holla kisha me vehte nj'a 10. 000 liret prej ikonomive të bame. Prandaj posa arriva në Milano i pari vepërim që bëra ishte të dërguarit ne ime shoqe e navlonit që të vinte bashkë me djalin gjer në Genova dhe s'andejmi i prisnja unë e shkonim bashkë në Vlorë.

Prita gjer sa gruaja ime mori të hollat dhe gjer sa mora telegraf që vijnë me vaporin "Mendosa" në Napoli. Kështu që ditën e caktuar u ndodha në Napoli, por për fat të keq nuk ardhë me atë vapor. Gjith' atë dit u lajmërova se vijnin pas një jave me vaporin "Madonna". Po unë me që s'kisha kohë u drejtova në Vlorë dhe atjè me një herë fillova nga detyra ime, si kryetar i gjyqit shkallës I të Vlorës. Pas një jave ardhi edhè gruaja me djalin t'em, dhe më von ardhi edhè Kostaq Kotta me të shoqen, gjeta në Vlorë dhe t'em vëlla Thanasin me teton t'onë plakë Ndinon dhe kështu zumë një shtëpi në Ujin e Ftohtë të Vlorës, ku pastaj ardhë me né dhe baxhanaku im Jovan Pozio me t'ime kunatë Marigonë.

Kështu, pas kaqe taksiratesh, pas kaqe hallesh e aventurash u mblothmë prapë në Shqipërinë tonë të lirë, fort të enthusiasur e të lumur!

Komiteti jonë, i cili me të vërtet punoj burrnisht e i shërbeu mjaft mirë problemit t'onë nacional, mbassi u largova unë dhe disa shokë të tjerë u shpërnda. Prej të gjithë nevej mbetnë Gjika dhe M. Gramenua të cilët si ardhi mbreti Wied, u kthyen dhe ata në Durrës.

## XVII

Kur fillova nga puna si Kryetari i Gjyqit, ose më mirë të them, kur mora dekretin e vajta në zyrë të fillonj nga puna, më ngjau një episod që meriton mundimin t'a përshkruanj këtu.

Unë si isha mveshur me roba santa-krut të bardha e me kapellë panamà, hyra me një herë në odën e veçantë të Kryetarit të Gjyqit. Aty gjeta tre zotnij që rinin mbi karigat e bisedonin. Prej këtyre dy ishin anëtarët e gjyqit, një plak Hassan bej Nishani dhe një më djalë Emin Kokalari. I treti ish Prokurori, që të tre këta prej fabrikës së madhe të Kadilerëve e Nurabxhijve të Gjirokastrës.

Kur hyra e i salutava dhe kur më panë ashtu me kapellë të bardhë, s'dhanë as një rëndësi dhe as u tuntnë nga vendi. Kujtuan se jam ndo një i huaj, ose ndo një

ndërgjygjës. S'më dhanë as një fron të rì, po gjeta në një cep atjè një karige të çalë e u ungja.

Ç'urdhron? më thotë ajy më plaku Hassan beu. As farë gjëje, i thom, ardhsh t'ju shoh. Edhe fillova t'a pyes: Si vini me gjyqet? – Ashtu ashtu. Sa civile, sa penale kini në për duart? – Kur i thashë kështu, Hassan beu, njeri nopran më pa një herë në sy me inat e s'më dha përgjigje. Unë pa u tronditur aspak e pyes prapë : Në ç' gjuhë i redaktoni vendimet? – Hassan beut i plasi shpirti tani dhe m'a pret me një herë hovin: Nuk më thua, zotrote, kè ndo një punë këtu, apo ke ardhur të ma bëç kontroll? Që të dyja, i thom, edhè punë kam edhè kontroll ardha të bënj.

Hassan beu më mori për të çmëndur ahere dhe çohet nga vendi e më tregoi derën me inat : del jashtë më thotë shpejt e n'a lerë rehat. – Qysh, i thom, kryetarin e gjyqit, kryetarin t'uaj dboni në këtë mënyrë? …. Qysh? Qysh? ....

Një konfuzion i patreguar ngjau ahere. Të gjithë u ngritnë më këmbë dhe si u paraqita dekretin, zunë e po kopsitnin xhaqetat e tyre dhe s'dinin si të silleshin. Hassan beu lëshon kulltukun e kryetarit e më vjen përpara, tuke më zënë për dore e tuke mosditur si të më

kërkonjë pardon! Qysh? Qysh? Zoti Floqi qënke zotrote e s'n'a thua? Bujrum, zoti Kryetar; Bujrum Reis-bej Efendi, urdhroni në fronin t'uaj, edhe aman, aman n'a ndjeni. Ne ju prisnim po s'muarm vesh se kur arthtë.

Të dy të tjerët më përshëndoshnë me një barrë komplimenta, si kur se Hassan Nishani dhe unë u ngrita prej kariges çalë edhe ndenja në kulltukun e qetë të Kryetarit.

Me një herë Prokurori dolli jashtë dhe lajmoj gjyqtarin Hetues Ali Tabakun, prapë nga Gjirokastra, kryesekretarin, Notarin si dhe gjithë sekretarët e tjerë e kopistat e arqivist-protokolistin. Këta u vrulë në zyrën ku isha dhe një nga një më përshëndoshnë tuke u rekomanduar prej Hassan Nishanit! I prita të gjithë me kënaqësi dhe, si kryetar' i tyre, i këshillova për detyrën e tyre përpara Shtetit e përpara meje.

Nuk munt të përshkonj në pushim edhè nj'a dy-trè episodi që më ngjanë në ditët e para në Vlorë, mbassi mora detyrën.

Disa miq më këshillonin të mos e vè kapellën, se bënj përshtypje të keqe, mbasi jam i vetëmi nëpunës i krishterë dhe mbassi të gjithë janë me feste, ose me kallpakë, a me takije. Unë në këto s'jepnja as më të paktën rëndësi, as që i mernja parasysh, dhe i salutonja të gjithë hulemânj e hoxhallarë gjithë tuke nxjerë kapellën evropajisht.

Mënia e Onxho-bonxhove (si i quan M. Gramenua), s'e duronte dot më kapellën t'ime dhe ardhi dita që të pëlciste vullkani kundra meje! Qysh? Reizi me kapellë? Ollmas, efendëm, ollmas, dipter ; né ollaxhak bojlè? Utanas qafir, qopagllu qepek! Këto edhe shumë të tjerëin sa një dit u mblodhë nj'a 15-20 hoxhallarë në divanin e Prefekturës, ku ishte edhe gjykatorja e jonë me prijës një fanatik, fanatiku Haxhi Muhametin, një gjakpirës plak, ardhë atje me një koxhà-mazbata në dorë të destinuar për Prefektin e Vlorës. Ish ahere Prefekt Fehmi bej Leskoviku.

Unë s'dinja gjë prej këtyre, po një nga shërbëtorët e mij, plaku Kadrijaj nga Gjirokastra, i cili më donte shumë se ja kisha shtuar rrogën prej 3 mexhite 5, ky arth e më tha se ata hoxhallarët kishin ardhur të ankoheshin ne Prefekti për mua, i cili, me kapellën që mbanja e me sjelljet e mija do t'i bënte kaurë gjithë adlijexhinjtë[1] që kisha nënë urdhër.

Unë i thashë Kadriajt të lajmëronjë komandantin e Gjindarmërisë Mustafa Kosovën, Shqiptar nacionalist ky, i cili me një herë ardhi në zyrën t'ime. I thom, pafsh Zotin n'a i çpor qafet këta firauna që n'a kanë okupuar gjithë divanin e Gjykatores.

Mustafaj, i cili jepte shpirtin për mua del me një herë dhe me qenë se s'deshin të shpërndahen me të mirë e zunë të më shanin mua, Mustafa beu i mori me përdhuni dhe i nxorri jashtë që të gjithë.

Qysh ahere filloj një mërì e madhe kundra meje nga an' e tyre dhe s'më duronin dot sa herë që më shihnin. Kush e di sa lutje i bënë Ismail Qemalit të më pushonjë nga puna dhe kush e di sa ankime të tjera bënë te ministri Poga për Reizin[2] kaur, mua, që po ju prishnja fenë e që po stërvitnja djelmurinë në ndjenja liberale, me anë të propagandës patriotike që po bënja për dit.

Mërin' e atyre e forcoj edhè një aksident tjetër. Kadiu i Vlorës, i cili ish një fanatik turkoman nga Gjinokastra, n'a kishte okupuar odën në Gjykatore. Me qenë se Prokurori më ankohej se s'kish zyrë të veçantë unë ju luta nj'a dy herë Kadi efendiut të n'a lëshonte odën dhe ajy të gjentte një odë tjetër. Edhè me që s'dëgjonte me lutje i adresova nj'a dy shkresa, po as ato s'e bintnë Kadinë revolucionar të lëshonjë odën. Ahere më kapi një maras që s'rëfehet dot. Në inat e sipër hyra vetë te Kadiu e ju luta edhè një herë të lëshonjë odën, po ajy vetëm s'e lëshoj po më urdhroj me zembrim të dal jashtë, si kur se të më dbonte nga shtëpia e tij. Si e pashë kështu m'u prish gjaku e s'e urdhrova dot vehten, e pashë se s'ishte çdukur akoma Turqia e qelbur e se këta zgjebarakë Turkoshakë s'ishin të kënaqur me Shqipërin' e lirë.

[1] adlye = ndërtesë e gjyqit (përkthyer me Google H. K.)
[2] reis = kryetar (H. K.)

Me një herë i afrohem përsipër Kadiut rezil, e zè për jake me sa fuqi kisha, e ngreh nga vendi e e përfshinj, i jap një shkelmë të mirë dhe e nxjer përjashta në divan, ku u përplas sa i gjati ish. Bërtiti ahere sa mundi se “e vrau kauri” dhe me një herë gjithë zyrtarët gjyqsorë e administrativë duall jashtë në divan dhe e panë Kadinë të shtrirë. Po lumnisht ata ishin gjithë djem patriotë si një e një, përveç ca xhorave të vjetër që s’n’a prishnin aqe punë e kështu shumica më dha hak mua. E vërteta ishte që u pendova mjaft për këtë vepër të papëlqyer që bëra, po i duheshe një msim i tillë atij turkoshaku të keq!

Kështu e nxora nga oda dhe vendosa atjè prokurorin. Kadiu u protesta dhe kërkonte dënimin t’em, po cila gjykatore e naltë munt të më gjykonte mua kurse gjykatë e këtillë nuk existonte?

Ky episod bëri të madhe ndërshtypje më fort në qarkun e hoxhallarëve e të softëve dhè veçanërisht në Qeveri. Ismail Qemali qysh ahere s’më shinte me sy të mirë. Më quante “asì” d. m. th. revolucionar nëpunës dhe pas 2 ditsh më dha urdhër të shkonj si kryetar i gjyqit në Elbasan në vent të Ibrahim Xhindit nga Kanina, që ishte Kryetar në Elbasan, po unë edhè këtij vendimi i kundrështova, tuke i thënë Ismail Qemalit se nuk ka të drejtë ajy si Kryetar i Qeverisë të më transferonjë, se kjo e drejtë i rezervohet vetëm ministrit të Drejtësisë. Po kur e bindnë edhè Ministrin Pogën të më transferonj, edhè ky për të satisfaktuar Ismail bejnë m’u lut më parë, pastaj më komunikoj edhè zyrtarisht transferimin, unë ju përgjegja shkrimisht se as ministri i Drejtësisë s’ka të drejtë të transferonjë një funksionar pa dashjen e tija, përveç se po të deshim nè të dy kryetarët, unë edhè Ibrahim Xhindi të këmbenim vendet, por se unë s’desha.

Kështu për të madhin maras të Ismail Qemalit unë mbeta në vendin t’em edhè qysh ahere munt të thom se s’pyesnja njeri, as dëgjonja urdhra, po bënja mbi kokë të

vet, mirë po populli i Vlorës më adhuronte nga ana tjetër se gjeti një drejtësi të plottë ne mua, një paanësi të pashoqtë, se unë ju binja në kokë pa mëshirë bejlerëve, të cilët deshnin me ç’do mënyrë t’ju hanin hakun fukaranjve; shumë prej atyre kisha burgosur me gjithë kërcënimet që më bëjshin, vendimet i eksekutonja shumë herë vetë, pa u drashtë as prej njeriut, kaqe sa Komisjoni ose Kontrolli internacjonal i të 6 delegatëve të fuqive të mbëdha, si dhe organizatorët hollandez, që ishin aso kohe në Vlorë, kënaqeshin fort nga drejtësia e paanësia ime dhe i shihnin me një mënyrë sympathetike vepërimet e mija juridike.

Mirpo Ismail Qemali, si thashë, s’më honepste dot. Ruante ditën që të m’a marrë hakun. Ngjanë edhè disa të përpjekura midis atij e mua, që ju shtuan edhè më tepër inatin dhe kështu e shihnja se dita-ditën humbisnja nga sympathia e tij faqe meje. Do të tregonj dhe këto episodi, që të merret vesh sa ishte i zembruar me mua Kryetari i Qeverisë Ismail Qemali.

Një dit më dërgon në zyrë një inspektor (myfetish), të cilin vetë Ismail Qemali, pa marrë mendimin as të Pogës, që ish ministër i Drejtësisë, dhe i cili inspektor quhej Mehdi Borshi.

Ky M. Borshi më vjen në zyrë dhe kërkon të më kontrollonjë aktet, dosjet, defterët e zyrës etj. etj. E pyes, me ç’ të drejtë ka ardhur, e më thotë se është inspektor i Drejtësisë. I thom ku e ka dekretin ministrial e më përgjigjet se ësht’ emëruar prej Ismail beut. Ahere i kthehem e i thom se s’e njoh aspak e s’i jap të drejtë të kontrollonjë edhè me qenë se u zembrua i bir’ i botës e ishte gati brenda në zyrën t’ime të raportonte kundra meje në Qeverì, unë ju luta të n’a lerë rehat se kishim edhè punë, dhe raportin munt t’a bënte me gjithë qetësin’ e duhur përjashta.

Po z. Inspektor u zembrua fort e më thotë të dal jashtë. Unë prapë s’ju zembrova, po i thashë se është turp të kërkonjë të më nxjerë jashtë nga zyra ime, kur se jam brenda, po mbassi e pashë se e teproj e zu po sillej harbutisht, u ngrita nga kulltuku e i tregova derën. Nuk e di si e fetisi Perëndia dhe dolli tuke sharë, se ndryshe nuk e di se ç’munt të ngjiste atjè, se përveç që kisha anëtarët e mij e sekretarët që më adhuronin e s’do më linin të turpërohesha, po sa për z. inspektor m’a hante syri se edhe me duart e mija ja mernja hakun.

Inspektori i paraqiti një koxha – mazbotë Ismail Qemalit kundra meje, ku edhe unë s'di se ç'kishte thënë. Ismail beu më thiri të nesërmet në zyrë të Kryesisë në Skelë, tuke qenë atjè edhè 3 ministra, A. Gurakuqi[1], Myfid Libohova dhe Gjorgji Çakua; më pas u shtua edhè Poga. Në mes të Ismail Qemalit e e meje filloj ky dialog:

Ism. Qem. Nuk më thua, memûr[2] je ti, apo andart[3]?

Unë. Memûr zoti Kryetar.

I. Qem. Kur një memuri i dërgojnë një myfetish t'a kontrollonjë, memuri duhet t'a pranojë, apo jo?

Unë. Si urdhëron, duhet t'a pranojë, po myfetishi që ardhi të më kontrollojë s'ish emëruar ligjërisht, prandaj nuk e pranova.

Ism. Qem. Psè, s'të mjaftoj zotris s'ate dekreti jem?

Unë. Unë, si Kryetar Gjyqi mar urdhra vetëm nga ministri im dhe kujtonj se jam brenda ligjit për këtë.

Ahere mer fjalën min. i Financave Çakua e i thotë Ismail Qemalit se "Floqi ka të drejtë" Ashtu foli edhè Myfid beu. Edhè me qenë se s'fliste Poga, unë ju solla këtij, tuke i thënë se, si munt t'a pranonja myfetishin kur s'isha emëruar prej tij? Po Poga nënëqeshte e s'fliste.

Ismail Qemali s'e zgjati më tepër edhè unë i salutava të gjithë e shkova në detyrën t'ime mjaft i kënaqur. I vetëtitulluari inspektor më s'ardhi të më bëhet havalè. Poga vjen atë dit vetë në zyrën t'ime e më shtërngon dorën, tepër i kënaqur se s'ju binda urdhrit të Ismail Qemalit, tuke shtuar se edh' ajy u ndoth ngushtë kur më urdhronte t'a pranonj inspektorin.

Më vonë me këtë inspektor u bëmë shumë mik dhe e futmë në qarkun e nacionalistëve, tuke e bërë edhè shok në llozhën t'onë të maçonerisë, ashtu si bëmë dhe Rauf Ficon, Pertef Pogonin, Sulo Bogdon e shumë të tjerë.

Po Ismail Qemali s'rinte rehat dhe gjithënjë qaheshe se unë i shkonj kundra edhè se më duhet një "ders[4]" (nyim) që të vinj në rregull e të ri urtë.

Për dreq nër ato dit n'a takoj një tjetër ngjarje.

Prej një letre anonime nga Korça informohesha se njëfarë Leko Lugati prej Korçe kish ardhur në Vlorë që të vrasë Sotir Pecin edhè Gani Katundin, i shtyrë prej Komitetit Grek të Vorjoepiriotëve. Unë me të shpejtë mar Prokurorin e vete e kërkonj këtë vërë më vërë gjer sa e gjeta e e mora në verejtje. Mbassi ja dhashë gjyqtarit Hetues dhe e gjykoj, e e burgosi.

Po i burgosuni kish edhè miq të tjerë, të cilët ndërmjetsuan pranë Ismail Qemalit dhe ky i dha urdhër Prefektit t'a nxjerë jashtë. Prefekti, Fehim bè Leskoviku, pa një pa dy i jep urdhër drejtorit të burgut dhe ajy e nxjer jashtë të burgosurin, i cili qysh atë natë iku shpejt nga Vlora.

Të nesërmen më ankohet Gjyqtari hetues se Prefekti e liroj të burgosurin. Me të shpejt unë thres drejtorin e burgut dhe mbassi i hoqa një të sharë e nxora me njëherë nga shërbimi. Telegrafisim ku mundim qinse i burgosuri në fjalë n'a iku nga burgu dhe e zenë në Fier, e lidhin e n'a e sjellin prapë në Vlorë, ku, me të shpejtë, Gjyqtari Hetues i pret letër-reshtimin dhe e burgos prapë.

Prefekti më kërkon fjalën pse e burgosa rishtas Leko Lugatin dhe ju përgjigja se iku nga burgu. Prefekti më thotë se e lëshoj vetë me urdhrin e Ismail Qemalit, po edhè unë ju përgjigja se as njeri s'ka të drejtë të përzjehet në detyrat e mija e më fort të Prokurorit. I zembruar shkon shpejt ne Ismail Qemali dhe kush di se si e sa ju ankua kundra meje. Pas dy orësh më thret Ismail beu në Skelë, ku edhè vajta e ju paraqita.

- Ç'janë këto hynere që më punon zotrote? më thotë. Gjithënjë rebel do jesh kundra urdhrave të mija? Si e burgos prapë një njeri që unë e çburgosa, se e pashë se e kishit burgosur pa të drejtë?

---

[1] A. Gurakuqi = Alois apo Luigj Gurakuqi (H. K.)

[2] memûr = nëpunës shteti (H. K.)

[3] andart = pjesmarrës në çetat e komitëve grekë, kryengritës (H. K.)

[4] ders = mësim, leksion (H. K.)

- Kini gabim, i thom, Shkelqësi, unë e lajmova Prokurorin edh' ajy e burgosi, po jo pa një arsye. Dhe kur burgoset një i pandehur vetëm Gjyqtari Hetues me Prokurorin, ose Gjyqi me vendimin e tij munt t'a çburgosin:

- Ashtu thotë Kanuni?

- Ashtu si urdhron. Kanunet vetë ju, Qeveria n'a ka urdhruar t'i zbatojmë edhè ne atë punë po bëjmë.

- Ti bën me kokë t'ënde gjithënjë dhe gjithënjë të gjenj përpara; je rebel dhe s'respekton urdhrat superiore, prandaj që sot jè i pushuar nga puna. Ik tani!

E salutava dhe ika. Që këtej munt të gjykonjë njeriu mentalitetin bizar të sundimtarëve të asaj kohe, të cilët ishin msuar të mos ju prishej qefi dhe t'i merrnin në për këmbë si ligje, si në punë. Anarhi!!!

Ismail Qemali prej inati nxori nga puna dhe Prokurorin, të cilin s'e honepste as Poga, po të cilin unë e kisha dorë të djathtë se ish edhè patriot. Në vent të tij emruan një Prokuror tjetër, të favorizuem nga Ismail Qemali, po të cilin unë e njihnja mirë, se ish edhè kumarxhi edhè pijanec.

Pas 3 ditsh qysh ahere (merret vesh se unë vazhdonja akoma në punë me gjithë që më kish pushuar gojarisht Ismail Qemali), ky Prokuror i ri, një farë Sami…. . prej Gjinokastre, tek zura vëndin e formova gjyqin dhe po fillonja një çështje penale, më heq me një herë verejtjen: - Zoti Kryetar, nuk munt të merni pjesë në gjyqet! - Pse, t'u ngjatë jeta? - Se jeni pushuar nga puna. - Kush të tha, efendëm? - Ismail beu - Të lutem shëko punën "Unë protestonj" Protesto gjer nesër. Një e një bëjnë dy. Do mbash vëndin që kè, a po jo? Kaqe po të thom. Po Prokurori u ngrit me inat e iku. Shkoj shpejt në Skelë t'i japë sihariqin Ismail Qemalit. Unë nga ana tjetër emrova një prej antarëve si zëvëndës Prokuror dhe vazhduam punën.

Pas dreke prapë më thret Ismail Qemali. Ishte kaqe i egërsuar, sa qitte shkumbë nga goja. Posa më pa : Akoma s'ke marrë vesh se jè hequr nga puna? Më thotë. Edhe unë as mbajta, as prita: Zoti Kryetar, i thom, kush më heq nga puna? - Unë thotë. - Një nëpunës, kur pushohet nga puna do ketë edhe një arsye, p. sh. paaftësi në detyrë, moral të çoroditur, ose ndonjë shkak të tillë me rëndësi, mua ç'faj më gjette? - Nuk të jap hesap ty! Të lesh punën shpejt, mos kemi avaze të tjera. - Me ligje, apo pa ligje, z. Kryetar? - Mos folë shumë. - zoti Kryetar, mos kujtoni se një Kryetar Gjyqi pushohet për kapriçon e njërit e të tjetrit? - Si thè, si thè? – Them se ka ligje për të pushuar një nëpunës, ashtu kot nuk pushohet, pastaj kemi edhè ministër drejtësije, z. Kryetar : ajy s'ka kurrë një shkak kundra meje. – Unë s'pyes njeri. I ndronj ministrat sa herë të dua. - Ahere, pse s'na thoni të marim raqet e të këputim qafën nga Shqipëria? - Edhe ajo do t'ju gjenjë!.... Ahere edhè unë s'u mbajta dot. Zoti Kryetar, jemi patriotë dhe s'e pranojmë kurrë atë fjalë. Në kujtoni se Shqipëria është çifligu juaj jini të gabuar: nè i kemi bërë ballë një Turqije këtu dhe tani në Shqipëri të lirë do mos munt të rregullojmë vehten? Unë e pranova këtë punësì që t'i shërbenj Atdheut, përndryshe s'kam nevojë se bënj dhe avokatllëk, po një herë zotrija juaj pa shkak s'munt të më hiqni nga puna! - Të heq me përdhuni! - Urdhroni, pra, të më hiqni!.... Këto thashë e zbrita shpejt shkallën vetë e u ngjita më këmbë në Vlorë.

Këjo gjë bëri një potere të madhe, aqe sa e mori vesh edhè Kontrolli internacional e i arth shumë keq për mua edhè më fort kur Ismail Qemali shtërngoj ministrat e tij, veç Pogës, dhe më pushuan nga puna me vendim ministrial!

Posa u muar vesh pushimi im, me një herë dy prej Kontrollorëve ajy i Austrisë Petrovichi dhe i Anglisë Lamp-i më vizituan në shtëpi e mbassi më pyetnë e ju tregova gjith' historinë, më thonë, që unë të shkonja në detyrë, pa e qojtur vehten të pushuar. Nga ana tjetër të dy ata i shkuan Ismail Qemalit dhe i hoqnë verejtjen për mua gjer sa me një vendim të dytë më suall prapë në krye të detyrës, tuke anulluar vendimin e parë, gjë që e kënaqi shumë ministrin e Drejtësisë. Këjo më dha një fuqì të rè edhè gjithëkush m'a kish frikën në Gjykatore, mbassi

munda e e vura me gjithë Qeverinë e dolla fitues. Kaqe e mora përsipër, sa, kur një dit Prefekti Fehmi Leskoviku kolisi[1] mbi derën e odës t'ime një orar për Gjyqësinë alla-turka dhe me gjuhën turqishte, unë e çorra atë afishe dhe në vent t'asaj redaktova një tjetër orar shqip edhè me orët alla-franga. Dukej se këtyre Meuxhibinxhëvet akoma s'ju ishte mbushur mendja se rronim në Shqipërinë e lirë. Kujtonin se po i shërbenim Turqisë akoma e se nè të tjerët ishim rahenj!

Posa që ja kallzuan këtë hyner të ri Prefektit dërgoj e më thiri shpejt në zyrë. Unë s'i vajta as pak. U zembrua e më thiri urgjent me shkresë, por me qenë se e kishte shkruar turqisht unë ja ktheva prapë me një anëshkrim që s'kuptonj ç'më thotë, mbassi s'm'a thotë në gjuhën zyrtare shqipe. Për çudi Prefekti s'më ra më në qafë. Ndofta ju ankua për këtë prapë Ismail Qemalit, po mua s'më trazoj as njeri.

Po nuk shkoj shumë kohë e u bëmë miq me këtë Prefekt, si edhè sot piqemi për dit këtu në Tiranë e më vjen e i vete në shtëpi të tija. Edhe ky shkak ardhi nga vdekja e të ndyerit mikut t'em dhe fisit të tij Orhan bè Pojanit, i cili vdiq ato dit në Vlorë dhe të cilit i mbajta një fjalë funerale në varrim e sipër që i mallëngjevi të gjithë dëgjonjësit e më fort Fehmi bejnë, i cili me lotte ndër sy ardhi e më shtërngoj dorën posa që mbarova fjalën.

Me gjithë që gjyqet t'ona punonin më mirë se ç'do zyrë tjetër, me gjithë që ishim të parit që përdoruam në shërbim gjuhën shqipe dhe formuam një diksionar prej 5000 e ca termash juridike si dhe atë gjuhën juridike që përdoret edhè sot në për gjykatat t'ona, dhe të parët që çpallmë vendimin e parë shqip e të kjartë (dhe vendimi ose aktgjykimi i parë dolli po në Vlorë nga zyra jonë dhe ish një vendim mbi një çështje falimenti kundra shoqërisë italo-oriente "Bernasoni"), po prapë s'kish javë të mos n'a ngjiste edhè nga një episod i rì.

Duhet të përmënden disa episodi të këtilla.

Një dit ministri i P. Brendshme Myfit bej Libohova më sjell në zyrë një akt gjykimi turqisht me fuqi të prème, me të cilin kish për të marrë prej Qeverisë Ottomane 5. 000 lira turke. Këtë akt-gjykim mbassi e përktheu shqip e e legalizoj e vuri në exekutim. Unë, i cili bënja ahere edhè detyrat e nëpunësit exekutues, në bazë të lutjes që kish bërë Myfidi vura sikvestro konservative mbi apothekat ku ishin gjërra ushqimesh ushtrijake turke, dhe kështu bëra procesverbalin dhe vulosa magazitë.

Nuk shkuan shumë ditt dhe vjen në Vlorë gjeneral Karà Seid Pasha, i dërguar nga kryegjeneralli i ushtrisë turke Xhavid Pasha, i cili, i thyer nga aleatët Ballkanas kishte ardhur me 70. 000 e ca ushtri të hallkatur e të rackapitur e të urët në Lushnjë, dhe tuke ditur se kanë disa erzake (ushqime) në Vlorë, kish dërguar një vapor të vogël në limanin e Vlorës, si dhe Karà Seid Pashën që t'i ngarkonte.

Kur i kërkoj çilsat Kara-Seidi, Ismail Qemali s'dinte se i kisha sikvestruar unë në embër të Myfid Libohovës, po mbassi pyeti e i thonë shkakun, dërgoj e më thiri shpejt në konak të tij në Skelë e më nguti t'i jap kyçet. I thom nuk mundem t'i jap kyçet se ato ushqime që janë brenda, janë të sikvestruara edhè kanë filluar të shiten në ankant.

Brè jahù, më thotë Ismaili, edhè këtu po më gendesh kundra? S'e kam fajin unë, i thom, bindeni Myfid bejnë të heqë sikvestronë edhè unë ju dorëzonj me një herë çilsat. – Nep kyçet shpejt, më thotë e leri ato fjalë. – S'është e mundur, i thom, unë jam nëpunës, s'munt të punonj jashtë ligjës. Mirpo Ismail beu u zembrua fort edhè këtë herë e më bërtiti me inat: Doni të losni me fatin e Shqipërisë ju patriotët e flaktë. Nuk shëkoni se akoma s'kemi shpëtuar prej thonjve të Turqisë? Doni të n'a lëshonjë Xhavid Pasha nj'a 20-30. 000 askerë[2] e të n'a bëjnë hì? Mosni, për riza të Zotit; bjermi shpejt çilsat. – Po s'i kam përsipër, i thom, ja kam dhënë kryesekretarit Hairi Kreshpanit.

Unë shkova, po Ismail beu dërgoj e thiri Kryesekretarin t'em. Më anë tjetër posa që u ngjita në Vlorë më vjen Kara-Seid Pasha në zyrë e me një mënyrë brutale asiatike më kërkon

[1] kolisi = ngjiti (H. K.)

[2] asqer = ushtar turk (H. K.)

çilsat e magazeve. Po, i thom, mon general, ato erzake janë të sikvestrume. - Si, thotë? Kush guxon të sikvestrojë mallin e Mirisë. - Nuk e dini se kam 70. 000 shpirt ushtri në Lushnje dhe ju vë zjarë e ju djek me gjithsej? - Digje, i thom e bëje pluhur Vlorën, po unë jam memûr edhè ato tesha janë sikvestruar me ligje. - Me ç'ligje? thotë. - Me ligjet t'uaja; me ligjet e Turqisë, dhe ja tregova gjithë çështjen.

Si e mori vesh mirë më kërkoj ndjesë, më dha të drejtë dhe shkoj shpejt në Skelë të merret vesh me Ismail Qemalin e me Myfid bejnë.

Mirpo Ismail beu e kish thirur kryesekretarin t'em dhe e kish shtërnguar e i kish marrë kyçet. Hairiu vjen shpejt tek mejet dhe unë e binda me frikësim pushimi nga detyra e më dha raport të nënëshkruar prej tij se kyçet ja mori me përdhuni Kryetari i Qeverisë. Këtë raport ja dhashë shpejt Kontrollorit Engles Mr. Lampit, i cili shkoj shpejt në Skelë, ja mori prapë kyçet Ismail Qemalit e m'i dorëzoj mua.

Kuptohet që këtej se Ismail Qemali si kur të më coptonte me dhëmbë s'ngjinjeshe. Po si e pa se do binte, ose ra jashtë, thiri Mufid bejnë, i dha nj'a 2. 000 lira e kështu vjen Mufidi në zyrë dhe ngreh sikvestron. Ahere edhè unë i dërgova Ismail beut kyçet e magazeve.

Të tilla ngjanë plot episodi deri sa një eveniment i fundit ju vuri kapak të gjithave dhe shkaktoj rënjen e Qeverisë. Ky eveniment, i cili është edhè një pikë interesante për historinë t'onë meriton të përshkruhet imtazi.

Sado që ish caktuar prej Fuqive të mbëdha princi i New-Wiedit Wilhelm Wied si Mbreti i Shqipërisë dhe ish dërguar në New-Wied një delegacjon i posaçëm Shqiptarësh, i cili i ofroj kurorën e Shqipërisë Mbretit të rì, një farë Izet Pasha, gjeneral Turk, i ndihmuar prej shumë propagandistëve, mjerisht shqiptarëve, e kishte sŷnë si kur të vinte ajy Mbret në Shqipëri. Për këtë qëllim satanik kish dërguar një mercenarin e tij, major Beqir Grebenenë, një burrë shkurtalaq po trim të rallë e kalorës kryenaltë.

Ky ardhi nj'a dy herë në Shqipëri dhe ishte marë vesh, për fat të keq, me shumë Shqiptarë në zë, si edhè me Esad Pashën, që të sillnin Izet Pashën mbret për Shqipëri. Të holla ishin ndarë pa masë ku mundnë dhe plani ishte goditur mjaft mirë. Kryetari i lëvizjes, ishte, si thashë, Beqir Grebeneja, i cili këtë radhë po priste nj'a 300 oficerë me ushtri, të gjithë nënë uniformë civile, si dhe municjone plot, të cilat do delshin në skelën e Semanit.

Ky komplot, në të cilin - me dashje, a pa dashje kish gisht edhè vetë Ismail beu, si u muar vesh më von, i kishte rënjët të thella, edhe qysh në Mitrovicë të Kosovës e gjer në Shkodër e në Korçë e në Prevezë e dijnin këtë lëvizje. Edhe do gjindeshim një dit përpara një fait-accompli-je, po të mos ishte zbuluar çështja prej Sureja bej Vlorës edhè pas atij edhe prej Mufid beut, kur se pjestarët e tjerë të Qeverisë flinin.

Komanda e Gjindarmerisë në Vlorë, tuke qenë lajmue se me një vaporin e Puglias po vijnin në Vlorë, të destinuar për në skelën e Semanit nj'a 27 oficerë turq me 400 e ca ushtarë me qëllim kryengritje. Beqir Grebeneja vinte më von, si orgtanizator i asaj lëvizje.

Me një herë gjeneralli organizator Hollandez De Weeri i jep urdhër Kolonelit trim Tomsonit, i cili mer edhè 3-4 oficerë të tjerë Hollandeze dhe hipin ne vapor, posa që ardhi, dhe i zë të 27 oficerët e i nxjer jashtë në skelë dhe i burgos. Ushtarët i la të lirë. Nga ana tjetër komandari i tyre Beqir Grebeneja, i cili ndodhej në Itali për municjone lufte e pregatitje të tjera, nuk dinte gjë nga këto. Edhe sa do që u lajmua prej një të besushmit të tij, mjerisht Shqiptar dhe funksionar i naltë, që të mos kthehej në Vlorë, po ky telegraf u konfiskua pa u nisur dhe Beqir Grebeneja ardhi në Vlorë e u zu si miu në kurth e u burgos veçanërisht.

Qeveria e Ismail Qemalit bëri përçapjet e duhura që të lëshoheshin këta oficera prej burgut se mos i ngelte hatri Turqisë, po gjenerall De Weeri, as ju dha rëndësi fjalëve të Qeverisë. Prandaj qysh të nesërmen u formua gjyqi ushtrijak për të gjykuar këta komplotistë, prej 4 anëtarëve civilë dhe 5 anëtarëve ushtrijake, midis të cilëve dhe gjenerall De Weeri si Kryetar. Po duheshe edhe një prokuror edhè një Gjyqtar Hetues (juge d'instruction).

Kolonel Thomsoni, i cili më njihte mjaft mirë e më kish provuar shumë herë e më estimonte[1] tepër, më dërgoj natën dy oficerë në shtëpi t'ime e më lutej të vinja te ajy të fjaloseshim për një çështje me rëndësi. Unë vajta me një herë te Tomsoni, i cili më mori më nj'anë e më kallzoj çështjen e kompllotit të Beqir Grebenesë e më tha që të mar përsipër pjesën që takon Prokurorit, se ne mua kishte besim të plot. Mirë, i thom, po unë jam Kryetar i Gjykatores dhe duhet të mar lejen e autorizimin për këtë prej ministrit t'em. – Ç'çan kryet më thotë i shkreti Tomson, kush i pyet ato, të cilët duket (shumica sidomos) se janë kundra interesit vital të Shtetit. Ti eja me nè, si një patriot i vërtetë që jè, ku përveç rrogës s'ate, kè edhè nga 1 napolon për ç'do ditë për sa kohë të vazhdojë ky gjyq. Prandaj, tha Tomsoni, shkojmë që tash përpara gjenerall De Weerit që të betohesh e të fillosh detyrën.

Këto më tha Kolonel Tomsoni. Po unë tue u mendue më thellë e tue e pa se baza e gjyqit duhet të ishin pa tjetër hetimet mbi kompllotin, dhe ishte nevoja për një njeri funksionar të besimit, sa do që vendi i Prokurorit ishte më i lartër se ajy i Pyetsit, unë preferova të mar pjesën e Gjyqtarit Hetues, për të cilën, vamë bashkë me Tomsonin ne gjenerall De Weeri, edhe ajy m'a besoj me kënaqësi të madhe e më tha të zgjeth për sekretar e nënësekretar cilin të desha dhe të fillonja nga puna.

Më duheshin, pra, dy njerës që të ishin edhè aktivë edhè të besimit, prandaj midis save që njihnja zgjodha si sekretar Taip Libohovën, shkollar diplomè të Universitetit të Stambollit dhe Kostë Çekrezin, si sekretar të dytë, i cili ishte edhè nga anëtarët t'em të Gjykatores dhe kështu e formova zyrën t'ime. Sa për Prokuror zgjodha Qerim Çelon nga Gjinokastra, të cilin ja presentova gjenerallit e e pranoj.

Kështu filluan hetimet piksëpari prej nesh. Unë si isha merak të mernja vesh ç'ngjiste, edhè si interesohesha më fort për personin e Ismail Qemalit, të cilin e shëkonja me një sy dyshimi, mora detyrën përsipër me gjithë zellin e duhur dhe kisha në dispozicjon sa fuqi gjendarmërije e ushtërije që të desha, se Qeveria as që pyeteshe aspak. Pastaj kisha edhe fuqì të pakufizuar të bënja si të desha e të përdornja ç'do mjet që t'a shihnja me nevojë.

Çështja ishte këtu : Me qenë se Shqipëria ish e njohur prej Fuqive të mbëdha dhe Mbreti i saj ish i caktuar e po pritej në Shqipëri, si pastaj njerës të huaj, tiranë gjer djè që mezi shpëtuam nga ata, Turqit d. m. thënë deshin të përzihen prapë në çështjen t'onë dhe tuke patur bashkëvepruës edhè disa prej Shtetit të lirë funksionarë të naltë Shqiptarë, deshin të ndryshonin situatën e vendosur prej Shteteve të mbëdha, tuke e ngritur popullin në revolucion dhe tuke formuar një Shqipëri turke nënë Izet Pashën, që kur të vinte Mbreti Wied të gjindeshe përpara një pune të mbaruar (fait accopli).

Ishte një rast ky për mua që e kërkonja në Qiell e e gjeta për Dhè, se këtej munda të mar vesh sa i çoroditur e i fëlliqur është ky karakteri i Shqipëtarit nga ndo një herë, i cili për ca pare shtyhet në tradhëtinë më të dobët kundra Kombit tij, dhe më fort desha të njoh karakterin tartufik e bastard të ca të vetëquajturve excelenca, të cilët populli naif, i vè në ballë e i nderon jo si prijsa, po si Perëndì e ju jep edhè zembrën e shpirtin në dorë me gjithë që këta janë më të ulët e më të dobët edhe se jevgët ordinerë e arixhinjtë.

Hetimet filluan me nxehtësi të madhe. Dokumentat që kisha në dorë s'ishin edhe shumë të forta, po si zura e i pyeta veç e veç gjithë oficerët e burgosur dhe disa persona të tjerë nëpunës e civilë të brendëshmë e Kossovar si edhè një nga një të gjithë ministrat e Ismail Qemalit dhe si burgosa ndo 20-25 persona të tjerë, prej disa kundrështimeve, kontradiksioneve dhe ballafaqimeve të tyre munda të nxjer shumë sende në dritë, por atë që dëshironja s'e kisha gjetur akoma.

Nga letrat që i gjeta përsipër Beqir Grebenesë, pas dy ditë si e zumë, dhe nga pyetjet njëra pas tjetrës që i bëra mora vesh se kompllotì në fjalë ishte organizuar me themel dhe se Esad Toptani, nj'a dy prej ministrave të Qeverisë së Ismail Qemalit si dhe shumë persona të

[1] estimoj = çmoj (H. K.)

tjerë kishin ardhur shpesherë në marëveshje për këtë qëllim me Beqir Grebenenë dhe ishin katehizuar mjaft mirë në kompllotin, tuke qenë kontent[1] të shohin më mirë një Turçelli, një Tartar mbi fronin e Kastriotit, se sa një Princ Europjan!

Të holla ishin harxhuar e ndarë mjaft për këtë qëllim. Kartat topoherografike që i gjeta Beqir Grebensë në valizat e tij dhe planin e dominimit të Mbretnisë, si e titullonin ata "Shqiptaro-Maqedhoniane" (ku përzjeheshin edhe disa persona të çquara të komitetit Bullgar-Maqedhonas, kësisoj edhè ky plan, po thom, i çuditshëm tregonin një mbretni mjaft të gjërë, një imperium, qysh prej Tivarit, dhe tue përfshirë gjithë Sanxhakun e Novipazarin e Kossovën, si dhe Podgoricën, Kuçin, Pllavën, Tuzin, Hotin e Grudën me gjithë distriktet e tyre, gjithë Shqipërinë e lirë, pjesën më të madhe të Maqedhonisë qysh prej Qafës së Thanës, Strugës, Ohrisë, Prespës, gjithë distriktin të Manastirit dhe gjithë vëndet e tjera këtej lumit Vardharit, gjithë Dibrën e Madhe dhe Çamërinë e gjer në Prevezë, e merte dhe Janinën akoma edhe Konicën.

Si Bullgarët Maqedhonas e Vllehtë e Pindhosit ashtu edhè Shqiptarët (disa) dhe elementi tjetër turk i Kossovës njihnin për mbret të famshmin Izet Pashën, vezir tjetër herë e minister i dëgjuar i Turqisë, ambassador, politikan, etj. me një fjalë njeri shum' i zoti.

Këtë plan, sa për Shqipërinë e pjesën e Maqedhonisë dhe të Epirit (Janinë, Konicë, Metsovë etj.) do t'a vinte në zbatim Beqir Grebeneja, major i Shtabit Madhuer të Turqisë, njeri shumë i zoti, i ditur, guximtar e trim i pashoqtë, në një

moshë jo më shumë se 32 vjetsh. Sa për Kosovën etj. atë ballë e kishte një tjetër kolonel Kosovar.

Në vazhdim të hetimeve, të cilat i ndiqte e i gjyrmonte me një interesë të madhe edhè kolonel Tomsoni, gjeta shumë argumenta, po disa telegrafe me shifra, ose me fjalë të errëta nuk shpjegoheshin dot, prandaj ishim akoma në errësirë.

Po ishte fati i Shqipërisë të delnin në dritë dhe të merrnim masat më efikase përpara një rreziku të rì që po n'a shkrepte mbi krye. Prandaj në të kryer e sipër të kësaj detyre të naltë nuk shëkonja përpara, as përfillnja as një rrezik, as gjumën s'e bënim tamam, se po thuaj nat' e ditë ishim më këmbë. Më të shumat herë punonim natën.

Kështu një natë kisha marë toger Meleq Frashërin me 8 gjendarmë të armatosur edhè komisarin e Policisë Hamzà Isanë dhe po shkonim nga Skela ku u duk një vapor që ardhi. Po drejtoheshim pra në Skelë të Vlorës që të shihnim pasaxherët që do delnin, të cilët i examinuam një nga një të gjithë po s'gjenim gjë. Beqir Grebeneja, sa do që e shtërngova nuk kallzonte gjë, as për fjalët e errëta që gjetmë në letrat e telegrafet s'na jepte një kuptim të plotë.

Si nuk gjetmë gjë suspekt, filluam të ngjitemi prapë në Vlorë ashtu si ishim, tuke ecur ngadalë. Ora do ishte 11 i mezit natës. Kur po afroheshim në qytet dëgjojmë përsëlargu një arabà dhe këmbë kuajsh që po vinin nga Skela. Me një herë i dhashë urdhër Meleq Frashërit të reshtohet andej këndej rrugës së Skelës bashkë me gjendarmët. Unë mbajta vetëm Hamzà Isanë.

Për pak n'a u afrua arabaja dhe piksëparit konstatuam se s'i kish ndezur fenerët. Me një herë i bërtas karocjerit të qëndronjë edh' ajy qëndroj. I them arabaxhiut pse s'i ka ndezur fenerat. Më thotë se kishte haruar. I thom, cilin ke brenda. Iç, thotë, nja jabanxhi pasaxher. - Japanxhi, pasaxher? Kjo n'a vuri me një herë në dyshim.

Ajy që ishte brenda si pa që isha vetëm unë, se komiseri nuk dukej, i jep urdhër karocerit të ecë shpejt e të mos ndalet. Urdhrin ja dha greqisht. Po mua këjo më kalli edhe më tepër në dyshim edhè mbassi pashë se arabaxhiu ju foli kuajve që të ecin me të shpejtë, më kapi inati kundra arabaxhiut, se s'më mori parasysh dhe ja mvesha një herë suratit me kamxhikun që kisha në dorë: nga ana tjetër ju hoth përsipër komiseri Hamza Isaj dhe e gremisi për dhè

[1] content = i kënaqur (H. K.)

arabaxhinë. Ajy q'ishte brenda del me një herë jashtë karoce dhe ja mbadhi këmbëve nga an' e Skelës, tuke ikur me vrap. Po ahere dy pushka buçitnë në herë dhe zëri i të ndyerit Meleq u dëgjua i ashpër në mes të hapësirës : alt! Pasaxheri i panjojtur qëndroj nga frika, se s'pandehu se do t'i dilte aqe e madhe puna dhe kështu u lëshuan dy gjendarmë e e zunë.

E vemë përpara e e sjellim në karakoll të Policisë, si pasaxherin e panjohur, ashtu edhe arabaxhinë. Kur arthmë në dritë shoh një njeri me sedre e me kallca, ose tirqe, një mesatar burrë, në moshën 45-50 vjetshe. E pyes. Quhej Kamber. Në krye bëhej sikur s'dinte tjetër gjuhë veç greqishtes: pastaj e pamë se dinte edhè turqisht edhè vllahisht.

Sado që passaporta e tij tregonte tjetër emër, si e shtërnguam mirë n'a tregoj se ishte i ungji i Beqir Grebenesë! Tani si kish dalë nga vapori pa e marë vesh Policija e Skelës? Tuke pyetur e tuke gjyrmuar, muarm vesh se kishte vajtur

barkë apostafat në vapor e e kish marë, tuke e nxjerë përtej doganës së Vlorës. Edhè ky ishte shkaku që s'e pamë me pasaxherët e tjerë kur duall.

E pamë më të katër anët në trup e s'i gjetmë gjë. Po komiseri Hamzaj, i cili ishte i vojtur në kësi punësh dhe kish experiencë të madhe, i thotë këtij Kamberi të nxjerë tirqet edhè brekët akoma. Kamberi s'deshte, po si hëngri nj'a dy shukreta prej komiserit ahere i zbathi tirqet.

Ç'të shohim? Këtu kish fshehur Kamberi një tok letrash me shumë rëndësi: kish fshehur disa karta të tjera topografie e të Shtabit Madhor, disa skica, disa plane, disa shënime. Më së fundi i gjetmë edhè atë që po e kërkonim kaqe ditt e s'e gjenim, fjalorin kryptografik të fjalëve të errta që ishin në për disa letra e telegrafe të dyshimta, që i kishim zënë e nuk i shpjegonim dot. Gjetmë me fjalë të tjera çilsin që munt të hapnim ç'do derë misteri. Si për shembull. Në një nga telegrafet shkruhej kështu ; Buradà soguk rusgjare gajet shitetllù ve myzir dër. Onën içun hanèi tutçk. Vimyzemçs çok tër stop. Maqina gjyzel ishlier bizè çok, jardëm vermektè dër

Nënëshkrim : Famiglia

Shpjegim nga turqishtja në shqipen :

"Këtu era e ftohtë tepër e fortë dhe e dëmshme. Prandaj zumë shtëpinë. stop. Mashina punon bukur dhe nevej n' a ndihmon shumë. Nënëshkrim : Familia

Fjalët kryptografike të shpjeguara mbas fjalorit që zumë :

Soguk = e ftohta = Austrohungaria
Rusgjar = era, ajri = Politika
Shitedllù = e fortë = E kundërtë
Myzir = i damshëm = Renimqàre
Hanè = shtëpi = Italia
Tutmak = zënë me qira = miqësuar, zënë miq
Ymyz = shpresa = përfundim
Çok = shumë = e plottë
Maqina = mashina = Ismail Qemali
Gjyzel ishlior = punon mirë = ndihmon shumë
Jardëm vermektë-dër = n'a jep ndihmë = n'a jep shumë lehtësira
Famiglia = familja = Beqir Grebeneja

Kështu pra, ky telegraf që i adresohej prej Trieshtit Izet Pashës shpjegohej kështu :

"Izet Pasha, hotel Marica
Stambull

"Me qenë se Politikën Austro-hungareze e kemi shumë të kundërtë dhe renimqare, zumë miqësi me Italinë. Prandaj përfundimi jonë është i plottë. Ismail Qemali n'a ndihmon shumë tuke na dhënë shumë lehtësira.

Nënëshkrim: Beqir Grebeneja

Këtë telegraf e solla si shembëll, se telegrafe të këtilla kompromet ante zumë shumë.

Tani kuptohet se Austria kur mori vesh këtë qëllim[1], u ngut sa më shpejt dhe në marveshje me Gjermaninë e me fuqit' e tjera propozuan Wiedin, si Mbret për Shqipërinë, i cili edhè u pranua. Mirpo, Italia, e cila kish proponuar Dukën e Abruzzëve dhe nuk u pranuan, fshehtëzi vepëronte ç'do propagandë si e si mos zbriste Wiedi në Shqipëri, si u duk e u çfaq më së fundi kur u shtërngua të ikë Wiedi.

Nga kjo politikë, pra, përfitonin Turqit, dhe tue pasë qëllim të sillnin një kontraballancë në fitimet e aleatëve Ballkanas, tuke u çkëputur Shqipërinë, Maqedhoninë dhe një pjesë të Serbisë e të Montenegros, si dhe Çamërinë, gjetnë shokë mjaft, si Esad Pashën, disa bajraktare Kossovas, disa kryekomita bullgarë, disa njerës të shenuar të Shqipërisë, si dhe Ismail Qemalin t'onë, e kështu vunë në vepërim këtë qëllim të çuditshëm, gjer sa prapë u ndalua ky nga ne Shqipëtarët, se Zoti e ka dashur gjithënjë Shqipërinë! Dikush munt të më theshte: Po ç'e shtërngoj Ismail Qemalin të marrë pjesë në një vepër kaqe të poshtër e antipatriotike? Përgjigjem :

Unë e pata psikologjisur thellësisht gjithë politikën aventuriere të Ismail Qemalit. Mbasse arsyea patriotike dhe detyra ime e lartër faqe Atdheut dhe Atdhetarëve të mij, në një kohë kur Shqipëria ishte në rrezik dhe mezì që shpëtoj e filloj të rilindej, nuk më permetonin[2] të çfaqnja kjartazi konviksjonin[3] t'em për këtë burrë Shteti. Po sot më duket se është koha të flasim me letrat e hapura dhe me ndërgjegjen e vërtetë[4].

Ismail Qemalin e njoha në rast të konfliktit të tij me Xhon Turqit. Ky, me qenë se nuk haronte kurrë dackën që hëngri në Parlament prej një deputeti Xhon Turk, ish i pari që ngriti flamurin e rebelizmit, jo aqe për të shpëtuar Shqipërinë, gjë që as ndër ment s'e shkonte, po që të dobësonte Turqinë dhe veçanërisht Xhon Turqit.

I msuar të merte parà pa masë nga të muntte, prej Austriakëve, Italjanëve, Englezëve dhe Grekëve akoma, ndiqte gjithënjë një politikë oportuniste, një politikë fatale për Shqipërinë. Kështu ishte mik herë i njerës politikë, herë i tjetrës. Kish Ismail beu ndjenja Shqiptari[5]? Këtë s'e besonj kurrë, se kurrë ndo një herë s'ju vu gjuhës shqipe t'a msonte, dhe as djemt e tij nuk i msoj shqip as që i riti me ndjenja Shqiptare, sa edhè sot akoma, pas kaqe vjetësh djemt e tij, Mahmudi, Etehemi, Qazimi, Qamili s'dijnë shqip, naturisht se s'janë shqiptarë.

---

[1] qëllim = organizimi i një komplloti nga Turqia për vendosjen e një mbreti turk në Shqipëri (ky kompllot është përshkruar me hollësi nga Kryetari i Gjykatës Penale Vlorë në vitin 1913 Dr. i drejtësisë Kristo Floqi) për t'a kthyer shtetin e posaformuar shqiptare në Shqipëri turke (analoge me Qipron turke të sotme), duke përbuzur gjakun e derdhur nga mijra e mijra patriotëve shqiptarë, në Veri e në Jug të Shqipërisë për të fituar pavarësinë e saj. Kuptohet se Austria është informuar për organizimin e këtij komplloti nga përfaqësuesi i saj në Vlorë si Kontrollor Ndërkombëtar, Petroviçi (H. K.)

[2] permetonin = më lejonin (H. K.)

[3] konvisjon = bindje (H. K.)

[4] Kjo pjesë e "Autobiografia ime" e Kristo Floqit është shkruar në vitin 1929, d. m. th. 12 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë (H. K.)

[5] Në dijeninë time, i vetmi dokument me shkrimin origjinal të I. Qemalit është firma e tij në Aktin e Pavarsisë ku ka firmosur "Ismail Kemal" dhe jo "Qemal". Vetëm ai nga familja "Vlora" ka hequr vullnetarisht mbiemrin e familjes së tij shqiptare , duke e zëvëndësuar me një mbiemër turk "Kemal" dhe jo Qemal. Me këtë veprim ai i ka treguar botës mbarë se ai nuk e ndjen vehten Shqiptar, por turk. Para moshës 70 vjeçare ai nuk ka marrë pjesë në asnjë shoqëri patriotike shqiptare dhe nuk ka asnjë aktivitet patriotik pro shqiptar, as në Stamboll as në ndonjë vend tjetër. Ismail Kemal gjithmonë ka qenë funksionar i lartë i Sulltanit të Turqisë, i ka shërbyer atij me devocjon, pra, nuk e ka ndjerë vehten as një herë shqiptar. Nga ana tjetër, im 'Âtë, Kola, më thote se "I. Qemali nuk e donte pavarsinë e Shqipnisë, por autonominë e saj ndaj Turqisë, porse Isa Boletini e ka detyuar atë me anën e armës të shpallë pavarsinë. Përfundimisht, jo vetëm Ismail Kemal, por edhe të gjithë pashallarët e tjerë që shpallën pavarsinë e Shqipërisë, kryesisht nga Shqipëria e Jugut dhe Shqipëria e Mesme, kur e panë se Turqija u detyrua të largohej nga Ballkani, siç e tregoi historia e mëpasme, kishin për qëllim që seicili të merrte për vehte nga një "llokmë të majme" nga kjo tokë e vuajtur që quhet Shqipëri. Fatkeqsisht, kjo histori u përsërit në vitin 1945, kur "djalli i Kuq"(siç e quante Ât Gj. Fishta komunizmin) edhe në vitin 1992, që vazhdon edhe sot, kur "Pashallarët e rinj", po grabisin pronat e Shqiptarëve. Shënimi është i Henrik Kaçulinit.

Pashë dy telegrafe, njërën që i adresonte Mbretit Konstandin të Greqisë dhe tjetrën Venizellos, ku ju falte disa vënde të Shqipërisë, si dhe Himarën, si kurse ky fliste në embër të Shqipërisë, si kurse Shqipëria ishte timari[1] a çifligu i tija!

Edhè kur u shtërngua prej Austrisë e Italisë të proklamonte Indipendencën Shqiptare, ky ndofta kish mendime të tjera, se kish dhënë të tjera premtime kundrejt shumave pa fjalë të mbëdhà, po s'kish ç'të bënte dhe kështu bëri si bëri, ardhi në Vlorë dhe proklamoj Indipendencën t'onë.

Një tjetër provë ishte edhè këjo. Atij i vinte shumë keq psè Shqiptarët s'ishin të gjithë Muhamedanë po u ndodhë edhè disa kaurë në mes që i prishnin punë. Prandaj festen s'e ndroj kurrë dhe ish i vetëmi ky midis ministrave te tjerë që mbante feste të kuqe edhè sidomos gjer në veshët, kurse kolegët e tij mbanin kapella ose kallpakë. Mua dhe Kostaq Kotten s'n'a honepste dot se mbanim kapella. Një dit, tek ishim bashkë me Kottën në sallonin e Ismail Qemalit, ku ishin dhe shumë të tjerë dhe tuke qënë afër nesh një karekllë bosh vumë mbi atë kapellat t'ona. Ismail Qemali kur e pa këtë s'e duroj dot. Me një herë kthehet e i thotë Durro Shaskës nga Vlora, që e kishim pranë : këtyre kristianëve nuk ju është mjaft që i lamë (!) e mbajnë kapella (??), po n'a zenë edhè nga dy frona! Këtë e dëgjova fort mirë vetë me veshët e mija dhe që të mos prishnja qetësinë se ish aty edhe kolonel Thompsoni dhe delegati i Francës Krajewski, bëra si kur s'dëgjova dhe mora Kottën e dolla jashtë.

Kur hodha Kadinë jashtë me shkelma, Ismail Qemali ish egërsuar shumë kundra meje. Si më thoshte i ndyeri A. Gurakuqi, ahere, paska dëgjuar që ju thoshte një grupi Vlonjakësh, që i ishin ankuar: Flokut (për mua) nuk i mjafton që e vumë memûr, po n'a hipi edhè përsipër tanì! Si t'ja bënj këtij firauni që i dalin zot edhè delegatët e huaj? Po ta kisha në dorë pa ja kallzoja qefin……

Edhe një tjetër provë e fundit të fanatizmit të Ismail Qemalit:

Kur formoj Qeverin' e parë s'pyeti as njeri po i emëroj vetë ministrat si deshi ajy. Edhe ministrat e zgjedhur prej Ismail Qemalit ishin gjithë Muhamedanë edhè asnjë i krishterë, Orthodoks ose Katolik. Mirë po u ndoth në atë mbledhje edhè një veteran tjetër orthodhoks, një karakter i lartër, guximtar i patrembur. Ky ishte i ndyeri Babë Dud Karbunara plak 70 e sa vjetsh nga Berati si delegat i atij qyteti dërguar për proklamimin e Indipendencës.

Dudë Karbunara posa që pa këtë kombinacion ministrash musullmanë që zgjodhi Ismail Qemali pa pyetur njeri, u hoth me një herë përpjetë, protestoj e mori fjalën e tha ;

Ismail bej, kështu n'a e formove Qeverin' e parë kombtare, vetëm prej turqve? Haj, haj, pa ka edhè kaurë këjo Shqipëri e shkretë, more zot. Dobarem të shkonje me një anallogjì, more zot, e të na peshonje edhè né, jo kështu. Kemi edhè nè pjesë në këtë Shqipërì, jo ashtu si doni ju!"

Fjalët e Babë Dudës bënë një përshtypje të madhe në mbledhje, po hipokriti Ismail beu i gëlltiti pa thënë gjë. Resultati i përshtypjes të atij protestimi të paharruar të Dud Karbunarës ishte ndrrimi me një herë i 4 personave që formuan Qeverinë, tue u ramplasue[2] me 4 persona të tjerë të krishterë, Alois Gurakuqin, si ministër të Arësimit, Petro Pogën, si ministër të Drejtësisë, Lef Nosin si ministër të Post-telegrafeve dhe Pandeli Calin, si ministër të Bujqësisë.

Prandaj dua të them se Ismail Qemali, simbas ndjenjave e mentalitetit turk që kish, me të cilat edhè ish ritur, s'e shëkonte me sy të mirë zbritjen e një princi të krishterë e Europjan në Shqipëri, prandaj them se u shty për ardhjen e Izet Pashës, të cilin e njihte mirë edhè me të cilin mbase munt të ndante edhè fitime të tjera, që s'u kuptua dot prej argumentave e dokumentave që patmë zënë.

Sido qoftë, mbassi shkresat që gjetmë mbi Kamber Alinë, i cili ishte edhè dajkua i Beqir grebenesë, n'a nxuar në dritë, hetimet arritnë gjer atje sa kishim një dijeni të plottë mbi

[1] timar = tokë që jepte të ardhura dhe i dhurohej spahinjve në Perandorinë Osmane (H. K.)

[2] ramplasue = me zëvëndësue (Nga frengjishtja H. K.)

veprimet e këtij komplloti dhe gjith' oficerët që kishin ardhur me embra të ndryshme e passaporta false u deklaruan të gjithë të kompрometuar.

Kompрometimi i oficerëvet u muar vesh nga një telegraf me fjalë të ndryshme kriptografike që i hiqte Beqir Grebeneja Izet pashës kështu :

"Hemen Simundè 50 çishmè ve 300 kundràve 10 ogjyz gjonderenëz bekliorëz.

Familia

Shpjegim

Simùn = Semani, ose skela e Semanit

Çishmè = oficerë (çishmà = oficerë)

Kundrà = ushtarë (këpucë = ushtarë)

Ogjyz = topa(buaj = topa)

Domethenë i kërkonte Izet Pashës Beqir Grebena t'i dërgonte shpejt në Seman 50 oficerë, 300 ushtarë dhe 10 topa, si kundrë edhè ja dërgoj Izet Pashaj edhè i zumë në Vlorë, përveç ushtarëve që i liruam mbassi s'kishin krye e përveç topave, të cilat

s'i gjetmë se vijnin me tjetër vapor, e mbassi u muar vesht zbulimi i kompllotit në Vlorë, u kthyen prapë nga ishin nisur.

Sidokudo brenda 20 ditëve hetimet i plotësova dhe si dhashë vendimin e duhur, përpara se t'ja komunikonj Prokurorit, simbas ligjës, mbassi ky nuk loste ndo një roll aktif në këtë mes edhè gjithë marrëveshjet e vepërimet bëheshin midis meje, gjenerall De Weerit e Thompsonit, përfundimin ja u komunikova këtyre të dyve, tuke u rezervuar mbi një pikë. Kjo pikë ishte që duhej marrë nën hetim edhè vet' ajy Kryetari i Qeverisë Ismail Qemali. Për këtë pikë, përveç që isha informuar mirë nga Syrejà bej Vlora, nga Myfit bej Libohova si edhè nga Gjorgo Çakua, të cilët i pyeta imtazi hollësisht e më sbuluan shumë gjërra, që as njeriut s'ja tregova, po kisha edhè dokumenta edhè argumenta mjaft edhè më fort një telegraf të fundit që i hiqte Ismail Qemali Beqir Grebenesë në Brindizi që të mos vinte në Vlorë, pa i treguar shkakun, dhe të cilin telegraf ajy kujtonte se e kish marrë Beqiri, po të cilin e kisha zënë unë që posa fillova hetimet, prandaj i ardhi çudi Ismail Qemalit si u gënjye e ardhi Beqiri në Vlorë me gjithë që ky e lajmoj të mos vinte!

Gjenerall De Weeri e Thompsoni, si dëgjuan mirë arsyetimet e mija, më dhanë të drejtë dhe muar përsipër t'ja thojshin këtë Ismail Qemalit.

Ismail beu, kur e dëgjoj të nesërmen këtë prej kolonel Thompsonit, i cili ja tha haptazi, u hoth përpjetë e s'e pranoj me asnjë mënyrë. Si ësht' e mundur, i tha, të merni në hetim një Kryetarin e Qeverisë? Ç' punë kam unë, i tha, me Beqir Grebenenë e me oficerët turq? Ja ku i kini, gjykojini, dënojini, po me mua punë s'kini. Po, i vrejti Thompsoni, është Gjyqtari Hetues që e kërkon këtë, e lyp nevoja e nderi juaj, mbassi prej hetimeve kanë dalë disa pika të dyshimta e duhet t'i kjartësojë Shkëlqesia juaj.

Ismail Qemali kishte kundrështuar shumë për këtë, kishte folur ç'kish mundur kundra meje dhe më së fundi s'e kish pranuar me asnjë mënyrë të pyetej prej meje. Kështu Thompsoni u kthyer pa bërë gjë. Po edhe në mos bëri gjë atë natë, të nesërmen shkoj e ja vuri në vesh Kontrollit Internacional dhe s'di si u bë, që ditën e dytë mbrëmanet më vjen kolonel Thompsoni në zyrën t'ime e më thotë se Ismail Qermali pranon të më japë vetëm shpjegime, po jo të qëndronjë e t'a pyes unë një nëpunës inferior një Kryeministri.

Unë i thashë se të këtilla shpjegime nuk ndryshojnë prej raporteve, ose exposeve ordinere, të cilat s'n'a hynin në punë, kur se Ismail Qemali, në një exposè të tillë munt të shkruante ç'të deshte dhe t'a nxirte vehten më të bardhë se një pëllump, ose të mos e përmentte as fare ; po e vërteta është se, në qoftë se ligja m'a jep mua këtë të drejtë t'a pyes si një Gjyqtar Hetues, ajy duhet të më përgjigjet në sa që e pyes, pa makar lè të shtonjë sa të

dojë dhe lè t'i zbukuronjë si t'i ketë kënda, veç mua të më përgjigjet në ato që i thom, në qoftë se pranohem si mystendik[1].

Thompsoni, i cili ishte tepër i zgjuar, i kuptoj mirë këto fjalë edhè insistoj në thezën t'ime pikë për pikë tuke e kërkuar si një pont sine qua non prej Kontrollorëve Internacionalë. Ahere, si mora vesh vanë te Ismail Qemali dy prej Kontrollorëve Lampi edhe Petraieffi dhe e bindnë të më pranojë si Gjyqtar Hetues.

Të nesërmen Ismail Qemali i komunikoj me adjutantin e tij, nëntoger Bilal Nivicën (sot kryetar i Gjyqit Politik e major) gjenerall De Weerit një shkresë me të cilën më pranonte të nesërmen ora më 5 mbas dite në konakun e tij. Këtë shkresë m'a komunikoj mua gjenerall De Weeri të përcjellë me një shkresën e tij për dijeni.

Shkresën e Ismail Qemalit që i adresoj De Weerit për mua, të nënëshkruar prej atijn e kam edhè sot në letrat e mija dhe e ruanj si një dokument të çmueshëm që një dit ky Kryetari i Qeverisë Ismail Qemali u pyet prej meje si Gjyqtar Hetues për çështjen e këtij komplloti, edhè këtë për historin' e vërtetë e të paanëshme të Shqipërisë.

Ditën e caktuar u pregatita, mora çantën me aktet dhe shkuam bashkë me Kolonel Thomsonin në Konakun e Ismail Qemalit në Skelë. Thomsoni ardhi më fort për hatër t'im se s'desha të vinja për të parën herë vetëm te Ismail Qemali, se mendonja se do bërtitte e do shante si mbas huqit që kish e nuk kisha qef të bëheshim fjalë. Herët, ose netët e tjera vajta vetë.

Ora më 5 m. dite atë dit, Koloneli më shoqëroj gjer brenda në zyrën e Ismail beut e mbassi ndenji pak iku e n'a la vetëm. Ismail Qemali më priti me një ftohtësi të madhe e më tha se nuk bëra mirë që e solla punën gjer atjè, se ajy s'ka gajle prej kësish gjepurash e thash-e theme, fjalë sokaku, se "Qielli i pastërtë s'ka frikë nga gjëmimi".

Unë i kërkova ndjesë dhe shtova se këtë nuk e bënj për një ambicjon, ose mërì personale, po vetëm se jam i shtyrë nga detyra. Unë, Ismail bè, i thashë, jam patriot e kam interesë si për personin t'uaj, si për historinë t'onë të delni faqe bardhë, kështu që, atë dorë që ngriti flamurin t'onë pas kaqe shekujsh në këtë Vlorën plakë e deklaroj indipendencën t'onë të t'a puthim edhè një herë edhe embrin t'uaj ta lemë të pa vdekur në histori!

Si folmë edhè disa fjalë të tjera, më thotë Ismail beu se ajy do më diktonjë në mënyrë raporti edhè unë do shkruanj ç'të më thotë, sepse pas mendimit të tij vetëm informacjone munt të më jepte. Po unë kësaj i kundrështova, tuke thënë se se jemi marrë vesh që unë t'a pyes e z. e tij të më përgjigjet dhe proçesverbalin t'a nënëshkruajm që të dy.

Dha mori të më bindë s'më bindi dot, më në funt s'foli. Unë prapë i thashë që në qoftë se nuk dëshiron t'a pyes në atë mënyrë që pretendova jam gati të ikinj e t'a lë të qetë. Ahere më thotë të fillojmë dhe kështu nisa t'a pyes.

Në krye e pyesnja shumë lavër që të mos i jepnja një përshtypje të keqe, po tuke vazhduar e tuke hyrë në themel të çështjes e pa edhè vetë ajy që isha armatosur mirë me dokumenta e argomenta plot dhe çështjen e kisha honepsur mjaft mirë.

Sado që më shqiste si ngjala, unë prapë e shtërngonja të hapej në hollësina, dhe sado që s'desh të më çfaqej mirë, prapë se prapë i çkëputnja nga ca fjalë që kishin rëndësi mbi çashtjen që e pyesnja.

Më thotë dikur: Ç'kujton z. Floq, t'a prêt mendja se unë jam përzjerë në këtë çështje skandalisht? Unë një Kryetar Shteti sot? Kisha kurrë ndo një interesë që të sillnja prapë Turqit këtu që mezi shpëtuam nga thonjt' e tyre? Ti nuk e di historinë t'ime si kam shpëtuar nga një Sulltan Hamid e sa herë vura jetën t'ime në rrezik për këtë Shqipëri? Si thoni ja u mer menda që unë t'a tradhëtonj Shqipërinë?

Zoti Kryetar, i thom, i di të gjitha këto edhè po të doni munt t'ju jap të gjitha numurat e gazetës s'ime që nxirnja në Amerikë "Zerin e Popullit" ku do shihni e do besoni se sa ju kemi

[1] mystendik = gjyqtar hetues (nga turqishtja H. K.)

çmuar e lartësuar ne Shqiptarët e Amerikës e ç'propagandë të fortë kemi bërë për ju. Edhè kur ardhë grumbull 200 e ca Shqiptarë prej Amerike që të shihnin Shqipërinë e lirë dhe Qeverin' e parë Shqiptare, e mbani ment se si i mora të gjithë në Skelë, sa u shtërnguat e zbrittë përposh e ju salutuan e ju puthnë dorën

gjith' ata djelmt të flaktë, të cilët i patë fort mirë edhè sa besim kishin të gjithë mbi mua e si më adhuronin, se edhè unë, si e dini jam një faktor i kësaj Shqipërisë së lirë. Po sot, Ismail bej, më takoj të jem një nëpunës dhe në shërbim të Qeveris s'uaj. Duhet, pra, apo jo, të punoj besnikërisht e t'u sbarth faqen? Besonj se do thoni se "po". Pra atë detyrë po bënj tani edhè ju si patriot duhet të më tregoni të drejtën, mbassi interesi është vetëm për të mirën e Atdheut t'onë.

Ismail Qemali këto fjalë po i dëgjonte me vërejtje po nuk fliste gjë, kështu që unë pasova t'a pyes edh' ajy më përgjegjeshe.

Natën, ose herën e parë nuk e zgjatmë shumë, ashtu edhè të dytën, se nuk e lodhnja më shumë se nga 1 ose 1 1/2 orë për ç'do natë.

Po nata e tretë ishte natë tragjike. Ishte një natë që s'e harronj kurrë. Atë natë ime shoqe s'deshte të më linte të shkonja në Skelë t'a pyesnja Ismail benë. Kështu më kështillonin edhè kunatat e kunetrit e mij. S'di pse ju kish hyrë një frikë e këtillë. Po çudi që këtë frikë e kish edhè sekretari im Kostë Çekrezi, i cili, megjithë që e kish të ënjtur njërën nofull nga një dhëmpallë që ment e prishte mentsh, nuk desh të më lerë vetëm. Ardhi me mua në Skelë. Edhè mua zu po më shkonte një mejtim pak i dyshimtë, po si të bënja se ish një detyrë këjo dhe duhet të mos i shmangesha. Nga ana tjetër s'di se ç'kish dëgjuar edhè Thompsoni i gjorë, i cili zbriti në Skelë 1/2 ore para se të vete unë atje, bashkë me dy oficerë të tjerë Hollandas.

Diçka kishte marrë vesh edhè miku im toger Meleq Frashëri, i cili ardhi edh' ajy në Skelë vet' i katërtë. Ç' ishte gjithë ky dyshim nuk mora vesh, veç se më von dëgjova se disa miqt' e Ismail Qemalit kishin thënë se ajy kauri (unë) i kisha hyrë si kumupe në hundë Ismail beut edhè duhesha vrarë, edhè sikur kishin bërë fjalë me një katil prej kat. Trèvëllezër që një natë kur të shkonja nga Skela të m'a bënin pilafin, të më vrisnin d. m. thënë.

Ora më 6 allafranga, d. m. th. si u ngrys, mora edhe Çekrezin e vajta në skelë. Thompsoni posa më pà u ngjit edhè ajy lart në konakun e Ismail beut dhe u fut më një dhomë ku ishin edhè ca të tjerë. Meleq beu ardhi edhè ajy lart e hyri në dhomën tjetër me ca oficerë. Unë hyra në odën e veçantë të Ismail beut edhe Kostë Çekrezi ndenji përposh se i dhemte edhè dhëmbi.

Ismail beu më priti mirë edhè këtë natë e më tha që, në mos kam ngrënë bukë të hanim bashkë. Ju fala nderit, mbassi kisha ngrënë. Ahere Ismail beu më tha se ajy s'kish ngrënë dhe t'a ndjenj nj'a 20 minuta sa të hajë bukë përposh. Duallm bashkë dhe ajy zbriti përposh unë u futa në odën ku ish edhè Thompsoni me Hollandezët e tjerë e ndenja atjè gjer sa u kthye Ismail Qemali.

Si u kthye dhe hymë brenda në odën e tij, filluam prapë hetimet. Këtë radhë e pyeta mbi thelbin e çështjes si për sh. për personin e Izet Pashës, për Beqir Grebenenë e marrdhëniet me atë, për ca çështje të tjera të imta, për dërgatën që kish në Shqipëri Beqiri dhe mbi vepërimet e tij.

Sado që evitonte të më japë shpjegimet që i kërkonja, tuke më hedhur brek më brek, po kur e pa se po insistonja në embër të detyrës s'ime dhe i zbulova disa telegrafe relative me komplotin edhè disa përgjigje tërthoraze që kish dhënë Ismail beu në disa pyetje kryptografike të Beqir Grebenesë prej Stambollit, prej Trieshtit e gjetkë edhè më fort kur i zbulova përzjehjen e Esad Pashës dhe të disa Shqiptarëve të tjerë, që ajy ishte në korent me ata, Ismail Qemali u habit! E pa që unë posedonja shumë gjërra mbi çështjen dhe se nuk mundej të fshihej serëku në thes; dhe fundi i fundit, kur i tregova telegrafin e tij të pa regjistruar në regjistrin e zyrës telegrafike të Vlorës dhe të hequr Beqir Grebenesë në Brindizi që të mos vinte në Vlorës e oficerët e tij ishin zënë prej autoriteteve Shqiptare etj. etj. që e kisha zënë

unë në telegrafanë, ajy u hoth përpjetë e zuri kryet me dorë, si kur e kafshoj ndonjë gjarpër. Paska arirw puna gjer atjé? , më thotë – Si urdhron, i thom, kemi edhè më akoma, sepse hetimi është në gjëndje t'ju çfaqnjë shumë argumente, faqe të cilave z. juaj s'munt të mbani një pozitë negative, po lipset të deklaroni po-në ose jo-në. Dhe fillova t'i sërendit edhè të tjera gjërra të cilat, e vura re mirë se i bënin impresion të math.

Zoti Floqi, më thotë Ismail Qemali përgjigjen në sa më pyete s'munt të ta jap dot sonte, se po vete edhè mezi i natës e unë jam plak e duhet të flè; ju jeni të rinj dhe duroni të rini pa gjumë edhè për darkë edhè si të hamë mir' e bukur i japim funt bisedimit.

Nuk i kundërshtova. Ishte ora 11 e 1/2 e mezit natës dhe kështu bashkë me Thompsonine oficerët e tjerë Hollandezë u ngjitmë në Vlorë.

Në shtëpi t'eme ishin bërë shumë merak pse u vonova. S'ime shoqeje i ishin çpifur hethet nga frika, sado që një orë më parë kishte shkuar Meleq Frashri në shtëpi t'ime e ju kish thënë se jam në odën e Ismail beut, tuke e pyetur.

Ajo natë i kish bërë një ndërshtypje shumë të madhë Ismail beut. Si më ankohej të nesërmen, atë natë të tmerishme s'kishte mbyllur sy! Se, për njëment, atë natë e mori vesh mirë Ismail beu dhe e pa bukur se pozita e tij viheshe në një bilemë. Ishte apo s'ishte një tradhëti për Shqipërinë të përzierit e tij tërthorazi në këtë çështje?

Të nesërmen mbrëma si pas akordimit u ndodha prapë në konakun e Kryetarit të Qeverisë në Skelë. Po këtë radhë Ismail beu më lehtësoj nga mundimi që të zinja vetë arabà për në skelë. Kishte dërguar arabanë e tij me një oficer të rrojës së tij, i cili më mori nga shtëpia dhe vamë në skelë poshtë.

Ismail Qemali dolli vetë ne porta e divanit që më priti, gjë që s'e kish bërë as për ndo një të huaj kontrollor, ose organizator gjer ahere.

Posa hyra më priti me shumë oborësì e thiri të birin Qazim bejn e i tha të shtrohet sofra mbassi më kishte mysafir. Mora fjalën e i thashë të më ndjenjë se hëngra në shtëpi t'ime. Po ajy më qortoj pse bëra ashtu kur e dinja se po më priste, po me gjithë ato urdhro më thotë të hamë edhe një herë. Unë prapë e falenderova, tuke i thënë se është e pamundur, mbassi hëngra një herë. Po Aziz Pashaj nga Berati, i cili ish edhè ajy mysafir, e gjeti menjiherë dhe ja pret Ismail beut:

E di unë psè nuk vjen z. Floqi në sofrë. – Pse? i thotë Ismail Qemali. – Se është memûr, efendëm, i thotë, e memurët nuk bën të hanë drekra e darkra kur janë ngarkuar me punë resmè. Ha! Tani e kuptova tha Ismail beu, po ahere si të doni s'ju shtërngonj.

Këto folmë edhè unë ndenja në zyrën e vet të Ismail beut, kurse ajy me Aziz Pashanë shkuan të hanë bukë. I prita gjersa ardhë, por se vonoj më shumë se një or' e gjysmë Ismail beu. Kur ardhi në zyrë, ku isha unë, ardhi i shoqëruar me gjith' Aziz Pashanë, i cili s'e kish ndërment të n'a linte vetëm, po as që Ismail Qemali s'i thoshte që të ikte.

Si e pashë se Aziz Pashaj ndenj edhè gjysmë ore më tepër mbassi pimë edhè kafetë, ahere i thashë vetë unë : Aziz Pasha hasretleri, z. juaj, si e thatë edhè vetë më parë e dijni se kam ardhur me detyrë këtu, edhè detyra është që të flasim për disa çështje shtetnore me z. Kryetarin e Qeverisë. Prandaj në qoftëse kini më parë z. juaj punë me Ismail benë, ahere unë mundem të pres gjer të më vijë radha.

Aziz Pashaj kur dëgjoj kështu u ngrit e menjiherë dhe tuke thënë aman, efendëm, af edersënëz[1], etj. na la vetëm. Posa dolli Aziz Pashaj unë hapa çantën e nxora aktet

përkatëse që të fillonim. Po Ismail beu më thotë të mos ngutem se kemi kohë dhe lè të llafosemi për ca gjërra të tjera. Si të urdhroni, i thom. Edhè fillon:

Zoti Floqi, nuk të kam pyetur ku e kini shtëpinë tuaj?

Ri bashkë me baxhanakun t'im Jovan Themelinë.

Jo, jo po të pyes në kè ndonjë shtëpi tënden.

[1] af edersën = më falni (nga turqishtja përkthyer me google H. K.)

Kisha një në Korçë, po e shiti babaj im sa ishte gjall. Kishim edhè në Greqi trè dyqane, po edh' ato u shitnë për borxhe që kishim. Sot s'kam asgjë.

Prandaj të pyeta, që të të japnjë vënt në "Ujin e ftohtë" dhe të bësh një shtëpi e një vreshtë e një bahçe nj'a 10 vreten[1] vent.

Dhjetë vretena munt të bëjnë 500 napolona, z. Kryetar, unë s'kam 500 grosh për sipër sot, ku do t'i gjenj t'i paguanj këto pa kur do t'a bënj shtëpinë?

Atë merak mos e kij ti, se t'i jep shteti; unë t'a jap

Faleminderit, po as shteti as z. juaj s'më keni ndo një borç, pse do m'i jepni? Do ma falni?

Po do të ta falim, atje ku muar të tjerë mer edhè ti, një patriot jè ke punuar për këtë Shqipri.

Ashtu s'e mar kurrë faleminderit fort.

Ç'ka, ç'ka, kësaj çesi do t'ja bëjmë, po unë dua t'ju fal edhè një peshqesh nga ana ime. I thashë djalit t'em Qazim beut të të sjellë nesër në shtëpi500 lira turke nga ana ime.

Kur dëgjova këto fjalë m'u prish gjaku me një herë. Këtu po loste ryshfeti; po

loste nderi im! Gjë këjo që kurrë, mos kurrë nuk e prisnja nga Ismail Qemali! Zura e po dridhesha; më zunë nervat. Ngrihem përpjetë me një herë edhè mar kapellën.

Ç'është, ç'është? më thotë, si pa të keq.

Ç' të jetë, z. Kryetar, zotria juaj e shoh se kërkoni të më merni me të mirë

me gjërra të paligjshme. E shoh se kërkoni të më çoroditni karakterin që të pranoj ryshfet, po jeni gënjyer shumë, z. Kryetar; duket se s'më paski njohur akoma ; duket se kujtoni se jam ndonjë laspangjoz, këpucëgrisur. Më vjen shumë keq, z. Kryetar. Unë jam një nëpunës i ndershëm që edhè sikur Shqipërinë të më falni një të atillë gjë s'munt t'a pranonj. E kam ballin shumë të lartër ; s'e kam çnderuar gjer tani vehten e do t'a çnderoj tash e tutje? E shoh se s'paskam vent këtu, edhè më ndjeni se do ikinj. Këtë përbuzje s'munt t'a duronj dot.

Çvara kapellën dhe zura të ikinj, po Ismail beu me një nënqeshje dhelprake çohet me një herë e më përfshin për mezi. Ha, ha, ha, thotë e qesh.

Qysh, z. Floqi, kujtove se me të vërtet po të jap 500 lira, ose vendin në

"Ujin e ftohtë"? Nuk e more vesh pse t'i thashë këto? Tabè që të të shprovonja se ç'karakter kè. Po bravo, aferim, paske një karakter xhevahiri, tani të njoha. Aferim, bir, aferim! Kështu i dua memurët unë!

Edhè filloj të më bënjë komplimenta, se e pa që ra jashtë e s'kish si të theshte ndryshe. Ndofta e bëri këtë që të më shprovonte, po më tepër kujtonj se e bënte me të vërtet, që kështu t' hiqnja nga mezi gjith' ato pyetjet e fundit që i bëra dhe të cilat ajy s'desh t'i nënështkruanj.

Si më qëndroj e ndenja, prapë ju luta të fillonim se po vinte ora 9 i natës dhe ish dimbër. Po Ismail Qemali s'kish nijet atë natë të përgjigjeshe që t'ji jepnim funt hetimeve të vështira.

Me një herë kthehet e më thotë prapë : Aqif Pashaj nga Elbasani më shkruan se kërkon një mytesarif të ndershim e aktif për Elbasan. A vete zotrote të të emëronj që nesër me një measH 30 lira në muaj?

Iu falemnderit edhè për këtë i thom. Të mbarojmë një herë këtë detyrë pastaj mendohemi.

Mendohu, thotë Ismail beu, se s'është vent i keq. Të bëhet shumë mirë. Më të zotin se ty s'munt të gjenj për Elbasan.

Faleminderit, i thom, kemi kohë për këtë.

Që në mos daç, më thotë prapë unë të bënj që nesër ministrin e Bujqësisë e të Pyjeve, se Panteli Calja kërkon të hiqet prej Ministrije.

Edhè për këtë prapë ju falem nderit z. Kryetar, i thom, po mendohi një

herë se ç'munt të thonë gjuhrat e këqija, sikur të më shohin nesër Ministrin e Agrikullturës kështu përnjëherjesh prej një mystendiku që jam sot. E merni vesh se qysh munt

[1]vreten = njësi matse toke: 1 vreten = pak më e madhe se 1 dynym (H. K.)

t'a komentojnë këtë ndryshim për hesapin e mbi kurrizin t'im me fort. Po ju lutem z. Kryetar lè të pasojmë të shpëtoni edhè ju edhè unë nga kjo belà se ju siguronj se në mos daçi që t'ju pyes, nesër në mëngjes do shkonj prane gjenerall De Weerit e do t'i paraqit doreheqjen t'ime nga detyra që më ngarkoj për shkak se z. juaj s'doni t'ju pyes.

Këto fjalët e fundit e egërsuan shumë Ismail Qemalin , i cili më sillet me zembërim: Bënj çudi me këtë fatin t'em që ardhi sëra të pyetem unë Ismail Qemali prej një adi (commim) mystentiku, si kur se kush e di se ç'faj kam bërë. Unë jam plak sot, mor bir, dhe në pleqërì njeriu nuk munt të bënjë kësij gabimesh, t'ju mbushet menda jyve nacionalistëve. Izet Pashaj, e di edhè unë, se dëshëronte të bëhesh Mbret i Shqipërisë, të cilin e ka dashur edhè Esad Pashaj. Unë, përkundrazi e kam këshilluar disa herë Beqir bej Grebenenë që të heqin dorë nga këto marrëzira, se Europa nuk ka dashur kurrë një princ Turk për Shqipërinë. E ju po vijni me mëntt e Syreja bej Vlorës, dushmanit t'em? pa le të m'a provojë ajy këtë punë!

Këto më tha Ismail beu, në të cilat unë i përmënda edhè një herë telegrafet e tija e dokumentat e tjera që kisha mbi këtë çështje dhe ju luta që lè të më përgjigjej makar shkurtazi në sa që e pyeta dhe kështu t'a mbyllim një her' e mirë këtë çështje.

Kur po thesha këto fjalë Ismail Qemali u çua nga vendi me një ngutësi e paqetësi të madhe. Hapi një herë derën e thiri adjutantin e tij Bilal Nivicën të qëndronte ne dera dhe si hyri dhe e mbylli derën e zyrës ku bisedonim, zu e po unjte perdhet e penxhereve dhe po lëvizte nga vëndet karigat dhe tryezën shkrimore me një nervozitet të çuditshëm, pa vënë rè se ç'po flisnja unë. Këto manovra zunë të më venë në një dyshim dhe s'kuptonja dot ç'kërkonte të bënte me ato. Prisnja t'i jepte ndonjë urdhër Bilal Nivicës, ose tjetër kujt për kundra meje, ose ku di unë ç'farë. Zembra po më rihte, gjësendi s'kisha përsipër, as armë, asgjë. Ora ishte 11 ose 11 e 1/2 i mesnatë, dhe asnjeri s'kisha me vehte as Thompsonin, as Meleqin. Po prapë mendohesha si munt të bënte një punë të shëmtuar një Kryetari Qeverisë? E ç'do të theshin për atë? Ajo do më lartësonte shumë mua në zembrat e popullit, të Kontrollit Internacional e të Organizatorëve Ollandezë, se vërtet do sakrifikohesha mbi detyrë e sipër, po do mbetesha i pavdekur në historinë Shqiptare! Po jo ; s'ma merte mendja se munt të bënte një marrì të atillë Ismail Qemali.

Si mbaroj së unjuri kurtinat e së lëvizuri fronet mer një karige e më afrohet afër. Më zè të duart me duart e tija e më thotë me një zë të mallngjyeshmë sa më depërtoj gjithë palcën e kurrizit : Djali im, e shoh se me të vërtetë qënke i zoti në detyrë dhe s't'u trëmka syri. Më kishin thënë për ty shumë gjërra të mira, po s'të kisha njohur që për s'afrit që të të çmonja më mirë. Tani e shoh se sa i nevojshëm ishe ti për mua dhe më vjen shumë keq që s'të pata një bashkëpunues të vlefshim. Do kisha përfituar shumë gjërra. Po, ishallah, do vinjë sëra që të të kem dorën e djathtë e jo si ca maskarenj që kam patur gjer tani, që përveç që më diskretituan, s'më bënë tjetër gjë! Tani t'a presim shkurt. E shoh që zotrote s'ndahesh prej mejet gjer sa mos marrësh ifadenë[1] t'ime. Pra, me që po kalon koha, leri evraket[2] këtu edhè nesër më drekë t'i dërgonj unë të plotsuara, tuke shkruar edhè ifadenë t'ime e tuke vënë firmën t'ime. Nuk më besont'i lesh këtu sonte këto evrake? Zoti Kryetar, i thom, munt t'ju lë edhè shpirtin z. juaj, po këto akte s'janë të mijat, janë mall i tjetër kujt dhe e kuptoni fort mirë z. juaj rëndësirën e këtyre fjalëve.

Ndërkohë më vajti mëndja në çantën t'ime që ishte mbi tavolinën e tij dhe me një herë më ngriu gjaku se mos më mertë çantën me përdhuni e s'kisha si ja justifikonja gjenerall De Weerit, mbassi bëra fajin t'i kem pas gjith' ato dokumenta të asaj çështje e gjithë proçes verbalet e mbajtura të atyre ditve mbi sa pyeta si të pandehur ose dëshmues. Po fatmirisht s'ngjau gjë nga sa shkonja në për mëndje.

Ismail beu nuk kundrështoj e kështu mbetmë d'akord që nesërmet do vinja edhè një herë e do mbaronim.

---

[1] ifade = shprehje, deklaratë (nga turqishtja H. K.)

[2] evrak = dokument (nga turqishtja H. K.)

Po të nesërmet në kohë të drekës më dërgoj në zyrën t'ime gjithë përgjigjet që i kërkova, të cilat përbëheshin prej 3 faqesh të mbëdhà dhe të cilat i kishte nënëshkruar. Sadoqë këto ishin negative më të shumat dhe pa një lidhje armonike dhe sa do që nuk ju përgjigjeshin pikërisht pyetjeve të mija që i kisha adresuar, me gjith'atë e nënëshkrova edhè unë atë proçes verbal e e bashkangjita me proçes verbalin tjetër të mbajtur për këtë çështje.

Si i studjova edhè një herë tjetër thëniet e tija dhe dokumentat relative dhashë vendimin t'em, të cilin e justifikova sa munda dhe me të cilin e akuzonja si fajtor edhè Ismail Qemalin me negligjencë të rëndë për mjetet, që pa një qëllim të keq, i kishte kontribue Beqir Grebenesë dhe tërthorazi Izet Pashës.

Këtë vendim kur ja paraqita gjenerall De Weerit - u habit! Qysh, më thotë, ke kaqe kurajo sa të akuzosh edhè Kryetarin e Qeverisë t'uaj? – Nuk e desha, i përgjigjem, po këtu bënj vetëm një detyrë. Aty u ndoth edhè Thompsoni, i cili m'u hoth për qafe e më felicitoj[1] për paansinë e burrninë në zbatim të detyrës.

Që atë natë De Weeri kish konferencë me Kontrollorët Internacjonalë dhe ju tregoj të gjitha ngjarjet.

Çështja bëri një përshtypje të madhe ndër ata, por e vunë nënë këmbë e më s'e bënë fjalë. Po, si mora vesh, vajtnë tre prej atyre (Kontrollorëve) te Ismail Qemali, të cilët, e me shkak të këtyre ngjareve e të akuzimit të Ismail Qemalit e bindnë këtë të japë dorheqjen prej kabinetit e të largoheshe për ca kohë nga toka Shqiptare.

Pas 2 ditsh Ismail Qemali dha dorëheqjen dhe shkoj jashtë Shqipërisë – dhe kjo ish her' e fundit që ndaheshe nga Shqipëria, se më nuk ardhi në Shqipëri, mbassi vdiq në Spanjë -! Ministrat e tjerë natyrisht edhè ata dhanë dorëheqjen, po me lutjen që ju bëri Kontrolli internacional ata qëndruan jo si ministra, po si drejtorë të përgjithëshëm të çdo dikasteri që patnë seicili, dhe nga ana tjetër Kontrolli

Internacional mori si delegat të Shqipërisë z. Medi Frashrin, simbas traktatit të Londrës, që e njohu Shqipërinë indipendente.

Po nga ana tjetër gjyqi i Beqir Grebenesë me shokët po vazhdonte (hetimet domethene se gjyqi s'kish filluar akoma).

Nga rrjedhja e hetimeve zbulova se Beqir Grebenea kishte pasur 5. 000 napolona me vehte kur ish në Triesht e mbas hesapet e tij që i gjeta nëpër shënime të ndryshme rezulltonte se kishin tepëruar një shumë prej1. 500 napolonash. Këto të holla Beqiri duhet t'i kishte me vehte ose t' kishte lënë gjëkundi amanet po brenda në Vlorë e jo gjetkë.

Menjiherë e thres Beqirin përpara meje e i bëj fjalë për këto të holla ku i ka. Beqiri u mundua t'a fshehë në krye po si e pa që insistonja se s'bëhej ndryshe, më kërkoj afat 24 orë të mendoheshe. I dhashë vetëm 4 orë me kushtin se do më tregonte të drejtën. Pas dreket ora më 3 kishin mbaruar 4 orët dhe e thira prapë Beqirin. Ky si ardhi më kërkonj leje t'i largonj nga zyra sekretarët e mij Taip Libohovën dhe Kostë Çekrezin se dëshëronte të ishim të dy vetëm, pa njeri tjetër, se kish gjërra me rëndësi të më theshte.

Ahere edhè unë i largova të dy sekretarët e mij, i dhashë urdhër reshterit t'em t'i lidhë duart Beqirit me hallkat dhe kështu m'a prunë në zyrë.

Beqiri posa hyri brenda dhe u largua reshteri, pikësëpari m'u ankua pse i lidha duart. I thashë të mos e marrë për keq këtë, se ishim në Cour Martial dhe kisha urdhër nga gjeneralli. Bashkëfjalimi jonë bëhej greqisht, mbassi Beqiri greqishten e kishte gjuhën e tij maternale.

"Hè, I thom Beqir Grebenesë:më thuaj tani ku i ke të 1. 500 napolonat? Mos n'a mundoni për riza të Zotit.

Beqiri ahere me një zë të ulët sa mezi e dëgjonja më thotë se jam gati t'ja u fal juve të 1. 500 napolonat të cilat as njeri s'e di se ku janë, po me konditë që edhè ju të më nxirni të pafajshëm si mua, si oficerët e mij nga kjo çështje.

[1] felicitoj = përgëzoj (H. K.)

Unë tani që t'i them drejt për së drejti se kjo punë s'bëhet, s'mundnja t'ia theshja se ahere do mos i vinim dot në dorë të hollat, u mendova, pra, t'i thom "po" veç të arrinte të m'i dorëzonte të 1. 500 napolonat. Por kur desh m'andej të më bentonte në fjalën e nderit e mbi "besën shqiptare" se do t'i qëndroj në fjalë, ahere i thom shkurt Beqirit se këto janë gjërra që s'bëhen. Një nëpunës i ndershëm s'e shet karakterin e tij me pare, prandaj, hiq dorë nga këto, i thom, z. Beqir, e n'a trego, ose n'a dorëzo të hollat, ndryshe do marrsh më qafë shumë persona se unë mbas argumentave që kam do t'i gjej gjer më së fundi, po mos hsrroni se do përdor gjithë fuqinë e shqenxa mizorë, që atë s'm'a do karakteri jem, mirë po ti do jesh responsabël për ç'do të ngjasë, ja ku po ta thom. Tani të lë 10 minuta të mendohesh e të më japësh përgjigjen, po ose jo.

Kështu i thashë dhe e veçova më një odë të veçantë ku e lashë të mendohet.

Si shkuan të 10 minutat e thira prapë. Hë, i thom, ç'thua tanì? Beqiri si u mendua edhè ndo një minutë akoma, më thotë se s'mundet të m'i dorëzonjë se s'janë të hollat e tija. Fort mirë, i thashë, po do pendohesh.

E dërgova prapë në burg edhè thira një shërbëtorin e tij, një plak nja 60-65 vjeç, te i cili, e dinja se kishte besim të patundur Beqiri e munt t'i besoheshe ç'do gjë që kish të fshehtë.

Kur ardhi përpara ky tuke u trëmbur, e mora me të mirë e i thom se Beqir beu më tha të më dorëzonte 1. 500 napolonat që i pat dhënë t'ja ruanjë. Këtë ja thashë se e mernja me ment se munt t'ja kish dhënë këtij për t'i lënë gjëkundi amanet.

Ky shërbëtori, kur dëgjoj për të 1. 500 napolonat që i kishin tepruar Beqir Grebenesë prej të 5. 000 napolonat që mori në Stamboll prej Izet Pashës, edhè me

qenë se ish informuar plotësisht për këtë, me njiherë kuptoj se unë jam brenda në çështje dhe e pashë se i hiku edhe gjaku nga fytyra.

Më thotë në krye se s'dinte gjë. Si, s'di gjë, i thom, ti e di fort mirë, prandaj po të thom se në qoftë se s'n'a i jep ose s'n'a rrëfen kujt ja ke dhënë amanet do të të

mvar me kryen tatpjetë dhe do të të mundonj keq megjithë që je plak. Folë! Beqir beu po të urdhëron të n'a i dorëzosh. Folë shpejt i ke ti, apo i lè gjetkë.

Plakut i shpëtoj ahere një fjalë pa dashur : Le të më thotë mua, tha, Beqir bej efendia, ju s'ju njoh. Mirë fort, i thom. Ahere po të të thotë Beqir beu të n'a i bësh teslim[1], ç'thua, n'a i bën?

Tani plaku kish rënë në hall; kishte kujtuar se, pa fjalë, do më kish thënë Beqiri një gjë të këtillë mua se ndryshe nga do t'a dinja se ishin 5. 000, pa se kishin mbetur1. 500? Kjo e gënjeu të shkretin plak e i shkanë fjalët që "po t'i thotë Beqiri aher munt të m'i dorëzonte të hollat, ndryshe jo". Pra u gjent i shtërnguar të më përgjigjet që "po t'i thotë Beqiri do të n'a i dorëzonte". Domethënë se të hollat ishin dhe ishin në Vlorë dhe shërbëtori munt t'i kish në dispozicjon të ti, ose munt të dinte ku ishin dhënë". Pra këtu duhet të shtërngonja plakun dhe fillova nga dalë.

Plak, më thuaj i ke përsipër të hollat? Se Beqir beu më tha se t'i dorëzoj ty dhe nuk e di a i kè vetë apo ja dhè njeriut tjetër t'i ruanj. Pra, në i kè vetë tani po ta thres Beqir Begun të të japë urdhër gojazi të n'a i dorëzosh, ndryshe në ja kè dhënë tjetër kujt prapë më thuaj që t'ja bëj të ditur Beqir beut që të të japë urdhër të vesh t'i marrësh vetë e të na i japësh. Ti sidokudo do jeç i lirë se me ty s'kemi gjë. Ishallah mbassi të n'a dorëzoni edhè këto të holla që i kërkon Shteti ahere lirohet edhe Beqir beu e shkoni në të mirën t'uaj se gjer tani istindaku s'ka gjetur gjë myzis edhe as mbesojmë të gjejmë.

Këto fjalë e gudulisnë mjaft plak-shkretën dhe i përsëlluan dëshirën e zjartë të librimit. Po më fort gëzoheshe se do t'i shpëtonte i zoti Beqiri për të cilin ushqente më të madhin adhurim që bëhej.

[1] teslim = Në dorë të një tjetri, në zotërim për ta ruajtur sipas marrëveshjes (H. K.)

U menda pra hall andej, hall këtej edhe mbassi e pashë se i ardhë për hesap këto fjalë dhe ish gati diçka të na rëfente, e mora prapë me të mirë, i thashë të ulet mbi karrigë se u loth etj. etj. sende relative me lirimin e tyre, gjer sa e binda të thotë se të hollat ja kishte dorëzuar ky një besnikut të këtyre që quhej Alia, tregtar prej Elbasanit, i cili kishte dhënë gocën e tij ne një farë Riza nga Grebeneja, që e kishte akrabà[1] Beqir beu!

Tani kishim dalë në dritë. Ishte e lehtë, pra, të vinim e të bastisnim shtëpin' e këtij Aliut dhe të zinim edhe këtë edhe të dhëndrin Rizanë e të gjenim të hollat. Po deshim të siguroheshim edhe një herë nga Beqiri a n'a thotë të drejtën plaku shërbëtori i tij, apo mos na rente. Prandaj, si e dërgova në burg plakun e thira prapë Beqirin para meje e i thashë se po n'a mundon kot se ne e dijmë ku i ka të hollat, sepse plaku shërbëtori i tij n'a i kallzoj të gjitha, prandaj duhej të n'a rëfente edhe vetë ajy. Po si e pashë se prapë s'desh të rëfente, i them se paratë janë te Aliaj nga Elbasani edhe në qoftë se s'n'a jep letër-urdhëruese për atë e për të dhëndrin Rizanë që të n'a i japin me të mirë do shtërngohemi t'i marrin përdhunisht.

Po edhe tani Beqiri s'desh aspak të n'a tregonjë amanetxhinë, prandaj atë e dërgova prapë në burg e mora Meleq Frashrin me 12 gjendarmë dhe me dy nënoficera, si dhe sekretarin t'em K. Çekrezin i cili sa do i frikshim e qotë, po vdiste për ca aventura të këtilla, po kurdoherë tuke pasur mua përpara - e kështu ora më dy të natës, alla turka vemë en grup në shtëpin' e Aliajt Elbasanasit, ku ishte edhe familja e tij bashkë me të dhëndrin Rizanë.

Si e qarkova shtëpinë, trokitmë në derë po s'deshin të na hapin. Ju lutmë me të mirë të zot shtëpisë Aliut s'deshte. E tremba se jemi "idareji urfijia" me azallah se e hapte derën. Ahere me të shpejtë dy sopata të mira, çamë derën në embër të ligjit e hymë brenda. Grat' e fëmija e Aliut vunë "behriajin[2]" dhe ngritnë lagjen më këmbë, po kush kuxonte të lëviste a të tundeshe? Njeri s'piptinte, as që hapeshe ndo një penxhere gjëkundi! Meleqi i shkretë me thotë të ruhem se mos më mbillnin mbi trup ndo një plump që së siprit. Gjendarmët ishin gati të shtijnin me një më të voglin urdhër që munt t'u jepnja.

Si hymë në avullì dhe arthmë para derës mezit, që ish edhe kjo mbyllur, ju luta edhe një herë Aliut t'a hapte derën me të mirë se ndryshe do t'a çanim. Ruajna Zot se dëgjonin, veç se thrisnin e bërdisnin si kur vajtonin njerì! Ahere një të thyer edhe derës së mezit e u gjetmë brenda dhe hipmë lart unë, Meleq Frashri dhe sekretari im, sidhe të dy nënoficerët.

Një tmer i kapi burra e grà ; zunë dridheshin dhe kalamajt' e gratë qanin. I them Aliajt, pse n'a solli gjer më atë shkallë, tuke qenë se munt të delte vetë ajy e t'a pyesnim, ose të vinte gjer në zyrën t'ime të n'a dorëzonte paratë që i kish lënë amanet Beqir Grebeneja?

Aliu u habit kur dëgjoj këto fjalë. Ç'parà? Thotë. Unë s'njoh as Beqir, as njeri, s'kam punë me asij njerësish. N'a dorëzo shpejt, i thom, paratë ndryshe do të bëjmë anketë[3] në shtëpi. Bëni sa të doni, thotë.

Ahere urdhronj Meleqin të mos lerë verushkë[4] pa parë dhe gratë i urdhrova të mos lozin nga ajo odë që ju caktova të rijnë, tuke i rrojtur me një kapter, gjer sa të vinte një grua nga lagja që dërgova të thres.

Po gratë (ishin 4 grà dhe dy goca), kur dëgjuan kështu zunë e po shiheshin sy ndër sy me njëra jatrën dhe njëra prej atyre dukej mjaft e paqetë e e trëmbur. Në një kohë që toger Meleqi me dy të tjerë po hapnin disa sëndyqe, ajo gruaja, që po thom, u fsheh prapa të tjerave dhe zu të shkopsitë gjoksin me ngutësi. U duk se diçka kishte për sipër. Me një herë e urdhërova të veçohet prej grave të tjera e të vinjë përpara mejet. Ajo u tremp fort e po dridheshe. Ç'ke i thom? mos u tremp, në qoftë se kè gjë përsipër rëfeje se nè do t'ju shëkojmë të gjithave ç' kini përsipër.

---

[1] akrabà = fare fis (H. K.)
[2] behriaj = kushtrim (K. F.)
[3] anketë = kontroll shtëpie, bastisje (H. K.)
[4] vërë = vrimë (H. K.)

Në atë kohë ardhi gjendarmi që po prisnja bashkë me një grua të krishterë Vlonjate, të cilën me të shpejtë e urdhrova t'a shohë atë zonjë ç'kishte përsipër. Zonja posa pa se do t'a shëkonte ajo gruaja e krishterë i thret me inat : mos m'u afro moj kaure se i nxjer vetë ç'kam përsipër.

Me një herë na nxori një qese prej meshine, të cilën e hapa dhe gjeta brenda 600 plot napolona! Të Beqir beut janë këto, i thom, zonjë? – Si urdhron, thotë. - Të tjera parà të Beqirit nuk kini? – Jo t'u ngjat' jeta. Po Beqiri thotë, se ju ka dhënë 1. 500 napolona. – Jo t'u ngjat'jeta, e ka gabim, s'kemi të tjera. – Do n'a ndjeni se do t'ju shohim të gjithave ç'kini përsipër. – Aman, zotni, mos n'a mundoni kështu, s'kemi të tjera, Vallahi, Bilahi, Tallahi. Më vjen keq, i thom, po s'kam si bënj, do t'ju shoh.

Edhè vura gruan e krishterë t'i examinojë, e cila me gjithë kërkimin e imtë që bëri mbi ato të gjitha s'gjeti gjë. Gjithashtu u munduam kot edhè në shtëpi, tuke mos lënë gjë pa parë më shumë se dy orë. Mungonin 900 napolona. Duhej të gjindeshin pa fjalë.

I thom Aliâjt të kallzonjë ku i ka të tjerat se do t'i mundonim tepër. S'tregonte gjë. I thom të dhëndrit Riza, ajy ca më keq akoma. Ahere i mora që të dy në zyrën t'ime, ku përposh ishin dhe burgjet. Ju thashë prapë të rëfejnë po s'deshin. Më së fundi i bashkova që të trè me Beqir Grebenenë, i cili, si e pa se i gjetmë të hollat, i porositi që të dy që të n'a i japin. Po prapë ata i mohuan, se duket se edhè Beqirit

deshin t'ja hanin, tuke kujtuar se ajy do mos delte më prej burgut kështu t'ju mbeteshin atyre paret.

Si e pashë që kot, i thom drejtorit të burgut t'i heqin një drù të mirë Rizajt në syt' e plakut, të vjehrit, që ta shohë edhè vetë ajy.

Rizaj, posa hëngri të dy kamzhiqet e para i dhëmbi lëkura dhe me një herë tregoj se paret i ka i vjehri plaku. Po plaku ishte, ç'ishte ; si kur t'a vrisnje s'nxirte fjalë nga goja!

Dhash' e mora s'e bindnja dot Më vinte keq t'a rihnja se ishte plak. Ahere dhashë urdhër si kur se do t'a mvarnja edhè me një herë prunë litar e karekllë dhe e kapmë litarin pas një reze majë tavanit. Aliu dinak i shihte këto po prapë s'trembej, se thellësisht e merte vesh se s'mvaret njeriu pa një ilam[1]. Po që ta bënja t'a ndjente tmerin e lidha me litar për sqetullash dhe filluam t'a ngrehnim t'a mbajmë në erë, gjë që e sëkëlldisi shumë, po prapë e duronte! Më kot i luteshe i dhëndri të rëfente paret; Aliu s'dëgjonte. Parà këto, 900 napolona s'ishin shakà! Po si e pa se mbet i mvarur për sqetullash në erë e si ja bëri sqetullat plagë litari dhe më fort kur hëngri edhè nj'a dy tre kërbaçe vitheve, u shtërngua të më thotë "aman lëshomë se po të rëfenj"!

E lëshonj e më thotë t'a lë të lirë të vejë e t'i bjerë që atjè ku i kish fshehur. Po i thashë se ësht' e pamundur, se do t'i vinja edhè unë pas kudo që të vinte. Ahere e pa se po mundohej kot e më tha të vemë bashkë gjer ne dyqane të tij, po pa qenë njeri tjetër me ne. Ç'ka, i thom, ec përpara.

Kështu duallm bashkë dhe tuke ecur ajy përpara unë prapa dhe 4 gjendarë pas mejet vamë në dyqan të tij, që kish gjithfarësh kinkalerije. Aty Aliu hapi dyqanin, hyri vetë brenda, tuke e pritur unë te porta, mori prapa një rafti gastaresh dy qeska të vogla të lidhura e të myhyrledisura me vullaqer[2] dhe ardhi e m'i dorzoj, tuke u dredhur e me një dëshpërim të math. Urdhro, më thotë, këto janë të hollat. –Janë, i thom, këtu 900 napolona? – Nuk e di, thotë, po besonj të jenë.

E mora prapë Alinë, vamë në zyrën t'eme, ku lashë Alinë bashkë me Rizanë dhe shkova e e sgjova nga gjumi gjenerall De Weerin si dhe Thompsonin, të cilëvet ju numërova të hollat. Qumeri (nuk lexohet mirë H. K.) kish 600 napolona, po të dy qeskat kishin vetëm 896 napolona! De Weeri dhe Thompsoni u çuditnë kur ja u paraqita ato të holla, të cilat sado që i numuruam disa herë prapë delshin 1. 500 pa 4 napolona! Ahere thirmë edhè një herë Beqirin,

[1] ilam = vendim gjyqsor (H. K.)

[2] myhyrledisura me vullaqer = të vulosura me dyll (H. K.)

i cili vërtetoj se aqe ishin vërtet, se 4 napolona i kish prishur ajy vetë. Kështu Alinë dhe Rizanë i lashë të lirë.

Ishte ora dy pas mezit të natës. Isha lodhur e këputur mjaft. Shkova në shtëpi, ku ime shoqe ment loste mentsh se u vonove tepër dhe kështu rash' e fjeta i qetë.

Të nesërmen plotësova gjithë aktet e ja paraqita gjenerallit, i cili me një herë caktoj ditën e gjyqit. Pas 2 dit fillonte ky gjyq i famëshim. Gjykata ushtariake përbëhej prej gjenerall De Weerit, si kryetar, prej kapitanëve Kasëm Sejdinit e Xhavid Leskovikut dhe prej gjyqtarëve civilë Mashar bej Nepravishta e Feizi Rulit. Prokuror ishte Qerim Çelua.

Gjyqi mbajti 4 ditt. Vendimi që u dha dënonte Beqir Grebenenë me vdekje,

8 oficerë me nga 101 vjet burgim, 12 të tjerë me nga 15 vjet burgim të rëndë, 3 të tjerë me nga 5-10 vjet, 2 të tjerë me nga 3 vjet dhe dy të fundit u lanë të lirë. Këta të fundit ishin Shqiptarë Kossovas.

Kështu mori funt ajy gjyq i famëshëm.

Beqiri do mvarej ato ditt. Po fati i tij të mrijë në Durrës, Mbreti Wilhem Wied, të cilit ju dërgua vendimi të dekretohej. Mbreti, si i rì dhe posa që kish ardhur kërkoj që të dërgohen në Durrës gjithë këta kompllotistë; ashtu edhè u dërguan. Pas një jave i fali të gjithë e i la të lirë Mbreti!

Kur pas një jave që isha thirur në Durrës e i poqa të gjithë këta në restaurantin "Europa" Beqiri posa më pà m'u hoth për qafe e më tha, që nga mua do kish shkuar tani në atë dynjà, po…. rroftë Mbreti! Me gjithë atë më shtërngoj dorën tuke më përgëzuar për detyrën që e kisha kryer plotësisht. Ashtu më thanë edhè gjith' oficerët e tjerë turq, tuke më përshëndoshur njëri pas tjetrin.

Këto sa për historinë. Gjyqi i këtyre kompllotistëve nxori shumë të palara në shesh, të clave bëjmë mirë t'ju hedhim gunën, se n'a shëmtojnë historinë.

## XVIII

Më 7 Marsit 1914 zbriti Mbreti Wilhelm Wied në Shqipëri bashkë me Mbretëreshën Sofia e me enturazhin tij dhe u prit me enthusiasmë të pa treguar prej popullit në Durrës.

Me një herë u qojt Durrësi si kryeqyteti i Shqipërisë kështu që Vlora Flamurtare, Vlora Plakë u là më nj'anë. Qeverija e parë mbretnore u formua nënë plakun Turhan Pashanë nga Përmeti dhe si ministër i Drejtësisë u emërua Mufid bè Libohova.

Ky dërgoj e më thiri me një herë në Durrës, tuke më emruar telegrafisht si sekretarin e përgjithëshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Kështu jemi nisur një natë të keqe me vaporin më të voglin e më të qelburin të "Puglias" që quhej "Bari", tuke pasur për shoqëri edhè të ndyerin kolonel Thompsonin me oficerin tjetër Hollandes Maidingottin. Gjith' atë natë të keqe kemi luftuar me dallgët e mbëdha të Adriatikut dhe uji n'a hynte gjithë brenda, sa s'mbet gjë pa u qullur si edhè robat e këpucët t'ona. Të nesërmen në mëngjes që me natë kur fishkëllente sirena e vaporit më zgjon tuke qeshur kol. Thompsoni dhe unë, tuke kujtuar se arimë në Durrës, shoh për çudi se kishim ardhur në Pasha-Limanin e Vlorës! Ndejmë atjè gjithë ditën sa pushoj fortuna dhe të nesërmen me një mijë vështirësi mezi shkelmë në Durrës.

Myfid beu, sa do që më deshte shumë e më çmonte po në përpillim të buxhetit 1914-1915 që trajtuam të dy me Mashar bè Nepravishtën, si mystesharin[1] e asaj ministrije, për të parën herë ramë në kundrështim, sepse ata (gjithë ministrat gati) ishin në një mëndje të mershin nga një rrogë 150 napolonash në muaj, si kurse ministrat të merhumes Turqi që kishin rroga të exagjeruara, kurse né me Mashar bejnë këtë rrogë sa për ministrin t'onë – e ulshim në 60 vetëm napolona në muaj dhe t'onat rroga prej 40 që e kish Mashar beu e ulmë në 30, edhè prej 30 nap. që e kisha unë e ulmë në 450 fr. Ar. d. m. th. 22 1/2 napolona.

[1] müsteşar = nënsekretar apo zëvëndës ministër (H. K.)

Këjo s'i ardhi aspak për hesap Mufid beut, i cili m'u zembrua dhe mbassi s'm'a kish dhënë akoma dekretin mbretnor të emërimit t'em në pozitën e rè, më dërgoj me marifet prapë në Vlorë për të plotësuar disa çështje të mvarura të atij gjyqi. Kështu që vajta në Vlorë, tuke marrë prapë rrogën e parë të Kryetarit të Gjyqit që ishte 17 1/2 napolonash në muaj.

Po kur ardha në Vlorë, i shkreti Muç Qulli bëheshe gati të nxjerrë gazetën e tij popullore "Populli" e më këshilloj të heq dorë nga memuristi se s'bëhet punë me bejlerët e të hap një zyrë avokatore, të cilën t'a kem vetë për hesap t'em, tuke nxjerë ndërkohë edhè gazetën "Populli" bashkë me Muç Qullin, ku do mernja një të tretën nga fitimet neto t'asaj gazete. Edhè kish të drejtë Muç Qulli të më këshillonte në atë mënyrë, që makar t'a kisha dëgjuar e të kisha shpëtuar nga potera e mbasandamë që më takuan për shkak se isha nëpunës!

Mbassi m'u lut t'i bënja nj'a dy artikuj, edhè unë ja trajtova e ja dhashë. Njëri ish një artikull letrar, po tjetri, nën titullin "Rroga, apo Rruga", ish një artikull politik, ku bashkë me të tjerat atakonja rreptësish lakmin' e ministrave të rinj Shqiptarë, të cilët – shumica – msuar që në kohën e Turqisë, deshin t'a çvatin Shqipërin' e mjerë të posa-përkëmbur, tuke çkëputur rroga kollosale për xhepat e tyre, në vënt që të shërojnë plagët e të metat e tjera të Shtetit si ministra responsablë që ishin, me fjalë të tjera thosha se ministrat t'onë nuk mendohen për rrugë të nevojshme që s'kemi, po për rroga të majme!

Këjo bëri një bujë të madhe, sa e ndjeu gjithë populli i mençur dhe mora me duzina telegrafe përgëzimi, por se n'a zembroj tepër edhè më fort ministrat musullmanë, si Turhan Pashën, Essad Pashën, Mufid Libohovën, Aziz Pasha-Vrionin e jo tjetër: Po, si msova më vonë, Essad Pashaj më kish dhënë të drejtë me gjithë që s'më shëkonte dot me sy, se tjetër herë në gazetën "Përlindja Shqiptare" të Vlorës, tuke i u përgjigjur Faik Konitzsës në sa shkruante në "Trombetën e Krujës" në Durrës në favor të Essad Pashës dhe kundra Ismail Qemalit, e kisha kritikuar tepër ashpër.

Mufid beu më heq një telegraf urgjent kështu: "Në është se artikulli politik "rroga e rruga" botuar në gazetën "Populli" që nuk e njeh Qeverija nuk është shkruar nga juve duhet ta përgënjeshtroni kategorikisht" Mufid.

Në të cilin telegraf ju përgjegja në këtë mënyrë "Artikullin "rroga apo rruga" e shkrova e e nënëshkrova unë vetë. stop. Mbassi ajy dekaster e desaprovon lutem pranoni dorëheqjen t'ime prej shërbimit"

Kryetari i Gjyqit

"Floqi"

Është e ditur se pas kësaj përgjigje arbitrare prisnja jo vetëm pushimin t'im nga puna po edhè ndëshkimin akoma. Po, si kur se n'a ngjau në kohën që më pushoj Ismail Qemali dhe në vent të nxiresha nga puna, përkundrazi shkrepi çështja e kompllotit me Beqir Grebenenë edhè unë sa të bjerr rrogën që kisha mora dy rroga bashkë atë muaj, d. m. th. atë të Kryetarit të Gjyqit 16 lira muore dhe atë të Gjyqtarit hetues të Gjyqit ushtarak nga 1 napolon ditën, ashtu edhè këtë radhë, në vent të pushohem nga puna u emërova Kryetar i Gjyqit të Apelit në Durrës! Si u bë këjo, akoma është një myster për mua!

Po, sa arriva të gëzohem për emërimin e rì, me një herë mar një telegraf të nisem për …. Berat, ku u emërova Prokuror i Apelit (?) i atij Gjyqi! Edhè sa të mendohem mirë, a duhej t'a pranonja, apo jo, pasi këjo bëhej si një dënim për mua, tjetër telegraf më vjen nga ministri Mufid beu në këtë mënyrë :

"Prokurorin Apelit Berat Kr. Floqin

Vlorë

"Të marmen këtë telegraf të niseni shpejt për Korçë për të marrë pjesë në Gjyqin Politik që u ngreh në atë qytet për trazirat e fundit. stop. Sa të vazhdojë kjo detyrë do

paguhi 1 napolon ditën. stop. Si shpenzime udhtimi e dijeta u urdhrua Financa e Vlorës tu numëroj 25 napolona. stop. Lajmëroni nisjen.

"Mufid"

Këtij telegrafi ju përgjigja kështu :

"Ministrit Drejtësisë", Durrës.

"Mora nga Financa e Vlorës 25 napolona. stop. Këtë ças nisem për Korçë si mbas urdhrit të asaj Ministrije" Prokurori i Apelit Beratit

Kr. Floqi

Do me thënë merreshe vesh se e kisha pranuar Prokurorinë e Apelit të Beratit, si dhe detyrën e re extraordinare.

Kështu u nisa për Berat ku natën posa arrimë në qytetin pitoreske të Komnenëve, i cili më bëri një përshtypje fantasmagorike me ato kodra grafike edhè me dritrat xhixhillore të natës, si kur se isha në Bujuk-Derè, ose në Bojaxhi-qaj" të Stambollit. Tale-quale një Stamboll i vogël domethënë, kaqe që më pëlqeu panorama e atij qyteti.

Si ndenja nj'a dy ditt në Berat, u nismë me mushka për në Korçë nga ana e Tomorit. Kur arthmë në rëzë të këtij mali historik ose prohistoriko-mythologjik, kemi ndenjur ndo një orë, tuke vërejtur e tuke u çuditur me pamjen madhështore e tërheqëse të atij gjigandi a titani! Aty u inspirova për kushtimin në vjershë që i bëra më von me titullin "Tomorit" të botuar edhè në "Skëndijat" e mija.

Si u nismë nga Tomori n'a ka zënë një shi e tmershim që u krydhmë krejt, si të kishim rënë në det. Mezi që kemi arirë hanin dhe mezi që u termë pak. Gjithashtu tjetër shi me stomma hoqmë të nesërmen, shi Maji që, kur arimë në Lavda mezi muntmë të zbresim nga kafshët, se ishim ngjitur pas samarëve!

Të nesërmen (d. m. thënë ditën e tretë që u nismë nga Berati) arimë në Korçë, të cilën kisha 9 vjett t'a shoh.

Posa ardha mora detyrën përsipër, tuke pjestuar në Gjyqin e posaçëm Politik të përbërë Panteli Vangjelit, që ish prefekt i Korçës, prej Komandantit të piaca-formës, majorit Hollandes Schneller, prej Abdyl Ypit dhe prej mejet. Veçanërisht unë u ngarkova edhè me kqyrjen e dosareve të ndryshme të të burgosurve të pandehun për revolucjonin, që 15 ditt më parë kishte ngjarë në Korçë, tuke u futur andartët grekë, të cilët, bashkë me qindra Grekomanë të tjerë Korçarë kishin bërë lustra civile në për rrugat e Korçës me qëllim që të dbonin autoritetet lokale Shqiptare dhe të sillnin Vorioepirotët!

Nga shqyrtimet që bëra nuk delnin as 5 të pafajshëm prej 200 e ca Korçarëve grekomanë që ishin burgosur si të pandehur për atë revolucjon. Ahere si lipse të bënja? T'i dënonim të gjithë këta për vdekje ose tradhëti të naltë? Kjo do ish një mjerim, një vepër katastrofale për Korçën se do mbyllnim 220 e ca shtëpi e do hithnim në vaj e logorì kaqe qindra nëna e motra e grà!Pastaj, ata s'ishin Korçarë? S'ishin Shqiptarë? Edhè në qoftë se u gabuan dhe e vunë në një anarhi vëndin e tyre lipset t'ja ngarkonim përsipër gjithë këtë faj? Aty ishin të burgosur më të mirët Korçarë e më të zotët, ç'mbetej si t'i mvarnim të gjithë këta? Né të trì me Panteli Vangjelin e me Abdyl Ypin, të dy të parët si Korçarë dhe i treti si Kolonjar a munt të shkaktonim një fatkeqësi të këtillë për vëllezrit t'onë? Po Grekët ç'do theshin si të shihnin gjith' ato exekutime? Nuk do theshin se n'a vranë omogjenët t'onë? Nuk do kasneconin se Korça ishte helenikotati (greke)?

Këto tuke menduar edhè me gjithë që dekreti mbretnuer që gjeta në Korçë më linte të lirë të mar për të çuar cilin do që t'a gjykonja fajtor u mora vesh edhè me shokët e mij, të cilët mbetnë dakord e m'a lanë mua përsipër gjithë punën e të burgosurve.

Unë, si i examinova mirë dosaret e akteve lashë të lirë 160 veta Korçarë, përveç 3-4 të huajve Grekë, msues në Korçë. Nj'a 30 prej syresh që bashkë me çështjen e revolucionit kishin vepëruar edhè krime të tjera ordinare i lashë për të dënuar, tuke ju parasjellë Gjyqit të posaçëm politik. Këta për me qenë më të sigurtë i dërguam lidhur në Berat, mbassi nër ato ditt filluan trazimet nga an' e andartëve Vorioepirotë, të cilët deshin prapë të zaptojnë Korçën dhe gjithë Shqipërin' e Jugës.

Në rjedhje të hetimeve që po bënja zbulova shumë atrocitete[1], shumë mizorina! Kush e di sa prej të burgosurvet ishin rahur keqas brenda në burg prej gardjanëve e rrojtarëve t'onë, tuke u violluar e tuke u grabitur nga të hollat që kishin përsipër dhe s'kuxonin të rëfenin, se mos pësonin më keq! Unë, i cili, veçanërisht si Korçar, i kisha mjaft kujdes, i lashë të lirë të më tregojnë ankimet e tyre, të cilat ata m'i treguan gjërr' e gjatë.

Ndrova kësi soj gjithë personelin e burgut, tuke u rekomanduar të riemëruarve të sillen mirë e me njerëzì, gjë e cila ju bëri përshtypje shumë të madhe të burgosurve, sa kur i vizitonja nga ndo një herë uleshin përmbys, tuke dashur të më puthnin këmbët!

Qysh se kisha marrë këto masa as një ankim s'u dëgjua më nga të burgosurit edhè sa herë që i pyesnja si shkonin me gardjanët, më përgjigjeshin sinqerisht se ishin shumë të kënaqur. Kaqe të enthusiasur ishin të shkretët me mua, sa kur hynja në burg dhe posa që më shëkonin bërdisnin të gjithë me një zë brohoritjeje "n'a rrofsh sa malet", "të paçim o shpëtimtar", "rrofsh për fukarenjtë", "rroftë Floqi" etj, etj.

Nj'a dy trì episode n'a ngjanë në këto, mjaft karakteristike, të cilat nuk do ish keq po t'i tregonja këtu :

Një natë drejtori i parë i burgut bashkë me dy gardjanë të tjerë (një civil e një gjendarm) kishin nxjerë nga burgu një farë Gjorgji nga Stratobërdha, e kishin hequr nga çeshme e Hamzos nga rrug' e Voskopojës e atjè, midis aravet, i kishin lidhur sytë, i kishin marrë 30 napolona që kish përsipër e ishin gati t'a vrasin, qinse dolli fshehtas nga burgu!

Mua vjen më lajmon një njeriu i tij në shtëpi t'ime e me sy plot lott "aman" më thotë, se do t'a vrasin sonte Gjorgjin (Gjorgj Priftin). Me të shpejtë i telefononj të ndyerit Themistokli Gërmenjit drejtorit ahere të Policisë në Korçë, i cili më dërgon një kalë, hipim e shkojmë të dy me vrap në vendin që na treguan, tuke pasur edhè 2 policë të tjerë kalorës dhe i gjejmë guximtarët, ku po e grabitnin viktimën në fjalë, i zumë, i lithmë e i plasmë në burg. Kështu shpëtoj nga rreziku i vdekjes i ngrati Gjergj Stratobërdha!

Një dit tjetër nj'a 4-5 bukuroshë Korçarë çahpinë[2], midis të cilëvet edhè një polic, kishin marrë 5 dhaskalica greke, çupa prej 18-22 vjetsh, msueset e shkollës femnore të Korçës, greke prej Manastiri e prej Selaniku e i kishin mbyllur në shtëpin' e një djali prej oxhaku, që më vjen turp t'i përment embrin, me qëllim që t'i çnderonin! Dy msuese të tjera Korçare vijnë e më kallzojnë ngjarjen. Me një herë mora një fuqi prej 10 ushtarësh e ju vajta përsipër, hyra brenda, u ngjita sipër dhe i gjeta të mjerat goca ku i kishin mbyllur më një odë e po bërdisnin si kur se i therte njeri!

Mjaftova t'ju përment edukatën e keqe që i shtyri në atë poshtërsi kundra 5 vajzave të huaja e të paprotektuara[3] dhe t'ju shtronj se është turp i math për një shqiptar të bënjë punë kaqe të shndershme si këtë! Kështu s'mora njeri në burg prej atyreve, veçse policit, të cilit që atë dit ja çvesha robat dhe e burgosa.

Msueset i vendosa në një shtëpi të ndershime dhe të nesërmet i përcolla të gjitha me roje gjer ne kufit' e Serbis e të Greqisë.

Çudì ishte se midis atyre gjeta edhè një …. kushërirën t'ime, sa do që ishte Greke edhè ja se si :

Kur e pyeta në radhën e saj më tha që quheshe "Efthalia Thomaidhou" dhe ishte nga Manastiri, po pikërisht më tha se është racë shqiptare. Qysh i thom, racë shqiptare? Po nga cili vent i Shqipërisë? Gjyshi im, thotë ishte prej Floqit, po prej shumë vjetësh ish shpërngulur në Manastir dhe atje ishte lindur edhè këjo. Po, a njeh njeri këtu? i thom. A di të kesh ndo një prej fisit t'ënt? Po, më thotë, kam dy kushërinj z. z. Angeli e Thoma Tomçon. Po ata, i thom, i kam edhè unë kushërinj, mbassi i at' i tyre Nisi me t'ëm atë ishin fëmijë vëllezërish; ahere pra, më thuaj, i thom, zotrote pse ke mbiemrin Thomaidhou? Nè, më

[1] atrocitete = krime të tmershme (H. K.)
[2] çahpin = çapkën (H. K.)
[3] të paprotektuara = të pambrojtura (H. K.)

përgjigjet zojusha, asëll quhemi Tomço dhe babaj im me babanë e z. z. Angjeli e Thoma janë kushërinj të dytë. Ahere, zojushe, i thom, si i paske ata më paske edhè mua!

U gëzua tepër e shkreta se njeriu i gjyqit u ndoth fisi i saj dhe kështu ajo u nda nga shoqet dhe ndjeti edhè 3 ditt akoma në Korçë për hatrin t'em gjer sa e përcolla edhè këtë te i ati, i cili më çoj falenderime të mbëdha për shpëtimin e së bijës etj.

I treti episode ka qenë me një furxhi. Dy ushtarë labër tek shkonin nga furr' e tija në kohën e drekës panë një gjel deti të pjekur në bojë trëndafili, i cili ja gudulisi oreksin. Pa një, pa dy ja rëmbyen nga tezga dhe zunë të hikin. Furxhiu i ngratë i ndaloj e fjalë pas fjalet u zunë dhe, siç ishin përpara furrës nj'a tre barrë dru të njohma të shkarkuara, njëri prej tyre rëmbeu një dru e t'i hyri dorë furxhiut gjer sa e shtriu përdhè! U mbloth aty një kallaballëk i math e po bënin sehir. Unë po ngjitesha nga zyra në shtëpi . Pashë kallaballëkun e u afrova dhe arriva në atë çash që nj'a dy-tre burra po kapeshin me ushtarët vandallë e s'i lëshonin të iknin. Njëri prej të dy ushtarve po mbante akoma tepsinë me gjelin e detit të pjekur. Hyra në mes, e si mora vesh ç'ngjau, ju bërtita një herë atyre burrave që ishin aty e që s'ishin të zotët të zenë dy reckapanë edhè me një herë rroka vetë pas jake ushtarin që kish rahur furxhinë. Ahere u sulë të gjitha grà e burra, i futmë që të dy ushtarët në furrë, ju muarm pasaturat[1], i lithmë bukur e i suallm që të dy në Komandën e Gjendarmërisë. Si i tregova Komandantit se ç'ngjau, ky, një toger Gjakovas më t'i shtruar ne dru, më t'i vrau së rahuri e më në funt i burgosi.

Furxhinë e dërguan në spitalin civil

Shum' e shumë ngjarje të shemtuara të tjera ngjanë në Korçë dhe më fort prej ushtarëve gegë e labër që kishim, që s'më vjen mirë t'i përment, për të mos sjellë ndë shesh gjërra që s'n'a rekomkandojnë aspak!

Midis atyre që pyesnja dit për dit, nga të burgosurit, n'a u ndoth edhè një farë Kosta Vasil nga Polena, që tjetër herë e kisha njohur në qytetin Worcester të Amerikës, si një patriot, por i cili, i zembëruar prej meje se e kritikova ashpër në gazetën "Dielli" që e drejtoja vetë, për ca paudhësira e shpërdorime që kishte bërë si orator i degës së Wustrit (Worcester) të "Vatrës". Ky, nga ky shkak më kishte sharrë shumë ndyrë në dy letra të tija, të cilat s'desha t'i përdor, tuke e hedhur në gjyq. Dhe s'mjaftoj me kaqe po më bëri edhè shumë çpifje të tjera sa arrimë për vrasje, por atë kohë unë si u hoqa nga "Vatra" shkova në New-York, ku themelova gazetën "Zëri i Popullit". Kështu, kjo çështje u là në heshtje.

Si t'a sjellë djalli tani të më bjerë në dorë si komplotist, mercenar i Vorioepirotëve, ky faqezi, të cilin e dinja si një patriot.

Kur e thira në zyrë e kur më pa në syt u zbè me një herë. Ish edhè ky fajtor, si të tjerët, se kishte lojtur një roll protagonist në atë kompllot, tuke futur kapitanin andart Mavezà në Korçë me gjithë bandën e tij nga an' e Kapshticës.

Pa filluar t'a pyes unjet më gjunjë e më kërkon mëshirë. Më kujtoj armiqsin' e Amerikës, tuke më thënë se bëri një faj të math atëhere për të cilin u pendua fort, etj. etj. I them : si e quan vehten mbas atyre poshtirsive e çpifjeve që më bëre në Amerikë? Si të të thom, thotë, quajmë si të duash. A je, i thom, njeri i poshtër ti? A jè një maskarà i fëlliqtë, një qelbanik? Jam, thotë, jam ç'të doni. Tani, a të kam në dorë të të mar për gjuhe? Në dorë më kè, thotë, edhè e meritonj, veç se, aman, të të vinjë keq për fëmijën t'ime! Pse u përzjeve, more faqezi, i thom, në këtë çështje? S'pate turp ti që e hiqnje vehten patriot në Amerikë? U gabuam, thotë, të gjithë. Po fajin e kanë turqit, thotë, (musulmanët shqiptarë) dhe autoritetet lokale që n'a munduan shumë. Edhe kishte të drejtë, se qysh se u bashkua Prefektura e Korçës me Shqipërinë tjetër, ata s'lanë gjë pa bërë, se s'kishin as kontroll asgjë. Një mjegull anarqije mbretëronte kudo. Dyqanet grabiteshin, njerzit çvisheshin në mes të rrugës, burgosnin e rihnin kë mundnin dhe as prefekti, as gjandarmërija s'i shtronin dot. Këto fjalë m'i përsëritnë edhè shumë grekomanë Korçarë.

[1] pasaturat = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalorët e mij, por duhet të jetë "paisje ushtarake" (H. K.)

Si e dëgjova hollë, më ardhi nderment sqena e Viktor Hygojt, në librin e tij të pa vdekur "Les Miserables" ajo sqenë që u çvillua midis Jean Valjeanit dhe Javerit, kur këtij të parit, si kryengritës i ra në dorë Javeri, që kur e mori lidhur e e çoj më një vënt të veçuar qinse t'a vrasë, dhe Javeri, tuke sjellë ndër ment sa të këqija i kishte punuar atij si drejtor Policije, dhe priste sigurisht vdekjen nga ajy, Jean Valjeani jo vetëm s'e vrau, po e zgjidhi dhe e là të lirë! Edhe unë, u mejtova andej, u mendova këtej, më së fundi vendosa në funt të hetimeve papërgjegjësin' e tij dhe e lashë të lirë! Kjo i bëri një përshtypje të thellë, u ul e më puthi duart me lot edhè s'la njeri pa ja treguar këtë mirëbërje.

Në këtë mënyrë lëshova nga burgu 156 Korçarë, gjë që bëri përshtypje të madhe dhe 5 ditt me radhë zjente shtëpija imë nga kallaballëku burrash e grash e fëmijësh që vinin të më falenderonin! U ringjall Korça!

Mjerisht situata politike dita-ditës po keqsohej. Turmat e andartëve, nënë kryesinë e kolonelit Gjiritas, të njohur nënë mbiemrin "Kapetan Vardha" po i afroheshin Korçës me fuqi të mbëdha. Nga ana tjetër rebelët Shqiptarë[1], të mbiemëruar "Elikiamasit", mbassi dbuan Mbretin Wied prej Durrsit, e mbassi zaptuan gati gjithë Shqipërin' e mesme ardhë gjer në Pogradec, po akoma s'kishin çpallë prokllamën e tyre dhe s'kishin ngritur edhe flamurin e baba-dovletit! Korça ishte në rrezik të math! Ushtrija kish ditë që luftonte gjattë lumit të Devollit afër Bihlishtit dhe babaljoni i Kolonjës kish zënë vent në Starovë për të ndaluar sulmin e rebelëve Shqiptarë!

Ato ditt takoj një vrasje në katundin Lin të Pogradecit, edhè unë, si prokurori i Korçës, (sepse ato dit kisha marre emrimin si prokuror i Korçës), u shtërngova të mar gjykatsin hetues dhe disa gjendarë e të vete në vent të vrasjes.

Si mbaruam atje punë, u kthyem në Pogradec.

Shkova t'i bënj një vizitë Nënprefektit të Starovës Xhelal beut. Po aty n'a ngjau një episod, që meriton t'a përment këtu. Atje ku po fjaloseshim n'ardhë nj'a 7-8 burra gegë të armatosur. Xhelal beu më rekomandoj ne ata, po ata s'kuptuan duket se unë isha prokurori. Se si takoj që Xhelal bejnë e thirë në telefon nga Korça edhè ky n'a kërkoj ndjesë dhe shkoj në odën e telefonit. Unë si u ndodha vetëm me ata dhe për të shkuar kohën i pyeta kot : Si vijni, si shkoni këtu dhe më së fundi kot prapë, ju si vijni këtej, si i kemi punët?

Ata u panë sŷ në sŷ me njëri-jatrin edhè kujtuan se mos jam edhè unë brenda në kompllot, mbassi, si e kuptova më von, shumë nëpunës të Shtetit t'onë ishin me tarafin e tyre, aty edhè vet' ajy kajmekami i Starovës Xhelal beu, ndonse hiqeshe dashamirës i Qeverisë!

Njërit prej syresh i shpëtoj fjala e m'u përgjeq : Këtu jemi fare mirë, zotni, po ju andej nga Korça si po vijni? A do na prismi me qejf kur të vijmë?

Këto fjalë më zgjuan nga gjumi dhe mbassi u mentova pak, zè i pyes përsëri me marifet, tuke u hequr si njeri i tyre e si anëtar i kompllotit. Ahere ata, njeri pas tjetrin, më zbraznë barkun dhe mora vesh se ishin kryetarët e Elikijamit dhe se kishin një fuqi 1. 000 e ca vetash rrotull, të armatosur mirë dhe me municjon plot, edhè ishin gati të ngrihnin në Pogradec flamurin me hënë e hyll, por, taksirat se paske ardhur mudejè-umumija në Starovë dhe prisnin gjer sa të hikte edh' ajy për në Korçë e ahere t'a çpallnin sundimin e tyre!

Kuptohet tani se mudejè-umumija (prokurori) isha unë vetë, po ata s'e kishin marrë vesh me gjithë që më rekomandoj Xhelal beu. I pyeta ahere : po Xhelal beu a i di këto lëvizje? Si jo, ma pret një prej tyre ; jo vetëm ajy, po gjithë memurët i kemi me vehte, përveç një laneti atij gjykatsit (gjykatsit pajtues Teufik Delvinës, i cili ushqente ndjenja patriotike e s'u bashkua me ata)!

U habita! S'e besonja kurrë që edhè Nënëprefekti vetë të që me ata! S'fola, se atë çash ardhi edhè Xhelal beu e e premë fjalën.

[1] bëhet fjalë për kryengritjen e drejtuar nga Haxhi Qamilit (H. K.)

Ju lashë shëndet e ika. Shkonj me një herë e pjek Abdyl Ypin : Morè, i thom, a e dijni se ç'ju ngjet këtu? Ç'farë? thotë. Këtu kini rebelat brenda e ju s'ditki gjë! Ku kullosni, për embër të Zotit? Dhe i tregova tërë ç'dëgjova. Po Abdyl beu nënqeshi e më tha, se ata janë disa rosga pa një rëndësi, edhè se i dinte edhè ajy po, një qen që leh, më tha, mos kij frikë se nuk kafshon! Hapni syt' i thom, mos merni më qafë taborrin e shkretë të Kolonjës, se kam frikë se mos bijen viktima pa pandehur! Mos u bëj merak, më thotë, se kam mëndjen unë.

Atë natë isha mysafir ne miku im, avokat Behlul efendiu, i cili ishte familisht në Pogradec. Si hëngrëm e pijmë e kënduam, më thotë Behluli të bije të flè pak, se nesër që me natë do vijnë karocat të n'a marin. Pse, i thom, me kaqe ngutësì? Unë do ri edhè nesër këtu se më pëlqeu. Unë të kam mik, thotë Behluli, dhe të dua të mirën prandaj po të thom, nesër pa gdhirë duhet të kesh hikur që këtej. E pse? i thom. Se Elikimanasit, thotë kanë dashur që pardjè të ngrehin flasmurin e baba-Dovletit këtu, po masi qëllove që ardhe zotrote, ne ju thamë të presin gjersa të largohet edhè mudejè-umumija, zotrote d. m. th. , që këtej, e pastaj t'a ngrehin. Përse kështu? i thom: ç'do t'i ndalonj unë në kishin një qëllim të këtillë rebelat? T'a merr mendja, m'a prêt Behluli. Se ti prokuror munt të kërkonje të bënje detyrën t'ënde e munt të ngrihnje më këmbë gjendarmërinë, ushtrinë më në funt, e do bëheshe ndo një fesat i math e do t'ishte edhè vetë në rrezik vrasje. Po nè i muarm parasysh këto. – Po mirë, i thom, po ahere pse s'lajmoni Abdyl Ypin dhe komandantin e bataljonit të Kolonjës, që ka ardhur apostafat për të mbrojtur vendin, kur se ju i paski rebelat brenda? Një her' e dy i kemi thënë Abdyl beut? Thotë. Po atyre s'u mbushet koka, e kujtojnë se 300 veta të baonit[1] do t'i bëjnë ballë rrezikut kur se rebelat kanë një fuqi prej 2. 000 e sà shpirt edhè të armatosur mirë, me topa e me mitraloza, kur se këta të tjerët kanë vetëm pushkat edhè 2 mitrolosa të ndryshkura.

Por, ti, i thom, Behlul effendi, me këta qënke? Ç' të bënj, thotë, munt të sillem ndryshe, kur i gjithë populli u bashkua me këta? Turp, i thom, turp, ku e harrimë këtë ditë!

Të nesërmet në mëngjes kishin ardhur 3 karoca përpara shtëpisë së Behlul Efendiut. Gjykatsi hetues që kisha pas, sekretari im edhè gjendarmet kishin okupuar dy karoca edhè e treta ishte për mua ku do më shoqëronte edhè kushërira ime Ollga e Mitkos që do kthehej prej Pogradeci në Korçë.

Para se të nisemi për Korçë dolla shpejt në Pazar e poqa Gani Butkën, nëntogerin, të birin e Salih Butkës që e kisha mik. I tregonj çështjen e i thom të vinjë me mua në Korçë, se ndodhet në rrezik. Po ajy s'dëgjoj të vijë me mua si dhe një nga oficerët e baonit të Kolonjës e kish për turp të linte vendin. Shtoj edhè këto fjalë : Ato që thonë rebelat i dijmë bukur nè; nuk n'a trembin me pallavrat e tyre; Bamp sa të bëjnë vetëm edhe do të shohësh që do t'i zemë si minjtë e do t'i flakim në gjoll. Mir' i thom. Kur se ju qenka mbushur mendja kështu, bëni si të doni, unë ju dolla nga borxhi! I lashë shëndet dhe më përcolli gjer te Behluli e kështu u nismë për Korçë.

Pa harrirë akoma në fshatin e Çërravës dëgjojmë një batarè pushkësh. Qendrojmë e vemë veshin. Pushkët vijshin nga Pogradeci dhe me një herë e mora vesh se ishte ndezur dyfegu! Ahere ju tregova shokëve se ç'qëllim kishin ato pushkë, me gjithë që ata s'e besonin, tuke thënë se janë pushka gjujtarësh.

Kur arthmë në Korçë muarm vesh se pas pak minutash si hikmë nè prej Pogradecit, rebelët ngritnë flamurin e Turqisë edhè me qenë se ju kundërshtoj tabori i Kolonjës, krisi pushka midis sokakëve të Pogradecit. I pari që u vrà prej bataresë rebele ishte i shkreti Gani Butka, që s'më dëgjoj të vinte pas mejet! Me Ganinë bashkë u vranë edhè shumë oficerë e ushtarë të tjerë dhe shumë të tjerë u plagosnë!

Në Korçë, kur u ktheva, punët i gjeta si mos më keq. Gjithë autoritetet e populli ishin allarmuar se pse andartët grekë ishin afruar Korçës. Nga an' e Kolonjës kishin zaptuar Ersekën edhè tash ndodheshin në Qafzez e në Elmës. Nga an' e Kazanit i ishin afruar

[1] baon = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalorët e mij po duhet të jeta e barabartë me fjalën bataljon (H. K.)

Dardhës, e cila ishte më të rënë e sipër. Nga Bihlishti ishin afruar në katundet Bitrisckë, Progër e Mushurishtë, gati të kapërxenin Devollin e të hidheshin në fushën e Korçës!

Korça ishte piskëlluar fort. Korçarët, nacionalistët, dua të thom, ishin mjaft të trembur. Autoritetet bashkë me komandantin Hollandes Shnellen-in dhe oficerët e tjerë po pregatiteshin t'a lijnin Korçën. Vetëm disa Korçarë nacionalistë po luftonin në ballë të Kolonjës me një fuqi 1. 000 e ca vetash dhe kapiten Leon Guilardi[1] në ballë të Devollit me një fuqi 2. 000 e ca shpirtsh. Këjo ishte gjithë fuqija e Korçës.

Nga Durrësi punët ishin edhè më keq. Wiedi ishte në rrezik të binte në duart e rebelëvet, Essad Pashaj, sa do që do t'ju dorëzoheshe nacionalistëve të Durrsit, mundi e u hoth në një vapor italjan me ndihmën e agjentëve italjanë dhe shpëtoj, tue kalue në Itali. Qeverija e Durrsit s'ishte në terezi. Po edhè né në Korçë s'dijnim nga t'ja mbanim, se edhè këtu administrata paralizoj krejt, s'dëgjonte njeri as urdhra, asgjë!

U mblothmë në godinën e Prefekturës dhe i dhamë funt të lijnim Korçën se s'ishte shpresë. Komandanti Hollandes Shnelleni më merr më njanë e më thotë se në rast që thyhet Guilardi në Devoll ne duhet të hikim ca më parë nga rruga e Beratit, që ishte e lirë.

Kur po kuvendonim kështu dëgjojmë një shamatë të madhe prapa nesh. Të burgosunit kishin thyer burgun e kishin dalë të gjithë jashtë! Kush t'i futte prapë brenda tani? Kush dëgjonte prej urdhrave? Në atë ças vjen Themistokli Gërmenji e

n'a thotë se ushtarët Gegë kishin filluar të thyenin me spata dyqanet e Korçës dhe kishin grabitur nj'a dy dyqane! Çohemi shpejt bashkë me Themistoklinë, e mbassi armatosmë nj'a 30 e sa veta civilë, si edhè vehten t'onë, u lëshuam bashkë me Themistoklinë në Pazar. Gegët n'a vunë në pushkë, po edhè Themistokliu ishte shumë trim, ndjesë pastë, dhe zuri vent e ju rà. Ajo mjaftoj t'i thyenjë Gegët, të cilët i ndoqmë gjer jashtë Korçës. Kështu shpëtoj tregu i Korçës!

Ish më të ngrysur. Lajmet sa po vijnin keqsoheshin. Shpresat n'a lanë. Gjithsecili pregatittë valixen. Shumë u nisnë e shkuan për Berat. Të nesërmen një panik i math allarmon popullin. Grekët kishin zaptuar Zvezdën, Dardhën edhe kullën e Qarit. Luftëtarët t'onë gjendeshin andej e këtej Qarit dhe një pakicë kish ardhur në Korçë.

Afër drekës mblidhemi në konakun e Prefekturës nëpunës e popull bashkë. Vendosim që të hikim të gjithë ca me kuaj, ca më këmbë. U mblothnë nj'a 300 e sa kuaj, mushka e gomarë. Mua më dhanë një kalë të çalë nga një këmbë, që s'ish e mundur të udhëtonja me atë. Kush e arriu zgjodhi e mori kalin që deshte!

Shkonj e i thom Komandantit Shnellen si do bëjmë? Më thotë : Lè t'i lejmë të shkojnë këta se né kemi mushkat e forta të artilerisë. Posa të kthehet fuqija jonë e Devollit do nisemi me gjith' ato për në Durrës, më thotë Komandanti, të cilin e kisha shumë mik. Shtoj akoma se Grekët s'munt të vijnë me një herë në Korçë pa u dlirë mirë vendi se kishin edhè frikën e bombavet.

Nga të ngrysurit pamë se po kthehej fuqija jonë e Devollit dhe mbas 2 orësh, do me thënë, ora 1 e natës ardhë disa oficerë, të cilët n'a thanë se munt të mbahen edhè nj'a dy ditt në bregun e Devollit, se iu kishin ardhur ndihmë shumë vullnetarë nga katundet e Devollit e të qarkut të Korçës. Si do qoftë ne s'munt të rijnim më në Korçë. Shnelleni, kur u ndahmë më tha që të nesërmen në mëngjes të marr valixën e të ndodhem aty se do shkonim tok.

Shkova në shtëpi dhe si hëngrëm bukë, ndejmë tuke llafosur gjer nga mezi i natës. Në atë kohë kisha pregatitur edhè gjithë plaçkat e mija në dy valixe të vogla.

Nga mezi i natës dëgjojmë së largu një allarmim, një ulëritje, një ushtim të math zërash. Këjo s'mbajti më shumë se gjysmë ore. Pastaj s'dëgjohej gjë, as një lehje qeni, as një fletë

[1] Leon Guilard = Uroj të mos jem i gabuar, por Guilardi ka qenë një oficer kroat në shërbim të ushtrisë shqiptare, të cilin Mbreti Zog e emëroi gjeneral, i cili, në krye të Gardës Kombëtare në vitin 1935 shtypi krzengritjen e Fierit kundra Zogut (H. K.)

druri. Ç' u bë? Nuk e shpjegonja dot. Desha të zbres në Pazar, po gratë që kisha në shtëpi, ime gjyshe, im' emte dhe dy kushërira s' më lijshin të dal jashtë.

Nga mëngjezi, si pas fjalës që kishim me z. Shnellen, mora valixat me një kushëririn t'em e u nismë për ne Shnelleni, mbassi ju lashë shëndet grave. Po kur ardha në konakun e Hollandezëve ç'të shoh? Dyert hapur: as një roje, as një ushtar, as një njeri gjëkundi. Dukej se Korça kishte vdekur! Kë të pyesnja? Kush të më informante ç'u bë, ç'ngjau? Hipim lart në konak dhe me habitje shoh petka ushtarake të hedhura andej e këndej, pjata e misure[1] me gjellra të ngrira plot dhe bukra të prera e të përhapura mbi një tryezë të gjattë, spata, kapella, dyfegje të mvarura pas murit. Ç' ishin gjith' ato?

E kuptova se Hollandezët dhe gjith' oficerët e tjerë kishin hikur befas, pa harrirë as të hanin bukë, as të pregatiteshin akoma! Hall' i math! Duket se e panë shumë pisk dhe s'patnë kohë as të më lajmëronin sidomos, me gjithë se Komandanti Shnellen e dinte shtëpinë t'ime.

Jashtë mora vesh se ushtrija kishte hikur krejt, se me qindra fëmijë, e grà të zbathura e të ngarkuara me djepet e tyre kishin shkuar me një panik të math, që të

mos bijnin në duart e andartëve gjakpirës! Vetëm Grekomanët kishin mbetur në Korçë, po edh' ata ishin mbyllur ermetikisht brenda, nga frika se mos pësonin gjë nga nacionalistët që po hiknin.

Fund' i fundit mora vesh se mbeta në Korçë, në mëshirën e andartëve Vorioepirotas! Hall i math! Po tani ç'bëhet? Nuk e humbas akoma shpresën. Lè kushëririn t'im me të dy valixat në konakun e gjendarmërisë dhe vetë nisem për në kat. Orman Çiflik, gjysmë ore lark Korçës, ku kisha disa miq, me qëllim që të gjenj një kalë të mirë e të nisem nga udha e Beratit, e cila ishte akoma e lirë.

Vajta në Orman Çiflik ne një mik, i cili më priti mirë, po kur i tregova qëllimin t'em, ajy si grekoman më thotë : I marrë jè që kërkon të shkosh vetëm? Ne s'të kursejmë një kal' e dy, po mos merr vehten më qafë. Grekët, thotë, ku do që të jenë afruan. S'kè nga të shkosh, po ri këtu me nè dhe të jesh i sigurt se ata do lenë kokën për ty, mbassi nè të krishterëvet n'a kè bërë kaqe të mira, n'a kè shpëtuar nga burgu etj. etj. Po unë s'dëgjonja nga këto. Zgjodha një kalë dorì të mirë dhe u nismë me mikun t'em për në Korçë:

Para se të hyjmë në qytet dëgjojmë disa krisma pushkash. Ç' ësht' i thom, mikut t'em Ligorit? Duket, thotë se kanë hyrë Grekët nga an' e Qarit. Medet!.... Pas pak dëgjojmë dhe këmbanat e Shën-Mërisë, të Shëngjergjit e të Mitropolisë që po buçasin me gzim. A e sheh? më thotë Ligori. Kur të them unë ti kërkon të bësh kokë të fortë! Po të duash, thotë, kthehemi në shtëpi t'ime, se aty do të jesh rehat e sigurt, se s'i bije ndërment njeriut të të kërkonjë. Jo, i thom, jo, po hyjmë një herë në Korçë të vete në shtëpi t'ime, pa si t'a kem nga fati lè të bëhet:

Si e pa Ligori se s'më bintte dot të kthehesha në Orman Çiflik, hyjmë bashkë në Korçë, muarm të dy valixat e mija dhe vamë tok në shtëpi t'ime. Kisha mbetur rop në mëshirën e Vorioepirotëve dhe Zoti e dinte tani se ç'munt të më ngjiste!

U futa në shtëpi dhe u mbylla në një odë që dritaret e saj shëkonin kodrën e bukur të Shën-Thanasit. Ligori mori kuajt e hiku. E porosità të mos i thotë as njeriut se mbeta në Korçë. M'u zotua se "po".

Rashë në një mendim të thellë! S'dinja si të bënja. Nuk hëngra as bukë atë ditë. Më shkonin nëpër ment një mijë të këqija!

Afër drekës mora vesh se kishin hyrë nja 600 shpirt andartë. Korçarët Grekomanë i kishin pritur si shpëtimtarët e tyre. Po shëkonja nga Shën-Thanasi një tufë njerës. I kqyr mirë me një dylbì ushtarake që kisha dhe i dallova se ishin Vorioepirotë. Shoh se ngatërohen me disa njerës të tjerë: zbrazën disa pushka ; dëgjohen ulërima e të bërtitura! Nuk mora vesh ç'u bë! Nga mbrëmja mora vesh se ata andartët ishin përpjekur me disa gjendarmë t'onët që

[1]misur = tas i madh për gjellë, çanak (H. K.)

kishin mbetur pa ikur; kishin vrarë e therur nj'a 6-7 shpirt dhe plagosur kush e di se sa dhe të tjerët i kishin zënë robër.

Pas dy ditsh ardhi në Korçë edhè Kryetari i çetavet, kapetan Vardha, të cilin Grekomanët e Korçës e apotheosnë[1] me gjithë shtat-madhorin e equipazhin e tij. Se kush më trathtoi e i tha se unë jam në Korçë. Ky kur dëgjoj embrin t'em u habit. Pyeti prapë në jam ajy Kristaq Floqi që në vitet 1894-99 isha student i Drejtësisë në Athinë. i thanë se "po" ajy vetë është. Ahere kapitan Vardha më dërgoj dy oficera në shtëpi, njëri nga të cilët ishte edhe kapitan Gjorgji Kondhihi, sot gjenerall edhè ministër i luftës në Greqi. I prita me të drojtur, po ata m'u treguan shumë të enthusiasur, edhè m'u falë edhè nderit nga an' e kryekomandantit për sa të mira ju bëra Grekomanëve (!), sa kohë isha në gjyqin politik në Korçë. Më thanë, në ish e mundur të vinja me ata

gjer të kryekomandanti, po ju thashë se isha paqef e s'mundnja, sepse i prita tuke qenë shtrirë në krevat.

Si ndejnë no një orë shkuan. Po pasdreke vijnë dy Korçarë, professor Evraim Gjini dhe Dr. Koço Noçka e më thonë se kryekomandanti deshte të më bënjë një vizitë, mbassi dëgjoj se jam i sëmurë. Ju thashë se do kem kënaqësinë më të madhe që t'a pres. Si shkuan këta të dy, pas gjysmë oret ja ku ja mbrin në shtëpi t'ime kapetan Vardha me 5 oficerë të Shtabit Madhor. Me të shpejtë mvesha pyzhamet edhè rashë në robat. Pas pak hapet dera e dhomës s'ime dhe hyn kryekomandanti Vardha me 5 oficerët e tjerë. Posa e pashë m'u duk një fytyrë e njohtur dhe po mendohesha ku e kam parë. Vardha posa më pà, edhè me gjithë që kishin kaluar qysh ahere më më shumë se 15 vjet, më njohti e më thotë: A nuk jè sotrote zoti Kr. Floqi, që banonje në rrugën Anhezmu në Athinë si student i Drejtësisë sot e 15 vjet, që piqeshim shpesh në sheshin "Omonia" në kafen "Paris" në Athinë, që dikur m'u bëre dëshmitar në një duello që bëmë më një nëntoger të Xhenis Gregoraqin?

Ahere më rà ndër ment me një herë se Vardhën e kisha pasur mik të ngushtë në Athinë, ku ajy ishte nëntoger i infanterisë dhe embri i tij i vërtetë ish Gjorgji Panajotakis. M'u hoth me një herë për qafe e më puthi, tuke ju thënë shokëve se ishim miq të vjetër e se mali me malin munt të mos piqen, po jo edhè miku me mikun! U gëzua fort që më pà pas kaqe vjet, tuke më falenderuar që shpëtova gjith' ata Korçarë omogjenë, që munt edhè të mvareshin të gjithë, tuke shtuar se kisha bërë një vepër të madhe bamirësije, për të cilin do mos harrohesha kurrë edhè për të cilën më faleshe nderin në embër të ushtrisë së tij e të Helenismit!

I thashë se unë bëra detyrën t'ime edhè si nëpunës, po edhè si Korçar edhè s'ka për se më falenderon, se nuk munt të merreshin më qafë gjith' ata njerës e të mvareshin en grupë!

U fjalosmë gjat' e gjërrë, sepse ishim njoftë me të vërtet aqe vjete me 'të në Athinë dhe e pashë se ishin fort të gëzuar se mbeta në Korçë.

Më thotë kryekomandanti Vardha se për këtë shërbim munt të kërkonj ç'farë shpërblimi të dua edhè se ishte gati të më emëronte qysh atë ditë kryeinspektor e të gjithë gjykatave Vorioepirote, ose drejtor të përgjithshëm të thesarit publik. I thashë: ju falem nderit fort po, nuk munt të pranonj as një nëpunësì të huaj, mbassi jam shtetas Shqiptar.

Leri ato fjalë, thotë Vardha, ti je jyni, tani s'ka Shqipëri e Shqiptarë; u shduk një her' e mirë, thotë, Shqipërija se prej Shkumbinit e poshtë do t'a marrë Greqija e prej Shkumbinit e nalt Jugoslavija.

M'a fal, i thom, z. komandant, atë gjë nuk e besonj kurrë. Shqipërija është njohtur si shtet më vehte prej Konferencës së Londrës: edhè nuk e besonj të lozë Europa me fatin t'onë. Ndofta sot u ngatërruan punët, po kjo tokë prapë Shqipërisë do t'i mbetet të jini të sigurt.

E pashë se nuk ju arth mirë të gjithëvet. Vardhës s'ju durua e kthehet e më thotë : mos më bëni të humbas idhenë që kam për ju. Ato janë ëndra që thoni, në të vdekur munt të dalim që këtej. Po të lutemi tani mos na prish qejfin edhè mendohi e n'a thoni ç'dëshironi, edhè më

[1] apotheosnë = hyjnizonin (H. K.)

ndjeni, më qoftë se si mik ju thom të më thoni në kini nevojë edhè për të holla ; jam gati t'ju jap sa të doni. – Ju falem nderit, thom nuk kam nevojë për parà, se këtu kam shumë far' e fis e miq e po t'ju kërkonj më japin, po tash s'kam nevojë se të holla kam. Sa për nëpunësì ju falenderonj edhè një herë, po s'munt të pranonj as një. Un' e quaj vehten akoma si shtetas Shqiptar edhè si nëpunës i mbretit Wied me dekret s'munt të pranoj as një nëpunësì. Në daçi më konsideroni si skllav, mbassi rashë në dorë t'uaj, në daçi edhè për miqësinë që kemi pasur tjetër here, munt të më jepni lejen e pasaportën të shkonj në Vlorë te familja ime, e cila nuk di si gjendet sot edhè si më di , të gjallë a të vdekur!

Na vjen shumë keq, thotë Vardhas të na hikësh kështu nga duart, kur se nè edhe vendi yt ka shumë nevojë për ty edhè kur se me qindra Korçarë më kanë ardhur në zyrë e më kanë çfaqur sympathitë mà të mbëdha për personin t'uaj, tuke m'u lutur që për të madhe punë mos ju lè të shkoni.

Unë, shumë do t'ju lutesha të më japnit passaportën, z. komandant, i thom, edhè më besoni se do t'ja u di për të mirë.

Si të doni, më thotë Vardha, po mendohuni një herë mirë për sa folmë. Për hatrin t'onë, thotë, do të rijni ca ditt këtu; ç'dreq, s'paskemi edhè ne miqtë të drejtë t'ju ndalojmë pak ditt këtu, pas kaqe vjetëve që mezi u pamë?

Ri, i thom, sa të doni, sa për atë.

Si ndejnë no një or' e mê tepër, u ngritn' e shkuan, tuke më falënderuar prapë.

Të nesërmen në mëngjes më vjen një officer tjetër, toger, një djalosh nj'a 25-26 vjetsh. Posa që hyri brenda m'u hoth për qafe, tuke më puthur me lotte ndër sy, e pastaj të dy duart. Shtije syt' e shoh: brè, i thom, ti Aristidhi jè? Unë, thotë. E rrok për qafe edhè e puth si djalin t'em! Këtë djalë e kisha shërbëtor në dyqan të babajt t'em. E kishim marrë që 9 vjetsh djalë dhe e kishim rritur e msuar shqip, që s'e ndanje që ishte Grek prej Karvasaraje. Mua më desh e më adhuronte si një baba të dytë. U gëzova fort që e pashë, se ishte djalë shum' i mirë. Ajy s'më ndaheshe për dita. Ishte njeriu i shtëpisë dhe e mbanja gjithënjë për drekë.

Në Korçë nj'a 10 ditt që ndenja njoha edhè shumë oficerë të Vardhës me të cilit ishim njohur tjetër herë në qytete të ndryshme të Greqisë, ku ndenja një jetë të tërë.

Më së fundi, ju luta Vardhës të më japë passaportën, edh' ajy si e pa se s'nxitonja m'a dha passaportën, po me hidhërim të math. Më përcolli me një oficer, adjutantin e tij gjer në Follorinë. Në Pisodér, që fjetmë natën e parë, sa do që ishte mez'i Korrikut, po ishte kaqe ftohtë, sa na ranë duar e këmbë ndër thonj. Kam marrë një bronshitë, që për dy muaj mezi u shërova.

Në Follorinë n'a priti Prefekti i vendit me anë të kryesekretarit të tij, i cili na çoj gjer në Stasjon e n'a nxori një biletë të klasit I-rë për në Selanik, dhe s'desh të merte të hollat, po unë s'e lashë dhe e falenderove.

Pas 7 orë ishim në Selanik. Aty ndenja dy ditt dhe natën e dytë mbrëmanet u nisa në Pirè me një kohë të bukur. Ndenja në Athinë nj'a 3 ditt edhè s'andejmi mora vaporin për në Korfus, ku dolla për pak minuta, po mbassi u informova se vaporet e Puglias kishin 2 javë që e kishin prerë lundrimin Patrasso-Korfus-Vlorë u shtërngova t'i hipinj po atij vapori që më pruri në Korfus, tuke shkuar në Sarandë edhè s'andejmi në Brindizi të Italisë, dhe mbas dy ditsh u nisa e ja mbrina në Vlorë pranë familjes s'ime.

Një telegraf që i kisha hequr s'ime shoqeje prej Brindizit e kishte ringjallur se s'dijnin aspak për fatin t'em e ment prisheshin mentsh. Mezi u sheshova në Vlorë.

Të nesërmen mora vesh se mbreti Wied me gjithë familjen mbretnore e suitën e tij e lanë Durrësin.

Në Vlorë punët po çqetësoheshin e po keqësoheshin dita-ditën. Vlonjakët nuk ishin të zott t'u bënin ballë rebelëve, që kishin ardhur te lumi i Drashovicës. Më së fundi u muar vesh me ata e i lanë të hyjnë lirisht në Vlorë. Né, posa e dëgjuam lajmin e zì, e pamë se ç'do nà ngjiste si nacionalistë edhè me të shpejt vrapuam të nisemi, të hikim nga Vlora. Po ku të

vemi? Vent tjetër s'kish veç se Shkodrës. Vetëm ajo ishte tok' e lirë, me gjithë që aty, mbassi krisi lufta Europjane, kishin ardhë ushtrì të Antantës, d. m. th. Englezë, Frengjë, Italjanë dhe Serbe.

Nisemi unë me fëmijën t'ime, ime kunatë, të ndjerë Marigo Pozio me fëmijën e saj dhe im vëllà me gruan e tij. Vamë në Durrës ku muarm edhè baxhanakun t'em Kostaq Kotën me të shoqen. Kështu të gjithë ju drejtuam Shkodrës:

Në Shkodrë unë me Marigonë, me K. Kotën e me të vëllanë e tij Ilo Kotën xumë një shtëpi më vehte dhe im vëlla me të shoqen e me të ndyerin Mustafa Qullin me të shoqen e tij zunë një shtëpi tjetër.

Ndo një punë nuku kish as një prej nesh edhè hanim pare të hazërta. Unë u përpoqa e u bëra ortak me Terenc Toçin, që kishte prej kohësh zyrë avokatore në Shkodër, e kështu, sa pa iç, mxirnja në pjesën t'ime 5-6 napolona në muaj, të cilat i prishnim së bashku me familjet e tjera që ishim tok.

Këtu në Shkodrë na prisnin ditët më të këqija që stërditmë[1] në jetën t'onë. Kallaballëk i math e papunësì e tmershme! Një re e zezë po n'a mvareshe mbi krye! As njeri s'dinte të nesërmen. Mbi këto filloj një grindje e madhe midis mysylmanëve e të krishterëve katolikë të Shkodrës, për shkak se të parët deshnin edhè një herë babadovletin dhe ishin gati të ngrihnin flamurin e tij mbi ndërtesat publike, kur se katolikët, që mbaheshin nazionalista këto lëvizje i urrenin fort.

U ngrehnë barrikada në për rrugët qëndrore edhè me një herë krisi pushka. Nuk n'a sosnin gjithë mjerimet e frika e urisë, që po shtoheshe dita-ditës po kishim eè avaze të tjera!

Lufta vazhdoj gjattë, edhè më fort në kohën e natës, po lumërisht pa një aksident as nga njera anë, as nga tjetra. Po ahere për se luftonin këta të marrë? Këjo më bëri një ndërshtypje qesharake edhè mbi të gjitha hallet, u inspirova një ditë edhè ju bëra një satyrë, të cilën e botoj avokat Terenc Toçi në gazetën e tij "Tarabosh" që botonte në Shkodër. Këtu po shënoj vetëm dy strofa të kësaj satyre sa për kujtim, me gjithë që këjo gati më kushtoj jetën, si do të shpjegohem me poshtë :

Bam-bûm kërcasin pushkat nat'për natë,
Shkodranë, pa n'a thoni, mos u vratë?
Jo brè vëlla, mos trembi, mos u tuti,
Se s'mrin në Shkodër kurrë kamb'hajduti!
Për se pëzajnë gjith këto burrija?
Mos msyni Essad Pasha, a Serbija?
Jo, hajdreq, nuk keni psè m'u drue,
Se né po qesim pushka veç m'u gjue!
---

Bam-bûm kërcasin pushkat nat' për natë,
Po dridhen delm e pleq, po edhè gratë *(ky rrjesht është prishur nga autori)*
Brè burra, n'a kallzoni, ç'dreqin pattë?
Jo, haj dreq, kurrkush nuk a varrue,
Po zbazin pushka vetëm për me u gjue!
Për se po bani, brè, gjith kêt poterë
E po n'a kllisni frikën edhè mnerë?
- Jo, brè vlla, por ishin do kusarë
Qi dojshin me n'a vjedh' lop' e magjarë[2]!

Etj. etj.

---

[1] Stërdit : has, takonj, gjenj përpara. (K. F.)
[2] magjar = në dialektin shkodran i thonë gomarit (H. K.)

Kur panë katolikët këtë satirë, që ishte një tallje për ata, e sidomos kur e panë malsorët, që përbënin pjesën më me rëndësi të beligjerantëve, u egërsuan e u ashpruan fort. U mblodhë me një herë në kuvent edhè vendosnë të më vrasin! Një Toskë të vinjë e të tallet me burrat e dheut? Këjo ishte një përbuzje e madhe për ata, që pas mendjes së tyre nuk laheshe veç se me gjak!

Qysh atë ditë zunë e po më kërkonin më të katër anët. I ndyeri Sotir Peci bashkë me Kol Ivananë më vijnë me gjysmë shpirti se do më vrasin malsorët. Gratë u trempnë fort, po edhè burrat K. Kota e Ilo Kota, e më thonë edhè këta të mfshihem ca më parë ku të munt. Po ku të vinja?

Para se të ngryset shtëpija jonë u gjent e mblokuar prej 100 e ca malsorësh të armatosur. Kryetari i tyre, një farë Pjetër Nushi, që kishte vrarë ndo 20 e ca shpirt me dorën e tij, një zog dreqi, hyri i pari vet' i tret në shtëpi t'onë e po më kërkon mua. Gratë dridhen si purtekë e s'më lenë të dal. Po unë e shëkonja se s'bëhej ndryshe, me gjithë që koka ime ishte në rrezik. Duhet t' dorëzohesha, se ndryshe munt t'i vinin edhè zjarrin shtëpisë si të marrë që ishin! Dolla ahere dhe zbrita në hajat. Urdhroni, thom, unë jam Kristo Floqi. Eja me nè, thotë Pjetër Nushi se kè me u gjykue prej gjyqit të Xhibalit edhe ç'fat të kesh.

Ime shoqe vuri vajin; t'ime kunata zunë bërtisnin, qanin me zë! Po, për fat të keq, s'bëhej ndryshe. I thom Pjetër Nushit : jam në besën t'ënde, më gjykoni, po mos më vrisni udhës me të pabesë. Nè s'jena faqezinj e horra, më thotë Pjetër Nushi. Jena Shqyptarë; Shqyptari nuk vret tinzi.

Kështu shkuam gjithë tok në "Kafen e Madhe" të Sereqit. Unë ecnja në rangun e parë me kryqëzorët e mij si Jezu Krishti në Golgothânë!

Kur hŷmë në kafehanën pamë një kallaballëk të math, përveç mijra njerësve që ishin grumbulluar jashtë kafenesë. Sehir i math! Të gjithë ishin të mendjes se do më vinin në plump jashtë Shkodrës nga vendi i qojtur "Ara madhe" dhe disa Shkodranë kopukë nuk përtuan të afrohen afër meje e të ma thonë faqeza "gajret, brè burrë, e n'a shkruj kah të veç te ajy dyrnjaja tjetër"!

Shegjertat e kafexhinjtë pregatitnë 3 tavolina me rradhë edhè m'at'anë, ose prapa atyreve disa kariga. Ishte Gjykatorja që u ngreh për mua! Disa malsorë zunë seicili vendin e tij mbi karrigat. Gjithsej 8 veta, edhe Pjetër Nushi ndejti në mes të tyre, si kryetar i Gjykatores. Ishte tamam gjyq, "Cour d'assises" Mua më vunë përpara tyre nja 2 hapa më lark, si të pandehur merret vesh. Më të djatht' e më të mëngjër qendrojnë pranë meje Sotir Peci dhe Kol Ivanaj dhe gjyqi filloj me gjithë seriozitetin e duhur.

Fjalën e ka kryetari, i cili hapi mbledhjen me një parafolje të shkurtër, po mjaft karakteristike e për të vënë rè.

Kryetari : Burrat e Dheut, - ju thotë gjyqtarëve – këtu jena mbledhë për me gjykue këtˆ zotnaje, qi emnin e ka Krista Floqi, toskë. Kena me e gjykue se ky me këtˆ gazetë (nxjer gazetën që përmbante vjershën satyrike e ja tregon anëtarëve) n'a ka shà e na ka flliqë, si me kenë horra; n'a ka thanë se "qesin pushka sallde për m'u gjujetë", me gjith që nè kena luftue me ata horra turq për çashtje flamuri! Na ka qujtë kusarë, qinse kena dashtë me grabitë lop' e gomarë; n'a ka përbuzë, bré burra, n'a ka korritë. Tash kena me e digjue, palé si ka me ju dalë zot këtyne fjalve dhe këta zotnae – rëfen me gisht Pecin e Ivananë, kanë me e mprujtë, palè, palè!

Këjo ishte gjith' akuza ime, tamam si munt t'a përfytyronte një prokuror para gjyqit.

M'andej ju adresohet avokatëve të mij: Ju, or zotnae avokatën hapni sŷtˆ e mos n'a thoni rrena këtu pasi vaj halli për ju; kena me ju hjekë xhezanë[1]. Pastaj më kthehet mua : Zotni Kristo Floçi mblidhe mendjen e folë. (Më tregon gazetën). A i ke shkrue zotnija yte gjith këto?

[1] çezà = dënim (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

Unë : Si urdhnon, zotni kryetar

Kryetari : Kryetar i thonë Zotit. Unë jam kryepari mbas kanunit Xhibalit[1].

Unë : Si urdhnon, zotni kryeparë

Kryetari : Folë, pra, a janë të tuat këto?

Unë: Si urdhnon:

Kryetari : E ç'ka të shtyni, mor zotnae me n'a korritë kaqe fort?

Unë : S'kam dashur me ju korritë, zotni kryetar, por e kam shkrue kot, e kam shkrue për me shkue vahtin, për me lujtë.

Kryetari : (i cili nxehet tepër me këto fjalë). Për me lujtë me nè? Asha Zotin mati fjalët kur flet, zotnae se këtu i thonë gjyqi i Xhibalit. Nuk a punë me lujtë, se këtu luan me kryet t'at, për gjakun e Krishtit!

E pashë se e kam hollë shumë me ata malsora e duhet të mendohesha mirë kur flisnja.

Unë : Zotni kryeparë, s'më keni marre vesht mirë. Unë kam dashtë me thanë se nuk e kam bà atë vjershë për me u tall me ju, aspak, por e kam bà kot, si t'ju thom e kam bà pa një mendim të keq, se unë as ju kam pà, as ju kam njoftë, e s'kam kurrgjà me ju, kot po e merni për ters.

Ivanaj : (Mer fjalën si avokati im mprojtës) Asha të madhin Zot, brè Lekë, kot dojni me e marrë në qafë këtë farë zotnije. A e dijni kush a ky? Dëgjoni pra, m'andej bani si të doni. Ky, lum zotnija, ashtë një nga ma të mirët, nga ma të mbëdhejtë mundem me thanë atdhetar i ksaj toke Arbnore, qi ka luftue kaqe vjete me radhë për atë Atdhè e ka shkri gjithë mundin e tij, e ka shkrue e ka shkrue pa masë lybra shqype, qi disa i kam këtu me vehte (Nxjer e ju rëfen një kopje të dramës s'ime " Fè e Kombësì", një kopje të komedisë "Merr të marrim" edhè një kopje të " Dëshirës së vërtetë të Shqyptarëve" prej së cilës ju këndon disa rubrika me randësi:

Ky zotnij ka themelue "Votran" në Amerikë. A e dijni "Votrën"? Asht nj' ajo ma e madhja shoqni Shqyptare që i ka dhanë nam gjithë Shqypnis!

Ky ka nxjerë kaqe vjet gazetën "Dielli" në Boston dhe gazetën "Zan' i Popullit" në New-York të Amerikës:

Ky më ka pritë mue me 1.000 e sa Shqyptarë në stasjonin e Bostonit, njat herë kur më çuet ju në Amerikë për çashtjen kombtare. – A ju bije ner mendje (Ju tregon nja 2-3 kopje të "Diellit" si edhè një kopje të "Zërit Popullit" atë kopje që kishte mbulue faqen e parë me flamurin e math të kuq e zi edhè që nën' atë kishte vjershën :

Valo, valo si të ka hije,
Shkrep por si Djelli, vetëtij, etj:

vjershën që pata bërë në New-York me rastin e çpalljes të indipendencës s'onë.

Gjithë gjyqtarët e mij, me gjithë se ishin 99% anallfabetë, po i kqyrnin me vërejtje të madhe librat e mija, ca nga e mbara e ca nga e mprapmja. Edhè oratori im Ivanaj merr yrysh :

Ivanaj : Këtë zotni, kërkoni me e denue? Mos për goshtat e Jezu-Krishtit, zotnij, mos e bani ket faqe t'zezë se kishte me kenë kobi e e zeza e juaj!! Ket zotni e ka nderue Shqypnija mbarë, si patriot, e si avokat, e si gazetar, e si shkrimtar, e ju tash doni me u marrë me dokrra, me shkumba tallazi? Mos brè burra, se bani nji m'kat të math!

E pse? Ju duket çudi se ju bani nji bejte (vjershë)? Mos kujtoni se u tall me ju? Shûjta Zana! A nuk e dijni se është bejtexhi vetë, dhe si bejtexhi mundet me bà bejta pa pague haraç? Ose hidhnoheni ju? E kini kot, vallahi! Sa t'i thoni "ty të lumtë e bardha dorë, ju dojni me e shkue në gjyq e me e dënue! A jeni ndër ment? Ket desha me u pvetë, e mos t'ju mbesë hatri. Prandaj brè shtërnipat e Lekës, unë kërkonj t'i jepni funt këtij kuvendi e t'a leni të lirë ket zotni, se po e presin pa shpirt shpija e tij!

Këto tha Ivanaj, i cili më mbrojti mirë fort, me gjithë që s'e kish zanat avokatinë.

[1] xhibali ose "komisioni i maleve" u krijua nga Valiu i Shkodrës rreth viteve 50 të shek. XIX. Ai kafunksionuar vetëm në qytetin e Shkodrës e askund tjetër, as në malsitë e Shkodrës (H. K.)

Peci i gjori u nemit e s'foli gjë! Ahere kryepari Pjetër Nushi tërhiqet më një dhomë të veçantë të kafehanes me gjithë parotët[1] e tjerë, e mbassi e kuvenduan çështjen më tepër se një orë, e cila m'u duk shekull (se nuk me delte frika, se munt të mos bindeshin në fjalët e Ivanajt, edhè si malokë që ishin munt të jepnin një vendim vdekje, edhè pastaj shko folë me ata, vinja si qeni në vreshtë; duall me një ceremoni të jashtazakonshime si singlotët e Romës antike për të çpallur botërisht vendimin e tyre.

Qëndruan më këmbë pa kësula, si edhè né. Gjithë hallku mbanin veshët, i grumbulluar si stiva drurësh, ose si sardhelet njëri mbi tjetrin.

Kryepari me një stomfë po çpall vendimin :

Vendim :

"Për të madhin Zot duhet me kenë i marrë, ose i pijshëm (i dehur – sarhosh). Ajo qi guxon me u tall me tjetrin me anë gazeta, e mbasi zotnija Krista Floçi nuk asht njeri i marrë po njeri me ment, pa fjalë qi duhet të ket kenë i pijshëm kur i shkroj këto bejta (vjersha), me gjithë se edhè vetë asht bejtaxhi (poet, vjershëtor).

Prandaj po me atë gazetë "Taraboshi" qi e ka botue bejten, ka me botue edhè këto:

"Unë, Krista Floçi, po i baji me dijtë popllit, se nj'at here qi shkrujshe e botojshe bejten "Bam e bum kërcasin pushkët" etj. kam kenë i pijshëm, e kshtu s'kam kenë në mende të kjartë e të kthelltë e s'kam dashtë kurrsesi me korritë burrat e Macis së Shkodrës, Postripës, Prekalit e Dugagjinit"

Ky ishte vendimi i malsorëve.

Kryepari kthehet i thotë Ivanajt: A e pranon ket vendim zotnaja e tij? (për mua thotë) Edhè Ivanaj, tuke qeshur i përgjigjet kryeparit: Me gjithë qejf zotnaje. – E pra, thotë kryetari, keni me e botue sot nji ket vendim, për ndryshe keni xhezanë, thotë. Ivanaj i siguroj se do t'a botojmë pa tjetër e do t'ju paraqesim nj'a 2-3 kopje të gazetës.

Kështu mbaroj gjyqi im edhè unë u mjaftuash me gjith' atë dënim të …. rëndë që më vunë po dha Zoti e m'u çporrë qafet se do gjenja belanë me malokët, të cilët s'dijnë shtat' e tetë kur ju mbushet mendja!

Më së fundi i përshëndetmë gjyqtarët, tue i zënë pas dore, po para se të largohemi mirë, pamë se po pregatiteshin edhè për një vendim tjetër. U afrohem pak dhe një prej antarëve që e pyeta unë, më tha se do vendosnin edhè për shtypëshkronjën e Toçit, që kishte nxjerrë gazetën "Taraboshi" ku ishte botuar satira.

Çohen prapë më këmbë dhe Pjetër Nushi ju sillet anëtarëve tjerë e u thotë : Tash, brè burra, si kena me ja bà asaj mashinës së dreqnume qi pat botue atë bejten e Krista Floçit? Hidhen nj'a dy vetë nga atë me gjak-nxehtët e bërtasin: " Të vem' e t'ja bajmë copë" thonë dhe kryepari e aprovon me një herë: Hallall ju kjoftë, brè burra, mir' e keni gjetë; duhet të thyhet ajo dreqnì makine. Vemë pra. Edhè me një herë nisen me një egërsì t'i thyejn Toçit shtypëshkronjën! Të shkretin ç'dëm katastrofal do t'a gjente! Me vrap ju rashë prapa dhe mezi i ndalova brenda në shtëpi të Toçit ku hynë të gjithë. Brè burra, ju thom, po në rast që do t'ja thyeni shtypëshkronjën Toçit, si do botohet vendimi juej në gazetën "Tarabosh"? Ahere mendohet pak kryepari. Kè të drejtë, vallahi, më thotë, ke të drejtë. Mirë thua. Të presim të botohet një herë gjygjimi i jona e m'andej e thyejm.

Desh Zoti, a dreqi dhe u larguan. Por Toçit i kish ngrirë gjaku dhe si shkoj turma e malsorëve, qëndruam bashkë e u këputmë së qeshuri me mënyrën që i shpëtova shtypshkronjën. Vendimin e tyre e botoj dhe ju dërgoj nj'a 10 kopje dhe këjo mjaftoj t'i shpëtonjë shtypshkronjën.

Kur u ktheva në shtëpi i gjeta gratë pik' e vrer; gati ment fluturonin nga mendja! U gëzuan fort kur më panë të giallë dhe një javë me radhë kemi qeshur me vendimin prototyp të

[1] parot = antar i jurisë (H. K.)

atyre malokëve, me mprotjen extraordinere të Ivanajt edhè me dhelpërinë që shpëtoj shtypëshkronja e avokat Terenc Toçit.

Po ç'n'a ngjau më von? Salih Nivica, i ndyeri, i cili pak kohë m'andej u vrà në Shkodër prej një katoliku, me qenë se e kish mik kryeparin e malsorëve Pjetër Nushin, një dit e thret në shtëpi të tij e kërkon të tallet me atë. I rëfen gazetën, ku ishte botuar vendimi i tyre, qinse unë isha i dehur kur e shkrova atë satirë e i thotë se, me këtë farë vendimi kishin bërë belì (kishin vërtetuar) se me të vërtet paskeshin qenë malsorë të trashë, budallenj. Qysh? i thotë Pjetër Nushi, pa më kallxo! Ja, i përgjigjet Salih Nivica, se një i dejshim, ose i pijshim, si i thoni ju, një sarahosh dua të them, a ësht' e mundur të shkruaj bejta e të tallet me të tjerët? Si bëhet kështu? Si s'e menduat aspak? Si ratë në drasë të kalbur kaqe burra? U! jazek ju qoftë që një toskë u tall me kaqe gegë si ju!.... Mirë thonë, i thotë Salih Nivica, se ju gegët s'kini ment, se po të kishit nuk do të bijnit në këtë llom! Tani sa të më thoni se ju e fituat hakun t'uaj, unë ju thom se ju ratë jashtë edhè me këtë që bëtë treguat se jeni xhahila, shashkënë, të marrë!.... Pjetër Nushi rà në një mendim të thellë! Po tani, breh Salih Nivica, si duhet me ja bà hallit? i thotë. I mallkuari, lugati Salih i thotë ahere se, për me larë këtë gabim trashanik duhet me i marrë pardon Kristo Floqit. Jo, haj dreq, ja kthen Pjetër Nushi, ajo gjë s'ka si bahet! Ahere duhet t'i thoni të paktën se kini bà gabim. Ashtu po, i thotë Pjetri. Dhe Salih Nivica, shejtani, e merr Pjetrin e m'a sjell në shtëpi. Unë s'dinj as gjë. Ajy më shkel synë fshehtazi që diç'ka kuptova.

Hynë brenda, e mbassi ishim vetëm, merr fjalën Salih Nivica e më sillet mua. Zoti Floqi, thotë, kemi ardhë me mikun t'em Pjetër Nushin të shpjegohemi pak mbi çashtjen e vjershës satyrike "bam-bum" dhe mbi vendimin që dha gjyqi i Xhibalit për ju. Këta të më kishin pyetur mua përpara se t'ju mernin në gjyq, unë nuk do t'i kisha lënë të bëheshin qepaze, sikurse u bënë (dhe më shkel prapë synë Salihu), se me atë vendim këta burrat e dheut ranë jashtë! Sepse t'a merr menda : një i pijshëm, jahu (e më shkel prapë synë) a munt të bënjë vjersha? Jo, vallahi, jo, ja pret Pjetër Nushi. Edhe më sillet mua : Né zotnae, kena bà gabim, tash po e shofim, s'n'a çeli sytë ky toska këtu, zotni Salija. Por të lutna të na falësh se të kena mërzitë kot! Edhe tuke më ngjatë dorën më thotë, qysh sot jena miq, e se unë tash po marr vesht ç'ka ke punue zotnija e jojte për ket Shqypnie, po të n'a e falësh. Ç'ka i thom ja u fal!

I gostita rakì e kafe dhe pas pak shkuan, po, i paudhi Salih Nivica e la Pjetrin ne shkalla edhè vetë hyri prapë në dhomën t'ime e zu hijet me dorë së qeshuri, sa edhè mua më lëshonin lott sytë. Ja u kishte punuar paq! T'a mora hakun më thotë. A e more vesh sa ment kanë malësorët e Mbishkodrës? Kështu t'a dijnë tjetër herë!

S'la njeri pa ja treguar dushmani sa e muar vesh edhè gurët e sokakut, dhe përfundimi i kësaj ilaro-tradhëtije ishte se qysh ahere pushuan edhè pushkat që zbrazeshin nat' për natë dhe u ngritnë barikadat nga rrugët.

Në Shkodër i ndyeri Muço Qulli, sa të mos rije pa punë filloj të ribotonjë gazetën "Populli" që botonte tjetër herë në Vlorë. Ishte viti 1915. Lufta paneuropiane ishte në vazhdim e sipër me fitimin e fuqive qëndrore. Shtrenjtësi e madhe, zì nga të katër anët e dëshpërim!

Mbassi iku edhè fuqija ushtarake internacionale e n'a lanë të lirë, Shkodra u bë teatri i çrregullimevet. Një anarhi e madhe mbretronte kudo. Kral Nikolla i Malit të Zì, e kish pikë çështjen e Shkodrës që nuk e gëzoj qysh në luftën ballkanike, kur ja dorëzoj Essad Pasha, prandaj nuk shihte ditën kur të vinte t'a okuponte prapë, si një mall të shkretë e pazot. Muç Qulli, tuke stigmatizuar këtë lakmì të shqaut të Cernagores e goditte shumë ashpër me gazetën e tij. Nga ana tjetër i ndyeri trim Çerçis Topulli bënte propagandë të madhe kundra agjentëve Malëzijas që me shumicë ndodheshin në Shkodrë, dhe të cilët përkraheshin fort nga konsulli grek i Shkodrës, i cili prapë desh me ç'do mënyrë të ligjshme e të paligjshme t'a shtinte Çerçizin në dorë e t'i merte gjakun e ish-mitropolitit Korçar Fotit, të cilin Çerçizi më 1906 e kishte vrarë te "Guri i Capit" afër katundit Bradvdo të qarkut Korçë.

Mali i Zi u pregatit sido kudo edhè një dit nënë kryesì të gjeneral Vukotiçit msyn Shkodrën me nja 3. 000 ushtarë të zbathur e të çveshur, hyri triumfalisht në qytet edhè burrat e Shkodrës e të Malsive, që tjetër herë e kishin tmeruar Cernagoren me të famshmin Osso Kukën, në vent t'i bëjnë ballë armikut shekullor e t'i thyejn hundët, përkundrazi, dolli e e priti me saze e me daulle! O, sa turp për Shqiptarët!!

Gjeneral Vukotiçi si hyri në Shkodrë, zaptoj kalanë e Rozafatit historik, ngriti atjè flamurin e Malit të Zi, tuke zbrazur 101 topa, shduki flamurat t'ona ku ishin e ku s'ishin dhe i zëvëndësoj me flamurat Malzijas, tuke stabilizuar ndërkohë edhe autoritetet lokale me gjuhën serbishte.

Një tmer i math n'a kishte kapur gjithë ne nacionalistët që ndodheshim në Shkodër, se e dijnim sigurisht se nuk do shkonim mirë me ata edhè se përfundimi jynë ish i tmershim. Nuk n'a ishte mjaft papunsija e vujtja për bukë, po kishim edhè shpatën e Damokleut mbi qafat t'ona!

Nuk shkoj as një javë qysh se u okupua Shkodra, po kur një ditë arestuan Çerçis Topullin e Muç Qullin. Kërkonin edhe Salih Nivicën, po s'e gjenin dot se ajy ishte fshehur.

U bëmë shumë merak edhè i kërkonim me anë të ca miqve, po nuk mernim vesh a i gjetnë e se ku i çuan. Pas pak ditë përhapet lajmi i zì se Çerçizin me Muç Qullin i kishin dënuar e vrarë pabesisht në fushën e Shtojës, afër Shkodrës! Në krye s'e besuam, po pastaj lajmi i hidhur u vërtetua!

N'a hyri një dyshim i madh, sepse fati i tyre n'a priste tani edhè né. Po n'a ngushëllonte pak lajmi i fshehtë se Muç Qulli me Çerçis Topullin ishin vrarë me shtyrjen e konsullit grek e jo për tjetër shkak, edhè se këtë të keqe e bëri konsulli Grek për të marrë shpagim për vrasjen e dhespotit të Korçës Fotit, si thashë më sipër. Sa për Muç Qullin thoheshe se u vra për ato çnderime e diskreditime që kishte botuar të "Populli" kundra Malit të Zi.

Vrasja e këtyre të dy patriotëve të shënuar n'a bëri përshtypje të keqe, n'a çeli një plagë në zemër e n'a vuri në një frikë të madhe edhè filluam të ruheshim, tuke mos dalë jashtë.

Kështu mblidheshim në shtëpin' e Kristaq Zografit, i cili bënte profesionin e dentistit në Shkodër, edhè aty shkonim kohën, tuke biseduar, e tuke lojtur me letra.

Mjerisht një ditë n'a vijnë aty nj'a tre policmanë Malëzijosha bashkë me një faqezi detektif Shqiptar, një farë Hilmi Drishti, e n'a zunë si minjtë në kurth. N'a thonë të mos kemi frikë, se n'a kërkojnë vetëm për ca pyetje që do n'a bënin në Polici e jo për tjetër gjë. Né u pamë sy ndër sy dhe i kuptuam bukur ato pyetje.

Aty ishim gjith' embrat që kërkonte Policija, d. m. th. unë, Sotir Peci, Idhomenë Kosturi, Kristaq Zografi, Ilo Kotta dhe Hil Mossi, por mungonte akoma edhè Kostaq Kotta, i cili ndodheshe në shtëpi t'ime.

Policmanët insistonin t'a gjenin edhè atë, edhè unë ju thashë se munt të vete vetë t'a mar nga shtëpija. Ahere komiseri i policjotëve më thotë shko t'a marrish, po mos u vono se po presim këtu: Edhè unë ja mbajta pênë për në shtëpi e vinj e i thom K. Kottës se n'a prêt e zeza, se shokët i zunë të gjithë, po shpejt të mshihemi gjëkundi.

Me vrap lajmëruam gratë e shkojmë e mshihemi në shtëpi të një miku që quhej Ago Mema. Ajy n'a përcolli ne një tjetër mik në një lagje të larkme të Shkodrës, ku s'i binte ndër ment as njeriut. Ishim aty të sigurtë.

Policija ardhi e kërkoj në shtëpinë t'onë, po s'n'a gjeti. Kështu të nesërmen që me natë të gjithë këta shokët t'onë që përmënda përsipër i nisnë për në Podgoricë bashkë me Shkodranët nacionalista Luigj Gurakuqin, Filip Krajën, Ndrek Kiçin, Zef Kurtin, Luigj Kodhelin e disa të tjerë, gjithsejt 22 shpirt.

T'a lemë ç'pësuan këta të shkretë në Podgoricë, e si mezi shpëtuan nga vdekja se i dënuan e do t'i shkonin në plump edhè si vajti me fuqi Isa Boletini t'i shpëtojë edhè pernjiment i shpëtoj, po ra i vdekur ajy me disa trima të tjerë Kosovarë.

Ne këtej që mbetmë në Shkodër ishim shumë keq. Përveç që ishim të mshehur e s'kuxonim të delnim jashtë, po ishim edhè pa një dyshkë në xhep edhè kishim 3-4 ditt që ushqeheshim vetëm me lakra shumë herë edhè të pakripura, se s'kishim as të holla për kripë! Ishim edhè të sëmurë.

Në atë agonì të madhe e të pashoqtë, në atë dëshprim të tmershëm e mizor shumë herë u mendova të vras vehten, ose t'i vè bombën shtëpisë e të ngrihemshim të gjithë në erë, të shpëtonim një her' e mirë, se sa të rronim në atë të keqe, në atë mjerim!

Nga ana tjetër filluan të fluturojnë mbi nè edhè aeroplanat ushtarake t' Austrisë dhe me bombën e parë që hodhë më 7 dhjetor 1916 vranë të motrën e prof. Gasper Mikelit, një zojushe 20 vjetsare të fejuar.

Mbi gjithë hallet që n'a ranë mbi krye, bash me këtë bombën e parë që u vrà ajo goca, ime kunatë Angjeliqija, e shoq' e K. Kottës lindi një çupë, që ja vume embrin "Teftë"

Aeroplanat po vijnin dendur. Tmer i math i kishte përfshirë të gjithë e s'dijnin ku të fshiheshin.

Të nesërmen u duknë nj'a 4 aeroplanë dhe dy prej atyre hodhë 2 gjyle të mbëdha afër konakut madhështor të Prefekturës, ku u vranë mizorisht 57 e ca oficera, ushtarë e Policjotë Malezijas, bashkë edhè me komandantin e Gjendarmerisë e Drejtorin e Policisë.

Copra këmbësh e duarsh, kokësh e trush, mushkërish e zorësh u shpërndanë mbi çatitë, mbi shelgjet e mbi rrugët. Tri-katër shtëpija u shempnë prej themelesh. Një zë vaji, një ulërim i pikëllushëm jehonte në atmosferë! Paniku i tmeruar i përfshiu të gjithë. S'dijnim ku të futeshim! Unë isha i sëmurë në shtëpi dhe fëmija më linin vetëm mbi krevatin t'em, tuke shkuar në qilar për t'u mbrojtur.

S'kish ditë të mos n'a vizitonin aeroplanat e të mos lijnin viktima e shtëpi të çkatëruara krejt, ose të shembura. N'a panë shumë mjerime të mbëdha sytë!

Dikur shëkonim prej dritareve edhè duela të shpeshta që bëheshin më erë midis aeroplanave Austro-hungaro-gjermanë dhe atyrve të Frëngjeve, Englezëve e Serbëve që kishin në Shkodër, po pa ndonjë rrezik, se gjithkush dinte t'a ruante vehten edhè qëllonin njëri-tjetrin që për së largu.

Tmeri më i math ishte kur aeroplanet n'a vizitonin natën. Me urdhër të Prefekturës gjithë dritat e qytetit ishin shojtur, po prap se prapë aeroplanat që së sipërmi nuk ndaheshin pa lënë edhe nga ndonjë viktim, ose dëm tjetër!

Po të gjithë, si do kudo do t'i duronim, po halli i bukës si bëhej? Lè ne të mbëdhenjtë agjeronim, edhè nga ndonjë herë, po të vegjlit që s'duronin dot, që u kishte hipur një oreks që s'munt të rëfehet?

Këjo problemë e bukës më tmeronte! Faza e vdekjes eventuale nga urija nuk më hiqej nga menda! Si të bënja? Ku të përpiqnja kokën? Kujt t'ja qanja hallin? Kush munt të n'a mëshironte? Lè pastaj që kishim mbetur edhè pa roba! Me fjalë të tjera "bir, Selman i nënës ç'të të qanj më parë"! Më keq s'kishte ku të shkonte!

Çudi bënja me baxhanakun t'em Kostaq Kotta. Më flegmatik njeri, më apathik, më stojik nuk kam parë! Ajy s'e çante kokën për kurgjë; edhè me të vërtet, 8 vjet që bashkëjetova me atë kurrë ndo një herë s'e pashë të vrasë mëndjen për ndo një punë, ose të përkujdeset për të nesërmen. Sa herë që i kisha thënë se si do bëheshe ky halli jonë kështu, ajy më përgjigjeshe stereotypikisht se "ka Perëndija"!

Një natë gati ment prishesha menç së menduari. S'kam fjetur gjithë natën; isha edhè i sëmurë akoma. Si të bënj? Ku të vete? Kujt t'i kërkonj hua? Mbi gjithë hallet kishim nevojë edhè për ca kuino[1], po edhè për këtë s'kishin parà, as që n'a jepnin veresije!

Me ra ndër ment se në Shkodër ndodheshe Mister Lampi, një plak i mirë Engles, i cili tjetër herë ishte një nga kontrollet internacionalë në Vlorë e më deshte e më estimonte fort, se

[1] kuino = ndoshta bëhet fjalë për quinin (kinina është ilaç kundra malarjes H. K.)

më kish provuar në shumë çështje, e sidomos në çështjen e komplotit të Beqir Grebenesë, për të cilin kam bërë fjalë tjetër herë.

Sado që isha i sëmurë u mendova t'i bënj një vizitë. Ishte shumë shpirt mirë. Të nesërmen u mshtolla mirë e me gjysmë shpirti shkova në villën e Lord Pazey'it, te Sahati i Inglizit, që e kisha afër shtëpisë s'ime, ku ndodheshe edhè Mr. Lampi.

Posa u anoncova, më futi kavazi[1] brenda në një sallë dhe pas pak minutash ardhi në sallë Mr. Lampi. Më përshëndoshi e më njohti, tuke kujtuar të shkuarat e Vlorës. Më tha si po ndodhem këtu edhè qëndrova e ja tregova anglisht të gjitha mjerimet t'ona, e sidomos këto të fundit që ishin të sëmurë e që kishin mbetur pa bukë kaqe shpirt!

Më vuri rè mirë e e pashë se i ardhi keq.

Dolli e më la vetëm edhè kthehet pas pakut e më jep një kuti me 1. 000 kokra kuino hollandeze, një shishe me tenturë d'iode, disa tuba aspirinash edhe 1 napoleon. Na këto, hë për hë, tha edhè nesër do t'ju dërgonj në shtëpi ca sende të tjera ushqimi, edhè mos u dëshpëroni se ka Perëndija, dhe sa herë të kini nevojë ejani këtu.

M'u duk sikur u ringjalla. Nuk dinja si t' falenderonja. I shtërngova fort të dy duart e tij edhè më vinte t'a shtërngonja me gjithë fuqinë t'ime në krahrorët e mija!

Ika me sŷtë plot me lott, tuke e falenderuar fort e fort dhe më s'pashë si dolla q'andej. Me të shpejtë shkova e bleva një këmbë të tërë mish dashi, nj'a 3 çyrekë bukë që kishim 2 javë t'a shëkonim me sy, si dhe disa pemë e embëlsira e u ktheva si blet' e plotë në shtëpi.

Kur më panë gratë e fëmija m'u hodhë për qafe e qanin tok nga gëzimi. Vetëm Kostaq Kotta s'u kthell, as u vrejt, po mjaftoj me frazën stereotipe të përditshme: a e pè kur të thom unë se "ka Perëndija? më tha Ç'i paguan pastaj këtij njeriu?

Të nesërmen nga dreka herë qëndron përpara portës t'onë i ati i Hil Mosit, që ish kavas në konsullatën Inglese në Shkodër, me një kalë të ngarkuar më një anë me një denk (thes) mjelli me 3 zero, d. m. th. nga më i miri edhè me dy kasa vajguri që kishin brenda ndo 20 copë teneqe të mbëdha me qumësht "Nestle", nj'a 20 okë oris, 20 okë patate, ndo 100 galeta e peksimadhe, nj'a 5 kilo sheqer, 3 qillo kafe etj. etj. Duhet shënuar këtu që kishim më shumë se një muaj që ja kishim harruar erën kafesë!

I at' i Hil Mosit më dhà edhè një letër, që ishte e Mr. Lampit, i cili më uronte t' hanim ato me shëndet, se Zoti ishte i math!

A ka si tregohet me pendë ky gëzim? Ahere për të parën herë e pashë K. Kottën të derdhe 2 lott nga sytë, tuke përseritur frazën : e pè se ka Perëndìjë?

Desh Zoti e zumë të hanim bukë gruri më në funt, se ishim kaqe fort të dëshëruar.

Kur bëmë bukën e parë në një tepsi të thellë edhè kur e muarm nga furra për në shtëpi, i pari furxhiu, pa pyetur as mua, preu një koxha copë e e përvetoj! po shembullin e tij e imituan edhe disa grà të tjera, që s'kishin parë bukë me sy prej kohësh, më keq se né! Kështu kur e muarm bukën nga furra s'kishte mbetur përveç se një e treta e bukës.

Shkuam mirë disa kohë si me bukë, si me ilaçe e gjerra të tjera dhe i harruam pak sikletet. Mirpo edhè buka edhe të hollat dikur soseshin një ditë, mbassi s'kishim ndo një punë në dorë.

Një dit vezhgëllova mirë edhè pashë se kishim mbetur me nj'a 5-6 okë mjell dhe me 5 grosh turke në xhep. Sigurisht pas një jave do fillonim prapë të agjeronim. Edhè i them edhè një herë K. Kottës : orè, akoma një çereçkë kemi, si do t'i bëhet halli? – "Ka Perëndija" më thotë, mos u sëkëlldis se prapë çe ku do të shkrepë, Nga? i thom. Unë tani s'kam as pikën e shpresës se edhè bamirësi jonë Mr. Lampi kishte shkuar në Angli. More, "ka Perëndija më thotë, mos u sëkëlldis, një herë do vdesim". Ç't'i thuash?

[1] kavazi = roja (H. K.)

Kur më tha gruaja një natë se s'kemi bukë tjetër, më ra tambllaja! Nesër d. m. th. do gdhiheshim pa bukë! Vaj halli! Lamë 1/2 çyreku për fëmijën, që s'duronte pa bukë, edhè nè të tjerët shtërnguam barkun, se do t'ju përvisheshim prapë lakrave e barrishtavet!

Atë natë s'kam fjetur fare. Ment u prisha menç nga meraku. Përkundrazi K. Kotta kishte fjetur si shqerë:

U lava shpejt posa u gdhi, edhè sado që isha i rackapitur pa gjumë, shkova në një kafehane të pinja një kafe veresije, se s'kisha as metalik.

Kur po pinja kafenë pashë një shkodran mik me nj'a dy oficerë englezë, po shkonin nga Gjuhadoli e vijshin në lagjen e Seregjit. E ndalova pak t'a përshendosh e i thom ç'punë ka me ata oficera Englezë që po shetit? Më thotë se janë adjutantët e gjenerall Filippsit, që tash shpejt ishte emëruar komandant i fuqive internacionale të qarkut Shkodrës. Po ti, i thom, ç'punë kè me këta? Unë, thotë jam dragoman i këtyre këtu në Shkodër.

Si u ndamë me mikun t'em, me një herë më shkoj ndër ment embri i gjenerall Filippsit. Me gjithë që s'e njihnja personalisht, më ranë ndërment disa sherbime që i kisha bërë, kur isha kryetar i Gjyqit Shkallës së I-rë në Vlorë. Ahere gjenerall Filippsi ishte në Durrës dhe mbas një korespondence anglisht që patmë ca kohë, i kisha dërguar një dragoman në Durrës edhè ishte i kënaqur fort. Një herë tjetër më kërkoj disa informata mbi legjendat e folklorit t'ona dhe i kisha dërguar ndonja 10 kollë[1] shkrime, për të cilat më dërgoj 10 lira engleze, po ja ktheva prapë, tuke i thënë se ja bëra miqësisht, mbassi tregonte aqe interesë aktive për kombin t'onë, gjë që i kishte bërë shumë përshtypje të mirë.

Tani pra, ishte rasti t'a njihnja edhè personalisht, dhe kisha një farë shprese se munt të më ndihmonte gjë, mbassi isha aqe nevojtar. Edhè tuke dijtur adresën e tij, si mbas informimit të mikut t'em që përmenda përsipër, u nisa drejt për në shtëpinë, ose pallatin e bukur të Ndoc Çobës, ku rinte Filippsi me gjithë suitën e tij.

Ora do ishte 9 para dreket.

Një ushtarit që rinte te dera i anoncova anglisht embër-mbiemërin t'em, i thashë se dëshironja të takonja gjenerallin edhè i dhashë një kartë-vizitë prej atyre të Vlorës kur isha kryetar i Gjyqit, prej të cilave më ndodheshin në portofol. Ushtari u ngjit sipër edhè me një herë zbret përposh e më thotë : urdhroni se ju pret gjeneralli:

Ngjitem lart e trokas në derën e gjenerallit. Një zë burrnor u dëgjue me një herë: "Comm in". Hyra brenda. Gjeneralli më priti më këmbë:Hallow, Mister Floki, you wellcomen! E zura për dore dhe më pëlqeu fort fytyra e tij madhështore. Më tha se është gëzuar që më njihte edhè personalisht dhe më falenderoj edhè një herë për shërbimet që i pata bërë.

Më pyeti pastaj si ndodhem në Shkodër, edhè në vazhdonj të jem akoma kryetar Gjyqi. Unë psherëtita ahere thellë e fillova e ja kallzonj çështjen që me pè e me gjilpërë, tue përshkrue gjendjen t'onë të mjerueshme me ngjyrat më të zeza.

Gjeneralli hunji kokën e zu mendohej. Doni një çaj? më thotë? Lè të pimë nga nja çaj. Dhe porositi çaj e biskota.

Si pimë çajet më thotë gjeneralli : Më vjen shumë keq për pësimet t'uaja, po bëni gajiret, mos e hupni shpresën. Dhe në ato fjal' e sipër më thotë : jam gati të bënj ç'të më thoni, ju lutem si munt t'ju dukem i dobishëm?

Unë mora pak frymë e i thom, se isha gati t'i shërbenja makar si një dragoman. Dragoman? Thotë. Ti një kryetar Gjyqi, një universitar me diplomë, do të

përulesh gjer në atë shkallë? Ç' të bënj, excellence? I thom. A munt t'a lè fëmijën të vdesë për bukë? Puna s'është turp ç'farë do qoftë! Kè të drejtë thotë. Kè shumë të drejtë. Edhè për të më ngushëlluar më tregoj edh' ajy disa peripecit' e tij, që kish mbetur disa herë pa punë e pa bukë e më tha se është në gjëndje të peshojë mjerimin t'em. I bije me një herë ziles dhe vjen një ushtar tjetër. Gjeneralli e urdhron t'i thresë një farë kapitan Lack.

[1] kollë = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalorët e mij, por kuptimi mund të jetë "koli", pra, pako, dosje (H. K.)

Për pak u duk kapitan Lacku, një djalë 27-28 vjetsh, i hollë e i gjattë e mjaft i hijeshim. Shik! I thotë gjeneralli : kemi nevojë për ndonjë dragoman? Edh' ndërkohë më rekomandon te ajy, tuke i thënë mjaft fjalë të mira për mua. I përgjigjet kapitan Lacku se "nuk ka nevojë shërbimi për ndonjë dragoman. Le të mos ketë, thotë gjeneralli. Duhet të gjejmë një vent për këtë mikun t'em, Mr. Flokin.

Kapitan Lacku mendohet andej, mendohet këtej edhè më në funt i përgjigjet se, vetëm në Vlorë munt të më dërgojmë, po të dëshëronj.

Unë mezì e prita atë lajmë edhè desha edhè vetë të vinja në Vlorë ku kisha edhè kunatën t'ime Marigonë, dhe ku, me këtë shkak do të tërhiqnja edhè fëmijën t'ime e të hithnim gur mbi Shkodrën e nëmur, ku vojtmë kaqe shumë.

Hë, më thotë gjeneralli, si thoni? E granoni? Në e pranoj? Thom. Me gjithë zembër, e ju faleminderit fort e fort.

I kthehet pastaj kapitan Lackut : Hë, kapitan? I thotë. Sa rrogë mujore do t'i japim zotit Floqi? Gjer më gjashtë lira Engleze, thotë kapitani. Pak janë, ja prêt gjeneralli. Për z. Floqin vëjani 8. All right! I përgjigjet z. Lack. Hë, i thotë prapë Filippsi? jepi një rrogë përpara tani.

Me të shpejtë kapitan Lacku nxjer një qeskë të vogël e më numuron 8 lira Engleze që shkrepëtinin. Kur i pashë në dorë, m'u duk se isha në ëndër. Po fërkonja sytë edhè s'besonja akoma të ish e vërtetë. I falënderova shumë, dhe kur do të shkonja, më tha kap. Llaku se brenda 3 ditve duhet të jem gati se do niseshim me një skuadril aeroplanash lufte për Vlorë.

Më s'pashë si ika q'andej. Ment u bëra copë, tuke zbritur nga shkallët. Vajta në shtëpi plot gëzim. Më njoftin me një herë në shtëpi se më qeshnin edhè thembrat e këmbëvet!

U gëzuan fort të shtëpisë, se mezi më panë një herë të kthellët, pas atë melankolì të madhe që kisha. Iu tregonj shpejt e shpejt sihariqin dhe nxjerr të 8 lirat engleze e ja lëshonj përpara. Nuk rëfehet ajy gëzim. Nuk përshkruhet lehtazi. Po kur ju thashë se do nisesha për në Vlorë, e para ime shoqe këceu nga vendi : Si, thotë, do ndahesh nga né? Ku do n'a lesh kështu vetëm si qyqet?

Dhashë mora t'a bint nuk ish e mundur. S'i mbusheshe mendja ; filloj të qanjë. Më së fundi mezì e qetsova, tuke i thënë do t'i lutesha gjenerallit të më mbante të paktën në distriktin e Shkodrës. Prandaj, mbas dreket i bëra tjetër vizitë gjenerall Filippsit, e i tregova ç'ngjau në shtëpinë t'ime. Ajy nënqeshi pak edhè e thiri edhè një herë kapitanin Lack dhe mbassi ndruan disa fjalë mes tyre, mbetnë d'akord që të qëndronj në Lesh, ku kishin fortesat e tyre luftarake, e ku ndodheshin ndo 25 e sa oficerë Englezë dhe gjithë fuqija tjetër Malëzijase.

Atë ditë rà një shì me stomna. Ishte Dhjetor i vitit 1916 në mbarim, dhe që të vete e të vinj të dytën herë te Gjenerall Filippsi u bëra qull, sa kur ardha në shtëpi më zunë një palë hethe të forta që pas 2 ditësh m'u çfaq një pneumoni e fortë.

Tjetër hall ky! U shtrova mirë në krevat me të dhembura të mëdha. Po ç'munt të bënja kur më zuri halli?

Mbas 3 ditsh, tamam ditën e caktuar, vjen kapitan Llaku në shtëpi t'ime që të më marrë të hikim, po kur pa se në ç'gradë isha sëmurë, më uroj shërim të shpejtë dhe shkoj.

Vojta një javë mjaft, po shpëtova nga rreziku.

Pas një jave më vjen prapë kapitan Lacku të më marrë, po unë nuk isha në gjëndje. Më tha se ajy po shkonte për në Lesh, e posa që të çohesha nga krevati të nisesha ca më parë për atjè.

Për fat të keq, dy ditt më vonë më vjen në mëngjes herët një tjetër kapitan engles, Blücher, një njeri nopran e i mprapshtë me dy kuaj âtër, e me një ushtar, që quhej Edgard. Më thotë se duhet të nisem shpejt e shpejt, se ashtu ishte puna. Aman, i thom, jam i sëmurë e s'munden të qëndronj dot në kalë. Qëndron, s'qëndron, thotë duhet të nisesh, ndryshe të n'a kthesh të 8 lirat engleze, që more përpara!

Medet! Tambllà të më kishte rënë nuk do më vriste kaqe, sa më vranë fjalët e tija! S'dinja si të bënja, po as të hollat s'munt t'ja ktheja, se vaj halli me nè pastaj.

Si e pashë se s'bëheshe ndryshe, mblodha vehten e u ngrita nga shtrati. Në qafë më paç, i thom, mua e fëmijën, në qoftë se pësonj gjë! U mvesha, u mshtolla pak edhè me gjithë që s'qëndronja dot më këmbë, i hipa kalit me mundim të math e u nisa i dëshpëruar në mes të lotte që derthnin fëmija ime. Kësaj i thonë "kërcet prifti nga belaja"!

Nisemi dal nga dale nga Shkodra.

Posa kaluam Urën e Bahçellëkut, 4 aeroplana armiq u duknë në qiellin e Shkodrës dhe njera na qëndroj përsipër nesh, gati të lëshonte bombat infernale! Këmbanat zun' e buçasin tani nga Shkodra Nga kodrat e Bërdicës e të Beltojës ja filluan topat, tuke qëlluar këtë aeroplan, i cili nuk vonoj të hedhë një gjyle kolosale. Oh, s'përshkruhet dot ajy tmer! Bomba bije mbi ca shatore Serbe. Një ulërim, një vaj i math n'a përsëllon veshët! Nuk di sa u vranë atjè, me gjithë që kjo tragjeti çvillohej 2 kilometra lark nesh. Tymi i dheut edhè flaga e shatoreve e e pavijoneve Serbe po çoheshin përpjetë? ! Një tmer i math n'a kapi. Si të bënim?

I them ushtarit Edgard të kthehemi prapë, po ajy s'dëgjon kurrsesì. Nuk shkuan 5 minuta, tjetër gjyle bije gati përpara nesh, 500 copa. Kali im u tremp e u hoth përpjetë, sa më rëzoj e më bëri copë. Rashë i zalisur në tokë e mezì me solli ndër ment ushtari engles. Valixat ishin këputur prej shalet e ishin përplasur për dhè.

Si u shpërnda tymi shoh një poterë të keqe. Dy nënoficerë Serbë ishin të coptuar, të vrarë; nj'a 5-6 të tjerë ishin të plagosur rëndë dhe njëri prej tyre, kur po e ngrihnim me Edgardin, n'a mbet i vdekur në duart t'ona! Mandej dy grà katundare ishin plagosur edh' ato rëndë; njera kishte humbur edhè syrin e djathtë, i cili po i kullonte! Më tepër se 20 kuaj ishin të vrarë, ose të plagosur rëndë, sa nuk çoheshin dot. Nuk rëfehet ç'n'a panë sytì atë ditë!

Mbledhim vehten edhè nisemi dal nga dalë me Edgardin dhe mezi harrimë pas dreke në Barbullush, që është gjysma e rrugës Shkodër-Lesh. Tani kishim për të ecur edhè gjysmën e rrugës tjetër edhè s'kish më shumë se 3 orë ditë akoma. Ish më të gdhirë Krëshndellat.

Edgardi më thotë të rijnë të çlodhemi, po kur kujtonja se do n'a zinte nata rrugës, edhè unë si i sëmurë do mos duronja dot të ftohtën, më hikte mendja. Që të mbeteshim atë natë në Barbullush s'kishin as ku të flemë, veç se përjashta, se 2-3 dhomat e hanit ishin okupuar me ushtarë e oficerë Serbë e Malëzijas, që shumica e tyre flinte në ahurët e kuajve!

I thom Edgardit të nisemi, po ajy si engles kokë-fortë, më thotë se ajy do rinte ndo një orë. Ahere unë vendosa të nisem vetë.

I hippa kalit edhè posa u largova pak nga hani, ja mbërtheva zengjitë pas mishit që të ecte pak. Kali, si ât i tërbuar që ishte, s'deshte t'i lutem më tepër. Ja fillon një revani e hikën si tren!

Këtu dua t'a përshkruanj hollë odhysenë t'ime, rrezikun e math në të cilin u gjenda pa dashur edhè poteren e madhe që më arth mbi krye, që jo një herë, po nj'a katër herë, po thua, e pashë vdekjen me sy!

Kali, si mori sulmin, nuk mbaheshe dot ; hikte link si kalë kursi! Un' e pashë vehten keq, edhè sa do që isha i sëmurë, bëra një kurajo të madhe dhe e përfshiva kalin pas qafe, tuke e shtërnguar fort, se ndryshe kush e di sa herë do më kishte përplasur në tokë, dhe sa do që rruga ishte e prishur e e shkatërruar dhe mbushur gjithë gjatsin' e saj me kërma kuajsh të ngordhur dhe mbante erë të keqe e të padurueshme, kali im s'ndalesh aspak!

Sulmin e parë e vazhdoj më shumë se 15 kilometra brenda gjysëm oret! Për një njeri që ka kaluar nga ajo rrugë mjafton të përment se prej Barbullushit harrimë afër malit të Kakarriqit brenda 25-30 minutave. Aty e ndaloj kali hovin e parë, me gjithë që u përpoqa sa herë t'a qëndronja. Kur pushoj së renduri, e kur pashë se zu të ecë si n'atë kohë që u nismë, d. m. th. ngadalë mora pak frymë dhe pashë se isha qull ne dijersë, me gjithë që duhet të isha tharë së ftohti me atë të ftohtë që kishte atmosfera. Po duket se nga përpjekjet e mija e nga agonija e patreguar isha lodhur fort e isha djersur.

Mirë po nata po afrohej. Ora do t' ishte 3 e 1/2 pas dite, kur se më 4 e 1/2 perëndonte Dielli e fillonte nata. Si të bënja, pra? Duhej me doemos të hynja në Lesh pa ardhur nata, ndryshe isha i fikur, se do binja në dyshek e do mos ngrihesha kurrë!

E mblodha edhè një herë vehten. Kisha zbritur edhè me një mijë belà mezi i hipa edhe një herë kalit. E ngava në krye nga dalë e jo me nguljen e spirunëve, si ja kisha bërë në Barbullush.

Kali zu të ecë prapë me një revan të vogël, që eduronja mirë, po nuk kaluan 5 minuta edhè, pa ja shtërnguar aspak frenat, mori një vrulë të re, të rrebët, i cili sa po vinte rrebtësoheshe edhè më tepër gjer sa kaloj shumë sulmin e parë të Barbullushit!

Këtë radhë e kisha shumë hollë! E pashë se 100% do më coptonte kali, se bënte si i harbuar. Kush e di sa herë u anova të rëzohesha, edhè kush e di saherë u përmbajta. Si s'rashë, si shpëtova ishte mrekulli. Kalin s'e mbanja dot. Ajy do e mos t'a zinte Leshin ca më shpejt, si e pashë, edhè s'ishte e mundur ta ndalesha me asnjë mënyrë.

Ishim afër kishës së Kakariqit. Dallonja një far' hendeku, të cilit po i afroheshim. Kujtova se aty do ndaloheshe kali, po ku? Nuk shkoj shumë edhè ju afruam hendekut. U mundova me gjithë fuqinë t'a ndal, po s'ishte e mundur ; kali s'e qendronte aspak hovin. Ishim në rrezik të math, rrezik coptimi! Me një herë i afrohemi hendekut ; shoh se ishte një hendek 3-4 metrosh i gjërë dhe e pashë se nuk do t'a kalonte dot! Po kali nuk trembet. Posa afrohet në buzën e hendekut e pashë që desh t'a kapërcejë ; u shtërngova fort pas qafës së tij, mbylla sytë dhe me mëndje thashë : O Zot shpëtona! Kali u hoth përtej, po kaqe më tronditi sa thashë se m'u thyen dhëmbët! Hapa sytë dhe i ngrita në Qiell, tuke falenderuar Zotin që n'a shpëtoj!

Desh Zoti e kalova edhè këtë rrezik, që s'pandeha të dal i gjallë q'andej. E pashë vdekjen me sy, po me gjithë këtë vujtje kurajon s'e humbaas një herë.

Harrova se isha posa ngritur nga shtrati ; harrova se isha i sëmurë keq. Ç' është nga ndo një herë edhè kjo ndjenja e vetëmbajtjes se njeriut! Pak të kisha humbur kurajon, pak të më kishte lënë zembra, isha i humbur ; sot do mos kisha fatin t'a përshkruanja këtë histori kaqe të hidhur, që do t'ja rëfenj varrit!

Tani u tëherë moti. Shoh për së largu një vark dritash edhè kuptonj se po i afrohem Leshit, nga i cili n'a ndajnë vetëm nja dy kilometra. Kali tani e kish rregulluar ecjen dhe po shkonte nga dalë. E shëkonja e më vinte t'a mbyt për sa të këqija më bëri, po kur kujtonja se gjith' ajo e ecur e marrë e gjithë ato rreziqe ishin për të mirën t'ime, se po të mos rendtë ashtu kali, një Zot e dinte se kur do vijnim në Lesh, edhè a do vijnim gjallë, apo jo, zura ta sympathizonj kalin e urgjisur edhè kush e di sa herë u unja e e putha në ballë!

Dha Zoti e hyjmë në Lesh, me gjithë që, tuke kaluar urrën e drunjtë e të shkatëruar të Drinit, që bashkon Leshin me bregun tjetër, shqamë disa herë, edhè disa herë futeshe kali në vërrat e hapura të urrës, ku njëra thundër, ku tjetra.

Në Lesh ja mbajta drejt te dyqani i një mikut t'em, Epaminonda Çilit, i cili ishte prej vitesh installuar familisht. Kaqe isha i lodhur sa nuk zbrisnja dot prej kalit edhè me zor më zbriti Epaminonda.

Po aty mora vesh se grupi i Englezëve nuk ishte në Lesh, po m'at'anë Leshit, në një kishë të vjetër katolike. Sa keq për mua që do t'i hipnja edhè një herë kalit për ndo 20 minuta edhè sidomos natën.

Qëndrova gati ndo një orë të çlodhem edhè hyra në dyqanin e tij që ish bakallhane e pijetore. Epaminonda më dhà nj'a 2 konjake të mira, që i piva me një herë, pa kuptuar gjë. Po i ati i Epaminondës, xha-Sotiri, i cili s'më njihte mua, kujtoj se po ja zura konakun edhè do flinja atjè. Prandaj s'ju durua, po i foli Epaminondës greqisht që bëj si bëj jepi udhët këtij, se mos na zerë këndin. Un' e dëgjova, po bëra si kur s'kuptova se ç'tha. Ahere Epaminonda e mori më nj'anë të jatin dhe i hoqi vërejtjen. Kthehet e më thotë mua, se kalin do ta çonte në

han edhè unë do të flinja atë natë në shtëpi të tij. E falenderova fort e i thashë se unë duhet të vinja ne Englezët, prandaj ju luta të më përcillte gjer m'atë anë të rrugës.

I hippa kalit edhè një herë edhè me një vështirësi të madhe mezi munda të ngjit të përpjetën gjer sa u sosa në kishën e vjetër, ku ishte edhè një kuvent, ose manastir katholik.

Ora ish 2 i natës. Bërtita një herë posa hyra anglisht dhe më duall nj'a 2 ushtarë. Kërkova kapitan Lackun, tuke qenë hipur akoma. Një kallaballëk i math ishte në avullin[1]' e këtij monasteri, ku disa Serbë e Malëzias piqnin në hell disa derra, pse të nesërmen gdhiheshin Krishndellat:

Kapitan Lacku dolli jashtë e kur më pa në atë hall, si zembër-mirë që ish, më qërtoj pse u nisa i sëmurë në këtë udhëtim. I thashë se më shtërngoj kapitan Blücheri dhe kap. Lacku u hidhërua fort i ngrati e zu e shante Blücherin si barbar e çnjerzor!

Më zbriti vetë prej kalit e më mori në një sallë të madhe, tuke më rekomanduar në nj'a 20 e ca oficerë Englezë që ndodheshin në sallë. Qëndova e ja tregova Lackut gjithë peripetinë t'ime e u çudit si ardha i gjallë gjer në Lesh. Por i vinte keq se s' kish se ku të më vinte të flinja, se gjith oficerët flinin kush mbi karrigat, kush mbi shalat e kuajve e kush mbi nj'a dy tavolina të gjatta. Krevat s'kishte as një!

Në atë kohë u duk në sallë ajy miku jem dragoman shkodran i Englezëve, që kisha pjekur më parë në Shkodrë, kur më bëri fjalë për gjenerall Filippsin, e që quhej Toni Trifuni, i cili më von, kur u martua më bëri kumbarë. Ky, posa më pà, më tha të zbres poshtë në ahurin e kuajve, ku kam zjar boll e ku do shkonj mirë se kishim shoqëri. U ngrita e shkova me Trifunin, dhe në krye, posa hymë në ahur, më përsëlloj hundët një her' e keqe, po pastaj u msuash edhè zura vent afër zjarit, po isha shumë ngushtë sa s'kisha ku të shtrinja këmbët. Më suall një ponç të mirë edhè një shishe me wisky të Anglisë, që i piva me një herë.

Si ndenja pak më mori gjumi. Por hoqa një hethe aqe të madhe atë natë, sa thashë se kapërceva. Se si u gdhiva i gjallë as unë s'di!

Ushtari Edgard që më shoqëronte në atë udhëtim të keq e të paharruar, ka mundur të vinjë në monaster pas mezit natës. Ajy dijti se ç'vojti gjithë natën prej të ftohtit, si më tregonte të nesërmet.

Ndenja nj'a dy ditt i sëmurë në atë ahur, ku, i shkreti kapitan Llaku më kishte kujdes e më shërbente si ndonjë vëlla.

Ditën e tretë më vjen një gjendarmë nga Leshi, i dërguar prej mikut t'em kolonel Ali Fehmi Kosturit, i cili ndodheshe Prefekt i Leshit me rethinat, dhe me të cilin njiheshim që në Bihlisht, ku ishte komandant ushtrije e ku unë kisha ndejtë disa ditt pranë atij me detyrë. Ky, posa mori vesh se jam m'atë anë të Drinit me Englezët edhe i sëmurë, pat mirësinë të më ftojë atjè pranë tij.

Iu fala nderit fort gjendarmit dhe i kërkova lejen kapitan Llakut, i cili m'a dha me gjithë qejf, e kështu, i sëmurë e i vrarë nga trupi, si isha, u nisa me një kalë e ardha në Lesh te Ali Fehmi beu, i cili më priti shumë mirë e më dha një odë të veçantë me një krevat të mirë. Në atë dhomë, në tjetër krevat finte edhè segretari i tij Xhevdet Mehqemeja, një djalë shumë i mirë e i zgjuar, me të cilin shkova nja javë shumë të mirë e u shërova.

I gjori kapitan Llaku – Zoti e faltë - vinte më shëkonte për dita e më sillte lëmonj, portokaj, çaj, wisky, qumësht "Nestle" e ç'tjetër munte!

Një ditë më thotë Prefekti Ali Fehmiu, se i kishte shkruar për mua Essad Pashës në Durrës, i cili ishte kthyer prapë në Shqipëri dhe kish formuar një qeveri më vehte, një Shqipëri të vogël Essadjane, me kryeqytet Durrësin, tuke përdorur një farë flamuri të kuq me një hyll në mes, të cilin e pashë ndehur edhè mbi kalanë e Leshit edhè në konakun e Prefekturës. Essadi kishte thyer asi kohe rebelët, kishte mvarur nj'a 30 e sa prej syresh, midis

[1] avulli = oborr (K. F.)

të cilëve edhè të famshmit Musà Qazimin edhè Haxhi Qamilin, edhè kishte stabilizuar një qetsi të mjaftme.

I thashë Ali Fehmiut : ç'bëre që i shkrove për mua? Ajy po të dijë se jam këtu munt të kërkonj të më sjellë lidhur në Durrës edhè të më mvarë më së fundi, si nacionalist. Përkundrazi, më thotë Ali Fehmiu, ajy është kënaqur shumë se jam në Lesh, edhè e kish porositur Ali Fehminë të më niste ca më parë për në Durrës, se do më kishte sekretarin e tij të veçantë! Folë mirë, i thom. Unë segretari i Essad Pashës? Unë që e kam luftuar me gazetë qysh në Vlorë e që s'kam dashur t'ja shoh fytyrën kurrë? Dëgjomë mua, thotë Ali Fehmiu se do shkosh mire atjè. Jam gati të të jap edhè nj'a 15 lira turke në dorë t'i kesh për shpenzime dhe nisu kur të jesh gati. I thom, është e pamundur e mos më merr më qafë, se un' e di se ç'më pret po t'i bije në dorë Essadit! S'është çudi, i thom, të kem fatin e avokat Nexhudi Libohovës, i cili edh' ajy sekretar i tij ishte, po një natë të mirë e futi në një thes edhè e vrau me kopaçe! Atij mirë ja bëri, thot' Ali Fehmiu, po zotrote s'jè shoku i tij. Ajy e tradhtoj keq, po nuk do t'a tradhëtosh edhè ti: Aman, aman, i thom, këtë barrë mos m'a verë përsipër, se, sado që të më thuash, unë Essadit s'i zë besë! Dhe e mori Ali Fehmiu po s'më bindi dot. Si të duash, më tha unë së fundi, po ti po të më dëgjosh mua shko.

Nuk ish e mundur t'i binja në dorë unë Essad Pashës, se e dinja mirë me ç'sŷ n'a shëkonte né nacionalistëvet. Duhet të isha shoqi i Faik Konitzës, aventurierit e dallkaukut të pashoqtë, që të hunja[1] qafën e të rëzonja poshtë nderit siç rëzonte ajy, pastaj të muntnja të bashkëpunonjë me Essadin!

Kisha një dyshim akoma edhe nga Ali Fehmija, s'munt t'a fsheh dot, dhe kisha frikë se mos më niste edhè pa dashur për në Durrës që të më dorëzonte si cjapin ne kasapi, po pastaj e vura rè se Ali Fehmiu e bënte këtë nga miqësija e jo për tjetër gjë.

Ali Fehmiu, si e pa se nuk munt të vinja në Durrës hoqi dorë e s'më tha gjë tjetër. Po prapë më silleshe mirë, gjer sa ardhi dita të shkëputem nga Leshi dhe ja se sì :

Kapitan Llaku vjen një ditë në dhomën t'imë e më thotë se ajy po shkon me ngutësi në frontin e Monastirit kundra Germano-bullgarëve, tuke më thënë se munt të vonohet të kthehet në Lesh, me gjithë që s'ishte i sigurt se do kthehesh. Ju, më tha, munt të shkoni në Shkodër, mbassi unë s'jam këtu edhè shokët oficerë kanë një dragoman. Po, i them, po ahere sa për kaqe më muart? Jo, thotë, se ti vazhdon të jesh në shërbimin t'onë edhè që ku po të jap edhè një rrogë tjetër, që të mos kujtosh se të hoqmë nga puna, edhè qiti e më dha 8 lira engleze të tjera, që më ardhi sikur ma fali një kalà! E falenderova fort e më ardhi keq që u ndava prej atij farë burri kaqe të mirë.

I lè shëndet Ali Fehmi beut, e falenderonj tepër për mirëpritjen miqsore dhe kështu u nisa prej Leshit me këmbët e mija e shkova prapë në Grupin e Englezëvet.

Si hëngrëm drekë tok me oficerët Englezë, pashë që ata nguteshin tepër e po pregatiteshin. Pyeta nj'a dy ç'është shkaku, po njëri më thesh ndryshe e tjetri prapë ndryshe. E pashë që gjithkush evitonte të më tregonte të drejtën. Ahere mora me maryfet më nj'anë një toger Engles mik (pikërisht Amerikan) leutnant Spencer, të cilin e kisha njohur tjetër herë në New York të Amerikës dhe më von në Korçë, ku ishte në shërbimin e hollandezëvet e i lutem të më thotë ç'ngjet. Ajy më merr për krahu dhe dalim një shetitje jashtë në rrugë, ku me thotë konfidencialisht se kanë urdhër të shkojnë në Vlorë, sepse Austro-hungarët, mbassi zaptuan gjithë Malin e Zi kishin ardhur në malin Tarabosh të Shkodrës edhè brenda 2-3 ditve do të hynin në Shkodër! Po më tha mos të përhap ndonjë fjalë se s'e di njeri. Shtoj akoma se gjithë fuqit' internazionale të Entantës që ishin në Shkodër kishin marrë po atë urdhër edhè kështu kishin filluar t' a zbrazin Shkodrën.

Ky sihariq gazmor kaqe më enthusiasisi sa ment ju hodha për qafe Spenserit, po u përmbajta. Mjaftova t'i them se më vinte shumë keq. Edhe Spenser më tha që po të desha

[1] hunja = ulja (nga folja me ulë H. K.)

munt të nisesha me ata për në Vlorë. Po kapitan Llaku, i thashë, a din gjë? Si jo, më tha, e di si e di edhè unë, po ajy mori urdhër të niset për në front të Monastirit bashkë me trè aficerë të tjerë, të cilëvet më kallzoj embrat.

I them Spenserit se kam fëmijën në Shkodër e s'munt të ndahem nga ajo. Ahere më tha Spenseri të mos ri aspak në Lesh, se munt të hidheshin këtej urës së Drinit ushtrit e Essad Pashës e mos pësonja gjë si nacionalist e si armiku i tij. Po, që të kesh një kujtim prej meje, më thotë Spenseri, tani që po ndahemi e që s'dihet në do të piqemi më, do të të fal një pêlën t'ime, të cilën s'munt t'a marr me vehte se nè për dy orë nisemi me aeroplanat për në Vlorë. Iu fala shumë nderit mikut t'em Spenserit, i cili ishte një djalë shum' i mirë, prej shtëpije të mirë edhè tepër hovardâ, që kur se më falte pêlën kur se munt ta shishte e të merte paret.

Nkthehemi prapë në monaster, ju lashë shëndet oficerëve Englezë edhè me gëzim të math e të pa treguar i hipa pelës, tuke u përqafuar me Spencerin, i cili, përveç pelës e shalës extra të saj që më fali, më dha edhe një pagur të mirë plot me wisky.

Vinj përsërithi në Lesh, ku dëgjova haptazi për ritratën[1] e Englezëvet e të Serbo-Malaziajve të Leshit. Aty Epam Çili më këshilloj të thyenj të 8 lirat engleska që më dha i gjori kap. Llak, sepse në Lesh prisheshin për 150 dinarë copa, kurse në Shkodër s'prisheshin më tepër se 90 dinarë argjendi copa. Ishte një ferk i math këtu, një fitim kollosal për mua. Kjo mëndje më pëlqeu e kështu i theva e mbusha dy koxha qese me dinarë që s'kisha se ku t'i vinja, se ishin mjaft të rënda. Me gjith'ato i mora paq dhe e konsideronja vehten pasanik.

I hippa pêlës spenserijane, i lashë shëndet Epaminondës, i cili më përcolli gjer m'at'anë urrës së Drinit dhe u nisa tuke kënduar për në Shkodër, ku, gjith' ato nj'a 10 ditt që ndenja në Lesh shtëpija ime nuk dinte në isha i gjallë a i vdekur edhè ishte në një siklet shumë të math, aty edhè ajy Kostaq Kotta, i cili nuk sëkëlldiseshe kollaj, po këtë radhë e pa pisk, se po të humbisnja unë, ajy kishte humbur e vdekur më parë!

Nuk mbanj ment të kem udhëtuar më mirë tjetër se sa udhëtova këtë radhë me pêlën e Spenserit, e cila më solli aqe bukur në Shkodër. Po m'e madhja nga të gjitha ishte entusiasmi që ndjenja në zembër për ardhjen e Austriakëve, të cilët aqe fort i kishin dëshiruar e i prisnim si shpëtimtarët t'onë!

Kur më panë në shtëpi u vranë së qari, se ju pashë gati si i vdekur, si lipsan, me gjithë që mua më dukeshe si kur kisha fituar 20 kilo! Nuk rëfehet gëzimi i tyre që më panë edhè një herë në gjì të tyre, se me të vërtet nuk ishte shakà ajy udhëtim, të ngrihesh i sëmurë keq nga shtrati e të nisesh me kalë ât[2] për Lesh! Djali im i vetëm, i vogli Pirro m'u hoth për qafe e nuk më çqiteshe dot nga malli!

Një gëzim tjetër baras i math me gëzimin që panë ishte edhè ajy që ndjenë kur panë dy koxha-qese plot me dinarë sermi që me një dinar në Shkodrë mbushnje shtëpinë asokohet. Domethënë nuk sosi që u ktheva i gjall, po u ktheva edhè i ngarkuar me pare. Shakà i thonë të sjellë brenda dhjetë dit 1. 200 dinarë të argjenda? Kurbeti më kish ecur mirë, prandaj edhè K. Kotta m'a përsëriti për të qindtën herë :"A e pè, kur të thom unë se, ka Perëndija"?

Nj'a 2-3 ditt u çlodha mirë në shtëpi t'ime. I harruam me një herë taksiratet dhe kënga e ahengu gjëmonin nat' e ditë. Malëzijasit, sa do që ndodheshin akoma në Shkodër, nuk na ranë më në qafë, edhè aeroplanat pushuan së besdisuri. Shita edhè pelën nja 15 napolona, me gjithë që më ardhi shumë keq, por s'kisha ç't'a bënja, edhè kështu s'kish më i lumtur se mua!

Po lumërija më e madhe n'a ruheshe më von. Lumërija jon' e vërtet ishte ardhja e Austriakëve, për të cilën meriton të bënj pak fjalë këtu.

Ishte e 3-ta dit qysh që u ktheva prej Leshit. Një ditë e Premte, si e mbaj ment, dit' e shënuar për né, ditë shpëtimi, ishte më të ngrysur. Me burra, me grà ishim mbledhur në odën t'ime afër zjarit edhè po losnim me letra, kur dëgjojmë që po buçasin këmbanat ose kampanat e kathedraleve të Shkodrës, të gjitha, dhe dukej se tingëllimi i tyre ishte një sihariq gazmor.

[1] ritirata = tërheqje (H. K.)

[2] kalë ât = kalë i klasit të parë (njëri nga shumë kuptimet e kësaj fjale H. K.)

Pas kampanave filloj edhè krisma e pushkave, që po zbrazeshin me batarè, të cilat i shoqëronin mijra zërra enthusiastike që ngjiteshin në kupën e Qiellit.

I lemë letrat me një herë edhè i pari unë u mvesha e dolla jashtë të shoh se ç'ngjet. Kur dal në rrugën qëndrore te Post-telegrafit ç'të shoh? Turma plot njerës që këndonin këngë patriotike shqipe gegërishte e toskërishte dhe diku diku kumbonte si trumbetë zëri "Rrnoftë Shqypnija"!

Afrohem mbi një tufë shkodrane e ju thom : Ç'ka asht zâni, brè burra? Si, a s'e dijni ju? Ma pret dikush prej atyne? – Ç'farë, pafsh Zotin? Qysh, më thotë, a s'e dini se Austriakët ardhë në Berdicë edhè deklaruan qysh atjè Shqypnin' e lirë, e n'a porositnë të ngrehim gjithkah flamuret t'onë kombtarë? Si thè, si thè? i thom, edhè i kërcenj në qafë e e puth e qanj si fëmijë!

Nuk shkova disa çape dhe me një herë shoh mbi pallatin e Prefekturës të valonjë madhështorë flamuri jonë kombëtar, si edhè mbi ndërtesën e Bashkisë! Oh, sa gëzim të math që ndjeva, se isha kaqe i dëshëruar e i dëshpëruar!

Disa Shkodranë po mundoheshin të çmvarnin tabellat zyrtare të Malazezve prej Prefektureje prej Bashkisë edhè oficerët Malazezë, që kishin mbetur në Shkodër, jo vetëm nuk protestonin, po qëndronin stoikisht e i bënin sehir! Oh, ironi e fatit, si kthehet rrota!

Kthehem në shtëpi e ja u tregonj të gjitha. Heu! ç'u bë ahere! U dehmë të gjithë nga gazi. Kampanat e pushkët nuk prajnin. Entusiasmi jonë kaloj ç'do masë!

Të nesërmen në mëngjes komandanti Austriak Von Richter me 4 bataljona infanterije dhe me dy kompani artiljerije të rëndë hynte triumfalisht në Shkodër. Burra e grà i kishin dalë përpara dhe e pritnë si Mesiah-un! Muzika e Bashkisë edh' ajo filarmonika e shoqrisë "Bogdani" ju prinin përpara. Kampanat e pushkët vazhdojnë akoma. Populli gjendet në zenithin e enthusiasmit të tij! Një oficer Austriak, që e fliste shqipen mê mirë se né, hipën në krye të shkallës së prefekturës dhe n'a përshëndet Shqip në embër të Imperatorit Franz Jozefit, tuke n'a dekllaruar, se ushtritë e Monarqisë të Absburgëve nuk vijnë si gadhnimtarë[1], po si shpëtimtarë. Pason së foluri në një Shqipe të kjartë e të pagabueshme, se ata (Austriakët) n'a kanë dashur gjithënjë të mirën t'onë edhè në kohërat e para edhè tani dhe n'a lenë të lirë të stabilizojmë autoritetet t'ona dhe të përdorim gjuhën Shqipe si gjuhë zyrtare, gjë që s'n'a e akorduan okupuesit e parë Anglo-Italo-Francezë.

Fjalimi i tij enthusiastik u prit prej nesh me brohori të mbëdha e me duartrokitje të parreshtura. Qysh atë ditë filloj një periudhë e rè për né. Gjykatoret u restorasnë[2] me një herë me magjistratë shqiptarë e me gjuhë shqipe, edhè né avokatët filluam të punojmë dhe nga të gjithë unë i pari çela një zyrë avokatore në pjacën e Shkodrës, në midisin e Parrucës. E mbassi dinja edhè pak gjermanishten, fillova të shkruanj edhè lutje gjermanisht për autoritetet ushtarake Austro-hungare, dhe prej këtyre fitonja mjaft.

Në pak muaj më zjente xhepi më parà dhe fukarallëkun e harruam krejt! Në gjykatore s'kish ditë të mos kisha 7-8 davara, përveç kërkesave, kontratave, protestave etj. që bënja, prej të cilave fitonja pa masë. Brenda në vitin e parë u gjenda me 80. 000 e sa korona austriake edhè me një arkë fyshekësh mbushur plot me korona serme skarmuca, pasuni, d. m. th. të mjaftë për atë kohë.

Me gjithë që ishte shtrentësi e madhe, sepse harrin të përment që një okë kafè kishte 350 korona, një okë sheqer 80 korona e një okë mjell 30 korona, po unë ja kisha gjetur myrafetin, se isha njohur me disa oficerë të intedancës, e sidomos me hauptmannin (kapitenin) Rajakovich, i cili më nderonte shumë dhe kështu më futi pjestar në menazherin' e oficerëve dhe vazhdimisht m'a jepnin edhè mua kafenë si të tjerëvet, d. m. thënë korona 3. 80 kilogramin, sheqerin 1, 50, mjellin 0, 80 të koronës gjithkështu gjërrat e tjera të ushqimit. Me

[1] gadhnjimtar = fitimtar – pushtues (edhe në vepra të tjera K. Floqi e përdor këtë fjalë në kuptimin e pushtuesit H. K.)

[2] u restorasnë = u rivendosën(H. K.)

fjalë të tjera isha fort i lumtur, edhè këtë lumturinë t'ime s'e gëzonte ç'do kush. Harxhonja 150-180 korona në muaj, kurse fitonja 15-20. 000 korona në muaj!

Këjo lumuri vazhdoj gjer në vitin 1919, që u thyen të shkretët Austro-hungarezë dhe n'a hyjnë prapë Serbët, pastaj italjanët edhè më së fundi Frëngjët.

Me ardhjen e Austriakëve një tjetër lumëri n'a e shkrepi në shtëpi t'onë. Më fali Perëndija një çupë, si një engjëll që e qojtmë "Drita". Po mjerisht s'e gëzova të gjorën më shumë se 6 muaj edhè shkaktarë ishin doktorët e Shkodrës që nuk ja njohtën sëmundjen, gjer sa e futnë më këmbë e vdiq!

Me Austriakët shkuam shumë mirë. Kishim kinematografë, koncerta e theatre të tjerë. Zjente vendi në këng' e në ahenge dhe aspak nuk merreshe vesh se kishin luftë.

Ishin shumë të rrebët në detyrë, po edhè shumë të drejtë e të ndershim. Nuk ngrihnin sytë përpjetë të shëkonin grat' e botës, sikurse Francezët, që s'lanë gjë pa bërë në Shkodër, që edhè rrugëve zinin grat' e ndershme, edhè nëpër shtëpit' akoma ju futeshin.

Por ardhi dita që të thyheshe fronti i Bullgarisë, kështu që Francezët e Englezët u futnë në Bullgari e që andej në Rumani, pastaj në Hungari e në Austri edhè më së fundi edhè në Gjermani, gjer sa u mblodhë Fuqit e Entantës edhè bënë traktatin e famshëm të Versaillës, i cili i dha funt luftës.

Kur iknin Austro-Hungarët prej Shkodre me të vërtet n'a vinte keq për ata, se u suall gjithmonë mirë. Veç aty prishnë punën kur hodhë në erë me bomba, tuke hikur, urën e Bahçellëkut, urën e Bunës dhe urrën e madhe të Matit, si edhè atë të Shkumbinit. Po rregulli, disciplina, seriozita, pastrija e drejtësija që mbajtnë ata do mos harrohen kurrë!

Kur iknë Austrijakët unë ndodhesha me një kapital prej 180. 000 koronash austrijake, dhe kur ardhë Italjanët bëra nj'a 30. 000 lira italjane, tuke i kthyer për nga 150 korona te 100 liretat italjane. Të tjerat i mbajta se gjithkush theshte se nuk do binte korona, po u gënjyem të gjithë, sepse kur pas dy vjetsh kam vajtur në Wienë, prej 100. 000 koronave që kisha me vehte nuk zura veç se 8. 900 lira italiane.

Kur ardhë Francezët nuk kishim atë qetësi e atë rregull, si me Austrijakët. U duk që në krye puna, se bataljonet e para që hynë në Shkodër shumica ishin Algjerijane e Senegalezë, d. m. th. të zinj, ndonse kur kujtonim "Francezë" pandehnim se kush e di se ç'pullumba do shëkonim.

Komandanti i parë i tyre një farë Vantry, siç ishte msuar në Madagascar e në Guinèe, kujtoj se po është edhè Shqipërija ashtu edhè me Shqiptarët, po ranë jashtë, se vërtet një herë i dha urdhër qenit të tij të çvatë një Evgjit, s'di se për se, edhè qeni ju hodh e e coptoj sa çeç vdiq i ziu, po nga ana tjetër ky qeni i tij të nesërmen u gjent i ngordhur po prej Evgjitëve. Pra s'munt të bënte shakà as me Jevgj.

Shumë episodi të këtilla ngjanë në Shkodër në ditët e para që ardhë Francezët, prej të cilavet do përment këtu disa, nga ato më karakteristiket.

Një ditë dy ushtarë Senegalezë zunë në një rrugë qëndrorë të lagjes "Perash" një zonjë shkodrane të ndershme dhe me gjithë kundrështimet e bërtitjet ata e puthnë e e trazuan në gjithë trupin!

Një ditë tjetër tre ushtarë të tjerë i ranë pas një shërbëtoreje të bukur muhamedane, që kish në duart një tenxhere të madhe me kos. Ajo si e pa që ju hodhë përsipër t'a puthnin me një herë ju derdhi tenxherenë me kos përsipër e i bëri që të trè

si mos më keq! Por ata s'ju ndanë çupës dhe e ndoqnë gjer brenda në shtëpi të saj dhe hynë. Si e pa pisk ajo bërtit sa mundi dhe me një herë zbritnë poshtë i ati dhe të dy vëllezrit e saj që u ndodhë në shtëpi dhe më t'i zënë që të trè, më t'ju muar bajonetat, më t'i rahnë bukur edhè ashtu të lidhur ja dorëzuan komandantit. Po komandanti, në vent t'i burgosë e t'i dënojë ushtarët vandalë si u meritonte, ky rahu e burgosi të trè burrat Shkodranë. Ahere marin vesh far' e fisi i këtyre dhe nj'a 30 vetë të armatosur mirë hynë në Polici, ku ishin të burgosurit, i muar e i nxuar jashtë përdhunisht e rahnë disa ushtarë francezë që ju kundrështuan.

Përfundimi ishtë se komandanti Francez s'bëri as një veprim kundra atyreve, se mos u ntrasheshe puna më keq!

Prapë një ditë tjetër dy ushtarë të bardhë këta, Francezë ishin dehur e bërë vaporë si njëri si tjetri e po shkonin shaklo. pikli rrugës, tuke kënduar, tuke …përmjerë paturpsisht e tuke bërë edhè disa të tjera ndohtësira këso doret! Një Shkodran policijet i ndalon dhe filloj t'i marrë që të dy në Polici. Por ushtarët e dehur kundrështuan, tuke nxjerrë që të dy kasaturat[1] e ju vërsulë policjotit Shkodran. Ky ahere s'hasmëris po, më t'ju fut nga një grusht suratit secilit dhe me ndihmën e disa civilave, t'i zë, t'i lith e ja dorëzon komiserit Frënk të Policisë, që ishte një kapitan i marrë, i cili jo vetëm i la të lirë ushtarët sarahoshë, po për shërbimin që bëri policjoti Shkodran e nxori nga puna!

Ajo që më bëri ndërshtypjen më të keqe ishtë një lieutenant kalorës, një djalë 25-26 vjetsh dhe dukej si i edukuar mirë se e kisha parë shpesh herë.

Ky një ditë tek kalonte përpara zyrës s'ime, suberb[2] e kryenaltë, has më një gocë Shkodrane 20 vjetshare dhe pa një pa dy ungjet nga kali, po pa zbritur edhè e zè gocën për faqesh. Goca s'ja vonon, po i fut një pëllëmbë të mirë suratit të tij me sa fuqi që kish! Prej asaj pëllëmbe, që tingëlloj shumë bukur, përfundimi ishte t'i rëzoheshe në baltë kapella oficerit bukurosh. Po ky, pa një zembrim e pa gjë të keq, me një naivitet të çuditshim zbriti nga kali, mori kapellën e ndotur e po e fshinte midis kallaballëkut që po e bënte sehir, e vuri prapë në kokë e u mjaftua t'a qërtonjë gocën vetëm me fjalët "O, la, la que tu es mechante ma belle[3]"!

Kësij bukurinash ngjisnin në Shkodër ditët e para me Francezët e qytetëruar! Katandisi sa s'kuxonte grua e çupë të delnin vetëm në për rrugët. Shumë desha të flas mbi sjelljet bukuroshe të ushtrisë Francese të qytetëruar edhè të bënja një paragon midis paturpësisë e barbarizmës të këtyre me kavalerozitetin, ose kalorësinë e disciplinën strikte të Austriakëve, po nuk është vendi këtu.

Kur ardhi koloneli Bardi de Fourton, i cili më von u gradua gjenerall në Shkodër, e pritmë shumë mirë. Unë u ngarkova nga an' e Bashkisë t'a përshëndes në emër të popullit, e kështu, kur ardhi i mbajta një fjalë të gjatë frëngjisht nga e cila u kënaq shumë e m'u përgëzoj po me atë mënyrë e me shumë elegancë e delikatesë, si kurse e kanë zakon Frëngjët.

Midis të tjerave, në fjalim e sipër nuk i fsheha edhè ato ngjarjet e turpshme që u bënë para se të vinjë ajy dhe për të cilat bëra fjalë më sipër. Generalli u çudit edhè nuk i besonte, po më von u informua mirë edhè një ditë më thiri në zyrë të tij e më tha se po i transferonte edhè komandantin Vandry edhè drejtorin e Policisë De Clavion e disa oficerë vandallë të tjerë.

Sa ishte gjenerall de Fourton nuk ngjau në Shkodër ndonjë çrregullim tjetër si ata që përmënda, veç se sqena të vogla edhè pa rëndësi. Ç't'i zemë në gojë ( Gjerra të vogla këto). Mjaftohem vetëm të thom se në për zyrat e Francezëve figuronin disa goca Shkodrane si daktyllografe – të cilat Francezët i titullonin elegantisht me titujt "nos petites dactylos" të cilat mbetnë të gjitha…. me barrë, e para, sidomos ajo e gjenerallit de Fourton, që ishte nga më të bukurat vajza të Shkodrës, nja farë Marie, vajzë 16 vjetshare!

## XIX

Ishte viti shpëtimtar 1920. Shqipërija ishte ndarë copa copa. Në Shkodër ishin Francezët, m'at'anë urrës së Bahçellëkut ishin italjanët që përfshinin gati 1/3 e Shqipërisë së mesme dhe

[1] kasatura = bajoneta (K. F.)

[2] superb = person i bindur se është superior ndaj të tjerëve duke i trajtuar të tjerët me përçmim dhe arrogancë (H. K.)

[3] O, la, la, sa e keqe je, bukuroshja ime!" (përkthyer me google nga frengjishtja H. K.)

gjithë Toskërinë përveç Korçës, e cila ishte Republikë më vehte nënë sundimin e patriotit Themistokli Gërmenji edhè nënë mbrojtjen e protektoratën e ushtrive Francezë. Në Durrës ishte formuar një qeveri shqiptare me Mufid Libohovën, Fejzi Alizotin, Mehdi Frashërin, Luigj Gurakuqin, Petro Pogën, Mustafa Krujën e të tjerë. Në Krujë ish një tjetër diktatori e vogël nënë krutanin Bazin e Canit etj. etj.

Gjendja kritike e Shqipërisë kish harrirë në një shkallë të keqe. Nuk munt të bëheshe më e keqe. Në Paris delegata e jonë, nënë kryesin' e Panteli Vangjelit kishte dështuar. Shqipërinë, me gjithë që e deklaruan një herë indipendente e i dërguan edhè një mbret, deshin prapë t'a ndanin dysh midis Serbëve e Grekëve. S'kishim asnjë përkrahje gjëkundi, përveç se Lord Robert Cecilin, Aubry-në dhe Miss Edith Durhamin filoshqiptaren e dëgjuar. Gorge Clemanceau, kryeministër ahere i Francës n'a urrente keq. "Nuk ka Shqiptarë, theshte, Shqiptarët janë nomadë e jo komp edhè s'meritojnë të rrojnë më vehte". Qeverija e Durrësit punonte kurdoherë si mbas interesavet Italiane; qeveria nacionaliste nuk existonte gjëkundi!

Në mes të këtij dëshpërimi, të kësaj katashtrofe të plottë, që i turresh Atdheut t'onë, shkrepi një shkëndi e vogël, e cila u transformua me një herë në një flagë të madhe. Ky ishte Kongresi historik i Lushnjës, i cili mbas vrasjes së Essadit në Paris prej Avni Rustemit vinte t'i shtonte Atdheut një rilindje të vërtetë!

Me nisjativën e disa patriotëve u mblodhë në Lushnjë më 20 të Janarit 1920 nga gjithë anët e Shqipërisë përfaqësuesit e kombit, të cilët do mernin masat për shpëtimin e Atdheut.

Qeverija e Durrsit e kundrështoj këtë, si një lëvizje antikombëtare (!) edhè Myfid Libohova marshoj prej Durrsi me një fuqi të mjaftë për me u rënë kryengritësve (!?). Po lumërisht, posa fuqija e Mufidit ardhi në Rogozhinë edhè harriu në bregun e këtejshim të Shkumbinit, të cilin deshte t'a kalonte e t'u binte qinse kryengritësve, Kongresi i Lushnjës, i cili nuk flinte, kish marrë edhè ajy masat e tija, tuke armatosur nj'a 500 e ca vullnetarë, të cilët me kohë kishin zënë anëbregun tjetër të Shkumbinit dhe ishin gati të mbroheshin.

Ahere ngjau një ndodhinë mjaft për të lavdruar, e cila rekomandon dashurin' e Shqiptarit për Atdhè, edhè e cila do mbetet e pavdekur në historinë t'onë kombtare.

Një prej prijsave të ushtrisë patriotike të Lushnjes ju bërtiti me sa mundi ushtarëve të qeverisë së Durrësit: "Vëllezër, në dojni bini ju! Po në qoftë se është thënë nga Zoti të vrasë vëllaj të vëllanë për hatër të ca personave që punojnë kundra Atdheut, ahere bëjeni, se nuk do mprohemi! Lè të na vrasin vëllezrit t'onë"!

Këtij zëri burrnor, ju përgjeq së këtejmi një tjetër zë i mallëngjyer prej ushtrisë së Mufidit. "Jo, ore jo, s'e ka thënë Perëndija të vrasim vëllaj të vëllanë! Ata që n'a dërguan këta e gjeçin nga Zoti, po ne jemi një gjak e s'ndahemi prej jush, pra, prisnani se po vijmë me ju".

Edhe me një herë hodhë përtej lumin e Shkumbinit e u bashkuan me shokët e tjerë. Këjo ishte një shuplak i math për qeverinë trathtare të Durrsit!

Kongresi i Lushnjës bisedoj gjërr' e gjatë gjithë çështjet më rëndësi që i përkisnin Atdheut që ndodheshe në rrezik. Formoj edhè statutin themeltar të Shtetit Shqiptar, mbassi ajy kongres mori edhè titullin e "Asamblesë Konstituente".

Një nga vendimet e para që mori ishte edhè disaprovimi i qeverisë së Durrsit, të cilën e rëzoj nga fuqija. Kështu si fuqi sovrane provizore emnoj ajy Kongres 4 persona, të cilët formonin "Këshillin e Naltë" të Shtetit. Këto persona ishin Aqif Pashaj Elbasani, Abdi bej Totani prej Tirane, Monsignor Bumçi edhè Dr. Mihal Turtulli nga Korça. Si qeveri zgjodhi Kongresi : Sulejman Delvinën, kryeministër,

Ahmet Zogun, si ministër të P. Brendëshme, Mehmet Konicën, ministër të P. Jashtme Sotir Pecin, ministër të Arësimit, Ndoc Çobën ministër të Financave, Hoxhë Kadri Prishtinën, ministër të Drejtësisë.

Si u formua Qeverija, e caktoj për kryeqytet prapë Durrësin, u urdhrua Ahmet Zogu të shkonjë me fuqi të mjaftë në Durrës, të rëzonjë qeverin' e Durrësit, tuke storasur[1] qeverin' e re patriotike të Kongresit të Lushnjës.

Ahmet Zogu e pranoj këtë dërgatë edhè ju drejtua Durrësit, por Italjanët, që s'i shihnin me sy të mirë veprimet e Kongresit të Lushnjës, i çuan fjalë që të heqë dorë prej këtij qëllimi, se po të marshonte mbi Durrës do haste përpara bajonetat e mitrolozet italiane.

Ahmet Zogu, për të evituar një konflikt të këtillë, që munt të kishte pasime të hidhura për né, ndryshoj me një herë mëndje dhe ju drejtua Tiranës, gjë që s'u shkonte ndër ment kurrë italjanëve.

Rrugës ku shkonte ushtërija e Zogut duall gjithë katundet me armë në dorë, tuke u bashkuar me fuqitë nacionale, deri sa harrinë shumën e 5. 000 e sa burravet, fuqi këjo kolosale për një expedicjon kësodore kurse fuqija aktive italiane nuk harinte as 1. 000 shpirt, dhe ku s'ish e mundur t'i ndihmonin edhè fuqi të tjera shqiptare.

Kështu Ahmet Zogu hyri triumfalisht në Tiranë, të cilën e proklamoj si kryeqytet, tuke ngritur flamurin kombëtar mbi konakun e math të Zija bej Toptanit, ku u installua qeverija nacionale e Kongresit të Lushnjës me gjithë personelin e saj. Italjanët jo vetëm s'ju suall asnjë kundrështim, por përkundrazi u trempnë kur panë gjith' atë fuqi ushtarake të Ahmet Zogut, e cila dita-ditën po shtoheshe, edhè një shumicë oficerësh i vanë Zogut e i kërkuan të jenë nënë mrojtjen e tij, se mos pësonin gjë nga populli i egërsuar.

Qeverija zuri vent mirë në Tiranë dhe filloj nga punët, tuke gjetur një Shqipëri me vështirësina të mbëdha e me ngatëresa të mjafta.

Ahmet Zogu pas disa ditësh shkoj në Durrës e kërkoj të shpërndahet qeverija famoze e Durrësit, për ndryshe do t'a shpërndante me anë të fuqisë. Panë ç'panë, pra, qeveritarët e Durrësit u tërhoqnë që të gjithë, tuke ja dorëzuar gjith' arqivat qeverisë së Tiranës! Kështu mori funt sundimi i qeverisë së Durrësit.

Po Ahmet Zogu nuk mjafton gjer këtu. Ju vërvit Krues me fuqi për të rëzuar sundimin diktatorial të Bazit të Canit, ose Abas Kupit, të cilën fuqi pas shumë mundimesh e rëzoj me një marrëveshje bashkë me Abas Kupin dhe Kruja u bashkua me pjesët e tjera Shqiptare pa u derdhur gjak.

Mbi këto një tjetër i shkrepi Tiranës. Ky ishte një farë Osman Bali, një burrë shkurtalaq, po trim, miku i ngushtë e mercenari i Essadistëve, i cili, tuke patur edhè disa pjestarë në Parlamentin e ri Shqiptar, që e themeloj Kongresi i Lushnjës, e kishte qarkuar Tiranën dhe kërkonte rëzimin e qeverisë së Tiranës edhè zëvëndësimin e saj prej një qeverije Essadijane.

Qeveritarët t'onë e panë pisk ahere se fuqija e saj ishte e përhapur, edhè nga ana tjetër nuk deshte të derdhte gjak vllazëror, prandaj u mundua me të mirë e me fjalë t'a bintte Osman Balin të hiqte dorë. Po ku dëgjonte Osman Bali! Ajy kujtonte se e kish Tiranën në dorë!

Qeveritarët t'onë, si edhè të katër anëtarët e Këshillës së naltë kishin bërë gati valixat të iknin nga Tirana. Veç Ahmet Zogu s'e humbi shpresën, po merret vesh me Bajram Currin edhè një natë të bukur e msynë Osman Balin edhè e zunë të gjallë bashkë me prisit e tjerë, tuke i shpërnda fuqit' e tija. Osman Bali ahere, që të shpëtonjë nga litari u bashkua me qeverinë, tuke i dhënë asaj besën.

Si shpëtoj nga ky rrezik, Zogu vendos të marshonjë mbi Shkodrën që t'a bashkonjë edhè atë me Shqipërinë tjetër, me gjithë që e dinte bukur se do ngatërohej me dy të mbëdha Europjane, atë të Italjanëve që shtriheshe deri në kodrat e Beltojës e të Berdicës afër Shkodrës edhè me atë të Francezëve, që kishin okupuar Shkodrën me rrethina.

U nis pra, prej Tirane bashkë me ministrin e Drejtësisë Hoxha Kadrinë edhè me një fuqi të mjaftë e vjen gjer në Lesh. Po aty e ndalojnë Italjanët e s'e lenë të shkojë më tutje. Ahmet Zogu me të shpejt u komunikon një ultimatum italjanëvet e u thotë se do të përdorte fuqin' e

[1] storas = vë në vëndin e vet, vendos, instaloj (H. K.)

armëve, në qoftë se e ndalonin, mbassi ky ishte urdhri që kish marrë nga qeverija e tij. Ahere Italjanët e lanë të lirë të kalojë urën e Drinit. Po kur vjen në Beltojë gjen tjetër rezisntencë të fortë prej Italjanëvet. Aty nuk dihet ç'urdhër mori komandanti italjan, i cili i la të kalojnë për në Shkodër.

Kështu Ahmet Zogu me Hoxha Kadrinë vijnë në Shkodër dhe Francezët ahere e muar vesh kur i panë që u futnë brenda në Shkodër. Po e panë edhè vet' ato që nuk munt t' kundrështonin, sepse populli i Shkodrës u çua më këmbë, edhè ishte gati t'u binte Francezëvet, në qoftë se sillnin ndonjë kundrështim.

Të dy ministrat Shqiptarë i pritmë me një enthusiasmë të madhe e me brohori, dhe gjeneralli Bardi de Fourton, i cili tre ditt më parë kish deklaruar se do t'u dorëzonte Shkodrën Serbëve, kur pà se Shkodra kërkohej prej qeverisë Shqiptare, nuk insistoj më tepër, po ja dorëzoj qeverisë kombëtare dhe kështu u largua miqësisht prej Shkodre e n'a là të lirë!

Po Serbët, që ishin të sigurt se do t'a shtijshin Shkodrën në dorë, u zembruan shumë me largimin e ushtrise Franceze nga kryeqyteti i Teutës e kështu marshuan mbi Shkodër nga an' e Kastratit.

Ahmet Zogu, i cili ndodhej akoma në Shkodër, ju dolli përpara me një fuqi shkodrane dhe pas një lufte të rrebtë të "Prroj i thatë" i Kastratit, i theu Serbët e i ndoqi deri në Vermosh, tuke u futur edhè në kufit' e tyre.

Kështu edhè Serbët hoqnë dorë prej aspiracjoneve të tyre e n'a lanë të qetë. Mirë po Ahmet Zogu qëndroj akoma për një kohë të gjattë në Shkodër edhè si ministër i dërguar prej qeverisë së Tiranës edhè si zëvëndës Prefekti i Shkodrës, sepse s'kishte kaluar frika e të msymeve të Serbëvet.

Unë aso kohe isha akoma në Shkodër, ku bënja avokatllëk, dhe kur ardhi Hoxha Kadriu si ministër i drejtësisë, u poqmë në Shkodrë e më tha se do formonte, po në qytetin e Shkodrës, trupin e diktimit dhe midis anëtarëve të tjerë m'u lut të marr pjesë edhè unë dhe kështu të më dërgonte dekretin përkatës të emërimit prej Tirane. Edhè unë, mbassi nuk vinte edhè aqe mirë puna e avokaturës, e pranova më një rrogë mujore prej 550 fr. Arit.

Pas pesë dittsh, qysh se shkoj Hoxha Kadriu në Tiranë muarm të gjithë dekretet t'ona dhe formuam trupin e Diktimit[1] (civil e penal), me kryetar Salih Torrën dhe anëtarë, mua, Mehmet Karagjosin, Mustafa Nuri Rippën dhe Nazif Jusufatit dhe filluam nga puna me një qejf e me një armoni të pashoqtë. S'mbaj ment të kem shkuar si nëpunës aqe mirë, sa kam shkuar atë kohë me ata shokë. Punonim me gjithë fuqinë, po edhè fjalë me shoqi-shoqin nuku ndruam kurrë. Ishte diktimi i parë ky i Shqipërisë.

Ndalemi në muajin e Nëntorit 1920. Tuke qenë se ime kunatë, e ndyera Marigo Pozio[2], kishte disa punë private në Vlorë, më shkroj disa herë që të vetë gjer në Vlorë, dhe për këtë shkak kisha marë 10 ditt leje nga Ministri i Drejtësisë e isha gati të nisesha për në Vlorë. Po nga ana tjetër, gjith'ato ditë kishim edhè krizë ministriale, kështu që, qeverija e Sulejman Delvinës dha dorëheqjen dhe Këshilla e Naltë e Shtetit ngarkoj Iljas bej Vrionin të formojë kabinetin e ri.

Ilias Vrioni e mori përsipër këtë detyrë tuke u munduar të formojë kabinetin e ri, dhe tue marrë e emërue dorë për dorë 4 ministra të cilët ishin Xhafer bej Ypi, si ministër i Drejtësisë, gjeneral Ali bej Kolonja, si zëvëndësministri të luftës, në vent të kolonelit Selahudin bej Shkozës, i cili ishte emëruar ministër titullar i luftës dhe Fuad bej Dibrën, si ministër të P. Brendëshme. të zëvëndësuar provizorisht prej Xhafer Ypit, dhe vetë Ilias Vrioni kish mbajtur portofolin e ministrit të P. Jashtme. Pra, mungonin nga Këshilli Ministror ministri i Financave dhe ajy i Arësimit.

[1] gjykata e Diktimit = Instanca më e lartë e sistemit gjyqësor në atë kohë (H. K.)

[2] Duke qenë se Marigo Pozio ka vdekur në verën e vitit 1932, siç e tregon K. Floqi më poshtë, kjo fjali tregon se kjo pjesë e autobiografisë së tij është shkruar pas vitit 1932 (H. K.)

Bash atë natë që do nisesha me anë të lumit të Bunës për Vlorë, takonj përpara zyrës së Bashkisë mikun e vjetër Tef Curranin, që me vjete kishte ndenjur në Austri dhe ishte i licencuar prej Export-Akademia' së Wienës, i njohur mirë si një financjer me kapacitet. Z. Currani, posa më pa, më mer për krahu e më heq më nj'anë e më thotë: Kam me t'kallxue nji sent, qi ka me të gzue prê së teprit, si mik që t'kam. – Hair-haber, i thom folë, t'a marr vesh që të gëzohem. Z. Currani, si përgjigje më fjalët e mija, nxjer nga xhepi një telegraf e m'a jep t'a këndonj. Telegrafi ishte prej Kryeministrit të rì Ilias Vrionit, i cili e emëronte si ministër të Financave z. Tef Curranin, e e porositte të shkonte ca më shpejt në detyrën e tij në Tiranë.

E përgëzova nxehtësisht z. Curranin dhe shkuam e pimë nga një kafè aty afër. Po nisem sonte, më thotë, dhe ç'ka të duesh më shkruj si mik që m'kè e të kam. Ju fala nderit fort z. Curranit dhe kështu më la lamtumirën e u ndahmë.

Atë natë si u ngrys, po rinja në shtëpi tuke i rënë mandolinës e po prisnja të servireshte darka. Ime shoqe me sherbëtoren po tiganisnin ca qofte, kur po dëgjonj kampanellën e derës që po troket. Sa të marr vesh kush po trokiste jashtë në atë kohë – ora 7 i natës – kishte shkuar djali im Pirrua e hapi portën. Një telegraf përndarës i kish dhënë djalit një telegraf për mua; djali i vogël e e mer e ja jep s'ëmës, po ajo s'e hapi se i kish duart me mjell të qofteve e m'a dërgoj, ose m'a solli vetë telegrafin edhè e hapa. Telegrafi përmbante këto :

"Zotnisë Kristo Floqit"

"anëtar i Diktimit"

"Shkodër"

"Atdheu ka nevojë sot për djelmat e tij. stop. Unë, tuke çmuar veprat t'uaja patriotike edhè me pëlqimin e Këshillës Naltë ju lajmëronj emërimin t'uaj si ministër i Arësimit. stop. Posa të merni këtë telegraf luteni të nisi ca më shpejt në krye të detyrës s'uaj këtu. stop. Lajmëroni nisjen t'uaj. stop

"Kryeministri Ilias Vrioni"

Ç' është? thotë ime shoqe. S'është gjë, i thom, po bëj gati e shtro darkën pastaj të thom, edhè zura të marr prapë mandolinën. Po gruaja ime, e kureshtuar tepër, e rëmbeu telegrafin me duar plot mjell si i kish, edhè e këndon. Me një herë më rrok për qafe, tuke qarë. Si? më thotë, more këtë lajmë kaqe gazmore e s'n'a rëfen gjë? Nuk përshkruhet ç'ngjau ahere! Po i hoqa vërejtjen gruas mos thotë gjë, as djalit se n'a mblithte gjithë Shkodrën në shtëpi. I thashë që, mbassi nisem për në Vlorë mos bëj fjalë gjëkundi, e kur të kthehem në Tiranë e të marr detyrën përsipër ahere vere edhè tellallin po të duash!

Në atë kohë ngjitet lart prapë im bir e më thotë se telegraf'përnduësi po prêt bakshishin se qënkam bërë ministër. Ahere e thres lart përndaesin, e darovita 1/2 napoloni e i thashë mos përhapë ndo një fjalë gjer nesër, si të nisem nga Shkodra, po ajy i shkreti m'u përgjigj që edhè në mos thënte gjë ky, këtë lajmë e muar vesh të gjithë.

Të nesërme pagdhirë mirë nisem për në Vlorë me anë të lumit Bunës se kish vapor në Prilaj për Durrës e Vlorë. Në vaporetën hynë disa pasaxherë, midis të cilëve Dr. Rauf Angoni, Bajram Fevziu, Serafin Mazreku e disa miq e të njohur të tjerë.

Vapori do nisej nga mezi i natës për Durrës. Pra gjith'atë natë e kemi shkuar me muhabet e me loje letrash. Midis muhabetit biseduam mjaft edhè mbi politikën dhe midis të tjerave edhè për kabinetin e ri të Ilias Vrionit, si dhe për ministrit e rinj. Tha dikush atjè që s'u emërua edhè ministri i Arësimit bashkë me të tjerët edhè po bënim disa kombinezone[1], se kush munt të jetë kandidat për atë dekaster. Shumë persona zunë në gojë përveç meje. Por, dhëndri i Luigj Gurakuqit, që ish edhë ajy me né e vinte në Tiranë për punë se e kishin pushuar nga detyra si msues edhè i cili ishte afër mejet, më thotë ngadale : Ishallah, zotni Floqi, n'a bahesh zotnija jote ministër i Arsimit, vallahi nuk do t'ishte keq. I thom, u emnua një Shkodran z. Tef Currani si ministër i Financave pra doni ju që gjithë ministrat t'i marin

[1] kombinezone = kombinacione (H. K.)

prej Shkodret? S'ka të bënjë thotë Serafini. Pastaj z. jyte s'jè Shkodran, po jè Korçar, edhè të meriton, për Zotin, të meriton. Po, allah-ile, në qoftë se bahesh ministër z. jyte a do më marrësh edhè mue në shërbimin pranë teje? Unë s'kisha ç't'i thesha. Po më dukej se diç'ka do dinte Serafini, që ma tha këtë fjalë, po prapë tuke e vezhgëlluae mirë kuptova se nuk dinte gjë. Me qenë se m'a përsëriti shumë herë, për t'a çkarkuar qafet edhè për të mos e zgjatur më fjalën, i thashë më së fundi, që, çasi[1] do të bëhet, po të emërohem ministër i Arësimit. Po ajy zok dreqi s'më ndaheshe. M'a jep dorën, thotë, se do t'a mbash fjalën, edhè unë pashë ç'pashë i dhashë edhè dorën edhè fjalën.

Si fjetmë nj'a pesë orë, në mëngjes të nesërmen, vapori hodhi hekurin në limanin e Durrësit. Me një herë barkat n'a u avitnë reth vaporit edhè i pari që hyri brenda në vapor ishte Rexhep Jella, prefekti i Durrësit. Hyn në sallonin ku ishin gjithë tok – ku – unë ndodhesha atë ças në kabinën t'ime edhè kërkon ministrin e Arësimit.

Të gjithë pasaxherët shëkohen sy ndër sy e i thonë me një gojë prefektit të Durrësit se ka gabim, se në vapor nuk ka ndonjë ministër të Arësimit. Qysh, u thotë Rexhep Jella, nuk ashtë këtu z. Kristo Floqi? Po, i thonë, këtu është. Pra, tamam e kam, u përgjigjet edhè një herë prefekti Jella, z. Floqi ashtë ministri i Arësimit që po kërkonj. Të gjith'ata pasaxherë, hapnë sytë dhe çuditeshin pse s'u thashë gjë unë gjith'atë natë që ishim bashkë.

Në atë çash dolla edhè unë nga kabina edhè m'u turrë te gjithë, tuke më përhiruar, edhè tuke u ankuar pse s'u tregova gjë deri ahere. Ju thashë se, mbassi vetëm një telegraf kisha nga Kryeministri Ilias Vrijoni dhe nuk dinja me ç'kondita do m'a ngarkonin ministrin' e Arsimit, edhè mbassi nisesha për në Vlorë, nuk kam dashur t'a përhap.

Ahere më shtërnguan t'i gostit, edhè i gostita të gjithë. Muar vesh edhè kapitanët e komandantët e vaporit e kështu më nxori nga qesja zoti Prefekt i Durrësit 264 lireta që pagova për shampanjat, etj, veçanërisht regallove[2] që ju dhashë komandantëve. Prej këtyre ç' kuptova? Asgjë. Veç se kapitani i parë i vaporit më bëri nderin, pa ja kërkuar asnjeri, të ngrehë flamurin Shqiptar në katartin e vaporit, shêjë këjo që në vapor brenda kishin një ministër Shqiptar.

Si u përshëndoshmë me Rezhep Jellën, më merr më nj'anë e më thotë se kish urdhër nga Kryeministri Ilias Vrioni telefonisht, të më merte nga vapori edhè të më shoqëronte me automobilin e qeverisë gjer në Tiranë, ku më priste padurim Kryeministri. I thom ahere Rexhep Jellës, se nuk mundem të vinj se isha nisur për në Vlorë për çështje familiare dhe ishte nevoja të vinja ca më parë, edhè se posa të mbaronja punë, i thashë, do kthehem me një herë në Tiranë, e ju luta t'a lajmëronte tekstualisht Kryeministrin. Rexhep Jella u mundua shumë të më bindë si edhè disa miq të tjerë pasaxherë, po s'më bindnë dot. Kështu u ndamë me prefektin e Durrësit edhè unë me disa pasaxherë të tjerë nisesha pas dy orësh për në Vlorë.

Unë, kur u nisa nga Shkodra nuk ju përgjigja Ilias Vrijoni në telegrafin e tij, se ahere do t'isha i shtërnguar të vinja në Tiranë, kur se nevoja ishte të vinja në Vlorë më përpara. Prandaj, para se të nisem nga Shkodra i kisha bërë një koncept telegrafi gruas s'ime që t'ja drejtonte Ilias Vrijonit, tuke i çfaqur falenderime, e tuke e lajmuar se unë isha nisur për në Vlorë për çështje familiare. Pra, që këtej meret vesh se Ilias beu, posa mori atë telegram lajmëroj me një herë prefektin e Durrësit e të më kthejë në Tiranë.

Kur harrimë në Vlorë kapitani i vaporit e ngriti prapë flamurin Shqiptar mbi katartin e "Molfetës" po, kur e pashë, ju luta t'a unjë që të mos bëheshe çështje. Po nga ajo që ruhesha nuk shpëtova , se varkaxhinjtë, posa ardhë në vapor, pyetnë për cilin e ngriti vapori flamurin Shqiptar, edhè një prej komandantëve i informoj se ishte në vapor ministri i Arësimit, tuke treguar me gisht personin t'em, kështu që lundratarët, me qenë se më njihnin mirë që kur isha në Vlorë, m'u mshtuall rrotull tuke më uruar.

[1] çasi = ç' ashtu (H. K.)
[2] regalo = dhuratë (H. K.)

Dolla në Vlorë e vajta në shtëpi të s'ime kunatë Marigosë, e cila më priti me gëzim të math, pa ditur gjë. U shtruam të llafosemi, po nuk shkoj gjysmë ore edhè plakosnë qyme-qyme një karvan burrash vizitorë që s'kishin të sosur. Ime kunatë kur dëgjoj piksëpari prefektin, Kryetarin e Bashkisë, Drejtorin e Financave edhè Drejtorin e Policisë që më uronin nxehtësisht për ofiqin e ri që kisha marrë, po që uronin edhè atë bashkarisht për mua, ajo e shkreta, si nuk dinte gjë u habit e po më shihte në sy si e hutuar, gjer sa i thashë edhè vetë. Ahere me sytë plott lott e ndyera m'u hoth për qafe, tepër e gëzuar se e harriu atë ditë!

Vizitorët nuk n'a lanë rehat dy ditt me radhë. Pastaj plakosnë gratë, sa s'n'a lijnin as një herë vetëm. Më së fundi e mblodhmë mëndjen edhè fillova t'i rrjeshtonj çështjet e saja, për të cilat më kishte ftuar. Por tani gjetmë belanë edhè nga telegrafet e Kryeministrit që po më çonte njërin pas tjetrit në Vlorë e që më ngutte të nisesha.

Pashë ç'pashë e lajmërova telegrafisht kryeministrin se po nisesha për Tiranë, me gjithë që s'ndenja në Vlorë veç tre ditt.

Kur vajta në Tiranë – që ish e para herë që e vizitonja – rashë në hotelin "Frashëri", hoteli më i mirë që ish aso kohe në Tiranë, ku s'kishte përveç se trè hotele, atë të "Durrësit" e të "Adriatikut" dhe vetëm një restaurant ku grumbulloheshim si sardhelet kush e kush të hante më parë.

Si u rrojta e u mvesha mirë vajta në zyrën e Kryeministrisë. Këtu duhet shënuar se edhè ministritë e tjera, po në atë konakun e Zija bej Toptanit ishin grumbulluar, edhè se cila ministri kish vetëm nga dy dhoma, një për ministrin edhè një për personelin tjetër të pakët që kishte se cila ministri. Mjerisht, ministrija e Arësimit kish një odë shumë të vogël për ministrin dhe vetëm një karekllë e një tryezë të vogël. Vizitorët që vijnin duhej të rinin më këmbë!

Kur ardha te dera e Kryeministrisë shërbëtori nuk desh të më linte të hynja brenda, se atë çash kishin këshillë ministrore. Më kot mundohesha t'a bint se jam edhè unë një nga ministrat, po ajy s'më zinte besë, veç se më shëkonte me një sy ironie, si kur se desha të tallesha me 'të. Tek e mbramja i dhashë një kartë-vizitë për Kryeministrin, të cilën ftuesi pat mirësinë të hapë derën e tij e t'ja dorëzojë Ilias beut. Ky me një herë del për jashta, më përshëndet më gëzim e më hidhet për qafe, se ishim miq të vjetër e më futi brenda, ku ishin edh' ministrat Tef Currani, që u shkul gazit kur më pa koleg, Xhafer Ypi, me të cilin njiheshim prej vjetësh, se edhè në Korçë e kisha nënë urdhrin t'em si një nga gjyqtarët paqtues, edhè gjenerall Ali Riza Kolonja, të cilin e njihnja për të parën herë.

Mbas si bëmë ndonjë orë muhabet të mirë u ngritmë siç ishim edhè vamë në zyrën e Këshillës së Naltë të Shtetit, ku me një ceremonì të qetë dhashë benë e duhur. Ndejmë pak edhè aty dhe u kthyem prapë në Kryeministri, ku ju dhamë funt disa vendimeve dhe kur ardhë dreka më mori Kryeministri për drekë.

Pas dreke shkova në ministrinë t'ime, ku fillova nga detyra. Me një herë të gjithë nëpunësit e mij nj'a 8 vetë gjithsej ardhë së bashkut me më uruan. I falenderova dhe ndërkohë i porositë të jenë të rregulltë e të zellshëm në detyrat e tyre. Bëra edhè qarkoren e duhur që lajmëronja gjithë drejtorit' e inspektorit' e Arsimit të Shtetit, që atë dikaster e kisha marrë unë përsipër edhe se kërkonja punë e vepërim prej gjithë arësimtarëve meshkuj e fembra.

Atë natë, mbassi hëngra darkë edhè ishte një kohë e bukur, po pa Hënëzë, dolla t'a shëtit një herë Tiranën. Ora do ish nj'a tetë. Tirana ahere ishte një farë katundi i math. Rrugët si aman o Zot. Ujët derdhej në formë të një lumi të vogël në për rrugët e Tiranës. Disa ura drrase, ose kadhramesh, bashkonin rrugët me dyqanet e ulta të Tiranës. Lopë e bagëti gjithfarësh e kafsha të trasha s'i mungonin kryeqytetit të kuq Shqiptar, tuke u sjellë nat' e ditë në për rrugët e qytetit, tuke shkuar për kullotje, ose tukë u kthyer s'andejmi. Brir' i bualli të çante nga do që të shkonje dhe duhet të kishe mëndjen! Tiranasit, njerëzit më fanatikë e më Turq nga gjithë populli tjetër i Shqipërisë, përveç disa intelektualëve e nëpunsve Tiranase që silleshin njerëzisht, të tjerët n'a shëkonin me sy të keq, si Kaura, sepse mbanim kapelle!

Mbylleshin që me pulat në për shtëpit' e tyre dhe gratë, me çembere[1] e roba të grisura e të reckosura e plot mballoma[2], shetisnin të mbuluara si takëm karnavalesh në rrugat. S'ishte e mundur me asnjeri të zinje miqësi e të ndronje këmbët, si thotë fjala. Kur vinte nata, si kur vinte mortja. S'kishte ku të dalç, as ku të vesh, dhe në qoftë se s'kishe ngrënë bukë me kohë, munt të flinje edhè pa bukë! Tirana binte në një terr të math mbassi s'kishte as fenerë në për rrugat, përveç disa xhixhillonjave, ose shkëndijave që të klejitura ndritnin aty-këtu si brokurezat në Pranverë. Qetësi e madhe kudo ; veç ahullimet e qenëve të pazzotë , nga të cilët ishte e pasur Tirana dhe gjelat e shtëpive munt të themi se e prishnin atë qetësi. Pra, edh' nëpunësit e Tiranës akoma ishin detyruar të mbylleshin me kohë e t'a shkonin natën tuke fjalosur, ose tuke lojtur poker, britzh, ose bakarà:

Si shetita nj'a dy orë atë natë e u largova mjaft, zura të kthehesha për në hotell, po mjerisht kisha humbur rrugën. Nuk shkuan pak minuta edhè has në mes të territ mbi një patrullë prej një polici edhè nj'a dy gjendarmëve. He!.... He!.... përgjigjem.

Hallt!.... Hallt!.... Ç' është u thom, ç'urdhëroni? Kush je ti? më thotë polici. Njeri jam, si ju, i thom. Ku shkon këtë orë? Shkonj në hotel "Frashëri". Nga je ti? më thotë polici. Jam jabanxhi, i thom, sot kam ardhur në Tiranë për të parën herë. – Ku e ke fenerin? Ç'fener, i them? A shetitin njerëzijt këtu natën me fenera? Si? S'e ditke? më thotë. Aspak! Nè në Shkodër e në Korçë, po edhè në Durrës e në Vlorë kemi vjete tani që s'i përdorim fenerat natën: - Këtu i thonë kryeqytet, m'a prêt me inat policmani. Anxhak[3], i thom, kryeqyteti është turp do përdorë fenera natën, si kur se jemi akoma nënë merhumen Turqi!

Leri fjalët, më thotë policjoti. Pse s'keni fener? Nuk e dinje urdhrin? Ku, djall t'a di, i thom këtë djall urdhër, tani po e marr vesh nga ty! Ahere, ma pret polici, eja me né bashkë. Ku të vemë? i thom. Në karakoll, ku gjetkë, thotë. Mos kujtove se do të të çojmë në hotell?

Dhashë mora t'a bint se s'e dinja urdhërin e se nuk e bënj tjetër herë, me azallah! Ku dëgjonte polici, i cili ishte gati t'u jepte urdhër gjendarmëve të më gostitnin me ndonjë kondak kurrizit në rast që u kundrashtonja! Thashë një herë t'u rëfenj ofiqin t'em, po do mos më besonin. Ç'deshte një ministër fill i vetëm edhè pa fener në atë kohë nate?

Desha s'desha u rashë pas gjer sa më prunë në një karakoll të vogël e të ngushtë, i cili egziston edhè sot në të dalmen e Tiranës afër spitaleve të Shtetit e t'ushtrisë.

Kur më futnë brenda, Zoti e bëftë, thashë, karakoll! Vetëm një krevat të hekurt me ca shtresha të vjetra e ta palara ish aty edhè nj'a dy frona draset njërin prej të cilëvet e okupova unë.

Policjoti si më la aty filloj të shkonjë prapë në detyrën e tij dhe un' e pashë bukur se atë natë do gdhihesha aty mbi fron, prandaj, përpara se të largohet policmani me gjendarmët i thom : Nuk më thua, këtu do të ri tërë natën unë? Polici qeshi. Pse? thotë nuk të pëlqen a? fli një herë këtu se nuk bëhet kijameti! Ahere i thom se dua të flas në telefon me drejtorin e Policisë. S'ke punë me atë, më thotë me inat, ajy flè tani, nesër. E dua tashti, i them me inat, ndryshe ke për ta paguar shtrenjtë këtë që më bëre sonte! Ajy më pa një herë me inat se e kapa vetë telefonin pa e pyetur, po s'kuxoj të më ndalojë.

I telefonoj komiserit të Policisë, po mezi më dha përgjigje se flinte. Hallow!.... Këtu ministri i Arësimit, telefonoj nga karakolli i Policisë i rrugës së Dibrës. – Urdhno, zotni minister, më përgjigjet komiseri. Edhè ja shpjegonj një nga një ç'më ngjau. Komiseri i shkretë më kërkon pardon e më thotë të bënj mundimin t'a pres pak se vjen vetë me karocë të më marrë, që të mos vij më këmbë aqe lark. Me të vërtet u suall shumë gentil ku komiseri, i cili quhej Qazim Bodinaku, që sot është prefekt i Shkodrës.

Polici kur dëgjoj shkëmbimin e fjalëve me telefon, u mpì, edhè m'u afrua afër, tue kërkue pardon. Unë s'i fola gjë. Pas 20 minutash ardhi komiseri me karocë, ju bërtit një herë

[1] çembere = nuk e gjeta në fjalor këtë fjalë, por duhet të ketë kuptim "perçe" (H. K.)
[2] mballoma = arna (H. K.)
[3] ançak = megjithatë (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

policit e gjendarmëve, që psè nuk më çuan në hotell, mbassi e panë se isha i huaj edhè kështu hipmë bashkë në karocë dhe vamë në hotell "Frashëri", ku ju fala fort nderit për gjentilecën dhe e përcolla gjer ne dera.

Të nesërmet kur ja u tregonja këtë kolegëve ministra u fiknë gazit.

Detyra e parë kur mora dorëzimin përsipër ishte të zè nja lokal të ri për Ministrin' e Arsimit, se ishte turp të rinja në atë odushkë të vogël, ku kish ndejtë predesori[1] im Sotir Peci një mot-mot, edhè e cila ishte 2, 50 X 2, 50 metra. Kështu zura

shtëpinë e Fuad Toptanit që kishte 5 oda të mbëdha edhè një koxha çardhak, ku u installuam bukur.

Një ditë me vjen në zyrë Serafin Mazreku, për të cilin kam folur më lart. Pas disa komplimentave që më bëri, zotni ministër, më thotë më së fundi, a mbani ment që më keni dhënë fjalën brenda në vapor, kur vijshim prej Shkodre në Tiranë, se po të bëheshit ministër do më emnojshit edhè mua që kam mbetë pa punë me një tufë fëmijë?

Kè të drejtë, i thom. Pritmë vetëm tre ditt. Ju pres, thotë edhè trembëdhjetë, mjafton të mos me qesni në harresë. Mos kij merak, i thom, se fjalën s'e hà.

Kështu brenda trè ditve emërova z. Beltoja – kryesekretarin t'em – si drejtor të arësimit në Shkodër edhè në vent të tij emërova Serafin Mazrekun, me gjithë që m'u zembrua sekretari i parë i ministrisë Wilhelm Luka, por ky ishte i ri akoma për atë ofiq, kurse Mazreku ishte arësimtar i vjetër, profesor gjymnazit.

Në atë kohë pat ardhur edhè Kristo Dakua prej Amerike, të cilin, me rekomandimin e Dr. Turtullit, që ish anëtar në Këshillin e Naltë, e kish thirur ministri arsimit Sotir Peci për t'a emëruar inspektor të Arësimit. Porse pa ardhur në Tiranë Kristo Dakua, i ndyeri S. Peci me shtytjet e Këshilltarit tjetër të naltë Emzot Bumçit, kish emëruar në atë vent katholikun msues Matthi Logorecin.

Kur ardhi Dakua e u paraqit te Dr. Turtulli – se Peci ahere ishte në Korçë – Dr. Turtulli i tha se s'ka në dorë t'i bënjë gjë, sepse Peci nuk është më ministër, edhè se në vent të tij kish emëruar Logorecin.

Dakua ahere më vjen në shtëpi me kunatën zojushen Parashqevi Kyrjas e më luten fort e fort që të mos e lè pa punë Dakon se s'ka as të holla me se të rronjë dhe se e muar më qafë, tuke e shpërngulur nga Amerika, ku kishte si do ku do një pozitë në Jamestown. I thashë do të mendohem.

Matthi Logoreci, si inspektor i përgjithëshëm i Arësimit, kishte gurin e arrën në dorë. I siguruar se kishte protektor një këshilltar të naltë, Bumçin, i dukej se kishte zënë Perëndinë për mjekre! Ishte i vetëmi, që jo vetëm s'më dërgoj as një telegraf, ose letrë urimi qysh se u bëra ministër, po edhè në raportet që më çonte, si inspektor, përdorte një gjuhë gati urdhëruese e pretencioze[2], e jo një gjuhë inferiori faqe një superiori të tij. Këjo sjellje më kish mërzitur fort e sidomos sjellja e tij mosbindëse, se sa do që e urdhërova dy herë të kthehet në qendër, në Tiranë, ajy më shishte mëndje, qinse ka nevojë akcili e akcili rajon për inspektim, qinse ishte nevoja të zgjatej inspektimi i tij edhè nj'a dy muaj të tjerë, se nuk i harrinin 4 muaj e sa, qysh në kohën e Pecit, që ishte i bir' i botës në inspektim, pa kishte të drejtë se veç rrogës, veç të ngrënave e të pirave në qarqet e ndryshme, ku i jepnin hospitalitet si një kryeinspektor, si një mysafir, po kishte edhè nga15 fr ditën dijetë, veç udhëtimit, gjë kjo që s'i jepte dorë t'a linte pas aqe lehtë. Prandaj ky njeri, ky katholik fanatik, që, kur ishim në Shkodër n'a sajonte për "Shqênj" sepse ishim orthodhoksë, ky njeri, po them më kish qëndruar në stomak! Edhe një dit i heq një telegram në Korçë ku ishte, e i thom të niset urgjent, ndryshe do t'a pushonj nga puna. Edhe ahere s'ishte si tani që s'munt të vepërojë një ministër në emërime e në pushime pa vendim të Këshillit Ministror edhè pa pëlqimin e dekretimin e sovranit; se unë kur mora përsipër ministrin' e Arsimit u shpjegova më parë me

[1] predesori = paraardhësi (H. K.)

[2] pretencioze = mendjemadhe, tregon vehten me intelekt më të lartë se ç' është në të vërtet (H. K.)

Kryeministrin pastaj edhè me të katër antarët e Këshillis së Naltë, që si ministër do të kem dorë të lirë mbi personelin t'em, mbi emnimin e pushimin e disciplinën e tyre, ndryshe, ja u kisha deklaruar se s'e pranonj atë dekaster, edhè isha gati të kthehesha në Shkodër vendin t'em, si anëtar i Diktimit, që ndodhesha akoma me leje. Po, si Këshilla e Naltë, ashtu edhè Kryeministri, sa do që u përtypnë në krye, më lanë më së fundi të lirë edhè këtë ja u kisha marrë me shkrim. Prandaj zotnin' e tij Llogorecin e kisha në dorë.

Të nesërmen të telegramit Llogoreci ishte në Tiranë. Por, i shkreti nuk u paraqit drejt për së drejti përpara meje, posa ardhi. Po shkoj më parë e ju ankua Këshillit të Naltë, m'andej Kryeministrit, për telegramin brutal se i quante ky, që i kisha drejtuar, tuke ja treguar telegramin ç'do këshilltari e ç'do ministri, sende që m'i treguan edhè mua shumë shpejt, organët e mij.

Kështu Llogoreci m'u paraqit dy ditt më von prej ditës që mbrini në Tiranë, gjë që më inatosi edhè më tepër për indisciplinën e tij.

Kur m'u paraqitë në zyrë e prita shumë ashpër, tuke i hequr verrejtjen e tuke çfaqur hidhërimin për sjelljet e tija. M'andej, tuke parë biografin' e tij i thom se shumë liksht kanë bërë që e kanë emëruar inspektor të përgjithëshëm të Arësimit, mbassi nuk ka çilsit e duhura, se pas rregullores së Arësimit duhej të kish shërbye të paktën pesë vjet si professor gjymnasi, tuke qenë më parë Doctor es letteres, doktor në filosofi, ose në fysiko-mathematikë, por se ti, i thom, s'kè asnjë çertifikatë që kè mbaruar një gjymnas, se ke qenë vetëm një msues ordiner në shkollat fillore!

Po Llogoraci mori zjar me një herë e m'u tur si kur kishte shoqin e tij përpara, tuke m'u kërcënuar më së fundi, se mbassi u emërua një herë me pëlqimin e Këshillës së naltë edhè me vendim të Këshillit ministruer, kishte një të drejtë të përfitume. Do me thënë ishte i sigurt se nuk e tundte njeri nga vendi!

Unë s'prita më tutje, thira kryesekretarin e e urdhërova të redaktonjë një urdhër me të cilin e pushonja nga ofiqi i kryeinspektorit, tuke e emëruar anëtar të komisisë letrare, ku ishin edhè Alexander Xhovani, Ndue Paluca, Salih Çeka, Pertef Pogoni edhè Zef Fekeçi, edhè në vent të Llogorecit emëronja si kryeinspektor Kristo Dakon, i cili ishte Doktor në Mathematikë të një nga universitetet e Shteteve të Bashkuara.

Llogoreci iku i mbushur me vrer e shkoj fill e u qà te Kryeministri, po ky ja preu me një herë rrugën, tuke i thënë se këjo ishte në dorë të ministrit të Arësimit, ku Këshilli Ministrues nuk përfshihet.

Që aty Llogoreci shkoj në Këshillën e Naltë e bëri poterën e madhe, po edhè atjè Dr. Turtulli me Aqif Pashanë i thonë se s'munden t'i bëjnë asgjë, se m'a kishin njohur mua me shkrim atë të drejtë!

Ahere ngrihet Monsignor Bumçi e vjen në Zyrën t'ime e më lutet miqësisht fort t'a tërheq pushimin e tij, tuke e mbajtur si kryeinspektor. I thashë Bumçit se ësht' e pamundur dhe të mos insistojë, edhe të jetë i kënaqur Llogoreci edhè atjè ku e vura, se as për atjè s'meritonte se nuk kish çilsit e duhura. Pa, ç'pa Bumçi s'foli gjë tjetër, po më salutoj e iku, por se Llogoreci çoj botën pesh për jashta tuke u ankuar fort kundra meje e nga ndonjë herë edhè tuke më sharrë, gjer sa e thira prapë në zyrë e e porosita strikt të ruthtë gojën e mos të shkonte tuke u ankuar posht' e përpjetë se do t'a pushonja krejt nga puna! Kështu Llogoreci mblodhi bishtin e s'u dëgjua më.

Puna vazhdonte bukur. Brenda 3 muajve shtuam 58 shkolla të reja të tjera, të cilat, kur kam dhënë dorëheqjen nga ministrija unë përpara Parlamentit, arritnë në 544 shkolla gjithsej, prej 318 që gjeta kur ardha ministër.

Në atë kohë e sipër, tuke ndjerë nevojën e madhe të një instituti të mirë për vajzat t'ona u mora vesh me Kr. Dakon dhe me zojushen Parashqevi Kyrjas dhe me vendim të Këshillit Ministror – të cilin dërsiva sa e binda – Ministrija e Arësimit la në dispozicjon 23. 800 fr. arit për fillimin e shkollës, nënë drejtimine zojushes Kyrjas, e cila u urdhrua prej meje të bënjë

projektin e institutit që do themelohej si edhe të orendive e të personelit ntë Shkollës. Pak vjet më vonë ngrihej edhe kjo shkollë në një ndërtesë madhështore mbi një kodër pitoreske të Valiasit, pak minuta lark tiranës, ku shndrit edhe sot, por mjerisht, me shtetëzimin e shkollave nga ministri malok e prototyp Mirash Ivanajt, kjo shkollë e shënuar mbet sot e shkretë!

Kishte ardhur Krishtlindja e vititit 1920. Me qenë se fëmijën e kisha akoma në Shkodër desha të vinja atje të ndodhesha edhe për ditën onomastike të embrit t'em. Prandaj mora lejen nga kolegët e mij dhe telegrafova gruas s' ime të më presë. Do shkonja një ditë më parë.

Ahere në Tiranë s'kish përveç se një kamion për bartjen e teshave etj. të zyrave të ndryshta, gati të shkatëruar edhe një veturë të vogël, të çalë, që përdorte Kryeministri, kur desh të bënte ndo një vizitë nëpër legatat e ndryshme. Po Kryqi i Kuq Amerikan, që ndodhej në Tiranë kish një veturë të mirë, të cilën, ju luta drejtorit të saj e m'a dha të vete në Shkodër. Mir po si shofer më dha një djalë Malëzijas, i cili s'ishte aqe i praktikuar, si kur se e provojti!

U nismë nga Tirana me një kohë të bukur dhe në veturën isha vetëm unë. Po nuk kaluan as tri kilometra, kur në rrugë n'a duall një karvan lopë, të cilat s'n'a lëshonin rrugën, sado që shoferi e përdori shpesh herë klaksonin.

Tani shoferi, po të ishte habil, i zoti, do t'a evitonte të keqen, tuke ndaluar sidomos veturën, ose tuke ecur nga dalë, sa të shpërndaheshin lopët. Po shoferi desh të ecë me shpejtësi të paktën 20 kilometra mbi lopët. Un' e pashë se do t'i shtypnim kafshët e mjera e më ardhi keq, prandaj ju luta një herë, dy herë me të mirë, po ajy prapë havân- e tij! Ahere i hoqa verejtjen edhe e shava, tuke e urdhruar të qëndronte. Po shoferi u zembrua fort edhe, si e pashë, s'dëgjonte as urdhra, as kshilla; i ishte mbushur mendja dhe deshte të bënte të tijnë. Ishte kokë shkëmp.

Kur ndesh njeriu me shoferë të këtillë është me azallah! E ka vehten në rrezik. Desha të zbres nga vetura, po s'më jepte kohë shoferi. E pashë se po n'a vërtiteshe një rrezik i math, ja lopët do shtypnim, edhe këtë nga një kapriçjo e marrë e shoferit, ja se do rëzoheshim në një hendek aty pranë, nga zik-zaket e nga të shmangurat e manovrat e tjera që bënte ky shofer i çmëndur, kur se e kish në dorë të qëndronte pak veturën dhe të evitonim çdo rrezik.

Befas kthen veturën nga an' e mëngjër, ku ishte çelur vendi edhe filloj të marrë rrugë, po me një shpejtësi të madhe, po mjerisht dy lopë, tuke u goditur njëra me tjetrën me brirët e tyre n'a dalin përpara e n' a zenë rrugën. Shoferi i marrë, që të mos i shtypte lopët, me gjithë që njërën e rëzoj poshtë parafangu i veturës dredhoj shpejt e shpejt nga an' e mëngjër, kaqe shpejt, sa vetura humbi ekuilibrin edhe u pruar shumë nga an' e hendekut të rrugës, sa ment n'a përplasi brenda në hendek, ku do të coptoheshim sigurisht, po hajvani shofer, që të shpëtojmë ne tani, që ment ramë në hendek i jep një gjeste kthimi volânit[1] nga e djathta kaqe të rrebtë sa me një herë u dëgjua një krismë e tmershme, automobili u hoth në erë se bëri explozjon kazani i benzinës, dhe u bë copë e copë, tuke më flakëruar mua nj'a 5-6 çape lark në tokë, ku mbeta gati i vdekur, edhe shoferi mbet nënë shemtuarat e veturës! Më vjen ndër ment, se veç krismës së tmeruar te explozjonit të automobilit, s'mbaj ment të kem kuptuar gjë tjetër, se e keqja ngjau çash për çash.

Nuk di sa ndenja në atë gjëndje të tmeruar me mendjen e humbur. Po kur ardha ndër ment pashë disa katundarë rrotull mejet. U ngrita më këmbë pa kuptuar gjë, ndonjë dhëmbje plagësh, ose ndo një sent tjetër. Si u shkunda mirë, vura re se portofoli im me nj'a 25 napolona arit, një qese me 400 korona sermit edhe një mushama impermeablë, që e kisha blerë 8 napolona kishin bërë këmbë! Kush i grabiti nuk e mora vesh.

E shoh veturën e bukur bërë copë-copë. Me një herë më ra ndër ment shoferi, po s'e shihnja gjëkundi. Kur shohim më mirë, vura re se shoferi i marrë, shkaktari i atij mjerimi, ishte i vdekur nënë veturën e prishur! Me ndihmën e atyre katundarëve i tërheqim andej këtej shkatrinat e veturës edhe mezi e nxuarm s'andejmi shoferin pa shpirt! Fytyr' e tij mbytur në

[1] volân = timon i makinës (H. K.)

gjak s'njihej fare; gjithkund në kokë, në trup, në duart ishte mbushur me plagë. Dukej se kish vdekur.

Katundarët e laknë me ujë, e shkuntnë e e përshkundnë gjer sa e suall ndër ment e zu po rënkonte nga dalë, po nuk çoheshe dot më këmbë.

Unë angazhova nj'a dy prej atyre katundarëve, tuke ju dhënë plaçkat e mija e tuke u kthyer bashkë me ata në Tiranë më këmbë, mbassi ahere s'gjenja rrugës as automobila, as karoca. Një katundar tjetër e lashë të rruante shoferin dhe veglat e tjera të veturës.

Kur ecnja s'kuptonja gjë, po pasi baritmë nj'a dy kilometra e dërsimë, nxora shamin' e bardhë të fshinj djersën. Me një herë shoh se shamija ishte mbytur në

gjak të kuq. Vë re mirë e mar vesh se kam një koxha plagë në kokë, prej së cilës kullonte gjaku.

Pak m' andej, se si ngrita krahun e mëngjër dhe bërtita një herë sa munda, se më dhembi fort e s'e losnja dot! Mora vesh se krahun do t'a kisha thyer! Po prapë vazhdonja të ecnja, gjer sa sosmë në ndërtesën e Misjonit Amerikan, ku ja tregova gjithë ngjarjen e keqe, tuke porositur drejtorin Amerikan M. Crowly të përkujdeset për të.

Takoj n'atë kohë që një tjetër veturë e Kryqit Kuq Amerikan ishte kthyer prej Durrësit, edhe kapitan Crowly, me gjithë të keqen q'u ngjau që u çkatërua vetura e tyre e re, po që të m'a çonte në vent nderin që desh të më bënte, më thotë anglisht që u bë si u bë, e humpmë ç'humpmë, po në rast që dëshëronj munt të nisesha prapë për Shkodër me veturën e dytë.

Ju fala nderit fort edhe mbassi dy nursa (infermiere të K. Kuq) më fashojnë krahun me epidesme, si dhe kokën e çarë, u pregatita të nisem, dhe ardhi edhe vetura e dytë. Aty u ndoth edhe Dr. Turtulli, anëtari i Këshillës së Naltë, të cilit ja tregova gjithë ngjarjen. Po kur zura të hipinj në veturë, më theri këllku i këmbës së mëngjër, e thira fort, e s'munda t'a ngrej dot përpjetë! Ahere më mer shpejt Dr. Turtulli brenda në një odë të veçantë, më çvesh e kur më sheh se kisha një plagë të madhe në këllkun e mëngjër, ku përmbi dy kile gjak i zi krejt ishte mbledhur tuke entur fort këllkun, më shtrin mbi krevat, më lau plagën me ndihmën e të dy infermjerave të K. Kuq, m'a lidh këllkun edhe gjithë këmbën me allçi, e më shtrin në krevat, tuke më porositur të mos lëviz fare nga vendi, edhe se është nevojë të ri të paktën 20 ditt në shtrat.

Deh, hall'i math që më gjeti! Ç' të mendonja tani, shtëpinë që po më priste? Vehten që e shihnja në atë ditë, apo të dhemburat e mbëdha që më zunë, apo gjithë ato të holla që humba!

Dërgova shpejt fisin t'em Petraq Korçarin, kushërirën e gruas s'ime, që e kisha emëruar drejtorin e të ardhurave në Financë, mbassi kisha dy javë e ca që kisha marrë përsipër edhe Ministrin' e Financave, se titullari i saj, Tef Currani kishte shkuar me një misjon në Romë.

Atë natë ç'kam hequr nga të dhëmburat varrit do t'ja rëfenj! Gjëndje e paduruarshme. Më vinte të vras vehten të shpëtonj! Mezi qetsohesha me inzheksjone morfine. Vajta kështu plot 18 ditt. Nuk do t'a harronj.

Pas dy ditsh ardhi edhe ime shoqe me djalin t'em në Tiranë, në një shtëpi që kisha zënë me qira, ku rijnim tok me Kristo Dakon, i cili bashkë me një infermjere të K. K. Amerikan, më bënin shumë hyzmet.

Me këtë shkak u shkëputa nga Shkodra.

Si u bëra mirë dolla prapë në zyrë, dhe ahere drejtonja që të dy ministritë, të Arësimit e të Financavet.

Gjithë personelin që kisha, si në njërën ministri, si në tjetrën, i kisha rregulluar e shtruar mirë në punë.

Piksëpari u mendova t'i plotësonj e t'i zbukuronj me mobilet e duhura gjithë ministritë, prandaj binda Këshillin Ministror të më vendosë një kredi prej fr. arit 200. 000 dhe kështu me këto brenda në një muaj të gjitha ministritë kishin mobila të reja, kolltuke, kareklla, divane, arqiva, teftera, telefone – se vetëm Kryeministrija kishte vetëm një telefon dhe ministri' e

tjera asnjë, as zyrat e tjera, kurse unë i mbusha me telefona të gjitha zyrat, gjithashtu bleva qilime e shtresa të tjera, përdhe, dollape, shkrestore etj. etj. kështu edhe një i huaj që vinte kuptonte se hynte në një ministri për të qënë.

Ndërkohë u kujdesa edhe për pullat e reja poste të Shtetit edhe porositmë shpejt e shtypmë 650. 000 seri të ndryshme, gjithashtu u përkujdesa edhe për shtypjen e re të pullave të monopolit, që ishin aqe të nevojshme. Në pak kohë u gjentmë në rregull.

Po ministri titullar i P. Brendëshme s'kishte ardhur akoma në Tiranë edhe n'a lajmëroj se nuk do vinte. Atë ministri e drejtonte provizorisht, ministri i Drejtësisë Xhafer Ypi. Pra ishte nevojë të emërohej një ministër i P. Brendëshme, që të mos mbetej vakante.

U mblothmë disa herë në Këshillën Ministrore për një vendim të këtillë edhe secili prej nesh propozoj edhe nga një kandidat. Nga ana ime kisha propozuar kryetarin e ahershëm të Bashkisë Shkodrës Musa Jukën, me të cilin kisha bashkëpunim tre vjet me radhë, si avokat i Bashkisë së Shkodrës dhe i njihnja e çmoja mirë aktivitetin e math e zotsinë e tij, mirë po shokët s'e pranonin.

Më së fundi, nuk di se kush ja kishte mbushur mëndjen Kryeministrit, po më duket se Dr. Turtulli, që të merte për ministër Refik bej Toptanin, të vëllan' e Mashar beut Toptanit, që ishte edhe patriot (Mashar beu) po edhe poet, kurse Refik beu, i vetë-titulluar "Refik Topia" – ndofta se kujtonte se mos ishte shtërnipi i Tanush e Karlo Topisë, ish përveç se një bulk pasanik. Kjo ngjau, sepse disa ditt më parë më kishte marrë Dr. Turtulli në katundin "Valijas" të Tiranës, t'i bënim vizitë Refik beut, në çifligun e tij, e ku, si biseduam nj'a dy orë, Dr. Turtulli më tha se do t'ishte mirë t'a kishim këtë ministër të P. Brendëshme. Unë qesha ahere me gjithë zembër, tuke ja treguar si një bulk naif, analfabet e krejt injorant, po e pashë se Dr. Turtulli e kish marrë me seriozitet, e ky ja kish rekomanduar Kryeministrit dhe insistoj aqe shumë për të.

I thashë Kryeministrit se do bijnim jashtë me një vendim t'atillë qesharak, po si e pamë që insistonte, s'ja prishmë qejfin.

Kur i dërgoj Iljas beu zyrtarisht emërimin si ministër të P. Brendëshme, Refik Toptani, ose Topija, posa e mori në dorë dekretin e K. Naltë, më vjen mua në shtëpi e më jep një vjershë të gjattë, të shkruar me një stil vullgar e me një mentalitet

qesharak, ku analizonte e përshkruante me vjersha gjithë programin e tij që do zhvillonte si ministër i brendëshëm.

E këndova atë dreq-vjershë – që Zoti e bëftë vjershë – dhe kush e di sa herë ment qesha me gjithë zembër, me gjithë që mezi e këndonja, se ajo gjuhë s'ishte as shqipe, as dreq, po prapë u mbajta, se s'desha t'a përbuz drejt për drejt, tuke respektuar hospitalitetin.

Në atë vjershë qesharake e sui-generis zhvillonte, si thashë programin e tij, një program të çuditshmë, program miturije, që as ajy vetë s'kishte kuptuar ç'do me thënë një ministër i brendëshëm, e si dukej as idhe s'kishte mbi ofiqin, që po thireshe të okuponte.

Aty fliste për bujqësi, për shkolla, për punë botore, për gjykatore, për burgje, për relasjone e politike të jashtme, në një mënyrë bizare e të ngatrume, po aspak s'liste për Prefektura e Nënprefektura e për Bashki e Komuna.

Më pyeti seriozisht si më duket programi i tij, si në pikpamje vjershe, mbassi edhe unë isha vjershëtor ashtu edhe në pikpamje administrative. I thashë me një fjalë, se, që në dy pikpamjet është "pikë".

Ahere m'u lut t'ja paraqitnja Këshillit Ministror për aprovim. Më porositi se nuk pranon asnjë ndryshim; në e pranofshin kështu si e ka, munt t'a merte përsipër atë ofiq që i ofronte Atdheu i dashur, ndryshe jo!

Të nesërmen, si e këndova disa herë atë vjershë të çuditshme, që s'kishte as masë as rimë, që s'kishte as një lidhje e armoni e që s'ishte as vjershë, as prozë, shkova në Këshillin ministror, e si u mblothmë të gjithë, u sillem shokëve e u thom: të ndershëm kolegë, sot kam nderin t'ju parashtronj programin e kandidatit ministër të P. Brendëshme, të z. Refik Topisë,

që më nderoj, tuke m'a dorëzuar mua, e tuke më ngarkuar t'ju a zhvillonj. Po me qenë se kadidati ministër është edhe vjershëtar, prandaj programin e tij ka nderin t'ju a parashtrojë në vjershë. U panë sy ndër sy ministrat e zunë të qeshnin. Kryeministri thret kryesekretarin Ferid Vokopolën të këndonjë programin. Z. Kryeministër, i thom, nuk është nevoja të thrisni sekretarin t'ju a recitojë, me gjithë që edhe z. Vokopola është një nga vjershëtarët. Do t'ju a këndonj unë, se e kam honepsur mirë.

Edhe fillova t' ju a këndonj me një stomf të naltë e me gjeste vjershëtore.

Kur dëgjuan kolegët e mij fjalët e para të programit prototyp u shkulë së qeshuri. Ilias beu s'mbaheshe dot së qeshuri; gjenerall Ali Rizaj qante me lott së qeshuri aty edhe Xhafer Ypi, që rinte gjith' i vrejtur, mbante hijet së qeshuri! Unë pasonj, tuke kënduar pikat e tjera, në një mënyrë që mora pozën e një aktori dramatik, tuke haruar se jam edhe vetë ministër. U a këndova aqe bukur, sa kujtuan se janë në theatro!

Si e mbarova, e ze për dore Kryeministrin edhe, mbassi i hoqa verejtjen se, një pikë po të ndryshonte nga këto, kandidati jynë nuk do t'a pranonte ministrin' e brëndëshme, i thashë më së fundi se ky është ministri futur[1] i brendëshëm edhe i shpreha përgëzimet e mija për zgjedhjen që kishte bërë!

Shkuam një orë dëfrimi nga më të bukurat e nga më hymoristiket.

Përfundimi i kësaj ilaro-tragjedie ishte të marim në vent të tij Mehdi Frashërin.

Refik Topija më ardhi pas dy ditt në shtëpi i zembëruar fort se kishte marrë vesh se në vent të tij kishin marrë Mehdi Frashërin. Ç' të të bënj, mor zotni? i thom. Zotrote s'deshe të ndryshojmë as një pikë të programit t'ënt, se po të m'a kishe dhënë këtë të drejtë sot do të ishe ministër i brendëshëm, po tani është tepër von! Iku i zembëruar Refik Topija, po mua më vjen edhe sot keq që s'e mbajta t'a kem atë program, ose të paktën nuk mbajta një kopje, se kishte aqe brilande e margaritarë, ca ishte mëkat të humbiste!

Mehdi Frashëri, të cilin e njihja mirë që në Vlorë e në Elbasan, posa mori ofiqin përsipër filloj nga ca masa të çuditshme. Dëshira e tij ishte të shdukte nga kadrua nëpunësit administrativë të krishterë e t'i ramplasonte me myslimanë! Kur e mora vesh i shkova në zyrë e i thom se është një turp i math të vepronte në atë mënyrë, se Shqipërija nuk u bë vetëm për hatër të muhamedanëve, kur se edhe të krishterët janë bijt' e këtij Atdheut. Më thotë se të 4/5 e popullsisë shqiptare janë myslimanë. Më vjen keq i them se s'ditke as gjeografin' e vendit edhe mos u bëj shkak të bëhen edhe të tjera memorandume, si ajy i Koço Kottës me shokë në Korçë, se ju i shkaktoni këto e n'a ndani shoqi me shoqin.

Si e pashë që s'i mbushej mendja e që insistonte se mysylmanët që do të emëronte ishin më të zotët, shkova e ja tregova Kryeministrit dhe shokëve të tjerë dhe Kryeministri e thiri me një herë dhe bëmë kaqe fjalë, gjersa e unjmë e hoqi dorë prej këtij satrapismi. Po Mehdi Frashëri qysh ahere s'e haronte këtë incidencë dhe nuk shkonim edhe aqe mirë.

Mehdi beu, nuk mjaftonte që ishte i çuditshëm në mendimet e tija, po përzjeheshe skandalisht edhe në detyrat e kolegëve tjerë, gjë që shkaktoj një grindje të madhe midis nesh e atij, se n'a prishi gjithë armoninë që kishim ma parë, gjer sa intervenoj vetë Kryeministri e një ditë përpara meje e ministrit të luftës, kolonel Selahudin Shkozës e qertoj shumë ashpër, sa i tha më në funt, se po t'a përseritte prapë do t'a shtërngonte të jepte dorëheqjen, ose do të jepnim ne të tjerët dorëheqjen. Kështu ja ndalovi pak hovin Mehdi Frashërit. Po me mua s'pajtoheshe akoma.

Një dit n'a ngjau një tjetër sent, edhe kjo prapë i detyrohet inkapacitetit e mendimit, ose mentalitetit të çuditshëm të tij.

Gjendarmërija e Gjinokastrës kish për të marrë nj'a 50. 000 e sa fr. arit, rrogat e tyre. Për këtë e kishim shtërnguar Prefektin e Gjinokastrës Kol Tromarën, t'i jepte urdhër drejtorit të Financave të Gjinokastrës që t'u a paguante. Edhe Prefekti e urdhroj drejtorin e Financave që

[1] futur = i ardhshëm (H. K.)

ishte Lame Karecua, që më von u bë edhe ky ministër i Financave, po Lame Karrecua s'dëgjonte as një urdhër tjetër veçse urdhrin e ministrit të Financave, urdhrin t'em. Kur më pyeti me telegraf, ju përgjegja mos paguaj as ovull[1] gjer sa të paraqitin Gjendarmërija kuadrin e të liquidojë hesapet e saj me Financën e Gjinokastrës.

Po kjo përgjigje e zembroj shumë Prefektin e çuditshëm Kol Tromarën (i cili harroj se tjetër herë ishte shërbëtori i jem në Amerikë e më lante pjatat), e më drejton një telegraf më një mënyrë gjysmë brutale, ku më porosit t'a pushonj nga puna satrapin drejtor të Financave, Lame Karecon.

Unë s'i dhashë as një përgjigje Kol Tromarës, veç se ja solla telegramin në kopje Ministrit të Brendëshëm, e kërkova t'i hiqet vërejtja Prefektit të Gjinokastrës. Po Mehdi Frashërit këjo nga njëri vesh i hyri e nga tjetri i dolli.

Nga ana tjetër Kol Tromara i heq një telegram shifër M. Frashërit, ku i tregon gjattë e gjërrë situatën e i thotë se oficerët e Gjendarmërisë së Gjinokastrës duhen paguar me domosdo edhe shpejt ndryshe menasojnë se do revoltojnë etj. etj. edhe Mehdi Frashëri me gjithë ment i jep prapë urdhër shifre Kol Tromarës e pa shumë të kthyera e të vërtitura i thotë t'i prijë Gjendarmërisë (oficerëve), të vejë me këta në Financën e Gjinokastrës dhe në kundrështoftë Lame Karecua këta të mos e dëgjojnë (!?), po.... të hapin kasën, të marrin të hollat, ose rrogat e tyre, të mbajnë një inventar dhe në tepërofshin t'ja kthejnë arkës së Gjinokastrës!

Gjithkusht munt të imazhinojë se ç'farë soj urdhri ishte ky edhe si kuxoj një ministër i P. Brendëshme të ndërhyjnjë në detyrat e ministrit të Financave me një mënyrë kaqe paradhoksale, me një mënyrë kaqe budalla! Ku ishim ne? Ku rronim? Kishim qeveri apo anarqi të plottë? E bënte këtë, jo një ministër i brendëshëm, po edhe një njeri me pesë para ment? Ky ishte hyneri[2] i Mehdi Frashërit, të cilin e pagoj shumë shpejt, hajvani, gomari[3]!

Drejtori i Financës së Gjinokastrës, po sa që e lajmoj Prefekti Kol Tromara se do vijshin në zyrë të tij e të gjëndej gati, se kishte urdhër (!) të paguheshe Gjendarmeria, ajy u habit edhe më një herë më telegrafon me shifra ç'i ngjet. Shpejt kapa telefonin, se s'priste puna, e i thom të ndryhet brenda në godinën e tij, ku ish edhe arka, e të mos permetojë as një ndërhyrje, as mos paguaj as një ovull, gjer sa të marrë urdhër të ri prej meje. Të kundrështojë me ç'do mënyrë kundra një vandalismi kësodoret!

Si mbylla telefonin me Lame Karecon, kërkova Kryeministrin, i cili atë ças po hante bukë, se ish ora e drekës. I them në telefon hyneret e Mehdi Frashërit, gjë që e zembroj fort e më porosit që ora dy ponktualisht[4] të jem në zyrë të Kryeministrit me gjithë korespondencën përkatëse të kësaj çështjeje, se do t'a zgjidhte vetë ajy këtë punë të çrregullshme, që kalonte ç'do kufi.

Unë m'anën tjetër lajmova telefonisht edhe ministrin e Luftës, kolonel Selahudinin, që ish njeri i drejtë e serioz e që më desh e më çmonte fort mua, e i thashë ç'ngjau me M. Frashërin, si dhe ç'do ngjiste me oficerët e Gjendarmerisë së Gjinokastrës pas pak ore, e e pyeta në dinte gjë. Ajy vërtet s'kish haber prej këtyre manovrave të M. Frashërit, edhe kaqe u xhindos e u ndez kur ja thashë, sa ngrihet vetë e më vjen në shtëpi, ku ja tregova edhe më mirë çështjen dhe e kurdisa bukur, që t'a kem edhe atë me vehte.

Në orën dy mbas dreke ishin lajmëruar gjithë ministrat u ndothmë prezent në Kryeministri si edhe M. Frashëri.

---

[1] ovull = monetë turke me vlerën më të vogël (H. K.)

[2] hüne = mashtrim, mbrapshti, ligësi etj. (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

[3] Këto dy fjalët e fundit (hajvan e gomar) janë shtuar disa kohë më vonë shkrimit të origjinalit nga Kristo Floqi. Boja dhe penda e përdorur është dukshëm i ndryshëm nga penda e boja që ka përdorur vazhdimisht autori i kësaj autobiografie. Gjithashtu edhe germat e këyre dy fjalëve nuk më duket se janë si germat që përdor K. Floqi, me të cilat unë u ambjentova se kam mbi dy vjet që merrem me 'to, kështu dyshoj se këto dy fjalë janë shtuar pas sekuestrimit të dorëshkrimit dhe depozitimit të tij në AQSH. Megjithate.... (H. K.)

[4] punktualisht = ekzakt, me përpikmëri (H. K.)

Posa që u hap mbledhja mora fjalën unë, tuke expozuar çashtjen me ngjyrat më të zeza e tuke tuke protestuar rreptësisht për mënyrën bizare sa edhe arbitrare, me të cilën kishte ndërhyrë në kompetencën t'ime ministri i brendëshëm prototyp. Kërkova që imediatisht të marrë prapë urdhrin që i dha Prefektit vandall të Gjinokastrës dhe me atë bashkë ndëshkimin e këtij Prefekti.

Si mbarova unë ju turr ministri i Luftës me një mynyrë krejt ushtarake e i foli kaqe rëndë, sa ment ardhë edhe në duart, po intervenuan[1] shokët e tjerë e mezi e qëndruan kolonel Selahudinin, i cili kish shumë të drejtë se i ndërhyri edhe atij në detyrat e tija!

Ahere e vuri përpara Kryeministri e s'e mbanj ment as unë ç'i tha, po me dy fjalë e vuri në vent, tuke i thënë akoma se këto gafat e këtij s'paskan të sosur! Gjith' ashtu ju vërsulë edhe ministrat e tjerë.

M. Frashëri ahere u topit e s'kish se ç'të theshte. J'a hodhi fajin kryesekretarit të tij Rauf Ficos, po edhe ky ja tha përpara nesh, kur e thiri, se pa urdhrin e tij ajy s'munt të bënte gjë. Edhe ashtu ishte vërtet. Mehdiu i gëlltiti të gjitha!

U shtërngua pastaj t'i telefononjë Prefektit Gjinokastrës të rijë urtë, se edhe ministri i Luftës i telefonoj Komandantit të Gjendarmërisë Gjinokastrës të shmanget nga kjo marrëzi, se ndryshe do t'i ndëshkonte rrebtësisht atë edhe oficerët e tjerë bashkëpunues, edhe të mos kuxojnë më të kërkojnë të holla pa paraqitur kuadrin e tyre e pa likuiduar përpara marrjet e disa somave nga an' e tyre. Kështu pas një ore lajmërohesha prej Lame Karecos nga Gjinokastra se punët u zbutnë edhe se atë e lanë të qetë.

Si u mbaruan këto kërkova prej Kryeministrit që M. Frashëri të çfaqte solemnisht përpara Këshillit hidhërimin e tij për sa ngjanë e të më kërkonte pardon. Edhe me që s'unjeshe M. Frashëri, un' u ngrita e kërkova të më pranohet dorëheqja, se s'kisha vent si ministër në atë Këshill. Gjithashtu bëri edhe ministri i Luftës, sa u shtërngua M. Frashëri të n'a kërkojë që të dyve pardon! Kështu e pësojnë budallenjtë!

Mbeti pastaj çështja e ndëshkimit të Prefektit. Po M. Frashëri e kishte dhënë vetë urdhrin si të bënte tani, t'a lëpinte? Thotë Kryeministri se mjaftonte gjer këtu, po ne tok me ministrin e Luftës vumë këmbën që të dy, e kështu me vendim të Këshillit t'onë ju pre gjysma e rrogës Prefektit Gjinokastrës me shënimin që po t'a përsëriste edhe një herë do të pushoheshe nga puna. Kështu Kol Tromara e frynte e s'ftoheshe edhe ndenji, si thotë fjala, më lark se shokët.

Këjo që ngjau në Gjinokastër n'a ngjau edhe neve këtu pas 5 ditsh qysh ahere.

Oficerët e Gjendarmerisë këtu n'a u ankuan pse s'u paguajm rrogat edhe si u lidhë me korespondencën e gjattë që hoqnë me mua, që i porositnja gjithnjë të rregullonin hesapet e tyre me Arkën e Min. së Financave dhe pastaj të kërkonin të paguheshin, ata një ditë më vijnë en grup nj'a 5-6 oficerë, të kryesuar prej nënëkolonel Tatzatit dhe më shtërngojnë që ja t'iu paguanj që atë çash 140. 000 franga ar të rrogave ja se.... . (është për t'u çuditur nga ndo një herë me këtë mentalitetin e Shqiptarit) do të rrethonin Tiranën me 400 e ca gjendarmë!

Këtë ja kishin thënë edhe Kryeministrit e ishte trembur mjaft e më telefonoj edhe mua që, aman, aman, t'u jap ç't'u jap që të n'a çporren qafet, se atë ditë prisnim edhe ministrin e jashtzakonshëm të Anglisë, Mr. Hares-in, i cili vinte si i dërguar i jashtzakonshëm i Britanisë së Madhe.

Ju përgjigja Iljas beut telefonisht se nuk u jap as pesëshin, gjer sa të mos rregullohen, edhe fajin, i thom hithma mua. Kështu që Kryeministri m'i dërgoj mua të gjithë këta oficerë, që më ardhë si xhelatë përsipër.

Ju thashë, zotrinj, mblithi mëndjen e rregullohuni me Arkën e Shtetit, si ju kam porositur shpesh herë edhe sa që të liquidohen hesapet jam gati t' ja u paguanj.

[1] intervenuan = ndërhynë (H. K.)

Por ata s'dëgjonin prej fjalësh, gjer sa u ashpërua bisedimi, edhe s'patnë turp të më thonë sheshazi se, në mos ju dhënça të hollat gjendarmërija do të qarkonjë Tiranën, dhe s'marrin as një responsabilitet për ç'ka do të ngjasë!

Ju thashë edhe një herë se atë ditë prisnim ministrin e Anglisë edhe është turp për ata të mendohen kësij gjërrash, që cënojnë e poshtërojnë dinjitetin e Shtetit! Po prapë s'dëgjonin dhe fundi i fundit m'u kërcenuan edhe mua. Ahere u ngrita me inat e ju thashë të dalin jashtë e këta duall e më lanë vetëm!

Si ardhi ministri i Anglisë dhe paraqiti letër-kredencjalet e u akreditua pranë Shtetit t'onë, vura në rrugë çështjen e rrogave të Gjendarmërisë me anë të një komisjoni financjer dhe përfundimi i hetimeve ishte që, jo vetëm që s'u detyroheshe Financa rrogat që pretendonin, por ata i kishin edhe borç Arkës një shumë prej fr. ari 647. 80, prej paradhëniesh, që kishin marrë. Kështu jo vetëm s'ju dhashë gjë, po ja u mbajta nga rrogat dhe deri sa hoqa dorë nga ministrija e Financave, ato të holla, ju a zura në hesap gjer në santim.

Po pasonj akoma mbi gafat e M. Frashërit. Po do mjaftohem të tregonj vetëm atë më karakteristiken, që të mos i përshkruanj të gjitha.

Asokohet Misjoni Amerikan me qendrë Tiranën, i cili kish edhe institutin e Kryqit të Kuq Amerikan, kishte çfaqur dëshirën të ngrehte një shkollë të madhe teknike (Vocation schooll) dhe për këtë kish kërkuar edhe ndihmën morale e materjale të qeverisë s'onë.

Si e biseduam çështjen hollë në Këshillën t'onë u vendos e m'u vue për barrë mua të bënj tratativat me drejtorin e Misjonit, që ishte po ajy kapitani Amerikan Crowly, për të cilin kam bërë fjalë më sipër. Nga ana tjetër unë me të dy kualitetet edhe si ministri i Arësimit edhe si ministri i Financavet, isha autorizuar prej Këshillit t'i jap deri në 60. 000 fr. arit, një ndihmë materiale, kur se Misjoni Amerikan do autorizonte gjer më 150. 000 fr. ar të tjera për ndërtesën e shkollës, për sendet e saj, për ambullancën e K. Kuq e mobilet e tjera dhe për personelin.

Pra, tratativat kishin filluar midis mejet edhe kapitan Crowly, të cilin e kisha edhe mik të veçantë. Po kur ardhi çështja në të hollat, kapitan Crowly i deshte për një herjesh të 50. 000 frangat t'i merrtë ne dorë, kur se unë këto të holla do t'ja jepnja me kondita brenda 2 vjetve, prej datës që do të ishte goditur prej atyre ndërtesën e shkollës teknike. [1]

Kapitan Crowly, si e pa se s'më bindte dot t'ja derthnja me një herë këto të holla, shkoj disa herë ne Kryeministri e ju lut, dhe ky më tha edhe mua e më dërgoj edhe nj'a dy kart-vizita për këtë punë, po unë nuk dëgjova t'ja jap. Më së fundit i thashë Mr. Crowlyt se s'kishte lezet të përdorte mjete e influenca tërthoraze, se nuk do të fitonte gjë, po t'u shtroheshe konditave që i kisha caktuar.

Mr. Crowly, si e pa se s'mbaronte dot punë, u mendua një ditë të thresë gjithë Këshillin Ministrial për një çaj në ora 4, kur se mua në invitacjonin që më dërgoj më kishte caktuar orën 5 pas dreke, d. m. th. një orë më von se kish ftuar kolegët e mij, edhe këtë e bëri që të kish kohë t'a goditte me ata më parë çështjen e të hollave që i duheshin e kur të vinja unë t'a kishte gati, se kujtonte, se po të më imponoheshin shokët nuk do thesha gjë.

Unë pa ditur gjë shkova ponktualisht në ora 5, po, kur po sbathnja llastikat, se ishte kohë shiu, një zojushe, Miss Williams, që shërbente edhe ajo pranë K. Kuq Amerikan, kur po më merte kapellën edhe ombrellën prej duarve, pa ditur gjë, më

thotë anglisht: Zoti Ministër, pse arthtë kaqe von? Shokët t'uaj kanë një orë që kanë pirë çajin!

Këto fjalë të Miss Williams më habitnë fort, se s'pandehnja një Amerikan të delte jashtë kufive të etiqetës. E mora vesh pse e kish bërë këtë kapitan Crowly, po u mbajta e s'fola gjë,

[1] Dokumentat zyrtare për këtë ngjarje ndodhen në AQSH Fondi i Ministris Arsimit 1920 Nr. 195-55-006, 007, 010, 011, etj. Shifrat përputhen plotësisht. Duke qenë se 20 fr. ar në atë kohë shkembeheshin me 1 monedhe floriri prej 6 gram, i bie që amerikani ka kerkuar nga arka e Shtetit Shqiptar 3. 000 (tremijë) monedha floriri (H. K.)

veç u mjaftova t'i them zojushës Engleze se kisha punë pa mbeta von, edhe se Mr. Crowly do m'a falte.

Në atë kohë, tuke qenë i informuar dolli edhe kapitan Crowly me një Engles tjetër e më pritnë ne dera e sallonit ku ishin mbledhur edhe kolegët e mij, të cilët, posa hyra u ngritnë të gjithë, përveç Mehdi Frashërit, i cili s'lojti nga vendi.

Si ndenja afër kolegut ministrit të Luftës Selahudin Shkozës, më suall një çaj. Aty më thotë me një herë ministri i Luftës, që pse u vonova të vinj në çaj, kur se ata kishin një orë atje. Unë nxora e i tregova letër-ftimin e Crowlyt, që më kish ftuar në orën 5 edhe ajy u çudit. E pyes ç'ka po bisedojnë kaqe orë me kapitan Crowlyn, e më tha se bisedojnë për çështjen e shkollës teknike, po unë s'fola gjë, me gjithë që u nxeva mjaft.

Si shkuan nj'a 2-3 minuta, M. Frashëri, i cili kishte një listë në dorë me disa shkrime të shkruara me lapis e nxjer prapë atë listën edhe i sillet në gjuhën frëngjishte kapitan Crowlyt që rinte kundrejt atij e i thotë të pasojnë bisedimin. Kapiten Crowly, i përgjigjet e i lutet t'a lenë për një ditë tjetër, po si e pa se M. Frashëri insistonte t'i jepej funt çështjes sa më parë, Mr. Crowly nuk insistoj.

Vrejta ahere mirë edhe dëgjonj M. Frashërin t'i thotë M. Crowlyt, se do t'i bëhet çareja që t'i marrë të 60. 000 fr. në dorë, po duhet të mbeteshin d'accord më parë sa klasa do ketë shkolla, ç'personel, edhe nga do merrej personeli, ç'profesjone do të merreshin e disa gjërra të tjera. Ahere m'u nxeh gjaku edhe i sillem M. Frashërit, tuke i thënë ç'po bisedonte me Crowlyn. Z. M. Frashëri s'e bëri as kabull të më përgjigjet sidomos par politesse, po unë s'e pushova fjalën. I thom: ju po bisedoni këtu për të hollat e Shkollës teknike që Ministrija e Financave do t'i japë K. K. Amerikan, po duhet t'a dijni më parë se s'kini as një kompetencë për këtë bisedim edhe ndërhyni padrejtësisht në kompetencën t'ime, si Ministër i Arësimit, kur se unë edhe si ministër i Arësimit edhe si ministër i Financave jam autorizuar prej Këshillit Ministror e jam lënë i lirë t'a rregullonj vetë këtë çështje, për të cilën as një prej jush s'ka të drejtë të ndërhyjë e të kundrështojë edhe se për këtë çështje kemi kaqe kohë që kemi hyrë në tratativa me Mr. Crowlyn. I sillem ahere edhe Kryeministrit edhe ministrave të tjerë: Ju zotërinj, ju thom nuk m'a kini lënë mua këtë të drejtë? Nuk e kini nënështkruar vendimin e Këshillit për këtë punë? Ke të drejtë të plottë, thotë Kryeministri. Ashtu është vërtet përgjigjen ministrat e tjerë. Po ahere, u thom, për këtë punë jini mbledhur këtu? Jo, thotë Kryeministri, këtu jemi thirur vetëm për një çaj. I sillem M. Frashërit: Po, z. s'ate, i thom, kush t'a dha këtë të drejtë? Pse përzjehesh në punët e mija? i thom. A jam përzjerë kurrë unë në kompetencat e tua?

Këtë fjalë po i bisedojmë frëngjisht që ta marrë vesh çështjen edhe kap. Crowly edhe ministri i Luftës, i cili, me gjithë që ish ministër i Shtetit Shqiptar, mjerisht.... nuk dinte Shqip

Një tavatur mjaft karakteristik bëhet atë ças. Kryeministri gjendet në një vështirsi të madhe e kërkon t'i hedhë gunën çashtjes, se e pa se ra në gabim. Ministrat e tjerë më kërkonin ndjesë e më këshillonin mos e zgjat më tutje. Ministri i Luftës u zembrua mjaft me gafën trashanike të M. Frashërit, e po e qërton turqisht që nuk ka pushuar akoma së bëri gafa, e se kjo n'a expozon në syt' e të huajve etj, etj.

Ahere i sillem Mr. Crowlyt anglisht i thom :Mr. Crowly, nuk e mendonja kurrë nga z. juaj që me pretekstin e çajit, n'a paski ftuar të bisedojmë për çështjen e të hollave të shkollës, që kërkoni prej nesh, se duhej t'u mjaftonja unë, si ministër i Arësimit e i Financave bashkë. Nuk ju jap të drejtë kurrë të mburri nesër-pasnesër se e thirtë këtu gjithë Këshillin Ministror të Shqipërisë edhe me një çaj që i gostittë mbaruat punën t'uaj! Veçanërisht më vjen shumë keq për hesapin t'uaj që jeni një gentlemann, një Amerikan i qytetëruar edhe me gjithë'ato kaluat kufirin e politesës, tuke ftuar kolegët e mij një orë më parë se mua, edhe mua në orën 5 pas dreke për çaj si e si të përfitoni t'a pregatitni punën, që kur të vinja unë të gjëndesha përpara përpara një fait-accompli-je! Për këtë do të ankohem edhe në Directoryn e përgjithëshme të K.

Kuq Amerikan në Washington, që të merni vesh se Shqiptarët, e sidomos ministrat shqiptarë nuk e hedhin poshtë prezdishin! (prestigjin? ? H. K.)

Edhe me një herë u ngrita të shkonj edhe bashkë me mua u çua edhe ministri i Luftës. Kapitan Crowly u zbeh në fytyrë kur dëgjoj këto fjalë të hidhura që i thashë edhe s'dinte as ajy si të bënte! Më mori më nj'anë e më kërkoj një mijë ekskuza[1], tuke m'u lutur t'ja fal e mos bëj demarshe të tjera, po unë s'e dëgjonja!

Dolla jashtë, mora kapellën e ombrellën po bashkë me mua duall edhe Kryeministri me kolegët e tjerë, salutuam, sidomos unë, ftohtësisht kapitan Crowlyn e shkuam.

Të nesërmen i dërgova një memorandum të gjatë K. Kuq Amerikan të Washingtonit, të redaktuar anglisht, ku i çvillonja hollësisht të ngjarat dhe i ankohesha kundra sjelljeve të kapitan Crowly.

Ky memorandum bëri përshtypje të madhe në Washington dhe pas dy muajve Mr. Crowly u urdhrua të lerë Tiranën. Në vent të tij ardhi Mr. Black, një

burrë i mirë e i matur, i cili kishte urdhër të trajtonte me mua kontratën, tuke pranuar pikë për pikë konditat e mija, edhe ashtu u bë e mori funt kjo çështje!

Një tjetër gjë n'a ngjau ato ditt me Gasper Beltojën, të cilin unë e kisha dërguar Drejtor të Arësimit në Shkodër, si kur se kam folur më sipër.

Një shumicë populli të Shkodrës kishin ankima personale kundra atij. Si u ankuan në Prefekturën e Shkodrës, pastaj edhe në Bashki edhe më së fundi të kryeipeshkvi i Shkodrës, Emzot Seregji te e mbramja m'u ankuan edhe mua për atë me një memorandum me 200 e ca nënëshkrime, vula e gishta. Unë u përgjegja se s'munt t'i mernja parasysh ato ankime, mbassi nuk ishin prej atyre që kishin relacjon me Gasper Beltojën, si drejtorin e Arësimit.

Po populli i Shkodrës nuk mjaftoj deri këtu. Bën një tjetër raport të gjatë, ku perzjen edhe çështje administrative arsimore në disfavor të G. Beltojës e kërkon pushimin e tij nga ajo drejtori.

Në atë raport të gjatë që kishin bërë, kishin marrë pjesë edhe nj'a 5-6 msues të SShkodrës, të cilët kishin ambicjone personale kundra Gasper Beltojës. Këtë lutje ja kishin drejtuar Këshillit Ministruer, me insistimin që G. Beltoja të pushoheshe iiimediatisht nga detyra e tij!

Këshilli ministrial m'a solli mua, me anë të Kryeministrit dhe unë ju përgjigja që nuk shoh ndonjë arsyje ligjore t'a pushonj nga puna, tuke shtuar se të dëmtuarit munt t'i silleshin drejt për së drejti Gjyqit kompetent. Nga ana tjetër i dënova më prerjen e gjysmës rrogës mujore gjithsecilin prej msuësve që kishin marrë pjesë në atë raport, tuke u hequr vrejtjen, që, në rast përsëritjeje, do mernja masa të tjera kundra tyre.

Kryeministri më foli veçanërisht që të mos e bënj çështje të madhe këtë, edhe mbassi e kërkon edhe Këshilli i Naltë, s'duhet t'ju a prishim

I përgjigjem Kryeministrit se Shkodranët ankuesa, nga sa shoh unë s'kanë të drejtë, veçse e kanë marraz Beltojën, se ka kryer seriozisht detyrën e tij, pa mbajtur as një hatër e që s'mundem të pushonja pa arsye të forta një nëpunës që s'më ka dhënë as më të paktin shkak pazotsije, as për mungesë tjetër administrative, gjithashtu se s'mundem t'a pushonj për hatër të njërit e të tjetrit, qofshin këta edhe Këshilltarët e Naltë.

Kryeministri, sa do që i dëgjoj mirë arësyetimet e mija, po tuke u shtërnguar nga Këshilli i Naltë, e sidomos nga Monsignor Bumçi, i cili interesoheshe personalisht në këtë çështje, edhe mbassi nuk më bindi dot s'di se qysh i kish dhënë fjalën Emzot Bumçit, që, edhe në mos desha unë do t'a pushonin me vendim të Këshillit Ministrial.

Kur e mora vesh këtë, pjek Kryeministrin e i thom që, shëkoni mirë mos bëni ndonjë punë të këtillë, se nuk është e drejtë, as që kini të drejtë të përzihi në detyrat

[1] ekskuza = kërkoj falje (H. K.)

e mija, mbassi çështjen e emërimit e të pushimit të nëpunësve të Arësimit m'a kini lënë mua exkluzivisht si Këshilli Ministror ashtu edhe Këshilli i Naltë i Shtetit.

Pas dy ditësh, kur ardhi prapë kjo çështje për bisedim, vura re se Kryeministri me gjithë kolegët e tjerë deshin t'a pushonin Beltojën me vendim të Këshillit Ministror, se ishin tepër shtërnguar nga Këshilli i Naltë.

Si e pashë se s'bëheshe ndryshe e se Beltoja, desha s'desha do të pushoheshe nga puna, se VOX POPULI VOX DEI, ju thashë shokëve, se këtë çështje e konsideroj si përbuzje e shkelje të detyravet e të nderit t'em, se çështjen e Beltojës e shoh si një çështje që drejtohet kundra personit t'em mbassi unë, si kompetent në këtë punë nuk isha i mëndjes të pushohej Beltoja, sepse e kishin atë në sŷ disa Shkodranë katholikë, kur se këtij s'i gjenja as një faj vetë. Më së fundi ju thom, se po të vendosin kështu si po duan, jam i shtërnguar të jap dorëheqjen.

Kryeministri zû të qeshte si edhe kolegët e tjerë, se s'besonin, se për një çështje kaqe të vogël, si kujtonin ata, unë do jepnja dorëheqjen.


Fundi i fundit shokët vendosnë pushimin e Beltojës për shkak pazotsije edhe vendimin m'a komunikuan mua me një herë që t'a vinja në veprim. Ahere mora gjithë dokumentat që provonin zotsinë e kapacitetin e Beltojës, prej të cilavet as idhe s'kishin kolegët e mij, të cilët shkuan pas behrijajit, dhe bashkë me ato dokumenta trajtova edhe shkresën e dorëheqjes s'ime, tuke i stigmatizuar këtë punë të keqe që deshin arbitrarisht t'ja bënin Arësimit, dhe kështu shkova në Këshillin e Naltë e ju parashtrova dorëheqjen t'ime.

Aqif Pashaj edhe Dr. Turtulli, po edhe Abdi Toptani, që s'e dijnin edhe aqe mirë këtë çështje si e konstatova, po që ishin të shtyrë tepër prej Monsignor Bumçit, i cili ishte nisiatori i çështjes, kur dëgjuan mirë arsyetinat e mija, kur ju tregova se sa i aftë e ponktual ishte Beltoja në detyrat e tija e si cmirat e disave kishin shkaktuar gjith'atë poterë etj. etj. këta të tre Këshilltarë, përveç Bumçit u habitnë fort edhe e vunë me Bumçin që pse s'u a kishte kallzuar mirë çështjen, po i mashtroj pushimin e Beltojës, sikur të ishte ky një kopuk.

K. i Naltë thiri ahere Kryeministrin, i cili ardhi e më gjet edhe mua në sallonin e bisedimeve të Këshillit, ku Dr. Turtulli i bëri disa verejtje, që pse të vijë puna gjer këtu, sa ministri i Arësimit të japë dorëheqjen, kurse edhe ne edhe ju, i tha, e kemi lënë me dekret të lirë z. Floqi, për emrimet e pushimet e arsimtarëve. Ashtu është vërtet, i thotë Kryeministri, po ne këtë pushim e bëmë më fort për qejfin t'uaj. Ha, kështu qënka tha Dr. Turtulli. Ne kemi pesë para ment sa do pleq që jemi, e s'munt të n'a heqë Bumçi për hunde. Ne dorëheqjen e Ministrit s'e pranojmë, se Ministri paska të drejtë, faji është i joni, edhe i juaji, i thotë, Ilias beut se edhe shkuat pas qejfit t'onë, e jo si e kishit me detyrë.

Përfundimi i kesaj komedie ishte që Këshilli i Naltë hoqi dorë nga pushimi i Beltojës, Këshilli Ministror e anulloj vendimin që dha, unë mbeta prapë ministër i

Arësimit dhe Beltoja në vendin e tij edhe katholikët ankues Shkodranë me kryetar Emzot Seregjin edhe Kel Marubin mblodhnë bishtin e ndejtin rehat.


DR KRISTO FLOQI
506
Quaderno
DI
Autobiografija im
Vol. III

*Vazhdon nga Vol. II*

Nuk shkoj një koh' e gjatë kur u çpall dekreti i Këshillës së Naltë për zgjedhjen e deputetëve, të cilët do ishin përfaqësonjësit e parë të Shtetit Shqiptar. Brenda muajit të Marsit 1921 u bënë zgjedhjet dhe nga fillimi i Prillit të atij viti u çel Parllamenti i parë Shqiptar me përfaqësuesit deputetë të të gjitha krahinavet.

Me qenë se mua nuk më zgjodhë deputet Korça – se nuk shtrova as kandidaturën t'ime, tuke kujtuar se, si një patriot të zgjedhur e një njeri që i shërbeu aqe shume Korçës e rretheve në kohën kritike të vitit 1914, Korça do më zgjidhte spontanisht deputetin e saj – pra u paraqitmë bashkë me kolegët e tjerë përpara Dhomës së deputetëve, ku muarm votën e besimit si kabinet legal, ku unë u çfaqa vetëm në cilsin' e ministrit të Arësimit.

Po unë kisha shumë miq Dibranë dhe pothuajse njihesha me parinë e me mjaft bajraktarë të krajinave Dibrane të cilëvet u kisha sjellë shumë lehtësira si ministër i Financave të cilën ministri e drejtova gati një vjet të tërë, dhe parija e Dibrës nuk i harronte këto, prandaj kur u lejua të nxjerrë deputetët e saj dhe kur mori vesh se Korça s'më zgjodhi deputet, me një herë e pa më pyetur as pak, më regjistruan në listën e deputetëve të Dibrës dhe kur ardhë dita më zgjodhën me tërësin' e votavet deputet të Dibrës. Kështu e fitova edhe këtë ofiq.

Si deputetë të Dibrës u zgjodhë këta: Hassan bej Prishtina, Ilias bej Vrijoni, Hoxhë Kadrija, Kolonel Selahudin Shkoza, Kristo Floqi, Kristo Dako, H. Strazimiri dhe një dibran, s'ja mbanj ment embrin. Ne e përfaqësuam denjësisht Dibrën dhe interesat e saj, edhe si ministra (sepse tre prej nesh bënin pjesë si ministra në kabinetin e Iljas Vrijonit) po edhe pas si dhamë dorëheqjen, si do t'a shpjegonjmë von, si deputetë të thjeshtë të Dibrës.

Në Parlament pas nj'a dy muajsh filluan intrigat, të adresoheshin më fort kundra Qeverisë s'onë. Shkaku ishte se disa prej zotrinjve deputetëve lakmonin kolltuket t'ona.

Kështu deputetët u ndanë në dy parti, në partinë nacjonale, ku pjestonja edhe unë dhe në partinë përparimtare, të cilën e kryesonin Fan Noli me Ahmet Zogun, që prapë edhe këta u përçanë në mes tyre, qysh ditën që Ahmet Zogu u zgjodh Kryeministër e mori frenat e Shtetit në dorë.

Partia kundrështare nuk qëndronte rehat; gjithnjë na qitte pengime. Kush e di sa herë na thiri në interpellancë mua dhe kolegët e mij. Më së fundi Kryeministrit Iljas Vrijoni një dit i plasi shpirti e na mblodhi të gjithve e na tha se deshte të japi dorëheqjen. Un' i thashë se qëndron në vullnetin e tij, sa edhe ne sikur të mos donim të lëshonim kolltukët, do ti lijnim do e mos posa Kryeministri të dekllaroheshe dorëheqës.

Kështu, një pasdreke herë të bukur në muajin e Qershorit 1921, Kryeministri z. Iljas Vrijoni u paraqit përpara Dhomës së deputetëve, me një buzë të qeshur, dhe pa e ditur as kushi, përveç se ne kolegët e tij, ajy bëri një raport të gjatë mbi vepërimet e Qeverisë, dyke provokuar parllamentarët të mbanin shënime e ti përgjigjeshin mbassi të kishte mbaruar fjalën dhe dekllaroj se ishte gati t'ja japë gjithkujt përgjigjen e duhur ajy dhe shokët e tij akoma, do me thënë ne.

Disa deputetë, si Stavro Vinjahu, Ali Këlcyra, Koço Tasi, Luigj Gurakuqi, Bahri Omari, Dh. Kacimbra etj. kërkuan fjalën dhe filluan të atakojnë Kryeministrin personalisht, pastaj edhe ministrat e tjerë, përveç meje e ministrit të Luftës, kolonel Selahudin Shkozës.

Gjithsecili nga ministrat mundnë t'ja japin përgjigjen e duhur interpellatarëve, po Iljas beu, si Kryeministër, s'duroj më tepër, po hipi me një nervozitet të madh në tribunën dhe ju dekllaroj se këto s'janë gjë tjetër përveç se profka, ose sabotazhe, që bëhen vetëm e vetëm për kolltukët, të cilat, tha, Iljas Vrijoni, ju a kemi falur, zotrinj dhe urdhroni të okuponi dyke i lakmuar kaqe fort, prandaj Qeverija kërkon sot prej jush votën e besimit.

Kryetari i Parllamentit Eshfref Frashëri urdhroj gjysmë ore pushimit dhe deputetët u mblodhë në sallën e veçantë të gjërë të Kryeministrisë dhe pas gjysmë oret u riçel mbledhja parllamentare.

Çështja u vu në votë nominative dhe kështu votuan 27 deputetë kondra Qeveris dhe 12 në favorin e saj.

Qeverija me anën e Kryeministrit Iljas Vrijonit dekllaroj se konsiderohet si dorëheqëse e kështu qysh atë ditë Kryeministri, në embër të kabinetit paraqiti dorëheqjen e Qeverisë përpara Këshillis së Naltë, e cila në fillim nuk ka dashur ta pranojë, se e konsideronte si një bllofë, ose një marrëzi parlamentare por mbassi e pa se insistuan shumë deputetë, i këshilloj ata të mendohen mirë për zgjedhjen e një kabineti të ri e sidomos i këshilloj të formonin një kabinet koalicjoni, ku do mernin pjesë edhe ministrat e Qeverisë dorëheqëse.

Kështu Këshilla e Naltë na ngarkoj ne të qëndronim akoma në pozitat t'ona gjersa të formoheshe kabineti i ri i koalicjonit. Në këtë mënyrë ne vazhduam edhe plot dy muaj të tjerë si zëvëndës ministra.

Pas dy muajve qysh ahere e mbas shumë e shumë përpjekjesh e shkëmbime mendimesh u formua më së fundi prej të dy partive edhe kabineti i ri i koalicjonit në këtë mënyrë :

Iljas Vrijoni, Kryeministër pa portofol
Sulejman Delvina, ministër i P. Brendshme
Panteli Vangjeli, ministër i P. Jashtme
Dhimitër Kacimbro, ministër i Drejtësisë
Tef Currani, ministër i Financave
Sotir Peci, ministër i Arësimit
Selahudin Shkoza, ministër i Luftës
Mehdi Frashëri, ministër i P. Botore

Mjerisht, intrigat që nuk mungonin për dita, filluan prapë vepërimet shkatëronjëse të tyre. Sabotazhet filluan në një shkallë të gjërrë kundra Qeverrisë së koalicjonit, e cila, si do shohim më poshtë nuk jetoj më tepër se 4 muaj.

Nga njera anë filloj kryengritja e Mirditës nënë kryesin' e kapitan Marka Gjonit, i cili, i shtyrë prej Serbëve si mercenar dekllaroj të ashtuquajturën Republikën e Mirditës, nënë mprojtjen e Jugosllavisë për dëmin e Shqipërisë. Intrigat e tjera të brendëshme në kryeqytet e në krahinat e tjera të Shtetit Shqiptar kishin marrë rrugën e tyre, sidomos në Dibër, ku shënoheshe një lëvizje e madhe kryengritëse, nënë prijësin' e Elez Jusufit.

Qeverija e Koalicjonit, sado që dërgoj ushtri të mjaftë sidomos në Mirditë s'munt t'ju bënte ballë çetave të mbëdha kryengritëse, të përkrahura edhe nga ushtritë Serbe me artilerit' e tyre të rënda.

Nisiatorët e lëvizjes mundnë të futin në rrethin e tyre edhe disa patriotë të tjerë të shënuar midis të cilëvet edhe një shumicë deputetësh të Parllamentit të Tiranës.

Nuk shkoj shumë kohë dhe u formua në Tiranë i ashtuquajturi "Grupi i shenjtë". Ky grup fillonj të vepëronjë me një mjeshtri e finecë të jashtzakonshme për të rëzuar Qeverin' e Koalicjonit e për të ardhur ata në fuqi.

Në atë kohë bëhet një mosjon në Parlament për të rezuar deputetët e Drinit ose të Dibrës, pse gjoja ishin zgjedhur ilegalisht. Me një herë u përkrah mosjoni dhe u muar vendimi i Parllamentit për rëzimin e këtyre deputetëve, të cilët edhe i rëzuan. Kështu deputetët e Dibrës, bashkë me të cilët edhe unë u xhvazmë nga ajo detyrë.

Po Grupi i shenjtë nuk mjaftoj me kaqe. I vuri qysqinë nga themelet edhe kabinetit bujë math të koalicjonit dhe s'ju ndah as pëllëmbën, gjer sa më 16 Tetorit 1921 e rëzoj.

Grupi i shenjtë ja ngarkoj Panteli Evangjelit formimin e Qeverisë re.

Vërtet Panteli Vangjeli e formoj Qeverin' e re, po prapë se prapë anëtarët e Qeverisë, të udhëhequr nga Grupi i shenjtë, pas pak ditsh filluan intrigat edhe kundra Panteli Vangjelit, të cilin deshnin t'a rëzonin.

Njëkohësisht Grupi i shenjtë vendosi të suprimonte edhe Parllamentin. P. Vangjeli s'merte vesh se suprimimi i Parllamentit ish për dëmin e rrezikun e tij. Grupi i shenjtë ju

imponua edhe Këshillit të Naltë, i cili nënë shtypjen e fortë të grupit, desh s'desh u shtërngua të lëshojë dekretin e suprimimit të Parllamentit.

Kështu, më 4 Nëntorit 1921 vetë Panteli Evangjeli u detyrua të invokojë mbledhjen e deputetëve me anën e Kryetarit të Parllamentit Eshref Frashërit, dhe po atë ditë, pa ditur asnjë nga parllamentarët vendimin e Këshillit të Naltë, P. Evangjeli, midis një pushimi të thellë recitoj nga tribuna këtë dekret :

"Këshilli i Naltë i Shtetit Shqiptar, tue marrë parasysh situatën politike të përjashtme të mvarrur dhe gjendjen tepër delikate, të krijuar prej ngjarjeve të fundit të papritura nga an' e Veri-Lindjes, dhe tue e pa nevojën e domosdoshme të një veprimi më të lirë të Qeverisë për ti bërë ballë situatës së vështirë, e tue u mbështetur në zakonet e adoptuar konstitucjonare, dekreton mbarimin e këtij sesjoni extraordinar të Parllamentit dhe urdhron konvokimin e tij më 4 Janar të vitit 1922".

Ky grusht - shteti, që s'e pat shembllën në historinë politike, i ra si një rrufe Parllamentit e e habiti fare! Si u nda P. Evangjeli, filluan bisedime të gjata midis parllamentarëve, të cilët më në funt përfunduan të mos mblidhen, si kishte caktuar Këshilli i Naltë më 4 Janarit 1922, po më 1 të Janarit të atij viti.

Tani ardhi radha e P. Evangjelit. Këshilli i Naltë, nënë presjonin e Grupit të shenjtë, filloj të shtërngojë P. Evangjelin të japë dorëheqjen, po Pant. Evangjelit s'i pëlqente të lëshonte kolltukun! Ahere 4 prej ministrave të kabinetit, midis të cilëvet edhe Zija Dibra, kapitan e ministër i P. Botore dhe Ahmet Dakli, ministër i Financave dhanë dorëheqjen spontanisht, kështu që desh s'desh u shtërngua edhe P. Evangjeli si kryeministër të japë dorëheqjen. Thonë se Zija Dibra me revolverin në dorë e shtërngoj Kryeministrin P. Evangjeli për këtë demarsh.

Këshilli i Naltë ngarkoj me një herë Qazim Koculin për të formuar kabinetin e ri. Qazim Koculi me të vërtet i mori frenat e Shtetit në dorë, por si e pa se dorëheqja e përdhuntë e P. Evangjelit kishte bërë një përshtypje të keqe edhe kishte tronditur opinionin publik e sidomos intelektualët e vendit, të cilët ishin egërsuar fort, nuk qëndroj në kolltukun kryeministror veç se 4-5 orë, dhe menjë herë ja paraqiti dorëheqjen Këshillit të Naltë, pa mundur akoma të formojë kabinetin e tij.

Me një herë Këshilli i Naltë, si suksesorin e Q. Koculit thiri Hassan Prishtinën, të cilin e ngarkoj me formimin e kabinetit të ri. H. Prishtina i kish gati shokët dhe me një herë e formoj kabinetin dyke marrë disa nga ministrat e kabinetit të P. Evangjelit, midis të cilëvet edhe Zija Dibrën e Ahmet Daklin, si edhe të rinj Hoxha-Kadrinë, Kristo Dakon, si ministra të Drejtësisë e të Arësimit e të tjerë. Këto ngjanë në fillim të Dhjetorit 1921.

Këjo Qeveri nuk u prit me sŷ të mirë prej sidomos intelektualëve, por edhe prej pothuaj gjithë nëpunsave të Shtetit, të cilët, duke patur si prijës shefat e tyre, filluan të revolltojnë e të çfaqin mos bindjen e tyre përpara ministrave të rinj. Shefat e drejtorët e përgjithëshëm të ministrive të ndryshme bënë një mbledhje të gjatë midis tyre dhe vendosnë të mos bashkëpunojnë me Qeverin' e re. Këtë vendim të prerë ja çfaqnë edhe Këshillit të Naltë dhe me një herë u larguan nga zyrat e tyre.

Një anomali e plottë u shënua në kryeqytet. Shumë deputetë, nëpunës, ushtarë e intelektualë e lanë kryeqytetin, dyke ikur për Elbasan, Lushnjë e Berat e gjetkë.

Hassan Prishtina, si i pa gjith' këtë e si priti kaqe protestime nga shumë anë të Shqipërisë, u shtërngua më së fundi të japë dorëheqjen. Kështu Qeverija e Hassan Prishtinës jetoj vetëm 5 ditt!

Pas këtyre ngjarjevet, edhe me nicjativën e njërit prej anëtarëve të Këshillit të Naltë, të Dr. Turtullit, u thirr z. Idhomene Kosturi, Korçar e tregtar në Durrës e patriot i vjetër, i cili u ngarkua të formojë Qeverin e re provizore dhe e formoj me sekretarët e përgjithëshëm të ç'do Ministrije, gjer sa të mblidheshe rregullisht Parllamenti e të zgjidhej Qeverija legale.

Nuk zgjati shumë kjo kohë pas pak mbrrijnë në Tiranë prej frontit të Mirditës ku luftonte, Ahmet Zogu me një fuqi prej 3. 000 e sa Matjanësh e të tjerë dhe e okupoj ushtërisht kryeqytetin.

Zogu thiri me një herë në kryeqytet deputetët e njerzit e tjerë të larguar. Parlamenti u mbloth e filloj nga vepërimet. Pas pak me shtytjen e Zogut u shtërnguan anëtarët e Këshillit të Naltë të japin dorëheqjen dhe në vent të tyre u emëruan Ymer Pashaj Vrijoni, Ndoc Pistulli, Refik Toptani dhe Sotir Peci.

Një çqetësim mbretëronte në Tiranë. Populli edhe qarqet politike kishin dyshim se mos Ahmet Zogu, me fuqin' ushtarake që kishte në dorë e që nuk e shpërndante, mos dekllarohej diktator, duke paralizuar gjithë fuqitë politike të Shtetit.

Dyke ditur se kisha një miqësi të ngushtë me Ahmet Zogun qysh në kohën e okupasjonit austrijak që ajy ndodhej si kolonel i fuqive shqiptare në Shkodër, u ngarkova nga an' e Qeverisë së Kosturit edhe nga disa politikanë e deputetë me një misjon të imtë e tepër delikat, të shkoja gjoja miqësisht si nga ana ime te Ahmet Zogu dhe t'i mernja mendimin e tij se ç'qëllime kishte me ushtrinë që kish nënë urdhrat e tija.

Unë shkova me një herë te Zogu dhe ajy më priti mjaft mirë. I fola si mik po edhe në embër të patriotismit të më thotë ç'kishte ndër ment të bënte më gjith' atë ushtëri që kish me vehte sepse ishte përhapur fjala se ajy do të shpallte diktaturën etj. etj.

Ahmet Zogu buzëqeshi kur i dëgjoj këto e më tha se un' as tjetër kush s'duhet të ushqejë kësij qëllimesh për një farë diktature, se ajy, po të deshte, munt edhe t'a shpallte e s'kish njeri kush t'a kundrështonte por se ajy një qëllim të këtillë s'e ka pasur kurrë dhe duhet të qetsohet edhe Qeverija edhe populli. Shtoj se edhe fuqinë ushtarake që kish munt t'ja linte në dispozicjon Qeverisë, por më këshilloj nga ana tjetër t'a bint Qeverinë e Idhomene Kosturit, se e mira është të japë dorëheqjen, mbassi s'mund të qëndronte ashtu si ishte zgjedhur, sepse pjestarët e kabinetit të tij ishin nëpunës të rregullshëm e jo politikanë, edhe vetëm Parlamenti munt të zgjedhë Qeverinë legale konstitucjonale.

E falenderova edhe shkova. Ja trasmetova këto Qeverisë së Kosturit e cila më një herë dha dorëheqjen më 24 Dhjetor 1921 dhe Këshilli i Naltë thiri me një herë z. Xhafer Ypi, të cilin e ngarkoj me formimin e Qeverisë.

Xhafer Ypi e formoj Qeverin- e re dhe më 2 Janar 1922 u mblodh edhe Parllamenti e aprovoj Qeverin e Xhafer Ypit.

## XX

Këjo jeta ime si ministër e si deputet kaloj për mua si një fillmë kinematografik, ose si një ëndër. Katër vjet tash që e kisha lënë profesjonin t'em të vlefshëm si avokat e po merresha me politikë, nga e cila s'kuptova gjë, përveç se kokë-çarje e skotura, dyke bërë midis këtyre edhe mjaft armikë, sa do që isha sjellë mirë e kisha punuar me zell e me sinqeritet të pashoqtë.

Mbassi u bë Qeverija e koalicjonit ku u muar gati gjithë pjestarët e Qeveris së parë të Iljas Vrijonit me përjashtim t'em e të Xhafer Ypit, sa do që vetëm ne të dy nuk n'a akuzoj Parlamenti, që shkaktoj dorëheqjen e Iljas beut, e mbassi me rëzuan edhe nga deputetsija e Dibrës, dyke u zgjedhur të tjerë deputetë në vëndet t'ona mua m'u mërzit shpirti, mblodha mëndjen dhe më 8 Janarit 1922 zura me qira një dyqan në rrugën e Dibrës, e transformova në zyrë avokatore edhe me një herë mora lejen e ju përvesha punës, dyke ushtruar profesjonin t'em shpëtimtar të avokaturës, në të cilën kisha shërbyer gjer ahere 30 e sa vjeç në Greqi (Patrassë, Messollonjë, Karvasarâ etj.) si edhe në Shqipëri në Korçë, në Monastir, në Vlorë e në Shkodër.

Lumërisht puna filloj të ecë mirë dhe brenda pak kohësh formova një klientellë të mirë, që më siguronte jetesën.

Isha mjaft i kënaqur dhe e ndjenja vehten te lumur, kaqe sa, kur nga Frori i atij viti kryeministri Xhafer Ypi sa do që më përgëzoj e insistoj kaqe herë të mernja përsipër ministrin' e Drejtësisë, unë nuk e pranova.

Dal-ngadalë punët avokatore po shtoheshin për dita. Davat' e shumta që pata fituar më kishin siguruar një pozitë mjaft të mirë, e sidomos nj'a dy dava të mbëdha, prej të cilave kisha marrë një kapar prej 200 e sa napolonash, të cilat edhe i fitova, më dhanë një nam të mirë kaqe sa billanxin e muajit prej 10-15 napolonash që e mbyllnja në muajt e parë, tani fillova t'a mbyll me 40, 50, 60 e deri me 100 napolona në muaj, gjë këjo që më bëri t'i harronj kolltuket e të mos i kem lakminë as atij kolltukut akoma të Kryeministrit. Edhe rehat e indipendent në punën t'ime dhe shkonja familisht një jetë të qetë e të lumur që nuk do t'a harronj kurrë.

Miq kisha mjaft; zijafete përhera; hanim e pinim tok e këndonim e kërcenim si jo më mirë, sa na kishin zili gjithë bota.

Mjerisht këtë jetë të qetë, këtë lumëri na e turbulloj një ngjarje e papritur! Ahmet Zogu kishte shumë armiq që kërkonin si e si t'ja hiqnin fuqinë nga dora e në ish e mundur t'a zhbijnin krejt nga faqja e dheut. Midis këtyre ishin Hassan Prishtina, Bajram Curri, Mustafa Kruja, Halit Lleshi, Elez Isufi, Salih Ohri, Zija Dibra e shumë të tjerë. Kjo lëvizje e madhe kryengritëse shënohej në Dibrat, në Çermenikë, në Martanesh, në Pukë, në Krasniq, në Lumë e njeti. Qeverija dërgoj disa detashmenta nënë major Prenk Jakun dhe kapitanat Meleq e Ferit Frashërin.

Shumë përpjekje u bënë në shumë vënde. Në njërën prej këtyre u vra edhe kapitan Meleq Frashëri. Elez Isufi me shokë e me nj'a 5-600 Dibranë mundnë të arrijnë natën në Tiranë e të futen me gjithë ushtrinë e tyre në kryeqytet. Kjo ngjau më 9 Janar 1922.

Një panik i math kapi Tiranën! Këshilli i Naltë bashkë me anëtarët e kabinetit të Xhafer Ypit dhe një shumicë deputetësh iknë me të shpejtë e shkuan në Elbasan. Ahmet Zogu, pjestar edhe ky i kabinetit nuk e la vëndin e tij, po qëndroj me një pakicë ushtarësh besnikë e u trinçerua në ndërtesën Qeveritare të Zija bej Toptanit, ku ish edhe Parllamenti. Ajy e shëkonte se gjith' ato manovra bëheshin për atë, po prapë se prapë pati kuximin të qëndrojë.

Unë, si thashë edhe më sipër e kisha mik të ngushtë Zogun edhe më vinte keq të vritej ashtu kot bash në vlugun[1] e moshës së tij e sidomos prej Shqiptarësh! Prandaj natën e dytë e lajmërova me një njerin' e tij se desha ta takonj edh' ajy më dërgoj fjalë se po më pret. Në orën e caktuar më dërgoj 3 gjendarmë të armatosur në shtëpi, të cilët më shoqëruan gjer në konakun e Qeverisë e më shtijnë në dhomën e veçantë, ku ishte Ahmet Zogu. Kemi ndenjur gjithë natën bashkë dyke biseduar e dyke pirë kafe e cigare gjer sa u gdhi. Për shoqëri kishim herë pas here major Guilardin dhe M. Leskovikun, nënkolonel, adjutantin e Ahmet Zogut.

Për se jeni munduar? më tha Zogu.

Ardha t'ju shoh, i përgjigjem, se më vjen keq të derdhet kot një gjak Shqiptari dhe po të më lejoni, mbassi i njoh e i kam miq edhe Dibranët kryengritës, të cilët, siç e dijni, më kanë zgjedhur dikur edhe deputetetin e tyre, në qoftë se më lejoni, po e përsërit, jam gati me disa miqt' e mij besnikë të ndërmjetësonj pran' atyre që të mos përpiqi me shoqi-shoqin, po të goditeni me të mirë. Unë të vinj në një mëndje me ata? ma priti Zogu, jo, kurrë. Ju s'e merni vesh se qëllimi i tyre është të më çfarrosin mua? Po t'ju bindem atyre, të jini i sigurt se ja do më burgosin, ja se do më shëkoni një dit të mvarrur!

Mos e dhëntë Zoti, i thashë. Ajo gjë s'munt të bëhet kurrë; mjafton të na japin besën.

Unë s'ju zë besë kurrë më tha, se i kam armiq. Sa të pësonj ndo një turp të çnderohem, më mirë të vdes si burrë me armët në dorë! E kam vendosur.

A jini menduar mir' – thom, për këtë rrezik ku e futni vehten dhe popullin bashkë?

[1] në vlugun e moshës = në lulen e moshës (H. K.)

E kam peshuar mirë, m'u përgjigj. Unë sot gjëndem në hallin e një breshke, që kuptoj rrezikun e u përblodh në kafkallën e saj të fortë. Ja se do më shtypin e të mbaronj, ja se kafkalla ime do t'u thyej këmbët e kështu do shpëtonj e do fitonj.

Dhash' e mora, po nuk e binda dot.

Si u informova mirë, A. Zogu, gjith' atë natë që bisedonim bashkë ajy ishte trinçeruar

mirë rreth ndërtesës Qeveritare. Veçanërisht te Sahati i kryeqytetit, mbi të dy minaret e xhamive afër Sahatit, mbi taracën e Min. Botore që ishte në shtëpin' e vllazërisë Gjorgoni, afër shtëpisë ku banonja unë, si edhe në disa vënde të tjerë strategjikë, A. Zogu kishte kurdisur mitraloza me artiljerë të provuar, gati, me shenjën e parë, tu binte kryengritësve, të cilët ishin grumbulluar në shtëpin' e Isuf Elezit e në disa shtëpi të tjera rrotull, dyke zënë gjith' atë lagje, e cila atë mëngjes u ndoth e qarkulluar prej fuqive armate të Zogut, i cili, telegrafisht kishte thirur mjaft ushtëri prej Elbasanit prej Beratit prej Lushnjes si ndihmë kundra kryengritësavet.

Atë ditë, si u ktheva në shtëpi nga mëngjezi, pas ndo një oret shkova e çela zyrën. Por aty nga ora 11 para dreke, befas krisi pushka e parë. Zogistët u ranë kryengritësvet, edhe këta u përgjiqnë me një herë.

Pa e marrë vesh mirë ishin ngrehur barikada në për rrugët e sidomos në rrugën e Dibrës, ku e kisha edhe zyrën t'ime. Mbylla me një herë dyert e penxheret edhe mbetmë brenda në zyrë bashkë me nj'a 2-3 kleintë të tjerë, të cilët i zuri taksirati, ashtu si më zu edhe mua.

Pushka u dëndësua. Plumbat vijnin breshër andej e këtej. U vranë nj'a dy nga an' e kryengritësve dhe u plagosnë nj'a 5-6. Dyfeku mbajti nja 4-5 orë dhe posa filloj të rallohet n'a lajmëruan të mbyllim dyqanet e të shkojmë me të shpejtë në për shtëpitë t'ona.

Kështu u mbyll gjithë tregu e të gjitha shtëpitë. Nata që pasoj, do me th. ajo natë, ka qenë një natë nga më të tmershmet që më kanë parë sytë!

Prej orës 8 të natës filloj gjëmimi i pushkëve nga të dy anët. Mitralozat prej Sahatit, prej xhamijave, e sidomos prej taracës së Min. Botore, që ishin përballë shtëpisë s'ime, filluan zjarin e tyre infernal. Përpara sokakut t'onë bëheshe lufta më e madhe. Plumbat na vërshellenin mbi krye. Kush e di sa prej tyre hëngrën murret e shtëpisë s'ime që e kisha për fat të keq në qoshe. Disa xhama n'a u thyen iskra. Qeramidhet po dërmoheshin prej coprave të mitralozavet, një zhurm' e një gjurulldi e madhe na shurdhonte veshët. Dëgjoheshin thirje e blegërime, si kur ishe në një thertore. Për mbi 7-8 vetë u vranë bash gjatë sokakut t'em edhe kushedi sa të tjerë u plagosnë nga të dy anët. Kijamet i math, thua se ishte hapur ferri vetë!

Të nesërmet një qetësi. S'dëgjohej zë gjëkundi, as që lëviste halë. Mbetmë kështu të mbyllur gjithë natën e gjer nga ora 4 pas dreke-herës. Nga ora pesë dëgjojmë tellallin e Bashkisë që po kndjellte popullin të largohen krejt nga Tirana në për fushat, se Zogu ishte gati t'i verë zjarin gjithë kartjerit ku ndodheshin kryengritësit e se do ta vazhdonte pushkën gjer më në funt!

Nuk tregohet lehtë ajy moment kritik. Të gjithë, me burrë, me gra u ngarkuam si muntmë e duallm jashtë Tiranës me nga një darkë bukë vetëm. Rreziku na kishte ardhur te dera. Situata ishte tepër e turbulltë!

Nuk kishim ndo një orë që u sheshtuam familisht përtej fushës së Shallvarit e po mendonim si do t'a gdhinim atë natë në mes të asaj së ftohte, kur ja më aviten dy policjotë, të cilët më kërkonin me istek, të dërguar nga an' e Ahmet Zogut. Ç' është? ju them. Çohu shpejt më thonë se po të pret Ahmet beu në konakun e tij. Me një herë i hipa automobilit që kish dërguar enkas me policjotët edhe për 2-3 minuta u ndodha atje ku mezi munda të hynj brenda, dyke kapërcyer thasët me zhur që kishin storasur njëri-mbi tjetrin si trinçe.

Hyra brenda. Ahmet Zogu më priti te dera e më dha dorën. Aty pashë disa oficera Shqiptarë edhe nj'a 2-3 civilë. Ahmet Zogu më tërhoqi më nj'anë e më tha se, mbassi kryengritësit kishin kërkuar një marrëveshje me atë, ajy kishte thirur mikun e tij, ambasadorin e Bretanjës së Madhe Mister Hares, i cili pas pak ja mbrini atje bashkë me dragomanin e tij.

Prandaj, vazhdoj A. Zogu, të thira edhe ty, pse dy ditt më përpara më pate thënë se dëshironje të ndërmjetësonje për një farë ujdije. Si thua, a dëshiron të shkosh nga ana ime për këtë qëllim bashkë me ambasadorin Engles? Me gjithë qejf, i përgjigjem, jam gati të vete në merqesin[1] e kryengritësvet edhe jam i bindur se do përfundojmë mirë.

Kështu pas 5 minutash, mbassi na tregoj kushtet e armisticit me kryengritësit, u nismë me Mr. Hares e me dragomanin e tij me veturën e ambasadorit engles e me flamurin e Bretanjës së madhe dhe shkuam në kartijerën e kryengritësve, dyke pasur ngulur në ballë të veturës një shami të bardhë si shenjë pagjeje.

Kryengritësit, sidomos prijësit e tyre Elez Isufi me shokë na pritnë shumë mirë. Na gostitnë edhe me kafe. Z. Hares me pak fjalë u shpjegoj qëllimin e ardhjes. Në fjalët e tija shtova edhe unë se jam i dërguar posaçërisht nga A. Zogu por se vinj edhe si miku e dashamirësi i tyre dhe kësaj çështje të shëmtuarshme duhet ti japim funt!

Brenda një oret kishin mbaruar bisedimet. Përfundimi ishte që kryegritësit pranuan kushtet e A. Zogut dhe qysh atë natë u larguan nga viset e Dibrës bashkë me armët e tyre pa i trazuar njeri dhe kështu situata prapë mori normalitetin e saj! Të nesërmen u kthyen në Tiranë ministrat e kabinetit të Xhafer Ypit bashkë me të gjithë të arratisurit e tjerë dhe Qeverija filloj veprimet e saj.

Por një tjetër rrezik po shkrepte nga ana e Shijakut. Shijakasit, dyke qenë të sigurtë se kryengritësit e Dibrës e kishin okupuar kryeqytetin, edhe si ishin nisur edhe tjetër herë në kohën e princit Wied, kur ngritnë krye kundra tij edhe kërkonin Babën (Sulltanin) dhe që shkaktuan gjith' ato vëllavrasje e mizorina gati në gjithë Shqipërin' e mesme e jugore, Shijakasit, po thom, të armatosur mirë edhe me një ushtëri të fortë kishin zaptuar Shijakun e Durrësin. M'andej ishin ndarë dysh. Një armatë marshonte për Kavajë edhe tjetra ju turr Tiranës dhe ardhi gjer në Kashar.

Situata ishte shum' e rrezikshme! Kësaj ushtrije rebele duhej t'i bëheshe ballë. Ahere Ahmet Zogu u dolli përpara me një fuqi të mjaftë dhe, pas një lufte të rreptë e të përgjakshme që u bë afër katundit Kashar e që mbajti nj'a 3 orë, A. Zogu ju ra këtyre rebelëve si një rrufe e zjarrtë, i shpërndaj dhe marshoj gjithë natën përpara gjer sa okupoj edhe Shijakun e m'andej hyri me ushtri edhe në Durrës.

Kjo luftë kish një rëndësi të posaçme sepse Shqipërija do kishte pësuar po thuaj atë që pësoj edhe më 1914 prej këtyre trathtorëve të Kombit, që akoma s'kishin marrë vesh se ishin Shqiptarë, po përpiqeshin për të huajt për tiranët tonë pes-shekullor, prej të cilëvet mezi shpëtuam! Ata s'e njihnin flamurin e Skënderbeut, sepse deshnin atë me gjysmë-hënë e me hyll të Babadovletit. Prandaj Ahmet Zogu në këtë rast kritik munt t'a themi pa një dyshim, ajy e shpëtoj me të vërtet Atdhenë nga coptimi. Një trimëri kësodoret meritonte me të vërtet një ellozh, një lavdërim. Prandaj edhe unë, si poet, e dyke çmuar veprën e tija madhështore i trajtova, në një enthusiasmë e sipër hymnin që e la të pavdekur, ndofta që e bëri edhe mbret më von e që u konsakrua m'andej si hymni mbretnor, passi u muzikua prej profesor z. Thoma Nasi prej Dardhe, i cili asokohe ndodheshe në Tiranë si drejtor i Bandës muz. "Vatra".

Po parashtronj vetëm një strofë këtu të këtij hymni, mbassi strofat e tjera dijen e këndohen prej të gjithë Shqiptarëvet :

"Si shkëndi që lëshohet prej Djellit
"Edhe tym edhe flagë shpërndan,
"Si rrufe që shkëputet prej Qjellit
"Edhe djek e shkatron e përlan,
"Si një Engjell i naltë prej Zotit,
"Si një hyll, që zbret befas mbi dhé
"Ashtu zbriti n'Arbrin' e Kastriotit,

[1] merkes = qendër (përkthyer me google nga turqishtja H. K.)

"Ashtu leu Ahmet Zogu për ne!
Ref. Rroftë Ahmet Zogu rroftë
Shpëtimtari i Atdheut etj. etj.

Të nesërmen shkova te Ahmet Zogu, të cilin e urova për atë triumf e m'andej e mora më nj'anë e ja këndova hymnin prej shënimeve që kisha mbajtur me llapis në bruta-kopjen, me gjithë se veçanërisht kisha mbajtur një kopje të daktyllografuar. Zogu u enthusias tepër me rroku për qafe e më puthi e më falenderoj fort e fort, dyke më marrë shkresën e hymnit, që t'a mbante, si më tha, për kujtim.

Dy ditt më vonë e thira në shtëpinë t'ime prof. Thoma Nasin e ja këndova hymnin, i cili e pëlqeu fort. Më lejon, më tha, t'a kompozonj në muzikë? Merre, i thashë, me gjithe qejf, e ja dhashë.

Pas një jave prof. Th. Nasi vinte prapë në shtëpin t'ime bashkë me fllauton e tij, sepse veçanërisht ajy ishte një fllautist virtuoz. Aty përpara mejet ja mori nj'a 5-6 herë me fllauto, gjer sa ma ndërshtyp fare mirë në shpirt, e mbassi suallm edhe disa ndryshime vokale në hymnin, ky dolli prej mejet i enthusiasur edhe brenda dy javëvet e kish kompozuar hymnin edhe për Bandën e tij muzikore.

Kështu një natë më ardhi në shtëpi me nj'a 7-8 muzikantë të Vatrës dhe e ekzekutuan disa herë përpara meje hymnin.

Këto ja bëra të njohtura edhe A. Zogut, i cili, tepër i kurreshtuar e thiri tërë bandën në pallatin e tij, ku Banda e lojti disa herë hymnin. Zogu e pëlqeu fort sa ardhi vetë në shtëpi t'ime e më falenderoj tepër për. . . (nuk lexohet H. K.).

Më von Zogu bëhej Kryeministër. Hymni i tij luhej shpesh herë nga Banda "Vatra" midis copëve të tjera që ekzekutonte në kopshtin publik, po kurdoherë si një marsh personal të Zogut.

Nga korriku i vititi 1922, i lodhur tepër nga vojtjet e skoturet, edhe si kisha një djalin t'em Pirron 7 vjetsh[1] ahere e dëshëronja ta vinja në ndo një shkollë të mirë, vendosa të shkonj familisht në Vijenë, ku edhe vajtmë dhe e regjistrova djalin në një kolexhë "Heller" për t'u msuar e për të msuar sidomos edhe gjuhën gjermane.

Në Wien ndejmë nj'a 3 muaj. Po një ditt Dr. Pekmezi, miku im, i njohtur në gjithë qarqet politike Wieneze, mbassi kish kaluar atje një jetë 40 e ca vjetshare, më thotë se Princ Wilhelm Wiedi, mbreti dikur i Shqipërisë, që banonte asokohet familjarisht në villën e tij në Ahen, qytet në frontierën Austro-Bavareze në një brek madhëshrtor e pitoresk të liqenit omogen, kishte marrë vesh prej deputetit mik Loni Llogorit, se gjendesha në Wien e më dërgonte të falat e tija, dyke më ftuar, po të ishte e mundur, mysafir me gjithë zonjën për disa ditt në Ahen, ose në Ahen-See, si quhej liqeni i Ahenit.

Unë ju përgjigja princ Wiedit se e pranonja me gëzin ftimin, dyke e falenderuar dhe dyke e larmëruar edhe ditën e nisjes telegrafikisht.

Në Wien ndodheshe ahere dhe kapitan Leon Guilard, miku jonë, i cili ish çregjistruar prej ushtris Shqiptare e po sillej pa punë posht' e lart në Wienë. Këtij i kisha premtuar se do ta mernja në Shqipëri e do përpiqesha me anën e miqve t'a regjistronja prapë me gradën që kish, për të mos mbetur pa punë.

Kur mori vesh Guilardi se isha i ftuar prej princ Wiedit në Ahen m'u qep pas e m'u lut t'a mar edhe këtë e s'andejmi të shkonim për Shqipëri!

Desha s'desha e mora edhe Guilardin, i cili më kushtoj mjaft.

Kështu ditën e caktuar muarm trenin e shkuam për në qytetin Jenbach. Aty, posa duallm në stasjon, një major gjerman, adjutanti i princ Wied, bashkë me sekretarin e tij Baron Von

[1] Duke qenë se djali i Kristo Floqit ka lindur në vitin 1911, siç e shkruan ai vetë më sipër, i bie që në vitin 1922 Pirro Floqi të ketë qenë 11 vjeç dhe jo 7 vjeç (H. K.)

Shtockhauzen, po na prisnin ne stacjon. Posa që u njohta me këta të dy, më thanë se ishin të dërguar nga princ Wiedi për të n'a pritur e për të na shoqëruar gjer në pallatin e tij.

Me një herë muarm trenin fenikollar, dyke u ngjitur në një naltësi prej 7-800 metrash. Posa duallmë në majën e malit, ku ishte stacjoni, një liqen i gjërr' e i gjatë, i bukur e panoramik e me një ujë llagar të kulluar shtriheshe përpara aravet. Kaqe n'a i kënaqi sytë ky liqen madhështor, sa s'gjenja mënyra si ta përshkruanja. Një liqen aqe i bukur, po edhe i thellë mbi një naltsi 800 metrash a më tepër mbi sipërfaqen e detit, çudi, mrekulli! Plot vaporeta e motoskafe lundronin mbi këtë liqen magjestik, dyke përçarë ujrat e tija të qehlibarta.

Si ndejtim pak e u çlodhmë në një restaurant afër stacjonit, Baroni Shtockhauzen kishte nxjerë biletat për të tre : mua, gruan t'ime dhe Guilardin e kështu hipmë në vaporeton dhe pas një shetitje të bukur nj'a një orë e gjysmë duallm në skelën e Ahenit, ku n'a prisnin dy automobilla luks me markën e Wiedit dhe u drejtuam në hotelin e math e madhështor Ahenseechof, ku n'a ishte pregatitur një apartament i tërë me 7 oda e sallone e veranta, banja etj. Aty qëndruam. Baroni me majorin n'a lanë në Hotel për të lajmëruar princ Wiedin. Pas një oret vjen pra baroni në hotel e me një veturë te Wiedit na çon në pallat të tij. Zonjën time e priti baronesha Oly Shtochhauzen e e mori në dhomën e saj. Unë u ngjita lart e ndenja pak në sallonin e pritjes. Pas 2 minutash vjen prapë baroni e më lajmëron se na pret princi Wied ne dhomën e tija të veçantë. Dolla nga salloni e hyra drejt ku më drejtoj baroni. Princi Wied i gjatë gjer atje lart e mveshur me roba të bardha civile po më priste më këmbë. Më shtërngoj dorën me buzën në gas e më tha frëngjisht : "Soyez le bien venu, cher mi" etj. etj. Pastaj, si ndejmë karshi njëri-tjetrit filloj të më flasë shqip në një dialekt shkodran, mjaft mirë sa e kuptonja. Më pyeti gjërr- e gjatë mbi Shqipërinë e Shqiptarët. Më tha në e kujtojnë Shqiptari që kur se me dhimbje të madhe u nda nga Shqipërija. Shtoj se me gjithë që kemi një Këshillë të Naltë sovrane në Shqipëri, por se sovrani i vërtetë është prapë ajy, sepse as ka abdikuar, as ka nijet të abdikojë nga froni i Shqiprisë. Më së fundi çfaqi gëzimin e tij që më pa edhe një herë, sepse në Durrës, sa ishte mbret e poqa vetëm dy herë. Më tha akoma se do më mbante mysafir ndo një javë, por, dyke ju falur nderit, ju luta të mos më mbante më shumë se 2-3 ditt, se kisha nevojë të kthehesha shpejt në Shqipëri. Ç'ka, më tha, si të dëshironi.

Folmë më tepër se një orë. Mbretëresha Sofija dhe fëmij ' e tij nuk ishin në Ahen, se kishin shkuar mysafirë te emta e tyre Mbretëresha Elisabetë e Rumanisë.

Kur kishim mbaruar së foluri ardhi në dhomën edhe gruaja ime e shoqëruar nga baronesha Shtochhauzen e u njoht me princ Wiedin, i cili i bëri nderime shumë.

Atë natë na shtruan një darkë shumë të mirë. Princ Wiedi qëndroj në krye të tryezës, mua më vuri nga an' e djathtë e pas mejet baroneshën Shtochhauzen, dhe gruan t'ime nga an' e mëngjër e pas asaj ndejti baroni Shtockhauzen. Nga fundi zunë vent majori adjutant i Wiedit edhe Guilardi.

Princ Wiedi fjaloste me ne me një familjaritet të posaçëm dhe gjithë qeshte. Aty dyke ngrënë na ngjanë nj'a dy episode. I pari episod ish që nuk shihnim bukë mbi tryezën. E thres më nj'anë njerën nga zojushat servitore gjermane që na servirnin. I them nga dalë gjermanisht : "Gibt es etwas brot hier; fraulein, weil seche ich nichts". Ajo qeshi mjaft, po princ Wiedi e kuptoj me një herë e më kthehet mua: "Dans ce pay, on ne se serf pas du pain, mon ami. En volez vous? Nous pourrons trouver quelque biscuits pour vous". Edhe ja krisi gazit. Unë mbeta, po prapë nuk e humba e ja ktheva : Majesti, ous antres les Albanais, comme sait bien votre Majesti, nous non sommes accoutumes de menger les aliments toujour avec de pain; Votre Majesti e veen en Albanie et je crois qu Elle ne s'efonne point sur cet ogject". Qeshi prapë princi, po qeshmë edhe të gjithë. Ndërkohë zojusha servitore më solli nj'a 6 buçka të rrumballakta e të vogla, të cilat për mua ishin 6 kafshita. I bëra nder gruas s'ime e i dhashë gjysmat, por ajo s'mi pranoj se i vinte gjoja turp; desh të hante me etiqeta përpara princit e çiftit baron, po unë nuk u sëkëlldisa aspak, po i morra prapë që të tri buçkat edhe i hëngra që

të gjashta. Më haheshin edhe të tjera, po më vinte turp ti thesha prapë zojushes servitore, se do me merte për harbut.

Episodi i dytë ishte ky : Servitorja e dytë gjermane na mbushi gotat me një verë të mirë fort e të vjetër. Si ngriti gotën Wiedi e bëri brindisi me ne, unë posa e vura gotën në buzë e çkullova me një herë gjer në funt godën. Ishte aq' e mirë, sa edhe kundrëmonjëse vera, kurse princ Wiedi piu vetëm një gisht verë. Servitorja ma mbushi prapë godën. Unë u vërtita andej, u solla këtej edhe me maryfet e çkullova edhe godën e dytë me një frymë. Servitorja, dyke buzëqeshur ma mbushi prapë. Wiedi akoma s'kishte pirë godën e parë, ashtu edhe konvitorët[1] e tjerë për respekt, po mua, që më pëlqeu tepër ajo farë vere, që s'ishte verë po nektar por s' po më durohej ; ju vërtita edhe gotës së tretë. E mora e e lashë nj'a 2-3 herë, gjer sa të katërtën e mora me vendim që ta çkulloja edhe atë, dhe i dhashë një të surbitur e e shpura gjer në mes. Ahere Wiedit s'ju durua. Sillet nga mua e më flet shqip : "Jahu, ç'ka je tue ba kshtu? Ne s'kena pì gotën e parë e zotnija juej po i jepni funt gotës tretë? "

Të gjithë i ranë gazit, po edhe unë s'ndenja prapa, e ju përgjigja : "Madhni s'kam faj unë, pse Madhnija jote paska një verë kaqe të mirë, sa s'e kam hasur tjetër herë". "Mirë, mirë, tha Wiedi po kqyrni, se mundeni edhe me u dehë". Ajo pak më prish punë, Madhni, i them, se pse afër e kam jatakun e vete shtrihem, po punë më prish ajo që do mos e gjenj tjetër herë këtë farë veret. Prandaj tani që e gjeta s'duhet t'a le rastin të kalonjë. Këto fjalët e fundit shkaktuan një humorizmë të mjaftë që zgjati për disa minuta. Gruaja ime po më shëkonte me inat sikur do më hante me dhëmbë, po unë as që u vrejta aspak, po shëkonja punën.

Si hëngrëm bukë, duallëm të gjithë tok me shëtit anës zallit të bukur të liqenit magjestik. Një panoram' e këndëshme e plot myster shtriheshe përpara nevet. Pas pak princ Wiedi kërkoj një barkë me rema, e cila na u afrua me një herë. Hymë brenda. Princi rëmbeu vetë njërën remë dhe tjetrin ja dha baroneshës. Që të dy i punonin bukur e mjeshtërisht remat. Baroni kapi timonin e lundrës dhe e drejtonte mirë.

Kaluan nj'a dy orë të bukura plot muhabet e qyfyre. Baronesha, të cilën e kisha afër mejet edhe e cila e dinte për mrekulli frëngjishten ishte një shakaxhes' e prapë. Më çkuli së qeshuri me evenimentat e ndryshme që me tregonte e me qyfyret e shakat' e tjera. Ishte një grua shumë simbël[2] e shum' e dashur.

Pas pak duallm prapë në brek e shkuam më këmbë gjer te pallati i Wiedit. Aty u ndamë, po baronesha ndezi shpejt një nga veturat lluks të Wiedit e dyke shoferur vetë na çoj gjer në hotel Ahenseechof, ku na uroj natën e mirë e na la. U ngjitmë me asansor të tre me kap. Guilardi dhe ajy shkoj në odën e tij edhe unë me t'ime shoqe në një odë tjetër që shkëlqente nga pastrija, nga pasqyrat e krevatet e nga mobilat që kish.

Dhoma e jonë kish edhe ballkon, që shëkonte drejt në parkun madhështor të hotelit, mbushur me lule e me ferrishte të ndryshme. Midis kopshtit nja shadrivan i bukur që e hithtë 7-8 metra ujën përpjetë, dyke e shpërndarë në majë me turbijonë, i jepte një pamje magjike kopshtit si dhe asaj nate të mrekullueshme. Një kohësisht edhe na freskonte. Gruaja u çvesh e ra në krevat e po më thriste edhe mua, mbassi kishte kaluar mesnata. Por unë që s'ngopeshe dot dyke parë atë natë aqe të bukur e mysterioze, s'kisha ndërmënt të los aspak prej vendi. Nuk shkoj shumë edhe ja dha Hënëza e plottë nga maja e një mali të liqenit. Oh, ahere nuk përshkruheshe dot ajo natë! Hëna dolli e tërë, dyke u fshehur në fillim midis bredhave kryepërpjetë të malit. Drita e saj reflektonte mbi sipërfaqen e liqenit, ku reflektonin edhe hyjtë. Liqeni ishte i qetë si një pasqyrë e kristalltë. Aty afër po lundronte nga dalë një vaporaq me dritra plot bengalike në fenera kartë të shumëngjyrëshme. Bukurija nuk përshkruheshe lehtas me pendë. Vaporaqi me një shumicë njerëzish djelm e çupa, dyke kënduar bukur disa këngë bavareze të shoqëruara me qithara e me mandolina, vaporaqi, po thom, po na afroheshe. Bukurija, mysteri kalonin zenithin e tyre. As kam parë, as do të shoh ndo një herë

[1] konvitorë = pjesmarrës në një banket ose në një dreke solemne (përkthyer nga italishtja (H. K.)

[2] simple = e thjeshtë (H. K.)

një natë aqe të bukur sa ajo, që ja kalonte edhe asaj nate që dikur pata ngjeruar[1] në Venetik prej hotellit "Rialto" mbi një nga kanalet mysterioze të nuses së bukur të Adriatikut, ku u ndodha atë natë, ku një gondollë e bukur me një kompani burrash e grash e me një harmonikë lundronin gjatë kanalit dyke kënduar këngra venecjane, që më bënë të mvishem, të zbres poshtë, ti ndjek gjatë kanalit, dyke bredhur mbi trotuaret e ngushtë toksorë të kanalit edhe më së fundi dyke kaparosur edhe vetë një gondollë tjetër që u rashë pas e i shoqërova ata ahenkçinj gjer sa xbardhëlloj dita! Por se kjo nata në liqenin e Ahenit me atë vapor aqe të shkëlqyer e me atë Hënë mrekulli i kalonte të gjitha.

Gruaja ime kishte bërë gjumin e parë e po kthesheshe nga krahu tjetër për të bërë të dytin. Më kot i thira të ngriheshe të vinte në ballkon e të ngjeronte atë natë. Më në funt s'më durua ; vajta e ngrita me të pahir, i hodha një shallë supevet e e mora gati xvarrë e hoqa gjer në ballkon me sytë gjysmë të mbyllur. Eja, moj e gjorë i thashë, se është gjynah të flesh me këtë natë me këtë ahenk kaqe të bukur. Gjumin e gjen kurdoherë, po këtë natë s'e gjen kurrën e kurrës!

Me të vërtet, kur hapi sytë u çudit edhe ajo e më dha plotësisht të drejtë. Ndejim atje të dy gjer sa u gdhimë. Pastaj muarm një gjumë nj'a 2-3 orë, u lamë shpejt, u mveshmë, pijmë kafenë me qumësht e me gjalpë faze e bukota që na servirnë dhe zbritmë poshtë e muarm një shetitje të gjatë rreth liqenit, ku na çuditi thellësija e tij që dukej prej 7-8 metrash poshtë, si edhe ujrat e kalltërta e të kulluar.

Më drekë ja shtruam prapë në pallatin e Wiedit. Hëngërm të tjera gjellra të ndryshme e të mira. Verë atë ditë kishim një verë të bardhë, por unë, pa komplimenta, ju luta servitores të më falë një shishe të tërë prej verës-nektar që kisha pirë një ditë më parë. Edhe ma solli, e jam kënaqur kaqe shumë sa do t'a mbanj ment. Kuptohet se brenda në shishe nuk lashë as një lot vere. Ishte gjynah t'a linja!

Mbas dite princi na pyeti në kishim qejf të fotografiseshim të gjithë bashkarisht. Është nder i math për ne, ju përgjigja princit. Ahere baronesha na mori disa fotografi bashkarisht me princin Wied me mua e me gruan t'ime. Në një prej tyre dolli edhe baronesha në fotografi. Por na i mbet merak kapitan Guilardit që nuk dolli edhe ajy me ne. Ahere ju luta baroneshës të na marrë edhe një fotografi tjetër të gjithve bashkë me Guilardin, edhe baronesha me gëzim e pregatiti prapë aparatin. Po Guilardi kishte një zakon që lyente leshrat e mjekrën me brillantinë dhe bëntë ç'bënte e nxirte shishkën nga xhepi edhe lyheshe. Pastaj nxirte guiben[2]e vogël e i krihte edhe leshrat edhe mjekrën.

Kur ishte gati baronesha të na merte fotografinë, Guilardi po brillantoheshe e po spilloseshe, pa dëgjuar fjalën "achtung" ("kini mëndjen") që shprehu baronesha. Ne të gjithë bashkë me princ Wiedin muarm pozën e duhur. Ahere u ngut edhe Guiladi e zuri vënt pak më tutje nga ne. Por në çastin që baronesha hapi aparatin fotografik, duket se Guilardit nuk ju durua pa zënë edhe një herë mjekrën për ta sheshuar në mënyrë elegante. Por, në atë minutë baronesha e mbylli aparatin dhe Guilardi u fotografis me dorën në mjekër! Këtë fotografi, që na fiku gazit e mbanj për kujtim, ashtu edhe fotografit e tjera që nxuarm.

Ndejmë plot 3 ditt pranë Princit Wied e u familiarizuam mjaft. Më tha se me rastin e parë që do normalizoheshin punët ajy do zbriste me fuqi të mjaftë gjermane në Shqipëri dhe këjo fuqi do qëndronte në Shqipëri gjer sa të siguroheshe froni i tij. Veçanërisht mua mu premtua se do më merte në Pallat si më të afërmin e më besnikun e tij dhe se do më emëronte ministrin e Pallatit. E falenderova mjaft.

Dy orë para se ndaheshim, përpara të gjithëve princ Wiedi më dha dekoratën e komandarit të Shkabës së zezë, një medalje fort të bukur bashkë me kordhelen e mëndafshtë me ngjyrë të kuqe e të zi, të shoqëruara me dekretin e posaçëm në gjuhën frëngjisht.

[1] ngjeroj = shijoj, gëzoj (H. K.)

[2] guibe = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalor por duhet të jetë krëhër (H. K.)

Prej princ Wied u ndahmë me një përzembërsi të madhe. Më përqafoj e më puthi. E falenderova tepër e u nismë me kaqé kujtime ta paharruara si për pritjen miqësore që na bëri, ashtu edhe për ditët e netët aqe të ëmbla që kaluam në atë parajsën e vërtetë të Achenit panoramik e prallor!

Baroni, baronesha dhe majori adjutant na përcuall gjer në vapor. Gjer sa u nis vapori ishim të gjithë brenda. Unë i gostita me birra të ftohta, dyke u lënë lamtumirën. Edhe si u nis vapori vazhduan përshëndetjet me anën e shamive ata që në skelë dhe ne që përbrenda vaporit.

Arrijmë prapë në Jenbach, ku pritmë gjer sa ardhi treni direkt prej Munchen-it dhe u nismë, dyke u drejtuar në Insbruk, prej andej në Steinach gjer sa zumë Brenerin ku ishin kufitë Austro-italjane.

Përgjithësisht i tërë Tirolli, ku përfshihet edhe Achen-i, na pëlqeu fort. Tirolli është nga më të bukurat e më pitoresket vende të Europës. Achen-i s'është tjetër përveç një grumbull villash e pallatesh të princërve e kontëve e pasanikëve të tjerë të Austrisë e të Bavjerës.

Prej Brenerit, dyke shkuar gjatë Trentos, Trentinos, Italla (?? H. K.) Roveretto, arthmë në Bollzano, që Gjermanët e quajn Bosen. Gjatë këtyre viseve banojnë popuj gjermanë, e vura re se flisnin gjermanisht.

Ditën tjetër nga mezi i natës arritmë në qytetin e bukur e historik të Veronës, ku banonte mbesa ime Evridhiqi Gobbini me të shoqin e saj Dido Gobbini, kapitan i Xhenios italian. Ata kishin dalë e po na prisnin në stacjon. Na hoqnë në shtëpin' e tyre, kurse Guilardi hoqi drejt për në Brindizi ku do na priste ne, që të shkonim tok në Shqipëri!

Pas tre ditsh ishim në Brindizi, ku e gjetmë edhe Guilardin, i cili kishte mbetur penk atje se i qenë sosur të hollat. U shtërngova e ja pagova borxhin që kish në hotell e në restorant, dhe atë mbrëmje u nismë tok nga Brindizi e arthmë në Vlorë në mëngjes, ku na priste në skelë baxhanaku im z. Jovan Pozio.

Në Vlorë u ndalmë 2 dit e m'andej u nismë me vapor për në Durrës e q'andej sosmë në Tiranë ; Zogu vazhdonte të ishte Kryeministër akoma. Ja paraqita Guilardin, i thashë se e mora vetë nga Wiena se kish mbetur në ditën e hallit e ju luta ta pranonte në ushtri me gradën e kapitanit që kishte, se ja kisha premtuar vetë, edhe Zogu e pranoj e dha urdhër të regjistroheshe në shërbimin ushtarak. Guilardi mbeti tepër i kënaqur e më falenderoj fort që të dyve. Të nesërmen, s'di se ku i mori hua një palë rroba e m'u paraqit në zyrë një koxha kapitan me gjithë mjekrën e zezë që kish, si mjekren e Othellos të Shakespearit.

Dal-ngadalë Guilardi ju ngjit Zogut e u bë si njeri i brendshmë në pallat. Bëri si bëri u gradua major e kështu arriu dal-nga dalë gjer në gradën e kolonelit, dyke u bërë adjutanti i Zogut edhe njeriu i besimit të tij. Po mua s'më harroj kurrë i shkreti se e theshte e e përsëritte shpesh se e kisha shpëtuar nga vdekja; kaqe shumë vazhdoj këja sa na u mërzit më së fundi të mos e përmendte më se i kish dalë edhe lezeti. Kisha çelur asokohe zyrë avokatore.

Kështu u sheshtova prapë në zyrën avokatore, që tash 3 muaj e kisha lënë të shkretë.

Viti 1922 mbaroj i qetë. Nga fillimi i vititi 1923 dolli në shesh çështja e kishës autoqefale Orthodhokse Shqiptare. Këtu s'është vëndi të përment hollësira e të tregonj gjithë përpjekjet e luftimet që u bënë gjer sa u përfundua çështja në favorin e kishës s'onë orthodhokse Autoqefale, të ndarë do me thënë nga Patriarqija e Stambollit në Fanar, mjafton vetëm të përment që edhe kjo çështje u zgjidh mirë. Në këtë çështje pata marrë edhe unë pjesë aktive dhe Kisha Autoqefale Orthodhokse e Shqipërisë për shpërblim më dekoroj me medaljen e argjentdtë të Kishës Autoqefale.

Njëkohësisht me njohjen e Autoqefalisë së Kishës Orthodhokse, edhe muhamedanët e Shqipërisë mbas shumë përpjekjevet e mundimevet, u çkëputnë edhe ata prej Sherh-ul Islamatit muhamedan e u bënë më vehte, dyke formuar edhe ata Autoqefalinë Islame Shqiptare, kështu që të dy elementët që formojnë shumicën e popullit Shqiptar, me një xhest

kuximtar e përparimtar formuan pamvarsin' e tyre fetare dhe këjo ishte një hap i math patriotik për patriotët Shqiptarë.

Kështu mbaroj edhe viti 1923.

Viti 1924 filloj mjaft i turbulltë. Në një kohë që Kuvendi Kushtetues ishte mbledhur në Tiranë dhe kishte filluar një rrugë patriotike, në Vlorë po çvilloheshin trazira. Disa Shqiptarë atje, Vlonjakë e të rretheve të tjerë të Toskërisë, filluan një lëvizje të madhe e cila përfundoj në një kryengritje. Ata, të pakënaqur prej Qeverisë së Zogut e prej regjimit kishin vendosur të përmbysnin edhe njërin edhe tjetrin. Bile kishin vendosur edhe vrasjen akoma të Zogut, për të cilën vrasje kishin angazhuar djaloshin e ri nga Mati Beqir Valterin.

Ditën e 23 Frorit 1924 isha thirur prej Kryeministrit Zogut për bashkëpunim për disa çështje juridike që i përkisnin Këshillit ministror. U ndala atje ndo një orë. Na ardhi aty edhe ambasadori mik i Bretagnës së Madhe Mr. Hares. Parlamenti sipër kishte filluar nga bisedimet. Pritesh Kryeministri Zogu që të jepte disa shpjegime për një mosjon që disa asamblistë i kishin bërë Qeverisë.

Zogu na lypi ndjesë neve të dyve me Mr. Hares-in dhe kështu duallm që të tre nga zyra kryeministrore dhe A. Zogu u drejtua nga shkalla e madhe për të ngjitur sipër dhe ne të dy me Mr. Hares-in, dyke bashkëfjaluar anglisht duallm nga pallati i Qeverisë dyke marrë rrugën. Por, nuk kishim bërë as dhjetë çapa kur dëgjuam një batare pushkësh sipër nga Parlamenti!

Ç'kishte ngjarë? Kur po mbaronte së ngjituri shkallën Zogu, Beqir Walteri, që po e gjuante aty afër në krye të shkallës e zbrazi dy herë revolverin e tij mbi Zogun, të cilin e plagosi në dorën e mëngjër edhe në kofshën po të mëngjër, ku edhe kish mbetur plumbi. Zogu, më një herë vrapoj e me revolverin e tij në dorë hyri me të shpejtë në sallën ku bisedonte Kuvendi Kushtetues. Kryetari i Kuvendit edhe të gjithë deputetët, të allarmuar mateshin të dalin jashtë që të shohin ç'bëheshe, por Zogu i ndaloj e me gjak të ftohtë i tha kryetarit : Vazhdoni punën t'uaj, se jam gjall' akoma, s'kam pësuar gjë! Disave oficerëve që vrapuan pas Zogut e hyjnë në Sallën e Parllamentit Zogu u tha : Vrasësin e kini nga nevojtorja e majtë, atje u fsheh, kapeni! Po asamblistët e sidomos partizanët e Zogut, kur e panë se ky po mbyteshe në gjak e këshilluan e e shtërnguan të shkonte në pallatin e tij e kështu ndo një' zet e sa shpirt e shoqëruan gjer në shtëpin' e vet.

Pushka po gjëmonte këtej. Beqir Valteri arrin e u fut në nevojtoren dyke mbyllur derën që përbrenda, e cila u bë shoshë nga plumbat, pa u plagosur aspak B. Valterin, i cili, mbassi ju sosnë fyshekët kërkoj të dorëzohet e kështu ju dorëzua kapitan Osman Gazepit e u burgos!

Në shtëpi të Zogut arriva edhe unë e ju afrova afër krevatit ku ish i shtrirë, e përgëzova që shpëtoj e qëndrova atje. Pas pak ja mbrrijnë aty dy doktora, Dr, . Osmani si chirurg dhe Dr. Simonidhi si pathollog.

Dr. Osmani nxori me një herë veglat e kirurgjike nga çanta, lau duart dhe u përvesh për operacjon, që ti nxirte plumbin nga kofsha e mëngjër, pa qenë nevoja të klloroformiset. Zogu nuk desh të operoheshe por më së fundi ja mbushmë mëndjen të gjithë se ajy ishte një operacjon i vogël e duhej të bëhej shpejt.

Kshtu, me ngutjen e Dr. Osmanit, unë që u ndodha më afër ja kapa e ja shtërngova me të dy duart këllkun e mëngjër dhe Dr. Osmani më 8-10 sekonda ja nxori plumbin, i cili ra mbi krevat. Unë e rëmbeva me një herë e ja dorëzova Zogut, i cili më shtërngoj për qafe e më tha : "Do të të kem vëlla, që m'u ndodhe këtu".

Pas një javet Zogu ishte shëruar krejt edhe Qeverija, si edhe Kuvendi Kushtetues e filluan normalisht punën e tyre.

Pas këtyre ndodhjeve, Zogu dha dorëheqjen dhe Qeverin' e re e formoj Shefqet Vërlaci.

Takoj ato ditë që u asasinua në Tiranë patrioti asamblist Avni Rustemi, vrasësi i tradhtorit Esad pashajt. Kundrështarët e Zogut këtë vrasje ja ngarkuan A. Zogut, me gjithë që e vërteta ish se kjo vrasje u shkaktua prej njerësve të Esad pashës, të cilët në këtë mënyrë muar gjakun për vrasjen e pashajt që ngjau në Paris.

Vrasja e Avni Rustemit çeli një plagë të madhe në zembrën e kombit, po solli edhe një trazirë të madhe në qarqet politike.

I vrari u përcuall me salltanet në vëndin e tij në Vlorë, i shoqëruar prej shumë vetash e prej një shumicë asamblistash. Midis tyre e përcolli gjer në Vlorë edhe Alois Gurakuqi, me gjithë se ish edhe pjestar i Qeverisë Vërlaci, si ministër i Financavet.

Ardhja e kufomës së Avni Rustemit në Vlorë mjaftoj të ndezë gjakrat e kryengritësve e ti egërsonjë kaqe fort sa të vendosin të marshojnë edhe mbi Tiranën nënë bajrakun e Fan Nolit me shokë.

Sado që u përpoq Qeverija e Vërlacit t'i zbutë punët nuk përfundoj gjë. Kryengritësit e Vlorës të marrur vesh edhe me disa të tjerë Gjirokrastritë e Shkodranë të pakënaqur, po pregatiteshin për të kaluar Shkumbinin e për të msyer Tiranën e Durrësin.

Gjendja ishte shumë kritike. Shefqet Vërlaci paraqiti me një herë dorëheqjen. Asamblistat u shpërndanë dhe Këshilla e Naltë ngarkoj Ilias Vrijonin të formonte Qeverinë, i cili edhe e formoj, po kur afroheshin kryengritësit në Tiranë si nga an' e Toskërisë, ashtu edhe nga an' e Shkodrës, u trapitasnë[1] me një herë të gjithë ministrat e kabinetit Vrijoni bashkë edhe me kryeministrin Ilias Vrijoni!

Tirana po priste kryengritësit nga të dy anët, nga jugu e nga Veriu i Shqipërisë. Vetëm A. Zogu kishte mbetur në Tiranë me suitën e tija.

Atë natë shkova në shtëpi të A. Zogut. E pashë se ish pregatitur të ikte. Pranë kish disa oficera besnikë, midis të cilëvet edhe kollonel Selahudin Blloshmin dhe Xhemal Araniti. Më pyeti në deshironj të ikim bashkë, i thashë s'munt të le familjen vetëm, një grua e një djalë që kam në mëshirën e fatit. Zogu nuk insistoj. Më tha në kam nevojë për pare, po ju përgjegja se s'desha gjë. Ahere nga mezi i natës u ndamë me Zogun dhe ky nga të gdhirët kishte shkuar nga Dibra bashkë me familjen e me shokët e tij.

Pas dy ditësh, më 11 Qershor 1924, kryengritësit, ata të jugës nënë komandën e kolonel Kasëm Qafëzezit dhe ata të Shkodrës nënë komandën e kolonel Rexhep Shalës hynin në Tiranë.

Pas dy tre ditësh u formua Qeverija e re nënë kryesin' e Fan Nolit, i cili njëkohësisht ish dorëzuar qysh më përpara edhe si Peshkop i Durrësit.

Nuk zgjatem më mbi këtë çështje e mbi ngjarjet e pasandajmë se këto i përkasin historisë.

Kur u poqa me Fan Nolin, ajy më priti mirë, mbassi ishin kaqe vjet të njohur edhe në Amerikë, ku bashkë me atë e me Faik Konicën kishim themeluar "Federatën Panshqiptare Vatrën" edhe në Shqipëri, ku unë në Vlorë, si kryetar i gjyqave e kisha pritur mirë e i kisha dhënë shumë lehtësira me gjithë urrejtjen e kundrashtimet që i bënin Ismail Qemali me ministrin e Drejtësisë Petro Pogën, të cilët deshin t'a dbonin nga Shqipërija, ose të paktën t'a internonin.

Me të gjithë krerët e kryengritjes, miq e patriotë dhe këta, u poqa. Nuk më thanë gjë, as që biseduam gjë rreth largimit të Zogut.

Populli i Tiranës i priti me gëzim kryengritësit, të cilët trumbetonin se do sillnin parajsën e vërtetë në Shqipëri, por mjerisht, nj'a 5 e sa muaj që vazhdoj regjimi i tyre në Shqipëri, jo vetëm nuk u bë ndo një ndryshim, po përkundrazi filloj një çrregullim e një pazotësi e dukshme administrative që përfundoj në një anarki, sa gjithë populli zu të urrejë mjaft, dyke e nderuar regjimin e parë të Zogut.

Pazotësija e Qeveris së re u duk qysh në ditët e para. Qyme, qyme djelmoshash, gjoja përparimtarë e patriotë, që ushqenin ndjenja ahmarrje e gjakpirësije kundra miqve të Zogut, silleshin posht e lart rrugëve të kryeqytetit me shkopinj në për duar e me shishe plot vaj recine, dyke dashur të imitojnë fashishtat e pare italjanë dikur dhe dyke pasur shënuar në një

[1] trapitasnë = ja mbathën këmbëve nga sytë këmbët (H. K.)

listë të gjatë embrat e atyre që do përdhunonin, dyke i rahur, ose dyke i dhënë shishe të tëra vaj recine t'i gëlltitnin me zor gjer në funt, filluan me të shpejt nga vepërimet e tyre infernale e të poshtra.

Në atë listë mjerisht isha shënuar edhe unë si miku i Zogut e si armiku i Qeverisë së re.

Këta të poshtër e edepsëzë, këta rrugaçë e parasitë të këqinj, zunë e po brithnin rrugëve, si maskarenj e faqezinj që ishin edhe ku takonin ndo një prej të shënuarve në listën e tyre e kapnin, e rihnin, e dërmonin e më në funt i jepnin edhe vajin me kobure në dorë! Në këtë mënyrë rahnë edhe avokatin plak Vasil Dilo e sidomos asamblistin patriot Jashar Erebarën, të cilit jo vetëm që ja çanë më dysh kokën me shkopinj, sa do që ishte plak, po edhe e vranë së rahuri e i dhanë edhe vajin e recinës që i piu i shkreti gjer në funt desh s'desh!

Tani kishte ardhur edhe radha ime. Unë s'dinja gjë prej gjëje, se ndryshe do të kisha marrë masat, të paktën dyke u armatosur me ndonjë revolver.

Isha në zyrën t'ime dyke shkruar e po pregatitja çantën t'ime me aktet për të shkuar në gjyq, se ishte ora 9 e mëngjezit. Bruf shoh nja 5-6 bandillash që hynë me shkopinj në dorë në zyrën t'ime. Njëri prej atyre mbante mbi krahun e mëngjër një pallto nën të cilën dukeshe shishja litërshe mbushur me vaj recine, i destinuar për mua. Posa i vura re këto e pashë se puna do shkonte keq. U thashë ç' kërkoni? Një prej atyre, që dukeshe si kryetari i tyre, maskara e i poshtër sa s'bëhej, mu përgjeq me një ton urdhëronjës : Jemi dërguar nga Komiteti (?) i jonë të të themi t'a ndryshosh atë marshin që i ke bërë Zogollaviçit. – Në ç'mënyrë? Po ju thom. – Në këtë mënyrë më tha, edhe nxori e më dha një fletushkë letre ku shënoheshin këto fjalë që ndryshonin refrenin e marshit të A. Zogut bërë prej meje :

"Posht' Ahmet Zogolli poshtë
"Tradhëtori i Atdheut
"Bres pas brezit krejt u shoftë
"Faqe-ziu i Skënderbeut!

Hë, më thotë kryetar-rezili, ç'thua? Nuk e bënj dot, i thashë, se s'kam dy palë faqe. Unë s'ju njoh as një prej jush, po duhet të dijni se jini përpara një patrioti, që ka shkrirë jetën për këtë Shqipri, e ju jini djelm akoma, as mbesonj se këta i bëni në embër të të ashtu-qojturit patriotizmë.

Fjalë të shkurtra m'a preu ajy maskaraj, një e një bëjnë dy, ç'thoni? – Nuk e bënj, ju them, si kur tani të shuhi që të gjithë, po këpusni qafën që këtej zuzarë të dobët!

Ahere kryetari-faqezi i bërtiti turmës : Marsh, bëjani avazin!.... . Me një herë dy djelmosha prej sijsh në një moshë 22-23 vjetsh më afrohen e fillojnë të më kapin. Koha s'priste për mua ; gjaku edhe shpirti më kishin ardhur maje hundës e kur e pashë vehten në rrezik me një herë i jap një grusht të plotë hundëvet njërit prej tyre, sa u tralis dhe ja filloj gjaku ; tjetrin, kur e pashë se mu lëshua si ndo një qen i tërbuar, pik së parit e shtyra tutje, po kur mu hoth i treti, ahere rëmbeva një karekllë që kisha aty pranë e ja vërvita me të dy duart mbi kokë me sa fuqi që pata, sa e pashë se ajy u shtri në çimenton i coptuar e i handakosur ; më një herë s'prita të më msynë të tjerët, po rëmbeva kolltukun t'em e u a flakëriva mbi suratet! Një efekt të mirë që bëri ajy i shejtë kulltuk ishte ajy që ja theu shishen atij bravos[1] tjetër edhe vaji i recinës u derth në tokë.

Mjerisht ishin mbledhur një kallaballëk i math përpara derës së zyrës s'ime dhe asnjë s'kish kurajon të ndërhynte e ti shpërndante këta burracakë të poshtër, por qëndronin si hajvanë e bënin sehir!

Lufta po vazhdonte, por ndjenja një gëzim se s'prita ndo një shkop kokës, sa të më bijnin në vënt, edhe kënaqesha me zembër që po e dominonja atë situatë! Po ahere me një herë pashë se 4 të tjerë shokët e tyre msynë me yrysh brenda në zyrë e ishin gati të më ofendonin me mënyrat më të poshtërme. Lumërisht ndërkohë edhe tamam pas këtyre një

[1] bravo = njëri nga kuptimet e kësaj fjale është njeri i egër, kafshë me fytyrë njeriu (H. K.)

kapitan ushtarak hyn brenda me revolver në dore e u thotë këtyre vagabondave : Marsh që këtej, largoji shpejt që të gjithë, tani, tani, shpejt! Kush të guxojë të verë dorë mbi këtë zotninë (më tregon mua me dorë) ka të bëjë hesap me këtë (e tregon revolverin e tij) . Burracakët maskarenj iknë një nga një si minjt të lagur e m'u çporrë nga zyra!

Kapitani vuri revolverin në kllëf , mori një karekllë e u afrua pranë meje. Më njeh mua, Z. Floqi? Më tha – Jo i thashë, vetëm se më vjen mirë që të solli Perëndija këtu e më shpëtove nga një rrezik e nga një çnderim të math, pra ju falem nderit fort e fort, i thom, e i shtërngova dorën. Oficeri ma pret : S'ka për se, Z. Floqi Unë jam Beqir Velua nga Kanina. Zotrote më ke shpëtuar dikur jetën, e ju falem nderit shumë! Ja se si ardhi sëra t'ju a shpërblej edhe unë sot.

Kur i dëgjova këto fjalë u habita fort! – Unë ju kam shpëtuar jetën? i thom. Po kur e ku e si? Unë sot po ju njoh për të parën herë, si bëhet t'ju kem shpëtuar edhe jetën? Çudi më vjen.

Zotrote, vazhdon kapitan Beqir Velua, kur ishit Kryetar i Gjykatores së Vlorës na gjykuat ne, nj'a 7-8 kaninjotë për vrasjet e nj'a 3-4 Çeparjotëvet, armiqtë tonë, me të cilit kishim rënë në gjak për nj'a dy vrasje të tjera, që ata na kishin shkaktuar. Zotrote gjykove për vdekje Beqir Sulën dhe nj'a 4-5 të tjerë me burgim të përjetshëm, kur se mua më dekllaruat të pafajshëm e më liruat, ndonse unë isha vrasësi kryesor i atyre, por e vërteta ishte se kisha të drejtë të plotë.

Tani më bije ndër ment, i thom, por si mbaj ment unë, për z. t'uaj s'kishim prova të mjaftueshme, prandaj ne nga një dyshim e sipër s'munt të të dënonim e kështu të dhamë pafajsinë.

Sido qoftë, më përgjigjet Beqir Velua unë e detyronj shpëtimin t'em ndër ju, prandaj, posa dëgjova se këta maskarenj ardhë të të ofendonin, pa ditur se je një patriot Shqiptar nga më të rallës e më të vlefshmit, vrapova e ardha këtu, si po më shëkoni, dhe jam në dispozicjonin t'uaj por ç'ka të doni e s'ju ndahem aspak.

Falem nderit shumë, i thom, e ju shpërblefsha me të mirë. E gostita një kafe e u nismë bashkë e shkuam gjer në gjykatore, ku më prisnin gjyqet e asaj dite.

Atë ditë mbremavet shkova te komandanti i vëndit Kasëm Qafëzezi, që ishte edhe ministri i luftës në kabinetin e ri e ju ankova mjaft për ato padrejtësi e çrregullime që po ngjisnin. Ajy mori me një herë masat e qysh atë ditë nuk u shënua më ndo një ngjarje e tillë e shëmtuar.

Qeverija e re e Fan Nolit u pa se s'bente gjë me gjithë të 20 pikat e prokllamës së saj që i çpalli popullit e që i premtonte Edenin e Parajsa qjellore.

Gjendja paraqiteshe mjaft kritike. Qeverija ishte paralizuar krejt. Populli ndodheshe në një dëshpërim të math. Kishte filluar një shkatërim fatal për të mjerën Shqipri!

Qeveritarët shëkonin qejfet e tyre e si e si të kënaqnin miqt' e tyre.

Jemi në muajin Dhjetor 1924. Qeverija revolucjonare kishte dënuar shumë burra Shteti për vdekje, si miqt' e partizanët e Zogut, po edhe Zogun vetë.

Një turbullim i math po zhvillohej në Dibrën e Madhe. Ahmet Zogu, që ishte në Beligrad me shokët, kishte pregatitur një ushtëri të fortë për të ardhur prapë në Shqipëri. Nga Kosova, nga Korça e nga Gjinokastra ishin bërë pregatitje të mbëdha dhe po e prisnin Zogun. Qeverija e Fan Nolit s'kish aspak haber nga këto që ngjisnin, por as që çante shumë kryet.

Kur mori vesh qeverija se Zogu ju afrua kufive të Dibrës dhe ushtrija e Korçës me atë të Gjinokastrës e me shumë vullnetarë të përzjerë po marshonin për Tiranë, lëvizi pak prej vëndit e u mundua t'u bëjë ballë msyesvet, por kot. Edhe sa do që ushtërija e pakët që u dërgua në Dibër nuk u përmbajt dot e po smbrapseshe, qeverija e Tiranës po kasneconte me rekllama të mbëdha të ngjitura në për muret se "armiku u thye përtej Drinit, se u vranë kaqe e aqe, se shume u dorëzuan" etj. etj. kurse Zogu me 4. 000 e ca shpirt kish arrirë Qafën e Tujanit, 3 orë lark Tiranës dhe të nesërmen do të hynte në Tiranë.

Fan Noli atë natë, i bindur se Zogu me ushtrinë e tij ishin thyer, ishte plot qejf dhe meraklli siç ishte për muzikë, kishte marrë në duart veglën e dashur të tij oboe e po i frynte me një kënaqësi zembre.

Befas vijnë e e lajmërojnë në Mitropoli, ku banonte e i thonë të ngrihet e të shkojë shpejt se Zogu është përpara dyerve të Tiranës gati të hynte në qytet.

Një panik i math ngjau atë natë. Të gjithë u mbyllnë brenda në për shtëpitë. Karoca, qere, automobila, autobuze, kuaj, gomarë, po vozitnin gjithë natën, kush mundte të ikte. Nuk njihte qeni të zonë.

Muarm vesh të nesërmen se kush e di sa vetë u gjendnë të vrarë rrugës së Durrësit, shumica e të cilëvet ishte rëzuar prej autobuzëvet e kamionëvet, që ishin ngarkuar me stiva e kapica njerzish.

Të nesërmen, që ishte edhe ungjilla e Krishtlindjeve (24 Dhjetor 1924), Zogu hynte triumfalisht në Tiranë me gjithë ushtërin' e tij. Ju bë një pritje mashështore prej popullit. Një gëzim e një enthusiazmë i math shiheshe në fytyrat e popullit.

Vajta atë natë në konakun e Zogut ku u përqafuam edhe një herë e i urova mirë-ardhjen atij dhe ushtrisë trime që kishte pas. E pyeta holl' e gjatë me gjithë kallaballëkun që po grumbullohej rreth tij, edhe ndenja pranë më shumë se dy orë. Zogu kishte dëgjuar torturat që kishin pësuar disa prej miqve të tij edhe veçanërisht sqenën që më kish ngjarë mua, për të cilën u fik gazit kur ja tregova me gjithë hollësirat e saja. Ajo natë ish një natë lumënije.

Qysh ditët e para të ardhjes së Zogut u pa një qetësi shembëllore e një rregull në administratë. Zogu, gjer sa solli normalitetin në vent vepëron si komandant i operacjonit.

Më 5 Janarit 1925 Këshilla e Naltë kishte ngarkuar Zogun për formimin e kabinetit të ri edhe Zogu e formoj me njëherë edhe menjëherë lajmëroj masat e Kuvendit Kushtetues për të ardhur në Tiranë që të legalizoheshe Qeverija e re Konstitucjonale.

Më 17 Janarit 1925 Kuvendi Koshtitues ishte mbledhur në Tiranë e kish filluar vepërimtarin' e tija, dhe me 21-I-925 kish adoptuar unanimisht formën e re të regjimit të Shtetit, dhe midis një enthusiazmi të të math e brohoritjeve të parreshtura Shteti Shqiptar u prokllamua Republikë . Një kohësisht ishte pregatitur edhe Statuti Themeltar i Republikës, i cili u çpall me një herë.

Mbas këtyre formaliteteve më 31-I-925 një pasdreke herë, dyke qenë Kuvendi Koshtitues i mbledhur me një ceremoni të duhur e me një seriozitet, Kryetari i Dhomës së asamblistëve panegjirikisht në mes të një pushimi të thellë çpalli vendimin e Asamblesë Koshtutore , dyke qenë të gjithë të ngritur më këmbë, me të cilin vendim Ahmet Zogu ishte zgjedhur si Kryetar i parë i Republikës Shqiptare!

Një duartrokitje e fortë shpërtheu me një orë në sallën e Parllamentit edhe gjithë Asamblistët, si edhe dëgjonjësit manifestuan gëzimin e tyre të pakufijshëm. Ahmet Zogu u ngrit e ardhi në tribunën, ku me një farë mallëngjimi falenderoj nga zembra Asamblenë për këtë nder të math që i bëri. Fjalët e Zogut drejtuar Assamblesë ishin këto : Ju falenderonj për nderin që më bëtë, dyke më zgjedhur Kryetarin e Republikës Shqiptare. " Ju jap fjalën e nderit, se as një ambicje personale nuk ka për të më influencue, as që ka me e ndalue fuqinë t'ime t'i dal zot Shtetit, e të shërbenj me ndërgjegje interesit publik".

Fjalët e Kryetarit të Republikës i mbuluan brohoritjet e duartrokitjet e pashuara. Enthusiazmi i asaj dite nuk ka si përshkruhet dot me pendë. Atë natë u bënë manifestime të mbëdha nga populli. Ishte një natë gëzimi e enthusiazmi që nuk harrohet kurrë.

Prokllamimi i Zogut si Kryetar i parë i Republikës Shqiptare u prit me kënaqësi të pa treguar nga gjithë krahinat e Shqipërisë. Me qindra telegrafe urimesh po vijnin nga të katër anët. Kam qenë 3 ditt rjesht në bashkëpunimin me Zogun, ku regjistruam më shumë se 800 telegrame këso doret.

Asambleja Koshtituese, si mbaroj së votuari Statutin e ri e punët e tjera u shpërnda më 2 mars 1925.

# XXI

Viti shpëtimtar 1925 kishte aguar me një hyll fort të mirë. Qetësija, rregulli, disciplina mbretëronin kudo. Administrata qëndrore e lokale kryenin punët e tyre në harmoni të plottë. As një ankim, as një qarje nuk dëgjoheshe gjëkundi. Gjithë populli ish i kënaqur

Për rregullaritetin e Statutit Kryetari i Republikës, mbassi shpërndau Assamblenë Kushtetuese, që e kishte mbaruar misjonin e saj, çpalli zgjedhjet e reja të deputetëvet. Këjo ngjau më 15 Marsit 1925, dhe Parllamenti i ri do mblidheshe më 1 të Qershorit të atij viti prej 57 deputetësh.

Kur çpalli zgjedhjet Kryetari i Republikës më thiri në Pallat të tij e më tha : "Miqësinë tuaj nuk e harronj kurrë, as veprat t'uaja patriotike, prandaj me gjithë zembër vendosa t'ju kem deputetin t'em nga an' e Prefekturës së Korçës e kështu dhashë urdhër e u regjistruat sot në listën e kandidatëve deputetë të përkrahur nga Qeverija ime".

E falenderova tepër e u largova. Më 17 Majit 1925 mernin funt zgjedhjet e deputetëve në të gjitha krahinat Shqiptare. Në Korçë zgjidheshin 9 deputetë, prej të cilëve 4 të krishterë, midis të cilëvet u zgjodha edhe unë si deputet i Korçë, dyke kaluar 40 e ca vota deputetin që mori më shumë vota se të tjerët. Deputetët e krishterë të Korçës ishin zgjedhur unë, Panteli Vangjeli, Kostaq Kotta dhe Kristaq Kosturi.

Më 1 Qershorit 1925 në mes të një enthusiazmi të patreguar u mbloth Parlamenti i parë konstitucionar republikan, dyke prokllamuar një zëri Kryetarin e Republikës Shqiptare, si edhe pranoj unanimisht programin e ri të Republikës, të çpallur solemnisht nga an'e Kryetarit të Republikës.

Punët tani shkonin mirë. Mbi profesjonin t'em si avokat më ishte shtuar edhe misjoni i deputetit edhe kisha të drejtë të ushtëronja njëkohësisht që të dyja, pa një ndalim.

Pas si u zgjodha deputet, një ditë më thiri prapë në pallatin e tij Kryetari i Republikës e më tha : "I dashtun, z. Floqi kam vendosur të kemi një farr' organi letrar për përkrahjen e Qeverisë e të interesave të vëndit. Për këtë qëllim ju zgjodha ju, si më të aftë e më të përmendun në fushën e gazetarisë, si edhe në atë të patriotizmit. Jam i bazuar në karakterin, në moralin e në ndërgjegjen t'uaj. Do t'a titulloni ju vetë gazetën që do nxirni dhe unë do t'a subvencjononj. Urdhroni një herë një avancë[1] prej mejet (e më dorzoj 100 napolona). Në qoftëse duhen të tjera këtu jam unë. Fitimet e të ardhurat e tjera të gazetës janë për hesap t'uaj, nuk ju përzjehet njeri. Do të shkruani si t'ju mbushet mendja dyke qenë në kontakt me Qeverinë. Artikujt t'uaj asdo ti kontrollojë, as do ti censurojë njeri. Kemi besim të plottë e të patundur mbi ndërgjegjen e patriotizmin t'uaj. Kini për qëllim përparimin e vendit. Goditni çrregullimet, padrejtësitë, sabotazhet, klikat, partizanit' etj etj. sa të mundni e mos kini frikë se mos i mbetet hatri dikujt dhe mos bëni armiq. Më kini mua prapa krahëve t'uaj. Sa herë që të kini nevojë, ose që të doni të piqeni me mua pallati im ësht' i hapur për ju, qoftë edhe natën. Jeni njeri i brendëshëm për mua. S'kam ç't'ju thom tjetër, ose t'ju porosit. Ju uronj sukses të plotë edhe grajani punës qysh tash. Unë pres me gëzim numrin e parë".

Këto më tha Kryetari i Republikës e më shtërngoj dorën. E falenderova se u mundua për këtë nder të math e për besimin më të math me të cilin më nderoj, edhe u largova mjaft i kënaqur. Zogu kur e deshte dikent me shpirt ja tregonte në një mënyrë globale miqësin' e simpathinë e i jepte me të dy duart. Për mua mjaft favore kish treguar gjer më tani.

Unë me nje hëre e vura në vepërim çështjen e gazetës. E titullova :"Indipendenca Shqiptare" për arsye se titujt "Pamvarësija Shqiptare", "Vetëqeverimi", ose "vetësundimi Shqiptar" etj. etj. nuk më tingëllonin mirë në vesh.

Pas një jave delte gazeta ime dhe fletën e parë ja shpura vetë Kryetarit të Republikës, i cili u kënaq tepër e më përgëzoj. I pëlqeu fort. Deshte të më darovitte po nuk ja pranova.

[1] avancë = paradhënie (H. K.)

Çpallja e “Indipendencës Shqiptare”, bëri një efekt të mirë në popull, i cili e blinte me kënaqësi. Prej 100 e sa fletësh që filluan të shiten brenda në Tiranë në dy javë shitja arrinte në 500 copë. Brenda një muaji kisha bërë 300 e sa abonatë, të cilët në funt të vitit të parë kaluan 1. 000.

Munt të kuptohen fitimet që kisha prej këtij rasti të papandehur, dyke i mbajtur të gjitha për vehte me përjashtim të pagimit në Shtypëshkronjë, që e paguanja vetë shtypin, si edhe shpenzimet postare. Më mbetej një fitim mesatar mujor 70-80 napolonash, që ishte një fitim tepër i mirë, edhe po të shtonim 22 napolona që mernja në muaj si deputet edhe 80 gjer 100 napolona në muaj që fitonja si avokat, unë kisha një të ardhur gati 200 napol. në muaj prej të cilave më mbeteshin neto 150-160 napol. mujore, kështu që brenda një kohe të shkurtër u gjeta me një kapital 600 e sa napolonash gjithë flori. Ky ish përfitimi që ja detyronja Zogut.

Një ndollinë që do të tregonj këtu më poshtë më bëri që të bëhem edhe me shtëpi, që as e kisha ndër ment, as e kisha fandaksur, po veç se e kisha ëndëruar vetëm. Unë të bënja shtëpi në Tiranë? Kurrë ndo një herë s’e besonja!

Banoja në një shtëpi të vogël prej 2 odash të vogla lart edhe një odë tjetër përposh, pa çardhak, pa kuzinë, pa ujë, pa gjë fare. Këjo ishte një nga shtëpit’ e kallanxhiut kucovllah Vangjel Kojës, të cilit i paguanja 5 napol. në muaj me kushtin që ja parapaguanja përpara të 5 muajt, do me th. i jepnja nga 30 napol. ar përpara ç’do 6 muajshi. Po V. Koja, ndjeje Zot, ishte shumë i lakmuar. Vitin e dytë më kërkonte nga 10 napol. muajin edhe këto përpara, do me th. 120 napol. posa që të fillonte moti II. Dhashë mora, s’ja mbusha kokën. Ja shtova 5, ja shtova 7 napolona, me azallah ajy s’dëgjonte kurrë! E keqja ish që s’gjenja tjetër shtëpi në Tiranë. Filloj grindja. Më preu ujin që merrnja nga pusi i tij. Më sillte plot ngatëresa. S’dinja si të bënja.

Për fat takoj një ndollinë tjetër. Kapitan Shefki Shatkua nga Dibra, që e kisha mik, ish kryetar i gjyqit ushtarak. Unë kisha marrë shumë davara në Gjyqin Ushtarak e kështu njiheshim mirë me Shefki Shatkon.

Takoj një natë që humbi në kumar nj’a 60 napolona, të cilat nuk ishin edhe të tijat. Më vjen ditën tjetër në zyrë e më tregon taksiratin që e gjeti. Aman, më thotë, në më ke mik, mos më turpëro, bëj si bëj e m’i gjej këto të holla se kam turp të kërkonj gjetkë, ty të kam më të afërmin mik edhe do t’i lanj pak nga pak.

E pashë se nuk munt të shmangesha dot, edhe pse e kisha mik, po edhe se mos e dispononja keq, si kryetar gjyqi, që munt të më prishte shumë punë edhe bile të më diskretitonte dyke më rëzuar davatë.

U afrova me një herë edhe pas dreke i numurova të 60 napolonat që më kërkonj. Më falenderoj tepër e më dorzoj kambialin të nënëshkruar prej tij, po nuk ja pranova. Këjo e obligoj edhe një herë për besimin që i sillnja, e më tha se nuk do t’a harronte kurrë këtë të mirë.

Por, pas 3 muajsh ra prapë ngushtë e me një mijë të drojtura më kërkoj edhe 40 napolona të tjera. Ç’ të bënja? Ja dhashë edhe ato pa ja pranuar as këtë radhë kambialin e nënëshkruar që më ofroj për 100 napolona tani, gjë këjo që e habiti tepër.

Pas një jave në vjen prapë në zyrë. Këtë radhë më thotë, nuk ardha t’ju kërkonj të holla, se më dhatë mjaft e ju falem nderit shumë. Ardha, thotë, vetëm t’ju marr të dalim një shetitje nga rruga e Dibrës, në të cilën rrugë kisha edhe zyrën. Me gjithë qejf, i thom, edhe mora kapellën e duallm të dy bashkë nga zyra ime. Shkuam gjat’ e gjatë, kur aty më një vënt u ndalmë. Hyjmë, më thotë në këtë bahçe të hamë ndonjë qershi, se ka qershi të mira. Edhe me një herë nxjer një çelës të vogël prej xhepit, e çel derën edhe hymë brenda në kopsht, një kopsht shum’ i bukur e plot drurë me pemë. U sheshuam aty dyke ngrënë qershi. E pyes : i kujt është ky kopësht? I jemi thotë. E kam blerë 200 napolona, e si e sheh ka 25 metro facadë e 58 metra gjatësi. Por mjerisht unë shtëpi s’munt të ngreh dot këtu se më mungojnë paret pastaj kam edhe borxhe. Me qenë se s’kam mundësi t’ju paguanj at borxhin që ju kam juve

vendosa ta shesh këtë vent. Në qoftë se e dëshironi ju, po ju preferoj si mik të vërtetë që ju njoha, e bile po ju le edhe 10 napolona, kështu që, po të doni më jepni edhe 90 napolona e i paçi hajrin këtij vënti.

E mejtova mirë, edhe sa të prisnja Shën Pollogun t'i mernja ato 100 napolona, preferova ti jap edhe të 90-tat e të përfitonj atë koxha vent, pa makar le të më mbeteshe.

Ç'ka i thom, d'akord, e pranonj. Zumë dorën njëri – tjetrit e u larguam nga kopshti. Unë s'i tregova njeriut ç'ngjau atë ditë, as gruas s'ime. Të nesërmet më thresin nga zyra e Kadastrës që të firmoj aktblerjen e një kopshti, të shitur mua prej Kap. Shefki Shatkos. Me një herë e firmova e mora tapinë. E pashë në aktin se Sh. Shatkua kish dekllaruar se i kishte marrë plotësisht prej meje të 200 napolonat e vleftës së kopshtit, kur se unë i kisha për ti dhënë akoma 90 napolona! Këjo më habiti tepër. Shkova në shtëpi e mora nga arka 90 napolona e i vajta në zyrë Sh. Shatkut. I thom: Ju falenderonj fort për gestin e shitblerjes se kopshtit po, qysh e dhatë ikrarin[1] pa ju dhënë kusurin e parevet? Po në qoftë se s'i kam këto të holla si bëhet? Ma priti me një buzëqeshje kapitani e më tha : Zotrote u tregove kaqe fisnik për mua kur më dhatë gjith' atë shumë paresh pa një dëftesë nga ana ime, si unë munt t'i mungonja kësaj mirësije? desha t'ju a shpërblenj, edhe në qoftë se s'i kini të 90 napolonat mi jipni kur ti kini.

Nxora ahere të 90 napolonat e ja dorëzova e shkuam të dy në një pijetore e çkulluam nj'a 3-4 shishe birra që i gostita unë.

Tani isha me një mylk[2], po njeri nuk dinte gjë rrotull kësaj shitblerjeje. Atë natë vendosa t'ja rëfenj ngjarjen gazmore t'ime shoqeje, po në një mënyrë befasije, pa ja paralajmëruar.

Nga të perënduarit e Djellit e mora në shetitje dhe dyke fjaluar arthmë në kopshtin t'onë. E pyes gruan t'ime : T'u duk larg gjer këtu që nga zyra ime? As pak, më thotë, as që e mora vesh se arthmë gjer këtu. Një miku im, i them, që është i zoti i këtij kopshti më dorzoj çelsin të hyjmë brenda, të hamë ca qershi, se ka një qershi shumë të mirë; dhe me një herë e çela deriçkën e kopshtit dhe hymë brenda. Gruaja u çudit kur e pa atë kopësht aqe të bukur e ngarkuar me pemë gjithfarësh. Si të duket , i them , ky kopësht? Ekstra, më thotë, s'bëhet më i bukur; makar të kishim edhe ne një si këtë. Ahere ju çfaqja. Hë, pra, i them, ky kopështi është mylku i jonë, e bleva sot, urdhro edhe tapinë; e ja dorëzova. Ajo u gëzua pa masë edhe s'dinte si të më tregonte gëzimin.

Thashë aty më lart se me patronin e shtëpisë, kallajxhinë Vangjel Koja kisha gjetur belanë, se kërkonte t'ja shtonja qiran' e shtëpisë prej 5 në 10 napolona e t'ja jepnja për një mot përpara. Paturpësija e këtij njeriu kishte arrirë kulmin. Isha në gjëndje të keqe, se shtëpi nuk gjenja, s'kisha ku të futesha, se edhe këtë shtëpi me miq e me një qint belara mezi e kisha gjetur. Vangjel Koja s'ishte mjaft që më preu ujin e më shkaktonte kaqe ngatëresa, po më së fundi edhe më paditi në gjyq dhe kërkonte lirimin e shtëpisë.

Vangjel Koja kish emëruar avokat z. Mihal Lehova, që hiqeshe patriot e që e kisha edhe mik. Mjerisht ky më luftoj shumë e ma bënte edhe për inat se e kisha diskretituar kaqe herë përpara gjyqit, ku kishte humbur shumë davara e kishte marrë një famë të keqe si avokat. Kur ju luta të ndërmjetsonte ti paguanja gjer më 7 napolona në muaj qira e të më linte rehat. Ajy s'dëgjonte, por as patronin e shtëpisë nuk e linte të merreshe vesh me mua. Kaqe fort ia kish mbushur mëndjen, se ishte i sigurt se do t'a fitonte davanë e do më nxirte jashtë nga shtëpija, që të kënaqej sidomos avokat Lehova.

Para se të fillonte gjyqi e thira patronin V. Kojën në zyrë, po s'më ardhi, as në shtëpin ku banonim. Po një ditë e gjeta mb' udhë e e ndalova. I thashë : mor zot, as jemi vrar' as jemi prerë, pse je kaqe kokë-fortë e s'vjen të merremi vesh, po shkove në gjyq? Nuk të mjaftojnë 7 napol. qira në muaj që po të ofronj? S'kam nevojë, më thotë, unë dua të më lëshosh shtëpinë që ma ke zaptuar përdhunisht. – Përdhunisht unë shtëpinë? Po nuk të kam paguar nga 5 nap.

[1] ikrar = rrëfim, deklarim (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

[2] mylk = pasuri e patundshme e madhe (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

në muaj, s'të janë mjaft për një copë shtëpi aqe të vogël e pa ndo një komoditet? Ahere, ja ku të them, i thashë, do bëhesh pishman e do vish të më lutesh ti vetë të ndreqemi, po do jetë von, se ahere s'të dëgjoj unë.

Kur u ballafaquam në gjyq me av. Lehovën, unë kërkova të kqyret shtëpija me ekspertë e të caktohet qiraja sa duhet t'i paguanj për 3 oda aqe të vogla, pa një kuzinë, pa një çardhak e pa një komoditet. Por më përpara nga këto gjyqi e kish gjobuar me taksin bashkiak të 3 fishtë e me shpenzimet përkatëse, se s'kishte bërë kontratën me mua. M'andej gjyqi vendosi ekspertimin e shtëpisë dhe ekspertat, si e kqyrë shtëpinë dhanë raportin relatif, mbas të cilit duhet ti paguanja V. Kojës vetëm 3 ½ napolona në muaj qysh ditën që hyra në atë shtëpi. Kështu gjyqi vendosi të më kthejë paditësi V. Koja 18 napolona prej të 60-vet, që i kisha paguar e q'andej e tutje të paguanja vetëm 3 1/2 qira në muaj.

Vendimin e diktoj V. Koja, por edhe Diktimi e vërtetoj aktgjykimin e Gjyqit të Paqit. Kështu ajo dava i kushtoj V. Kojës përveç nj'a 300 e sa frangave për shpenzime gjyqi e të drejta avokatore të parapaguara av. Lehovës, por mbassi unë e vura në eksekutim aktgjykimin, ajy më kthen edhe 18 napolona mua, përveç që pagoj edhe shpenzimet e ekzekutimit e kështu ndenji lark nga shokët, i penduar e i pikëlluar!

Një ditë ardhi në zyrë e më tha : më zuri gjynahu, zotni, ti më dolle hakut, po më qafë më pastë Lehova ; diçka e dinja por ajy qënke shakllaban. E mu lut t'i paguanja qiranë si më parë. Unë i thashë të shëkojë punën, se s'ka punë me mua.

Mirë po qysh atë ditë gjetmë belanë nga e shoq' e tij e nga djemt' e tij. ç'të bënja? Të grushtohesha, të rrihesha me ata? Arrin një jet' e paduruar, sa na u ngrit krejt qetsija!

Këto më bënë të vendos të bënj një copë shtëpi, ku të fut kokën me familjen t'ime. U mejtova mirë e thellë. Në kasë kisha vetëm 360 napolona. Bëheshe shtëpija me kaqe të holla? Jo, kurrë. Më mbajti shpresa se mbassi fitonja 180-200 e sa napolona në muaj nga profesjoni im, nga rroga e deputetit e sidomos nga të ardhurat e gazetës, brenda 4-5 muajve, sa desh shtëpija të bëheshe, munt t'i bënja 1000-1200 napolona, të cilat pas mendimit t'em do të ishin të mjafta për një shtëpi dollmallije[1], për një shtëpi Elbasanase një kati me nj'a 3 oda e një kuzinë. Vëndin po e kisha edhe kështu shpëtonja nga një skoturë të madhe për të gjetur shtëpi. Për këtë qëllim u këshillova me mikun t'em arqitekt Kristo Sotirin nga Pogradeci, që kish një pamje madhështore kur e shëkonje me një mjekër të gjërë e të gjatë si të Tollstojit.

Atij i tregova qëllimin t'em. I thashë se shtëpija s'duhet të më kushtojë shumë mbassi do jetë përdhese, dhe duhet ta dinte se s'kisha më tepër se 600 napolona. Ajy bëri një llogari aty shpejt-shpejt mbi tavolinën, e më tha se arrijnë 500 napolona për një shtëpi këso-doret, mbassi e kam vëndin. Ardhë e kqyri edhe vëndin, mati gjërësin' e gjatësin' e shtëpisë edhe caktoj me një herë themelet në vënt. Ajy vetë gjeti edhe muratorë të mirë Pogradecarë që kishin punuar në Rumani e që i njihte e kështu një mëngjes të bukur ftova edhe disa miq në vënt e mbassi bëmë kurban një dash, sipas zakonit, hothmë çementon e parë e themelit të shtëpisë së re midis një gëzimi të pa treguar.

Shtëpija filloj dhe prej gëzimit që ndjenja kush e di sa herë e linja punën dhe Parlamentin e vinja përpara shtëpisë së re që po ngriheshe, dyke inkurajuar ustalloarët e dyke i gostitur me cigare e raki.

Në fillim m'u dukte një gjë e vogël, një si lodër, se s'kisha harxhuar shumë të holla, por nuk kaloj një muaji, e kur pashë që më ardhë billat[2] me llogarit e ngryshme të lëndëve prej kreditorëve të mij, e kur pagova me një herë 280 e sa napolona edhe shtëpija s'ishte ngritur as dy metra, më ra vilanija! Gjer atë ditë punimet e shtëpisë më kishin kushtuar 350 napolona dhe shtëpija s'ish gjëkundi. E thira me një herë arqitektin Sotiri e i thashë: shëko mirë mos bijem jashtë se s'më duket të na arrijnë as 700 napolona kështu si po shkon shtëpija. Po arqitekt dinak, i cili kish tjetër mendim për mua, që më quante ndofta ndo një miljoner, më

[1] dollmallije = shtëpi një katshe me bodrum poshtë (H. K.)

[2] billat = faturat (anglisht H. K.)

qetsoj e më tha se munt të venë edhe 700 napolona, po kjo s'është ndo një kijamet i math për ju e mos u trembni, se ju kini edhe rrogën e deputetit edhe gazetën, pastaj fitoni mjaft edhe si avokat, pse kini frikë?

Kisha vënë re se betonet armate të murevet të thurura me tulla ishin 70 pont të gjërra e i thashë arqitektit se kështu shkon shumë material dhe do na hajë betoni me hekurat, po ajy ma priti me fjalët : Një herë bëhet shtëpija, ja ta bësh të shëndoshë të mos dojë t'ja dijë, ja mos e bëj fare.

Kreditorët tregëtarë si edhe tullaxhinjtë e gëlqerexhinjtë e të tjerët më sillnin material me të tepër dhe unë, sa do që e shihnja materialin e grumbulluar në bahçe s'isha mejtuar ndo një herë seriozisht pale sa kushtonte gjith' ajy material që ish e ajy që do vinte akoma.

Takoj që shkova në Napoli për shkak të djalit t'em Pirros që e regjistrova në shkollën ushtarake mbretnore të Napolit dhe u vonova nj'a 5-6 javë gjer sa u ktheva në Tiranë. Kur arriva, sa do që ishte natë, s'mu durua, po shkova shpejt të shoh gjer ku kishte vajtur shtëpija, të paktën kujtonja se do ish hedhur çatija. Pyeta gruan t'ime në qoftë se kishte shkuar ndo një herë nga shtëpija edhe në ç' gjëndje ishte, por ajo, qysh se ika unë për në Itali as një herë s'kishte shkuar atje.

Nisem shpejt edhe drejtohem nga shtëpija. ' të shoh? Shtëpija ishte bërë me dy kate e ishte ngritur 8 metra e sa përpjetë! Skelat e mbëdha që kishin gritur rrotull i jepnin një pikpamje gjigandeske shtëpisë; ishte tamam një pallat. Medet!. . . Mos jam në ëndër, thesha me vehten t'ime. ç' më bëri kështu ky i mallkuar inginer? Unë e kërkova shtëpinë dollmalli e ku po më ngrehka këtu një pallat? Kush i tha? Me ç'të drejtë? Më paska marrë më qafë, ah!.... Këjo më dëshpëroj krejt, sa, sikur t'a kisha përpara arqitektin nuk di ç'do t'i thosha! Atë natë as kam ngrënë bukë, as kam fjetur nga meraku. Kot mundoheshe të më ngushëllonte gruaja e gjorë, po unë ja hithnja fajin asaj që s'u kujdes një herë të shohë ç' bëhet e ti ndalonte të ngrihnin katin e dytë.

Të nesërmen, pa gdhirë mirë, shkova në shtëpi të ing. Sotirit dhe i fola shumë ashpër. ç'më bëre? i thashë. Më more më qafë; tani do mos kem as shtëpi, se unë s'arrinj dot kështu, më the se do mos kushtojë më shumë se 700 napolona e tani? I fola shumë rëndë, po ajy s'u zembrua. E bija Kuerina më qiti një kafe, po as atë s'desha të pinja nga inati. Po ing. Sotiri, që i gëlltiti të gjitha këto, nuk e prishi aspak gjakun. Më mori me të mir' e me të butë e më tha se s'munt të bëheshe shtëpija ashtu si e desha unë, por ashtu si e deshte teknika arqitekte e si e lypte vëndi. Një shtëpi jerevi[1] s'munt të ngriheshe në një vent aqe të bukur e pitoreske si ishte bahçja ime edhe për këtë s'duhej të vrerosesha, se kështu e kanë pësuar shumë veta, të cilët m'andej e kanë edhe falenderuar arqitektin, se bija edhe shtëpija kanë fatet e tyre , e më së fundi "Ka Perëndija" edhe s'duhet të trembësha, se kisha edhe miq që munt të më ndihmonin edhe shpresa nga ato që fitonja.

I dëgjonja me vrejtje këto, po prapë nuk qetësohesha, se më vinte çudi si do ti lanja gjith ato borxhe të materialit e të puntorisë, kur unë s'kisha atë kohë veç se nj'a 200 napolona?

Neise, u bë ç'u bë, po tani duheshe mejtuar thellë si do të përballonja gjith këto shuma paresh e ku të futesha? Ing. Kr. Sotiri më kishte hedhur në një pellk të math, në një llom, prej të cilit nuk do dilnja kurrë!

Pas 3 dittsh më vijë në zyrë një grumbull notash të kreditorëve të materialit, që përfaqësonin një shumë prej 325 napolonash. Mbi ato muratorët më paraqitnin një hesap, që përfaqësonte një shumë prej 70 e sa napolonash! Po tani? ç'bëhet tani? Kujt t'i ankohesha? Kujt t'ja qanja hallin? Pagova shpejt ustallarët, se s'priste puna, m'andej pagova ndo 130 e sa napolona material e kështu mbeta pa një metalik në xhep e kisha edhe borxhe të tjera, që i paguanja dita ditës....

[1]jerevi = në dialektin shkodran i thonë shtëpisë një katshe në fund të oborrit që shërben si depo, kthinë (H. K.)

Ajo natë ishte një natë mjerimi për mua. S'ishte mbaruar akoma karabinaja e mua më kishin dalë prej xhepit 550 përveç vëndit, do me th. gjithsejt 740 napolona edhe kishte edhe 130 të tjera borç, edhe gjer sa të mbaroheshe karabinaja ashtu si kish filluar duheshin edhe nj'a 200 napolona të tjera; po të lyerat, po dyshemetë, po penxheret etj. etj.? Medet e vaj halli, ku do vinja unë? Mëndja ment më loste! Piva një paqetë cigare atë natë; u gdhiva më këmbë. S'dinja ku të futesha!....

Nga të gdhirët më kishte marrë gjumi, se isha i vrarë e i këputur. Po edhe tani s'më lanë të fle. Një shofer Himarjot, i shkreti Mihal Stefo, që vdiq më von prej tuberkulozi, vjen e më zgjon nga gjumi për një punë urgjent për atë. Desha, s'desha u ngrita. Shkuam bashkë në hotelin e math Continental, ku ndodheshe një gjerman, drejtor i shoqëris gjermane INAG për sfrutimin[1] e pyjeve të Mamurasit, që i kishte marrë me koncesjon prej Qeveris Shqiptare.

Mihal Stefua kish për të marrë prej atij nj'a 50 napolona për transportime të ndryshme me veturat e tij, që i kish shërbyer INAG-ut e me që s'dinte as gjermanisht, as frëngjisht që të merreshe vesh me drejtorin gjerman, më mori mua edhe si avokat edhe si dragoman.

Unë u njoha me drejtorin e shoqërisë në hotell dhe pas gjysmë oret e kisha bindur për të drejtat e Mihal Stefos, e ky qiti e i numuroj përpara meje 48' napolona, që Mihali mbet fort i kënaqur.

Po drejtori gjerman nuk më la të shkonj. Ajy kishte të tjera punë me mua e më tha se ësht' i lumur që u takua me mua, se kërkonte një avokat të mirë për punët e Shoqërisë INAG e i kishin rekomanduar mua, po s'pati kohë të më piqte, e tash nguteshe të shkonte për në Konstanz të Gjermanis ku e kishte qendrën shoqërija INAG. Mu lut që të merrnja shpejt një noter publik të më lëshonte një prokurë të përgjithëshme për punët e shoqërisë e në Shqipëri. Shkova e mora noterin i cili redaktoj prokurën me fuqi të përgjithëshme veprimi.

Drejtori svizeran i INAG-ut, mbassi nënëshkroj e më dorëzoj prokurën, më tha se ajy po niseshe shpejt, dhe pas ndo një jave do vinte në Tiranë zëvëndësi i tij z. Wihelm Kapferer, si drejtor permanent i shoqërisë, tek i cili do më rekomandonte, dhe ajy do më dorëzonte çështjet që shoqërija kishte me Qeverinë Shqiptare edhe me disa privatë. Më së fundi më dha një çek prej 100 napolonash, si avancë, ose kapar avokatije.

Kur u ndava prej z. Drejtor, u ndala pak në një kafene të pi një kafe. E ndjeva vehten pak të lumur. Pashë se Mihali i shkretë nuk më zgjoj kot. Përpara meje kish filluar të zgjidhej pak problemi i të hollave, që ment më prishi mentsh atë natë! Tek po pinja kafenë ardhi edhe Mihali i ngratë në kafene e e qirasa edh' atë me një kafe. Ajy nxori e më dha 5 napolona. Na, më tha, merri se i ke hallah, se zotrote më mbarove punë.

U gjenda me një herë me 105 napolona atje ku s'kisha as metelik e ku vrisnja mëndjen so do t'ja bënja hallit. Shkova e mora parat e çekut në bankën Kombëtare të Tiranës e ardha me qejf në shtëpi ku rash' e fjeta i çkujdesur. Kishte të drejtë arqitekti Kr. Sotiriu!

Të nesërmet shkoj në zyrë. Aty mar një dava të mirë në gjyqin ushtarak, prej së cilës mora kapar 30 napolona. Përpara drekës, po atë ditë mernja edhe rrogën e deputetit për muajin Shtator 1926. Po atë pasdreke mora edhe 12 napol. të tjera prej abonentëve te gazetës, dërguar me çeke, ose me mandat-postar.

Isha i zoti i 172 napolonave tani brenda një dite. Problemi kishte filluar të zgjidheshe. Lava shpejt ca borxhe që kisha e më mbet edhe kusuri. E ndjenja vehten të lumur!

Pas nj'a 10 ditësh ardhi edhe drejtori i ri i INAG-ut z. Kapferer, i cili më takoj në zyrën t'ime. E prita si jo më mirë, se në personin e tij shikonja "Perëndinë nga makina" (Deus ex maqinam).

Z. Kapferer më angazhoj të trajtonj dy kontrata të mbëdha sipërmarrje drush me një shoqëri italjane. Për këto dy kontrata, në bazë të ligjeve avokatore, po mernja pas në jave 200 plot napolona të verdha, me anë të një çeku të lëshuar.

[1] sfrutimin = çfrytëzimin (H. K.)

Pas dy javësh të tjera i takoj një ngatrese e madhe shoqërisë me Qeverinë. Këtë ngatëresë munda e e zgjidha brenda 20 ditëve dhe prej shpërblimit 5% që e kishin simfonisur mora 182 napolona! S'dua ta zgjat më tepër, veç se përfundimonj dyke thënë se INAG-u ish për mua shpëtimi i jem! Ajo shoqëri pagoj gati 1/2 e harxheve të shtëpisë, përmbi 1. 000 napolonash, prej shpërblimeve që më dha. gazeta, rrogat e deputetit dhe të ardhurat e tjera të zyrës përmbushnë kusurin e shtëpisë, e cila me llogari në dorë, kushtoj përmbi 2. 800 e sa napolona ar kurse unë kujtonja se munt t'a mbaronja me 6-700 napolona, po.... . bija e shtëpia paskan fatet e tyre!.... ing. Sotiri kishte të drejtë. Ka Perëndija!

Shtëpija u bë vërtet një pallat, me 12 oda, veç koridoreve, me 5 kthina të tjera nënëdhesa të qilarit, që dy prej atyre na shërbejnë për oda, gjith'ashtu u bë një koxha verandë e me një taracë madhështore prej së cilës shihet panorama e Tiranës.

Gjer këtu shkoj mirë, po tani kisha rënë në një hall tjetër. Shtëpija e re desh edhe mobilla të reja; gjith' ato oda e sallone si do mobilloheshin? Pastaj desh edhe dritra, gjith ato llamba elektrike si do t'installoheshin , sa shpenzime kërkonin? Pastaj mungonte dhe installimi i njërës për banjot e nevojtoret posht' e lart, ç'harçe kollosalle duheshin? Tjetër hall dhe hall i madh ky! Gjer tani ishin harxhuar me vent, me mure e godinë mbi 3. 000 napolona, tani duheshin edhe ndo një mijë te tjera, ku do ti gjenja?

Por unë nuk e harronja atë proverbë të vlefshimë të ing. Sotirit: bija e shtëpija kanë fatet e tyre, si edhe atë shpresën që më kishte dhënë tjetër herë "ka Perëndija". Kisha besim të plotë ne dyja këto fjalë të urta dhe nuk dëshpërohesha. Edhe me të vërtetë s'dolla i gënjyer. Inagu, gazeta, të ardhurat e zyrës, dy shoqëri të tjera sipërmarëse që i mora përsipër si avokat edhe disa dava të tjera me rëndësi civile e penale e zgjidhi edhe këtë çështje. Kur pashë se e mbarova shtëpinë pa vënë ndonjë borç e kur konstatova se m'u mblodhë nj'a 600 napolona, vrapova shpejt në Napoli e bleva të gjitha mobilat e nevojshme për të gjitha odat e sallonet, konsolla, krevate, trapeza, pasqyra, kanapè, etj. etj. piktura muri, perdhe, çarçafë, jastekë, kuverta etj. etj. që kushtuan 600 e sa napolona me gjithë transportet, përveç shpenzimet e mija të rrugës e të ndenjurit në Itali më shumë se një muaj. Kështu u pasuruan mirë të gjitha ato oda e sallone e kuzinat.

Pas pak kohë si u ktheva në Tiranë fillova dhe instalimin e ujës e m'andej të elektrikut me 36 e sa llambadina për të gjitha odat me llamba e polyele të vlefshëm etj. etj. që kushtuan të dy këta installime gjithsejt 940 napolona me gjithë mobilat, do me th. 340 napolona vetëm instalimet.

Me fjalë të tjera, prej 600 napolonash që e bënim hesap me ing. Sotirin, shtëpia kushtoj 4. 000 napolona!.... "Bija e shtëpija kanë fatet e tyren"! Po mbi të gjitha këto "Ka Perëndija"! Zoti është i math, kanë qenë për mua dy shtylla ku mu mbështet besimi, i cili më nxori në selamet!

Tani shtëpija ishte komplete. Mbi këto ish edhe e larë, e fshirë e e rregulluar, si dhe kopshti i mbjellë e i ujdisur.

Natën e 1 Marsit 1929 (duhet të jetë 1927[1] e jo viti 1929 siç lexohet në tekst H. K.) ishim installuar në shtëpin' e re. Na dukeshe si çudi, si u ndodhmë kështu brenda 9 muajve me shtëpi, edhe ç'farë shtëpi pallat, që si atë gjer ahere s'kishte parë Tirana edhe për dita vijnin me grumbuj njerës që e vizitonin.

Kur fjeta natën e parë në shtëpizën t'ime e ndjeva vehten aqe të lumtur sa nuk do t'a harronj kurrë! Msuar me llamba vajguri, kur u çelnë dritat elektrike, na u duk se ishim në një pallat prallor, si ata të Halimasë!

[1] Në vitin 1927 është bërë një fotografi e shtëpisë ku në ballkon shihen jo vetëm antarët e familjes së K. F. por edhe gjithë të ftuarit në momentin e inaugurimit. Kjo foto mban datën 1927, të cilën unë e kam në whatsapp dhe ia kam dërguar edhe trashëgimtarëve të Kristo Floqit (H. K.)

Të 3 [en] ditë dhashë një darkë e ftova gjithë të afërmit, të cilët ardhë me plot peshqeshe për shtëpin' e re. Kur i ndesmë të gjitha dritat brenda e jashtë shtëpija shkëlqeu! Prej jashtë dukeshe tamam si një pallat splendit.

Kështu u bëmë më shtëpi e shpëtuam nga izijetet e nga pocaqitë[1] e shtëpis së V. Kojës.

U largova pak në këtë tregim, por e quanj si një nga ndollinat më me rëndësi të jetës s'ime.

Vijmë tani prapë në jetën e në veprimet e gazetës s'ime. Këjo po vazhdonte ekstra. Abonetë po shtoheshin. Shkruheshin artikuj e gjërra me rëndësi. Do të tregonj këtu disa ndollina që meritojnë të përmenden, ndollinat të cilat suall një reaksjon të vërtetë edhe diku-diku më vunë edhe jetën në rrezik.

Një nga këto ishte çështja e shumë nëpunësve tembelë e të pazot, injorantë e parasitë.

Këta kishin katandisur me të vërtetë një plagë për Shtetin. Në një kryteartikull që botova në gazetën t'ime u a zbulonja të gjitha dallaveret e padrejtësitë e tyre. Dikush mu përgjeq, po tërthorazi. Këtij ja dhashë përgjigjen dyfijsh, po me qenë se mora nj'a 5-6 letra anonyme me sharje e me frikësime, u shtërngova e ja tregova Zogut, i cili më porositi të mos kem as një mëshirë për këta. Ahere e xhvesha pallën mirë dhe në një artikull të titulluar "Duhet t'u vijet fshesha" përshkruanja një nga një disa dame e abuzime, disa ngatëresa e sabotazhe të tjerë që ata i kishin shkaktuar Shtetit. Përfundimi i këtyre ishte një anket[2]' e himtë nga ana e Qeverisë në të gjitha degat administrative, dhe nxjerrja nga detyra e 150 e sa prej këtyre parasitëve! Këjo shkaktoj një turbullim të math. Unë vetë e kisha jetën në rrezik, po e vërteta ishte se Shteti kish shpëtuar nga kjo plagë.

Një tjetër ndollinë me rëndësi ishte ajo e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, installuar në Tiranë. Kushtet që u kish vënë qeverija jonë përfaqësuesve italjanë për kapitalet t'ona e për formimin e Bankës, ata i kishin cytuar e bastarduar fare. Shteti Shqiptar në atë mënyrë që dëshironin ata e me atë mjeshtëri e dinakëri që po vepronin, vijeshe në problemë; kapitalet t'onë ishin në dyshim.

Ahere, mbassi studjova mirë çështjen e mora informatat e duhura prej të vetmit financjer deputet që kishim në Parlament z. Vasil Bamiha, ju përvesha punës seriozisht, dyke zbuluar e qitur në dritë shumë të shtrembra e padrejtësira për të ndritsuar popullin, po edhe Parllamentin. çështja mori zjar. Italjanët drejtues bashkë me këshilltarin e tyre ligjor z. Amadeo Gambino më ardhë disa herë në shtëpi që të munt ti vijnim nja kapak çështjes se kish marrë bujë. Vetë drejtori i Bankës më ofroj 50. 000 fr. ar që ta pushonja polemikën, po e pa se ish e pamundur, dhe iku i turpëruar se ja dhashë nderin në dorë!

Ishin momente kritike! Populli bërtiste kundra këtyre që deshnin të na thithsnin gjakun. Zogu vetë, si Kryetar i Republikës, u interesua personalisht e më thiri në pallat e biseduam nj'a dy orë së bashkut.

Përfundimi i kësaj lufte ishte të ndroheshe krejt Statuti i Bankës, të siguroheshin kapitalet t'onë dhe pjesmarja në 50% të aksjoneve, si edhe rezerva e jonë e arit të mbeteshe në Shqipëri, pa u transportuar në as një vent jashtë Shqipërisë, të emëroheshe një agjent bankar Shqiptar, me të drejtë kontrollimi të operacjoneve bankare dhe të vihej një rregull i drejtë mbi faux d'emisjones[3] e mbi kreditë bankare dyke u kufizuar privilegjet e forta të mëparshmet që kishte stabilizuar statuti i parë i bankës kundra shoqërive e debitorëve të ndryshëm privatë Shqiptarë.

Një tjetër ndollinë gazetare që të tërheq edhe gazin, po që solli një reaksjon të vërtetë në pikpamje qytetërimi e përparimi e që meriton të shënohet është këja që do të tregonj më poshtë.

---

[1] pocaqi = mundim, vuajtje, mjerim (H. K.)

[2] anket = hetim(H. K.)

[3] faux d' emisiones = gabimet në hedhjen në treg të kartmonedhave (H. K.)

Në Tiranë, por edhe në gjithë Shqipërinë ne vetëm të krishterët mbanin kapella e cilindra gjer aso-kohet. Muhamedanët aspak. Këta mbanin qeleshe, kallpaqe e diku festet e kuqe me xhufkë të Babadovletit. Gratë me azallah se kuxonin jo vetëm kapella të mbanin, por sidomos ato muhamedanet as çarçafet të nxirnin as të dalin açik përpara burravet. Këjo ishte me të vërtetë një njollë kundra qytetërimit.

Nga ana tjetër një tjetër sqenë kapellash po na ngjiste e na okuponte.

Kryetari i Republikës me anën e adjutantit të tij kolonel Zef Sereqit na kish porositur të bënim të paktën dy palë rroba zyrtare për t'u prezantuar në pallat e në festa e ceremonira zyrtare. Rrobat zyrtare do t' ishin frak dhe tajit dhe kapella dy llojesh, cylindër edhe bombè.

Unë vrapova shpejt në Itali dhe pas dy javësh kthehesha komplet në Tiranë nga rrobat e nga kapellat që të gjitha shic dhe extra. Vetëm 5-6 deputetë kishin uniforma të këtilla.

Kur na panë ne të tjerët të mveshur shik, me një herë u ngutnë edhe ata edhe i plotësuan kostumet zyrtare, shumica në Tiranë, si mos më keq, o Zot, se po thuaj gjithë rrobaqepsit e Tiranës s'kishin haber prej kësi kostumesh. Prandaj ata u mveshnë si karnavala.

Po tani mungonin cylindrat e kapellat e forta. Një shumicë porositi në Bari, dyke dërguar masat për secilën kokë. Është e tepër të shtonj këtu se kur ardhë këto kapella e kur i vunë mbi krye kolegët e mijë ishte tamam një komedi ti shëkonje, pse dyke i mveshur kapellat bëheshin edhe ata komikë. Dikujt i vinte kapella majë kokës, dikujt s'i nxinte as pak, dikujt i hynte gjer ne veshët, dikujt i vinte shtembër, dikujt ( që e kishte kokën me xhunga, ose me gdhënj) i lindë vënde bosh kapella, sa i hynte hera nga të katër anët. Më kot i shkëmbenin kapellat me njëri-tjetrin, prapë se prap kapellat nuk puthiteshin mirë. Si dreq kështu? çfarë djaj kapella këto? Pa le gjith' e gjithë, po të jenë blerë edhe me porosi e me masat në dorë! Le të mos e zgjatim më tutje këtë komedi, me gjithë që vazhdoj më tepër se një muaj që vijnin e kthehesin kapellat e prapë s'ujdisnin mbi kryet. . . (nuk lexohet H. K.) të kafkave Shqiptare, gjer sa fundi i fundit mundnë se cili të gjejë kapellën që i përshtatej e kështu mezi që mbetnë pak të kënaqur.

Mirë po shumica e deputetëve që ishin muhamedanë, kishin mbetur pa cylindra e kapella të forta, me gjithë që fraket e tajtet i kishin plotësuar. Po pse s'porositnë kapella këta si ata të tjerët? Arsyeja ishte se nuk kishin dëshëruar, pse .... . i ndalonte feja! Po Zogun edhe disa të tjerë deputetë muslimanë që ishin komplet me kapella, këta a nuk i ndalonte feja si të tjerët që mbetnë pa kapella?

E kuptova se këta ishin tepër fanatikë dhe as që do bindeshin kurrë të vinin kapella mbi krye.

Prita si do silleshin në rast të një feste, ose ceremonije zyrtare. Edhe festa erdhi. Ishte dita e shënuar e 28 Nëntorit 1927. Të gjithë ishin mveshur me uniformë zyrtare me cylindra, këpucë llustrina dhe gante[1] të bardha. Ata që s'kishin kapella kishin mbi krye qeleshe, ose kapella të bëra synet, do me th. të shkurtuara nga rredhi i tyre. Po t'i shëkonje nuk do mbanje dot të qeshurat. Ishin mveshur si karikatura, tamam si në kohën e karnavalevet!

Kur u paraqitnë përpara Kryetarit të Republikës, ajy qeshi fort kur i pa ata, që ndanin nga ne të tjerët, po edhe u zembrua shumë se midis tyre ishin, mjerisht, edhe disa ministra, një nga të cilët ishte edhe fanatiku i fanatikëve Musa Juka Shkodrani, ministër ahere i P. Botore.

Zogu u hoqi vërejtjen këtyre e u tha se tjetër herë s'duhej të paraqiteshin në atë mënyrë qesharake në festat zyrtare edhe në ceremonit' e tjera, se do bënin një përshtypje të keqe e qesharake, sidomos përpara të huajve, ambasadorë, konsujve e të tjerë. Tjetër herë mos ju shoh kështu urdhëroj.

Ky urdhër mjaftoj që të mvisheshin ashtu si ne të gjithë ata fanatikët.

Po këtu na u zembrua Musa Juka, me gjithë se ishim miq. Ajy kujtoj se un' e shtyva Zogun t'u heqë verejtjen në atë mënyrë. Mor zot, i thashë, unë nuk di gjë nga këta. Pse do t'ja

[1] guante = dorashka (H. K.)

thesha Kryetarit të Republikës, kurse munt të ta them edhe vetë drejt për drejt, si t'a kam thënë edhe tjetër herë në Shkodër, në kohën e Austriakëve, ku mezi të bindmë t'a heqësh festen e kuqe me xhufkë nga koka. Pastaj mendohu ku rrojmë. Babadovleti vdiq po që ju dhe s'mundni t'a sillni më në Shqipëri, me gjithë që ju djek fort zembra. Është turp e anakronismë për ju, i thashë, të mos doni përparimin e Kombit t'onë, po të vazhdoni kështu me këto mëndje të ndryshkura, bile sot që kini një pozitë të lartë shtetnore e që konsiderohi ai udhëheqës.

Po Musa Juka vazhdonte të më mbante mëri, me gjithë se këjo s'më prishte as një punë mua.

Gjer këtu fola për cylindrat e kapellat e ministrave dhe të deputetëve. Tani do tregonj edhe për shkaqet që shkaktuan edhe vënjen e kapellave nga ana e muhamedanëve Shqiptarë.

Ato ditt kishin ardhur prej Stambollit disa Shqiptarë muhamedanë me kapella në krye, por se pa ju afruar akoma Durrësit i kishin hequr që në vapor brenda e i kishin ndruar me kallpaqe, që i blenë në Durrës, posa duall jashtë nga vapori, edhe këtë nga frika se mos i kajtisnin me gurë fanatikët e tjerë muhamedanë Shqiptarë.

Midis këtyre të ardhurve nga Stambolli u ndoth edhe i biri i Fejzi bej Alizotit, Hassan bej Alizoti, i cili ma tregonte këtë meselè. E pyeta : Në Stamboll a mbajnë kapella muhamedanët? Të gjithë, mu përgjeq, pa një përjashtim, bile kanë gjoba po të kuxojnë të mbajnë feste me xhufkë. Po, ahere, i them Hassan Alizotit, s'ju ndalon të mos i vini këto kapella në kokë në tokën e lirë Shqiptare? Mos ju ndalon Qeverija? Jo, thotë, po kemi frikë nga vullgu, nga populli muhamedan Shqiptar, i cili s'është mësuar, e do na shohë me sy të keq e do na marrin me gurrë. Je budalla, i them Hassanit, se s'munt të kuxojë ta bëjë njeri këtë gjë brenda në një kryeqytet, se ka edhe policë edhe gjendarmëri. Por, mbassi ju jini të kuptuarshëm, si edhe ata të tjerët shokët e tu, që ardhtë bashkë nga Stambolli, duhet të kini kurajon t'a vini edhe këtu në Shqipëri kapellën e mos ju bënjë as tërr veshi. Thuaju edhe shokëve të tjerë edhe nesër që është e Djelë urdhroni të gjithë me kapella në kafenenë "Internasional" ku do t'ju presim edhe ne nj'a 7-8 veta të krishterë me kapella që t'ju shoqërojmë. Kështu do dalim bashkarisht të shetisim në për rrugët e Tiranës dhe kush të dojë le të urdhërojë t'ju ndalojë, ose t'ju vërshëllenjë, ose t'ju zerë me gurrë si thoni. Ju siguronj se me këtë gjest do shkaktoni që edhe të tjerë muhamedanë të venë kapellë, sepse njoh shumë që janë gati, po s'kuxojnë, edhe kështu, i them Hassanit, do sillni një përparim të math në Atdhenë t'uaj në pikpamje qytetërimi.

E deva e e enthusiasa Hassanin me fjalë gjer sa e binda. Edhe për një ment Hassani të nesërmen, ditën e Djelë, kish marrë edhe shokët e tij e na ardhë në kafenenë "Internacional" ku po i prisnim.

Posa ndejnë afër nesh, të gjithë sytë sa kishim rrotull u vërtitnë me një herë mbi kapellat e Hassanit me shokët e po i shëkonin me një sy kurreshtimi e inati, si kur do t'i hanim me dhëmbë. Dikush prej sijsh na u afrua e me një farë ironije i thotë Hassanit : Si e bëtë kështu? Nuk e dijni se ne na ndalon feja të vemë kapellën e kaurit? – Mos folë ashtu, ja pret Hassani. Ato janë gjepura. Pse në Stamboll të gjithë muhamedanët mbajnë kapella? Ata nuk i ndalon feja?

Fjala fjalën ardhë gjer në acarim. Po ahere filluam edhe ne të tjerët t'i japim përgjigjen e duhur atij fanatiku, si edhe të tjerëve që na kishin grumbulluar. Më së fundi u çuam të gjithë dhe duallm të shetisim jashtë, se ishte një dit' e bukur. Disa episodhe na ngjanë udhës më fort me ca kalamanj, por as një incident me rendësi.

Nuk shkuan shumë ditt edhe kapellat muar yrysh në kokërat e muhamedanëvet. Më tepër se 100 nëpunës e kush e di sa civilë të tjerë muhamedanë u panë me kapella mbi krye brenda dy javëve.

Mjerisht në Tiranë na delte një fletushkë, gjoja patriotike, po me frymë fanatike muhamedane e titulluar me embrin "Dajiti" dhe e drejtuar prej të ashtu-qojturit patriot e

dijetar (sic) Mullâ Hafis-Brahimit. Ky e hiqte vehten si një patriot i math, si një dijetar i jashtazakonshmë midis muhamedanëve të tjerë të Tiranës, ndonse ishte edhe vazhdon të jetë një injorant gjysmak.

Ky ngriti flamurin i pari me anë të shtypit, dyke përkrahur fenë muhamedane, si kur se ajo të ishte cytur ose dhunuar, pse disa muhamedanë që kuxuan të venë kapellë, kundra porosive të shêjta gjoja, të Kur-ânit e të tjera, e tjera.

Këtij budallaj ju përgjigja me një herë me anën e gazetës s'ime që ajy nuk dinte ç'i bëheshe, as që kishte haber nga Kur-âni, të cilin kujtonte se e dinte më gojë, sepse Kur-âni, as që bën fjalë gjëkundi për kapella, as që përzjehet kurrë me kapellat e me ç'do mbulesë tjetër koke, për të cilat ësht' i lirë gjithkush që t'i mbajë pas dëshirës e pas qejfit të tij e se Hahëz Brahimi këtë e bën vetëm se i shtyrë nga fanatizmi dhe bën shumë keq se helmon karakterin Shqiptar e fut grindjen e përçarjen midis vëllezërve t'onë muhamedanë, sidomos më një kohë që interesat e idealet e Atdheut kërkojnë një vëllazërim e një bashkëpunim të plotë të dy elementevet.

Hazëz-Brahimit s'i goditnë mirë në vesh këto fjalë. Kish pastaj prapa tij edhe një klikë të qelbur injorantësh që e inkurajonin ta pasonte luftën e të shdukeshin kapellat.

Ky i marri e vuri me mua dhe pa një pa dy filloj të më atakojë personalisht me gazetën e tij. Unë i përgjigjesha me arësyje e pa të shara. Ajy vazhdonte polemikën e egër e më egër me fraza poshtëruese, si e pa që nuk i përgjigjesha në të lehurat e tija. Unë ahere e hoqa në gjyq dhe Hafëz Brahimi u dënua, po prapë nuk vuri ment!

Ahere sa ta paditnja prapë, u përvesha edhe unë e zura t'a qëllonja po me ato gurrë që më qëllonte ajy edhe nga ndo një herë edhe me të fortë, sa e pashë se i dhempnë shumë e e diskretituan mjaft! Mjafton që ja provonja me fakte padijeninë të trashë të tija, zakonet monstruoze e qesharakë tiranase, që ajy ishte një nga më të mprehtët partizanë që i adoptonte jetën e tij prapanike, sjellje e tij të dobta e fanatike, shpirtin e tij lugat etj. etj.

Këto e nxehnë fort Hafëz-Brahimin, se nuk duronte dot t'a shajë një kaur, një rajà[1]! Me ç'të drejtë, ku e gjeti kuximin? Se mos jemi ne barabar me ata? Ne i kemi shtypur e do t'i shtypim kurdoherë!.... Të këtilla fjalë e të tjerë përhapte posht' e lart prapaniku-fanatik Hafëz-Brahimi, të cilat më vijnin një nga një në vesh.

Populli i kurreshtuar fort dhe amator i prapë i polemikave, këto i ndiqte me një gëzim të pashoqtë. E kuptonja fort mirë këtë e sidomos nga tirazhi i gazetës s'ime që kalojte 3. 000-at copë e që arrinte dita që gazeta ime shiteshe gjer më 2 lekë copa, se mungonin kopjet.

Më së fundi Hafiz-Brahimi nuk duroj. Bëri një klikë të fortë fanatikësh rrotull tij dhe një ditë i shkon protektorit të tyre, fanatikut të fanatikëve Musa Jukës me nj'a 12 hoxhallarë të tjerë e i ankohen, e i thon, e i thonë aqe shumë sa e bënë derr! Musa Juka u a muar përsipër këtë dert e i qetsoj se do ti vinte kapak.

Po atë ditë më thiri në ministri, ku edhe vajta. Ishte fort i zembëruar; sytë i ishin zgurdulluar, nuk mbaheheshe dot. Më priti me një romuz[2], si kur se isha ndo një qehaj i tij. Më bërtiti fort, veç se nuk më shau. Po kur e pashë se filloj të goditte tavolinën me duar, si e kish zakon të imponoheshe, ahere s'mu durua! Me ngadalë, zotni, i thashë, mendohu se s'ki ndo një njeri ordiner përpara; jam një deputet, një drejtor gazete, një njeri i shtetit, e si domos një patriot i njohur e s'të jap kurrën e kurrës lejen të sillesh me mënyra brutale, si ato që i ke zakon zotnija yte! Mati e përtypi fjalët kur i flet! Unë respektonj zyrën dhe pozitën tënde si një ministër, se për ndryshe, sa personin tuaj di të përdor një gjuhë edhe më të fortë se atë tënden, e në daç gjuhën Korçare!

Gjith' ajo tigër e keqe me fytyrë njeriu, ajy burracak i dobët u ûl me një herë, kur pa se i kundrështova. I zbuti fjalët e filloj të më marrë me të mirë. Më tha se nuk ësht' as e drejtë, as

[1] rajà = Nënshtetas jo mysliman në Perandorinë Osmane, që nuk kishte të drejta e shtypej egërsisht, Njeri i nënshtruar, që pranon pa bërë zë zgjedhën e tjetrit; shërbëtor a puthador i dikuj (H. K.)

[2] romuz = fjalë e thënë me thumba, shpotì (H. K.)

e arësyeshme të ndes popullin muhamedan e të bënj propagandë t'a venë kapellën në kryje. Ju përgjigja me arsyet kuptimplote të mijat, dyke shtuar se unë kontribuonj në këtë mënyrë në përparimin e kombit Shqiptar e se këtë nuk e bënj për ndo një inat tjetër, veç se dyke u shtyrë nga ndërgjegja ime. I thashë se feja muhamedane nuk e ndalon kapellën, se gjithë turqit e Turqisë mbajnë kapella sot dhe hanë gjoba të forta ata prapanikë që nuk i binden urdhrit të Mustafa Qemalit, që është një prijës i dejtë Europjan për kombin e vet.

Ahere Musa Juka më tha :mor vëllà s'e them unë këtë, po e thotë gjithë popullit musulman. Shumë nga parija muhamedane e Tiranës i janë ankuar Sh. së tij, Presidentit të Republikës dhe ajy më dha urdhër mua të të këshillonj në këtë mënyrë, se unë s'e bënj nga vehtja.

A, ashtu qënka? i them. Pse s'ma thatë që në krye këtë, po bëmë kot kaqe fjalë! Do me thënë qënka urdhri i Kryetarit të Republikës mos ta vazhdojmë këtë propagandë? Si urdhron, më thotë, aj vetë më porosit t'ju a them këto fjalë.

Kur ësht' ashtu i them, ahere pushonj ç'do polemikë e propagandë, se s'munt të kundrështonj urdhrat e tij, që i respektonj.

Kështu në numurin tjetër të gazetës s'ime nuk bëra as pak fjalë rrotull kapellave. Po kur ditën që dolli gazeta ime, Kryetari i Republikës më thiri me urgjencë në selin' e tija. Unë kujtova se do më hiqte ndo një verejtje, ose do më porositte gjë për kapellat. E mernja me ment mos ish i zembëruar e pregatitesha si ti flisnja.

Kur hyra në sallën e fronit, Kryetari i Republikës më priti me një përzembërsi të jashtzakonshme dhe këjo më qetsoj mjaft. Më tha : Ku ishit kaqe ditt, që s'ju kam parë, z. Floqi? Këtu kam qenë Shkelqësi ju përgjigja, po s'pata ndo një punë. Unë të thira, më tha, që të pyes ç'bëhet çështja e kapellave, që unë po e ndjek me kaqe interesë. Pse nuk shkruat gjë sendi në këtë numurin e sotmë? Shkëlqesi, i them, ju pattë urdhruar që t'a pushonj këtë polemikë. Unë? më thotë me një habitje të madhe, unë të kem dhënë nja urdhër të këtillë? Jo, kurrë! Kush ju tha se kam urdhruar në këtë mënyrë? Z. ministër Musa Juka, i them, më thiri në ministrin' e tij e më tha se ishte porositur nga Sh. juaj të më thotë t'a pushonj këtë polemikën e kapellave se u bë një skandall i math!

Ahmet Zogu ja krisi të qeshurit. Të paska gabuar më tha; unë s'i kam thënë as gjë për këtë çështje, si kuxoj e të tha se e kam urdhruar unë? Çuditem fort!

Ahere un' e mblodha vehten. E pashë se Musa Juka më gënjeu se desh të më bindë e të më trembte me këtë mënyra dhe ju përgjigja Zogut: Do me thënë më paska rrejtur z. Musa Juka! Të jesh i sigurt, më tha, se të ka rrejtur dhe duhet t'i kërkosh fjalën. Me gjithë qejf, Shkelqësi, i them, mjafton të më lejoni ju. – Lejen e ke me pash më tha, sepse ke të drejtë të ankohesh e ti kërkosh fjalën e satisfaksjonin[1], se edhe mua s'më vjen mirë të abuzojë besimin t'em si një ministor, dhe po të doni e thras këtu, që përpara meje t'i kërkosh satisfaksjon. Si të urdhroni i thashë, unë jam gati, se e shoh vehten të fyer këtu. Një ministër është turp të gënjejë!

Un' e dinja se Zogut i pëlqenin kësijsh episodesh, se e kishte provuar edhe tjetër herë, po edhe unë dëshironja që t' atakonja në syt' e Kryetarit të Republikës, se sa gjetkë veçanërisht, se edhe do t'a vinja në vënt si duhet edhe satisfaksjonin do t'a mernja më të plotë; se kisha edhe përkrahjen e Zogut, por edhe Musa Jukës do t'i bëheshe një mësim i mirë që të mësoheshe të mos gënjente tjetër herë.

A. Zogu, porsa dëgjoj fjalët e mija të fundit nuk priti më, por thiri kolonel Sereqin e i tha të telefonisë Musa Jukës të vinte shpejt në pallat. Urdhri u krye me një herë edhe për 5 minuta Musa Juka hynte në sallën e fronin ku ishim ne me Kryetarin e Republikës.

Zogu posa e pa që hyri Musa Jukën, me një çere të vrejtur e serioze, i tha : Z. Ministër, a ju kam dhënë unë ndo një urdhër t'a porositnit z. Floqin t'a pushonte polemikën e kapellevet?

[1] satisfaksjonin = dëmshpërblimin (është kuptimi i dytë i kësaj fjale H. K.)

Musa Juka u zbeh në fytyrë si fildishti e po më shëkonte mua me inat!

“Jo, Shkelqësi, i tha, Sh, juaj nuk më patët thanë gjë, por patnë ardhur shumë popull muhamedan e midis tyne edhe nja 10-12 hoxhallarë e m’u ankuan për së teprit për ket çështjen e kapellavet. – Edhe z. yte qëndrove e i dëgjove këto e nuk i përzure me një herë andej nga ardhë? – Ja priti Zogu me inat! Unë po fërkonja duart tani!

Zogu kthehet nga mua e më thotë : Ashtë siraja jote z. Floqi të kërkoni fjalën tani.

Un’ e përmblodha vehten e i them Kryetarit të Republikës : Më vjen shumë keq, Shkelqësi, një ministër i botimit, si z. Musa Juka, të kuxojë të abuzojë detyrën e tija dhe të më rrejë mua një patriot, deputet, politikan e gazetar si në këtë mënyrë! Më vjen shumë keq për hesap të z. ministrit, dhe me që e quanj vehten të fyer kërkonj satisfaksjon përpara Sh. s’uaj dhe dua të më vejë nderi në vënt!

Musa Juka ment loste mentsh, kur dëgjonte këto fjalë që po ja përplasnja në fytyrë. I vinte të më hante me dhëmbë, të më xhvatte, po u ndoth ngushtë e s’kish ç’të bënte.

Zogu ja priti Musa Jukës : Zotni Floqi ka të drejtë të plottë se e keni rrejtë në një mënyrë që nuk i përshtatet dinjitetit t’uaj si një ministër! Duhet t’i jepni satisfaksjon.

Musa Juka ngeli si drû; zû po dridhej i tërë; e kuptoj thellë gabimin e tij, po nuk kujtoj kurrë se puna do arrinte gjer atje! Si të bënte tani? I sillet Zogut : Shkëlqesi, i thotë, ju kërkonj pardon, se verovërtet u gjënda fajtor përpara Sh. s’uej, por u gjenda ngushtë përpara një popullit dhe s’kisha si me ja ba ndryshe! Sa për z. Floqi, që e kam edhe mik të vjetër, besoj të më fali dhe se nuk ka më e shty punën ma gjatë.

Zogu kthehet nga mua : Jeni të kënaqur me kaqe? më thotë. Shkëlqesi, i them, kjo është një satisfaksjon, ashtu si e kuptonj unë, prandaj unë vazhdonj t’a konsideronj akoma të fyer vehten t’ime.

Musa Juka u xhindos e më kthehet mua : E ç’po kërkoni tash prej mejet, zotni? Mos doni të bajmë edhe ndonjë duello? Edhe ate munt ta bajmë i them po ajo më përket mua si të fyem e jo juve! Munt të gjejmë një tjetër solusjon çashtjes bash këtu ku jemi. E në qoftë se nuk ju jap satisfaksjonin që doni do më thrisni në duello? më thotë. – Jo, i them, se unë s’di të përdor as shpatë, as pushkë. E atëhere? Thotë M. Juka. Ahere, i them, unë do shtërngohem t’a tregonj gjithë çështjen me anën e gazetës, ku do shtonjse ju më keni rrejtë në një mënyrë jo të drejtë për pozitën t’uaj, që ta marri vesh edhe publiku se rrejnë dikur edhe ministrat e të dijë t’ju çmojë më mirë! Ja këtë do bënj, po të mos më jepni qysh tash një satisjaksjon!.... Ka të drejtë, ja pret me një farë hymorismi Kryetari i Republikës. Duhet t’i jepni satisfaksjon. Në ç’mënyrë? Thotë Musaja. Në këtë mënyrë ja pres unë : Do më kërkoni pardon këtu përpara Sh. së tij, dyke e njohtur fajin që bëtë!

Musa efendija po gërciste dhëmbët! Ishte një dush i math për këtë këjo. Dha e mori, u vërtit andej, këtej, më së fundi më tha: E ma falni , pra, gabova. Njerës jemi!. . . Ahere A. Zogu na detyroj ti zemë dorën njëri tjetrit e të pajtohemi, dyke mbetur prapë miq. Ashtu edhe bëmë. Musa Juka mbet mjaft i turpëruar; atë gabim e pagoj me të tepër!

Unë kërkova lejen prej Presidentit të largohem. Ajy më tha: Hë, do vazhdoni tani të shkruani mbi kapellat? Dua ti jepni funt me sukses kësaj çështjeje, se dëshironj që ta venë të gjithë kapellën si shenjë përparimi.

Mos kijni merak, Shkëlqesë, i them, tani do shëkoni se ku do t’arrijë puna e kapellës. Dhe u ngrita e shkova, por dyke u ndalur pak në adjutanturë, pashë pas 5 minutash se zbriti edhe Musa Juka e u poqmë në koridor.

Nuk kam me t’a harrue kurrë, më tha, këtë që më punove përpara Presidentit! Unë s’kam faj, i them, ju deshit e e suallt punën kështu. Do ma paguani shtrejt më tha. Bëni ç’të doni, ju përgjigja; nga friksimet t’uaja nuk sëkëlldisem edhe shumë; jeni fajtor dhe duhet t’a ndjeni fajin. Këto i thashë dhe ika, e lashë.

Numuri tjetër i gazetës s'ime përmbante plot dy kollona për çështjen e kapellavet. Në funt të artikullit përkatës kisha shtuar edhe një vjershë, dyke goditur më fort qelbanikun Hafëz-Brashimin. Po shënonj nj'a dy strova të fundit:

"Kto kapellat muarn bujë
"E po mvishen dit' për ditë,
" Bëjna zhurm' edhe rëmujë,
"Fanatikët s'duan dritë;
------
"Hiqni dorë, mor të marrë
"Se aspak s'u ndalon feja,
"Kjo gjëkundi s'është parë
"Popull tundu, ndër ment eja!
.... .... .... .... .... .... . . .
"Vjen tamam qytetërimi
"Po t'a verë (kapellën) Hafëz-Brahimi
-------

Këtë herë bëri një përshtypje të thellë ky artikull. Mora kush e di sa letra përgëzimi, të cilat më inkurajuan mjaft. Polemika vazhdoj edhe nj'a dy javë akoma, gjer sa ja suprimuan fletushkën "Dajiti" Hafëz-Brahimit e kështu s'kishte më as dhëmbë, as thonj me se të më atakonte kjo ijenë!

Musa Juka më s'kuxovi më të më lujtë ndo një verejtje, ose të më trembte!

Shëkonja me gëzim se populli ishte fort i kënaqur dhe rall' e tek dëgjoheshin ankime.

Rezultati i kësaj polemike që vazhdoj nja 2 muaj ishte ky, që, brenda kësaj kohe u konstatuan më shumë se 300 kapelle në kokërat e bashkatdhetarëve musulmanë përveç kapellave që po vijeshin nëpër krahinat e ndryshme të Shtetit dhe qeleshet e takijet po zhdukeshin dal-nga dalë.

Kjo polemikë me atë reaksjon solli një përparim të math.

Ato ditt ishte mbaruar afati i ofiqit të kryetarit të Parlamentit dhe duhej të zgjidhej kryetari i ri.

Deri ahere Kryetar i Dhomës së deputetëve ishte plaku Mihal Kasua. Partitë të ndryshme u mblodhë në bisedim edhe pas shumë shkëmbim mendimesh kishin vendosur dy kandidatë, Eshref Frashërin dhe Xhafer Ypin, që njëri prej këtyre ta votonin si kryetar Parlamenti.

Deputeti i Matit Abdurahman Krossi, njeri i veçantë i Kryetarit të Republikës, më merr një ditë më nj'anë e më thotë se Presidenti (A. Zogu) nuk dëshiron për kryetar as një prej kandidatëve deputetë të propozuar. E më tha të vete vetë te Presidenti se ka një fjalë rreth kësaj çështjeje. Dhe unë vajta. Kryetari i Republikës më pyeti cilin kemi shënuar për kandidat kryetari në Parlament dhe unë i tregova tregova çështjen si ishte e ku qëndronte. Ajy më tha se nuk dëshiron as njërin, as tjetrin, dhe përfundoj se ish i mejtimit t'a merrnja unë Kryesin' e Parlamentit për shumë arësyna. I thashë që e pranoj me gjithë qejf, por se kam gazetën në dorë dhes'kisha si e linja në mes të rrugës. Ajy më tha t'ja ngarkoj një tjetri atë barrë. Unë e mora me ment se ky ishte shkak të më hiqeshe gazeta prej dore, se në kohët e fundit s'kishte mbetur aqe i kënaqur Zogu për disa artikuj që kisha botuar, që nuk i pëlqenin, por se nuk ma çfaqte dot.

Si e pashë A. Zogun se po insistonte ja përsërita prapë që e pranoj me gjithë qejf, po, dyke u mejtuar se ky ofiq i ri do mos më lejonte të kisha zyrën e të ushtronja avokaturën, gjë që më bënte të më iknin nga dora 100 e sa napolona në muaj që fitonja, kurse rroga e kryetarit të Parlamentit ishte vetëm 35 napolona në muaj, ndonse unë 25 napol. i merrnja që i merrnja si deputet, e mblodha pak mëndjen e i thashë me fjalë të shkurtra : Shkëlqesi, e kuptonj se ky është një nder i math për mua edhe desha t'a pranonja me shumë gëzim. Por, ju lutem, merni parasysh, se po të bëhem Kryetar i Parlamentit duhet t'a mbyll zyrën t'ime avokatore e këtu

më gjen një dëm mujor nga 100 e përpjetë napolonash. Po të dëshironi i therorizoj edhe këto për hatrin t'uaj!

Zogu u mejtua pak e m' andej kthehet e më thotë : Nuk e dua zararin t' uaj, prandaj nuk po insistonj. Ahere më diktoni ju një person të besimit të cilit t' ja ngarkonj këtë barrë.

Unë me një herë kujtova baçanakun t'em Kostaq Kottën, që ish edhe ky deputet, e që gjer më atë kohë kishim shkuar mirë, se edhe banonte bashkë me nè. I thashë: Ju propononj, Shkëlqesi, z. Kostaq Kottën, mikun t'uaj e baçanakun t'em. Ajy qeshi pak. Mirë më thotë, po nuk jam i sigurt se munt t'a drejtojë mirë atë detyrë, e mos bijem jashtë! Unë u mundova t'a bint, dyke i thënë, se nj'ashtu si e kam stërvitur 4 muaj me radhë në çështjet administrative, kur e patët emëruar Prefekt në Berat, ashtu do ti qëndron përsipër edhe tani e do t'ja plotsonj ç'do të metë.

E pashë se Zogut nuk i ardhi edhe aqe mirë që ja prisha qejfin, po s'foli gjë. Më së fundi e pranoj. Unë ja thashë në shtëpi K. Kottës këto, por ajy s'i besonte; i dukej se mos tallesha me atë, sa edhe vetë ma përsëriti 2-3 herë se s'ka aqe zotësi për atë detyrë, e cila më përkiste mua, por unë ja kallzova arësyetimet që më ndalonin t'a pranonja.

Të nesërmet ishte dita e zgjedhjes. Deputetët ishin lajmëruar tërthorazi se duhet të zgjidhnin për Kryetarin e Parlamentit K. Kottën, me gjithë se asnjë nga deputetët as që e deshte, as që e honepste. Në një parambledhje parlamentare që patmë ata grumbullisht më thanë të vinja unë kandidaturën për kryesin' e Parlamentit, se do hiqnin dorë nga të dy kandidatët e tjerë e do më zgjidhnin unanimisht, por unë i falenderova, dyke ju kallzuar arësyet e vërteta që nuk më lejonin t'a pranonja, pa u treguar se ç'u fol midis Kryetarit të Republikës edhe mejet.

Kur u mbloth zyrtarisht Parlamenti K. Kotta kishte dekllaruar se ishte kandidat. Bashkë me atë shtruan kandidaturë edhe Mihal Kasua me Loni Ligorin. Përfundimi i zgjedhjeve të fshehta ishte, se prej të 42 votave që ishin, 29 mezi që i mori K. Kotta, 10 mori L. Ligori, asnjë M. Kasua ose vetëm një, votën e tija, të tjerët abstenuan.

K. Kotta dyke zënë vëndin e Kryetarit mezi që mundi të flasë nj'a dy fjalë falenderimi, edhe ato të përtypura e dyke u dredhur, daç prej gëzimit, dash prej turpit, se gjer atë ditë as një herë s'e kishin dëgjuar të flasë në Parlament, ose të përzjehet edhe ajy në ndo një çështje si të tjerët. Ka qenë më i pazëshëm si peshku dhe vetëm i zoti për të ngritur dorën kur bëheshin votimet.

Unë e kisha vënë re mirë se Zogu nuk kishte mbetur i kënaqur prej mejet. Ish e para herë që unë ja kisha prishur qejfin, dhe ajy si ambicjoz që ishte nuk e duronte këtë.

Këjo nuk priti shumë të çfaqeshe edhe me argumente të tjera, të cilat do ti tregonj më tutje, dhe të cilat shkaktuan më von daljen t'ime nga favori i Zogut dhe si vazhdim dekadencën t'ime.

Një dit P. Poga, që ishte ministër i Drejtësisë aso kohet, më vjen në zyrë e më thotë e më proponon të marr kryesinë e Degës Penale të Diktimit, se është nevoja. I thashë, jahû, ç'kuvendon ashtu? Unë sot jam një deputet dhe ushtronj një profesjon që më sjell mjaft të ardhura qysh thoni ju tani, të lë dasmën e të shkonj për shkarpa, me fjalë të tjera për 40 napolona skarta që do më jepni të vete të mbyllem në burgun e Diktimit? – Mejtohi mirë, më thotë Poga se këtu kini një karierë, sot jeni deputet, nesër s'jini. Ta kam falun, i them, atë karjerë.

Poga u ngrit e shkoj pa më thëne gjë. Por nuk kaluan dy javë dhe një dit më thret në Pallat Kryetari i Republikës. Vajta atje edhe e gjeta të sëmurë në shtrat prej një influenze. Kishte në duart "Dekameronin" e Bocacio-s frëngjisht e po e këndonte. Z. Floqi, më tha, të thira për një çështje që i di edhe zotrote. Ç'farë? i them. Kqyr atje sipër mbi tavolinën dhe gjeje emërimin t'ënt, që e kam nënëshkruar. Cilin emërim, Shkelqësi? i them. Ju kam emëruar, më thotë Kryetar të Diktimit në degën Penale, me propozimin e ministrit z. Poga, edhe ju perhajronj.

Unë u hodha përpjetë me një herë. Si kështu, i them, Shkëlqesi, kush ja dha atë të drejtë z. Pogës të më proponoj? Ajy më tha e më bëri vërtet fjalë për këtë, po unë s'pranova aspak! Po, qysh e bëri këtë Poga, pa konsentimentin t'uaj? më tha Zogu. Edhe unë habitem, po i them. Unë, Shkelqësi, s'munt ta barazonj ofiqin e deputetit me atë të Kryetarit të Diktimit. – E mora vesh, thotë Zogu, s'është nevoja të zgjatemi, zotrote ke po ato arsyet e para, për të cilat nuk pranove as Kryesin' e Parlamentit që ju ofrova. – Ndofta, i thashë, Shkëlqesija juaj e kuptoni vetë. – Tamam, deh, m'a pret Zogu, do me th. se nuk është vetëm çështja e deputetsisë. – Unë e mora vesh se ç'kërkonte të thosh me ato fjalë, po u përmbajta e s'fola gjë. E pashë se nuk i ardhi mirë dhe ish e dyta herë këjo që po ja thyenja qejfin, po ç'munt të bënja? Durim, ku do dalë? . . .

Pas një javet emëroheshe z. Terenc Toçi si kryetar i Degës Penale të Diktimit, gjer ahere Drejtor i Shtypit në Ministrin' e brendëshme.

Pas një jave tjetër më thret rishtas në Pallat Zogu dhe pa një pa dy më thotë se misjoni i gazetës t'uaj duhet të quhet i mbaruar. Ju falem nderit për përkrahjen e për propagandën e deri tashmë, se na kini shërbyer mjaft, e tani lerjauni radhën edhe të tjerëvet.

E pashë se ky ishte një dush i mirë për mua, si pasojë e prishaqejfeve të mëparëshme. U kufizova ta gëlltit follën[1] e t'i them, se, në urdhrin t'uaj edhe unë po e qendronj gazetën me kusht që të rregullohesha me abonentët brenda një muaji. Ashtu edhe u bë. Pas një muaji gazeta ime kishte perënduar! Durim!

Gjatë jetës s'ime parlamentare ngjajtën disa ndollina, prej të cilave do të shënonj këtu ato që kanë më tepër rëndësi.

Zogu, dyke ndjekur gjithënjë politikën italjane, me gjithë që edhe me Englezët e me armiqtë t'onë Jugosllavët nuk shkonte keq, u shtërngua të pranojë traktatin e miqësisë s'onë me Italinë, të proponuar prej Duçes. Midis misave[2] që do zgjidheshin për tratativat e këtij traktati u zgjodha edhe unë. Bashkëpunimet t'ona me të dërguarin e jashtëzakonshëm të Italisë z. Ugo Sola, vazhduan një kohë të shkurtër. Traktati bilateral u pranua nga të dy parlamentet, të Italisë dhe të Shqipërisë dhe ne që muarm pjesë si përpilluesit e traktatit u dekoruam të gjithë si Commendatorë me medalin e "Koronës të Italisë" prej Mbretit të Italisë Viktor Emmanuelit të III, mbi propozimin e Benito Musolinit, i cili, mbassi e njihnja personalisht qysh në Milano më 1913, ku ndejta më se 6 muaj si kryetar i Komitetit Shqiptar për lirimin e tokave të okupuara, Duçja, po them më dërgoj veçanërisht mua një letër të tij autografe plot urime, të cilën e ruanj edhe sot në shkresinën t'ime.

Një ditë në Parlament u hap çështja e urës së madhe të lumit "Mat" që kishte kontraktuar shoqrija INAG, të cilën e përfaqësonja unë si avokat, për llogari të Qeveris Shqiptare.

Midis të tjerave nj'a dy deputetë pretenduan se në konstruksionin e sipër të asaj ure u bënë abuzime të mbëdha dhe fajin ja hithnin ministrit të asaj kohe, që ishte po ky Kostaq Kotta, që sot kryesonte Parlamentin.

Unë, si avokat i Shoqris INAG dinja shumë hollësira rreth kësaj çështjeje, po s'munt të flisja gjë, as që u kujtua ndokush prej deputetëve të më ngutte të flas, dyke kërkuar shpjegime e hollësira, të cilat, fundi i fundit munt edhe të mos i jepnja, se i përkisnin profesjonit t'em, as që kisha të drejtë të ngatëronja, ose të kompromentonja shoqërinë INAG, e cila në këtë rast isha i bindur se nuk ish fajtore, se faji qëndronte në sipërmarrësin e në ingjinerët Shqiptarë të punimeve, ku, ndofta, s'ishte çudi të ish përzjerë direkt, ose tërthorazi edhe vetë ministri i botores K. Kotta në atë kohë.

Ç'do njeri që akuzohet duhet edhe të mprohet e të dlirë vëndin e tij prej akuzave që i drejtohen. Në rastin konkret K. Kotta, duhet të linte me një herë kulltukun e Kryetarit të Parlamentit e të hipte në tribunë për t'u justifikuar kundrejt atakuesve deputetë, të cilët prej

[1] folla = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalor, por në dijeninë time vollë i thonë dardhës së papjekur dhe shprehja "unë nuk ha vollë" ka kuptimin që "unë nuk e besoj lehtazi", "nuk m' a hedh dot" (H. K.)

[2] mis = antar, pjestar i një grupi njerzish (H. K.)

dyve u bënë gjashtë edhe gjithë po shtoheshin. Dhe diskush prej tyre pretendonte se ka edhe dokumenta në dorë që provonin abuzimet. Këta arrinë gjer atje, sa të kërkojnë të bëhet një anketë parlamentare në ministrin' e P. Botore.

K. Kotta i dëgjonte këto, si i dëgjonim edhe gjithë ne të tjerët, por as vrejteshe, as ktheheshe, as që lëvizte nga vendi. Çudija ishte që vetë ajy, si kryetar, u a jepte fjalën oratorëve që të atakonin po personin e tij si abuzues!

Të gjithë e shëkonin në sytë edhe po çuditeshin, po K. Kotta, as që loste nga vëndi.

Kur pashë gjithë këto sqena nuk m'u durua. Kërkova fjalën, e kur ma dha fillova të flas që nga vendi i jem : Zoti Kryetar, i them, e shëkoni e e merni vesh fort bukur se gjithë këto akuza vërtiten rrotull personit t'uaj. Tjetër kush në vëndin t'uaj do t'a kishte lënë tani atë kulltuk për t'a zëvëndësuar nënëkryetari i Parlamentit dhe kju vetë do kishit kapur tribunën që të justifikohi, si do që ta ndjeni vehten, fajtor ose jo. E kuptoni se po ju akuzojnë, pra, vazhdoni akoma të mbani kulltukun?

K. Kottës nuk i tingëlluan mirë në vesh këto fjalë edhe e vura re se u zembrua fort e u zbeh në fytyrë e më përgjigjet mua : "Le të flasë kush të dojë, i lirë është. S'kam për se të përgjigjem, se e di vehten se nuk jam i kompromentuar. Zotërinjtë deputetë munt të flasin sa të lodhen. Mua s'më përkasin këto!". . .

Ahere u zembrova fort dhe ngrihem nga vendi e i thom faqeziut : "Po ahere kujt i përkasin në qoftë se s'ju përkasin juve? Kush ka qenë ministër i Botores në atë, veç se ju? Pse s'përgjigji? Pse s'justifikohi? Ç' do të thotë opinioni i Parlamentit në qoftë se ju lijni çështjen në heshtje? Detyra e juaj është të përgjigjeni e të jepni sqarimet e duhur".

K. Kotta ahere më s'u mbajt dot edhe tepër i turbulluar ma pëllcet mua në surat pa një pa dy e më thotë me inat :

"Nuk do ma msoni ju detyrën t'ime"!

Edhe unë as prita më, me gjithë që vetë ja kisha lëshuar atë vent edhe që e kisha edhe njerinë t'em. Me një herë ju përgjigja:

"Po kush ju u ka msuar gjer tani atë detyrë, që s'kini ditur se nga ju mbahet festja? A nuk kam qenë unë? Ju e dijni edhe vetë që edhe tjetër her' herë unë ju msova detyrën t'uaj, kur u emëruat prefekt në Berat, kur u emëruat inspektor i Arësimit në kohën e Ismail Qemalit, edhe prapë tani kur ju lëshova atë vent që kini, që m'u ofrua mua më përpara, edhe unë edhe sot desha t'ju mësonja prapë detyrën t'uaj që s'e dijni. Në mos e çmoni s'kam faj unë, më qafë paçi vehten!"

Këto fjalë bënë një përshtypje të madhe në Parlament. Duartrokitjet s'pushonin. Shumë herë u dëgjuan zërat :

- Ka të drejtë, ka të drejtë!
- Ashtu është vërtet, s'e lot gjë!
- Kryetari që s'përgjigjet është fajtor
- Bravo Floqi, bravo etj. etj.

K. Kotta që s'mbaheshe dot urdhroj nga selija e Kryetarit 5 minuta pushim. Ishte kaqe i zembëruar me mua sa zjente nga inati! Qysh atë ditë s' foli me mua. E kishim prishur krejt. Dal-nga-dalë filloj një programë diskreditimi ky njeri shpirt-keq, dyke harruar ç'do të mirë që i bëra. Nuk mbanj ment ç'u bë m'andej, a u bë ndo një anketë parlamentare, apo jo, dhe në u gjetnë abuzime e abuzues. Këtë di vetëm se K. Kotta nuk e harroj kurrë atë poshtërim që i bëra përpara Parlamentit dhe qysh atë ditë filloj një luftë akanite[1] kundra meje, sikur ti kisha vrarë babanë, me gjith që unë desha t'a mbronj.

Një ndollinë tjetër parlamentare n'a takoj këjo që do të tregonj tani e që ka një rëndësi të madhe. Mufid bej Libohova ishe aso-kohet ministër i Financavet. Midis meje dhe atij

[1] akanite = qënçe, luftë si qent (H. K.)

eksistonte një miqësi e përzemërtë qysh në kohën e Ismail Qemalit më 1913, kur unë isha kryetar i gjykatoreve të Shk. I civile e penale të Vlorës.

Unë i kisha sjellë shumë lehtësi në disa punë private të tijat, e sidomos u bëra shkak, dyke i siguruar 5. 000 e sa lira turke që kishte për të marrë nga Qeverija turke në bazë të një ilamit[1] të gjykatës së Stambollit. Këto të holla nuk do t'i merrte kurrë, po të mos kisha ndërmjetësuar unë, i cili e këshillova ta përkthente Shqip ilamin turqisht që kish në dorë e t'ja paraqitte me një lutje gjykatores s'onë për t'a vënë në eksekutim.

Ashtu edhe veproj Mufid beu, dhe unë e omollogova nga an' e gjyqit t'onë e ja solla për vepërim zyrës së eksekutimit. Vazhdimisht, në kërkimin e veçantë që i adresoj gjyqit t'onë M. Libohova, që, pas udhëzimeve të mija kërkonte sekvestrimin e nxjerjen në ankant të sendevet ushqimore, që Qeverija turke, para se të çpallet Pamvarësija jonë i kishte mbyllur në një depo të madhe në skelën e Vlorës. Ky mall përballonte një shumë prej 20. 000 e sa lirash turke të asaj kohe. Unë vura me një herë sikvestro mbi atë mall, dyke sekvestruar një sasi që vlente aproksimativisht çmimin e 6. 000 liravet.

Po ç'na ngjau më von? Kryegjenerali turk Xhavid Pashaj, i thyer prej Ballkanikëvet kishte ardhur në Lushnjë me 70. 000 shpirt ushtarë, të cilët po vdisnin për bukë. Xhavid Pasha dërgoj në Vlorë gjenerall Kara-Seid Pashanë që të merte ushqimet që ishin në Vlorë, siç tregova më sipër. Kur ardhi Kara-Seid Pasha e gjet deponë të hapur edhe erzaket e Turqisë depozituar në skelë i gjet në ankant e sipër. Këjo e marrosi fort e ngjitet sipër në Vlorë e më vjen si i xhindosur në zyrën t'ime të gjykatores. – Kush është Kryetari? pyet. – Unë, efendëm, i them. Ç' urdhëroni? – Me ç'të drejtë, thotë, kini nxjerë në ankant ushqimet e ushtris' sonë? A nuk e dijni se kemi ardhur në Lushnjë me 70. 000 e sa ushtarë të raskapitur e të reckosur që po vdesin nga urija? Shpejt, thotë, jepni urdhër të ndalet ankandi dhe të na dorëzohen neve ushqimet se kam sjellë edhe një vapor të vogël me vehte, ndryshe, Vallahi, Bilahi, po i ve zjarin gjithë Vlorës! A e dijni se na ka ardhur shpirti maje hundës? ....

Unë mezi e kallmova, dyke e marrë me të mirë e dyke ja shpjeguar arësyjen pse ishin nxjerë në meajde ato ushqime, dhe kur i rëfeva ilamin turk, ahere e pashë se u bint.

Af edersimir, af edersimir, efendëm, hakikate bu dogruder as efnenezi

isterham, ederem! m'a priti Kara-Seid pasha. Me fjalë të ndjera më kërkoj edhe ndjesë, se unë kisha të drejtë.

Ahere i kallzova mënyrën si të ngrihet sekvestrimi. Kështu që Ismail Qemali e thiri Myfid bejnë dhe bënë si bënë bashkë, sa ardhi Mufiti tek meje e më tha të jap urdhër të ngrihet sekvestrimi, se u pagua. Ahere e vura përpara meje të bëjë lutjen e ngritjes së sekvestrimit, të cilën ja diktova vetë. E nënëshkroj e kështu u ngrit sekvestrimi dhe Kara-Seid Pasha i mori të gjitha ushqimet e i ngarkoj për në Seman me destinacjon për në Lushnjë.

E tregova midis paranthesës këtë episod që të rëfenj ç'lehtësi i kisha bërë M. Libohovës. Po jo vetëm këtë, po kështu disa të tjera në çështje të ndryshme, kështu që ishim miq të mirë.

Po këtë miqësi e çartmë më von, kur M. Libohova ishte ministër i Drejtësisë në Qeverin' e Wiedit në Durrës e kur unë, si sekretar i përgjithëshëm i asaj ministrije, dyke trajtuar budxhedin preventif të vitit 1914-1915 të ministris së Drejtësisë, rrogën e tij prej 150 napolonash ja kisha zbritur vetëm në 50, gjë që shkaktoj përzënien t'ime prej Durrsit, dyke më transferuar prapë në Vlorë me degradim. Ahere, në gazetën "Populli" e të ndyerit Mustafa Qullit, si e kam treguar edhe tjetër herë, pata shkruar një artikull të fortë me titullin "Rroga, apo rruga? " ku ju binja kokës këtyre gjakpirësve të Shtetit që ishin msuar ti thethinin gjakun kombit Shqiptar, ashtu si kishin vepëruar edhe në kohën e Turqisë. Ky artikull, si e kam përshkruar edhe tjetër herë në këtë përshkrim e xhindosi Mufidin, i cili më urdhroj telegrafisht në Vlorë t'a përgënjeshtronja. Unë ju përgjigja prapë telegrafisht se s'munt ta përgënjeshtronj edhe i paraqita dorëheqjen, e cila nuk m' u pranua. Por më von sa do që në ndryshimet që

[1] ilam = vendim gjyqsor (përkthyer nga turqishtja H. K.)

bëheshin në Ministrin' e Drejtësisë isha shënuar si Kryetar i Gjyqit t' Apelit Mufid beu këtë gradë ma unji e më emëroj Prokuror të gjyqit të Apelit në Berat, ku më urdhroj të shkonj shpejt, por se, si e thash' edhe tjetër herë aso kohet kishte krisur revolucjoni i Korçës edhe Essad Pasha më dërgoj urgjent në Korçë si gjyqtar hetues ekstraordiner i gjyqit Marsial që ishte formuar në Korçë edhe njëkohësisht si pjestar po të asaj gjykatoreje. Kështu që dëshira e Mufid beut nuk u plotësua e atij i mbeti maras edhe s'e harroj kurrë, se unë si vajta në Korçë obtenova një pozitë edhe më të lartër kundra vullnetit të Mufidit, i cili kërkoj disa herë pushimin t'em, po s'e fitoj dot, se nuk ja pranoj Këshilli Ministror, e sidomos hollandezët, sepse i ndyeri kolonel Tomsoni më kishte shumë mirë e më shëkonte si të dy sytë.

Këto ishin shkaqet që e kishim thartuar me M. Libohovën, i cili s'para më shihte me sy të mirë edhe sa do që u ndothmë të dy deputetë edhe veçanërisht ajy si ministër i Financave, ku kishte filluar prapë të bënte disa vandalizma, që po thuaj se ja dijnin gjithë personeli i Min. së Financave, por nuk kishin kuximin t'ja nxirnin në shesh.

Ng'ana tjetër Zogu e kishte mik e shok se Mufid beu kishte hyrë me ushtrin' e tij në Gjirokastër, dyke i ndihmuar fuqisë së A. Zogut, i cili, si e tregova, zbriste me ushtrinë tjetër nga Dibra për të okupuar Tiranën më 1924 ditën e 24-të të Dhjetorit, kështu që Zogu, edhe në qoftë se kishte marrë vesh gjë rreth abuzimeve të tij, ajy ja toleronte e s'theshte gjë.

Po kazani zjente. Më të katër anët pëshpëriteshe se M. Libohova mvithte me shuma të mbëdha. Për këtë ishin kaqe dokumenta të gjalla. Pastaj M. beu kishte 23. 000 e sa napolona borç ne tregëtarët e Gjirokastrës edhe kishte vënë penk gjithë pasurin' e tija të palujshme në Libohovë të cilat i çliroj të gjitha brenda një javet. Skandali ishte i math, po kush kuxonte t'a bënte çështje në Parlament e t'a thriste në fjalëdhënie M. Libohovën?

Disa herë biseduam me disa shokë deputetë, të cilët i njihnin këto abuzime më fort pas të dëgjuarit, se gjërra konkrete nuk kishin në dorë.

Mua më interesoj tepër këjo çështje, se s'duronja dot të bëheshin të këtillë shpërdorime në kurrizin e Shtetit e të popullit.

Po Mufid beu kishte taraf të fortë e përkrahje të mjaftë. As kush nuk kuxonte të ballafaqoheshe me atë e s'ja përplaste në surat gjith' ato çrregullime, ato vjellje kollosale!

Unë mora shkak nga përzënja e nga pushimi që pak ditt më parë i kishte bërë M. Libohova një nëpunsi shkodran Mark Martinit, drejtorit të Monopoleve në Ministrin' e Financave, nëpunës të zellshëm e të aftë, që e kisha kuptuar edhe vetë sa kohë drejtova zëvëndësisht Ministrin' e Financavet e e kisha nënë urdhrat e mija.

Po Mufid beu nuk e honepste këtë, se i kish hyrë kounoipe[1] në hundë, prandaj bëri si bëri e çporri qafet pa ndo një arsyje, dyke e justifikuar jo për pazotësi, ose për ndo një të metë tjetër, po vetëm "për arësyje administrative".

Unë e thira në zyrë Mark Martinin. Bisedova 2-3 orë gjat' e gjërë mbi lëvizjen financjare dhe mbi sjelljet e çpërdorimet e ministrit të financave Mufid Libohovës. Mark Martini të nesërmet më sillte një tok dokumentash, të kopijuara nga origjinalet dhe disa informata të veçanta me anë letrash private, si dhe shënimet e duhura mbi vepërimet kadastrale të kadastrës së Libohovës, ku figuronin të penguara pasurit' e tija të palujtshme e m'andej po në një dit të çliruara të gjitha.

Tani kisha fakto të gjalla në dorë, me të cilat mundnja ta luftonja sigurisht Mufid Libohovën përpara Parllamentit e t'a diskreditoja.

Pas dy dittsh e kërkova në interpellancë përpara Dhomës së deputetëve z. Ministër të Financave Mufid Libohovën, dyke shënuar si theme "fjalëdhënien mbi disa çrregullime të shërbimit financijar".

Misjoni im u përkrah prej 10 deputetëvet dhe kështu Mufid beu u thir nga ana e Kryesis së Parllamentit për fjalë dhënie.

[1] kounoipe = mushkonjë (përkthyer nga greqishtja me google H. K.)

Ditën e caktuar Mufid beu nuk ardhë vetë, por as që dërgoj përfaqësues. Këjo e zembroj shumë Parllamentin. Dikush prej deputetëve tha : "Z. Ministër, si bej e oxhak, nuk bëri kabull të paraqitet sot këtu, se ndofta s'jemi në një nivel me atë". Një tjetër deputet ja priti: "Ka kujtuar zotri' e tij, se ajy është bej e ne të tjerët këtu jemi harbutë!". "Jo, jo, u hoth një tjetër deputet nga an' e djathtë, nuk e besonj të jet' ashtu si thoni; ajy duket ka frikë të vijë këtu, se ndofta s'është në gjëndje të dlirte e nuk ja mban të përballohet me ne!"

Një zhurmë e një shamatë u çfaq me një herë plot ankime e professime.

Një deputet bërtiti sa mundi : "Duhet të vijë, passi është lajmuar në kohë nga Kryesija e Parllamentit". Një tjetër thiri: "Zoti Kryetar, lajmëroheni z. Ministër Libohovën të vijë shpejt këtu, se s'kemi kohë t'a presim; kemi edhe punë të tjera.

Kryetari i Parllamentit shkoj vetë në telefon dhe e lajmëroj të vijë, se po e presin deputetët, po Myfid beu ju përgjigj se është tepër i okupuar e t'a lerë për një ditë tjetër interpellancën.

Kryetari i Dhomës vjen prapë përpara nesh e na i përsëriti këto fjalë, dyke na u lutur t'a shtyjmë për një tjetër interpellancën, por deputetët u zembruan fort prej kësaj sjelljeje të papëlqyer të një ministri të Financavet dhe u egërsuan tepër.

Dikush bërtit: Ç'janë këto maskarallëke? Mos kërkon të tallet me ne z. ministër i Financavet?". Dikush tjetër tha: "Zoti Kryetar, një ministër s'ka të drejtë të përbuzë një Parllament të tërë!" U dëgjua një tjetër që tha: "Zotërinj, mbassi s'ardhi z. ministër i Financave, sa do që u thir me kohë e zyrtarisht prej asaj Kryesije, unë propononj të vazhdojmë qoft'akoma edhe në mungesën e tija!" Jo, jo, tha një tjetër deputet, duhet të jetë edhe vetë personi i tij që t'u përgjigjet një nga një atakimeve prandaj propononj të azhurnohet çështja për një ditë tjetër dhe të lajmërohet prapë ministri i Financave të ndodhet këtu atë ditë.

Kryetari vuri në votë që të dy proponimet: I-ra Të azhurnohet për një ditë tjetër. Këjy proponim u përkrah vetëm prej 5 votave me kontra 44 vota. Ahere vuri në votë proponimin tjetër: II, Duhet të vazhdojë interpellanca në mungesën e të interpelluarit? Ky proponim i II-të u pranua me 45 vota. Katër deputetë abstenuan.

Kryetari i Parllamentit më dha fjalën mua si interpellues dhe unë mora tribunën dhe në mes të një pushimit të thellë e të një kureshtimit të math fillova[1] :

Kr. Floqi Zoti Kryetar, zotërinj deputetë.

Nuk do çuditi për se e mora vetë këtë nisiativë të dal përpara jush, dyke ju tërhequr verejtjen t'uaj për sa kini për të dëgjuar rreth veprimeve financjare të ministrit të Financavet z. Mufit Libohovës, nuk do çuditi, po ju them për këtë demarsh, në qoftë se mejtohi kështu si mejtonj edhe unë, se asnjë ambicje, asnjë hasmëri, asnjë shkak tjetër nuk më kanë shtyrë për këtë interpellancë, përveç se detyra ime si një deputet, që duhet të ketë kuximin të përkrahë lirisht interesat vitale të Shtetit e t'u dalë zot këtyre, dyke përkrahur kështu interesat e popullit Shqiptar, i cili na ka dërguar këtu, dhe i cili na ka mveshur me besimin e tij të plottë.

Me z. ministrin e Financave na ka lidhur, ësht' e vërtetë, një miqësi e vjetër, se kemi bashkëpunuar rrjesht për disa vjete, qysh në kohën e Ismail Qemal Vlorës, prandaj po ju a përsërit, mos u çuditni në qoftë se, përpara një interesi të math që vinj sot të mpronj këtu, që ësht' interesi i popullit të gjorë, vinj e e le më nj'anë gjith' atë miqësi, edhe e thras këtu zyrtarisht z. ministër të Financavet M. Libohovën për të dhënë shpjegime mbi sa kam për të parashtruar e për t'a sqaruar Dhomën e Deputetëve.

Më vjen keq pra, zotërinj, pse nuk mori mundimin të urdhronte sot këtu z. ministër i Financave, sepse dëshironja t'ja thesha sŷ ndër sŷ ç'kam për të thënë, e jo t'ja flas prapa krahëvet e në mungesën e tija.

Po në qoftë se z. ministër shkëlqeu sot me absencën e tija, me gjithë që u thir zyrtarisht, faji, zotërinj, s'munt të më ngarkohet mua. Un' i shtrohem vendimit që pak më parë dha e

[1] Fjalimet e mëposhtme janë kopijuar fjalë për fjalë nga Proçes-verbalet e parlamentit (K. Floqi)

ndershmja Dhomë e Deputetëvet dhe në qoftë se opinioni juaj e dënon fajtorin, ajy ka të drejtë të mprohet, si munt të bënte një i dënuar. – (Zëra). Kush është fajtor? Kush është i dënuar?

Kr. Floqi Gjer tani s'ka as një fajtor, as të dënuar, po munt të ketë më pas. Kini durim e prisni përfundimin.

Një deputet. Duhen fakte jo vetëm fjalë!

Kr. Floqi. Po të mos ju bint me fjalë kam për t'ju bindur me fakte, zotërinj, kini durim, se edhe faktet e dokumentat nuk më mungojnë.

Kr. Floqi. Ka kohë, zotërinj, që po pështpëritet posht' e lart për disa çrregullime e abuzime që janë bërë në ministrin e Financave, dhe shkaktar i këtyre duan të thonë se është drejt për drejt vetë personi i ministrit të Financavet, i cili, si thonë, tamam për një arsye të këtillë që të mos dalin ta palarat në shesh, ka pushuar nga detyra ashtu kot-së koti, një nga më të aftët kryenëpunës të tij, drejtorin e Seksjonit të Monopoleve, z. Mark Martini, se i paske hyrë si mushkonjë në hundë, dyke ja prerë hovin ministrit për disa abuzime që qëllonte dita më drekë. Ky, z. Mark Martini ju gjet bela z. ministrit të Financave, prandaj edhe ministri e çporri qafe, dyke e shkarkuar nga detyra pa një arsye ligjore.

B. Begolli. Shumë keq ja bani, z. kryetar ky z. ministri i Financave Mufid
begu atij të shkretit Mark Martini, si e tha edhe parafolësi zotni Floqi.

J. Hurshidi. Le të silleshe mirë të mos e dbonte. Kush sillet keq ashtu e pëson!

Kr. Floqi : Po të ketë me të vërtetë faj mirë ta pësonjë, po nëësht' i pafajshëm e u
pushua padrejtësisht nga puna prej një kapriçoje të ministrit, këtë padrejtësi duhet vetë ta ndreqë ministri, e në qoftë se s'do ta ndreqë, duhet t'i imponohemi ne, sepse kot nuk pushohet një nëpunës bile me rëndësi për hatër të njërit e të tjetrit ministër. Mark Martinin e njoh fort mirë. E kam provuar 8 muaj me radhë kur isha ad interim[1] ministër i Financave e e kisha nënë urdhrat e mija, prandaj për nderin e zotsin' e tij ja u tregonj vetë personalisht.

J. Erebara. E mori më qafë!

Kr. Floqi. Vërtet e mori më qafë e i mbylli shtëpinë me një tufë fëmijë. Po të ishte fajtor duhet t'a pezullonte e t'ja çonte gjyqit kompetent dhe ajy të vendoste, se me profkat qinse arësyjavet administrative, nuk pushohet kështu një drejtor i Monopoleve. Po për personin e Mark Martinit do flasim më tutje, mbassi theme kryesore e jona qëndron në abuzimet e tjera financijare.

J. Hurshidi. Janë fjalë rrugësh ato abuzime e gjepura! S'ka abuzime si vazhdoni e thoni, se kërkoni të shfryeni kondra Myfit beut, kush e di për ç'shkake munt të kini në mes t'uaj ku ta dimë?

Kr. Floqi. E siguronj z. deputet të Gjirokastër, se, siç thashë edhe në fillim të fjalës s'ime nuk kam asnjë ambicjon, asnjë armiqësi private, as ndo një shkak tjetër kundra Mufidit, përkundrazi e kam konsideruar mik, edhe z. e tij ka prova të mjafta të jet' i bindur për këto që thom, por, si pata nderin t'ju them, këtu më shtyri vetëm qëllimi i lartër i interesit vital të Atdheut dhe interesa e djersa e popullit t'onë, dhe përpara një interesi të këtillë ç'do burrë Shteti duhet t'i lerë më nj'anë ç'do interes e miqësi tjetër. Prandaj e siguronj z. deputet nga Gjirokastra se këto që do them e do çvillonj më poshtë nuk janë fjalë rrugash e kafehanesh e pijetoresh, as që janë gjepura, si kujton ai, por janë të vërteta fjalë, fjalë të mbështetura në fakte e në dokumenta e mos pandehë z. e tij se nuk kam ardhur i pregatitur këtu për një zbulim t'atillë.

Zërra. Vazhdoni, vazhdoni.

B. Begolli. Mos harroni Mark Martinin , allah-ile.

Kr. Floqi. Po hynj në themën e po më vjen keq se s'e kam këtu z. ministrin e Financave që t'a pyesnja : A ësht' e vërtetë se për disa borxhe të vjetra që kish ne 3-4 tregëtarë Gjirokastritë ky kishte penguar pasurin' e tij të palujshme për 23. 000 e sa napolona? Dhe, në

[1] ad interim = i përkohshëm (përkthyer nga latinishtja H. K.)

qoftë se këjo ësht' e vërtet, a është gjith'ashtu e vërtetë se këtë borç kollosal me gjithë kamatat e tyre e shpenzimet e tjera përkatëse z. Mufid Libohova e lau brenda tre ditve, dyke u a transferuar zotnimin e këtyrë pasurive, gruas së tij dhe djemve, qinse ata ja paguan këto borxhe? – Ku i gjetnë ata gjith këto të holla? Nga i prokuroj Mufid beu gjithë këto mijë napolonash kaqe shpejt, sa të munt të paguante me një herë gjithë borxhet e tij e të çpengonte gjithë pasurin' e tij të pa lujshme?

Zërra . Bré, bré, bré! .... . .

J. Hurshidi. Kini dokumenta ku i bazoni këto?

Kr. Floqi. Si urdhron, kemi shënime zyrtare kadastriale e noterjale, ose më mirë t'ju them, çertifiklatat përkatëse të legalizuara; kini pak durim se do ti shëkoni edhe vetë. Ju Gjirokastrit jini dhe miq atje mjaft kini, munt të shkruani e munt të informoheni po prej kësaj mërzije do t'ju çkujdes unë, z. deputet i Gjirokastrës, se, si ju thashë nuk flasim në erë; alltipatllaren[1] e kemi plot, tani do dëgjoni zbrazjet....

Zëra. Bravo, bravo!.... Të lumtë z. Floqi!

H. Delvina. Ju lumt' e bardha gojë!

Rauf Fico. Vazhdo, vazhdo, ashtu më qofsh!

M. Kasso. Z. Kryetar, le të më falë pak z. Floqi, në qoftë se e pengonj pak nga fjala.

Kr. Floqi. Urdhroni, z. Kasso jam gati.

Mih. Kasso. E mbesoni seriozisht, z. Floqi, se Mufid beu këto të holla i ka përvetuar nga Financat e Shtetit?

Kr. Floqi. Seriozisht po ju them edhe unë z. Kasso, se nuk kam dashur ta mbesonj në fillim, po si t'ju thom këtyre dokumentave, që kam nër duar, këtyre çertifikatave zyrtare për të cilat bëra fjalë më parë dhe të cilat flasin vetë?

Mih. Kasso. Nuk mundet të ketë mundësi që këto të holla ti ketë gjetur në për miqt' e tij?

Kr. Floqi. Tamam atë desha të di edhe unë, prandaj më vjen keq se nuk ndodhet këtu z. e tij që të na jepte shpjegime, të justifikonte gjendjen e këtyre të hollave e të dlirte vehten.

Mih. Kasso. Edhe pse s'është këtu duhet t'a dënojmë në mungesë?

Kr. Floqi. Z. Kasso, ju jeni edhe avokat e dijni se dënim në mungesë nuk do me thënë dënim definitif. I dënuari ka të drejtë të bëjë kundrështim dhe gjykatorja, në rastin konkret Parllamenti, ësht' i obliguar t'ja dëgjojë e t'ja çmojë kundrështimet. Në qoftë se z. juaj doni ta përkrahni si mik, u jap të drejtë ta bëni edhe avokatin e tij edhe pa prokurë, e në qoftë se jini të bindur se Mufid beu i ka prokuruar nga miqtë këto të holla, jeni të lirë të më nxirni prej gabimit e të sqaroni opinionin e Parllamentit, po me konditë se do të prisni gjersa të zbraz të gjitha fyshekët e revolverit t'em e ahere të merni fjalën ju.... .... .

Zëra : Mjaft, mjaft.

R. Fico : Lëreni oratorin të vazhdojë.

Kryetari : Urdhroni z. Floqi, vazhdoni. Ju lutem zotërinj deputetë mos e ndërpreni fjalën pa ndopnjë shkak e arësyje.

Kr. Floqi : Që z. Ministër i Financave M. Libohova e ka patur këtë borç, që e ka paguar, që e ka çpenguar pasunit' e tija të pa-lujshme e që m'andej ky vetë, gjoja si kur e mori këtë shumë prej së shoqes e prej të bijve u transferoj atyre zotnimin e këtyre pasurive, këto provohen nga faktet e dokumentat që kam ndër duar dhe s'lenë as një dyshim. .

Mbetet tani çështja, ose problemi tjetër; Ku i gjeti me një herë gjith këto të holla Mufit beu? Edhe në qoftë se ja hojtnë, ose me këto të holla fëmija e tij ja blenë këtë pasuri, ahere pyes prapë: ku i gjetnë gjith këta pare fëmij' e tij? A nuk ishin këto në dijeni të Mufit beut? A nuk kishte kontrollin ky mbi familjen e tija? Se mos harroni; këtu kemi tre veprime zyrtare, nga të cilët njëri ësht' ajy që Mufid beu lau borçin e çpengoj pasurit e penguara edhe ky akt

[1] alltì = armë zjarri (H. K.)

përbëhet prej 4 akteve të tjerë mbassi katër ishin edhe kreditorët e tij. Akti i dytë është një akt noterial, ku Mufid beu i ka marrë hua këto të holla nga e shoqja dhe nga djemtë dhe i treti është një akt kadastror, ku M. Libohova transferon zotnimin e pasurive të palujtshme mbi të përmendurit njerëzit e vet. Pra, në qoftë se supozojmë për një ças si na tha z. Kassua, se këto të holla munt t'i ketë prokuruar nga miqt' e tija, ahere ç'ishte nevoja të na tregonte se ja dhanë fëmija e tij si çmim shitblerje të pasurive të penguara? A di z. Kasso ndo një farë vepërimi që të jetë bërë për huajtjen e këtyre parave prej personave të tjerë? Si ish e mundur 23. 000 e sa napolonë të jepeshin ashtu në erë pa një sigurim, pa një kondraballancim? Në qoftë se një marrëdhënie kaqe me rëndësi munt të bëhet në këtë mënyrë le të na e thotë z. Kassua.

Unë po ju sjell edhe një argument tjetër që është ky : Vitin e kaluar, në kohën e hyrjes në Tiranë të qeverisë revolucjonare të Fan Nolit, z. Mufid Libohova u gjent në Shkodër dhe, dyke qenë i shtërnguar të dalë për jashta Shqipërisë, e dyke mos patur as një metalik në xhep, mori hua prej një mikut të tij në Shkodër 50 napolona. Tani e shohim që kthehet edhe pa mbushur akoma 6 muaj si ministër i Financave, ky gjindet me një herë me një kapital 23.000 e sa napolonash e shkon e lan borxhet e tij, dyke shpenguar pasurin' e tija të penguar. Për mbi ato, si jam informuar mirë, është në pazarllëk të blerë edhe një vilë që kushton 3-4.000 napolona. Pra e pyes prapë z. Kasson, ku i gjeti kaqe shpejt gjith këto pare Mufid beu? Mos kujtoni se ha bar populli jashtë z. Kasso? E kur një popull bërtet nga katër anët se ministri i Financave ka bërë çrregullime, abuzime, përvetsime....

J. Erebara : Thoni vjedhje më mirë!

Kr. Floqi : Përdora një termë juridike, që përfaqëson njëkohësisht vjedhjet, grabitjet, kusaritë, hajdutllëkat, plaçkitjet!....

Zërra : Mjaft, mjaft, e muarm vesh.

Kr. Floqi : Kur një popull i tërë, po them, bërtet posht' e lart se Mufid beu bën çrregullime e përvetsime mbi kurrizin e shtetit, nuk është kjo një Vox populi, Vox Dei? Ne deputetët atëherë, që jemi përfaqësuesit e popullit duhet të flemë, të rijmë me duart kryq, apathikë, a po duhet të çojmë zërin gjer në kubën e Qjellit?

J. Erebara : Ka kujtuar se Shqipërija është çifligu i tij!

Kr. Floqi : Tamam ashtu, ka kujtuar si ka kujtuar një pakicë e bejlerëve Shqiptarë.

H. Vrijoni : Merreni fjalën prapa!

Kr. Floqi : Psé ta marr, nuk ësht' e vërtet këjo që po them? Mos u trazuat z. juaj që po ju intereson kjo çështje, a po mos u djek miza në shapkë? Po duhet të dijni se populli ynë e njeh mirë këtë pakicë bejlerësh dhe nuk është lark koha që do çlirohet prej kësaj, e mos kujtoni, z. deputet i Beratit se Shqipërija u krijua për hatër të kësaj pakice, jo, kurrë! Shqipërija u krijua për Shqiptarët në saje e me kuximin e shkrimtarëve të saj patriotë e të atyre që luftuan e derdhë gjakun për këtë Shqipëri!.... (Duartrokitje. Zhurmë. Zërra: Bravo, bravo.

H. Vrijoni : Z. Kryetar, z. deputet i Korçës më ka fyer!. . .

V. Bamiha : Në të ka fyer, të drejtë ka, këtu fjala është e lirë; në e ndjeni vehten të krosvalur[1] sjelljuni gjyqit!

H. Vrijoni : Pusho ti grekoman!

V. Bamiha : Në jam unë një grekoman edhe ti je një turkoman, po këtu që të dy jemi deputetë e barabar si njëri-tjetri. (illaritet e zhurmë. Ndërhyn Kryetari)

Kryetari : Qetësi ju lutem, ndryshe jam i shtërnguar të mbyll mbledhjen. Urdhro z. Floqi, vazhdoni fjalimin t'uaj.

Kr. Floqi : E shoh se u zgjatmë pa hyrë akoma në themën e çështjes. Pra, po i bije shkurt: Ju lutem zotërinj deputetë, të mbani shënim, dyke më dëgjuar me vërrejtje, dhe në qoftë se dikush prej jush kërkon shpjegime, i lutem të ketë durim gjer sa ta mbaronj fjalën e ahere i jap seicilit shpjegimet që kërkon.

[1] krosvaluar = të kryqëzuar (përkthyer nga greqishtja me google H. K.)

Çrregullimet, abuzimet e përvetsimet e z. Mufit Libohovës, zotërinj, përmbledhen në këto pika :

1. Është një sasi kollosale mjelli, që u importua së jashtmi në Sarandë pa tagër, do me th. në mënyrë klandestine, që shqip i thonë kontrabandë , për hesap të disa tregtarëve të atij qyteti, me dijeninë e plotë, pa dyshim e me konsentimentin[1], natyrisht të z. ministrit të Financave.

R. Fico : Bëkërka edhe kontrabandë Myfid beu?

Kr. Floqi : Ju lutem mos preni fjalën, dëgjoni gjer më në funt.... Nga ky vepërim humbi shteti një sasi prej 222, 864. 00 fr. arit, të cilat u ndanë përgjysmë midis tregtarëve dhe z. ministrit M. Libohova. Për të mbuluar këtë veprim kundraligjor fllagrant, z. Mufid Libohova ju paraqiti këtu një dekret-ligjë me fuqi retroaktive, e cila u pranua me duartrokitje në mungesën t'ime.

Gj. Çako : Pse, nuk u ndothtë atë dit këtu?

Kr. Floqi : Fatkeqësisht u ndodha në Itali për punë private, ndryshe do kisha kundrështuar.

V. Bamiha : Sa gjërra ngjasin nënë Djellë!

Kr. Floqi : Pika e dytë, zotërinj, është çështja e vaporëve të mbytur në detet toksorë të Shtetit t'onë. Duhet të dijni që nxjerja e këtyre hekurishteve të çmuara prej detit u dha një sipërmarrje, por sipërmarja u bë jashtë ligjës, kështu që dy tregtarë, një Durrsak e një Tiranas që konkuronin, me ndërmjetësinë e Avni bej Delvinës, krahut të djathtë të Mufid beut muar prej Avniut dy kambiale nga 500 napolona seicili për të hequr dorë nga ankanti, që të mbeten në sipërmarrje të Avni Delvinës, i cili ja shiti të drejtat e tija një shoqërije italjane që i pagoj shumën e 5. 000 napolonave ar. Prej këtyre 3. 000 napolona i mori Mufid beu prej Avni Delvinës dhe 2. 000 i mbajti Avniu për hesap të tij. Por ç' ngjau m'andej? Avni Delvina këto të holla i mbajti për vehte dhe të dy konkurentëve tregtarë, që hoqnë dorë nga ankanti u kthevi bryllin dhe tregtarët që të dy protestuan kambialet e i vunë në ekzekutim, me fjalë të tjera këtu kemi një grabitje, po edhe një batakçillëk!

H. Myftiu : More paturpësi!

K. Mjeda : Batakçillarë me dipllomë!

Kr. Floqi : Pika e tretë është çështja e abuzimit të pullave postare që u shtypnë prej firmës Aspiotti në Korfus për llogari të ministris sonë të Financave. Shifrat dhe një dokument që kam tregojnë se këtu u bë një abuzim prej 40. 000 e sa frangave shqiptare mbi kurrizin e Shtetit. Prej këtyre jam informuar se 25. 000 franga shkuan në xhepin e Mufid beut!

Zërra : Turp, turp!. . .

Kr. Floqi : Si këto abuzime di edhe disa të tjera më të vogla, por s'kam informata të sakta. Me fjalë të tjera më vjen të përsërit proverbin "Bir Selam i nënës ç'të të qanj më parë"! Por se vazhdojmë se kalon koha.

H. Delvina : Kemi pikën e katërt, z. Floqi.

Kr. Floqi : IV. Pika e katërt është çështja e eksportimit të kafshëve jashtë Shtetit. Si e dijni, zotërinj, kemi një ligjë që ndalon eksportimin e kafshëve të trasha për ç'do arësyje. Z. ministër i Financave, dyke bërë syrin e verbër e veshin e shurdhuar, lejoj tërthorazi disa tregtarë kafshësh të transportonin në Greqi me mijra lopësh, demash, buallicash, kuajsh, mushkash e gomerësh. Prej save jam i informuar mirë dhe me dokumenta në dorë, jam në gjëndje t'ju them se shifrat e këtij tregtimi përballojnë shumën e një dëmi prej 80. 000 e sa frangash Shqiptare në kurris të Shtetit, të ndara këto në mënyrë të barabartë midis tregtarëve kontrabandista e z. Mufid Libohovës. I dëgjoni këto zotërinj Kasso e Javer Hurshidi?

Nd. Kiçi : Kusarë me patenta!

[1] konsentiment = pëlqim, miratim (H. K.)

Kr. Floqi : V. Pika e pestë, zotërinj, ësht' çështja e vaporeve të blerë prej Shtetit t'onë nga Italia. Si e dijni Shteti jonë bleu dy vaporë të vegjël prej Shtetit Italjan për nevojat shtetnore për lundrim e për kontrollimin e shkelave për kontrabandistët. Këta vaporë me nisjativën e M. Libohovës e me ndërmjetsin' e vëllajt të tij Eqrem Libohovës, ministër i Shqipërisë në Romë, u blenë për 800. 000 lireta. Po, nga ekspertimi që u bë në vënt prej të dërguarve të Qeverisë s'onë, ku muarn pjesë edhe dy expertë italjanë, këta vaporë ishin të vjetër, jashtë përdorimit e gati të shkatëruar, edhe vlefta e tyre si material s'munt të kalonte të 300. 000 liretat. Si u muar vesh më von, vaporët ishin blerë efektivisht për 500. 000 lireta, por ishin dekllaruar se u blenë për 800. 000. Qeverija jonë, si e dijni, nuk i mori në dorëzim këta vaporë, po u shtërngua t'ja sheshë një shoqërije italiane për 325. 000 lireta, dyke bjerrur në këtë mënyrë shumën prej 475. 000 liretave, mbassi kishte paguar 800. 000 lireta për ata vaporë.

Tani ju shenonj vetëm se kursi i liretës ka qenë aso kohet 117 lireta equivalente me 20 fr. ar shqiptar. Pra, ju lë të kuptoni se ç'dëm e gjeti të mjerin Shtetin t'onë, dhe ku e në cilat xhepa kaluan këto të holla! Edhe mjerimi ka qenë, zotërinj, se aspak s'u bë nerak Qeverija jonë për një mashtrim kaqe të math, po as që nxori zë askush, as që u dëgjua ndonjë ankim prej dikasterit!

M. Bushati : Turp, turp!

A. Koprencka : Jo turp, po rezalit[1] thuaj!

B. Begolli :Qënkan hajdutë me çizme Vallahi!

Kr. Floqi : VI. Vijmë në pikën e VI-të, që është çështja e ndërtesës së Prefekturës së Vlorës. Me një urdhër vetëm të ministrit M. Libohova ndërtesa e Prefekturës së Vlorës u transferua nënë zotnimin e personit juridik të Bashkis së Vlorës. Gjithkush e di se një ekspropracjon[2] i këtillë ka disa formalitete zyrtare, për sh. vendimin e Kësh. Administratif të Prefekturës, pëlqimin e min. P. të Brendëshme, akt-noteria shitblermje, transkriptimin etj. etj. Po si u bë kështu? Gjithkush habitet! Po a ka ndo një bisht prapa? Flasim shumë gjërra, por për këtë kohë argumentat s'janë të mjaftë që t'ja paraqit çështjen me domethënie për veprim, me gjithë se jam i sigurt se edhe këtu ka gisht Mufid beu, edhe do kuptohet prej hetimeve që duhet të bëhen.

H. Delvina : Pika e VII , zoti Floqi.

Kr. Floqi : VII. Kini dëgjuar të dërgojë Shteti apostafat një nëpunës gjer në Durrës për të marrë s'andejmi e për të sjellë në Arkën e Qeveris këtu një shumë prej 200. 000 e sa fr. ari dhe të paguajë dijeta e shpenzime rrugore këtij nëpunësi, plus edhe 1% mbi shumën e inkasuar? Nuk kish Shteti mjete të tjera të sillte këto të holla këtu? Nuk janë mjaft Bankat, çeket etj. etj.? Ç' ishte arsyeja që proçedoj në këtë mënyrë? Pse këto shpenxime të kota mbi kurrizin e Shtetit? Ësht' e mundur të mos ketë përfituar prej këtij rastit Mufid beu? Kini për ta parë shifrat dhe argumentat përkatës dhe pastaj gjykoni vetë.

K. Mjeda : Batakçillëqe!

Kr. Floqi : VIII Ministrija e Financave ka patur në zotnimin e saj një maune të madhe për shërbim transportimi për Doganën e Durrësit. Me qenë se kjo maune ishte pak e vjetërsume ministri i Financave ka dashur ta sheshë. Drejtori i Doganës së Durrësit, dyke ardhur në marrëveshje me disa tregtarë në Durrës, e lajmon z. Mufid Libohovën se i japin gjer më 10-11. 000 lireta, dyke kërkuar autorizimin e tij, por z. M. Libohova, dyke e lënë në pritje drejtorin e Doganës me një herë ja shiti maunën Konsullatës Italisë në Durrës, pa një formalitet edhe sikur e kish mallin e tij, vetëm për 1. 500 lireta, që edh' ato nuk i inkasuan në Arkën e Shtetit! Si e konsideroni këtë zotërinj deputetë?

K. Radovicka : Të jet' e vërtetë këjo?

[1] rezali = turp i madh (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

[2] ekspropracjon = heqje e titullit të pronësisë, transferim pasurije të patundshme, shtetizim, etj (H. K.)

Kr. Floqi : Aqe e vërtetë z. Radovicka, sa e dëshmon me habi të plottë edhe vetë drejtori i doganës së Durrësit, të cilin munt edhe t'a thresim kurdoherë që të duam; aqe është e vërtetë, sa e dëshmon edhe korrespondenza zyrtare midis ministrit e drejtorit të Doganës, aqe e vërtetë sa edhe vetë ata tregtarët e Durrsit që ishin në pazarllëk për këtë maunë, u çuditnë edhe ardhë e ju ankuan drejtorit të Doganës.

K. Radovicka : Kur ësht' ashtu s'kam ç'të them.

Kr. Floqi : IX. Ajo që më ka bërë përshtypjen më të madhe, zotërinj deputetë, e që më ka hequr vërejtjen, është çështja e një të ashtuquajturi misjoni dipllomatik për raison d'Etat, arsyje Shteti siç e quajn në gjuhën dipllomatike, misjon që, si u informova mirë nuk u bë. Ngjarja ngjau kështu. Z. M. Libohova, dyke vepëruar si zëvëndës i Min. P. Jashtëme i dha urdhër të vëllajt të tij Ekrem Libohovës në Romë, ose më mirë, zëvëndësi i Min. P. të Jashtëme M. Libohova, i jep urdhër ministrit të Financave prapë M. Libohovës t'i paguaj z. Ekrem Vlorës[1], ministër i Shqipërisë në Romë shumën gllobale prej 14. 000 fr. arit për një misjon dipllomatik, për të cilin misjon ka dijeni vetëm Këshilli Ministror.

Të hollat ju paguan me një herë Ekrem Libohovës, por misjoni nuk u bë! Ahere ku vanë këta para? Këshilli Ministror pse nuk kërkoj zbatimin e misjonit? Edhe në qoftë se misjoni nuk pati vent, pse nuk i kërkon Qeverija të hollat ti kthehen prapë? Në qoftë se ngjet ndonjë myster nuk duhet t'a dijë Parllamenti? Ahere kush i kontrollon të hollat shtetnore? Nuk ka ndonjë kontroll Qeverija?

Z. Ministër i Financave ka bërë edhe të tjera abuzime më të vogla, që po t'i radhitja këtu do të kërkonte një kohë të gjatë, si për sh. abuzimin e bakshishevet.... .

B. Begolli : Ç'janë ato bakshishe, pafsh Zotin?

Kr. Floqi : Janë një sasi e madhe të hollash, që z. ministër i Financave, me rastin e Bajramit u ndau gjithë shërbëtorëve të Min. Financave, muslimanë e të krishterë, jo nga xhepi i tij por drejt për drejt nga arka e Financave, vetëm me një urdhër verbal.

J. Erebara : Qënka edhe mahramotlli[2] beu i Libohovës!

M. Kasso : Sa ishin gjithsej këto të holla?

Kr. Floqi : Franga Shqiptare 2. 000

H. Myftiu : Mashallah, bakshish i majmë!

Kr. Floqi : Si këtë që ju tregova kam edhe mjaft të tjera, të cilat rezervohem t'ja paraqit hollësisht komisjonit të parllamentar që munt të formohet.

Të gjitha sa ju thashë, zotërinj deputetë, si e kuptuat kanë një rëndësi të madhe dhe s' duhet të kalojnë pa kontrollin e kësaj Dhome. Janë të bazuara të gjitha me fakte e dokumenta, që, si relator i çështjes jam gati t'ja paraqit komisjonit.

Nuk kam dashur të bënj një filijoik[3] kundra ministrit të Financavet, z. Mufit Libohova, po desha t'ju ve në dijeni të këtyre ngjarjeve skandalloze, dyke akuzuar për këto si shkaktar kryesor z. ministrin e Financave Mufid Libohovën dhe në embër të së drejtës e të nomit[4] 44 të Rregullores t'onë, të kërkonj të bëhet një anketë parllamentare, të caktohet një komisjon i posaçëm e i paanshëm të bëjë hetimet e duhura, e në qoftë se vërtetohen mbi pasivin e z. ministrit të Financave këto që ju tregova, kërkonj të vendoset prej kësaj Dhome dërgimin e tij përpara Gjyqit të posaçëm si çrregullues e abuzues i pasurisë shtetnore.

Vinj, tani, në çështjen e pushimit arbitrar të drejtorit të Monopolit z. Mark Martinit.

B. Begolli : Folni, aman, ju lumtë goja.

---

[1] duhet të jetë Ekrem Libohova dhe jo Ekrem Vlora. Ky është një gabim i Kristo Floqit, të cilin e korigjon vetë autori tre rrjeshta më poshtë. Sipas biografisë së tij marrë nga Wikipedia Ekrem Vlora nuk ka qenë kurrë përfaqësuesi i Shqipërisë në Romë, kurse Ekrem Libohova ka qene si i tillë në vitin 1924 emë pas (H. K.)

[2] mahramotlli = këtë fjalë nuk e gjeta në fjalorët e mij dhe nuk e di kuptimin e saj (H. K.)

[3] filijoik = nuk e gjeta këtë fjalë në fjalorët e mij, por besoj se kuptimi është "hedh litarin në qafë, ngrej kurth" (H. K.)

[4] nom = ligj (nga greqishtja H. K.)

Kr. Floqi : S'ka kush prej nesh të mos ketë patur dakaver arke me z. Mark Martinin e të mos e ketë njohur, po më tepër nga të gjithë e njohim ne, që e kemi patur në shërbimin t'onë gjatë një kohe shërbimi prej 14 vjetësh. Mark Martini, jo vetëm s'ish dëgjuar për ndo një abuzim, por, mund t'ju siguronj se as një gjobë s'ka ngrënë, as që i kanë hequr ndonjë vërejtje, përkundrazi ka marrë disa lavdërime, një nga të cilat i kam dhënë dhe vetë për një shërbim të çmuarshëm që i ka sjellë Shtetit.

Po Mark Martini u ndodh një gjëmp për min. e Financave z. Mufid Libohovën, i cili e quante ngatërestar e fesatxhi[1], dhe s'dinte si t'a çporrte qafet, sepse i gjendeshe gjithë një bela e nuk e linte të punonte pas qejfit. Pushimi i tij ilegal u shkaktua për një dëftesë 80 frangash për disa botime private të Mufid beut, që ky kërkonte t'ja paguanj arka e Shtetit.

J. Erebara : Zakon' i Bejlerëve ky!

Një zë : Jo i gjithë Bejlerëvet!

J. Erebara : Ç'ka, po si do qoftë është një zakon beu, se ata e kanë zakon të mos paguajn

H. Vrioni : Jo të gjithë....

J. Erebara : Po thuaj se të gjithë, Hysen bej, me përjashtim të harbutëve, se ata kanë zakon që paguajn (illaritet e duartrokitje).

Kr. Floqi : Ky ka qenë i vetmi shkak që një nëpunës zelltar e i ndershëm u pushua vetëm me një urdhër të ministrit Libohovës.

B. Begolli : Kërkonj edhe për këtë të bëhet një anketë parllamentare.

Kr. Floqi : Nuk është nevoja për anketë, sa është nevoja të insistojmë ne këtu për rimarjen e tij në shërbim, se është gjynah, një nëpunës i këtillë të flaket rrugëve pa një arsye ligjore e të vuanj për bukë me një karvan fëmijë! Prandaj ja rekomandonj Parlamentit, me rrugën legale të nisistojë që Mark Martini të merret në shërbim.

R. Fico : Zotërinj deputetë! Kolegu jonë, i ndershëm e patriot z. Floqi, që e kemi për nder t'a kemi këtu, na ndritshtoj mjaft mbi këto abuzime të çuditshme të z. M. Libohovës. Me të vërtet duhet të kemi kurazhin[2] civil të flasim, ashtu si foli z. Floqi, e jo të fshihemi e ta luftojmë tjatrin prapa krahëvet. Ne që kemi ardhur këtu si përfaqësuesit e popullit, duhet të kemi kuximin të mos shkelen të drejtat e tij e të mos hahet djersa e tija. Unë kujtoj se edhe ata që i dalin zot Mufid beut, si z. Javer Hurshidi, z. Mihal Kasso e të tjerë, nuk janë të huaj në këtë çështje, po bëhen si kur s'dijnë gjë, se duan të përkrahin mikun e tyre, po, mos kujtoni se nuk e kemi edhe ne mik Mufid bejnë e ndofta më shumë se ju, po, kur vjen sëra e çfaqen abuzime asij fllagrante, si na i tregoj z. Floqi, ahere do të ishte turp për ne të mbyllim sytë e të mbajmë hatëre njërit e tjetrit. Prandaj po bashkohem me z. Floqi e po kërkonj edhe unë të emërohet një komisjon i posaçëm për të proçeduar në anketën parllamentare.

Zërra : Po, po, d'akord jemi të gjithë.

Mih. Kasso : Kam fjalën , z. Kryetar

Kryetari : Urdhro, zoti Kasso

M. Kassua : Unë, si e thashë edhe në krye, e kam pasur dhe vazhdonj t'a kem mik të ngushtë z. Mufid Libohovën, se me shtëpin e tij njihem tash një jetë të tërë. Po, në qoftë se këto që u thanë dalin të vërteta, ahere ju siguronj edhe ju z. Kryetar, edhe gjithë Parllamentin, se do të pres ç'do miqësi me Mufid bejnë!

Zërra : Bravo, zoti Kasso!

Mih. Kassua : Po, në qoftë se prej kësaj akuze Mufid beu del llagar, ahere Parllamenti duhet t'ja sjellë nderin në vënt, se ashtu pas berihajit nuk poshtërohet një njeri si Mufid beu n' atë mënyrë. Këtë ju rekomandoj dhe akozonjësit, mikut t'em z. Floqit, që në rast të pafajsisë së Mufid beut, ajy i pari duhet t'i japë satisfaksjonin e duhur.

[1] fesat = ogurzi, shpirtlig (përkthyer nga turqishtja me google H. K.)

[2] kurazh – kurajo (H. K.)

Kr. Floqi : Mos dysho as pak për atë z. Kasso. Edhe ne i lutemi Zotit të dalë i pafajshëm. Pra, po përsërit proponimin t'em, për anketën parllamentare dhe i lutem Kryetarit t'a verë në votë.

Kryetari : Përkrahet proponimi i z. Floqit për anketë Parllamentare kundra Ministrit të Financavet z. Mufid Libohovës? E dijni se duhet ta përkrahin 10 deputetë.

Zërra. : E përkrahim të gjithë.

Kryetari : Të çfaqen të paktën 10 deputetë.

J. Erebara : Unë një (shënohet prej sekretarit)

V. Bamiha : Edhe unë "

R. Fico : Edhe unë "

Sel. Blloshmi : Edhe unë "

H. Delvina : Edhe unë "

Kol Mjeda : Edhe unë "

Ndrek Kiçi : Edhe unë "

H. Myftiu : Edhe unë "

Lon Llogori : Edhe unë "

Fikri Russi : Edhe unë "

Kryetari : U bënë dhjetë, mjaftojnë.

Zëra : Në votë, z. Kryetar.

Kryetari : Po e vë në votë nominale çështjen e anketës parllamentare kundra ministrit të Financave z. Mufid Libohovës, si rjedhim i interpellacjonit drejtue e zhvillue prej deputetit të Korçës z. Kr. Floqit.

Bëhet votimi nominal, përfundimi i të cilit ishte proçedimi në anketë parllamentare kundra z. Mufid Libohovës. Prej të 42 deputetëve prezentë 36 votuan për anketën parllamentare dhe vetëm 6 ishin në favor të M. Libohovës.

M'andej Kryetari ju suall Dhomës të zgjedhë një komisjon, i cili u zgjodh kështu :

Kristo Floqi Kryetar i komisjonit.

Kr. Floqi : Z. Kryetar, unë s'duhet të figuronj si antar i këtij komisjoni, për dy arsye : I: se s'dëshironj të flitet jashtë se i binda, ose i influencova shokët; II: se unë jam drejt për drejt akuzuesi dhe si i tillë, vetëm si rellator munt të paraqitem përpara komisjonit për të presantuar dokumentat përkatëse të çështjes dhe për të dhënë shpjegimet e duhura.

Zëra : Ka të drejtë, ka të drejtë.

Vazhdon zgjedhja e antarëve të komisjonit:

Z. Rauf Fico, si kryetar i komisjonit

Z. Vasil Bamiha, si anëtar

Z. Fikri Russi, si anëtar

Z. Kasëm Radovicka, si anëtar

Z. Maliq Bushati, si anëtar.

Me zgjedhjen e komisjonit mori funt mbledhja e Parllamentit.

Komisjoni filloj punën imtazi dhe argumentoj plotësisht çrregullimet, grabitjet e mvjedhjet që u bënë në ministrin' e Financave, mbassi më parë pat vajtur në atë ministri e marrë një nga një origjinalet e akteve.

Përfundimi i raportit që ju paraqit Parllamentit, kishte vërtetuar jo vetëm çrregullimet e vjedhjet që kisha denoncuar unë, por edhe shum' e shumë të tjera, të gjitha në kurris të ministrit të Financave z. Mufid Libohovës.

Kur u këndua raporti në Parllament u çuditnë të gjithë, e të gjithë deputetët, përveç dyve më shtrënguan dorën!

Zërra : Duhet dërguar në gjyq!

R. Ficua : Edhe ajo do të bëhet po t'a kërkojë Dhoma e Deputetëvet.

Zërra : E kërkojnë të gjithë.

S. Blloshmi : Vëre në votë, z. Kryetar.

Zërra : Në votë, në votë!

Kryetari : Për krahet?

Zërra shumë : Po, po .... . .

V. Bamiha : Ta merr mendja, z. Kryetar, ndryshe pse gjith ky telash për anketë parllamentare? Ç' kuptim do kishte anketa, po të mos kish si rezulltat dërgimin në gjyq të fajtorit, që në rastin konkret është vetë ajy z. Myfid Libohova.

Kryetari : Po e vé në votë nominale. Kush ësht' anëtar të dërgohet në gjyq ministri i Financave z. Mufid Libohova le të ngrehë dorën.

Mih. Kasso : Si bëhet ashtu, z. Kryetar që më nj'anë e vini çështjen në votë nominale, e më tjetrën anë na thoni të ngrehim dorën? Ja nominale, ja ngritje dore!

Kryetari : (Dyke nënëqeshur). Gabim, gabim. Po e vé në votë nominale. Le të këndohet katallogu i Deputetëve, kush është "pro" lé të thotë "po", të tjerët do thonë "jo".

Këndohet katallogu. Rezulltati 29 u përgjiqnë "po", 6 u përgjiqnë "jo" 4 abstenuan.

Kryetari : U vendos ti dërgohet gjyqit të posaçëm si i pandehur z. Mufid Libohova ministër i Financave për çrregullimet e përvetimet e bëra në kurris të Arkës së Shtetit, me konditë që, ky vendimi i jonë duhet të marrë edhe aprovimin e Senatit.

Kështu mbledhja mori funt.

Atë natë nga ora 11 para mesnatës na thiri në pallat Kryetari i Republikës mua, Rauf Ficon dhe Vasil Bamihën. Bisedimi që u çvillua midis nesh është ky :

A. Zogu : Ju thira t'ju përgëzonj e t'ju falënderonj për detyrën që kryet me ndërgjegje të plottë e me paanësi të dukshme. Si u informova, Parllamenti vendosi edhe dërgimin në gjyq të Mufid beut.

R. Ficua : Si urdhron Çkelqësì.

A. Zogu : Do ty'ju tregonj një arsyje politike të rëndësishme, që na shtërngon të mos e shtymë punën më tutje.

Kr. Floqi : Po presim të dëgjojmë, Shkelqësi

A. Zogu : Para një ore – po entre nous[1] këjo – mora një telegraf prej Mussolinit, i cili më lutet të mos vepërohet gjë kundra Mufid beut, mbassi ky është një "persona grata" për italjanët. Ç' thoni?

V. Bramiha : Ne, Shkelqësi, nuk mundim të përzjehemi në politikën e jashtme e në çështje personale. Ato janë punët që interesojnë drejt për drejt Sh. juaj. Ne jemi langorët e z. s'ate dhe Sh. juaj jini gjahtari. Ne bëmë si bëmë e nxuarm gjahun, ose ljepurin nga udha, z. juaj e keni çiftes në dorë, po të doni e vrisni, po të doni e lijni.

Kr. Floqi : Shkëlqesë, më falni, në qoftë se vinj t'ju kujtonj ç'u tha më parë rreth kësaj çështjeje. Atë ditë që e akuzova z. M. Libohova përpara Parllamentit dhe ja zbulova një nga një edhe me dokumenta në dorë, të gjithë grabitjet skandalloze, që ajy kish vepëruar në kurrizin e Shtetit, Sh. juaj më thiri këtu, më shtërngoj dorën e më përgëzonj për kurajon civile që pata kundra një njeriut me aqe rëndësi, si është Mufid beu e tani!.... .

A. Zogu : Ke të drejtë, vëllathi im, ke plotësisht të drejtë për sa që thua ; vërtet të shtërngova dorën e tani prapë po t'a shtërngonj ty edhe shokëve të tu për kurajon që pattë, po mos harroni, se unë gjëndem sot në një pozitë delikate përpara një mikut t'onë të math, si është Mussolini, dhe ju tani duhet të më jepni një mendje si të sillem.

R. Ficua : Shkëlqesi, unë kam qenë një nga më të afërmit miq me Mufid bejnë e tani e kuptoni ç'farë armiqësije ka hyrë në mes t'onë. Duhet të dijni se vetëm detyra si deputetë na shtyu në këtë veprim e jo gjë tjetër. Nga ana tjetër ju e dijni më mirë se mua se, Mufid beu është një njeri ambicioz edhe s'e harron kurrë një të keqe që i bëhet. Pastaj ka edhe asish bravosh që i vë t'ja marrin hakun brenda 24 orëve, si p. sh. ka major Bilhal Nivicën me shokë,

[1] entre nous = midis nesh (H. K.)

që janë shtyrë e që shtyhen në ç'do therori për hatër të tij. Tani ne e bëmë detyrën t'onë, ju bëni si të doni, po edhe ne duam një sigurim e një përkrahje nga ana e Sh. s'uaj, se kemi edhe fëmijë.

A. Zogu : Nuk do shkojë puna gjer atje, mos kini frikë. Jam unë garant për ju të gjithë e do t'a thres e do ta kshilloj si duhet.

Si e pamë që s'kishim më punë atje, u ngritmë e shkuam. A. Zogu na dërgoj se cilin prej nesh në për shtëpitë t'ona me veturën e tija.

Të nesërmen M. Libohova jepte dorëheqjen. A. Zogu emëroj z. Sul Starovën, si ministrin e Financavet.

Nuk e di në se telegrafi që na tha A. Zogu kish ardhur me të vërtetë prej Duçes, se ne nuk e pamë, po si u muar vesh mirë, Zogu e përkrahte personalisht M. Libohovën e nuk desh të diskreditoheshe. Sido qoftë M. Libohova, passi dha dorëheqjen shkoj në Itali për të mos u kthyer më në Shqipëri. Atje, pas një sëmundje 4 muajshe vdiq!

U zgjata dyke treguar këtë episod, që ka pasur një rëndësi të madhe politike, se ish e para herë që një ministër, e sidomos një ministër i Financave, një njeri i dëgjuar me një rëndësi të jashtzakonshme, një bej më së fundi nga më feudalët që ka pasur Shqipërija, u atakua zyrtarisht në një mënyrë aqe skandalloze e kuximtare, sa u çvesh krejt dhe u poshtërua ashtu si nuk e pandehte kurrë, në një mënyrë që ajy atakim i kushtoj jo vetëm dorëheqjen po edhe jetën e tija!

Një çudi për mua ka qen' ajo, që as Qeverija as Kryetari i Republikës nuk u përkujdesnë aspak për konfiskimin të paktën e gjithë pasunisë toksore e ndërtesore të M. Libohovës për të nxjerrë në favorin e Arkës së Shtetit gjith' ato vjedhje, gjith' ato sasi të mbëdha që kishte përvetuar – ndjesë pastë – le të themi, Mufid beu. Gjetkë nuk do mundte të ngjiste këjo, po mjerisht, ne Shqiptarët kemi stomak të fortë e i bluajmë të gjitha!.... .

Ndodhemi në verën e vitit 1928.

Aty nga fillimi i Majit filluan të pëshpëriteshin disa fjalë rreth ndryshimit të regjimit t'onë Republikan. Fjala ishte se A. Zogut, po i afroheshe afati i mbarimit të zgjedhjes së tij si Kryetar Republike, edhe me gjith se ishte i sigurt se do zgjidhej përsëri, se s'kishte ndo një rival tjetër, Zogu dyke ëndëruar duket, pozita më të nalta e më të shkëlqyera e dyke dashur ta sigurojë një her' e mirë selinë e dinastin' e tija, e dyke qenë në marrveshje edhe me Duçen, i cili e përkrahte shumë, filloj të bëjë sondazhe mbi ndrimin e Regjimit Republikan, dyke e kthyer këtë në Regjim Monarqik dyke u dekllaruar ky "Mbret i Shqiptarëvet"

Sado që s'merreshe vesh ndo një gjë e saktë, po prapë nuk ish edhe ndonjë çudi t'i kishte shkuar një mëndje e këtillë Zogut, i cili ishte tepër ambicioz e megalloman, aqe sa kish të drejtë plotësisht një miku im, që më tha një natë se Zogu e paske kënduar disa herë historin e Napolonit të Math e e kishte msuar mëgojë[1] dhe se ëndëronte edhe ky të bëhej një ditë Napoloni i Shqiprisë.

Një natë dërgoj veturën e tij e më mori në pallat. Më priti shumë mirë. Mbassi më gostiti një kafe të mirë e cigare, më tërhoqi më nj' anë e filloj të më kërkojë disa mendime juridike në domethëniet e ndryshimet midis regjimeve të ndryshëm Republikan, Monarqik, Federal, midis regjimit konstitucional e apolitarqik, midis regjimit diktatorial etj. etj.

Unë e kuptova me një herë se ku e kishte qëllimin, por u kufizova ti jap shpjegimet e duhura mbi sa më kërkonte. Fundi i fundit kur e pashë se s'hiqte dorë së pyeturi rreth Regjimit Monarqik, dyke kërkuar shumë hollësira, ahere s'mu durua e i thashë : Shkelqësi, ju lutem pse më pyesni kaqe tepër mbi këtë regjim? Mos ky ju pëlqen më mirë për administrimin e Shtetit t'onë? Jo, ma priti, por, si një sovran duhet ti dallonj mirë të gjitha systemet qeveritarë që është një nga parimet kryesore të një sovrani, e mbassi unë s'jam jurist, ju pyeta juve që jini jurist e që ju kam më të afërmin.

[1] mëgojë = përmenç (H. K.)

U mendova pak e vazhdova : Do t'ju thom një sent, por ju lutem mos e merni në pikpamjen serioze.... Ç'farë, më thotë? Pështëritet jasht' e nalt, i thom, se Sh. juaj dëshironi të ndryshohet Regjimi i jonë Republikan, dyke u përkthyer në atë Monarqik, ësht' e vërtetë? Jo, as pak, mu përgjigj Zogu. . Kush i thotë ato fjalë? I flasin njerës seriozë? – Edhe seriozë edhe jo seriozë, i them, por se i flasin, e gjithë këto fjalë pështëriten në gojën e popullit. Natyrisht, pas ndrimit të Regjimit t'onë në Regjim Monarqik, vjen pyetja tjetër: Kush do bëhet Monark, me fjalë të tjera "Mbret"? Sigurisht jo se s'ka kush t'ju kundrashtojë kandidaturën.... Edhe i mbesuat edhe ju këto fjalë? ma pret Zogu: - S'dua ti mbesoj, i them, por i kam dëgjuar prej popullit, prandaj edhe vetë dëshironja të marr disa shpjegime e të dëgjonja drejt për drejt nga goja juaj në janë këto të vërteta, apo jo, me gjithë që Sh. juaj s'kini nevojë ti çfaqni dikujt ndjenjat e mendimet t'uaj. – Janë rrena këto, më thotë Zogu, janë fjalë sokaku, mos dëgjoni kësijsh pallavrash! Po të kisha ndonjë qëllim të këtillë nuk do t'ta thesha qoftë ty, si mikut t'em? – Tamam, ashtu kujtonj edhe unë, i them, po mora shkak nga hollësirat që më kërkuat rreth regjimeve të ndryshëm e prandaj Ju a thashë. Me gjithë atë kërkonj ndjesë prej Sh. suaj. Po, në qoftë se ma permetoni, kam edhe një pyetje tjetër të vogël. Urdhroni, më thotë Zogu. – Desha t'ju pyes, Shkelqësi, me lejen t'uaj : Në rast që munttë supozohet se ka shkuar një mendim i tillë për sh. si kur do prokllamoheshit "Mbret i Shqiptarëvet", me lejen t'uaj, desha miqësisht të pyesnja Sh. tuaj, ç'farë përfitim munt të kishte Shteti ynë nga një ndryshim i këtillë, makar edhe Sh. juaj personalisht? Pas mëndjes s'ime, jam i bindur se Regjim më i mirë se ky që kemi, s'munt të bëhet për Shqipërinë e për popullin Shqiptar, i cili është msuar zakonisht të sundohet prej një regjimi të butë e të lirë, një regjimi popullor, ashtu si ka jetuar gjithënjë, e si e tregon edhe historija Shqiptare, sidomos Sami bej Frashëri në librin e tij të vogël, po ta pa-vdekur " Shqipërija ç'ka qenë, ç'është e ç'do të jetë" ku bën fjalë hollësisht mbi sundimin e popullit shqiptar me anë të pllakonive, të pleqësive, ose të bajraqeve, që s'kanë kuptim tjetër veç atij të Regjimit Republikan. Unë s'kam ndonjë përfundim tjetër, përveç atij që do t'i vihet popullit një zgjedhë edhe kjo jo trashëgimtare, që populli i jonë nuk është mësuar t'a duronjë, gjë që e çfaqi në kohën e Princ Wiedit me revolucionin e Shijakut, gjer sa Princi u shtërngua t'a lerë Shqipërinë. Sa për fatosin e math Skënderbenë, ky vërtet u dekllarua "Mbret i Shqipërisë", po në realitet s'ishte përveç se një sundues popullor, një kryeprijës ose sido thoshim sot një Duçe ose një Fuehrer, udhëheqës i popullit, e jo me ekipazhe e me salltanete etj. etj. si e lyp një mbret i sotëm konstitucionar.

Ja ku ju a çfaqa mendimin t'em, Shkelqësi, sinqerisht ashtu si e dëshironi e pa dredhina. Tani Ju, jeni të mentshëm vetë, gjykoni në kam, apo jo të drejtë edhe bëni si t'ju a marrë mendja.

Edhe një herë po ju them, më tha Zogu, se ato janë fjalë; populli munt të thotë ç'të dojë, s'ja mban gojën njeri, por se mua sinqerisht po ju them, as më ka shkuar nëpër ment një qëllim i tillë, as që dua ti bëhen havale Shtetit t'onë fukara me shpenzime kollosale! Pas pak u ngrita e shkova.

Këto më tha Zogu, po un' e kuptova se më gënjeu, se e pa që ju çfaq një kundrështar në qëllimet e tij. Sikur të isha rëfyer se ja adaptoja mejtimet e tij, ndofta do më ishte çfaqur edhe kështu nuk do më ngjisnin ç'më ngjanë me von, si do ti tregonj më poshtë, por ç'ishte nevoja t'a bënja atë hipokrizi, kur ndërgjegja ime i kundrështonte këta qëllime ambicioze e të mbrapshtë e fort të dëmshme për popullin t'onë?

Nuk shkoj një muaj qysh atë ditë, kur çështja ardhi edhe në Parllament, piksëpari në një mënyrë private, pastaj edhe zyrtare.

Ata që s'dijnin ose që s'i mbesonin qëllimet megallomane të Zogut u çuditnë kur i dëgjuan prej njerësve më të afërm të Zogut, si për sh. prej Abdurahman Krossit e prej Zef Sereqit. Unë kur u hap fjala në parasqenat e Parllamentit nuk i tregova as një deputeti se kisha dijeni rreth asaj çështjeje, ose të tregonja ç'u fol midis Zogut e meje për atë çështje.

Kur nj'a 3-4 deputetë më kërkuan mejtimin u a thashë sheshazi se ajo do t'ishte një fatkeqësi e një vet-vrasje për popullin të ndronte Regjimin e të pranonte një Mbret hereditar që të mos e çporrte kurrë prej qafe, në rast që nesër-pasnesrit nuk e dëshironte.

I konstatova deputetët që më pyetnë e i kuptova se kishin mbetur të kënaqur. Ishin edhe ata të një mejtimit me mua.

Pas nj'a 4-5 dittt më ardhë në shtëpi nj'a 18 deputetë e u fjalosmë gjërr' e gjattë rrotull kësaj çështjeje e mbetmë të gjithë dakord se në rast që hapeshe këjo punë në Parlament ne të gjithë do t'ishim kundra.

Këto duket se i vanë në vesh Zogut dhe pas 2 ditsh më zenë në Parllament disa deputetë si Hysen Vrijoni, Selah. Blloshmi, Fikri Russi, Hiqmet Delvina, Javer Hurshidi dhe Ferid Vokopola e më thanë se kishin marrë vesh ç'kishim folur më ata të 18 deputetët që më ardhë në shtëpi rreth çështjes së ndryshimit të Regjimit, por, më kështilluan të mos sjell kundrështime, as të mos bënj propagandë se Zogut i mbetet hatri të dëgjojë këto fjalë prej një miku, kur se ajy e ka vendosur të bëhet mbret, se ashtu e sheh oportûn (!?) dhe është kot të kundrështojmë se, ja kështu ja ashtu ajy do t'a mbarojë qëllimin e tij.

Unë ju thashë se në kësij punësh me rëndësi të madhe shetnore nuk hyn në mes miqësija. Principi i jem është që Regjimi Monarqik ësht' i dëmshëm për Shqipërin' e shkretë edhe se Zogu, në është patriot i vërtetë duhet të heqë dorë nganjë pretendim i tillë ambicioz e dëmprurës.

Ne kaqe dijmë kaqe të themi si më thanë këta kolegë, zotrote nuk fiton gjë, veç se do t'a zembrosh Zogun, që ajy të ka dashur aqe fort. E di, u thashë, e di se më do e i falem nderit shumë, po edhe un' e dua dhe këtë që po ju them nuk është se e kam lakmi, ose haset, po e them se ashtu ma ndjen zembra se nuk do t'i dalë mirë gjer më në funt edhe po ja them si mik. Ahere u tregova edhe ç'kishim folur ca kohë më parë me Zogun për këtë çështje.

Në seancën e arthme të Parllamentit një deputet, Hiqmet Delvina, e hapi çështjen e ndryshimit të Regjimit, mbas një oratorije 15 minutash dyke treguar nevojën e këtij ndryshimi sipas kohëve që kalon Shteti e populli.

Fjalën e këtij e përkrahnë njëri pas tjetrit 4 deputetë të tjerë, Fiqri Russi, Abdurahman Dibra, Hysein Vrijoni dhe Javer Hurshiti. Unë u qëndrova të gjithve përpara, dyke folur më shumë se 20 minuta e dyke rëzuar një nga një argumentat e tyre.

E pashë se këto bënë një përshtypje të thellë, aqe më tepër, pse atë dit u ndodhë edhe shumë të huaj, ministra etj. etj.

Kur u vu çështja në votim "a duhet të mblidhen të dy Dhomat, Parllamenti Senati për çfaqjen e mejtimit për ndryshimin e Statutit e të Regjimit, sa do që s'mori fjalën as njeri të më përkrahte në argumentat që parashtrova për mos ndryshimin e Regjimit Republikan, si do mos prej atyre 18 deputetëve që kishin mbetur dakord në shtëpinë t'ime, prapë se prapë me gëzim vura re se rezulltati i votimit ishte 22 pro, 20 kundra dhe 6 vota të bardha, kështu që vetëm me dy vota u fitua gjith ajy proponim, që të gjithë e prisnin të votoheshe unanimisht.

Këjo me të vërtetë më kënaqi fort, po prapë mejtonja se e kishim edhe Senatin në favor të Regjimit Monarqik, edhe këjo më turbullonte mëndjen, se do mbeteshim me gisht në gojë ne të tjerët e do mos na shihte me sy të mirë Zogu, që sigurisht do dekllarohej Mbret.

Ditën e caktuar u mblodhë të dy Dhomat, nënë kryesin' e Panteli Evangjelit, i cili ish edhe Kryetari i Senatit. Në fytyrën e deputetëve shiheshe një nervozitet i math. Nj'a 2 prej kolegëve deputetë që votuam bashkarisht kundra ndryshimit të Regjimit m'u afruan nga dalë e më pyetnë se ç'farë atitude[1] do të mbanja, tash që do fillonte të bisedohej zyrtarisht çështja. Ju thashë: Atituda është ajo që kemi folur e që e kemi edhe votuar me gjithë që mbetmë në pakicë. Dikush tjetër më tha: Kini mëndjen se më duket se jemi përpara një fait-accompli – je dhe kot sa të harmohemi[2] me Zogun. – I thashë se unë s'tundem nga principet e mija; jam një

[1] atitudë = qëndrim (H. K.)

[2] harmohemi = të bëhemi copa-copa, të coptohemi, grihemi (H. K.)

patriot e do flas me ndërgjegjen t'ime ashtu si m'a merr mendja që bëhet mirë për Shtetin e për popullin dhe s'munt të sakrifikonj interesa të lartra të Atdheut për hatrin e njërit ose të tjetrit.

Si u këndua katallogu e u gjetnë gati po thusajse të gjithë senatorët e deputetët, kryetari mori fjalën, e mbassi përmendi rendin e ditës me të vetëm themë "Rreth ndryshimit të statutit" na tha :

Kryetari : Kujtonj se mbi këtë çështje jini d'akord që të dy dhomat, themën po e dijni, të mos e zgjatim më dhe ta vemë në votë....

Kr. Floqi : Ç' farë të vemë në votë?

Kryetari : Çështjen e ndryshimit të statutit.

Kr. Floqi : Ç' do me thënë çështjen e ndryshimit të statutit? Nuk do bisedohet më parë? Nuk do të rrihet? Nuk do shkëmbejmë mendime? Nuk do paraqitim arësyetime për se e për ç' shkak po e ndryshojmë statutin, ç' na shtyri, pse? Se kështu dyke ndenjur e pa ndo një nevojë nuk ndryshohet Statuti Themeltar, zotërinj!

Kryetari : Shkaqet e arsyetimet janë folur që më përpara, zoti deputet.

Kr. Floqi : Kur edhe ku janë folur? Unë s'kam haber as pak! Në qoftë se janë folur e biseduar familjarisht, ose shoqërish ajo s'më intereson; më interesojnë vetëm ato bisedohen këtu. Çështje të këtilla me kaqe rëndësi si këjo që kemi sot këtu përpara, nuk bisedohen ashtu si kujtoni z. Kryetar në për parasqenat e fshehuriçkathi, po bisedohen këtu në mënyrën më solemne, sepse nuk ka të drejtë asnjë prej nesh të shkelë parimet e Statutit t'onë themeltar. Unë e shoh këtu se po nguten të dy Dhomat t'i japin funt kësaj çështje. E di fort mirë psenë, po të paktën duhet të vijë puna me një çikë lezet e jo të na qeshin prapa si njerës që s'dijnë se ç'bëjmë, që s'kemi haber nga parimet konstitucionare e që hiqemi për peri[1]. Pyes : Jemi, apo s'jemi të lirë këtu?

Kryetari : Nuk ju kundrështon njeri, zoti deputet, por mbassi çështja konsiderohet si e përfunduar.... . . .

Kr. Floqi : (me nervozitet) Kush ju tha se konsiderohet si e përfunduar çështja? Kur u përfundua? Si u përfundua? Ne s'dijmë gjë! Ahere pse më ftuat këtu, apo që t'ju mbajmë ison? Më vjen keq, z. Kryetar, se ju i pari po i shkelni normat kryesore të Statutit.

Kryetari : Atë fjalë e merrni prapë!

Kr. Floqi : Jo vetëm s'e marr prapë, po edhe e përsërit, se ju do bëhi shkaktar sot të përfundojë arbitrarisht një punë që duhet të përfundojë konsitucionarisht.

Kryetari : Ju mar fjalën. Flisni jashtë themës.

Kr. Floqi : (i egërsuar mjaft) Ju më merni fjalën, me ç'të drejtë? Flas jashtë themës unë, apo ju s'jini në themë? Gjer sa jam në rregull as njeri s'munt të ma marrë fjalën dhe do të flas gjer nesër në mëngjes e ju jini i detyruar të më dëgjoni se flas si deputet konstitucionar në bazë të konstitucionit t'onë, përpara të cilit ju edhe kush do tjetër senator, ose deputet duhet të unjë kryet!

F. Alizoti : Është i lirë të flasë oratori, z. Kryetar, s'ka të drejtë kush t'ja ndalojë fjalën.

Kr. Floqi : Zotërinj senatorë e deputetë, z. Kryetar urdhroj e tha, në qoftë se dëgjova mirë, se "mbi ndryshimin e Regjimit qënkemi d'akord të gjithë, themën po e ditkemi dhe s'duhet ta zgjatim më, po ta vemë shpejt në votë"! Ju pyes pra, në cilin Parllament të botës janë bërë këto? A ka ngjarë ndo një herë për një çështje me kaqe rëndësi, si kjo e sotmja të kini biseduar ashtu fluturimthi që jashtë e të vijni këtu e të thoni se jemi d'akord të gjithë e shpejt-shpejt t'a vini në votë? Kur biseduat e ku biseduat e kur i dhatë funt? Si ju e ditki të gjithë e unë jo, kurse dita e bisedimit ishte caktuar sot? Janë veprime parllamentare këto që z. kryetar s'na lë as të flasim të paktën?

[1] perrì = Figurë e besimeve popullore që përfytyrohej si një vajzë shumë e bukur; hyrìj. (H. K.)

Në atë ças më vjen një biletë në dorë nga ana e deputetit Hiqmet Delvinës, i cili më lutet të mos e zgjat fjalënmë se çështja ka marrë funt. Unë e këndova dhe vazhdova fjalën :

Kr. Floqi : Një nga të ndershmit kolegë më lutet të mos e zgjat fjalën, se çështja paska marrë funt! Më vjen shumë keq, se çështja as që ka nisur të bisedohet! Unë protestonj në mënyrën më kategorike kundra këtyre sabotazhevet edhe në qoftë se më bëhet edhe ndo një vërejtje tjetër, ju siguronj se do marr kapellën e do ikinj, se s'paskam vent këtu!

Zërra : Folë, folë....

Zërra të tjera : Mjaft, mjaft (Poterë e madhe, këmbë-trokitje!)

Kr. Floqi : Në qoftë se s'flas drejt, kini të drejtë të më disaprovoni, por në qoftë se them të vërtetën pse përpiqni këmbët si kalamaj?

Eshref Frashëri : Kur e duam ne të gjithë ç'ka zoti Floqi që kundrështon?

Kr. Floqi : Kundrështon zotrote në mendimet e para, që ishe një nga më të fortët kundrështarë të ndryshimit të regjimit, pra s'jam un' ajy që kundrështonj po zotrote, që s'e mbajte fjalën!

E. Frashëri : Ësht' hesapi jem, nuk do më shtërngoni ju t'ju çfaq arësyjen!

Kr. Floqi : Ju shtërngon detyra, zotni e jo unë; ju shtërngon populli, Atdheu, që ju kanë ngarkuar këtë përgjegjësi e jo unë! Duhet ta dijni të gjithë, se nuk e kemi këtë të drejtë speciale, që kërkojmë arbitrarisht t'a përdorim sot! Populli e ka çfaqur vetë Statutin t'onë Themeltar se në ç'mënyrë munt t'a ndryshojmë atë Statut. Përpara se të vijmë këtu duhet të pyesnim popullin e të mos ja grabitnim këtë të drejtë konsitucionare.

H. Vrijoni : Qysh t'a pyesnim?

Kr. Floqi : Qysh t'a pyesim? Më vjen keq që s'e paski kënduar Statutin, e ahere duhet t'jua e them unë. Në raste të këtillë, zotni Deputet i Beratit, sovrani shpërndan Parllamentin, urdhron zgjedhjen e një Asambleje syntaktike, ose mbikqyrëse të Statutit, mblidhet Asambleja, mbaron punën e saja, shpërndahet, zgjidhet Parllamenti i ri e ahere vijon në rregull punët. Ç' bëmë në faqe këtyre? Me ç'të drejtë mblidhen sot të dy Dhomat të çfaqin mendimin rreth Statutit e ndryshimit të Regjimit? Supozoni, zotërinj se Statuti Themeltar është një lis i math, pra, ja se do të krasitim disa degë të lisit dhe lisin do të lemë prapë aty ku është, ja se do t'a shkurtojmë krejt lisin dhe në vent të tij do të mbjellim një shelk tjetër, pishë, plep, bung[1], ah, e ku di unë. Ajo ngjet edhe këtu me ne, zotërinj. Në qoftë se dëshirojmë të përmirësojmë lisin, me fjalë të tjera, në qoftë se duam të sjellim përmirësime në Statutin t'onë, dyke ndruar, ose ndryshuar disa nene që s'na pëlqejnë neve, ahere duhet ta vendosim këtë me 2/3 e votave, si e lypin dispozitat përkatëse të Statutit t'onë, dyke formuar një komisjon për redaktimin e neneve që do ndryshohen e kështu, raportin e tyre do t'a votojmë e do t'ja shtojmë Statutit, pa e suprimuar, ashtu si kërkoni të bëni ju. Tani mbetet pikpamja tjetër: Në qoftë se duam t'a shkurtojmë, ose ta zhbijmë krejt lisin, ahere ne një gjë kemi në dorë, t'a çfaqim, do me thënë, këtë dëshirë e të shpërndahemi, për t'i lënë vent Assamblesë Konstituente që do zgjidhet nga populli, që ajo t'i japë funt çështjes së Regjimit, e m'andej sovrani ka të drejtë të provokojë zgjedhje të reja parllamentare edhe Parllamenti i ri do t'a verë këtë në zbatim.

Kështu bëhen këto punë, zotërinj senatorë e deputetë, në qoftë se duam të vepërojmë brenda caqeve konstitucionale, ose kushtatore, si thoni ju, e jo malokçe si e shoh unë, e si na ngut Kryetari ynë të bëjmë. Kush nuk e di mënyrën duhet të pyes më parë që të mos bjerë jashtë e që të mos bëhet qesharak!

Tani ne pse u mblodhmë këtu? Që të krasitim disa degë të lisit e t'a lemë lisin prapë në vent? Apo t'a shkurtojmë lisin nga rrënjët? Si po e shoh unë e si tha z. Kryetari, këtu ngjet pikpamja e dytë dhe ju të gjithë, veç mejet, qënkerki mbetur d'akord ta zhgulni lisin nga rrënjët, po t'a dijni mirë se jemi përgjegjës përpara popullit, përpara historisë s'onë për këtë

[1] Bung = një farë lisi, përnar, çinar i vogël (K. F.)

“grusht Shteti” që kërkoni të shkaktoni! E mira do t’ishte, mbassi paski këtë qëllim, të pakët të vendosni ç’kini për të vendosur, të shpërndaheni e t’ja lijni vëndin Assamblesë të dalë prej gjirit të popullit e të mveshur me atë detyrë, që ajo të vendosë ndryshimin e Statutit e të Regjimit se ju vetë, ne të gjithë dua të them, s’e kemi këtë të drejtë.

Zotërinj senatorë e deputetë!

Me qenë se vendimi i juaj mbi këtë çfaqje nuk mund të kryhet, përpara se të jetë biseduar çështja e të jenë shkëmbyer mendimet e përpara se të jetë justifikuar shkaku i vepërimit t’uaj, prandaj është nevoja dhe proponoj të çfaqen mendime pro edhe kundra dhe mbassi të marrin funt këto, të vendoset nevoja e ndryshimit të Statutit e të Regjimit, për arsyet që do çfaqen. I lutem z. Kryetar ti japë fjalën kujt që dëshiron të flasë mbi themën.

Zërra : Pranohet, pranohet.

Kryetari : Mbi sa proponoj z. deputet i Korçës Kristo Floqi, kush prej z. z. t’uaj kërkon fjalën? (H. Delvina jep shenjën se kërkon të flasë).

H. Delvina : Z. Kryetar, më vjen keq se ngjanë disa sqena këtu në Parllament, po prapë vinj t’a falenderonj kolegun e dashur z. Floqi, që na dha gjith’ ato sqarime e shembuj të bazuar mbi llogjikën, prej të cilavet u ndritshua mjaft kjo Dhomë. Nga ana ime propononj të vendoset prej të dy dhomave nevoja e ndryshimit të Statutit t’onë themeltar e te Regjimit të Shtetit, për arsye se populli ynë gjer sot ka përparuar mjaft dhe këtë përparim ja detyron Sh. tij Kryetarit të Republikës Ahmet Zogut, i cili, me zgjuarsin’ e tij e me vullnetin e çeliktë që ka, e udhëhoqi kombin gjer në këtë gradë përparimi. Pra ajy vullnet e ajo zgjuarsi për mua duhet të vazhdojnë e jo të kufizohen, sepse nesër pasnesër kur ti mbarojë afati Kryetarit të Republikës e kur të thirret populli të zgjedhë Kryetarin e ri, munt ti mbushet mendja të zgjedhë një tjetër e jo Ahmet Zogun, që për mua do t’ishte një fatkeqsi t’ja zinte vendin tjetër kush, se nuk kujtonj të gjejmë një sovran më të zgjuar e më të zotin se atë, që sot qëndron në kryen e Shtetit. Prandaj po thom, për mua ky vullnet, ky person duhet të vazhdojë përgjithnjë, trashëgimisht, bres pas brezi në krye të kësaj detyre të naltë, dhe kjo është arësyeja që më shtyn të kërkonj ndryshimin e regjimit t’onë republikan, me atë monarqik, me një mbret në krye, i cili të jetë “Mbreti i Shqiptarëvet” sovrani ynë i përhershëm! Më kuptuat.

Fikri Russi : Z. Kryetar, edhe unë bashkohem me mendmin e porsafolësit.

J. Hurshidi. Z. Hiqmet Delvina na e paraqiti çështjen si duhet edhe me të vërtetë, ajo që tha, është një arsyje e madhe e bindëse që e adoptojmë të gjithë.

K. Mjeda : Edhe vetë jam d’akord me parafolësit. Mjaft na shërbeu Republika, populli ka nevojë për një mbret.

Kryetari : Ka njeri tjetër fjalën?

Zërra : Jemi d’akord të gjithë.

Kryetari : Për se jeni d’akord?

Zërra : Për ndryshimin e Regjimit.

Kryetari : Në Regjim monarqik?

Zërra : Po, poooooooo. . .

Kryetari : Zotni Floqi ka fjalën.

Kr. Floqi : Z. deputet i Gjirokastrës Hiqmet Delvina parashtroj arësyen për ndryshimin e Regjimit t’onë në atë Monarqik, sa do që ajy duhet të çfaqte mendimin vetëm për sa i përket ndryshimit radikal të Statutit t’onë, se çfaqja e mendimit për Monarqi e për Mbret i përket, si thashë edhe më parë Assmblesë konstituente. Me gjith’ atë, arsyetimet e z. Delvina mua s’më bindnë aspak, as që do më bindin kurrë! Po ju a them këtu përpara se nuk jam një patë e Kampidolit[1] që u trëmba se pse Galët u ngjitnë me shkalla gjer në majë të Kampidolit për të msyrë në befasi Romakët. Në u trempnë patat e tjera, unë s’u tremba, as që trembem.

Dikush : Pse, pata të Kapitolit jemi ne?

[1] Campidoglio = gjithmonë ka qenë dhe është Bashkia e Romës (Itali). Mbi bedenat e saj ka thuajse gjithmonë zogj të bardhë të mëdhenj që K. Floqi i quan pata (H. K.)

Kr. Floqi : Mos e merrni për ofezë, zotërinj, se edhe vetë e konsiderova vehten t'ime si patë, po dua të them se janë pata që tremben, po edhe pata që s'kanë frikë kurrë! Në qoftë se ky mendim që po çfaqni këtu është edhe mendimi i popullit mbarrë, unë heq dorë, se e di se me një lule s'çel Pranvera. Po në qoftë se këtë mendimin t'uaj nuk e pranon popullit, ahere përgjegjësija ju mbetet juve. Në daltë për mirë do t'ju besonjë populli, po në qoftë se del keq, ahere po ju them: Rrujuni nga mallkimi i popullit, se mallkimi i tij vete gjer në veshin e Perëndisë! Vox populi, Vox Dei!

Tani do çfaq edhe unë mendimin t'em, jo vetëm si deputet i lirë e i pamvarur, por edhe si patriot i vërtetë.

Zotërinj, është e vërtetë që kemi kaluar një jetë katër-vjetshare nënë këtë regjim të mirë e të qetë republikan, ku kemi ngjeruar gjithë pemët e nje lirije e vetëveprimi të vërtetë. Dhe këto, jam d'akord edhe unë me Z. Hiqmet Delvina, ja detyrojmë zgjuarsisë dhe krahut të fortë të Kryetarit të Republikës (duartrokitje). Nuk dyshonj se kjo zgjujtësi e ky vullnet do vazhdojnë gjer sa ky të jetë gjall. E njoh fort bukur edhe fare së afërmi Ahmet Zogun, se kam bashkëpunuar shpeshherë me atë. Nuk e fsheh se jam edhe mirënjohtës përpara atij, prandaj shumë kush prej jush kishte me u çuditë si kuxonj unë të flas kështu përpara një bamirësi?

Zotërinj, mos u çuditni aspak, sepse flas në interesin vital e të math të Shtetit e të popullit. Kur ne të mos gëzojmë lirin' e fjalës e të trembemi nga njëri e nga tjetri, e të kqyrim miqësira, favore e interesa personale, ç'do të thotë populli , ajy popull që na zgjodhi përfaqësuesit e tij e na pajoj e na mveshi me gjithë besimin e tij të plotë?

Pra, dyke kqyrur vetëm e vetëm atë interesë e jo tjetër personale vinj e ju them këtu se për ne nuk aliverdis në asnjë mënyrë të kërkojmë ndryshimin e Statutit dhe ndrimin e Regjimit Republikan në atë Monarqik dhe arsyet janë këta:

I. Populli nuk është mësuar prej natyrës së tij të ketë një Mbret mbi kryet që nesër pasnesër po të dalë nga vija e të mos punojë pas dëshirave të tija të mos ketë si t'a zhgulë qafet, përveç se me revolucjon e me gjakderdhje, që të mos them me vëllavrasje. Këjo u pa edhe në kohën e Princ Wiedit me rebelët e Shijakut, që u përhapnë në gjithë Shqipërinë për dëm të interesave publike e të popullit veçanërisht. Këjo le të jetë një mësim për ne që të mos e përsëritim.

II. Sot kemi një Kryetar Republike, një njeri simpël e popullor, pa etiqeta e pa ekipazhe, një njeri që munt të shkonjë ç'do kush e të ankohet për një padrejtësi nga an' e autoriteteve, kurse një Mbret nuk merret me kësij vogëlsinash dhe as që pranon kësij ankimesh sepse ka organet e tij dhe është shumë zor e shumë keq për popullin e ngratë kur takon që bije ngushtë. Dëshpërimet shtohen, padrejtësitë vazhdojnë, anturazhi i oborit mbretnor nuk e lejojnë popullin t'u afrohet dyerve të pallatit dhe këto janë kurdoherë mbi kurris të popullit e për fatkeqësinë e mjerimin e tij!

III. Me një Kryetar Republike në një Shtet Republikan shpenzimet janë të thjeshta e të pakta, kurse me një Mbret shpenzimet janë kolosale, obori i tij, adjutantët e tij, suita e tij, salltanetet e tij dhe shkëlqimet e nevojat e tjera duan shpenzime të mbëdha e të rënda, e sot populli jonë, si fukara, nuk është në gjëndje t'i mbartë e ti durojë këto.

Këto pikërisht e shumë të tjera më detyrojnë të çfaqem kontra mejtimit t'uaj. Këtë që ju parashtrova sot ja kam thënë tjetër herë edhe Sh. tij Kryetarit të Republikës, kur ka dashur të marrë mejtimin t'em, këto po ju them edhe juve sot. Mejtohuni mirë dhe vini gishtin në zemër. Tjetër s'ju them

Kryetari : Çështja u bisedua, zotërinj, po e ve në votë: Kush është anëtar i ndryshimit radikal të Statutit të ngrehë dorën.

H. Myftiu : Edhe për Regjimin, z. Kryetar.

Kryetari : Ajo është punë e Asamblesë si na e shpjegoj edhe z. Floqi dhe si e gjenja edhe unë të arsyeshme.

Votohet unanimisht pranimi i nevojës për ndryshimin e Statutit, përveç meje, i cili votova kundra.

Të nesërmen me dekret presidencial të Kryetarit të Republikës Parllamenti shpërndaheshe, me gjith' se nuk kishte mbaruar akoma sesjoni katërvjetshar.

A. Zogu, atë natë që u shpërnda Parllamenti më thiri në pallat e, përpara se të më zerë në gojë ndo një tjetër më shtërngoj dorën për kurazhin civil që pata e që e çfaqa publikisht. E më tha : Njerës si z. juaj duhet të çmohen shumë; duhet të jenë në krye të administratës Shtetnore, në pozitat më të nalta të Shtetit, se e meritojnë! Edhe shtoji: jo vetëm s'ju hidhërohem, z. Floqi, për ç'ka foltë në Parllament, po për kundrazi ju çmonj tepër e do t'ju kem mê mik, se sa ju kam patur, se ju nderoni Shtetin e Kombin. Këto ditt do të nënëshkruanj dekretin e zgjedhjes së Assmblessë Konsituente, e cila, si të mbaronjë detyrën e saj do mvishet me detyrat e Parllamentit. Në zgjedhjet e arthme dëshironj të vesh kandidaturën tënde në Korçë, edhe Qeverija ime dot'ju përkrahë me gjith fuqi.

E falenderova për këtë A. Zogun, por i thashë e ju luta të mos marrë mundimin të më proponojë si assamblist, se unë e kisha çfaqur një herë mendimin se jam kundra Regjimit Monarqik, e s'munt të bëhesha mësallë me dy palë faqe! A. Zogu insistoj, po unë prapë ju luta se nuk e pranonj atë detyrë edhe si kur akoma të më zgjidhte populli. – Si të doni, më tha, po mua më vjen keq të mos kem një njeri si ju në Parllamentin e ri. – E falenderova edhe një herë e më s'e zgjatmë fjalën.

Fjalimi im i fundit në Parllament kishte bërë një bujë të madhe. Për mbi 60 letra kam marrë prej shumë patriotëve të shënuar brenda e jashtë Shqipërisë, të cilët më falenderonin për atë gjest e më inkurajonin për së tepri.

## XXII

Në zgjedhjet e reja të assamblistëve unë s'mora pjesë edhe natyrisht nuk u zgjodha. Më 1 të Shtatorit Assambleja Konstituente u mbloth në Tiranë e mbassi ndryshoj Statutin prokllamoj Ahmet Zogun si "Mbret të Shqiptarëve" me titullin Zogu i I.

Kur vajta e e urova Zogun si Mbret ajy më priti me një fisnikëri të jashtzakonshme. Pas ca ditësh më thiri prapë në pallat e midis të tjerave më proponoj të mar pjesë në kabinetin e ri që do formoheshe nënë Koço Kottën, baçanakun bukurosh t'emin e më tha të marr njërën nga të dy ministritë, ose atë të Drejtësisë, ose të Financavet. Un' u mejtova pak, e dyke qenë se prej kohësh nuk flisnim me Koço Kottën për disa arsye familjare, po edhe nga ana tjetër s'munt të pranonja për kryetar një inferiorin t'em, një çirakun t'em, i thashë Mbretit se nuk lejonte Statuti të ishin pjestarë të kabinetit dy njerës të afërmë në gradën e II afiniteti. Ajy më tha se ajo s'na prish punë, se e plotëson ajy me një dekret të posaçëm. Ahere, si e pashë, se më shtërngoj shumë, i thashë: Madhëri, edhe sikur të mos na ndalonte gjinija, prapë se prapë nuk do t'a pranoja, e para, se unë s'flas me gojë me Kottën për shkak se është sjellë shumë keq me gruan e tij, që e kam motër; e dyta, se nuk pranonj kurrë një inferiorin t'em, një çirakun tem, që e kam pasur nënë urdhrin t'em kaqe vjet, që jam sakrifikuar për atë e që ka qenë kaqe pa-mirënjohtës faqe meje e që është kaqe injorant ajy të figurojë si Kryeministër, si superiori jem. Po edhe sikur të ma kishit ngarkuar mua formimin e Kabinetit, unë nuk do ta kisha pranuar në kabinetin t'em, se nuk e meriton atë pozitë.

E pashë se nuk i ardhi aspak mirë, se ajy ishte lidhur me mishe me shpirt më Kottën, se e kish organin e tij e se me atë e me disa shokët e tij munt të kryej gjith qëllimet e tij, në të cilat mua më kish kundërshtar.

Si të doni, më tha, unë nuk insistonj.

Kështu unë ju shtrova edhe më mirë profesjonit t'em të avokaturës dhe shkonja mirë e isha i kënaqur, dyke vendosur të mos përzjehesha më në politikë, ashtu si nuk u përzjeva.

Vjetët 1929, 1930 kaluan pa ndo një insident. Mot e për mot shkonja fasmiljarisht për verim herë në Napoli, herë në Wienë. Në vitin 1931, pas 25 vjet largimi nga Greqija shkuam me gjithë gruan atje për të parë miqt e far' e fisin t'onë. Vamë edhe në Lutra të Korinthit, ku ndejtim një muaj për banja.

V. O. Ky paragrafi i fundit është i kufizuar me dy vija paralele ngjyrë blu brenda të cilave është vendosur shenja X si shenjë shuarje, por në të vërtetë shkrimi është i qartë dhe lexohet shumë mirë. Nuk e di se kush e ka bërë këtë kufizim, vetë Kristo Floqi apo ndonjë dorë tjetër H. K.

Në vitin 1929 Statuti i ri monarqik kishte parashëkuar krijimin e dy instituteve të nalta shtetnore. Këta ishin : "Këshilli i Shtetit" edhe "Këshilli i Kontrolluës".

Mbreti Zog dëshironte të formojë që të dy këta institute dhe piksëpari filloj nga Këshilli i Shtetit, dhe me qenë se i mbet si peroni[1] pse s'pranova të zgjidhem asamblist e m'andej deputet në zgjedhjet e reja, si edhe pse nuk i pranova një nga ministerat që më ofroj, atë të Drejtësisë, ose të Financavet, ajy s'kishte qejf të më largonte nga rredhi i tij. Prandaj një ditë me thiri me urgjencë në pallat e më tha : Z. Floqi, unë po formoj sot Këshillin e Shtetit prej 10 burrash nga më të zgjedhurit e më intelektualët e Shtetit. Në krye të këtyre dëshironj të jini ju si Kryetar i atij instituti me një rrogë mujore prej 800 fr. arit. Pra të thira të të lajmëronj edhe mbesonj këtë radhë të mos ma prishësh qejfin si herët e para. Si u mejtova pak ju përgjigja : "Madhëri, ju falenderonj nga zembra për këtë ofiq, edhe me gjithë se profesioni jem më siguron një rrogë më tepër se dyfijshi nga rroga e Kryetarit të Këshillit të Shtetit, po për hatrin t'uaj po e sakrifikonj profesjonin t'em e po e pranonj, veç se më lejoni nj'a 2 javë sa të lajmëronj klientët e mij e të ujdis çështjet e zyrës e relacjonet e mij me tribunalet.

-Falem nderit, më tha, e më përhiroj, dyke më shtërnguar dorën e dyke më porositur të bënj sa më parë, sepse dekreti më komunikohet brenda javës.

E pyeta m'andej cilët janë shokët e tjerë e mi numuroj, ose më mirë më dha listën ku pashë këto embra : Këshilli i Shtetit :

Kryetar z. Kristo Floqi

Anëtar z. z. Mehdi Frashëri, Salih Torra, Shefqet Frashëri. Dr. Martin Ivanaj, Ajet Libohova, Dr. Demir Villa, Faik Dibra, K. Çekrezi, Elmas Konomi.

Me një herë angazhova një prej avokatëve të Tiranës z. Hamdi Bimbashin të qëndrojë në zyrën t'ime me detyrë që të ndjekë e të përkrahë gjithë davat' e mija të mvarura pa një shpërblim edhe sa davara që t'i sillnja unë të reja, ose që do të merte ajy do ti ndahnim në mes, gjithashtu shpenzimet e qiran' e zyrës e kishim se bashku. Këtë e bëra që të mos e mbyllnja zyrën, se ishte gjynah gjith' ajo klientellë e madhe e e zgjedhur të shkonte për dhjamë qeni. Tabellën e jashtme mbi embrin t'em s'e lojta aspak. Kështu, sido që të vinte puna nuk e humbisnja bicen[2] dhe sofrën e kisha të shtruar.

Po ç'na ngjau? Më vjen një dit dekreti, ku unë isha emëruar jo kryetar i K. të Shtetit, si ma premtoj goja e Mbretit, po vetëm si anëtar.

Sekretarit të tij të veçantë Mustafa Currit, që ma solli dekretin, ja ktheva prapë me inat e i thashë se nuk e pranonj!Aman, vëllako, më tha Curri i shkretë, mos e bëj këtë se do hidhërohet fort Mbreti e nuk bën për ty. Po të duash, eja të hipim bashkë në automobil që po pret te dera (se ishim në shtëpi t'ime) merr edhe dekretin me vehte, unë të fut brenda dhe ahere ja thuaj gojazi ç'i ke për të thënë se kështu më venë bela edhe mua të ngratin.

Ashtu bëmë. Hipmë në veturë bashkë me M. Currin e u drejtuam në pallat, ku pas 5 minutash hyra në sallën e fronit.

[1] peron = gozhdë (H. K.)

[2] bice = Vend ku ngulet një njeri për të punuar a për të ndenjur për një kohë, të gjatë; qoshe e rehatshme (H. K.)

Mbreti Zog, posa më pa, s'priti t'i ankohem unë – se e mori vesh me një herë kur pa se e kisha dekretin në dorë – po më rëmbeu për krahu, më solli afër fronit, më dha një cigare, të cilën m'a ndezi vet' ajy e filloj : Zotni Floqi, e kuptonj se ju ka ardhur rëndë se nuk ju emërova kryetar, si ju pata thënë e si e patë edhe vetë në listë, shkaku ish se na u zembrua Mehdi beu Frashëri pse e vumë anëtar simpël. Kështu u shtërngova të thres këtu Kryeministrin dhe Kryetarin e Parllamentit, se, si e dijni ata të dy ju proponojnë. Pra, këta proponuan edhe Mehdi bejnë si kryetar, në mënyrë që u bëtë dy kryetarë e duhej të mbeteshe vetëm një. Atëhere hothmë lloto dhe llotua i takoj Mehdi beut. Po me gjithë atë zotrote do marësh rrogën e Kryetarit 800 franga, me gjithë që je anëtar.

Un' i thashë se nuk munt të qëndronj si anëtar në Kësh. e Shtetit, as që munt të pranoj rrogën e Kryetarit në dëm të Arkës së Shtetit, po e mira do t' ishte si kur të më shkarkoni nga kjo detyrë të pa dëshiruar prej mejet.

Ju lutem shumë, më tha Zogu, mos ma bëj atë të keqe, se Këshilli i Shtetit pa juve nuk do vlente gjë. Do t'a pranosh për hatër t'em, qoftë edhe me kondita. Për sh. munt t'ju thres për së shpejti ministër, ose kryeministër, ose munt ta dërgojmë Mehdi bejnë në Ligien e Kombeve në Genevë dhe zotrote emërohesh me një herë si Kryetar i K. të Shtetit. Po ju jap fjalën e nderit se brenda 6 muajve qysh me ditën e sotme do bëhet ja njëra, ja tjetra. Tani për tani do t'a pranoni vetëm për 6 muaj këtë ofiq. Mos ma çartis qejfin.

Me gjithë se isha e sigurt se po më gënjente, siç më gënjeu kaqe herë, po dyke parë se s'munt të bënja ndryshe, u shtërngova t'a pranoj. Ahere i thashë për herën e fundit, se dua vetëm një privilegje. – Urdhro, më tha, jam gati për ç'do që të doni. Dua, i thashë, të mos më bëhet verejtje për zyrën avokatore që do punojë në embër t'im me një avokat tjetër, as të më hiqet verejtja se tabella e zyrës avokatore, që ndodhet mbi mbi derën e zyrës, do mos hiqet s'andejmi. Pun' e mbaruar mu përgjeq. A doni gjë tjetër? Jo, i thashë dhe kështu u shpërndamë miqësisht.

Nuk kaluan dy muaj edhe Mehdi Frashëri u emërua si ministër i Ekonomisë Kombëtare. Unë qëndrova me dekret si zëvëndës kryetar i Këshillit të Shtetit.

Dy ditt, pasi u emërua Mehdi beu shkova në pallat, pas një audience që kërkova e i thashë Mbretit : Ja, Madhëri, ardhi koha që të dejoni të ma sillni në vent dëshirën t'ime, si më kini premtuar. Prandaj u çudita kur mu komunikua sot dekreti i M. s'uaj që emërohem si zëvëndëskryetar. Si vete këjo? Edhe Zogu mu përgjeq me një buzëqeshje : Kini plotësisht të drejtë dhe unë e mbanj fjalën që ju kam dhënë. Kini pak durim gjer sa të dalë dekreti i juaj definitif si Kryetar i kësh. të Shtetit.

Me gjithë që s'e mbesova u largova i kënaqur, po kur pashë se ditët po kalonin dhe dekreti jem s'po delte akoma, një ditë kërkova audiencë e i vajta në pallat Mbretit. Posa më pa, nënqeshi. Mos u bëj merak, më tha, se kam patur shumë punë, por këtë javë pa fjalë e firmonj dekretin, passi të më dërgojnë propozimin t'uaj si Kryetar edhe Kryeministri edhe Kryetari i Parllamentit, të cilët janë lajmëruar për këtë çështje.

Me gjithë që isha e sigurt se më gënjeu edhe këtë radhë, prapë s'fola gjë, po u largova.

Mjerisht shkoj një javë, dy, tri po dekreti as që dukeshe gjëkundi! Këjo më dëshpëroj krejt dhe pa humbur kohë redaktova dorëheqjen t'ime, për shkak se kishin kaluar të 6 muajt, sipas kushtit që kishim dhe një e një shkova në pallat. Mbreti më priti, si nga hera, me një buzëqeshje, e filloj të më sheshë pralla e të më gënjejë si më parë. Unë në vënt të ç'do përgjigjes tjetër nxora nga çanta dorëheqjen t'ime nga Këshilli i Shtetit e ja dorëzova. - Ç' është këjo? më tha – Është dorëheqja ime, madhëri, prej K. të Shtetit e ju lutem të ma pranoni! – Ajo gjë s'bëhet kurrë më tha, pak i zembruar. S'munt të pranonj dorëheqjen e një nëpunësi të naltë e të denjë si z. t'uaj; e ma ktheu prapë lutjen e dorëheqjes, dyke më parë me të mirë e dyke më thënë tekstualisht këto fjalë : " Ju jap fjalën mbretnore e ju betohem për nderin t'im e për kryet e motrave të mija, se brenda një javet do të jeni sigurisht i emëruar Kryetar i K. të Shtetit. Kini pak durim e mos bëni kështu! – Gjer kur ky durim, Madhëri?

Kam 3 muaj e sa që po pres, e mbassi e shoh se munt të kini ndo një farë arësyeje që s'më emëroni, më mirë të tërhiqem se sa t'ju bezdis kështu!

-Nuk ju mjafton fjala ime e nderit e betimet e tjerë? – Ç'ka i them, po duronj edhe këtë herë.

Mjerisht kaloj edhe java e s'u bë gjë! Kësij gënjeshtari si ky as kisha parë, as kisha dëgjuar tjetër herë! Të më gënjejë kaqe paturpësisht edhe kush një Mbret, që këtë s'e bënte as një hamall? Mbret është ky?

Një ditt të Djelë afër drekës më vjen gjeneral Sereqi, adjutant i Mbretit me veturën e tija në shtëpi t'ime, urgjent. Hyn brenda në shkresoren t'ime e më thotë të fala nga Nalt-madhnija e tij, e mbassi po shkon familjarisht në banjat e Durrsit, m'u lut t'a fal nga an' eMbretit, që s'pati kohë të më dërgojë dekretin, por se do ma dërgojë brenda javës nga banjat. Ç'ka , i thashë Sereqit : Ku prita 3 muaj lé të pres edhe një javë, po prapë kam frikë, i thashë se këjo nuk do bëhet kurrë! Bah, ma pret gjenerali, një Mbret kur t'a jep fjalën ësht' e mundur të mos e mbajë? - Po ma ka dhënë kaqe herë fjalën, i thashë Sereqit, dhe bile më është betuar. – Mos kij merak, thotë Sereqi, quaje se e ke dekretin në gji.

Shkoj edhe java e nuk u bë gjë! Zef Sereqi më ardhë pas ca ditësh në shtëpi e më dha një zarf me 200 napolona nga an' eMbretit. Ç' janë këto? i them Sereqit. – Meri, thotë e veri në kasë e mos e bëj fjalë. - S' mar vesh, i them, pse më dërgon këto të holla Mbreti? Ajy më dërgoj një herë 130 napolona, si peshqesh për shtëpin' e re e ja pranova, po këto për se m'i dërgon? – Ti dërgon thotë si shtesë rroge, mbassi gjer tani e ke marrë rrogën si antar i Këshillit të Shtetit. – S' më duket të jetë ajo, i përgjigjem, po, si duket mi dërgon të më zerë gojën, se e bezdisa shumë shko-ejaket, për dekretin e Kryetarit të K. të Shtetit. Po, si do qoftë unë s'i pranonj, i thashë Sereqit; ja se do më dërgoni dekretin, ja se hoqa dorë nga Këshilli i Shtetit edhe sikur të mos më pranohet dorëheqja. Sereqi insistoj nj'a 2 herë, po si e pa se nuk i pranonja i mori prapë.

Pas nj'a 3 ditt më gjen rrugës një njeri i pallatit e më tha më nj' anë: S'bëre mirë që ja refuzove ato të holla Nalt-madhërisë. Ajy u zembërua mjaft, aqe sa më vjen të besonj e të të them, se, kështu si u solle as dekretin mos e prit! S'prish punë, i thashë, për mua mjafton se u rrejta pas një sovrani. Kurrë s'do t'a kisha mejtuar se një Mbret mundet t'a hajë fjalën që jep! S' ka gjë, s'ka gjë i them shëndoshë qoftë.

Që ditën që më solli gjeneral Sereqi ato 200 napolonat kaluan 2 javë akoma edhe dekreti s'po dukeshe gjëkundi. Un' e mblodha mëndjen, ja dërgova Mbretit rekomande dorëheqjen e nuk shkova më në zyrën e K. të Shtetit. Kolegët e mij u bënë merak, se mos isha i sëmurë, po në vent të më gjenin në shtëpi, më gjenin në zyrë, dyke u marrë me profesjonin t'em. Këjo vajti në vesh të Qeverisë, po edhe të Mbretit, se një ditë më vjen prapë gjenerall Sereqi në Zyrë e më tha se Naltmadhnisë i ka ardhur shumë keq që nuk shkon në zyrë e të lutet të shkosh, se Ajy do përkujdeset për dekretin e Kryetarit etj. etj. se dorëheqjen s'ma pranon. I thashë Sereqit se u lodha më së prituri e s'jam ndo një kalaman që të tallen me mua! Unë s' vete më në Këshillin e Shtetit edhe ç' është për të bërë lé të bëhet! Sereqi iku i zembruar po këjo s' më prishi punë.

Pas disa ditsh, pa pritur e pa-pandehur më thret në zyrën e tij Kryeministri Panteli Evangjeli. Kur vajta, s'priti as ti zë dorën e ta përshëndet, po më foli me një romûz!

P. Evangjeli : Për ç'arsyje nuk shkoni në kryen e detyrës s'uaj?

Kr. Floqi : Për arsye se nuk dua të shkonj.

P. Evangjeli : Është në dorën tënde të mos shkosh?

Kr. Floqi : Pse? Mos me urdhroni ju?

P. Evangjeli : Të urdhronj edhe fort.

Kr. Floqi : Nga dale, z. Kryeministër. Përpara se të jemi nëpunësit e Shtetit, më duket se jemi Korçarë si unë, si zotrija jote, dhe e njohim mirë njëri tjetrin. Në qoftë se kërkon të të nderonj si Panteli Vangjelin si një patriot veteran si një mik, si një Korçar, më në funt si një

plak që je, këtë e mar vesh; po në qoftë se më flet kështu si një Kryeministër, unë s'të njoh aspak, as të jap kurrë të drejtë të më japësh urdhra, se s'jam shërbëtori yt!

P. Evangjeli : (dyke unjur pak supenë) Po pse nuk shkon në zyrë?

Kr. Floqi : Të thashë, se nuk dua të shkonj. As më urdhron njeri, as më kufizon lirin t'ime personale!

P. Evangjeli : Pse e dhe dorëheqjen nga një pozitë kaqe të lartër?

Kr. Floqi : Se ashtu mu mbush mendja!

P. Evangjeli : Deshe ta shtërngosh me të pahir Naltmadhninë të të emërojë Kryetar të Kësh. të Shtetit?

Kr. Floqi : S'e shtërngoj njeri Mbretin për këtë çështje. Ajy vetë m'a premtoj.

P. Evangjeli : Po munt të ketë ndo një arësyje që nuk të emëron. Ku ta dish ti?

Kr. Floqi : As e di, as më intereson ta di, vetëm këjo më intereson që, kur më jep fjalën një Mbret duhet t'a mbajë.

P. Evangjeli : Ja që s'e mbajti, ç'dolli nga këjo?

Kr. Floqi : Ahere s'meriton të jetë as Mbret, as njeri, se edhe një hamall kur e jep fjalën e mban e nuk gënjen kështu paturpësisht, se ajy më ka gënjyer mua!

P. Evangjeli : (merr zjar). Ç' flet ashtu për Mbretin t'onë, a e di se ku je këtu?

Kr. Floqi : Mos u zembro xhaxha! Të thashë se si Kryeministër as që të njoh as pak. Ne bisedojmë këtu si dy patriotë, si dy Korçarë; në mos të pëlqen, mar kapellën e ikinj.

P. Evangjeli : Fole shumë rëndë për një Mbret.

Kr. Floqi : Për një Mbret po, por jo për një gënjeshtar të klasit të parë. Mos kujto se i kam frikën njeriut, ç'të dalë lé të dalë, më ka plasur shpirtin, xhaxha!

P. Evangjeli : More Kristaq, more djalë, mos bëj kështu se merr vehten më qafë. Mos e tharto me Naltmadhninë; mjaft e ke thartuar gjer tani, dyke i kundrështuar.

Kr. Floqi : Xhaxha, ti e di se e kam patur mik e e desha sinqerisht Zogun, po, qysh ditën që e pashë se e kujtoj mylkun e tij Shqipërinë, ndryshova mendim. E mban mend poteren që u bë në Parllament, kur ajy ëndëronte të prokllamoheshe Mbret, e kur ju tërhoqi me vehte të gjithëvet? Mua s' mundi të më bindë edhe e patë të gjithë se sa i kundrështova. Ju nuk do t'a bënit atë që bëra unë. Është e vërtetë se unë mbeta si oazë në mes të shkretëtirës, po dobarem jam i kënaqur se ndërgjegjen t'ime e kam të pastër. S'ka gjë se mbeta jashtë tempullit. Për këtë do të flasë një ditë historija! Unë s'jam dallkauk!

P. Evangjeli Nuk bën të shtysh punët në ekstrem, duhet edhe të durosh.

Kr. Floqi : Xhaxha, mos më bëj të hap gojën e të ti sërëndit të gjitha me radhë.

P. Evangjeli : S' ke të drejtë. Pse s'pranon të zgjidhesh assamblist bashkë me ne?

Kr. Floqi : Se nuk isha mësallë me dy palë faqe.

P. Evangjeli : Po kur të propozoj ministrinë e Drejtësisë pse s'e pranove?

Kr. Floqi : Me Koço Kottën kryeministër, me një injorant, me çirakun t'em?

P. Evangjeli : Pse s'i more të 200 napolonat që të dërgoj me gjenerall Sereqin?

Kr. Floqi : A!.... E ditërki edhe këtë? Unë kujtova se ishte një gjë e fshehtë e nuk e dinja se paska vënë tellallin! Pse t'i pranonja, për ryshfet? Ose që të më zinte gojën e të mos e besdisnja të më emëronte Kryetar' e Këshillit të Shtetit? Sa pare më bënin të 200 napolonat e tij; ja kam falur; le t'u a japë atyre dallkaukëve që ka pas e që e tamjanisin për dita; unë s'jam mësuar të bënj kësijsh dallaveresh! S'jam çanak lëpirës!

P. Evangjeli : Hé, lé, fund' i fundit, a do vesh në zyrë?

Kr. Floqi : Në zyrën t'ime avokatore po, po në zyrën e Këshillit të Shtetit kurrë!

P. Evangjeli : E vendose me këmbëngulje?

Kr. Floqi : E vendosa dhe s'e kthenj fjalën. Po të më doni, ju lutem të insistoni të më pranohet dorëheqja, se pa atë pranim, s'munt të rimar lejen e avokaturës.

P. Evangjeli : Po të del më mirë si avokat?

Kr. Floqi : Si avokat fitonj dy herë sa është rroga juaj. Unë kam pasur dëm të math, sa kohë isha në Këshillin e Shtetit. Dobarem e kam mëndjen e fjetur.

P. Evangjeli : Sa kohë të bëhen në shërbim?

Kr. Floqi : Bashkë me të 8 vjetët që më llogariten qysh në kohën e Ismail Qemalit, kur isha kryetar i gjyqit më 1913 më bëhen gjithësejt 14 vjet.

P. Evangjeli : Po a e di se me dorëheqjen tënde këto humbasin të gjitha në pikpamjen e pensjonit?

Kr. Floqi : Çudi e madhe! S'bëhet kijameti! Ja kam falur Shtetit edhe përqindjet.

Më s'e zgjatmë më tepër, se u ngrita e shkova. Po Evangjeli duket se ja tha këto edhe Mbretit, po jo të gjitha, edhe si e mora vesh prej Sotir Martinit, Mbreti s'desh aspak të ma pranonte dorëheqjen.

Unë qëndrova në zyrë, po pëlqimi i dorëheqjes nuk më vinte. Kështu, vërtet s'delnja dot përpara gjyqeve, po punën e mbaronja me ortakun t'em avokat edhe rrogën mujore të 600 frangavet vazhdova ta mar 3 muaj me radhë me gjithë që nuk shkelnja në Këshillin e Shtetit.

Më së fundi m'u pranua edhe dorëheqja, pa m'u çfaqur as një përgëzim për shërbimet.

Tani isha i qetë në punën t'ime, as politikë as nemurijete. Nga zyra avokatore isha tepër i kënaqur. Si largova dhe ortakun avokat Hamdi Bimbashin, mbeta vetëm dhe isha mirë.

Mot e për mot shkonja familisht për verim herë në Itali, herë në Austri, herë nëpër bjeshkat e Korçës, në vëndet klimaterike, si në Dardhë, Vithkuq, Floq, Voskopijë.

Vitin 1931, pas 25 vjet largimi, qysh se u largova me kondita të këqija nga Greqija, si nacjonalist, vendosa të vete t'a shoh edhe një herë Greqinë, ku, në Karvasarâ kishim tjetër herë pasuninë t'onë, po mjerisht e humpmë nga duart për borxhet e babajt. Kisha për të parë edhe disa nga fisi t'onë teto e kushrira e nipër në Messollongji.

Për verim atë vit vamë në Lutraq të Korinthit, ku kaluam ndo një muaj shumë mirë me banjat e me dëfrimet e tjera.

Kur ikmë nga Latraqi u drejtuam në Athinë ku ndejmë disa ditë, dyke vizituar muzetë e monumentet kllasike Greke, si Akropolin, Lykaviton, Theseion etj.

Që andej hoqmë në Vollo e në Selanik, ku qëndruam një javë pranë xhaxhallarëve Ballauras të gruas s'ime.

Prej Selanikut me anën e Follorinës u kthyem në Korçë, ku t'anët kishin dalë e po na prisnin në Zvezdë. Ky ish një udhëtim i paharrueshëm për mua.

Vitin 1932 shkuam në banjat e Elbasanit. S'kishim bërë 2 javë kur lajmërohemi telegrafisht se, Marigoja, e motra e gruas s'ime ishte sëmurë keq e po na kërkonte shpejt të na shihte. Me njëherë vrapova e e arrimë gjall dhe pas 4-5 orësh jepte shpirt e ngrata në duart e mija, tepër e mjerë, e Ter[1] nga sytë e fatzezë! E qava me lotë pikëllimi, si një motrën t'ime, e bile më shumë se një motër se e desha e më desh fort e gjora Marigo. Ajo, mbassi kish humbur djalin e vetëm në moshën 25 vjetshare, mbassi humbi të dy çupat e saja, si dy zëmbake, të mira, të zgjuara, të dashura e fort të bukura si engjej, Fereniqin në moshën e 22 vjetve dhe Lirinë, atë engjëll të shkruar në 15- tën Pranverë të saj, mbeti e mjerë dhe më së fundi humbi edhe dritën e syve e nuk shëkonte fare! Në atë gjëndje të mjeruar e përmblodha unë e e mbajta 4 vjet me gjithë shërbimet e duhur gjer sa vdiq e ngrata!

Të nesërmen të vdekjes saj, shkova që me natë në shtëpi të Kryeministrit Panteli Evangjelit e i tregova vdekjen e saj, dyke e lutur të varroseshe me shpenzimet e Shtetit e me bandën muzikore, se i përkiste një patriote të rallë si Marigoja, që kishte bashkëpunuar me ne si një burrë për komitetin t'onë "pro patria" dyke harxhuar më shumë se 1. 000 napolona nga qesja e saj, dyke shkruar në për gazeta e rivista shqiptare, dyke predikuar posht' e lart me një oratori të flaktë dhe fund' i fundit dyke u djegur e u therorizuar për idealin kombëtar e dyke mbetur e varfër, e mjerë ee verbër!

[1] ter = errësuar, terr (H. K.)

P. Evangjeli për çudi mblodhi supet. Ç'munt të bënj unë, më tha? – Si, ç'munt të bësh? i them. Nuk je një Kryeministër? Nuk e njehMarigonë që ke bashkëpunuar me atë e që ke hyr' e dalë qindra herë në shtëpi të saj? Është detyra jote këjo? Është turp e gjynah të mos e varrosë Shteti një patriote të këtillë.

Folë, më tha, me baxhanakun tënt Koço Kottën. Atij i kam qitur sytë, i thom, ajy s'ardhi t'a shohë as kur ishte e sëmurë e lëngonte, s'u afrua as kur dëgjoj se vdiq, me gjithë se Marigoja ishte sakrifikuar për atë pa-mirënjohtës maskara; atij t'i them? Atij katili, pse është Kryetar i Parllamentit? Jo, i them, ate as e shoh dot me sy. Ç' ke për t'a bërë do ta bësh ti. Shko edhe te Mbreti, se edh' ajy e njeh, e do kujdesohet për atë. – Pse nuk shkon vetë te Mbreti? më tha Panteliu. – Po të shkonja unë s'kisha nevojë nga ju, po si e dijni, unë s'e kam mirë me atë. – Ahere tha, Panteliu, duku këtu pas dreke. – Pas dreke jo, i them, se nuk pret koha, po do vinj aty afër drekës, se jam okupuar edhe me veprimet e tjera që nevojiten për të vdekurin. – Ç' ka, më tha, eja në kohën e drekës.

Isha isigurt se diçka do të bëheshe, edhe në orën 12 të mesditës shkova prapë në shtëpi të P. Evangjelit. – Hé, i them, ç'bëtë? – S'u bë gjë, më thotë! Fola edhe me Koço Kottën, po edh' ajy s'e gjen të arsyeshme, thotë, të varroset me shpenzimet e Shtetit! Ahere, në atë dëshpërim e sipër s'mejtova ç'fola; s'i lashë gjë pa thënë Panteliut; unë së fundi mora kapellën e i thashë: Turp, turp i math për ju, për Shtetin e për Mbretin akoma që silli në këtë mënyrë! Inshallah ju a pastë borç kombi kur të vdisni edhe ju me Kottën e mos u kujdesoftë për gjë, se s'e meritoni as ti, as ajy i poshtri e faqe-ziu Koço Kotta! Edhe ika pa e sallutuar!

Atë mbrëma u kthye edhe dhëndri i Marigosë, major Oddo Gobbini, e vendosmë në një kasë të mir' e të stolisur edhe vet' ajy me një automobil e çoj në kimiterin[1] e Zvërnecit afër Nartës së Vlorës, ku e varrosnë të mjerën e fatzezën Marigo!

Në varrtoren e Svernecit, si familja e Marigosë, ashtu edhe familja e s'ëmës saj, s'ime vjehre Lenkës Poçit kanë varrtoren e posaçme të tyre. Aty gjënden të varrosur me radhë ime vjehrë Lenka e Poçit, i bir' i saj profesori Dhimitri Poçi, Marigoja dhe të bijt' e saj Vasillaqi, Fereniqi edhe Lirija. Aty u çlodh e mjera Marigo Pozio!!!.... ....

Gjatë viteve 1933-34 nuk ngjau ndonjë gjë me rëndësi. Në vitin 1935 pa pritur e pa pandehur humbmë kunatën t'ime Angjeliqinë, motrën më të vogël të gruas s'ime dhe të shoqen e Koço Kottës, në një moshë 38 vjeçare!

Do të zgjatem pak mbi vdekjen tragjike të kësaj të mjere, që e desha edhe si motër edhe si çupë sepse kur u martova unë me të motrën e saj ajo ish 15 vjetsh, e kështu u rit me ne si një çupa jonë.

Si e kam treguar edhe tjetër herë, Angjeliqinë bashkë me t'ëmën e saj t'ime vjehrë Lenkën, i kishte marrë në Amerikë i biri e i vëllaj i tyre, im kunat Kristo Poçi, dhe kishin zënë vënt në qytetin e bukur Salt-Lake-City të Shtetit Utah, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pranë Californisë.

Më 1909, kur vajta të parën herë në Amerikë, u drejtova në Salt-Lake-City, ku jetova bashkë me familjen e s'ime vjehre mot-mot.

Kur u nisa s'andejmi për në Shqipëri, im kunat Kristo Poçi më kish porositur t'i gjejmë një burrë Angjiliqisë, e cila aso kohet ish 20 vjetsh.

Unë ardha në Shqipëri e sidomos në Vlorë ku kisha familjen t'ime. Kur u thashë grave, sidomos së mjerës Marigo dhe gruas s'ime qëllimin që i kishte motra Angjeliqija, ato u gëzuan shumë dhe e vumë me një herë çështjen në veprim.

Aso kohet kishte ardhur në Vlorë Koço Kotta, dyke braktisur studimet e tij në Paris për mjekësi. Kishte ardhur pa një pesësh në xhep dhe jetonte në kurrizin e Kllubit të Shqiptarëve të Vlorës.

[1] cimitero = varrezë (H. K.)

K. Kotta na vinte për dita në shtëpi edhe gratë Marigoja me t'ime shoqe, dyke parë shtatin e mustaqet e bukura të zeza të K. Kottës, e vendosnë me një herë t'a bëjnë dhëndër e ti japin Angjeliqinë.

Kur e dëgjova në krye u kundrështova, se un' atë e dinja të martuar me një greke në Athinë, bile edhe baba, se kish një çupë me atë grua, po mbassi gratë insistonin me këmbëngulje e mora përsipër të bënj hetimet e duhur mbi këtë pikë. E dyta se ish rryp daulle pa një pare në xhep, e që rronte si parasit, po gratë mbi këtë më vinin përpara se ish i biri i Nuçit Pjestos (Kottës) dhe i ati ish pasanik etj. etj.

E mora K. Kottën më nj'anë e pa i treguar qëllimin t'em e pyeta mbi çështjen e gruas së tij që kishte me kurorë, si dhe për çupën e tij e më tha se me gruan e tij ka divorcuar me kohë dhe ësht' i lirë, dhe çupën e mbajti e ëma, kështu që ky s'kish as një obligim përpara atyre, shtoj akoma, se edhe gruaja e tij, në bazë të vendimit të divorcit ishte martuar me një italjan në Athinë.

Gratë u kënaqnë shumë nga këto përgjigje të Koço Kottës, që nuk ishin të vërteta si u kuptua më von, edhe më shtërnguan t'i jap funt çështjes sa më parë.

Unë, përpara se të dëgjonja mëndjen e grave, i shkrova t'im kunati në Salt-Lake City, Kristo Poçit, një nga një ç'ngjet edhe ajy më dërgon pa një pa dy 300 dollarë telegrafisht mua, dhe telegrafisht më porosit t'i jap funt çështjes dhe të nisem bashkë me K. Kotten për në Salt-Lake-City.

Unë, asokohet, i installuar në Vlorë, kisha filluar të ushtronj profesjonin e avokaturës dhe nuk dëshironja të vinja edhe një herë në Amerikë, po mbassi ishte një çështje me rëndësi edhe që të mos e dërgonja vetëm K. Kottën, se munt edhe të mos vinte në vënt, i msuar si aventurier, vendosa të shoqëronj edhe vetë gjer atje.

Harxhet ishin kollosale, po si të bënja? Nga ana tjetër mu vardis edhe gruaja, me që ishte vetëm në Vlorë, se pak më parë mëma ime, im vëlla edhe tetua ime Ndinua kishin shkuar në Korçë dhe gruan t'ime bashkë me çupën t'ime motake Teftën, i kishin lënë në Vlorë. Mëma ime 4 muaj mbassi shkoj në Korçë vdiq papandehur.

U mejtova e prapë u mejtova si të bënja, po si e pashë se edhe gruan s'munt ta linja vetëm bashkë me një foshnjë të vogël, kurse në Salt-Lake City kisha edhe t'ime vjehrë e kunatën Agjeliqinë, të cilat e ftonin si mysafire, i dhashë karar t'a mernja edhe gruan e çupkën në Amerikë me kusht që pas 3-4 muajsh të ktheheshim prapë në Vlorë.

Ahere e thirmë K. Kottën në shtëpi, ja propozuam Angjeliqinë edh' ajy e pranoj me gjithë zemër e kështu u nismë që të tre ne, si edhe çupa ime për në Amerikë.

Tani fillon për mua një peripeti, një Odysé që nuk do t'a harronj kurrë, pse ky njeri i keq, jo vetëm më kushtoj mjaft e mu ngjit si rrodhja pas këpucës e nuk më çqitej, po edhe ment më mori më qafë kaqe herë.

U nimë nga Vlora e shkuam për në Triesht. Nga Durrësi muarm ndo 1. 000 cigare të mira të Regi-së turke për rrugës e për të sheshë[1] në Amerikë. Kur na hapnë valixat në doganën e Trieshtës nuk na gjetnë gjë, sepse cigaret i kishim me vehte unë, ime shoqe dhe Kotta. Po Kotta që pinte 3 paqeta ditën, në kuris të tjetrit, s'i duroheshe pa cigare. Aspak s'mejtonte rrezikun. Unë po merresha në doganë me valixat, po kur shoh një rrojtar dogane, që na e sjell K. Kottën në zyrë të drejtorit të Doganës me nj'a 300 e ca cigare, që ja kishin gjetur. . . Medet!. . . Po tani ç'bëhet? Shoh edhe gruan t'ime që e futnë në një odë tjetër e dyke e parë një grua tjetër i kish gjetur nj'a 250 cigare të tjera!.... Zura sikur të justifikohesha, ku mu vërtitnë edhe mua e më gjetnë nja 15 paqeta përsipër, d. m. th. të tjera 300 cigare! Po tani ç'bëhet? Si turpi, si xhezaja[2], si sigaret që do na shkonin kot!

E mblodha vehten e e sigurova drejtorin e Doganës se ne ato cigare i kishim për rrugën, se ishim nj'a 7-8 veta që do t'i pijnim, se nuk do qëndronim në Triesht veç se sa të nxirnim

[1] për të sheshë = për të shitur (H. K.)
[2] çezà = dënim (H. K.)

biletat për në Amerikë, etj. etj. . Mezi e binda. Ahere na dha vetëm 6 paqeta, të tjerat i mbajtnë në Doganë me kushtin që kur të hipnim në vapor të na i dorëzonin atje. Pagova dhe 25 korona austriake taks transiti e mezi u çkëputmë e vamë në hotel! Ky ishte hyneri i parë i Kottës.

Në hotel na u sëmur Kotta. E zunë hethet mallarike, që i kish trashëguar nga Vlora. Përveç që na la pa gjumë atë natë, po na shtërngoj të rijmë 2 dit e munt të rinim edhe të tretën dyke humbur edhe vaporin e dyke ndenjur edhe 15 ditt të tjera gjersa të vinte vapori tjetër. Deh, or hall, deh, se ç'më polli me tersin!

Të 3-en ditën, me që vapori niseshe më 4 mbas dreket, u shpejtuam të vemë në vapor të zemë vendet. Biletat i kishim nxjerë klas II.

Kur hipmë në vaporin transatllantik "Carpathia" të Cunard Line, e kur na examinuan doktorët, K. Kottën na e gjetnë të sëmurë edhe me një herë e nxuar jashtë. Dhashë e mora me kapitanët e vaporit, po ish e pa mundur. Ahere lashë gruan e çupën brenda në vapor, vetë dolla jashtë, vajta e ktheva biletën e Kottës e me qenë se vapori do vinte në Fiume ku do ndalesha një ditë të tërë, i lashë ndo 100 korona austriake Kottës e i thashë të shkonte shpejt në Fiume, ku do mundonja t'a futnja brenda. Kështu ajy u nis për në Fiume e unë u ktheva në vapor, ku më suall edhe cigaret.

Tjetrën ditë në mëngjes ishim në Fiume. E poqa me një herë Kottën e e futa brenda pa e parë njeri. Po nuk kaluan 2 orë e ardhë e e zunë e e qitnë prapë jashtë! M'andej, mbassi u muar vesh se e futa unë, mua më burgosnë në vapor! Po tani? Vaj halli!!....

Kotta mbet jashtë, paratë do ti soseshin unë do vinja pa atë në Amerikë, si do bëhej pra? Për fat nga penxherja e vaporit vezhgëllova K. Kottën, i cili po silleshe i dëshpëruar, dyke shetitur afër molit. E thira shpejt e u afrua nj'a 4-5 metra lark penxheres. I thashë se, për shkak të tij tani ndodhesha i burgosur. E këshillova të vinte nga an' e Paris-Havrë me vapor tjetër. Mbështolla e i lidha mirë në një shami nj'a 30 napolona e ja hodha jashtë në mol ku ajy i mori. I thashë të niset shpejt e të piqeshim në New York.

K. Kotta ndenj në mol gjer sa u ngrysh e pastaj iku të marrë trenin. Unë ndenja 6 orë i burgosur edhe vetëm kur u nis vapori më nxuarn nga burgu, ku, kur u poqmë me gruan e çupkën t'ime ato ishin vrarë së qari nga dëshpërimi, se s'e kishin marrë vesh ç'u bë dhe kujtonin se mos mbetnë vetëm në vapor! Ky ishte hyneri i dytë i tersit K. Kottës!

Si hikmë nga Fiume vamë në Palermo të Siçiljes, që andej pas 4 orësh u nismë e arthmë në Napoli, ku ndejmë një dit të tërë.

Prej Napolit muarm ndo 100 pasagjer. Por, mjerisht 3 ditt passi kishim lënë Napolin, na u çfaq kolera në vapor! Kur vamë në Malaga të Spanjës s'e lanë vaporin as të afrohet. Kaluam Gjibralltarin e duall në Oqeanin Atllantik. Gjer sa vamë në ishujt Portugeze Azores na vdinë 6 të kolerjasur, që i hodhë në det! Dy prej këtyre të mjerët i pashë edhe vetë kur i lëshonin në valët e Oqeanit. Kishim një tallas të math. Valat ngriheshin përpjetë si male!

Në Azores gjithashtu s'e lanë vaporin të afrohet. Gjer sa vamë në New-York na vdiqnë edhe të tjerë 12!

Në New-York na detyruan të bëjmë 5 ditt karantinë. Kur duallm jashtë në Castel-Garden ishim të pocaqisur e të vrarë, si unë, si fëmija, sidomos unë nga sikletet e nga deti isha bërë si një sqelet!

Në Castel-Garden, kur po kalonim gjatë një ure prej vaporit në Vrojtoren Shtetnore, gruan time me foshnjën i lanë të lirë, dyke i drejtuar në një sallë të madhe, ku ishin më tepër se 2. 000 shpirt. Mua më nxuar të sëmurë e më tërhoqnë në një sallon të veçantë, ku do na examinonin doktorët, dhe po të na gjenin vërtet të sëmurë do na kthenin të gjithve nga kishim ardhur!

Hall i math se u ndava nga fëmija e tani s'dinja si do më vejë filli, do më lijnin të lirë, a po do më kthenin prapë?

Ti lemë më nj'anë gruan e çupën, që ato dijnin si bënin pa mua. Mua më futnë në një sallë e më çveshnë cak-lakuriq, si edhe nja 50 të tjerë si mua, prej të cilëvet vetëm 8 veta mbajtnë si të sëmurë e i kthyen prapë, kurse të tjerët i lanë të lirë.

Kur erdhi sëra ime, më shtrinë mbi një trapesë të gjatë prej mermeri. Më examinuan e më panë se isha i shëndoshë e më thanë të mvishem. Po kur zbrita nga tryeza e mermertë më ishte mpirë tepër këmba e djathtë dhe fillonj të çalonj mjaft. Më panë doktorët dhe një prej atyre foli anglisht : To bet, he is lame, take him away. Domethënë, mjerisht qënka i çalë, ktheheni prapë!

Lumërisht unë e dinja anglishten dhe i dëgjova ç'thanë. Më preu në zemër. Me një herë i dhashë fuqi vehtes e u bërtita anglisht : Who is lame misters, I? But I walk all-right lake you, lask-ut! Do me thënë: Kush është i çalë zotërinj, unë? Po unë barris tamam po si ju! Edhe me një herë e durova të dhemburin e mpirjes dhe fillova të barris mirë. Ata u çkulë së qeshuri dhe një prej doktorëve më ndihmoj gjer sa u mvesha e më dha biletën e lirimit.

Shkova në sallën e madhe të pasaxherëve, po tani ku t'a gjenja gruan dhe foshnjën. U vrava së kërkuari nj'a një gjysmë ore, gjer sa mi zuri syri. Vrapova shpejt e i gjeta dyke qarë. Ime shoqe me shpirt në dhëmbë më qortoj pse i lashë vetëm, po si ja qava hallin, s'foli gjë.

I them ku e ke çantën e parevet? Ajo prej turbullimit që pati, ja kishte dhënë një gruaje greke, që bashkë me djalin e saj Nikon do vinin në Lynn, Mass. Çantën, i thom, ç'bëre kështu? Ti na le në mes të rrugës! Ahere me një drithmë më tha : Aman, s'jam ndërment, ja kisha dhënë asaj grekes t'a mbante, dhe ajo tash ka 10 minuta që shkoj e s'e kuptova. Po, po.... (nuk lexohet H. K.) – S'humbas kohë. E mar gruan e foshnjën e zbresim përposh ku ishin peeret d. m. th. limanët e ndryshme nga niseshin vaporët për në skelat e Amerikës. Vëzhgëllonj ku është peeri i Lynn-it, ku shembëlleva atë gruan Greke me të birin; hynj me një herë në vapor e ja rëmbeva çantën e një shallë të s'ime shoqeje. Po kur do delnja nga vapori, ajy kishte zgjidhur litarin e kishte vënë përpara elikën. Sa të mbetesha brenda u hodha me një herë jashtë, pashë se rashë mbi pllakat e portit e u dërmova fort! Edhe këtë ja pata borç tersenesë K. Kottës, se po t'ish edh' ajy në vapor do më ndihmonte e nuk do pësonja këta.

Të lodhur e të këputur kërkuam lejen të rinim nj'a 2 dit në New-York, po s'na lanë. U shtërnguam të niseshim shpejt për në Salt-Lake-City për ku do deshnim 6 ditt e 6 nett rrugë! Ç' kemi vuajtur atë natë, si dhe gjatë udhëtimit të pasosur do t'ja tregonj varrit.

Kur arthmë në Omaha të Nebraskës na u sëmur çupa nga fruthi. Ndejmë një ditë atje po çupa më fort keqsoheshe. Arthmë në Cicago dhe duallm jashtë të marrim pak frymë e të shëkonim për ndo një doktor. Frynte një her' e marrë, sa s'na permetonte të delnim nga stacjoni. U shtërnguam të hyjmë prapë në tren, e të shkojmë përpara. Çupa e gjore kish një hethe 39 e sa gradash. Mezi e çuam të gjallë në Salt-Lake-City, i ramë prapa me doktorë etj. etj. po s'ish e mundur ta shpëtonin. Më së fundi vdiq engjelli i shkruar, ajo çupë aq' e bukur, sa edhe e dashur që na dëshpëroj krejt! Edhe këtë ja pata borç tersit K. Kottës, që po t'a kisha me vehte nuk do më ngjisnin këto. Humba çupën e vetëm për hatër të tij, që e qava me lot e që nuk do t'a harronj kurrë!

S'ishin mjaft këto. Po s'kisha derman nga im kunat pse s'e solla dhe K. Kottën me vehte, po ardha vetëm me fëmijën t'ime! Se të më qante hallin që u sakrifikova për atë maskara, ajy filloj të grindeshe, sa n'a u pre buka e qetsija, aqe sa më vinte të merrnja syt' e këmbët e të hiknja e mos ja shihnja më sytë, po u përmbajta nga hatri i s'ime vjehre e i Angjeliqisë, që na silleshin aqe mirë.

Humbja e Teftës s'ime më kish kushtuar shumë! Isha pa ment në kokë. U mërzita krejt!.... . Po në atë kohë e sipër mar një telegraf nga bukuroshi Kotta prej Castel-Gardenit të New-Yorkut që t'i dërgonj telegrafisht 60 dollarë, ndryshe do ta kthenin prapë nga ardhi! U shtërngova t'ja dërgonj shpejt ato 60 dollarë telegrafisht edhe pas 6 ditsh e solli kokën në Salt-Lake-City, i zi si harap, i palarë, i pandruar kaqe kohë, sa s'njiheshe fare!

Pas një jave, i martuam me Angjeliqinë. Po ajy, si nuk dinte as gjuhën anglishte, e si nuk ish i zoti për asnjë punë, u bë një parasit i keq. Unë bëra si bëra u sheshova në një nga dyqanet që kish im kunat Kr. Poçi, dyqan të vogël që shishnim akullore, çokollata etj.

Më së fundi e bindmë të qëndrojë në një furrë, që e drejtonte Kr. Poçi, por as aty s'ish i zoti të bënte gjë, veç të nxjerrë çyrrekët nga furra me lopatë e të bëjë tava. Kështu u shtërnguam t'a dërgojmë në St. Louis bashkë me të shoqen në ca kushërinj të tij, të cilëvet u pëlciti në kokë e e ushqenin, pa qen' i zoti të qesë ndo një punë!

Se si bëri shkoj në Shqipëri me të shoqen e me t'em kunat Niko Poçin. Atje u orvatnë ca kohë, dhe si i dha e shkreta Marigo navllonin për burrë e grua nj'a 100 napolona, ardhë prapë në Amerikë!

Un' ahere u ndodha në Boston, si drejtor i gazetës kombëtare "Dielli" , ku pa një pa dy më ardhë e mu përplasnë në shtëpi. Tani fillonte një peripeti e keqe për mua se më zunë këndin e s'kisha ç't'ju bënja. I mbajta 6 muaj. Mua më nxuar nga shërbimi i "Diellit" e u shtërngova të vete në Brockton e të bëhem hotelxhi. Po Kotta s'mendoheshe. E mbajta 4-5 muaj edhe atje. Si vajta në New-York e fillova të nxjer gazetën "Zëri i Popullit" më ardhi edhe atje bashkë me të shoqen, ku i mbajta një mot të tërë, me të ngrënë me të pirë e me mvesh-mbathje. Ika prej New-Yorkut e ardha në Triesht në Kongresin Pan-Shqiptar të 1 Marsit 1913, dyke lënë gruan e djalin t'em Pirron në New-York bashkë me K. Kottën me të shoqen. I kisha lënë K. Kottës 100 dollarë, po ato u bënë rrush e kumbulla e ment më lanë pa bukë gruan e djalin. Vajta në Millano e q'andej i dërgova shpejt navllon gruas të vinte me klass II në Napoli bashkë me djalin, ku do ti prisnja e do shkonim në Vlorë. K. Kotta u zembrua pse s'i dërgova edhe atij navllonin të vinin tok me familjen t'ime. Fundi i fundit ime shoqe me djalin ardhë në Shqipëri, po pas një muaji ardhi edhe Kotta me të shoqen e mu përplasnë prapë në shtëpi t'ime, ku i mbajta mjaft kohë. Kisha gjetur me të vërtetë belanë që më polli me këtë parasit të paturpshëm. U shtërngova e me një mijë bela e emërova inspektorin e arësimit në Vlorë, po prapë nuk çkoliste prej meje! Më së fundi, kur ikmë nga Vlora prej rebelëve të Shijakut e vamë në Shkodër, K. Kotta më ndoqi pas. E mbajta edhe 3 vjet në Shkodër, gjer sa e këputi qafën e shkoj si inspektor i arësimit në Berat. Nuk flas më tepër për këtë parasit të keq se më erret mendja. Mjerisht gjithë këto mi shpërbleu me mënyrën më të keqe e më çnjerzore ky vagabond i pashoqtë.

Vijmë tani në vdekjen tragjike të së gjorës Angjeliqi, gruas së tij, që ngjau në Korçë më 1935.

Ky bukurosh, si ardhi me Zogun më 1924 në Tiranë, e si zaptoj gjithë ndërtesën e Metropolisë orthodokse për disa vjet pa paguar as një dyshkë qira, nuk ka dashur të sjellë edhe të shoqen me fëmijën e tij, një çup' e një djalë që kish me gjithë që ju lutmë kaqe herë si unë, si ime shoqe. Ajy desh të ish i lirë, se e kish ujdisur me një daktyllografe çifute. E shoqja s'dinte ç'të bënte në Korçë, por se duronte. E me qenë se i hoqi vërejtjen më në funt ky i poshtër vendosi t'a shdukte që të martoheshe me një tjetër. Fundi i fundit e gjeti rastin. Kish një shërbëtore të poshtër dhe i prokuroj kësaj një hape cyanium që sillte një vdekje fudronjante. Shërbëtorja, një natë kur Angjeliqisë i dhembnin mishrat e dhëmballavet, ja dha atë hapen, gjoja si kur e bleu nga farmacija, të cilën e shkreta Angjeliqi e piu pa ditur gjë, kështu që pas 6-7 orësh dhimbjesh të tmershme, vdiq e shkreta në një agoni të madhe!

Gjithë Korça u tunt nga vdekja e pa pritur e saj, e cila ish krejt e shëndoshë dhe atë natë kish gosti, se kish embrin e djalit të saj! Të gjith' e muar vesh se vrasësi moral ishte vetë burr' i saj K. Kotta, i cili, nuk shkoj as në varrimin e saj, sa do që ardhi nga Tirana në Korçë!

Orën e varrimit të saj u mbyll gjithë tregu i Korçës për shenjë zije e prej sympathisë që ndjente populli i Korçës, burra e gra ku e mjera Angjeliqi ishte e mirënjohur. Opinioni publik i Korçës ishte e vazhdon të jetë se e shkreta Angjeliqi ra viktimë e pashpirtësisë së të shoqt, i cili u tregua kaqe pa mirënjohtës e i poshtër jo vetëm faqe gruas së tij që e adhuronte e që i kishte bërë kaqe të mira, por akoma edhe përpara meje u tregua pa mirënjohtës e i keq, që i

bëra kaqe të mira, që e mbajta kaqe vjet me shpenzimet e mija, që e emërova kaqe herë si inspektor Arësimi dhe si prefekt e më së fundi i cedova[1] edhe vendin t'em si Kryetar i Parlamentit, që mu propozua prej Zogut, gjë që e miqësoj me Zogun e që e bëri të arrijë gradat më të nalta të Shtetit, si atë të Kryeministrit disa herë e të Kryetarit të Parlamentit, të deputetit, të asamblistit etj. etj. ndonse K. Kotta ishte e vazhdon të jetë krejt injorant, i pazoti, hajdut, etj. etj. gjërra që janë provuar me fakte! Arrim të përmendim këtu një shembull të vogël që të kuptohet sa infernal ka qenë ky njeri, sa ipokrit, sa tartuf :

Kur iku Zogu që këtej i dbuar prej Fanolistëve, në Qershor 1924, e kur u shtërngua të ikte edhe K. Kotta, ky s'kish një metalik në xhep. I hojta unë 3 lira engleze, të cilat akoma s'mi ka kthyer, ashtu si nuk më ka kthyer edhe kush e di se sa hesape të tjera të mvarrura, se ajy e ka patur zakon gjithë jetën e tija të rrojë si parasit në kurriz të tjetrit.

K. Kotta u kthye bashkë me Zogun, si kam thënë më lart, më 24-12-1924. Prej atij viti, ose prej fillimit të vitit 1925 e gjer sa theu qafën më 6 Prill 1939, d. me thënë brenda 13 e ½ vjetëve K. Kotta u gjent me këtë pasuri :

I. Ndërtoj një shtëpi të re përbri shtëpis tij Nap. 1. 500
II. Ndërtoj një pallat në Tiranën e Re " 5. 000
III. Bleu një shtëpi të madhe në Paris " 8. 000
IV. Bleu një tjetër ndërtesë në Athinë " 4. 400
V. Një çiflik në fushën e Korçës " 3. 000
VI. Një çiflik në Berat " 2. 000
VII. Në Bankat e Svicrës e të Parisit " 10. 000
VIII. Harxhoj për një mantenutë franceze " 2. 000
IX. Udhëtoj kaqe herë në Romë, Paris, etj. " 1. 000
X. Bleu një truall në Tiranë " 1. 500
XI. Mori me vehte kur iku " 2. 000
Shuma prej napol. arit " 40. 400
Përveç aksioneve të Sitës, të Stamlerit, të
shoqërisë "Maliq" të shoq. korçare të elektrikut,
që thuhet se përballonin një shumë " 2. 300
Do me thënë se brenda ka : " 42. 700
Brenda kësaj kohe Kotta u ndoth me nj'a 5. 000 napolona!

Ku i gjet? Sigurisht që i grabiti! Grabiti si ministër i P. Botore nga "INAGU", nga disa shoqëri sipermsarrëse italjane, nga disa shoqëri e ente të tjera, nga disa shuma të zyrës sekrete si ministër i P. të Brendëshme etj. etj. etj.

Ky ishte bukuroshi Koço Kotta, që edhe asaj fukarasë Marigo ja hëngri të gjitha paratë sa i kishte huajtur ajo, edhe më së fundi një ditë as nuk e nqasi në shtëpin' e tij në Metropoli ku ajo i shkoj ti qajë hallin e saj si vëlla!

Thotë një proverbë greke : ".... . . . " (shkruar greqisht H. K.) d. m. th. " Ato që i sjell era, i shpërndan Djalli". Pra, edhe Kotta, vërtet i mvodhi të gjitha këta, por më së fundi ja konfiskuan që të gjitha italjanët, kur hynë e okupuan Tiranën.

Kështu, Koço Kotta, që ishte bërë një lord i dytë i Shqipërisë, u gjent pa gjë, përveç atyre të hollave që mundi e mori me vehte kur iku, si dhe të atyreve që kishte në për bankat e ndryshme evropjane.

E ëm' e Koço Kottës, plakë sot 90 vjetsh shtërngohet të paguanj qira për nj'a 2 odë që ka okupuar të shtëpis së saj, që ishte shtëpija dy-fijshe e K. Kottës.

Gjithë lopët e qetë e bagëtinë etj. etj. të çifligut të Korçës e të atij të Beratit ju konfiskuan gjer më një. K. Kotta që u martua për së treti me një bijë kasapi nga fis' i Dallamangove, u shtërngua me gjithë të shoqen të vejë tek një i njohur në Stamboll, që të mos

[1] cedoj = jap, lëshoj (H. K.)

vdesin urijet. Çupën e djalin e tij i braktisi në Paris, ku po gjinden akoma në një vështirësi të madhe.

Kështu është fundi i parasitëve batakçinj!

## XXIII

Viti 1936 ka qenë një vit sikletesh e vështirsinash për mua. Punët e avokaturës që vijnin kaqe mirë më parë, tash kishin dy vjet që po paksoheshin e që po shkonin keq e më keq. Shpenzimet ishin të mbëdhenj dhe fitimet shumë të pakët. Me votimin e ligjës katastrofale të moratoriumit për debitorët, që shkaktoj dëme kollosale dhe paralizimin e kapitaleve, në kllasat profesjonale, e sidomos në kllasën e avokatëve u shkaktua një krizë e madhe. Punët e avokatëvet u paksuan gati 80%. Ishte një problem i math rrojtja për ne avokatët. Nga ana ime kisha filluar për të parën herë të hynj në borç dhe e shëkonja se kisha marrë tatëpjetën. Duheshe gjetur një farë rrugë shpëtimi, mbassi as të ardhura kisha, as mburrime të tjerë!

Atë vit Kryeministër ishte Mehdi bej Frashëri, miku e kolegu jem. Kryetar i Parllamentit vazhdonte të ishte Koço Kotta, me të cilin vazhdonte e ashpër armiqësija jonë.

U mejtova një natë dhe të nesërmen i shkova në zyrë Mehdi beut. Ja qava hallin si një miku dhe e pashë se ish i interesuar fort. I thashë rreth dorëheqjes s'ime së parës më 1930 prej Këshillit të Shtetit, dyke shtuar se tani ishte rasti të përpiqeshe për mua të munt të riemërohesha në këshillin e Shtetit, kështu që edhe nga problemi financjar shpëtonja, edhe të 12 vjetët shërbim që i kisha e që i humba me dhënien e dorëheqjes s'ime i fitonja prapë dhe siguronja çështjen e pensionit të paktën.

Mehdi beu më vuri përpara çështjen e ligjës së përjashtimit nga shërbimi të nëpunësve që kishin kaluar moshën 55 vjetshare e cila ligjë përjashtoj nga detyra 120 e sa nëpunës, ashtu kot së kot, sepse e desh interesi i disa ministrave për të marrë hak nga disa kundrështarët e tyre që tash ishin nëpunës.

Mehdi beut ja shpjegova hollësisht pikpamjen e asaj ligjës, që kishte një karakter transitor për atë kohë e për atë qëllim e se nuk munt të më ndalonte mua me gjithë që i kisha kaluar të 55 vjetët. Si e binda Mehdinë, ajy u takua me K. Kottën, që bashkëpunonin dhe në bazë të ligjës organike të Këshillit të Shtetit të më propozonin që të dy së bashku për emërimin si anëtar i K. të Shtetit përpara Mbretit të Shqiptarëvet.

K. Kotta, kur dëgjoj për mua u hoth përpjetë edhe i tha Mediut se këjo është një punë që s'bëhet gjer sa z. e tij që kish rekordin e injorancës, ishte Kryetar i Parllamentit.

Kur më solli përgjigjen Mehdi beu, un' i thashë se s'bëri mirë t'a futë në veshin e K. Kottës, me të cilin jam armik, po do t'ish më mirë të merreshe vesh me Mbretin, dyke ja parashtruar çështjen si urgjente për Këshillin e Shtetit, i cili tash kishte mbetur në duart e disa matufëve, me përjashtim të nj'a 2-3 personave. Veçanërisht e porosita mos t'a merte vesh Zogu se vetë unë e desha këtë vent, se prapë munt të mos bëheshe kurrë, sepse unë isha tjetër herë atje dhe dhashë dorëheqjen, me gjithë insistimin e Zogut, i cili, dyke dashur të marrë hakkun tani munt të mos pranonte kurrë një proponim të këtillë për mua, qoftë edhe si kur të më propononin bashkarisht edhe Kryeministri edhe Kryetari i Parllamentit, në bazën e ligjës organike të K. të Shtetit.

Mehdi beu më rastisi pas ca ditsh e më tha se i kishte bërë fjalë gjër' e gjatë Mbretit, por se ajy s'i kish dhënë as një fjalë afirmative, as edhe një shpresë. E pashë Mehdi benë të dëshpëruar, por i dhashë pak kurajo, dyke i thënë të mos dëshpërohet me të parën, po t'ja përsëritë prapë në ja gjettë volinë.

Mehdiu i shkretë gjeti dikur kohë e ja zuri prapë në gojë. Në këtë rast Mbreti e pyeti a në e dëshironja edhe vetë unë këtë vent, prej të cilit kisha hequr dorë tjetër herë. Mehdiu, si e kisha porositur unë, i tha Mbretit, se Floqi as ka haber nga kjo gjë, por ky vetë Mehdiu e

gjente të arësyeshme për prestizhin e Këshillit të Shtetit, i cili kishte rënë shumë poshtë. Shtoj bile se është shumë nevoja edhe në qoft' e mundur të më thriste vetë Mbreti në pallat të ma propozonte, që t'a pranonja pa bërë naze shumë.

Ishin fjalë këto që ja kisha shtënë një nga një në vesh Mehdi Frashërit.

Ky më thiri të nesërmen në Kryeministri e mi tha të gjitha ç'foli me Mbretin dhe kish shpresë se munt të më thriste vetë Mbreti të ma propozonte.

Shkoj një javë e tërë që prita kot. S'u duk gjë. Zura të dëshpërohesha mjaft. I thashë përsëri Mehdiut edhe përsëri i shkreti ja zu në gojë Mbretit çështjen t'ime, i cili i tha se e pat harruar edhe e mori nënë shënim që të më thresë në pallat.

Kisha mot-mot e ca që s'kisha shkuar në pallat, po kur një dit dërgon adjutantin e tij major Allamanin e më mori në pallat me veturën e Oborit. Si prita ndo një or' e ca gjer sa u larguan vizitorët e tjerë, që kishin kërkuar audiencë major Allamani më futi në sallën e fronit ku më priste Mbreti Zog, i cili, posa më pa, më zgjati dorën me një herë me një përzembërsi të jashtzakonshme, më rëmbeu për krahu e më vuri të ri pranë tij, dhe ajy zuri vent në fronin mbretnor, që ishte afër mejet. Më pyeti mjaft si shkoj e si vete etj. etj. edhe si vete edhe me punën. Unë ju përgjegja se, si nga shëndeti, si nga profesjoni ja shpije extra, si jo më mirë. Ku t'a

dinte ajy se të tjera më fliste buza e të tjera më ndjente zembra. U tregova aqe buzë-qeshur, sa Zogu me gjithë finecën e tij nuk më kuptoj as pak.

- Kishte ndonjë urdhër, Mbretërija jote? i them Zogut.
- Desha, thotë të të shihnja, se të kam mik të vjetër e kisha kohë t'ju shoh. Veçanërisht

desha të mar mendimin t'uaj, më thotë, mbi kuptimin e domethënien e ligjës "mbi përjashtimin e nëpunsavet 55 vjeçar" me fjalë të tjera a na ndalon këjo ligjë të emërojmë ndo një nëpunës që ka kaluar moshën e 55 vjertëve, në rast që kemi nevojë.

Ma falni, Madhëri, i them, për një vërejtje që munt të bënj mbi këtë ligjë. Për mua ajo

ka qenë një ligjë pa një arsyje e pa as një kuptim, një ligjë e çmëndur që mori më qafë disa nëpunës të aftë e të zotët, për hatër të disa hakmarësve deputetë. Unë, po të isha deputet, i kisha bërë poterën për një ligjë drakonike e extravagante si ajo, edhe në rast që nuk e bindnja Parllamentin me arsyetime e me argumentima të plotta që do t'parashtronja, të paktën do vinja t'ju lutesha të mos dekretonit një ligjë budallaqe si ajo, që na la si njollë në analet parllamentare, po ç'u bë, u bë!

Ke të drejtë të plottë, më thotë Mbreti, dhe të siguronj se edhe unë u pendova që e

dekretova me një ngutësi të madhe, po tani shkoj e vajti këjo. Tani më mbushe mëndjen për efektin e kësaj ligjeje në rast të ndo një emërimit të ri të kandidatëve që e kanë kaluar moshën e 55 vjetëve. Ligja në fjalë, i them, është një ligjë speciale me karakter provizor që parasheh vetëm

për ata nëpunës që u ndodhë në zbatimin e ligjës e që kishin kaluar moshën e 55 vjetave. Këjo ligjë nuk mund të kundrështojë normat e ligjës së Pensioneve për civilë e ushtarakë, e cila e cakton moshën në 65 vjetsh për efektet e pensionit për nëpunësit pensionistë. Pra, Madhërija juaj, është e lirë të pranojë e të dekretojë emërimin e nëpunësve që nuk kanë kaluar moshën e 65 vjetve.

- Jini të sigurt për këtë?
- Aqe i sigurt sa sikur Ju shoh e më shihni Madhëri! Unë me një herë e kuptova se ku

do ta nxirte fjalën, po Zogu, nuk hyri me një herë në themën që do më propozonte, se e pashë që e ktheu fjalën mbi disa ndodhina të tjera, që s'kishin të bëjnë me qëllimin, për të cilin më thiri. Më foli për sh. mbi veprimet letrake, a ke shkruar ndo një vepër të re, a lodhem së shkruari etj. etj. dhe më së fundi pyeti si vete me punët avokatore. Unë ju përgjigja se shkonj shumë mirë, se jam i kënaqur me profesionin t'em etj. etj. që Zogut i bënin përshtypje të madhe këto, sa u bint se s'kisha nevojë për nepunësi. Si ti thesha ndryshe? Ajy, po të dinte sigurisht se unë ja kisha kaqe tepër nevojën, munt edhe të më mundonte, ose të më gënjente

prapë si herët e para edhe më në funt të mos më emëronte aspak. Po e shëkonja në sy e po mundohesha t'ja blinja mëndjen, por ajy me një herë e la këtë bisedë e më thotë : Kam shkuar pardje me motrat e mija në Spitalet civilë e ushtarakë për të vizituar të sëmurit. Kaluam nga shtëpija juaj dhe për çudi pashë se paske ngrehur një villë madhështore, tamam një pallat dhe u çudita fort, por edhe m'u bë qejfi, se një miku jem bëri një pallat kësi-doret. Kush ju a dha pllanin? – inxhinjeri i Madhëris s'uaj, i them, z. Kristo Sotiri.

- Bravo, ma pret Mbreti. Mos e kini dhënë me qira? Jo, i them, banonj vetë me Ç' do kuptojmë nga kjo jetë, Madhëri? i them. Se mos do t'a mar me vehte kur të vdes. Po të mos i gëzohemi tani sa jemi gjall kur do gzohemi? – Bravo, më thotë. Shumë mirë jé mejtuar. Po si duket s'ke nevojë, se për ndryshe do t'a kishe dhënë me qira shtëpinë. Tani, më thotë, do të pranoni edhe diçka prej meje. – Ç'farë Madhëri? – Me qenë se shumë nga miqtë t'uaj ju kanë falur nga ndo një peshqesh për shtëpinë e re, edhe unë, si miku juaj, duhet të kontribuonj në këtë pikpamje. – Të lutem Madhëri, i them, Madhërija jote s'ka pse trazohet. Ju jeni një Mbret sot, s'keni kohë të mendoni për vogëlima të këtilla. – Tamam, ma pret, se jam një Mbret, duhet edhe peshqeshi që do t'ju bënj të jetë mbretnor. Prandaj ju lutem pranoni nga ana ime këtë peshqesh të vogël, se s'di ç't'ju ofroj tjetër. Në këto fjal' e sipër hapi sirtarin e tij, nxori një zarf të math mbushur me bankonota Shqiptare e ma dorzoj. Ju lutem, Madhëri, i them. – Do t'a pranoni, më thotë, mos ma bëni si ma bëre një herë tjetër, e mbani ment. Ishte çështja e 200 napolonavet që më pat dhënë, kur insistonte që të mos jap dorëheqjen dhe unë ja refuzova. Desha s'desha u shtërngova t'ja pranonja dhe i mora ne dorëzim, dyke e falenderuar edhe pa ditur se ç'përmbante brenda ajy zarf i rëndë.

Prita se mos më thosh tjetër gjë, po Zogu s'foli më. E kuptova se duhej të iknja dhe kështu u ngrita e shkova, dyke e falenderuar prapë.

Kur ardha në zyrë e çila zarfin dhe gjeta brenda plot 150 napolona! Për Zotin peshqesh shum' i mirë ky e i dejtë për një Mbret. Mu duk si kur më ra prej Qjelli në mes të asaj ngushtie financjare e të halleve që kisha.

Po më bëri përshtypje këjo : Pse s'më tha gjë rreth çështjes për të cilën më thiri. Mos, dyke dëgjuar prej meje se ja shpija mirë me profesjonin t'em kish ndryshuar mëndje? Mos nuk bëra mirë që i fola në atë mënyrë, a po këjo ishte një nga manovrat që Zogu e kishte zakon të përdorte në raste anallogë?

Pas 3 dittsh piqem prapë me Mehdi bejnë. Posa më pa më tha : Jahû, si e kishe hallin që ju lëvdove Mbretit se shkon mirë me profesjonin tënt, kurse ti je në ditë të hallit, si ma shpjegove? Po ç'kërkon zotrote, i them, ti binja nëpër këmbët e ti thosha aman? Ahere sigurisht nuk do më emëronte kurrë. Zotrote ja njeh karakterin e tij, si ja njoh edhe unë. Në qoftë se i the, se këtë e bënj nga halli imath që kam, ahere s'ke bërë mirë, se unë shprehimisht ju porosita të mos i thonit gjë. – Mos kij merak më thotë Mehdiu, se unë s'i fola asgjë për hallet e nevojën që ke. – Ahere paskam bërë mirë, i them, pse më qorton, pra?

Mehdi beu qeshi në këto fjalë e më tha : Po të them edhe unë, se Mbreti u çudit për atitudën tënde, ndonse ajy ësht' informuar mirë se të gjithë avokatët vuajn. Po un prapë i fola sot e më porositi t'a bënj propozimin edhe un' e bëra. Po më tha edhe këto, se mos harrojmë. – Ç'farë? – Më tha, shiko mirë se mos na bëjë naze Floqi e na e kthen dekretin, si na e ktheu edhe një herë tjetër, kur e emërova kryetarin e Diktimit. Mos kini merak Naltmadhni, i thashë, atë punë e mar unë përsipër.

E falenderova Mehdi bejnë nga zembra edhe u ndamë. Pas 3 dittsh piqemi prapë e më thotë Mehdi beu, se kishte gjetur belanë nga Koço Kotta, i cili nuk dëgjonte ta firmonte propozimin. Po unë, tha Mehdiu, i thashë Mbretit t'a shtërngojë ajy vetë dhe ashtu do bëhet.

Pas nj'a 10 dittsh më vjen gjenerali Sereqi në zyrë me veturën e pallatit e më thotë: "eja shpejt se po të pret Naltmadhnija. – Ç' ësht', i them, z. gjenerall? – Nuk di gjë thotë, po aty në pallat janë thirur edhe kryeministri, s'e di çka kanë për të biseduar ku do merni pjesë edhe ju.

U ngrita shpejt e shkuam në pallat me gjenerall Sereqin, i cili, passi prita pak në sallën e pritjeve, kthehet e më merr e më shtije në sallën e fronit. Aty ishte Mbreti mbi fronine tij dhe Mehdiu e Kotta më të djatht' e më të majtën e tij.

Urdhro, ma pret Mbreti. Ju thira të më përsëritni edhe një herë përpara këtyre zotërinjve e të më ndritstroni prapë mbi domethënjen e pasojat e ligjës së 55 vjetsharëvet.

Ahere unë fillova më një bindje të thellë dominonjëse t'ju shpjegoj një nga një të metat e asaj ligjeje, karakterin, fuqin e saj provizore etj. etj. sa e pashë se ishin d'akord të gjithë, përveç maskarajt, burracakut Koço Kottës!

Unë passi parashtrova arësyetimet e argumentat e duhura mbi mosvleftësin' e asaj ligje për emërime eventuale nëpunësish që kishin kaluar moshën e 55 vjetve, qëndrova e s'fola më tepër. Atëhere mori fjalën Mbreti e më tha : Z. Floqi unë kam nevojë për një anëtar të zotin për Këshillin e Shtetit. Megjithë që e di se s'duhet t'ju loz nga profesjoni juaj, me të cilin jini kontent, por vendosa t'ju emëroj ju, e bile me një shtesë 200 frangash në muaj mbi rrogën t'uaj mujore, me bintjen që të ma pranoni pa një kundrështim.

Unë s'fola gjë. Veë se i dhashë me shenja Mbretit të kuptonte se për hatër të tij po e pranonj. Ahere kthehet e i thotë Mehdi Frashërit : Z. Kryeministër, ku e kini proponimin për Z. Floqin? – Edhe Mehdi beu e nxori me një herë nga çanta e tija proponimin të pregatitur e ja paraqiti Mbretit, i cili ja solli me një herë K. Kottës e i tha : Nënëshkrueni dhe ju z. Kryetar i Parllamentit, mbassi ashtu thotë ligja organike e Këshillit të Shtetit.

K. Kotta zu si kur përtypeshe. Naltmadhni, i tha Mbretit, a na permetohet të vepërojmë kundra ligjit? Qysh? ja pretMbreti. Po a nuk u bindtë nga shpjegimet juridike e exakte që na dha z. Floqi? Doni jurist më të mirë për t'ju shpjeguar një ligjë? As unë, as ju, as z. Kryeministër nuk jemi jurista ; jurista janë këta; këta ja dijnë fenë ligjës. Nëqoftë se kini ndo një kundrështim tjetër jashtë këtyre thojeni. - Jo, jo, tha Kotta edhe pa ç'pa e mori në dorë proponimin e e nënëshkroj me nj' herë.

Zogu ahere thiri sekretarin e tij Mustafa Currin e i dorzoj proponimin, dyke i thënë : Protokolloje shpejt që këtë moment dhe bjermani dekretin këtu t'a firmonj.

Pas 5 minutash Mustafa Curri ardhi prapë në sallën e fronit me dekretin në dorë. Zogu e firmoj me një herë e ma dorzoj, dyke më shtërnguar dorën e dyke më uruar. Gjith' ashtu bëri edhe miku Mehdi beu, i cili, e pashë edhe vetë, u gzua fort. Unë s'prita të më urojë Kotta, se as i shtriva sytë t'a shoh. Sallutova Mbretin dhe me kokë Mehdi bejnë edhe ika dyke e falenderuar Mbretin, me dekretin në dorë.

Po atë ças më ndaloj Mustafa Curri, i cili i thotë Mbretit: Naltmadhni, është nevoja të betohet prapë z. Floqi, mbassi është betuar tjetër herë?

Si thotë ligja? më thotë Mbreti.

Ligja thotë, ja pres, të betohemi sa herë që emërohemi.

Ashtu? tha Zogu. Ahere ju thres një ditë tjetër z. Floqi për të dhënë benë.

Naltmadhni, i them; beja ka të bëjë me rrogën t'ime. Min. i Financave, për pa pasur

lajmërimin e pallatit se e dhashë benë, s'munt të fillojë nga rrogat, prandaj do t'ishte mirë t'a jepnja qysh tash benë e të mbaronte këjo punë.

Mirë thoni, ma pret Mbreti. Le të mbarohet edhe këjo, mbassi qënka kështu.

Mustafa Curri, shejtani, e kish në xhep formën e betimit dhe filloj t'a këndojë e unë t'a përsërit, dyke ngritur dorën e djathtë përpjetë, në prezencën edhe të Kryeministrit. U bë protokolli e u nënëshkrua.

Kështu mori funt ajo ceremoni dhe unë tepër i kënaqur me dekretin në xhep.

Problemi i math e i vështirë financjar ishte zgjidhur tashmë.

Brenda një javet ja u dorëzova çështjet e mvarura gjyqsore disa avokatëve të Tiranës me konsentimentin e plottë të klientëve të mij. E mbylla zyrën avokatore e i lashë shëndet profesjonit t'em. aqe të vlefshëm, po edhe aqe delikat si kishte katandisur.

Mezi fillova të fle rehat, dyke shpëtuar nga rendjet e kotta e të largëta e të vështira në për gjyqet, me aqe andralla e skutura dhe pa një satisfaksjon.

E sheshova mëndjen dhe ju përvesha nëpunësisë, ku gjëndem edhe sot e kësaj ditë, dyke përfituar njëkohësisht edhe gjithë vjet që kisha humbur për efekt të pensjonit.

## XXIV

Qysh më 1936 që u riemërova anëtar i Këshillit të Shtetit e gjatë 2 vjetëvet rrjesht kaluam një jetë shumë të mirë dhe aqe më tepër se kishim një omogjenitet e një harmoni të plottë me kolegët e mij, anëtarët e tjerë. Kur na ardhi Dr. Mirash Ivanaj, profesor gjer ahere i Gjymnazit edhe më von ministër i Arësimit, kur na ardhi po them i emëruar prej Zogut si Kryetar i Këshillit të Shtetit, ne kolegët e tjerë nuk e pritmë as pak mirë në fillim, se na dukej mjaft brutal e i pashoqëruar, po dal-nga-dalë kuptuam se ishte vërtet një malok, por malok i zgjuar, i pajisur me shumë virtute që gjer ahere s'ja kishte njohur njeri, ishte një burrë serioz e me karakter e me një vullnet të çeliktë edhe njëkohësisht mjaft i msuar e i stërvitur. Ishte një profesor i rallë e një juristi fortë, por, mbassi nuk i pëlqenin mburrjet e lëvdatat nuk deshi kurrë ti bëjë rekllamë vehtes. I pari që ju afrova e që ja kupëtova dijeninë dhe zotsin' e tij isha unë, dhe nuk shkoj shumë kohë që edhe ajy më njohu mirë e u lithmë që të dy me një miqësi të ngushtë e të pazgjidhur. Unë isha nënëkryetar i këshillit të Shtetit, po e vërteta ish se un' e drejtonja Këshillin e Shtetit, dhe isha krejt i lirë në vepërimet e në masat që mernim bashkarisht dhe kurrë ndo një herë s'arthmë në konflikt, as që kundrështuan njëri-tjetrin. Këjo ngjiste se pse unë isha më i stërvitur se ajy në administrimin e brendshme, e mbas eksperiencës që kisha si avokat edhe si nga më të vjetrit anëtar të Këshillit të Shtetit isha unë i përshtatshëm për atë institut. Dr. Ivanaj zgjatej shumë në redaktimin e koncepteve e të shkresave të tjera, sa ato merrnin një ngjyre skollastike e përfundonin shpesh herë të pakuptuarshme. Prej meje msoj si të jetë llakonik në shprehjet e si t'ju japë këtyre një kuptim të plottë e të qartë. Kështu po zhvillohej një dashuri e madhe midis neve të dy dhe një miqësije të fortë. Njëri çmonte tjetrin dhe puna vinte si sahat. Pastaj si u njoh mirë edhe me shokët e tjerë, aherë ishim të gjithë një trup kompakt dhe të gjitha zyrat na kishin zili për omogjenitetin e harmoninë që kishim.

Një episod që do tregonj tani është karakteristik sa të provojë gjer ku arrinte altruismi i jonë për Dr. Mirash Ivananë.

Takoj festa e 25 vjetshorit të pamvarësië Shqiptare. Argëtime të mbëdhenj po pregatiteshin, të huaj intelektualë, si dhe me qindra nga parit' e qytetarëve e të katundarëve të Shqipërisë ishin ftuar në kryeqytet si nysafirët e Qeverisë, dhe gjith' hotelet e Tiranës dhe shumë shtëpi ishin okupuar me kësij mysafirësh, të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë. Qeverija me Kryeministër Koço Kottën, këtë njeri shpirt-keq e infernal, egoist e pa karakter, kish vendosur që edhe dhomat e Këshillit të Shtetit të përdoreshin për hotel. Ky vendim ishte dhënë edhe për dhomat e Gjyqit të Diktimit edhe për ato të Këshillit Kontrollues, dhe të dy këta institute i ishin shtruar urdhërit të Qeverisë dhe i kishin lëshuar të gjitha dhomat, dyke u përmbledhur si sardhelet, ose si ngjalat në thes në 2-3 dhoma. Eksekutues i këtyre urdhravet ishte ministri i brendëshëm Musa Juka. Tani i kish ardhur radha edhe Këshillit të Shtetit, po Musa Juka nuk dinte se kishte të bënte me Mirash Ivanajn që kishte një kokë, që s'ktheheshe kurrë! Qëllimi i Koço Kottës ishte prej kohësh të zhbirit e të shdukurit krejt të institutit të Këshillit të Shtetit, si një trup i tepërtë e i panevojshëm dhe për këtë i kish bërë 2 herë propozime mbretit Zog, që ta suprimonte krejt me dekret mbretnor. Kur më pat pyetur dikur Zogu që, a munt të syprimonte një institut, për sh. si atë të Këshillit Kontrollues me një dekret vetëm, unë i qeshë përgjigjun, se institute si Këshilli Kontrollues e Këshilli i Shtetit, që janë themeluar me statut, nuk munt të suprimohen me një dekret mbretënor, për pa u ndryshuar

statuti nga an' e Asamblesë nacionale. Zogu ndërmejtonte Këshillin e Shtetit, kur më bënte fjalë gjoja për Këshillin Kontrollues, po e vuri re se un' e mora vesh, edhe përgjigja që i thashë ja mbylli derën për një abuzim këso doret. Pra sado i shtyrë nga Kotta dhe nga gjithë pjestarët e Kabinetit e nga shumë deputetë, që na kishin alë në sy, ajy s'mundi të bëjë gjë edhe K. Kotta me shokët e frynin qullin tani, po qulli s'ish e mundur të ftoheshe. Këshilli i Shtetit, pra, qëndroj edhe një herë i patundur. Musa Juka i dha një urdhër urgjent Kryetarit të Këshillit të Shtetit Dr. Mirash Ivanajt që t'i zbrazë sa më shpejt të gjitha dhomat e Këshillit të Shtetit. Ivanaj, posa e mori këtë u trondit dhe ardhi në zyrën t'ime e ma tregoj urdhrin; e pashë se ishte shum' i nxehur. Un' i thashë se ne duhet të mos tundemi, pa le t'i bjerë legenit sa të dojë Musa Juka. Ashtu them edhe unë, mu përgjeq Ivanaj. Ata, i them, do me th. Qeveria ka për qëllim të na hedhë rrugavet edhe nesër pasnesër të thotë se s'kemi vent ku ta vemë këshillin e Shtetit, por as që kemi nevojë prej tij, prandaj insistojnë të na nxjerin sa më parë. Nuk tundemi, tha Ivanaj, ç'ka për t'u ba, le të bahet! Musa Juka kur pa se ne s'lojtmë prej vendit u mahnit; edhe jep një tjetër urdhër urgjentissimo që ti lirojmë odat, po Ivanaj ju përgjigj shkurt: "S'mundemi ti lirojmë për as një arsye"! Këjo e tërboj Musa Jukën. Ky dërgoj gjenerall Sereqin, i cili foli me Ivananë, por nuk e bindi dot. Mbreti nuk dinte gjë nga këta se ajy ishte në Banjat e Durrësit. Ahere vjen Abdurahman Krossi (i ashtuquajtur zëvëndës mbreti), i cili e shtërngoj Ivananë ti shtrohet urdhrit. Po Ivanaj s'jepet! Punët vanë majë-më-majë, por Ivananë s'e tunt as dreqi i mallkuar!

Ivanaj kur pa se Abd. Krossi nguli këmbët edhe si mushkë matjane desh ti shkonte urdhri në vent, ndryshe munt ti gremiste të gjitha me fuqinë që kishte, shkoj shpejt në pallat te Zogu ti paraqitë dorëheqjen e tija. Para se të shkonte më dorëzoj mua zyrën. Në atë koh' e sipër Musa Juka i telefonon Ivanajt, pa ditur se ky shkoj të paraqitë dorëheqjen. Në telefon u ndodha edhe unë dhe bisedimet në mes t'onë u çvilluan në këtë mënyrë:

Musa Juka : Z. Ivanaj aty? Ministri Juka.

Unë : Jo z. ministër; Z. Dr. Ivanaj më dorëzojmua zyrën dhe vetë shkoj të Naltmadhnija për me i paraqitë dorëheqjen e tija!

Musaj : Ne demek këjo? Për ç'arsyje kërkon të japë dorëheqjen?

Unë : Për arsyjen se nuk dëshiron ti lironjë odat e Këshillit të Shtetit e t'ju a dorëzoje juvet.

Musaj :Urdhni asht urdhën dhe inferiori duhet ti bintet superiorit, ndryshe kemi një anarqi të plottë!

Unë : Nuk jam vetë responsabël për këmbënguljen e z. kryetar të Këshillit të Shtetit.

Musaj : Kur shkoj në Pallat?

Unë : Ka nj'a dy orë që u nis për atje!

Musaj: Mua më duhen odat t'ueja dhe brenda 2 orëve duhet ti keni boshatisur pa tjetër.

Unë : Z. Ministër, unë s'kam si i dorëzonj këto oda.

Musaj : (me inat) Ne demek? Nuk i bindeni urdhrit?

Unë : Duhet të prisni, z. ministër, gjer sa të kthehet kryetari. Unë jam zëvëndësi i tij; gjer sa ajy qëndron kryetar, është puna e tija, e kur të pranohet dorëheqja ahere kini të bëni me mua.

Musaj : Po bjerrim kohën me fjalë. Po ju pves edhe një herë: A do ti lironi odat brenda dy orëvet, po, apo jo?

Unë : Nuk e bënj dot dhe më vjen keq.

Musaj : Ahere do shtërngohem t'ju dërgonj policët e mij të marrin në dorëzim odat?

Unë : Gjer atje ka me shkue puna, z. Ministër? Po kush asht ajy polic që do kuxojë të na nxjerrë prej krahut jashtë ne anëtarët e Këshillit të Shtetit?

Musaj : Kur t'u jap urdhën unë do t'a ekzekutojnë.

Unë : Ahere le të urdhrojnë organët t'uaj të na nxjerin përjashta, po duhet të dijni, z. ministër, se po na bëhet një padrejtësi flagrante dhe përpara një skandalli këso doret, ne nuk

do qëndrojmë me duart kryq, se gjendemi në një pozitë mbrojtjeje dhe responsabiliteti që rëndon z. t'uej e jo ne; pastaj mos harroni se instituti jonë mvarret drejt për drejt prej Mbretit sovran e jo prej Qeverisë, dhe ne, z. ministër, s'jemi msuar gjer tani të marrim urdhra prej Qeverijet, as që munt të dëgjojmë kësijsh urdhrash, ilegale për ne! Mejtohuni mirë për demarshin që do bëni!....

Musa Juka nuk mu përgjeq, po mbylli me një herë telefonin. Unë i thira një herë kolegët anëtarë të Këshillit të Shtetit, u ekspozova çështjen dhe ata aprovuan unanimisht qëndrimin t'em. Me një herë redaktuam një proçes-verbal dhe një lutje, që e nënëshkruam të gjithë e që do t'ja paraqitnim Mbretit, të cilit po i parashtronim që të gjithë dorëheqjet t'ona. Nga ana tjetër mbyllmë të gjitha odat e Këshillit të Shtetit dhe gjithë personeli duallm jashtë e po kqyrnim tani se ç'do bënte Musa Juka. Por gjer sa u ngrys nuk u bë as një veprim. Musa Juka duket se s'kuxonte të bënte një marrëzi të këtillë. Tani kush e di se ç'mejtoheshe. Ky qëndrimi jonë bëri një bujë të madhe në gjithë qarqet e nëpunësve, po edhe në tërë kryeqytetin dhe ne, ose Këshillin e Shtetit e qojtën "Alkazar" për kujtimin e Alkazarit të Spanjës, ku ushtarët e oficerat spanjollë të atij qyteti preferuan të vdesin gjer në një, po jo të dorëzohen! Ivanaj ja paraqiti dorëheqjen ministrit të Oborit dhe nuk priti përgjigje po shkoj e u mbyll në shtëpin' e tija dhe nuk e pamë më. Ne në Këshillin e Shtetit vazhduam 2 ditt me radhë në detyrat t'ona pa ndo një incident nga an' e Musa Jukës. Ditën e tretë më ardhi në zyrë adjutanti i Mbretit generall Zef Sereqi, i cili më tha t'a lajmëronj Dr. Mirash Ivanajnë se mbreti nuk ja pranon dorëheqjen edhe se çështja e marrjes së dhomave t'ona u rregullua. Më tregoj se mbreti u çudit kur dëgjoj se ç'kishte ngjarë, gjithashtu edhe sa ngjanë dhe midis mejet e të Musa Jukës e kishte qeshur mjaft. Ju bë qejfi më tha z. Sereqi për qëndrimin t'onë burrnor dhe i dha urdhër Musa Jukës të mos përzjehet në Këshillin e Shtetit dhe ne të qëndrojmë rehat në punrat t'ona. Dërgova e lajmërova Ivanajnë, i cili ardhi në zyrë e më përqafoj, pastaj thirmë edhe shokët e tjerë dhe Mirashi na gostiti të gjithve nga një kafe. Këshilli i Shtetit e kish fituar postin e tij.

## XXV

Ndodhemi në vitin fatal 1938. Mbreti Zog kishte kohë që nuk aderonte si më parë në politikën italjane, se Italija dita-ditën imponoheshe në politikën e brendëshme e të jashtme Shqiptare dhe Shteti i jon' i vogël, sado që figuronte si një shtet indipendent, po në realitet ishte një shtet vasal i Italisë. Italjanët, kur zembroheshin na kërcisnin dhëmbët shpesh herë, se ata kishin të drejtë e obligim të na protektonin, në bazën e mandatit që kishin marrë nga Lidhja e Kombeve të Gjenevës. Theshnin kështu, në vent të çfaqnin të vërtetën se Shqipërinë e konsideronin si një protektoratin e tyre. Me koncesjonet e mbëdhaj që kishin marrë prej nesh e që vazhdonin të merrnin, italjanët kishin zënë rrënjë të thella në Shqipëri. Këtë e shëkonim të gjithë dhe të gjithë e prisnim një ditë ardhjen e italjanëve në Shqipëri. Zogu kish kohë që po ndiqte një politikë inglize, por pa fryt, se inglizët ishin indiferentë për çështjet shqiptare. Dikur u zembruan Italjanët kundra Zogut, për çështje që nuk munt ti përment këtu, çështje, kuptohet politike, dhe Duçeja na dërgoj me një herë fllotën italjane në ujrat e Durrësit, duke bërë kështu një dimostracjon naval, si atë që bëri tjetër herë në Korfuz. Ankoruan në ujrat rreth Durrsit 28 plot vaporë lufte gjithë farë formet, por lumërisht çështja u godit në pasivin t'onë dhe fllota italjane ju largua Durrsit.

Pas ca ditsh mbreti Zog martoheshe me konteshën Gelardina Appony, prej një shtëpije të vjetër e herojike të Hungarisë. Dasma u bë me shkëlqim të math dhe Zogu dukeshe të jetë mjaft i lumër me këtë bashkëshorte, e cila mori titullin e "Mbretëreshës të Shqiptarëve", duke u aprovuar edhe me anën e Statutit themeltar nga Asambleja Kombëtare. Mbretëresha Geraldinë ishte mjaft e bukur, e hollë e e gjatë si një selvi, fort e qytetëruar edhe mjaft e sjellë.

Për pak kohë ajo u bë popullore në Shqipëri dhe kishte filluar edhe të flasë shqip, se pse e studjonte me një zell të math gjuhën shqiptare. Gjithë populli Shqiptar dukej i lumur me një mbretëreshë të këtillë, duke kujtuar se rronte në kohën e të madhit fatos kombëtar, të Skënderbeut, dhe në fytyrën e mbretëreshës Geraldina u dukej shqiptarëve se po shihnin fytyrën e gjallë të asaj mbretëreshe fatlume Donikës....

Po mjerisht, mbretëresha Geraldina duket se ishte këmbë-terse, sepse posa që u martua me Zogun filluan taksiratet e mjerimet e Shqipërisë, gjer sa ra e shkreta në duart e Italjanëve, si do shohim më poshtë. Që Geraldina kishte pasur këmbën terse, u duk qysh ditën që u martua me Zogun, sepse ditën e nesërme kur me aeropllan 3 motor largoheshin 24 e sa të ardhur enkas për atë dasëm, gazetarë të huaj, kontë, gra të huaja me rëndësi politike e gazetare, përfaqësues e delegatë etj. etj. midis të cilëve dhe ministri i Shqipërisë pranë Romës, i ndyeri Xhafer bej Villa, para se të sosnin në Romë, edhe nga pakujdesija e pillotit, aeropllani u futt në mes të një mjegulle të dendur dhe me fuqin' e madhe që kish u përpoq kundra një mali u doq e u shkatrua! Gjithë pasazherët që u ndodhë brenda u doqnë e u shkrumbëzuan! Ky ishte tersllëku i parë i Geraldinës, si e quaj në gojën e popullit Shqiptar. Ngjanë edhe të tjerë aksidente gjatë atij viti, por ajy që pat efektin më të math e që e groposi Shqipërin' e ngratë, ka qenë dita e zezë e 7-të Prillit 1939, kur ushtritë italjane, pa shkak e pa arësyje invaduan e okupuan krejt Shqipërinë. Atë ditë Geraldina ia kishte falur mbretit Zog një djalë, që do t'ishte trashëgimtar i Fronit Shqiptar. Populli shqiptar festonte me të katër anët atë ditë lumriprurëse. Delegatë nga brenda e nga së jashtmi të Shqipërisë ishin grumbulluar në Tiranë. Kostumet më të bukura të Shqiptarëve të Veriut e të Jugut dhe të Shqipërisë së mesme edhe aqe më fort kostumet e bukura e madhështore të shqiptarkave të Shqipërisë, si dhe ato të Shqiptarkave të Italisë, po bënin dukjet e tyre me shkëlqimin më të math që munt të imagjinohet e sidomos ndër vallet e ndryshme që, si burra si gra, kërcenin në për sheshet kryesore të Tiranës. Saze, zurma e daulle buçisnin nga të katër anët dhe populli festonte me gjithë zembër këtë argëtim të dëshëruarshëm. Po Italjanët mendonin ndryshe. Ata kishin ardhur dy ditt më parë në Durrës me një fllotë të konsiderushme me plot ushtri e me municjone lufte nënë komandën e Gjenerall Guzzonit, të ftuar që më parë prej disa mercenarëve mjerisht shqiptarë, të cilët u kishin shitur atyre Shqipërinë. Italjanët vijnin si në dasmë dhe filluan të zbarkojnë në Durrës. Një garnizon i mjaftueshëm dolli në skelën e atij qyteti dhe po marshonte përpara më një bandë ushtarake, që po i prijnte, porse, posa u duknë në rrugën kryesorë të Durrësit, në bulevardin Zog I, një batare e madhe armësh i priti me një herë në befasi! Shumë italjanë ranë të vrarë dhe kush e di sa të tjerë të plagosur. Batareja e pushkëvet u përsërit disa herë me shumë viktima të ushtrisë zbarkuese italjane, gjer sa filloj bombardimi i topave, që i shpërndau shqiptarët që qëllonin. Atë ditë përpara drekës, ministri italjan në Shqipëri Francesco Jakomoni po i jepte ultimatumin ministrit t'onë të P. Jashtme Eqrem bej Libohovës, nga ana e Duçes. Populli s'e kishte marrë vesh akoma. Zogu ju përgjeq atij ultimatumi se nuk i bindeshe, përkundrazi, tha ajy, se do bënte rezistencë gjer në ushtarin e fundit por këto ishin fjalë të thata, sepse ajy nga ana tjetër pregatiteshe të ikte, duke e lënë Shqipërinë në mëshirën e Italjanëvet! Aty nga ora 4 pasdreke të asaj së zezës ditë, Qjelli i Tiranës u mbush me një herë me nj'a 5-6 formacjone aeropllanash. Populli u alarmua dhe djelmuria po bënte demostrata nënë prijësin' e Mehdi Frashërit e disa oratorëve të tjerë. Mehdi Frashëri i hoqi një telegraf Duçes, si tjetër herë Spartiati Leonidha në Thermopylet që e lajmëronte gjeneralin Pers Mardonins: ".... . " (shkruar në një gjuhë që nuk e kuptoj, që K. Floqi e ka përkthyer "eja t' a marrësh") = eja t'a marrësh, ku i theshte (Mehdiu) se ahere do zaptosh Shqipërinë kur ushtritë italjane të shkelin mbi kufomat shqiptare. Po ç'ishte për të bërë u bë! Ushtrit' italjane okupuan Durrësin, m'andej Tiranën dhe dal-nga dal u përhapnë në gjithë Shqipërinë. Gjen. Guzzoni hyri në Shqipëri, dyke i prokllamuar popullit Shqiptar se ajy vjen si mik e jo si okupator, sepse popullin shqiptar e konsideron si "popull vëlla" dhe Shqipërinë si "Aleatë me italjanët në bazë të traktatit të aleancës që ekzistonte midis dy

qeverivet. Shtonte akoma se Shqipërinë e njihte indipendente e integrale. Dy ditt më vonë vinte në Shqipëri ministri i P. Jashtme, Conte Galeazzo Ciano, i cili prokllamoj nga ana e Duçes se ushtrija shqiptare do të inkorporoheshe me ushtrin' italjane dhe ministria e P. jashtme të Shqipërisë do syprimoheshe, mbassi interessat italo-shqiptare ishin të njëjta dhe do përfaqësoheshin për jashtë prej nëpunësvet italjanë. Njëkohësisht futi edhe fashizmin në Shqipri, dyke krijuar partin fashishte shqiptare pak ditt më von me anën e sekretarit të partis fashishte italjane Aqile Storaçe, i cili apostafat ardhi në Tiranë. Më 12 të Prillit, njerës pa ndërgjegje e skrypyl kombëtar, nënë kryesin e Shefqet Vërlacit, armik personal të mbretit Zog, i cili kishte ikur tani me gjithë suitën e tija për Elbasan e prej andej me anën e Kapshticës në Greqi, ku zunë vent në Larissë të Thesalisë, këta njerës po them, në marëveshje edhe me Franscesko Jakomonin, që kishte urdhra prej Duçes, u mblodhë ashtu kot në Dhomën e Deputetëve, duke mbledhur edhe ç'mundnin nga rrugët – sepse asnjë patriot nuk u afrua në atë mbledhje – formuan një farë të ashtuqojturit Asamble Kombëtare, ku zgjodhë si për kryetar Xhafer Ypin, i cili hapi mbledhjen dhe proponoj rëzimin e mbretit Zog të I e të dinastisë së tij duke i ofruar Mbretit të Italisë kurorën e Skënderbeut e duke e prokllamuar këtë Mbretin e Shqipërisë. Mbreti i Italisë Viktor Emanueli III e pranoj këtë propozim, që ishte pranuar e duartrokitur prej së vetqojturës Assamble Nacionale dhe kështu mori titullin "Mbret i Italisë dhe i Shqipërisë, Perandor i Abysinisë" Njëkohësisht me zgjedhjen e mbretit, u zgjodh edhe qeverija e re fashishte shqiptare me kryeministër Shefqet Vërlacin e me anëtarë këta : Xhafer Ypi, ministër i drejtësisë, Xhemil Dino, ministër i P. brendëshme, Fejzi Alizoti, ministër i Financavet, Ernest Koliqi, ministër i Arësimit, Anton Beça, ministër i ekonomisë kombtare dhe Teufik Mborja ministër sekretar i Partisë fashishte shqiptare. – Një gjë për të vënë re ishte ajo, që disa nga këta ministra, si Xhafer Ypi, Fejzi Alizoti, etj. ishin prej atyre që ishin miqt' e ngushtë e të pandarë të Zogut, dhe të cilëvet Zogu u kish bërë kush e di sa të mira, i kish emëruar ministra në kabinetet e ndryshëm e u kish lënë dorë të lirë të bënin si të deshin. Shumë të tjerë, midis të cilëvet edhe metropolitin Visarionin, që i kish favorizuar aqe fort, e quheshin të afërmit e Zogut, si këta, si të parët ministra, s'lanë mallkim pa përdorur dhe gur e baltë pa hedhur mbi Zogun!

Pun' e parë e italjanëvet ishte të na fazhizonin flamurin t'onë kështu që e futnë këtë ndër kllapa dyke i shtuar nga të dy anët të dy satëret e fazhizmit dhe nga fundi stapin e shenjat e Likktorit. Këjo nuk u pa me sy të mirë nga an' e Shqiptarëvet, edhe vetë italjanët e panë se gabuan dhe pas dy vjetve u shtërnguan vet' ata ti tërhiqnin këto shenja e të na lijnin flamurin e lirë. Italjanët na vunë edhe këshilltarë të përhershëm në të gjithë ministritë dhe na imponuan në për zyrat edhe gjuhën italjane. Po u ndodhë nëpunës patriotë, i pari ndër të cilët isha unë, të cilët nuk e toleruam dot këtë përdhuni. Unë për sh. kuxova e i ktheva Milicjes fashishte pyjore shkresën e parë në gjuhën italishte, që më drejton në këshillin e Shtetit ku isha zëvëndës kryetar, pas ikjes të kryetarit Dr. Mirash Ivanajt, i cili u arratis bashkë me mbretin Zog, si partizan i tij. Shkresën italishte ja ktheva Milicjes fashiste pyjore me këtë anëshkrim : " Me qenë se në bazë të nenit 2 të statutit Themeltar, falur Shtetit Shqiptar prej M. T. mbretit-perandor Viktor Emanuelit III, gjuha zyrtare e Shtetit Shqiptar indipendent është gjuha Shqipe, lutemi të na tregohet në këtë gjuhë qëllimi dhe objekti i shkresës në fjalë" Këjo bëri një përshtypje të madhe në qarqet italjane dhe më një herë mëkëmbësi i mbretit-perandor Francesko Jakomoni më thiri në pallat e më hoq verejtjen pse ja ktheva shkresën Milicjes Fashiste Pyjore. Unë ju përgjigja mëkëmbësit se bëra detyrën t'ime dhe se isha plotësisht në rregull, i tregova me një herë dhe nenin 2 të statutit, të cilin ja këndova italisht dhe më dha të drejtë. Të nesërmen me një qarkore luogotenenciale i porositte të gjithë autoritetet italjane të Shqipërisë të korrespondonin në gjuhën italjane sa herë që u adresoheshin zyrave shqiptare. Italjanët, dyke kujtuar se mos ndodhen midis felahëve të Libisë e zezakëve të Abysinisë, sa që në fillim na silleshin mirë, filluan m'andej të na përdornin ashpër dhe shpesh herë me egërsi. Po Shqiptarët këto nuk i duronin dot dhe me një herë u çfaqnë çështje mos kënaqje e

protestimi kudo në Shqipëri! Aniversartin e parë të ofrimit të kurorës mbretit Viktor Emanuelit, dyke dashur të bënin një manifestim me rëndësi italjanët, Luogotenenca dërgoj në të gjithë qytetet kryesore të Shqipërisë delegacjone Shqiptarësh për ti mbajtur fjalimin e ditës nga ballkonet e Prefekturave, ose të Bashkive të atyre. Mua më dërguan në Korçë me nj'a 4-5 delegatë të tjerë, të zgjedhur të gjithë nga anëtarët e Këshillit të Shtetit. Fjalimi ishte stereotyp për ç'do delegacjon, i përmbledhur në 12 pika, sipas dëshirës së mëkëmbësisë. Unë, kur e këndova nuk e pëlqeva krejt, se disa prej atyre pikave na takonin në nderin t'onë kombëtar dhe cënonin patriotizmin Shqiptar. Pa shkuar në Korçë u paraqita te mëkëmbësi i mbretit-perandor dhe i thashë që unë, si një patriot i vjetër e që kisha sakrifikuar të ritë t'em për këtë ideal, nuk ish e mundur të mbanja një fjalë të atillë dhe i tregova pikat e shënuara, ato pika që na lëndonin dinjitetin t'onë si komp e që aprovonin vasalitetin t'onë, kurse ne s'ishim vasalë, por ishim një popull i lirë. Mëkëmbësi thiri me një herë sekretarin e këshilltarin e tij Piero Parinin, burrë me mënt e me karakter e i kallzoj ç'kishim folur bashkë. Parini i tha se unë kam të drejtë të plottë, po mjerisht pikat e fjalimit të ditës ishin caktuar prej vetë dallkaukut ministrit shqiptar të Partisë fashiste, se, si duket kishin në mes t'onë maskarenj e të poshtër, që vetë me thonjt' e tyre gërmonin varrin e Shqipërisë dyke na shtyrë thell' e më thellë nënë zgjedhën e huaj! Parini tha se duhet të lihen të lirë oratorët të çfaqnin ndjenjat e mendimet e tyre përpara popullit. Ahere Jakomoni nënëqeshi dhe më fërkoj supet, dyke më lënë të lirë të flas në Korçë. Kështu shkova në Korçë e mbajta fjalën e ditës nga ballkoni i Bashkisë të atij qyteti, përpara mikrofonit, dyke e inkurajuar sa munda popullin të mos harrojë se Korça është djepi i idealit kombëtar, dyke shtuar se italjanët i konsiderojmë si miq edhe se këta do gëzohen shumë kur të na shohin se po bëhemi shqiptarë të mirë se kemi qenë, dhe që të mbesin kontent italjanët, gjeneralla e kollonella që kisha rreth meje, si dhe personeli tjetër i autoriteteve italjane në Korçë, u tregova Korçarëve një ngjarje karakteristike, që na ngjau në Milano në vitin 1913, kur isha kryesonjës i një grupi prej 30 e sa patriotësh Shqiptarë, të mbledhur në atë qytet për qëllim kombëtar që ishte çlirimi i Korçës, i Gjinokastrës e i Shkodrës prej thundrave të huaja që i kishin okupuar ata vënde, dhe ku njoha rastësisht Benito Mussolinin, ahere drejtorin e fletores socialiste "Avanti" që delte në Milano, ku Duçja i sotmë, na ndihmoj, u thashë, tepër me gazetën e tij dhe njëkohësisht me anën e ministrit të jashtmë italjan të atëhershëm, marqezit San Giuliano që provokoj dërgimin e një vapori të tërë me mjellra, oris, patate, makarona e qumësht të kondensuar për popullin e urët të Vlorës, të cilin vapor e shoqërova unë gjer në Vlorë, dyke ndarë gjith' ata nozullime[1] në popullin e në rredhet e Vlorës bashkë me 150 flamurë kombëtar me shkabën dykrenare, që i shpërndava në Shqipëri, si peshqesh nga an' e Italisë. Fjalimi im u brohorit e u duartrokit nga an' e popullit të Korçës dhe gjithë italjanët, që e dëgjuan mbetnë tepër të kënaqur. Desha t'u them me fjalë të tjera se Duçja qysh ahere ishte miku i Shqipërisë, mbassi nuk mundja t'u flas ndryshe. Ky fjalim pat efektin më të math në Luogotenencë. Kur u ktheva në Tiranë, mëkëmbësi Francesko Jakomoni më thiri në pallat e më shtërngoj dorën. Më tha se ky episod që tregova në Korçë bëri shumë më tepër përshtypje ndër qarqet italjane, se sa pikat e fjalëve që më kishin shënuar në programin e parë, shtoj se kishte mbetur shumë i kënaqur dhe do t'ja transmetonte edhe Duçes në Romë. Qysh ahere italjanët e sidomos mëkëmbësi Jakomoni më çmonin me të vërtetë si një patriot Shqiptar e mik të sinqertë të Italisë dhe më lanë krejt të lirë në vepërimet e mija. Po takoj më vonë, që unë, si zëvëndës kryetar i Këshillit të Shtetit kërkova zyrtarisht prej kryeministrit Shefqet Vërlaci të më paguheshin në bazë të ligjës 1/5 e rrogës nominale të Kryetarit të Këshillit të Shtetit për të tre vitet e kaluar gjer ahere (prill 1942)[2], si rrogë zëvëndësije. Shefqet Vërlaci në kryje më kundrështoj, po pastaj i ra ndër ment një ahmarje e vjetër kundrejt Ahmet Zogut dhe tani gjeti mua të më përdorte si vegël për

[1] nozullime = Sende ushqimore (H. K.)

[2] Ky pohim vërteton se shkrimi i kësaj pjese të "Autobiografia ime" është shkruar nga K. F. pas kësaj date (H. K.)

qëllimet e tija të errëta e infernale. Shefqet Vërlaci dikur tjetër herë kishte vluar çupën e tij me Ahmet Zogun, po ky, si u bë Kryetar i Republikës Shqiptare e më von Mbret i Shqipëtarëve gocën ja la Shefqet Vërlacit si një gunë të dhirtë! Këtë s'e gëlltitte dot Shefqet beu dhe ngafarite nga marazi për të zbrazur vrerin kundra atij. Edhe si vegël për zbatimin e këtij qëllimi më zgjodhi mua, i cili kisha nevojë për ato rroga zëvëndësije, që i kërkonja dhe kujtoj ky burracak se unë do bëhesha instrument i tij posa të më jepte të hollat, ose më mirë të mbaronja qëllimet e tij pastaj do merrnja të hollat! Edhe kështu filloj të më marrë me të mirë gjer sa më së fundi ma deklaroj haptazi propozimin e tij, i sili ishte ky : Me qenë se unë s'jam më miku i Zogut dhe natyrisht duhej ta kisha mirë me Italjanët, në qoftë se dëshironja të mbaj pozitën t'ime e të gradohem akoma si Kryetar i Këshillit të Shtetit, këtë duhej t'a pranonja edhe me funte që ti bindnja italjanët se me të vërtetë jam mik i tyre dhe se aderonj politikën e tyre për Shqipërinë. Pra, duhej pas Shefqet Vërlacit të botonja në gazetën fashiste "Tomori" se Ahmet Zogu ishte njeri pa karakter, njeri imoral sa arrinte të kurvëronte (o dhé, o Qjell) akoma edhe me të motrat e tija (!!) se ishte një hajdut që e fiku Shqipërinë si vjedhuri ajy me klikën e tija, se ishte një tradhëtor që e kishte shitur Shqipërinë, një njeri i poshtër, një çorroditës nderi të disa familjeve fisnike të Tiranës, një çvirgjinues vajzash etj. etj. ku di unë sa!

Kur i dëgjova këto fjalë të poshtra u drodha i tëri! Z. Kryeministër, i thashë, mos kujtoni se unë kam ardhur gjer në atë gradë, sa të botonj në gazetë këto që më thatë? Pse nuk më thoni më mirë se ju kini për qëllim të çfryni kundra Zogut për hesape të vjetra që kini në mes t'uaj? Pandehtë, z. kryeministër, se unë do bëhem vegla t'uaj e do të botonj gjithë këtë poshtërsi? Unë s'kam 2 palë faqe, z. Kryeministër, e më vjen keq, si u mejtuat kështu e më propozuat një gjë kaqe të dobët, sa edhe qesharake. Ja ku ju them, se jini munduar kot, se ju s'paski marrë parasysh karakterin t'em dhe ju siguronj se jini shumë të gënjyer, në kujtoni se për ca të holla do më bëni veglën t'uaj. Prandaj po ju them se nuk i dua as ato të holla edhé më nuk do më shëkoni këtu. Po shkonj me zembër të thyer dhe nuk do t'i harronj kurrë këto fjalë, që aqe fort më cënuan dinjitetin t'em.

Po Shefqet Vërlaci, i msuar në kësijsh dallaveresh as u mverth, as u skuq. Mejtohuni mirë, më tha, se në qoftë se s'e bën këtë nuk jini mik i italjanëvet edhe merni vehten e familjen t'uaj më qafë, se po tronditet qysh tash pozita e juaj. – Ashtu? i thashë, po ahere propozoni një or' e më parë pushimin t'em nga detyra, mbassi qenka kështu. Unë kam jetuar i ndershëm gjer tani dhe ashtu dua të vdes, si një patriot që kam qenë, as jam mercenar e i shitur as dallkauk e çanaklëpirës, si janë, mjerisht shumë Shqiptarë! – Pse? ma pret Sh. Vërlaci me zembërim, kush është dallkauk e mercenar? – Ju vetë i dijni më mirë se mua, z. Kryeministër, i them, ësht' e tepërt t' ju a them. – Mos kujtoni, më thotë, se këto që ju thashë ja u imponova unë?

– Po kush tjetër? i përgjigjem. Është urdhri i mëkëmbësit, më thotë. – Flisni seriozisht i them. – Po, po më thotë është urdhri i atij, që po ju a transmetonj unë. – Në qoftë këjo e vërtetë, i them, ahere thojini edhe mëkëmbësit edhe kujt tjetër se Kristo Floqi nuk bën kësij gafash, kësij budallallëqesh! Le të më pushojnë nga detyra, le të më internojnë, le të bëjnë si të duan! Mora kapellën edhe ika pa e sallutuar aspak! Mbas dite shkova e ju paraqita në pallat mëkëmbësit. Ajy më priti mjaft mirë, po kur më pa të turbulluar më tha me një herë : Cosa é sucesso, caro Floki? Unë ja tregova të gjitha që më pe e me gjilpërë.

Ajy u habit tepër e më tha, se s'ka as më të paktën dijeni për këtë gjë, dhe çuditeshe si m' i tha këto fjalë Kryeministri edhé si zuri në gojë edhe embrin e mëkëmbësit, pa dijtur gjë ky! I thashë se më vjen shumë keq që një Kryeministër të gënjejë kaqe poshtërsisht, por kur i mungon karakteri e edukata, të gjitha duhet t'i presim! Mëkëmbësi më qetsonj mjaft e më gostiti edhe një kafe, bile. Shtoj se ajy ka estimasjonin më të math për mua e se më çmon për një patriot e dijetar e si një nga më të mirët e më të vlefshmit nëpunës të Shtetit Shqiptar, edhe se do më zembroheshe shumë po të bënja ndo një gafë kësodoret, po edhe gazetën që munt të

shkruantë një artikull të këtillë do t'a konfiskonte që atë ças e do t'a mbyllte. E falenderova mjaft dhe u nisa të shkonj, po mëkëmbësi më qëndroj prapë. Sa kini për të marrë gjithësej gjer tani, më tha, nga shpërblimi si zëvëndësonjës i Kryetarit të Këshillit të Shtetit? Aproksimativisht, i thashë, kam për të marrë nj'a 7480 fr. shqiptare. Rrijni i qetë më tha se këtë çështje e rregullonj unë me Kryeministrin. Pas këtyre fjalëvet u largova prej mëkëmbësit dhe nuk kaluan 5 ditt, kur ardhi sekretari privat i mëkëmbësit Dr. Giuseppe de Angelis, i cili më pruri 400 plot napolona, do me thënë më shumë se sa kërkonja si rrogë zëvëndësije. Dr. De Angelis më tha se luogotenenti ja kërkoj këto të holla Kryeministrit nga fondi 1. 000. 000 frangash që kishte Kryeministrija për shpenzime të jashtazakonshme dhe ja mori e m' i dërgoj mua. Ju fala nderit me një herë Dr. De Angelisit për këtë shërbim dhe veçanërisht ju fala nderit me një letër të posaçime luogotenentit. – Shefqet Vërlaci nuk e priste këtë, as që e kujtonte se munt të vinte puna gjer atje. E kuptoj edhe vetë se më gënjeu, si gënjejnë të gjithë këta të vetë-qojtur bejlerë, këta gjakpirësit e popullit, që s'kanë as karakter, as gjak Shqiptari. Qysh ahere as më foli, as i fola më me gojë, me gjithë që u takuam shumë herë bashkë në Pallat, në aeroport e në disa ceremoni të tjera.

## XXVI

Xgjedha italjane dita-ditën po bëheshe më e rëndë për ne nacionalistët. Italjanët i harruan, ose nuk deshin t'i zbatonin pemtimet e tyre që na trumbetuan posa ardhë për lirinë e pavarësinë t'onë. Na futnë fashizmin, që ish një plag' e rëndë për ne e na detyruan të bëheshim të gjithë fashistë, ndryshe humbisnim për gjithmonë nëpunësitë t'ona. Në krye të çdo ministeri na emëruan këshilltarë të përhershëm italjanë dhe këta ishin në realitet ministrat që sundonin e jo ministrat shqiptarë, që ishin kuklla vetëm sa për formën. Ne Shqiptarët s'kishim gjë në dorë. Filluan m'andej persekutimet kundra nesh nacionalistëvet. Me qindra u burgosnë, u internuan ose shkuan nga gjyqi politik i posaçëm, formuar gjithë prej oficerësh italjanë dhe dënoheshin shumë rëndë. Disa prej këtyre u dënuan me vdekje dhe u mvarrë, ose u pushkatuan! Këjo, ose këto masa i egërsuan tepër shqiptarët dhe me një herë populli filloj të ngrehë krye e t'u kundrështoj autoritetevet italjane. Komunizmi piksëpari, që kish disa gjyrmë të vjetra filloj të ringjallet e të vepërojë, duke revolltuar gati të gjithë shkollat e mesme me djelm e me goca e duke marrë malet. Më von filluan therorizmat dhe komunistat vrisnin në mes të pazarit e ditë më drekë nëpunës e ushtarakë italjanë e sidomos prefekta, nënëprefekta e komandante ushtarakë Shqiptarë, si edhe agjentat e Questurave, duke i konsideruar si tradhtorë. Nga gjithë vrasjet që u bënë prej komunistave, ose prej nacionalistave çlirimtarë, që muar malet, në Tiranë, Në Korçë, në Elbasan, në Berat, në Shkodër, në Vlorë e kudo gjetkë nuk u zu as një atentator, as që u ra në dorë ndonjë prej këtyre ndo një autoriteti!

Sa më tepër kalonte koha, aqe më tepër kuximtarë bëheshin si komunistët, si nacionalistët, të cilët u përhapnë më të katër anët e Shqipërisë, duke therorizuar e terrorizuar autoritetet italjane, si edhe ato ushtarake shqiptare, që bashkëpununin e u jepnin ndihmën italjanëve për kontra atyre e të nacionalistave Shqiptarë. Sidomos mnija e komunistavet e e nacionalistave Shqiptarë vërvitesh kundra milicjes Shqiptare, që paguheshin e mvisheshin e mbatheshin nga italjanët për dëm të vëllezërve të tyre Shqiptarë, të cilët i persekutonin, mjerisht, më tepër se sa vetë ata italjanët, duke i vrarë, ose duke i plagosur, duke i zënë e duke i burgosur, ose duke u djegur shtëpi e kësolla nëpër fshatrat.

Këto i tërbuan komunistët e nacionalistët, të cilit e dyfishuan therorizmin, sidomos kundra milicisë shqiptare, të cilën e gjyrmonin kudo dit' e natë e e coptonin, duke vrarë me dyzina milicë, ushtarë e oficerë. Italjanët u shtërnguan të përdorin edhe mitraloza edhe tankse, po Shqiptarët e maleve, si edhe ata që gjëndeshin nëpër qytetet nuk trembeshin as pak prej këtyre, aqe sa, takoj dikur që një tanks bombardoj një shtëpi, ku ishin fshehur komunista, që u

tradhëtuan prej milicëve dhe komunistët mbassi e mbajtnë gjithë natën luftën më këmbë, kuxuan e ju hodhë përsipër edhe atij tanksi, duke vrarë një nga artiljerët e tij, e duke u vrarë edhe një prej komunistave msyes, kurse të tjerët mundnë të shpëtonin e t'u .... (nuk lexohet H. K.) duarvet ushtrisë! Shpesh herë komunistët vijnin në për fshatërat e hanin e pijnin nëpër shtëpit e katundarëve, po të nesërmet vinte ushtërija italjane e diqte ato shtëpi, dhe njerëzit e shtëpisë, jo vetëm ata, po edhe shumë të tjerë të pa fajshëm burra e pleq, gra e fëmijë, i shkonin me dyzina në mitraloz! Kjo ngjau në Rajonin e Korçës, në Kurvelesh, në fshatrat e Vlorës e të Mallakastrës e gjetkë. Italjanët paguan disa mercenarë të tjerë Dibranë, të cilët ju vërsulë Vlorës dhe Vlonjakët, si edhe rrethet e Vlorës i plaçkitnë sa mundnë, i doqnë e i poqnë dhe vranë shumë prej komitavet si dhe brenda në Vlorë pushkatuan disa djelm të pafajshëm, ashtu si pushkatuan edhe ministrin e Shtetit Qazim Koculin dhe Prefektin e Vlorës Lele- Koçin. Po edhe prej dibranëvet u vranë 180 e sa. Gjithashtu u vrâ edhe një kollonell italjan dhe disa oficerë të tjerë italjanë. Për të çfryrë këtë mëri, italjanët nuk u mjaftuan të vrasin Qazim Koculin dhe profesorin e Vlorës Lele Koçin, po muar edhe 4 djelmosha Vlonjakë prej burgut, i nxuar jashtë dhe i pushkatuan që të katër pa një shkak. Këjo poterë do vazhdonte akoma, po të mos ishin ndodhur edhe njerës që t'u kundrështonin. Një ndodhinë karakteristike, që do ta tregonj këtu poshtë na dha të kuptojmë, se kur has sharra në gozhdë, munt të thyhet sharra po jo gozhda. Komanda epërore dha urdhër të mirren prej burgut të Korçës 10 të burgosur e të pushkatohen pa një formalitet tjetër! Kur dëgjuan këtë Korçarët dërguan shpejt një delegacjon prej 6 burrash te mëkëmbësi i përgjithëshëm i mbretit-perandor, të cilët ju ankuan mëkëmbësit për këtë padrejtësi të çuditshme. Mëkëmbësi kur i dëgjoj ankimet e justifikimet e këtyre u çudit fort, se nuk dinte gjë. Ahere ky i dha urdhër gjenerallit të fuqive armate në Shqipëri që të mos bëhet një e keqe e këtillë, edhe kështu shpëtuan ata nj'a dhjetë të burgosur Korçarë, që do shkonin për dhjamë qeni! Po komandanti ushtarak epëror, mbassi nuk çfryri dot në Korçë për atë ahmarje, vendosi t'ja nxjerë zjarin e tij nga burgu i Tiranës e sidomos nga burgu i posaçëm, ku ishin rreshtuar 280 e sa djelm komunista. Jep shpejt një urdhër dhe dërgon shpejt një plloton prej nj'a 6 ushtarësh italjanë me një kapitan në krye të tyre të cilët vijnë në burgun në fjalë. Kapitani i dorëzon urdhrin drejtorit të burgut, i cili për fat të mirë u ndoth shqiptar dhe i kërkon të dorëzojë 10 të burgosur komunista, ata që të zgjidhte kapitani midis të burgosurve komunistë. Po drejtori i burgut i kundrështoj kapitanit të pllotonit ekzekutar, duke i thënë se s'munt ti dorëzojë pa një urdhër verbal të superiorit të tij që ish ministri i P. Brendëshme. Kapitani i zembëruar iku e ju paraqit gjenerallit të fuqive të armatosura, tuke kërkuar të japë urdhër për ekzekutimin e atyre të dhjetëve fatzinj të burgosur. Ministri i brendëshëm u ndoth në një pozite delikate dhe s'dinte qysh të silleshe, po gjeneralli nguli të dy këmbët për ekzekutimin e tyre. Megjithë se ministri i brendëshëm ishte një djaloshar i pastërvitur, por prapë se prapë u mbajt dhe nuk ju shtrua kërkimit të gjenerallit, i cili, tepër i zembëruar urdhroj kapitenin e pllotonit ekzekutif të marrë fuqi të mjaftë e të shkojë në burg, t'i rëmbejë përdhunisht të dhjetë dhe në rast nevoje të përdori edhe armë! Ky urdhër tronditi gjithë popullin dhe kur e muar vesh të burgosurit komunistë u grumbulluan pranë derës së burgut dhe ishin gati të kundrështonin të gjithë cilës do fuqije të armatosur, qoftë edhe me sakrificjen e tyre, kështu që kur ja mbrrijni në burg kapitani italjan e pa edhe vetë se s'kish si përdorte armë përpara atij grumbulli të vendosur për vdekje dhe u ngrit e shkoj me gjithë fuqin që kishte sjellë pas. Kështu shpëtuan ata të dhjetë pa u pushkatuar kot – së – koti për hatrin e një gjeneralli kapriçoz, që kujtoj se kish të bënte me felahët e Libisë, ose me zezakët e Abysinisë! Qysh ahere s'kursenj të bënjë ndo një vepërim tjetër këso doret as gjeneralli i fuqive të armatosura, por as ndo një tjetër shok i tij.

Por miqtë italjanë nuk hiqnin dorë nga qëllimet e tyre. Kështu dalë nga dalë bënë armik gjithë popullin, i cili filloj të kundrështojë e të revoltojë, se nuk i duronte dot këto shtypje! Me qindra djelm muar malet. Djelm' e vajzat e shkollave të mesme bënë disa herë grevë e s'vijnin as pak nër shkollat. Një ditë, në një demostratë që u bë prej djelmsh e vajzash të Gjymnazit,

karabinerija sulmoj mbi ata me revolverë e mitroloza, ku u plagosnë disa djelm e goca, dhe një prej syresh, i biri i Qani bej Dishnicës mbet i vrarë në vent. Nga an' e karabinierëvet u vra një e u plagosnë dy të tjerë. Këjo ngjarje egërsoj gjithë rinin' e Tiranës, po edhe të Shqipërisë mbarrë. Varrimi i atij të shkretit djalë u bë tepër madhështor. Për mbi 20. 000 shpirt e shoqëruan prej spitalit gjer në aeroport. Djemt' e vajzat e mbajtnë ndër duar qivurin e tij gjatë rrugës spital-aeroport, dhe shumë njerës, midis të cilëve edhe vetë Kryeministri Eqrem bej Libohova edhe disa ministra të tjerë e shoqëruan kufomën gjer në Fier, ku kish familjen e tij dhe e varrosnë me një shkëlqim të math! Qysh atë ditë djelmoshat nxënës vendosnë ahmarje. Brenda në Tiranë u vranë disa policë e nëpunës të tjerë, të konsideruar miqt' e italjanëvet, ose spiunët e tyre. Midis këtyre ka qenë edhe nënkoloneli Ndok Gjeloshi, kryekomandant i Milicjes fashiste shqiptare, i cili u vra bash ne bulevardin Viktor Emanueli III ditën e Djelë pas dreke, kur njerzit me mijra kishin dalë të shetisin dhe ku u ndodh një kallaballëk aq i math. Po kundrështarët kuxuan e e vranë në mes të atij kallaballëku!

Ashtu si nënëkollonel Gjeloshin vranë edhe shumë të tjerë, sikurse prefektin e Korçës, Skënder Çamin, prefektin e Elbasanit Musa Pukën, prefektin e Vlorës Riza Runën, misën e dhomës korporative Beqir Russin, disa questorë e policjotë etj. etj. Dhe çudija ka qenë këjo, që asnjë kuximtar ose vrasës nuk ra në dorë të italjanëvet, në kaqe vrasje e atentate që ngjanë njëra pas tjetrës! Inatet e këtyre italjanët e çfryjnë mbi njerës të pafajshëm, pa kursyer as gra, as fëmijë. Për sh. në katundin Pojan të Korçës, sepse hëngrën darkë një natë disa komunista, të nesërmen pushkatuan gjith' atë familje të ngratë prej 8 shpirtsh, burra, gra, pleq e kalamanj edhe së fundi i vunë zjarin shtëpis së tyre dhe e doqnë! Po në një tjetër katunt, për shkak se u vranë disa ushtarë italjanë, vunë në mitraloz 30 e sa veta burra e gra. Në Karbunarë e në nj'a dy katunde të tjerë të Mallakastrës doqnë kush e di sa shtëpi. Nga Korça e nga Vlora, pa pasur as një shkak e arësyje internuan në Campo di concentramento në Porta Romano të Durrësit 182 Korçarë e 151 Vlonjakë, burra, gra e vajza të parritura! Këto gjërra i tërbuan partizanët shqiptarë, që kishin marrë

malet dhe filluan të zenë robër italjanë oficera e ushtarë, por pa i vrarë e pa i torturuar, por duke i ushqyer e duke i mbajtur mirë, gjer sa autoritetet italjane të lironin disa të burgosur nga burgjet. Kur i kanë dorëzuar këta në autoritetet përkatës kishin dekllaruar se kryengritësit, nacionalista qofshin, ose komunista, u ishin sjellë shumë mirë e me njerzi e i kishin trajtuar si miq e mysafirë, sa edhe ata vetë ishin çuditur. Në qafën e Krrabës disa komita shqiptarë e ndalë nga rruga një autokamjon italjan me ushtarë. Po ushtarët u kundrështuan me armë komitave, dhe këta i vranë që të 7 ushtarët, që ndodheshin brenda kamionit bashkë edhe me shoferin të cilët i prunë e i varrosnë në Tiranë. Shumë përpjekje të këtilla të përgjakshme u shënuan, pa rënë në dorë as një prej komitavet, nacionalista, ose komunista. Po italjanët prapë vazhdonin taktikën e tyre të gabuarshme. Disa prej nesh, midis të cilëvet edhe unë i tërhoqmë kush e di sa herë vërejtjen Qeverisë, të intervenonte pranë Luogotenencës e tu vihej një garth një her' e mirë këtyrë shëmtimeve që bëheshin jo vetëm për dëmin t'onë, po edhe për atë të italjanëve, sepse na vinte keq të gjithëve si njerës të shëkonim kaqe viktima, por mjerisht edhe qeverija tregoheshe e plogët e pa një farë guximi edhe e keqja po shtoheshe për dëmin e të dy palëve. Më së fundi kërkova vetë audiencë pranë Luogotenentit Francesko Jakomoni, i cili, me të vërtetë u tregua tepër gjentil përpara meje e më priti qysh atë ças, që e lajmërova. Ja tregova të gjitha sa munda dhe si munda, ju luta të marrë sa më shpejt masat e duhura dhe të pushojnë këto vrasje e atentate, që tmeruan gjithë popullin. Më dëgjoj me vërejtje të madhe e më përhiroj që e vura në dijeni të situatës së vërtetë mizore. më tha se do verë gjithë fuqinë për të ndaluar këtë gjak-derdhje, por mjerisht kaluan javë e muaj e s'u bë gjë. E keqja sa vinte po shtoheshe. Mëkamësi, si mori vesh, u përpoq mjaft, po kush e dëgjonte? Ajy ish vërtet shpirt-mirë e mëshir-plotë, po mjerisht s'u bë gjë, se urdhrat e tij as dëgjoheshin, as zbatoheshin. Potera po zhmbërthente edhe më rëndë! Përpjekje të shpeshta vazhdonin kudo e sidomos nga an' e Vlorës, ku të ikurit ndër malet në një ndeshje të fortë rrethuan një ushtri të

tërë dhe përveç se vranë prej italjanëvet dhe milicëve shqiptarë, po zunë rob edhe 170 ushtarë graduatë italjanë, midis të cilëvet edhe 12 oficerë. Kryengritësit të bashkuar tani në një front si komunista ashtu edhe nacionalista zaptuan një nga një të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe Italjanët u përmblodhnë vetëm në për qendra e qyteteve Korçë, Ersekë, Pogradec, Bihlisht, Elbasan, Berat, Gjirokastër, Vlorë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lesh e Shkodër. Komitat u afruan gjer më largësi një orë lark qendrave të qyteteve, si për sh. në Korçë ardhë gjer në katundin Boboshticë e Drenovë, në Ersekë ardhë gjer në Rehovë e në Mborovë që mbajnë gjer më një orë lark Ersekës. Leskovikun me gjithë rrethinat e zaptuan kryengritësit, fshatrat e Beratit, të Elbasanit e të Gjinokastrës ranë po në duart e atyre. Si kemi dëgjuar, edhe mbassi në gjithë komunat e Shqipërisë nuk ekziston asnjë kryetar komune, kryengritsit i kanë në dorë të gjitha; ata përkujdesen për qetësin' e për ushqimin e popullit, ata mbledhin taksa e të dhjeta e i harxhojnë për mbajtjen e ushtërisë që kanë formuar etj. etj. Edhe kur u mungon buka ata e kanë kollaj zbresin me kafshë në për lumenjtë, ose në për depozitat e grurit, e misrit e elbit, tërshërës etj, etj. dhe ngarkojnë sa bereqet u lipset pa pikën e kundrështimit nga an' e autoriteteve, se kush kuxon t'u bëj ballë?

Gjendja e jonë u vështirësua tepër! Autoritetet italjane u duk se nuk e përballojnë dot këtë situatë të keqe. Qeveritë ndrohen njëra pas tjetrës, pa qitur gjë në shesh, se ç'do qeveri i ka duart e lidhura e s'ka si vepëron si duhet e ku duhet. As qeverija s'lejohet të bëjë ndo një vepërim, as vetë italjanët nuk e ndalojnë dot të keqen. Të arratisurit sa vjen po bëhen edhe me fort kuximtarë, gjer sa arrijnë, për sh. në Elbasan, dita më drekë të msyjnë Kuesturën e atij qyteti, të marrin shkresa, municjone e ç'tjetër mundnë nga ajo zyrë dhe më së fundi të vrasin një polic e të plagosin një tjetër, pa i kapur njeri! I hidhen Elbasanit e t'a qarkojnë dy herë e të mbajtnë luftë 4-5 orësh me ushtrinë italjane, e këjo të mos jetë e zonja të kapë një grusht komita! Të vejë një bataljon i tërë në katundin Pezë, për një farë komiti Selim Peza e t'a qarkojë e ky të ndeshet në luftë me ata e t'u bëjë kërdinë, duke shtrirë të vrarë plot 183 italjanë, ushtarë e oficera midis të cilëve një kolonel, një major, dy kapitanë dhe 2 togerë e nëntogerë dhe më së fundi Selim Peza më shokë t'u ikë nga duart, pa pësuar gjë, ku është parë e dëgjuar një pun' e këtillë? Të kuxojnë ti japin ultimatum ushtërisë të hiqet për sh. prej një qyteti, prej Leskovikut se do t'a okupojnë të arratisurit dhe ushtërija italjane pa një, pa dy të shtërngohet t'ua lëshonjë kryengritësve, të cilët e okupuan me një herë, ku është dëgjuar edhe këjo? Të vijnë midis qyteteve shqiptare komunista, ose nacjonalista të mbajnë fjalë publikisht përpara popullit kundra italjanëve, po edhe kondra qeverisë shqiptare e të ngrihen të ikin me qetësinë më të madhe, që munt të bëhet, pa lëvizur nga vëndi as Prefekt, as autoritet tjetër për ti shtënë në dorë, edhe këjo ku është dëgjuar? Të vrasin Prefektin e Elbasanit Musa Pukën, Prefektin e Korçës Skënder Çamin, deputetin e Elbasanit Beqir Russi, nënëkomisartin e Policis të Tiranës Beqir Kazazin, nënëkolonelin e Milicjes Shqiptare Ndok Gjeloshin etj. etj. në mes të ditës, në mes të bulevardevet e të rrugëvet, përpara zyrës së Fashjos në Tiranë etj. etj. e të mos kapet asnjë vrasës, ose atentator, edhe këjo me se hahet? Ku është parë e dëgjuar? Të ndalojnë autobuzin e Satës përpara dyerve të Tepelenës e të çveshin gjithe pasaxherët, sa ti lenë vetëm me brekë e me këmishë e tu marrin ç'kanë përsipër, si edhe afër Peqinit të qëndrojnë prapë autobuzin e Satës e të marrin të gjithë të holla si edhe postën me vleftë e të mos u bjerë njeri prapa, edhe këjo ku është dëgjuar? Të rrethonjë një koxha kompani ushtarësh italjanë e tu marrin pushkat, revolveret e fyshekët pa një farë kundrështimi edhe këjo me se hahet? Të kuxojnë të paraqiten në zyrën e Kryeministrit Mustafa Krujës e ta trembin faqeza, duke e imponuar të lëshohen nga burgu disa miqt e shokët e tyre komunista e të bëhet këjo e ajo dhe kryeministri, me gjithë programet e famshme të tij e me gjithë friksimet e premtimet të mos kuxojë të kundrështojë, po të bindet vullnetit e dëshirave të tyre dhe m'andej të shkojë i trembur e të mbyllet në shtëpin' e tija, pa kuxuar as pak të dalë as te pragu i derës edhe këjo me se hahet? Gjërra të këtilla ku gjetkë munt të ngjasin?

Gjenerall Pariani, njeri fort i naltë e fisnik, ky dashamirësi i shqiptarëve, që jetoj tjetër herë me ne bashkë 10 vjet e sa, që na ka njohur e e kemi njohur shumë mirë dhe që u ka bërë kaqe të mira shqiptarëve, për fat të mirë tash von u emërua Mëkëmbës i përgjithëshëm i Mbretit-Perandor në Shqipëri. Gjithë Shqiptarët, kur e dëgjuan këtë lajmë gazmore u rritnë gazit, dhe e pritnë me brohori e me kënaqësi të madhe Generall Parianin. Ky njeri, të cilin edhe vetë e kam njohur fort mirë e e kam pasur shumë mik qysh në kohën e Zogut e kemi ngrënë e kemi pirë disa herë bashkë, ka një karakter me të vërtetë të mirë e bujar. Ësht' i drejtë e i paanëshëm. Ka qenë edhe ministër lufte e i ka shërbyer si duhet shtetit italjan në raste shumë delikate si një ushtar i vërtetë; po shqipëtarët i ka konsideruar e i ka dashur si miq dhe u ka atribuar shumë të mira. Kur italjanët okupuan Shqipërinë, këtij i ardhë më keq, se pse ky ish nisiatori i aleancës së parë italo-shqiptare dhe gjithnjë ka dëshiruar që Shqipërija të ishte krejt indipendente e jo protektoratë, gjithashtu është çfaqur se Shqipërija duhet të ndihmohet sinqerisht e me ç'do sakrificije prej Italisë si një shok e bashkëpuntor e jo si vasall, as që të çiken, ose të shytohen[1] të drejtat e saja si Shtet, as që të përzjehet Italija në punët e brendëshme të sajat dhe kur dëgjoj si u suall italanët, i ardhi shumë keq dhe i çfaqi Duçes hidhërimet e tij, po si duket këjo e zembëroj Duçen dhe Pariani u vu në dispozicion, duke u larguar edhe nga kulltuku i ministrit sekretar të luftës dhe nga rangjet akoma të ushtërisë, duke u larguar në villën e tij në Italin' e sipërme. Po ardhi koha që politika e Jakomonit edhe ajo e Mellonit në Shqipëri falimentuan dhe ahere u shtërngua Duçja t'a sjellë Parijanin prej internimit në Romë e t'a dërgonjë si mëkëmbësin e Mbretit-Perandor në Shqipëri, duke i dhënë carta-bianca (letër të bardhë) të vepërojë në Shqipëri. Me këto mendime zbriti në Shqipëri gjenerall Pariani, e u mundua e po mundohet me gjithë fuqin' e tij të verë një regull e të sjellë qetësinë. Po mjerisht punët i gjeti shumë keq; e keqja kish përparuar mjaft, si një sëmundje epidemike, që përshkon tërë trupin. Ndofta të kish ardhur më parë do t'arrirë katastrofën që po i shkrepte Shqipërisë. Shumë njerës të dukshëm në lamën patriotike prej Shqiptarëve i ka thirur pranë e është këshilluar me ata. Edhe mua më ka ftuar gjer më sot 6 herë në pallat. Edhe tani që po shkruanj këto rreshta po vij prapë prej pallatit, ku më thiri e biseduam për mbi 1 e 1/2ore së bashkut, e ku i çfaqa sinqerisht pikpamjet e mija mbi ç'do problemë që më paravinte. Me fjalë të tjera unë i tregova shkurt këto pika për të mundur të ristabilizohet rregulli në Shqipërin' e shkatëruar prej kësaj anarqije :

I. Të bëhet një amnisti e përgjithëshme për të gjithë të dënuarit, për të internuarit e për ata që ndodhen nënë gjyq, si dhe për të arratisurit për faje politike.

II. Të forcohet e të ndihmohet në ç'do pikpamje gjendarmërija Shqiptare dhe të lijet e lirë në funksionimet e saj

III. Të mos përzihen në administratën Shqiptare as autoritetet ushtarake as ato civile, duke u larguar nga ç'do dikaster këshilltarët e përhershëm italjanë që kanë zëvëndësuar gjer sot qeverinë Shqiptare.

IV. Të sanksionohet an' e kant në zyrat Shqiptare gjuha Shqipe, si dhe korespondenca me Pallatin, si dhe me autoritetet e tjera italjane të bëhet në gjuhën Shqipe.

V. Gjyqi ushtarak dhe gjyqi politik special përsa u përket fajeve që bëjnë shqiptarët midis tyre, e që kanë një karakter militar ose politik, të gjykohen prej magjistratëve shqiptarë edhe në bazë të ligjeve Shqiptare në vigor[2], përveç atyre që kanë komplikim me ushtrinë italjane.

Këto edhe disa të tjera i propozova mëkëmbësit mik, generall Parianit, i cili dëgjoj me vëmëndje të thellë. Më tha, se të gjitha janë të mira e të arsyeshme, dhe me gjithë që edhe vetë gjeneralli është është i këtij mendimi, sot për sot ësht' e pamundur të zbatohen, se atmosfera politike është shum' e turbull. Unë, tha mëkëmbësi, ushqenj gjithë vullnetin e mirë që të vë në zbatim sa të mundem prej këtyre pikave që më shënuat, po dhe ju do kini durim e do të përpiqeni edhe nga ana e juaj që t'u vemë një kapak këtyre problemeve më fort për të mirën

[1] shytohen = cungohen (H. K.)
[2] vigor = fuqi (H. K.)

t’uaj e të Shqipërisë. Punët kanë ngelur krejt në vështirsin’ e tyre. Të ikurit sa më tepër shkon koha, aqe më tepër inkurajohen dhe frymëzohen me kuximin më të math që munt të bëhen. Ata më parë kërkonin ndihma fshehtazi e tërthorazi e tani agjentët e tyre të vijnin dita më drekë në zyrë, ose në shtëpi dhe të kërkojnë ndihma dhe as druhen as kanë frikë prej askujt! Një e keqe tjetër, që është një plagë e fëlliqur në zembrën e Shqipërisë është këjo, që jashtë atyre të ikurve që përpiqen për një ideal për Shqipërinë, janë edhe asijsh që përpiqen për xhepin e tyre edhe vetëm për këtë. Këjo s’është tjetër përveç se një kusari, një hajdutllëk.

V. O. Faqja pasardhëse është krejt e zbardhur, asaj i ka dalur boja e nuk lexohet gjë. Këtu përfundon volumi 3 (H. K.)

# Të nderuar trashëgimtarë të Kristo Floqit

Doktori në Drejtësi Kristo Floqi, ju ka lënë autobiografinë e tij me shkrim dore – pra është i pamanipulueshëm –, që ndodhet në Arkivën Qendrore Shtetërore në Tiranë me Nr. Fondi 429 Dok. 1. Ky dokument ka mbetur i mbyllur në Arkivë për 72 vjet rrjesht, mbuluar nga pluhuri i harresës. Sot, "Autobiografia ime" e Kristo Floqit po sheh dritën e botimit.

Rastësisht unë e gjeta në Arkivë këtë dokument prej 1788 faqesh në katër volume, dhe mbasi e lexova vendosa të blej nga Arkiva një kopje të saj, t'a transkriptoj në kompjuterin tim, duke e kopjuar rigorozisht ashtu siç e ka shkruar autori, dhe të botoj vetëm 3 volumet e para (sepse i katërti ka hollësira mbi disa ndolli të tija që i ka përshkruar më parë). Me këtë rast unë falenderoj gruan time Diana, si dhe kunatën time Ermira Shundi që më kanë nxitur dhe kanë sponsorizuar realizimin e këtij plani. Gjithashtu, falenderoj edhe Ansi Shundin për inkurajimin që më ka dhënë, si dhe për sponsorizimin e botimit të këtij libri.

Mendoj se ky libër është i dobishëm për ju sepse do të mësoni se kush kanë qenë para-ardhësit e juaj, si kanë jetuar ata, arritjet e tyre në jetë, të mirat e të këqijat që pësuan nga jeta, ndershmërinë e tyre, kontributin e tyre për shoqërinë Shqiptare, etj. Gjithashtu do të mësoni kontributet e Kristo Floqit si dramaturg, komediograf, gazetar, moralist, jurist, instrumentist, kritik veprash operistike, bashk-themelues i Federatës Pan-Shqiptare në Amerikë, por edhe si puntor i thjeshtë, etj., si dhe kontributet e tij në krijimin e Shtetit Shqiptar, Shtetit ligjor që aq shumë i kërkohet Shqipërisë sot. Gjithashtu. do të mësoni karakterin e tij të mirë, vullnetin e fortë për të bërë gjëra të mira për Kombin Shqiptar, duke n'a mësuar të sakrifikojmë gjithçka, edhe vehten, për të mirën e Atdheut. Në të vërtetë gjithë jeta e tij, deri në vdekje, është mbështetur në parimin "**Përpara së gjithash Atdheu**" që ka qenë deviza e tij e botuar në çdo numur të gazetës "Indipendenca e Shqipërisë" në vitin 1925, themeluesi, botuesi dhe redaktori i së cilës ka qenë Kristo Floqi.

Uroj që një ditë të botohen të gjitha veprat letrare e juridike të Kristo Floqit, komeditë, dramat, tragjeditë, vjershat, studimet e tija shkencore arkeollogjike të antikitetit, artikujt mbi drejtësinë, duke bërë të mundur kështu që ai të zerë vendin që i takon në literaturen artistike e juridike Shqiptare.

Gjithashtu, uroj që një ditë të botohen edhe veprat e tija madhore "**E Drejta Themelore ose Konstitucionale**" botuar në prill 1920, ku bëhet një trajtim shkencor i parimeve kryesore për hartimin e një Kushtetute të vendeve të qytetëruara, parime që i përmbajnë të gjitha Kushtetutat e vendeve të Bashkimit Europian, por që pjesa themelore e saj i mungon Kushtetutës së sotme të Shqipërisë, si dhe vepra tjetër e tij "**Administrata ose e drejta sunduese**", ku përshkruhet organizimi i administratave vendore të shumicës së vendeve të qytetëruara të Europës, duke i rekomanduar Shtetit Shqiptar të zgjedhë njërin prej tyre për organizimin e administratës vendore të Shtetit Shqiptar. E përbashkët në këto dy kryevepra të tij është koncepti i decentralizimit të Shtetit Shqiptar.

Së fundi, ju duhet të jeni krenarë që jeni trashëgimtarët gjenetikë të Kristo Floqit.

**Henrik Kaçulini**

Tiranë, Prill 2022